AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
BOTIME TË VEÇANTA CXXXIII
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE
LIBRI 44

PAJAZIT NUSHI

LEKSIKON I PSIKOLOGJISË

Vëllimi I

A-M

PRISHTINË
2014

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SPECIAL EDITIONS CXXXIII
SECTION OF SOCIAL SCIENCES
BOOK 44

PAJAZIT NUSHI

LEXICON OF PSYCHOLOGY
Volume I
A-M

Approved for publication at the meeting of the Section of Social Sciences,
held on 20th March, 2014, after review by
academician Ekrem Murtezai and prof. dr. Neki Juniku.

Editor: Academician Mark Krasniqi, Secretary of Section of Social Sciences.

PRISHTINA
2014

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
BOTIME TË VEÇANTA CXXXIII
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE
LIBRI 44

PAJAZIT NUSHI

LEKSIKON I PSIKOLOGJISË

Vëllimi I

A-M

U miratua për botim në mbledhjen e Seksionit të Shkencave Shoqërore,
mbajtur më 20 mars 2014, në bazë të recensioneve të
akademik Ekrem Murtezait dhe prof. dr. Neki Junikut.

Redaktor: Akademik Mark Krasniqi, Sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore.

PRISHTINË
2014

Copyright © ASHAK

PARATHËNIE

Nga fjala në fjalor dhe nga fjalori te "Leksikoni i psikologjisë" do të ishte shprehja më e përshtatshme për të treguar veçanërisht rrugën e gjatë të hartimit të "Leksikonit të psikologjisë". "Leksikoni i psikologjisë" në ndryshim nga fjalorët psikologjikë përmban informacione bashkëkohore shkencore për konceptet a nocionet e psikologjisë dhe emrat e personaliteteve të njohur nga rezultatet e gjurmimeve të rëndësishme të tyre. Për këtë arsye u desh një punë sistematike për një periudhë relativisht të gjatë kohore në hartimin e këtij leksikoni; u desh rreth një gjysmë shekulli punë me ritmikë kohore të ndryshme për mbledhjen e fjalëve nga literatura popullore e gjuhës shqipe dhe ajo profesionale e shkencore e karakterit terminologjik për proceset shpirtërore, psikike dhe për sjelljet e njeriut, si edhe për aktivitetin e kafshëve, përzgjedhjes së fjalëve-terma, përcaktimit të kuptimit të tyre, sistemimit e paraqitjes leksikografike të termave të shndërruar në zëra të këtij Leksikoni. Preokupimi dhe angazhimi i drejtpërdrejtë në aktivitetin terminologjik kushtuar vetëm psikologjisë ka qenë pothuajse i përhershëm që nga vitet `60 të shekullit njëzet. Për këtë shkak "Leksikoni i psikologjisë" është fryt i një aktiviteti intelektual përreth pesëdhjetë vjet. Ndërsa "Fjalori i psikologjisë" i vitit 1987 ka qenë më tepër një fjalor i psikologjisë për nevoja të përgjithshme diturore, sidomos për nevoja didaktike dhe mësimore, "Leksikoni i psikologjisë" synon plotësimin e nevojave universitare, profesionale dhe shkencore të psikologjisë bashkëkohore. Për këdo që ndjen nevojën e thellimit të kulturës psikologjike në këtë leksikon mund të gjejë rekomandime për studimin e veprave të psikologjisë, aktualisht veprave themelore të saja.

PSIKOLOGJIA BASHKËKOHORE DHE "LEKSIKONI I PSIKOLOGJISË"

Zhvillimet intensive të disiplinave të sistemit të shkencave të psikologjisë në gjysmën e dytë të shekullit njëzet e më tej u reflektuan edhe në zhvillimet leksikologjike dhe enciklopedike të mendimit psikologjik. Të tilla zhvillime u dalluan posaçërisht në arritjet e psikologjisë kognitive, të psikologjisë fiziologjike, psikologjisë sociale dhe psikologjisë klinike e psikopatologjisë. Këto ndryshime kanë prekur në mënyrë të veçantë raportet ndërmjet sistemit të koncepteve e termave përkatës të disiplinave të përmendura dhe të biopsikologjisë, somatopsikologjisë dhe psikiatrisë. Shumë terma të koncepteve të psikologjisë u plotësuan me informacione të reja dhe me lidhje të posaçme ndërmjet tyre. Kështu, termi *diskriminim* në psikologjinë sociale ka kuptimin e mospërfilljes ndaj tjetrit, që i përket gjinisë, etnisë, kombit dhe racës tjetër, kurse në psikologjinë e perceptimit kuptimi i këtij termi ka të bëjë me aftësinë e dallimit të

diferencave më të vogla ndërmjet objekteve e cilësive, si edhe të raporteve ndërmjet tyre. Në rastet e këtilla diferencat i japin kuptim të plotë perceptimit të objekteve të caktuara. Shumë prej termave e ruajtën leksemën e tyre edhe në shqipe, por ndryshuan kuptimin e tyre. Për këtë arsye këto terma u bënë të pavlefshëm për të emërtuar tërësisht konceptet e psikologjisë bashkëkohore. Përfundoi "jeta" e termave të vjetër, shumë të tjerëve iu ndryshua kuptimi i brendshëm i tyre. U krijuan koncepte a nocione të reja me emërtimet përkatëse gjuhësore. Fjalët e psikologjisë popullore shqipe me kuptimin e vjetër të tyre, por të shndërruara në terma e zëra leksikologjikë, si: *besimi, mëshira, shpirti* etj. gjithnjë e më pak po gjejnë përdorim në literaturën e psikologjisë së sotme. Ndërkaq, termat e rinj: *inteligjenca artificiale, kujtesa implicite, mendimi konvergjent, neurotransmetuesit, psikoleksikologjia, terapia e drejtuar mbi pacientin* etj. gjithnjë e më shumë gjejnë përdorim në literaturën e psikologjisë e më gjerë.

Këto ndryshime treguan se edhe termat e psikologjisë kanë "jetën" e tyre: lindin, zhvillohen, vjetrohen dhe "vdesin" duke u bërë të papërdorshëm në psikologjinë bashkëkohore e më gjerë. Jeta e tyre kryesisht zgjat rreth një dekadë dhe më pas botimet terminologjike i përkasin historisë. Kjo ndodh sidomos në mjediset me nivel të lartë të traditës shkencore e terminologjike.

Gjithë këto ndryshime krijuan në njërën anë, jo aktualitetin e fjalorëve, të leksikonëve dhe të enciklopedive të psikologjisë të botuar në dy-tri dekadat e para të gjysmës së dytë të shekullit të kaluar, dhe në anën tjetër, parashtruan kërkesën e hartimit të botimeve terminologjike bashkëkohore. E njëjta mund të thuhet edhe për "Fjalorin e psikologjisë", 1987, botuar nga Instituti Albanologjik i Prishtinës. Megjithëkëtë, "Fjalori i psikologjisë" dhe kartoteka e fjalëve dhe e termave të tij, e plotësuar, e shtuar dhe e përditësuar vazhdimisht ka hapur rrugën e hartimit të botimit të ri leksikologjik të psikologjisë. Këtë rrugë të gjatë po e përfundojmë me përgatitjen e veprës "Leksikoni i psikologjisë".

"LEKSIKONI I PSIKOLOGJISË" DHE VEÇORITË E TIJ

Siç e përmendëm "Leksikoni i psikologjisë" është një vepër më e gjerë dhe e plotë se fjalori, jo vetëm për nga numri i zërave, por edhe nga trajtimi semantik dhe gjuhësor bashkëkohor i tyre, si edhe nga përfshirja e personaliteteve që kanë lënë gjurmë në historinë e psikologjisë. U përgatit në kushte, rrethana dhe raporte zhvillimore të veçanta të zhvillimit të psikologjisë dhe të mendimit psikologjik. Në përputhje me to ndryshon shumë nga fjalori i mëparshëm, si nga synimi, ashtu edhe nga ana sasiore, nga përmbajtja e zërave, si dhe nga mënyra e trajtimit të tyre.

Me synimin gjithëpërfshirës të termave të psikologjisë dhe me trajtimin semantik dhe gjuhësor bashkëkohor të tyre ky Leksikon pretendon të jetë sa më lart shkencërisht dhe profesionalisht, në krahasim me "Fjalorin e psikologjisë". Këto synime dallohen në disa nga veçoritë a karakteristikat e këtij Leksikoni.

Në hartimin e "Leksikonit të psikologjisë" u ndoq ky parim: gjetja dhe paraqitja shpjeguese e koncepteve dhe termave, përkatësisht e zërave të tyre, që kanë të bëjnë me teoritë, drejtimet dhe shkollat psikologjike, si të disiplinave teorike, ashtu edhe të

atyre zbatuese dhe me sistemin konceptual të tyre. Këtij qëllimi i është nënshtruar i tërë aktiviteti gjatë hartimit të tij. Sipas këtij qëllimi u përzgjodhën zërat e Leksikonit, u shpjegua kuptimi i tyre dhe u krye renditja sipas rendit alfabetik në gjuhën shqipe.

Leksikoni përmban një fjalës (termës) me afër 5000 zëra, (2543 në vëllimin e parë dhe 2457 në vëllimin e dytë). Nga këta zëra 172 sosh janë zëra personalitetesh, të cilët krijuan historinë e psikologjisë dhe të zhvillimit të mendimit psikologjik përgjithësisht dhe atë të shqiptarëve në veçanti. Për këto personalitete është shkruar biografia e shkurtër dhe veprimtaria shkencore e profesionale e tyre. Ndërkaq, numri i autorëve dhe veprave të cituara të tyre është 516.

Përmbajtja e leksikonit u nda në dy Vëllime. Vëllimi i parë shtrihet prej shkonjës A deri në shkonjën M duke përfshirë edhe tekstet paraprake. Në vëllimin e dytë janë tekstet e zërave që fillojnë nga shkronja N dhe përfundojnë me shkronjën Zh përfshirë edhe përmbajtjen e teksteve "Dokumente"

Për hartimin e Leksikonit është vjelë lëndë e gjerë leksikore-terminologjike. Në mënyrë të veçantë janë nxjerrë terma nga literatura e psikologjisë. Përmbajtja e zërave të nxjerrë nga literatura është krahasuar me përmbajtjen e tyre në fjalorë, leksione dhe enciklopedi të fushës përkatëse. Rreth informacioneve të dala nga ky krahasim dhe relacioneve ndërmjet tyre u arrit në një përgjithësim të domethënies së zërave të këtij leksikoni. Referencat e autorëve e të veprave prej nga janë vjelë termat kryesorë janë dhënë në gjuhën origjinale dhe të përkthyer në gjuhën shqipe; këto janë dhenë në përfundim të shtjellimit të përmbajtjes së zërave kryesorë.

Kuptimi i numrit më të madh të zërave është shpjeguar sipas modelit sintetik, gjenetik e përgjithësues. Sipas këtij modeli është bërë diferencimi i zërave në zëra të vegjël (deri në 5 rreshta), të mesëm (deri në 15 – 35 rreshta) dhe në zëra të mëdhenj (mbi 35 rreshta). Kategorisë së zërave të vegjël i përkasin zërat: "*Maktli*", "*Sinkretizim*", "*Kujtesa Gjenetike*" etj.; Të kategorisë së mesme janë zërat: "*Harresa*", "*Interiorizim*", "*Kleptomania*" etj.; Kategorisë së zërave të mëdhenj i përkasin zërat: "*Bihejviorizëm*", "*Historia e psikologjisë*", "*Personaliteti*" etj.. Përmbajtja e zërit ka përcaktuar shtrirjen grafike të tij, prandaj kufiri i shtrirjes së përmbajtjes së zërave është relativ. Qëllimi ka qenë shpjegimi i zërit duke përfshirë informacionet e përgjithshme, të domosdoshme dhe karakteristike të secilit zë, si edhe lidhjet thelbësore ndërmjet tyre. Pavarësisht nga madhësia e zërave synuam hartimin e secilit zë si tërësi të ngjeshur informacionesh dhe tërësi koherente mendimesh e qëndrimesh. Shpjegimi konciz i zërave i është nënshtruar në radhë të parë dhe para së gjithash shtjellimit të përmbajtjes së secilit e jo formës së shkurtër, të mesme dhe të gjatë, a të madhe të paraqitjes formale grafike të zërave.

Përmbajtja e zërave kryesorë të psikologjisë ka përmasë etimologjike. Kjo ka të bëjë me prejardhjen gjuhësore të zërit, me përkufizimin e përmbajtjes, me kohën e shfaqjes së tij në historinë e mendimit psikologjik dhe, atu ku ka qenë e mundur, me emrin e autorit të atij zëri. Etimologjia e tyre, përpos të tjerash, lë të kuptohet se në gjuhën shqipe shumë zëra të psikologjisë e kanë rrënjën burimore nga disa gjuhë të huaja (greqishtja, latinishtja, anglishtja, frëngjishtja, gjuhët sllave etj.).

Nga burimi gjuhësor i zërave del një karakteristikë e posaçme e Leksikonit. Në fillim të zhvillimit të psikologjisë këta zëra u morën nga latinishtja e greqishtja,

kurse më vonë nga gjuhët romane (frëngjishtja e italishtja), e më pas nga anglishtja. Por rrugët e depërtimit të këtyre zërave në terminologjinë shqipe të psikologjisë kanë qenë të ndryshme. Në terminologjinë shqipe të psikologjisë zërat me origjinë nga gjuhët e huaja nuk kanë hyrë në shqipe domosdoshmërisht dhe drejtpërdrejt nga gjuha burimore e tyre; shumë prej tyre kanë hyrë në shqipe nga një gjuhë tjetër. Kjo çështje mbetet ende të shqyrtohet.

Parimi i paraqitjes së zërave sipas rendit të shkronjave të alfabetit të gjuhës shqipe copëzoi termat e lidhur me fjalën "kyçe" të tyre. Kështu, në vend që nën zërin *Kujtesë* të renditeshin *Llojet e kujtesës*, *Baza neurofiziologjike, teoritë e kujtesës* etj., zëri *llojet e kujtesës* është renditur në shkronjën Ll, *baza neurofiziologjike e kujtesës* është renditur nën shkronjën B dhe *Teoritë e kujtesës* janë renditur në shkronjën T; në vend që të shtjellohej pas zërit *Personaliteti* zëri *Teoritë e personalitetit*, ky i fundit është renditur në shkronjën T etj. Mendojmë dhe shpresojmë se përdoruesve të këtij Leksikoni kjo mënyrë e strukturimit të zërave nuk do t'u sjellë vështirësi.

Klasikët e psikologjisë dhe studiuesit e parë shqiptarë të psikologjisë përbëjnë pjesën e posaçme të Leksikonit, që në mënyrë përmbajtjesore është integruar në tërësinë e përmbajtjes së tij. 172 klasikët dhe studiuesit e psikologjisë janë paraqitur me të dhënat elementare biografike për secilin, kurse vëmendja më e madhe i është kushtuar qëndrimeve, pikëpamjeve dhe kontributit të tyre në zhvillimin e psikologjisë dhe të mendimit psikologjik. Për secilin nga klasikët dhe nga studiuesit e parë shqiptarë është dhënë burimi origjinal i veprave të botuara në gjuhën e tyre përkthyer në gjuhën shqipe. Ndër klasikët e psikologjisë u përzgjodhën ata që i kanë kontribuar zhvillimit të psikologjisë dhe kanë bërë emër në historinë e psikologjisë botërore. Ndërkaq, ndër studiuesit e psikologjisë u përzgjodhën ata që kanë kontribuar në zhvillimin e psikologjisë ndër Shqiptarët. Studiuesit klasikë të psikologjisë ndër shqiptarët janë 15 autoritete. Nga këtu, studiuesit e historisë së mendimit psikologjik mund të merren me çështjen e gjenezës së mendimit psikologjik të përgjithshëm dhe të gjenezës së mendimit psikologjik ndër shqipfolësit, sidomos me gjurmimet e lidhjeve ndërmjet tyre. Ky studim do t'i shërbejë njohjes së vetëdijes kulturore e shkencore për veten tonë, për të tjerët dhe për të gjithë humanistët.

Nga antropologjia, biologjia, filozofia, fiziologjia, psikiatria u morën në shqyrtim dhe u shpjeguan zërat me theks psikologjik të rëndësishëm. Për këtë lloj leksikoni të psikologjisë bashkëkohore zërat e psikologjisë popullore u menduan si të tepërt, prandaj shumë prej tyre nuk arritën të gjejnë vend në përmbajtjen e tij.

Si çdo leksikon tjetër, ashtu edhe ky ka përmasa të caktuara të ndërthurjeve të zërave me lëndë domethënëse të njohur nga fjalorët e leksikonët e deritashëm. Kjo përmasë është gati paqenëse në zërat e mendimit psikologjik shqiptar.

Zërat nga psikologjia fiziologjike dhe statistika janë shoqëruar me ilustrime përkatëse (grafikë, foto, skica, skema, tabela etj.). Në fund të përmbajtjes së Leksikonit janë dhënë disa regjistrime karakteristike: *Treguesi alfabetik i zërave, Treguesi alfabetik i autorëve dhe Treguesi i termave në gjuhë të huaja*, të përdorur si terma burimorë, *Ndryshimet zhvillimore më të rëndësishme të psikologjisë deri në fund të shekullit XX, Fillet e mendimit psikologjik dhe ndryshimet zhvillimore të psikologjisë ndër Shqiptarët deri në fund të shekullit*

XX, Vështrim përgjithësues i shkollave të psikologjisë dhe i sistemeve konceptuale të tyre, Pasqyra e përgjithshme e fobive të thjeshta dhe *Treguesi i lëndës.*

Përmbajtja e tërësishme e Leksikonit ka një fije ngjyrese kombëtare. U përzgjodhën dhe u shpjeguan zërat karakteristikë për shqipfolësit dhe zërat nga zhvillimi historik i mendimit psikologjik ndër Shqiptarët. Zëra të këtillë janë: "*Zhvillimi i psikologjisë ndër shqipfolësit*", "*Psikikë*" dhe "*Psikologji*" etj. Krahas tyre hasen një varg përcaktimesh karakteristike për Shqiptarët në shpjegimet e disa zërave psikologjikë. Pjesa e studimeve të para shqiptare të psikologjisë flet për ngjyrimin kombëtar të përmbajtjes së këtij Leksikoni që nga burimet e zërave të parë të tij. Por, në këtë pikëpamje "Leksikoni i psikologjisë" në gjuhën shqipe nuk dallohet nga botimet e ngjashme të popujve të tjerë.

Në mbyllje, mirëpres vërejtjet e sugjerimet e lexuesve, studiuesve dhe përdoruesve të këtij Leksikoni, që do të shërbejnë për përmirësimin e kësaj vepre në ndonjë ribotim të përditësuar e të plotësuar në të ardhmen.

Autori, Prishtinë më 26 tetor 2013

FALËNDERIME

Kjo vepër ka një autor nga Prishtina dhe një redaktore nga Tirana; falë këtij fakti është ruajtur një stil i përbashkët dhe i qëndrueshëm në përmbajtjen e krejt Leksikonit. Megjithëkëtë, në hartimin e Leksikonit të Psikologjisë u mor mendimi i gjuhëtarëve, i psikologëve, i psikiatërve dhe i terminologëve. Falënderime të posaçme u drejtohen:

Akademik Idriz Ajetit, pedagog i gjuhës shqipe në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës (në pension); akademik Rexhep Ismajlit, pedagog i lëndës Gjuhësi e përgjithshme dhe Histori e gjuhës shqipe në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës (në pension); akademik Ekrem Bashës, letrar; prof. dr. Nuri Abdiut, pedagog i psikologjisë në Universitetin e Tiranës; prof. dr. Myqereme Rusit, pedagoge e psikologjisë në Universitetin e Tetovës; prof. as. dr. Vilma Prokos, kërkuese shkencore në Qendrën e Enciklopedisë Shqiptare të Qendrës së Studimeve Albanologjike, Tiranë, Ph. D. c Ali Cakës, pedagog i lëndëve Gjuhësi kompjuterike dhe Informatikë në Fakultetin Filologjik, të lëndëve Informatikë e Resurse gjuhësore dhe Shkrim akademik e Kulturë gjuhe në programin AKM të Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Prishtinës për përkushtimin në lektorimin dhe redaktimin shkencor, gjuhësor e teknik të përmbajtjes së Leksikonit; prof. dr. Agron Duros, gjuhëtar-terminolog në Departamentin e Leksikologjisë dhe të Terminologjisë në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë të Qendrës së Studimeve Albanologjike, Tiranë (në pension); prof. dr. Violeta (Rizvanolli) Nushit, pedagoge e konstruksioneve arkitektonike në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës të Universitetit të Prishtinës, për ndihmesën sistematike në ilustrimet cilësore të një numri zërash; Barbana Nushit, studente e shkencave juridike, për kontributin në përkthimin e literaturës nga anglishtja në shqipe.

Falënderime të veçanta i drejtohen Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës për miratimin e propozimit të Seksionit të Shkencave Shoqërore për botimin e "Leksikonit të Psikologjisë", si dhe ekipit profesional të ASHAK.

LISTA E SHKURTIMEVE DHE SHKURTESAVE

ACTH	adrenokortikotropinë
AGCT	A(rmy) G(eneral) C(lasification) T(est) – Testi i Përgjithshëm Klasifikues i Armatës
AIDS	Sindroma Retrovirusore e Shkaktuar nga HIV-i
AND	Acidi Dezoksiribonukleik
APA	A(merican) P(Sychological) A(sociation) = Shoqata e Psikologëve Amerikanë
ARN	Acidi Ribonukleik
asnj	asnjanëse (gjini)
Asortmenti Q	Përzgjedhje e tipareve të personalitetit sipas teknikës Stivenson dhe K. Roxhers
bit	binary digit
CA	hipokampusi
DSM4	Doracak Diagnostikues e Statistikor i Çrregullimeve Mendore i Shoqatës së Psikologëve Amerikanë
db (dB)	decibel
EKG	elektroencefalogramë
EPPA	Bashkësia Europiane e Shoqatave Kombëtare të Psikologëve
e.r.	era e re
ERG	E(xistence), R(elatedness), G(routh) = Ekzistencë, Farefisni, Rritje
f.	femërore (gjini)
gesh	geshtalti(zmi)
Gj	Faktori i Përgjithshëm i Inteligjencies
Hz	herc
I	intensiteti
IQ (KI)	Koeficienti i Inteligjencies
M	Faktori i kujtesës
Ma	Mesatarja aritmetike
m.	mashkullore (gjini)
mb.	mbiemër
m mb	mekanizëm mbrojtës
mm	mosha mendore

mk	mosha kalendarike
MMPI	(M)inessota (M)ultiphasic (P)ersonality (I)nventory = Inventari Multifazor i Minesotos për Personalitetin
MMQ	Mausdley Personality Questionary = Fletëpyetës për Personalitetin e Shmangur
N	Faktori Numerik i Aftësive Parësore
nm	nanometër
NREM	N(on) R(apid) E(yes) M(ovement) = Lëvizje Jo e Shpejtë e Syve
O	Simbol për organizmin
P	Faktori perceptues
PEN	P(sikotizmi), E(kstraversioni), N(eurotizmi)
P+	Personalitet me organizim tiparesh pozitive, të mira
P-	Personalitet me organizim tiparesh negative, të këqija
p.e.r.	para erës së re
Q	Shmangia kuartile
R	Faktori i rezonimit
REM	R(apid) – E(yes) – M(ovement) = Lëvizje e Shpejtë e Syve
S	Faktori hapësinor
S – O – R	Stimul – Organizëm – Reagim
S Q 3 R	Survey – Question – Read – Recite – Review = Vështroj – Pyes – Lexoj – Përsëris – Rishikoj
Shën.	shënim
Shkalla A – S	Shkalla e antisemitizmit
Shkalla M – F	Shkalla matëse e mashkulloritetit dhe e feminilitetit
shkurt.	shkurtesë
T A T	Thematic Aperception Test = Test i Tematikës Aperceptive
TOTE	Test – Operate – Test – Exit = Test – Veprim – Test – Dalje
V	Faktori verbal (i të folurit)
W	Faktori i të folurit të rrjedhshëm

A

ABAZI, - A. f. Term i psikiatrisë dhe i psikopatologjisë i ardhur nga greqishtja *a* "parashtesë mohimi" dhe *βασία* "hap, ecje", që nënkupton humbjen e aftësisë së të ecurit. Abazia është çrregullim funksional, në të cilin lëvizja e secilës këmbë dhe e dy këmbëve është e ruajtur, por kjo nuk i nënshtrohet kontrollim nga ana e atij që vuan nga abazia. Shkaktohet nga lëndimi i trurit të vogël ose i pjesës ballore të trurit të madh; me këtë rast njeriu humb aftësinë e koordinimit të lëvizjeve të këmbëve. Abazia mund të shkaktohet edhe nga faktorët psikogjenë: frika e trishtimi i papritur dhe i shkallës së lartë mund të jetë simptomë e histerisë.

ABDIU Nuri. Psikolog. Lindi në Sohodoll të Dibrës më 1.02.1930 dhe vdiq më 29.04.2014. Kreu studimet e larta për pedagogji dhe psikologji në Universitetin e Moskës më 1958. U doktorua në fushën e historisë së mendimit psikologjik shqiptar. Profesor i psikologjisë në Institutin e Lartë Pedagogjik të Shkodrës; drejtues i Departamentit të Psikologjisë në Universitetin UFO, në Tiranë; nënkryetar i Shoqatës Mbarëshqiptare të Psikologëve. Është konsulent botimi i revistës shkencore "European Psychologist". U mor me studimin e zhvillimit të mendimit psikologjik shqiptar nga kohët e lashta deri më 1985. Lidhur me këtë fushë ka botuar shumë trajtesa, artikuj dhe vepra psikologjike. Ndër trajtesat psikologjike dallojmë: "*Zhvillimi dhe formimi i perceptimit dhe vrojtimit*", 1966; "*Shënime mbi ndjenjat dhe emocionet*", 1967; "*Rreth interesave për lexim tek nxënësit e kl. IV të ciklit të ulët të shkollës 8-vjeçare*", 1972, "*Shënime për Pjetër Bogdanin dhe kontributin e tij në mendimin psikologjik në shekullin XVII*", 1973; "*Psikologjia" e Hasan Tahsinit – dokument me vlerë për historinë e mendimit psikologjik shqiptar*", 1979; "*Aspekte psikologjike e social-psikologjike në veprat e Luigj Gurakuqit*", 1980 etj. Është bashkautor i teksteve shkollore të psikologjisë: "*Psikologjia parashkollore*" (Maket), 1972; "*Psikologjia parashkollore*" (për shkollat e mesme pedagogjike, 1972, 1985); "*Çështje të psikologjisë për shkollat e larta*" (përmbledhje materialesh për seminare), 1973 etj. Ndër veprat kryesore: *"Bibliografi e*

A

punimeve psikologjike e për psikologjinë të botuara në vendin tone para dhe pas çlirimit deri më 1985", 1986; *"Kontribute themelore në historinë e mendimit psikologjik shqiptar deri më 1939",* 2002; *"Psikologjia e Hasan Tahsinit",* 2007.

ABDUKCION, - I. m. Term i anatomisë dhe i fiziologjisë i ardhur nga latinishtja *abduktio*, që emërton largimin anash të gjymtyrëve të trupit në raport me vijën e mesme e tij. Abdukcioni ka edhe kuptim të veçantë në psikologjinë kognitive. Me këtë term emërtohet përgjithësimi i hipotezave në mbështetje të fakteve të njohura dhe të lidhjeve ndërmjet tyre. Konsiderohet se është komponent themelor i mendimit krijues. Me këtë kuptim e ka përdorur mendimtari amerikan Çarls S. Pirs (Charles S. Peirce, 1839 – 1914).

ABERACION, - I. m. Term i përgjithshëm i ardhur nga latinishtja *aberration* "bredh", që paraqet dukurinë e shmangies së procesit, të sjelljes, të veprimit nga rendi dhe rrjedha normale e zhvillimit të tyre. Ky kuptim ka shtrirje të gjerë në fiziologji dhe në psikologjinë fiziologjike, sepse emërton shmangien e zhvillimit të trupit të njeriut dhe të strukturave të tjera të tij nga zhvillimi normal i tyre. Kështu, aberacioni kromozomik është shmangie e zhvillimit të strukturave të kromozomeve, duke shkaktuar ndryshime në sasinë numerike të kromozomeve (në vend që të dy zhvillohen tri kromozome, mund të dyfishohen, ta ndryshojnë vendin e tyre etj.).

ABERACIONI KROMATIK. Thyerje e pabarabartë e rrezeve të dritës me gjatësi valësh elektromagnetike të ndryshme, kur këto kalojnë nëpër lentën e syrit. Për këtë shkak shfaqet spektri i ngjyrave kromatike prej rreth 380 nanometër deri në 740 nanometër.

ABERACIONI SFERIK. Paraqitja e shtrembëruar e figurës së një objekti për shkak të thyerjes së padrejtë të rrezeve të dritës ose të zhvillimit të çrregullt të lentës së syrit.

ABIOGJENEZ/Ë, - A. f. Term i zhvillimit evolutiv i ardhur nga përngjitja e fjalëve greke *a* "jo", *βιο* "jetë" dhe *γένεση* "lindje". Abiogjeneza është lindja e gjallesave nga materiali jo i gjallë, të cilën e formuloi biologu Tomas Henri Haksli (Thomas Henry Huxley, 1825 – 1895) për të shpjeguar procesin e lindjes së jetës. Ka ushtruar ndikim edhe në zhvillimin e disa pikëpamjeve për zhvillimin e jetës shpirtërore.

ABLACION, - I. m. Term i kirurgjisë dhe i psikologjisë fiziologjike, i neuroropsikologjisë, që paraqet një teknikë kërkimore, me anën e së cilës hiqet në mënyrë kirurgjikale pjesa e një strukture të organizmit, zakonisht të një pjese të qendrës motorike, të receptorit etj., me qëllim hulumtimin e lidhjes funksionale që ka ajo pjesë e shkolitur me proceset e caktuara psikike dhe me sjelljet e veçanta të njeriut. Kjo teknikë u zbatua sidomos në gjurmimet e përmendura te kafshët.

ABLEPSI, – A. f. Term i ardhur në psikopatologji nga bashkërenditja e fjalëve të greqishtes *a* "parashtesë mohuese" dhe *βλέπειν* "shoh". Ablepsia është verbimi psikik dhe karakterizohet nga përqasja që i bëhet një dukurie, objekti, procesi etj., duke mos i parë përbërësit dhe lidhjet e rëndësishme ndërmjet tyre, si dhe me

dukuritë, objektet dhe me proceset e tjera. Posaçërisht theksohet pamundësia e të parit të lidhjes së shkakut paraprak me pasojën e atij shkaku.

ABNORMAL, - E. mb. I ardhur nga latinishtja *ab* "parashtesë mohuese" dhe *normalis* "normale", me kuptim shtrirës të madh që përcakton një zhvillim jonormal, të parregullt, jo të natyrshëm. Shprehimisht do të thotë që ajo shmanget nga zhvillimi normal, nga zhvillimi i procesit dhe i sjelljes normale, i sjelljes së shmangur nga norma e caktuar.

ABREAGIM, - I. m. Term i të folurit të zakonshëm dhe i psikanalizës. Në kuptimin e përgjithshëm emërton shkarkesën emocionale nëpërmjet përjetimit rishtas të një gjendjeje stresuese, çlirimin e energjisë psikike të lidhur me përmbajtjen e një konflikti të brendshëm. Në psikanalizë emërton zbrazjen e energjisë afektive që dikur ka ndikuar në lindjen e një sjelljeje jonormale, duke rikujtuar situatat e shtypura, të ndrydhura dhe duke i lidhur këto me çlirim të energjisë psikike, që ka qenë e lidhur me ndonjë përjetim traumatik. Abreagimi ndaj këtyre situatave shkakton çlirimin e njeriut nga ngarkesa emocionale e rëndë dhe nga sjellja jonormale e tij.

ABSENCI, - A. f. Term i psikiatrisë dhe i psikopatologjisë i ardhur nga latinishtja *absens* "mungon", që emërton formën e sulmeve të vogla epileptike të njohura me termin latin *absentia epileptika*, përkatësisht te forma epileptike e njohur si *petit mal*. Manifestohet me errësirën e përkohshme të vetëdijes. Vihet re edhe te ata që vuajnë nga histeria.

ABSOLUT, - E. mb. I ardhur nga latinishtja *absolutes* "i pakufizuar, i mëvetësishëm". Në psikologji përdoret i lidhur me subjektin e caktuar, si pragu, mendimi, vendimi absolut etj. Shih – ***PRAGU ABSOLUT I NDIJIMIT.***

ABSORBIM, - I. m. Term i fizikës dhe psikologjisë fiziologjike, që në shqip ka sinonimin përthithje. Kështu absorbimi i dritës do të thotë përthithje e dritës. Shih – ***PËRTHITHJA.***

ABSTRAKT, - I. m. Në literaturën shkencore është përmbledhje e shkurtër e përmbajtjes së një punimi shkencor. Abstrakti në punimet shkencore jepet në fillim të punimit, duke fokusuar edhe termat e koncepteve kryesorë që janë trajtuar në këtë punim. Sot punimet e mirëfillta shkencore nga psikologjia, por jo vetëm nga psikologjia, kanë edhe tekstin paraprijës të përmbajtjes së gjerë të atij punimi – tekstin e abstraktit.

ABSTRAKTIM, - I. m. Term i psikologjisë kognitive i ardhur nga latinishtja *abstraction* "ndarje, shkëputje". Ndarje mendore e një cilësie, e një komponenteje, e një ane etj. nga konkretja, përkatësisht nga objekti, dukuria, procesi real. Abstraktimi është procesi mendor i ndarjes së cilësive të njërës anë, raporteve dytësore, të rastësishme dhe sipërfaqësore të një ose disa objekteve, dukurive, proceseve dhe situatave nga ato parësoret, thelbësoret dhe të domosdoshmet e atij objekti ose të asaj klase objektesh, dukurish, procesesh, situatash etj., me qëllim të formimit të koncepteve të caktuara. P.sh., "patriotizmi" është koncept abstrakt, i ndarë nga patrioti dhe nga situata konkrete e manifestimit të patriotizmit

A

nga ana e tij. Ky koncept është produkt mendor i abstraksionit.

ABULI, - A. f. Term i psikopatologjisë i ardhur nga greqishtja *a* "jo" dhe *βουλιψία* "vullnet", që ka të bëjë me mungesën e vullnetit. Abulia shfaqet me mungesë gatishmërie për të marrë vendim dhe për të kaluar në realizimin konkret të tij. Dëshira dhe synimi për të filluar aktivitetin nuk kanë humbur, por është e pranishme dukuria patologjike e mungesës së vullnetit, shpesh e shoqëruar me paaftësi të marrjes së vendimit për të nisur një veprim, një punë**.**

ABUZIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *abutere* "shpërdoroj"; është term i shkencave juridike. Në psikologji me termin abuzim emërtohet kuptimi i marrjes përtej masës të alkoolit, të medikamenteve apo barnave, madje edhe drogave. Sot kuptimi i këtij termi është shtrirë më gjerë, duke përfshirë edhe keqpërdorimin e fëmijëve nga ana e prindërve ose kujdestarëve, si dhe nga ana e të tjerëve**.**

ACARIM, – I. m. I ardhur nga latinishtja *irritation* "ngacmim", që përfaqëson vetinë e organizmave të gjallë për të reaguar ndaj ngacmuesve. Me këtë kuptim acarimi është shumë i shprehur sidomos në qelizat nervore të organizmit. Në gjuhën shqipe acarimi përdoret edhe me kuptimin e ndjeshmërisë së lartë emocionale (zgjim i ndjenjës së hidhërimit, mërisë, zemërimit etj., ndaj ngacmuesve të posaçëm).

ACETILKOLINË, - A. f. Derivat i kolinës; lloj transmetuesi, i cili sekretohet në sinapset neuromuskulare, në ganglionet e sistemit nervor autonom dhe në pasganglionet fijezore të pjesës së tij parasimpatike. Kryen funksionin e bartjes së impulseve nervore nga qelizat nervore në qeliza të tjera nervore dhe nga këto në muskujt skeletorë dhe në muskujt e organeve të brendshme dhe të enëve të gjakut. Këta muskuj kanë lidhje me fijezat nervore të sistemit parasimpatik. Acetilkolina gjendet në fushat e ndryshme të sistemit nervor qendror, ku luan rol të rëndësishëm në neurofiziologjinë e kujtesës. Shënohet me shkurtesën Ach**.**

ACIDI DEZOKSIRIBONUKLEIK (ADN). Lëndë makromolekulare natyrore që përbën materialin gjenetik themelor të kromozomeve, të cilat ndodhen në bërthamën qelizore. Ka formën e fijezave spirale të dyfishta, ku secila prej tyre ka bazë nukleotide. Ekzistojnë katër lloje bazash të këtilla: adenina, guanina, timina dhe citozina. Secila prej këtyre bazave është çift: njëri çift në njërën fije dhe çifti tjetër në fijen tjetër. Kryen funksionin e sintezës së albuminave në qeliza. Këtu gjendet edhe gjeni që luan rol në trashëgimi.

ACIDI GAMA-AMINOBUTER (GABA). Acid me cilësi të neurotransmetuesit inhibitor. Ekzistojnë dy lloje të këtij acidi: gama-aminobuter A ose GABA A dhe gama-aminobuter B ose GABA B. Këto dy lloj acidesh gjenden në masën e përhimët të sistemit nervor. Sasia e dozave të çrregullta të këtij acidi shkakton lëndime të rënda të karakterit ankthor, por ndikon edhe në sëmundjen e quajtur ***KOREA HUNTINGTON*** – shih.

ACIDI NUKLEIK (BËRTHAMOR). Zinxhir molekular i përbërë nga monomerë që quhen nukleotide. Ndodhet

në të gjitha qelizat e gjalla, zakonisht i lidhur kimikisht me proteinat, me të cilat formon nukleoproteinat. Në acidet nukleike hyjnë: acidi ribonukleik ARN dhe acidi dezoksiribonukleik ADN. Acidet nukleikë u zbuluan nga studiuesi i gjenetikës dhe statisticieni anglez Roland A. Fisher (Roland A. Fisher, 1890 – 1962). Përdoren në kërkimet biokimike e mjekësore, për të sqaruar natyrën e sëmundjeve virale, të kancerit etj.

ACIDI RIBONUKLEIK (ARN). Molekulë e madhe dhe e ndërlikuar që gjendet më tepër në citoplazmën e qelizave. Këtë acid e ndërtojnë nukleidet që përmbajnë citozinën, të tilla si: adenina, guanina, citozina dhe uracili. Këta nukleide përmbajnë sheqerin ribozë. Dallohen tri lloj acidesh ribonukleike: acidi ribonukleik ribozomik, acidi ribonukleik informativ dhe acidi ribonukleik transportues. Këta acide kanë lidhje njëvargore dhe vendtakimi i tyre është qeliza. Acidi nukleik shënohet me shkurtesën ARN.

a. **Acidi ribonukleik ribozomik –** lloj i acidit ribonukleik që gjendet në citoplazmë, ku sintetizohen albuminat. Ribozomet janë struktura qelizore ku sintetizohen proteinat sipas kodit gjenetik të caktuar;

b. **Acidi ribonukleik informativ –** lloj i acidit ribonukleik që drejtohet nga acidi dezoksiribonukleik në bërthamën e qelizës dhe bart informacione nga acidi dezoksiribonukleik se si të sintetizohen albuminat;

c. **Acidi ribonukleik transportues –** bartës i acidit albuminoz që përftohet nga pjesët e tjera të citoplazmës në ribozomë, nga e cila sintetizohen proteinat.

ADAPTIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *adapatatio* "përshtatje". Ka depërtuar edhe në shqipe duke u përdorur jo vetëm në biologji, por edhe në psikologjinë fiziologjike, duke emërtuar tiparin e përgjithshëm të qenieve të gjalla për të ndryshuar apo modifikuar proceset fiziologjike dhe format e veprimeve në përputhje me kërkesat e mjedisit të tij. Në psikologji termi adaptim përdoret më tepër për të emërtuar përshtatjen e ndjeshmërisë së një shqise ndaj intensitetit të një nxitësi që vepron pandërprerë në një shqisën të caktuar. Shih **– *PIRSHTATJA*.**

ADEKUAT, - E. mb. I ardhur nga latinishtja *adaequatus* "i përshtatshëm, i përputhshëm". Në psikologji bëhet fjalë për ngacmuesin adekuat, përkatësisht për ngacmuesin e përshtatshëm të një shqise, si: drita është ngacmues adekuat i syrit, zëri është ngacmues adekuat i veshit, aroma është ngacmues adekuat që i përgjigjet plotësisht hundës etj.

ADIPSI, - A. f. Çrregullim i marrjes së lëngjeve për plotësimin e nevojave biologjike të etjes. Adipsia ka të bëjë me mungesën e etjes, megjithëse organizmit i mungojnë lëngjet e domosdoshme, e pikërisht uji për funksionimin e tij. Ka karakter kronik dhe shkaktohet nga dëmtimi i pjesëve anësore të hipotalamusit sipas rezultateve gjurmuese te kafshët.

ADLER Alfred (**Alfred ADLER).** Mjek psikiatër, psikolog austriak. Lindi në Vjenë më 7.02.1870 dhe vdiq në Aberdeen (Skoci) më 28.05.1937. Ithtar i pikëpamjes së Zigmund Frojdit për psikanalizën e tij. Një ndër redaktorët e revistës psikanalitike

"Zentralblatt fur Psychoanalyse"; prej vitit 1910 ka qenë kryetar i Shoqatës Psikanalitike të Vjenës. Nga ky pozicion kritikoi Zigmund Frojdin për teorinë e seksualitetit dhe rolin mbisundues të seksualitetit në zhvillimin psikik të njeriut. U largua nga Shoqata Psikanalitike e Vjenës dhe më 1912 themeloi Shoqatën e Psikologjisë Individuale. Në veprat e tij theksoi rolin e raporteve ndërnjerëzore në zhvillimin psikik të njeriut, të zhvillimit të veprimtarisë së gjithëmbarshme të tij, të drejtuar në qëllime të caktuara dhe rolin e vullnetit dhe të synimit në përsosjen e zhvillimit të njeriut. Koncepti i vetaktualizimit të personalitetit zë fill me pikëpamjet për zhvillimin psikik të njeriut. Veprat kryesore të Alfred Adlerit janë: *"Praxis und Theorie der Individualpsychologie",* 1918 – ("*Psikologjia individuale – Praktika dhe teoria*", përkthyer në shqip, 2011); *"The Science of Living*", 1926 – (*"Shkenca e të jetuarit*", përkthyer në shqip, 2009)*; "What life could mean to you",* 1928 – ("*Ç`kuptim mund të ketë jeta",* përkthyer në shqip, 2003); *"Understanding Human Nature",* 1929 – (*"Të kuptosh natyrën e njeriut",* përkthyer në shqip, 2010). Instituti i Kurrikulave dhe i Standardeve në Tiranë botoi më 2005 veprën "*Psikologjia individuale në shkollë dhe psikologjia e edukimit"*.

ADMINISTRIMI I TESTIT. Tërësia e angazhimit të ekspertëve në zbatimin e testit, përkatësisht në ekzekutimin e tij. Ky angazhim përfshin këto veprime: organizimin e veprimtarisë sipas rregullsive për zbatimin e testit, kontrollin e përgjigjeve dhe të detyrave të zgjidhura nga ana e të testuarve, përcaktimin e saktë të pikëve pozitive e negative, përcaktimin e rezultatit bruto si edhe shndërrimin e tij në rezultat derivues.

ADMIRIM, - I. m. Ndjenjë shoqërore e nderimit dhe e respektit të posaçëm ndaj cilësisë së lartë të një aktiviteti krijues, të një individi tjetër. Ndjenja e tillë mbështetet në besimin dhe bindjen e njeriut për rëndësinë dhe vlerën e lartë të aktivitetit të tjetrit. Vlera e tillë mund të jetë letrare, muzikore etj. që shkakton te individi tjetër mahnitje. Admirimi i drejtohet individit tjetër vetëm për shkak të vlerës së posaçme që ai ka krijuar. Admirohet ai jo si personalitet i tërësishëm psikofizik i integruar, por si i admiruar për vlerën që ka.

ADOLESHENC/Ë, - A. f. Term i përdorur në terminologjinë e disa disiplinave shkencore (në mjekësinë ligjore, në pedagogji, psikologji, sociologji etj.), i ardhur nga latinishtja *adolescentia*. Adoleshenca është faza e zhvillimit të një individi që fillon me pubertetin dhe përfundon në moshën kur individi i rritur merr mbi vete përgjegjësitë. Kjo fazë fillon rreth moshës 15 vjeçare, pikërisht te meshkujt prej moshës 14 vjeç deri në moshën 22 vjeç dhe te femrat prej moshës 12 vjeç dhe zgjat deri në moshën 21 vjeç. Këtë fazë zhvillimore të të rinjve e karakterizojnë këto ndryshime: zhvillimi joharmonik ndërmjet ndryshimeve organike e fiziologjike dhe ndryshimeve psikike e sociale, të cilat dallohen derisa zhvillimi trupor ka përfunduar kryesisht, shfaqet zhvillimi i bujshëm i motivit seksual, i jetës emocionale, i proceseve kognitive, i interesave profesionale e jetësore, formimi dhe qëndrueshmëria e qëndrimeve dhe formimi i vlerave

personale. Në këtë fazë adoleshenti dallon më thellë vlerën e së vërtetës, të bukurës, të mirës, të besimit në Zot, të krijojë marrëdhënie të reja shoqërore dhe në to orvatet ta gjejë veten e tij. Në adoleshencë dobësohet ndikimi i prindërve dhe i familjes dhe përforcohet ndikimi i kulturës së grupeve shoqërore. Dallohen edhe sjelljet e përshtatjes së tij ndaj kërkesave të mjedisit. Për këto shkaqe adoleshenca është jo vetëm kategori konceptuale biologjike e zhvillimit të njeriut, por edhe kategori psikologjike e shoqërore.

Burimet:

Lawrence Kohlberg: *"Handbook of sociazation theory and research"*– (*"Libri mbi teorinë e socializimit dhe të gjurmimeve"*), Chicago, 1969.

John C. Coleman: *"The natyre of adolescence"*– (*"Natyra e adoleshencës"*), London and New York Methuen, 1980.

Michael G. Schofield*: "The social behavior of young people"*– (*"Sjelljet sociale të rinisë së hershme"*), London, 1965.

Stanley G. Hall: *"Adolescence. Its Psychology and its Relation to Physiology, Anthropology, Sociology, Sex, Crime, Religion and Education"* – (*"Adoleshenca. Psikologjia dhe lidhja e saj me Fiziologjinë, Antropologjinë, Sociologjinë, Seksin, Krimin, Besimin dhe Edukimin"*), New York, 1904.

Albert Bandura: *"Adolescent Aggression"* – (*"Agresiviteti i adoleshentit"*), New York, 1959.

Erik Erikson: *"Identity, Youth and Crisis"* – (*"Identiteti, rinia dhe kriza"*), New York, 1968.

Fransuazë Dolto: *"Adoleshenca"* (përkthim në shqip nga frëngjishtja), Shtëpia botuese UEGEN, Tiranë, 2003.

Charles G. Morris & Albert A. Mausto: "*Psikologjia. Shkenca e proceseve mendore dhe e sjelljes njerëzore"* (përkthim nga anglishtja), Qendra për Arsim Demokratik, Tiranë 2008, fq. 331 – 336.

Edmond Dragoti: *"Adoleshenti – Vështrim socialpsikologjik i fillimeve të Adoleshencës"*, Tiranë, 1999.

ADOPTIM, - I. m. Term i drejtësisë, por me komponente të theksueshme psikologjike të natyrës emocionale-motivuese. Adoptimi është përvetësimi shpirtëror i fëmijës së prindërve të tjerë nga ana e prindërve që dëshirojnë të kenë fëmijë. Shih – ***BIRËSIMI.***

ADORNO Teodor (**Theodor ADORNO**). Filozof, sociolog dhe muzikolog gjerman. Lindi në Frankfurt më 11.09.1903 dhe vdiq në Visp (Valis) më 6.08.1969. Me veprimtarinë e tij ndikoi në zhvillimin e psikologjisë në gjysmën e parë të shekullit XX. Anëtar i ngushtë i Rrethit të Frankfurtit, i quajtur edhe "Rrethi i Adornos". Profesor ordinar i filozofisë dhe i sociologjisë në Universitetin e Frankfurtit; drejtor i Institutit për Studime Sociale në Frankfurt gjatë viteve 1953 – 1969. Më 1934 emigroi dhe u kthye në Frankfurt më 1949. U mor me disa çështje të rëndësishme filozofike, sociologjike dhe psikologjike, si: vetëdija e tjetërsuar, kriza e mendimit shkencor, bazat ideore të jetës së tërësishme europiane etj. Në psikologji është më tepër i njohur në disiplinën e psikologjisë sociale. Sipas tij kultura masive e botës moderne manipulon masat e gjera në disa drejtime. Ishte kritikues i ashpër i shkatërrimit të së kaluarës në kulturë dhe në art, duke shkaktuar vetëdije të shtrembërur te masat e gjera, si edhe vetëdije të tjetërsuar. Veprat kryesore nga psikologjia të Teodor Adornos janë: *"The authoritarian Personality"* – (*"Personaliteti autoritar",* 1950); *"Kulturkritik und Gesellschaft"* – (*"Kritika kulturore dhe shoqëria",* 1955); *"Minima Moralia"* – (*"Minimumi i moralit",* 1951); *"Asthetische Theorie"* – (*"Teoria e estetikës",* 1970) etj.

A

ADRENALIN/Ë, - A. f. Term i fiziologjisë dhe i psikologjisë fiziologjike i ardhur nga greqishtja. Adrenalina është njëri nga hormonet e gjëndrës mbiveshkore, që sekretohet nga pjesa qendrore, nga palca e saj. Sekretohet me rastin e zmadhimit të veprimtarisë së sistemit nervor autonom. Adrenalina ushtron ndikim në këto procese fiziologjike dhe psikike: nxit aktivitetin e përshpejtuar të zemrës, rrit tensionin arterial të gjakut, përshpejton procesin metabolik në të gjitha qelizat e organizmit, stimulon mëlçinë që me aktivitetin e saj të rrisë përqendrimin e sheqerit në gjak, përshpejton qarkullimin e gjakut në muskujt skeletorë dhe në Sistemin Nervor Qendror dhe kryen funksionin e neurotransmetuesit. Këto ndryshime janë të lidhura ngushtë me këtë veprimtari psikike: rrit aktivitetin e përgjithshëm psikik të organizmit, merr pjesë në ndryshimin e gjendjes emocionale të njeriut, sidomos kur ky përjeton gjendjen e stresit fizik ose psikik, përgatit organizmin për të reaguar sa më mirë ndaj stresantëve etj. Në disa tekste të psikologjisë fiziologjike emërtohet edhe me termin epinefrinë**.**

ADRENENERGJIK, - E. mb. Që përcakton neuronet e sistemit nervor që shfrytëzojnë lëndët e ngjashme me adrenalinën për nxitjen e fuqisë transmetuese të neurotransmetuesve të sinapsave.

ADRENENERGJIKUES, - E. mb. Cilësi e neuroneve apo e qelizave nervore, e fijezave dhe e rrugëve nervore që nxisin sekretimin e adrenalinës, i japin energji neuroneve, pjesëve të tyre, si edhe rrugëve nervore për të vepruar ngjashëm me adrenalinën. Në rastet e tilla shpesh përdoret termi epinefrinë që emërton substancën dhe cilësinë e saj të adrenalinës. Këtë cilësi e kanë disa lloj cipash të receptorëve kimikë ose të qelizave muskulore që prodhojnë aminat biogjene. Këto mundësojnë bartjen e impulseve nervore nga një qelizë në tjetrën, si edhe nga qelizat nervore në muskuj.

ADRENOKORTIKOTROPIN/Ë, - A. f. Hormon i posaçëm që sekretohet nga pjesa e përparme e hipofizës. Kryen funksionin e zhvillimit të mbështjellësit të veshkave, të rritjes normale të organizmit dhe të ndalimit të prodhimit të testosteronit. Ky hormon shënohet me shkurtesën ACTH. Shih – ***GJËNDRAT MBIVESHKORE.***

ADHURIM, - I. m. Ndjenjë e thellë dashurie, malli e nderimi e një individi ndaj një individi tjetër dhe ndaj asaj që ai e vlerëson se i përgjigjet shkallës së lartë të kënaqësisë, që ai e përjeton kur e percepton si fryt të së mirës, së bukurës, së ndershmes. E tillë është ndjenja e adhurimit ndaj pikturës së Abdyl Frashërit, ndaj bukurisë së madhe natyrore në Luginën e Valbonës, në shpellën e Gradimjes etj. Në terminologjinë fetare ka të njëjtën kuptim, por objekt adhurimi është Zoti, fuqia e mbinatyrshme, së cilës besimtari i përulet me kënaqësi, mall dhe nderim të lartë.

AEROFAGI, - A. f. I ardhur nga greqishtja αερο "ajri" dhe φαγία "ngrënie". Afagjia është çrregullimi i marrjes frymë në mënyrë automatike, sepse njeriu nuk është ngopur me sasi të mjaftueshme ajri. Ndër shkaqet e shfaqjes së këtij çrregullimi është shqetësimi i madh emocional dhe përjetimi i

rëndë i konflikteve të pazgjidhura personale. Aerofagjia është simptomë e histerisë dhe e disa çrregullimeve neurotike të veçanta.

AFAGI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *a* "jo" dhe *a φαγείν* "ngrënie", që nënkupton çrregullimin e motivit të urisë. Kjo gjendje karakterizohet nga mungesa e urisë në organizëm, pavarësisht nga sasia e pamjaftueshme e lëndëve ushqimore që organizmi merr. Në gjendje të tillë njeriu refuzon kategorikisht marrjen e ushqimit. Afagjia te kafshët është rezultat i dëmtimit të pjesës së zverkut të hipotalamusit.

AFAKI, - A. f. Term i anatomisë patologjike i ardhur nga greqishtja *a* "jo dhe *φακός* "lentë, lenta e syrit". Afakia shkaktohet nga lëndimi i syrit ose nga disa sëmundje të syrit. Mund të jetë edhe pasojë e një ndërhyrje kirurgjikale në sy. Syri pa lentë është shumë i ndjeshëm ndaj ngjyrës së kaltër, si edhe ndaj rrezeve të dritës me gjatësi valësh elektromagnetike, që lenta e syrit i përthith. Mungesa e lentës kur ajo shkolitet nga syri për të shëruar kataraktën është shkaktare e çrregullimeve të përmendura.

AFAZI, - A. f. Emërtim i përbashkët i disa çrregullimeve të të folurit i ardhur nga greqishtja *a* "jo dhe *φασία* "të folur". Afazia është humbje e pjesshme ose e tërësishme e aftësisë të të folurit dhe kuptimit të saj. Manifestohet në forma të ndryshme: me vështirësi në shprehje të mendimeve dhe të përdorimit të simboleve verbale të caktuara, me pamundësi të të kuptuarit të fjalëve e lidhjeve ndërmjet tyre etj. Afazia është pasojë e lëndimit të disa qendrave të cipës së trurit të madh.

AFAZIA AUDITORE. Paaftësi e të kuptuarit të fjalëve të shqiptuara, edhe pse shqisa e dëgjimit funksionon normalisht. Fjalët e fjalitë shqiptohen mirë nga ana e pacientit, por ai nuk arrin të kuptojë kuptimin e tyre. Afazia ditore emërtohet edhe me termin shurdhëri e thjeshtë ose e pastër për fjalë.

AFAZIA NOMINALE. I ardhur nga latinishtja *nomen* "emër" dhe nga greqishtja *a* "parashtesë mohuese" dhe *φαση* "të folurit". Afazia nominale është humbje e aftësisë së emërtimit të objekteve. Përfaqëson dukurinë patologjike të të folurit që është pasojë e paaftësisë së përzgjedhjes së duhur leksikore për dukurinë, objektin procesin etj.

AFAZIA PAMORE. Pamundësi e emërtimit të objekteve të shfaqura para pacientit. Në rastet e këtilla pacienti di për çfarë shërben këpuca, lapsi, tavolina etj., por nuk është në gjendje t`i emërtojë me emrat e duhur objektet e përmendura. Madje, ai i mbath këpucët, por nuk është në gjendje ta thotë fjalën këpucë. Afazia pamore shkaktohet nga lëndimi i disa qendrave të cipës së trurit të madh.

AFAZIA RECEPTIVE. Çrregullim i aftësisë së kuptimit të gjuhës së folur dhe të shkruar, që shfaqet me lidhje jokoherente fjalësh, me përzgjedhje të varfër fjalësh dhe me shumë gabime gramatikore. Kjo është pasojë e lëndimit të thellë të qendrës së kuptimit të të folurit. U zbulua nga neurologu gjerman Karl Vernik (Carl Wernicke, 1848 – 1905).

AFAZIA SINTAKTIKE. Humbja e aftësisë së përcaktimit të sintaksës së fjalëve. Çrregullim i të folurit që karakterizohet nga leksiku i kufizuar,

pamundësia e rregullimit të lidhjeve gramatikore e logjike të fjalëve e fjalive me anë të përdorimit të lidhëzave e parafjalëve. Afazia sintaktike shkaktohet nga lëndimi i pjesëve të cipës së trurit të madh; lidhet me lëndimin e masës së bardhë trunore të fundit të pjesës së trurit ballor.

AFAZIA TRAUMATIKE. Humbja e pjesshme ose e tërësishme e aftësisë së të folurit nga lëndimi i kokës, sidomos nga lëndimi i kokës gjatë procesit të lindjes.

AFEKT, - I. m. Term që ka ndryshuar kuptimin e vet dhe nuk ka të bëjë shumë me kuptimin leksikor të tij; i ardhur nga latinishtja *affectus* "me ndiku mbi dikë". Në të folurin e përditshëm përdoret më tepër për të emërtuar kuptimin e fjalës emocion. Në psikologjinë strukturaliste të Eduard B. Tiçenerit (Edward B. Titchener, 1867 – 1927) emërtonte përmasën e tretë të funksioneve psikike, përkatësisht atë të emocioneve (të kënaqësisë dhe të pakënaqësisë), që u quajt toni afektiv. Termi afekt sot emërton ndjenja me intensitetit të lartë që zgjasin pak kohë, që janë të shkurtra, gjendje emocionale kalimtare, por të fuqishme. Të këtilla janë: entuziazmi i tepërt, frika e madhe, lemeria, zemërimi i madh, trishtimi etj. Këto ndjenja prekin shtresat e thella psikike të njeriut. Afektet shoqërohen me ndryshime fiziologjike qendrore dhe periferike, si: ngritja e tensionit arterial të gjakut, ritmi i përshpejtuar i rrahjes së zemrës, ndryshimet në sekretimin e hormoneve të disa gjëndrave endokrine, ndryshimi i pulsit, reagimi psikogalvan i lëkurës etj. Të tilla ndryshime shoqërohen edhe me ndryshime të karakterit psikik, si: çrregullimi i vëmendjes, çrregullimi i kujtesës, kontrolli i pamjaftueshëm i veprimeve nga ana e njeriut etj., të cilat kanë ndikim të fuqishëm në rrjedhën e proceseve të mendimit. Veprimet penale të kryera në gjendjen afektive të njeriut konsiderohen nga ana e trupit gjykues në një mënyrë tjetër nga veprimet e kryera në gjendjen normale të aktivitetit të tij.

AFEKTI PATOLOGJIK. Formë e veçantë e afektit të fuqishëm të njeriut që karakterizohet nga raporti i parregullt ndërmjet shkakut të afektit dhe intensitetit të lartë të afektit dhe kohës së gjatë të ndikimit të tij në veprimtarinë e njeriut. Intensiteti i lartë i reagimit afektiv nuk është adekuat me ngacmuesin që ka shkaktuar gjendje afektive. Afekti patologjik shfaqet më tepër kur perceptimi i ngacmuesit apo i një situate ngacmuese prek vlerën e caktuar të njeriut, sidomos kur ai i tejçmon vlerat e veta. Afekti patologjik karakterizon më tepër sjelljet e atyre që vuajnë nga disa çrregullime kortikale, ata që vuajnë nga demenca prekoks, që marrin sasi të pakontrolluara alkooli etj.

AFEKTIVITET, - I. m. Term përmbledhës për të gjitha llojet e gjendjeve emocionale, për gjithë sferën shtrirëse të afekteve. Afektiviteti është karakteristik për disa sjellje, që shkaktohen nga përjetimi i gjendjes afektive, por nuk kanë të bëjnë me mendjen e njeriut.

AFEKTIVITETI LABIL. Gjendje e ndryshueshme e përjetimit të afekteve, që ndryshon nga reagimet emocio-

nale me intensitet shumë të lartë deri në reagimet emocionale normale ndaj ngacmuesve të papritur, e pikërisht prej një skaji në tjetrin. Është karakteristik për disa çrregullime psikotike të karakterit organik**.**

AFERENT, – E. mb. Term i anatomisë, i fiziologjisë dhe i psikologjisë fiziologjike, i ardhur nga latinishtja *affero* "bart, sjell". Përcakton qelizat nervore me fijezat e tyre, të cilat bartin impulse nervore nga periferia e strukturave të trupit të njeriut, më shpesh nga strukturat shqisore të organizmit, në një strukturë të caktuar të Sistemit Nervor Qendror dhe të cipës së trurit të madh. Me këtë mbiemër përcaktohen nervat qendërprurës. Në psikologjinë fiziologjike bartja e tillë e impulseve nervore emërtohet edhe si bartje centripetale.

AFILACION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *affilatio* "përvetësim, vëllazërim". Emërtim i koncepteve me përmbajtje të marrëdhënieve shoqërore pozitive, të mira, të pëlqyeshme etj. me të tjerët. Përbëhet nga fuqia nxitëse e brendshme e njeriut për t`u bashkuar, për t`u shoqëruar me të tjerët, si edhe nga nevoja e bashkëpunimit me të tjerët.

AFINITET, - I. m. I ardhur nga latinishtja *affinis* "i afërt, i ngjashëm". Në psikologji dhe në psikiatri afiniteti emërton kryesisht afërsinë dhe mbështetjen emocionale të një individi ndaj një klase të caktuar të objekteve p.sh., akuarelave, profesioneve të caktuara, personaliteteve të njohura etj. Mbështetet në interesimet, qëndrimet, shprehitë, vlerat etj. të një individi dhe shprehet me prirjen pozitive të tij ndaj objektit të afinitetit. Afiniteti në tipologjinë e Ernst Kreçmerit (Ernst Kretschmer, 1888 – 1964) është afërsia, ngjashmëria ndërmjet përbërjes së trupit të njeriut e tipareve të karakterit e temperamentit dhe tipareve eventuale psikotike të tij.

AFONI, - A. f. Term burimor i ardhur nga greqishtja *a* "jo" dhe *φωνία* "zëri" që nënkupton humbjen e aftësisë së prodhimit të zërit nga organet e të folurit, nga dëmtimi i laringut dhe i pejzave artikuluese të zërit të njeriut. Afonia mund të shkaktohet edhe nga sëmundja organike e muskujve, sidomos e atyre të aparatit të të folurit, si edhe nga disa faktorë psikogjenë.

AFORIZ/ËM, - MI. m. Term i përdorur më tepër në letërsi, por me theksime psikologjike të posaçme, i ardhur nga greqishtja *αφορισμός* "kufizim". Aforizmat janë thënie të plotfuqishme kuptimore, të shkurtra dhe udhërrëfyese të nxjerra nga jeta e përditshme në formë mendimesh të kondensuara, si "Arma e më të mençurit është libri", "Fruti që nuk të mërzit kurrë është fëmija", "Shkenca në vetvete është fuqi"etj.

AFRAZI, - A. f. Humbja e aftësisë së të folurit të rrjedhshëm dhe kuptimplotë. Afrazia është çrregullim funksional; organet e të folurit janë të palënduara dhe të padëmtuara, por renditja, lidhja dhe ritmi i të folurit të fjalive është i çrregulluar. Madje, edhe aftësia e të shprehurit të fjalëve një nga një është e ruajtur, por ndërtimi i fjalive dhe lidhja e tyre në një tërësi foljore nuk është e arritshme për ata që vuajnë nga afrazia**.**

AFRODIZIAK, - U. m. Nxitës të dëshirës, të motivit seksual. Disa nga llojet e ushqimeve stimulojnë aktivitetin

seksual të njeriut, si: peshku i skuqur, mishi i qengjit të pjekur, i shoqëruar me verë etj., por këto ushqime kanë më tepër ndikim subjektiv, sesa ndikim organik dhe fiziologjik.

AFSH, - I. m. Dëshirë e fortë e njeriut e drejtuar në një qëllim të caktuar, i cili për të është i pazëvendësueshëm. Afshi ka të bëjë me një ndjesi të krijuar nga kënaqësia dhe ëndja e një intensiteti të lartë të një individi, gati të pafrenuar ndaj një qëllimi që synohet të arrihet, duke pasur besim në vetvete se ky individ do të jetë në gjendje t`i zotërojë pengesat që mund t'i shfaqen në rrugën e realizimit të asaj dëshire. Afshi e mbisundon veprimtarinë psikike të gjithëmbarshme të njeriut dhe ky i fundit mbetet i preokupuar me të deri në realizimin e afshit dhe në çaste të posaçme bëhet rob i kësaj dëshire të fuqishme. Ky term ka ardhur nga kuptimi i parë i tij "i nxehtë, avull që del nga zjarri". Më pas ka marrë kuptimin e dëshirës së zjarrtë, që disa gjuhëtarë i japin përmasës së epshit.

AFTËSI, - A. f. Strukturë psikike potenciale për kryerjen me sukses të veprimtarive të posaçme nga ana e një individi, apo të një lloji qeniesh të larta njerëzore. Aftësitë e tilla janë tipare themelore që përcaktojnë nivelin e suksesit në kryerjen e një veprimtarie apo disa veprimtarive të ngjashme. Aftësitë zhvillohen gjatë veprimtarisë së njeriut mbi dispozitat e lindura dhe nën ndikimin që ushtrojnë faktorët e mjedisit. Dallojmë aftësitë e përgjithshme apo fondamentale dhe ato të posaçme ose speciale. Aftësi e përgjithshme është inteligjenca, që mundëson nivel të suksesshëm në disa lloj veprimesh me pak ushtrime, kurse aftësitë e veçanta apo speciale mundësojnë kryerjen e lehtë, të menjëhershme dhe me kompetencë të një veprimtarie të ngushtë me shumë pak ushtrime, si: mprehtësia e të parit, e të dëgjuarit, e operimit me numra, e shkathtësive të gishtërinjve etj. Shih **- *DISPOZITA.***

AFTËSIA INTELEKTUALE. Struktura të mendjes së njeriut, të cilat aktivohen në procesin e zgjidhjes së situatave problemore, ku kërkohet mëtim për lidhjet konceptuale më të rëndësishme të asaj situate problemore.

AFTËSIA MEKANIKE. Aftësi e veçantë e njeriut për të manipuluar lehtë, shpejt dhe në mënyrë të saktë me vegla pune, me makina etj. Aftësia mekanike gjen zbatim në punët praktike të përditshme. Kjo aftësi nënkupton edhe procesin e të kuptuarit të strukturës së makinave dhe të funksionimit të këtyre strukturave në kuadrin e tërësisë së tyre. Megjithëkëtë, konsiderohet se aftësia mekanike është e nivelit të aftësive të ulëta.

AFTËSIA PROFESIONALE. Gatishmëria e një individi për të kryer me sukses punën profesionale të tij. Kuptimi i këtij termi shtrihet prej vlerësimit të disa simptomave për kryerjen me sukses dhe me kënaqësi të një aktiviteti profesional të caktuar deri në njohjen e interesave, të gatishmërisë psikomotorike, të shkallës së ushtrimeve dhe të shkollimit të tij.

AFTËSIA SPECIFIKE. Çdo aftësi e njeriut për kryerjen e lehtë dhe të shpejtë të detyrave të një lloji të caktuar. Aftësi specifike është aftësia fjalësore, hapësinore, numerike etj. Ajo nënkup-

ton aftësinë në teorinë dyfaktoriale të inteligjencës, e cila e ka zbërthyer inteligjencën në faktorin e përgjithshëm dhe në faktorin specifik. Derisa faktori i përgjithshëm merr pjesë në zgjidhjen e detyrave dhe të problemeve të ndryshme, faktori specifik mundëson zgjidhjen e problemeve dhe plotësimin e detyrave të veçanta.

AFTËSITË MOTORIKE. Aftësi të lidhura me lëvizjet e organeve dhe të trupit të njeriut, si edhe me veprimtarinë e gjithëmbarshme të trupit të tij. Këto aftësi mbështeten në strukturat neurofiziologjike, që janë bazë për zhvillimin dhe formimin e shkathtësive dhe të shprehive. Aftësitë motorike manifestohen në lëvizjet e suksesshme të gishtërinjve, në koordinimin e lëvizjeve të duarve, në shpejtësinë dhe në fuqinë e reagimit të duarve, të gishtërinjve, të këmbëve, të kokës etj. Shih – ***PSIKOMOTORIKA.***

AFTËSITË PARËSORE MENDORE. Tërësi aftësish themelore që mundësojnë sukses në zgjidhjen e shpejtë e të lehtë të detyrave intelektuale. Termi aftësi parësore mendore i atribuohet psikologut amerikan Luis L. Terstonit (Luis L. Thurstone, 1887 – 1955), i cili zbatoi me përpikëri metodën e analizës faktoriale dhe atë të analizës së shumëfishtë. Duke zbatuar këtë metodë arriti ta zbërthejë faktorin e përgjithshëm të inteligjencës në 7 faktorë parësorë të të menduarit të karakterit grupor: 1) Faktori verbal (W) që ka të bëjë me begatinë e fjalorit të njeriut, me gjetjen e shpejtë dhe të lehtë të fjalëve përkatëse për shprehje të rrjedhshme e të kuptueshme të mendimeve, të ndjenjave dhe të gjendjes së tij; 2) Faktori i kuptimit të lehtë dhe të shpejtë të përmbajtjeve, të cilat janë formuluar me fjalë; kjo është aftësia e shënuar me V; 3) Faktori numerik – aftësia e operimit të suksesshëm me numra (N); 4) Faktori i kujtesës – aftësi e mbajtjes mend dhe e riprodhimit të shpejtë dhe të lehtë të të dhënave të ndryshme të palidhura ndërmjet tyre (M); 5) Faktori special ose i përfytyrimit të veçorive hapësinore dhe të raporteve ndërmjet tyre (S); 6) Faktori i shpejtësisë së perceptimit që manifestohet në të vërejturit e shpejtë dhe të lehtë të ndryshimeve të vogla ndërmjet objekteve, përmbajtjeve e veçorive të tyre (P) dhe 7) Faktori i rezonimit që shfaqet në zgjidhjen me sukses dhe të shpejtë të problemeve që kërkojnë angazhim të procesit të mendimit në nxjerrjen e përfundimeve nga gjykimet e veçanta dhe në zbatimin e saktë të parimeve dhe të ligjeve në zgjidhjen e situatave problemore konkrete (R). Në identifikimin e këtyre faktorëve, që nga viti 1943 zbatohen zakonisht testet e shkollës psikologjike të Çikagos.

AFTËSITË SENSORIKE. Aftësi që i përkasin funksionimit të shqisave dhe të receptorëve të tyre dhe kanë të bëjnë në rend të parë me zbulimin e ngacmuesve dhe të veçorive të tyre, si edhe me dallimin e hollësishëm të intensitetit dhe të kohëzgjatjes së tyre. Për caktimin dhe identifikimin e aftësive të këtilla provohen këto cilësi shqisore: hapësira apo fusha e të parit, identifikimi i burimit të zërit dhe i shkallëve të ndryshme të ndjeshmërisë së zërit, pragu absolut i ndjeshmërisë, në rend të parë pragu i ndjeshmërisë së të parit dhe i të dëgjuarit, mprehtësia e të parit, aftësia e dallimit të ngjyrave etj.

A

AFTËSITË SHQISORE. Aftësitë e ndijimeve dhe të perceptimeve të mbështetura në funksionimin e sistemit shqisor. Shih – ***AFTËSITË SENSORIKE.***

AGCT. Shkurtesë e testit të shfrytëzuar për nevoja ushtarake në Armatën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në fillim dhe gjatë Luftës II Botërore, i ardhur nga anglishtja: **A** = Army "i armatës", **G** = General "i përgjithshëm", **C** = Classification "klasifikim" dhe **T** = Test " test". U përdor për të vlerësuar aftësitë e përgjithshme intelektuale. Ky test përbëhet nga detyrat dhe problemet verbale, të rezonimit numerik dhe të vlerësimit të aftësive lidhëse hapësinore. Pas përfundimit të Luftës II Botërore u përdor edhe për nevoja joushtarake.

AGEUZI, - A. f. I ardhur nga greqishtja α "jo"dhe γευσία "shije". Humbja e ndjeshmërisë së shijes që kanë lëndët ushqimore (perimet e pemët) si edhe gjellët e ndryshme. Shkaktohet nga lëndimi i pjesëve të cipës së trurit të madh, nga çrregullimi i funksionit të fijezave nervore nëpërmjet të cilave barten impulse nervore të shijes nga gjuha dhe goja deri në qendrat e shijes në cipën e trurit të madh. Ageuzia shfaqet më tepër nga sëmundjet e gjuhës dhe të receptorëve, të puprrive të shijes.

AGLOZI, - A. f. Në psikopatologji i ardhur nga greqishtja ἀ "jo" dhe γλωσσος, "gjuhë". E metë e rëndë e komunikimit verbal me të tjerët. Aglozia është humbje e plotë e aftësisë së të folurit të artikuluar, që shkaktohet si pasojë e çrregullimeve organike dhe funksionale të organeve të aparatit të të folurit me pak ose fare mundësi ripërtëritjeje.

AGNOZI, - A. f. I ardhur nga greqishtja α "jo" dhe γλωσία "njohje" që nënkupton pamundësinë e strukturimit të informacioneve të ndijimeve dhe humbjen e aftësisë së rinjohjes dhe të të kuptuarit të tyre. Ai që vuan nga agnozia ndikohet nga objektet dhe format e ndryshme të tyre, por këto nuk është në gjendje t'i njohë dhe t`i kuptojë e aq më pak t`i shpjegojë. Agnozia mund të jetë pamore, dëgjimore, prekëse etj. Ndër to agnozia pamore, dëgjimore dhe e prekjes ose taktile janë më të njohura. Agnozia pamore ose verbimi shpirtëror është humbje e aftësisë së rinjohjes së objekteve të perceptuara, humbje e aftësisë së kuptimit të fjalëve të lexuara, të simboleve me ngjyra. Agnozia dëgjimore është humbje e aftësisë së rinjohjes së tingujve dhe dallimit të tyre sipas kuptimit që kanë etj. Agnozia taktile është humbje e aftësisë së rinjohjes së objekteve të perceptuara me anë të lëkurës dhe të ndërgjegjshmërisë për duart, gishtërinjtë dhe për strukturën e trupit të vet. Ky çrregullim i madh është pasojë e çrregullimit të funksioneve të disa qendrave të cipës së trurit të madh.

AGNOZIA APERCEPTIVE. Çrregullim i perceptimit pamor dhe i fushës perceptuese të objekteve, të dukurive, situatave etj. Agnozia aperceptive shfaqet në pamundësi të njohjes dhe rinjohjes së objekteve dhe të formës së tyre, megjithëse mprehtësia e të parit nuk është dëmtuar.

AGNOZIA ASOCIATIVE. Mungesë e njohjes dhe e rinjohjes së kuptimit dhe rëndësisë së objekteve, të

përmbajtjeve, të situatave etj. Pacienti është në gjendje ta perceptojë shfaqjen pamore të simboleve të tyre, por pacienti nuk është në gjendje të njohë kuptimin dhe rëndësinë e tyre.

AGNOZIA AUDITIVE. Paaftësi e rinjohjes së kuptimit së tingujve të organizuar në tërësi domethënëse të veçanta. Tërësi të këtilla mund të jenë: tingujt e kambanës së kishës, melodia e një kompozicioni, struktura tingullore e një fjale p.sh., guri, misri, kompjuteri etj., ku secila ka kuptimin e vet, por ai që vuan nga agnozia dëgjimore apo auditive kuptimin e tyre nuk është në gjendje ta rinjohë. Kjo shkaktohet nga lëndimi i pjesës parietale ose tepore të cipës së trurit të madh**.**

AGNOZIA PAMORE JOPERCEPTIVE. Term i psikologjisë kognitive që emërton pamundësinë e formimit të perceptimit nga përpunimi i informacioneve pamore, megjithëse është ruajtur aftësia e të parit të objekteve. Agnozia pamore joperceptive manifestohet me pamundësinë e perceptimit të një tërësie kuptimore për objektin dhe situatën që njeriu duhet ta perceptojë.

AGNOZIA TAKTILE. Humbja e aftësisë së njohjes së trupave dhe cilësive të tyre, kur këta ngacmojnë lëkurën e njeriut. Shfaqet në pamundësinë e emërtimit të ngacmuesit të lëkurës dhe në interpretimin e këtij ngacmimi. Është pasojë e faktorëve të ndryshëm organikë e funksionalë.

AGONI, - A. f. Gjendje e posaçme psikike e fiziologjike e organizmit të njeriut, para se të pushojnë së vepruari proceset psikike dhe funksioni i strukturave organike. Gjendja e tillë i përket çasteve para vdekjes së njeriut. Agonia karakterizohet me këto cilësi: humbja gati e plotë e kontrollit mbi veten, dobësimi i funksionit të shqisave, të folurit e pakuptimtë, humbja e aftësive psikomotorike etj. Kjo gjendje mund të zgjasë disa orë dhe rrallëherë disa ditë.

AGONIST, - I. m. Muskuli që tkurret dhe funksionon në drejtim të kundërt të muskulit shtrirës. Muskuli agonist dhe antagonist veprojnë së bashku në drejtime të kundërta në të njëjtën kockë ashtore dhe kjo është baza fiziologjike muskulore e veprimit të tyre, përkatësisht e kryerjes apo ekzekutimit të lëvizjeve.

AGORAFOBI, - A. f. Term i psikopatologjisë i ardhur nga greqishtja αγορα "treg" dhe φοβία "frikë". Agorafobia është frika e paarsyeshme, patologjike nga hapësirat e hapura, nga tregu, rrugët etj., përkatësisht frika irracionale që shfaqet te njeriu, kur ai gjendet vetëm në sallën e kinemasë, në rrugë, në stadium etj. Shih – ***FOBIA***.

AGRAFI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *a* "jo" dhe *γραφία* "shkruaj" që ka të bëjë me humbjen e aftësisë së plotë ose të pjesshme të të shkruarit. Shfaqet shpesh me humbje të aftësisë të të lexuarit dhe është e lidhur edhe me afazinë, si edhe me agnozinë. Është pasojë e lëndimit të disa zonave të cipës së trurit të madh, që gjenden në pjesën parietale ose tepore të saj, kurse aftësia e lëvizjes së gishtërinjve ruhet. Në rastet e agrafisë së rëndë shfaqen gabime semantike. Riparimi i kësaj aftësie te të rriturit është gati i pamundur, kurse te të vegjlit procesi i agrafisë mund të pengohet në zhvillimin e vet.

A

AGRAMATIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga greqishtja *a* "parashtesë mohuese" dhe *γραφία* "shkronjë" që ka të bëjë me një lloj çrregullimi të të folurit, që shfaqet në vështirësitë dhe pengesat e hartimit të fjalive sipas parimeve e rregullave të gramatikës së një gjuhe të caktuar. Ai që vuan nga agramatizmi ka fond të pasur fjalësh, por nuk ka aftësi të shfrytëzimit të tyre, sipas strukturës gramatikore të gjuhës që e flet. Kjo shpie në pamundësi të pjesshme ose të plotë të të kuptuarit të shprehjeve me gojë ose me shkrim. Agramatizmi është pasojë e lëndimit nervor ose e çrregullimit funksional të mendimit, por edhe e zhvillimit të kufizuar psikik.

AGRESION, - I. m. Term i qëndrueshëm edhe në gjuhën shqipe i ardhur nga latinishtja *agressio* "sulm". Agresioni është lloj i veprimtarisë që karakterizohet nga armiqësia, sulmi ndaj tjetrit, në ndonjë objekt me vlerë të posaçme dhe në bartësin e vlerave të tilla. Ka karakter të përgjithshëm, sepse shfaqet në forma të llojllojshme dhe me intensitet të ndryshueshëm. Është nën ndikimin e fuqishëm të mjedisit social e kulturor të tij. Agresionin mund ta shkaktojnë pengesat fizike, sociale e politike për realizimin e synimeve të individit, frustrimet, konfliktet dhe kërcënimet, që nga format e ndryshme të akteve të rrezikshme për qenien e njeriut dhe jo vetëm të tij. Sjelljet agresive fillojnë prej fjalëve therëse, ofendimeve, fyerjeve, dhunës fizike (shpulla e shqelma) ndaj një individi tjetër e deri në asgjësimin e tij (vrasje e zhdukje).

AGRESIVITET, - I. m. Motiv i veprimtarisë së agresionit dhe formave të ndryshme të tij. Sipas psikologëve instiktivistë agresiviteti është shtytës i lindur dhe universal. Shfaqet te të gjithë anëtarët e një lloji të caktuar kafshe dhe te njerëzit, duke qenë shkaktar i sjelljes agresive. Me sjelljen agresive konkrete të individit ndaj individit tjetër zbrazet energjia e këtij motivi. Nga energjia e këtij motivi sjellja ndaj individit tjetër mund të jetë luftarake, energjike, nevojë për afirmim, mbisundim, vetëmbrojtje etj. dhe sjellje e drejtuar në asgjësimin e tjetrit.

AGRESIVITETI BENINJ. I ardhur nga latinishtja *benignus* "pa të keq". Agresivitet me parashikim për një gjendje të mirë të organizmit në rast nevoje për të sulmuar dikë. Agresiviteti beninj është reagim mbrojtës i organizmit ndaj atij ose atyre, të cilët kanë vënë në rrezik qenien e njeriut, kur janë rrezikuar interesat jetësore të tij dhe të gjithë atyre që gjenden në një mjedis të caktuar, si edhe të llojit të caktuar të kafshëve. Ky agresivitet ka karakter filogjenetik të qëllimshëm dhe të përbashkët për gjininë njerëzore dhe atë shtazore të drejtuar në largimin e rrezikut. Zhvillohet kur shfaqet rreziku për jetën dhe largohet kur rreziku i tillë mënjanohet, asgjësohet. Termi i përket psikologjisë së Erik Fromit (Erich Fromm, 1900 – 1980).

AGRESIVITETI I ZHVENDOSUR. Agresivitet i drejtuar në qëllime të tjera, agresivitet jo i drejtuar drejtpërdrejt në burimin e frustrimit të njeriut. Zbatohet shpesh kur zotërimi i burimit të frustrimit është i pamundur të bëhet, kur subjekti i frustruar ka frikë prej sulmit të mundshëm të kundërshtarit etj. Objekti zhvendosës mund të jetë një njeri, një grup njerëzish etj.

AGRESIVITETI INSTRUMENTAL. Formë e agresivitetit të një individi, gjatë së cilës agresiviteti i zbatuar ndaj individit tjetër shërben si mjet apo instrument jo për ta shkaktuar ose asgjësuar tjetrin, por si mjet për t`ia arritur një qëllimi tjetër. Kërcënimi që i bëjmë fëmijës për një sjellje të keqe është formë e agresivitetit të prindit, me qëllim që ai të largohet nga sjellja e keqe. Në rastet e këtilla agresiviteti në çfarëdo formë dhe intensitet të përdoret zbatohet vetëm si mjet për eliminimin e sjelljeve të papërshtatshme dhe zhvillimin e atyre që janë të pranueshme për mjedisin familjar, mjedisin e ngushtë dhe atë të gjerë shoqëror.

AGRESIVITETI MALINJ. I ardhur nga latinishtja *malign* "i keq, i rrezikshëm për jetën, me pasoja shumë të rënda për jetën e njeriut" dhe *aggressivus* "agresion". Agresiviteti malinj nënkupton synimin e njeriut për të asgjësuar, për të shkatërruar diçka të jashtme, pavarësisht se objekti, situata, dukuria e jashtme etj. nuk janë kërcënim për jetën e njeriut dhe qenien e tij. Zhvillohet dhe formohet gjatë zhvillimit, socializimit dhe edukimit të njeriut. Ky agresivitet përbën një veçori të karakterit të tij, që nuk ka bazë hereditare. Agresiviteti malinj shfaqet atëherë kur nevojat themelore të jetës së njeriut nuk mund të plotësohen për shkak të kushteve e raporteve të ndërlikuara ekonomike, sociale e politike. Në raste të tilla te ai shfaqet synimi dytësor – agresiviteti malinj. Ky term i përket psikanalistit humanist, mendimtarit amerikan me prejardhje gjermane, Erik Fromit (Erich Fromm, 1900 – 1980), që dallohet posaçërisht për veprën e njohur të tij "Anatomia e destruktivitetit njerëzor".

AGRESIVITETI NË PSIKANALIZË. Formë e lindur e shtytësit parësor të vdekjes. Ky shtytës nuk mund të çrrënjoset dhe të zhduket, por vetëm mund të drejtohet në një individ tjetër ose në vetvete. Kjo është pikëpamja e Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939) neurologut dhe psikiatrit austriak me origjinë hebreje. Vilhelm Rajh (Wilhelm Reich, 1897 – 1957), psikanalist dhe bashkëpunëtor i Zigmund Frojdit, konsideronte se agresiviteti është derivat i shtytësit për jetën. Alfred Adler (Alfred Adler, 1870 – 1937), psikiatër austriak dhe themelues i psikologjisë individualiste konsideronte se agresiviteti është prirje për të qenë mbi të tjerët, përkatësisht prirja për fuqi. Për neopsikanalistin amerikan të lindur në Gjermani, Erik Fromin (Erich Fromm, 1900 – 1980) agresioni qe reagim, përgjigje ndaj pengesave për të arritur deri në plotësimin e nevojave themelore për jetën. Psikanalistja amerikane me origjinë gjermane Karen Hornei (Karen Horney, 1883 – 1952) konsideronte se ekziston prirja destruktive te të gjithë njerëzit e drejtuar për dëmtimin dhe shkatërrimin e armikut, por kjo prirje nuk është e lindur.

AGRESIVITETI NË TEORINË E INSTINKTIVISTËVE. Bartje e instinkteve prej botës së kafshëve në botën e njerëzve. Pikëpamje të tillë ka etologu gjerman Lorenc Z. Konrad (Lorenz Z. Konrad, 1903 – 1989). Sipas tij agresiviteti nuk mund të provokohet nga faktorët e jashtëm, por është i trashëguar. Kësaj pikëpamjeje i

përket edhe psikologu britanik Uiliam MegDugal (William McDougall, 1871 – 1938).

Burimet*:*

Lorenz Z. Konrad: *"Das sogenannte Böse – zur naturgeschichte der Agression"* – (*"E ashtuquajtura e keqe – Historia natyrore e agresivitetit"*), 1963*; "Über tierisches und menschliches Verhalten"* – (*"Mbi sjelljen e kafshëve dhe të njerëzve"*), 1964/5; *"Das Wirkungsgefüge der Natur und das Schicksal des Menschen"* – (*"Struktura e natyrës dhe fati i njeriut"*), 1978 etj.

Dollard: *"Frustration and Agression"* – (*"Frustrimi dhe agresioni"*), 1939.

Maurice Merleau–Ponty: *"Humanisme et terreur"* – (*"Humanizmi dhe terrori"*), 1947.

Sigmund Freud: *"Massenpsychologie und Ich – analyse"* (*"Psikologjia e masave dhe analiza e unit"*), 1921; *"Përtej parimit të kënaqësisë",* Tiranë, 2004.

Karl von Frisch:*"Të folurit e vallëzimit dhe orientimi i bletëve",* München, 1965.

Erich Fromm: *"The Anatomy of Human Destructiveness"* (*"Anatomia e destruktivitetit njerëzor"*), 1973; *"Anatomia ljudske destruktivnosti"* – (*"Anatomia e destruktivitetit njerëzor"*), Zagreb, 1976.

Nicollas Tinbergen: *"The Study of Instinct"* – (*"Studim për instinktin"*), Oxford: O. U. P., 1951.

Albert Bandura: *"Aggression: a Social Learning Analysis"* – (*"Agresioni: Analiza e të mësuarit shoqëror"*), London, 1973.

Ross Vasta & Marshall M. Haith & Scott A. Miller: *"Psikologjia e fëmijës – Shkenca moderne",* Tiranë, 2007, fq. 488 – 498.

AGJENT, - I. m. Term me kuptim të veçantë në fiziologji dhe në neuropsikologji, i ardhur nga latinishtja *agens* "veprues, energji vepruese". Termi agjent emërton kuptimin e një nxitësi që ndikon në organizëm ose në një organ të tij dhe shkakton ndryshim, reagim të atij organi ndaj agjentit, përkatësisht ndaj këtij nxitësi veprues. Ky është faktor i jashtëm ose i brendshëm që ka efekt të caktuar në organizëm ose në një organ të tij. Kështu, bëhet fjalë për agjentin kimik, vasodilator etj. Në literaturën shqipe të psikologjisë termi agjent haset rrallë. Shih – ***NXITËSI.***

AH Narciz Kaspar (**Narziss Kaspar ACH)**. Psikolog gjerman. Lindi në Ermershausen (sot Maroldsvasah) më 19.10.1871 dhe vdiq në Mynih më 25.07.1946. Anëtar i Shkollës së Vyrzburgut, profesor i psikologjisë në Universitetin e Berlinit, Kënigsbergut (Königsberg) dhe Gëtingenit (Göttingen). Në gjurmimet e procesit të të menduarit me anë të metodës së introspeksionit eksperimental zbuloi faktorin e prirjes përcaktuese gjatë zgjidhjes së detyrave dhe problemeve ose të situatave problemore. Sipas tij prirja përcaktuese është përshtatja e organizmit dhe e veprimtarisë psikike për ta perceptuar problemin apo situatën problemore në përputhje me gjendjen e çastit ose strukturat afatgjata psikike, si: interesat, qëndrimet, tiparet e personalitetit, shprehitë etj. Një koncept i tillë ushtroi ndikim në gjurmimin e asaj që pas viteve të para të shekullit XX u quajt "set". Rezultatet e gjurmimeve të mendimit nga ana e Narciz Kaspar Ahut treguan lidhjen e ndikimit të autoritetit dhe të sistemit të vlerave në procesin e zgjidhjes së problemeve dhe të situatave problemore. Ai ka treguar posaçërisht lidhjen e procesit të mendimit me atë të vullnetit të njeriut. Përfundimet e studimeve të tij u botuan në trajtë monografish nga Shkolla e Vyrzburgut.

AIDS, - I. m. Akronim i anglishtes i njohur në shqipe me shkurtesën SIDA: **A**(cquired), **I**(mmuno) **D**(efficiency)

dhe **S**(yndrome), i cili emërton sindromën e fituar të deficiencës imunologjike, përkatësisht çrregullimin e funksionit imunologjik të organizmit, të shkaktuar me virusin e veçantë që asgjëson qelizat imunologjike të organizmit të njeriut. Bartet kryesisht me anën e kontaktit seksual.

AJTEM, - I. m. I ardhur nga anglishtja, por ka depërtuar edhe në shqip, sidomos në përkthimet e testeve psikologjike. Termi ajtem ka kuptimin e përcaktorit të njësisë së detyrave dhe problemeve testore. Këto janë formuar nga ata përcaktorë, të cilët përfaqësojnë ndryshoren psikologjike që matet me anë të një testi të caktuar. Ajtemet e tilla mund të kenë këto përmasa: peshën dhe vlefshmërinë e tyre. Pesha e ajtemit ka të bëjë me përcaktimin e shkallës së duhur të vështirësisë së detyrave dhe problemave, ku pesha e duhur e ajtemeve shtrihet në mes, 50 % të rënda dhe 50 % të lehta. Vlefshmëria e ajtemave ka të bëjë me përcaktimin e masës së duhur të ngopjes së detyrave dhe problemave me ato përmbajtje detyrash e problemash që duhet të jenë të përputhura me atë që ajtemet masin.

AJZENKJ. Hans (Hans J. AJZENK). Doktor i shkencave të psikologjisë. Lindi në Berlin më 1916 dhe vdiq në Londër më 1997. Qysh në moshë më të re ka qenë kundërshtar i regjimit nazist në Gjermani. Kjo qe arsyeja kryesore që Ajzenku u shpërngul përgjithmonë nga Gjermania naziste e asaj kohe. Në fillim u vendos në Francë, por shpejt e la Francën dhe jetoi në Angli, duke zhvilluar një veprimtari të zellshme. Kreu studimet për psikologji në Universitetin e Londrës dhe mbrojti doktoratën në fushën e gjykimeve estetike. Gjatë Luftës II Botërore ka punuar si psikiatër në spitalin traumatologjik "Mill Hill", kurse pas përfundimit të Luftës, gjatë viteve 1945–1950 punoi si psikolog në Spitalin Maudesley. Është themelues i departamentit të psikologjisë në Universitetin e Londrës, duke e drejtuar deri më 1983. U mor kryesisht me studime të personalitetit dhe të inteligjencës, duke zbatuar metoda dhe procedura gjurmuese statistikore të veçanta. Ishte kundërshtar i psikanalizës dhe ndikoi në ngritjen e statusit të psikoterapisë në një nivel më të lartë. Gjurmoi karakteristikat psikologjike të mijëra ushtarëve të përvuajtur nga lufta; nga lënda e grumbulluar, të cilën e studioi me kujdes arriti në përfundimin për tri dimensionet e gjera të personalitetit të njeriut: Dimensionin ekstravers/intravers, dimensionin e neuroticizmit dhe më vonë shtoi edhe dimensionin e tretë, atë të psikotizmit. Për secilin prej këtyre dimensioneve ka përcaktuar karakteristikat dhe shtrirjen psikologjike të tyre. U mor edhe me studimin e zhvillimit dhe të strukturës së inteligjencës. Sipas tij zhvillimi i inteligjencës kushtëzohet në masë të madhe nga faktorët gjenetikë. Pikëpamjet e sipërpërmendura i ka paraqitur kryesisht në veprën "*Dimensionet e personalitetit*" dhe në veprën "*Rasa, inteligjenca dhe arsimi*". Veprat kryesore të Hans Ajzenkut janë: *"The Structur of Human Personality"* – (*"Struktura e personalitetit të njeriut*", 1952); *"Uses and Abuses of Psychology*" – ("*Përdorimi dhe abuzimi i psikologjisë",* 1953); "*The Measasurement of Personality"* – (*"Dimensionet e personalitetit*", 1976).

A

AKALKULIM, - I. m. Humbja e aftësisë së kuptimit të sasive të shprehura me numra dhe pamundësia e operimit, mbledhjes, heqjes, shumëzimit dhe pjesëtimit të numrave. Akalkulimi shkaktohet nga çrregullimi funksional i disa pjesëve të cipës së trurit të madh, dhe pikërisht kjo nuk rezulton nga padija.

AKINEZI, - A. f. I ardhur nga latinishtja *akinesia* "palëvizshmëri" që ka të bëjë me humbjen e aftësisë për lëvizje të vullnetshme. Njeriu merr vendim për të lëvizur prej një vendi në tjetrin, por këtë nuk arrin ta realizojë. Komponentja kognitive e vlerësimit dhe e marrjes së vendimit është e paprekur, por mungon realizimi i saj.

AKOMODIM, - I. m. Në fiziologji i ardhur nga latinishtja *accomodatio* "përshtatje". Kuptimi i përgjithshëm i këtij termi ka të bëjë me përshtatjen e një organi ose organizmi ndaj kërkesave dhe rrethanave të mjedisit të jashtëm. Me këtë lloj kuptimi nuk dallohet nga kuptimi i termit adaptim. Akomodimi i syrit është përshtatja e tij për të parë qartë objektet që gjenden në largësi të ndryshme. Këtë e mundëson elasticiteti i thjerrëzës së syrit, përkatësisht konveksiteti i saj dhe funksionimi i muskulit qerpikor. Me rastin e akomodimit të syrit rrafshi i thjerrëzës bëhet pak a shumë i mysët, në varësi nga rritja e rrezeve të dritës. Këto ndryshime bëjnë të mundur që figurat e objekteve në retinën e syrit të dallohen nga njëratjetra me mprehtësinë e tyre pamore.

AKROMATIK, - E. mb. I ardhur nga greqishtja *αχρωματωία* "i pangjyrë", që i përket të bardhës dhe të zezës dhe nuancave ndërmjet tyre. I këtillë mund të jetë të parit akromatik dhe, lidhur me këtë, ndijimi akromatik, kur çdo objekt e dukuri që shihet është e bardhë, e përhimët e zezë, rrjedhimisht edhe ndijimi është i tillë.

AKROMATOPSI, - A. f. Term i patologjisë së syrit për të dalluar ngjyrat kromatike, i ardhur nga greqishtja *a* "parashtesë mohuese", *χρωματ* "ngjyra" dhe *ωία* "syri". Akromatopsia është verbim i syrit për t`i dalluar ngjyrat kromatike (të verdhën, të portokallinjtën, të kuqen, të gjelbrën dhe të kaltrën me nuancat e shumta ndërmjetëse të tyre. Kjo është gjendje pamore e objekteve të perceptuara me ngjyra të ndryshme, por syri i njeriut këto i percepton si objekte të bardha të përhimëta ose të zeza. Akromatopsia është pasojë e dëmtimit të funksionimit të kunjëzave – receptorë të të parit. Me rastin e akromatopsisë zvogëlohet shumë mprehtësia e të parit të objekteve dhe e dallimit të tyre. Akromatopsia mund të jetë edhe e pjesshme. Shih – ***DALTONIZMI.***

AKROMEGALI, - A. f. Rritje shumë e madhe e organizmit të njeriut, sidomos e gjymtyrëve, e kokës, e mjekrës etj., që vihet re pas përfundimit të fazës së rritjes maksimale të organizmit. Është pasojë e mbiprodhimit të hormonit të hipofizës për rritjen e organizmit.

AKSELERACION, - I. m. I ardhur në psikologji nga latinishtja *acceteratio* "shpejtim". Përdoret më shumë në psikologjinë e të mësuarit. Shih – ***PËRSHPEJTIMI.***

AKSIOM/Ë, - A. f. Term i logjikës dhe i psikologjisë kognitive i ardhur nga greqishtja *αξίωμα* "kërkesë". Në

psikologjinë kognitive aksioma është gjykimi, qëndrimi dhe vlera të cilat nuk kanë nevojë të argumentohen. Aksioma dhe përmbajtja e saj e shprehur me fjali është një e vërtetë konkrete e drejtpërdrejtë; nga kjo e vërtetë fillohet për të ardhur deri në nxjerrjen e një gjykimi përfundimtar të formës deduktive.

AKSION, - I. m. Term i të folurit të përditshëm dhe profesional, i ardhur nga latinishtja *action* "veprim". Aksioni është proces në veprim e sipër. Mund të jetë aksion i vullnetshëm – i pavullnetshëm, i brendshëm – i jashtëm, psikologjik – fiziologjik. Aksioni mund të jetë i vetëdijshëm (aksioni i mbledhjes së armëve, shëtitja në lulishte, vrapimi në fazën vrapuese 100 m, shfrytëzimi i literaturës në bibliotekë etj.) dhe i pavetëdijshëm (aksioni potencial i neuroneve, të rrahurit e zemrës, tretja e ushqimit etj). Kuptimi i ngushtë psikologjik ka të bëjë me disa veprime të lidhura njëri me tjetrin dhe të drejtuara në një qëllim apo objektiv të caktuar.

AKSON, - I. m. Term i anatomisë së sistemit nervor i ardhur nga greqishtja *áξονaç* "bosht" që përfaqëson një fibër, bisk apo zgjatim citoplazmatik të vetëm të trupit të qelizës nervore, përkatësisht të neuronit. Aksoni kryen funksionin e bartjes së impulseve nervore nga një qelizë nervore në tjetrën ose në fijeza muskulore dhe në ato të gjëndrave, në organet ekzekutive të trupit.

AKT PSIKOLOGJIA. Psikologjia e akteve ose akt psikologjia është doktrinë psikologjike, apo sistem i ndërlidhur konceptesh që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me proceset e tërësishme të mendjes së njeriut, kurse përmbajtja e këtyre akteve është produkt i vetë akteve psikike. Psikologjia e akteve është psikologji empirike e drejtuar në vëzhgimin e modeleve të aktiviteteve mendore. I është kundërvënë psikologjisë strukturaliste dhe metodës eksperimentale të saj, për të zbuluar përbërësit themelorë të strukturave dhe proceseve psikike. Themelues i këtij sistemi konceptesh psikologjike është filozofi dhe psikologu fetar austriak Franc Brentano (Franz Brentano, 1838 – 1917), i cili i botoi pikëpamjet e tij më 1874 në veprën "Psychology vom empirischen Standpunkt" – ("Psikologjia nga pikëpamja empirike"). Akt psikologjia konsiderohet më tepër pjesë përbërëse e historisë së psikologjisë. Megjithëkëtë ajo ka luajtur rol në zhvillimin e funksionalizmit në psikologji.

AKT, - I. m. I ardhur nga latinishtja *actus* "veprim" që në psikologji emërton një model të caktuar të sjelljes, përkatësisht një reagim të ndërlikuar të organizmit dhe rezultatin e sjelljeve. Kështu, bëhet fjalë për aktin ejakular, aktin emocional, aktin konvulsiv etj. Më shpesh emërton organizimin e integruar mendor, të perceptimit, të emocioneve dhe të motivacionit të drejtuar në arritjen e një qëllimi apo zotërimin e tij ose ndryshimin e atij qëllimi. Në raste të veçanta kuptimi i tij ka të bëjë me njësi psikologjike, që për përdoruesit e shkollave specifike të psikologjisë i përket marrjes së vendimit, të mësuarit të qëllimshëm etj.

AKTIV, - E. mb. Që është vepruese, që ka të bëjë me aktivitetin e organizmit, që përcakton veprimtarinë e një

individi të caktuar. Aktiv mund të jetë cikli i ndryshimeve të organizmit (uri, etje, seks etj.), që e shtyjnë organizmin të veprojë. I tillë mund të jetë fjalori i një individi, që ka të bëjë me numrin e fjalëve të përdorura në të folurin gojor ose në të shkruarit nga ana e atij individi. Aktivë janë edhe shtytësit e veprimtarisë së organizmit (nevojat, motivet), ku, pavarësisht nga mungesa e ndonjë ngacmuesi të brendshëm ose të jashtëm, organizmi është në mënyrë të pandërprerë në një shkallë aktive të caktuar.

AKTIV – PASIV. mb. Term i psikanalizës, një nga tri polaritetet e jetës psikike e në përgjithësi, e raporteve ndërmjet tyre, sidomos e shtytësve të aktivitetit psikik. Aktiv është agresiviteti, burrëria, sadizmi etj., pasiv është nënshtrimi, feminizmi, mazokizmi etj.

AKTIVITET, - I. m. I ardhur nga latinishtja *activus*, *activitas*. Aktiviteti është term përmbledhës për të gjitha llojet e veprimeve, ku hyjnë reagimet refleksive, shprehitë, veprimet e vullnetshme. Tërësi veprimesh të një individi ose të një grupi të caktuar individësh, me anë të të cilave ndikohet në ndryshimin e gjendjes së një trupi, dukurie, mjedisi, të një procesi etj. Aktiviteti shkaktohet nga strukturat psikike e fiziologjike të brendshme, si: interesimet, nevojat, motivet, pikëpamjet, proceset metabolike, qëndrimet etj., si edhe nga strukturat psikike e fiziologjike të jashtme, si: ngacmuesit fizikë, socialë, psikikë etj. Shih – ***VEPRIMTARIA.***

AKTIVITETI IMPULSIV. Term i përgjithshëm që përdoret edhe në psikologji e që nënkupton tërësinë e veprimeve të një individi ndaj ngacmuesve të ndryshëm, kur veprimi i tij nuk orientohet sipas një qëllimi të parashtruar, duke mos menduar as për rrjedhimet e këtij veprimi.

AKTIVITETI SPECIFIK. Tërësia e reagimeve të pareformuara të organeve që përjetohet si tension i brendshëm, i ngjashëm me tensionin e organizmit, kur këtij i mungon lënda e posaçme e ushqimit. Ky tension e shtyn organizmin të ndërmarrë aktivitet të posaçëm me qëllim ndryshimin pozitiv të gjendjes së organizmit. Termi aktivitet specifik i përket psikanalizës, që neurologu dhe psikiatri austriak me origjinë hebreje Zigmund Frojdi (Sigmund Freud, 1856 – 1939) e ka përdorur që nga viti 1895.

AKTIVIZIM, – I. m. Në filozofi i ardhur nga latinishtja *actives* "vepro, puno". Në psikologji aktivizimi emërton konceptin e veprimtarisë së vetëdijshme njerëzore të drejtuar në ndryshimin praktik të objekteve dhe përgjithësisht të mjedisit ekonomik, kulturor, social etj. Aktivizimi është i lidhur me qëndrimet aktive, ku shprehet gatishmëria e njeriut për t`i realizuar qëndrimet e veta, për t`i mbrojtur ato dhe synimet e tij, si edhe për të pasur besim në fuqitë fizike, psikike e morale. Aktivizmi ka kuptim e emërtim të kundërt me pasivizimin.

AKTIVIZIMI I ENGRAMEVE. Procesi i ringjalljes së gjurmëve nervore të kujtesës afatgjatë dhe shfrytëzimi i tyre për plotësimin e nevojave aktuale (për riprodhimin e një përmbajtjeje të mësuar më parë, për zgjidhjen e një problemi apo situate problemore etj).

AKTUALITET, - I. m. I ardhur nga latinishtja *actualis* "i çastit, i tanishëm,

i sotëm". Në psikologji termi aktualitet emërton çdo gjendje, motiv, proces etj. që i përket të tashmes, që nuk ka të bëjë me të kaluarën dhe as me të ardhmen, por vetëm me të tashmen. I tillë mund të jetë personaliteti, sjellja politike, turpi i kohës etj. Psikologjia humaniste angazhohet për testimin dhe shpjegimin e interesimeve, të motiveve, të qëndrimeve dhe të qëllimit të tashëm të sjelljeve të njeriut. Psikanaliza thekson rolin e përvojave në të kaluarën, madje edhe të moshës fëmijërore në shpjegimin e sjelljeve, të konflikteve, të kompleksеve etj.

AKTUALIZIMI I PERSONALITETIT. Në psikologjinë e motivacionit të psikologut amerikan Abraham Maslou (Abraham Maslow, 1908 – 1970) nënkupton shndërrimin e përmbajtjeve psikike, të energjisë së strukturave të brendshme të personalitetit në sjelljet dhe veprimet konkrete të tij, duke u shfaqur ashtu si ai është dhe, si i tillë, organizon veprime me qëllim të realizimit të plotë të mundësive të zhvillimit personal.

AKULTURIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *ad* "kah" dhe *cultura* "kulturë", që paraqet procesin e përvetësimit të modeleve të sjelljes kulturore, të përvetësimit të parimeve, normave e rregullsive të sjelljeve të kultivuara, të qëndrimeve, të vlerave, të mënyrës së jetesës, të ekzistencës dhe organizimit të sjelljeve të suksesshme të njeriut në një mjedis me kulturë të caktuar. Në kushtet e ndryshimit të mjedisit kulturor i ardhuri në këtë mjedis zëvendëson bindjet, interesimet, qëndrimet etj. të fituara në mjedisin e vjetër me bindje, interesime, qëndrime etj. të mjedisit të ri, sidomos kur gjendet në një mjedis me kulturë mbisunduese. Integrimi i individit në mjedisin kulturor është rezultat i procesit të përvetësimit të modeleve të sjelljes nga ana e atyre që vendosen në një mjedis kulturor të ndryshëm nga ai i mëparshmi. Kjo vlen posaçërisht për emigrantët, si edhe për të zhvendosurit nga një mjedis rural në një mjedis urban.

AKUSTIK/Ë, - A. f. Degë e fizikës që merret me studimin e zërit dhe të karakteristikave fizike të tij. Akustika ka lidhje me perceptimin e zërit dhe me bazën fiziologjike e psikologjike të dëgjimit. Dijet elementare për zërin dhe njohja e akustikës luan rol të posaçëm sidomos në psikoakustikë, në gjuhësi dhe në muzikë. Shih – ***PSIKOAKUSTIKA***.

AKUT, - E. mb. I ardhur nga latinishtja *acutus* "i mprehtë" dhe më i përdorshëm në mjekësi me kuptimin e shfaqjes së një sëmundjeje të papritur, të menjëhershme dhe me kohëzgjatje të shkurtër. Në psikologjinë klinike më tepër përdoret në trajtën e shprehjes që emërton saktësisht sëmundjen dhe sindromën e caktuar, si reagimi akut ndaj stresit, çrregullimi akut stresant, faza akute e sëmundjes etj.

ALAKSI, - A (L-) f. Faktor i personalitetit ose tipar i tij që përbën skajin negativ të shtrirjes së tij përballë skajit pozitiv të këtij faktori, të njohur me termin protenzi (protenzi (L+) - Alaksi (L). Faktori aleksi (L-) është bartës i sjelljes së besueshme të personalitetit dhe kështu është përkufizuar në teorinë e psikologut amerikan për personalitetin dhe strukturën e tij, Rajmond B. Katel (Reymond B. Catell, 1905 – 1998).

A

ALALI, - A. f. Në psikopatologji i ardhur nga greqishtja *a* "parashtesë negative" dhe *λαλία* "llomotitje". Alalia është humbje e aftësisë së të folurit të artikuluar (pamundësia e shqiptimit të zanoreve dhe e bashkëtingëlloreve, si edhe e lidhjes së tyre). Kuptimi i tillë është i pranishëm te shumica e autorëve, duke shtuar se ka raste të tilla ku është ruajtur aparati i të folurit dhe ai i të dëgjuarit. I atribuohet dëmtimit funksional të qendrave nervore. Humbja e aftësisë së të folurit të artikuluar shkaktohet nga faktorët e ndryshëm, ndër të cilët përmenden edhe faktorët psikogjenë. Shih – ***AFAZIA.*** Ata që vuajnë më shumë nga alalia janë oligofrenët. Ushtrimet fonetike, morfologjike dhe gramatikore etj. mund të sjellin efekte të kufizuara**.**

ALARM, - I m. në shqipe termi alarm ka gjasë të ketë ardhur nga frëngjishtja ose italishtja *all`arme,* ose *alarme*. Në psikologji ka ardhur nga terminologjia ushtarake – "thirrje për të rrokur armët". Në të folmen e përditshme ka domethënien e shqetësimit të madh të njeriut nga një ngacmues i papritur, që paralajmëron rrezik, që shkakton frikë dhe kërkon angazhim për një veprim a kundërveprim.

ALBINIZ/ËM, - MI. m. Mungesë e plotë pigmentesh në lëkurë, në flokë dhe në ylberthin e syrit. Mungesa e pigmenteve në këto organe shkakton ngjyrën e bardhë të lëkurës, të flokëve dhe të ylberthit të syrit. Ata që vuajnë nga albinizmi vuajnë edhe nga humbja e aftësisë së syrit për të dalluar ngjyrat kromatike, përkatësisht janë të verbër për ngjyrën e verdhë, të portokallinjtë, të kuqe, të gjelbër dhe të kaltër, si edhe për nuancat ndërmjet tyre.

ALEGORI, - A. f. Term i letërsisë i ardhur nga greqishtja *αλληγορία*, por me komponente strukturore kognitive dhe emocionale. Alegoria është përmbajtja e një koncepti, e një pohimi etj., por e veshur me pamje figurative, siç janë tregimet e Ezopit, disa krijime të Filip Shirokës, të Migjenit etj.

ALEKSI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *a* "parashtesë mohuese" dhe *λεγο* "lexim". I përket terminologjisë së psikopatologjisë dhe emërton humbjen e tërësishme të aftësisë së leximit të përmbajtjes së teksteve të shkruara (të fjalëve të shkruara, të kuptimit të numrave, të notave etj). Shkaktohet nga lëndimi i disa strukturave të sistemit nervor të mesëm që janë bartëse organike dhe fiziologjike të leximit të shenjave emërtuese të përmbajtjeve të shkruara.

ALEKSITIMI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *αλεξιθυμία*, përkatësisht α "parashtesë mohuese" dhe λεξιθυμία e "leksitimit". Aleksitimia është çrregullim i përjetimit të ndjenjave dhe i përshkrimit fjalësor të gjendjeve të tilla. Kjo paaftësi e njohjes së gjendjeve emocionale nga vetë njeriu dhe e shprehjes së tyre me fjalë e me fjali nga ana e tij, shoqërohet shpesh edhe me kufizime të funksioneve kognitive. Ata që vuajnë nga aleksitimia janë joemocionalë, të ftohtë në marrëdhënie me të tjerët dhe të painteresuar për mjedisin dhe ndryshimet e tij. U përshkrua nga fundi i shekullit të njëzet nga ana e S. Sifneos, i cili ka konsideruar se aleksitimia shkaktohet nga këputja e lidhjeve nervore ndërmjet pjesëve të sistemit nervor limbik (amigdalës, bërthamave të përparme të talamusit, girusit cinguli, hipotalamusit dhe të

forniksit) dhe qendrave të të folurit të cipës së trurit të madh.

ALERGJI, - A. f. Në mjekësinë dhe psikologjinë klinike emërton reagimet e mbindjeshmërisë jonormale fiziologjike dhe psikike të disa individëve ndaj disa ngacmuesve të zakonshëm të organizmit (llojet e ndryshme të ushqimeve, medikamenteve, poleni i luleve etj). Alergjia shfaqet me këto shenja kryesore: çrregullim i ritmit të frymëmarrjes, dhembje e organizmit, ndjenjë e mundimshme e paidentifikuar, sëmundje ngjitëse etj. Mund të jetë trashëguese, por alergjitë psikike fitohen gjatë përvojës së njeriut.

ALFABETI BRAJ. Alfabeti i të verbërve që përbëhet nga shenja të posaçme numrash dhe me pozicione të ndryshme të pikave të relievit, përkatësisht pika të shpuara në letër. Ky sistem shenjash paraqitet në formë skematike në këtë mënyrë: pikat e relievit shtrihen në gjashtë rreshta të renditur paralelisht në dy shtylla, ku secili ka nga tri pika përkatësisht. Kombinimi i këtyre pikave bën të mundur formimin e pikave të shpuara në pozicione të ndryshme, nga të cilat formohen fjalët dhe fjalitë. Të verbrit i lexojnë këto fjalë dhe fjali duke prekur me gishtërinj vrimat në letër. U zbulua nga muzikanti dhe mësuesi francez Luis Braj (Louis Braille, 1809 – 1892).

ALGORIT/ËM, - MI. m. Procedurë mendore që ndihmon zgjidhjen e shpejtë të një situate problemore, përkatësisht marrjen e shpejtë të vendimit për një sjellje të caktuar në një situatë të dhënë, duke zbatuar rendin e operacioneve hap pas hapi. Të tilla janë operacioni i shumëzimit të numrave dhjetorë deri në procedura të gatshme të zgjidhjes së ekuacioneve lineare.

ALGJEZI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *αλγεινός* "dhembje". Algjezia është aftësi e posaçme e përjetimit të dhembjes nga ana e njeriut. Kuptimi i tillë është i paqëndrueshëm në literaturën e psikologjisë dhe të psikopatologjisë; shpesh emërton ndjeshmërinë e tepruar të dhembjes nga ana e njeriut, ndonëse për këtë ekziston termi hiperestezi.

ALGJEZIMETËR, - I. m. Instrument provues i dhembjes që mat shkallën e ndjeshmërisë së dhembjes. Përbëhet nga një gjilpërë, intensiteti i së cilës matet sipas energjisë së shtypjes së saj, kurse subjekti ka për detyrë të tregojë shkallën e dhembjes. Algjezimetri mund të ketë edhe formë të ndërlikuar, kur ngacmuesi i organeve të dhembjes është sasia e energjisë elektrike që vepron mbi siprfaqen e lëkurës, sasia e rrezatimit të lëkurës dhe intensiteti termik i larë i ngacmuesit etj. Në rastet e këtilla subjekti raporton për shkallën e ndjeshmërisë së dhembjes.

ALIENACION, - I. m. Term i sociologjisë dhe i psikologjisë sociale i ardhur nga latinishtja *alienation* "tjetërsim". Në historinë e psikologjisë përmendet në psikopatologji, që ka emërtuar çrregullimin psikik të njeriut (*alienatio mentis*). U përdor në tekste filozofike: Hegeli foli për tjetërsimin e mendimit të njeriut nga realiteti, kurse Marksi për tjetërsimin e njeriut nga natyra e tij njerëzore e shoqërore. Alienacioni në psikologji është emërtim i konceptit psikologjik për njeriun, i cili i përjeton përmbajtjet psikike të tij të huaja për të. Manifestohet me sjellje të pakup-

timta për jetën dhe ekzistencën e vet, përjeton gatishmëri të arratisjes nga mjedisi shoqëror, pandjesi për detyrat e përgjegjësitë e tij. Me këtë kuptim e hasim sidomos në psikologjinë e personalitetit, posaçërisht në shpjegimin e dinamikës së tij.

ALIMENT, - I. m. Term me rrënjë latine që në shqip ka kuptimin e ushqimit. U përdor nga ana e psikologut zviceran Zhan Piazhe (Jean Piaget, 1896 – 1980) për të emërtuar aktin e përfshirjes së objekteve të rinj në skemën kognitive të fëmijëve, përkatësisht në shtrirjen e fazave zhvillimore të proceseve kognitive.

ALIVANOSJ/E, - A. f. Humbje e përkohshme e kontrollit të vetëdijshëm të njeriut ndaj proceseve dhe sjelljeve të njeriut, kurse proceset fiziologjike vazhdojnë aktivitetin metabolik të tyre. Alivanosja mund t`i ndodhë njeriut normal për shkak të helmimit, të çrregullimit të proceseve të neurokortiksit, të rraskapitjes etj. Gjendja e tillë emërtohet në shqipe edhe me termin të fikët. Në rastet psikopatologjike alivanosja karakterizon sëmundjen e epilepsisë.

ALKIMIA E JUNGUT. Term i vjetër i ardhur nga arabishtja *al qimiya "pseudoshkencë"*, që e shfrytëzoi psikanalisti zviceran Karl G. Jungu (Carl G. Jung, 1875 – 1961) për shpjegimin e koncepteve të së pavetëdijshmes kolektive dhe për gjurmimin e saj. Ky studiues ka konstatuar analogjinë e përvojës së alkimistëve dhe të psikologjisë analitike apo komplekse të tij. Alkimistët në mbështetje të "shkathtësisë" së shndërrimit të çdo objekti dhe dukurie që vjen në kontakt me to në "gur të urtisë", "në lëng të jetës" për të siguruar pavdekshmërinë e shpirtit dhe këtë e kanë paraqitur në simbole, që për Karl G. Jungun janë të njohur si përmbajtje të jetës së pavetëdijshme. Sipas tij "Alkimisti ka kërkuar "Fshehtësinë hyjnore" në materien e panjohur dhe në këtë mënyrë ka arritur deri në rrugët që janë të ngjashme me ato të psikologjisë së sotme të pavetëdijes. . . ". Kjo analogji i paska dhënë kuptim përmbajtjeve historike shpirtërore të zbuluara sipas rrugëve të alkimistëve. Botoi veprën "*Studen Über Alchemistische Vorstellungen"* – (*"Studime mbi konceptin e alkimisë*").

ALKOOL, - I. m. Substancë depresive, përbërës helmues i organizmit. Substancë e lëngshme e tillë është birra, rakia, uiski, vera dhe pijet e tjera të distiluara ose të fermentuara.

ALKOOLIZ/ËM, - MI. m. Ves, dukuri psiko-sociale negative shumë e përhapur, e shkaktuar nga përdorimi i tepërt i alkoolit. Gjendje e çrregulluar e personalitetit e shkaktuar nga zhvillimi i shprehisë së konsumimit të pamasë të pijeve alkoolike. Konsumimi i tillë godet rëndë sistemin nervor, mëlçinë, veshkën etj., duke shkaktuar çrregullime organike e fiziologjike, që janë të lidhura ngushtë me çrregullimet e proceseve kognitive (të perceptimit, të kujtesës, të mendimit), emocionale dhe motivuese. Alkoolizmi është degradim i pakthyeshëm psikik e fiziologjik. Alkoolisti humb shkallë-shkallë kuptimin dhe ndjenjën e detyrës, të përgjegjësisë, e sidomos përmbajtjes së rregullave, parimeve dhe normave morale të sjelljes; veprimtaria e vullnetshme dobësohet shkallë-shkallë, kurse men-

dimi dhe të folurit humbin gradualisht bazën e realizmit. Në fillim u përdor si mjet shërimi për disa sëmundje, madje edhe u quajt "uji i jetës". Alkoolizimin e shkaktojnë disa faktorë personalë, familjarë dhe shoqërorë. Ndër ta përmenden: mos-suksesi në punën profesionale, pasiguria ankthi, depresioni, varfëria, humbja e statusit social, shkelja e të drejtave njerëzore dhe e të drejtave politike etj. Nga ndikimi i këtyre faktorëve sot alkoolizmi konsiderohet ves i mësuar. Faktorët e përmendur të alkoolizmit mund të çojnë në varësi alkoolike të individit, përkatësisht në alkoolizëm kronik**.**

ALOGJI, - A. f. I ardhur nga greqishtja ἀ "parashtesë mohuese" dhe λογος "mendim, fjalë" që ka të bëjë me humbjen e aftësisë së të folurit dhe të të menduarit logjik. Alogjia manifestohet në formën më karakteristike te imbecilët, sidomos në idiotizëm, herë–herë shfaqet edhe si simptomë e histerisë. Shkaktohet nga dëmtimi i strukturës së indeve nervore dhe nga çrregullimi i lidhjeve nervore. Alogjia në rend të parë është çrregullim mendor i lindur.

ALOKORTEKS, - I. m. Term i anatomisë së sistemit nervor i ardhur nga latinishtja që emërton pjesën më të vjetër të cipës së trurit që u zhvillua në fazën e parë të zhvillimit filogjenetik të cipës së trurit të madh. Kjo pjesë e cipës dallohet si në pikëpamjen anatomike e morfologjike, ashtu edhe në pikëpamjen funksionale nga cipa e re e trurit të madh.

ALTER EGOJA. asnj. Term i latinishtes që në shqipe ka kuptimin e unit të dytë. Termi *alter ego* në psikologjinë e personalitetit përdoret me dy kuptime: emërtim për strukturën domethënëse të përmbajtjeve të pavetëdijshme dhe të paravetëdijshme, si edhe për një përjetim të çuditshëm të njeriut, kur ky e konsideron veten aq të afërm dhe shumë të ngjashëm me një individ tjetër, duke përjetuar veten me personalitet të dyfishtë.

ALTERNATIV/Ë, - A. f. I ardhur nga latinishtja *alternus* "i ndryshëm". Ky term ka përdorim të përgjithshëm me kuptimin e përzgjedhjes së njërës ndër dy mundësive. Në psikologji emërton gjendjen psikike të njeriut, kur ky gjenmdet në një situatë të rëndë, gjithsesi edhe të padurueshme: ai është i detyruar të bëjë përzgjedhjen e njërës ndër dy mundësitë, që përjashtojnë njëra-tjetrën; ose do të çarmatoset ose do të përdorë armën.

ALTRUIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga latinishtja *alter* "të tjerët". Altruizmi është ndjenjë e ndërlikuar dhe prirje e një individi që ka të bëjë me gatishmërinë e tij për të jetuar dhe punuar jo vetëm në dobi të tij, por edhe të të tjerëve, madje duke i shkaktuar vetes një të keqe, duke flijuar të mirën dhe mirëqenien e tij për tjetrin. Altruizmi zhvillohet dhe formohet nën ndikimin e faktorëve shoqërorë e psikikë, ku rol të rëndësishëm luan edukata dhe arsimimi. Altruizmi ka buruar nga ndjenja e lidhjes dhe e ndihmës reciproke ndërmjet anëtarëve të mjedisit shoqëror, nga paraburimi njerëzor i miqësisë, i dashurisë dhe i nevojës për të jetuar dhe vepruar bashkërisht me të tjerët. Objekt i altruizmit është mirëqenia e individit tjetër në bazë të bashkëpunimit, respektimit,

A

gatishmërisë dhe ndihmesës së të tjerëve. Altruizmi merr përmasën e tiparit të karakterit, kur ai vazhdimisht synon të mirën e tjetrit, madje edhe në dëm të vetes. Termi i përket filozofisë së mendimtarit francez August Komte (August Comte, 1798 – 1857), i cili me altruizëm ka emërtuar konceptin e dashurisë ndaj të afërmve.

ALTRUIZMI RECIPROK. Formë e posaçme e altruizmit, altruizëm i ndërsjellë, i dyanshëm që në literaturën e psikologjisë e ilustrojnë me thënien "Mos i bëj tjetrit atë që nuk dëshiron të ta bëjë ai ty". Në rastet e tilla gatishmëria e pengesës së bërjes keq të tjetrit lidhet me angazhimin për mosbërjen keq të tjetrit ndaj teje.

ALTRUIZMI VETËVRASËS. Skajshmëri e altruizmit që shfaqet me flijim, me sakrificën e jetës për mbrojtjen e interesit, të jetës së të tjerëve. Raste të tilla janë treguar edhe ndër Shqiptarët: nëna sakrifikon veten për mbrojtjen e birit të saj, ushtaraku sakrifikon veten duke luftuar me një armik shumëherë më të fuqishëm, për të krijuar një korridor të largimit të qytetarëve të pambrojtur etj. Altruizmi vetëvrasës është term i konceptit të identifikuar nga ana e sociologut francez Emil Durkem (Emile Durkheim, 1858 – 1917).

ALUZION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *allusion* dhe i ngritur në nivelin e termit me të cilin shprehet forma domethënëse e konceptit, e mendimit jo të drejtpërdrejtë, por në mënyrë të fshehur, e veprimit të fshehur për arritjen e një qëllimi të largët. Aluzioni përdoret më tepër në të folurin e përditshëm.

AMALI E KAMALI. Emrat e dy vajzave të gjetura në një shpellë ujqërish në Midnapore të Hindisë më 1920. Amali p qe 1.5 vjeç, kurse Kamali rreth 8 vjeç. Janë bërë përpjekje për socializmin e tyre pas vitesh të tëra jete të kaluara me egërsi. Amali ka vdekur pas disa ditësh, kurse Kamali ka jetuar deri në 9 vjeç e mezi ka arritur të përvetësojë disa shprehi të jetës së njerëzve dhe disa fjalë të mjedisit ku është provuar socializimi i saj.

AMAUROZ/Ë, - A. f. I ardhur nga greqishtja *αμαυρος* "i verbër". Amauroza është humbje e të parit që rrjedh nga çrregullimi organik i strukturës dhe i funksionit të nervit pamor, nga dëmtimi i qelizave të tij etj., kurse syri dhe funksioni i tij nuk është i dëmtuar. Amauroza mund të jetë e njëanshme dhe e dyanshme. E para shkaktohet më tepër nga tromembolia etj., kurse e dyta rrjedh nga atrofizimi i nervit pamor dhe zhvillohet me ritëm të ngadalësuar. Amauroza te fëmijët zhvillohet me ritëm të shpejtuar.

AMBICI/E, - A. f. Term i psikologjisë i ardhur në shqipe nga latinishtja *ambitio* "përqafim i famës". Ambicia është synim i një individi që përçohet me dëshirën e thellë të tij për të arritur në një qëllim, objektiv të caktuar, që ka vlerë dhe rëndësi të madhe për të. Pushtimi i qëllimit të tillë i siguron atij autoritet dhe prosperitet shoqëror. Si e tillë ka vlerë pozitive, sepse ka fuqi të madhe motivuese dhe është në përputhje me mundësitë reale të individit me ambicie të tillë dhe kjo nuk është e drejtuar kundër askujt. Ambicia mund të jetë jonormale, kur individi synon të arrijë në qëllimin apo objektivin e caktuar me çdo kusht dhe me çdo mjet, kur

nuk është në përputhje me aftësitë e njeriut, me inatin dhe me vetafirmimin për të dalë mbi të tjerët.

AMBIDESKRITET, - I. m. I ardhur nga latinishtja *ambo* "të dy ose të dyja" dhe *dexter* "i djathtë". Ambideskriteti është përdorimi me shkathtësi të njëjtë i të dy duarve, i dorës së djathtë dhe dorës së majtë, përkatësisht i anës së djathtë dhe anës së majtë të trupit. Njeriu lind me këtë aftësi. Nën ndikimin e radhës së vendosur në kryerjen e veprimeve të caktuara (të shkruarit nga e majta në të djathtë, të rrokurit e dorezës së derës me dorën e djathtë etj.) dhe të ushtrimeve për ta zotëruar këtë radhë, te pjesa dërrmuese e popullsisë, gjymtyrët e anës së djathtë të trupit, bëhen më të shkathëta për veprime.

AMBIVALENC/Ë, - A. f. I ardhur nga latinishtja *ambo* "të dy"dhe *valentia* "vlerë". Ambivalenca është dukuri e pranisë së ndjenjave, të qëndrimeve, të vetive, të vlerave etj. të kundërta te një personalitet i caktuar, që i shpreh ndaj një dukurie, objekti, situate etj. Në fushën e ndjenjave ambivalenca shfaqet në përjetimin e ndjenjave të kundërta, p.sh., dashuri dhe urrejtje ndaj objektit, situatës së njëjtë. Me këtë kuptim e hasim te shprehja e shkrimtarit të madh anglez Uiliam Shekspir "Ndarja është hidhërim i ëmbël". Dukuria e ambivalencës haset edhe te qëndrimet, kur bashkekzistojnë qëndrime të kundërta ndaj të njëjtës situatë që manifestohet në prirjen e individit për vetafirmim dhe për vetëmohim. Ambivalenca u përshkrua për herë të parë nga psikiatri zviceran Eugen Bloiler (Eugen Bleuler, 1857 – 1939), i cili këtë dukuri e identifikoi te skizofrenët.

AMBLIOPI, - A. f. Në psikopatologji i ardhur nga latinishtja *amblyopic* "dobësim i të parit pa dëmtime organike të strukturës së syrit". Ambliopia shfaqet me pamundësinë e dallimit të detajeve dhe të lidhjeve ndërmjet tyre. Ambliopia është pasojë e helmimit të organizmit, e alkoolizmit dhe e marrjes së drogave.

AMENC/Ë, - A. f. Term i vjetër i psikiatrisë dhe i psikopatologjisë i ardhur nga latinishtja *amentia* "dobësi mendore, zhvillim mendor i kufizuar". Amenca është shkalla e ulët e zhvillimit të aftësive mendore të njeriut. Ky term sot haset rrallë në literaturën e psikiatrisë dhe të psikopatologjisë.

AMENORE, - A. f. Term i fiziologjisë i ardhur nga greqishtja *a* "parashtesë mohimi", *υνς* "hëna" dhe *πενς* "rrjedhë". Dukuria e mosardhjes së menstruacioneve për shkaqe organike dhe psikike. Ndër to dallohen: rraskapitja, shtatzënia, sëmundja, frika, ankthi, stresi etj.

AMETROPI, - A. f. Përthyerje jonormale e rrezeve të dritës në syrin e njeriut dhe përftimi i një figure të dobët e të turbullt në retinën e syrit. Te ata që vuajnë nga kjo e metë mezi arrihet të formohet qartësisht figura e objektit që perceptohet.

AMFETAMINË, - A. f. Substanca sintetike me strukturë kimike të posaçme që zhvillojnë aktivitet të veçantë në Sistemin Nervor Qendror, duke shkaktuar gjendje të ngjashme me euforinë, ngritje të nivelit psikomotor, largim të përkohshëm të lodhjes etj. Emërtimi i tyre rrjedh nga llojet e këtyre substancave: a(lfa) + m(etil) + f(enil) + e(til) + aminat. Marrja kronike e kësaj subs-

A

tance shkakton varësi të organizmit nga një substancë e tillë.

AMIGDAL/Ë, - A. f. I ardhur nga latinishtja *amigdale*. Amigdala është pjesë e strukturës limbike që përbëhet nga grupi i trupëzave të qelizave nervore me formë bajamesh, të vendosura në pjesën e përparme të pjesës temporale ose tëmthore të trurit të madh. Është bartëse e nevojave biologjike dhe e rregullimit të plotësimit të tyre, si edhe e përjetimeve emocionale të lidhura me forma të caktuara të sjelljeve. Amigdala merr pjesë edhe në rregullimin e disa formave të kujtesës.

AMIMI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *αμίμητος*. Amimia është humbje e aftësisë së komunikimit me të tjerët me anë të gjesteve dhe e aftësisë së njohjes së drejtë të gjesteve të të tjerëve dhe të kuptimit së tyre. Amimia shfaqet në dy forma: 1) Amimia motorike – humbje e aftësisë së gjestikulimit dhe 2) Amimia sensorike – pamundësia e njohjes dhe e të kuptuarit të kuptimit të gjesteve të të tjerëve.

AMINAT BIOGJENE. Grupe aminash të zhvilluara në bazë të sintezës së aminoacideve. Këto grupe luajnë rol të veçantë në funksionimin e sistemit nervor. Roli i tyre ka të bëjë me kryerjen e funksionimit të neurotransmetuesve. Për këtë rol të tyre në psikologjinë fiziologjike përmenden dy nëngrupe të aminave biogjene: indolaminat dhe kateholaminat. Strukturat përbërëse të këtyre nëngrupeve kryejnë funksione të rëndësishme metabolike; çrregullimi i tyre shpie në çrregullime psikike të rënda, përkatësisht në gjendje depresive dhe në skizofreni.

AMINOACIDET NEUROTRANSMETUESE. Struktura organike, ndërtuese të vargjeve polipeptidike. Aminoacidet neurotransmetuese janë glicina dhe acidi glutaminik, që kryejnë funksionin e neurotransmetimit të impulseve nervore.

AMNEZI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *αμνησία* "harresë". Amnezia është humbje e pjesshme apo e plotë e asaj që është mësuar brenda një kohe të caktuar, ose për ngjarjet e një kategorie të caktuar, duke u shtrirë deri në mosmbajtjen mend të identitetit personal. Shkaktohet nga proceset patologjike të organizmit, lëndimi i trurit dhe nga faktorët psikikë, në rend të parë, nga traumat, dhembjet shpirtërore, mbresat e pakëndshme etj. Nëse shkaku i amnezisë është lëndimi organik, harrohen të gjitha ngjarjet e përjetuara para ose mbas lëndimit.

AMNEZIA EPISODIKE. Harresa e një ose e disa informacioneve të një ngjarjeje, që shoqërohet me "formimin e një zbrazëtire në kujtesën e përmbajtjes së asaj ngjarjeje, në tërësinë e dëmtuar të saj".

AMNEZIA FUNKSIONALE. Humbje e pjesshme ose e plotë e kujtesës, që shkaktohet nga faktorët psikogjenë e jo nga dëmtimi i faktorëve neurologjikë.

AMNEZIA INFANTILE. Pamundësia e të kujtuarit të ngjarjeve nga koha e foshnjërisë dhe e fëmijërisë së hershme. Amnezia infantile shpjegohet me faktorët neuro-fiziologjikë, sipas të cilëve mekanizmat neuro-fiziologjikë ende nuk janë aftësuar plotësisht për të depozituar në kujtesën afatgjatë kujtimet e foshnjës, përkatësisht të fëmijës së moshës më të re.

AMNEZIA RETROGRADE. Humbja e mbajtjes mend të ngjarjeve të përjetuara nga ana e njeriut, menjëherë para se ai të përjetojë traumë. Besohet se trauma e përjetuar është shkaktare e harresës së ngjarjeve paraprake. Ka raste kur mbahen mend dhe nuk humbin përfundimisht këto ngjarje edhe pas përjetimit të traumës.

AMOK, - U. m. Term i rrallë i psikopatologjisë që emërton çrregullimin psikik e akut, që shfaqet me eufori të jashtëzakonshme dhe vrapim të rraskapitur. Amoku zhvillohet si rezultat i marrjes përtej masës të kanibisit. Ky çrregullim kronik u dallua në fillim te qytetarët e Malajzisë, por filloi të përhapet edhe në mjedise kulturash të tjera.

AMPLITUD/Ë, - A. f. Term i disa disiplinave të shkencave natyrore, në rend të parë i fizikës. Në psikologji ka ruajtur kuptimin e përgjithshëm të fjalës latine *amplitude* "madhësi, gjerësi". Kuptimi i termit amplitudë ka të bëjë me regjistrimin e lartësisë së një vale të potencialit elektrik, neurofiziologjik etj. Në psikologji bëhet fjalë për amplitudë të dhembjes, të akomodimit, të veprimit etj. Amplituda matet nga vala e mesme e dyfishtë deri në lartësinë e valës, si edhe prej valës së mesme të dyfishtë deri në pikën më të ulët të shtrirjes së saj. Në psikoakustikë amplituda përcakton fortësinë e tingullit.

AMSHIM, - I. m. Term i teologjisë që ka përkapje kuptimore psikologjike. Amshimi është pafundësia kohore e fillimit dhe e mbarimit të një procesi, përjetësia e shpirtit, përjetësia e njeriut që ndërroi jetë, por që vazhdon të jetojë në botën tjetër.

AMUZI, - A. f. Humbja e aftësive muzikore, e përjetimeve dhe e ekzekutimeve të krijimeve muzikore popullore e artistike. Amuzia është pasojë e lëndimeve organike të trurit. Ai që vuan nga amuzia është i paaftë për të perceptuar tërësitë muzikore. Kjo lloj amuzie i përket amuzisë sensorike. Amuzia motorike është humbje e aftësisë ekzekutuese të kompozimeve muzikore.

ANA O. Pseudonim i pacientes së Jozef Broierit (Joseph Breuer, 1842 – 1925) tashmë e njohur me emrin Berta Papenhajm, e cila ka qenë një grua e bukur, inteligjente dhe e edukuar. Vuante nga histeria me prirje funksionale edhe më të rënda (ankthi, halucinacioni, konfuzioni mendor etj.), duke mos pasur çrregullime organike. Simptomat e përmendura u zhdukën, e për rrjedhojë ajo u shërua, pas tregimit të kujtimeve të saj në gjendje hipnotike. Kjo formë e shërimit është quajtur metodë katardike ose metodë e shërimit me anë të bashkëbisedimit. Këtë rast e përmend Zigmund Frojdi me rastin e përcaktimit dhe të zbatimit të metodës psikanalitike të tij.

ANAGLIFI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *τικανάγλυφη*. Dukuria e të parit të dy figurave të një objekti, të një skene etj. të larguara pak nga njëra-tjetra, ku njëra është e ngjyrosur me ngjyrën e gjelbër dhe tjetra me ngjyrën e kuqe. Nëse secilën prej tyre e shohim me syza, ku njëri xham është i gjelbër dhe tjetri xham i të njëjtave syze është i ngjyrës së kuqe, atëherë secili sy e sheh veçmas figurën e vet në ngjyrën komplementare dhe, me këtë rast, njeriu përjeton dy figurat e para, të cilat

A

na japin pamjen tripërmasore. Shih – ***STEREOSKOPI.***

ANAGRAM, - I. m. I ardhur nga greqishtja *ανάγραμμα* "shkrim i anasjelltë". Anagrami është ndryshim i vendit të shkronjave për të formuar nga të njëjtat shkronja fjalë me kuptim të caktuar, p.sh., formim i fjalës me kuptim specifik, duke iu ndryshuar vendin shkronjave të fjalës anas: sana. Në psikologji anagrami është lloj detyre problemore, që përdoret në hartimin e testeve që provojnë zhvillimin e aftësive kognitive. Për këtë qëllim zbatohen këto forma të anagramit: 1) Nga shkronjat e ekspozuara të formohet fjala e caktuar, si raaofna : anafora, 2) Nga shkronjat e një fjale të formohet fjala tjetër, si lavaz : vazal dhe 3) Nga shkronjat e ekspozuara të krijohen sa më shumë fjalë dhe sa më shpejt.

ANAL, - E. mb. I ardhur nga latinishtja *anus*, që përcakton atë që ka të bëjë me anusin, shih – ***Anusi***. Ky mbiemër është i lidhur më tepër me psikanalizën, ku bëhet fjalë për fazën anale, për karakterin anal etj.

ANALGJEZI, - A. f. Në psikopatologji i ardhur nga greqishtja *av* "jo" dhe *αλγησία* "dhembje" që ka të bëjë me dukurinë psikofiziologjike të humbjes së ndjesisë së dhembjes, pra pandjeshmëria e njeriut ndaj dhembjeve. Shkaktohet nga ndikimi i disa substancave kimike, nga ndikimi i përkohshëm i analgjezikëve (substanca që largojnë dhembjen) në strukturat shqisore e nervore të dhembjes, por edhe nga dëmtimi i strukturave anatomike të analizatorit të dhembjes. Analgjezia në disa përmbajtje tekstesh ka edhe kuptimin e gjendjes së vetëdijshme të krijuar me qëllim të zvogëlimit të dhembjeve ose të neutralizimit të vetëdijshëm të tyre.

ANALITIK, - E. mb. Që ka të bëjë me analizën, që shërben për analiza, që zbaton analizën në veprimtarinë mendore etj. Kuptimi i tillë i këtij mbiemri përcaktohet saktësisht kur ky mbiemër përdoret me subjektin e caktuar, si p.sh. metoda analitike, situata analitike, testi analitik etj.

ANALITIK, - U. m. Term me kuptim të përgjithshëm dhe të veçantë. Kuptimi i përgjithshëm ka të bëjë me një individ që merret me analiza (në kimi, në biologji, në psikologji etj.). Kuptimi i veçantë përfshin dy fusha të psikanalizës: analitik – zbatues i metodës së psikoterapisë së psikanalizës së Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939) dhe analitik – zbatues i analizës në studimin e pavetëdijes kolektive dhe të arketipave të psikanalistit dhe ithtarit të psikologjisë analitike – Karl G. Jungut (Carl G. Jung, 1875 – 1961).

ANALIZ/Ë, - A. f. I ardhur nga greqishtja *ανάλυση* "zbërthim". Analiza është zbërthim i një tërësie fizike, organike, mendore etj. në disa pjesë dhe shërben si metodë gjurmuese e komponentëve përbërës të një tërësie të ndërlikuar në gramatikë, në kimi, në matematikë etj. Analiza për drejtimin strukturalist të psikologjisë ka qenë metodë e vetme e njohjes së elementeve psikike, që zbatohej me qëllim të identifikimit së strukturës së fundit të pandashme më tej, me të cilën përbëhen proceset psikike. Kjo qasje nuk ka arritur t`i përgjigjet pyetjes, se si është e mundur që nga sinteza e atyre strukturave të formohet tërësia e perceptimit, e ndjenjave, e motiveve etj.,

dhe si është e mundur që nga një tërësi psikike të hiqet njëra nga strukturat përbërëse dhe ajo prapë ta ruajë tërësinë e vet? Megjithëkëtë, termi analizë ka përdorim të shpeshtë dhe të diferencuar në psikologji.

ANALIZA DIDAKTIKE. Term i psikanalizës që ka të bëjë me aftësimin profesional të atyre që kanë kryer studimet universitare dhe duan të merren me psikanalizë, në rend të parë e të diplomuarve në psikologji. Zigmund Frojdi ka konstatuar se psikanaliza është baza e psikologjisë, por jo edhe e mjekësisë. Analizës didaktike mund t`i nënshtroheshin sipas Frojdit ata që kanë dijeni nga historia e artit, historia e kulturës, psikologjia, mjekësia etj.

ANALIZA E AJTEMAVE. Formë statistikore e të provuarit të karakteristikave metrike të testit (të shkallës së vlefshmërisë ose vlerës, të peshës, të besueshmërisë dhe të përmasës së diskriminimit) të secilës pyetje, detyrë, apo problem të testit. Analiza e ajtemave kryhet para përcaktimit përfundimtar të një testi me qëllim që testi, pyetësori etj. t'i ketë të përmbushura të gjitha karakteristikat metrike. Kështu, indeksi i peshës së lehtë ose të rëndë të ajtemave përcaktohet duke kërkuar raportin ndërmjet numrit të përgjithshëm të ajtemave dhe përgjigjeve apo zgjidhjeve të drejta të tyre. Nëse ndryshimi ndërmjet zgjidhjeve të drejta dhe tërësisë së ajtemave është i vogël, atëherë kjo tregon se ajtemat janë të vështira dhe nuk japin një pasqyrë të drejtë të ndryshores që provon testi (testi i aftësive, testi didaktik etj.). Proporcioni ideal i peshës së ajtemave do të ishte 50 : 50. 50 % e të provuarve ato njësi të testit ose ato ajtema i zgjidhin pozitivisht dhe 50 % nuk janë në gjendje t`i zgjidhin.

ANALIZA E ËNDRRAVE. Teknikë gjurmuese e përmbajtjes së ëndrrës që u zbatua nga ana e përfaqësuesve të psikanalizës. Sipas kësaj teknike psikanalitike synohet njohja e dëshirave të shtypura apo të ndrydhura dhe fuqia motivuese e tyre. Psikanaliza ka shfrytëzuar teknikën e analizës së ëndrrave të përshkruar nga klientët e tyre dhe më pas është kërkuar që përmbajtjen e ëndrrës së përshkruar klienti ta lidhë me disa sjellje të tij. Psikanalisti në analizën e përmbajtjes së ëndrrës dhe të lidhjes së saj me disa nga sjelljet e veçanta, shpesh jo të zakonshme, është përpjekur që ta bëjë subjektin të vetëdijshëm për motivet e vërteta të sjelljeve të çuditshme të tij dhe me ndërgjegjësimin e tij ai është çliruar nga pushtimi i personalitetit të tij nga shtytje të tilla dhe nga sjellje të çuditshme.

ANALIZA E KARAKTERIT. Identifikimi i tipareve të mbrojtjes së karakterit të një pacienti, kur ky i nënshtrohet terapisë psikanalitike. Termi analizë e karakterit i atribuohet praktikës dhe shkrimeve psikanalitike të psikanalistit amerikan me prejardhje austriake Vilhelm Rajh (Wilhelm Reich, 1897 – 1957).

ANALIZA E KOHËS DHE E LËVIZJEVE. Term i psikologjisë së punës i ardhur nga studimet e ekonomistit Tejlor dhe studentëve të tij. Kjo analizë ka të bëjë me përcaktimin e njësive më të vogla të një procesi pune, të cilat mund të maten. Përcaktimi i këtyre njësive ka mundësuar përcaktimin e kohës më të shkurtër gjatë së cilës mund të ekzekutohen ato lëvizje.

A

U zbatua me qëllim të racionalizimit të procesit të punës. Por ka disa të meta: kohëzgjatja e një procesi të punës nuk është vetëm shumë e njësive kohore të lëvizjeve, por edhe e tërësisë së atij procesi, si edhe e faktorëve të tjerë.

ANALIZA E PËRMBAJTJES. Metodë e analizës sasiore të ideve, të informatave, të qëndrimeve, të porosive etj. në përmbajtjen e tekstit të një fejtoni, fjalimi politik, novele etj. Për një analizë të tillë përcaktohet njësia analizuese, përkatësisht tema e analizës dhe qëndrimi, porosia etj. brenda asaj teme p.sh., porosia dhe shkalla e përsëritjes së saj, niveli i frekuencës së saj, evoluimi numerik i kësaj porosie politike dikur dhe sot, raporti i saj me njësitë e tjera të asaj përmbajtjeje etj. Në bazë të analizës së përmbajtjes së një teksti letrar, politik, social etj. mund të zbulohen dëshirat, synimet etj. të atij që e harton atë tekst. Analiza e përmbajtjes zbatohet edhe në përmbajtjet e materialit të pashkruar si të pikturave, të skenave filmike etj.

ANALIZA E QËLLIMIT DHE E MJETEVE. Formë e strategjisë hulumtuese që ka për qëllim të harmonizojë objektivin e gjurmimit me mjetet dhe me format e organizmit të gjurmimit të një çështjeje të një ndryshoreje psikologjike. Harmonizimi i tillë është i ndërlikuar, por është i domosdoshëm të kryhet me qëllim të realizimit objektiv të qëllimit hulumtues.

ANALIZA E TË DHËNAVE PSIKOLOGJIKE. Mbledhja, sistematizimi, klasifikimi, dhe përpunimi i të dhënave sasiore të përftuara nga matja e një ndryshoreje psikologjike në një grup subjektesh. Analiza e tillë ka për qëllim njohjen e prirjes së përgjithshme të zhvillimit të asaj ndryshoreje, të shkallës së ndryshimeve individuale të të dhënave, të nivelit të ndërlidhjes së tyre etj.

ANALIZA E VARIANCËS. Procedurë statistikore e përcaktimit të shkallës së ndryshimeve dhe atribuimit të tyre ndikimit specifik të një faktori ose atribuimit të këtyre ndryshimeve rezultateve të rastësishme. Për këtë qëllim testohet vlera sasiore e ndryshimeve ndërmjet dy vlerave të mesme aritmetike. Kjo procedurë mund të jetë e thjeshtë, kur e njëjta ndryshore provohet në disa situata eksperimentale dhe vlerat sasiore përpunohen për të dalluar sa ajo ndryshore është e varur prej një faktori apo prej disa faktorësh. Forma e ndërlikuar e analizës së ndryshores është ajo që ka të bëjë me analizën e rezultateve ku janë provuar njëkohësisht dy ose më shumë ndryshore të pavarura.

ANALIZA E VENDEVE TË PUNËS. Zbërthim i përmbajtjes, i kërkesave dhe i kushteve në një vend pune me qëllim të njohjes së tyre dhe përcaktimit adekuat të punëtorit, i cili duhet të jetë në gjendje fizike dhe psikike të tillë, që t`iu përgjigjet këtyre kërkesave. Analiza e tillë është e nevojshme, madje, në raste të posaçme edhe e domosdoshme për realizimin e një programi profesional dhe për zgjedhjen e një personeli të aftë për atë program. Kjo është baza nisëse jo vetëm e përzgjedhjes së punëtorëve adekuatë, por edhe e programimit të përsosjes profesionale të tyre.

ANALIZA FAKTORIALE. Teknikë e përpunimit të të dhënave të përftuara nga zbatimi i disahershëm i një testi në

një grup subjektesh ose i të dhënave të përftuara nga zbatimi i dy apo tri testeve ose pyetësorëve te i njëjti grup subjektesh, me qëllim identifikimin e faktorëve të përbashkët që marrin pjesë në funksionimin e një ndryshoreje psikologjike dhe të përcaktimit të saktë të përmasës së pjesëmarrjes së ndërlidhjes së tyre. Karakteristika kryesore e analizës faktoriale është reduktimi i numrit sa më të vogël të faktorëve që marrin pjesë në një numër sa më të madh ndryshoresh psikologjike, si edhe përcaktimi i shkallës së korrelimit të secilës ndryshore me faktorin e përbashkët të tyre. Krahas kësaj, me analizën faktoriale duhet të përcaktohet shkalla e lidhshmërisë së secilës ndryshore me faktorin e përbashkët të vërtetuar. Përdorimi i analizës faktoriale ka dy objektiva kryesorë: 1) Vërtetimin e një numri sa më të madh të ndryshoreve me sa më pak faktorë dhe 2) Testimin e hipotezës për numrin e faktorëve përgjegjës për rezultatet e arritura në matjen e një numri sa më të madh të ndryshoreve. Analiza faktoriale u zbatua në fillim për hulumtimin e strukturës së aftësive, përkatësisht të inteligjencës, kurse tashmë zbatohet në hulumtimin e faktorëve, të funksioneve, proceseve, strukturave të tërësishme psikike etj. në të gjitha fushat e psikologjisë eksperimendore. Teknikën e analizës faktoriale e kanë zbatuar për herë të parë në hulumtimet psikologjike psikologët Çarls Spirman (Charles Spearman, 1863 – 1945), Luis L. Terston (Louis L. Thurstone, 1887 – 1955), Siril Bërt (Cyril Burt, 1883 – 1971), Rejmond Katel (Raymond Cattell, 1905 – 1998), Robert Xh. Sternberg (Robert Stenberg, 1949), Robert Vudvord (Robert Woodworth, 1869 – 1962) etj.

ANALIZA FUNKSIONALE. Analiza e sjelljeve të njeriut duke marrë për bazë lëvizjet e jashtme të sjelljeve e jo faktorët e brendshëm motivues të asaj sjelljeje. Me këtë kuptim është përdorur termi analiza funksionale nga ana e Burhus Skinerit (Burrhus Skinner, 1904 – 1990).

ANALIZA REGRESIVE. Veprim statistikor, me anën e të cilit parashikohet rezultati i mundshëm i një subjekti në zhvillimin e një ndryshoreje, në bazë të njohjes së koeficientit të ndërlidhjes ose korrelacionit të një ndryshoreje me ndryshoren tjetër. Analiza përfshin disa veprime statistikore: gabimin standard të prognozës, ndryshueshmërinë reziduale etj. Ka raste kur mund të parashikohet me shkallë të lartë të besueshmërisë rezultati i një subjekti në zhvillimin e një ndryshoreje në bazë të ndërlidhjes ose korrelacionit të disa ndryshoreve.

ANALIZA SISTEMATIKE. Analiza e një veprimtarie që bëhet rregullisht sipas një sistemi me një qëllim të caktuar: analiza e procesit të prodhimit, analiza e metodave të të nxënit të përmbajtjeve abstrakte, analiza e arritjeve në zotërimin e gjuhës së huaj.

ANALIZA SITUACIONALE. Gjurmim analitik i proceseve psikike dhe i sjelljeve në situata natyrore, në kushte dhe raporte të natyrshme, përkatësisht analiza e proceseve dhe e sjelljeve jashtë kushteve artificiale, laboratorike. Kjo zbatohet sidomos në gjurmimin e procesve psikike dhe të veprimeve të kafshëve.

A

ANALIZA TRANSAKCIONALE. I ardhur nga latinishtja *transactio* "marrëveshje, ujdi" që ka të bëjë me përputhjen teorike të koncepteve fëmijë, i rritur, prindër, me konceptet psikanalitike id, ego dhe super ego. Komunikimi dhe ndërveprimi ndërmjet njerëzve konsiderohet ujdi apo transakcion ndërmjet gjendjeve të unit. Kjo është njëra ndër pikëpamjet psikoterapeutike të psikologut kanadez Erik Bern (Eric Berne, 1910 – 1970). Sipas tij secili individ reagon ndaj ngacmuesve të jashtëm sipas gjendjes së unit mbisundues të tij në atë moment. Analiza transakcionale konsiderohet formë e psikoterapisë, që ka për qëllim "t`i mësojë njerëzit për të njohur gjendjet e egos së tyre dhe të të tjerëve si edhe t`i zotërojnë gjendjet e tyre vetjake". Kështu, në moshën e rritur individi nuk duhet të reagojë me gjendjen e egos së fëmijërisë së tij.

ANALIZA THELLËSORE. Veprimi i posaçëm psikoterapeutik, sipas të cilit rikonstruktohen dëshirat, komplekset, konfliktet dhe traumat e hershme të njeriut në bazë të metodës së asociacioneve të lira, të shpjegimit të ëndrrave, gabimeve të rastësishme etj. duke e bërë pacientin të vetëdijshëm për këto, përkatësisht duke e liruar nga këto ngarkesa dhe duke krijuar mundësi për organizim të sjelljeve normale.

ANALIZANT, - E. Term i psikanalizës që ka të bëjë me nënshtrimin e një individi ndaj psikanalizës. Individët e tillë duhet të jenë të sinqertë, të aftë për verbalizimin e përmbajtjeve të sakta të pengesave, frustrimeve, të konflikteve etj., të motivuar për këtë proces, të gatshëm për bashkëpunim me psikanalistin etj.

ANALIZATOR, - I. m. Mekanizëm neurofiziologjik që përbëhet nga shqisat dhe receptorët e saj, nervi prurës (aferent), qendra e trurit dhe lidhja e saj me qendrat e tjera trunore. Funksioni i tërësishëm i analizatorit përbën bazën e ndijimeve dhe të perceptimeve. Termi analizator është i lidhur me teorinë e shkollës ruse të Ivan P. Pavllovit (Ivan P. Pavlov, 1849 – 1936), mjek dhe fiziolog i njohur rus.

ANALOGJI, - A. m. Term me kuptim të përgjithshëm i ardhur nga greqishtja *αναλογία* "ngjashmëri". Në psikologji ka kuptimin e përshkrimit, të shpjegimit dhe të arsyetimit sistematik të një dukurie, objekti, mendimi etj. në bazë të ngjashmërisë së tij me atë që tashmë e njohim. Me këtë kuptim analogjia përdoret në psikologjinë kognitive, përkatësisht në procesin e konkluzionit, kur në mbështetje të ngjashmërisë së dy a më shumë gjykimeve dhe lidhjeve ndërmjet tyre përfundojmë në një gjykim të përgjithshëm. Çdo ngjashmëri e tillë nuk çon në përfundime të drejta nëse i marrim në konsideratë dhe i vlerësojmë vetëm cilësitë e tiparet e ngjashme e jo edhe tiparet dalluese, nëse tiparet e ngjashme nuk janë tipare thelbësore dhe nëse këto nuk janë në lidhje të ngushtë ndërmjet tyre.

ANAMNEZ/Ë, - A. f. I ardhur nga greqishtja *ανάμνηση* "të kujtuarit". Anamneza është term i mendimit filozofik, i psikiatrisë dhe i psikologjisë klinike. Në psikiatri dhe në psikologjinë klinike ka kuptimin e tregimit të gjithë asaj që i kujtohet një pacienti për çrregullimin e sjelljes së tij, përkatësisht për sëmundjen e tij dhe pikëpamjen e vet për shkakun ose shkaqet

e asaj sëmundjeje. Anamneza është histori e sëmundjes (format e ankesave të para, fillimi i sëmundjes, zhvillimet e saj, historia e familjes etj.). Me qëllim anamneze shfrytëzohen edhe përmbajtjet e dokumenteve të shkruara për historinë e sëmundjes. Në psikologji përgjithësisht anamneza është vetëndërgjegjësimi i njeriut për ato ide, ndjenja, motive etj. që ai ka kujtuar se janë zhdukur me kohë nga kujtesa e tij.

ANATOMI, - A. f. Term i greqishtes me të njëjtin emër. Anatomia është shkenca që studion strukturën dhe formën e organeve, të sistemeve dhe të indeve të tyre - përbërës të organizmit. Këtë e studion në lidhje reciproke me funksionin që kryejnë gjatë gjithë fazave të zhvillimit të organizmit. Ndahet në anatomi të përgjithshme që studion ndërtimin e organeve dhe të organizmit në përgjithësi dhe në anatomi patologjike, që studion ndryshimet strukturore të indeve dhe të qelizave që pësojnë organet nga sëmundjet. Anatomia është ndër lëndët e rëndësishme për studimet e psikologjisë. Madje, anatomia e fiziologjia e sistemit nervor, e shqisave dhe e muskujve, si edhe sistemi integral i funksionimit të tyre në kuadrin e organizmit është ndër kushtet kryesore të studimit të proceseve psikike dhe të bazës biologjike të sjelljeve.

ANCIOZITET, - I. m. I ardhur nga latinishtja *anxietas* "ankth". Anciozi-teti është term ndërkombëtar. Shih – ***ANKTHI.***

ANDRAGOGJI, - A. f. Disiplinë e sistemit të shkencave pedagogjike që merret me studimin sistematik të proceseve edukative e arsimore, të metodave, mjeteve dhe formave organizuese të këtij procesi te të rriturit. U aktualizua me zhvillimin industrial dhe teknik. Andragogjia shfrytëzon arritjet e fiziologjisë, të pedagogjisë, të psikologjisë, të sociologjisë etj. Zhvillimi i saj mori hov pas përfundimit të Luftës II Botërore, kryesisht në Angli, Francë, Gjermani, SHBA etj.

ANDROGJEN, - I. m. I ardhur nga greqishtja *ανδρο* "njeri mashkull" dhe *γύνης* "i lindur". Tërësia e hormoneve seksuale mashkullore që luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin e karakteristikave mashkullore, të shtytësit seksual, të sjelljeve seksuale mashkullore dhe në zhvillimin e procesit riprodhues (testosteroni dhe androsteroni që ka veprim më të dobët se testosteroni. Androgjenet gjenden te meshkujt dhe te femrat, por janë dominues te meshkujt. Këtë hormon e sekretojnë testikujt dhe cipa e gjëndrave mbiveshkore (në sasi të vogël) te meshkujt, kurse në sasi më të vogël sekretohet nga vezoret e femrave.

ANDROGJENITET, - I. m. Veçori e femrave ose e meshkujve te të cilët janë të zhvilluara në masë relativisht të barabartë si karakteristikat mashkullore, ashtu edhe ato femërore. Këto janë ato veçori që marrin përmasa të tipareve stereotipe, që mjedisi kulturor i caktuar iu atribuon vetëm meshkujve ose vetëm femrave. Haset një numër i kufizuar i individëve me veçori të tilla. Këta individë arrijnë shkallë të lartë si në matjen e veçorive mashkullore, ashtu edhe në matjen e veçorive femërore.

ANDROMANI, - A. f. Dëshira seksuale me impulse të pakontrolluara

të grave për plotësimin e shtytësit seksual. Shfaqet me pamundësi të ruajtjes së dashurisë së qëndrueshme ndaj bashkëshortit. Përmendet e përshkruar hollësisht që nga shekulli i tetëmbëdhjetë. Shih – ***NIMFOMANIA.***

ANEKTOD/Ë, - A. f. I ardhur nga greqishtja *ανέκδοτο* "i pabotuar". Anekdota është përmbajtje më tepër popullore e formuluar në mënyrë të shkurtër, me mendime të mprehta, me stil të shkathët, që paraqet një dukuri, individ, situatë, duke nxjerrë në pah pozitiven me prirjen për kultivim të saj, por duke kritikuar ashpër negativen. Është formë e mendimit popullor e përhapur mjaft edhe ndër shqipfolësit.

ANESTEZI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *av* "jo"dhe *αλγησία* "që shkakton dhembje". Gjendje e veçantë e organizmit, e cila krijohet si pasojë e administrimit të një ose disa lëndëve dhe që karakterizohet nga analgjezia, amnezia, mbrojtja neurovegjetative, e shoqëruar në shumicën e rasteve me miorelaksim (lëshim i muskujve). Më pas u zëvendësua nga termi anestezi e përgjithshme, që përdoret edhe sot, që realizohet nga kombinimi i disa lëndëve: analgjezike, hipnotike dhe miorelaksante. Anestezia është degë relativisht e re në familjen e disiplinave e të shërbimeve mjekësore. Lindi më 1846, kur u bë dhe anestezia e parë, dhe u quajt fillimisht narkozë. Në psikologji me anestezi kuptohet më tepër humbja e pjesshme ose e tërësishme e njohjes së fortësisë, të gjendjes agregate, të ftohtësisë dhe të nxehtësisë së trupave që veprojnë në lëkurë, si edhe humbja e ndjeshmërisë së dhembjes. Njihet dhe anestezia histerike – mungesë e ndjeshmërisë së modaliteteve shqisore që shkaktohet nga faktorët psikogjenë, e në rend të parë, nga konfliktet e brendshme dhe frustrimet.

ANËSI, - A. f. Të mbajturit e anës së interesimeve, të qëndrimeve, të përcaktimeve etj. gjatë vlerësimit të rezultateve të arritura në zbatimin e anketës, të intervistës, të testit etj. Anësia është prirje e vlerësuesit për të dhënë vlerësime pozitive vetëm për atë me të cilën vlerësuesi pajtohet, asaj që pajtohet me situatën e dhënë politike, sociale etj. "Shëndeti" i mirë i zbatimit të drejtë të instrumenteve hulumtuese dhe i vlerësimit objektiv të rezultateve kërkon domosdoshmërish mënjanimin e vlerësuesve jo objektivë dhe eliminimin e faktorëve anësorë.

ANGËSHTI, - A. f. Fjalë popullore që përdoret në disa krahina shqipfolëse, që ka kuptim të përafërt me termin ankth, përkatësisht emërton frikën që të zë frymën, një gjendje emocionale negative difuze etj. Mund të ketë ardhur nga latinishtja *angustus* Shih – ***ANKTHI.***

ANGINA. f. Term i patologjisë dhe i psikologjisë klinike i ardhur nga latinishtja *angina*. Angina është dhembje e fortë shtrënguese e shoqëruar me sulme agushimi, përkatësisht me ndjesi të pengesave në frymëmarrje dhe me frikë të madhe. Angina kuptohet më lehtë kur bëhet fjalë për atë të gjoksit, përkatësisht për *angina pectoris* (pektoris) – dhembje e fortë e zemrës me simptomën e ndjesisë së shtypjes së madhe të të zënit të frymës. Shkak-

tohet nga pakësimi i sasisë së gjakut në zemër si pasojë e ngushtimit të arteries koronare.

ANHEDONIZ/ËM, - I. m. I ardhur nga greqishtja αν "jo" dhe *ηδονία* "kënaqësi". Humbje e aftësisë për të përjetuar dhe shijuar kënaqësitë e zakonshme të jetës dhe të aktiviteteve të përditshme. Haset në disa çrregullime mendore, por shkaku i kësaj humbjeje është i panjohur, ndonëse rrallë shfaqet e izoluar nga çrregullimet e tjera psikike.

ANIMA. f. I ardhur nga latinishtja *anima* "shpirti". Term i leksikonit të koncepteve kryesore të psikologjisë analitike apo komplekse të Karl G. Jungut (Carl G. Jung, 1875 – 1961). Anima është strukturë e pavetëdijshme, përkatësisht fotografia shpirtërore e femrës së fshehur në psikikën e mashkullit. Sipas Karl G. Jungut "secili mashkull ka gjithmonë me vete një fotografi femre dhe kjo është fotografi e një femre çfarëdo. Kjo fotografi është në themel pjesë e trashëgimisë kryesore, që ka ardhur nga parahistoria dhe ka hyrë në sistemin jetësor; është tip (arketip) i përvojës së gjithëmbarshme të brezave të tërë për qenien e femrës, sublimimin e të gjitha mbresave për femrat, sistem i trashëguar psikik i përshtatjes". Te meshkujt kjo është fotografia parahistorike e gjinisë së kundërt. Fotografia (arketipi) e tillë paraqitet në fantazinë e mashkullit në formë të zanës, të nënës, të shtrigës plakë etj.

ANIMATIZ/ËM, - MI. m. Besimi në një "substancë"parashpirtërore që e përçon gjithë trupin e njeriut dhe mjedisin e tij. Sipas themeluesit të psikologjisë empirike Vilhelm Vuntit (Wilhelm Wundt, 1832 – 1920) animatizmi ka të bëjë me lidhjen e të gjitha proceseve jetësore me shpirtin; shpirti është fillesë e jetesës. Shih – ***PANPSIKIZMI.***

ANIMIZ/ËM, - MI. m. Term që ka për bazë fjalën latine *anima* "shpirt". Animizmë është dhënie shpirti, atribuimi i shpirtit dhe i veçorive të njeriut të gjitha objekteve dhe dukurive inorganike dhe organike, duke e trajtuar këtë, madje, si shkak i ndryshimeve dhe i lëvizjeve të tyre. Mbështetet në bindjen se gjësendet inorganike dhe organike i vë në lëvizje shpirti dhe vullneti. Termi ka hyrë në antropologji nga ana e antropologut britanik Eduard B. Tejlor (Edward B. Tylor, 1832 – 1917) në veprën e tij "*Primitive Culture*"– ("*Kultura primitive*"), e botuar më 1871. Po ashtu, këtë e ka theksuar edhe antropologu francez Lësien Levi –Brul (Lucien Lévy–Bruhl, 1857 – 1939) në veprën e tij "Les Functions Mendores dans les Societes Inferieures" – ("Funksionet mendore në shoqëritë inferiore"), botuar më 1910, i përkthyer në gjuhët e tjera me titullin "Mentaliteti primitiv". Psikologu zviceran Zhan Piazhe (Jean Piaget, 1896 – 1980) ka konsideruar se animizmi është njëra ndër veçoritë e mendimit të fëmijëve të moshës së hershme. Këta besojnë se hëna lëviz sipas dëshirës së saj, se dielli i sheh sjelljet e tyre në rrugë, se guri ka dhembje, kur atij i mëshohet me këmbë ose me një gur tjetër etj.

ANIMIZMI NË PSIKANALIZË. Mënyrë primitive e konceptimit të gjithësisë me të gjitha format e zhvillimet

e saj, karakteristik për fazën e parë të zhvillimit të mendimit njerëzor mbi natyrën dhe për dukuritë e saj. Animizmi ka qenë koha pa fe dhe pa perëndi e zhvillimit të mendimit njerëzor. Por, "edhe atëherë bota ka qenë plot me qenie shpirtërore antropoide (ato ne i quajmë demonë).... ". Këtë e ka përpunuar Zigmund Frojdi (Sigmund Freud, 1856 – 1939) në veprat e tij, sidomos në veprën e njohur "Hyrje në psikanalizë"e përkthyer edhe në shqip më 2005 dhe në veprën "Totem dhe tabu", të përkthyer në shqip më 2003.

ANIMUSI. m. I ardhur nga latinishtja *animus* "frymë". Derisa anima ishte fotografia e mashkullit në strukturën psikike të femrës, animusi është fotografia e mashkullit në strukturën psikike të femrës. Kështu, haset në psikologjinë analitike apo komplekse të Karl G. Jungut. Sipas tij "E pavetëdijshmja ka si të thuash parashenjë mashkullore. . . Siç i përgjigjet anima erosit amnor, kështu animusi i përgjigjet logosit të babait. Te meshkujt erosi, përkatësisht funksioni gjegjës, sipas rregullit është më pak i zhvilluar se logosi. Te femrat, përkundrazi, erosi përfaqëson shprehjen e natyrës së vërtetë të tij". Animusi te femrat është ndërmjetës në mes të funksionit të unit të vetëdijshëm dhe të femrës dhe përmbajtjes së panjohur të pavetëdijes së saj.

ANKET/Ë, - A. f. I ardhur nga frëngjishtja *enquete* "kërkim". Anketa lloj i procedurës gjurmuese të qëndrimeve, të bindjeve, të interesimeve dhe të vlerave shoqërore te një grup individësh të një popullate. Anketa realizohet me anë të fletanketave, që hartohen sipas rregullave psikologjike dhe gjuhësore. Është pjesë përbërëse e një projekti gjurmues. Përgjigjet e dhëna grumbullohen dhe studiuesi i përpunon në bazë të qëllimit të anketës. Zakonisht bëhet në formë anonime. Zbatohet më tepër në psikologjinë sociale. Zbatimi i anketës me anë të fletanketës realizohet sipas këtyre fazave: 1) Hartimi i pyetësorit sipas një qëllimi të përcaktuar saktësisht të çështjes që do të gjurmohet, formulimi i shkurtër, i qartë, jo i dykuptimshëm dhe josugjestiv i pyetjeve, si edhe sistemimi i tyre duhet të kuptohet nga ata që anketa do t`iu drejtohet; 2) Përzgjedhja e subjekteve sipas rregullave të përfaqësimit të mirëfilltë të popullatës; 3) Mbledhja dhe sistematizimi i përgjigjeve dhe 4) Përpunimi statistikor i përgjigjeve. Me anë të anketës mund të arrihet në njohjen e disa përjetimeve dhe formave të sjelljes sipas qëndrimeve, interesimeve, vlerave etj., por vetëm të atyre që duan dhe dëshirojnë të anketohen. Anketa dhe procesi i anketimit ka tri subjekte: udhëheqësin e anketimit, të anketuarit dhe vlerësuesit e përgjigjeve.

ANKETA KUDER E INTERESIMEVE PËR PROFESIONE. Lloj instrumenti për përcaktimin dhe matjen e interesimeve për profesione. Anketa Kuder e interesimeve për profesione ka 168 kategori me tri lloj nivelesh. Anketa përbëhet nga 10 fusha të interesimit që shprehin fushën e interesimit të subjektit për profesione të ndryshme, si: administrative, artistike, mekanike, persuasive dhe shkencore. Në këtë anketë subjekti zgjedh vetëm tri nga ato aktivitete që me ëndje do t`i bënte dhe tri nga aktivitetet e tjera që nuk kishte për t`i bërë. Rezultati i secilit subjekt në anketën Kuder ka

të bëjë vetëm me parapëlqimin e atij subjekti për profesionin e caktuar. Anketa mori emrin e hartuesit të saj, psikologut amerikan Frederik Xh. Kuder (Frederic G. Kuder, 1903).

ANKETUARI (I). Subjekti apo subjektet që i nënshtrohen procesit të anketimit dhe studiuesi iu referohet përgjigjeve të dhëna në instrumentin e anketës, përkatësisht në pyetësorin e parashtruar. Këto janë burim i të dhënave psikologjike, që i nënshtrohen përpunimit të tyre**.**

ANKIM, - I m. Term që emërton dhembjen, pakënaqësinë për një të papritur dhe për këtët shkak ka marrë përmasën e një termi të psikologjisë. Është fjalë e term burimor i shqipes, që haset te shkrimtarët e vjetër shqiptarë (Buzuku, Budi). Në terminologjinë e psikologjisë ka ardhur nga terminologjia juridike.

ANKTH, - I. m. I ardhur nga latinishtja *anxietas* "shqetësim, kokëçarje e madhe duke mos ditur shkakun". Ankthi është ndjenjë e ndërlikuar e frikës së madhe, e mërzisë, e tensionimit të organizmit dhe e pasigurisë së njeriut nga dyshimet dhe nga shkaqet e panjohura ose të supozuara. Për gjuhëtarët ankthi është "ëndërr e keqe që të zë frymën, shqetësim i madh". Këtë fjalë-term e hasim te Fjalori i Kristoforidhit që nga fillimi i shekullit njëzet, saktësisht nga viti 1904. Kjo ndjenjë e ndërlikuar ka bazë fiziologjike; baza fiziologjike e ankthit është veprimi i përforcuar i sistemit nervor autonom. Shfaqet me simptoma të çuditshme të merakut të njeriut se ajo që e pret do të jetë e tmerrshme, do të sjellë një të keqe të madhe. Dallohet nga frika, sepse ankthi nuk ka objekt të caktuar të ankthit, kurse frika shkaktohet nga objekti, situata etj. e caktuar. Ankthi ka përmasën e motivit që e shtyn individin të marrë masa vepruese të caktuara. Termi ankth u përdor nga themeluesi i psikanalizës, Zigmund Frojdi (Sigmund Freud, 1856 – 1939) me rastin e përshkrimit të neurozës ankthore. Kjo gjendje shkaktohet nga frika e rrezikut, nëse i mundësohet depërtimi i energjisë së ndonjë shtytësi të pavetëdijshëm. Por, termi ankth sot është bërë term i rëndomtë i psikopatologjisë dhe i psikologjisë klinike.

ANKTHI ANTICIPUES. Gjendje psikike (emocionale dhe kognitive) e fiziologjike e njeriut, i cili pret shfaqjen e drojës dhe të frikës me rrjedhime negative të tyre, si: humbje e kontrollit të vetëdijshëm të aktiviteteve, panik, çrregullime të proceseve fiziologjike të organizmit etj.

ANKTHI DHE FRIKA. Term togfjalësh që emërton koncepte të ndryshme. Ankthi emërton rrezikun e brendshëm të pavetëdijshëm të njeriut ndaj fillimit dhe rrjedhës së çfarëdolloj aktiviteti të tij. Frika është pasojë e shkaktuar nga rreziku i mundshëm i një objekti, dukurie, i një situate etj. dhe mjedisit të jashtëm. Për rrezikun e tillë si edhe për frikën e shkaktuar nga ky rrezik njeriu është i vetëdijshëm.

ANKTHI EKZOGJEN. Lloj i ankthit patologjik që shkaktohet nga veprimi i dukurive të jashtme, i përfytyrimeve të gjalla, i mendimeve pushtuese etj., që shoqërohen me një frikë relativisht të madhe të njeriut, ndjeshmëri të shtuar të individit, rritje të vështirësive dhe pengesave etj.

A

ANKTHI ENDOGJEN. Lloj ankthi që lind nga faktorët e brendshëm të organizmit, nga konflikti i motiveve intensive, nga përjetimi i gjendjeve emocionale intensive të pakontrolluara etj.

ANKTHI I INDUKTUAR. Ankth i nxitur nga psikoterapeuti për të krijuar gjendje zbutjeje të ankthit, duke organizuar ushtrime provokuese të gjendjes ankthore. Me këtë rast aktivizohen ndryshime fiziologjike të lidhura me gjendje ankthi dhe pacientët këto i perceptojnë për të qenë të vetëdijshëm dhe për t`u aftësuar për zotërimin e gjendjeve ankthore.

ANKTHI I MUAJIT TË TETË. Frika e fëmijës që paraqitet ndaj fytyrave të njerëzve të panjohur. Kjo formë e ankthit shfaqet rreth muajit të tetë pas lindjes dhe ka këto forma manifestuese kryesore: kthimi i fytyrës duke kërkuar t`ëmën, të qarët me zë, shqetësimi i përgjithshëm etj. U përshkrua për herë të parë nga psikologu amerikan me origjinë austriake Rene A. Shpic (Rene A. Spitz, 1887 – 1974). Sipas tij ankthi i muajit të tetë ka rëndësi të posaçme në zhvillimin e fëmijës. Ky është raport objekti kalues, i cili tregon se fëmija ka arritur të bëjë dallimin e individëve të tjerë të panjohur (të objektit, njeriut, mjedisit etj.) nga objekti i lidhur më së shumti emocionalisht, pra nga e ëma.

ANKTHI INSTINKTIV. Term i psikanalizës, sipas kuptimit të të cilit kuptohet shfaqja e simptomave të ankthit, të shkaktuar nga energjia depërtuese e shtytësve të shtresës së personalitetit të idit ose esit.

ANKTHI MANIFESTUES. Formë e përjetimit të posaçëm të mërzisë dhe papërshtatshmërisë së njeriut, që ka këto cilësi kryesore: është i vetëdijshëm për këtë dhe e heton dhe e dallon mërzinë e madhe, mposhtet nga disa probleme personale, ka çrregullim të përqendrimit të vëmendjes, priret ndaj të këqijave etj. Ndryshimet fiziologjike kryesore të njeriut me ankth manifestues janë: përshpejtimi i ritmit të rrahjeve të zemrës, djersitje e pazakonshme e shuplakave të duarve, tharja e buzëve etj. Këto ndryshime fiziologjike i përkasin më tepër funksionimit të sistemit nervor autonom. Ankthin manifestues psikanaliza e shpjegon kryesisht si simptomë të konfliktit personal të shtypur ose të ndrydhur.

ANKTHI NEUROTIK. Term i themeluesit të psikanalizës Zigmund Frojd (Simund Freud, 1856 – 1939). Me këtë term ka emërtuar praninë e frikës së pakuptimtë akute dhe kronike para dhe gjatë një aktiviteti, një pune të caktuar. Sot ky term përdoret rrallë dhe këtë e ka zëvendësuar termi çrregullimi i përgjithshëm ankthor – ankth kërcënues i përhershëm i shoqëruar me frikë të madhe, që manifestohet me dridhje të përhershme, me ritmikë të përshpejtuar të të rrahurit të zemrës, me pengesa në tretjen e ushqimit.

ANKTHI OBJEKTIV. Lloj i posaçëm i ankthit, që shfaqet me njohjen dhe përcaktimin e saktë të shkakut real të ankthit. Rastet e tilla janë të rralla, sepse ankthin e vërtetë e karakterizon më tepër frika, tensioni, shqetësimi psikik i njeriut, kryesisht në mungesë të objektit të ankthit.

ANKTHI ORGANIK. Ankthi i një njeriu, i cili është në dijeni për

mosfunksionimin e duhur të një organi të trupit të tij dhe përjeton vuajtje të tepruara, të shoqëruara me një frikë të madhe për sëmundje organike.

ANKTHI PARAPRIRËS. Gjendje ankthi që karakterizon një individ që pret të ndodhë një ndodhi, ngjarje, situatë dhe kjo pritje provokon ankth. Ndodhia, ngjarja, situata përjetohet, por nuk është e thënë se shkakton ankth.

ANKTHI THEMELOR. Term i psikologjisë së Karen H. Hornei (Caren H. Hornay, 1883 – 1952) që emërton frikën që shkakton pasiguri dhe dyshim në mundësinë e kryerjes me sukses të një detyre, pune etj. Sipas saj ankthi themelor ose ankthi bazë është burimi i problemit të përshtatjes të individit ndaj kërkesave të mjedisit të tij. Përjetohet si izolim i njeriut nga mjedisi, lënie pas dore e tij nga të tjerët e një mjedisi armiqësor. Paraqitet që nga mosha e fëmijërisë së hershme, në raportet e tilla ndërmjet fëmijës dhe prindërve të tij, kur fëmija dallon moskujdesin e duhur të tyre, kur këta janë dominues, e nënçmojnë fëmijën e tyre dhe sjelljet e tij i përqeshin. Dalja nga kjo gjendje psikike angazhon energji psikike, që vë në veprim personalitetin.

ANOKSI, - A. f. I ardhur nga greqishtja αδ "jo" dhe oξύς "i mprehtë". Anoksia është mungesa e sasisë së duhur të oksigjenit në indet e trupit, duke përfshirë edhe në rend të parë vështirësitë në furnizimin e gjakut me sasi të mjaftueshme të oksigjenit. Kjo ndodh kur njeriu gjendet në hapësira të larta mbi 4000 m. Anoksia shkakton çrregullime fiziologjike dhe psikike. Ndër këto ndryshime dallohen: lodhja e madhe e organizmit, dobësimi i aftësisë së perceptimit, rënia e aftësisë së procesit të mendimit dhe të të folurit, gjendja e pavetëdijshmërisë etj. Nëse gjendja e anoksisë zgjat mbi gjashtë minuta shkaktohen dëmtime anatomike e funksionale të trurit dhe së bashku me këto ndryshime shfaqen ndryshime negative sjelljesh, që janë të pariparueshme.

ANOMALI, - A. f. I ardhur nga greqishtja α "jo" dhe νομία "ligj". Anomalia është çrregullim, zhvillim i çrregulluar që shmanget nga zhvillimi normal, nga ai që ka karakter të ligjit dhe, për këtë, anomalia konsiderohet se është shmangie nga ajo që pritet. Në psikologji anomalia është zhvillim jonormal i një procesi, sjellje, strukture, tipari psikik etj.

ANOMALIA MORAL INSANITY. Një ndër format më të theksuara të anomalisë së mendimit, të ndjenjave dhe të sjelljeve morale. Anomalia moral insanity manifestohet me mungesën e plotë të kuptimit për të mirën dhe për gjendjen e vështirë të tjetrit, me mungesën e plotë të ndjenjës së pikëllimit për gjendjen e vështirë të të tjerëve, me shkallën e moszhvillimit të ndjenjës së fisnikërisë, të altruizmit, të nderit, të detyrës etj. Anomalia moral insanity mund të jetë pasojë e sëmundjeve të ndryshme psikotike dhe e kushteve të rritjes së njeriut në një mjedis të shthurur moralisht, ku bëhet pak fjalë për edukatën morale.

ANOMALIA SEKSUALE GJENITALE. Veprim seksual jonormal, të cilin e hasim te ata individë që nuk kanë sjellje seksuale sipas parimeve dhe normave morale të mjedisit të

tyre. Sjelljet e tilla (homoseksualiteti, fetishizimi etj.) nuk janë sjellje seksuale patologjike; këto anomali nuk i përkasin anomalive biologjike dhe anatomike të seksualitetit.

ANOMALITË E TË FOLURIT. Forma të të folurit të parregullt të një individi që shfaqen me çrregullim të shprehjes së artikuluar të mendimit, të ndjenjave etj., si edhe me çrregullim të shprehjeve në formë të shkruar. Këto shfaqen në dy forma çrregulluese kryesore: çrregullime funksionale duke ruajtur strukturën anatomike të aparatit të të folurit dhe si çrregullime organike – pasojë e dëmtimit të strukturës së organeve të të folurit. Shih **- *LOGOPATIA.***

ANOMALITË MOTORIKE. Çrregullime të lëvizjeve të organizmit dhe të organeve të tij, që kanë të bëjnë me parregullsi të sistemit lëvizor e bazës neuro-organike e fiziologjike të sistemit nervor. Dallohen tri forma kryesore të anomalive motorike: dobësim i energjisë së muskulaturës, pengesa në koordinimin e lëvizjeve dhe lëvizje me bazë patologjike të mirëfilltë.

ANOMALITË NDIJIMORE. Çrregullime të ndijimeve dhe perceptimeve të të gjitha modaliteteve shqisore. Këto kanë të bëjnë me pamundësinë e njohjes së cilësive të trupave dhe të energjisë që shkaktojnë ndijime dhe perceptime të tyre, kur këta ushtrojnë ndikim në shqisat e njeriut. Anomalitë ndijimore mund të shkaktohen nga dëmtimi i strukturës së aparatit ndijimor, duke përfshirë edhe dëmtimin e strukturës së qendrave të caktuara të cipës së trurit të madh. Këto mund të shkaktohen edhe nga çrregullimet funksionale të pjesëve të aparatit ndijimor të organizmit të njeriut.

ANOMI, - A. f. Term i sociologjisë dhe i psikologjisë sociale i ardhur nga greqishtja *a* "jo"dhe *nomos* "ligj". Ka dy kuptime të ngushta psikologjike e sociologjike: 1) Lloj i afazisë, që ka të bëjë me humbje të pjesshme apo të plotë të aftësisë së mbajtjes mend të emrave të njerëzve, të dukurive, objekteve etj.; 2) Ndjenja e izolimit, e shkëputjes së lidhjeve farefisnore dhe ndërqytetare, që e përjetojnë sidomos banorët e vendeve urbane dhe të industrializuara. Gjendjen e tillë ua imponon shkalla e lartë e zhvillimit të industrisë dhe teknologjisë. Termi anomi u përdor për herë të parë nga sociologu francez Emil Durkem (Emile Durkheim, 1858 – 1917) për të emërtuar mungesën e normave ligjore të zhvillimit të shoqërisë, duke përfshirë edhe moszbatimin e tyre, përkatësisht kontrollin e moszbatimit të tyre, dukuri, që shpie në çrregullim të ndërgjegjes, të vetëdijes morale dhe të sjelljeve individuale e kolektive që e destabilizojnë shoqërinë e një mjedisi të caktuar. Gjendja e tillë shfaqet sidomos në mjediset ku kryhen kthesa të fuqishme të sistemeve politike, sociale dhe ekonomike. Të tilla mund të jenë gjendjet e atij mjedisi që kalon nëpër kriza të rënda ekonomike, sociale etj. Sipas Emil Durkem (Emile Durkheim, 1858 – 1917) gjendjet e këtilla u shkojnë për shtat shfaqjes së formave të ndryshme të sjelljeve delikuente.

ANOREKSI, - A. f. Dukuri e mungesës së oreksit për marrjen e ushqimit me sasinë dhe cilësinë e duhur. Anoreksia shfaqet me neveri ndaj ushqimeve, me marrje të sasisë së vogël dhe të pamjaf-

tueshme të ushqimit. Forma e parë e paraqitjes së anoreksisë është e lidhur me ndarjen e fëmijës nga të ushqyerit me qumësht të gjirit. Te të rriturit anoreksia mund të ketë karakter social, që me tepër shfaqet te femrat, të cilat nuk marrin sasi të mjaftueshme dhe të duhura të ushqimit nga druajtja e të shëndoshurit. Kjo dukuri "femërore" është e njohur më tepër me termin latin *anorexia nervosa*. Mund të jetë pasojë e çrregullimit të funksionit të asaj pjese të talamusit, e cila kontrollon marrjen e sasisë së duhur të ushqimit në organizëm.

ANORMALITET, - I. m. Sjellje që shmangen nga sjelljet normale të popullsisë së një mjedisi kulturor të posaçëm. Anormaliteti është term përmbledhës për të gjitha sjelljet e qëndrueshme që nuk përputhen me parimet dhe me normat e sjelljeve normale të popullatës së një mjedisi. Ka kuptim jo të njëjtë për mjediset kulturore të ndryshme. Shih – ***ANOMALIA.***

ANOZMI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *av* "jo" dhe *οσμια* "erë, aromë". Anozmia është mungesë apo humbje e ndjeshmërisë nuhatore. Kjo ka të bëjë me mosndjeshmërinë e erërave të trupave të ndryshëm të gjendjes flurore (të erës së benzinës, të kalbësirave, të trëndafilit etj.). Anozmia mund të jetë mungesë e përkohshme ose e përhershme. Anozmia e përhershme është humbje e ndjeshmërisë nuhatore ndaj të gjitha llojeve të erërave. Anozmia e përkohshme është kalimtare (shfaqet pas disa sëmundjeve). Anozmia e përhershme shkaktohet nga çrregullimi i funksionit receptor dhe i proceseve fiziologjike të lidhura me shqisën e nuhatjes dhe e një pjese të trurit ballor.

ANOZOGNOZI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *νοσο* "sëmundje"dhe *γόνος* "njohje". Term i psikiatrisë dhe i psikologjisë klinike. Emërton paaftësinë e një individi për ta njohur sëmundjen dhe çrregullimin psikik nga i cili vuan, duke mos qenë njëkohësisht i pavetëdijshëm për këtë dhe shkaqet e saj.

ANSHMËRI, - A. f. Përkrahës i padrejtë i njërës anë, i njërit grup, individ etj. Në gjurmimet profesionale dhe shkencore anshmëria është joobjektiviteti i gjurmuesit që ndikon në përzgjedhjen e fakteve, të kampionit përfaqësues, të interpretimit dhe të vlerësimit të rezultateve sipas dëshirës dhe bindjeve personale.

ANTAGONIST, - E. mb. I ardhur nga greqishtja *ανταγωνισμός* "kundërshtim, veprimtari e kundërt"; që është e kundërt ndaj dukurisë tjetër, që i kundërvihet funksionit të organit tjetër, që duke iu kundërvënë e pengon ose e neutralizon funksionin e organit tjetër etj. Ky term në psikologji ka ardhur nga fiziologjia, ku bëhet fjalë për muskujt antagonistë të organizmit (shtrirja e njërit – e muskulit ekstensor, tërheq mbledhjen e tjetrit – të muskulit fleksor), një hormon vepron në të kundërtën e hormonit tjetër etj. Në psikologji kemi disa procese antagoniste, si proceset e vetëdijshme dhe të pavetëdijshme, racionale dhe irracionale etj.

ANTAGONIZ/ËM, - MI. m. Në psikologjinë fiziologjike emërton raportin kundërveprues të një procesi nervor ndaj tjetrit, gjendjen fiziologjike e psikike të shkaktuar nga kundërveprimi i fuqive të kundërta. I tillë është raporti ndërmjet funksionit të pjesës simpatike dhe parasimpatike të sistemit nervor autonom që në përbashkësinë e tyre

vepruese sigurojnë funksionimin e rregullt të organeve trupore dhe gjendje të caktuara emocionale të njeriut**.**

ANTEROGRAD, - E. mb. Term që përcakton atë që ka ndodhur pas një ngjarjeje. Kështu, amnezia anterograde është pamundësia e rikujtimit të ngjarjeve që kanë pasuar pas përjetimit të një traume; ndikimi i traumës ka shkaktuar pamundësinë e të kujtuarit të gjithë asaj çfarë ka ndodhur pas traumës. Shih – ***AMNEZIA RETROGRADE.***

ANTICIPIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *anticipare* "merret para kohës". Anticipimi në psikologji është përcaktim paraprak i objektivit të veprimtarisë së caktuar, gjendja emocionale dhe kognitive e pritjes së një ngjarjeje që do të vijë në të ardhmen e shpejtë. Kjo është parapritje e asaj që do të vijë dhe përgatitja e njeriut për të pranuar, perceptuar prurjen që do të vijë. Anticipimi i tillë mund të bëhet për shkaqe psikike ose sipas ligjeve logjike. Mund të shkaktojë lehtësi në perceptimin përmbajtësor të asaj që do të perceptohet, por ndodh që të shkaktojë perceptim jo objektiv, sepse ai do t`i përshtatet bindjes, interesimit, qëndrimit të perceptuesit**.**

ANTIFONI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *αντι* "kundër" dhe *φώνηση* "zëri". Instrument për pengimin e depërtimit të valëve të zërit intensive në veshët e punëtorëve, që punojnë në kushte specifike të posaçme, përkatësisht të atyre punëtorëve që punojnë në ato vende pune, ku janë të ekspozuar vazhdimisht me tinguj të fuqishëm dhe me zhurma frekuencash të larta dhe të dëmshme.

ANTIKONFORMIZ/ËM, - MI. m. Term i sociologjisë dhe i psikologjisë sociale. Në psikologjinë sociale emërton ato lloj reagimesh të njeriut që janë në kundërshti me bindjet, me qëndrimet dhe me sjelljet e shumicës të një mjedisi, përkatësisht në kundërshti me konformizmin. Ka të bëjë me reagimet e kundërta ndaj presionit që ushtron mjedisi i jashtëm në anëtarët e saj. Ky kuptim i antikonformizmit emërtohet edhe me termin kundërkonformizëm ose kontrajonformizëm.

ANTIPATI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *αντιπαθεία* "me disponim negativ ndaj tjetrit". Ndjenjë e pakënaqësisë, e mosbesimit, e refuzimit, e mosdurimit, madje edhe e neverisë së një individi ndaj një individi tjetër, ndaj qëndrimit ekonomik, politik etj. dhe bartësve të tij. Antipatia manifestohet në forma të ndryshme duke filluar nga mosdashja, mosmarrja pjesë në përjetimet emocionale të tjetrit deri në refuzim të komunikimit dhe bashkëpunimit me tjetrin. Zakonisht ka përmbajtje shkaqesh të panjohura pjesërisht, por ka mjaft raste kur ekzistojnë shkaqet e argumentuara për antipati ndaj tjetrit**.**

ANTIPSIKOTIK, - E. mb. Term përmbledhës për të gjitha llojet e barnave që përdoren për shërimin e çrregullimeve dhe të sëmundjeve psikike. Ndër ta dallohen fenotiazina, tioantini, butirofenoni etj. Ndikimi i marrjes së tyre ka më tepër karakter të zbutjes së efekteve negative të çrregullimeve e sëmundjeve psikike, por ky grup barnash nuk i shëron individët nga këto çrregullime e sëmundje.

ANTISEMITIZ/ËM, - MI. m. Paragjykim diskriminues ndaj hebrenjve.

U manifestua sidomos në përndjekjen dhe vrasjen e hebrenjve. Antisemitizmi është pjesë e paragjykimeve të përgjithshme racore, që kanë histori relativisht të gjatë. Antisemitizmi ka përmasat e veta. Ky matet me shkallën e antisemitizmit të hartuar nga Teodor Adorno dhe bashkëpunëtorët e tij. Shih – ***SHKALLA A – S.***

ANTISOCIAL, - E. mb. Që përcakton formën e sjelljes së një anëtari ose disa anëtarëve, me të cilat dëmtohet kohezioni shoqëror i një grupi ose synohet rrënimi i raporteve ndërmjet anëtarëve të atij grupi, rrjedhimisht i grupit shoqëror.

ANTONIM, - I. m. Term i leksikologjisë i ardhur nga greqishtja *αντι* "kundër" dhe *ώνυμο* "emër". Çifte fjalësh dhe termash të koncepteve me përmbajtje të kundërt. Në psikologji ka terma të tilla, si: *aftësi – paaftësi, frenim – shfrenim, simpati – antipati* etj. Mbi përmbajtjen e antonimeve zhvillohet sidomos shtrirja e tipareve të personalitetit, si: *abstrakt – konkret, astenik – stenik, ekstravers – intravers* etj.

ANTROPOCENTRIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga greqishtja *ανθρωπο* "njeri" dhe *κεντρισμός* "qendër". Pikëpamje e vjetër, sipas së cilës njeriu dhe jeta komplekse e tij është qendër e gjithësisë, ku objektet, dukuritë dhe të gjitha ndryshimet e natyrës i nënshtrohen njeriut. Njohja e njeriut është qëllimi përfundimtar i gjithë asaj që ndodh në gjithësi. Konceptues i kësaj pikëpamjeje të përgjithshme ka qenë studiuesi gjerman Kaspar F. Volfi (Caspar F. Wolff, 1733 – 1794).

ANTROPOGJENEZ/Ë, - A. f. Shkenca mbi origjinën e njeriut dhe prejardhjen e tij nga lloji i kafshëve me zhvillim të lartë organik dhe psikik.

ANTROPOID, - I. m. I ardhur nga greqishtja *ανθρωποειδής*. Lloj majmunësh që i përngjasin njeriut nga pamja e jashtme dhe nga ndërtimi i trupit të tyre. Të tillë janë: shimpanzetë, orangutangët, gorilla dhe gibonët. Këtyre majmunëve u mungon bishti. Studimet mbi aktivitetin e tyre kanë dhënë rezultate të vlefshme për njohjen e zhvillimit dhe të evoluimit të strukturave, të proceseve psikike dhe të shumëllojshmërisë së sjelljeve të njeriut.

ANTROPOLOGJI, - A. f. I ardhur nga greqishtja ανθρωπο "njeri" dhe λόγος "shkencë". Antropologjia është shkenca mbi njeriun dhe mbi thelbin e qenies njerëzore në përgjithësi. Disiplinë shkencore ndërdisiplinore, që sintetizon dijet për njeriun dhe zhvillimin e tij nga anatomia, arkeologjia, filozofia, fiziologjia, gjenetika, gjuhësia, historia, etnologjia, psikologjia, sociologjia etj. Kjo synon të zbulojë thelbin njerëzor në përgjithësi dhe zhvillimin e saj. Antropologjia ndahet në këto degë kryesore: antropologjia filozofike – shkenca mbi natyrën e njeriut; antropologjia fizike – struktura anatomike dhe përbërja trupore e njeriut; antropologjia kulturore – kultura lëndore dhe kultura shpirtërore e njerëzve etj. Informacionet e para mbi ndërtimin antropologjik të Shqiptarëve i hasim në përshkrimet e udhëtimeve të të huajve (etnologëve në radhë të parë), të cilët vizituan viset shqiptare në shekullin XIX dhe XX. Ndër këta dallohen: F. Pukvil, H. Hekard, P. Treger etj. Sami Frashëri në veprën "Përsëri njeriu" më 1886 ka paraqitur disa tipare antropo-

logjike të Shqiptarëve; Faik Konica në veprën "Shqipëria, kopshti shkëmbor i Europës Juglindore" botuar në shqip më 1957 ka dalluar tiparet fizike e psikike të Shqiptarëve. Por, kërkimet antropologjike të mirëfillta nga ana e studiuesve shqiptarë i përkasin fundit të shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe gjysmës së dytë të shekullit të njëzet. Më 1973 u ngrit Laboratori Antropologjik pranë Institutit të Historisë në Tiranë dhe më 1997 u krijua Shoqata Antropologjike Shqiptare.

Burimet:

Charles Winick: *"Dictionary of Antropology"* – (*"Fjalor i antropologjisë"*), Littlefield, Adams & Co. New Jersey, 1977;
Victor Barnouw: *"Culture and Personality"* – (*"Kultura dhe Personaliteti"*), Dorsey Press, Homewood III, 1985;
Ruth Benedict: *"Patterns of Culture"* – (*"Modelet e kulturës"*), 1934;
Raymond Scupin: *"Cultural Anthropology"* – (*"Antropologjia kulturore"*), Prentice Hall. New Jersey, 1992;
Luan Memushi: *"Antropologjia",* Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 2000;
Zyhri Bajrami: *"Teoria e evolucionit"*, Universiteti i Tiranës, Tiranë 1989.

ANTROPOLOGJIA KRIMINALISTIKE. Disiplinë shkencore që merret me studimin sistematik të tipareve trupore e psikike të individëve kriminelë, me qëllim përcaktimin e masave ndaluese dhe penguese të krimeve dhe të gjitha formave të tij.

ANTROPOLOGJIA KULTURORE. Disiplinë e veçantë e antropologjisë që merret me studimin e raportit ndërmjet mjedisit kulturor dhe të individualitetit të njeriut. Qëndrimi fillestar i antropologjisë kulturore është: personaliteti i njeriut me të gjitha dimensionet e veta (me gjenezën, dinamikën dhe me funksionin e vet) mund të hulumtohet në thellësi, vetëm duke studiuar modelet e kulturës së mjedisit ku njeriu zhvillohet dhe formon personalitetin e tij. Këtu dallohet raporti i ngushtë i antropologjisë kulturore dhe psikologjisë së personalitetit. Zhvillimit të kësaj disipline i ka kontribuar posaçërisht antropologia amerikane Margaret Mid (Margaret Mead, 1901 – 1978).

ANTROPOMETRI, - A. f. Nëndisiplinë e antropologjisë që merret me matjen e madhësive, të formave dhe të proporcioneve të pjesëve të ndryshme të trupit të njeriut, me qëllim të njohjes së ngjashmërisë dhe të ndryshimeve ndërmjet njerëzve të racave, gjinive, etnive, popujve etj. Ndihet ndikimi i saj në zhvillimin e psikometrisë, e cila u zhvillua më vonë, pavarësisht nga ndryshimi i strukturave dhe i funksioneve, si edhe i ndërlidhjeve të tyre në lëndën matëse të antropometrisë dhe të psikometrisë.

ANTROPOMORFIZ/ËM, - MI. m. Atribuim i cilësive dhe i tipareve njerëzore të organizmave të tjerë, përkatësisht i organizmave me strukturë dhe nivel zhvillimor të ulët. U dallua te disa gjurmues të veprimeve dhe të jetës së kafshëve. Ka qenë karakteristikë e të menduarit mitik dhe e njerëzve të kulturave të lashta. Ka raste të shfrytëzimit të termave të psikologjisë për të përshkruar dhe shpjeguar disa nga veprimet e kafshëve të larta. Tashmë i përket të kaluarës**.**

ANTROPONOMI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *ανθρωπό* "njeri" dhe *νομος* "ligj, emër". Term që haset në psikologjinë anglosaksone për të emërtuar

termin bihejviorizëm. Ky term u propozua nga psikologu amerikan Valter S. Hanter (Walter S. Hunter, 1889 – 1953), i cili shkoi edhe më larg në përdorimin e këtij termi. Ishte i mendimit se edhe termi psikologji, i njohur që nga shekulli i gjashtëmbëdhjetë për shkencën mbi shpirtin të zëvendësohet me termin antroponomi.

ANTROPOZOFI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *ανθρωπο* "njeri"dhe *σοφία* "urti". Tërësi pikëpamjesh dhe qëndrimesh të natyrës okulte dhe religjioze, me anën e të cilave bëhen orvatje për të shpjeguar lindjen e zhvillimin e njeriut lidhur me Perëndinë. Vetëm njeriu me shpirtin e tij mund ta kuptojë botën hyjnore. Antropozofia i përket misticizmit naiv të përzier me teologjinë, si edhe me pikëpamjen e filozofisë idealiste. Kjo tërësi pikëpamjesh mbështetet në bindjen e njeriut për njohjen e Perëndisë dhe të bashkimit me të.

ANUS, - I. m. I ardhur nga latinishtja *anus* "pasdalje". Vrima fundore e rektumit, përkatësisht e pjesës së fundit të traktit të tretjes**.**

APARAT, - I. m. I ardhur nga latinishtja *apparatus* "mjet". Aparati është mjet i posaçëm që përdoret për qëllime studimore në psikologji, sidomos në psikofizikë, në psikologjinë fiziologjike, psikologjinë pedagogjike etj. Ndër ta dallojmë ergografin, esteziometrin, takozoskopin etj. Termi aparat emërton edhe grupin e organeve, pjesët e trupit ose indet e ndërlidhura që kryejnë funksion të përbashkët fiziologjik. Me këtë kuptim termi aparat përdoret me mbiemër, si p.sh., aparati i Golxhit (nga fiziologu e histologu italian Kamilo Golxhi (Camillp Golgi, 1843 – 1926). Aparati i Golxhit përbëhet nga disa cisterna të shtypura, nga vezikula e vakuola dhe shërben për ruajtjen e proteinave të sekretuara, për sintezën e disa polisaharideve, si edhe për formimin e glikoproteinave**.**

APARATI I TË FOLURIT. Sistem i organeve të njeriut që marrin pjesë në prodhimin dhe në artikulimin zanor të fjalëve dhe të fjalive. Këtë sistem e formojnë mushkëritë, gurmazi, skërfyelli, pejzat zanore, gjuha, zgavra e gojës dhe zgavra e hundës. Ajri që del nga mushkëritë kalon nëpër tejzat e zërit dhe nëpër hapësirën e gojës. Ky shndërrohet në energji zanore në bazë të dridhjes së tejzave të zërit. Zëri i tillë formësohet në tërësinë foljore ritmike në bazë të lëvizjes së gjuhës, të muskujve të gjuhës dhe të gjuhës.

APARATI NDIJIMOR. Organi shqisor me degëzimet periferike të nervit përkatës, nervi prurës që bart impulse nervore në qendrën përkatëse të cipës së trurit të madh, ku impulset nervore shndërrohen në ndijim të caktuar**.**

APARATI PSIKIK. Instanca psikike të njeriut, të cilat sipas Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939) janë: e pavetëdijshmja, e paravetëdijshmja dhe e vetëdijshmja, përkatësisht më vonë ai këto instanca i emërtoi: idi, egoja dhe superegoja. Këto instanca përbëjnë organizimin shpirtëror të njeriut dhe, secili prej tyre kryen funksione të posaçme, kurse i tërë ky aparat funksionon si tërësi. Roli i tij ka të bëjë me rregullimin e zhvillimin e energjisë psikike, të sasisë dhe të shpërndarjes së kësaj energjie në strukturat e këtij aparati.

A

APARATI VESTIBULAR. Organi shqisor i vendosur në pjesën e brendshme të veshit. Përbëhet nga tri kanalet gjysmërrethore dhe nga dy qeska të emërtuara utrikuli dhe sakuli. Në këtë aparat gjenden receptorët e ndjeshmërisë së vendndodhjes së trupit dhe të lëvizjes së trupit dhe të kokës së njeriut. Kanalet gjysmëharkorë janë të mbushur me një lëng të quajtur endolimfë. Me rastin e lëvizjes së kokës valët e endolimfës ngacmojnë fijezat e nervit dëgjimor. Në qeskat, përkatësisht në utrikul dhe në sakul, në fijezat e ndjeshme gjendet një lloj mase specifike me disa kristale të kalciumit të njohur me termin otolit dhe statolit. Në gjendjen e qetë të trupit këto kristale shkaktojnë shtypje të njëtrajtshme në fijeza nervore, kurse me rastin e lëvizjes së kokës veprojnë në këto fijeza. Falë funksionimit të tyre ne jemi në gjendje të përcaktojmë vendndodhjen horizontale apo vertikale të trupit.

APATI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *απαθεία* "pandjeshmëri". Në psikologji apatia është gjendje plogështie psikike me këto cilësi: indiferenca, molisja, toni emocional i zbehtë dhe në raste të posaçme mungesa e reagimit emocional, mosinteresimi dhe pavullnetshmëria. Ka një shtrirje të gjerë: nga topitja emocionale e diferentizmi i përkohshëm, te pandjeshmëria afektive deri në molisje të thellë dhe në gjendje depresive, në të cilën njeriut nuk i bën përshtypje asgjë dhe nuk reagon ndaj ngacmuesve. Në kushte të zakonshme apatia është çrregullim i lehtë psikik që lind si rezultat i mbrojtjes nga frika që mund të sjellë jeta reale dhe nga droja për detyrat që pritet t`i kryejë një njeri. Shih – ***MËVESHTIA.***

APERCEPTIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *ad* "kah" dhe *percipere* "kuptoj". Term i psikologjisë klasike strukturaliste, me të cilin është emërtuar faza e plotë e perceptimit, ku njeriu ka arritur ta identifikojë dhe ta kuptojë përmbajtjen e asaj që percepton; rinjohje e objektit perceptues dhe lidhja e tij me sasinë e dijes së përvetësuar mbi të. Ndër psikologët me aperceptim u mor më tepër psikologu gjerman Vilhelm Vunt (Wilhelm Wundt, 1832 – 1920). Sipas tij aperceptimi është procesi mendor aktiv i përzgjedhjes së strukturuar të përvojës së brendshme, fokusimi i vëmendjes brenda fushës së vetëdijes. Termi aperceptim ka qenë i njohur para Vilhelm Vuntit; është trajtuar më tepër nga filozofi e matematikani gjerman Gotfrid F. fon Lajbnic (Gotttfried F. von Leibnitz, 1646 – 1716) dhe pedagogu gjerman Johan F. Herbart (Johann F. Herbart, 1776 – 1841), i cili me aperceptim ka emërtuar kuptimin dhe procesin themelor të njohjes së cilësive të trupave, që asimilohen me dijeninë e njeriut për objektin dhe situatën e dhënë dhe në këtë mënyrë realizohet njohja e atij objekti apo asaj situate. Nga mendimtarët ka ardhur edhe termi masë aperceptive – sasia e dijeve dhe e përvojës së fituar, me të cilën njeriu i qaset perceptimit të dukurisë, të objektit dhe të situatës. Ky term në psikologjinë bashkëkohore kognitive përdoret pak në kuptimin e psikologjisë klasike.

APETIT, - I. m. I ardhur nga latinishtja *appeto* "me pas dëshirë për diçka". Term i së folmes së përditshme dhe term psikologjik. Apetit në të folmen e përditshme emërton nevojën dhe synimin në një qëllim, zakonisht në ushqimin

e pijen e caktuar. Në psikologji apetiti emërton formën e mësuar të reagimit ndaj një lloji të caktuar ushqimesh, pijesh, madje edhe ndaj preferencave seksuale të veçanta. Në rastet e ankthit shfaqet dukuria e humbjes së apetitit ose e marrjes së tepruar të ushqimeve. Kjo dukuri është e lidhur me intensitetin e motivit seksual dhe me vështirësi të njeriut për ta kontrolluar frikën e tij. Në psikologjinë instinktiviste apetitit i kanë dhënë kuptimin e instinktit.

APNE, - A. f. Term i huazuar nga greqishtja *ά* "parashtesë mohimi" dhe *πνοια* "frymëmarrje". Apnea është bllokim i shkurtër prej disa sekondash i rrugëve të frymëmarrjes nga mosfunksionimi i qendrave të trurit që kontrollojnë procesin e frymëmarrjes. Është shumë i rrezikshëm për jetën e njeriut. Shfaqet më tepër te fëmijët dhe te pleqtë, sidomos gjatë gjumit të thellë. Apnea është e lidhur me disa sëmundje, por shfaqet edhe te të shëndoshët. Lë pasoja edhe në ritmin e zhvillimit të proceseve psikike, si edhe në shfaqjen e simptomave të ndjenjës së rraskapitjes së organizmit.

APOPLEKSI, - A. f. I ardhur nga latinishtja *apoplexia* që ka të bëjë me një sëmundje të rëndë, keqësim të madh të gjendjes organike e psikike të njeriut, te i cili pushojnë së funksionuari disa nga qendrat e cipës së trurit të madh. Apopleksia është pika ose damllaja, pra humbja e menjëhershme e vetëdijes. Në apopleksi njeriu humb kontrollin ndaj vetes, sidomos ndaj lëvizjeve. Apopleksia rrjedh nga gjakderdhja në trurin e njeriut ose nga mpiksja e gjakut në enët e trurit. Godet rëndë, sidomos qendrat motorike dhe ato emocionale. Sot termi apopleksi në psikopatologji dhe në psikiatri emërton çrregullimin e rrjedhës së gjakut në hipofizë.

APOPTOZ/Ë, - A. f. Term i anatomisë, por me rëndësi për zhvillimin e proceseve psikike e të sjelljeve sipas bazës biologjike të tyre. Apoptoza emërton vdekjen e qelizave të trupit të njeriut, duke përfshirë edhe vdekjen e qelizave të trurit. Me lindje të foshnjës numri i neuroneve është 50 % më i madh se kur kryhet procesi i zhvillimit të tyre. Numri i tepërt i neuroneve vdes si rezultat i procesit të apoptozës. Vdesin më shumë ato neurone që nuk kanë arritur të vendosin lidhje të rregullta ndërmjet tyre. Vdekja e tyre shkakton çrregullime psikike dhe çrregullime sjelljesh në nivele të ndryshme.

APRAKSI, - A. f. Term i greqishtes α "parashtesë mohimi"dhe πραξία "veprim". Apraksia është humbje e aftësisë për të kryer lëvizje dhe veprime të vullnetshme. Dëshira dhe veprimtaria e lëvizjeve elementare të muskujve është e ruajtur, por njeriu këto lëvizje nuk ka mundësi t`i lidhë dhe t`i koordinojë në tërësi psikomotorike. Apraksia mund të jetë: Apraksi ideomotore – paaftësi për të realizuar dëshira e urdhra motore p.sh., pamundësi e larjes së dhëmbëve; Apraksi ideore – paaftësi për të realizuar lëvizjet e thjeshta p.sh., për ta marrë shkrepësen dhe për ta ndezur cigaren dhe Apraksi okulomotore – paaftësi e koordinimit të lëvizjes së syve me lëvizjet e duhura p.sh., e sheh derdhjen e qumështit në shportë të ndezur, por nuk ke mundësi të ndërmarrësh lëvizje me anën e të cilave e largon enën me qumësht nga zjarri. Apraksia është pasojë e lëndimit të disa pjesëve të trurit. Sipas

lokalizimit të këtyre dëmtimeve trunore dallojmë disa forma të apraksisë; si: apraksia akinetike – pamundësia e ekzekutimit të lëvizjeve spontane; apraksia amnestike – pamundësia e ekzekutimit të lëvizjeve sipas kërkesave të të tjerëve; apraksia ideokinetike – humbja e aftësisë së ekzekutimit të lëvizjeve sipas rendit të tyre; apraksia motorike – pamundësia e ekzekutimit të veprimeve të vullnetshme, që është pasojë e lëndimit të qendrave dytësore të zonës motorike të trurit; apraksia e gjymtyrëve – humbja e aftësive të ekzekutimit të lëvizjeve sipas rendit e koordinimit të tyre nga ana e duarve dhe e këmbëve, që është pasojë e lëndimit të pjesës së përparme të pjesës trunore të hemisferës së majtë të trurit**.**

APRAKSIONI IDEOMOTORIK. Formë e humbjes së plotë ose të pjesshme të aftësisë së kryerjes së një veprimi të qëllimshëm nga ana e të sëmurit, i cili di çfarë duhet të bëjë, nuk është as i paralizuar, por nuk është në gjendje që dëshirën, idenë dhe mendimin e tij ta shndërrojë në aktivitet motorik. Apraksioni motorik shkaktohet nga shkëputja e lidhjeve nervore ndërmjet qendrave të proceseve intelektuale dhe qendrës motorike të trurit. Çrregullimi i tillë lidhet me fushën dyzet të hartës trunore të neurologut gjerman Korbinian Bordman (Korbinian Brodmann, 1868 – 1918) që është një lloj epilepsie, së cilës nuk i dihet shkaku, apo shfaqet pa shkak të identifikuar. Epilepsia idiopatike shfaqet në moshën e hershme të njeriut dhe supozohet se ka bazë hereditare.

APREHENZI, - A. f. I ardhur nga latinishtja *apprehensio* "të kuptuarit". Formë e mendimit të thjeshtë që ka të bëjë me aktin e rrokjes mendore të thelbit të një objekti, ngjarjeje, situate etj. Për kapjen mendore të raporteve thelbësore të situatave të ndërlikuara zakonisht përdoret termi *komprehenzia*. Termi aprehenzi përdoret edhe për të emërtuar frikën, madje edhe ankthin e njeriut për atë që do të vijë.

ARAKNOIDE, - A. f. Term i anatomisë së sistemit nervor i ardhur nga latinishtja *arachnoidea* "cipë merimange e trurit dhe e palcës së kurrizit". Me këtë term emërtohet cipa e tretë mbështjellëse e trurit dhe e palcës së kurrizit, që së bashku me cipën *dura mater* dhe me atë *pia mater* mbrojnë gjithë lëndën e trurit dhe atë të palcës së kurrizit, duke mundësuar zhvillimin e proceseve neuro-fiziologjike e psikike të lidhura me sistemin nervor.

ARGUMENT, - I. m. I ardhur nga latinishtja *argumentum* "provë". Në psikologji argumenti është fakti i pamohueshëm dhe aspak i pakontestueshëm në të cilin ose mbi të cilët mbështetet një e vërtetë. Argumenti mund të jetë shkak objektiv i rëndësishëm i pranimit ose i refuzimit të një qëndrimi. Mbi themelin e argumenteve të tilla mbështetet ndjenja e sigurisë së njeriut për mendimin dhe për sjelljet e tij.

ARGUMENTI I BURIDONIT. Veprim mendor i mendimtarit francez J. Buridon që vdiq rreth vitit 360, i cili e mbështet ekzistencën e vullnetit në motive. Këtë e ka argumentuar me faktin që në rrethana motivuese të barabarta njeriu nuk vendos lehtë për të kryer një veprim të vullnetshëm. Për të argumentuar këtë tezë të Buridonit kundërshtarët e tij i kanë atribuuar shembullin e trilluar "Gomari i Buridonit", që sipas tyre paska ngordhur i

uritur ndërmjet dy mullarëve me bar të thatë, pasi nuk paska qenë në gjendje të vendoste se me barin e cilit mullar ta zhdukte urinë!

ARISTOTELI. Filozof grek. Lindi në Stagirë të Trakisë dhe jetoi gjatë viteve 384 – 322 p.e.r. Pati ndikim të fuqishëm në vënien e themeleve të mendimit psikologjik. Në këtë kuadër ai krijoi një sistem konceptual për shpirtin, që ishte shtysë për gjurmimet empirike të organizmave të gjallë. Shpirti për Aristotelin ishte shfaqje e qenies së gjallë, kurse vetë qenia e gjallë ishte shfaqje e shpirtit të tij. Ai dallonte shpirtin vegjetativ, që kishte të bënte me zhvillimet biologjike (marrja e ushqimit dhe të shumuarit e organizmave), shpirtin animal, që kishte të bënte me ndjeshmërinë e vetlëvizjes dhe shpirtin njerëzor që kishte të bënte me mendjen, përkatësisht me arsyen. Këtë të fundit e shpjegonte me ndarjen e mendjes në mendje pasive (regjistrim i përmbajtjes së shqisave që marrin nga jashtë), nga individualiteti i asaj që ekziston. Mendja aktive është përpunimi i asaj çka ka marrë mendja pasive në formën konkrete dhe formimi i koncepteve, i ideve të përgjithshme nga ana e mendjes së njeriut. Të këtilla janë kategoritë: substancë, kuantitet, kualitet, vend, kohë, marrëdhënie, pozitë, zotërim, veprim dhe pësim. Aristoteli ka qenë konceptuesi i lidhjes së ideve. Këto pjesë të sistemit konceptual i gjejmë në veprën "*De anima*" ("*Shpirti*"). Pjesa e tretë e sistemit të tij ka të bëjë drejtpërdrejt me përshkrimin dhe shpjegimin e qartë të përvojave dhe të sjelljeve njerëzore, si: rinia e pleqëria, gjendja e zgjuar e njeriut dhe gjendja e përgjumur e tij, procesi i të kujtuarit dhe i të rikujtuarit etj. Këto përshkrime dhe shpjegime gjenden në veprën "*Parva natyralis*" – *"Shënime të shkurtëra mbi natyrën"*. Por, edhe në studimet e karakterit tjetër, përkatësisht të karakterit etik dhe politik gjejmë koncepte që kanë karakter psikologjik, si: shqetësim shpirtëror, mallëngjim, vetëpërmbajtje, marrëdhënie ndërmjet njerëzve etj. Nga shkrimet e tij është marrë shumë më vonë edhe koncepti dhe termi katarsë. Me fjalën greke *καθαρός* Aristoteli ka emërtuar procesin e çlirimit të njeriut nga pasionet, kur ai e vështron dhe e përjeton përmbajtjen e një tragjedie në skenën teatrale. Këtë fjalë e morën shumë më vonë Zigmund Frojdi dhe Jozef Brojeri dhe e përdorën në studimin e tyre "*Studim mbi histerinë*". Në këtë vepër *katarsa* emërton veprimin terapeutik, me anën e të cilit një individ arrin të çlirohet nga struktura psikike patogjene, duke përjetuar kujtimet nga ngjarjet traumatike me anë të verbalizimit të tyre, kur këto ishin të lidhura me efektet patogjene emocionale dhe me sjelljet e tilla të individit. Nga universiliteti gjenial i tij shkëputëm vetëm pjesë të sistemit të tij racional e të dijes, që kanë të bëjnë me psikologjinë dhe kanë ushtruar ndikim të rëndësishëm në zhvillimin shumëvjeçar të psikologjisë filozofike. Përmbajtja e këtyre pjesëve u përpunua hollësisht në veprën "*Aristotel`s Psychology"* – (*"Psikologjia e Aristotelit*"), të hartuar nga W. A. Hammond, botuar më 1902.

ARITMOMANI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *αριθμός* "numër"dhe *μανία* "dëshirë e sëmurë, marrëzi". Aritmomania është preokupim i njeriut me vlerat sasiore të dukurive, të objekteve etj. dhe prirja jonormale e tij për të

A

numëruar vazhdimisht objektet dhe dukuritë e ndryshme. Nën ndikimin e vazhdueshëm të kësaj prirjeje njeriu fillon të largohet nga natyra, nga cilësitë, tiparet dhe nga raportet konkrete që ekzistojnë ndërmjet objekteve, cilësive, dukurive etj. Është e pranishme në mendimin skizofrenik.

ARKETIP, - I. m. Term i psikologjisë analitike të Karl G. Jungut (Carl G. Jung, 1875 – 1961) që të bëjë me një konstrukt hipotetik, strukturë përbërëse e pavetëdijes kolektive. Sipas Karl G. Jungut arketipi është gjurmë kolektive e përvojës njerëzore që trashëgohet dhe manifestohet si formë e pavetëdijes individuale. Këto janë parafigura pa përmbajtje të caktuar, nuk janë përfytyrime, por janë "shtresa përvojash të njerëzisë që përsëriten vazhdimisht". Arketipat kanë karakter psikoid, d.m.th., qenia e vetme e arketipave nuk ka aftësi të vetëdijes". Të tillë janë arketipi i fëmijës, i heroit, i lindjes, i vdekjes etj. Arketipat kryejnë funksionin e ndihmës së njeriut, të lehtësisë për t`u gjendur në situata të rëndësishme jetësore.

Burimet:

Carl Gustav Jung: *"Über die Psychologie des Unbevustensein",* 1916;
Carl Gustav Jung: *"Psikologjia e së pavetëdijshmes 1,",* Tiranë ;
Carl Gustav Jung: *"Ese mbi gjurmimin e pavetëdijes",* Tiranë, 2010;
Carl Gustav Jung*: "Njeriu dhe simbolet e tij,* Tiranë, 2010.

ARMIQËSI, - A. f. Prirje e formuar e një individi, të cilën e përbën keqdashja, urrejtja, zemërimi etj. dhe gatishmëria për t`i bërë keq një individi tjetër ose një grupi të caktuar. Kjo prirje e përçuar me emalgamë ndjenjash negative të intensitetit mbi mesatar zgjat relativisht një kohë të gjatë, por edhe individi i reziston ndryshimit të saj. Në këtë pikëpamje armiqësia ka edhe përmasën e një qëndrimi. Madje, në të folurin e përditshëm përdor shpesh togfjalëshin qëndrim armiqësor.

AROM/Ë, - A. f. Në të folurin e përgjithshëm në shqip është emërtim i erës së këndshme për njeriun. E tillë është aroma e trëndafilit, e vjollcës, e zambakut etj. Në psikologji termi aromë emërton ndijimin e shkaktuar nga ndikimi i trupave flurorë dhe ata të shijes, që lidhen edhe me ndijimet e të prekurit dhe të temperaturës.

ARSIMI PROFESIONAL. Tërësia e përmbajtjeve mësimore, e shkathtësive, e shprehive dhe e interesimeve që zhvillohen në një institucion të posaçëm (në një shkollë profesionale të nivelit të mesëm, të lartë dhe superior, si edhe në forma të organizmit të trajnimeve), me qëllim të përgatitjes së plotë të ndjekësve të atij institucioni profesional për kryerjen me sukses të mjeshtërisë ose të profesionit të caktuar. E tërë përmbajtja e veprimtarisë arsimore dhe edukative të institucioneve arsimore profesionale zhvillohet sipas planit dhe programit mësimor të përcaktuar në bazë të analizës së hollësishme të aktivitetit profesional dhe sipas formave organizuese më të suksesshme. Të tilla janë: shkolla bujqësore, e mjekësisë, e teknologjisë së tekstilit etj., si edhe kurset e trajnimeve të arsimit pa shkëputje nga puna.

ARSYE, - JA. f. I ardhur në psikologji nga filozofia që emërton aftësinë e njohjes së raporteve thelbësore ndër-

mjet dukurive, objekteve, proceseve fizike, biologjike, sociale e psikike. Është forma më e lartë e mendimit në konceptimin e së përgjithshmes. Në psikologji arsyeja është koncept i afërt me përmbajtjen e konceptit intelekt. Arsyeja është aftësi e përgjithshme kognitive, që nuk i nënshtrohet dëshirave, emocioneve, interesave dhe motiveve të njeriut. Qëndron në raport antagonist me motivet, nevojat, shtytësit dhe me vullnetin e njeriut. Ka përdorim të madh në psikologjinë kognitive dhe mund të jetë huazuar nga latinishtja *rationem*. Arsyeja haset në shqip për herë të parë në shkrimet e Buzukut qysh nga viti 1555.

ARSYETIM, - I. m. Proces mendor i parashtrimit të argumenteve në bazë të arsyes dhe përftimi i njohurive të reja duke bërë lidhjen e njohurive të vjetra me idetë, konceptet dhe me gjykimet e reja. Ky proces përmban argumentimin e një qëndrimi, të një gjykimi, të një përfundimi duke marrë për bazë shkaqet në të cilat ai mbështetet dhe duke futur qartësi në natyrën, në rendin dhe në rëndësinë e tyre. Procesi i arsyetimit ka funksion autonom. Me anën e këtij procesi ne depërtojmë në njohjen e motiveve, të synimeve e të qëllimeve të njeriut. Këto nuk janë dhënë konkretisht dhe as që kanë mundësi të gjenden në fushën e njohjes shqisore.

ART TERAPIA. Formë e psikoterapisë grupore. Art terapia realizohet duke nxitur pacientët dhe klientët t`i shprehin emocionet, frustrimet, konfliktet e tyre të brendshme me anën e krijimtarisë artistike: të muzikës, të pikturës, të vallëzimit etj. U zhvillua mbi konceptin e marrëdhënieve ndërpersonale të Jakob L. Morenos (Jacob L. Moreno, 1889 – 1974).

ARTERIOSKLEROZ/Ë, - A. f. Term i anatomisë dhe i fiziologjisë, si edhe i psikologjisë fiziologjike i ardhur nga latinishtja *arteriosclerosis* "trashje dhe fortësim i mureve të arterieve të gjakut". Dukuri e rrezikshme, sidomos kur fillon të shfaqet përbrenda arterieve të gjakut të trurit. Në rastet e këtilla njeriu pëson çrregullime të rënda fizike dhe psikike. Çrregullimet më të rënda psikike shfaqen në fushën e proceseve kognitive dhe emocionale. Arterioskleroza shkakton humbjen e aftësisë së kujtesës, të përqendrimit të vëmendjes, çrregullim të proceseve të mendimit etj., si edhe gjendje depresive të shoqëruar me ankth.

ARTIFICIALIZ/ËM, - MI. m. Term me kuptim të përgjithshëm që tregon për dukurinë dhe për prirjen e shfaqjes së objekteve e të dukurive me përmbajtje dhe me formë jo të natyrshme. Termi artificializëm ka kuptim të veçantë në psikologjinë e Zhan Pijazhes (Jean Piaget, 1896 – 1980). Në teorinë e zhvillimit të mendimit dhe të inteligjencës së fëmijëve, sipas Zhan Pijazhes, artificializmi është prirja e fëmijëve dhe besimi i tyre që mjedisin fizik dhe të gjitha ndryshimet e tij t`i shohin si produkte të aktivitetit të njeriut, produkte artificiale. Bjeshkët, hëna e lëvizja e saj në horizont, pemët etj. janë produkte të dorës së njeriut. Kjo cilësi e mendimit të fëmijëve karakterizon mendimin e theksuar egoist të fëmijëve në fazën para-operacionale të zhvillimit të mendimit të tyre**.**

ARTIKULIM, - I. m. Term i gjuhësisë i ardhur nga latinishtja *articulation*, që në shqip ka ekuivalentin "nyjëtim".

A

Në gjuhësi artikulimi është shqiptimi i qartë i tingujve përkatës të shkronjave (i zanoreve dhe i bashkëtingëlloreve), të rrokjeve e fjalëve dhe lidhjeve të tyre në fjali dhe në struktura fjalësore të tërësishme me anë të angazhimit të rregullt të aparatit të të folurit. Në psikologjinë geshtaltiste artikulimi është niveli i ndërlikuar i strukturave perceptive.

ARRATISJA NË SËMUNDJE. Formë e sjelljes së atyre individëve, të cilët kanë aftësi të kufizuara të përshtatjes ndaj kushteve e rrethanave konkrete të mjedisit të tyre dhe aftësi të kufizuara të durimit të ndikimit të tyre dhe të angazhimeve fizike e psikike për t`u rrokur me to. Arratisja në sëmundje është karakteristike për psikoneurotikët, të cilët synojnë t`i shmangen ndjenjës së përgjegjësisë. Këtë dukuri e ka trajtuar posaçërisht themeluesi i psikanalizës Zigmund Frojdi (Sigmund Freud, 1856 – 1939).

ARRATISJA NGA REALITETI. Shfrytëzimi i përmbajtjeve imagjinuese e fantastike në procesin e përmbushjes së dëshirave, të nevojave, të motiveve etj. Njeriu i arratisur nga realiteti, në vend që të rroket me dukuritë, objektet, me proceset e me raportet reale, kënaqet me kombinimet imagjinuese e fantastike.

ARRITJ/E, - A. f. Term i statistikës i ardhur nga anglishtja *score* "rezultat". Rezultat i përgjithshëm numerik, i dëshmuar me pikët e fituara në një instrument matës psikologjik, sidomos në testin e matjes së aftësive dhe në testin didaktik apo të dijenive nga një lëndë e posaçme mësimore. Arritja llogaritet duke mbledhur pikët e fituara nga zgjidhja e drejtë e secilit problem, përkatësisht nga dhënia saktë e përgjigjes në secilën detyrë testore. Vlera sasiore përfundimtare e të gjitha pikave të fituara paraqet arritjen e subjektit në atë test. Sot në psikologji ka filluar të përdoret termi anglez *skore* për rezultatin e arritur të një individi në testin e zbatuar. Shih – ***SKORI.***

ARROGANC/Ë, - A. f. I ardhur nga latinishtja *arrogans* "i vrazhdë" që është emërtim i sjelljeve karakteristike të disa individëve, me të cilat ai fyen dhe ofendon të tjerët, duke synuar vazhdimisht imponimin e tij dhe të sjelljeve të tij mbi të tjerët. Arroganca është karakteristikë, në radhë të parë, e personaliteteve autoritare, që kanë tipare agresive ndaj të nënshtruarve.

ASEMI, - A. f. I ardhur nga greqishtja α "jo" dhe στιγματισμός "shenjë". Humbje e pjesshme ose e plotë e aftësisë së kuptimit të simboleve dhe të shenjave (të fjalëve, figurave, të gjesteve etj.) si edhe e përdorimit të tyre në procesin e komunikimit me të tjerët. Konsiderohet se është formë e afazisë, megjithëse ka raste klinike ku asemia zhvillohet nga faktorët psikogjenë, duke mos pasur bazë organike të çrregullimit.

ASFIKSI, - A. f. Vështirësi e të marrit frymë nga mungesa e ajrit me oksigjen. Zgjatja e frymëmarrjes së tillë shkakton humbjen e kontrollit të vetëdijshëm të proceseve dhe të sjelljeve të njeriut, përkatësisht vdekjen nga grumbullimi në gjak i sasisë së madhe të dioksidit të karbonit.

ASIMILIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *assimilation;* ka kuptim të përgjithshëm dhe të veçantë. Kuptimi i

përgjithshëm i këtij termi ka të bëjë me procesin e përshtatjes, të "shkrirjes" së dijeve të reja në sistem të dijeve paraprake. Shfaqet në procesin e të mësuarit të informacioneve dhe të lidhjeve ndërmjet tyre me sistemin e informacioneve tashmë të përvetësuar dhe të lidhjeve të tyre me përmbajtjet paraprake. Në psikologji termi asimilim ka edhe kuptim specifik të lidhur me pikëpamjet studimore të disa gjurmuesve të jetës dhe të dukurive psikike. Ndër kuptimet specifike të termit asimilim dallojmë: 1) Në psikologjinë e zhvillimit intelektual të psikologut zviceran Zhan Piazhes (Jean Piaget, 1896 – 1980) asimilimi ka të bëjë me përshtatjen e dijeve të reja në skemat e përgjithshme të dijes; 2) Në psikologjinë analitike të Karl G. Jungut (Carl G. Jung, 1875 – 1961) asimilimi është procesi i ndryshimit të ideve, të përfytyrimeve të objekteve, të ndodhive etj. dhe i përshtatjes së tyre nevojave të njeriut; 3) Në teorinë e të parit të fiziologut gjerman Hajnrih E. Heringut (Heinrich E. Hering, 1866 – 1948) asimilimi është procesi i ndërtimit dhe i riparimit të substancave të dritës në rrjetëzën a retinën e syrit; 4) Në sistemin e teorive psiko-dinamike të personalitetit asimilimi ka kuptimin e "trupëzimit" të përvojës së pakëndshme, të elementeve psiko-patogjene në përvojën e mëparshme të pakëndshme dhe të ndrydhur, por ende të durueshme për sjelljet e njeriut; 5. Në psikologjinë klinike asimilimi ka kuptimin e vetëdijesimit të njeriut dhe të integrimit të tij në përvojën e përjetimeve të pakënaqësive etj.

ASIMILIMI KOGNITIV. Procesi i integrimit të përvojës së re në skemat e njohurive të realitetit. Termi asimilimi kognitiv i përket psikologjisë së Zhan Pijazhes (Jean Pijaget, 1896 – 1980) Sipas pikëpamjeve të Zhan Pijazhes asimilimi kognitiv luan rol të rëndësishëm në procesin e njohjes së realitetit. Në bazë të asimilimit kognitiv zhvillohet fitimi i njohurive të reja në vazhdimësi, konceptohet përvoja e re, ndikohet në njohjen sa më të thellë të informacioneve për të gjitha format e ndryshimet e realitetit dhe të modaliteteve të tij.

ASIMILIMI RECIPROK. Skemë motorike dhe pamore e formuar nga dy përbërjet duke asimiluar përbërëset e përbashkëta dhe duke ruajtur secila statusin e vet. Me këtë kuptim e hasim në Psikologjinë e psikologut zviceran Zhan Pijazhe (Jean Piaget, 18908 – 1980).

ASIMILIMI SHOQËROR. Procesi i ndikimit të traditës, kulturës e normave morale të një mjedisi shoqëror në individin e ardhur nga mjediset e tjera dhe ndikimi i këtij mjedisi në zbutjen dhe humbjen e identitetit burimor të prejardhjes. Zakonisht bëhet fjalë për ndikimin e mjedisit të gjerë në anëtarët e pakicave apo minoriteteve dhe në shkrirjen e tyre graduale në traditën, zakonet dhe kulturën e mjedisit të gjerë. Ky është procesi i asimilimit spontan. Asimilimi politik është ndikim i ushtruar me qëllim shkrirjen e pakicave dhe anëtarëve të tyre në kulturën e mjedisit mbisundues.

ASKETIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga greqishtja *άσκηση* "ushtrim". Asketizmi është pikëpamje për vlerat e jetës së njeriut dhe për mënyrën e jetesës, të cilën e përbën të hequrit dorë të njeriut nga dëshirat, afshet, epshet, kënaqësitë etj., me qëllim të përsos-

jes së jetës shpirtërore të tij. Shfaqet në forma të ndryshme të sjelljes së njeriut ndaj vetes së vet, nga të cilat dallojmë: jetën në vetmi, qëndrimin në të ftohtë, jetesën me sasi e cilësi të ushqimit të pamjaftueshëm etj. Është ndër format e theksuara të vlerave morale dhe religjioze.

ASOCIACION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *association* "lidhje, shoqërim". Një ndër termat e vjetër dhe me shkallë të lartë përdorimi në psikologji. Asociacioni është lidhje elementesh, përbërësish dhe informacionesh të përmbajtjes së proceseve psikike dhe të formës së shfaqjes së tyre në bazë të përvojës së individit, përkatësisht në bazë të lidhjeve të mësuara nga ana e individit për përmbajtjet e ndryshme të jetës psikike të tij (lidhja ndërmjet ideve, ndijimeve, përfytyrimeve, ngacmuesit dhe reagimit ndaj tij etj.). Asociacioni ose lidhja ndërmjet përmbajtjeve dhe përbërësve të tyre shfaqet në faktin se prania e njërit nga elementet e përmendura tërheq pas vetes kujtimin e elementit tjetër, si: fjala borë menjëherë lidhet me fjalën të ftohtët, gjelbërim i natyrës – stina e pranverës, pranvera – mosha rinore etj. Asociacioneve ose lidhjeve të këtilla i është atribuuar fuqia kohezive shpirtërore që i lidh proceset psikike. Termi asociacion është i njohur që nga koha e mendimtarit të madh grek Aristotelit (Aristotel, 384 – 322 p.e.r.).

ASOCIACIONI KONTROLLUES. Lloj asociacioni që ka të bëjë kryesisht me atë teknikë të lidhjes së ideve, të përfytyrimeve etj., kur kufizohet përgjigjja e subjektit në ngacmuesin e dhënë, sepse nga subjekti kërkohet të përgjigjet saktësisht për ngacmuesin e dhënë. Testi i antonimeve është një formë e asociacionit kontrollues, ku kërkohet nga subjekti të përgjigjet me antonim përkatës ndaj një antonimi, p.sh., i zi – i bardhë, i madh – i vogël, e saktë – jo e saktë etj. Në ndryshim nga asociacionet e lira asociacioni kontrollues është teknikë shumë e kufizuar për subjektin që hulumtohet. Ky asociacion zakonisht zhvillohet në psikologjinë klinike, si edhe në disa lloje eksperimentesh të veçanta. Me anë të asociacioneve të kontrolluara u hulumtua procesi i të menduarit.

ASOCIACIONIZ/ËM, - MI. m. Doktrinë e përgjithshme psikologjike, sipas së cilës tërësia e proceseve psikike dhe e sjelljeve janë lidhje elementesh të thjeshta psikike. Fillimin e zhvillimit të asociacionizmit e hasim që nga mendimet e Aristotelit (Aristotel, 384 – 322). Pikëpamjes së Aristotelit për lidhjen e ideve në bazë të ngjashmërisë, të kontrastit dhe të të prekurit i janë referuar shumë më vonë mendimtarët e empirizmit anglez Xhon Loku (John Lock, 1632 – 1704), Xhorxh Berkli (George Berkley, 1685 – 1753), Dejvid Hjum (Dawid Hume, 1711 – 1776) etj. Tomas Hobsi (Thomas Hobbes, 1588 – 1679), duke iu referuar pikëpamjes së Aristotelit mbi kujtesën, u përpoq ta shpjegonte të gjithë sistemin e proceseve kognitive në bazë të tri ligjeve të asociacionizmit të ideve. Asociacionizmi e arriti kulmin e zhvillimit të tij me mendimet e filozofit dhe të mjekut anglez David Hartli (David Hartley, 1705 – 1757) dhe të birit, filozofit skocez Xhejms S. Mill (James S. Mill, 1773 – 1836). Mbi bazën e pikëpamjeve filozofike u zhvillua asociacionizmi eksperimental i lidhur

me gjurmimet e kujtesës të Herman fon Ebinghauzit (Hermann von Ebbinghaus, 1850 – 1909), të fiziologut rus Ivan Pavllovit (Ivan Pavlov, 1849 – 1936) për reflekset e kushtëzuara, për të arritur kulimin e zhvillimit të vet në punimet eksperimentale të Xhon B. Uotsonit (John B. Watson, 1878 – 1958) e bashkëmendimtarëve të tij. Asociacionizmi ndikoi në zhvillimin e psikologjisë së të mësuarit dhe tërhoqi vëmendjen në gjurmimin e reagimeve dhe të sjelljeve të jashtme të organizmit, duke lënë anash strukturat mendore dhe termat e koncepteve të tyre.

Burimet:

David Hartley: *"Observations on Man, His Frame, His Duty and His Expectations"* – (*"Vëzhgime mbi njeriun, ambientin, detyrat dhe shpresat e tij"*), 1749.

George Berkeley: *"A Treatise concerning the Principles of Human"* – (*"Shqyrtim mbi parimet e njohjes njerëzore"*), 1709.

David Hume: *"An Enquiry human understanding"* – (*"Hulumtime mbi arsyen njerëzore"*), 1758.

Johann F. Herbart: "*Psychologie als Wissenschaft*" – ("*Psikologjia si shkencë*"), 1824 – 1825.

Edward Titchener: *"A Textbook of Psychology"* – (*"Libër tekstesh psikologjike"*), 1910.

Edwin Guthrie: *"The Psychology of Learning"* – (*"Psikologjia e të mësuarit"*), 1935, botim i rishikuar, 1952.

ASPIRAT/Ë, - A. f. I ardhur nga latinishtja *aspirare* "lartësim". Aspirata është synim i gërshetuar me dëshirë të zjarrtë dhe me shpresë të madhe për t`ia arritur një qëllimi të lartë me vlerë të rëndësishme për njeriun dhe për mjedisin shoqëror të tij. Njerëzit ndryshojnë ndërmjet tyre edhe nga pikëpamja e aspiratës dhe e nivelit të zhvillimit të saj.

ASTAZI, - A. f. Term i latinishtes *astasia* që është dëmtim i rëndë i koordinimit të lëvizjeve të gjymtyrëve të poshtme, që shfaqet me paaftësi të qëndrimit në këmbë të njeriut dhe qëndrimit të drejtë të trupit të tij kur ai është i ulur, megjithëse këmbët nuk janë të paralizuara. Astazia zakonisht zhvillohet paralelisht me paaftësinë e të ecurit, përkatësisht astazia dhe abazia zhvillohen paralelisht. Konsiderohet se çrregullimi astazi – abazi ka prejardhje funksionale, megjithëse deri vonë është konsideruar se ky çrregullim është pasojë e çrregullimit vetëm të trurit të vogël**.**

ASTENI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *αsθενός* "dobësim, ligështi". Astenia është përjetim subjektiv i lodhjes së tepërt, i rraskapitjes fizike dhe psikike, depresionit të frenimit të aktivitetit të njeriut. Shfaqet në forma të ndryshme, nga të cilat dallojmë: humbjen e përqendrimit të vëmendjes, dobësimin e proceseve të kujtesës, ngadalësimin e dukshëm të proceseve të mendimit, mungesën e nismës, motorikës së trupit dhe të gjymtyrëve të tij. Është pasojë e sëmundjeve me bazë cerebrale.

ASTIGMATIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga greqishtja *a* "parashtesë mohuese" dhe *stigma* "pikë". Astigmatizmi është lloj i posaçëm i të metës së të parit, që manifestohet me paqartësi të figurës së retinës nga thyerja e padrejtë e rrezeve paralele të dritës, që kalojnë nëpër brisë, duke mos rënë një pikë e rrjetëzës apo retinës së syrit. Ka mundësi korrigjimi duke përdorur lente të posaçme të syzave.

ASHPËRSI, - A. f. Emërtim për qëndrim dhe sjellje të pamëshirshme, të rëndë, të vrazhdë ndaj tjetrit.

A

ATAK, - U. m. Goditje e papritur fizike në trupin e njeriut, përkatësisht në organet e tij, sidomos në tru, që shkaktohet nga ndikimi i fuqishëm i ngacmuesve të jashtëm. Kjo ndodh pas përballjes së njeriut me një stres të skajshëm. Ataku i tillë mund të jetë vdekjeprurës ose me pasoja të rënda të pariparueshme anatomike e fiziologjike.

ATAKU ME PANIK. Gjendje psikike me kohëzgjatje të pacaktuar që shoqërohet me frikë, me shqetësime, me humbje kontrolli ndaj sjelljeve etj. Ky atak shoqërohet me vështirësi në frymëmarrje dhe me rrahje të forta zemre.

ATAKSI, - A. f. Paaftësia e koordinimit të lëvizjeve që shkakton mosrealizimin e veprimtarisë së vullnetshme. Ataksia mund të jetë e plotë ose e pjesshme. Manifestohet në disa forma, nga të cilat më të njohurat janë: Ataksia mendore – mungesë e koordinimit të ideve dhe të emocioneve me lëvizje të duhura, kur mungesa e tillë është e qëndrueshme. Emërtohet edhe me termin ataksi psikike; Ataksia sensorike – dëmtim i koordinimit të lëvizjeve për shkak të zvogëlimit të sasisë së energjisë së bartjes së impulsive nervore deri në qendrat përkatëse, sidomos të bartjes së impulsive nervore nga qendrat për vendndodhjen e trupit, qëndrimin në vend dhe të lëvizjeve të drejtuara në qëllimin e caktuar; Ataksia statike – dëmtimi i koordinimit të lëvizjeve me humbjen e aftësive të qëndrimit drejt, përkatësisht normal të trupit në një vend të caktuar.

ATAKSIA STATIKE. Term i psikiatrisë dhe i psikopatologjisë i ardhur nga greqishtja *statos* "i vënë" dhe latinishtja *ataxia*. Ataksia statike është çrregullim i aftësisë së qëndrimit drejt të trupit të njeriut, apo çrregullim i baraspeshës trupore. Ka të bëjë më tepër me çrregullim të funksionimit të trurit të vogël.

ATAKSIGRAF, - I. m. Aparat për matjen e stabilitetit të vendndodhjes së trupit gjatë kohës së lëvizjeve të pjesëve të ndryshme të tij.

ATASHIM, - I. m. Lidhje e qëndrueshme emocionale e një individi me tjetrin, e një të madhi me të voglin, e nënës me fëmijën e saj duke e vënë këtë të fundit në shkallë të ndryshme vartësie nga e ëma. Atashimi nënë – fëmijë ka qenë objekt studimesh nga ana e themeluesit të psikanalizës Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939). Sipas tij lidhja midis fëmijës dhe nënës së tij zhvillohet lidhja për plotësim nevojash biologjike (ushqimit, seksit etj.) ka rëndësi të madhe për zhvillimin e marrëdhënieve të mëvonshme shoqërore të fëmijëve tashmë të rritur dhe të tij e të të tjerëve, përkatësisht ndërmjet moshatarëve të tij. Rezultatet e studimeve bashkëkohore kanë treguar se në zhvillimin e marrëdhënieve shoqërore ushtrojnë ndikim edhe faktorët e tjerë, që nuk janë të lidhur me afrimin e ushqimit dhe kënaqjen e shtytësit të urisë të fëmijës nga ana e nënës së fëmijës. Bartja e përvojës nga atashimi nënë – fëmijë, baba – fëmijë etj. në zhvillimin e shtrirjes së marrëdhënieve me të tjerët është ndër çështjet studimore të psikologëve.

ATASHIMI FORMAT. Procesi i zhvillimit dhe i ruajtjes së ndërlidhjes në mes dy individëve me disa forma,

që shfaqen posaçërisht në kuadrin e raportit nënë – fëmijë. Atashimi ambivalent – prania e njëkohshme e kërkesës së fëmijës për nënën dhe tërheqja nga kjo kërkese sapo kjo shfaqet; Atashimi i qëndrueshëm – kërkesa me ngulm e fëmijës për kontakt me nënën apo babanë e vet.

ATAVIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga latinishtja *atavus* "paraardhës" që është shfaqja rishtas e atyre karakteristikave trupore, të cilat nuk kanë qenë të pranishme në brezat paraprak. Shkak i atavizmit është ndikimi i gjeneve recesive, zbërthimi apo rikombinimi i funksionit të gjeneve të dy prindërve. Në të folurin jolibror atavizmi është rikthim i sjelljeve të brezave të mëparshëm në brezin e tanishëm. Ky term haset edhe me kuptimin e shfaqjes së organeve të fishkëta.

ATDHEDASHURI, - A. f. Dispozitë e ndërlikuar ndjesore, kognitive dhe konative e njeriut ndaj atdheut dhe vlerave të tij. Në këtë dispozitë mbisundon emocioni qendror i dashurisë ndaj atdheut dhe i gatishmërisë së angazhimit për zhvillimin dhe mbrojtjen e tij. Shfaqet në dashurinë, gëzimin e kënaqësinë e njeriut për përparimin e atdheut të tij, si edhe në hidhërimin, zemërimin e pakënaqësinë, kur atdheu i tij ngec në procesin e zhvillimit, të përparimit ekonomik, kulturor, sportiv etj. Atdhedashuria zhvillohet gjatë socializmit dhe edukimit.

ATEIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga greqishtja *a* "jo" dhe *theos* "Zot". Mohim i ekzistencës së Zotit, i të jetuarit dhe zhvillimit të njeriut duke mos njohur, mos nderuar, mos respektuar dhe mos iu përkulur Zotit. Ateizmi është pikëpamje e rëndësishme për psikologjinë filozofike e materialiste. Megjithëse është folur qysh herët për ateizmin, shekulli XVIII konsiderohet shekulli i ateizmit. Ndër mendimtarët e dalluar ateistë me pikëpamje psikologjike dallohet psikiatri dhe psikologu austriak Zigmund Frojdi (Sigmund Freud, 1956 – 1938), themeluesi i psikanalizës. Siç dihet, për të sfera e së pavetëdijshmes së njeriut përcakton mendimet dhe sjelljet e vetëdijshme të tij. Mendimtari gjerman i psikologjisë dhe i sociologjisë, Erik Fromi (Erich Fromm, 1900 – 1980), kuptimin e ekzistencës së njeriut nuk ia atribuon Zotit, por aktivitetit të vetë njeriut, mjedisit shoqëror dhe raportit të njeriut me zhvillimin e mjedisit shoqëror të tij.

ATESTIM, - I. m. Proces i përcaktimit objektiv të shkallës së zhvillimit të aftësive të një individi për kryerjen me sukses të një profesioni, për përcaktimin e nivelit të dijeve për një fushëveprim të caktuar etj. Realizohet me anë të testeve të standardizuara. Shih – ***TESTI.***

ATËVRASJ/E, - A. f. Vrasje e babait nga pasardhësit e tij, përkatësisht nga i biri ose bijtë e tij. Atëvrasja në psikanalizë ka kuptim të posaçëm. Sipas Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939) njerëzit primitivë kanë jetuar në hordhi, në fise dhe në krye të secilit fis ka qëndruar babai – pronar i gjithëfuqishëm i të gjitha grave dhe xheloz ndaj tyre. Babai i tillë nuk është parë me sy të mirë nga bijtë e tij dhe këta një herë qenkan rebeluar kundër të atit dhe këtë tiran e paskan vrarë. Mirëpo, për shkak të fajit të bërë, pendimin për

këtë e kanë bartur në totem të hordhisë, të fisit të tyre, përkatësisht në një shtazë hyjnore (ar, gjarpër, lopë etj.), e cila është trajtuar mbrojtëse e fisit dhe simbol i tij. Kjo është konsideruar prejardhje mitike që siguron lidhjen e mirë ndërmjet anëtarëve të atij fisi. Për këtë meshkujt janë larguar edhe nga femrat e fisit të tyre. Sipas Zigmund Frojdit te njerëzit ekziston synimi i pavetëdijshëm për vrasjen e të atit dhe ky synim bartet nga brezi në brez.

ATIPIK, - E. mb. Që përcakton atë që shmanget shumë nga masat e prirjes qendrore të zhvillimit të dukurive psikike, të ndryshores që eksperimentuesi e mat me anën e testeve (nga e mesmja aritmetike, mesorja dhe vlera modale). Atipikja është cilësi përshkruese me vlerë neutrale.

ATOMIZ/ËM, - MI. m. Qasje studimore e proceseve psikike dhe e sjelljeve duke kërkuar njësinë më të vogël (si atomin në fizikë dhe në kimi), të pavarura dhe të pandashme, prej të cilave përbëhen proceset psikike dhe sjelljet. Kjo qasje ka ardhur nga filozofia dhe është karakteristike për asociacionizmin dhe strukturalizmin.

ATONI, - A. f. Mungesë e tonusit të muskujve. Atonia emërton mungesën e tensionit të muskujve skeletorë, kur këta nuk janë të përfshirë në realizimin e ndonjë lëvizjeje. Ka raste kur me atoni kuptohet shkalla e tensionuar e muskujve.

ATRIBUIM, - I. m. Në psikologji atribuimi ka kuptimin e procesit së të dhënit, të përshkruarit të një cilësie, vetie e tipari një individi tjetër. Kështu, nderi, turpi, vendosmëria etj. i atribuohet ose i përshkruhet tjetrit. Zakonisht në rastet e atribuimit ose të përshkrimit të cilësive të tjetrit gabohet, sepse një përcaktim i tillë mbështetet në besimin individual mbi shkaqet e sjelljeve të individit tjetër e jo në kritere objektive. Shih – ***TEORIA E ATRIBUIMEVE.***

ATRIBUIMI SITUACIONAL. Atribuimi i shkaqeve të një sjelljeje të caktuar ndaj situatës së jashtme ku gjendet njeriu dhe supozimi se sjellja e caktuar përpara është rezultat i asaj situate, ose i faktorëve të brendshëm dhe karakteristikave e tipareve të vetë subjektit. E tillë mund të jetë kërkesa dhe shtypja shoqërore e një grupi social për t`u sjellë si një anëtar i tij sipas kërkesës së tyre.

ATRIBUT, - I. m. I ardhur nga latinishtja *attribuere* "ndaj i përshkruaj". Cilësi themelore e një ngacmuesi që perceptohet nga ana e njeriut (nuanca e ngjyrave, pastërtia e tyre, shkalla e shkëlqimi i ngjyrave etj.). Me këtë cilësi emërtohet më shumë ana psikike e perceptimit të një cilësie, e cila në kuptimin e vet fizik ndryshon, por jo në atë psikik.

ATROFI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *a* "parashtesë mohuese", τροφία "ushqim". Atrofia është dobësim i funksionimit të një ose disa organeve dhe i organizmit për shkak të mungesës së ushqimit në organizëm, madje edhe për shkak të mosveprimit të tyre për një kohë të gjatë. Ndikon drejtpërdrejt në realizimin e veprimeve të vullnetshme duke penguar realizimin e tyre.

AUDIOGRAM/Ë, - A. f. Paraqitja grafike e pragut absolut të ndjeshmërisë zë zërave nga ana e secilit vesh të njeriut. Shih – ***AUDIOMETRIA.***

AUDIOMETËR, - I. m. Instrument elektro-akustik për matjen e mprehtësisë së dëgjimit të zërit. Me anën e këtij instrumenti matet shkalla e humbjes së aftësisë së dëgjimit të zërave. Kjo përcaktohet në bazë të normave të dëgjueshmërisë së zërave, sipas këtij modeli: audiometrik prodhon tinguj zërash prej 125 Hz deri në 10 000 Hz, përkatësisht nga pragu më i ulët i ndjeshmërisë, pra pakëz mbi pragun absolut të ndjeshmërisë deri në tingull me intensitet shumë të lartë, që shkakton dhembje. Raporti ndërmjet normës dhe intensitetit të dëgjuar tregon shkallën e ndjeshmërisë, e cila përcaktohet me decibel.

AUDICION NGJYROR. I ardhur nga anglishtja *audition color*. Dukuria e përjetimit të një toni me përjetimin e një ngjyre të caktuar. Shfaqet në formën e lidhjes së toneve muzikore me kohën dhe me ritmin e tyre, duke u lidhur me përjetimin e ngjyrave. Përjetimi i toneve të larta me ritëm të shpejtë lidhet me përjetimin e ngjyrave të çelëta, kurse përjetimi i toneve të thella me ritëm të ngadalshëm lidhet me ngjyra të përhimëta. Dukuria është e lindur, por ende jo e studiuar si duhet.

AUR/Ë, - A. f. Në filozofi i ardhur nga greqishtja *αερο* "ajër i këndshëm", sipas së cilës aura është fryma hyjnore që u jep jetë dhe i vë në lëvizje dukuritë shpirtërore dhe sjelljet e njeriut. Në psikologjinë e sotme aura është përjetim psikik paraprijës i sulmit epileptik dhe sulmeve të migrenës - dhembjes së kokës. Në rastin e parë aura ka disa karakteristika: ndryshim i karakterit të emocioneve të epileptikut, përjetim i çrregulluar i raportit ndërmjet madhësisë së objekteve dhe hapësirës ku ndodhen objektet, frika nga objektet e panjohura, ngadalësim ose përshpejtim i proceseve mendore me iluzione dëgjimore, hundore dhe pamore. Kur përjetimi i paraprin sulmeve të migrenës, atëherë aura shfaqet me këto cilësi: përjetim halucinacionesh, tëi burimit të dritës etj.

AUTIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga greqishtja *autizam* "i vetëm". Gjendje psikike jonormale që shfaqet në prirjen e njeriut për të qenë i preokupuar vetëm me botën e brendshme të tij, madje në këtë botë ai zhytet thellë, duke mos marrë në konsideratë mjedisin dhe kërkesat e tij. Është pasojë e zhvillimit të pamjaftueshëm të mendjes dhe proceseve mendore. Shfaqet me çrregullime në perceptimin e objekteve dhe të dukurive reale, me pushtimin e vetes me botën e fantazmave të veta, me emocione të ftohta ndaj të tjerëve etj. Termi autizëm u përdor në fillim nga psikiatri zviceran Eugen Bloiler (Eugen Bleuler, 1857 – 1939) për shpjegimin e simptomave të skizofrenisë, por sot ka më tepër kuptimin e çrregullimit të proceseve dhe sjelljeve fëmijërore, që shfaqen me këto ndryshime negative: prapambetje në procesin e të menduarit dhe të të folurit, pamundësi e zhvillimit të marrëdhënieve me të tjerët, rezistencë ndaj ndryshimeve etj. Nga disa të dhëna statistikore dallohet raport i 6 : 10.000 d.m.th., 6 fëmijë me autizëm në 10.000 fëmijë.

AUTIZMI INFANTIL. Çrregullim i rëndë psiko-social i fëmijëve. Autizmin infantil e karakterizojnë këto sjellje të prapambetjes: zhvillim i nivelit të ulët të aftësisë së të folurit dhe i komunikimit me të tjerët, mungesë

A

e interesimit për të tjerët, tërheqje në vetvete etj. Këto janë simptomat kryesore të diagnostikimit të autizmit infantil te fëmijët deri në moshën rreth tridhjetë muajsh.

Burimet:

Bernard Durey: *"Autismes et humanité"*– (*"Autizmi dhe humanizmi"*), Marseille, Theetete, 1995.

Hochmann Jacques: *"L`histoire de l`autisme"*– (*"Historia e autizmit"*), Odele Jacob, 2009.

Spiro Saqellari: *"Autizmi – në këndvështrimin psikoedukativ"*, Tiranë 2011.

AUTODIDAKT, - I. m. I ardhur nga greqishtja *αυτο* "vetë" dhe *δίδακτος* "mësoj". Individi që mëson vetë dhe përvetëson dituri, formon shprehi e shkathtësi, duke zhvilluar njëkohësisht proceset mendore në bazë të organizimit të procesit sistematik të motivuar nga vet ai e jo në bazë të arsimit dhe të edukimit të organizuar në institucione të posaçme arsimore, edukative dhe shkencore. Autodidaktët shpeshherë arrijnë të bëhen specialistë të njohur në një fushë të caktuar të krijimtarisë njerëzore. Ndër më të njohurit janë: Leonardo da Vinçi, Franklini, Darvini etj.

AUTODINAMIZËM, - MI. m. Tërësia e shkaqeve të formave të ndryshme të sjelljeve të njeriut, si: dëshirat, motivet, nevojat, synimet, shtytësit etj., pavarësisht nga natyra e tyre biologjike, shoqërore e psikike, si dhe pavarësisht nga shfaqja e tyre që me lindjen e njeriut apo të mësuara gjatë përvojës dhe zhvillimit të tij. Termi autodinamizëm haset në veprat e psikiatrit amerikan Harri S. Saliven (Harry S. Sallivan, 1892 – 1949).

AUTOEROTIZ/ËM, - MI. m. Kënaqësi e shtytësit seksual të njeriut, që shkaktohet nga ngacmimi i pjesëve të trupit, nga prekja e organeve gjenitale dhe e zonave përreth tij. Ky term me këtë kuptim u përcaktua nga studiuesi anglez i seksologjisë Elis Havelok (Elis Havellok, 1859 – 1939). Formë karakteristike e autoerotizmit është masturbimi. Nga studimi i Havelok Elisit studiuesi Zigmund Frojdi (Sigmund Freud, 1856 – 1939) e huazoi këtë term për të emërtuar veprimin seksual kur energjia e shtytësit seksual është e drejtuar në trupin e njeriut apo në organet e tij e jo te të tjerët. Autoerotizmi është tipar i zhvillimit seksual të fëmijëve dhe dallohet posaçërisht në fazën orale të zhvillimit; zhvillimi i libidos shkon nga vetvetja në përzgjedhjen e partnerit të jashtëm.

AUTOKINEZ/Ë, - A. f. Lëvizje, ndryshim që zë fill brenda organizmit të njeriut. I tillë mund të jetë ndryshimi proprioceptiv, informim për pozicionin, vendin e qëndrimit, drejtimin e lëvizjes së trupit. Shtrirja domethënëse e termit autokinezë kanë edhe ndryshimet në proceset kognitive, sidomos të perceptimit, që burojnë nga vetë organizmi, nga përvoja dhe dija e njeriut.

AUTOKTON. mb. Në psikologjinë e personalitetit emërton atë që e ka rrënjën në vetë njeriun, atë që buron nga organizmi i njeriut, nga jeta dhe zhvillimi organik, biologjik, shoqëror dhe psikik i tij. Të tilla janë sjelljet burimore të karakterit filogjenetik, modele sjelljesh, përkatësisht reagime të lindura të organizmit të njeriut (të të gjithë njerëzve) ndaj kategorisë së ngacmuesve të posaçëm.

AUTOMATIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga greqishtja *αυτόματος* "që lëviz vetë".

Term përmbledhës për lëvizje mekanike. Në psikologji në fillim të përdorimit të këtij termi ka emërtuar reagimet dhe veprimet e njeriut që kryhen pavarësisht nga vullneti dhe pa kontrollin e plotë të vetëdijes së tij. Sot emërton procesin e përsosjes së një shprehie deri në shkallën zhvillimore që ajo të kryhet pa kontroll të vetëdijshëm, ose me pak energji të mbikëqyrjes së vetëdijshme të këtij procesi. Në psikologjinë e punës mekanizimi emërton zbatimin e makinave dhe të instrumenteve, që zëvendësojnë njeriun në procesin e prodhimit dhe të administrimit. Në këtë proces roli i njeriut është mbikëqyrja e funksionimit të makinave dhe instrumenteve dhe eventualisht ndërhyrja e tij në rast të ndaljes së procesit prodhues, ose në rast të paraqitjes së pengesave dhe vështirësive në procesin e zhvillimit teknologjik të prodhimit.

AUTONOMI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *αυτό* "vet"dhe *νομος* "ligj". Term që përdoret në shkencat juridike, politikologjike, filozofike etj. Në psikologji termi autonomi përdoret më tepër në kuadrin e togfjalëshave. Kështu, autonomia e personalitetit emërton pavarësinë e një individi në përcaktimin e sjelljeve, të pikëpamjeve, të qëndrimeve dhe të veprimeve etj. nga ana e tij, pavarësisht nga të tjerët, sidomos nga autoritetet e mjedisit kulturor ku ai jeton dhe vepron. Përbëhet nga ndjenja e pavarësisë, nga dëshira për të mos qenë sjelljet e tij të kontrolluara nga të tjerët.

AUTONOMIA FUNKSIONALE. Synimi i një motivi për t'u bërë i pavarur nga shtytësi, nevoja dhe nga motivi parësor, prej të cilit buron fuqia e tij. Termi autonomi funksionale i përket psikologjisë së motivacionit dhe është i lidhur me emrin e psikologut amerikan Gordon V. Olport (Gordon W. Allport, 1897 – 1967).

AUTONOMIA FUNKSIONALE E MOTIVEVE. Shkëputje relative e një motivi nga rendi i motiveve parësore, funksionimi i pavarur i tij dhe shndërrimi i mjetit me të cilin motivi parësor është plotësuar në motiv të pavarur. Termi u përdor nga psikologu amerikan Gordon V. Olport (Gordon W. Allport, 1897 – 1967)**.**

AUTONOMIA GRUPORE. Grup koheziv i gatshëm për t`i përballuar ndërhyrjet nga jashtë dhe i vendosur për ta ruajtur pavarësinë e sjelljeve grupore të të gjithë anëtarëve të atij grupi.

AUTORITET, - I. m. I ardhur nga latinishtja *auctoritas* "pushtet". Personalitet i shquar, i cili gëzon famë e nderim dhe ushtron ndikim të fuqishëm në mjedisin shoqëror të tij. Fama dhe nderimi që ai gëzon mbështetet në vlerat e sjelljet morale, në shkallën e lartë profesionale, në dijeninë e tij, në statusin shoqëror si edhe në tërësinë e këtyre tipareve të karakterit të tij. Për këtë shkak ai ka arritur nivel të lartë në hierarkinë shoqërore të mjedisit të tij. Kjo shkakton drojë dhe fobi te njerëzit e varur, të papjekur emocionalisht dhe të pasigurt.

AUTORITETI ANONIM. Autoriteti i një individi të panjohur, të fshehur, i cili jep urdhra sipas mendjes së shëndoshë, urdhra këmbëngulës, shpesh edhe jorevokues, por këta urdhra janë impersonalë, pa emër dhe mbiemër. Termi me këtë kuptim i përket psikanalistit social amerikan me prejardhje gjermane Erik Fromit (Erich Fromm, 1900 – 1980).

A

AUTORITETI IRRACIONAL. Autoritet i fituar nga ana e një individi në baza hyjnore apo religjioze. Autoriteti i tillë nuk ka mbështetje në aftësitë dhe as në dijet, por në sjelljet manipuluese. Njeriu me të tillë sjellje të autoritetit shkakton frikë dhe nënshtrim të të tjerëve. I kundërt me tipin irracional është tipi racional.

AUTORITETI KARIZMATIK. I ardhur nga greqishtja *χάρισμα* "dhunti". Formë e autoritetit të rrallë që shfaqet te disa individë që janë sugjestivë dhe kanë shkallë të lartë të zhvillimit të intuitës; këta "me urdhër të Zotit" janë paracaktuar të jenë udhëheqës të lartë. Këta kanë tipare e veti mbinjerëzore dhe mbinatyrore me të cilat u imponohen të tjerëve. Këta shquhen me oratori, me suksese të jashtëzakonshme, me trimëri të pashoqe etj. Zakonisht shfaqen në periudha krizash shoqërore dhe qëndrojnë jashtë institucioneve legjitime. I tillë ka qenë Musolini, Hitleri, Zogu etj. I ardhur në psikologji nga sociologjia e Maks Veberit (Max Weber, 1864 – 1920), ekonomist dhe sociolog gjerman.

AUTORITETI LEGJITIM. I ardhur nga latinishtja *legis* "ligj". Autoriteti legjitim është autoriteti i parlamentit, i pushtetit, i qeverisë, autoriteti i lirisë, i qëndresës etj., që pranohet dhe nderohet nga mjedisi shoqëror i caktuar.

AUTORITETI RACIONAL. Autoritet i një individi që bazohet në aftësinë mendore të tij, duke mos pasur lidhje me statusin e vet në një shoqëri të ngushtë ose të gjerë dhe duke vepruar në një fushë kryesisht të ngushtë profesionale.

AUTORITETI TRADICIONAL. Autoritet i një individi i fituar mbi bazën e imponimit me forcë te pasardhësit të mendimit, të pikëpamjeve, të qëndrimeve, modeleve të sjelljeve etj. të traditës së një vendi dhe popullit të tij. Ky autoritet zhvillohet dhe ruhet duke shpërblyer përmbajtjet tradicionale dhe duke dënuar të tjerat. Në këtë proces rol të rëndësishëm ka shoqërizimi i fëmijës në familje.

AUTOSUGJESTION, - I. m. Vetësugjerim, përkatësisht ndikimi në vetvete. Autosugjestioni është proces i qëllimshëm i ngritjes së vetëbesimit, me anën e të cilit njeriu i ndryshon vetë bindjet, qëndrimet dhe sjelljet në përputhje me dëshirat, interesimet, brengat dhe ngarkesat e frikës së tij. Autosugjestioni bëhet edhe për ta zvogëluar frikën dhe ngarkesat e tjera negative. Realizohet sipas një qëllimi të caktuar duke përsëritur në kushte specifike mendimet dhe përfytyrimet për objektet, situatat e lidhura me sjellje të veçanta. E konceptoi fizioterapeuti dhe farmacisti francez Emil Kue (Emile Coue, 1857 – 1926), duke përsëritur së paku tridhjetë herë në ditë fjalinë "Çdo ditë, në çdo pikëpamje gjithnjë e më shumë po përparoj". Ka ndikim të pakët, madje edhe ky ndikim ka të bëjë vetëm me përjetimet e vetëdijshme.

AVERSION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *a* "parashtesë mohuese" dhe *veretere* "kthehem". Ndjenjë neverie, mundimi dhe qëndrim refuzues ndaj një dukurie, një njeriu, një situate etj., që rrjedh nga brendësia shpirtërore e njeriut. Ky mund të ketë aversion ndaj një lloj ushqimi dhe për këtë ikën, largohet nga një ushqim i tillë**.** Shih – ***NEVERIA*.**

B

BABINSKI Fransua (FELIKS Zhozef) (**François BABINSKI**, **Joseph FÉLIX).** Mjek-neurolog francez me prejardhje polake. Lindi në Paris më 1857 dhe vdiq në Paris më 1932. Ishte "nxënës" i Zhan Marten Sharkos në spitalin Salpetrier të Parisit. Interesimi i tij për histerinë ishte shkak i angazhimit në gjurmimin e shkaqeve të histerisë dhe të sjelljeve histerike. Iu bashkua pikëpamjes së Zhan Marten Sharkos, sipas së cilës shkaqet e histerisë nuk kanë të bëjnë me çrregullime neurologjike, sepse histeria është pasojë e çrregullimeve psikike të njeriut. Më 1901 e rishikoi përkufizimin e histerisë të përcaktuar nga mësuesi i tij dhe këtë e quajti pitiatizëm (nga greqishtja *πείθω* "bindje" dhe *ιατρικός* "e shërueshme". Thelbi i këtij ndryshimi është hedhja poshtë e etiologjisë seksuale të histerisë dhe të bazuarit e zhvillimit të saj në shkaqe psikike. Por, termi pitiatizëm nuk ka zënë vend shumë kohë në psikopatologji dhe as në psikiatri. Ndër rezultatet e gjurmimeve neurologjike në psikologji ka mbetur koncepti i refleksit të Babinskit – tërheqja e gishtërinjve të këmbës nga brenda, si reagim ndaj ngacmimit të shputës së këmbës. Kjo zgjati deri në vitin e parë dhe, nëse shfaqet edhe më vonë, është simptomë e çrregullimit organik, pra e dëmtimit të rrugëve nervore motorike. Edhe pse me autoritet profesional e shkencor të lartë, nuk përmendet për ndonjë vepër të shkruar. Por, emri i Fransua Babinskit gjendet në enciklopedi të përgjithshme dhe në enciklopedi profesionale, si në veprën e Elisabet Roudineskos *"Histoire de la psychoanalyse en France"* – (*"Historia e psikanalizës në Francë"* vëllimi 1, botuar më 1982).

BAGAZHI I KUJTESËS. Sasia e informacioneve të kujtesës, përkatësisht e kujtesës afatgjatë, ku janë depozituar këto informacione. Nga ky burim njeriu merr idetë, konceptet, gjykimet e lidhjet e ruajtura ndërmjet tyre, duke i shfrytëzuar këto për marrjen e një vendimi për sjellje të caktuar ndaj një objekti, procesi apo situate.

BAJIQ Baja. Psikolog. Lindi në Mitrovicë të Sremit më 1896 dhe vdiq në Beograd më 1988. Profesor inordinar për lëndën "Psikologji e përgjithshme"

në Universitetin e Beogradit. Kreu studimet universitare për drejtësi në Paris më 1923, duke i ndjekur njëkohësisht edhe lëndët e psikologjisë te profesorët e njohur të asaj kohe Pjer Zhane, (Pierre Janet), Zhorzh Dyma (Georges Dumas, 1866 – 1946) dhe Anri Valon (Henri Wallon, 1879 – 1962). U diplomua për psikologji një vit pas përfundimit të drejtësisë, më 1924. Menjëherë pas diplomimit në psikologji zgjodhi si temë doktorature "*Psychologie de la Revèrie*" – ("*Psikologjia e ëndërrimit*"), të cilën e mbrojti me sukses më 1927. U punësua pas shumë peripecive në Universitetin e Shkupit, duke marrë thirrjen universitare docent për lëndën psikologji e përgjithshme. Lufta e Dytë Botërore e gjeti si profesor inordinar në Universitetin e Beogradit, ku ka ligjëruar lëndën psikologji e përgjithshme për studentët e grupit të filozofisë së thjeshtë dhe për studentët e katedrës së pedagogjisë. Me themelimin e seminarit të psikologjisë, më pas të katedrës së psikologjisë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Beogradit dha mësim në lëndën psikologji e përgjithshme për studentët e psikologjisë, derisa doli në pension më 1964. Në veprimtarinë mësimdhënëse dhe shkencore të tij ka sintetizuar me sukses mendimin psikologjik të shkollës franceze dhe atë të psikologjisë kognitive të shkollës gjermane. Libri i tij "*Opsta psihologija I*" – *("Psikologjia e përgjithshme I")* është vlerësuar lartë nga qarku profesional dhe shkencor i psikologëve të Beogradit dhe prej vitit 1954 deri më 2009 libri u ribotua pesë herë. Studentët shqiptarë që kryen psikologjinë në Universitetin e Beogradit (Pajazit Nushi dhe Neki Juniku) kanë pasur nderin të mësojnë psikologjinë e avancuar europiane, së pari atë franceze dhe gjermane, nga ky profesor i respektuar. Ka mbajtur një qëndrim të drejtë ndaj studentëve shqiptarë dhe mbetet i nderuar më tepër për zhvillimin e mendimit psikologjik në Kosovë, mbi themelin e psikologjisë moderne europiane të gjysmës së dytë të shekullit të njëzet. Mësimet e tij kanë përcaktuar esencialisht drejtimin e zhvillimit të psikologjisë europiane me ndikim të pakët të psikologjisë sovjetike. Veprat kryesore të Baja Bajiqit janë: *"Psihologija i medicina"* – (*"Psikologjia dhe mjekësia"*, Skopje, 1934);*"Opšta Psihologija I"* – (*"Psikologji e përgjithshme I*", Beograd, 1954); *"Vojna Psihologija"* – (*"Psikologjia ushtarake"* (Kapituj të përzgjedhur), Beograd, 1960)*; "Alfred Adler*" etj.

BALDUIN Mark Xhejms (Mark James BALDWIN). Psikolog dhe filozof amerikan. Lindi më 1861dhe vdiq më 1934. U mor me studimin e psikologjisë zhvillimore, të psikologjisë fiziologjike dhe të psikologjisë sociale. Profesor i sociologjisë në Paris. Themelues i Shoqatës së Psikologëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në kuadrin e mendimeve filozofike ka bërë dallimin ndërmjet shkencave statike apo jogjenetike dhe atyre gjenetike. Shkencat e jetës zhvillohen nga pikëpamja gjenetike, kurse ato jogjenetike reduktohen në studimin e sasisë, të barazisë dhe të mekanicizmit. Ndërkaq, integrimi i tyre kryhet në bazë të përvojës estetike. Mbi këtë bazë mund të thuhet se ai ka bërë ndarjen dualiste në sisteme konceptuale organike dhe joorganike, kurse integrimin e tyre e sheh të pamundur nga këndvështrimi

logjik, por vetëm me anë të përvojës dhe përjetimeve estetike. Në historinë e psikologjisë mbeti i njohur më tepër me veprat e botuara të karakterit teorik, që kishin rëndësi të posaçme për zhvillimin e psikologjisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës që nga fillimi i viteve të para të shekullit të njëzet. Veprat kryesore të Balduinit janë: *"Development in Child and Race"* – (*"Zhvillimi në fëmijëri dhe në gjini",* 1897); *"Dictionary of Philosophy and Psychology"* – (*"Fjalor i filozofisë dhe i psikologjisë",* 1901 – 1905); *"Genetic Logic"* – (*"Logjika gjenetike",* 1906 – 8); *"Elements Psychology"* – (*"Elementet e psikologjisë",* 1909); *"The individual and Society"* – (*"Individualja dhe shoqërorja",* 1910); *"History of Psychology"* – (*"Historia e psikologjisë",* 1913).

BALIZ/ËM, - MI. m. Çrregullim i lëvizjes së gjymtyrëve të trupit të njeriut. Shfaqet me pamundësinë e njeriut për t`i kontrolluar lëvizjet e pavullnetshme të duarve dhe të këmbëve ose të njërës anë të gjymtyrëve. Format konkrete të manifestimit të balizmit janë: lëvizje të shpejta, të pakoordinuara dhe të vrazhda të duarve dhe ndryshimi i formave të këtyre lëvizjeve. Balizmi është pasojë e lëndimit të njërës nga bërthamat a nukleuset e subtalamusit që janë të lidhura me ganglionet e mëdha bazale të trurit dhe lidhja e tyre shtrihet deri në pjesët e trurit të mesëm.

BAMIRËSI, - A. f. Tërësi qëndrimesh e synimesh të organizuara të një individi, me të cilat u sjell të tjerëve të mira morale e materiale. Kur bamirësia merr karakterin e përgjithshëm dhe të qëndrueshëm të sjelljeve ndaj të tjerëve, atëherë ajo përbën njërin nga tiparet e karakterit të njeriut. Bamirësia mund të ketë karakter qëndrimi, po qe se shfaqet si sjellje e qëndrueshme ndaj dukurisë, grupit të individëve, objektit, situatës së caktuar etj.

BANDURA Alfred (Alfred BANDURA). Lindi më 1925. U diplomua për psikologji dhe mbrojti doktoratën për psikologji më 1952. Punoi shumë kohë në katedrën e psikologjisë së Universitetit Stanford. U mor kryesisht me çështjet e të mësuarit social, përkatësisht me modelimin e sjelljeve, me faktorët dhe rrugët e modelimit të sjelljeve të njeriut, duke mos u mbështetur në rezultatet e gjurmimit të rolit të reflekseve të kushtëzuara, të refleksit operant dhe në rezultatet e njohura deri atëherë të rolit të imitimit në modelimin e sjelljeve. Megjithëkëtë ai e ka konsideruar të rëndësishëm rolin e imitimit, duke theksuar këtë mekanizëm psikologjik përmbajtësor. Në këtë kuadër u mor me studimin e agresivitetit dhe ndryshimin human të sjelljeve agresive. Më vonë pohoi "se pritja për atë që do të arrijmë ndikon në atë që me të vërtetë arrijmë". Veprat kryesore të Alfred Bandurës janë: *"Adolescent Aggression"* – (*"Agresioni i adoleshentit"*), 1959; *"Social Learning an Personality Development* – (*"Të mësuarit social dhe zhvillimi i personalitetit"*), 1963; *"Principles of Behavior Modifikation"* – *"Parimet e modifikimit të sjelljeve"*), 1969; *"Aggression: A Social Learning Analysis"* – (*"Agresioni: analiza e të mësuarit social"*), 1973; "*Self - Efficacy: The Exercise of Control"* – (*"Vetefikasiteti: zbatimi i kontrollit"*), 1997.

BARAGNOZI, - A. f. I ardhur nga latinishtja *baragnossia*. Baragnozia është humbja e aftësisë së vlerësimit të saktë të peshës së ngritur të një objekti me duart e individit. Pamundësia e këtij

vlerësimi është pasojë e lëndimit të lobit oksipital (zverkor) të trurit të madh dhe cipës së lobit të kësaj pjese të trurit.

BARBITURATE. asnj. Substanca farmakologjike që përbëjnë një grup të madh substancash të tilla, të cilat vënë në gjumë marrësit e tyre. Këto substanca farmakologjike quhen psikofarmakologjike, sepse futja e tyre në organizëm godet qendrat subkortikale të trurit, duke qetësuar organizmin e njeriut, duke ngadalësuar në rend të parë proceset psikike kognitive, sidomos procesin e kujtesës, të menduarit e të folurit dhe të mësuarit. Substancat më të njohura të këtij grupi janë: amobarbitalet, barbitalet, fenobarbitalet etj. Për nga kohëzgjatja e efektit të tyre barbituratet ndahen në barbiturate me ndikim afatgjatë, afatmesëm dhe afatshkurtër. Përdoren më tepër për të rregulluar ritmin e gjumit, për anestezi dhe si mjete terapeutike për epilesi. Marrja e shpeshtë e tyre çon në varësi psikofizike të organizmit nga këto substanca.

BARORECEPTOR, - I. m. Receptorë të vendosur në zemër dhe në paretet e arterieve të mëdha të gjakut. Këta receptorë reagojnë ndaj ndryshimeve të sasisë së gjakut në arterie. Marrin pjesë edhe në rregullimin e etjes së organizmit.

BARRIER/Ë, - A. f. I ardhur nga frëngjishtja *barrière* "pengesë, pritë". Pengesa që kushtëzojnë individin në arritjen e një qëllimi, përkatësisht deri në realizimin e motivit të tij. Këto mund të jenë tri llojesh: natyrore, shoqërore dhe personale. Pengesat ose barrierat natyrore janë ato që kanë burim natyror (dëshira e flaktë për të arritur në majë të Everestit). Pengesa shoqërore janë ato pengesa që kanë të bëjnë me rendin, zakonet, ligjet etj. Pengesat ose barrierat personale mund të jenë ato që kanë të bëjnë me të metat trupore ose me zhvillimin e kufizuar të aftësive të njeriut. Nëse pengesat apo barrierat e tilla janë të pazotërueshme nga ana e një individi, kurse fuqia motivuese e zotërimit të tyre është e madhe, atëherë shfaqet frustrimi i njeriut. Shih – ***FRUSTRIMI.***

BASTARD, - I. m. Individi me tipare të zvetënuara të karakterit dhe të personalitetit. Bastardi është rezultat i ndikimit të shumë faktorëve të ndërlikuar psikologjikë, shoqërorë dhe pedagogjikë.

BASHKËRENDITJA E LËVIZJEVE. Shih – ***KOORDINIMI I LËVIZJEVE.***

BASHKËSIA TERAPEUTIKE. Bashkësi e përbërë nga psikoterapeuti, mjeku, infermierja etj. Këta së bashku në mjedisin spitalor orvaten ta zvogëlojnë sa më shumë dallimin e sjelljeve të klientit në rrethin spitalor dhe jashtë tij, përkatësisht në mjedisin e zakonshëm. Konsiderohet formë bashkëkohore dhe efikase e shërimit të klientit.

BATERIA E TESTEVE. Grup testesh të ndërlidhura që përbëjnë një tërësi dhe provojnë në të njëjtën kohë anët e ndryshme të funksioneve të një strukture psikike (të inteligjencës), ose të një procesi të ndërlikuar duke i zbatuar te subjektet e njëjtë. Bateri testesh mund të jetë testi didaktik i matematikës i përbërë nga këto teste: testet e të provuarit të aftësisë së operacioneve llogaritëse, të zgjidhjes së problemave matematikore dhe të llogaritjes përmendësh. Arritjet e subjektit në

zgjidhjen e detyrave dhe të problemave të të tri grupeve të testeve përbëjnë një rezultat të përbashkët. Ky rezultat ka vlerë më të madhe dhe ka shkallë besueshmërie më të lartë se rezultati i arritur vetëm në zgjidhjen e problemave dhe në kryerjen e detyrave të një testi të matematikës.

BAZ/Ë, - A. f. I ardhur nga greqishtja *βάση* "themel". Themeli mbi të cilin zhvillohet një veprimtari e caktuar dhe që paraqet një tërësi kushtesh të domosdoshme për atë veprimtari. Nga rrënja e kësaj fjale greke, tashmë e stabilizuar në gjuhën shqipe, formohet mbiemri bazal e bazik, përkatësisht themelor, përcaktues i disa strukturave psikike dhe funksioneve të posaçme. Në gjuhën shqipe përdoret më shumë mbiemri themelor e jo bazal dhe as bazik.

BAZA BIOLOGJIKE E SJELLJEVE. Sistemi nervor, gjëndrat me sekretim të brendshëm, shqisat e muskujt. Funksioni i ndërlidhur i tyre me organizmin në tërësi ka të bëjë drejtpërdrejt me zhvillimin e sjelljeve dhe të proceseve psikike. Shih – ***SISTEMI NERVOR.***

BAZA NEUROFIZIOLOGJIKE DHE BIOKIMIKE E KUJTESËS. Kujtesa ka bazë neurofiziologjike dhe biokimike të ndërlikuar, madje, ende të pacaktuar tërësisht. Kujtesa dhe proceset e saja në pikëpamje neurofiziologjike besohet se është e lidhur ngushtësisht me zonën limbike të trurit, përkatësisht me strukturën e neuroneve dhe me sinapset e tyre të hipokampusit, organ i kores a cipës së trurit të madh që gjendet në brendësi të pjesës oksipitale ose zverkore të trurit. Rezultatet klinike kanë treguar se hipokampusi është qendër trunore e konsolidimit të gjurmëve nervore të të mbajturit mend të asaj që është mësuar. Në pikëpamjen biokimike kujtesa dhe proceset e saja shpjegohen me teorinë e rolit të substancave të neurotransmetuesve, ku rol të pazëvendësueshëm në ruajtjen e informacioneve luajnë dy substanca: acetilkolina dhe acetilkolinesteraza. Por, deri tani ka mbetur i pamohueshëm argumenti i rolit të qelizave nervore të trurit të mesëm me sasi të madhe të acidit ribonukleid (molekula të ndërlikuara të fosforit, të sheqerit etj.) në zhvillimin e proceseve të kujtesës.

BAZHDARIA E TESTEVE. Normimi dhe shkallëzimi i rezultateve bruto dhe shndërrimi i këtyre rezultateve në një shkallë matëse më të lehtë për të kuptuar dhe vlerësuar rezultatet bruto të arritura nga ana e një individi. Është pjesë përbërëse e standardizimit të testeve. Pika referuese e procesit të bazhdarimit të testeve është mesatarja aritmetike e përftuar nga matja e një ndryshoreje psikologjike nga një popullatë e madhe përfaqësuese. Nga kjo pikë largohen rezultatet individuale në shkallë të ndryshme, që japin lëndën e përcaktimit të shkallës së shmangies së tyre nga mesatarja aritmetike. Shkalla e shmangies së këtyre rezultateve nga mesatarja aritmetike përcaktohet duke zbatuar këto procedura statistikore: shkalla e decileve, e centileve, e vlerës z etj. Rezultati individual i arritur në njërën nga shkallët e përmendura nga matja e inteligjencës tregon sa është niveli i zhvillimit të inteligjencës mbi ose nën atë shkallë.

Burimet:

Save the Children, *"Si të hartojmë një test?"*, Tiranë, 2002.

B

BEBJA E SYRIT. Pjesa e përparme e diafragmës së ylberthit të syrit. Madhësia e saj është e ndryshueshme dhe varet nga sasia e rrezeve të dritës që depërtojnë në të. Sasia e madhe e rrezeve të dritës të një burimi shkakton zvogëlimin, kurse sasia e vogël zmadhimin e bebes së syrit. Rritja dhe zvogëlimi i saj ka karakter refleksiv dhe sillet prej 2 mm deri në rreth 8 mm. Bebja e syrit është rregullatore e kalimit të sasisë së duhur të rrezeve të dritës për në retinë. Në anatominë e syrit njihet më tepër me termin latin *pupila*.

BEFASI, - A. f. Dukuri, proces, situatë etj. e papritur nga ana e njeriut. Karakterizohet me ndjenjën e çudisë, me gjendjen e organizmit për të reaguar sipas modelit të përgjithshëm të reagimit ndaj klasës së dukurive apo situatave të ngjashme dhe me reagimet e papërgatitura të njeriut ndaj saj. I tillë mund të jetë informacioni për vdekjen e prindit në një fatkeqësi komunikacioni, asgjësimi i trupit të lisit shumëvjeçar nga rrufeja etj.

BEHTERJEV Mihajlloviç Vladimir (Vladimir Mihajlovic BEHTERJEV). Neurolog dhe psikiatër rus me ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e psikologjisë objektiviste. Lindi në Sorali afër qytetit Vjatka më 20.01.1857 dhe vdiq në Moskë më 24.12.1927. Pas përfundimit të studimeve në Fakultetin e Mjekësisë në Moskë u mor me studimin eksperimental të reagimeve refleksive, të llojeve të këtyre reagimeve dhe bazës neurologjike të tyre. Ka hulumtuar funksionin e rrjetës retikulare dhe lidhjet e funksionimit të saj me proceset psikike. Zbulues i një lloj sëmundjeje reumatike e njohur me emërtimin "Sëmundja – B" ("*spondylarthritis amkylopoetica*"). U emërua profesor i Universitetit të Petrogradit, i Universitetit të Kazanit dhe më pas i Akademisë Mjekësore Ushtarake të Universitetit të Petrogradit. Anëtar i Akademisë së Shkencave të ish Bashkimit Sovjetik. Veprat e tij janë botuar në rusisht; janë përkthyer në gjermanisht, frëngjisht e në anglisht dhe janë botuar në Berlin, Paris dhe në Nju Jork. Rezultatet e studimeve të tij në fushën e reflekseve i dhanë shkas të merret edhe me studime psikologjike. Konsiderohet një ndër themeluesit e mjekësisë psikosomatike. Psikologjia e Vladimir Mihajlloviç Behterjevit mbështetet në analizën e hollësishme të refleksit të kushtëzuar klasik dhe të atij operacional. Sipas tij ekzistojnë dallime cilësore ndërmjet refleksit të kushtëzuar klasik dhe atij që u quajt kushtëzim operacional, pra refleks operant. Zgjeroi bazën nervore anatomike dhe fiziologjike të reagimeve refleksive, duke shtrirë qendrat e këtyre reagimeve, jo vetëm në cipën e trurit të madh, por edhe në qendrat nëncipore të trurit të madh. Në bazë të këtyre arritjeve "psikologjia" e tij u quajt refleksologji. U dallua me shpjegimet e sjelljeve shoqërore, duke i vendosur këto shpjegime në kuadrin e ligjeve psikologjike. Me këtë konsiderohet se është inicues i zhvillimit të psikologjisë shoqërore apo i psikologjisë sociale. Veprat kryesore të tij janë: *"Osnovi učenija o funkciji mozga"* – (*"Bazat e diturisë mbi funksionin e trurit"*, 1903 – 1907); *"Objektivnaja psihologija"* – (*"Psi-*

kologjia objektive I–III", 1907–1912); *Obšije osnovi refleksologiji"* – (*"Bazat e përgjithshme të refleksoologjisë",* 1918); *"La Reflekxologie collective"* – (*"Refleksoologjia kolektive"*, botuar në Paris, 1957).

BELBËZIM, - I. m. Njëra nga format e shpeshta të çrregullimit të rrjedhës, të ritmit dhe artikulimit të duhur të fjalëve nga ana e një individi belbacak. Belbëzimi shfaqet më tepër te fëmijët e moshës deri 7 vjeç, përkatësisht rreth 15 % e fëmijëve të moshës 4 – 7 vjeç vuajnë nga belbëzimi, dhe, nga këta, rreth 75 % e fëmijëve që belbëzojnë i takojnë atyre të gjinisë mashkullore. Format më të shpeshta të shfaqjes së belbëzimit janë dy: 1) Vështirësitë e shqiptimit të tingullit të parë të fjalës dhe pamundësia e daljes së tyre nga një bllokim i tillë. Kjo formë i përket tipit të shqiptimit të fjalës shtëpi, që fëmija belbacak e shqipton duke u bllokuar në tingullin e parë, 2) Formën e dytë e karakterizon përsëritja e panevojshme e tingullit të parë me të cilin fillon një fjalë e caktuar, p.sh., për shqiptimin e fjalës shtëpi ai bllokohet në shqiptimin e tipit sh – sh – sh – sh – shtëpi. Në rastet e këtilla shfaqen edhe disa ndryshime fiziologjike, si: të ngërdheshurit e muskujve të fytyrës, buzët dhe nofullat marrin formë të posaçme, ritmi i frymëmarrjes çrregullohet etj. Belbëzimi ka formë të çrregullimit funksional. Te fëmijët në rastet më të shpeshta shfaqet me përjetimin e ndonjë traume (ndarja e prindërve, vdekja e njërit prind, dhuna në familje etj.). Deri më sot nuk ekziston ndonjë shpjegim etiologjik gjithëpërfshirës i belbëzimit. Belbëzimi lind më shpesh si pasojë e problemeve ndërmjet prindit autoritar dhe fëmijës. Me zbatimin e masave logopedike shkalla e zvogëlimit mund të bjerë, madje edhe të mënjanohet. Format më të shpeshta të terapisë së belbëzimit janë: terapia bihejviorale, terapia psikanalitike, terapia farmakologjike etj.

BEQJA Hamit. Psikolog shqiptar. Anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Lindi në Shkodër më 1929 dhe vdiq në Tiranë më 2011. Kreu studimet universitare për pedagogji dhe psikologji në Universitetin e Moskës më 1953. U mor me studimin e çështjeve edukative, shoqërore dhe të aktualitetit politik të Shqipërisë së dekadave të para të gjysmës së dytë të shekullit të njëzet. Përmbajtja e këtyre studimeve u kundrua nga bazat teorike të zhvillimeve psikologjike, kryesisht të shkollës fiziologjike ruse të Ivan Pavllovit. Bashkautor i teksteve të psikologjisë për shkollat e mesme dhe të larta, si: "Psikologjia – tekst për shkollat e mesme", 1961; "Psikologjia", Për Institutin pedagogjik 2- dhe 4-vjeçar dhe për Institutin Juridik. Kurs leksionesh", 1956; "Psikologjia. Tekst për Universitetin dhe institutet pedagogjike 2-vjeçare", 1959 etj. Bashkautor në përkthimin e këtyre përmbajtjeve nga rusishtja në shqip për hartimin e librit "Pedagogjia" për shkollat e larta të botuar më 1960: "Roli i trashëgimisë, i ambientit dhe i edukatës në zhvillimin e fëmijëve"; "Veçoritë e moshave të fëmijëve"; "Edukimi i vullnetit dhe i karakterit". Autor i shumë trajtesave dhe artikujve të botuar në revista pedagogjike e kulturore të Tiranës. Ndër këto punime ka trajtesa të lidhura drejtpërdrejt me psikologjinë, ku dallojmë: "Aspekte psikologjike e pedagogjike të formimit

të edukatës qytetare", 1976; "Afirmimi i psikologjisë socialiste të njeriut tonë të ri (Njeriu i ri me psikologji të re)", 1982; "Veçoritë psikike të personalitetit të rinisë shkollore dhe problemet edukative që dalin", 1985. Veprat kryesore të tij janë: *"Mbi karakterin kombëtar të edukatës",* 1979; *"Rreth edukatës qytetare",* 1981; *"Si të sillemi, ç'zakone ndjekim?",* 1986; "*Kë edukojmë, si edukojmë",* 1987; "*Rrjedhave të sociologjisë së edukatës dhe kulturës",* 1989; "*Edukata me syrin e popullit",* 1988; *"Edhe engjëlli edhe djalli janë brenda tek i gjalli*", 1995; "*Tranzicioni demokratik dhe psikologjia e Shqiptarëve të sotëm",* 2001; *"Galeria dhe plateja",* 2002.

BERKSON Anri (Henri BERGSON). Filozof francez. Lindi në Paris më 18.10.1859 dhe vdiq në Paris më 14.01.1941). Profesor për shumë vite i filozofisë në "Collége de France" ("*Kolegji Francez*"). Në moshën 55-vjeçare u zgjodh anëtar i Akademisë së Shkencave të Francës dhe më 1937 ka fituar çmimin Nobel për letërsi. Konsiderohet si një filozof me kulturë të lartë psikologjike, mendimtar e tepër produktiv. Autoritet shkencor me ndikim të fuqishëm në zhvillimin e mendimit psikologjik të shekullit të nëntëmbëdhjetë e në gjysmën e parë të shekullit të njëzet. Pikëpamjet e tij filozofike dhe psikologjike kanë ushtruar ndikim të fuqishëm në zhvillimin e psikologjisë, të psikanalizës dhe të psikologjisë ekzistencialiste. Sipas tij, zhvillimi mendor i njeriut është i nxitur nga "*élan vital*" – *"fuqia, vrulli jetësor*", dhe mbi bazën e tij zhvillohen proceset e larta psikike, duke përfshirë edhe vullnetin e lirë të njeriut. Kohëzgjatja e vullnetit të lirë kapet me anë të intuitës. Sipas tij intelekti i njeriut ka rëndësi për njohjen e realitetit, për analizën e dukurive të tij sipas qëllimeve praktike të njeriut. Intuita e shtrin fuqinë e vet në angazhimin e brendshëm të njeriut, duke ndriçuar për një çast procesin e iluminacionit. Te njeriu elani jetësor e ka arritur shkallën më të lartë evolutive të lirisë së vet. Për Anri Berksonin njeriu është produkti më i lartë i evolucionit, kurse kujtesa e tij është thelbi i shpirtit të vetë njeriut. Veprat e tij janë përkthyer në shumë gjuhë të botës, ndër të cilat më kryesoret janë: "Matièrie et Memoire" – ("*Materia dhe kujtesa",* botuar më 1897); *"L`Evolution créatrice"* – (*"Evolucioni krijues",* botuar më 1907); "*Essai sur les données immediate de la conscience"* – (*"Pasqyrë e fakteve imediate të vetëdijes",* botuar më 1889).

BERNARD Klod (Claude BERNARD). Fiziolog francez. Lindi më 1813 dhe vdiq më 1878. Pasi përfundoi Fakultetin e mjekësisë, u doktorua në shkenca mjekësore. U zgjodh profesor i fiziologjisë në Universitetin e Sorbonës dhe më pas u zgjodh anëtar i Akademisë së Shkencave të Francës. U mor me studimin e sistemit nervor, përcaktoi synimin e organizmit për të vënë një baraspeshim automatik në organizëm. Në hulumtimet e tij ka përdorur dhe zbatuar metoda karteziane, që filluan të zbatohen me kujdes të posaçëm edhe në gjurmimin e proceseve psikike. Së bashku me fiziologët e tjerë (A. Haller, R. Loce, P. Broka etj.) i përpunuan parimet dhe procedurat e hulumtimeve eksperimentale objektive, duke treguar mundësinë e zbatimit të tyre edhe në psikologji. Disa nga këto procedura edhe sot zbatohen në gjurmimet e veprimtarisë

psikonervore. Klod Bernar përmendet si një ndër themeluesit e psikologjisë eksperimentale. Vepra kryesore e tij është*: "Introduction ā l`étude de la médicine expérimentale" – ("Hyrje në hulumtime të mjekësisë eksperimentale"),* 1865.

BERRHUS Skiner F. (Skiner F. BURRHUS). Lindi në Susquehanni të Pensilvanisë më 1904 dhe vdiq më 1990. Studioi letërsi e më pas psikologji në Universitetin e Harvardit, ku pas përfundimit me sukses të studimeve për psikologji vazhdoi veprimtarinë gjurmuese, ku u magjistrua dhe doktorua. U zgjodh profesor i psikologjisë në Universitetin e Minesotos ku dha mësim në vitet 1937–1945; më pas, në vitet 1945–1948 në Universitetin Indiana dhe deri sa doli në pension ishte profesor i psikologjisë dhe studiues eksperimental i sjelljeve në Universitetin e Harvardit, ku si profesor i psikologjisë mori thirrjen e nderit "Edgar Pirs". Ithtar i madh i bihejviorizmit, por në ndryshim nga themeluesi i bihejviorizmit Xhon Uotson, ishte i prerë në qëndrimin se "*Psikologjia nuk duhet të merret me shpjegimin e asaj çfarë ndodh në organizëm, madje edhe në qoftë se ka të bëjë me procese fiziologjike të thjeshta, por duhet të merret me hulumtimin dhe përshkrimin vetëm të marrëdhënieve të organizmit me mjedisin e jashtëm, duke u përkufizuar në përshkrimin e pastër dhe duke u larguar nga çfarëdo interpretim, ose duke u përmbajtur nga të shtuarit e çfarëdolloj faktesh të vërtetuara*". Për Skiner Berrhusin sjelljet janë rreptësisht të përcaktuara. Konceptet e reja bihejvioriste të tij u mbështetën kryesisht në refleksin operant. Zhvilloi një teknikë të përsosur të gjurmimit shkencor të sjelljeve dhe të modelimit të tyre, duke ndikuar shumë në zhvillimin e psikologjisë objektive. Veprat kryesore të tij janë: "*The behavior of organism*" – ("*Sjelljet e organizmit*", 1938); *"Science and human behavior" – ("Shkenca dhe sjellja njerëzore",* 1947); "*Verbal behavior*" – ("*Sjellja verbale*", 1959); *"Beyond freedom and dignity" – ("Në anën tjetër të lirisë dhe të dinjitetit",* 1971); *"About behaviorism' – ("Rreth bihejviorizmit",* 1979) etj.

BES/Ë, - A. f. Tërësi e ndërlidhur normative e motiveve, e qëndrimeve, e ndjenjave, e vlerave dhe e sjelljeve ndaj fjalës së dhënë, të fjalës së nderit për të zbatuar detyrën e marrë përsipër. Bazën psikologjike të besës e përbën ndjenja e lartë e përgjegjësisë ndaj detyrës së marrë përsipër, qëndrimi pozitiv i njeriut ndaj parimeve e normave morale të mjedisit, motive i vetafirmimit, i sigurisë etj. Është rregullatore e brendshme e marrëdhënieve morale e psikike ndërmjet individëve, familjeve, farefisnive etj. Besa ka tiparet e karakterit të njeriut.

BESA NDËR SHQIPTARËT. Parim moral dhe institucion i së drejtës dokësore të trashëguar brez pas brezi. Ndër Shqiptarët besa ka të bëjë me karakterin e kultit të fjalës së dhënë për realizimin e detyrës së marrë. Thelbi kognitiv, emocional dhe konotativ i besës ka të bëjë me premtimin që duhet mbajtur me çdo kusht, qoftë edhe duke flijuar jetën. Është tipar themelor i karakterit të Shqiptarit dhe kriter themelor i vlerësimit të karakterit të tyre. Përmbajtja e besës cilëson tiparin e karakterit pozitiv, të mirë dhe mospërmbajtja e saj karakterizon tiparin e karakterit negativ, të keq. Sipas institucionit të besës edhe armiku i familjes i rënë në besë

duhet të mbrohet. Strukturën e besës e përbëjnë pokontestueshmëria e saj, ndjenja e burrërisë, e guximit, e krenarisë, e trimërisë, motivi dhe sjellja e përputhur me kërkesat e këtij institucioni zakonor. Ka karakter kanunar. Thyerja e saj ka pasoja të rënda për individin dhe trashëgimtarët e tij. Pasojave të thyerjes së besës nuk i nënshtrohen fëmijët dhe femrat. Ky institucion ndër Shqiptarët është pasojë e raporteve shoqërore dhe ekonomike shumëvjeçare dhe e zhvillimit të izoluar të krahinave pa pushtet, karakteristik për zhvillimin historik të popullit, të etnisë dhe të kombit shqiptar, si dhe i zhvillimit të vonshëm të shtetit të tyre. Besa sot në raport me zhvillimet juridike e historike ka pësuar disa ndryshime. Rregullatore e marrëdhënieve tashmë janë ligjet.

BESIM, - I. m. Qëndrim i përçuar me ndjenjën e sigurisë ndaj një konstatimi, lidhjeje, raporti etj. të argumentuar. I tillë është qëndrimi në gjykimin "Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm", "E mira nuk vjen vetvetiu", "Mëso nga e djeshmja, jeto të sotmen, shpreso në të ardhmen" etj. Besimi ka intensitet të ndryshëm, ka përmasë të theksueshme individuale dhe ushtron ndikim në sjelljet e individit ndaj objektit të besimit.

BESIMET POPULLORE. Tërësi besimesh, parafytyrimesh e paragjykimesh për fuqi mbinatyrore të disa dukurive, proceseve e objekteve, si edhe të fetishizimit të tyre. Janë të lidhura me kulte, magji, mite etj. Termi i përket etnologjisë, por ka përmasa përmbajtësore psikologjike. Qëndrimi pozitiv ndaj tyre, i shoqëruar me ndjenjën e një besimi të madh dhe me sjellje të veçanta përbën strukturën psikologjike. I tillë ka qenë besimi në nivel kulti ndaj gjarprit, që konsiderohej mbrojtës i shtëpisë, i familjes, i prodhimeve bujqësore etj. E kanë zanafillën në prapambetjen e lashtë që bartej nga një brez në brezin tjetër, duke u bërë të qëndrueshme dhe rezistuese ndaj ndryshimeve të tyre. Në Kosovë maja e maleve të Pashtrikut konsiderohet edhe sot e shenjtë, sepse është vendlindja e qenieve të mbinatyrshme, ku jepen rekomandime dhe receta për shërim nga sëmundjet e rënda organike dhe psikike. Në këtë vend, si edhe në majën e Shkëlzenit, të Rumisë etj. për festa të caktuara mblidhen familje të shumta dhe bëjnë lutje ose "Dua" për pjellshmëri të mbarë, për ardhmëri pa brenga e të lumtur. Këtu bëhen flijime (theren dele, qengja, viça etj.) dhe përgatiten ushqime të posaçme dhe me bollëk.

BESNIKËRI, - A. Qëndrim i bazuar në besimin e thellë të individit në një parim, pikëpamje, në një lëvizje etj., të cilin e karakterizon vijimësia e sjelljeve të pandryshueshme ndaj objektit të besnikërisë dhe qëndrueshmëria ndaj atyre që kërkojnë ndryshimin e këtij qëndrimi. Besnikëria është një ndër tiparet e karakterit të njeriut, që shfaqet me sjelljet konseguente ndaj objektit të besnikërisë, në të cilin njeriu ka besim të thellë.

BESUESHMËRIA E TESTIT. Një ndër karakteristikat metrike të një testi ose të një instrumenti matës të ndryshoreve psikike (pyetësorit, shkallës së vlerësimit etj.). Ka të bëjë me përftimin e rezultateve të njëjta ose shumë të ngjashme, kur përsëritet i njëjti test te të njëjtat subjekte dhe në të njëjtat

kushte, përkatësisht në kushte shumë të ngjashme. Shih – ***KARAKTERISTIKAT METRIKE TË NJË TESTI.***

BETELHAJM Bruno (Bruno BETTELHEIM). Psikolog amerikan me prejardhje austriake. Lindi në Vjenë më 25.08.1903 dhe vdiq në Silver Spring (Meryland) të SHBA më 13.03.1990. Me studimet e tij ka kontribuar në zhvillimin e psikologjisë së fëmijëve dhe të psikologjisë sociale. Ka qenë drejtor i shkollës "Sonia Shankman Orthogenetic", institucion i njohur për angazhimet profesionale dhe shkencore në shërimin e fëmijëve me sjellje të rënda të çrregulluara dhe për ndikimin e terapisë së veçantë në shërimin e tyre. Vepra kryesore e tij është: "*The Uses of Entshantment: The Meaning and importance of Fairi Tales*" – (*"Udhëzim për realizimin e mendimit të rëndësishëm të Fairi Talesit",* botuar më 1976 - vepër e rëndësishme për psikologjinë e përrallave).

BËRTHAMA DORZOMEDIALE. Në psikologjinë fiziologjike bërthama e talamusit që merr ngacmimet ose informacionet nga sistemi limbik dhe i shtrin në koren apo cipën e trurit të madh. Luan rol të rëndësishëm në proceset e kujtesës.

BËRTHAMA RAFE. Në anatominë e sistemit nervor, i ardhur nga latinishtja *raphe* "lidhje". Emërton kompleksin e bërthamave, nukleuseve në thelbin e palcës së trungut të trurit. Bërthama Rafe ose nukleusi është një grup bërthamash qelizore të nervave të vendosura në mesin e formacionit retikula të medulës, urës dhe trurit të mesëm. Në këtë pjesë janë të vendosura një numër i madh neurotransmetuesish frenues të procesit të gjumit, të dhembjeve dhe të çrregullimeve të ndjesive.

BËRTHAMA VESTIBULARE. Bërthamë e formacionit nervor që gjendet në trurin e vogël (*cerebellum*). I merr impulset nervore nga pjesët e tjera të trurit të vogël dhe reagimet e veta i bart deri në palcën kurrizore.

BIBLIOGRAFIA PSIKOLOGJIKE. I ardhur nga greqishtja *βιβλίο* "libri", *γράφω* "shkruaj", *ψυχή* "shpirt" dhe *λόγος* "shkencë". Përshkrim i titullit të librit, emërtim i autorit, i vendit dhe vitit të botimit. Në kuptimin e gjerë kjo është paraqitje sistematike e botimeve shkencore nga disiplinat e sistemit të shkencave të psikologjisë. Një bibliografi e tillë përfshin veprat psikologjike, periodikun psikologjik, enciklopeditë e fjalorët e psikologjisë, si dhe librin shkollor të psikologjisë. Këto klasifikohen sipas sistemit të caktuar bibliografik. Bibliografia analitike e psikologjisë është forma më produktive e studimeve për zhvillimin e psikologjisë dhe të disiplinave të këtij sistemi, si edhe e çështjeve a tematikave të veçanta psikologjike. Termi ka edhe kuptim të ngushtë që ka të bëjë me regjistrimin e burimeve për një punim shkencor të fushës së psikologjisë dhe me radhitjen e tyre në fund të punimit shkencor.

BIBLIOTERAPI, - A. f. Formë e terapisë direktive që ka të bëjë me porositë dhe këshillimet që i jepen pacientit për të lexuar libra me tematikë e përmbajtje të caktuara, kuptimi i të cilave ia mundëson njohjen e problemeve psikike, të sjelljeve karakteristike që e mundojnë, si edhe njohjen e mënyrave të zgjidhjes së këtyre problemeve. Leximi me kujdes i këtyre librave është i dobishëm në disa pikëpamje:

shkakton kënaqësi, fiton informacione e dije të reja, identifikohet me personazhet e suksesshme etj.

B

BIÇIKLETËGOMETRI, - A. m. Aparat në trajtë biçiklete që përdoret për matjen e aktivitetit fizik, të punës fizike me karakteristika të ergografit. Përdoret në kuadrin e gjurmimeve psikofiziologjike organizative. I testuari me këtë aparat bën lëvizje gjymtyrësh e trupi me ngarkesë peshash të ndryshme, me qëllim matjen e energjisë rezistuese ndaj këtyre ngarkesave. Me biçikletëgometri zakonisht maten këto ndryshime: harxhimi i energjisë, ndryshimi i ritmit të pulsit, ndryshimi i ritmit të frymëmarrjes, ndryshimi i temperaturës së trupit etj. Me aparatin e këtij tipi matet edhe shpejtësia e rikthimit të gjendjes psikofiziologjike pas një pune të caktuar.

BIHEJVIORIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga anglishtja *behavior* "sjellje". Drejtim psikologjik, themelues i të cilit është psikologu amerikan Xhon B. Uotson (John B. Watson, 1878 – 1958). Sipas këtij drejtimi, psikologjia si lëndë studimi duhet të ketë studimin e sjelljeve, për metodë studimi duhet të ketë metodën e të vrojtuarit objektiv dhe të matjes së sjelljeve, kurse për qëllim duhet të ketë njohjen e sjelljeve dhe të reagimeve të organizmit të njeriut ndaj ngacmuesve të caktuar. Pikënisje e bihejviorizmit të Xhon Uotsonit ishte pohimi: ". . . Psikologjia që dëshiroj ta krijoj si shkencë fillon nga faktet e vështruara të organizmit të njeriut dhe të kafshëve bashkërisht, mënyrës si këta (organizma, shën. i *autorit*) i përshtaten mjedisit të tyre me ndihmën e trashëgimisë dhe të shprehive. Kjo përshtatje mund të jetë shumë adekuate, por mund të jetë joadekuate, e në këtë mënyrë organizmi mezi mundet të jetojë në atë mjedis. . . ". Sipas kësaj që është shkruar dalloj se njeriu është njësi biologjike që mund të studiohet si të gjitha kafshët. Sjelljet, sipas tij kufizohen me reagime të veçanta të muskujve, madje të atyre periferikë të organizmit dhe të gjëndrave, kurse gjendja e vetëdijshme e njeriut dhe, përgjithësisht, gjendjet psikike të tij duhen konsideruar procese shoqëruese të reagimeve dhe të sjelljeve. Kështu, sipas tij, mendimi i njeriut është reagim i brendshëm motorik dhe sensorik, ndjenjat janë veprime të brendshme të organeve që kanë të bëjnë me ndryshime fiziologjike, perceptimi është reagim shqisor ndaj objekteve që ushtrojnë ndikim në shqisat e njeriut etj. Faktorët e jashtëm janë vendimtarë për zhvillimin e sjelljeve dhe përgjithësisht për formimin e personalitetit të njeriut. Caku i studimeve bihejvioriste është parashikimi dhe kontrolli i sjelljeve. Në fillim të zhvillimit të bihejviorizmit përmbajtja e tij zhvillohej sipas formulës S(timulues) – R(eagim). Në këtë mënyrë u mohua roli i faktorëve të brendshëm të njeriut në zhvillimin e sjelljeve dhe të vetë atij, u mohua roli i vetëdijes në veprimtarinë e gjithëmbarshme të njeriut, pjesa më e madhe e rezultateve të psikologjisë introspektive dhe bashkë me to edhe metoda e vetvëzhgimit, si edhe konceptet themelore dhe termat e tyre "mentaliste", që u zhvilluan deri në kohën e shfaqjes së bihejviorizmit. "Duket se ka ardhur koha që psikologjia të hedhë... vetëdijen dhe ... proceset mentale si objekt vëzhgimi". Në zhvillimin e

bihejviorizmit kanë ushtruar ndikim të rëndësishëm arritjet studimore të shkollës fiziologjike ruse të Ivan M. Seçenovit (Ivan M. Secenov, 1829 – 1905), të Vladimir M. Behterjevit (Vladimir M. Behterjev, 1857 – 1927) dhe të Ivan P. Pavllovit (Ivan P. Pavlov, 1849 – 1936), arritjet e shkencave natyrore, sidomos zhvillimi i metodës eksperimentale. Qysh herët, pikëpamjet e bihejviorizmit u përkrahën nga shumë psikologë, sidomos nga ata që studionin zhvillimin psikik të botës shtazore dhe zhvillimin psikik të fëmijëve. Mirëpo, pas pak kohësh bihejviorizmi u kritikua ashpër për shkak të mohimit të rolit të rëndësisë e rolit të faktorëve të brendshëm në zhvillimin e tipareve njerëzore dhe shoqërore të njeriut. Në këtë drejtim zhvilluan mendimet e tyre neobihejvioristët, të cilët konsideruan të qenësishëm proceset e brendshme, që nuk i nënshtrohen vëzhgimit si mjete për shpjegimin e sjelljeve. Ndër neobihejvioristët u dallua bashkëkohësi i Xhon Uotsonit, psikologu amerikan Frederik B. Skiner (Frederick B. Skinner, 1904 – 1990), si edhe psikologu amerikan Eduard K. Tolman (Edward Ch. Tolman, 1886 – 1959), Klark L. Hol (Clark L. Hull, 1884 – 1952) etj. Neobihejvioristët i bënë modifikime të caktuara bihejviorizmit klasik, sikurse është përmbledhja e përmbajtjes së bihejviorizmit së bihejviorizmit në formulën S – O – R. Në këtë formulë paraqitet roli i faktorit O(rganizëm), përkatësisht i faktorit që ndërhyn në zhvillimin e reagimeve ndaj ngacmuesve. Eduard K. Tolman futi rishtas në përdorim termat mentalistë, si harta kognitive, pritja, synimi etj., por kuptimi i tyre ndryshonte nga kuptimet e dikurshme. Megjithëkëtë, bihejviorizmi ka ushtruar ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e metodave gjurmuese të lëndës së psikologjisë, sidomos të metodës së vëzhgimit objektiv sistematik dhe të metodës eksperimentale. Ndikimi më i rëndësishëm i bihejviorizmit u ndje në studimin e procesit të të mësuarit.

BIHEJVIORIZMI TE SHQIPFOLËSIT. Ndër Shqiptarët bihejviorizmi filloi të depërtojë rreth viteve pesëdhjetë të shekullit të njëzet. Përmendet më parë në librat shkollorë të psikologjisë, të pedagogjisë dhe të sociologjisë të përkthyer në shqipe nga serbokroatishtja në Kosovë. Në këto disiplina më tepër është shkruar për trajtimin bihejvioristik të rolit të faktorëve të jashtëm në zhvillimin e sjelljeve të njeriut dhe, përgjithësisht, në formimin e personalitetit të tij. Nga ky këndvështrim më shumë ka spikatur pohimi i themeluesit të bihejviorizmit Xhon Uotsonit (John Watson, 1878 – 1958), kur ka thënë: "Më jepni disa fëmijë të shëndoshë. . . unë ju siguroj që secilin prej tyre do ta aftësoj të bëhet ekspert sipas zgjedhjes sime. . ., pavarësisht nga talenti, dëshirat, aftësitë e tyre....". Më pas u përpunuan konceptet themelore të bihejviorizmit në tekstet shkollore e universitare, por nuk u shënua ndonjë studim i hollësishëm për bihejviorizmin dhe për pozitën e sistemit konceptual të tij në shkollat e psikologjisë. Në Shqipërinë e tri dekadave të gjysmës së dytë të shekullit njëzet bihejviorizmi u konsiderua "Një nga rrymat më të përhapura në psikologjinë borgjeze; qëndronte në pozita antishkencore dhe i kundërvihej teorisë materialiste dialektike mbi

psikikën njerëzore". Për atë kohë kjo ishte e mjaftueshme për të mos mundur të përpunohej sistemi konceptual i kësaj shkolle psikologjike. Në fund të shekullit të njëzet, sidomos më pas, me përkthimin e teksteve të psikologjisë nga anglishtja, filloji një kthesë e menjëhershme nga psikologjia refleksologjike në një sistem konceptesh të qëndrueshme sipas psikologjisë së vendeve anglo-saksone. Më 1999 u përkthye nga frëngjishtja teksti "Historia e psikologjisë", ku ka zënë vend të posaçëm edhe bihejviorizmi. Kështu, edhe në Tiranë e gjetkë depërtuan konceptet bihejvioriste nga përkthimi i teksteve shkollore, por edhe i atyre të përgjithshme. Më 2004 bihejviorizmi u shtjellua gjerësisht në 42 faqe libri nga studiuesi shqiptar Edmond Rrapti.

Burimet:

John B. Watson: *"Psychology as the Behaviorist Views it" – ("Psikologjia nga këndvështrimi i bihejvioristit"),* Psychological review 20, 1913, fq. 158 – 177.

Frederick B. Skinner: *"Science and Human Behavior" – ("Shkenca dhe sjellja njerëzore"),* New York, Macmillan, 1953.

Albert Bandura: *"Behavior Theory and Models of Man" – ("Teoria bihejvioriste dhe modeli i njeriut"),* Americkan psychologist 29, 1974, fq. 859 – 869.

Edmond Rrapti: *"Histori e mendimit psikologjik",* Tiranë, 2004, fq. 153 – 195.

Neki Juniku: *"Modifikimi i sjelljes në shkollë",* Prishtinë, 1997, fq. 15.

Maurice Reuchlin: *"Historia e psikologjisë"*, Tiranë, 1999, fq. 27 – 29.

Bardhyl Musai: *"Psikologji edukimi" – ("Zhvillimi, të nxënit, mësimdhënia"),* Tiranë 1999, fq. 85 – 114.

BILINGUIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga latinishtja *bi* "dy" dhe *lingua* "gjuhë, dygjuhësia". Dukuria e të folurit në mënyrë të njëjtë dhe të lehtë relativisht e dy gjuhëve të caktuara, duke konsideruar sikur individi i ka dy gjuhë amtare, pra duke mos konsideruar asnjë gjuhë të huaj. Zakonisht është dukuri e fëmijëve nga martesat e përziera (babai ka gjuhën e vet amtare, kurse nëna gjuhën e vet), ku komunikohet në dy gjuhë. Kjo dukuri është e shpeshtë edhe në mjediset me shumë etni. Nga një mikromjedis dhe makromjedis i tillë fëmijët bilingualë arrijnë t`i mësojnë dy gjuhët në të njëjtën kohë. Bilinguizmi mund të jetë i baraspeshuar ose i balancuar, kur individi i flet njësoj dy gjuhët, kur lexon dhe shkruan në dy gjuhët. Kur njëren gjuhë e flet dhe e shkruan shumë më mirë se tjetrën (zakonisht gjuhën amtare) bilinguizmi i tillë është bilinguizëm i paekuilibruar. Problemi psikologjik i gjurmuar fare pak është raporti ndërmjet dygjuhësisë dhe zhvillimit intelektual të individit. Në zhvillimet bashkëkohore të nxënit e gjuhës tjetër ka arritur të bëhet pothuaj kusht i përparimit të zhvillimit intelektual të njeriut. Në rastet e tilla pas të mësuarit mirë të gjuhës shqipe, p.sh., fillon të mësuarit e gjuhës angleze, franceze, gjermane etj., duke shfrytëzuar dijeninë e gjuhës shqipe për zotërimin e gjuhës së huaj.

Burimet:

William F. Mackey & Theodore Anderson: "*Bilingulism in Early Childhood*" – ("*Bilinguizmi në fëmijërinë e hershme*"), 1977;

Norman Segallovwitz: "*Psychological Perspectives on Bilingual Education" – ("Perspektiva psikologjike e edukatës dygjuhëshe")* në "Frontiers of Bilingual Education", 1077.

BINDJE, - A. f. Besim i plotë i njeriut në pranimin e një supozimi, të një pohimi, pikëpamjeje etj. për dukurinë,

individin, raportin, situatën e caktuar, i shoqëruar me shkallë të lartë të sigurisë në bazën e argumentimit të tij. Bindja ndikon në sjelljet e individit, megjithëse herë–herë nuk shoqërohet me aksione. Formohet më lehtë kur argumentimi për atë përputhet me bindjet e tjera të individit që kanë të bëjnë me situata të ngjashme.

BINE Alfred (Alfred BINET). Lindi në qytetin Nicë të Francës më 1857 dhe vdiq në Paris më 1911. Përfundoi studimet për mjekësi dhe mbrojti doktoratën po nga kjo fushë me temë "Sistemi nervor i insekteve"; më pas iu kushtua vetëm studimeve psikologjike, duke u bërë përfaqësues i psikologjisë eksperimentale franceze. Këtë përkushtim e dallojmë në krijimin e laboratorit psikologjik në Universitetin e Sorbonës më 1889, në botimin e revistës së parë psikologjike në Francë "*L`Année psychologique*", 1895 dhe në përkushtimin e gjithë veprimtarisë profesionale e shkencore për studimin e psikologjisë së inteligjencës. Drejtor i laboratorit të psikologjisë në Sorbonë. Së bashku me mjekun psikiatër Teodor Simonin, i angazhuar me aktivitet profesional dhe shkencor në spitalin "Ana e Shenjtë" mbrojti doktoratën në psikologji me tezën "Ndërlidhja e zhvillimit fizik me kapacitetet intelektuale", hartuan "Testin Bine–Simon" për matjen e zhvillimit të inteligjencës së fëmijëve normalë dhe të atyre me vonesë të zhvillimit të inteligjencës, pra me prapambetje mendore. Kjo është shkalla e parë e studimit të inteligjencës, që u botua pas gjurmimeve empirike disavjeçare. Rezultatet e gjurmimit të matjes së inteligjencës së fëmijëve i botuan në revistën "*L`anée psychologique*", 1905 dhe më 1908. Ky test në SHBA njihet me termin "Testi i inteligjencës Stanford Bine", që është përshtatje e suksesshme e testit Bine–Simon për popullatën e moshës së re të këtij shteti. Me testin Bine – Simon ka filluar zbatimi i matjes së inteligjencës në historinë e psikologjisë. Veprat kryesore të Alfred Bines janë*: L`âme et corps" – ("Shpirti dhe trupi"*), Paris, 1905; "*L`etude experimental de l`intelligence" – ("Të provuarit eksperimental të inteligjencës"*, Paris , Alfred Kostes, 1922; *'La Mesure – du développement de l`intelligence chez les jeunes enfants",* Paris, 1911. U përkthye në gjuhën shqipe me titull: *Alfred Binet & Theodore Simone, "Testet – Inteligjenca e fëmijëve",* Shtëpia Botuese UEGEN, Tiranë, 1998, botimi i dytë, 2002.

BINGSVAGER Ludvig (Ludwig BINGSWAGER). Psikiatër zviceran. Lindi në Kroslingen (Thurgau) më 13.04.1881 dhe vdiq po aty më 5.02.1964. Pasardhës i familjes së njohur psikiatrike: gjyshi dhe i ati, Oto Bingsvager (Otto Bingswanger, 1852 – 1920) kanë qenë psikiatër të njohur. Ludvig Bingsvageri ka qenë mik i ngushtë i Zigmund Frojdit, por edhe pjesëmarrës në gjurmimet e psikiatrit zviceran Eugen Bloiler (Eugen Bleuler, 1857 – 1939) dhe në pikëpamjet e Karl Gustav Jungut. Një ndër themeluesit e analizës ekzistenciale (Daseinanalyse). Konsiderohet përfaqësues i ekzistencializmit në psikologji. Qysh herët përvetësoi pikëpamjet e filozofisë ekzistencialiste të Martin Hajdegerit (Martin Heidegger, 1889 – 1976); ishte njohës i mirë i përmbajtjes së veprës së tij "*Sein und Zeit*" – ("*Qenia dhe koha*"). Vepra kryesore e tij është:

B

"Grundformen und Erkenntnis Menschlichen Daseins" – (*"Forma themelore dhe të njohurit e qenies njerëzore"*), botuar më 1943.

BINJAK, - Ë. Dy fëmijë që lindin gati njëkohësisht nga fekondimi i njëkohshëm i një vezoreje dhe zhvillimi paralel i organizmave të tyre. Këta mund të jenë binjakë bizigotë dhe monozigotë. Binjakët bizigotë janë ata që lindin njeri pas tjetrit në të njëjtën kohë, por janë të zhvilluar nga koncepitimi i dy vezoreve njëkohësisht. Binjakët monozigotë zhvillohen me koncepitimin e një vezoreje dhe me ndarjen e një zigoti. Këta të fundit janë gati organizma identikë. Binjakët, sidomos ata monozigotë, janë subjekte të përshtatshëm për hulumtimin e rolit të faktorëve të trashëgimisë dhe rolit të faktorëve mjedisorë në zhvillimin e proceseve psikike dhe të sjelljeve të njeriut. Për këtë qëllim këta ndahen dhe njëri rritet në kushte, rrethana e raporte të tjera mjedisore nga tjetri, i cili rritet e zhvillohet në kushte, rrethana e raporte të tjera nga ato të vëllait binjak. Pas kohëve të ndryshme të zhvillimit të tyre te secili maten dhe vlerësohen zhvillimet psikike dhe më në fund vlerësohet roli i faktorit trashëgues dhe ai i faktorëve të jashtëm në zhvillimin psikik të tyre, sidomos në zhvillimin e inteligjencës.

BINJAKËT MONOZIGOTË. Të lindurit e njëkohshëm njëri pas tjetrit nga e njëjta nënë dhe të zhvilluar nga ndarja e një qelize mbartëse në dy qeliza identike. Binjakët monozigotë janë kryesisht të një gjinie dhe nga pikëpamja biologjike duken gati të njëjtë. Këta binjakë shfrytëzohen për hulumtime biologjike e psikologjike, sidomos për hulumtimet që kanë të bëjnë me ndikimin e faktorëve të jashtëm në zhvillimin e tipareve biologjike (të trashësisë e gjatësisë së trupit) dhe, sidomos të tipareve psikologjike, siç është roli i ndikimit të faktorëve të jashtëm në zhvillimin e inteligjencës, të prirjeve për krime etj.

BIOENERGJI, - A. f. Lloj i psikoterapisë që besohet se bën të mundur bartjen e energjisë, të rrezeve trupore nga trupi i terapeutit në atë të pacientit. Terapeuti me anë të shuplakës së duarve bën ngjeshjen e trupit të pacientit dhe me anën e kësaj ngjeshjeje besohet se kryhet bartja e kësaj energjie. Një veprim i tillë pret shpjegimin e mundur të saj; besohet se është më tepër çështje sugjestionimi. U zbatua nga psikanalisti Vilhelm Rajh (Wilhelm Reich, 1897 – 1957).

BIOFIDBEK, - U. m. I ardhur nga greqishtja *βίος* "jetë" dhe nga anglishtja *feedback* "kthim, përkatësisht, lidhje kthyese biologjike e informacionit". Biofidbeku është mënyrë e vetëkontrollit të ndryshimeve të disa funksioneve të brendshme, të fshehta, autonome dhe të pavetëdijshme të organizmit nga ana e vetë individit. Këto informacione individi mund t'i marrë nga aparatet për matjen e shtypjes a të presionit të gjakut. Ndryshimet e tilla për të cilat mund të marrim informacione kthyese janë: të rrahurit e zemrës, presioni i gjakut, rrjedhja e gjakut në gjymtyrët e trupit të njeriut, valët alfa të trurit etj. Në mbështetje të disa indikatorëve për ndryshimet e përmendura (tensioni i lartë, paraqitja e valëve alfa etj.) njeriu ka përpiluar sistemin e informimit të vet dhe ka ndërmarrë masa për kontrollimin dhe

ndryshimin e sjelljeve të tij me qëllim të uljes së presionit të gjakut, të qetësimit të zemrës etj. Kështu, njeriu mund të modifikojë disa forma të sjelljes së tij në bazë të informacioneve që i merr nga sinjalizimet e tilla.

BIOFILI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *bios* "jetë" dhe *fileia* "dashuroj". Biofilia është dashuria ndaj gjithë asaj që është e gjallë dhe zhvillohet. Është prirje e përgjithshme njerëzore për afirmimin e jetës në përgjithësi, e sidomos të jetës njerëzore. Biofilia u përmend nga Erik Fromi (Erich Fromm, 1900 – 1980), i cili theksoi se biofilia është pasioni themelor i njeriut, që ka përmbajtje të kundërt me nekrofilin. Sipas Erik Fromit "... njeriu është i pajisur në mënyrë biologjike me biofili ... ". Madje edhe nekrofilia, dashuria për vdekje, zhvillohet nga mungesa e përjetimit të dashurisë për jetën.

BIOLOGJI, - A. f. Shkenca për jetën që merret me studimin e ligjeve të lindjes, të zhvillimit të jetës dhe të formave të qenieve të gjalla. Psikologjia ka disa lidhje me nëndisiplinat e biologjisë, përkatësisht me antropologjinë, anatominë, fiziologjinë dhe me evolucionin. Mbi këtë bazë u zhvillua psikologjia biologjike, psikologjia gjenetike dhe psikologjia fiziologjike.

BIOLOGJIA E ANKTHIT. Frika ankthore e shkaktuar nga faktorët që zhvillohen jashtë sferës psikike. Frikë e lidhur me mekanizmat neuroanatomikë, gjenetikë dhe përgjithësisht me proceset neurobiologjike. Zbulimi i kësaj lidhjeje ka vërtetuar pohimin e Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1938), sipas të cilit ekzistojnë dy lloje frikash: ato të shkaktuara nga problemet psikike dhe ato të shkaktuara nga faktorët anatomikë e fiziologjikë.

BIOPSIKIK, - E. mb. Procese psikike dhe forma sjelljesh të zhvilluara mbi bazën e bashkëveprimit të faktorëve biologjikë dhe psikologjikë. Ka struktura të personalitetit të njeriut dhe tipare psikike që zhvillohen mbi bazën biologjike. Kështu, tiparet e temperamentit zhvillohen mbi bazën e funksionimit të gjëndrave me sekretim të brendshëm dhe, përgjithësisht, mbi bazën e strukturës trupore të njeriut.

BIOPSIKIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga greqishtja *bios* "jetë" dhe *psyche* "shpirt". Pikëpamje e vjetër për raportin ndërmjet dukurive, proceseve dhe mekanizmave jetësorë dhe atyre të jetës psikike. Sipas kësaj pikëpamjeje dukuritë jetësore kanë domosdo edhe përbërës psikikë të tyre. I përket më tepër terminologjisë filozofike.

BIOLOGJIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga greqishtja *bios* "jetë" dhe λόγος "shkencë". Pikëpamje e doktrinës, sipas së cilës dukuritë psikike, proceset psikike dhe sjelljet duhen përshkruar dhe shpjeguar në bazë të parimeve dhe ligjeve biologjike. Mbi këtë bazë shpjeguese duhet përshkruar dhe shpjeguar zhvillimi i inteligjencës, i motiveve, çrregullimet e sëmundjet psikike etj. Psikanaliza e Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939) dhe bihejviorizmi i Xhon B. Uotsonit (John B. Watson, 1878 – 1958) kanë elemente kuptimore të biologjizmit dhe, për këtë, shpesh janë kritikuar.

BIPOLAR, - E. mb. Shtrirja e një dukurie, ndryshoreje e procesi psikik, si edhe e qëndrimeve, e vlerave, e tipareve të personalitetit ndërmjet dy

poleve të kundërta: nga poli negativ – 1 nëpërmes pikës asnjanëse deri në polin pozitiv +1. E tillë është shtrirja e sjelljeve të tipave introvert – ekstravert, mosreagimi – reagimi, depresioni – mania, dominimi – nënshtrimi etj. Shtrirja e tillë matet me instrumentin gjurmues – me shkallën e vlerësimit.

BIRËSIM, - I. m. Përvetësimi i fëmijës së tjetrit dhe të bërit e tij ose të saj bir a bijë shpirti, si fëmijë e lindur prej tij dhe duke siguruar respektimin e të drejtave të tij/saj themelore. Marrëdhëniet ndërmjet birësuesit me të birësuarin nuk ndryshojnë nga ato ndërmjet prindit dhe fëmijës së lindur. Rezultatet e shumë studimeve kanë vërtetuar, se fëmijët e birësuar, megjithëse nuk kanë asgjë të përbashkët me prindërit e tyre adoptues, ndajnë të njëjtin mjedis me familjen e tyre të re, duke formuar sjellje dhe tipare sjelljesh sipas modelit të familjes së re. Gjenet e prindërve biologjikë ndërveprojnë me faktorët mjedisorë duke u modifikuar sipas kërkesave, kushteve e raporteve konkrete të familjes së prindërve jobiologjikë të tyre.

BISEKSUALITET, - I. m. Cilësia e organizmave që kanë karakteristika sjelljesh të gjinisë mashkullore dhe femërore. Këto cilësi të përbashkëta të të dy gjinive mund të jenë cilësi trupore dhe sjellje të të dy gjinive. Prania e tyre shfaqet në drejtimin e shtytësit seksual ndaj tjetrës ose tjetrit dhe ndaj vetes njëkohësisht. Në psikanalizë pohohet se te të gjithë mund të gjenden gjurmët e organit seksual të të dy gjinive, por këta kanë humbur funksionin e tyre parësor. Ndërkaq, synimi biseksual si term e koncept psikik, ka të bëjë më shumë me hermafroditizmin dhe te disa mund të jetë më i dukshëm në sjellje. Karl G. Jungu ka pohuar se te pjesëtarët e çdo gjinie gjenden veti psikologjike të gjinisë tjetër. Shih – ***ANIMA***; ***ANUSI.***

BIT. asnj. Shkurtesë e termit anglisht nga fusha e informatikës *binary digit* që paraqet njësinë matëse të sasisë së informacioneve, kur ka mundësi shkurtimi të informacioneve të ekspozuara në gjuhën e tyre, përkatësisht prej katër në dy sosh. Një bit, pra, kemi atëherë kur kemi informacion që e eliminon gjysmën e tyre.

BIXHOZI PATOLOGJIK. Sjellje jonormale e lidhur drejtpërdrejtë me tiparin e asaj sjelljeje të qëndrueshme negative, që ka të bëjë me marrjen pjesë në lojërat e fatit. Termi ka kuptim dhe përdorim plotësisht të caktuar vetëm atëherë, kur emërton sjelljen e përhershme negative të lidhur me lojën e caktuar të fatit, përkatësisht me format e caktuara të bixhozit. Sjellja e këtillë konsiderojmë se merr përmasa patologjike vetëm atëherë, kur çrregullon jetën normale të njeriut, veprimtarinë profesionale, raportet ndërfamiljare, si edhe ato me individët e tjerë jobixhozçinj.

BLOILER Eugen (Eugen BLEULER). Psikiatër zviceran. Lindi në Zollikon (Colikon) afër Zyrihut më 30.04.1857 dhe vdiq më 15.07.1939. Në vendlindje, Zyrih filloi studimet për mjekësi për t`i vazhduar në Bernë dhe në Paris. Specializimin për psikiatri e përfundoi në Bernë, ndërsa angazhimin në përsosjen profesionale dhe shkencore e kreu pranë profesorit francez Zhan M. Sharko, duke shfrytëzuar edhe ligjëratat e Valentin Manjait. Por, herë pas here është kthyer në Londër

dhe në Mynih për çështje profesionale dhe shkencore. Prej vitit 1889 filloi punën si mjek në klinikën e njohur "Burghelcli" te profesor August Foreli, të cilin e zëvendësoi pas pak kohe. Në vitet 1910–1913 përvojën shumëvjeçare të kësaj klinike në mjekimin dhe shërimin e sëmundjeve psikike, sidomos të skizofrenisë, Eugen Bloileri e zëvendësoi me dijet psikanalitike të Zigmund Frojdit, i cili po ashtu kishte qenë për një specializim në psikiatri te Zhan M. Sharko. Por, edhe Eugen Bloileri, ashtu si edhe Karl Jungu u nda nga pikëpamjet e Zigmund Frojdit dhe të psikanalizës së tij. Megjithëkëtë, nuk hoqi dorë nga qasja psikogjene e të luajturit mendsh. Termin skizofreni e zëvendësoi me termin *dementia praecox*. Veprat kryesore të tij janë: *"Dementia praecox ou groupe des Shizophrenies",* Leipzig, 1911 – (*"Dementia prekoks apo grupi i skizofrenisë"*); "*Lehrbuch der Psychiatrie"* – (*"Libri i psikiatrisë"*), 1916 (këtë libër e përpunoi dhe e ribotoi djali i tij, Manfred Bloiler).

BLLOKADA EMOCIONALE. Mundësia e pamjaftueshme e njeriut për t`i kryer detyrat e veta individuale dhe shoqërore për shkak të përjetimit të një gjendjeje emocionale me intensitet të lartë.

BLLOKIM, - I. m. Ndërprerje e papritur e procesit të mendimit dhe të të folurit dhe e rrjedhjes së këtyre proceseve. Në raste të tilla pjesa më e madhe e atyre që e përjetojnë këtë proces ndiejnë njëfarë zbrazësie, thua se rrjedha e këtij procesi nuk ekziston. Për këtë shkak këta nuk janë në gjendje ta rifillojnë këtë bisedë dhe aq më pak ta përpunojnë konceptin e caktuar. Proceset e tilla në psikologji emërtohen edhe me termin inhibim, megjithëse ky term përdoret më shpesh në psikologjinë e kujtesës dhe të të mësuarit.

BLLOKIMI I KUSHTËZIMIT. Proces pengues i të mësuarit të një reagimi të ri. Kjo ngjet atëherë kur kushtëzimi paraprak pengon kushtëzimin me një ngacmues të dytë, përkatësisht pengon formimin e reagimit të ri ndaj ngacmuesit të dytë. Pengesa e tillë shkaktohet nga të mësuarit e kushtëzuar vargor (njëri pas tjetrit), si edhe nga të mësuarit e reagimit ndaj dy ngacmuesve, kur këta veprojnë njëkohësisht.

BLLOKU ALFA. Emërtim i frenimit të ritmit të valëve trunore. Një frenim i tillë ndodh kur njeriu dallon një dukuri, gjendje, objekt etj. të rëndësishëm, madje edhe të rrezikshëm për të dhe e ndërpret gjendjen e qetë të tij, duke bërë përpjekje për të reaguar në mënyrë të përshtatshme ndaj tij. Blloku Alfa u dallua në incizimin e ndryshimeve ritmike të valëve të trurit, kur sjelljet e njeriut shmangen nga gjendja e qetë e një organizmi vigjilent.

BOGDANI Pjetër. Shkrimtari më i shquar i letërsisë shqiptare të Mesjetës, klerik i lartë katolik, doktor në teologji dhe filozofi, veprimtar i lëvizjes çlirimtare kundërosmane. Pjetër Bogdani lindi në Gur të Hasit afër Kukësit, rreth vitit 1625 dhe vdiq në Prishtinë më 1689. Në veprat e tij dallojmë qëmtime për jetën shpirtërore të njeriut, koncepte dhe terma përkatëse psikologjike. Këtë e dallojmë në shpjegimin e koncepteve "*burrënia", "djelmënia", "fëminjënia"*, "*shembëlltyra*, "*kërthinjenia*", "*pleqënia", "pleqënia e mbettun", "pomendunitë*" – "*mbamendja*", "*shqisa",* "*volendetsë*" – "*vullneti*" etj. Pjetër Bog-

dani është paraprijës i terminologjisë së psikologjisë në gjuhën shqipe, e parë dhe e shpjeguar nga pikëpamja religjioze e filozofike e kohës kur ai jetoi dhe veproi, pra e shekullit të shtatëmbëdhjetë. Sipas tij kujtesa, intelekti, vullneti, vëzhgimi dhe roli i shqisave në procesin e njohjes, si edhe ndërlidhja e tyre, janë strukturat shpirtërore kryesore të njeriut. Njohja e zhvillimit shpirtëror është një process i pandërprerë, të cilin e ka ndarë në shtatë faza: 1) "kërthinja" – "foshnjëria" prej lindjes deri në katër vjeç, 2) "fëmijënia" – nga katër deri në katërmbëdhjetë vjeç, 3) "djelmënia" – prej katërmbëdhjetë deri në njëzetedy vjeç, 4) "trimënia" – nga njëzetedy deri në dyzetenjë vjeç, 5) Burrënia" – prej dyzetenjë deri në pesëdhjetegjashtë vjeç, 6) "pleqënia" – nga pesëdhjetegjashtë deri në gjashtëdhjetetetë vjeç dhe 7) Pleqënia e mbettunë" – nga gjashtëdhjetetetë deri në nëntëdhjetë vjeç. Për secilën nga fazat e përmendura ai ka dhënë veçoritë shpirtërore. Këto veçori i përkasin më tepër mënyrës, shpejtësisë dhe forcës së reagimit të njeriut ndaj ngacmuesve, e pikërisht janë të lidhur më tepër me temperamentin e njeriut. Vepra kryesore e tij është: *"Cuneus Prophetarum"* – (*"Çeta e Profetëve"*), botuar më 1685.

BON Gustav Lë (Gustave Le BON). Sociolog francez. Lindi më 1841 dhe vdiq më 1931. U mor me psikologji, por është i njohur më tepër në sociologji. U rrit në një familje fisnikësh, në kohën e lëvizjeve revolucionare franceze dhe në kohën e revolucionit francez, kurse ngjarjet e Komunës së Parisit i përjetoi në moshën e rinisë. Në fushën e studimeve psikologjike u mor më tepër me studimin e psikologjisë së turmës. Në këtë kuadër ka pohuar se veçoritë psikike të popujve dhe të racave janë pasojë e trashëgimisë dhe e kontakteve mendore ndërmjet tyre. Sipas tij njerëzit lidhen ndërmjet tyre të shtyrë nga motivet e ndryshme, por edhe nga ndjenjat. Ndjenjat bëjnë që këta në kuadrin e grupeve të mëdha ose të vogla, të masës dhe të turmave të mbisundojnë sjelljet e veçanta të zhvilluara në radhë të parë nga ndjenjat. Për këtë shkak sjelljet e tyre në grupe, në masë, në turmë mund të jenë jo aq të kontrolluara dhe më pak të sunduara nga mendja, madje këto mund të jenë sjellje të vrazhda. Veprat kryesore të tij me përmasa psikologjike janë: *L` home et les societies"* – (*"Njeriu dhe shoqëria"*), botuar më 1881; *"Les Lois Psychologiques de l`Evolution des Pouples"* – (*"Ligjet psikologjike të zhvillimit të popujve"*), 1894; *"La Psychologie des Faules"* – (*"Psikologjia e turmave"*), 1895; *"La revolution Francaise et la Psychologie de Revolutions"* – (*"Revolucioni Francez dhe Psikologjia e Revolucioneve"*), 1912 etj. Në gjuhën shqipe u përkthye *"Psikologjia e racave",* 2001!.

BORING Edvin (Edwin BORING). Psikolog amerikan. Lindi më 1886 dhe vdiq më 1968. Autoritet i njohur shkencor në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Profesor i psikologjisë në Universitetin e Harvardit dhe drejtor i departamentit të psikologjisë të këtij universiteti. Redaktor i parë i revistës për psikologjinë bashkëkohore në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ndonëse i rritur dhe i zhvilluar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku kish lulëzuar bihejviorizmi, Edvin Boringu anonte kah mendimit psikologjik europian, duke injoruar njëkohësisht kontributin e psikologëve të Europës

Lindore dhe përgjithësisht kontributin e mendimtarëve të kësaj pjese të Europës në zhvillimin e kulturës europiane dhe në zhvillimin e mendimit shkencor të psikologjisë. Veprat kryesore të tij janë: "*A History of Experimental Psychology"* – (*"Historia e psikologjisë eksperimentale"*), Appleton – Century – Crofts, Nju York, 1929 (u ribotua dhe u përpunua më 1957); "*Sensation and Perception in the History of Experimental Psychology"* – (*"Sensacioni dhe perceptimi në historinë e psikologjisë eksperimentale"*), Appleton – Century, 1942.

BOS Medard (Medard BOOS). Psikiatër zviceran, përfaqësues i terapisë së analizës së qenies. Lindi në Galen më 4.10.1903 dhe vdiq në Colikon më 21.12.1990. Kreu mjekësinë në Zyrih më 1928 dhe kreu kualifikimin për përsosje mjekësore në Paris dhe në Vjenë, si edhe për marrjen e leksioneve nga psikanaliza në disa institucione të Gjermanisë e të Anglisë. Ka bërë udhëtime studimore në Hindi. Profesor i psikoterapisë në Universitetin e Zyrihut, kryetar i Federatës Ndërkombëtare për Psikoterapi Mjekësore, si dhe kryetar nderi i saj. Drejtor shkencor i Institutit Analitik të Qenies për Psikoterapi dhe Psikosomatikë. Ka qenë përkrahës i pikëpamjeve dhe i qëndrimeve të psikologjisë ekzistencialiste. Për të, si edhe për psikologët ekzistencialistë, rëndësi parësore për psikologjinë ka analiza fenomenologjike e drejtpërdrejtë e përmbajtjes së vetëdijes. Në këtë analizë ekzistenca e qenësisë "*dasein*" dhe përshkrimi i saktë i saj është koncepti themelor. Këtu dallohet edhe ndikimi i filozofisë së Indisë. Ekzistenca e qenies zhvillohet përgjatë kohës dhe hapësirës, relacione këto që kanë përmbajtjen e tyre psikologjike. Qenia njerëzore ka të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen. Në këtë kuadër paraqiten mundësi të ndryshme të zhvillimit, nga të cilat njeriu zgjedh atë që i përgjigjet atij. Kjo zgjedhje është argument i ekzistencës së pavarur. Frika nga asgjësimi i ekzistencës së tillë është shoqëruese e pandërprerë e jetës së saj dhe për këtë kundërvënia e njeriut ndaj saj është veti dinamike e qenies. Vepra kryesore e tij është: *"Psychoanalysis und Daseinanalysis"* – (*"Psikanaliza dhe analiza e qenësisë"*), 1947.

BOTËKUPTIM, - I. Tërësi e pikëpamjeve të sistematizuara dhe kohezive të një individi për gjithësinë, për vlerën e përgjithshme të jetës njerëzore dhe bindjen e tij për natyrën, shoqërinë, njeriun dhe raportet e përgjithshme ndërmjet tyre, si edhe për rolin e tij në ndryshimin e tyre. Sipas themeluesit të psikanalizës Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939) botëkuptimi është "konstruksion intelektual që jep zgjidhje të përbashkët për problemet e ekzistencës sonë, duke mos lënë të hapur asgjë. Në të gjendet secila zgjidhje për të cilën jemi të interesuar. Njeriu me botëkuptim di si t`i organizojë sjelljet drejt qëllimit të tij". Është rezultat i të mësuarit. Në bazë të procesit të të mësuarit, ai i lidh pikëpamjet dhe qëndrimet e tij, i sistematizon dhe i organizon në sistem pikëpamjesh koherente për gjithësinë. Karakterizon njeriun e pjekur dhe ushtron ndikim të veçantë në veprimet e tij ndaj dukurive dhe raporteve natyrore, biologjike, shoqërore dhe psikike, si edhe ndaj ndërlidhjeve të tyre.

B

BOULBI Xhon (John BOWLBY). Psikiatër dhe psikanalitik anglez. Lindi më 1907 dhe vdiq më 1990. I lindur në një familje të lartë borgjeze. Personalitet kryesor në zhvillimin e lëvizjes psikanalitike në Angli. Ka studiuar për psikologji dhe për shkenca natyrure në Kembrixh dhe më pas përfundoi studimet e mjekësisë. Drejtor i klinikës prestigjioze Tavistok në Londër. Anëtar i grupit të specialistëve të pavarur për psikiatrinë e fëmijëve. Në prag të Luftës I Botërore u zgjodh anëtar i rregullt i Shoqatës Psikanalitike Angleze. Ka mohuar rolin vendimtar për zhvillimin psikik të fëmijës, falë lidhjes emocionale me të ëmën. Ka luajtur rol të rëndësishëm në konceptimin e Paktit për të Drejtat e Fëmijëve në cilësinë e këshilltarit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Tri koncepte themelore kanë karakterizuar veprimtarinë psikatrike e psikanalitike të tij: "lidhja", "humbja" dhe "ndarja". Fjala është për rolin e lidhjes së fëmijës me kujdesin amënor, për ndikimin e humbjes dhe të ndarjes së fëmijës nga kujdesi amënor. Në këtë drejtim i është kundërvënë pikëpamjeve psikanalitike të Melani Klajnit, megjithëse i është tërhequr vëmendja se anon kah e pavetëdijshmja, ngaqë ka përkrahur qëndrimet biologjike dhe etologjike për zhvillimin e fëmijës. Veprat kryesore të tij janë: *"Maternal Care and Mental Health"* – (*"Kujdesi amënor dhe shëndeti mendor"*), 1951; *"Attashment"* – (*"Ndarja"*), 1969.

BOVARIZ/ËM, - MI. m. Dukuri e rrallë jonormale që ka të bëjë me dallimet e mëdha ndërmjet mendimit e fantazimit të vetes dhe realitetit, saqë, ai që vuan nga kjo çmenduri humb kriterin e dallimit ndërmjet asaj që është reale dhe asaj që i përket fantazisë. Një individ i tillë e përfytyron dhe e vlerëson veten personalitet madhështor dhe të përkryer; kështu ai largohet shumë nga realiteti, duke humbur perceptimin real të tij. Këtë dukuri psikiatri francez e ka emërtuar Ema Bovari, sipas personazhit kryesor të romanit të njohur të Gustav Floberit "Zonja Bovari".

BRADIKARDI, - A. f. Ritëm i ngadalësuar i të rrahurit të pulsit. Kjo ulje e ritmit është jonormale, sepse pulsi rreh 60 herë në një minutë. Zakonisht është shenjë e keqësimit të gjendjes së zemrës. Ka lidhje me disa gjendje psikike (rënia në gjendje depresive, informacioni i papritur "shokues" etj.).

BRADIKINEZI, - A. f. Lëvizje shumë të ngadalësuara të gjymtyrëve dhe trupit të njeriut, madje edhe frenim i plotë i tyre brenda një kohe relativisht të gjatë. Shkaktohet nga çrregullimet organike dhe ato funksionale.

BRADIPSIKIZ/ËM, - MI. I ardhur nga greqishtja *βραδύς* "ngadalë" dhe *ψυχή* "shpirt". Paraqitje e ngadalshme dhe zhvillim i vonuar i strukturave dhe i funksioneve psikike. Termi përdoret zakonisht për ata që kanë zhvillim të vonuar psikik. Shkaktohet nga çrregullimet organike të sistemit nervor dhe nga ato funksionale. Shfaqet edhe në këto forma: bradifreni – ngadalësim jonormal i funksionimit të proceseve njohëse ose kognitive; bradilali – zhvillim i ngadalësuar i të folurit; bradileksi – zhvillim i ngadalësuar dhe jonormal i procesit të leximit të teksteve të shkruara në gjuhën amnore.

BRAZDA ROLAND. Brazda qendrore e trurit e njohur me termin latin "*culcus centralis Rolandi*". Kjo është brazdë në

mesin e dy hemisferave të trurit të madh, brazda ndarëse e pjesës ballore të trurit nga pjesa e brendshme e dy hemisferave të trurit të madh. Fusha e cipës së trurit të madh prapa brazdës së Rolandit është bartëse e ndijimeve të brendshme të trupit, kurse ajo para kësaj brazde i përket fushës së lëvizjeve ose fushës motorike të trupit dhe të pjesëve të tij. Brazda e Rolandit mori emrin e anatomistit italian Luigji Rolando (Luigi Rolando, 1773 – 1831).

BRAZDA SILVI. Në anatominë e sistemit nervor emërton brazdën prerëse të pjesëve ose hullive të trurit ballor nga ai tëmthor të trurit të madh. Emërtohet edhe me termin brazda anësore ose laterale, që vjen nga latinishtja *sulcus lateralis cerebri Sylvii*.

BREJTJA E NDËRGJEGJES. Strukturë e ndërlikuar e përjetimit të ndjenjës së vetëhidhërimit e vetëzemërimit, kur njeriu vlerëson se me sjelljet e tij ka bërë faj duke mospërfillur ndonjë nga vlerat themelore njerëzore dhe duke vlerësuar se me këtë është bërë i padenjë për t'u respektuar dhe për t'u nderuar. Ushtron ndikim negativ në jetën psikike, në sjelljet ndaj të tjerëve dhe ndaj vetes, duke lënë pasoja edhe në rrënimin e proceseve trupore. Term i etikës dhe i psikologjisë së moralit.

BRENG/Ë, - A. f. Mall e pikëllim i një individi i shkaktuar nga pamundësia e përjetimit të kënaqësisë, të gëzimit, të shpresës etj. për mungesën e përjetimit të kënaqësisë me rastin e takimit me shokun, mikun e dëshiruar dhe nga pamundësia e ndikimit të tij në "zbutjen" e vuajtjeve dhe të mundimeve shpirtërore.

BRENTANO Franc (Franz BRENTANO). Filozof dhe teolog gjerman me orientim psikologjik. Lindi në Marienberg më 16.01.1838 dhe vdiq në Zyrih më 17.03.1917. Profesor i filozofisë në Vyrzburg, në Universitetin e Vjenës dhe në Zyrih. U doktorua në Universitetin e Tybingenit me mbrojtjen e tezës me titull: "Të kuptuarit e qenies nga Aristoteli". Ishte përfaqësues i psikologjisë së akteve, ku si lëndë studimi e psikologjisë nuk do të ishte përmbajtja e vetëdijshme e mendjes, por veprimtaria, pra aktet e proceseve të mendjes; aktet e tilla janë burim themelor i të dhënave dhe fakteve empirike. Në pikëpamjet e tij filozofike-psikologjike objekt i hulumtimeve psikologjike do të ishin aktet mendore dhe dukuritë e shqisave. Sipas Franc Brentanos psikologjia duhet të merret edhe me studimin e vetëdijes për procesin e perceptimit, me karakterin qëllimor të çdo veprimi psikik, në radhë të parë me karakterin e brendshëm qëllimor të perceptimit, e jo vetëm me përmbajtjen e perceptimit. Franc Brentano ishte i mendimit se ekzistojnë tri lloj aktesh mendore: "Vorstelungen" – "*Përfytyrimi*", "Urteile" – "*Gjykimi*" dhe "Gemutsbewegungen" – "*Disponimi emociocional*". Metoda kryesore e këtij studimi të akteve psikologjike është përshkrimi i thjeshtë, i pastër e subjektiv i aktivitetit psikik. Ky orientim ka ushtruar ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e psikologjisë geshtaltiste. Veprat kryesore psikologjike të tij janë: *"Psychologie vom Empirischen Standpunkt"* – (*"Psikologjia nga pikëpamja empirike"*), Leipzig, 1874; "*Von der Klassification der Psychischen Phanomene"* – (*"Mbi klasifikimin e dukurive psikike*"), Leipzig, 1911.

B

BROIER Jozef (Joseph BREUER). Mjek-neurolog dhe psikolog austriak. Lindi në Vjenë më 15.01.1842 dhe vdiq në Vjenë më 20.06.1925. Ka punuar në Fakultetin e Mjekësisë në Vjenë së bashku me Zigmund Frojdin. Në këtë fakultet ka qenë edhe profesori i fiziologjisë Ernst V. Bruke (Ernst W. Brücke, 1819 – 1892), sipas të cilit psikologjia ka si lëndë studimi energjinë psikike, të cilën e prodhojnë qelizat nervore gjatë aktivitetit të njeriut dhe, e cila, ripërtërihet gjatë gjumit të natës. Për këtë shkak njohja e funksionimit të sistemit nervor dhe e strukturave të tij është kusht i domosdoshëm për studimin e dukurive, proceseve dhe akteve psikike. Në këtë fakultet Josef Brojeri u njoh me Zigmund Frojdin dhe punuan së bashku në mjekimin dhe shërimin e sëmundjeve psikike, sidomos të histerisë. Mirëpo, nuk kaluan shumë kohë dhe u ndanë, ngaqë Josef Brojeri nuk u pajtua me Frojdin në dy koncepte themelore: 1) Shkak i sëmundjeve shpirtërore, kryesisht i histerisë, janë ndryshimet fiziologjike të organizmit, që Zigmund Frojdi nuk e pranonte dhe 2) Derisa Zigmund Frojdi e shpjegonte zhvillimin e personalitetit dhe çrregullimet e tij mbi bazën e seksualitetit, kjo ishte e papranueshme për Josef Brojerin. Megjithëkëtë, para ndarjes, së bashku ishin autorë të studimit të njohur mbi histerinë. Brojeri ishte autor i parë, kurse Frojdi autor i dytë. Në këtë vepër u theksua se simptomat e histerisë shpesh burojnë nga përjetimet e dhimbshme të njeriut nga mosha e hershme. Vepra kryesore e ti së bashku me Frojdin është: *"Studien über Hysterie"* – (*"Studimi për histerinë"*), 1895.

BROKA Pol (Paul BROCA). Mjek francez, fiziolog dhe kirurg. Lindi më 1824 dhe vdiq më 1880. Në psikofiziologji është njohur me zbulimin e rolit të zonës në lobin ballor të majtë, të zonës Broka, pra të qendrës Brok. Kirurg i njohur edhe për hapjen e kafkës dhe identifikimin e qendrave funksionale të cipës së trurit të madh. Në këtë kuadër Pol Broka zbuloi edhe dëmtimin e zonës, përkatësisht të qendrës Brok të cipës së trurit të madh, që shkakton format e ndryshme të afazisë, përkatësisht çrregullimin e artikulimit të fjalëve dhe të fjalive. Rezultatet e studimit të pacientëve afazikë kanë treguar se pacientët me dëmtim të kësaj zone ishin të paaftë të krijonin fjali komplekse të formësuara drejt sipas rregullave sintaksore. Këtë e kanë vërtetuar edhe rezultatet e hulumtimeve të mëvonshme me mjete dhe procedura moderne, por këto njëkohësisht kanë treguar edhe për rritjen e aktivitetit funksional të pjesës adekuate të anës së djathtë. Këtë e ka argumentuar fiziologu dhe kirurgu Ros. Hulumtimet dhe rezultatet e Pol Brokës u botuan në revistat prestigjioze për fiziologji në frëngjisht, gjermanisht dhe anglisht. Është i njohur edhe me formulën Brok, sipas së cilës "pesha e njeriut duhet të jetë aq e rëndë sa centimetra është lartësia e trupit të tij mbi një metër".

BRUNER Xherom (Jerome BRUNER). Psikolog amerikan, i përket më tepër disiplinës së psikologjisë zhvillimore. Lindi më 1915**.** Profesor i psikologjisë në Universitetin e Harvardit, ligjërues i psikologjisë në Universitetin Prinston, në Kembrixh etj. Ka mbajtur ligjërata nga psikologjia edhe në

Shoqatën e Psikologëve të Zvicrës. U mor me studimin e perceptimit në përgjithësi, sidomos perceptimit të objekteve dhe ngjarjeve, në varësi nga fusha perceptive, nga përvoja dhe nga motivacioni. Në këtë kuadër ka studiuar edhe perceptimin social. Me fëmijët e moshës së mesme ka bërë gjurmime për perceptimin e vlerës së madhësisë së trupave nga rëndësia motivuese e objekteve perceptuese. Vepra kryesore e tij është: *"Acts of Meaning: Four Lectures on Mind and culture"* – (*"Akte mbi mendimin: Katër leksione mbi mendimin dhe kulturën"*), botuar më 1990.

BUJARI, - A. f. Ndjenjë zemërgjerësie e gatishmërie për t`u bërë të tjerëve mirë, duke u dhënë ndihmë të pakursyer dhe duke përjetuar kënaqësi të posaçme për gatishmërinë e dhënies së ndihmës dhe për dorëdhënien e lirë. Bujaria në të drejtën mbarëshqiptare është konsideruar virtyt i lartë i njeriut.

BUJAS Ramiro (Ramiro BUJAS). Psikolog kroat. Lindi në Budva më 1879 dhe vdiq në Zagreb më 1959**.** Ka studiuar dhe është diplomuar për filozofi në Universitetin e Gracit. Ka dhënë filozofi e psikologji në shkollën normale të arbëreshëve të Zarës. Docent dhe profesor i psikologjisë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Zagrebit që nga viti 1929; ka udhëhqur katedrën e psikologjisë të këtij fakulteti deri në pensionim. Gjatë kësaj kohe ka themeluar Institutin për psikologji dhe përmbledhjen psikologjike "Acta Instituti Psychological Universitatis Zagrebiensis" – "Akte të Institutit Psikologjik të Universitetit të Zagrebit", duke qenë njëkohësisht redaktor i kësaj reviste deri në vdekje. U mor me studimin e disa çështjeve të psikologjisë së përgjithshme eksperimentale, ndër të cilat dallohet studimi i ndijimeve shqisore, reagimi psiko-galvan, hipnoza, shfaqja e emocioneve, inteligjenca, dukuria e lodhjes dhe zbatimi i psikologjisë në veprimtarinë pedagogjike. Themelues i laboratorit të parë psikologjik më 1929. U angazhua në zbatimin e psikologjisë në veprimtarinë profesionale, sidomos në procesin arsimor – edukativ. Ka vënë themelin e shkollës psikologjike të Zagrebit. Veprimtaria e tij është përqendruar më tepër në gjurmimin objektiv dhe matjen e dukurive, të funksioneve dhe proceseve psikike. Në këtë kuadër ka zhvilluar psikometrinë dhe zbatimin e saj në përmasat më të gjera. Në nderim të personalitetit dhe veprimtarisë shkencore organizohen "Ditët e Ramiro Bujasit" çdo dy vjet, ku paraqiten arritjet profesionale dhe shkencore të psikologëve, sidomos të psikologëve të rinj. Në këto tubime kanë marrë pjesë edhe psikologët shqiptarë. Është ndier ndikimi i tij pozitiv edhe në shkollimin e arbanasve të Zarës.

BUJAS Zoran Ramiro (Zoran Ramiro BUJAS). Psikolog kroat. Lindi më 1910 dhe vdiq më 2004. Vazhdues i studimeve psikologjike të të atit dhe së bashku konsiderohen themelues të psikologjisë rigoroze në Zagreb, si edhe të psikologjisë zbatuese në Kroaci. U diplomua në filozofi (Psikologji) në Zagreb më 1932. Është ndër shkencëtarët e rrallë që, përpos diplomimit në Zagreb, u diplomua edhe një herë për psikologji në Paris te psikologu Anri Pieron, ku ka kryer dhe angazhimin studimor për kualifikim në psikologji dhe ku u doktorua

më 1933. Më 1954 u zgjodh profesor ordinar i psikologjisë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Zagrebit. Prej vitit 1956 – 1958 u zgjodh rektor i Universitetit të Zagrebit. Anëtar i rregullt i Akademisë Jugosllave të Shkencave dhe Arteve në Zagreb. Pas daljes në pension t'atit, mori drejtimin e Institutit dhe të Departamentit të Psikologjisë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Zagrebit. Falë angazhimit shkencor të tyre (Boris Petz, Mlladen Zvonjareviq, Ante Fulgosi etj.) psikologjia e Fakultetit Filozofik të Universitetit të Zagrebit mori tiparet e shkollës psikologjike të Zagrebit. Zoran Ramiro Bujasi u mor kryesisht me psikofiziologji, posaçërisht me psikofiziologjinë e shqisave, sidomos me hulumtime të organit shqisor të gjuhës dhe ndijimeve të shijes, me psikometri dhe me hartimin dhe standardizimin e disa llojeve të testeve. Veprat kryesore të tij janë: "*Osnovi psihifiziologije rada*" – (*"Bazat e psikofiziologjisë së punës"),* 1968 (me bashkëpunëtorin Boris Petz); "Uvod u metodë eksperimentalne psihologije" – (*"Hyrje në metodat eksperimentale të psikologjisë"*), 1981. Ka botuar shumë punime origjinale në Kroaci dhe jashtë saj. Dallohet studimi eksperimental i Ramiro dhe Zoran Bujasit me titull "Čitljivost *latinskog i ćirilskog pisma"* – (*"Lexueshmëria e alfabetit latin e cirilik"*), 1987.

BUKOLA Gabriel (Gabriele BUCCOLA). Mjek-psikiatër dhe psikolog arbëresh në Itali. Lindi në Munxifsi (Mezzoiuso) të Siçilisë më 1854 dhe vdiq në Torino më 1885. U diplomua në Universitetin e Palermos për mjekësi dhe shërbeu në spitalin e të sëmurëve mendorë në Rexhio–Emilia, më pas në Institutin Psikiatrik Universitar të Torinos dhe të Palermos. Drejtor i revistës shkencore "*Gli Atomi*" – ("*Atomet*"). Më 1883 u emërua docent i lirë për mësimdhënie universitare. Më 1884 fitoi konkursin për specializim në Mynih, ku pati disa oferta dhe mundësi të shërbimit profesional dhe të zhvillimit të veprimtarisë shkencore, por të cilën e ndërpreu për shkak të vdekjes së parakohshme. Njihet si një ndër psikologët hulumtues italianë, i cili ushtroi ndikim në zhvillimin e mëvonshëm të mjekësisë, të psikologjisë eksperimentale dhe të psikologjisë fiziologjike. Hulumtimet e para i kishte filluar në Institutin "Reggio Emilia", ku u mor posaçërisht me hulumtimin e relacionit ngacmim-reagim te kafshët dhe njerëzit. Lidhur me këtë hulumtim kishte zbuluar disa mjete për matjen e saktë të kohës reaguese të organizmit ndaj ngacmuesve. Konsiderohet një ndër themeluesit e fiziologjisë dhe të psikometrisë, me ndikim të madh në zhvillimin e fiziologjisë dhe të psikologjisë eksperimentale. Vdiq i ri, por ka lënë pas vetes 33 punime nga fusha e fiziologjisë dhe e psikologjisë. Vepra kryesore e tij është: *"La legge del tempo"* – (*"Ligji i kohës"*), 1883.

BULBI NUHATOR. Struktura e veçantë nervore e njohur me termin latin *bulbus olfactorius*. Shtrihet në pjesën e sipërme të pulpës së trurit, në anën e majtë dhe të djathtë të të ashtuquajturës "kreshta e gjelit" *crista galli*. Në të përfundojnë fijet nervore të qelizave të nuhatjes së mukozës së hundës. Nga pjesa e prapme e saj niset rruga nuhatëse që përfundon në pjesën frontale ose ballore të trurit të madh,

ku impulset nervore shndërrohen në ndijime të nuhatjes.

BULBI OBLONGATA. I ardhur nga latinishtja në anatominë e sistemit nervor, që në shqip do të thotë "palca e zgjatur". Kjo lidh trurin me palcën e kurrizit. I përket pjesës së trurit të mesëm dhe hynë në strukturën e shtyllës së trurit. Në këtë pjesë janë të vendosura disa qendra që rregullojnë dhe kontrollojnë funksionet vitale të organizmit (aktiviteti i zemrës, frymëmarrja, shtypja e gjakut).

BULBI OLFAKTOR. Përshtatje e termit të latinishtes *bulbus olfaktorius*. Shih – ***BULBI NUHATOR.***

BULIMI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *βούληση* "vullnet" dhe *λιμός* "uri". Bulimia është grykësi e jashtëzakonshme, çrregullim i shprehisë së marrjes së ushqimit, e shuarjes së urisë, që shfaqet me oreks të shtuar te disa individë për të futur në organizëm ushqim në sasi të madhe. Zakonisht bulimia është shoqëruese e gjendjeve depresive të njeriut të shoqëruar me ndjenjën e fajit.

BULIMIA NERVORE. Çrregullim i marrjes së ushqimit nga ana e njeriut, që cilësohet me ndryshime ciklike të marrjes së ushqimit të tepruar gjatë një faze kohore prej disa javësh e muajsh dhe me ndërprerjen e ritmit të tillë, përkatësisht me marrjen e masave të rrepta për t`u çliruar nga konsumimi i tillë i ushqimit.

BURT Lodovik Siril (Cyril Lodowic BURT). Psikolog anglez. Lindi në Londër më 3.03.1883 dhe vdiq në Londër më 10.10.1971. Hulumtues i psikologjisë së çështjeve të psikologjisë zhvillimore, sidomos të inteligjencës dhe themelues i psikologjisë pedagogjike në Angli. U mor me statistikën dhe zbatimin e saj në matjet psikologjike; me studimin e sjelljeve të delikuentëve, të fëmijëve me zhvillim të vonuar të inteligjencës dhe me çështjet e orientimit profesional. Pohohet se ka qenë psikologu i parë shkollor. Profesor i psikologjisë në Liverpul, ku u mor me gjurmimin empirik të zhvillimit të inteligjencës. Një ndër psikologët kryesorë në administratën shkollore të Londrës. Në Liverpul dhe, sidomos në Londër, ka grumbulluar lëndë të gjerë për inteligjencën, të cilën e ka përpunuar me kujdes. Profesor i merituar i Universitetit të Oksfordit, doktor nderi i disa universiteteve dhe anëtar i Akademisë së Shkencave të Britanisë së Madhe. Mori thirrjen "*sir*" – "*zotëri*" për merita të posaçme në organizmin e shërbimit psikologjik gjatë Luftës II Botërore. Në këtë fushë përmenden meritat e tij në përzgjedhjen e pilotëve, por edhe për angazhimin e tij në shërbimin sekret ushtarak. Preokupimi kryesor i tij ishte inteligjenca, struktura dhe zhvillimi i saj. Lidhur me këtë çështje ka gjurmuar zhvillimin e inteligjencës te binjakët dhe në bazë të rezultateve të arritura u përpoq të argumentonte zhvillimin e inteligjencës me baza trashëgimie, pra mbështeti pikëpamjen për rolin e trashëgimisë në zhvillimin e inteligjencës. Kundërshtar i bihejviorizmit.

BURRËRI, - A. f. Tërësia e tipareve të ngulitura të karakterit të njeriut që përbëjnë ndjenjat karakteristike. Lidhja e ngushtë ndërmjet besnikërisë, bujarisë, mençurisë, ndershmërisë e trimërisë së njeriut. Manifestohet në sjelljet e qëndrueshme të njeriut ndaj

objekteve të vështira për pushtim, ndaj situatave të vështira për t`u zotëruar etj. Kjo mund të jetë individuale dhe kolektive. Burrëria kolektive është vlerë e përbashkët e disa mjediseve shoqërore, që i përket sistemit të vlerave etike dhe psikologjike të përbashkëta për popullsinë e atij mjedisi. Është rezultat i procesit të të mësuarit të vlerave.

BURRËRIA NDËR SHQIPTARËT. Vlerë e pacenueshme etike dhe psikologjike që u zhvillua dhe u formua si vlerë e posaçme gjatë një periudhe të gjatë të orvatjeve dhe luftërave për mbrojtje dhe çlirim. Hyri në sistemin e traditës duke u bartur prej një brezi në tjetrin, mori përmasën e tiparit të "karakterit popullor" dhe u bë kriter themelor i vlerësimit të sjelljeve e karakterit të secilit. Kërkesat e sjelljeve burrërore në kushtet e në raportet e vështira të jetës dhe të ekzistencës e ngritën vazhdimisht nivelin e vlerës së burrërisë. Përvetësimi i tyre mori përmasat e tiparit me fuqi motivuese të posaçme, që e shtynin individin të sillej pozitivisht ndaj bashkëkombësve të tjerëve dhe ndaj raporteve ndërnjerëzore, duke humanizuar vazhdimisht përmbajtjen e këtyre raporteve.

BYLER Karl (Karl BÜHLER). Psikolog gjerman. Lindi në Mekeshaim më 27.05.1879 dhe vdiq në Los Anxhelos, më 24.10.1963. Mbas përfundimit të Fakultetit të Mjekësisë u mor me studimin e psikologjisë së mendimit si anëtar i shkollës së Vyrzburgut, me çështjet e psikologjisë zhvillimore dhe me psikologjinë geshtaltiste. Pas pushtimit të Austrisë emigroi në Norvegji dhe më pas në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pikëpamjet e tij për psikologjinë e të menduarit i përkasin qasjes geshtaltiste; sipas tij procesi i të menduarit zhvillohet pa ndërmjetësim figurash dhe pa elemente përfaqësuese. Ky është proces i thjeshtë, i pastër. Veprat kryesore të tij janë*: "Die Krise der Psychologie"* – (*"Kriza e psikologjisë"*), 1927; "*Sprachtheori"* – (*"Teoria e gjuhës"*), 1934; *"Das gestaltprinzip im leben des Menschen und der Tiere"* – ("*Parimet e geshtaltit në jetën e njeriut dhe të kafshëve*"), 1960.

BYLER Sharlot (Charlotte BÜHLER). Gjurmuese gjermane e zhvillimit psikik të fëmijëve. Lindi në Berlin më 20.12.1893 dhe vdiq në Shtutgard më 3.02.1974. Ka studiuar në Friburg, Berlin e në Mynih. U martua me psikologun Karl Byler. Kreu doktoratën në filozofi më 1918. Drejtore e Institutit Psikologjik të Vjenës, por emigroi në Oslo e prej këndej në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku avancoi shumë në karrierën universitare të saj. Nga fundi i viteve `50 të shekullit të kaluar, së bashku me Kurt Goldshtajnin, me Abraham Masloun dhe me Karl Roxhersin themeluan "Bashkimin Amerikan të Psikologjisë Humaniste". Veprat kryesore të tij janë: *"Kinheit und Jugend"* – (*"Fëmijëria dhe rinia"*), 1928; *"Values in Psychotherapy"* – (*"Vlerat në psikoterapi"*), 1962*; "Die Psychologie im Leben unserer Zeit"* – (*"Psikologjia në jetën e kohës sonë"*), 1962. Kjo vepër u përkthye në anglisht dhe frëngjisht më 1968 dhe më 1972.

C

C = shenjë emërtuese e koeficientit të korrelacionit (ndërlidhjes) kontigjential.

CA = (shkurt. i ***hipokampus***). I ardhur nga latinishtja *cornu Ammonis* "bri i Amonos". Emërton pjesët e ndryshme të hipokampusit**,** që jepen me shkurtesat CA1, CA2, CA3, CA4. Nga këto pjesë të hipokampusit janë studiuar më shumë pjesët CA1 dhe CA2. Këto dy pjesë luajnë rol të rëndësishëm në proceset e kujtesës.

CAK, – U. m. Rezultati përfundimtar i një veprimi që shkaktohet nga një motiv i caktuar, si: gjendja psikike e dëshiruar, objekti me të cilin plotësohet motivi, shtytësi e dëshira e nje riut. Caqet mund të jenë të afërta - të largëta, konkrete – abstrakte, të arritshme – të paarritshme, reale – joreale, të vetëdijshëm – të pavetëdijshëm. I afërt është caku i takimit me shokun në shkollë; i largët është caku i përfundimit të doktoratës; konkrete mund të jetë blerja e një palë rrobash; abstrakt është caku i zbatimit të së drejtës së mirëfilltë; i vetëdijshëm është caku i përmendur dhe i argumentuar; i pavetëdijshëm mund të jetë caku i natyrës seksuale, agresive, narcizike etj., për të cilat bën fjalë psikanaliza. Arritja në cak dhe zotërimi i cakut tregon fazën përfundimtare të ciklit motivues. Shih – ***CIKLI MOTIVUES***. Caku i përkufizuar mund të bëhet ndërkohë i paarritshëm. Në raste të tilla caku mund të zëvendësohet me një tjetër, i cili për individin është i moralshëm, fisnik, i arritshëm, i pranuar nga mjedisi social etj.

CAKU GRADIENT. Sintagma emërtuese e dijes së njeriut, sipas së cilës, një individ në moshë madhore sa më shumë t`i afrohet një caku të caktuar, aq më shumë e shton veprimtarinë e tij për ta zotëruar atë cak. Ky raport ndërmjet afërsisë së individit me cakun dhe veprimtarisë gjithnjë e më efikase të tij për ta zotëruar atë cak dallohet sidomos në përshpejtimin e lëvizjeve, në precizionin dhe në efikasitetin e tyre, në zvogëlimin gjithnjë e më shumë të lëvizjeve të gabuara dhe njëkohësisht në përforcimin e shpejtësisë dhe të saktësisë së lëvizjeve. Por, një raporti i tillë është i lidhur ngushtë me natyrën e cakut dhe të situatës ku gjendet individi.

C

CAKU I JETËS. Sipas psikologjisë individuale të Alfred Adlerit (1870 – 1937) ky term shpreh konceptin themelor të psikologjisë së tij, sipas të cilit në zhvillimin e personalitetit ndikon shumë më tepër shqetësimi mbi të ardhmen e njeriut se sa rrethanat, kushtet, raportet e ngjarjet e së kaluarës. Caku i jetës është drejtimi i të gjithë proceseve psikike, të synimeve, të sjelljeve etj. të njeriut në objektivin e caktuar. Çdo individ ka një cak të caktuar të jetës, në bazë të të cilit ai i plotëson synimet e përbashkëta për nderim, mbisundim etj., me qëllim kompensimin e ndjesisë së vlerës së mangët. Fal cakut të jetës së tij personaliteti i njeriut siguron unitetin, integritetin dhe veçantinë individuale të tij. Realizimi i cakut të jetës lidhet ngushtësisht me planin jetësor të njeriut. Shih – ***PLANI JETËSOR.***

CAKU INHIBUES. Në teorinë psikanalitike ka të bëjë me përshkrimin dhe me shpjegimin e raportit ndërmjet cakut seksual dhe afërsisë e miqësisë së atij individi me cakun seksual. Në raste të tilla përvoja në seancat psikanalitike ka treguar se një cak i tillë i kujtohet me vështirësi klientit që i është nënshtruar kurimit psikanalitik. Pikërisht ky raport (pengesa etike e sociale dhe caku seksual) lidhet me karakterin inkibues të atij caku, përkatësisht pamundësinë e të kujtuarit afatshkurtër apo afatgjatë të atij caku.

CALLOSUM. Shih – ***CORPUS CALLOSUM; TRUPI KALLOR.***

CAUDA EQUINA. I ardhur nga latinishtja që në anatominë e sistemit nervor nënkupton "bishtorja e kalit". Me Cauda Equina emërtohet fundi i grupit të nervave që kalon nëpër pjesën e poshtme të unazës së tretë të shtyllës kurrizore.

CEFALOKAUDAL. mb. I ardhur nga greqishtja *κεφάλι* "kokë" dhe *caude* "bisht", që i përket zhvillimit të fëmijës, duke filluar nga koka e duke ardhur kah pjesët e poshtme të organizmit. Shih – ***PARIMI I ZHVILLIMIT CEFALOKAUDAL.***

CENESTIZION, – I. m. I ardhur nga greqishtja që emërton tërësinë e ndijimeve të përgjithshme të njeriut, për të cilat ai në çastin e dhënë është i vetëdijshëm. Termi rrjedh që nga Aristoteli, dhe nënkupton atë që i bashkon të gjitha të dhënat shqisore të njeriut në një çast të caktuar. Përdoret rrallë dhe ka së paku dy kuptime: 1) Funksion nervor i sintetizimit të ndijimeve dhe i përjetimit të një ndijimi të përgjithshëm për gjendjen e përgjithshme të organizmit (gjendje e tensionuar – jo e tensionuar, e relaksuar – jo e relaksuar, e shëndoshë – jo e shëndoshë etj.); 2) Gjendje e vetëdijshme e njeriut për individualitetin e tij.

CENSUR/Ë, - A. f. I ardhur nga latinishtja *censura* "kontroll". Kontrolli i një informacioni, përmbajtjeje a një dëshire etj. me qëllim të lejimit ose moslejimit të bartjes së informacioneve, të ideve, të dëshirave etj. nga një burim në një individ ose masë individësh. Në psikologji censura njihet si term i terminologjisë së psikanalizës. Z. Frojdi e ka përdorur termin censurë në punimet e hershme të tij që nga viti 1897, për të shpjeguar atë proces psikik të brendshëm të njeriut, që kontrollon përmbajtjet psikike të pavetëdijshme, të cilat orvaten të kalojnë

nga sfera e pavetëdijshme në atë të vetëdijshme. Censura me funksion të tillë është instancë psikike që gjendet në kufirin që ndan të pavetëdijshmen nga e vetëdijshmja. Ajo kontrollon dëshirat, impulset, energjinë e shtytësve etj. dhe disa akteve të tilla u lejon depërtimin e tyre në përmbajtjen e vetëdijes së njeriut. Dëshirat impulsive, energjitë e shtytësve që janë të dëmshme, madje edhe të rrezikshme për njeriun pengohen në depërtimin e tyre në sferën e vetëdijes së njeriut prej censurës. Pengimin e depërtimit të këtyre akteve të padëshirueshme për njeriun ajo e kryen me anë të procesit të shtypjes ose represionit**.** Në terminologjinë e psikanalizës bashkëkohore *shtypje* është zëvendësuar nga *censurë*. Në punimet e mëvonshme të Z. Frojdit një censurë e tillë konceptohet si instancë morale, e cila emërton funksionin dinamik të super egos**,** që e pengon dhe ia ndalon idit**,** depërtimin e impulseve të shtytësve, kur këta e kundërshtojnë superegon. Ky plotësim kryhet në shpjegimin e strukturës së personalitetit dhe të raporteve ndërmjet tyre. Shih – ***IDI; EGOJA; SUPEREGOJA***.

CENSURA E ËNDRRAVE. Në psikanalizë është përdorur më tepër për shpjegimin e ëndrrave. Sipas Z. Frojdit censura e ëndrrave ka të bëjë me asgjësimin e disa përmbajtjeve të padëshirueshme të një ëndrre, me dhënien kuptim të pjesëve të tjera të ëndrrës, me kundërvënien ndaj atyre synimeve që janë të papranueshme nga pikëpamja etike, sociale, estetike etj. Me këtë funksion të censurës përmbajta e ëndrrës, sidomos pjesa manifestuese e saj, shndërrohet në përmbajtje të ngatërrueshme, gati të pakuptueshme për ëndërruesin. Besohet se refuzimi i këtyre pjesëve të ëndrrës kryhet për të mos lejuar prishjen e gjumit të ëndërruesit dhe zgjimin e tij nga gjumi.

CENTIL, – I. m. Rezultati i ranxhuar i një grupi subjektesh, që përfaqëson të njëqindtën pjesë të të gjitha rezultateve të arritura nga ana e të gjitha subjekteve. Centili është pika e arritur e një përqindjeje në një shkallë matëse nga ana e të gjithë subjekteve të provuar në një test të arritjeve ose në një test të inteligjencës. Kur thuhet se pika e arritur e centilit është 30, kjo do të thotë se kjo arritje i takon asaj pike, ku 30 % të të gjithë subjekteve të provuar e kanë zgjidhur me sukses sistemin e detyrave dhe të problemave të atij testi, kurse 70 % të të tjerëve janë përgjigjur më dobët në pyetjet e parashtruara. Disa nga hulumtuesit centilet dhe debilet, shih – ***DECILET***, i quajnë ranxh njëqindsh.

CENTRALIZ/ËM – MI. m. Në psikologjinë klasike, pikëpamje, sipas së cilës veprimet e sjelljet e njeriut kuptohen vetëm duke njohur proceset dhe funksionet nervore të tij. Termi i përket mbarimit të shekullit nëntëmbëdhjetë, kur zhvillimi i fiziologjisë u shfrytëzua për të shpjeguar proceset dhe sjelljet e njeriut. Antonimi i tij është ***PERIFERIZËM*** – shih.

CENTRIFUGAL, - E. mb. Që largohet nga qendra, qendërikës. Në psikologjinë fiziologjike nënkuptohet grupi i nervave që bartin impulse nervore nga qendra në periferi të organizmit. Nervat e tillë njihen me termin nerva eferente. Këta janë nervat motorikë. Fuqi centrifugale mund të jetë fuqia e motiveve, e shtytësve, e

dëshirave etj., fuqi kjo që buron nga brendia psikike e njeriut dhe vë në veprim organizmin ose pjesët e tij. Gjestet e njeriut mund të kenë karakter centrifugal, sepse mendimet, qëndrimet, emocionet etj. të individit u drejtohen të tjerëve. Kjo ndodh edhe në psikolinguistikë, por vetëm në ato raste kur individi flet e përjashton nga fjalori i tij përemrin "unë".

CENTRIPETAL, - E. mb. Që lëviz në drejtim të qendrës, përkatësisht nga periferia e organizmit në qendrën e tij; qendërsjellës. Si termi centrifugal, ashtu edhe termi centripetal janë terma që i përkasin psikologjisë fiziologjike. Me centripetal emërtohet grupi i nervave që bartin impulse nervore nga periferia në qendrën e organizmit, në radhë të parë në trurin e tij. Përdorimi i gjesteve gjatë komunikimit me të tjerët duke i kthyer duart kah vetes, i përket lëvizjeve centripetale. Drejtimi i duarve të njeriut kah vetes, gjatë kohës kur komunikon me të tjerët është shembull i sjelljeve centripetale. Antonimi i tij është ***CENTRIFUGAL*** – shih.

CEREBELLUM, - I. m. Në anatominë e sistemit nervor emërton trurin e vogël. Shih – ***TRURI I VOGËL.***

CEREBRAL, - E. mb. Trunor, që i përket trurit, përkatësisht cerebrumit. Në shqipe shpesh trunor ka kuptim metaforik dhe emërton njeriun e mençur, që i punon truri.

CEREBROTONI, - A. f. Një nga tipat e tipologjisë së temperamentit sipas Sheldonit. Tipi cerebrotonik i temperamentit është karakteristik për atë zhvillim anatomik e fiziologjik që Sheldoni e ka quajtur tip ektomorf me muskuj të dobët dhe me gjymtyrë të gjata etj. Shih – ***TIPI EKTOMORF.*** Tipi cerebrotonik–ektomorf ka këto tipare kryesore: i prirur kah përsiatjes së çështjeve dhe zgjidhjes racionale të tyre, kontrollues i mirë i sjelljeve dhe i veprimeve të veta ndaj të tjerëve dhe ndaj vetes së tij, në raporte dhe në komunikim me të tjerët është individ i përmbajtur, zakonisht është tip i tërhequr, përkatësisht jo i gatshëm për të hyrë në komunikime me të tjerët, më shumë parapëlqen vetminë, ka ndjesi të lodhjes së përhershme, është pak i rezistueshëm ndaj kërkesave dhe presioneve fizike, ka gjumë të çrregullt etj.

CEREBRUM, - I. m. Në anatominë e sistemit nervor emërton trurin e madh. Shih – ***TRURI I MADH.***

CEREMONIA RELIGJIOZE. Manifestim fetar që kryhet në kohë, shpesh edhe në një vend të caktuar, që përbëhet nga disa rituale të ndërlidhura, karakteristike për një religjion të caktuar.

CEZARIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga latinishtja e vjetër *Caesarism*. Cezarizmi është udhëheqje arbitrare dhe totalitare e një shoqërie, shteti etj. nga ana e një individi (Jul Çezari, Napoleon Bonaparti, Hitleri, Stalini etj.). Cesarizmi është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

CIEN Teodor (**Theodor ZIEHEN**). Psikolog, psikiatër dhe filozof gjerman. Lindi në Frankfurt më 12.11.1862 dhe vdiq në Visbaden, më 29.12.1950. Një nga përfaqësuesit e pozitivizmit dhe asociacionizmit në psikologji. Profesor i psikologjisë dhe i logjikës

në Universitetin e Jenës, të Berlinit dhe në Universitetin e Hales. Në psikologji u mor kryesisht me bazat fiziologjike të jetës psikike. Sipas tij "*gjësendet, uni im, uni i huaj janë vetëm përfytyrime. Diçka jopsikike është fjalë boshe*". Nga këto gjykime pohuese e vlerësuese kuptojmë mbisundimin e psikikës në gjithësinë lëndore e frymore dhe në njohjen e saj. Këtë e dallojmë posaçërisht në veprën "*Teoria e njohjes në baza të fizikës dhe të psikofiziologjisë*", të botuar më 1922. Veprat kryesore: *"Lehrbuch der Logic auf Pozitivischer Grundlage"* – (*"Libër i logjikës në baza pozitiviste"*, 1920); *"Psychophisiologische Erckenntnistheorie"* – *"Teoria e njohjes psikofiziologjike",* 1898); *"Die Grundlagen der Psychologie"* – (*"Bazat e psikologjisë"* (në dy vëllime), 1915); *"Grundlagen der Charakterologie"* – (*"Bazat e karakterologjisë",* 1930).

CIK/ËL, - LI. m. I ardhur nga greqishtja e vjetër "rreth". Në psikologji emërton një varg ndryshimesh dhe shndërrimesh të ndërlidhura, që përsëritën rregullisht sipas një rendi të qëndrueshëm, duke formuar një tërësi veprimesh të përforcuara. Sipas kriterit kohor dallojmë ciklin dytësor, siç është rasti me numrin e lidhjeve të një ngacmuesi brenda një sekonde.

CIKLI I AKTIT SEKSUAL. Akt që zhvillohet duke kaluar në katër faza psikomotorike, që zëvendësojnë njëra-tjetrën. Këto faza janë: eksitimi (ngacmimi seksual), paraorgazma, orgazma dhe qetësimi i organizmit.

CIKLI JETËSOR I INDIVIDIT. Fazat jetësore të përgjithshme të jetës së një individi që paraqiten sipas një rendi, një standardi të përgjithshëm. Cikli jetësor i njeriut përbëhet nga zhvillimi i embrionit të fetusit, nga lindja, porsalindja, fëmijëria e hershme, e mesme, e vonshme, nga rinia e hershme, e mesme, e vonshme, nga pjekuria psikofizike, pleqëria dhe nga vdekja.

CIKLI MOTIVUES. Proces rrethor që përbëhet prej disa fazave, të cilat zëvendësojnë njëra-tjetrën sipas një rendi të caktuar. Fazat e ciklit motivues janë: paraqitja e motivit, sjellja e instrumentalizuar, arritja në cak, lehtësimi. Këto dallohen sidomos te motivet homeostazike, shih – ***MOTIVET HOMEOSTAZIKE***.

CIKLOTOMI, - A. f. I ardhur nga greqishtja që emërton çrregullimin relativisht lehtë të qëndrueshmërisë së gjendjes psikike të njeriut, që shfaqet me ndryshim të gjendjes psikike, duke u sjellë prej gjendjes depresive në gjendjen jodepresive. Ky cikël i ndryshimeve të gjendjes psikike, në radhë të parë i gjendjes emocionale, mund të zgjasë dy vite. Shqetësimi shpirtëror i formës rrethore karakterizon individin me strukturë dhe me integritet të posaçëm të personalitetit. Ndryshimet psikike të tipave të tillë sillen prej aktivitetit në joaktovitet, nga entuziazmi me hidhërim në pikëllim, nga dëshpërimi i madh në gjendje të gëzueshme dhe të hareshme etj. Ky zëvendësim gjendjesh psikike të kundërta ka karakter periodik; mund të zgjasë një-, dy-, tre muaj, e më shumë dhe pas kësaj kohe pason gjendja e kundërt psikike, për të cilën njeriu është i pavetëdijshëm.

CILËSI, - A. f. Në psikologji ka kuptimin e veçorisë thelbësore dhe përcakton veçantinë e një procesi psikik, të një lloj sjelljeje, të një individi etj. Me

këtë domethënie në shqipe përdoren edhe dy termat joburimorë: karakteristikë dhe atribut. Cilësia duhet dalluar nga tipari. Shih – ***TIPARI.***

CILËSIA E JETËS. Tërësia e kushteve, rrethanave dhe e raporteve fizike, ekonomike, sociale dhe psikike në të cilat zhvillohet dhe vepron njeriu. Në strukturën e kualitetit të jetës së njeriut hyjnë shëndeti fizik e psikik, situatat sociale, financiare e politike, format e reagimit e të sjelljeve të njeriut ndaj situatave të tilla dhe ndaj ndryshimit të vazhdueshëm të tyre.

CILËSIA E NGJYRAVE. Cilësi që lidhet me tonin e ngjyrës si edhe me nuancat e shumta të tonit të ngjyrave kromatike. Kur rrezet e diellit kalojnë nëpër prizmin optik ato zbërthehen në ngjyrë të kuqe portokalli, të verdhë, të gjelbër dhe të kaltër. Cilësia e ngjyrave varet kryesisht nga gjatësia e valëve elektromagnetike.

CILËSIA GESHTALT. Term i përdorur nga filozofi dhe psikologu gjerman Kristin fon Erenfels (Christian von Erenfells, 1859 – 1916), prirës i zhvillimit të psikologjisë geshtaltiste. Ky mendimtar e ka cilësuar cilësinë e tërësisë, përkatësisht "Gestaltqualitat", tërësi që del nga ngacmuesi dhe struktura e tij dhe se kjo cilësi është perceptuale që i shtohet elementeve të tjerë përbërës të kësaj tërësie. Kjo pikëpamje u kundërshtua nga geshtaltistët e tjerë.

CILËSIM, - I. m. Proces i përcaktimit të cilësisë ose atributit të një sjelljeje të caktuar të një individi. Cilësimi kryhet në mbështetje të parimeve të fituara gjatë përvojës dhe në mbështetje të kritereve të përkufizuara në bazë të funksionit të proceseve kognitive. Mbi këtë bazë kryejmë cilësimin e sjelljeve, të gjykimeve, të ndjenjave, të synimeve etj. Njohja e cilësive të këtyre proceseve dhe sjelljeve çon në identifikimin e shkaqeve të gjendjes së proceseve dhe të sjelljeve të caktuara. Për cilësime imediate është përcaktimi, vlerësimi dhe, aq më tepër, njohja e shkaqeve të cilësimeve. Për këtë arsye cilësimet janë të lidhura ngushtë me përcaktimin e shkakut ose të shkaqeve të gjendjes së proceseve e të sjelljeve, si edhe të ndryshimeve të tyre. Në cilësimin e sjelljeve theksohet roli i motiveve dhe rëndësia e njohjes së tyre për një cilësim të drejtë të një sjellje të caktuar. Në psikologjinë sociale cilësimi është emërtuar edhe me termin atribuim.

CILËSITË E NDIJIMEVE. Veçoritë thelbësore të procesit të ndijimeve që përcaktojnë veçantitë e ndijimeve. Duke u bazuar në to një ndijim dallohet nga ndijimi tjetër. Cilësitë e ndijimeve u përcaktuan që nga shkolla strukturaliste, e cila ka hulumtuar ndijimet (sensacionet). Cilësitë e ndijimeve janë: kualiteti, intensiteti, kohëzgjatja dhe lokalizimi. Cilësitë e tilla përcaktohen në thelb nga ngacmuesi dhe nga karakteristikat e tij, kur ai ndikon drejtpërdrejt në shqisat e caktuara, duke shkaktuar reagim fiziologjik të asaj shqise, si edhe të sistemit nervor, përkatësisht të qendrës së caktuar të trurit të madh. Shndërrimi i cilësive të ngacmuesit në reagim trunor përcakton natyrën, intensitetin dhe kohëzgjatjen e tij. Për këto shkaqe ndijimi dhe cilësitë e tij përcaktohen si pasqyrim aktiv i ngacmuesit në procesin ndijimor. Ndijim të pastër të një cilësie të objektit, të dukurisë, të procesit

etj. kemi atëherë kur pasqyrojmë cilësinë e caktuar si një mbresë shqisore të papërzier me përvojë, me dije etj. Përjetimi i cilësive të tilla shkaktohet nga perceptimi i tërësisë së një objekti, dukurie a procesi.

CILËSITË METRIKE TË TESTIT. Për të realizuar qëllimet dhe detyrat e veta testi duhet të ketë këto cilësi metrike: 1) Vlefshmërinë ose validitetin; 2) Besueshmërinë ose reliabilitetin dhe 3) Ndjeshmërinë ose sensibilitetin dhe objektivitetin e tij. Vlefshmëria e testit ka të bëjë me shkallën e duhur të zotërimit të asaj cilësie për të cilën testi i caktuar është hartuar. Besueshmëria e testit është ajo cilësi e testit, e cila ka të bëjë me faktin se ai test jep rezultate shumë të ngjashme ose të njëjta, sa herë që përsëritet në kushte shumë të ngjashme ose të njëjta me subjekte të njëjtë. Ndjeshmëria e testit është cilësia e testit për të shkaktuar të njëjtin aktivitet psikik dhe për të matur saktësisht dallimet ndërmjet subjekteve në shkallën e zotërimit dhe të zhvillimit të atij aktiviteti. Objektiviteti i testit ka të bëjë me faktin se testi i ka të saktësuara kushtet e dhënies së pyetjeve, detyrave e problemave dhe të gjithë vlerësuesit duhet të japin të njëjtin vlerësim në rezultatet e arritura nga ana e secilit subjekt të testuar. Shih – ***VLEFSHMËRIA E TESTIT*; *BESUESHMËRIA*; *NDJESHMËRIA E TESTIT*; *OBJEKTIVITETI I TESTIT*.**

CINGULOTOMI, - A. f. Formë speciale e ndërhyrjes neurokirurgjike te ata pacientë, të cilët vuajnë nga çrregullimi obsesiv–konvulsiv. Cingulotomia u tregua në të shumtën e rasteve formë e suksesshme në shërimin e çrregullimit obsesiv–konvulsiv.

CINIZËM, - MI. m. Qëndrim mohues i një individi ose i një grupi individësh ndaj vlerave të tyre. Cinizmi shfaqet me nënçmimin dhe me injorimin e vlerave dhe të bartësve të tyre, duke i përqeshur, tallur dhe zhvleftësuar në mënyrë ironike vlerat e tilla dhe bartësit e tyre. Cinizmi merr karakterin e tiparit, kur sjelljet cinike bëhen të qëndrueshme dhe përcaktojnë karakterin e njeriut. Është tipar negativ dhe i ulët i karakterit të një individi.

CIP/Ë, - A. f. Në anatomi emërton mbështjellësen e hollë të një organi. Me këtë kuptim përdoren edhe *kore* dhe *membrana*. Në psikologji dallohen: cipa bazilare, cipa e palcës kurrizore, cipa e trurit të madh etj.

CIPA BAZILARE. Cipë e hollë, e butë dhe e ndjeshme e tingujve të zërit. Cipa bazilare është e vendosur në veshin e brendshëm. Kjo cipë e njohur edhe me termin membranë bazilare është krijuar nga rreth njëzetmijë fijeza nervore. Këto fijeza përbërëse kanë gjatësi dhe trashësi të ndryshme dhe shtrihen në kërmill të veshit. Shumë prej tyre shtrihen në themelin e kërmillit dhe në majë të kërmillit. Fijezat kryejnë funksione të ndryshme ndaj intensitetit të tingujve. Fijezat e shtrira në themelin e kërmillit janë fijezat e ngurta, të shkurtra dhe të trasha; këto dridhen kur ngacmohen nga tingujt me frekuencë të lartë. Fijezat e gjata, të holla dhe të thyeshme janë të vendosura në majë të kërmillit dhe reagojnë duke u dridhur ndaj tingujve me frekuencë të ulët. Mbi cipën bazilare është zhvilluar organi i kortit Shih – ***ORGANI I KORTIT*.** Organi i kortit ka cilësinë e shndërrimit të këtyre dridhjeve në impulse nervore në ner-

vin e dëgjimit. Këto impulse barten në qendrën e dëgjimit të trurit të madh dhe me këtë rast procesi fiziologjik i dëgjimit shndërrohet në proces psikik të ndijimit dëgjimor.

CIPA E TRURIT. Mbështjellëse e dy hemisferave të trurit me një sipërfaqe prej rreth 2400 mm katrorë dhe një trashësi që sillet prej 1,5 – 4 mm. Cipa e trurit kryen funksione të rregullimit dhe të koordinimit të shumë proceseve dhe të sjelljeve të ndërlikuara psikike të njeriut. Kjo cipë përfaqëson shkallën më të lartë të zhvillimit evoluitiv të trurit që karakterizon vetëm njeriun; kjo është bartëse e jetës psikike të njeriut. Cipa është ndërtuar dhe zhvilluar nga trupi i qelizave nervore që formojnë masën e përhimët të trurit. Në cipën e trurit dallohen njëmbëdhjetë shtresa nervore: gjashtë i takojnë neokorteksit, dy paleokorteksit dhe tri arkitekorteksit. Këto shtresa tregojnë procesin zhvillimor të trurit të njeriut, ku qelizat nervore gjatë zhvillimit të tyre kanë marrë formë, madhësi dhe dendësi të ndryshme. Në cipën e trurit dallojmë disa zona trunore: zona parësore e dytësore sensorike, zona parësore dhe dytësore motorike dhe zona asociative. Zona parësore sensorike dhe motorike përbën shtresën projektuese. Në qendrat sensorike të shtresës parësore të zonës së sensacioneve ose të ndijimeve, impulset nervore shndërrohen në procese psikonervore, përkatësisht në ndijime. Qendrat e zonës motorike mbisundojnë organizimin e lëvizjeve të qëllimshme të organeve dhe të organizmit në tërësi. Shtresat dytësore sensorike dhe motorike kryejnë funksionin e integrimit të pjesshëm të veprimtarisë nervore ndërmjet qendrave motorike dhe qendrave sensorike. Zona asociative kryen funksionin e integrimit të përgjithshëm të veprimtarisë nervore të të gjitha qendrave të cipës së trurit.

CIPA RAJSNER. Cipa ose membrana e hollë e kërmillit të veshit. Kjo cipë është parahyrja që ndan kanalin e kërmillit nga pjesa e kanalit spiral të tij. U emërtua sipas emrit të anatomistit gjerman Ernst Raisner (Ernst Reissner, 1824 – 1878).

CITALOPRAM, - I. m. Bar, ilaç efikas në shërimin e çrregullimit të ankthit. Citaloprami i përket grupit të penguesve të marrjes rishtas të serotinës në sinapse. Shih – ***SINAPSA.***

CORPUS CALLOSUM. Shih – ***TRUPI KALLOR.***

CORTEX CEREBRI. Shih – ***CIPA E TRURIT.***

CYTJE, - A. f. Ngasje dhe nxitje e njeriut dhe e kafshëve për të vepruar ndaj objektit, individit, dukurisë së caktuar etj. Faktorët nxitës mund të jenë të jashtëm dhe të brendshëm. Dhuratat, çmimet e caktuara për arritje të larta në mësime, në prodhim, në sjellje pozitive etj. janë nxitës me fuqi cytëse, kurse faktorët e brendshëm cytës mund të jenë aspirata, motive, nevoja etj. Derisa nxitësit me fuqi cytëse veprojnë në lidhjet jashtë – brenda – jashtë, faktorët e brendshëm veprojnë nga brenda – jashtë.

Ç

ÇARJA HESHËL. Fushë nervore sensorike e cipës a kores së trurit të madh në pjesën temporale të saj. Kjo fushë është bartëse e dëgjimit të toneve dhe zhurmave. Dëmtimi i dyanshëm i kësaj fushe (në dy hemisferat e trurit) shkakton shurdhërinë kortikale të njeriut (pamundësinë e dëgjimit të toneve dhe zhurmave), pavarësisht nga fakti se organi i dëgjimit, përkatësisht veshi është i padëmtuar.

ÇARJA SINAPTIKE. Çarje apo plasja e sinapsës ndërmjet nyjëzës përfundimtare të qelizës nervore, përkatësisht ndërmjet fshikëzës së vogël në fund të aksonës apo neuritit dhe cipës së qelizës fqinjë të saj në kuadrin e sinapsës. Kjo çarje është shumë e vogël dhe sillet rreth 20 – 30 mm. Nëpërmjet saj barten impulset nervore me anë të neurotransmiterëve.

ÇEKIÇI I VESHIT. Njëra nga qeskat e veshit të mesëm që është e lidhur me dy qeskat e tjera të kësaj pjese të veshit (me kullën dhe yzengjin) dhe me funksionin e përbashkët të tyre bartin dridhjet e timpanit në pjesët e veshit të brendshëm, përkatësisht në kërmillin e veshit të brendshëm duke vë në lëvizje lëngun e këtij organi. Shih – ***VESHI.***

ÇELËSI I ZGJIDHJES SË PROBLEMAVE TESTORE. Treguesi i zgjidhjes së problemave në regjistrin e problemave të zgjidhura të një testi, që lehtëson, thjeshton dhe përshpejton procesin e kontrollit të një testi dhe të vlerësimit të rezultatit të arritur në zgjidhjen e problemeve të tij dhe plotësimin e detyrave të parashtruara në këtë test. Hartohet zakonisht në dy forma: 1) në formë të regjistrit të veçantë, ku rendi i zgjidhjeve përputhet me rendin e detyrave dhe të problemeve të testit; 2) në formë të maskës plastike ose të kartonit tregues të detyrave të zgjidhura në dy a më shumë alternativa**.**

ÇELTËSIA E NGJYRAVE. Cilësi e ngjyrave dhe e ndijimit pamor të tyre, që ka të bëjë me ndryshimet e cilësisë së ngjyrës gjatë kalimit nga e bardha në të zezë. Një ngjyrë është aq më e çelët, sa më tepër t`i afrohet ngjyrës së bardhë. Përkundrazi, ngjyra është aq më e errët sa më shumë t`i largohet

ngjyrës së bardhë dhe t`i afrohet ngjyrës së zezë. Çeltësia e ngjyrave është e lidhur ngushtë me intensitetin e valëve të dritës dhe bën të mundur qartësinë e ndijimit të tyre dhe dallimin e asaj ngjyre nga ngjyrat e tjera.

ÇLODH/JE, - A. f. Rivendosje e gjendjes normale organike e psikike të organizmit të njeriut dhe përjetimi i kësaj gjendjeje. Çlodhja nevojitet pas një pune e aktiviteti fizik e mendor të gjatë, të shkaktuar nga harxhimi i energjisë së organizmit dhe grumbullimi i disa lëndëve helmuese në muskujt e organizmit. Arrihet duke pushuar dhe pakësuar përqendrimin e substancave helmuese të grumbulluara në organizëm gjatë një pune të gjatë, e sidomos monotone.

ÇMENDURI, - A. f. Humbje e pjesshme ose e tërësishme e aftësive intelektuale dhe e lidhjeve të tyre me gjendjen emocionale, si edhe me motivet e veprimtarisë së njeriut. Një humbje e tillë e aftësive intelektuale dhe e ndërlidhjeve të tyre me përjetimet emocionale dhe me motivet e aktivitetit të njeriut shfaqet në çrregullimin e personalitetit, sidomos në çrregullimin e tiparit të integritetit të tij.

ÇOMSKI Noam Avram (**Noam Avram CHOMSKY**). Gjuhëtar, filozof dhe psikolog amerikan, si edhe aktivist politik. Lindi në Filadelfia më 1928. Profesor ordinar i gjuhësisë në Institutin për Teknologji në Masaçusets. Doktor nderi i Universitetit të Çikagos dhe i Universitetit të Londrës. Themelues i gramatikës transformuese-gjenerative. Sipas tij gjuha është e caktuar gjenetikisht dhe kjo zhvillohet krahas funksioneve të tjera trupore. Gramatika për të përfshin sintaksën, morfologjinë dhe strukturat e tjera të gjuhës. Por, ". . .*vendi qendror i përket sintaksës dhe gjithmonë niset nga fjalia: së pari gjenerohen strukturat abstrakte sintaktike, në të cilat më pas zbatohen njëra pas tjetrës rregullat e ndryshme leksikore, morfologjike dhe fonologjike, për të përfituar më në fund fjalën e vërtetë, e gatshme për të qenë e folur ose e shkruar*... ". Sipas mendimit të tij gjuhësia është degë e psikologjisë kognitive, kurse gramatika gjenerative është si teoria e aftësive gjuhësore. Në studimet e tij pasojat e këtij zhvillimi të aftësive gjuhësore dhe të zbatimit të gramatikës gjenerative kanë bazë psikologjike dhe filozofike. Mbi këtë bazë ai ka zhvilluar sistemin e të mësuarit të gjuhës. Ka dhënë kontribut të posaçëm në drejtimin e gjurmimit të mendjes së njeriut me anë të analizës gjuhësore. Veprat kryesore të Noam Çomskit janë*: "Language and Mind"* – (*"Gjuha dhe mendja",* 1968); *"Current Issues in Linguistic Theory"* – (*"Çështjet aktuale të teorisë së gjuhës",* 1964); *"Topics in the Theory of Generative Grammar"* – (*"Tema në teorinë e gramatikës gjenerative",* 1968), *"Syntactic Structures "* – (*"Strukturat sintaksore",* përkthyer në shqip, "Dituria", 2011).

ÇRREGULLIM, - I. m. Mungesa e rendit, e rregullit dhe e zhvillimit të një procesi, sjelljeje, shkathtësie, prishja e rendit të një dukurie a procesi psikik, nervor etj. Një çrregullim i tillë dëmton seriozisht zhvillimin e ritmit dhe funksionimin normal psikofizik të organizmit. Madje, në rastin e çrregullimeve të rënda dallohen rënie të theksuara të funksionimit psikofizik të organizmit. Ndeshen disa forma çrregullimesh të zhvillimeve psikike.

ÇRREGULLIMET E AUTIZMIT. Çrregullime dhe dëmtime të natyrës së autizmit që përbëjnë një seri nivelesh të ndryshme të dëmtimit të sjelljeve sociale, të shprehive të sjelljeve të mira të disa individëve. Te këta persona vihet re çrregullimi i komunikimit normal me njerëzit e afërm dhe me ata më të largët. Këta individë zakonisht gjatë komunikimit me të tjerët përdorin fjalë e sjellje me natyrë stereotipe, të shoqëruara shpesh me përsëritje të tyre.

ÇRREGULLIMET E GËNJESHTËRTA. Formë e gënjeshtrës me të cilën disa nga pacientët paraqesin simptoma të çrregullimeve psikologjike. Kjo gënjeshtër zakonisht fsheh çrregullime serioze të personalitetit. Pacientët e tillë shpesh marrin barna për të përmirësuar proceset e kujtesës, të mendimit, të halucinacioneve etj.

ÇRREGULLIMET E HUMORIT. Turbullime përjetimesh të gjendjes së humorit ose të disponimeve psikike të njeriut, që karakterizohen me ngritje dhe me rënie nën shkallën e përjetimit normal të gjendjes së humorit ose gjendjes psikike. Këto çrregullime janë të ndara në dy grupe: 1) Çrregullime unipolare dhe 2) Çrregullime bipolare. Çrregullimet unipolare kanë të bëjnë më shpesh me ngjyrosje pesimiste të jetës psikike, me mungesë të duhur të shkallës së përjetimit të haresë, të kënaqësisë, të gëzimit, me frenim mendimesh e të të folurit etj. Gjendjet e tilla zakonisht quhen gjendje depresive. Çrregullimet bipolare i përkasin gjendjes euforike dhe kanë këto karakteristika: optimizëm të tepruar, hare e gëzim të shkallës së lartë – përçues të aktivitetit të ngjeshur të tyre, të cilët vuajnë nga këto çrregullime, të folurit gati pa pushim me kapërcim mendimesh prej një fushe në tjetrën etj. Identifikimi i llojit të çrregullimeve të humorit sot kryhet në bazë të DSM4 (Doracak Diagnostikues e Statistikor i Çrregullimeve Mendore i Shoqatës së Psikologëve Amerikanë, i ripunuar më 1994).

ÇRREGULLIMET E KUJTESËS. Çrregullim i procesit të mbajtjes mend, të rikujtesës dhe të riprodhimit të asaj që është mësuar. Çrregullimet e kujtesës shfaqen në forma të ndryshme, ndër të cilat dallohen: sëmundja Alzaimer (Alzheimer), amnezia, hiperamnezia, hipoamnezia, konfubulacia, kriptomnezia, para-amnezia dhe pseudoamnezia me dy format e njohura të saj: ***DEZHA VU; ZHAME VU*** – shih**.**

ÇRREGULLIMET E PANIKUT. Sulme periodike paniku të karakterit ankthor, të cilat shoqërohen me mundime, djersitje, dridhje të trupit e më tepër të gjymtyrëve të tij, si edhe me frikë të shtuar, madje edhe me frikë të fuqishme se ai do të pësojë më të keqen. Çrregullimet e panikut janë të befasueshme. Këto çrregullime janë të tilla që njeriu arrin t`i përballojë me vështirësi format e rënda të frikës. Këto janë të papritura, befasuese dhe individi me vështirësi të mëdha arrin t`i kontrollojë edhe pas rreth 15 minutave.

ÇRREGULLIMET E VETËDIJES. Dukuri patologjike të funksionimit të vetëdijes me anën e së cilës njohim tërësinë e jetës psikike të njeriut, të formave dhe të zhvillimit të tyre në mënyrë sasiore dhe cilësore. Ana sasiore ose kuantitative e çrregullimeve të vetëdijes shfaqet

me këto forma patologjike: ***KOMA; SOMNOLENCA; SOPORI*** – shih**.** Ana cilësore ose kualitative e çrregullimeve të funksionit të vetëdijes shfaqet me këto forma: depersonalizim, derealizim, çorientim, errësim të vetëdijes, fugë, gjendje onirike dhe somnambulizëm**.**

ÇRREGULLIMET FUNKSIONALE. Çrregullime psikike duke mos qenë të bazuara në dëmtim organik. Çrregullime psikike që nuk mund të shpjegohen me dëmtim të organeve ose të funksioneve të tyre, sepse struktura e organeve dhe funksionet organike të tyre janë të paprekura, kurse funksioni psikik është çrregulluar.

ÇRREGULLIMET PSIKIKE BIPOLARE. Çrregullime procesesh psikike dhe sjelljesh që sillen prej depresionit intensiv, ku mbisundojnë dëshpërimi e pikëllimi i madh deri te hipomania, ku mbisundojnë entuziazmi, veprimtaria e shpejtë, impulsiviteti dhe ritmi i shpejtuar i të menduarit dhe i të folurit; zëvendësimi i njërës gjendje me gjendjen tjetër. Kalimi prej njërës gjendje në gjendjen tjetër mund të kalojë nëpër një fazë kohore të qetë, që mund të zgjatë shumë kohë.

ÇRREGULLIMET SOMATIKE. Term i përbashkët për sëmundje trupore të ndryshme ose për një të metë trupore pa bazë organike e fiziologjike dhe që nuk ka të bëjë me ndonjë faktor psikik. Çrregullime të këtilla janë: çrregullimet konversive (humbja e ndijimeve e lëvizjeve dhe e koordinimit të tyre, dhembja e kokës etj.), somatizimi (lodhja, dhembjet në gjoks dhe në shpinë, pengesa në tretjen e ushqimit, në jashtëqitje etj.). Këto çrregullime janë të njohura edhe me termin çrregullime somatoformike.

ÇRREGULLIMET SOMATOFORE. Çrregullime psikike të njeriut që i atribuohen simptomave fizike, megjithëse nuk kanë bazë mjekësore të sëmundjes trupore. Sipas DSM 4 – 1944 çrregullimet somatoforme u klasifikuan në një grup të veçantë çrregullimesh, ku kryesoret janë: çrregullimet konversive, hipokondritë, çrregullimet e padiferencuara etj. Konstatimi i këtyre çrregullimeve dhe i shkaqeve të tyre është mjaft i ndërlikuar.

ÇRREGULLIMI AKUT I STRESIT. Reagim i çrregulluar i individit pas përjetimit të një gjendjeje traumatike, që shfaqet me disa karakteristika, ndër të cilat dallohen: ngushtimi i funksionit të proceseve njohëse apo kognitive, në njohjen reale të mjedisit dhe të ndryshimeve fizike, sociale e psikike të njerëzve të atij mjedisi; humbja nga kujtesa e ngjarjes që ka shkaktuar traumë, ngurtësim të gjendjes emocionale dhe çrregullim të ndryshimit të gjendjeve emocionale.

ÇRREGULLIMI ANKTHOR. Term përmbledhës për të gjitha llojet e simptomave të çrregullimeve psikike të mbështetura në shfaqjen e herëpashershme të ankthit. Këtu hyjnë: çrregullimi psikik i përgjithësuar, çrregullimi i panikut, çrregullimi i fobisë dhe çrregullimi i stresit pastraumatik**.**

ÇRREGULLIMI ANTISOCIAL I PERSONALITETIT. Sistem qëndrimesh që krijojnë një gjendje psikike te një njeri, i cili me sjelljet e tij bie në kundërshtim të hapët me normat etike, sociale dhe kulturore të një mjedisi shoqëror të caktuar. Sjelljet e

individëve të tillë mund të jenë sjellje impulsive, agresive, kërcënuese dhe të rrezikshme. Sipas psikanalizës njerëzit me sjellje antisociale janë kryesisht ata, të cilët e kanë të zhvilluar në nivel relativisht të lartë egon e personalitetit të tyre, të shfaqur në shpërpjesëtim me superegon e tyre.

ÇRREGULLIMI AUTIK. Përjetimi i zhvillimit të kufizuar organiko-fiziologjik e psikik me ndikim të dukshëm në zhvillimin e disa proceseve psikike të rëndësishme për zhvillimin dhe formimin e një personaliteti të shëndoshë. Ndikime të tilla shfaqen sidomos në perceptimin e çrregulluar të realitetit, në lëvizjet jo të integruara e të ngadalësuara, në gatishmërinë e kufizuar të përqendrimit të vëmendjes në një situatë, objekt të caktuar etj.

ÇRREGULLIMI BIPOLAR. 1) Çrregullim i gjendjes psikike të njeriut, kryesisht i gjendjes emocionale të tij, që ka karakter shtrirës dyskajësh: nga gjendja depresive kalohet në gjendje të manisë dhe njëra gjendje e zëvendëson tjetrën në periudha kohore të caktuara (dy, tre, gjashtë muaj etj., mbisundon një gjendje dhe pas një periudhe të caktuar kjo gjendje zëvendësohet me gjendjen tjetër). Mund të ndodhë që ndërmjet periudhës depresive e maniake të shfaqet gjendja normale psikike, por këto janë raste të rralla. 2) Çrregullim i gjendjes së zotërimit të emocioneve apo të humorit. Në këtë mënyrë emërtohet çrregullimi i humorit nga gjendja e depresionit të lartë ose atij intensiv në gjendje të hipomanisë. Shih – ***HIPOMANIA.*** Si te gjendja e parë ashtu dhe te ajo e dytë psikiatrit parapëlqejnë kripën e litiumit.

ÇRREGULLIMI CIKLOTOMIK. Shih – **CIKLOTOMIA.**

ÇRREGULLIMI DEPRESIV. Formë specifike e çrregullimit të gjendjes së zotërimit të emocioneve ose e humorit, që shfaqet me disa shenja ose simptoma dalluese: pakësim i dukshëm i interesit për ato sjellje që janë të lidhura me fushën e interesit ose me pasionin, ngadalësim i ritmit të lëvizjeve, prani e ndjenjës së fajësisë së paarsyetuar, përjetim i ndjenjës së lodhjes së qëndrueshme, pagjumësi, etj. Prania e këtyre simptomave ose e disa prej tyre, zakonisht e pesë simptomave të tilla, gjatë një periudhe prej dy javësh, tregon për praninë e çrregullimit depresiv, që është njihet edhe me termin çrregullim depresiv madhor.

ÇRREGULLIMI DISTIMIK. Çrregullim i gjendjes emocionale, përkatësisht i humorit ose i zotërimit psikik. Çrregullimi distimik shfaqet me këto simptoma kryesore: zhvillim gjithnjë e më i madh i gjendjes pikëlluese, mbisundim i gjendjes depressive në jetën dhe në sjelljen e individit, humbje e interesit për veprimtari të përditshme. Çrregullimet distimike nuk kanë të bëjë me gjendjen depressive akute të njeriut, por me çrregullime të gjendjes emocionale normale të përjetimeve emocionale. Të tilla çrregullime shfaqen gjatë aktivitetit të përditshëm, duke u zgjatur gjithnjë e më shumë. Një gjendje e këtillë zgjat një ose më së shumti dy vjet. Të njëjtin kuptim ka edhe ***NEUROZA DEPRESIVE*** – shih.

ÇRREGULLIMI EMOCIONAL. Reagim emocional dhe sjellje emocionale joadekuate e njeriut ndaj situatave dhe ndaj ngacmuesve me cilësi, intensitet dhe kohëzgjatje të ndryshme.

ÇRREGULLIMI I ADAPTIMIT. Humbja e aftësisë së përshtatjes së individit ndaj situatave të ndryshme pas përjetimit të situatave stresore, si edhe ndaj situatave të reja stresore. Çrregullime të tilla janë të shpeshta, por te shumë individë nuk zgjasin shumë kohë. Rezultatet klinike tregojnë se gjendjet e tilla te një individ mund të jenë të shpeshta, por kanë karakter të përkohshëm. Zakonisht këto gjendje zgjasin rreth tre muaj. Pas kësaj kohe individi me këto çrregullime adaptuese fillon të mësohet për t`iu përshtatur situatave të reja.

ÇRREGULLIMI I ANKTHIT. Formë e sjelljes karakteristike të njeriut, që përçohet me ankth të qëndrueshëm me intensitet të lartë. Kjo formë e çrregullimit të ankthit shfaqet edhe atëherë kur individi bën përpjekje për ta larguar ankthin dhe arrin ta zvogëlojë intensitetin e ndikimit të tij, por shoqërohet edhe me çrregullime në sjelljet e tij. Çrregullimi i ankthit shfaqet edhe në formë të përgjithësuar: te ata individë, kur këta përjetojnë frikë të paarsyeshme, duke mos pasur objekt ngacmues të frikës dhe as situatë ngacmuese të saj. Kjo formë ankthi mund të jetë karakteristike edhe për fëmijët.

ÇRREGULLIMI I ANKTHIT TË NDARJES. Formë e çrregullimit të ankthit, të cilën e ka identifikuar Karen Horni (Karen Horney, 1885 – 1952). Sipas rezultateve të hulumtimit të saj çrregullimi i ankthit të ndarjes ka të bëjë me përjetimin e ankthit në një situatë të caktuar, përkatësisht kur individi ndahet për një kohë të gjatë nga familja, fëmijët, njerëzit e afërt etj. Por, jo çdo ndarje nga të tjerët përcillet me çrregullim të ankthit. Me këtë lloj çrregullimi përcillet vetëm ndarja nga njerëzit e afërt dhe të lidhur në mënyrë jetësore me ta.

ÇRREGULLIMI I DËSHIRËS SEKSUALE. Mungesë dhe zvogëlim i dukshëm dhe relativisht i qëndrueshëm i interesit, imagjinatës së një individi për një individ të një gjinie tjetër, përjetim neveritës ndaj individit të gjinisë tjetër dhe përgjithësisht neveri e largim prej aktivitetit seksual në lidhje me këtë individ. Te këta individë të gjinisë femërore a mashkullore mungon edhe nxitja seksuale, madje individi femër i këtij grupi nuk arrin ta përjetojë orgazmën. Numri i individëve me çrregullim të dëshirës seksuale nuk është i vogël; këta individë shfaqin sjellje jonormale ndaj të tjerëve, sidomos ndaj individëve të gjinisë tjetër dhe kanë shqetësime dhe vështirësi në jetën dhe në veprimtarinë e përditshme të tyre. Çregullimi i dëshirës seksuale ka të bëjë me hipoaktivitetin e gjëndrës seksuale.

ÇRREGULLIMI I IDENTITETIT DISOCIATIV. Dukuri e rrallë, e cila shfaqet me përjetim të dy identiteteve te një individ i caktuar. Në raste të tilla, secili identitet i personalitetit të atij individi ka kujtimet, mendimet, qëndrimet e format e sjelljeve të tij të veçanta. Sjellja e përgjithshme e individëve me dy identitete varet nga situata në të cilën ndodhet ai individ, i cili e ndryshon sjelljen në varësi nga kërkesa e situatës ku ai ndodhet.

ÇRREGULLIMI I IDENTITETIT GJINOR. Mospërputhja e mendimit dhe e qëndrimit të një individi me gjininë, përkatësinë biologjike dhe kundërshtimi i gjinisë biologjike të tij nga dëshira për të qenë i gjinisë së kundërt.

Ky mendim e qëndrim shoqërohet me një stil sjelljeje dhe veshjeje të asaj gjinie, për të cilën ai mendon se është gjini e duhur për të. Ky çrregullim karakterizon fëmijët, por edhe të rriturit.

ÇRREGULLIMI I KARAKTERIT. Çrregullimi i karakterit emërton sjelljet e qëndrueshme problematike të një personi, që kanë të bëjnë me përshtatjen e vështirë të tij kërkesave dhe nevojave të mjedisit duke penguar në këtë mënyrë edhe zhvillimin harmonik të personalitetit të tij.

ÇRREGULLIMI I MENDIMIT. Zhvillim i mendimit për një çështje duke humbur drejtimin e mendimit kah çështja që kërkon zgjidhje. Një çrregullim i tillë i mendimit zakonisht është i lidhur me një gjendje jonormale psikike dhe mund të shërbejë si simptomë për gjendje të tilla te një individ. Çrregullimi i mendimit shfaqet në dy forma kryesore: 1) Çrregullim i formave të të menduarit dhe 2) Çrregullim i përmbajtjeve të procesit mendor. Te forma e parë dallohen këto simptoma kryesore: inkoherenca e ideve, fluturimi i ideve, detalizimi patologjik etj. Te çrregullimi i përmbajtjes së mendimit dallohen këto simptoma kryesore: obsesioni, varfëria e ideve të përmbajtjes së mendimit për çështjen e caktuar, mbisundimi i idesë vlerësuese dhe paaftësia e shkëputjes së individit nga ajo ide etj.

ÇRREGULLIMI I PERSONALITETIT. Çrregullim sjelljesh dhe procesesh të ndërlidhura, që shmangen nga integriteti, identiteti dhe uniteti i sjelljeve normale të njeriut. Këtu hyjnë një grup i madh çrregullimesh psikike të personalitetit, që kanë karakter të qëndrueshëm dhe shfaqen në trajta gati të pandryshueshme. Çrregullimet e personalitetit shfaqen konkretisht në sjelljet problematike të njeriut ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj detyrimeve në punë etj. Njihen shumë forma të çrregullimit të personalitetit. Klasifikimi i drejtë i tyre është pothuajse i vështirë, sepse vijat ndarëse të njërës formë nga forma tjetër janë të paqarta. Diagnostikimi i tyre zakonisht kryhet sipas manualit psikiatrik DSM – 4 dhe atij ICD – 10. Njihen dy tipe të personalitetit me modele sjelljesh: 1) Tipi i personalitetit me modele sjelljesh të çrregullimit kognitiv dhe 2) Tipi i personalitetit me modele sjelljesh jonormale emocionale. Tipit të parë i përket modeli i sjelljeve të personalitetit skizofrenik me këto karakteristika kryesore: perceptime joreale, përjetime fantastike, mungesë gatishmërie për të komunikuar me të tjerët, për të ndjerë dashuri ndaj të tjerëve dhe për të qenë I dashur me të tjerët. Tipit të çrregullimit të personalitetit me modele sjelljesh emocionale jonormale i përket tipi i personalitetit paranojak, që ka këto karakteristika kryesore: dyshim të përhershëm në sjelljet e të tjerëve dhe mosbesim ndaj të tjerëve. Në këtë grup hynë edhe tipi i sjelljeve narcizoide, i cili ka këtë karakteristikë kryesore: ndjenjën e përhershme mbi madhështinë e personalitetit të tij dhe kërkimin e vazhdueshëm të admirimit të të tjerëve ndaj tij etj.

Burimet:

Jean Menechal: *"Hyrje në psikopatologji*", Botim i Shoqatës së Psikologëve *"*Kthim në vetvete*"*.

Nazim Shtino & Anita Pilika: *"Personaliteti dhe çrregullimet e tij",* Tiranë, 2001.

Nazim Shtino: *"Psikiatria Ligjore",* Botimet Toena, Tiranë, 2003, fq. 106 – 123.

Fatbardha Osmanaga: *"Psikologjia abnormale",* Shkodër, 2005, fq. 157 – 182.
Gregory P. Korgeski: *"Fobitë: një udhërrëfyes i plotë",* "Dituria", 2011.
Sadik H. Lala: *"Psikopatologjia klinike",* Albtipografia, Tiranë, 2013, fq. 255 – 308.

ÇRREGULLIMI I PERSONALITETIT NARCIZOID. Çrregullimi i personalitetit është që emërton sjelljet e atij personaliteti, i cili thekson vazhdimisht rëndësinë e madhe të personalitetit, si edhe të sjelljeve të tij për t`i tërhequr vëmendjen të tjerëve dhe për të entuziazmuar të tjerët me veprime karakteristike, duke fantazuar se ai është më i pasuri, më i nderuari dhe me dashuri ideale, si edhe duke reaguar rrallë në vërejtjet dhe kritikat e të tjerëve ndaj tij. Në forma të rënda personaliteti narcizoid sillet duke mos përjetuar fare ndjenjën e fajit, sepse nuk "i njeh" të tjerët, që për të nuk kanë rëndësi sa ka vetë ai.

ÇRREGULLIMI I VËMENDJES. Formë e çrregullimit të drejtimit, sidomos e përqendrimit të vëmendjes në një objekt ose cilësi të tij, në një proces, dukuri etj. Zakonisht është dukuri e sjelljeve të fëmijëve, të cilët janë hiperaktivë. Te këta fëmijë çrregullimi i procesit të vëmendjes shfaqet në shpërthime inatesh, në rezultate të dobëta në mësime etj.

ÇRREGULLIMI KONVERSIV. Shndërrimi i konfliktit psikik në formë të çrregullimit organik e fiziologjik. I tillë është konflikti psikik i frikës ndaj udhëtimit me anije dhe shndërrimi i këtij konflikti në dhembje të trupit, në marramendje, në pengesa frymëmarrjeje etj. Ky shndërrim zakonisht bëhet për t`i sjellë individit të caktuar ndonjë fitim, si: shkallë më të lartë të autoritetit, mundësinë e mungesës nga puna, largimin prej veprimeve të pakëndshme etj. Këtë mekanizëm Zigmund Frojdi (Sigmund Freud, 1856 – 1939) e ka identifikuar gjatë procesit të shërimit të histerisë, kur ka dalluar se bazën e çrregullimeve histerike e përbëjnë simptomat simbolikë të fshehur në pavetëdijen e njeriut.

ÇRREGULLIMI KOORDINUES ZHVILLIMOR. Çrregullim i lëvizjeve, i lidhjeve ndërmjet tyre dhe i koordinimit të lëvizjeve. Tërësitë lëvizore copëtohen në lëvizje të veçanta shkathtësie, shprehjesh e veprimesh. Ky është çrregullim serioz me pasoja shumë të rënda për zhvillimin normal të mëtejshëm të jetës psikike.

ÇRREGULLIMI NEUROTIK. Sipas teorisë së personalitetit të Karen D. Hornei (Karen D. Horney, 1883 – 1952) është mendim, ndjenjë, sjellje e përçuar me neurozë. Shih – ***NEUROZA.***

ÇRREGULLIMI OBSESIV–KOMPULSIV. Model i sjelljeve të qëndrueshme të atyre individëve, të cilët karakterizohen me shqetësime të vazhdueshme e të tepruara për aftësinë dhe gatishmërinë e zbatimit të rregullave, me synimin e përhershëm drejt përsosmërisë e përpikërisë, me këmbënguljen dhe kokëfortësinë në realizimin e synimeve dhe të dëshirave etj.

ÇRREGULLIMI ORGANIK. Çrregullim i funksionit të një organi i shkaktuar nga një e metë strukturore ose funksionale e tij.

ÇRREGULLIMI ORGANIK I TRURIT. Dëmtime në strukturën e sistemit nervor dhe në lidhjet ndërmjet tyre. Dëmtime të tilla janë të

lidhura me një varg çrregullimesh psikike (çrregullime ndijimesh, lëvizjesh, perceptimesh, të proceseve të kujtesës etj.) Ndër shkaqet më të përhapura të këtij çrregullimi janë aksidentet e ndryshme, disa sëmundje të zhvilluara pas lindjes ose ndonjë sëmundje e lindur etj.

ÇRREGULLIMI ORGANIK MENDOR. Ndryshim negativ, i çregullt i një procesi, funksioni e sjelljeje mentale, që shkaktohet nga një ose disa të meta organike, sidomos të atyre që janë të lidhura drejtpërdrejt me sistemin nervor. E tillë mund të jetë demenca parësore degjenerative.

ÇRREGULLIMI PASTRAUMATIK. Ndikimi i fuqishëm i përjetimit të një gjendjeje traumatike dhe stresore në proceset psikike dhe në sjelljet e mëvonshme të individit. Ky lloj çrregullimi ka të bëjë me rikujtimin e asaj ngjarjeje traumatike stresante, me pezmatimin e njeriut ndaj asaj ngjarjeje dhe me bartjen e këtij përjetimi në sjelljet e pastraumës. Por, përjetimi i traumës dhe i stresit nuk janë faktorët e vetëm që shkaktojnë çrregullim pastraumatik. Shpjegime për këtë tip çrregullimi kanë dhënë Z. Frojdi, Horovic (Horovitz, 1976) dhe Kristal (Krystal, 1988). Natyra psikologjike e çrregullimeve pastraumatike ka të bëjë me përjetimin e frikës së ngjarjeve të ngjashme, të cilat kanë mundësi që të ndodhin në të ardhmen dhe që, për të cilat ai përjeton shqetësime të pandërprera duke iu larguar përfytyrimeve, mendimeve dhe sjelljeve që kanë ngjashmëri me situatën e përjetuar traumatike. Sa më e vrazhdë të jetë trauma e stresi, aq më i madh është supozimi se individi do ta përjetojë çrregullimin pastraumatik. Në psikiatri dhe në psikologjinë klinike çrregullimi pastraumatik diagnostikohet në bazë të MKB 10 – 1992 dhe DSM 4 – 1994. Nga historia e çrregullimit pastraumatik mësojmë se këtë çrregullim e kanë emërtuar sindroma Dakosta dhe i pari që e ka identifikuar ka qenë hulumtuesi Jakob Mendes. Ky e ka përshkruar këtë sindromë hollësisht nga përvoja e tij mjekësore me ushtarët amerikan që kanë marrë pjesë në luftën qytetare.

ÇRREGULLIMI PSIKOMOTOR. Humbje e pjesshme ose e plotë e lidhjes së ideve, përfytyrimeve etj. me lëvizjet e duhura, si edhe humbje e përvojës për koordinim të lëvizjeve dhe zhvillim normal të shprehive. Për shkak të këtyre çrregullimeve individi nuk arrin të kryejë me sukses dhe si duhet aktivitetet e tij.

ÇRREGULLIMI PSIKOSOMATIK. Dukuri e çrregullimit të funksionit të organeve trupore ose të një organi nga problemet psikologjike e jo nga dëmtimet organike. Ndjenjat intensive, afatgjata, ndryshimi i intensitetit e kohëzgjatjes së tyre etj., mund të shkaktojnë efekte negative në funksionimin e organeve ose të një organi të organizmit të njeriut. Si të tilla mund të jenë: ulcera në lukth, ulcera në zorrën dymbëdhjetëgishtore, e shkaktuar nga ankthi kronik, çrregullimi i presionit të gjakut, menstruacionet e parregullta etj.

ÇRREGULLIMI SOMATIK. Çrregullim trupor që përjetohet në forma të ndryshme, ku dallohen: përjetimi i dhembjeve relativisht të qëndrueshme, megjithëse rezultatet klinike nuk tregojnë për ndonjë çrregullim anatomik dhe fiziologjik; hipokondria

apo çrregullimi dismorfik i trupit etj. (preokupim dhe frikë e tepruar nga mundësia e vuajtjes prej një sëmundje të rëndë). Shih – ***HIPOKONDRIA***.

Burimet:

Kurt Schneider: *"Die Psychopatischen Persönlichkeiten"* – (*"Personaliteti psikopat"*), Wien: Deuticke, 1950.

DSM 4, "*Diagnostic and statistical manual of mental disorders"* – (*"Doracaku diagnostik dhe statistik i çrregullimeve mendore"*), APA, 1994.

Nazim Shtino, Anita Pilika: "*Personaliteti dhe çrregullimet e tij*", Tiranë, 2001.

John Bancroft: *"Human Sexuality and its Problems"* – (*"Seksualiteti njerëzor dhe problemat e tij"*), Churchill Livingstone, 1989.

Nazim Shtino: *"Psikiatria ligjore"*, Botimet Toena, Tiranë, 2003.

Fatbardha Osmanaga: "*Psikologjia anormale*", Shkodër 2005.

Sadik H. Lala: *"Psikopatologjia"*, Tiranë, 2013.

ÇRREGULLIMI TRUNOR KRONIK. Çrregullim sjelljesh të njeriut dhe çrregullim i proceseve psikike që shkaktohen nga dëmtimet e trurit dhe të pjesëve të tij. Dëmtimet e këtilla më të shpeshta janë: psikoza senile ose e pleqërisë dhe psikoza alkoolike.

ÇRREGULLIMI ZHVILLIMOR. Klasë e posaçme e çrregullimeve serioze psikike të moshës fëmijërore, që zhvillohen edhe më vonë. Në këtë klasë çrregullimesh hyjnë: çrregullimet e funksionimit të strukturave njohëse të realitetit (perceptimi, kujtesa, mendimi), të jetës emocionale, të zhvillimit psikomotor, të të folurit dhe të vëmendjes.

ÇUDI, - A. f. Gjendje psikike e individit, që karakterizohet me përjetim emocional të zotërimit psikik ose të humorit, shpesh të pavetëdijshëm, e shkaktuar nga një ngjarje e befasishme dhe e pa-pritur për të cilën nuk ka përgatitje të duhur dhe nuk përshtatet me dijet e tij. Një gjendje e tillë haset më tepër te disa individë, të cilët gjenden ende në fazën e papjekurisë emocionale, sidomos te ata histerikë.

D

D 1 Shmangie e një vlere statistikore nga e mesmja aritmetike në statistikën e psikologjisë;

D 2 Në statistikën e psikologjisë tregon dallimin ndërmjet dy të mesmeve aritmetike, rezultat i cili pjesëtohet me shmangien standard dhe produkti i përftuar nga ky operacion statistikor tregon madhësinë e efektit të një faktori;

D 3 Në statistikën e psikologjisë paraqet shkallën e dallimit të dy niveleve të arritjeve nga ana e një individi në dy teste të ndryshme; masa e shpërndarjes së arritjeve që janë dhënë si dallim ndërmjet dhjetë e nëntëdhjetë percentilesh. Shih – ***PERCENTILI.***

d` masa e ndjeshmërisë së një subjekti ndaj një ngacmuesi ose stimuluesi të caktuar. Kjo masë mund të llogaritet për secilin subjekt që i përket grupit eksperimental në hetimin (dedektimin) e një sinjali**.**

DAHAU (DACHAU). Kamp përqendrimi gjerman në Luftën e Dytë Botërore, ku janë kryer eksperimente mjekësore dhe psikologjike me të zënit rob, para të gjithëve me hebrenjtë. U ngrit më 1933 dhe është konsideruar qendër mësimore e hulumtuese. Ky kamp ka pasur edhe 150 degë në Gjermaninë Jugore.

DAKTILIM, - I. m. I ardhur nga greqishtja *δάχτυλο* "gisht". Sistem shenjash i gishtave të duarve me të cilat komunikojnë shurdhmemecët. Shkronjat e alfabetit të gjuhës shqipe përcaktohen në radhë të parë, sipas pozicionit të gishtërinjve të dorës së djathtë. Duke bërë lidhjen ndërmjet shenjave krijohen fjalët dhe fjalitë, me të cilat i kumtohet tjetrit dëshira, kërkesa, mendimi, urdhri etj.

DAKTILOGJI, - A. f. Gjuha e komunikimit me anë të shenjave të gishtërinjve të duarve dhe studimi i saj.

DALTONIZ/ËM, - MI. m. Formë e verbimit të individit, që shfaqet në pamundësinë e dallimit të ngjyrës së kuqe dhe të gjelbër nga ana e tij. Daltonizmi është dukuri e të parit jonormal të të dy ngjyrave kromatike – të ngjyrës së kuqe dhe asaj të gjelbër, nga e cila vuajnë rreth 4 – 5 % e meshkujve, kurse te femrat kjo është dukuri më e rrallë, që sillet rreth 0,4 %. Këtë dukuri e ka përshkruar i pari kimisti anglez Xhon

Dalton (John Dalton). Daltoni ka vuajtur edhe vetë nga ky lloj verbimi.

DALLIMET INDIVIDUALE. Qasje studimore të atillë dukurive psikologjike të personalitetit dhe veçorive morfologjike, fiziologjike e psikologjike, që kanë të bëjnë me ato tipare, në mbështetje të të cilave bartësi i këtyre tipareve, përkatësisht personaliteti i caktuar dallohet nga të gjithë të tjerët.

DARVIN Çarls (**Charles DARWIN**). Natyralist anglez. Lindi në Shrewbury të Britanisë së Madhe më 12.02.1809 dhe vdiq në Down (Kent) më 19.04.1882. Me pikëpamjet e tij për zhvillimin e llojeve të qenieve të gjalla nga format më të thjeshta të jetës deri te ato më të ndërlikuarat ushtroi ndikim edhe në zhvillimin e pikëpamjeve për jetën shpirtërore dhe për zhvillimin e veprimtarive dhe të sjelljeve te njeriu dhe te qeniet e tjera. Theksoi rëndësinë e faktorit "*Struggle for live*" – "*Të luftës për ekzistencë*", përkatësisht të zgjedhjes së më të fuqishmit në këtë luftë dhe të zhvillimit e përsosjes organike dhe të aktivitetit të kryefitimtarit në konkurrencën për jetë a vdekje. U mor edhe me gjurmimin e jetës emocionale. Veprat kryesore të Çarls Darvinit janë: "*On the origin of Species by Means of Natyral Selection*" – (*"Origjina e llojeve me vështrim mbi përzgjedhjen natyrore"*, 1839); *"The variation of Animals and Plants under Domestication"* – (*"Ndryshueshmëria e kafshëve dhe e bimëve nën kultivim"*, 1866); "*The Expression of the Emotion*" – (*"Shprehja e emocioneve",* 1872) etj.

DARVINIZ/ËM, - MI. m. Drejtim studimor i shkencave biologjike që ka të bëjë me teorinë e evolucionit, e cila ka pranuar dhe zbaton qëndrimet, pikëpamjen dhe botëkuptimin për zhvillimin e qenieve të gjalla, të cilin e ka formuluar shkencëtari anglez Çarls Darvin (Charles Darwin, 1809 – 1882). Sipas kësaj teorie përzgjedhja ose seleksionimi natyror është parimi kryesor në bazë të të cilit variacionet e shumta të llojeve të ndryshme të qenieve të gjalla dhe të pjesëtarëve të këtyre llojeve shpjegohen me aftësinë e tyre për të jetuar. Dallimet ndërmjet tyre nga pikëpamja e aftësive përshtatëse ndaj kërkesave të mjedisit të tyre në luftën e përhershme për të jetuar barten prej një brezi në tjetrin dhe kështu sigurohet ekzistenca e pjesëtarëve të një lloji të caktuar të qenieve të gjalla. Seleksionimi i llojeve dhe i anëtarëve të një lloji përfshin edhe përzgjedhjen e sjelljeve më të përshtatshme për mbijetesë të llojit. Në këtë pikëpamje vepra e tij e njohur "Origjina e llojeve" dhe botimi i Darvinit "Shprehja e emocioneve" kanë ndikuar edhe në zhvillimin e psikologjisë dhe të mendimit psikologjik në përgjithësi.

DASHAMIRËSI, - A. f. Ndjenjë e ndërlikuar ku "shkrihen" në një cilësi ndjenjash kënaqësia, miqësia, mirëdashja, gëzimi e dashuria ndaj tjetrit. Objekt i kësaj ndjenje mund të jenë njerëzit e miqtë më të afërm, por edhe grupi i njerëzve, farefisnia, vendlindja etj. Dashamirësia ka një përmasë të sentimentit. Shih – ***SENTIMENTI.***

DASHJ/E, - A. f. Në psikologjinë e motivacionit e ka burimin nga analiza e aktit të vullnetit në psikologjinë strukturaliste. Dashja është fazë e posaçme e procesit të veprimtarisë së vullnetshme. Këtë fazë e karakterizon qartësia e qëllimit ose e cakut, e rrugëve dhe e mjeteve me të cilat realizohet dëshira a synimi i një individi.

DASHURI, - A. f. Gjendje emocionale e veçantë, që karakterizohet para së gjithash nga ndjenja e kënaqësisë së një individi ndaj një objekti, dukurie, qenie etj., e shoqëruar me përjetim të atij individi. Objekti, dukuria dhe qenia e dashurisë konsiderohet vlerë e jashtëzakonshme për të dhe për këto shkaqe individi i dashuruar me shtëpinë, me lulet, macen, prindërit, bashkëshorten etj. e konsideron objektin e dashurisë pjesë përbërëse të jetës psikike dhe intime të tij. Mbi këtë bazë zhvillohet një raport i qëndrueshëm pozitiv ndaj objektit të dashurisë. Individi nga shumësia e objekteve dhe e personave që e rrethojnë nën ndikimin e dashurisë përzgjedh vetëm ato objekte, të cilat e zhvillojnë pjesën intime të botës së brendshme të tij. Bota e tillë e individit zhvillohet nga internalizimi (shih – ***INTERNALIZIMI***) i objektit të dashurisë, që ngrihet mbi mekanizmin psikik të lidhjes emocionale të një individi me objektet e përzgjedhura të botës së jashtme. Dashuria ka përbërësen psikike dhe trupore. Këto dy përbërëse janë të lidhura ngushtë ndërmjet tyre dhe sajojnë një tërësi të pandashme. Ka disa lloje dashurish. Në psikologjinë bashkëkohore përmenden dashuria e prindërve ndaj fëmijëve, e fëmijëve ndaj prindërve, e motrës ndaj vëllait dhe ajo e vëllait ndaj motrës, ndaj vetvetes, ndaj familjes, farefisnisë, ndaj dy individëve të gjinive të kundërta (dashuria seksuale dhe dashuria platoniane).

DASHURIA FALUSORE. Dashuri ndaj organit seksual te meshkujt. Dashuria falusore shfaqet ndaj organit seksual mashkullor, penisit, kurse te femrat ndaj organit seksual femëror, klitorisit.

DASHURIA NË PSIKANALIZË. Zigmund Frojd dashurinë e konsideron pasion të libidos, (shih – ***PASIO; LIBIDO***) të drejtuar gjithnjë në plotësimin sa më të madh të ndjenjës së kënaqësisë. Sipas Frojdit dashuria ka gjenezë të posaçme; në fazat e para të rritjes së fëmijës zhvillohet forma e dashurisë së narcizmit parësor (shih – ***NARCIZMI***). Më pas, me zhvillimin dhe me formimin e personalitetit zhvillohet dashuria ndaj objekteve të përzgjedhura që individi orvatet t`i bëjë për vete dhe t`i përbrendësojë. Me pjekurinë e gjëndrave seksuale në moshën e pubertetit zhvillohet dashuria e mbështetur në ndjeshmërinë shqisore dhe në kujdesin e posaçëm ndaj objektit të dashurisë. Me bashkimin e këtyre dy përbërësve të dashurisë zhvillohet personaliteti i integruar, unik dhe me veçantitë individuale të tij.

DASHURIA PASIONANTE. Lloj dashurie ndaj një femre ose ndaj një mashkulli, kur këta pushtohen tërësisht nga dashuria, duke përjetuar jo vetëm preokupim të qëndrueshëm, por duke shprehur edhe nevojën për kënaqësi të menjëhershme.

DASHURIA PLATONIKE. Term me kuptim të përafërt me dashurinë romantike. Dashuria platonike është kënaqësi, miqësi, shoqëri e ngushtë ndërmjet të rinjve të gjinive të kundërta pa kryer marrëdhënie seksuale. Kjo dashuri për mendimtarin e madh të Greqisë klasike, filozofin Platon (Platon, 427 – 347 p.e.r.) që ka hyrë në historinë e psikologjisë sepse është marrë me studime të vlefshme për natyrën shpirtërore të njeriut, i ka tejkaluar përmasat trupore dhe i përket spirituales. Është dashuri e përcaktimit të

atij raporti që përjashton erotizmin, që ka të bëjë me ide të pashoqëruar me aktivitet, idealizim i dashurisë. Ky term haset edhe në literaturën psikanalitike dhe emërton mekanizmin mbrojtës të shndërrimit të raportit seksual në raport sublimi, në raport mendor joerotik.

D

DASHURIA REALISTE. Formë dashurie, sipas së cilës të dashuruarit në moshë madhore (të pjekur) shfaqin kënaqësi, besim, respekt ndaj objektit të dashurisë me prani realiste të përbërësve të dashurisë, nga të cilat dallohet sidomos qëndrueshmëria dhe thellësia e përjetimeve të dashurisë ndaj objektit të dashurisë (fëmijëve, shokëve, bashkëshortes/bashkëshortit etj.).

DASHURIA ROMANTIKE. Ëndrra dhe shpresa dashurie ndërmjet të rinjve të moshës së përafërt ose të njëjtë. Në psikologji termi dashuri romantike me këtë kuptim ka ardhur nga mendimtari danez Edgar J. Rubin (Edgar J. Rubin, 1886 – 1951).

dB shkurtesa për decibel. Për decibel përdoret edhe shkurtesa db. Shih – ***DECIBEL.***

DEBILITET, - I. m. I ardhur nga latinishtja *debilitas* "i mangët, sakat, i dobët". Lloj i veçantë i mungesës së aftësive të njeriut, që shfaqet me shkallë të posaçme të zhvillimit të dobësisë intelektuale të tij. Ata që i përkasin kësaj shkalle të dobët të zhvillimit intelektual apo kognitiv kanë koeficient të zhvillimit të inteligjencës që sillet prej 0,70 – 0,50. Këta individë (debilët) kanë mundësi të aftësohen për disa punë të thjeshta dhe me disa forma elementare të sjelljeve me të tjerët gjatë komunikimit me ta. Për këtë aftësim të tyre nevojiten ushtrime sistematike nga pedagogët specialistë.

DECENTRALIZIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja që do të thotë ndarje, largim nga qendra. Në psikologji ka të bëjë me qasjen e zhvillimit kognitiv sipas Zhan Pijazhes (Jean Pijaget, 1896 - 1980). Sipas pikëpamjes së Pijazhes decentralizimi emërton kalimin prej një faze të zhvillimit kognitiv në fazën më të lartë të këtij zhvillimi. Kjo ndodh atëherë, kur nga centralizimi i të gjithë jetës psikike (shih – ***EGOCENTRIMI)*** fëmija kalon në një shkallë më të lartë zhvillimi, sepse kupton lidhjen e organizmit dhe të sjelljeve të tij me të tjerët. Decentralizimi karakterizon fazën zhvillimore, kur fëmija mësohet se në sjelljet e tij duhet të marrë në konsideratë edhe sjelljen e të tjerëve, si edhe qëndrimet e pikëpamjet e tyre.

DECEREBRACI, - A. f. Në neurokirurgji, ndërhyrje kirurgjikale në trurin e madh, përkatësisht mënjanimi me prerje në trungun e trurit. Organizëm i decerebruar është ai organizëm, të cilit i është mënjanuar truri i madh dhe dallohet nga të tjerët nga sjellje të çuditshme.

DECIBEL, - I. m. Njësi fizike e matjes së intensitetit të zërit. Decibeli është e dhjeta pjesë e belit**.** Decibeli llogaritet në bazë të shkallës së logaritmit, kur merret për bazë standarde pragu absolut i ndijimit të zërit, ose pragu më i ulët i ndijimit të zërit. Ky prag shkaktohet nga 1000 Hz dhe është i barabartë me një bel. Biseda ndërmjet dy ose më shumë individëve është një milion herë më e lartë se pragu absolut. Zakonisht zhurma e intensitetit shumë të lartë mund të ketë

njëqindenjëzet decibel dhe zakonisht shkakton dhembje.

DECIL, - I. m. Vjen nga statistika, por përdoret edhe në hulumtimet psikologjike. Në statistikën e psikologjisë nënkupton numrin e përgjithshëm të arritjeve në një test nga ana e dhjetë subjekteve të testuar. Decili përfaqësohet vetëm nga një pikë e arritjeve nga të nëntë pikat e shkallëzuara, pikë kjo që ndan shpërndarjen e rezultateve të ranxhuara nga pikat e tjera të arritjeve, ku njëra pikë nga tjetra dallohet me një largësi ose interval prej dhjetë arritjeve. Prandaj, intervali decil përfshin një të dhjetën e rasteve të subjekteve të testuar.

DETEKTORI I GËNJESHTRAVE. Aparat i krijuar për zbulimin e gënjeshtrave të një të dyshuari për veprime antiligjore. Aparati i gënjeshtrave në të vërtetë mat ndryshimet fiziologjike, si: ritmin e frymëmarrjes, të rrahjes së zemrës, të reagimit psikogalvan, të presionit të gjakut etj. Këto janë ndryshime fiziologjike që shoqërojnë një emocion të shkaktuar nga shqetësimi dhe frika, i cili intensifikohet me rastin e dyshimit të një akti kriminal të një individi. Zbatohet më tepër në kriminalistikë. Detektori i gënjeshtrave quhet poligraf (shih – ***POLIGRAFI*****).** Të dhënat e përftuara nga poligrafi nuk janë argumente të sakta për zbulimin e gënjeshtrës, prandaj nuk vlejnë në aktin e marrjes së vendimit për gënjeshtrën ose jogënjeshtrën e të akuzuarit. Krahas poligrafit a detektorit të gënjeshtrave u krijuan edhe aparate të ngjashme për matjen e atyre cilësive të padukshme që përcjellin ndryshimet e brendshme fiziologjike e psikologjike të disa proceseve psikike, si fillimi i saktë i përjetimit të një ndijimi, perceptimi, kufiri i saktë ndarës i kohës së mbarimit të një procesi dhe i fillimit të një procesi tjetër etj.

DEDJA Bedri. Psikolog dhe pedagog. Lindi në Korçë më 1930 dhe vdiq në Tiranë më 2004. Kreu studimet në Universitetin "Lenjin" të Moskës në degën pedagogji–psikologji, duke ndjekur edhe studimet në të njëjtin universitet për letërsi për fëmijë. Anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë që nga themelimi i saj, si edhe sekretar shkencor i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë nga viti 1973–1975. Kryetar i Shoqatës Mbarëshqiptare të Psikologëve dhe anëtar i Asamblesë së Lidhjes Botërore të shkencave psikologjike. Autor dhe bashkautor i disa teksteve shkollore të psikologjisë për shkolla të mesme dhe të larta. U mor edhe me gjurmime psikologjike në Elbasan dhe në Shkodër. Veprimtaria krijuese e tij përfshinte letërsinë për fëmijë, pedagogjinë e historinë e arsimit shqip, si edhe psikologjinë. Në përmbajtjen e teksteve të psikologjisë për nevojat e shkollimit të nxënësve dhe të studentëve të gjysmës së dytë të shekullit të njëzet, vërehet ndikimi i psikologjisë së shkollës ruse, sidomos ndikimi i shkollës ruse të fiziologjisë së Ivan Pavllovit. Kjo mbështetje është e pranishme përgjithësisht te kolegët që kanë kryer studimet pedagogji–psikologji në ish Bashkimin Sovjetik dhe pikëpamjet e shkollës ruse karakterizojnë psikologjinë dhe zhvillimin e saj në Shqipërinë e viteve 1945–2000. Ishte drejtues dhe organizues i kursit të studimeve pasuniversitare për psikologji, ku të interesuarit që kishin përfunduar studimet në gjuhë shqipe e letërsi,

gjeografi, histori, matematikë etj., pas përfundimit të këtij kursi, vazhduan studimet pasuniversitare për psikologji në vende të ndryshme, sidomos në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Bedri Dedja ka hartuar këto vepra kryesore nga psikologjia: *"Drejt enigmave të psikikës së njeriut",* 1989; *"Psikologjia sociale",* 1990; *"Sekreti i talentit",* 1998. Ka botuar një varg artikujsh dhe trajtesa në revista brenda e jashtë vendit. Dallohet referati i lexuar në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe me titull: *"Rreth përshpejtimit psikik dhe ndikimit të tij në mësimin e gjuhës letrare".*

DEDUKSION, - I. m. Proces mendor i arritjes në një përfundim, sipas të cilit operacioni logjik lëviz nga dijenia e përgjithshme në atë të veçantën. Këtë e siguron lidhja e gjykimit të përgjithshëm me gjykimin e veçantë dhe nxjerrja e gjykimit konkret. Me këtë rast është e domosdoshme konsistenca logjike, sepse nuk kërkohet verifikim tjetër i gjykimeve.

DEFEKT, - I. m. Funksion dhe dukuri e zhvilluar me të meta, strukturë e papërfunduar e zhvillimit të një organi dhe rrjedhimisht funksion jo i rregullt i tij. Sipas këtij kuptimi dallojmë defektin ndijimor, motor, intelektual, individual etj. Defekti ndijimor është çrregullimi i procesit të bartjes së impulsive nervore dhe i pranimit të tyre në qendrat përkatëse të trurit të madh. Defekti motor është çrregullim i lëvizjeve dhe i koordinimit të tyre. Defekti intelektual është çrregullimi i funksionimit të proceseve kognitive etj. Termi defekt i takon zhvillimeve të mëparshme dhe sot përdoret gjithnjë e më pak. Në vend të këtij përdoret zhvillim i kufizuar.

DEFEKTET PAMORE. Çrregullime të thyerjes së rrezeve të dritës në pjesët e syrit të njeriut, para se këto rreze të arrijnë në rrjetëzën ose retinën e syrit. Ky çrregullim shkakton disa të meta në të shikuarit: Shih – ***ASTIGMATIZMI; MIOPIA.***

DEFEKTI SHOQËROR. Në psikanalizën sociale të Erik Fromit (Erich Fromm, 1900 – 1980) emërton konceptin e zhvillimit të çrregulluar e të penguar të njeriut, i cili me synimet e zhvillimit të lirisë njerëzore ngec në procesin e arritjes së kësaj lirie. Këta janë kryesisht ata individë, të cilët kanë dijeni të pamjaftueshme për unin e tyre.

DEFEKTOLOGJI, - A. f. Shkenca që merret me studimin e të metave organike e psikike te ata individë që kanë defekte ose deficit në strukturën dhe në funksionimin e proceseve fiziologjike e psikofiziologjike. Pasojat e këtyre të metave janë të ndryshme, por mbisundojnë ato që kanë të bëjnë me vështirësi dhe pengesa në përshtatjen e individëve me këto të meta, me kërkesat dhe raportet gjithnjë në ndryshim të mjedisit të ngushtë dhe të gjerë.

DEFICIT, - I. m. Mungesa e një elementi në një tërësi të caktuar. Gjendja e çrregullt nga mungesa e një ose e disa përbërësve. Ndërsa te defekti kemi të bëjmë me gabim të funksionimit ose me çrregullim të lidhjes së strukturave të një tërësie, te deficiti kemi të bëjmë me funksion të çrregullt që shkaktohet nga mungesa e një përbërësi të asaj tërësie. Deficiti i vëmendjes është mungesa e përqendrimit të vëmendjes në njohjen e një përmbajtjeje të re.

DEFINICION, - I. Shih – ***PËRKUFIZIMI.***

DEFLORIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *flos viginitatis* "lule e virgjërisë". Humbja e virgjërisë së një të reje pas kontaktit të parë seksual. Ky çast shoqërohet me ngarkesa të fuqishme emocionale, sidomos me frikë të madhe. Termi deflorim u përdor për here të parë në krijimtarinë poetike dhe kjo i atribuohet poetit Katula.

DEFORMACION, - I. m. I ardhur nga latinishtja që nënkupton ndryshimin e keq të formës së një trupi. Në psikologji emërton konceptin e shndërrimit të keq, jo të natyrshëm të formës së një organi të trupit të njeriut dhe rrjedhimisht ndijimin jonormal dhe të çuditshëm që shkaktohet nga deformimi i këtij organi.

DEFORMIMI PROFESIONAL. Shprehje e përgjithshme e asaj dukurie, e cila ka të bëjë me ndikimin që ushtron profesioni dhe autoriteti i tij në përmbajtjen fjalësore të diskutimeve që nuk kanë të bëjnë me atë profesion, por diskutuesi nuk arrin t`iu ikë atyre shprehjeve profesionale. Agronomi, arkitekti, krijuesi letrar, mjeku etj., që kanë arritur shkallë të lartë në hierarkinë profesionale, i bartin shprehjet autoritare të tyre edhe në qarqe diskutuesish të profesioneve të tjera.

DEGJENERIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja "zvetënim, rrënim". Në kuptimin e përgjithshëm emërton konceptin e rrënimit progresiv të një organi, të organizmit, të një institucioni a strukture sociale. Në shqip me këtë term emërtohet koncepti i degjenerimit të tipareve morale. Në psikologji dhe në psikiatri nënkupton një proces patologjik të indit nervor me pasoja të rënda psikike, që mund të shkaktohet kryesisht nga dy faktorë kryesorë: nga lëndimi i sistemit nervor dhe nga mungesa e elementeve biokimike të domosdoshëm për zhvillimin e qelizave dhe të indeve nervore. Haset në dy forma: Degjenerim anterograd dhe degjenerim retrograd. Degjenerimi anterograd ka të bëjë me ndarjen e aksonit nga trupi i qelizës, ose me shkatërrimin e qelizës nervore, në të cilën ndodh rrënimi i shpejtë i pjesëve distale të aksonit. Degjenerimi retrograd shfaqet në ato raste kur aksoni ndahet në një largësi të caktuar nga qeliza nervore, pjesa e qelizës pranë aksonit gjithashtu shkatërrohet, por më ngadalë, ngaqë trupi i qelizës është ende në gjendje të furnizohet me lëndë ushqyese.

DEHJ/E, - A. f. Gjendje e posaçme psikike e atij individi që konsumon sasi të caktuara të pijeve alkoolike. Përqendrimi i këtyre sasive të alkoolit në gjak sillet prej 1,5 – 2,5 në një centimetër kub alkool të pastër. Dehja ka katër shkallë intensiteti: 1) dehja e lehtë (një gram alkool në 1000 ml gjak); 2) dehje me errësirë të vetëdijes dhe me humbje të kontrollit mbi lëvizjet vetjake (1,5 – 2,5/1000 ml), 3) dehje e plotë (2,5 – 4/1000 ml) dhe 4) Dehje vdekjeprurëse (mbi 4/1000 ml). Kjo sasi e alkoolit ushtron ndikim negativ në funksionimin e disa organeve në organizëm, nga të cilët dallohet funksionimi i sistemit nervor, i mëlçisë, i veshkave etj. dhe vihet re me humbjen graduale të kontrollit të individit ndaj reagimeve, ndaj sjelljeve, mendimeve, të folurit etj.

DEIKS, - A. f. Kufizim i gjuhës duke fiksuar kohën, vendin dhe përbërësit e raporteve ndërmjet individëve. Kufizime të tilla të gjuhës janë të përqendruara kryesisht në shprehjet: ky/ajo, këtu/atje, para/tash, tash etj. Kjo dukuri qe interesante për studime psikolinguistike, sidomos për mënyrën e të nxënit dhe të përvetësimit të këtyre përbërësve gjuhësorë të gjuhës.

D

DEKART René (**René DESCARTES**). Filozof francez. Lindi në La Hayeu më 31.03.1596 dhe vdiq në Stokholm më 11.02.1650. Sistemi i mendimeve të tij ka ushtruar ndikim të fuqishëm në zhvillimin e mendimit shkencor në përgjithësi, dhe në veçanti në zhvillimin e mendimit shkencor psikologjik. Ka zënë vend të rëndësishëm në veprën "*Historia e psikologjisë*" e Xhejms Baldvinit, botuar më 1913 dhe në veprën "*Historia e psikologjisë eksperimentalë*" e Edvin Boringut botuar më 1929. Lënda (materia, apo trupi) dhe fryma janë dy substanca që zhvillohen paralel njëra me tjetrën. Për lëndën, materien apo trupin është karakteristike shtrirja dhe lëvizja, kurse për frymën është karakteristikë mendimi. Në kuadrin e shpjegimeve të raportit "shpirt"–"trup" René Dekarti u mor me çështjen e përcaktimit të vendqëndrimit të shpirtit në trurin e njeriut. Zbulimet e deriatëhershme anatomike, fiziologjike dhe mjekësore të trurit i dhanë lëndë të rëndësishme për të arritur në konkluzionin se qendra e shpirtit është truri dhe se në te gjendet gjëndra pineale, pra epifiza, dhe ky është vendqëndrimi i shpirtit. Sipas tij "Kjo gjëndër preket në mënyra të ndryshme, është e depërtueshme nga shpirti... vepron në frymën që e rrethon nëpër poret e trurit, që e çliron veprimin e nervave në muskuj. Vetëm njeriu ka frymë, shpirt. Trupi i kafshëve dhe ai i njeriut janë makina. Por, nëse njeriut ia marrim shpirtin, frymën edhe ai bëhet makinë". Analiza e emocioneve është ndër më të rëndësishmet për studimet e psikologjisë filozofike të René Dekartit. Dekarti i ka shpjeguar pasionet me anë të lëvizjeve trunore, të qarkullimit të gjakut dhe të aktivitetit të organeve vitale të organizmit. Sipas tij ekzistojnë gjashtë pasione themelore: 1) Kërshëria (çudia), 2) Dashuria, 3) Urrejtja, 4) Dëshira, 5) Gëzimi dhe 6) Pikëllimi. Llojet e tjera të emocioneve janë produkt i këtyre pasioneve themelore, janë të lidhura me organizmin dhe kryejnë funksionin e ndërmjetësimit të trupit me shpirtin. Morali i njeriut orvatet të vendosë rend në zhvillimin e këtyre pasioneve, por jo gjithmonë e arrin këtë. Në këtë pikëpamje angazhimi i shpirti i përngjet angazhimit të njohjes: ashtu si mendja që orvatet të vendosë rend në strukturat njohëse, ashtu edhe morali orvatet të vendosë rend në zhvillimet emocionale e shpirtërore. Në këtë kontekst emocionet për Dekartin janë si funksione intelektuale. Sistemi konceptual i René Dekartit është sistem dualist. Sipas tij ekziston "*res cigitans*" – *fryma, vetëdija* dhe "*res extensa*" – *lënda, materiali*, të kuptuar si realitet që gjendet jashtë mendimit të njeriut. Në shpjegimin e funksionimit të organizmit ai ka marrë për bazë mekanikën. Për të shpjeguar aftësinë mendore të njeriut ai mendon se organizmi është si makina, së cilës i shtohet fryma. Në vështrimet e mendimeve të tij për dualizmin trup–shpirt hasim edhe karakterin irracional të

emocioneve dhe të motivacionit. Për këtë u fol më vonë në psikanalizën e Zigmund Frojdit. Veprat kryesore të René Dekartit janë: *"Discours de la method pour bien conduire sa rasion et chercher la verite dans les sciences"* – (*"Diskutim mbi metodën e të udhëhequrit të mendjes dhe gjurmimi i së vërtetës në shkenca"*), 1631; "*La géometrie*" – (*"Gjeometria*"), 1637; "*Meditationes de prima philosophia*" – (*"Meditime për filozofinë e parë*"), 1641; *"Les passions de l`ame"* – (*"Pasionet e shpirtit"*), 1649 etj.

DEKATEKS, - I. m. I ardhur nga greqishtja, që në teorinë psikanalitike ka kuptimin e ruajtjes, të retensionit. Dekateksi është dukuria e tërheqjes së kateksit nga një individ, nga një objekt. Në raste të tilla sipas Frojdit energjia e libidos transferohet në një individ apo objekt tjetër ose mund të tërhiqet plotësisht në egon e individit. Dekateksi në rastin e sëmundjes së skizofrenisë përqendrohet në egon e individit dhe prej këndej nuk lëviz, duke shkaktuar te i sëmuri skizofren moskuptimin e botës së jashtme dhe të ndryshimit të saj. Në këto raste për skizofrenin bota e jashtme është e zbrazët, e thatë, e ftohtë.

DEKLARIM, - I. m. Akt i të folurit nga ana e një individi të caktuar, kur ai përdoret për një qëndrim, pikëpamje, botëkuptim etj. dhe këtë e kumton publikisht. Në psikologji termi deklarim përdoret më tepër në trajtat ***DIJENI DEKLARATIVE***; ***KUJTESË DEKLARATIVE*** – shih**.**

DEKODIM, - I. m. Në teorinë e informacionit emërton procesin e deshifrimit të një mesazhi a porosie, sipas kuptimit të paracaktuar të shenjave specifike, shih – ***KODIMI***. Shndërrimi i informatave, i porosive etj. nga një sistem shenjash, i fiksuar dhe i njohur për dhënien e marrjen e atyre informatave, porosive etj. Shenja të tilla mund të jenë impulse elektronike që realizojnë shndërrimin e tyre në gjuhë të kuptueshme për të tjerët. Dekodimi dhe kodimi i kodit të shenjave të caktuara përdoret shumë, sidomos në shërbimet sekrete, por edhe në psikiatri dhe në psikologjinë klinike, kur nuk duhet që pacienti të kuptojë.

DEKOMPENSIM, - I. m. Në psikologjinë e personalitetit nënkupton dukurinë e mos-suksesit të mekanizmit mbrojtës të kompensimit. Dekompensimi shfaqet me efekte negative në rrënimin e përkohshëm ose të përhershëm të qëmdrueshmërisë dhe integritetit të personalitetit. Ndikimi i fuqishëm i dekompensimit shkakton lirimin e ndonjë procesi patogjen të mundshëm dhe me këtë rast dobësohet shumë gjendja psikike e atij personi.

DEKONSTRUKSIONIZ/ËM, - MI. m. Në analizën tekstore të ligjërimit ka të bëjë me dukurinë, sipas së cilës të gjitha shprehjet e koncepteve pozitive nënkuptojnë mënjanimin e koncepteve negative. Në një lidhje të tillë qëndrojnë konceptet dhe termat arsye – pasion, teologjik – laik, feminilitet – maskilitet etj. Dekonstruksionizmi i atribuohet Zhak Deridit. Këmbëngulja e leximit të teksteve me argumente a domethënie negative mund të shpjerë deri në dyshimin e të menduarit racional.

DEKONTEKSTUALIZ/ËM, - MI. m. Interpretim i koncepteve dhe i termave të këtyre koncepteve të një përmbajtjeje të shkruar psikologjike,

sociale, biologjike etj. jashtë kontekstit, ku kanë zënë vend termat e atyre koncepteve.

DEKORTIKACION, - I. m. Gjendja dhe procesi i heqjes kirurgjikale të një pjese të cipës së trurit dhe ndikimi i kësaj heqjeje në sjelljet dhe në proceset psikike të kafshës, e cila i është nënshtruar kësaj ndërhyrjeje kirurgjikale. Natyrisht, hulumtime të tilla i përkasin natyrës eksperimentale, por kërkojnë aftësi të zhvilluara profesionale të kirurgëve. Palëvizshmëria (damlla) e një personi zakonisht shkaktohet nga mosfunksionimi i qendrave lëvizëse të cipës së trurit.

DEKSTERIMETRI I MINESOTOS. Deksterimetri i Minesotos është test që provon shkathtësinë e dorës dhe shkathtësinë e gishtërinjve të duarve. Ky test përbëhet nga një dërrasë katërkëndore me 58 vrima të barabarta dhe me largësi të njëjtë të njërës nga tjetra, e cila ka edhe 58 cepa të drunjtë. Detyra e subjektit është që t`i vendosë sa më shpejt këta cepa nga një rend vrimash në rendin tjetër. Me këtë provohet shkathtësia e duarve të subjektit. Ndërkaq, shkathtësia e gishtërinjve provohet duke kërkuar nga subjekti që cepat t`i kthejë nga njëra anë në tjetrën dhe t`i vendosë në vrimën përkatëse.

DEKSTERIMETRI OKON. Aparat i posaçëm që përdoret për të provuar apo testuar shkathtësinë e gishtërinjve të dorës, shpejtësinë dhe koordinimin e lëvizjeve të gishtërinjve. Deksterimetri O`Kon (O`Conn) është formë specifike e testimit të gishtërinjve (e shkathtësisë, e lëvizjeve dhe e koordinimit të lëvizjeve të gishtërinjve), që përbëhet nga një pllakë metalike me shpime largësish simetrike dhe prej disa shkopinjve metalikë të shkurtër. Subjekti ka detyrë që në shpimet e kësaj pllake të vendosë sa më shumë shkopinj brenda një kohe sa më të shkurtër.

DEKSTRALITET, - I. m. I ardhur nga latinishtja *dexter* "i djathtë". Haset më shpesh në literaturën e psikologjisë në gjuhë të ndryshme, sidomos në atë romane dhe anglosaksone. Nënkupton përdorimin e anës së djathtë të trupit, sidomos të dorës së djathtë në punët e përditshme.

DELIKT, - I. m. I ardhur nga latinishtja *delictum*. Në shkencën juridike e penale do të thotë faj dhe emërton ato sjellje të njeriut, të cilat i sjellin dëm tjetrit dhe shoqërisë. Sjelljet e tilla i përkasin delikteve dhe bartësi i tyre dënohet penalisht.

DELIKUENC/Ë, - A. f. Sjellje kundërvajtëse, dëmtuese, e karakterit penal që dënohet ligjërisht. Të tilla janë të gjitha ato sjellje që shquhen për mosrespektimin e normave morale dhe juridike. Kategori e posaçme e një delikuencës të tillë është delikuenca.

DELIKUENCA JUVENILE. Delikuenca e të miturve, të rinjve, që shfaqet me forma të sjelljeve të rënda antisociale, siç mund të jenë: vjedhja, sulmet ndaj të tjerëve, dhunimet seksuale etj. Delikuenca e të miturve dhe e të rinjve janë forma të rënda të sjelljeve, që i përkasin jo vetëm kriminalogjisë, por edhe psikologjisë e pedagogjisë. Këto forma të sjelljeve dhe bartësit e rinj të tyre ndahen në tri kategori: 1) Sjellje antisociale bartëse nga një tip agresiv i një të riu apo të reje, sjellje pasive e një tipi jo të përshtatshëm

për mjedisin shoqëror dhe sjellje antisociale të tipave të të rinjve të zgjuar. Rezultatet e shumë hulumtimeve kanë treguar faktorët e zhvillimit dhe të formimit të të miturve dhe të të rinjve. Ndër sjelljet delikuente dallohet veçanërisht roli i edukatës familjare në zhvillimin e personalitetit.

DELIR, - I. m. Gjendje psikike e çorganizuar e shoqëruar me kllapi, errësim të vetëdijes, me dukuri iluzive e alucinative dhe me mundësi të kufizuara të përqendrimit të vëmendjes në objektin e bisedës. Rezultatet e shumë hulumtimeve kanë treguar se deliri fillon me ritëm të shpejtë dhe karakterizohet me kohëzgjatjeje të shkurtra, të cilat ndryshojnë pas disa muajsh. Deliri shkaktohet nga dëmtimi i trurit, helmimi, temperatura e lartë trupore etj. Shfaqet në disa forma, nga të cilat më të njohurat janë: deliri i molisjes, deliri i përndjekjes dhe deliri tremens.

DELIRI ALKOOLIK. Çrregullim shpirtëror që manifestohet me ngushtim të madh të kontrollit të vetëdijes së jetës dhe veprimtarisë së individit, i cili për një kohë të gjatë ka marrë doza gjithnjë të përforcuara të pijeve alkoolike. Shih – ***DELIRI TREMENS.***

DELIRI I MOLISJES. Ka karakter akut dhe shkaktohet nga puna e rëndë fizike dhe afatgjatë në kushtet e një jete dhe aktiviteti të përditshëm të papërshtatshëm. Deliri i molisjes mund të shkaktohet edhe nga temperaturë e lartë trupore, sidomos kur kjo zgjat dhe nuk merren masa për zbritjen e saj.

DELIRI I PËRNDJEKJES. Formë e delirit që shfaqet me një ndikim të madh e të pazotëruar të frikës nga ana e individit, e shoqëruar me halucinacionin e rrezikut nga të panjohurit.

DELIRI SOMATIK. Gjendje psikike që e karakterizon individin me besim se organet e trupit po humbin gjithnjë e më tepër funksionin e tyre duke marrë madje formë të përçuditshme.

DELIRI TREMENS. Delir i shkaktuar nga përdorimi i tepërt dhe jo i rregullt i alkoolit. Deliri tremens ka të bëjë së pari me gjendjen e shkaktuar nga përdorimi i tepërt dhe afatgjatë i alkoolit dhe shfaqja e tij ka të bëjë me ndërprerjen e marrjes së pijeve alkoolike dhe është e lidhur me ditët e para pas ndërprerjes së marrjes së alkoolit. Gjatë këtyre ditëve individi shfaq këto simptoma: dridhje të trupit, sidomos të gjymtyrëve, temperaturë të lartë të organizmit, djersitje të madhe, pagjumësi, vetëdije me gjendje të përzier (herë e errësuar më pak, herë e errësuar më shumë), mendime të shkëputura pa lidhje, shfaqje të halucinacioneve. Kjo gjendje zgjat 2 – 5 ditë dhe individi me këto simptoma del shpejt nga kjo gjendje, bie në gjumë të thellë dhe zgjohet i molisur dhe i qetë.

DELUZION, - I. m. Besim i gabuar i njeriut në një ide, qëndrim, pikëpamje etj., që karakterizon mendimin e çorientuar të një njeriu të mbështetur mbi një perceptim të gabuar. Deluzioni shfaqet kryesisht në disa sëmundje psikike dhe ka të bëjë me rezistencën e madhe të njeriut ndaj ndryshimit të një ideje, qëndrimi a pikëpamjeje edhe atëherë, kur argumentet për rrëzimin e tyre janë më se të bindshëm. Rast i tillë është rasti i një të sëmuri me xhelozi jonormale, që beson në tradhtinë e bashkëshortit ose të bashkëshortes

dhe ngulmon në këtë besim e bindje edhe atëherë kur nuk ekzistojnë fakte për këtë lloj tradhtie. Deluzioni duhet dalluar nga besimi dhe nga bindja e njeriut në një ide, qëndrim, pikëpamje, shih – ***BESIMI.*** Ka disa lloje deluzionesh: deluzioni i fajësisë, i madhështisë, i persekutimit etj.

D

DELUZIONI BIZAR. Deluzion i çuditshëm, jo i natyrshëm, i mbështetur në fantazinë e njeriut – bartës i këtij lloj iluzioni. Deluzione të tillë ka shumë, por më të përmendur në literaturën e psikologjisë janë: 1) disa nga të sëmurët psikikë, në radhë të parë nga skizofrenia, janë të bindur se mendimet e ndritura të tyre individët e tjerë i thithin nga truri i tyre i jashtëzakonshëm e shumë produktiv; 2) bindja se prindërit e vërtetë të një individi janë njerëz të famshëm etj.

DELUZIONI EROTIK. Çrregullim i rëndë i bindjes së një individi, kur ky beson thellë se është dashuruar nga një personalitet i njohur nga fusha politike, artistike, shkencore etj.

DELUZIONI I HELMIMIT. Vuajtja sistematike e njeriut nga bindja se dikush do ta helmojë dhe do t`i marrë jetën. Sjelljet e atij që vuan nga deluzioni i helmimit janë më se të çuditshme: ai përdor lloje ushqimesh të paketuara mirë dhe të pahapura nga të tjerët, nuk pranon ushqimin e gatuar nga të tjerët përpos prindërve, nuk merr ushqim para se ai të provohet nga të tjerët etj.

DELUZIONI I KONTROLLIT. Bindja e një individi se mendimet, qëndrimet, pikëpamjet, ndjenjat, vlerat etj. të tij kontrollohen nga të tjerët. Individi me deluzion të kontrollit ka bindje se dikush nga jashtë, ndonjë fuqi e mbinatyrshme, apo të tjerë i imponojnë mendimet, qëndrimet, ndjenjat, pikëpamjet etj.

DELUZIONI I MADHËSHTISË. Formë e deluzionit që shfaqet me bindjen e pathyeshme të një individi, se ai ka vlera të rralla morale, aftësi të jashtëzakonshme, talent dhe prirje për studim të çështjeve të njohura pak etj., por që të tjerët nuk i pranojnë.

DELUZIONI I PËRNDJEKJES. Lloj i veçantë i deluzionit që shfaqet në bindjen e individit se ai përndiqet hap pas hapi, survejohet nga policia kriminale, nga të huajt, të panjohurit etj., sepse këta "përndjekës" ia duan të keqen, duan ta izolojnë, ta eliminojnë fizikisht etj. Bartësi i deluzionit të përndjekjes dyshon në të thënët e gjithçkaje, te gjithkush, në çdo situatë etj. Këta të sëmurë ndërmarrin masa të veçanta për mbrojtjen e tyre, si: mbyllin dyer e dritare të shtëpisë për të mos u përgjuar nga të tjerët, i japin kuptimin e deluzionit të përndjekjes çdo lëvizjeje te të tjerët, madje edhe bisedave që zhvillojnë me të tjerët etj.

DELUZIONI NIHILIST. Dukuri e çrregullimit psikik të njeriut, që shfaqet me përjetimin për mosekzistencën e një pjese ose të gjithë organizmit fizik e psikik të tij.

DELUZIONI SISTEMATIK. Deluzion i lidhur me një temë nga e cila individi nuk arrin të shkëputet, por me atë temë rreshtohen një varg deluzionesh që ndërlidhen gjithnjë e më tepër me ngjarjen mbizotëruese në mendimet e individit. Për këtë shkak bindja e tij për atë ngjarje është e murosur dhe bartësi i këtij deluzioni arrin

me vështirësi të lirohet nga një bindje e tillë.

DELUZIONI SOMATIK. Deluzion i lidhur me bindjen e individit mbi disa çrregullime trupore të tij, si: bindja në mungesën e ndonjë pjese të trupit, në çrregullimin e funksionit të një sistemi organesh, në zhvillim trupor jonormal etj.

DEMENC/Ë, - A. f. I ardhur nga latinishtja *dementia* "marrëzi, çmenduri". Rrënim çrregullues gjithnjë e më i rëndë dhe kurrë i përmirësueshëm i proceseve intelektuale dhe i raporteve ndërmjet tyre. Pasojat e një rënie të tillë janë të rënda, sepse gjithnjë vjen duke u dobësuar aftësia e të mësuarit, të mbajturit mend, sidomos kujtesa afatshkurtër, rrënohet gjithnjë e më shumë aftësia e të kuptuarit të asaj për të cilën bëhet fjalë, kufizohet gjithnjë e më tepër aftësia e të gjykuarit drejt për një situatë, raport, gjendje etj. dhe kjo shoqërohet me rënie të shprehjes drejt të mendimeve të tilla, me rrënim të procesit të aftësive motorike etj. Rrënime të tilla pasqyrohen në ndryshimet negative të tipareve të personalitetit dhe të integritetit të tyre. Shkaku kryesor i një rrënimi të tillë është çrregullimi i strukturës dhe i funksioneve të sistemit nervor, lëndimi i trurit, por ka edhe shkaqe të tjera, si: proceset degjenerative të pleqërisë, alkoolizmi etj. Demenca sot konsiderohet sindromë organike mentale. Tashmë janë diferencuar disa lloje demencash, si: ajo alkoolike, Alzaimer, infantile, multi-infarktike, paralitike, prekoks, senile dhe vaskulare.

DEMENCA AIDS. Rrënim i pakthyeshëm progresiv i proceseve intelektuale dhe i sjelljeve të lidhura me të, që shkaktohen nga virusi HIV në trurin e njeriut. Manifestohet me këto ndryshime kryesore: apati e përgjithshme, frikë e madhe nga vdekja, pamundësi e përqendrimit të vëmendjes, çrregullim të proceseve të kujtesës dhe i të menduarit, si edhe e veprimeve të tjera të lidhura me pjesën ballore të cipës së trurit të madh.

DEMENCA ALKOOLIKE. Rrënim dhe humbje e kapaciteteve mendore nga konsumimi i tepërt i alkoolit. Kjo gjendje mund të shkojë deri në atë masë sa individi nuk është në gjendje t`i organizojë sjelljet normale në vendin e punës dhe as në mjedisin e gjerë shoqëror. Gjendja e tillë njihet me termin ***Sindroma Korsakov*** – shih**.**

DEMENCA ALZAIMER. Shih – ***SËMUNDJA ALZAIMER.***

DEMENCA BOKSIERE. Lloj i demencës që shkaktohet nga lëndimet e shpeshta të të rënave të fuqishme, që i përngjasin grushteve të rëndë të boksierëve. Me goditje të rënda shfaqen edhe dobësime dhe rrënime psikike, në radhë të parë, humbje graduale të kujtesës, çrregullim të të folurit, çrregullim i ecjes së drejtë etj.

DEMENCA INFANTILE. Formë e çrregullimit të integrimit të dukurive psikike gjatë kohës së fëmijërisë, kryesisht rreth moshës 3-vjeçare. Demenca infantile shkaktohet nga zvetënimi i qelizave të trurit të disa zonave të trurit të madh, duke goditur keq zonën e ndijimeve dhe atë asociative. Kjo formë e demencës shfaqet më tepër në pamundësinë e fëmijës për të folur dhe menduar.

DEMENCA MULTI-INFRAKTIKE. Formë e demencës që karakterizohet nga rrënimi i aftësive dhe i proceseve

kognitive hap pas hapi. Ky çrregullim shfaqet në disa zona trunore. Përpos rrënimit të hovshëm të strukturës së zonave të trurit te demenca multi-infraktike dallohen simptoma të çrregullimit të enëve të gjakut, qarkullim i dobët i gjakut, presion i lartë i gjakut, gjymtyrë me zhvillim të kufizuar etj. Shkak i këtij çrregullimi është në radhë të parë qarkullimi i dobët i gjakut dhe furnizimi i pamjaftueshëm i trurit me gjak të pastër.

DEMENCA PARALITIKE. Çrregullim i aftësive e proceseve kognitive i shoqëruar me paralizë progresive. Demenca paralitike shkaktohet nga infektimi sifilitik terciar i trurit.

DEMENCA PIK. Demencë e lidhur me periudhën e moshës së parapleqërisë, rreth 50 – 60 vjeç. Demenca Pik është e lidhur me çrregullimin e strukturës së trurit, e në radhë të parë, të pjesëve ballore të trurit. Simptomat kryesore të demencës Pik janë: rrënim i funksioneve intelektuale, labilitet emocional, sjellje stereotip etj. Kjo lloj demence godet më tepër gratë, te të cilat hasen edhe çrregullime emocionale. Ka mendime se demenca Pik mund të jetë demencë trashëguese. Demenca Pik u përshkrua për herë të parë nga mjeku çek A. Pik (A. Pick).

DEMENCA PREKOKS. Çmenduri e periudhës së zhvillimit rinor te njeriu, e zbuluar nga Benedikt Morel (Benedict Morel, 1809 – 1873) dhe e përpunuar nga Emil Krepelin (Emil Kraepelin, 1856 – 1926). Ndërsa demenca e emërtuar "skizofreni" përmendet për herë të parë nga Eugen Bloiler (Eugen Bleuler, 1857 – 1939). Simptoma më e theksuar e demencës prekoks është humbja progresive e lidhjes së individit të një moshe të re me mjedisin e tij, si edhe me ndryshimet e me kërkesat e këtyre ndryshimeve**.**

DEMENCA SENILE. Demenca e pleqërisë ka karakter të një procesi degjenerativ, ku shfaqen çrregullime strukturash e funksionesh psikike, në fillim të atyre kognitive, si edhe çrregullime në lidhjet ndërmjet tyre. Kjo demencë shoqërohet zakonisht nga sëmundja Alzaimer, Pik etj.

DEMILINIM, - I m. Procesi i humbjes së mieliniumit, mbështjellësit të bardhë dhjamor të aksoneve të shumë qelizave nervore. Humbja e mieliniumit shkakton disa çrregullime nervore e psikike, ndër të cilat dallojmë disa forma të sklerozës, shih – ***SKLEROZA.***

DEMOFOBI, - A. f. Vjen nga greqishtja *δημοφοβιά* dhe ka kuptimin e frikës së paarsyeshme nga grumbulli i madh i njerëzve.

DEMOGRAFI, - A. f. Disiplinë shkencore që studion duke përshkruar, shpjeguar dhe parashikuar popullsitë dhe veçoritë e tyre. Shfrytëzon disa metoda, nga të cilat dallohen metodat dhe procedurat statistikore. Rezultatet e demografisë shfrytëzohen nga shumë disiplina të tjera, ndër të cilat dhe psikologjia.

DEMONOLOGJI, - A. f. Shkenca mbi demonët - është përkthim i drejtpërdrejtë nga greqishtja e vjetër. Sot demonologjia ka më tepër karakterin e pseudoshkencës, që merret me studimin e djajve, të vampirëve etj. në tregimet popullore, përralla, mite etj.

DEMONOMANI, - A. f. Pushtim i mendjes dhe i mendimeve të një individi nga demonët, nga djajtë dhe kufi-

zimi i mundësive të tij për t`u çliruar nga një pushtim i tillë jonormal.

DENDURI, - A. f. Shpeshtësia e përsëritjes së një dukurie, vetie, ose përmase të caktuar brenda intervaleve kohore, ose tipave të të dhënave, të përcaktuara saktësisht. Denduria e të dhënave në psikologji ka të bëjë me numrin e përsëritjeve të një ndryshoreje që matet, p.sh., numri i përsëritjeve të një liste prej dhjetë rrokjesh nga ana e dyzet subjekteve, të cilët kanë për detyrë t`i përvetësojnë këto rrokje deri në shkallën e përsëritjes së tyre pa asnjë gabim.

DENDURIA ABSOLUTE. Shpeshtësia e një vlere të një ndryshoreje psikologjike që matet dhe shprehet me numra absolutë.

DENDURIA BIMODALE. Shpërndarja e dendësisë së rezultateve dhe paraqitja grafike e tyre, ku dallohen dy maja grafike të paraqitjes së këtyre rezultateve, për ndryshim nga shpërndarja e rregullt e rezultateve në formë të paraqitjes grafike të tyre sipas trajtës së Gausit. Kështu, në sistemin koordinativ rezultatet bimodale paraqiten sipas figurës së mëposhtme:



DENDURIA KRITIKE. Pikëtakimi i dendurisë së dy grupeve të të dhënave pamore (i dridhjeve të rrezeve të dritës) kur humb dallimi ndërmjet tyre, përkatësisht kur dridhjet e rrezeve të dritës janë aq të shpejta sa ato nuk ndihen të ndara, por të bashkuara në një rreze drite të pandarë.

DENDURIA KUMULATIVE. Mbledhja e të gjitha dendurive të vlerës së një ndryshoreje që matet brenda shpërndarjes së këtyre vlerave në klasa të veçanta deri në fundin e këtyre vlerave të shpërndara në klasa të veçanta. Dendurinë kumulative e paraqesim në tabelën e mëposhtme:

Klasa	**Denduria**	**Denduria kumulative**
0 - 4	4	4
5 - 9	2	11 (4 + 7)
10 - 15	13	24 (4 + 7 + 13)

DENERVIM, - I. f. Mënjanim i një nervi të caktuar ose i pjesëve të fundit të tij nga indet e një organi të caktuar të trupit.

DENOTATIV, - E. mb. Që i jep formë kuptimit të një fjale, e cila është bartëse e brendisë së përgjithshme të një koncepti. Realisht përmasa e kuptimit të përgjithshëm përfaqësohet vetëm me fjalën e caktuar.

DENTRIT, - E. m. I ardhur nga greqishtja. Në anatominë e sistemit nervor dhe të qelizave nervore janë degëzime të trupit të qelizës nervore, përkatësisht të neuronit. Si pjesë përbërëse të neuroneve dentritet kryejnë funksionin e bartjes së impulseve nervore nga receptorët dhe nga neuronet e tjera në trupin e neuronit.

DEPERSONALIZIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *dis* "ndërprerje, ndarje" dhe *indivída* "maska". Në psikopatologji dhe psikiatri është humbje e ndjenjës së identitetit personal dhe përjetimi i vetes si qenie e huaj, si qenie tjetër

prej asaj që është në realitet. Njeriu i depersonalizuar është ai që humb lidhjen me veten dhe ka mendime për veten e tij, përkatësisht mendimet e tij i konsideron mendime të huaja; ka ndjenjën se nuk i përket përvojës së vet. Jeta emocionale e tij është e zbrazët dhe këta individë janë plotësisht indiferentë për atë çfarë ngjet rreth tyre dhe në lidhje me vetveten. Koncepti depersonalizimi në psikologji ka ardhur nga ekzistencializmi, sipas të cilit njeriu i depersonalizuar është ai, i cili ka përjetim të humbjes së vetvetes pa ndjenja njerëzore. Zakonisht depersonalizimi haset te disa sëmundje të rënda psikike dhe në thelb, ata që vuajnë nga kjo dukuri e çrregullimit të personalitetit të tyre kanë të bëjnë me kriza të thella identiteti.

DEPRESION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *depression* "rënie, rrënim". Depresioni ka kuptim jopsikotik dhe psikotik. Depresioni jopsikotik haset në psikologji dhe emërton konceptin e njeriut normal, të cilin e karakterizon pikëllimi, mërzia, pesimizmi, mungesa e vullnetit për punë, shpirtngushtësia, procesi i ngadalësuar i mendimit etj. Ndërkaq, në psikiatri termi depresion ka kuptim tjetër. Ai ka karakter psikotik. Depresioni psikotik emërton gjendjen e çrregulluar të individit që ka këto veti kryesore, kryesisht afatgjata: pushtim nga ndjenja e pikëllimit të thellë, humbje e interesave për mjedisin e vet, për veten e tij dhe për kënaqjen e vetes, pagjumësi, humbje e pjesshme e oreksit, lodhje e vazhdueshme, mungesë e vlerësimit të vetes etj. Një depresioni tillë godet në radhë të parë proceset dhe gjendjen emocionale të njeriut, duke vijuar me eflektim edhe me ngadalësim të procesit të mendimit dhe ndryshim të ritmit të këtij procesi, shoqëruar me të folur stereotip, me ton të ulët dhe me ritëm të ngadalësuar.

DEPRESIONI ANAKLITIK. I ardhur nga greqishtja *ανάκλιση* "i kthyer pas". Gjendje e dërrmuar e njeriut, me gatishmëri të zvogëluar të veprimtarisë, e ngarkuar me pikëllim, me pesimizëm etj., karakteristika këto, që thellohen gjithnjë e më shumë. Gjendja e këtillë është identifikuar te fëmijët e ndarë nga nëna biologjike, te të braktisurit, jetimë te fëmijët të lënë pas dore nga ana e nënës kujdestare. U përshkrua nga ana e psikanalistit amerikan me prejardhje austriake Rene Shoic (Rene Spitz, 1887 – 1974). Depresioni anaklitik është kryesisht rezultat i mospërjetimit të dashurisë amnore apo prindërore. Këtë dukuri e kanë hasur te majmunët disa studiues të aktivitetit të majmunëve.

DEPRESIONI I VONUAR. Depresion karakteristik për individin me veti psikomotorike shumë të ngadalësuara. Në këtë kontekst duhet kuptuar jo vetëm ngadalësimi i veprimeve të vullnetshme, por edhe ngadalësimi i ritmit të shprehive dhe të shkathtësive.

DEPRESIONI INVOLUTIV. Term i vjetruar i psikiatrisë që emërton depresionin e paraqitur te gratë pas fazës së menopauzës.

DEPRESIONI MADHOR. Formë depresioni karakteristike për psikiatrinë. Në kuptimin implicit në psikiatri nënkupton depresionin. Përpos simptomave të përmendura të këtij depresioni në psikiatri (pikëllimi, mërzia, pesimizmi, lodhja, pagjumësia

etj.) depresioni madhor është karakteristikë për individin e pushtuar nga ndjenja negative, madje edhe të karakterit morbid, ku me raste shfaqet edhe orvatja për vetëvrasje. Ka edhe raste të depresionit madhor të shoqëruar me vetëvrasje.

DEPRESIONI MINOR. Lloj depresioni që karakterizon në radhë të parë çrregullimet e lehta të zotërimit psikik ose të humorit, me disa nga ndryshimet e përshkruara në depresionin madhor ose major. Depresioni i vogël ose minor nuk ka karakter të qëndrueshëm, por shfaqet gjatë periudhave me kohëzgjatje të ndryshme.

DEPRESIONI REAKTIV. Depresion i shkaktuar nga ngjarjet që kanë të bëjnë me një individ të caktuar. Depresioni reaktiv shfaqet me një reagim jo të përshtatshëm emocional të njeriut ndaj një ngjarjeje, ndodhie a ndryshimi të gjendjes së papritur. Ngjarje që shkaktojnë reagim reaktiv mund të jenë humbja e papritur e prindit, shfaqja e një sëmundje të rendë, shkatërrimi i pasurisë nga faktorë të panjohur etj. Ndaj këtyre ngjarjeve individi reagon me hidhërim, me mërzi, me sjellje të vetëdënimit, me sjellje agresive ndaj vetes, ndaj të afërmve, etj. Depresioni reaktiv njihet edhe si depresion ekzogjen.

DEPRESORË, - T. m. Në terminologjinë e anatomisë emërton nervat, të cilët e reduktojnë aktivitetin e muskujve ose të gjëndrave me sekretim të brendshëm. Ndërkaq, me termin depresor në kuptimin e ngushtë duhet kuptuar dega e nervit të dhjetë (X) kranial, që për funksion kryesor ka uljen e presionit të gjakut.

DEPRIVIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *de* "nga" dhe *privare* "heq". Në kuptimin e përgjithshëm shpreh humbjen, ose mungesën e kushteve të domosdoshme për plotësimin e nevojave të rëndësishme. Në psikologji emërton gjendjen psikike të një individi, i cili kryen aktin e heqjes së një kushti, të një mundësie ose të një lidhjeje kushtesh, mungesa e të cilëve shkakton përjetimin e gjendjes së objektit, të individit etj. të humbur.

DEPRIVIMI SENSORIK. Mungesë e të dhënave shqisore ose e intensitetit të mjaftueshëm të tyre, që shkaktojnë gjendjen e një ndijimi të paqartë, e në raste të posaçme edhe mungesën e një ndijimi të caktuar.

DEPRIVIMI SHOQËROR. Përjetim i rëndë i një individi, kur ai nuk ka mundësi ose deprivohet nga kontakti shoqëror dhe nga komunikimi me të tjerët ose me grup shokësh e shoqesh, me të cilët ka marrë pjesë për një kohë të gjatë në aktivitete të ndryshme.

DEREALIZ/ËM, - MI. m. Besimi i një individi të caktuar se objektet e një mjedisi si edhe i tërë mjedisi është tjetër nga ai që perceptohet; ndërtesat e një rruge, pemët e mbjella anës rrugëve të asaj lagjeje, shokët e asaj lagjeje etj. nuk janë më ata që në të vërtetë janë; këta duken të tjerë, madje disa prej tyre thua se nuk ekzistojnë, megjithëse janë të pranishëm. Në gjendjen derealiste individi vepron me fantazi, me përfytyrime dhe me ëndrra, në vend që të veprojë me perceptim të drejtë të tyre. Derealizmi shpesh është simptomë e psikozës së skizofrenisë dhe e manisë depresive. Kur gjendja

e një individi të caktuar merr karakter të qëndrueshëm dhe ai e humb lidhjen me realitetin atëherë kemi të bëjmë me autizëm. Shih – ***AUTIZMI.***

DEREFLEKSION, - I. m. Një nga teknikat e mjekimit të gjendjes së çrregulluar psikoseksuale që ka të bëjë me mënjanimin e përqendrimit në stërmundimin për të shkaktuar ereksion dhe me kthimin e mendimeve dhe të përqendrimit të tij tek partneri, si dhe në kënaqjen psikoseksuale të tij. Teknika e refleksionit u zbatua për herë të parë nga psikiatri dhe psikoterapisti austriak Viktor Emil Frankël (Viktor Emil Frankl, 1905 – 1997).

DERIVIM, - I. m. Procesi i nxjerrjes së një opinioni, të një gjykimi, etj. nga informacioni bazë, përkatësisht nga mendimi bazë, që arrihet me anë të transformimit të burimit origjinal. Në psikanalizë, në teorinë psikanalitike dhe në statistikën e psikologjisë ka të njëjtin kuptim. Në psikanalizë emërton procesin e zhvillimit të një veprimi nga konfliktet e pavetëdijshme duke mos shkaktuar ankth. Në teorinë geshtaltiste të perceptimit emërton perceptimin e një objekti të varur nga cilësitë e objekteve të tjerë të atij mjedisi. Në statistikën psikologjike emërton transformimin e një rezultati në një rezultat të vlefshëm për krahasim etj.

DERMË, - A. f. I ardhur nga latinishtja që emërton lëkurën në përgjithësi. Por në veçanti emërton shtresën mbështjellëse të lëkurës që gjendet nën shtresën e jashtme të saj.

DESENSITIMI SISTEMATIK. Ekspozim progresiv dhe hierarki e subjektit me situata ankthore në rrethana relaksuese me qëllim të zvogëlimit të frikës së përhershme dhe zhdukjes së saj. Është formë e psikoterapisë, e zbatuar nga psikiatri afrikano-jugor i ardhur në SHBA, Xhozef Volp (Joseph Wolpe, 1915 – 1968).

DESKRIPSION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *description* "përshkrim". Në psikologji ka kuptim të veçantë, shih – ***PËRSHKRIMI.***

DESTRUKSION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *destruction*. Veprim që shkatërron, prish apo asgjëson strukturën e një trupi, të një organizmi, rrënon funksionin e një organi, rrënon me qëllim, pa argument të saktë, pikëpamjen e një individi për një dukuri etj. Shkak i një destruksioni a një veprimi destruktiv mund të jenë motivet e ndryshme, si ai i njohjes së hollësishme të elementëve të strukturës së një organizmi, të një virusi, të një pjese të kometës etj., motivi i të jetuarit, i arritjes së një niveli zhvillimor më të lartë etj. Por, te destruksioni i veprimtarisë së njeriut shkak kryesor është motivi i destruktivitetit, që te disa individë stabilizohet, duke marrë karakterin e tiparit të personalitetit shkatërrues.

DESTRUKSIONI NË PSIKANALIZË. Frojdi e shpjegon destruksionin në mbështetje të një shtytësi të pavetëdijshëm, të një shtytësi drejt vdekjes, të tanatosit (shih – ***TANATOS***). Mbi bazën e këtij shtytësi zhvillohet edhe motivi i agresivitetit te një individ, motiv i pavetëdijshëm që e shtyn, e drejton dhe e organizon veprimtarinë e tij në asgjësim, në shkatërrim. Psikanalisti Vilhelm Rajh (Wilhelm Reich, 1897 – 1957) lidhur me këtë shpjegim të Frojdit ka futur në terminologjinë e

psikanalizës termin *destrudo*, me të cilin ka emërtuar energjinë e supozuar të shtytësit drejt vdekjes. Neopsikanalisti Erik From destruksionin e shpjegon si pasojë të zhvillimit jonormal të personalitetit dhe të karakterit të një individi të caktuar, ku dallojmë mungesën e krijimit të dashurisë ndaj të tjerëve, të lirisë dhe të prosperitetit të të tjerëve, duke hapur rrugë për zhvillimin e destruksionit.

DESURGJENSION, - I. m. Në psikologjinë e personalitetit të Rejmond Katelit (Raymond Catell, 1905 – 2001) përfaqëson polin e kundërt apo polin negativ të surgjensionit. Në kuadrin e këtyre dy poleve zhvillohet tipari burimor i personalitetit. Poli i desurgjensionit është faktori F i personalitetit, i cili ka këto veçori kryesore: sjellje flegmatike, të ngadalësuara, pesimiste, obsesive, të tensionuara, me prirje të dallueshme të përqendrimit të vëmendjes kah personaliteti i tij dhe kah sjelljet e tij.

DETERIORIZIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *deteriorare* "keqësim", që në literaturën psikologjike përdoret më tepër në anglisht. Me termin deteriorizim emërtohet koncepti i rrënimit progresiv të aftësive psikike dhe të funksioneve fiziologjike. Të deteriorizuara mund të jenë: proceset kognitive, emocionale dhe konative, tiparet e personalitetit, funksioni psikomotorik i njeriut etj. Por, me këtë term emërtohen edhe konceptet e rrënimit të funksioneve fiziologjike, si: funksioni i gjëndrave hormonale, i sistemit nervor, i muskujve etj. Deteriorizimi zakonisht godet personalitetin në tërësi, por më i dallueshëm është rrënimi i sjelljeve shoqërore, kur individi shfaq sjellje vulgare ndaj të afërmve e shokëve të tij, përdor fjalor të papërshtatshëm, lëshon jargë ose pështyn vend e pavend kur hidhërohet etj. Shkalla më e rëndë e deteriorizimit është rrënimi i sjelljeve shoqërore, i emocioneve dhe i mendimit të shoqëruar me ide sumanite, shih – ***PARANOJA; SKIZOFRENIA.***

DETERMINANT, - I. m. Faktor vendimtar që përcakton drejtimin e sjelljeve të njeriut, i paraprin atyre sjelljeve dhe konsiderohet se është shkaktar kryesor i sjelljeve të tilla. Me termin determinant emërtohet edhe koncepti i tiparit të personalitetit, që ka të bëjë me synimin e palëkundur të një individi për të arritur një qëllim të caktuar dhe për ta zotëruar atë, pavarësisht nga pengesat e llojeve të ndryshme. Hasen këto lloj determinantësh:

1) **Determinanti gjenetik** – Faktor trashëgues i zhvillimit psikofizik të organizmit të njeriut.
2) **Determinanti i sjelljes së individit** – Shkaku, motivi kryesor dhe përcaktues i sjelljes së një individi në një situatë të caktuar. Term i ardhur në psikologjinë e të mësuarit nga teoria e Tolmanit mbi të mësuarit. Sipas kësaj teorie determinanti i sjelljes së individit është ajo ndryshore (variabël) që shkakton në mënyrë determinuese një sjellje të caktuar të atij individi në situatën e krijuar.
3) **Determinanti organizmik** – Faktor i brendshëm i organizmit.
4) **Determinanti personal** – Faktor përcaktues i shkakut të një sjelljeje që buron nga tipari i caktuar i personalitetit dhe i karakterit të njeriut.

5) **Determinanti situacional** – Shkaktar i veprimeve të caktuara të një individi që i diktohen nga situata në të cilën gjendet etj.

DETERMINIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga latinishtja *determinare* "përcaktoj". Doktrinë e përgjithshme sipas së cilës çdo ndryshim, lëvizje, sjellje etj. ka shkakun e vet dhe, rrjedhimisht, asgjë nuk krijohet dhe nuk shfaqet rastësisht. Shkaqe të tilla janë nga më të ndryshmet, por asgjë nuk mund të ndodhë jashtë tyre. Determinizmi në psikologji ka luajtur rol të rëndësishëm në hulumtimin e shkaqeve të proceseve kognitive dhe të sjelljeve të përgjithshme të njeriut. Në kërkim të shkaqeve determinuese të zhvillimit të proceseve kognitive dhe të sjelljeve të njeriut dallohen disa pikëpamje:

a. Pikëpamja bihejvioriste që pohon se sjelljet e njeriut përcaktohen nga stimujt e jashtëm dhe vetëm në këtë mënyrë sjelljet mund të kontrollohen dhe të parashihen;
b. Pikëpamja e psikologjisë humaniste, sipas së cilës njeriu ka aftësi të zgjedhjes së sjelljeve dhe të qëllimeve personale sipas vullnetit të lirë të tij;
c. Pikëpamja psikanalitike sipas së cilës, sjelljet e njeriut janë të përcaktuara kryesisht nga faktorët e brendshëm psikikë, nga shtytësit dhe nga motivet e pavetëdijshme. Sa më i vetëdijshëm të bëhet individi për këto motive të sjelljes së tij, aq më i lirë është në zgjedhjen e qëllimeve të sjelljeve të veta dhe në marrjen e vendimeve për sjelljen më produktive.

DETERMINIZMI KULTUROR. Pikëpamje e veçantë për kulturën dhe rolin e saj në zhvillimin e njeriut dhe të sjelljeve të njerëzve. Sipas kësaj pikëpamjeje tërësia e mendimeve, e qëndrimeve dhe e sjelljeve të njerëzve është produkt i kulturës dhe tërësinë e tillë e kontrollon dhe e përcakton kultura dhe zhvillimi i saj. Për këtë arsye, hulumtuesit e kulturës dhe të zhvillimit të saj duhet të studiojnë kulturën, pavarësisht nga njerëzit, pavarësisht nga bartësit e kulturës dhe të sjelljeve kulturore.

DETERMINIZMI SHOQËROR. Në psikologjinë e veçantë emërton konceptin e asaj doktrine të përgjithshme shoqërore, sipas së cilës në shoqëri ekzistojnë ligjësi, të cilat gjenden mbi ligjësitë e zhvillimit individual të njeriut. Sipas kësaj doktrine sjelljet e një individi zhvillohen dhe organizohen sipas kërkesave dhe veçorive të sistemit shoqëror të një vendi e jo sipas zhvillimit individual të qenies njerëzore.

DETYR/Ë, - A. f. Kërkesë për kryerjen e një pune, të një aktiviteti, për zgjidhjen e një problemi etj., të cilën individi ia parashtron vetes ose e merr nga të tjerët. Detyrat e tilla formulohen qartë dhe si të tilla aktivizojnë procese të caktuara psikike, si proceset kognitive a njohëse, ato emocionale dhe nxitëse apo motivuese. Së bashku ato drejtojnë veprimtarinë e tyre kah qëllimit përfundimtar, duke ushtruar ndikim pozitiv në organizimin e kësaj veprimtarie, për arritjen deri në realizim të asaj detyre. Detyrat mund të ndahen në disa grupe. Sipas natyrës së tyre ato mund të jenë detyra matematikore, gjuhësore, morale etj. Sipas rëndësisë që ato kanë për zhvillimin e individit dhe të grupit shoqëror mund të jenë: detyra kryesore, parësore, të domosdoshme, kontrolluese etj. Sipas

mënyrës së realizimit të tyre mund të jenë detyra të drejtpërdrejta dhe të tërthorta; sipas afatit të realizimit mund të jenë detyra afatgjata, afatshkurtra, ditore etj.

DETYRAT E PSIKOLOGJISË. Dhënie e përgjigjeve të sakta në tri pyetjet kryesore të psikologjisë: çfarë është shkenca e psikologjisë, përse është e tillë dhe si është zhvilluar dhe formësuar si disiplinë shkencore me sistemin e degëve të saj? Detyrat kryesore të shkencës së psikologjisë janë: përshkrimi, shpjegimi, kontrolli dhe parashikimi i dukurive psikike. Këto detyra mund të jenë detyra teorike dhe detyra praktike.

a. **Detyrat teorike** kanë të bëjnë me përshkrimin dhe shpjegimin sa më të plotë të dukurive psikike, të funksionimit e zhvillimit të tyre dhe të zbulimit të shkaqeve se përse ato janë të tilla, me sistemimin e të dhënave të mbledhura sipas kritereve objektive, me analizën e shkoqitur dhe me përgjithësimin e veçorive parësore të tyre në formë rregulli, parimi, ligji etj.

b. **Detyrat praktike** i përkasin fushave të ndryshme të psikologjisë zbatuese, sidomos psikologjisë klinike, psikologjisë pedagogjike dhe psikologjisë organizative. Këto detyra janë të lidhura drejtpërdrejt me një fushëveprim të caktuar të njerëzve dhe janë të drejtuara në kryerjen sa më me sukses të punëve të tyre.

DETYRAT STERNBERG. Detyra testore për gjurmimin e kujtesës dhe të proceseve të saj. Detyrat e këtilla përbëhen nga 5 ose më shumë të dhëna (numra, shkronja, fjalë të huaja etj.) dhe nga subjekti kërkohet t`i mbajë mend dhe, më pas, të thotë sa më shpejt se e dhëna nga eksperimentuesi, a është e re, apo gjendet në vargun e të dhënave të mësuara. Testi i këtillë i të provuarit të kujtesës u hartua nga psikologu amerikan Sol Sternberg (Saul Sternberg, 1933).

DETYRAT TESTORE. Detyra që kërkojnë përgjigje të saktë dhe zgjidhje të plotë të asaj që kërkon një detyrë gjuhësore, matematikore, informuese etj. Detyrat testore janë njësia më e vogël e sistemit të detyrave të një testi. Detyrat testore mund të jenë dy llojesh: detyra të tipit të mbyllur dhe detyra të tipit të hapur.

a. **Detyrat e tipit të hapur** janë ato detyra, të cilat kërkojnë përgjigje të lirë në formë të një fjale, fjalie, eseje etj. Me detyrat testore të tipit të hapur provohet sasia dhe thellësia e njohjes, e zotërimit të një fushe të dijenisë, të programit të një lënde mësimore etj. Te këto detyra paraqitet vështirësia e përcaktimit të saktë të pikave pozitive a negative në përgjigjet e dhëna në formë të lirë, sepse ndryshimet individuale në zotërim të dijes që provohet me test detyrash të hapura janë të mëdha dhe të niveleve të ndryshme.

b. **Detyrat e tipit të mbyllur i** përkasin atyre detyrave, të cilat kanë 3 – 5 përgjigje dhe detyra e subjektit është të zgjidhë përgjigjen e saktë nga përgjigjet e dhëna. Detyrat e tipit të mbyllur zbatohen për të provuar sasinë dhe thellësinë e programit të synuar të një lënde mësimore, por këto zbatohen për të provuar edhe shkallën e zhvillimit të inteligjencës të një individi. Vlerësimi i përgjigjeve të zgjedhura është i lehtë dhe objektiv.

DEUTERANOPI, – A. f. I ardhur nga greqishtja *δεύτερος* "i dyti sipas rendit". Pamundësia e dallimit të ngjyrës së gjelbër dhe të cilësive të kësaj ngjyre. Ata që vuajnë nga kjo e metë e ndjeshmërisë së ngjyrës së dytë nuk janë në gjendje ta dallojnë ngjyrën e gjelbër nga ngjyrat e tjera të spektrit të ngjyrave kromatike. Deuteranopia shkaktohet nga mungesa e pigmenteve absorbuese të ngjyrës së gjelbër në retinën e syrit të njeriut.

DEVIJIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *deviation* "shmangie". Shmangia e rrjedhave të një dukurie, të një procesi, të një prirjeje etj. nga rrjedha normale, nga norma e caktuar, nga vlera e rëndomtë, nga rregulli, nga ligji etj. Përdoret më tepër në statistikën e psikologjisë, ku emërton shkallën e shmangies së disa vlerave statistikore konkrete nga vlera mesatare e tyre. Shih – ***SHMANGIA MESATARE; SHMANGIA KUADRATIKE.***

DEVOTSHMËRI, - A. f. Ndjenjë e ndërlikuar morale te njeriu, ku "shkrihen" me një cilësi të posaçme dashuria, besnikëria dhe nderimi ndaj një individi, një pikëpamjeje dhe një vlere, si edhe ndaj bartësve të tyre. Kjo ndjenjë e ndërlikuar zhvillohet dhe merr karakter të plotë kur bëhet ndjenjë e qëndrueshme ndaj objektit të devotshmërisë. Në këtë pikëpamje i përngjet ndjenjës, shih – ***SENTIMENTI***, por ndryshon nga ajo, sepse devotshmëria është e një drejtimi, e drejtimit pozitiv. Në shqipe haset më tepër në psikologjinë e religjioneve.

DEZINHIBIM, - I. m. Zvogëlim i efektit të inhibicionit ose i frenimit të një reagimi duke përdorur faktorë të rinj me funksion ngacmues. Është përdorur nga Pavllovi në kuadrin e shuarjes së reflekseve të kushtëzuara. Nëpërmjet mënjanimit të frenimit apo të inhibicionit të reagimit të kushtëzuar me anë të një ngacmuesi të ri, ai ngjall reagim të kushtëzuar pas përsëritjeve.

DEZINTEGRIM, - I. m. Term i ardhur nga frëngjishtja *des* "mënjanim" dhe latinishtja *integratio* "rivendosje, rindërtim"**.** Shkatërrimi, rrënimi i një tërësie të ndërlikuar, madje edhe i organizmit të njeriut ose i pjesëve fizike dhe psikike të tij. Nivelet e dezintegrimit mund të jenë të ndryshme. Te psikozat dezintegrimi i personalitetit është humbje e unitetit dhe e integritetit të tipareve të personalitetit dhe çrregullim i organizimit dhe i funksioneve të tyre.

DEZHA VY. Term i ardhur nga frëngjishtja *déjà vu* "tashmë e parë". Përjetim i pabesueshëm sipas të cilit, për një peizazh që perceptohet, për një situatë të re, për një mendim të ri, a një përvojë të re etj., pohohet se, këtë e kemi parë, dëgjuar, njohur tashmë nga e kaluara jonë, ndonëse nuk mund t`i përcaktohet vendi dhe koha e përjetimit të mëparshëm. Dezha Vy është dukuri e të rriturve, e fëmijëve, por edhe e të sëmurëve psikikë, sidomos të atyre që vuajnë nga epilepsia. Përjetimi, tashmë i parë, i dëgjuar, i njohur zgjat pak (disa sekonda e më së shumti dy minuta). Dezha Vy u ka tërhequr vëmendjen edhe mendimtarëve të vjetër. Psikanaliza e Z. Frojdit këtë e shpjegon me shkakun se përvoja e re, perceptimi i objektit për të parën herë etj. na kujton atë që e kemi shtypur thellë në pavetëdijen tonë dhe tashmë, një pjesë e tij kujton atë që gjendet

në pavetëdijen tonë. Dezha Vy hyn në grupin e paramnezive. Shih – ***PARAMNEZIA***.

DËGJIM, - I. m. Proces fiziologjik, neuropsikologjik dhe psikofizik me anën e të cilit individi përjeton ndijimin e tingujve, domethënien ndijimore dhe perceptive të një ngacmuesi tingullor dhe burimin e tingujve, të cilët ngacmojnë veshët e njeriut normal. Ndjeshmëria e dëgjimit të tingujve dhe të zhurmave me intensitet, lartësi dhe ngjyrë të ndryshme shkakton ndijimin e tyre. Një proces i tillë shkaktohet nga tonet dhe zhurmat që kanë intensitet prej 16 deri rreth 20.000 Hz. Të folurit dhe tonet muzikore zakonisht lëvizin përbrenda këtyre dy kufijve. Veshët e njeriut normal e regjistrojnë zhurmën prej 15 Db në largësi prej 1,5 m. Në moshën e pubertetit dëgjimi te njeriu arrin shkallën më të lartë. Më pas, në pleqëri shkalla e dëgjimit bie dukshëm.

DËSHIRË, - A. f. Synim psikik i njeriut që nxitet dhe përforcohet me përfytyrimin e objektit të dëshirës, të cilin individi dëshiron ta arrijë dhe ta përvetësojë. Në literaturën e psikologjisë shpesh nuk bëhet dallimi ndërmjet dëshirës së vetëdijshme dhe dëshirës së pavetëdijshme. Psikologjia klasike me dëshirë kupton dëshirën e vetëdijshme. Në kuadrin e analizës së aktit të vullnetshëm dëshira është fazë e posaçme e këtij akti. Ndërkaq, psikanaliza shpjegon edhe dëshirat e pavetëdijshme. Këto dëshira lidhen me atë që, rrënjët e tyre i kanë në shtytësit e hershëm seksualë, agresivë dhe egoistë.

DËSHIRA IMPULSIVE. Dëshirë jonormale e njeriut të sëmurë nga ana psikike. Dëshirën impulsive e karakterizon intensiteti i lartë i saj dhe gati i pamundshëm për t'u kontrolluar, shfaqja e befasishme e kësaj dëshire dhe mbisundimi i saj ndaj sjelljeve të atij personi. Ka disa lloje dëshirash impulsive, si: ***DROMOMANIA; KLEPTOMANIA; ITOMANIA; PIROMANIA*****,** – shih**.**

DËSHIRA PËR VDEKJE. Shprehje e shtytësit të vdekjes, përkatësisht e tanatosit. Shih - ***TANATOSI.*** Një dëshirë e tillë aktivizohet duke e shtyrë njeriun në aktin e vdekjes, sidomos kur atij i rrezikohet jeta nga situata të rënda dhe të pakuptimta për të.

DËSHIRIM, - I. m. Energji e madhe e një shtytësi (amnor, seksual, agresiv etj.), që përcillet me ndjenja intensive të drejtuara mbi individin, objektin etj. që i mungon dhe që beson se këtë duhet ta pushtojë. Dëshirimi i tillë merr përmasat e një motivi të fuqishëm që dikton drejtimin e sjelljeve dhe organizimin efikas të tyre drejt objektit ose individit të caktuar.

DËSHMIMI I AFTËSIVE. Paraqitja objektive e aftësive të caktuara në kryerjen cilësore dhe të shpejtë të një akti krijues, të një vlere, në zgjidhjen e drejtë dhe të shpejtë të një situate problemore, si edhe përsëritja e një suksesi të tillë në situata të ngjashme. Dëshmia e aftësive vërtetohet me anë të sistemit të detyrave testore të një testi inteligjence.

DËSHMITAR, - I. m. Në psikologjinë penale, individ, i cili dëshmon me përgjegjësi të plotë morale dhe juridike për ngjarjen e ndodhur dhe për pjesëmarrësit e asaj ngjarjeje, si edhe për veprimet e tyre. Dëshmitari ka për detyrë të paraqesë faktet në formën e parë dhe krejtësisht objektive, duke mos i komentuar ose duke i komentuar

vetëm në masën që i nevojitet për të argumentuar faktet e asaj ngjarjeje.

DËSHPËRIM, - I. m. Proces emotiv i përjetimit të frikës te një individ, kur ai arrin në konkluzionin se ndonjë situatë, rrethanë etj. të cilën ai nuk ka mundësi ta kontrollojë ose ta mbikëqyrë mund ti rrezikojë një objekt të rëndësishëm për aktivitetin apo jetën e tij, ose objektin të cilin ai e konsideron përgjegjës për veten e tij. Dëshpërimi përmban elemente të frikës dhe, në kushte të veçanta mund të mbartë edhe elemente të ankthit. Dëshpërimi ka elemente të frikës atëherë kur ngjarja penguese ndodh në rrethanat e tanishme, por kur dëshpërimi ndodh në të ardhmen e afërt të lidhur me dëshirë dhe me shpresë, atëherë dëshpërimi merr elemente të ankthit. Dëshpërimi nuk ka vetëm karakter emotiv; në strukturën e tij gjenden edhe elemente intelektuale të ndërlidhura me emocione.

DËSHTIMI I QËLLIMIT. Objektiv i paarritur nga ana e një individi, që përcillet me ndjenjën e mossuksesit për përpjekjet e bëra në drejtim të realizimit të një caku të parashtruar. Pasojat e dështimit të qëllimit të një veprimtarie të caktuar për individin janë të shumëllojshme. Ndër këto pasoja dallohet gjendja frustruese e individit, e shkaktuar nga dështimi i qëllimit. Shih – ***FRUSTRIMI.***

DIAGNOZË, - A. f. I ardhur nga greqishtja *διάγνωση*, *διά* "dy" dhe *γνωση* "dijeni". Në psikologji ka të bëjë me përcaktimin e natyrës dhe llojit të një gjendjeje, procesi, vetie psikologjike normale ose të çrregulluar, si dhe të faktorëve dhe përmasave të zhvillimit ose të ngadalësimit të procesit zhvillimor të saj. Një diagnozë e tillë vihet nga specialisti i psikologjisë, përkatësisht nga psikologu klinik, i cili për këtë qëllim zbaton metoda dhe procedura të duhura psikologjike. Diagnoza përfshin edhe klasifikimin e rasteve të veçanta në bazë të kritereve dalluese të përcaktuara qartë. Diagnozës së saktë zakonisht i paraprin faza e hulumtimit dhe e vlerësimit të sjelljeve problematike, të historisë së zhvillimit, rrethi familjar e social i tij etj.

DIAGNOZA DIFERENCIALE. Term i psikologjisë klinike i ardhur nga psikiatria. Me diagnozë diferenciale kuptojmë identifikimin e saktë të një anomalie psikike, të një çrregullimi, sëmundjeje, çrregullimi dhe përcaktimin e pozitës së saj në klasifikimin e çrregullimeve apo të sëmundjeve psikike, duke dalluar veçoritë nga anomalitë, sindromat dhe sëmundjet e afërta me të. Metodat e përcaktimit të saj janë: metoda e testeve, e vëzhgimit sistematik, e bashkëbisedimit etj. Diagnoza diferenciale ka filluar të shtrihet edhe në disiplina të tjera të psikologjisë, sidomos në psikologjinë e personalitetit.

DIAGRAM/Ë, - A. f. I ardhur nga greqishtja *διάγραμμα* "vizatim". Paraqitje grafike e raporteve sasiore me anë të pikave, vizave ose të figurave gjeometrike. Diagrama në kuptimin e ngushtë është paraqitja grafike e lëvizjes ose e zhvillimit të një dukurie në kuadrin e sistemit të koordinatave. Është term i matematikës dhe i statistikës, që përdoret edhe në statistikën psikologjike. Me diagramë paraqiten konkretisht marrëdhëniet ose raportet ndërmjet dy ndryshoreve, siç është rasti i numrit të paraqitjes së një reagimi ndaj një ngacmuesi dhe shpeshtësisë (frekuencës)

apo ritmit të paraqitjes së atij reagimi te një numër subjektesh që provohen në laboratorin e psikologjisë.

DIAGRAMA E SHPËRNDARJES SË TË DHËNAVE. Paraqitja tabelore e rezultateve të arritura në dy lëndë mësimore nga ana e të njëjtit grup nxënësish, si p.sh., rezultatet e arritura në testin e përvetësimit të gramatikës së gjuhës angleze (a) dhe të gramatikës së gjuhës frënge (b). Arritjet e secilit nxënës shënohen në shtyllën grafike vertikale dhe atë horizontale, përkatësisht, arritjet në a shënohen në shtyllën vertikale dhe arritjet në b shënohen në shtyllën horizontale dhe në fund të shtyllës vertikale dhe horizontale shënohet numri i përgjithshëm i arritjeve nga ana e të gjithë subjekteve të provuara. Kjo formë e paraqitjes grafike tabelore zakonisht përdoret për gjurmimin e koeficientit të ndërlidhjes ose të korrelacionit.

DIASHIZË, - A. f. Formë e çrregullimit të funksionit nervor të trurit. Rezultatet e hulumtimit kanë treguar se diashiza është pasojë e çrregullimit të funksionit të rrjetës nervore, nga dëmtimi që pëson truri, kur njeriu rrëzohet keq. Diashiza kryesisht ka karakter të përkohshëm.

DIATEZA STRES. Përgjithësim përvojash sipas të cilave supozohet se disa sjellje jonormale të njeriut janë rezultat i ndjeshmërisë së trashëguar të një individi ndaj reagimeve stresuese të mjedisit, duke u shoqëruar edhe me mungesën e kundërveprimit të menjëhershëm të individit për ta bllokuar stresin. Shih – ***STRESI.***

DIDAKTIKË, - A. f. I ardhur nga greqishtja *διδαχτικός* "me mësue". Disiplinë pedagogjike që merret me studimin e parimeve dhe të ligjësive të mësimit në përgjithësi dhe në veçanti me studimin e ligjësive të mësimdhënies në shkollë. Disa nga pedagogët e konsiderojnë didaktikën si disiplinë e teorisë së arsimit me anë të mësimdhënies në shkollë. Themelues i didaktikës është çeku Jan Amos Komenski (Jan Amos Komenski), i cili me veprën e njohur "Didactika magna" – "Didaktika e Madhe" e botuar më 1632 ka vënë bazat shkencore të shkencës mbi mësimin, duke cilësuar qëllimin, detyrat, metodat, mjetet, format e organizimit të mësimit dhe parimet e mësimdhënies.

DIENCEFALON. Shih – ***TRURI I NDËRMJETËM.***

DIFERENCË, - A. f. I ardhur nga latinishtja *differentia*, që në kuptimin e përgjithshëm ka të bëjë me dallimin apo ndryshimin ndërmjet dy tipareve, dy binjakëve, dy rrjedhave zhvillimore etj.

DIFERENCA E FIGURAVE TË OBJEKTIT PERCEPTUES NË RETINËN E SYRIT. Dallimi i njërës anë të një objekti të perceptuar nga syri i majtë dhe syri i djathtë. Figura e secilës anë të atij objekti që bie në retinën e njërit sy dhe të tjetrit bashkohen në një figurë duke krijuar figurën e tërësishme të atij objekti. Shih – ***DISPARITETI BINOKULAR.***

DIFERENCIALI SEMANTIK. Procedurë e matjes së kuptimit konotativ të fjalëve, të kuptimit individual të fjalëve të përdorura nga ata që e flasin të njëjtën gjuhë. Diferenciali semantik përbëhet nga shkallëzimi i qëndrimeve që ka subjekti provues për kuptimin

e fjalëve dyskajore i bardhë – i zi, i mirë – i keq, i madh – i vogël, i ngrohtë – ftohtë etj. Kuptimi konotativ i fjalëve ka tri përmasa: 1) Fuqinë; 2) Vlerësimin dhe 3) Aktivitetin. Shtrirja domethënëse e fjalëve në diferencialin semantik prej kuptimit pozitiv deri në atë negativ ka shtatë shkallë. Nga subjekti provues kërkohet të përcaktojë qëndrimin e tij në njërën nga shtatë shkallët e fjalëve të dhëna, si: atdheu, dinjiteti, dhunimi, nevriku, pushteti, stuhia, shija etj. U tregua një procedurë gjurmuese e vlefshme për gjurmimin e qëndrimeve ndaj demokracisë, etnive, feve etj. Diferenciali semantik u hartua nga psikologu amerikan Çarls E. Osgud (Charles E. Osgood, 1916 – 1991).

DIFERENCIM, - I. m. Proces i dallimit të dy a më shumë ngacmuesve, i dallimit të reagimeve të një individi ndaj ngacmuesve të caktuar apo ndaj rrethanave, në të cilat ai individ mësohet të reagojë. Në hulumtimin e procesit të perceptimit diferencimi ka domethënien e procesit të dallimit të saktë të objektit perceptues, kur ai gjendet në mesin e objekteve të ngjashëm, shumë të ngjashëm ose identikë, me përjashtim të një cilësie.

DIHOTOMI, - A. f. I ardhur nga greqishtja, *διχοτομία* që nënkupton ndarje, prerje në dy pjesë. Në psikologji ka gjetur shprehje në disa terma gjysmë të përngjitur, ndër të cilat më të shpeshtë janë termat e përdorur qysh nga trajtimet e hershme të çështjeve psikologjike, si: të lindur – të fituar, racional - irracional, trupor – mendor etj. Ndër studiuesit e psikanalizës dallojmë disa terma, të tillë si:

a. Shtytësi i jetës – shtytësi i vdekjes, e vetëdijshme – e pavetëdijshme. objektive – subjektive etj., në veprat e Z. Frojdit;

b. Pavetëdije individuale – pavetëdije kolektive, tip introvert – tip ekstravert, shtytësor - shpirtëror etj., në veprat e Karl G. Jungut (Carl G. Jung, 1875 – 1961) etj.

DIJENI, - A. f. Sistem i tërësishëm informacionesh e përvojash i organizuar sipas parimeve e ligjeve të mendimit logjik të një individi, i shoqëruar me besimin e tij për karakterin, rëndësinë dhe rolin e këtij sistemi në aktivitetin e përditshëm dhe në atë profesional. Dijenia është rezultat i mësuarit dhe i përvojës. Strukturën e saj e përbëjnë informacionet, të dhënat e faktet e vërtetuara, parimet, rregullsitë, ligjet, teoremat e teoritë, pikëpamjet dhe botëkuptimi i një individi të caktuar.

DIJENIA DEKLARATIVE. Sistem faktesh e të dhënash të sistematizuara që mund të deklarohen me gojë ose me shkrim në formë gjykimesh pohuese, si gjykimi "Migjeni ishte poet i mjerimit", ose në formë gjykimesh mohuese, si "Ajri i ndotur nuk është i shëndetshëm". Dijenia deklarative shprehet në formën më të gjerë me një frazë, e cila fillon me fjalët "dije se", ose gjykimin "Vitet ikin shpejt".

DIJENIA GJENERIKE. Dijenia e përgjithshme e sistematizuar në formë konceptesh e lidhjesh ndërmjet tyre, duke u mbështetur në domethënien e fjalëve dhe të termave të domethënieve të besueshme. Dijenia gjenerike shfaqet me fjali gjykimesh në formën "Të zënit e hënës ndodh atëherë, kur. ....".

DIJENIA PROCEDURALE. Dijeni e përvetësuar për mënyrën e kryerjes së

një veprimi, të një pune etj., e cila është në mbështetje të zbatimit të shpeshtë të saj dhe ka arritur shkallën e një shprehie, që mezi ruan karakterin e vetëdijshëm të saj, pasi në kushte të posaçme zbatohet gati në formën mekanike. Dijeni procedurale është të ngarët e automobilit, të biçikletës, lidhja e kollares etj. Këto shprehi më lehtë u tregohen të tjerëve duke i shfaqur konkretisht, se sa duke i përshkruar me fjalë.

DIJENIA RELACIONALE. Sistem konceptesh e gjykimesh për natyrën, prejardhjen dhe zhvillimin e një dukurie, procesi etj., që përftohet me veprimtari të vetëdijshme duke u përqendruar në njohjen e lidhjeve dhe të raporteve ndërmjet koncepteve dhe gjykimeve. Dijeni relacionale është pohimi "a është e barasvlershme me b, b është e barasvlershme me c, atëherë edhe c është e barasvlershme me a".

DIKROMATOPSI, - A. f. I ardhur nga greqishtja. Pamundësi ose anomali në dallimin e dy ngjyrave. Dallohen disa forma të dikromatopsisë:

a. **Dikromi** – Çrregullim i dallimit të dy ngjyrave që shfaqet te ata individë, të cilët janë të aftë të shfrytëzojnë vetëm dy gjatësi valore, kurse individët normalë për të parë ngjyrat shfrytëzojnë tri gjatësi valësh të dritës. Format më të përhapura të dikromisë janë: protanopia - pamundësi në dallimin e ngjyrës së kuqe dhe të gjelbër dhe deuteranopia - vështirësi në dallimin e ngjyrës së kaltër dhe të verdhë;
b. **Tritanopi** – Vështirësi në dallimin e ngjyrës së kaltër në spektrin e ngjyrave;
c. **Tetartanopi** – Vështirësi në dallimin e ngjyrës së verdhë në spektrin e ngjyrave kromatike.

DILEMË, - A. f. I ardhur nga latinishtja. Gjendje psikike e një individi, kur ai gjendet në një situatë ku veprojnë dy a më shumë mundësi me veprim të kundërt dhe individi duhet të zgjedhë njërën prej tyre, duke përjashtuar tjetrën ose të tjerat, pavarësisht nga fakti se asnjëra prej tyre nuk e kënaq plotësisht individin e gjendur në një situatë të tillë. Dilemat mund të jenë edhe detyra testore me të cilat provohet mënyra dhe shpejtësia e marrjes së vendimit për zgjedhjen e njërës mundësi dhe mënjanimin e tjetrës.

DILEMA SHOQËRORE. Gjendja psikike e një individi që në kuadrin e lidhjeve dhe të bashkëpunimit me të tjerët në grupin social ballafaqohet me konfliktin ndërmjet dëshirave, interesave, synimeve etj, personale, me ato të grupit ku ai është pjesëtar. Zgjatja kohore e dilemës shoqërore mund të shkaktojë çrregullime relativisht të mëdha personale dhe sociale. Por, edhe harmonizimi i interesave personale me ato grupore, kur këto kanë drejtime të kundërta, është proces i vështirë.

DILTAJ Vilhelm (**Vilhelm DILTHEY**). Filozof dhe psikolog gjerman. Lindi në Bibrih (Visbaden) më 19.11.1833 dhe vdiq në Seis (pranë Bosenit) më 1.10.1911. U doktorua pranë Stenli Holi – profesor amerikan i psikologjisë. Më pas u caktua si profesor i psikologjisë dhe i filozofisë në Universitetin e Bazelit, të Bratislavës, të Miçiganit, të Çikagos, në Universitetin e Kolumbias në Nju Jork, kurse prej vitit 1881 në Universitetin e Berlinit. Themelues i filozofisë së jetës ("Lebensphilosophie"), përkrahës i pedagogjisë

filozofike dhe i variantit të saj "*Kulturpedagogjik*" – ("*Pedagogjia e kulturës*") dhe nismëtar i psikologjisë së frymës. Sipas pikëpamjeve të tij, përmbajtjet mendore mund të kuptohen, por këto nuk mund të shpjegohen sipas qasjes së shkencave natyrore. Psikologjia frymore ka si çështje studimore mendjen njerëzore dhe zhvillimin e saj, për të kuptuar dhe shpjeguar zhvillimin e historisë. Për të kuptuar dhe shpjeguar zhvillimet historike rëndësi të posaçme i jep njohjes së biografive dhe autobiografive të personaliteteve të njohura. Kjo lëndë është pjesë e realitetit dhe, si e tillë, duhet shfrytëzuar. Këtë e hasim sidomos në veprat "*Hyrje në shkencat frymore*" dhe "*Ndarje e shkencave frymore*". Veprat kryesore të Vilhelm Diltajt janë: *"Einleitung in die Geistes wisenschaften"* – (*"Hyrje në shkencat frymore",* 1883); *"Der Aufbau der geschichtlichen Welt in den Geisteswissenschaften"* – (*"Ndërtimi i botës historike në shkencat frymore",* 1910); "*Ideen über eine beschreibende und zergliedernde Psychologie"* – (*"Ideja mbi psikologjinë përshkruese dhe zbërthyese",* 1894) etj.

DIMENSION, - I. m. I ardhur nga latinishtja që nënkupton përmasë ose dimension social, përmasë ose dimension semantik etj. Në psikologji përdoret në kuptimin e një instrumenti psikologjik matës të vlerave sociale, estetike, morale etj., që shtrihet prej skajit pozitiv në skajin negativ. Në kuadrin e këtyre dy skajeve duhet përcaktuar vendi ose pozita që zë një vlerë që matet nga ana e disa vlerësuesve.

DIMENSIONET E PERSONALITETIT. Përmasat e zhvillimit të faktorëve dhe të tipareve të personalitetit. Në këtë kuptim flitet për ekzistencën e tipareve dhe të shkallës së zhvillimit të tyre te një personalitet i caktuar. Faktorë e personalitetit janë: ***AMBICIA; ASPIRATA; INTERESIMI; SYNIMI; VLERA*** – shih. Konstruktet e matjes së dimensioneve të personalitetit dallohen te testet e personalitetit shih – ***TESTI,*** e sidomos te ***INVENTARËT E PERSONALITETIT*** – shih**.** Në këtë kuptim në psikologjinë e personalitetit bëhet fjalë për dimensionet: altruist – egoist, esktravert – introvert, i ndershëm – i pandershëm, i rregullt – i parregullt etj. Përcaktimi i masës së zhvillimit të një tipari mundëson në masë të madhe besimin dhe parashikimin e sjelljeve të atij personaliteti në një situatë të ngjashme, sidomos në një situatë identike.

DINAMIKË, - A. f. I ardhur nga greqishtja *δυναμία* "fuqi", që u përdor në fillim në fizikë e më pas edhe në psikologji. Dinamika emërton ndryshimin e sjelljeve, të cilësive, të tipareve etj. të një individi nën ndikimin e një ose disa faktorëve. Sipas kësaj kuptimi bëhet fjalë për dinamikën e personalitetit, ku cilësohet struktura e fuqive të brendshme, në radhë të parë e motiveve, që shkaktojnë veprimtarë të caktuar me intensitet të posaçëm. Përfaqësuesit më të dalluar të dinamikës në psikologji janë: Uiljam Mek Dugal (William McDugall, 1871 – 1938), i cili ka trajtuar instinktet dhe rolin aktiv të njeriut nën ndikimin e numrit të caktuar 16, përkatësisht të 12 instinkteve; Robert Uduërth (Robert Woodworth, 1869 – 1962), i cili ka trajtuar psikologjinë dinamike dhe drejtimin e funksionalizmit në zhvillimin e psikologjisë; Z. Frojdi e K. Jungu kanë trajtuar motivacionin e pavetëdijshëm

dhe proceset e pavetëdijshme etj. Ky term u përdor nga Gotfrid V. Lajbnic (Gottfries W. Leibnic, 1646 – 1716) duke gjetur zbatim në mekanikë. Shih – ***PSIKOLOGJIA DINAMIKE***.

DINAMIKA BIHEJVIORALE. Karakteri energjetik, dinamik i strukturave të personalitetit (i nevojave, i motiveve, i shtytësve etj.), që sajojnë themelin e veprimtarisë dhe të sjelljeve konkrete të tij. Dinamika bihejviorale ka edhe kuptimin e qasjes psiko-dinamike studimit të personalitetit. Kjo qasje konsiderohet bartëse përgjegjëse për studimin e sjelljeve të njerëzve.

DINAMIKA E GRUPIT. Në psikologjinë sociale ka të bëjë me hulumtimin e sjelljes së një grupi shoqëror, të ndryshimeve të strukturës dhe të funksionimit të një grupi shoqëror dhe të ndërveprimit të pjesëtarëve të atij grupi. Dinamika e grupit nënkupton ndikimin e veprimit të ndërlikuar të një grupi shoqëror në ndryshimin e raporteve brenda anëtarëve të atij grupi dhe të sjelljeve të tyre. Dinamika e grupit shtrihet në fushën ndërvepruese të anëtarëve të grupeve të vogla.

DINAMIKA E PERSONALITETIT. Ndryshimet e proceseve, të motiveve, të mekanizmave psikikë etj., nga: a) faktorët e brendshëm, me të cilët nxitet aktiviteti i njeriut dhe format e ndryshme të tij të drejtuara kah ambientit dhe ndryshimeve të tij dhe b) nga vetë individi që konsiston në ndryshimin e sjelljeve ndaj vetvetes. Faktorë të tillë me energji psikike mund të jenë: motivet, nevojat, shtytësit, ambicia, interesimi, synimi, vlera etj.

DINAMIZ/ËM, - MI. m. Haset më shpesh në psikologjinë e Hari Salivenit. Qëndrueshmëria e organizmit të njeriut e mbështetur kryesisht në plotësimin e shtytësve dhe motiveve, duke u përqendruar në mbrojtjen e organizmit nga format e ndryshme të stresit.

DINAMOMET/ËR, - RI. m. Instrument i fizikës që përdoret edhe në psikologjinë e organizmit. Dinamometri mat fuqinë e muskujve, e në radhë të parë fuqinë e muskujve të duarve dhe të grushteve.

DINJITET, - I. m. Virtyt i lartë i karakterit të njeriut, tipar i rëndësishëm, e drejtë themelore e njeriut dhe e respektimit të saj te secili anëtar i familjes njerëzore. Ka strukturë të ndërlikuar vlerash dhe ndjenjash të larta morale, ku hyjnë: krenaria, vlerësimi objektiv, respekti etj.

DIOPTRI, - A. f. Njësi optike që mat fuqinë e thjerrëzës së syrit për t`i vënë fokus konvergjent dy rrezesh drite. Termi Dioptri gjen zbatim edhe në psikologjinë e ndijimit dhe të perceptimit pamor.

DIPLOPI, - A. f. Formë e çrregullimit të të parit të objekteve me të dy sytë. Diplopia ka të bëjë me paraqitjen e figurës së të njëjtit objekt si një figurë e dyfishtë. Shkak i saj është pamundësia e lëvizjes së drejtë të të dy syve dhe pamundësia e lidhjes së të njëjtës figurë të objektit perceptues që bie në retinën e syrit të majtë dhe në retinën e syrit të djathtë.

DIPSOMANI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *διψο* "etje" dhe *μανία* "çmenduri". Nevojë e theksuar e një etje të madhe me karakter periodik për konsumim të pijeve alkoolike në sasi të pakontrolluara. Dipsomania ka përmasat e krizës konvulsive. Intervali i

pushimeve ka zgjatje kohore të ndryshme, por kryesisht ka karakter të përkohshëm, që shpesh shoqërohet me "sule" psikike. Mund të jetë simptomë e çrregullimit të unitetit të personalitetit. Në historinë e zhvillimit të dipsomanisë janë shënuar edhe raste poetësh, letrarësh, kompozitorësh etj., si: Edgar A. Poe (1809 – 1849), Ernest Heminguej (1899 – 1961).

DIREKSION, - I. m. Term i studiuesit të procesit të mendimit N. Majer. Në eksperimentet e tij N. Majer ka konstatuar se ekziston një drejtim apo orientim i subjekteve në zgjidhjen e problemeve të ndërlikuara. Kjo direktivë mund të jetë direktivë e pavetëdijshme. Ky drejtim dhe mënyra e qasjes së zgjidhjes së një problemi shpesh konsiderohen skema të karakterit të përgjithshëm, por këto skema drejtimesh, ku duhet kërkuar zgjidhja dhe ku duhen kapërcyer pengesat në zgjidhjen e një problemi, mund të shpien në rrugë të gabuar. Në raste të tilla mjafton tërheqja e vëmendjes së subjekteve që zgjidhjen do duhet ta kërkojnë në mënyrë tjetër, në mënyrë produktive.

DISASOCACION, - I. f. I ardhur nga greqishtja *δισ* "jo" dhe *ασοτιατιών* "shoqërim, lidhje"**.** Ndërprerje e lidhjeve ndërmjet përvojave të ndryshme ose pjesëve të tyre, përkatësisht shkëputja e lidhjeve ndërmjet të dhënave shqisore, përfytyrimeve, ideve etj. dhe proceseve të tyre.

DISEMI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *δυσ* "keq" dhe *θυμία* "shenjë". Në psikopatologji nënkupton çrregullim të njohjes së kuptimit që emërton disa nga shenjat me të cilat një individ shfaq ndjenjat, mendimet, qëndrimet etj. Ata që vuajnë nga ky çrregullim nuk janë në gjendje që në bazë të gjesteve, të mimikës së fytyrës, të ngritjes së zërit etj., të njohin gjendjen emocionale të tjetrit.

DISFAGI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *δυσφαγία* që ka të bëjë me çrregullimin e të ushqyerit. Nënkupton vështirësitë ose pengesat neurologjike në procesin e marrjes së ushqimit. Termi disfagi ka edhe kuptim të përgjithshëm, madje përdoret edhe me nënkuptim, si në rastin: "Nuk dua të gëlltis fyerje të tilla"**.**

DISFAZIA RECEPTIVE. Çrregullim i madh i dëmtimit të aftësisë fjalësore ose verbale të njeriut që manifestohet në pamundësinë e formulimit të dëshirave, të kërkesave, të nevojave të thjeshta të tij. Disfazia receptive e nis zhvillimin e vet që nga mosha e fëmijërisë.

DISFORI, - A. f. Simptomë e theksuar e depresionit të njeriut me gjendje a humor të pakëndshëm, me humbje të vullnetit për punë, me pikëllim e shpesh, edhe me dhunë ndaj të tjerëve, herë-herë edhe ndaj vetvetes. Shkaqet e disforisë lidhen më tepër me faktorë psikogjenë.

DISFUNKSION, - I. m. Pengesë në funksionimin e organeve dhe të proceseve fiziologjike dhe psikologjike. Në psikologji nënkupton çrregullimin e një procesi dhe çrregullimin e rrjedhës normale të tij në raport me proceset e tjera.

DISGRAFI, - A. f. Pamundësi e të shkruarit ose e shprehjes së mendimeve e ndjenjave me anë të të shkruarit ose paraqitjes grafike të tyre sipas

rregullave gramatikore të gjuhës amtare. Kjo pamundësi shkaktohet nga dëmtimi i qelizave nervore. Disgrafia shfaqet në forma të veçanta, si: pamundësi e të shkruarit me shkronja të mëdha, shkrim vetëm i zanoreve, shkrim i numrave por jo i shkronjave etj.

DISGRAFIA FONETIKE. Pamundësi e thënies së fjalëve dhe e të shkruarit të tyre. Ata që vuajnë nga kjo formë e disgrafisë nuk janë në gjendje t`i shkruajnë fjalët që i dëgjojnë për herë të parë. Një çrregullim i tillë shkaktohet nga dëmtimi i pjesës së sipërme të felës temorale ose tëmthore të trurit.

DISGRAFIA ORTOGRAFIKE. Formë e disgrafisë që ka të bëjë me artikulimin e drejtë të formave të rregullta të foljeve, por jo edhe të formave të çrregullta të atyre foljeve, si në gjermanisht, në anglisht etj. Disgrafia ortografike është e lidhur me dëmtimin e pjesës së poshtme parientale të trurit.

DISIPLINË, - A. F. I ardhur nga latinishtja që në kuptimin e parë ka të bëjë me shkollim, mësim në shkollë, por më vonë ka marrë kuptime të tjera: 1) Rend, rregull sipas të cilit organizohet sjellja e anëtarëve të një grupi individësh a institucioni (ushtri, sekt fetar, shkollë etj.) dhe kontrolli i përshtatjes së sjelljeve të pjesëtarëve të tyre sipas këtij rendi e rregulli; 2) Sistem dijesh i një dege të posaçme të shkencës a i një lënde mësimore, si biologji, sociologji, arkeologji etj.

DISIPLINA NORMATIVE. Grup disiplinash shkencore që janë formuar në mbështetje të përcaktimit të normave të sjelljeve individuale ose që synojnë të marrin statusin e disiplinave normative duke zbatuar metoda normative në procesin e hulumtimit të sjelljeve të një numri të madh të anëtarëve të një mjedisi shoqëror.

DISIPLINAT E PSIKOLOGJISË. Degë hulumtuese të sistemit të shkencave të psikologjisë. Disiplina të psikologjisë janë: psikologjia e përgjithshme, psikologjia fiziologjike, psikologjia sociale etj., që i përkasin grupit të disiplinave teorike të psikologjisë. Ndërkaq, psikologjia klinike, psikologjia pedagogjike, psikologjia e menaxhimit etj. janë disiplina zbatuese të psikologjisë. Shih – ***SISTEMI I SHKENCAVE TË PSIKOLOGJISË.***

DISKINEZI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *δυσ* "parashtresë e mohimit" dhe *κινησία* "lëvizje". Në psikopatologji dhe psikiatri ka të bëjë me çrregullimin e lëvizjeve të vullnetshme. Gjatë të folurit shfaqet me lëvizje anormale të gjuhës, të muskujve të gojës dhe të fytyrës, sidomos me lëvizje spastike të gjymtyrëve dhe të gjithë trupit. Ky çrregullim lëvizjesh i organeve të trupit dhe i të gjithë organizmit të njeriut është i ngjashëm me sëmundjen e Parkinsonit shih – ***SËMUNDJA E PARKINSONIT*****,** e cila fillon me shfaqjen e lëvizjeve të pakontrolluara të gjymtyrëve dhe është pasojë e çrregullimit të strukturës dhe të funksionimit të disa qelizave nervore. Njihet edhe një formë e diskinezisë e quajtur diskinezia e vonë**.**

DISKREPANCË, - A. f. I ardhur nga latinishtja *discrepantio* "papërputhshmëri, jo harmoni". Në psikologji nënkupton mospërputhshmërinë e dy proceseve, ose dy funksioneve të strukturave psikike. Kështu, qëndro-

jnë në diskrepancë vetëdija dhe pavetëdija, ndërgjegjja dhe shtytësi etj.

DISKRIMINIM, – I. m. I ardhur nga latinishtja *discriminare* "me nda, me bë dallim". Ka kuptime të ndryshme në psikologjinë e të mësuarit dhe në psikologjinë sociale. Në psikologjinë e të mësuarit diskriminimi u përdor nga shkolla bihejvioriste dhe ka kuptimin e të mësuarit për të dalluar e diferencuar dy ngacmues, dy objekte, dy situata të ngjashme etj. Në fazën e perceptimit nënkupton mundësinë e dallimit të stimujve perceptues. Në psikologjinë sociale, në psikologjinë politike dhe në disa fusha të disiplinave shoqërore e humaniste termi diskriminim emërton trajtimin jo të barabartë e jo të drejtë të individëve që kanë përkatësi etnike, gjinore, racore etj. të ndryshme.

DISKRIMINIMI SHQISOR. Gatishmëria e subjekteve për të dhënë përgjigje të ndryshme ndaj stimujve të ndryshëm shqisorë dhe cilësive të tyre. Për njeriun normal është e mjaftueshme përgjigjja me fjalë për të dalluar ndryshimin ndërmjet stimujve. Nëse kemi të bëjmë me organizma kafshësh të larta diskriminimi shqisor argumentohet me faktin që, për një stimulues vazhdimisht jep një reagim dhe për tjetrin jep një reagim tjetër.

DISKRIMINUES. mb. Që ka të bëjë me diskriminimin.

DISKRONIZ/ËM, - MI. f. Çrregullim i ndjeshmërisë së një individi ndaj largësive kohore. Diskronizmi është i dukshëm sidomos në rastet kur udhëtohet në zona të largëta me avion dhe kur çrregullohet ritmi biologjik i njeriut.

DISKU PAMOR. Fusha pamore e rrjetëzës ose e retinës së syrit, ku janë të grumbulluara të gjitha fijet nervore dhe ku, prej këtu këto fije vazhdojnë rrugën nervore si gërshetë fijesh nervore, përkatësisht si nerv pamor ose optik.

DISKURS, - I. m. I ardhur nga latinishtja *discursus* "bashkëbisedim, të folurit". Segment i të folurit ndërmjet bashkëbiseduesve i përbërë nga më shumë se një fjali. Në këtë bashkëbisedim provohet argumentimi i plotë i një mendimi, i një teze të parashtruar etj., për të arritur deri në të vërtetën e saktë për mendimin e parashtruar në formë teze, problemi etj.

DISKURSIV. mb. Që i përket diskursit e që mbështetet në përsiatjen dhe në të folurin racional të karakterit konceptual, gjykues dhe konkludues. I tillë është mendimi diskursiv për një çështje, për zgjidhjen e një situate problemore, kur individët orvaten që me anën e operacioneve kognitive e jo me intuitë të arrijnë në zgjidhjen e asaj situate. Shih – ***INTUITA.***

DISKUTIMI GRUPOR. Shqyrtimi i një çështjeje nga ana e pjesëtarëve të një grupi për të arritur deri në pajtim mendimesh e qëndrimesh dhe për të marrë vendim mbi angazhimin e atij grupi (klasë nxënësish, grup punëtorësh, shoqatë profesionale etj.).

DISLALI, - A. f. **I** ardhur nga greqishtja *δύσ* "jo" dhe *ληπτος* "me fol". Vështirësia në shqiptimin e drejtë të tingujve të një fjale. Në këto raste bëhet fjalë për çrregullim të të folurit. Dislalia është një ndër format e shpeshta të çrregullimit të të folurit. Ky lloj çrregullimi mund të shkaktohet nga pengesat psikologjike dhe nga mosfunksionimi i rregullt i organeve periferike të të folurit (lëvizja e gjuhës, e muskujve të buzës, e pejzave të prodhimit të zërit etj).

DISLEKSI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *δύσ* "jo" dhe *λεξης* "fjalë". Çrregullim i leximit të teksteve të shkruara që është i lidhur me çrregullimin e perceptimit të shkronjave dhe të lidhjeve ndërmjet syresh. Disleksia shfaqet me përzierje dhe ngatërrim të shkronjave, me pamundësi të shqiptimit të fjalëve, me "ngrënie" fjalësh etj. Shkaqet e disleksisë ende nuk njihen krejtësisht, me përjashtim të faktit se disleksia shfaqet te individët që nuk e kanë të dëmtuar sistemin e funksioneve të proceseve kognitive dhe e kanë ruajtur aftësinë e përgjithshme. Në fëmijërinë e viteve para të shkollimit mendohet se disleksia shfaqet nga pamundësia e përqendrimit të vëmendjes, nga përdorimet e mangëta dhe të dobëta të fjalëve, nga perceptimi i çrregulluar i simboleve, sidomos i shkronjave etj. Mendohet që me anë të ushtrimeve të organizuara mirë, ky lloj çrregullimi mund të përmirësohet, madje edhe të eliminohet. Në kuptim të ndryshëm nga disleksia haset edhe aleksia. Shih – ***ALEKSÍA.*** Disleksia ndeshet në disa forma**:**

a. **Disleksia e drejtpërdrejtë** është formë e disleksisë, që shfaqet me pamundësinë e të kuptuarit të përmbajtjes së një teksti që lexohet kryesisht drejt;

b. **Disleksia fonologjike** ka të bëjë me vështirësi në fonologjizimin e duhur të fjalëve dhe në të mësuarit e shqiptimit drejt të tyre. Ata që vuajnë nga disleksia zakonisht mësojnë t`i shqiptojnë fjalët me tinguj të përsëritur të shkronjave të tyre, por kanë vështirësi në shqiptimin drejt të fjalëve të reja, sidomos të emrave të gjatë.

c. **Disleksia e thellë** shfaqet me këto karakteristika kryesore: lexohet teksti me vështirësi dhe me gabime në emërtimin e kuptimit të fjalëve, posaçërisht të atyre fjalëve që kanë kuptim abstrakt dhe që lidhen me nyje, me lidhëse dhe me parafjalë. Disleksia e thellë shkaktohet nga dëmtimi i disa pjesëve ballore të trurit.

DISOCACION, - I. f. I ardhur nga latinishtja *dissociation* "ndarje, çarje". Proces dhe rezultat i ndarjes a prishjes së mendimeve, emocioneve etj. nga tërësia harmonike e integruar e personalitetit dhe funksionalizimi i tyre i ndarë nga pjesa tjetër e personalitetit. Disocacioni është formë e dekompozimit të harmonisë ndërmjet proceseve psikike e tipareve të sjelljeve karakteristike të një individi. Proceset dhe strukturat mendore në gjendjen e disocacionit kontrollohen vetëm pjesërisht nga truri. Disocacioni shkaktohet kryesisht nga streset e thella të përjetuara në raste të rralla, siç janë: aksidentet, abuzimet, dhunimet seksuale etj. Për disocacionin është shprehur fillimisht Pjer Zhane (Pierre Janet, 1859 – 1947), duke e konsideruar mekanizëm mbrojtës nga streset e fuqishme.

DISOMNI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *dysombya* "pagjumësi". Çrregullim i të fjeturit të njeriut që shfaqet në disa forma, si: pagjumësi në cilësinë e gjumit (gjumë sipërfaqësor), në kohëzgjatje (gjumë me copa me kohëzgjatje të ndryshme) dhe në shpërndarjen kohore të gjumit (prishje e gjumit të pandërprerë si dhe e vendit të gjumit) etj. Disomnia shkaktohet kryesisht nga pengesat dhe çrregullimet emocionale (frika e madhe, ankthi, stresi etj.).

DISONANCË, - A. f. I ardhur nga latinishtja *dissonanti* "joharmoni". Term i akustikës dhe i muzikës, por që përdoret edhe në psikofizikë. Disonanca

ka të bëjë me strukturën joharmonike të toneve dhe shkakton ndijim dëgjimor që shoqërohet me pakënaqësi. Ka raste kur disonanca shtrihet edhe në fusha të tjera të psikologjisë, si p.sh., disonanca e qëndrimeve, disonanca kognitive etj.

DISONANCA KOGNITIVE. Gjendje psikike e njeriut, i cili ka dy mendime, dy informacione, dy qëndrime etj. që nuk kanë harmoni ndërmjet tyre. Disonanca kognitive shfaqet edhe në rastet kur personi vepron në kundërshti me dijeninë e tij, me qëndrimet e veta etj., përkatësisht kur paraqitet konflikti ndërmjet qëndrimit dhe sjelljes së një individi. Në rastet e tilla shfaqet jokonseguenca ndërmjet qëndrimit dhe sjelljes. Zgjidhja e konflikteve të tilla ka mundësi të bëhet duke ndryshuar qëndrimin, besimin, bindjen etj. për doktrinën, për dukurinë sociale, për individin etj. Disonancën kognitive e ka futur në terminologji të psikologjisë psikologu amerikan Leon Festinger (1919 – 1989). Sipas tij ndryshimi i qëndrimit krijon kushte të sjelljes adaptuese të individit të caktuar.

DISPARAT, - E. mb. I ardhur nga latinishtja *disparatus* "jo i njëjtë, jo i barabartë" që emërton veçorinë e trupave, të pamjes së retinës së syrit, të përfytyrimeve, të koncepteve etj., kur dy trupa, dy pamje, dy përfytyrime, dy koncepte etj. janë të ndryshëm, të papërputhshëm. Në psikologji termi përdoret kryesisht në përshkrimin e pamjeve të retinës së syrit, kur pamja e një objekti që shihet nga individi me syrin e majtë në një largësi prej tij, nuk përputhet me pamjen e syrit të djathtë dhe shkakton perceptimin e dy figurave.

DISPAREUNI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *δυσπαρευνία* që ka kuptimin e dhembjes gjatë marrëdhënies intime seksuale, para dhe pas kryerjes së aktit seksual. Dhembjet e një akti të tillë shfaqen si te femra, ashtu edhe te mashkulli, dhe, sidomos për femrën, ndjehen më shumë në pjesën e sipërme, në gjoks dhe në lukth. Dispareunia shkaktohet nga frika e pavetëdijshme e kryerjes së aktit seksual.

DISPARITETI RETINAL. Dallimi i pamjeve të të njëjtit objekt, të para me të dy sytë, kur pamja e objektit të parë me syrin e majtë ndryshon prej pamjes së të parit të të njëjtit objekt me syrin e djathtë**.** Në kushtet e të parit normal, kur dy sytë funksionojnë normalisht, shih – ***TË PARIT BINOKULAR***, të parit me të dy sytë e një objekti të fokusuar mundëson perceptimin e thellësisë së atij objekti. Kjo dukuri ndodh ngaqë njeriu e sheh të njëjtin objekt nga kënde të ndryshme të të parit.

DISPERSIONI DISKRIMINUES. Shpërndarje e përgjigjeve të përfituara nga ana e subjekteve të një grupi eksperimental, ku provohet të mësuarit diskriminues.

DISPONIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *disponere*. Në psikologjinë klasike term i shpeshtë i jetës emocionale të njeriut, që emërton konceptin e gjendjes relative emocionale me intensitet të ulët, por gjendje depërtuese nëpër të gjitha format e aktivitetit të njeriut. Një gjendje e tillë mund të jetë gjendje e lidhur me stimuj të jashtëm ose e paraqitur vetvetiu. Format e shfaqjes së disponimit janë të ndryshme, por ndër më të shpeshtat janë kënaqësia e pakënaqësia, që e përçojnë gjithë jetën e veprimtarinë e njeriut. Një gjendje e

tillë emocionale emërtohet edhe me termin humor. Shih – ***HUMORI.***

DISPOZITA DYTËSORE.

Dispozitë më pak e rëndësishme e personalitetit që i përket rendit të dytë të sjelljeve. Termi i përket psikologjisë së personalitetit të psikologut amerikan Gordon V. Olportit (Gordon W. Allport, 1897 – 1967), i cili ka bërë dallimin ndërmjet dispozitave qendrore dhe dispozitave dytësore, që numerikisht janë më të shumta se ato qendroret. Këto shfaqen në një numër reagues të kufizuar të personalitetit ndaj situatave të pakta të tij.

DISPOZITA KARDINALE. Dispozita më e rëndësishme e personalitetit. Kjo dispozitë karakterizon tërësinë e veprimtarisë së njeriut duke i dhënë vulë specifike asaj veprimtarie. Dispozita kardinale e bën dallimin e aktivitetit të secilit individ nga veprimtaria e të tjerëve dhe me këtë e bën personalitetin e secilit unik dhe të dallueshëm nga të gjithë të tjerët. Këtë dispozitë duhet dalluar nga dispozitat qendrore, sidomos nga dispozitat dytësore. Ky term i përket psikologjisë së personalitetit të psikologut amerikan Gordon V. Olport (Gordon W. Allport, 1897 – 1967).

DISPOZITË, - A. f. I ardhur nga latinishtja "rregullsi", që përdoret në psikologji, në psikologjinë klinike dhe në psikiatri. Në psikologji përdoret për të emërtuar aftësinë e një individi për arritjen e një niveli sa më të lartë dhe cilësor. Struktura neurofiziologjike e dispozitave krijon bazën e zhvillimit të aftësive, të sjelljeve, të vlerave etj., që te një individ i caktuar shprehen në karakteristika të veçanta. Dispozitat në psikologjinë klasike janë përcaktuar si faktor neurofiziologjik i lindur për aftësi të caktuara dhe fuqi neurofiziologjike e mundur për t`u zhvilluar me ritme të shpejta, duke përmirësuar dukshëm nivelin e arritjeve në një fushë të caktuar të prodhimtarisë. Dispozita në psikologjinë klinike dhe në psikiatri ka konotacion tjetër prej asaj që u tha më lart. Në këto disiplina dispozita emërton prirjen e një individi për reagime psikopatologjike dhe për sëmurje të caktuara, siç është psikoza e skizofrenisë.

DISPRAKSI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *δύσπραξία* që emërton konceptin e dukurisë së çrregullimit të lëvizjeve, sidomos dobësimin e koordinimit të lëvizjeve ndërmjet pjesëve të ndryshme të trupit, posaçërisht ndërmjet gjymtyrëve.

DISQET MAKSUELL. Disqe ngjyrash të ndryshme, të cilët kur rrotullohen shpejt në një aparat të posaçëm, shkaktojnë pamjen e ngjyrave të përziera. Disqet Maksuell shërbejnë për të provuar ligjet e përzierjes së ngjyrave. Këtë e ka zbuluar fizikani skocez Xhejms K. Maksuell (James C. Maxwell, 1831 – 1879).

DISTIMI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *δυστυχία*. Prirja e një individi kah gjendja emocionale depresive me ankth. Destimia ka këto karakteristika: nuk është gjendje depresive madhore, çrregullim i gjendjes shpirtërore ose i humorit në drejtim negativ, që mund të zgjasë gjatë për një ditë, disa ditë, ose të shoqërojë aktivitetet e njeriut gjatë një periudhe relativisht të gjatë (deri në dy vjet).

DISTRIBUCIONI T. Shih – ***SHPËRNDARJA T.***

D

DITARI I ZHVILLIMIT TË FËMIJËS. Metodë klasike e hulumtimit të zhvillimit fizik e psikik të një fëmije. Në ditarin e zhvillimit të fëmijës shënohen sistematikisht të gjitha ndryshimet e zhvillimit trupor dhe psikik që paraqiten çdo ditë. Ditar të tillë zakonisht mbajnë mjekët, psikologët, pedagogët etj. Ditari i zhvillimit të fëmijës është i lidhur me emrin e Çarls Darvinit (Charles Darwin, 1809 – 1882), Vilhelm Stern (Wilhelm Stern, 1871 – 1938) etj.

DITARI PSIKOLOGJIK. Tërësi të dhënash të shënuara sistematikisht për dukurinë, përjetimet dhe vëzhgimet e tiparit, të sjelljes së tipit të caktuar, të reagimeve emocionale etj., si edhe të ndryshimeve të tyre në kushte dhe rrethana të caktuara. Këto shënohen ashtu si shfaqen dhe pa komente. Koha e mbajtjes së ditarit është aq e gjatë sa zgjat dukuria që vëzhgohet, përkatësisht aq sa ka nevojë studiuesi.

DIVERGJENCË, - A. f. I ardhur nga latinishtja *divergere* "të ndarë në drejtime të kundërta". Mospajtim në mendime, në qëndrime dhe në sjellje ndërmjet dy a më shumë individëve. Divergjenca në psikologji emërton konceptin e lëvizjeve të syve gjatë perceptimit të cilësive hapësinore të trupave (të thellësisë, të largësisë etj.), në të cilin kokërdhoku i njërit sy lëviz në drejtim për nga jashtë, kurse ai i syrit tjetër në drejtim për nga brenda. Ndryshimi i të parit të tillë, shih – ***TË PARIT BINOKULAR,*** mundëson perceptimin e thellësisë së një trupi.

DOCILITET, - I. m. I ardhur nga latinishtja *docilis* "që mësohet lehtë". Term i vjetër i përdorur kryesisht në pedagogji. Gatishmërisë intelektuale për të marrë informacione dhe për t`i mësuar ato dhe lidhjet ndërmjet syresh në mënyrë sa më të lehtë, madje edhe në mënyrë mekanike. Gatishmëria e tillë e të mësuarit i përket të mësuarit nën ndikimin e autoritetit dhe jo me anë të angazhimit të proceseve psikike të vetëdijshme.

DOGMË, - A. f. I ardhur nga greqishtja *dogma*. Besimi, bindja e një individi sipas një pikëpamjeje të autoriteteve fetare, morale, politike etj., duke mos afruar të dhëna e fakte empirike, përkatësisht argumente të verifikuara për vërtetësinë e asaj pikëpamjeje. Dogma nuk ka përqasje kritike, por pranim të një qëndrimi, pikëpamjeje, botëkuptimi të shoqëruar me besim dhe me bindje të thellë në vërtetësinë e saj. Fatalizmi në psikologji është një dogmë.

DOGMATIK/Ë, - A. f. I ardhur nga greqishtja *δογματικός*. Dogmatika në psikologjinë e besimit studion dogmat fetare; është disiplinë që merret me të vërtetat themelore të fesë. Në fenë katolike dogmatika konsiderohet sistem të vërtetash themelore për fenë katolike, sistem dijesh për zbulesën mbinatyrore.

DOGMATIZ/ËM, - MI. m. Qëndrim i përgjithshëm sipas të cilit e vërteta për dukuritë, objektet, gjithësinë etj. njihet vetëm nga mendimi jokritik i ideologjive dhe i themeluesve të tyre. Në psikologji dogmatizmi është tipar i atij individualiteti, që nuk pranon qëndrime të kundërta, është jotolerant ndaj bartësve të qëndrimeve të kundërta, duke pasur besim të thellë në parimet, qëndrimet dhe në pikëpamjet e tij.

DOKIMOLOGJI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *δοκιμασία* "provoj", *λόγος* "shkencë, fjalë". Fushë e veçantë

studimore e psikologjisë, pjesë e psikologjisë pedagogjike që merret me studimin sistematik të organizimit, të formave të vlerësimit të drejtë, të saktë, objektiv e të vyeshëm të dijeve, shprehive e shkathtësive të nxënësve, të studentëve dhe të gjithë të tjerëve që duhet ta zotërojnë programin e një lënde mësimore, arritjet në zotërimin e programit gjatë një trajnimi të caktuar. Dokimologjia u përdor për herë të parë nga psikologu francez Anri Pjeron (Henri Pieron, 1881 – 1964).

DOKTRINË, - A. f. Tërësi parimesh të një rryme, të një shkolle që i karakterizon sistemimi i fakteve dhe i raporteve relevante në një shtrirje të gjerë, por edhe me përmasa të konotacionit neutral që zgjojnë ndjenjën e besimit të njeriut në atë sistem mendimesh dhe në parimet e tij. Doktrina shpesh ka predispozita teorike që i kalojnë caqet e hulumtimeve empirike. Doktrinë me këtë kuptim mund të jetë frenologjia, fiziognomika etj.

DOMETHËNIE, - A. f. Kuptim i përmbajtjes dhe i raporteve thelbësore të një objekti, dukurie, procesi etj., që emërtohet me një simbol verbal ose joverbal të caktuar, ose me disa simbole të veçanta. Domethënia e një ose e disa simboleve ka të bëjë me porosinë që bartin ato simbole prej një individi te individi tjetër nëpërmjet një kanali të posaçëm. Në këtë kuptim duhet marrë domethënia e simbolit amvisë, dinjitet i argumentuar, çiltërsi e madhe, shpresë etj. Në psikologji bëhet fjalë për disa lloje domethëniesh:

a. **Domethënie asociative** që ka të bëjë me zgjimin e atyre asociacioneve dhe lidhjeve ndërmjet tyre që në ndonjë formë "prekin" ose përkojnë me simbolin e paraqitur para tij (figurë, fjalë, gjest etj.)

b. **Domethënie denotative** që është formë e domethënies me të cilën përcaktohet, identifikohet domethënia eksplicite e një simboli, shenje, gjesti etj. që emërton objektin, dukurinë, procesin etj. Domethënie të tillë kanë fjalët a simbolet: katror, bimësi, vëmendje, gjest i syve të lëshuar përdhe dhe i buzëve të varura në një mjedis kulturor të caktuar etj.

c. **Domethënie konotative** që është identifikimi implicit i një simboli ose i disa simboleve, përkatësisht domethënia subjektive e një gjesti, fjale, termi etj. Domethënie të tillë kanë simbolet që janë të ngarkuara me emocione, si dashuria, fati, liberalizimi etj. Domethënia konotative emërtohet edhe me termin domethënie afektive.

d. **Domethënie referuese** që emërton një fjalë, një term, një shenjë etj., që udhëzon në dukurinë, qëndrimin, udhëkryqin etj. e caktuar. Domethënie referuese ka ngjyra e kuqe e semaforit, kryqi i gjelbër që ndriçon në fillim të rrugës, simboli me yll pas një fjale në tekstin e caktuar, që udhëzon lexuesin ku ta kërkojë atë fjalë me kuptim të zbërthyer etj.

DOMINIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *dominare* "me dominu, me mbisundu". Përdoret në anatomi, gjenetikë, etologji, politologji, sociologji etj. Në psikologji, tipar i individualitetit të një individi që synon vënien e plotë të tij nën kujdesin e të tjerëve. Në psikologjinë e Henri Marit (Henry Murray, 1893 – 1988) nënkupton nevojën e kontrollit të sjelljeve të individëve të tjerë.

DOMINIMI CEREBRAL. Dominim i funksionit të njërës hemisferë të trurit ndaj hemisferës tjetër në mbikëqyrjen dhe kontrollin e lëvizjeve të njërës pjesë të trupit dhe të gjymtyrëve të asaj pjese, ndaj pjesës tjetër të trupit. Te të majtët mbisundon funksioni i hemisferës së djathtë, te të djathtët dominon funksioni i hemisferës së majtë. Në vend të tij sot përdoret më shpesh dominimi i hemisferave trunore.

DOMINIMI I SYRIT. Dukuri e mbisundimit të të parit të njërit sy ndaj syrit tjetër. Kur lexojmë syri i djathtë tërheq syrin e majtë për t`u fokusuar nga një pikë e fokusit të leximit në pikën tjetër të fokusit të leximit.

DOMINIMI PAMOR. Dukuri e mbisundimit të të parit të dritës e të ngjyrave para dëgjimit të tingujve, kur dy stimujt – drita, ngjyra dhe tingulli – veprojnë në të njëjtën kohë në shqisën e të parit, përkatësisht të dëgjimit**.**

DOPAMINË, - A. f. Lloj hormoni që kryen edhe funksionin e neurotransmetuesit. Dopamina kontrollon funksionin e qendrave motorike të trurit dhe funksionin e proceseve kognitive duke rregulluar pamjen e ngjyrave, duke stabilizuar gjendjen emocionale të dominimit ose të humorit të njeriut dhe zvogëlon ndikimin e prolaktimës. Rezultatet e shumë hulumtimeve kanë vërtetuar se çrregullimi i funksionimit të këtij hormoni dhe i rolit transmetues të tij shpie në shfaqjen e sëmundjes së parkinsonit dhe të paranojës. Disfunksioni i dopaminës shkakton edhe çrregullimin e funksionit të disa proceseve të njohjes, në radhë të parë të kujtesës dhe të vëmendjes.

"DORA". f. Sinonim i pacientes së Zigmund Frojdit, Ida Bauer. Me këtë sinonim Frojdi ka botuar më 1905 argumentet e tij për etiologjinë seksuale të neurozës histerike, të konflikteve dhe metodën e zbatuar më 1900 e 1901 gjatë mjekimit dhe shërimit të saj. Metoda e zbatuar në mjekimin e simptomave të neurozës seksuale te "Dora" ka qenë shpjegimi i ëndrrave të saj dhe metoda e asociacioneve të lira. Zbatimi i suksesshëm i këtyre metodave dhe shërimi i kësaj pacienteje ka treguar dobësitë e metodave të përdoruara para vitit 1900, sidomos të metodës së sugjestioneve dhe të katarsës. Shih – ***SUGJESTIONI; KATARSA***. .

DORA MBIZOTËRUESE. Dora me të cilën njeriu kryen aktivitetin e tij më lehtë, më shpejt dhe më me pak mund e angazhim muskulor se dora tjetër. Te shumica dërrmuese e njerëzve dora e djathtë është dorë mbizotëruese.

DOSJ/E, - A. f. I ardhur nga frëngjishtja *dossier* "mbështetje". Ka gjetur përdorim të posaçëm sidomos në psikologjinë forensike, në psikologjinë klinike dhe në psikologjinë pedagogjike. Dosja është tërësi të dhënash për një njeri, sidomos për sjelljet problematike, si edhe për faktorët që kanë mundur të ndikojnë në zhvillimin e sjelljeve problematike të tij. Dosja paraqet "historikun" e posaçëm për një individ të caktuar dhe për tiparet e sjelljet problematike të tij.

DREJTIMI OPERACIONAL. Drejtim psikologjik sipas të cilit konceptet apo nocionet e psikologjisë duhen përkufizuar në bazë të operacionit që kryejnë kur përcaktojmë përmbajtjen e saktë të një koncepti a nocioni psikologjik.

DREJTIMI PROFESIONAL. Këshillimi i të rinjve për zgjedhjen e profesionit përkatës. Shih – ***ORIENTIMI PROFESIONAL***.

DREJTIMI PSIKOLOGJIK. 1) Vijë e përgjithshme mendore e konceptimit, e përshkrimit dhe e shpjegimit të proceseve dhe të sjelljeve psikologjike dhe orvatja e ithtarëve të saj për ta komentuar me konsekuencë sistemin konceptual psikologjik nga një pikëpamje e caktuar. Drejtimi psikologjik ka si karakteristikë themelore orvatjet për t`i integruar të gjitha të dhënat, faktet, rregullsitë, parimet, ligjet dhe teoritë në një sistem koherent të dijeve psikologjike. 2) Shkollë psikologjike – sistem konceptual relativisht koherent i grupit të caktuar psikologësh me qëndrime dhe pikëpamje integruese për proceset psikike, sjelljet dhe ndryshimet individuale të tyre. Mbi bazën e këtij kuptimi të drejtimit psikologjik janë zhvilluar

PSIKOLOGJIA STRUKTURALISTE;
PSIKOLOGJIA FUNKSIONALISTE;
PSIKOLOGJIA PSIKANALITIKE;
PSIKOLOGJIA REFLEKSOLOGJIKE;
PSIKOLOGJIA BIHEJVIORISTE;
PSIKOLOGJIA GESHTALTISTE;
PSIKOLOGJIA EKZISTENCIALISTE;
***PSIKOLOGJIA HUMANISTE*,**

PSIKOLOGJIA KOGNITIVE – shih. Por, duhet shtuar se asnjëra nga drejtimet psikologjike të sipërpërmendura nuk ka arritur të krijojë sistem gjithëpërfshirës konceptual për proceset psikike dhe sjelljet. Në kuptimin e ngushtë drejtimi psikologjik ka të bëjë me interpretimin e proceseve dhe të sjelljeve nga një këndvështrim i caktuar. Dallojmë këto drejtime psikologjike kryesore:

a) **Drejtimin asociativ** – Interpretim i dukurive psikike në bazë të asocacioneve;

b) **Drejtimin psikodinamik** – Drejtim mendor i karakterit psikanalitik, sipas të cilit theksohet dinamika e pavetëdijes në shpjegimin e aktivitetit të njeriut;

c) Drejtimin kognitiv – Drejtim mendor që thekson rëndësinë e perceptimit, të kujtesës dhe të mendimit e të folurit në organizimin e veprimtarisë së gjithëmbarshme të njeriut;

ç) Drejtimin psikokulturor – Drejtim që i interpreton sjelljet e njeriut duke vënë theksin në rëndësinë e të mësuarit të vlerave sociale e kulturore në procesin e përshtatjes së një individi, një mjedisi e ndryshimeve të tij, si dhe në ndikimin e tij në ndryshimin e atij mjedisi

d) Drejtimin tradicional – Drejtim qëndrimesh, vlerash dhe modele sjelljesh sipas traditës së një populli; nënshtrim i qëndrimeve, i vlerave dhe i sjelljeve traditës së një vendi. Drejtimin e tillë e zhvillon mjedisi shoqëror dhe raportet e ndërsjella të banorëve të atij mjedisi. Është term i koncepteve sociologjike të sociologut amerikan Dejvid Rajsman (David Riesman, 1909 – 2002).

DREJTPESHIMI I ÇRREGULLUAR EMOCIONAL. Ndryshim i gjendjes emocionale të një individi duke mos pasur shkaqe për një ndryshim të tillë. Ndryshime të tilla janë ndryshime të shpeshta prej gjendjes emocionale pozitive në atë negative, përkatësisht prej humorit euforik në depresion dhe në pikëllim dhe anasjelltas, nga depresioni dhe pikëllimi në gjendje euforike. Kjo lëvizje e

ndjenjave dhe ndryshim i gjendjes emocionale të shpejtë pa shkak karakterizon në radhë të parë psikozën maniako – depresive, por shfaqet edhe te fëmijët dhe te disa individë të moshës së pubertetit. Te kjo kategori e drejtpeshimit të çrregulluar emocional ndryshimet e tilla zhduken me kohë. Ndryshime të tilla shfaqen edhe te adoleshentët dhe te individët senilë (të moshuarit) dhe kur këto ndryshime kanë karakter relativisht të qëndrueshëm mund të jenë simptoma të një psikoze të rëndë.

DRESURË, - A. f. I ardhur nga frëngjishtja *dresse* "stërvitje". Formë e të mësuarit të disa lëvizjeve të organizmit që kanë të bëjnë me përshtatjen e aktivitetit të tyre ndaj mjedisit dhe disa ndryshimeve mjedisore. Dresura mbështetet në metodën e të mësuarit sipas fitimit të refleksit të kushtëzuar. Dresura është formë e të mësuarit që haset kryesisht në botën shtazore.

DRILL, - I. m. Formë e të mësuarit deri në shkallën e saktë të ekzekutimit të disa lëvizjeve dhe të sjelljeve të domosdoshme në mjedise karakteristike dhe për nevojat e atij mjedisi. Për herë të parë u përdor në të mësuarit e sjelljeve të ushtarëve të armatës së dikurshme të Prusisë. Sot përdoret rrallë për të emërtuar të mësuarin e shpejtë të atyre lëvizjeve e shprehive të thjeshta për dominimin e veprimeve të domosdoshme për punë të caktuara në procesin e prodhimit.

DRITË, - A. f. Ngacmuese fizike e syrit. Drita është rrezatim elektromagnetik me denduri dhe gjatësi valësh elektromagnetike, që syri i njeriut normal është në gjendje t`i kapë duke reaguar ndaj tyre. Syri i njeriut normal është në gjendje t`i kapë dhe të reagojë në një interval të shkurtër valësh elektromagnetike, që sillet prej rreth 390 – 700 milimikron; nën këtë prag dhe mbi këtë prag syri i njeriut është kryesisht i pandjeshëm. Në psikologji drita përcaktohet si valë elektromagnetike. Karakteristikat e dritës janë:

a. **Denduria e dritës -** fluks i emetuar, i reflektuar nga një sipërfaqe reflektuese e rrezeve të dritës dhe e bartur në sipërfaqen e një trupi të caktuar. Njësia për matjen e dendurisë së rrezeve të dritës është drita e qiriut në një metër katror;

b. **Intensiteti i dritës** - shkalla e ndriçimit të një hapësire, që mund të jetë e ulët, mesatare ose e lartë kur ajo shkëlqen. Intensitetin e dritës e shkakton burimi i fluksit të rrezeve të dritës sipas njësive të një hapësire.

DRITËGJATËSI, - A. f. E metë e të parit të objekteve, të cilën e karakterizon figura e paqartë e objekteve të largëta, në të cilat janë drejtuar sytë e njeriut. Këtë të metë e shkakton thyerja jo e rregullt e rrezeve të dritës së atij objekti në syrin e njeriut dhe paraqitja e figurës së atij objekti pas retinës së syrit. Të parit e tillë korrigjohet me thjerrëza syzash konkave pozitive.

DRITËSHKURTËSI, - A. f. E metë e të parit të qartë të objekteve e të dukurive që ndodhen në afërsi të njeriut. Këtë të metë e karakterizon paqartësia e objekteve të kundruara nga afër, të cilën e shkakton thyerja e rrezeve të dritës e objektit të afërt dhe takimi i këtij fluksi rrezesh para retinës së syrit. Një e metë e tillë shkaktohet nga shkaqe të ndryshme, ndër të cilat dallohet edhe puna e përhershme me objekte të imta. Dallohet dritëshkurtësia e përhershme

dhe ajo zhvilluese. Dritëshkurtësia korrigjohet me thjerrëza negative syzesh.

DROGË, - A. f. Substancë kimike natyrore dhe sintetike me ndikim të fuqishëm në funksionet e organeve, sidomos të sistemit nervor. Droga merret e depërton në organizëm duke shkaktuar ndryshime të mëdha në proceset fiziologjike, por edhe në ato emocionale, kognitive dhe motivuese. Ndikimi i drogës në këtë proces është i madh; ajo ndryshon në thelb sjelljen e individit. Disa nga drogat shkaktojnë përjetim përvojash të çuditshme që shoqërohen me përjetim të ngjyrave të shumëllojshme, disa të tjera shkaktojnë iluzionin e zbutjes së dhembjeve, madje edhe ndryshim të përmbajtjes së vetëdijes së individit – marrës i drogës. Marrja e drogës në fillim shkakton kënaqësi. Pas tolerimit të disahershëm organizmi i një individi fillon të formojë shprehi të marrjes së herëpashershme të drogës dhe në këtë mënyrë bëhet gjithnjë e më shumë i varur nga marrja e saj. Drogat janë të disa llojeve. Dallohen drogat depresive (opiatet, morfina, heroina), drogat stimuluese (amfetamina, kafeja, nikotina).

DSM - IV R. Shkurtesë e manuelit diagnostifikues e statistikor të çrregullimeve mentale. Ky manuel është i katërti me radhë dhe ka pak ndryshime nga të tjerët të mëhershëm. Përndryshe DSM është akronim i doracakut diagnostik e statistikor "Diagnostic and Statistical Manual". DSM është doracak i Shoqatës të Psikiatërve Amerikanë (APA). Rishikimi i fundit i këtij doracaku u krye më 1994 dhe titullohet DSM 4 – TR, që ndryshon nga manuali ndërkombëtar ISD 10. Konsiderohet se DSM 4 – TR është më i përshtatshëm për diagnostikimin e çrregullimeve psikologjike, sepse ka 230 diagnoza të ndara në 16 kategori kryesore.

DUA MATER. I ardhur nga latinishtja. Cipa e hollë mbështjellëse e trurit dhe e palcës kurrizore në anatominë e sistemit nervor. Kjo cipë përbëhet nga indet e fijezave të forta nervore dhe lidhet me dy cipat e tjera të trurit e të palcës së kurrizit. Kjo strukturë e ndërlidhur nervore mbron indet nervore nga ndikimet dëmtuese të sistemit nervor.

DUALIZ/ËM, - MI. I ardhur nga latinishtja që prek edhe zhvillimin e mendimit për dukuritë psikike dhe dukuritë fiziologjike, përkatësisht problemin psikikë – trup**.** Dualizmi emërton konceptin e përgjithshëm sipas të cilit në natyrë ekzistojnë dy botë, dy entitete, dy parime themelore në të cilat mbështetet zhvillimi i gjithësisë. Në historinë e psikologjisë përmendet më tepër mendimtari i njohur francez Rene Dekarti (René Decartes, 1596 – 1650). Por, para tij dallimin ndërmjet mendjes dhe trupit e ka shpjeguar Platoni. Dallojmë pikëpamjen e dualizmit klasik, që merr në konsideratë që mendja dhe trupi janë entitete të ndryshme, por qëndrojnë në raport interaktiv. Dualizmi paralel konsideron se proceset mentale dhe proceset fiziologjike janë të procese të ndërlikuara të organizmit, por funksionin e tyre e zhvillojnë në mënyrë paralele. Themeluesi i psikologjisë strukturaliste Eduard Tiçener (Edward Titchener, 1867 – 1927) ka shfaqur pikëpamjet e tij për dualizmin psikofizik. Dualizmi psikofizik konsideron se ekzistojnë dy substanca "res cognitas" – "trupi mendor" dhe "res extensa" – "trupi material që shtrihet". Këto

dy substanca janë të pavarura e nuk ndikojnë te njëra-tjetra. Megjithëkëtë, këto substanca kanë një pikë takimi trupor. Pikëtakimi i tillë është gjëndra pineale në trurin e njeriut.

DUF, - I. m. Ndjenjë negative në trajtë afekti. Dufi është energji e grumbulluar e zemrimit e lidhur me inat dhe me xhelozi, që shpërthen pothuaj befas, por me intensitet të lartë. Ka veçoritë e gjendjes afektive të njeriut, duke u manifestuar në formë gati të pamundur për të kontrolluar proceset psikike dhe sjelljet e veta. Grumbullimi i dufit dhe paaftësia e njeriut për të zbutur duke gjetur arsyetime për të, është ngarkesë psikike dhe mundim i posaçëm i tij.

DUHAN, - I. m. Bimë, përpunimi i së cilës në fabrika prodhon duhanin ose cigaren, në përdorimin e përgjithshëm. Pirja e duhanit është varësia më e madhe njerëzore nga bima e duhanit. Prija e duhanit stimulon nivelin e aktivitetit të disa grupeve neuronesh të sistemit nervor autonom, sidomos në neuronet e ganglioneve të themelit të trurit. Thithja e tymit të duhanit ka disa efekte psikologjike, sidomos në sferën e ndryshimit të gjendjeve emocionale. Te disa "duhanxhinj" mënjanon frikën, kurse te disa të tjerë e shton nivelin e frikës ndaj një dukurie përcjellëse. Vesi i thithjes së tymit të duhanit është ndër veset e rralla jashtëzakonisht të vështirë për tu larguar. Për këtë shkak ky ves zhduket me vështirësi të madhe.

DUKURIA. Shih – ***FENOMENI.***

DURIM, - I. m. Gatishmëria psikike e njeriut për t`u përballuar me pengesat, vështirësitë, shqetësimet, vuajtjet etj. dhe për të reaguar ndaj tyre me gjakftohtësi, me qetësi dhe pa u ankuar ndaj të tjerëve. Durimi shfaqet ndaj vështirësive që njeriu has në angazhimet e tij për të realizuar ambiciet, dëshirat, synimet etj.

DYSHIM, - I. m. Qëndrim i përgjithshëm i mosbesimit dhe i pasigurisë së një individi në pikëpamjen, qëndrimin, propozimin etj. e paraqitur nga individi tjetër, kur ka edhe argumente që nuk përputhen plotësisht me përmbajtjen e mendimeve të paraqitura në forma të ndryshme. Dyshimi paraqitet sidomos ndaj çiltërisë së të tjerëve. Dyshimi mund të marrë edhe karakterin e tiparit të individualitetit. Dyshimi i përket tiparit të individualitetit, atëherë kur ai merr karakter të qëndrueshëm dhe shfaqet përherë me mosbesim, skepticizëm dhe në përmbajtjen e individit për t`u deklaruar në favor të një mendimi apo kundër tij. Baza e tiparit të dyshimit është frika e individit nga cenimi i pozitës sociale, i autoritetit, i vetëbesimit etj.

DYSHIMI KARTEZIAN. Koncept i dyshimit i cilësuar nga filozofi francez René Dekart. Sipas tij njohja duhet me qenë e sigurt, e plotë dhe e pashoqëruar me dyshime. Për të arritur deri në një njohje të tillë njeriu duhet të çlirohet nga çdo paragjykim dhe gjykim për të arritur deri në këtë njohje objektive Dekarti e ka konsideruar metodë njohëse qasjen e njohjes duke u çliruar nga ndjenjat, paragjykimet, qëndrimet, mendimet stereotip etj.

DYSHIMI OBSESIV. Pushtim i njeriut të caktuar nga dyshimi i disa veprimeve të zakonshme që ai i kryen, por që më pas dyshon se atë detyrë, mendim etj. e ka kryer. Megjithëse e ka mbyllur derën e shtëpisë, të dyqanit etj. ai dyshon dhe prapë kthehet për ta vërtetuar dhe për të qenë i sigurt.

DH

DHEMB/JE, - JA. f. Ndijim jashtëzakonisht i madh i pakënaqësisë që shkakton vuajtje fizike ose psikike dhe fiziko-psikike të organizmit. Dhembja dhe frika është faktori kryesor i procesit të vetëruajtjes së organizmit dhe zhvillimit të tij. Dhembja shkaktohet nga stimujt e fuqishëm elektrikë, mekanikë, kimikë etj., që ushtrojnë ndikim në një organ ose në organizmin e njeriut. Dhembja është një tregues që vë në dijeni organizmin për t`u larguar nga stimujt e dëmshëm. Dhembja ka bazë fiziologjike, neurologjike dhe psikologjike, si edhe shfaqet në forma të veçanta të saj. Në psikologjinë klasike ekzistojnë receptorë të posaçëm për dhembjen. Sot rezultatet e hulumtimeve neurologjike e receptore nuk kanë arritur t`i identifikojnë saktësisht receptorët e posaçëm të dhembjes. Hulumtime të tilla kanë vërtetuar se impulset nervore që bartin informacione për dëmtimin e organizmit ose të një pjese të tij arrijnë deri në palcën kurrizore, prej nga barten në talamus dhe prej këndej arrijnë deri në bazën e trurit të madh. Organizmi i njeriut i përshtatet me vështirësi ndijimeve të dhembjes, të cilat shfaqen me disa ndryshime fiziologjike të trupit të njeriut. Ndër këto ndryshime dallohen: ngritja e presionit të gjakut, përshpejtimi i rrahjes së zemrës e të pulsit etj. Kuptimi i saktë i stimujve të dhembjes është përgatitja e organizmit për të përballuar ndikimet dëmtuese dhe për të bërë të mundur një durim të veçantë. Dallohen këto lloje të dhembjes:

a. **Dhembja akute** – Dhembje e menjëhershme me fuqi prerëse që zgjat rreth tre muaj. Dhembja akute mund të jetë shenjë e mundësisë së shfaqjes së ndonjë sëmundje. Kjo dhembje rrjedh nga goditja e indeve; me rigjenerimin e indeve largohet edhe dhembja akute;
b. **Dhembja fantom** – Dhembje që është e pranishme edhe në rastet kur individit i janë amputuar gjymtyrët, njëra prej tyre ose kur njeriu ka pësuar paralizë gjymtyrësh;
c. **Dhembja kronike** – dhembje që zgjat më shumë se gjashtë muaj. Shkaktohet si pasojë e depresionit, frikës, ankthit, traumës etj. Dhembja kronike ndikon negativisht në veprimtarinë e njeriut.

d. **Dhembja psikogjene** – Lloj dhembjeje që shkaktohet nga faktorë psikologjikë emocionalë, kognitivë, madje edhe motivues. Faktorë të dhembjes psikogjene mund të jenë pikëllimi, zemërimi, inati etj.

DHEMBSHURI, - A. f. Ndjenjë e ndërlikuar që ka përmasa të empatisë dhe shkaktohet nga keqardhja, hidhërimi, zemërimi etj. i një individi për gjendjen e vështirë materiale, morale e psikike të një shoku, miku, fqinji etj., ndaj të cilit ushqen dashuri e respekt**.**

DHËNA PSIKOLOGJIKE (E). Fakte psikologjike ose grup faktesh me cilësi karakteristike që mblidhen, klasifikohen dhe më pas i nënshtrohen përpunimit statistikor. E dhëna psikologjike ka të bëjë me procesin, dukurinë, vetinë, sjelljen, me konstruktin etj. psikik të caktuar. Të dhënat psikologjike mund të emërtohen me simbole, me shenja të veçanta, por identifikimi, si edhe në grumbullimi dhe klasifikimi i tyre arrihet me veprimtari të organizuar.

DHËNA SHQISORE (E). Përjetim elementar i cilësisë pamore, dëgjimore, nuhatore, etj. i një stimuluesi të jashtëm ose të brendshëm, që lind nga ndikimi i atij stimuluesi ose ngacmuesi në receptorin e organit përkatës shqisor. Ky do të ishte përcaktimi i të dhënës shqisore nga ana e psikologjisë strukturaliste. Por sot, shumë psikologë mohojnë mundësinë e ekzistencës së të dhënës shqisore të kulluar, të pastër, pa përpunim të emërtimit, të përvojës, të rinjohjes së atij stimuluesi.

DHËNAT Q (TË). Njëri ndër tre burimet e të dhënave të përftuara nga zbatimi i pyetësorit e personalitetit ose nga intervista diagnostifikuese e bazuar në vetëvëzhgim dhe vetëvlerësim të atij që provohet. Q të dhënat është term i psikologjisë së personalitetit të Rejmond B. Katelit (Reymond B. Catell, 1905 – 1998), ku dallohen edhe dy burime të dhënash: L të dhënat dhe T të dhënat.

DHOMA AMES. Dhoma e psikologut amerikan Albert Ames (Albert Ames, 1880 – 1955), i cili ka demonstruar rolin e thellësisë së objekteve në paraqitjen e perceptimit të iluzionuar. Kjo dhomë ka pamje muresh asimetrike, ku tre muret kanë formë trapezoidësh, kurse muri i tavanit duket me formë paralelopipedi. Kur vështrohet me një sy pamja e dhomës nga një kënd i parjes dhoma perceptohet ashtu qysh është. Pavarësisht nga lartësia dhe thellësia e parregullt. Por, kur e njëjta vështrohet me dy sy njerëzit dhe objektet e tjerë duken të mëdhenj e të vegjël. Kështu, dy njerëzit që perceptohen në këtë dhomë asimetrike janë të së njëjtës madhësi, por i pari duket i rritur, kurse i dyti me të njëjtën madhësi duket i vogël. Këtë iluzion e shkakton përvoja dhe dijenia e subjektit se dhomat kanë formë katërkëndëshe simetrike. Nga historia e këtij iluzioni mësojmë se kjo dukuri lidhet me emrin e fizikanit gjerman Herman Helmholc (Hermann Helmcholtz, 1821 – 1894). Dhomën Ames e ilustron figura e mëposhtme:



DHUNË, - A. f. Veprim i qëllimshëm i një individi për ta detyruar individin tjetër me mjete fizike a psikike që t`i nënshtrohet interesave, synimeve e dëshirave të tij. Dhuna ushtrohet zakonisht me mjete dhe metoda fizike, morale, psikike etj. Qëllimi i individit që ushtron dhunë është që ta detyrojë individin tjetër që të bëjë diçka jashtë vullnetit e dëshirave të tij.

DHUNA ETNIKE. Dhunë e qëllimshme dhe agresive e një individi apo e një etnie e ushtruar për dëmtimin e një individi apo etnie tjetër. Dhuna etnike shfaqet me nxitje të urrejtjes, asgjësim të pronës, shpërngulje të detyrueshme, madje edhe me eliminim fizik të pjesëtarëve të etnisë së caktuar. Ndër faktorët motivues të dhunës etnike mund të jenë paragjykimet, synimet politike, sjelljet stereotip etj.

DHUNA SEKSUALE. Trajtimi i trupit të një individi femër apo mashkull si objekt i kënaqësisë dhe i veprimit seksual ndaj saj apo tij pa dashjen e kësaj apo këtij të fundit. Dhuna seksuale përfshin këto akte: abuzimin seksual, frikësimin, përdhunimin, keqtrajtimin seksual etj.

DHUNSH/ËM, - ME (I, E). mb. që bëhet me dhunë, që ka karakter të dhunës. I dhunshëm mund të jetë mendimi, neuroza, përfytyrimi, veprimi etj.

DHUNTI, - A. f. Strukturë kognitive e lartë, e gatshme për t`u zhvilluar lehtë në sajë të veprimtarisë së individit, të kushteve e të raporteve që ushtrojnë ndikim pozitiv në zhvillimin e saj. Dhuntia shfaqet në moshën e hershme kryesisht me nivelin e lartë të cilësisë së aktivitetit të një fushe të caktuar.

E

E = simbol për grupin eksperimental;

E = energjia;

E = konstrukte teorike të procesit të të mësuarit në teorinë e Hallit.

EBINGHAUZ Herman (**Hermann EBBINGHAUS**). Psikolog gjerman bashkëthemelues i psikologjisë eksperimentale. Lindi në Barmen më 24.01.1850 dhe vdiq në Halle të Gjermanisë më 26.02.1909. Ka qenë profesor i psikologjisë në Universitetin e Berlinit, të Bratislavës (Poloni) dhe në Universitetin Hale. Përfaqësues eminent i psikologjisë eksperimentale, sidomos në studimin e proceseve të larta psikike, e veçanërisht të të mësuarit, të kujtesës e të harresës. Herman Ebinghauzi ka studiuar kujtesën dhe harresën në kuptimin e mirëfilltë, duke mënjanuar përvojën, proceset e mendimit dhe emocionet për lëndën që mësohej. Për këtë qëllim ai ka përdorur rrokjet si lëndë e të mësuarit dhe e të mbajturit mend (*cik, nem, zap* etj.), duke u bërë edhe vetë subjekt i kësaj ndërmarrjeje studimore që atëherë ishte ndërmarrje studimore epokale. Po ashtu, Herman Ebinghauzi zbatoi metodën e kursimit të asaj që është mësuar në raport me kohën. Këtë metodë e zbatoi në këtë mënyrë: subjekteve u dha të mësojnë një listë prej 12 rrokje, duke matur numrin e përsëritjeve, derisa ata të arrinin ta përsëritnin listën e rrokjeve dy herë pa asnjë gabim. Më pas i la të qetë (të luanin, të mësonin një lëndë tjetër, të flinin etj.) dhe i ftonte ta përsërisin listën e mësuar pas 20, 30, 60 minutash, pas 24 orësh, pas 6 ditësh dhe pas 31 ditësh. Meqë harresa kishte shkaktuar rrënimin e disa rrokjeve që i kishin përvetësuar plotësisht më parë, ai kërkonte prej tyre t`i mësonin rishtas, duke matur njëkohësisht numrin e përsëritjeve dhe kohën e duhur për t`i zotëruar plotësisht rrokjet e asaj liste. Ebinghauzi konstatoi se pas 20 minutash subjektet kishin kursyer 58,2 % të kohës për ta zotëruar materialin e mësuar më parë; pas 24 orësh ata kishin kursyer 33,7 % të kohës; pas 6 ditësh ata kishin kursyer 25, 4 % të kohës, kurse pas 31 ditësh ata kishin kursyer 21,1 % të kohës në raport me kohën që kishin humbur, duke mësuar atë rrokje kur qenë ballafaquar për herë të

parë me të mësuarit e tyre. Mbi bazën e rezultateve të arritura ai konceptoi ligjin Ebinghauz të mbajtjes mend dhe lakoren e harresës. Veprat kryesore të tij janë: *"Grundzüge der Psychologie I – II"* – (*"Bazat e psikologjisë I – II",* 1897 – 1902); *"Abris der Psychologie"* – (*"Skica e psikologjisë",* 1908); *"Memory: A Contribution to Experimental Psychology"* – *"Kujtesa – Një kontribut në psikologjinë eksperimentale",* 1885).

E

EDIP, - I. m. Emër i njohur në mitologjinë greke. Edipi ishte bir i mbretit Laj dhe i mbretëreshës Jokasta, më vonë mbret i Tebanës në Greqinë Antike. Edipi pa ditur kishte mbytyr të atin – mbretin Laj dhe ishte martuar me të ëmën, Jokastën, me të cilën pati katër fëmijë. Pas shumë kohësh, kur mori vesh të vërtetën Jokasta u vetëvra, kurse Edipi nxorri sytë. Qëndrimi emocional i djalit ndaj të ëmës është dhe xhelozia ndaj të atit, dukuri e përgjithshme e raporteve ndërmjet djalit dhe nënës, babait e bashkëshortes së tij. Këtë raport ndërmjet djalit – nënës – babait, pikërisht bashkëshortit të nënës së djalit Zigmund Frojdi e quajti Kompleks i Edipit. Shih – ***KOMPLEKSI I EDIPIT***.

EDUKATË, - A. f. Dukuri kryesore dhe e përhershme shoqërore dhe koncepti themelor i pedagogjisë. Edukata është proces sistematik dhe i vetëdijshëm që ka të bëjë me bartjen e përvojës shoqërore e historike të brezave të mëparshëm te brezat e rinj, me qëllim të afrimit psikofizik të secilit, për të kryer me sukses rolin e tyre shoqëror të së tashmes dhe në të ardhmen. Në bazë të kësaj bartjeje ruhet vijimësia e një procesi të tillë. Në këtë kuptim te edukata hyjnë ndikimet e vetëdijshme familjare, shkollore dhe të institucioneve të tjera shoqërore. Me anë të edukimit arrihet zhvillimi i sistemit të dijeve, të shkathtësive, të shprehive, të qëndrimeve, të vlerave dhe të sistemit të tyre. Në këtë mënyrë edukata duhet dalluar nga arsimimi dhe të mësuarit.

EFEKT, - I. m. I ardhur nga latinishtja *effectus* "produkt, veprim". Një ngjarje, një proces, një dukuri etj. që është pasojë e një ose e disa shkaqeve. Kështu duhet kuptuar të zotëruarit e një liste fjalësh të gjuhës angleze nga përsëritja e mjaftueshme e tyre. Në këtë rast efekti i përsëritjeve është përvetësimi i listës së atyre fjalëve. Efekti në statistikë emërton dallimet ndërmjet dy vlerave mesatare që janë pasojë e efektit të ndryshoreve të çfarëdoshme që provohen në laboratorin hulumtues.

EFEKTET E SOCIALIZIMIT. Tërësia e ndikimeve të mjedisit shoqëror te një individ i caktuar dhe në zhvillimin e formimin e personalitetit dhe, sidomos të karakterit dhe tipareve të tij. Efekte të socializimit janë: gjuha e ligjërimit, mënyra e mendimit dhe e të folurit, motivet sociale, qëndrimet, vlerat, tiparet karakteristike të sjelljes së njeriut etj.

EFEKTI AUTOKINETIK. Formë e iluzionit lëvizor. Shfaqet me dukurinë e përjetimit të lëvizjes së një pike ndriçuese në dhomën e errët nga e majta në të djathtën deri në 20 gradë, kur ajo praktikisht është e palëvizshme. Kjo dukuri iluzore nuk është e lidhur me lëvizje të kokërdhokut të njërit sy dhe të tjetrit.

EFEKTI CAJGARNIK. Emërtimi i dukurisë së mbajtjes mend për një kohë më të gjatë dhe më mirë të fakteve dhe të dhënave të një situate

problemore të pazgjidhur ndaj asaj të zgjidhur. Detyrat e pakryera, të papërfunduara etj. mbahen mend më mirë dhe më gjatë se detyrat e përfunduara. Termi rrjedh nga psikologjia ruse e Bluma Cajgarnik (Blumma Zeigarnik, 1900 – 1988).

EFEKTI HALO. Ndikimi që ushtron prirja dhe vlerësimi i përgjithshëm tashmë i formuar nga ana e një individi për një individ, objekt, dukuri etj. në perceptimin e një karakteristike të atij individi, objekti e dukurie. Nëse kemi një përshtypje a qëndrim të përgjithshëm negativ për një individ, atëherë e vlerësojmë negativisht edhe një veti të veçantë të tij dhe përkundrazi. Efekti halo shfaqet sidomos në vlerësimin e një tipari nga ndikimi që ushtron përshtypja e përgjithshme e tij në atë tipar. Ky efekt shfaqet edhe atëherë kur një tipar i theksuar i një individi ndikon në vlerësimin e përgjithshëm të atij individi. Termi efekti halo u përdor për herë të parë nga psikologu amerikan Frederik L. Uells (Frederick L. Wells, 1884 – 1964), por edhe më vonë e përforcoi përdorimin e tij Eduard Torndajk (Eduard Torndike,1878 – 1949).

EFEKTI I ASIMILIMIT. Përjetim i veçantë i nivelit të përvetësimit të një qëndrimi të ri për një çështje, meqë ai i afrohet më tepër qëndrimit të vjetër të një subjekti për atë çështje, që është dallimi i vërtetë ndërmjet këtyre dy qëndrimeve te i njëjti subjekt. I tillë efekt ndodh sidomos, kur intensiteti i qëndrimit të ri hyn në fushën e pranimit të atij qëndrimi.

EFEKTI I ATMOSFERËS. Ndikimi i kushteve dhe i raporteve të përgjithshme të një mjedisi në shfaqjen e reagimeve të njeriut ndaj një dukurie. Efekti i atmosferës së këndshme të një mjedisi shoqëror është në përshtatje me sjelljet dhe emocionet e një anëtari të atij grupi, me atmosferën emocionale e sociale të përgjithshme. Efekti i atmosferës shfaqet edhe në procesin kognitiv të përfundimit, kur premisat pozitive shpin në përfundim pozitiv, pavarësisht se ky përfundim është i gabueshëm, si: të gjitha këto ëmbëlsira janë me çokollata, të gjitha çokollatat janë të këndshme, prandaj, ëmbëlsirat me çokollata janë të këndshme. Efekti i atmosferës është term i vjetër i psikologjisë.

EFEKTI I IZOLIMIT. Mbajtja mend më lehtë, më shpejt dhe për një kohë më të gjatë e atyre elementeve që ndryshojnë shumë nga forma, madhësia, gjatësia etj. nga të tjerët që kanë formë, madhësi, gjatësi etj. të njëjtë. Efekti i izolimit tregon se më lehtë mësohen elementet e theksuara, të izoluara në perceptim, të mësuarit e një serie rrokjesh, fjalësh të huaja etj., se elementet e tjerë që dallojnë pak ndërmjet tyre. Efekti i izolimit shfaqet më tepër gjatë të mësuarit mekanik. Këtë dukuri e ka identifikuar psikologia gjermane Hedvig fon Restorf (Hedwig von Restorff, rreth vitit 1939).

EFEKTI I KËNAQËSISË. Parimi i përgjithshëm i të mësuarit sipas të cilit përmbajtjet që sjellin kënaqësi mësohen më lehtë dhe më shpejt dhe, po ashtu, mbahen mend për një kohë më të gjatë se përmbajtjet që mësohen me zor dhe për atë që i mëson shkaktojnë pakënaqësi. Shpërblimi, cilësimi para të tjerëve për atë që ka mësuar fëmija ka efekt motivues, sepse shkakton kënaqësi. Por, kjo është e lidhur edhe me individualitetin e atij që mëson.

EFEKTI I KONTEKSTIT. Trajtimi i një ngacmuesi apo reagimi ndaj tij në kuadrin e kontekstit ku ai gjendet. Çdo normë e ndërlikuar e të mësuarit dhe rezultatet e saj realizohen në kuadrin e një konteksti të caktuar, i cili ndikon në përvetësimin e një mendimi, të një reagimi, sjelljeje etj. Ndikimi i kontekstit argumentohet me faktin se diçka e re në kujtesë, në mendime, në veprime etj. nuk ndodh në kurrfarë vakuumi psikik. Në kuadrin e dy qëndrimeve efekti i kontrastit shfaqet në dallimin e një qëndrimi të një situate të re nga efekti apo intensiteti i mëparshëm i qëndrimeve të tilla. Ky dallim nuk i përgjigjet saktësisht qëndrimit të subjektit ndaj njërit qëndrim apo tjetrit. Kjo ndodh atëherë kur intensiteti i qëndrimit të ri nuk hyn në fushën e intensitetit të qëndrimeve të tij, por hyn në fushën e refuzimit të qëndrimeve.

EFEKTI I LIGJIT EMPIRIK. Lloj reagimi, sjelljeje e mësuar që ruhet në kujtesë dhe shfaqet përsëri në situata të njëjta ose të ngjashme ku gjendet individi, atëherë kur ai reagim, ajo lloj sjelljeje është ushqyer, është vlerësuar dhe individi ka marrë shpërblim për të. Reagimet dhe sjelljet e "shuajtura", ndaj të cilave njeriu është indiferent, harrohen më shpejt. Një efekt të tillë e ka përshkruar Eduard Torndajk (Edward Thorndike, 1874 – 1949) qysh më 1904, në një ligj të formuluar në këtë mënyrë: "Çdo akt që në një situatë të dhënë shpie në kënaqësi do të jetë i lidhur me atë situatë në atë mënyrë që, kur të përsëritet kjo situatë, të rritet shkalla e probabilitetit se ai akt do të përsëritet. Përkundër kësaj, çdo akt në situatën e dhënë që shpie në pakënaqësi ndahet nga ajo situatë në atë mënyrë që, kur situata përsëritet, shkalla e probabilitetit të jetë më e vogël që ai akt të përsëritet". Sot flitet për përforcim të një akti të caktuar e jo për kënaqësi e pakënaqësi. Për këtë shkak efekti i ligjit të E. Torndajkut ka më tepër vlerë historike.

EFEKTI I PASNDIKIMIT TË NGACMUESIT. Shfaqja e funksioneve fiziologjike të një shqise ose e disa shqisave dhe shfaqja e pavullnetshme e përmbajtjeve psikologjike pas ndërprerjes së ndikimit të një ngacmuesi në një shqisë të caktuar ose në shqisa të njeriut. Efektet e tilla janë më të shpeshta në shqisën e të parit dhe më rrallë në atë të dëgjimit. Shih – ***FIGURAT PASNGACMUESE.***

EFEKTI I PËRGJITHËSIMIT. Ndikimi që ushtron mendimi i përgjithësuar për kënaqësinë dhe karakterin dëmtues të ngacmuesve të caktuar në njohjen e lehtë e të shpejtë të një koncepti, një stimuluesi në përzgjedhjen e reagimit, të sjelljes etj. Termi efekt i përgjithësimit është trajtuar për herë të parë në psikologjinë e të mësuarit nga psikologu Eduard Torndajk (Edward Thorndike, 1874 – 1949).

EFEKTI I PLATOS. Angazhim i kufizuar i një individi në përparimin e zotërimit të një lënde, të një gjuhe etj. ngaqë ka arritur "platon" - maksimumin e mundshëm, shih – ***PLATO*** dhe përtej kësaj shkalle nuk vlen të angazhohet më. Efekti i platos në statistikën psikologjike ka kuptim të veçantë: pamundësi e regjistrimit të të gjitha ndryshimeve individuale në hulumtimin e një ndryshoreje a variabli te një grup subjektesh, nga shkaku se shumica e tyre e kanë arritur këtë platon, shkallën më të lartë të zhvilli-

mit të asaj ndryshoreje. Kjo shkakton asimetri në shpërndarjen e të dhënave të vëzhguara.

EFEKTI I PURKINIT. Ndryshimi i shkallës së ndriçimit të një sipërfaqeje të ngjyrosur me ndonjërën prej ngjyrave themelore kromatike kur intensiteti i dritës bie mbi ngjyrën e asaj sipërfaqeje. Ngjyra e kuqe e një sipërfaqeje të një figure në dritën e ditës ka ndriçim të nivelit të lartë, kurse në errësirë e njëjta ngjyrë duket e errët. I njëjti efekt shfaqet edhe në rastin e ndikimit të ngjyrave të tjera kromatike: ngjyra e kaltër e një veshjeje gjatë ditës ka ndriçim të nivelit të lartë, kurse në terr e njëjta ngjyrë humb ndriçim e saj të ditës. Në këtë pikëpamje më pak ndryshime pëson ngjyra e gjelbër; ngjyra e gjelbër e një fustani nën dritën e ditës duket e ndritshme, por ajo nuk e ndryshon shumë cilësinë e ndriçimit edhe gjatë natës. Një efekt të tillë e ka zbuluar fiziologu çek me origjinë gjermane Johanes Purkinje (Johanes Purkyne, 1787 – 1869) dhe sipas emrit të tij efekti quhet efekti i Purkinit.

EFEKTI I VENDNDODHJES SË FAKTEVE. Dukuria e të mbajturit mend në mënyrë mekanike e fakteve të vendosura në fillim dhe në mbarim të një liste rrokjesh, numrash, fjalësh, nga të tjerat që gjenden ndërmjet fakteve të fillimit dhe të mbarimit të asaj liste, pikërisht të fakteve që gjenden në mes të asaj liste, të cilat mbahen mend më me vështirësi.

EFEKTI KINETIK I THELLËSISË. Dukuria e perceptimit dydimensional të një organizimi të dhënash në një tërësi të veçantë kur njeriu gjendet në pozicion të ulur, të shtrirë etj., ndërkaq kur i njëjti njeri gjendet në lëvizje, atëherë ai atë tërësi e percepton në trajtën tripërmasore.

EFEKTI PLACEBO. Ndikim veprues i një substance neutrale që është i ngjashëm me ndikimin veprues të një substance të vërtetë dhe efikase në qetësimin e organizmit. Efekti placebo ka të bëjë kryesisht në lehtësimin e dhembjeve nga besimi i pacientit se ai ka marrë "ilaçin", përkatës, kurse në të vërtetë ai ka marrë injeksion uji. Shkaku i vërtetë i lehtësimit të dhembjeve ka të bëjë me ndërhyrjen kirurgjike, me endorfinat etj. Zbatohet edhe në situata eksperimentale të caktuara.

EFEKTI RESTORF. Në psikologjinë e të mësuarit dhe të kujtesës është efekti i të mësuarit më shpejt dhe i mbajtjes mend më lehtë të atyre fjalëve, formulave, numrave etj. që dallohen nga të tjerët për nga forma, madhësia, ngjyra etj. Efekti i tillë u dallua nga psikologu gjerman Hedvig fon Restorf (Hedwig von Restorff, rreth vitit 1939).

EFEKTI ROZENTAL. Verifikimi i vlerës shkencore të ndikimit të besimit, të bindjeve, të qëndrimeve etj. të eksperimentuesit në rezultatin e ndryshores psikologjike të gjurmuar. Udhëzimi i një gjurmuesi të veprimeve të minjve se me një grup minjsh ka të bëjë me ata inteligjent, kurse me grupin tjetër ka të bëjë me grupin e minjve jointeligjent (në të vërtetë ka pasur të bëjë me të njëjtin grup minjsh) ka ndikuar në rezultatin përfundimtar të gjurmimit. Ky efekt doli nga rezultatet gjurmuese të psikologut amerikan të lindur në Gjermani Robert Rozental (Robert Rosenthal, 1933 –).

EFEKTI STRUP. Efekt i identifikuar nga gjurmimet e proceseve fjalësore ose verbale që u dallua në eksperimen-

tet e psikologut amerikan Xh. R. Strup (J. R. Stroop, 1930–). Ky psikolog kërkoi nga subjektet emërtimin e saktë të ngjyrave të shkruara me ngjyrë jo të përshtatshme me natyrën e ngjyrës, si: fjala e kuqe është shkruar me ngjyrë të kaltër, fjala e gjelbër me ngjyrë të verdhë, fjala e kaltër me ngjyrë portokalli etj. Në serinë e dytë të eksperimentit subjektiv janë paraqitur vetëm pika ngjyre dhe nga ata është kërkuar emërtimi i tyre. Ky gjurmues ka dalluar se koha e emërtimit të ngjyrave në serinë e parë ka qenë më e gjatë se në të dytën. Kjo është shkaktuar nga mospërputhshmëria e fjalës së shkruar me ngjyrën që nuk i përket asaj fjale. Këtë dallim kohor Xh. R. Strupi e ka quajtur efekti Strup.

EFEKTI TARHANOV. Formë e reagimit elektrik të lëkurës së njeriut që shfaqet me ndryshime të nivelit të ulët të intensitetit elektrik të lëkurës dhe është i lidhur me disa ndryshime në qarkullimin e gjakut. Këtë energji elektrike e prodhon vetë organizmi i njeriut dhe ndryshimet e intensitetit të tij maten me galvanometër të posaçëm. Ky efekt manifestohet në mënyrë të veçantë në procesin e ndryshimeve emocionale të njeriut. Mori emrin sipas fiziologut rus Ivan R. Tarhanov (Ivan R. Tarchanoff, 1846 – 1908).

EFEKTI TAU. Formë e iluzionit pamor të lëvizjes. Nëse i ndezim njëri pas tjetrit tre qirinj, A, B, C dhe nëse, koha ndërmjet ndezjes së qiriut A e B është më e gjatë se ajo ndërmjet B e C shkakton përjetimin e perceptimit iluzor të largësisë më të madhe të qiriut A e B se ndërmjet A e C. Këtë iluzion e shkakton dallimi kohor ndërmjet ndezjes së qiriut A e B nga ai B e C.

EFEKTIVITETI. m. Gatishmëria e njeriut e lidhur me aftësinë e përgjithshme për t`u ballafaquar me dukuritë e gjësendet e rrethit të tij dhe për t`i zotëruar ato (në njohjen, sjelljen ndaj tyre etj.) Në leksikun e psikologjisë së Alfred Adlerit (1870 – 1937) theksohet motivi i përgjithshëm i individit për mos qenë inferior.

EFEKTOR, - I. m. Muskuli ose gjëndra e caktuar që realizon një aktivitet të caktuar, për shkak të bartjes së impulseve nervore nga qendra trunore në këtë muskul ose gjëndër. Me anën e impulseve nervore që vijnë nga qendra trunore në muskujt e organeve të organizmit dhe në gjëndra trupi i njeriut realizon lëvizjet dhe ndryshimet në organizmin e tij dhe ndaj ngacmuesve të jashtëm. "Rruga" e bartjes së impulsive nervore nga qendra trunore në muskuj dhe në gjëndra është rruga eferente.

EFERENT, - E. mb. I ardhur nga latinishtja *efferents* "nxjerrje", që emërton tubat e fijëzave nervore dhe "rrugën" bartëse të impulseve nervore nga qendrat e trurit në pjesët periferike të organizmit, në muskujt dhe në gjëndrat e organeve periferike, si edhe në disa organe qendrore të tij. Me këtë term emërtohen edhe impulset nervore që barten prej një qendre nervore në një tjetër qendër nervore në disa tekste të fiziologjisë.

EGO, - JA. I ardhur nga latinishtja *ego* "unë". Emërton konceptin e tërësisë së proceseve psikike dhe të sjelljeve të njeriut, bërthamën qendrore nga e cila buron energjia rregulluese dhe veprimtaria e vetëdijshme e njeriut. Egoja, një ndër përbërësit e aparatit psikik në mendimin psikanalitik të Z.

Frojdit, është njëra ndër tri strukturat e personalitetit – e pikërisht, rregullatorja e sistemit të veprimeve të vetëdijshme të tij. Në teorinë strukturore të personalitetit egoja kryen aktivitete të rëndësishme racionale; rregullon marrëdhëniet e njeriut me botën e jashtme, përcakton karakterin e ndjenjave dhe zgjedhjen e aktiviteteve të njeriut, kontrollon dhe rendit të parat impulset e shtytësve të aktivitetit. Detyra më e rëndësishme e egos është të ndërmjetësojë ndërmjet idit dhe superegos në atë mënyrë që t'i përshtatet kërkesave reale, fizike e shoqërore, por edhe duke ruajtur veten e vet. Në shtresimin e strukturave të personalitetit egoja zë vend ndërmjet idit, shih – ***IDI*** dhe superegos, shih – ***SUPEREGO,*** duke kryer njëkohësisht funksionin e lidhjeve ndërmjet veprimeve të tyre. Një pjesë e funksioneve të egos ka karakter të pavetëdijshëm; kjo pjesë e egos ka të bëjë me mekanizmat mbrojtës. Shih – ***MEKANIZMAT MBROJTËS.***

EGO ANGAZHIMI. Gjendja e angazhimit të plotë e një individi në një detyrë të caktuar dhe për realizimin e saj. Kjo ndodh atëherë kur individi konstaton se për të asgjë nuk është më e rëndësishme se ajo detyrë, e cila përfshin të gjithë angazhimin psikik të tij.

EGO ANKTHI. Reagim i posaçëm i individit, kur ai konstaton se i është rrezikuar egoja e tij. Sipas teorisë psikanalitike një gjë e tillë ndodh atëherë kur shkaktohen konflikte ndërmjet kërkesave të idit dhe të superegos, ndërkohë që egoja nuk ia del dot gjithmonë të rregullojë raportet ndërmjet tyre.

EGO BLLOKADA. Pengesa e zhvillimit të egos ose e ndonjë funksioni të saj (e zhvillimit të kujtesës, të mendimit, të marrjes së vendimit etj.) dhe e autonomisë së funksioneve të egos. Pengesa të tilla burojnë nga shkaktarët burimorë psikikë dhe nga disa faktorë irracionalë.

EGO DISTONIKE. Perceptimi i pikëpamjeve, i qëndrimeve, i vlerave etj. të një individi, të cilat ai i konsideron të papajtueshme me egon e personalitetit të tij. Ego distonike konsiderohet çrregullimi obsesiv kompulsiv.

EGO E SHTYTËSIT. Tërësia e të gjithë shtytësve, të cilët janë të drejtuar në vetëmbrojtjen e njeriut. Në grupin e ego shtytësve, sipas mendimeve të para të Z. Frojdit, bëjnë pjesë ata shtytës, të cilët nuk i përkasin idit. Në studimet e mëvonshme Frojdi i ka ndarë shtytësit në shtytës të jetës dhe në shtytës të vdekjes. Shih – ***EROSI; TANATOSI.***

EGO E UNI. Në literaturën e psikologjisë zakonisht bëhet dallimi ndërmjet egos dhe unit të personalitetit të njeriut, por ka edhe mjaft raste kur të dy termat përdoren me kuptim të njëjtë. Është mirë që termin ego ta ruajmë për të emërtuar atë që Z. Frojdi ka emërtuar. Shih – ***EGOJA***, kurse uni të konsiderohet ajo pjesë e abstraktuar e personalitetit me të cilën individi përjeton vetveten.

EGO FUQIA. Pjesëmarrja e egos në ndarjen e fuqisë psikike të njeriut dhe shfrytëzimi i kësaj pjese të fuqisë psikike për funksionimin e egos. Fuqia e egos e bën individin të qëndrueshëm ndaj sulmeve që vijnë nga ambienti ku ai jeton dhe vepron.

EGO IDEALI. Egoja e idealeve të njeriut, pikërisht tipari pozitiv më i mirë që njeriu dëshiron ta arrijë dhe që ideali i tij të bëhet më i miri, më i zgjuari, më i ndershmi etj. Ego ideali është strukturë e egos që luan rolin e vlerësuesit të asaj që njeriu ka arritur dhe sa larg është niveli që synon të arrijë prej nivelit të arritur. Ego ideali u konsiderua nga Z. Frojdi rreth vitit 1923 strukturë e njëjtë me super egon, kurse më vonë arriti në konkluzionin se ego ideali rrjedh nga super egoja dhe ka si funksion ta shtyjë egon për ta barazuar sa më shumë me rolin e ego idealit. Megjithëkëtë, pas viteve `30 të shekullit njëzet ai ka bërë dallimin ndërmjet ego idealit dhe super egos: ego ideali është përcaktues i synimeve të jetës që ndryshojnë gjatë jetës së njeriut, kurse super egoja ka për detyrë të vendosë kufizime në sjelljet e njeriut të cilat formohen herët. Derisa pengesat në arritjen e ego idealit shkaktojnë turp, shih – ***TURPI***, rrënimi i kufijve të super egos shkakton ndjenjën e fajit. Ego ideali ka përmasa të theksuara motivuese, sepse e shtyn individin gjithnjë në shkallët më të larta të përsosjes së tij.

EGO KUFIRI. Tendosja e kufirit ndërmjet zhvillimit të egos dhe funksioneve të egos përballë atyre që nuk i takojnë egos. Në këtë kuptim termi i përket grupit të termave topologjikë dhe, si i tillë, është një konstrukt hipotetik.

EGO LIBIDOJA. Energjia e libidos së njeriut e drejtuar dhe e përqendruar në egon e tij. Te ego libido objekti i dashurisë së njeriut është vetja e tij. Po, ka edhe mendime se te ego libido energjia e tërë psikike përqendrohet në kryerjen e funksionit të egos. Ego libido dallohet posaçërisht në drejtimin dhe përqendrimin e libidos, jo në objektin e botës së jashtme, por në vetë personalitetin. Mund të jetë edhe pasojë e narcizoizmit.

EGO MBROJTJA. Emërtim i mekanizmave mbrojtës të egos dhe i procesit të mbledhjes dhe drejtimit të energjisë së libidos së idit në mbrojtje të egos.

EGO NEUROZA. Lloj i neurozës që shkaktohet nga zhvillimi i pamjaftueshëm i egos së njeriut të rritur dhe dallohet në pamundësinë e tij për të harmonizuar raportet ndërmjet strukturave të personalitetit (id, ego, superego), si edhe kërkesat e egos me ndarjen proporcionale të energjisë së libidos ndërmjet kërkesave të egos dhe objektit të jashtëm të libidos. Në rastet e tilla kemi të bëjmë me çrregullim të funksionit të egos dhe për këtë shkak terapia psikanalitike drejtohet në zhvillimin përforcues të egos.

EGO OBJEKTI. Koncepti psikanalitik, sipas të cilit e gjithë përmbajtja psikike e njeriut që nuk gjendet në egon e tij i përket objektit ku është drejtuar energjia e libidos.

EGO PSIKOLOGJIA. Drejtim i psikanalizës, sipas të cilit ego psikologjia ka për detyrë kryesore hulumtimin e egos dhe të funksioneve të saj, sidomos të kujtesës, të mendimit e të folurit, të marrjes së vendimeve për sjellje të caktuara të drejtuara kah realiteti. Ego psikologjisë nuk i përket hulumtimi i idit. Derisa Z. Frojdi ka konsideruar se egoja buron nga idi, ithtarët e ego psikologjisë konsiderojnë se idi dhe egoja janë struktura të lindura që

zhvillohen paralelisht, Sipas tyre egoja është strukturë me funksione të pavarura dhe ushtron ndikim në psikodinamikën e personalitetit. Funksioni i egos nuk është në shërbim të idit dhe as të energjisë së shtysave a shtytësve të idit. Edhe konfliktet brenda personalitetit të njeriut dalin nga mospërputhja e qëllimeve të egos, e jo nga raporti ndërmjet idit, egos e super egos. Themelues të ego psikologjisë konsiderohen Hainc Hartman (Heinz Hartmann, 1894 – 1970) dhe Ana Frojd (Anna Freud, 1895 – 1982). Sipas ego psikologëve funksionet e pavarura të egos bëjnë që njeriu t`i përshtatet më lehtë dhe më shpejt kërkesave dhe ndryshimeve të mjedisit ku ai zhvillohet. Me këto funksione ego psikologjia del nga qarku i psikopatologjisë dhe ego psikologjia është në gjendje të shpjegojë proceset psikike dhe sjelljet e njeriut normal.

EGO PUSHTIMI. Drejtimi dhe përqendrimi i energjisë psikike në një objekt, përmbajtje psikike, dukuri etj. dhe pushtimi i tyre nga energjia e tillë psikike. Termi i përket psikanalizës së Z. Frojdit dhe kuptimi i ngushtë e tij ka të bëjë me drejtimin dhe përqendrimin e libidos në atë objekt, përmbajtje etj., me të cilin vihet baraspesha psikike e organizmit të njeriut dhe harmonizohen raportet ndërmjet strukturave të personalitetit të kuptuara sipas teorisë psikanalitike. Ego pushtimi ka një dinamikë të theksuar dhe ka raste kur energjia e libidos drejtohet prej një objekti në tjetrin duke rrënuar drejtpeshimin psikik të personalitetit. Për rrjedhojë, ego pushtimi e shtyp, e ndryshon këtë energji me qëllim ruajtjen e harmonisë psikike. Në literaturën e psikologjisë efekti i pushtimit njihet me termin profesional ego kateksi.

EGO SINTONIKE. Rrjedh nga anglishtja *ego syntonic*. Emërton konceptin e asaj që i përket vetëdijes së njeriut. Ego sintonike është tërësia e pikëpamjeve, e vlerave, e ndjenjave etj. e harmonizuar me "fytyrën" ideale që ka vetë njeriu. Këtë përmbajtje njeriu e konsideron përmbajtje të vetën dhe kjo është përmbaja reale për njeriun dhe vetëdijen e tij.

EGO ZHVILLIMI. Procesi i zhvillimit gradual të fëmijës deri në nivelin e njohjes së plotë të qenies së tij, si qenie e pavarur dhe e veçantë. Për këtë lloj zhvillimi dallohen dy pikëpamje:

a. Pikëpamja e Zhan Pijazhes – që thekson rolin dhe rëndësinë e zhvillimit të proceseve kognitive në formimin e vetëdijes së individit se ai është qenie e veçantë dhe e pavarur;

b. Pikëpamja psikanalitike – sipas së cilës egoja, proceset e egos dhe sjelljet zhvillohen te fëmija, pavarësisht nga ato të prindërve të tyre. Kjo është pikëpamja e psikanalizës klasike. Ndërkaq, psikologjia e studiuesit amerikan Erik H. Erikson (Erik H. Erikson, 1902 –) konsideron se e tërë jeta e njeriut mund të kuptohet vetëm kur ai është në gjendje t`i kuptojë fazat e zhvillimit të egos. Shih – ***TEORIA E ERIKSONIT PËR PERSONALITETIN.***

Burimet:

Heinz Hartman **"***Ich Psychologie" – "Psikologjia e unit", 1962.*

Theodor Lipps "*Das Wissen von fremden Ichen" "Njohja e egos së huaj"*, Psychologische Untersuhungen, Band 1. Leipzig:Engelmann, 1907.

Zigmund Frojd *"Metapsikologjia"*, Tiranë, 2003.

Zigmund Frojd *"Psikologjia e turmave dhe analiza e unit"*, Tiranë, 1998.
Anna Freud *"Das Ich und die Abwehrmechanismen" – "Uni dhe mekanizmat mbrojtës"*, Wien, 1936.
Erich Fromm "Njeriu për vete – Gjurmime në psikologjinë e etikës", Tiranë, 2003.

EGOCENTRIK, - E. mb. Që i përket egocentrizmit, që ka të bëjë me egocentrizëm, si p.sh., mendim egocentrik, të folur egocentrik, veprim egocentrik etj. Në psikologji bëhet fjalë më tepër për të folurit egocentrik.

EGOCENTRIZ/ËM, - MI. m. Rrjedh nga latinishtja *ego* "unë" dhe *centrum* "qendër". Ka dy kuptime:

a. Egocentrizmi në kuptimin e përgjithshëm emërton preokupimin e një individi të rritur me veten: dëshirat, interesat, nevojat, mendimet, e veprimet e veta i ka në qendër të çdo situate dhe së bashku me këtë preokupim ai e ka të ulët nivelin e zhvillimit për të tjerët.
b. Egocentrizmi në psikologjinë e Zh. Pijazhes ka kuptim tjetër: egocentrizmi në këtë psikologji emërton konceptin teorik për zotërimin e njohjes së realitetit në tërësinë e mendimeve dhe të të folurit të fëmijës.

EGOIZ/ËM, - MI. m. Prirja dhe mbisundimi i mendimeve, i interesave, i motiveve etj. personale pa pasur konsideratë për të tjerët, për nevojat aktuale, të kujdoqoftë dhe sjellja e egoistëve në përputhje me mendimet, qëndrimet, interesat dhe motivet e tij. Kur një tipar i tillë merr karakter të prirjes së qëndrueshme në sjelljet e një njeriu të caktuar, atëherë është e vështirë vënia e kufirit ndërmjet dëshirës, prirjes së sëmurë dhe asaj normale.

EGOMANI, - A. f. I ardhur nga latinishtja *ego* "unë" dhe *mania* "marrëzi". Sjellje jonormale e njeriut, i cili konsideron se mendimet, interesat, nevojat etj. të tij janë prioritare, kurse ato të të tjerëve, në çfarëdo lloj situatash nuk kanë rëndësi. Egomania ka përmasë motivuese, madje edhe të fuqishme. Egomania e shtyn njeriun të mohojë interesat e të tjerëve, të shfaqë mosinteresim ndaj raporteve sociale, për grupet sociale e nevojat e tyre etj.

EGOTIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga latinishtja. Egotizmi emërton synimin e qëndrueshëm të një individi për të vlerësuar shumë lart veten e tij, sjelljet, interesat, dijen personale etj. Egotizmi i njeriut herë–herë e vë individin në pozicion të pakënaqshëm duke shkaktuar sjellje negative të të tjerëve ndaj prirjeve të tij egotike.

EIDETIK, - E. mb. Që e karakterizon dukuria e eidetizmit, që ka të bëjë me figura të riprodhuara, me përfytyrime të gjalla të objektit të perceptuar.

EIDETIKË, - A. f. I ardhur nga greqishtja *εἶδος* "figurë". Eidetika është pjesë e psikologjisë së perceptimeve dhe përfytyrimeve, e cila merret me gjurmimin e lidhjes së perceptimeve, me përfytyrimet dhe me formimin e përfytyrimeve karakteristike për objektet e dukuritë perceptuese. Përfytyrimet e objekteve perceptuese te disa individë janë shumë "të gjalla", të pasura me hollësira të objektit të perceptuar më parë, në atë masë sa vështirë të dallohen nga perceptimi i atyre objekteve. Eidetika merret edhe me gjurmimin e perceptimeve dhe të përfytyrimeve te anëtarët e fiseve primitive.

EIDETIZ/ËM, - MI. m. Dukuria e sjelljes ndër mend të figurave të gjalla të objekteve të perceptuara pak kohë

më parë në nivel të lartë të gjallërisë së objektit të parë ose të tingujve të dëgjuar, shumë rrallë të erërave të nuhatura. Ka raste kur eidetizmi karakterizon fushën e të parit dhe të dëgjuarit. Eidetizmi është karakteristik për moshën fëmijërore, kurse më vonë kjo dukuri vjen duke u zbehur dhe humbet. Mjeku V. Urbançiç (V. Urbantschich) e ka përshkruar i pari këtë dukuri, ndërkaq E. Jensh (E. Jaensch) e ka përpunuar hollësisht eidetizmin dhe ka arritur të përcaktojë tipat eidetikë: tipin B dhe tipin T.

EINSTELUNG, - U. m. I ardhur nga gjermanishtja. Einstelungu është koncept dhe term i psikologjisë klasike gjermane të shkollës së Marburgut që emërton përshtatjen e mendimit të një individi në zgjidhjen e problemeve. Në literaturën angleze përdoret termi *set mendor*. Më vonë termi *einstelung* u përdor me kuptim të zgjeruar, duke emërtuar shtrirjen e proceseve mendore dhe përshtatjen e tyre në reagimet përkatëse të një njeriu ndaj ngacmuesve të caktuar.

EKG. Shkurtesë për termin elektroencefalogramë**.** Shih – ***ELEKTROENCEFALOGRAMA*.**

EKLEKTIK, - E. mb. I ardhur nga greqishtja *εκλεκτικός* "që zgjedh". Përcakton zgjedhjen dhe shfrytëzimin e asaj që konsiderohet më e mira, më e dallueshmja në pikëpamjen pozitive dhe pranimin e tyre në një sistem konceptesh, duke i mbetur besnik kuptimit të atij sistemi. Pakujdesia në përzgjedhjen e asaj që është më e mira dhe pakujdesia në sintezën e më të mirave shpie në konstruksione mendore jokoherente dhe të gabuara.

EKOKINEZË, - A. f. Përsëritje automatike e veprimeve, e lëvizjeve, e gjesteve etj. të të tjerëve. Shih – ***EKOPRAKSIA*.**

EKOLALI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *echo* "jehonë" dhe *lalia* "fjalë". Formë e çrregulluar e të folurit, lloj i veçantë i alalisë. Shih – ***ALALIA*.** Ekolalinë e karakterizon përsëritja e herëpashershme, madje gati edhe e pandërprerë, e fjalëve dhe e fjalive të dëgjuara nga të tjerët dhe shpesh kjo bëhet duke mos njohur kuptimin e përmbajtjes së tyre. Ekolalia është më e shpeshtë te afazia dhe konsiderohet se është përbërëse e autizmit dhe e simptomës së skizofrenisë**.**

EKOLOGJI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *οικο* "shtëpi" dhe *λογία* "shkencë". Disiplinë e biologjisë, e cila merret me studimin e raporteve dhe të interakcioneve ndërmjet organizmave bimore e shtazore dhe mjedisit natyror të tyre. Nga fundi i shekullit njëzet ekologjia mori rëndësi të veçantë edhe për psikologjinë. Termi ekologji në terminologjinë e psikologjisë përdoret kryesisht për të emërtuar konceptin e disiplinës së psikologjisë ekologjike.

EKONOMIA E ZHETONAVE. Formë e kushtëzimit me anën e së cilës individët, e më tepër ata të moshës fëmijërore, fitojnë zhetona (lodra, figura me vlerë, letra të dëshiruara etj.) që shërbejnë si përforcues të sjelljeve të dëshiruara. Këto zhetona fëmija i këmben me artikuj të dëshiruar dhe në këtë mënyrë përforcohet dhe stabilizohet reagimi dhe sjellja e dëshiruar.

EKONOMIZIMI I ENERGJISË PSIKIKE. Shfrytëzimi racional i energjisë psikike gjatë procesit të akti-

vizimit të strukturave psikike, të proceseve psikike dhe të sjelljes së njeriut. Në kuptimin e ngushtë ky term paraqet funksionalizimin e llojeve të ndryshme të aktivitetit psikik të njeriut, duke shfrytëzuar sa më pak energji psikike, e pikërisht kursim sa më të madh të energjisë psikike, duke mos dëmtuar funksionimin e rregullt të strukturave psikike dhe funksionin e rregullt dhe optimal të tyre.

EKOPRAKSI, - A. f. Çrregullim në fushën e psikomotorikës, që shfaqet me përsëritjen mekanike të lëvizjeve, të veprimeve, të gjesteve, duke përfshirë edhe pozat e të tjerëve. Forma më e shpeshtë e paraqitjes së ekopraksisë është apraksia, shih – ***APRAKSIA.*** Ekopraksia mund të jetë simptomë e disa sëmundjeve psikike, si, p.sh. e oligofrenisë. Shih – ***OLIGOFRENIA*** dhe e skizofrenisë. Në shumë raste klinike ekopraksia shfaqet te ata pacientë, të cilët e kanë pasur të dëmtuar pjesën ballore të trurit.

EKSITIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *exitatio* "nxitje, ngacmim". Shih – ***NGACMIMI.***

EKSPERIENCË, - A. I ardhur nga latinishtja *experimentum* "përvojë". Termi eksperiencë ka zënë vend edhe në leksikun e gjuhës shqipe. Shih – ***PËRVOJË.***

EKSPERIMENTAL, - E. mb. Që ka të bëjë me eksperimentin dhe me hulumtimet eksperimentale, si edhe me rezultatet e hulumtimeve eksperimentale.

EKSPERIMENT, - I. m. I ardhur nga latinishtja *experimentum* "provë". Në psikologji emërton metodën e hulumtimit shkencor të raporteve që kanë dy dukuri, ku në mënyrë sistematike hulumtuesi ndryshon një dukuri për të dalluar, matur dhe kontrolluar ndikimin e saj në dukurinë tjetër dhe për të përcaktuar saktësisht përmasat e ndikimit të saj. Eksperimenti i kryer në fillim në psikologji gjeti zbatim në psikofizikë dhe në psikologjinë fiziologjike dhe prej këndej u zbatua edhe në disa disiplina të psikologjisë. Eksperimenti kryhet për të argumentuar ose hedhur poshtë si të pavlefshme një hipotezë të caktuar. Thelbi i eksperimentit është vërtetimi i qëndrueshëm i ndryshores së pavarurar në ndryshore të varur prej saj, përkatësisht në shkaktimin e një dukurie psikike ose në ndryshimin e saj. Eksperimenti ka disa vlera, ndër të cilat dallohen: dukuria e hulumtimit që shkakton hulumtuesi dhe këtë mund ta përsëritë dhe ta kontrollojë me përpikëri. Eksperimenti ka edhe kufizime, si p.sh.: disa nga dukuritë psikike nuk kanë mundësi të hulumtohen me anë të eksperimentit; ka dukuri psikike që për shkaqe etike nuk mund të hulumtohen me anë të eksperimentit dhe, duhet pasur gjithmonë parasysh karakteri artificial i eksperimentit, si dhe veçoritë natyrore të dukurive psikike në mjedisin natyror të tyre. Megjithëkëtë, eksperimentin e konsiderojmë metodën më ekzakte, më të sigurt dhe më objektive. Rezultatet e kësaj metode kanë vlerë të lartë shkencore.

EKSPERIMENTI ASH. Formë e të provuarit të ndikimit të konformizmit në perceptimin e trupave fizikë, të njerëzve, të situatave etj. U zbatua nga ana e psikologut amerikan Solomon Ash (Solomon Asch, 1907), sipas këtij modeli: subjekti provues ishte anëtar

i një grupi shoqëror dhe kishte për detyrë të perceptonte dy viza madhësish të ndryshme (njëra e gjatë, tjetra e shkurtër), kurse anëtarët e tjerë të grupit që merrnin pjesë në eksperiment ishin të udhëzuar të jepnin përgjigje të gabuar me zë. Në këtë eksperiment u tregua ndikimi i fuqishëm i mendimit, i qëndrimit etj. të të tjerëve në perceptimin dhe në vlerësimin e mendimeve, të qëndrimeve etj.

EKSPERIMENTI FUNKSIONAL. Ndryshim i faktorit eksperimental në nivele të ndryshme dhe vlerësimi i ndikimit që ushtron ndryshueshmëria e tij në procesin, gjendjen, vetinë psikike etj.

EKSPERIMENTI INTROSPEKTIV. Provë vetvëzhguese që zbatohet duke konstatuar dhe analizuar rolin e faktorëve të caktuar nga ana e hulumtuesit, në bazë të raporteve që japin subjektet e provuara në kushte të ndryshme provuese. Kjo formë e eksperimentit u shfrytëzua nga studiuesit e procesit të mendimit të shkollës së Vizburgut (Kylpe, Marbe etj.).

EKSPERIMENTI KONTROLLUES. Vazhdim i rishqyrtimit të kujdesshëm të rezultateve të eksperimentit të kryer, me qëllim të vërtetimit të saktë të rolit të faktorit, të kushtit ose të shkakut që hulumtohet dhe përmasat e ndikimit të tij në paraqitjen e një dukurie psikike të caktuar ose në ndryshimin e saj.

EKSPERIMENTI KRUCIAL. I ardhur nga latinishtja *experimentum crucis*. Lloj eksperimenti, sipas rezultateve të të cilit vërtetohet përfundimisht e vërteta e një hipoteze, përkatësisht rrëzohet si i pavërtetë gjykimi përfundues, gjegjësisht konkludimi për një hipotezë. Në hulumtimet psikologjike eksperimenti krucial është i rrallë.

EKSPERIMENTI LABORATORIK. Provë e organizuar në kushte artificiale me qëllim të ndjekjes sistematike dhe të vëmendshme të ndryshoreve, të përsëritjeve dhe të kontrollit të efekteve dhe të raporteve të tyre, si edhe me qëllim të izolimit të subjekteve nga ndikimi i faktorëve pengues të jashtëm. Organizohet kryesisht për hulumtime psikofizike dhe psikofiziologjike. Por, ndarja e subjekteve nga mjedisi natyror i sjelljeve të tyre dhe eksperimentimi me to në laborator mund t`i ndryshojë rezultatet e hulumtimit eksperimental dhe kjo është një dobësi e këtij lloj eksperimenti. Për të shmangur këtë dobësi zbatohet eksperimenti natyror, përkatësisht kryerja e eksperimentit në kushte natyrore.

EKSPERIMENTI ME GRUPE PARALELE. Provë me grupe shumë të ngjashëm ose të njëjtë individësh, nxënësish, studentësh, ushtarësh etj. Subjektet ndahen në dy a tri grupe të barabarta. Njëri grup quhet grupi eksperimental, kurse tjetri grupi kontrollues. Grupi eksperimental vepron në kushte eksperimentale, ku provohet ndikimi i një ndryshoreje ose i ndryshores së pavarur, p.sh., ndikimi i të mësuarit të rrokjeve në mbajtjen mend tyre, kurse grupi tjetër në kushte joeksperimentale, përkatësisht ndikimi i të mësuarit të fjalëve të huaja në mbajtjen mend të tyre. Ndryshimi i rezultateve të arritura i atribuohet ndryshores eksperimentale, përkatësisht faktorit të të mësuarit të rrokjeve. Për studime të niveleve të larta zgjidhen disa palë binjakësh të braktisur të së njëjtës moshë

dhe të së njëjtës gjini dhe njeri grup i tyre zhvillohet në kushte ideale familjare (fëmijë të përvetësuar nga çiftë mjekësh të pasur), kurse grupi tjetër në kushte familjare të tjera (fëmijë të përvetësuar nga çifte bashkëshortësh të varfër) dhe pas disa vitesh matet shkalla e zhvillimit të inteligjencës. Ndryshimi i rezultateve ndërmjet anëtarëve të grupit eksperimental (grupi i parë) dhe grupit kontrollues (grupi i dytë) i atribuohet ndryshores eksperimentale (kushteve familjare të çifteve mjekë).

EKSPERIMENTI ME NDRYSHIM FAKTORËSH EKSPERIMENTALË. Formë e zbatimit të eksperimentit në hulumtimet psikologjike, të cilën e karakterizon ndryshimi i rolit të grupit eksperimental dhe të grupit kontrollues, përkatësisht grupi eksperimental merr rolin e grupit kontrollues dhe grupi kontrollues merr rolin e grupit eksperimental. Rezultatet e përftuara përpunohen dhe krahasohen. Ndryshimi ndërmjet rezultateve të arritura përcakton saktësisht efektin e faktorëve të hulumtuar në paraqitjen, në zhvillimin dhe në ndryshimin e një procesi, të një funksioni të strukturës psikike etj.

EKSPERIMENTI ME NJË GRUP SUBJEKTESH. Formë e veçantë e eksperimentit psikologjik, që organizohet vetëm me një grup subjektesh (nxënësish, studentësh, ushtarësh, punëtorësh etj.), por duke ndryshuar situatën e ndikimit të një faktori në të mësuar, në stërvitje, në punë të përbashkët etj., dhe duke kontrolluar saktësisht efektin e faktorëve të ndryshuar dhe duke vlerësuar ndryshimin, në procesin e të mësuarit, të stërvitjes, të punës etj. te anëtarët e këtij grupi. Kjo formë e eksperimentit zakonisht zbatohet për shkak të mundësisë më të mirë të kontrollit të ndryshores te të njëjtët subjekte.

EKSPERIMENTI ME ZGJEDHJE TË SHUMËFISHTA. Hulumtim në baza eksperimentale, kur subjekti duhet të bëjë zgjedhjen e asaj që kërkohet në një situatë problemore nga disa mundësi të paraqitura. Kryesisht zbatohet në hulumtimin e proceseve kognitive, kur nga disa figura gjeometrike, subjekti (zakonisht fëmijët) duhet të zgjedhë atë që ndryshon nga të tjerët në një element. Ky lloj eksperimenti i përngjet eksperimentit introspektiv, sepse mund të kryhet jo vetëm me zgjedhjen adekuate të asaj mundësie të paraqitur ndër shumë syresh, por edhe të tregojë si ka ardhur deri te zgjedhja e duhur.

EKSPERIMENTI NË KUSHTE NATYRORE. Provë hulumtuese e organizuar jashtë laboratorëve psikologjikë. Eksperimenti në kushte natyrore organizohet në klasë nxënësish, në klinika, në fabrika, në burgje etj. Zakonisht subjektet nuk janë të informuar se ata janë subjekt ku provohet ndikimi i një ndryshoreje në reagimet e tij. Ky lloj eksperimenti ka disa avantazhe ndaj eksperimentit laboratorik, por edhe disa disavantazhe, ndër të cilat dallohet sidomos pamundësia e izolimit të ndryshores provuese, sepse kushtet natyrore janë të ndërlidhura dhe të ndërlikuara.

EKSPERIMENTI STRATON. Të parit e çrregulluar, që shfaqet kur njeriu e sheh tjetrin në shtrirje vertikale të kundërt nga të parit e tij normal. Pas përdorimit të syzave me prizma speciale, që e rrotullojnë pamjen e një

objekti me 180 gradë, individi e sheh këtë objekt me shtrirje normale. Por, po qe se i largon syzat, prapë i paraqiten pengesa në pamjen e objekteve, sepse fusha e të parit kthehet në të kundërtën e normales së saj. U quajt eksperimenti Straton sipas psikologut amerikan Xhorxh M. Straton (George M. Stratton, 1865 – 1957).

EKSPLICIT, - E. mb. I ardhur nga latinishtja *explicitus* "i qartë". Diçka që është konkrete dhe e mundshme të vëzhgohet dhe të përshkruhet qartësisht dhe plotësisht. Kështu duhet kuptuar shprehja procese kognitive eksplicite, kur këto procese mund të përshkruhen tërësisht dhe qartësisht, sepse njeriu është i vetëdijshëm për këto procese dhe për funksionin e tyre.

EKSPLORIM, - I. Shih – ***HULUMTIMI.***

EKSPRESION, - I. m. I ardhur nga latinishtja që përdoret edhe në gjuhën shqipe, sidomos në fushën e estetikës për të emërtuar shprehjen e jashtme të përjetimeve të brendshme të njeriut. Në psikologji termi ekspresion përdoret më tepër në përshkrimin e shfaqjes së përmbajtjeve psikike (të llojeve, të mënyrave dhe të stileve të shfaqjes së jashtme të tyre) në shprehjen e emocioneve shfaqen ndryshimet në muskujt e fytyrës, të gojës, në ngjyrën e lëkurës së fytyrës, në rrahjen e pulsit, në gjestet, në sjelljet etj. Shih – ***SHPREHJA E EMOCIONEVE.***

EKSPRESIONI EMOCIONAL. Shfaqja e jashtme e emocioneve me anë të ndryshimeve fiziologjike të jashtme, siç janë: dridhja e zërit, e duarve, skuqja e fytyrës, ndryshimi i ritmit të rrahjes së pulsit, të zemrës, ndryshimi i potencialit psikogalvan të lëkurës etj. Këto ndryshime konsiderohen struktura përbërëse të reagimeve emocionale.

EKSPRESIONIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga frëngjishtja *expressionisme* në terminologjinë e artit dhe të estetikës. Në psikologji ka kuptim domethënës, sepse është stil i shprehjes së gjendjes emocionale të një krijuesi. Kjo lloj shprehjeje dallohet sidomos në pëlhurën e piktorit, i cili e paraqet një formë të zmadhuar, e ngjyros pikturën e tij me ngjyra të fuqishme etj. për të treguar pikëllim, zemërim etj. Ekspresionistët më të njohur janë: Van Gog (Van Gogh, 1853 – 1890), Eduard Munk (Edward Munck, 1863 – 1944) etj.

EKSTAZË, - A. f. I ardhur nga greqishtja *eks* "jashtë" dhe *stasis* "gjendje". Gjendje e jashtëzakonshme e gëzimit, e haresë, e entuziazmit etj. Ekstaza karakterizon sidomos disa mistikë, të cilët nga hareja e madhe pothuajse arrijnë veten, ku vetëdija e tyre pëson ndryshime të përqendruara në zhvillimin maksimal të asaj gjendjeje, kur ndjenjat e thella dhe intensive bëjnë që ai ta humbë gati krejtësisht kontrollin dhe sundimin e veprimeve të tij brenda një kohe jo të gjatë. Njeriu në gjendjen e ekstazës e ndien veten të bartur në një jetë tjetër, ku nuk gjen njerëz të tjerë. Në gjendje ekstaze pësojnë ndryshime disa funksione të organeve të trupit: ndjeshmëria e shqisave është e kufizuar, frymëmarrja është e ngadalësuar, ritmi i rrahjes së zemrës dhe i pulsit është i ngadalësuar etj.

EKSTENSION, - I. Shih – ***SHTRIRJE.***

EKSTENSOR, - I. m. I ardhur nga latinishtja *extensor* "shtrirje". Me termin ekstensor emërtohet koncepti

i muskulit shtrirës që merr pjesë në aktivitetin e gjymtyrëve. Muskuli ekstensor së bashku me muskulin fleksor (muskuli mbledhës) mundësojnë veprimin e rregullt të muskujve të dorës, të gishtërinjve, të këmbëve etj. Shih – ***FLEKSORI.*** Funksioni shtrirës i ekstensorit dhe ai mbledhës i fleksorit përbëjnë veprimin antagonist të tyre.

EKSTERNALIZIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *externus* "i jashtëm". Termi eksternalizim përdoret shpesh në literaturën e psikologjisë. Ka kuptimin e lindjes së brendshme të një përjetimi, të një shtytësi, të një motivi etj. të individit, me prirjen për të paraqitur strukturat psikologjike të përmendura në mjedisin e jashtëm të atij individi. Në psikologji termi eksternalizim ka kuptime të ndryshme. Në psikologjinë zhvillimore emërton mekanizmin e dallimit të unit nga jo-uni i fëmijës. Në psikologjinë e K. Hornit emërton njërën nga mënyrat e zgjidhjes së konfliktit të brendshëm të individit të caktuar, kur ai ia atribuon konfliktin e brendshëm të papranuar prej tij situatës së jashtme (eksternalizimi aktiv) dhe përjetimin e ndjenjave sociale ndaj të tjerëve ia atribuon vetes (eksternalizimi pasiv).

EKSTERORECEPTOR, - I. m. I ardhur nga latinishtja *extero* "i jashtëm" dhe *receptor* "marrës". Tërësia e organeve shqisore, të cilët aktivizohen kur në këto organe vepron ngacmuesi me cilësi, intensitet, shtrirje dhe kohëzgjatje adekuate. Ngacmues të jashtëm të ekstrareceptorëve mund të jenë ndryshimet objektive fizike, kimike, biologjike, sociale etj., që janë në gjendje të ngacmojnë mbaresat e nervave të këtyre shqisave dhe prej këndej impulset nervore barten në qendra ndijimore të caktuara, duke shkaktuar reagim të posaçëm shqisor dhe sjellje të caktuara ndaj këtyre ngacmuesve të jashtëm. Në tërësinë e ekstrareceptorëve hyjnë: receptori i të parit – syri dhe rrjetëza (retina) e syrit; receptori i të dëgjuarit – veshi dhe labirinthi i veshit; receptori i të prekurit – lëkura dhe trupthat e shtresës së brendshme të saj; receptori i të shijuarit – gjuha dhe puprria e gjuhës; receptori i të nuhaturit – hunda dhe pjesa e sipërme e mukozës së saj. Termi përmbledhës ekstrareceptor i atribuohet fiziologut anglez Çarls Sherington (Carles Sherinngton, 1857 – 1952).

EKSTIRPACION, - I. m. I ardhur nga latinishtja e i përdorur më shumë në kirurgji e në anatomi se në psikologji. Mënjanimi i një organi, i një qendre trunore etj. për qëllim shërimi. Termi ekstirpacion në psikologjinë klasike është përdorur në hulumtimin e disa kafshëve, me qëllim njohjen sa më të plotë të funksionit të strukturave të ngjashme me trurin e njeriut.

EKSTRAPOLIM, - I. m. Në statistikën psikologjike, i ardhur nga latinishtja *extra* "jashtë" dhe *polire* "me mbet i uritur". Ekstrapolimi është proces i konkludimit për ato fakte, përmasa dhe raporte që nuk ishin më parë në rendin e fakteve të njohura, por në bazë të të dhënave dhe fakteve të mëparshme konkludohet edhe për fakte, të dhëna e raporte dhe për përmasat e tyre sipas tënjëjtës mënyrë konkluduese. Me ekstrapolim kryhet parashikimi jo vetëm i të dhënave, fakteve e raporteve, por edhe parashikimi i rrjedhës së funksioneve të tyre. Ka mjaft raste në psikologji, kur ekstrapolimi nuk çon në konkluzione të drejta.

EKSTRAVERSION, - I. m. Në psikologjinë e personalitetit term i stabilizuar posaçërisht në psikologjinë komplekse të K. Jungut, që paraqet konceptin e atyre individëve, synimi dominues në sjelljet e të cilëve është shfrytëzimi i energjisë psikike, përkatësisht i libidos në kuptimin e përgjithshëm të këtij termi, të drejtuar kah bota e jashtme dhe kah ndryshimet e saj. Ky synim i të gjithë atyre, që karakterizohen nga ekstraversioni shkakton kënaqësi të posaçme te këta individë.

EKSTRAVERSIONI - INTRAVERSIONI. Dy pikat e fundit të shtrirjes së dimensioneve të personalitetit dhe të vëzhgimit shkencor të zhvillimit të tyre. Në psikologji termi ekstraversion – intraversion është përdorur për të emërtuar koncepte të kundërta të personalitetit. Rezultatet e hulumtimeve kanë treguar se këto nuk janë koncepte krejtësisht të kundërt, sepse komponentët e ekstraversionit mund të përmbahen edhe te intraversioni dhe anasjelltas. Madje edhe theksimi i ekstraversionit nuk është i lidhur me zvogëlimin e intraversionit.

EKSTRAVERT, - E. mb. Në psikologjinë e K. Jungut, i ardhur nga latinishtja *extra* "jashtë" dhe *veretere* "kthej". Ekstravert është tipi i njeriut, i cili ka këto tipare kryesore: orientimi i sjelljeve të përgjithshme të tij kah dukurive, objekteve, e individëve të tjerë të jashtëm; është realist, komunikues,i hapur ndaj të tjerëve dhe praktik. Tipi i njeriut ekstravert është i preokupuar me çështjet praktike, në zgjidhjen dhe në zotërimin e të cilave ai drejton veprimtarinë e përgjithshme të tij. Shih – ***EKSTRAVERSIONI.***

EKSTRINSEK, - E mb. Që i përket dhe që ka të bëjë me faktorë të jashtëm. Në psikologji emërton kryesisht motivacionin e jashtëm, përkatësisht motivacionin ekstrinsek. Motivacionit të jashtëm ose ekstrinsek i përkasin çmimet, shpërblimet, garat, të mësuarit për notë sa më të lartë etj.

EKTODERMË, - A. f. Në anatomi i ardhur nga greqishtja *έκτο δερμαε*. Ektoderma është shtresa e jashtme e qelizave embrionale me të cilat përbëhët lëkura e njeriut. Termi ka kuptim të gjerë, sepse krahas qelizave embrionale të shtresës së jashtme të lëkurës, përfshin edhe zhvillimin e sistemit nervor, zhvillimin e disa pjesëve të hipofizës etj.

EKTOMORFI, - A. f. Term i psikologjisë së personalitetit, e veçanërisht i tipologjisë së personalitetit. Me këtë term emërtohet përmasa e posaçme e trupit të një individi, i cili i ka të zhvilluara qelizat e lëkurës qysh në gjendjen embrionale, si edhe ato organe që lidhen drejtpërdrejt me zhvillimin e këtyre qelizave (truri dhe pjesët e tij). Termi ektomorf i përket tipologjisë së personalitetit të Uiliam Sheldonit (William Sheldon, 1889 – 1977), i cili ka identifikuar tri përmasat trupore të personalitetit dhe tipet përkatëse të tyre. Shih – ***ENDOMORFIA; MEZOMORFIA.***

EKUILIBËR - I. Shih – ***BARASPESHA.***

EKZALTIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *exaltio* "ngritje". Gjendje e ndjenjës së nivelit shumë të lartë të kënaqësisë së një individi, kur ai arrin atë që e konsideron të pamundur. Kjo gjendje zakonisht përshkruhet për mistikët, kur ata mendojnë se kanë arritur kulmin e besimit në Zotin e tyre

dhe përjetojnë, madje edhe ndjenjën e bashkimit me të. Ekzaltimi shkaktohet edhe nga tronditja e thellë shpirtërore e njeriut nga shkaqe të ndryshme, ndaj të cilave individi përjeton përfytyrime shumë të gjalla, dhe brenda një kohe të shkurtër shkëputet nga objektet dhe nga raportet e tjera të mjedisit të jashtëm. Në psikologji termi ekzaltim përdoret më tepër në trajtën, *kujtesë ekzaltimi*, që emërton mbajtjen mend në mënyrë të jashtëzakonshme të kujtimit të hollësive në një situatë, të cilën individi e ka supozuar të harruar nga mot.

EKZAMINIM, - I. Shih - ***VËZHGIMI SISTEMATIK; EKSPERIMENTI.***

EKZIBICIONIZ/ËM, - MI. I ardhur nga latinishtja *exhibition* "paraqitje, shfaqje". Në kuptimin e përgjithshëm është prirja e ndonjë individi për të qenë në qendër të vëmendjes së të tjerëve. Kjo prirje shfaqet në mënyrën e veshjes, në sjelljet e çuditshme etj. Në kuptimin e veçantë ekzibicionizmi është formë e çrregullimit të motivit seksual, ku kënaqësia seksuale shfaqet duke parë trupin e lakuriqësuar, sidomos duke shfaqur haptazi e pa drojë organet seksuale. Ekzibicionizmi i përket grupit të çrregullimeve seksuale, që emërtohen me termin parafilie. Shih – ***PARAFILIA.***

EKZISTENCIALIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga latinishtja *existential* "qenie". Rrymë filozofike dhe letrare e lidhur në fillimet e saj me emrin e Sëren Kiergearit (Sören Kierkegaar, 1813 – 1855) dhe Fridrih Niçes (Friedrich Nietzsche, 1844 – 1900). Në shekullin e njëzet emrat më të njohur të ekzistencializmit janë Karl Jaspers (Karl Jaspers, 1883 – 1969) dhe Zhan Pol Sartri (Jean Pol Sartre, 1905 – 1980), mbi teorinë e të cilëve u zhvillua njëra nga pikëpamjet e psikologjisë filozofike. Sipas kësaj pikëpamjeje njeriu i lindur është i lirë ta zgjedhë vetë thelbin e tij njerëzor dhe t`i japë kuptim jetës së tij; faktorët dhe raportet që e mundësojnë këtë i paraprijnë qenies së vërtetë të tij. Ekzistencializmi theksohet në psikologji, sepse merret me studimin e ekzistencës së njeriut dhe me emocionin e frikës.

EKZOCITOZË, - A. f. Në neurofiziologji proces neurofiziologjik i çlirimit të përbërjeve kimike të tepërta nga brendësia e qelizave nervore. Me anën e këtij procesi neurotransmetuesit çlirohen nga qelizat nervore dhe në këtë mënyrë mundësohet bartja e impulsive nervore nga një qelizë nervore në qelizën tjetër nervore.

EKZOGAMI, - A. f. I ardhur nga greqishtja. Martesa e dy çifteve të gjinisë së kundërt, të cilët i përkasin grupit tjetër të farefisnisë, mjediseve të ndryshme etnokulturore, e pikërisht nuk i përkasin familjes, fisit, vëllazërisë e as gjakut të farefisnisë. Frojdi e shpjegon ekzogaminë si proces të zhvilluar pas vrasjes, mbytjes së stërgjyshit më të vjetër nga ana e meshkujve të një fisi.

EKZOGJEN, - E. mb. Që emërton cilësinë e trupave, të dukurive, të proceseve etj. të jashtme të njeriut, të cilët shkaktojnë një veprimtari të caktuar të tij ndaj këtyre trupave, dukurive, proceseve etj. Kështu, grupi i faktorëve biologjikë, socialë e psikologjikë ushtron ndikim në zhvillimin e dispozitave të njeriut.

ELABORIM, - I. m. I ardhur nga greqishtja *ελαβορ* dhe ka kuptim të përgjithshëm dhe kuptim të veçantë. Kuptimi i përgjithshëm shtrihet në disa fusha të disiplinave natyrore dhe shoqërore. Në psikologji elaborimi ka të bëjë më tepër me proceset kognitive dhe me hulumtimin e tyre, sidomos të kujtesës dhe të mendimit. Elaborimi në fushën e hulumtimit të kujtesës ka të bëjë me të kujtuar të një ngjarjeje, që nxit asociacione të ndryshme dhe me shpjegimin e lidhjeve ndërmjet tyre nga ana e një subjekti, i cili i nënshtrohet hulumtimit të kujtesës në laboratorin e psikologjisë. Elaborimi i procesit të mendimit është nxitja e subjekteve për zgjidhje të një situate problemore dhe shpjegimi i tij në mënyrë të hollësishme se si është arritur deri në zgjidhjen e saj.

ELAN, - I. m. I ardhur nga greqishtja *ελαν* që nënkupton "entuziazëm". Termi i përket mendimit filozofik të Anri Bergson (Henri Bergson, 1859 – 1941). Elani i përket terminologjisë së motivacionit. Ka kuptim psikologjik, sepse emërton konceptin e nxitjes së njeriut në veprimtari dhe aktivitete nga entuziazmi i tij.

ELEKTRA. f. Sipas mitologjisë greke Elektra ka qenë vajza e mbretit Agamemnon dhe e mbretëreshës Klitemnestra. Në psikologji ky emër u përdor për të emërtuar kompleksin e Elektrës, shih – ***KOMPLEKSI I ELEKTRËS.*** Sipas mitit, Agamemnoni flijoi bijën e tij, Ifigjeninë, si kusht i vendosur nga perënditë për të sjellë erërat favorizuese për anijet që do të niseshin në fushatën kundër Trojës. Pas kthimit nga fronti i luftës i Agamemnonit, Klitemnestra planifikon dhe vë në jetë vrasjen e të shoqit, si hakmarrje për flijimin e së bijës. Elektra, e pikëlluar dhe e hidhëruar për vrasjen e babait, në sajë të dëshirës për hakmarrje, nxit vëllain, Orestin, për të vrarë nënën e tyre.

ELEKTROENCEFALOGRAMË, - A. f. Regjistrim dhe paraqitje grafike e veçantë e valëve elektrike të kores së trurit të madh, të cilat janë pjesë përbërëse dhe përcjellëse të përhershme të aktivitetit të trurit të madh. Regjistrimet e tilla shfrytëzohen për ekzaminime klinike, kryesisht neurologjike dhe për hulumtime psikofiziologjike. Në rastet e funksionimit të parregullt të kores së trurit të madh ose të ndonjë pjese të saj ndryshon ritmi i valëve alfa e beta nga rrjedha e ritmit dhe e formës normale të tyre. Ky ndryshim shfrytëzohet për interpretim të çregullimit të proceseve psikofizilogjike dhe të sjelljeve patologjike të një individi të caktuar. Elektroencefalograma shkurt njihet si **EKG**.

ELEKTROTERAPI, - A. f. Veprim klinik për stimulimin e funksionimit të trurit, duke shfrytëzuar përforcimin e lehtë artificial të ngacmuesit elektrik. Elektroterapia ka karakterin e një terapie shumë të ndjeshme dhe për këtë shkak vetëm përdorimi me profesionalizëm mund të jetë efikas.

ELEMENT, - I. m. I ardhur nga latinishtja *elementum* "bazë". Koncepti i përbërësve të një tërësie, përkatësisht koncepti i pjesës më të vogël të asaj tërësie. Termi element në psikologji ka hyrë nga filozofia dhe kimia. Psikologjia në fillim të zhvillimit të saj (nga fundi i shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe fillimi i shekullit të njëzet u mor me identifikimin e pjesëve më të vogla

të strukturave pskike. Duke shfrytëzuar metodën e vetëvëzhgimit psikologjia strukturaliste identifikoi elementët e vetëdijshëm të përbërjes së saj, të cilët ishin: ndijimi, ndjenjat dhe përfytyrimet – elementë të procesve psikike dhe të sjelljeve. Strukturat psikike të ndërlikuara ishin kombinim i këtyre elementëve.

ELEMENTARIZ/ËM, - MI. m. Term i përgjithshëm për të gjitha ato qasje studimore që merren me zbërthimin e një tërësie në pjesët përbërëse të saj. Në psikologji elementarizmi është pikëpamje e vjetër për dukuritë shpirtërore të njeriut. Sipas kësaj pikëpamjeje dukuritë psikike, proceset dhe sjelljet e ndërlikuara mendore, si dhe tërësitë e përgjithshme psikike njihen duke i zbërthyar ato në pjesë më të vogla dhe më të pandashme. Këto pjesë ekzistojnë pavarësisht nga tërësia së cilës i takojnë. Mbi bazën e pikëpamjes elementariste u zhvilluan drejtimet psikologjike të strukturalizmit, të redukcionizmit, të atomizmit psikik etj. Elementarizmi në psikologji i përket kohës më të vjetër të zhvillimit të psikologjisë. Kjo pikëpamje në kohët e mëvonshme të zhvillimit të psikologjisë u kritikua ashpër në përgjithësi nga psikanaliza dhe nga psikologjia humaniste.

ELEMENTET E PERSONALITETIT. Njësitë më të vogla dhe më të pandashme që përbëjnë strukturën e personalitetit. Këto njësi kanë kuptim të ndryshëm në teoritë e personalitetit. Për teorinë bihejvioriste elemente të personalitetit janë S(timuluesi) dhe R(eagimi, përkatësisht S(timuluesi), O(rganizmi) dhe R(eagimi), për teorinë faktoriste elementë të personalitetit janë: faktorët e personalitetit, tiparet e përgjithshme; për teorinë psikanalitike të personalitetit elementë të personalitetit janë: shtytësit, idi, ego, super ego etj.; për teorinë humaniste këto elementë janë: nevojat themelore, tiparet, vlerat etj.

ELIS Albert (Albert ELLIS). Lindi në Picbur të Pensilvanisë më 1913, por u rrit në Nju Jork. Pas përfundimit të studimeve për ekonomi në moshën 29-vjeçare u regjistrua në psikologji në Universitetin e Kolumbias, ku dhe doktoroi në psikologji më 1947. Ka punuar në Këshillimoren "Rutgers" dhe në Universitetin e Nju Jorkut si psikolog klinik, saktësisht në Klinikën për Higjienën Mendore të Veriut të Nju Xhersit. Sipas tij "Nuk mund të presim që do jemi vazhdimisht me fat. Çlirimi nga të gjitha dhimbjet trupore gjithsesi nuk do të jenë përvojë e juaja. Por, mundimi i jashtëzakonshëm mendor dhe emocional mund të jetë i juaji – nëse mendoni se është i mundur dhe nëse punoni në atë që besoni". Nga veprimtaria praktike e tij konceptoi formën e re të terapisë racionale-emocionale, ku argumentoi se çrregullimet emocionale burojnë nga mendimet, qëndrimet dhe besimet tona (jo sipas Zigmund Frojdit nga shtypja apo ndrydhja e dëshirave dhe e nevojave). Këto ishin mendimet themelore të Albert Elisit, nga të cilat nxori përfundimin se *"nyjat" emocionale në kuptimin e pengesave, të konflikteve etj. me anën e mendimit tonë mund të eliminohen.* Vepra kryesore e tij është: *"Udhëzues për jetesë të mençur*" (në bashkëpunim me Rober Harper), botuar më 1961. Ka shkruar rreth 600 punime akademike.

ELITË, - A. f. I ardhur nga latinishtja *eligere* "me zgjedh". Term i sociologjisë dhe i psikologjisë sociale, që emërton konceptin e një grupi individësh më të fuqishëm, më të mirë dhe me autoritet, të cilët, me këto cilësi ushtrojnë ndikim në mes të tjerëve, në një mjedis shoqëror të caktuar, duke miratuar vendime të përbashkëta me interes për të gjithë. Këtë grup, nga këndvështrimi i psikologjisë humaniste të Abraham Maslout (Abraham Maslow, 1908 – 1970) e formojnë kryesisht ata, të cilët kanë arritur nivelin e personalitetit të vetaktualizuar.

EMANCIPIM, - I. m. Term me burim nga latinishtja *emancipatio*, me kuptim të veçantë në sociologji, në kulturologji, në drejtësi dhe në psikologji. Domethënia e përgjithshme e emancipimit ka të bëjë me çlirimin e njeriut nga nënshtrimi i sunduesit; çlirimin nga varësia e marrjes së vendimit, mendimit, qëndrimit, sjelljeve etj. të tij nga vendimi, mendimi, qëndrimi, sjelljet etj. e të tjerëve, që pengojnë zhvillimin e lirë. Në kuptimin e ngushtë të psikologjisë emancipimi është arritja e zhvillimit të individit në nivelin e marrjes së një vendimi të pavarur nga të gjithë të tjerët. Në psikanalizë emancipimi nënkupton arritjen e egos në atë shkallë të zhvillimit, që egoja e tij është në gjendje të funksionojë e pashtrënguar nga ndikimet e kërkesave dhe urdhrave të fuqisë së shtytësve të pavetëdijshëm ose atyre të super egos.

EMBRION, - I. m. Fillesa e zhvillimit të organizmit në fazën më të hershme të zhvillimit të tij në periudhën paralindëse ose prenatale. Embrioni fillon zhvillimin e vet pas fekondimit të qelizës femër dhe zgjatë katërmbëdhjetë ditë; në ditët e para të zhvillimit qeliza e fekonduar zhvillohet duke marrë formën e rrumbullakët me një diametër rreth 5 mm Dhe, prej kësaj kohe, zhvillimi i qelizës së formuar fillon diferencimin e saj, duke i dhënë embrionit formën e organeve të organizmit të njeriut, deri në mbarimin e javës së gjashtë, kur fillon faza zhvillimore e fetusit. Shih – ***FETUSI.***

EMFAZË, - A. f. I ardhur nga greqishtja *έμφαση* "kuptim". Shprehje e posaçme e përmbajtjes së një drame, tragjedie, komedie etj. që përçohet me përjetim ndjenjash të thella të aktorit, si edhe me zgjim ndjenjash të thella te marrësit e asaj përmbajtjeje. Disa nga pjesët e përmbajtjeve të tyre shprehen me theksim të posaçëm të fjalëve e të fjalive, duke ndryshuar intensitetin dhe ngjyrën e zërit kumbues.

EMOCION, - I. m. Kategori konceptuale e psikologjisë që së bashku me kognicionin dhe me motivacionin, si edhe me shumësinë e koncepteve diferenciale të tyre përbëjnë strukturën e vetëdijshme të proceseve dhe të sjelljeve të njeriut. Termi emocion përdoret në të folmen e përditshme dhe në atë profesionale, e ka prejardhjen nga fjala latine *emovere* "lëviz". Emocioni është ndër termat e psikologjisë që në literaturën profesionale si term përcaktohet në disa mënyra. Në kohën më të hershme emocioni është reagimi i posaçëm i njeriut, reagim subjektiv ndaj një ngacmuesi të jashtëm ose të brendshëm që e vlerëson të rëndësishëm për organizmin dhe aktivitetin e tij dhe ka bazë neurofiziologjike, kognitive, sociale e cilësi motivuese. Reagimi subjektiv ndaj ngacmuesve të këtillë konsiderohet se është shtytës

i përgatitjes së organizmit për sjellje të përshtatur ndaj ngacmuesve dhe ndryshimit të tyre. Emocioni është proces që ka këtë strukturë: situatën stimuluese të organizmit, perceptimin e kësaj situate, vlerësimin e rëndësinë e saj dhe reagimin, përkatësisht sjelljen e caktuar nga ana e njeriut ndaj kësaj situate. Ndërkaq, strukturën e brendshme të sistemit emocional e sajojnë: komponenta fiziologjike e aktivuar (aktivizimi i sistemit autonom nervor dhe endokrin), komponenta ekspresive e periferisë trupore me ndryshime të fytyrës dhe të zërit, komponenta motivuese me ndryshim sjelljesh në muskulaturë skeletore dhe në veprimet trupore, vetëdija e perceptimit të komponenteve trupore dhe komponenta e përjetimit të ndjenjës së caktuar. Në strukturën e këtillë duhet konsideruar komponentën shoqërore të ndjenjave përbërës të jetës emocionale. Në literaturën e psikologjisë hasim raste të trajtimit të posaçëm kuptimor për termin emocion dhe për termin ndjenjë. Por, ka raste të trajtimit të njëjtë kuptimor të këtyre dy termave. Këtë trajtim e hasim edhe në literaturën shqipe të psikologjisë, si edhe në atë të përkthyer nga gjuhët e tjera në gjuhën shqipe.

EMOCIONAL, - E. mb. Që emërton cilësinë e atyre situatave, ngacmuesve etj., të cilët kanë cilësi, intensitet dhe kohëzgjatje të duhur për të shkaktuar emocion të caktuar te njeriu. Por, kjo nuk do të thotë se ato situata dhe ngacmues shkaktojnë emocione të njëjta te të gjithë njerëzit. Dallimet ndërmjet reagimeve emocionale të njerëzve ndaj situatave dhe ngacmuesve të njëjtë janë relativisht reagime të mëdha.

EMOCIONALITET, - I. m. Gjendjet emocionale të cilat mund të konstatohen, të kontrollohen dhe të maten në bazë të sjelljeve të jashtme të organizmit të njeriut dhe të kafshëve, si edhe në mbështetjen e ndryshimeve fiziologjike të organizmit, si: ndryshimet e ritmit të rrahjes së pulsit, të zemrës, të frymëmarrjes, të presionit e strukturës së gjakut etj. Sjelljet e njeriut pësojnë disa ndryshime me rastin e përjetimit të një emocioni, si: bllokim i sjelljeve, jorregullsi në radhën e sjelljeve, përshpejtim i sjelljeve etj. Sipas këtyre ndryshimeve strukturore të sjelljeve dhe të ndryshimeve fiziologjike të organizmit të njeriut koncepti i emocionalitetit i përket në radhë të parë psikologjisë bihejvioriste.

EMOCIONALIZ/ËM, - MI. m. Pikëpamje psikologjike e gjysmës së parë të shekullit të njëzet, por e theksuar edhe nga disa psikologë të mëvonshëm. Sipas kësaj pikëpamjeje emocionet përbëjnë themelin e zhvillimit të së gjithë jetës psikike të njeriut dhe të formave të shumëllojshme të saj. Rëndësi të tillë i japin emocioneve dhe zhvillimit të tyre Karen Hornei (Karen Horney, 1885 – 1952), Herri Saliven (Harry Salivan, 1892 – 1949), Erik From etj. Natyrisht, emocionet kanë rëndësi të madhe për të gjithë jetën psikike, por kjo nuk mund të reduktohet në emocione dhe në forma të shumëllojshme të zhvillimit të tyre.

EMOCIONET DYTËSORE. Emocione specifike për pjesëtarët e kulturave të ndryshme dhe që mbështeten në emocionet parësore, shih – ***EMOCIONE PARËSORE.*** Frika, zemërimi, gëzimi etj. janë të zhvilluara te të gjithë, por përjetimi i tyre ndryshon

nga pjesëtarët e një mjedisi kulturor prej pjesëtarëve të një mjedisi tjetër kulturor.

EMOCIONET ELEMENTARE. Emocione që shfaqen herët, qysh në procesin e zhvillimit të fëmijës, të përbashkëta për njerëzit dhe primatët e tjerë, që kanë karakter të përgjithshëm, bazë fiziologjike të posaçme, që shfaqen lehtë, shpejt dhe janë intensive, por afatshkurtra. Emocionet elementare janë të lidhura ngushtë me veprime instinktive dhe shtytëse dhe variojnë nga pesë deri në nëntë, të cilëve u paraprin emocioni i kënaqësisë dhe emocioni i pakënaqësisë. Megjithëse për emocionet elementare janë shprehur të parët filozofët, të cilët i kanë quajtur emocione themelore e bazike (Aristoteli, R. Dekarti, Tomas Hobs (Thomas Hobbes) e Spinoza), në psikologji ndarja e emocioneve në emocione elementare dhe emocione komplekse i atribuohet Uiliam Mekdugalit (William Mcdougall).

EMOCIONET KOMPLEKSE. Emocione e të rriturve, si emocionet estetike, emocionet e fajit, ndjenjat etj. Këto emocione dallohen nga emocionet elementare, sepse janë zhvilluar dhe formuar gjatë zhvillimit dhe përvojës së njeriut, kanë strukturë të ndërlikuar, cilësi të veçanta, nuk janë shumë të lidhura me emocionet elementare, por lidhen me sjellje të veçanta të njeriut ndaj një objekti apo me ndonjë situatë reaguese të njeriut ndaj objekteve dhe situatave të caktuara. Emocionet komplekse kanë përmasa motivuese, por thelbi i sjelljeve të njeriut nuk buron nga emocionet. Grupi i emocioneve komplekse i përket ndarjes tradicionale të emocioneve në emocione elementare dhe emocione komplekse (Uiliam Mekdugal, Plutçik etj.). Shih – ***EMOCIONET ELEMENTARE.***

EMOCIONET NDAJ TË TJERËVE. Përjetim subjektiv i gjendjes emocionale të njeriut gjatë komunikimit me të tjerët në kuadrin e relacioneve të ndryshme shoqërore, duke përfshirë edhe këto relacione. Emocionet ndaj të tjerëve janë: dashuria, inati, dhembshuria etj. dhe mund të jenë emocione pozitive dhe negative. Emocione pozitive janë: dëshira për afrim me të tjerët dhe për intimitet vetëm me disa, altruizmi, respektimi, nderimi etj. Emocione negative janë: antipatia, inati, urrejtja, xhelozia etj.

EMOCIONET NDAJ VETES. Grup emocionesh të lidhura me vetë njeriun. Këto emocione përcaktohen në bazë të kriterit të vlerësimit të qëndrimeve dhe të sjelljeve vetjake, duke pasur për bazë kriteret e brendshme të moralit të një mjedisi social. Emocione të tilla janë: ndjenja e fajit, ndjenja e përgjegjësisë, ndjenja "e vrarjes" së ndërgjegjes, krenaria etj. Këto emocione janë produkt i edukatës dhe zhvillohen që nga fëmijëria, në fillim në rrethin familjar e më pas në një rreth më të gjerë.

EMOCIONET PARËSORE. Emocione themelore të jetës dhe të aktivitetit të njeriut që përfshijnë: frikën, gëzimin, zemërimin e pikëllimin (në literaturën bashkëkohore pohohet se ekzistojnë gjashtë emocione parësore). Këto emocione (frika, gëzimi, zemërimi dhe pikëllimi) janë emocione të zhvilluara qysh herët gjatë evoluimit psikik të njeriut. Rregullisht përjetohen të lidhura me sjelljet që drejtohen kah qëllimi i caktuar i njeriut. Këto

emocione përjetohen me ndryshime fiziologjike periferike dhe qendrore dhe me tension relativisht të lartë të organizmit të njeriut.

EMOCIONET RELIGJIOZE. Tërësi emocioesh që formojnë në radhë të parë një ndjenjë. Shih – ***NDJENJA***. Sipas Uliam Xhejms (Wililiam James, 1842 – 1910) ekzistojnë disa lloje emocionesh që mund të shkaktohen nga objektet religjioze". Të tilla emocione janë: frika religjioze, dashuria religjioze, gëzimi religjioz etj. Megjithkëtë, disa rezultate të hulumtimit të emocioneve religjioze tregojnë se ekziston ndjenja religjioze e sajuar nga disa emocione dhe qëndrime të drejtuara në një objekt të caktuar, në Perëndi, në Bibël, në Kuran etj.

EMOCIONET SHQISORE. Emocione të shkaktuara nga ngacmuesit e shqisave të jashtme ose të receptorëve të brendshëm të njeriut. Ngacmues të tillë mund të jenë ngjyra e gjelbër e një panorame livadhesh, shija e ëmbël e një ushqimi, marrja e lëngjeve kur kemi etje etj. Këta ngacmues të shqisave, krahas reagimeve receptorike, shkaktojnë kënaqësi ose pakënaqësi. Kënaqësia dhe pakënaqësia e shkaktuar nga këta ngacmues luhatet prej një intensiteti më të ulët deri në atë më të lartin. Për nga intensiteti kënaqësia mund të luhatet nga kënaqësia e thjeshtë deri në skajin e përjetimit të një entuziazmi të madh; pakënaqësia luhatet prej një shkalle të ulët deri në refuzim, neveri dhe dhembje të madhe, e shkatuar nga ngacmuesit shkatërrues të organeve të njeriut.

EMOTIV, - E. mb. Që përcakton shkallën e lartë të ndjeshmërisë emocionale të njeriut dhe cilësinë e atyre ngacmuesve të jashtëm ose të brendshëm, të cilët janë në gjendje të shkaktojnë reagim emocional te ai. Me këtë kuptim mund të pohohet se shumë individë janë emotivë ndaj acarit të madh, ndaj gjendjes së varfërisë, ndaj mundimit të madh të të moshuarve etj. Në shqipe më tepër përdoret cilësori emocional ose emocionale, për ata ose ato situata që janë në gjendje të shkaktojnë emocione te njeriu. Emotiv a emotive mund të jetë cilado anë apo aspekt i emocioneve, cilësia, intensiteti, shprehja e jashtme e emocioneve, shoku emocional, përshkrimi i një gjendjeje të caktuar emocionale etj.

Burimet:

James Wenceslas Papez: "*A proposed mechanism of emoyion" – ("Parashtrimi i mekanizmit të emocioneve"),* Archives of neurology and psychiatry 38 (fq. 725 – 743);

Jean Piaget: *"Intelligence and affectivity: their relation during child development" – ("Inteligjenca dhe afektet: lidhja e tyre gjatë kohës së zhvillimit të fëmijës"*), Paolo Alto. California: Annual Reviews Inc. 1981;

Carl G. Lange: "*Über Gemuthsbewegungen" – (*"*Mbi ndjenjat"*), Leipzig: Theodor Thomas, 1887.

Walter B. Cannon: *"The James – Lange Theory of Emotion. A critical examination and an alternative theory" – ("Teoria e Xhejms – Langut mbi emocionet. Një provë kritike dhe teoria alternative"*). American Journal of Psychology, 39:106 – 124, 1927.

Wilhelm Wundt: *"Grundriss der Psychologie" – (*"*Bazat e psikologjisë"*), Leipzig: Engelamann, 1902.

Jerome L. Singer: "*Daydreaming and fantasy" – ("Ëndrrat ditore dhe fantasia*"), Oxford: Oxford University Press, 1975;

Ulrich Mees: *"Die Struktur der Emtoionen" – ("Struktura e emocioneve"),* Göttingen: Hogrefe, 1991.

Rene Zazo: "*L` Attachement" – ("Burimi i ndjenjave"),* Delachaux et Nioestle Neuchatel (Sulsse), 1974;
Roger Gil: *"Neuropsychologie" – ("Neuropsikologjia")* (përkthyer në shqip, "Dituria", 2002, fq. 220 – 230);
Robert Plutchik: "*Emotion: a Psychoevolutionary synthesis" – ("Emocioni: sinteza psikoevolutive"),* New York: Harper & Row., 1980;
Robert Plutchik: *"Emotion theory, research, and experience" – ("Teoria e emocioneve, gjurmime dhe përvoja"),* ed. R. Plutchik and H. Kellerman, Akademic Press, New York, 1980;
William James: *"The principles of psychology" – ("Parime të psikologjisë"),* vol. II. Reissued 1950. New York, 1890.
Wolfgang Rost: *"Emotionen – Elixiere des Lebens" – ("Emocionet – Eliksire të jetës"),* Berlin: Springer, 1990.
Zenel Orhani: *"Psikologjia e emocioneve",* Tiranë, 2003;
Dominique Moïsi: *"Gjeopolitika e emocioneve*", Tiranë, 2012;
Pettijohn F. Terry: "*Psychology" – ("Psikologjia – Një hyrje koncize")* (i përkthyer në shqip,), Shtëpia Botuese "LILO", Tiranë, 1996, fq. 348 – 367.

EMPATI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *εμπάθεια* që ka kuptim të përgjithshëm, sipas së cilës ajo është ndarje e përjetimit emocional të një individi me të tjerë, të marrjes pjesë aktive në përjetimin e situatës emocionale të një individi tjetër. Empatia shtrihet që nga fusha njohëse e emocioneve të tjetrit, e kuptimit të gjendjes emocionale të tij dhe përmbledh edhe marrjen e asaj gjendjeje të një individi tjetër dhe përfshirjen e saj në jetën aktuale të tij. Individi me empati është i vetëdijshëm se e kupton dhe e ndien atë që mundon individin tjetër, vuajtjen, mjerimin, por edhe gjendjen e gëzueshme dhe të hareshme të tjetrit. Në psikologjinë e personalitetit empatia ka kuptim të posaçëm: në psikanalizë, sidomos në psikoterapinë psikanalitike, empatia është lloj i përjetimit të emocioneve të tjetrit gjatë kohës së komunikimit me të. Në teorinë e personalitetit të Hari Saliven ajo ka kuptim të gjerë: empatia është bartja e mendimeve, pikëpamjeve, qëndrimeve, ndjenjave etj. nga një individ në tjetrin kur këta komunikojnë vetëm ndërmjet tyre, duke mos e bërë publike përmbajtjen e këtij komunikimi. Termi empati në fillim i përkiste leksikut terminologjik të estetikës, ku mendimtari Teodor Lips (Theodor Lipps, 1851 – 1914) me empati ka shpjeguar futjen e një përjetimi emocional në aktin krijues të një piktori, poeti etj**.**

EMPATIA KRITIKE. Identifikimi i vetëdijshëm i psikoterapeutit me pacientin në pikëpamje të gjendjes emocionale, të mendimeve, të qëndrimeve, të vlerave etj., por duke mbajtur largësinë e duhur ndaj objektit hulumtues. Termin empati kritike e ka përdorur Henri A. Marei (Henry A. Murray, 1893–).

EMPIRIK, - E. mb. I ardhur nga greqishtja *εμπειρία* "përvojë", që emërton gjithë atë dije të njeriut, burim i së cilës është përvoja dhe që mbështetet në përvojë. Empirike mund të jenë: faktet, metodat hulumtuese, qasjet studimore etj. Qasjen empirike të hulumtimeve e ka formuluar shkencërisht Xhon Lok (Jones Locke, 1632 – 1704). Sipas tij baza e gjithë dijes dhe e përmbajtjes së proceseve psikike njohëse është përvoja ose empiria.

ENCEFALITIZËM, - MI. m. I ardhur nga greqishtja *ενκεφαλος* "truri". Encefalitizmi në kuptimin ontologjik emërton konceptin e procesit të

marrjes nën kontoll dhe të drejtimit të aktiviteteve të ndryshme nga ana e trurit. Një proces i tillë zhvillohet gjatë rritjes dhe zhvillimit organik, biologjik e social nga mosha më e hershme e organizmit të fëmijës deri në moshën e pjekurisë. Encefalitizmi evoluitiv është emërtim i konceptit të zhvillimit trunor nga shkalla më e ulët e qenieve të gjalla deri te njeriu.

ENCEFALON, - I. m. Term i anatomisë për trurin; emërtim i vjetër i trurit, që sot përdoret rrallë. Shih – ***TRURI.***

ENCEFALOPATI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *ενκεφαλος* "truri" dhe *πάθος* "sëmundje". Emcefalopatia është term përmbledhës për të gjitha çrregullimet e trurit, për të gjitha disfunksionet e trurit.

ENCEFALOPATIA VERNIKE. Çrregullim lëvizjesh, sidomos i kapakëve të syrit, i orientimit të njeriut në hapësirë i shoqëruar me turbullira mendore. Ky çrregullim shfaqet si pasojë e dëmtimit anatomik dhe funksional të qendrës Vernik në cipën e trurit të madh të zonës tëmthore (temporale).

ENCIKLOPEDIA PSIKOLOGJIKE. Vepër psikologjike e tipit të përpunimit, të përcaktimit dhe të hartimit të zërave të disiplinave psikologjike dhe të personaliteteve të afirmuara në hulumtimet psikologjike dhe me rezultate të njohura. Zërat enciklopedikë janë zëra të hartuar shkurt, pa shpjegime, që kanë informacion të ngjeshur dhe janë të zhveshur nga përjetimet emocionale; në zërat enciklopedikë flet shkenca e jo autori i tyre, përkatësisht ky i fundit bën përzgjedhjen e informacioneve kryesore, karakteristike për përmbajtjen thelbësore të atij zëri, duke i rreshtuar këta zëra sipas shkronjave të alfabetit të asaj gjuhe në të cilën është konceptuar enciklopedia e psikologjisë.

Burimet:

Alan E. Kazdin – Editor in Chief "Encyclopedia of Psychology" – "Enciklopedia e Psikologjisë", Amarican Psychological Association, Oxford University Press, 2000.

Enzyklopädie der Psychologie – "Enciklopedia e Psikologjisë", Verlag für Psychologie Dr. C. J. Hogrefe, Göttingen – Toronto – Zürich, 1999.

Raymond J. Corsin & Alan J. Auerbach: *"Concise Encyclopedia of Psychology" – ("Enciklopedia e përmbledhur e psikologjisë")*, 1995.

ENDODERMË, - A. f. Struktura e qelizave të embrionit të cipës së brendshme të organeve të një organizmi, nga e cila zhvillohen organet tretëse të ushqimit.

ENDOGAMI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *ενδο* "e brendshme" dhe *γαμεο* "me u martu". Raport i vjetër martesor, ku ndalohet martesa ndërmjet dy çifteve të një farefisnie, fisi, vëllazërie etj. Por, në popujt e disa kulturave ka ekzistuar zakoni i martesës ndërmjet anëtarëve të një farefisnie, që i përkisnin një "kaste" të privilegjuar të shoqërisë (farefisni mbretërore, farefisni bejlerësh etj.).

ENDOGJEN, - E. mb. I ardhur nga greqishtja *ενδογενής*. Gjinia, origjina e një dukurie, organi, procesi etj., zhvillimi i brendshëm, që e ka origjinën nga faktorët zhvillimorë të brendshëm. Me cilësorin endogjen emërtohet gjeneza e mirëfilltë e zhvillimit të një organi nga ndikimi i faktorëve të brendshëm të një organizmi të caktuar. Endogjen ka kuptim fiziologjik dhe psikologjik.

Në fiziologji ai emërton ndryshimet e brendshme zhvillimore të proceseve fiziologjike. Në psikologji emërton origjinën e zhvillimeve të brendshme të strukturave e të proceseve psikike, të sjelljeve etj.

ENDOKRINOLOGJI, - A. f. Shkenca që merret me studimin e gjëndrave me sekretim të brendshëm, me strukturën, funksionin, llojet, efektin dhe me çrregullimin e tyre (të hipofizës, të gjëndrës tiroide, paratiroide etj.), shih – ***GJËNDRAT ME SEKRETIM TË BRENDSHËM.*** Sot kuptimi i endokrinologjisë është zgjeruar duke përfshirë edhe sekretime të tjera në organizëm.

ENDOLIMFË, - A. f. I ardhur nga greqishtja *ενδολεμφικός* që i përket anatomisë e fiziologjisë së shqisës së dëgjimit që emërton lëngun që gjendet në labirinthin e veshit të brendshëm. Shih – ***VESHI.***

ENDOMORFI, - A. f. Në tipologjinë e Uiliam Sheldonit (William Sheldon, 1898 – 1977) emërton dimensionin konstitucional të klasifikimit somatopsikik të personalitetit. Tip endomorf është një njeri i shëndoshë, me zhvillim të dukshëm të indeve dhjamore, me lukth të madh, me zhvillim të dukshëm të organeve të brendshme trupore, me muskuj dhe eshtra të dobëta dhe me sipërfaqe të vogël të lëkurës në raport me peshën e trupit të tij.

ENDORFINA BETA. Peptid i karakterit aminoacid që luan rolin e transmiterit. Prodhohet në trurin e njeriut, përkatësisht në hipofizë. Luan rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe kontrollimin e gjendjeve emocionale të njeriut, sidomos të gjendjes afekte, të ankthit, të dhembjes dhe frikës. I përket grupit të endorfinave më të fuqishme.

ENERGJI, - A. f. Term i fizikës që përdoret edhe në psikofiziologji, por me kuptim jo aq të saktë si në fizikë. Në psikofiziologji emërton aftësinë energjetike të organizmit për metabolizëm bazal si edhe atë për kryerjen e proceseve metabolike të ndryshme. Në psikologji përdoret më tepër emërtimi energji mendore, që është energjia e intelektit për të kryer e një aktiviteti psikik, të një procesi psikik, të një sjelljeje etj. Aktiviteti fizik dhe aktiviteti mendor kërkojnë energji të veçanta. Aktiviteti mendor kërkon energji më të vogël se ai fizik. Për këtë shkak flitet edhe për punë mendore. Termi energji ka zënë vend të veçantë në teorinë e Z. Frojdit, të K. Jungut dhe të Kurt Levinit (Kurt Lewin, 1890 – 1947).

a. **Energjia psikike e psikanalizës së Z. Frojdit –** Energjia me të cilën vihet në veprim aparati psikik. Frojdi ka trajtuar më tepër energjinë e shtytësve, sidomos të shtytësit seksual. Kjo energji buron nga proceset organike e fiziologjike të organeve të trupit të njeriut dhe ka të bëjë me funksionin e shtytësve. Ai ka dalluar dy lloje të energjisë psikike: energjinë psikike të lirë dhe energjinë psikike të lidhur;

b. **Energjia psikike në psikologjinë komplekse të K. Jungut –** Formë e energjisë trupore të njeriut, e cila mundëson zhvillimin e aktivitetit mendor. Sipas K. Jungut personaliteti i njeriut është sistem i energjisë së mbyllur; me anë të kësaj energjie njeriu zhvillon individualitetin e tij.

c. **Enegjia psikike në teorinë e fushave sipas K. Levinit –** Energji e veçantë

mendore, energji specifike, e cila prodhon aktivitet psikik të caktuar. Kjo energji kryen funksionin e baraspeshimit të personalitetit me synimin e drejtuar drejt një qëllimi të caktuar.

ENERGJIA SPECIFIKE AKSIONALE. Term i vjetër i studiuesve të natyrës i lidhur me etologjinë. Emërton konceptin hipotetik të energjisë së supozuar vepruese të organizmit që i jep energji atij për të reaguar ndaj ngacmuesve të caktuar. Pas përfundimit të atij reagimi kjo energji ripërtërihet. Energjia aksionale specifike fillon së vepruari në organizëm ose në një pjesë të tij menjëherë sapo të ngacmohet pjesa e organizmit me ngacmues adekuat. Nëse nuk ngacmohet me ngacmues adekuat atëherë energjia e tillë derdhet në pjesën tjetër të organizmit, ose aktiviteti mbetet pa energji. Termin energji specifike aksionale e ka përdorur më tepër etologu austriak Konrad C. Lorenc (Konrad C. Lorenz, 1902–). Shih – ***ENERGJIA SPECIFIKE E NERVAVE.***

ENERGJIA SPECIFIKE E SHQISAVE. Term i pikëpamjes së fiziologut gjerman Johan Myler (Johannes Müller, 1801 – 1858), sipas të cilit cilësinë e një ndijimi e të një perceptimi nuk e përcakton trupi i jashtëm ose një cilësi objektive e tij, por receptorët e shqisave; këta receptorë prodhojnë impulse nervore, sepse zotërojnë energjinë specifike, me anën e së cilës ato e përcaktojnë ndijimin pavarësisht nga lloji i ngacmuesit të tyre. Në mbështetje të një energjie të tillë lindin ndryshimet individuale në ndijimin dhe në perceptimin e trupave nga ana e njeriut, përkatësisht të shqisave me receptorët e tyre.

ENGRAM, - I. m. I ardhur nga greqishtja *ευ* "në" dhe *γραμμ* "e shënuar". Koncept hipotetik që ka të bëjë me gjurmët biokimike relativisht të qëndrueshme të qelizave, të indeve nervore të kores së trurit të madh dhe të lidhjeve të tyre, si pasojë e ndikimit që ushtrojnë ngacmuesit e përvojës dhe të përmbajtjeve që njeriu i mëson. Ndryshimet e tilla përbëjnë bazën neurofiziologjike të të gjithë të mësuarit dhe të kujtesës së njeriut, kurse dobësimi dhe zhdukja e këtyre ndryshimeve nervore janë të lidhura me harresën. Pohohet se këto ndryshime të qelizave nervore janë të natyrës biokimike, por ende nuk ka rezultate nga hulumtimet e shumta të kësaj baze për ta vërtetuar këtë gjykim hipotetik. Ndryshimet biokimike besohet se janë korelate të kujtesës dhe supozohet se kanë vend të caktuar, por këtë duhet ta vërtetojnë studimet e mëvonshme. Termi i përket leksikut terminologjik të biologjisë sipas biologut Rihard Semon, por shfrytëzohet edhe në psikologji dhe është përdorur nga psikologu H. Ebinghaus dhe nga studiuesit e tjerë të kujtesës.

ENKODIM, – I. m. Term i teorisë së informatikës që ka filluar të stabilizohet edhe në terminologjinë e psikologjisë, sidomos në deshifrimin e shenjave të koduara në një sistem të dhënash për qëllim të përpunimit të lehtë dhe të shpejtë të tyre. Enkodimi është proces me të cilin njeriu i shndërron informatat e marra sipas një kodi të caktuar në porosi të mundshme për t'u bartur nëpër kanalin e komunikimit. Enkodimi mund të bëhet në disa forma: enkodimi semantik bëhet duke deshifruar sipas kodit kuptimin e

fjalëve, të fjalive etj., me anë të impulsave elektrikë, të alfabetit Mors etj.

ENKOPREZË, - A. f. I ardhur nga greqishtja *ευ* "në" dhe *κοπρεζ* "feçe". Pamundësia e çlirimit në mënyrë të vullnetshme nga mbeturinat e ushqimit të përpunuar në organizëm. Enkopreza mund të konsiderohet çrregullim, atëherë kur fëmija edhe pas moshës 3-vjeçare defekon vend e pavend, duke mos pasur mundësi t`i nënshtrohet vullnetit të organizmit. Enkoprezia shfaqet më tepër te djemtë e vegjël se te vajzat. Ka karakter psikogjen dhe shfaqet pa ndonjë bazë në çrregullimet organike e fiziologjike. Është më e rrallë se enureza.

ENTELEHI, - A. f. Term i vjetër i greqishtes që ka kuptimin e fuqisë së jetës, të fuqisë vitale. Entelehia nuk ka mundësi të shpjegohet sipas parimeve të fizikës, të kimisë dhe as sipas parimeve mekanike. Entelehia është fuqi e brendshme e trupit dhe e shpirtit. Sot ky term përdoret më tepër për shpjegime filozofike.

ENTROPI, - A. f. I ardhur në fizikë nga greqishtja *ευ* "në" dhe *τροπία* "shndërrim". Në termodinamikë shpreh sasinë e energjisë që nuk mund të shfrytëzohet për punë. Në literaturë zakonisht lidhet me ligjin e dytë të termodinamikës, sipas të cilit entropia e një sistemi, gjatë shndërrimit të energjisë termike në atë mekanike, ndonëse një pjesë e saj humbet, nuk zvogëlohet, por ruhet. Ky term përdoret në biologji, në sociologji dhe në disa disiplina me kuptim të veçantë. Entropi përdoret në psikologjinë sociale dhe në teorinë e psikanalizës sipas këtyre kuptimeve:

a. Në psikologjinë sociale entropia është humbja e energjisë për ndryshime shoqërore me qëllim të përparimit të asaj shoqërie, përkatësisht humbja e energjisë sociale për ndryshime progresive të raporteve shoqërore.
b. Në psikanalizë entropia është humbja e energjisë shpirtërore, e libidos dhe pamundësia e shfrytëzimit të asaj pjese që mbetet, ngaqë është shpenzuar pak a shumë në një objekt të caktuar.

ENTUZIAZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga greqishtja *ενθουσιασμός*. Gjendje psikike e njeriut, të cilën e karakterizon ndjenja e kënaqësisë, gëzimi, dashuria dhe fuqia motivuese e tyre nga përjetimi i veçantë i një aktiviteti, suksesi, krijimi etj. Një gjendje e tillë ka karakter preokupues dhe përmasë shtytëse të zhvillimit të posaçëm të sjelljeve ndaj asaj veprimtarie, objekti e akti krijues.

ENUREZË, - A. f. I ardhur nga greqishtja. Urinim i shpeshtë, pa mundur për të mbajtur nën kontroll mëshikëzën e urinës dhe funksionin e saj. Enureza është problem i moshës fëmijërore të fëmijëve, që urinojnë zakonisht natën në krevat. Enureza merr karakterin e dukurisë negative atëherë kur urinimi i pakontrolluar shfaqet edhe pas moshës 3 – 4 vjeç. Shkaqet mund të jenë: frustrimi i madh, lindja e vëllait ose e motrës dhe tërheqja e vëmendjes së prindërve te ai e jo te i porsalinduri me anë të urinimit etj. Shërimi nga çrregullimi i tillë i urinimit është teknika e nxitjes elektrike të lehtë që të prodhojë tinguj ritmikë të ziles për ta zgjuar fëmijën nga gjiri, ose duke përdorur ndonjë ngacmues aversiv për fëmijën.

EPIDEMIA PSIKOLOGJIKE. Përhapje e shpejtë e një çrregullimi të gjendjes psikike në masat e gjera të një mjedisi shoqëror dhe ndikimi negativ i saj në pjesëtarët e këtij mjedisi. Epidemi psikologjike mund të jetë përhapja e shpejtë e frikës, madje edhe e ankthit nga rreziku kërcënues i ndonjë sëmundjeje ngjitëse; shtimi i numrit të vetëvrasjeve nga frika e humbjes masive të vendeve të punës etj. Në mbështetje të njohjes së rregullsive të paraqitjes së epidemive psikologjike merren masa për pengimin e përhapjes së saj, përkatësisht për çrrënjosjen e kësaj epidemie në një mjedis të caktuar shoqëror.

EPIFENOMEN, - I. m. I ardhur nga greqishtja *επιφαίνομαι* "shfaqje e mëvonshme". Në psikologji shpreh dukurinë përcjellëse të një procesi, sjelljeje etj., ose të paraqitjes së mëvonshme të saj, duke mos pasur kurrfarë lidhjeje kazuale me procesin ose me sjelljen kryesore. Të tilla mund të jenë artefaktet e një situate eksperimentale, proceset neurobiokimike gjatë ëndërrimit, kërkimi i shkakut të një fatkeqësie në trafik në rrethana të parëndësishme e jo në shkakun kryesor të sjelljes joprofesionale të shoferit etj.

EPIFENOMENALIZMI NË PSIKOLOGJI. Term i metafizikës që ka gjetur zbatim edhe në psikologji. Epifenomenalizmi në psikologji është trajtimi i dukurive, proceseve psikike dhe i sjelljeve të njeriut si produkt dytësor, i parëndësishëm i proceseve neurofiziologjike e biokimike. Sipas kësaj doktrine metafizike mendja e njeriut, vetëdija, proceset kognitive, emocionale e motivuese si edhe e tërë jeta mendore e njeriut janë vetëm prodhim i proceseve fiziologjike të trurit dhe të organeve të organizmit të njeriut. Faktorët psikogjenë të zhvillimit të një çrregullimi mendor nuk do të ekzistonin sikur të mos kishte ndonjë çrregullim anatomik a fiziologjik. Bota fizike e biologjike, si edhe ajo sociale është botë reale, kurse dukuritë e proceset psikike, si edhe sjelljet e njeriut janë vetëm aktivitete përcjellëse të asaj bote. Epifenomenalizmi sot ka karakter vetëm të një koncepti dhe termi historik.

EPIFIZË, - A. f. Gjëndër me tajim ose sekretim të brendshëm, e zhvilluar mbi pjesën e trurit të mesëm. Kryen funksione të ndërlikuara fiziologjike dhe psikologjike. Është konsideruar qendër e lidhjes së zhvillimeve organike dhe shpirtërore. Te fëmijët kryen funksionin e lehtësimit të eshtrave të skeletit dhe rritjen e tyre. Është e lidhur ngushtë me funksionin e gjëndrave të tjera me tajim ose sekretim të brendshëm. Epifiza luan rol të rëndësishëm në aktivizimin e mekanizmit mbrojtës ndaj situatave stresante. Funksionet fiziologjike të saj janë disa, nga të cilat dallohet funksioni i rregullimit të sasisë së ujit, sheqerit, oksigjenit etj. Hormoni i saj melatonin krijohet në kohën e pubertetit dhe rregullon shfaqjen e cilësive seksuale dytësore. Funksionet e tjera të epifizës janë në gjurmim.

EPIGJENEZË, - A. f. Term i biologjisë i ardhur nga greqishtja *epi* "pas" dhe *gjvedhis* "lindje". Teori biologjike me shtrirje kuptimore edhe në psikologji. Sipas kësaj teorie embrioni nuk është i paraformuar në vezën e fekonduar nga spermatozoidi, por struktura e organizmit, organet, funksionet dhe përgjithësisht strukturat morfologjike zhvillohen gradualisht sipas zhvillimeve të reja të embrionit,

duke pësuar ndryshime nga përbërjet e thjeshta në ato më të ndërlikuarat. Ky proces zhvillimi shtrihet edhe në zhvillimin e strukturave, të funksioneve dhe të sjelljeve të njeriut. Këtë term e ka shfrytëzuar Erik H. Erikson (Erick H. Erikson, 1902–), në konceptimin e teorisë së personalitetit në bazë të zhvillimit psikosocial të tij. Shih – ***TEORIA E PERSONALITETIT E ERIKSONIT.***

EPILEPSI, - A. f. Term i psikiatrisë që ka zënë vend edhe në terminologjinë e psikologjisë. I ardhur nga greqishtja *επθληψία.* Përmbledhë disa çrregullime neurotike ku hyjnë: errësira e vetëdijes, humbja e funksionit kontrollues të saj ndaj tërësisë së funksioneve psikomotorike e psikosensorike, aktivitet jonormal encefalografik, rënie përdhe e epileptikut etj. Origjina e epliepsisë është pjesërisht e shpjegueshme: mund të ketë karakter trashëgues, por mund të zhvillohet edhe nga ndryshimet metabolike të një grumbulli fijezash të neuroneve, sidomos të atyre të pjesës tëmthore e ballore. Nga epilepsia vuajnë përafërsisht 1 ndër 200 vetë. Goditjet epileptike mund të zgjasin disa sekonda dhe kanë shtrirje, kohëzgjatje, shpeshtësi dhe fuqi të ndryshme. Këto goditje epileptike klasifikohen sipas parimeve të ndryshme.

EPILEPSIA ALKOOLIKE. Epilepsi e shkaktuar nga marrja e pandërprerë e pijeve alkoolike, kur dozat e pandërprera të alkoolit goditin keq strukturën dhe funksionin e pjesëve të brendshme të trurit. Me ndërprerje të pijeve alkoolike sulmet epileptike nuk ndërpriten, por ndikojnë në paraqitjen më të rrallë të tyre dhe në shkurtimin e kohëzgjatjes së këtyre sulmeve.

EPILEPSIA E XHEKSONIT. Formë e epilepsisë e shkaktuar nga dëmtimi dhe disfunksioni i zonës motorike të kores së trurit. Format e shfaqjes së saj janë: dridhja e gjymtyrëve me goditje epileptike të përqendruara në nyjet e muskulaturës së një organi të trupit, zakonisht në gishtërinjtë e njërës dorë apo tjetrës, në pamundësinë e lëvizjes së gjuhës, të një palë gjymtyrëve etj. Zgjat disa sekonda dhe më pas mund të zhduket ose të përhapet edhe në pjesët e tjera të trupit. Emërtimin epilepsi e Xheksonit e ka marrë sipas zbuluesit të saj – neurologut Xhon H. Xhekson (John H. Jackson, 1835 – 1911).

EPILEPSIA FOKALE. Lloj sulmesh epileptike që e kanë të lokalizuar kryesisht funksionin e qendrave të kores së trurit. Epilepsia fokale karakterizohet me sulme të shkurtra intensive të çrregullimit të funksioneve sensomotorike.

EPILEPSIA GRAND MAL. Sëmundje e madhe sipas frëngjishtes "Grand mal". Kjo epilepsi karakterizohet nga këto simptoma: humbje e shpejtë e funksionit të vetëdijes, humbje e kontrollit ndaj disa funksioneve fiziologjike, rrëxim në vend, nxjerrje e "shkumës" nga goja, ngritje e presionit të gjakut, përshpejtim i rrahjeve së zemrës. Epilepsia Grand Mal i përket grupit të sëmundjeve psikike të emërtuara sulme konvulsive të parealizuara.

EPILEPSIA MOTORIKE XHEKSON. Formë e epilepsisë tek e cila, sulmet epileptike fillojnë me lëvizje të pavullnetshme dhe me ngërçe në njërën prej pjesëve të trupit dhe më pas, ose mbeten të lokalizuara ose përhapen në pjesët motorike të afërta me

pjesët e goditura. Gjatë kësaj forme të epilepsisë veprimtaria e vetëdijshme e epileptikut është e pacenuar, pikërisht kjo është e ruajtur. Fillesat e epilepsisë Xhekson mund të jenë dora e njërës pjesë të trupit, gishtërinjtë e saj, gjuha etj. Shkaktohet nga dëmtimi i fushës motorike të cipës së trurit të madh, saktësisht nga dëmtimi i fushës para brazdës qendrore të trurit të madh. U identifikua nga ana e neurologut anglez Xhon H. Xhekson (John H. Jackson, 1835 – 1911).

EPILEPSIA PETIT MAL. I ardhur nga frëngjishtja *petit mal* që ka kuptimin e një sëmundjeje të vogël. Petit Mal është formë e epilepsisë, karakteristike më tepër për moshën fëmijërore, e përqendruar më tepër në mes të moshës 6 – 12 vjeç. Goditjet epileptike të këtij lloji të epilepsisë i përkasin goditjeve jokompulsive, zgjasin zakonisht një kohë më të shkurtër se ato të sëmundjes epileptike Grand Mal, nuk shoqërohen me ngërçe dhe përçohen me ndëprerje të shkurtra të funksionimit të vetëdijes.

EPILESIA PËRGJITHËSUESE. Epilepsi me sulme epileptike të shkaktuara nga ndryshimet patologjike të aktivitetit elektroencefalografik. Në epilepsinë përgjithësuese të sulmeve epileptike shfaqen ndryshime në funksionin e gjithë sipërfaqes së kores apo cipës së trurit.

EPILEPSIA SENSORIKE XHEKSON. Formë vatrore e epilepsisë që ka të bëjë me çrregullimin e ndijimeve të veçanta. Në këtë formë të amnezisë çrregullohet funksionimi i qendrave ndijimore të posaçme të cipës së trurit të madh. U përshkrua nga neurologu anglez Xhon H. Xhekson.

EPILEPSIA SIMPTOMATKE. Emërtim i përgjithshëm i të gjitha formave të mësuara të epilepsisë, të cilave u dihet shkaku. Epilepsia simptomatike është rezultat i dëmtimit të pjesëve të trurit, i një tumori në trurin e njeriut, i çrregullimeve funksionale neurologjike. Epilepsia simptomatike nuk është e lindur, por shfaqet gjatë zhvillimit të njeriut, kur ky pëson lëndime të lidhura kryesisht me funksionet e sistemit nervor**.**

EPINEFRINË, - A. m. Emërtin i posaçëm nga greqishtja i adrenalinës - hormonit të gjëndrës mbiveshkore. Epinefrina ose adrenalina rrjedh nga thelbi i veshkave. Kryen funksione të ngjashëm me sistemin nervor simpatik. Shih - ***SISTEMI NERVOR SIMPATIK,*** si: përshpejtim të funksionimit të zemrës, ngritje të presionit të gjakut etj. Termi epinefrinë përdoret rrallë, sepse termi adrenalinë përdoret në terminologjinë e fiziologjisë së gjëndrave me tajim ose sekretim të brendshëm. Shih – ***ADRENALINA.***

EPISOD, - I. f. Tërësi konceptesh e lidhjesh midis tyre të një ngjarjeje të tërësishme që kanë njëfarë mëvetësie brenda tyre ose që perceptohen si një tërësi e qëndrueshme. Zakonisht në përmbajtje të kësaj tërësie ekziston edhe koncepti e termi i tij që përcakton kohën dhe vendin e asaj ngjarjeje. Në psikologjinë patologjike dhe në psikiatri dallojmë disa episode.

EPISODI I DEPRESIONIT MADHOR. Kohë relativisht e gjatë, e mbushur me depresion që ka këto simptoma kryesore: zgjatje përreth dy javësh të mendimeve për vdekjen, për fajësinë, për pavlefshmërinë e punëve dhe të personalitetit të një

individi. Shkaqet e kësaj gjendjeje janë të karakterit psikogjen dhe zakonisht karakterizojnë individin me depresion të herëpashershëm.

EPISODI I HIPOMANISË. Sjellje e çrregulluar që ka këto simtoma kryesore: vërshim idesh nga më të ndryshmet me pamundësinë e përmbajtjes së një individi nga një vërshim i tillë idesh, mungesë e nevojës për gjumë, gjendje ftohtësie ose humor i ftohtë, prani e shpeshtë e mendimeve të madhështisë etj. Proceset dhe sjelljet me simptoma të tilla zgjasin pak.

EPISODI I MANISË. Vetëvlerësim i tepruar, prania e ndjenjës së madhështisë së skajshme, mendime që shoqërohen me të folur gati të pandërprerë, shpërthime ndjenjash të pajustifikueshme, qëndrime seksuale të jashtëzakonshme dhe sjellje seksuale të pakontrollueshme etj.

EPISTEMOLOGJIA GJENETIKE. Në psikologjinë e zhvillimit të proceseve njohëse u përdor për herë të parë nga psikologu zviceran Zhan Pijazhe (Jean Piaget, 1896 – 1980). Termi epistemologjia gjenetike ka këto kuptime: proceset njohëse të realitetit zhvillohen gjatë organizimit të tyre për t`iu përshtatur sa më mirë mjedisit dhe kërkesave të tij; një zhvillim i tillë shfaqet nga konstruksioni aktiv i individit dhe nuk ka të bëjë me trashëgiminë dhe, së fundi, zhvillimi i tillë kryhet nga nevoja e tejkalimit të kontradiktave që krijon funksionimi i organizmit në mjedisin e ndërlikuar të ndryshimeve të vazhdueshme.

EPITALAMUS, - I. m. I ardhur nga latinishtja *epithalamus*. Hapësirë e ngushtë e vendosur mbi talamusin. Përbëhet nga dy pjesë: nga epifiza dhe nga bërthamat hibenulare. Shih –***EPIFIZA.*** Nëpër bërthamat hibenulare kalojnë fijezat nervore me anën e të cilave cipa a korja e trurit të madh kontrollon funksionin e organeve të brendshme.

EPJ/E, – A. f. Një lloj ndjenjeje te njeriu, kur ai ka një dëshirë të fortë për t'u dhënë pas një dukurie, objekti, virtyti etj., sepse përjeton kënaqësi të madhe për ta ndjekur zhvillimin e saj. Epja e tillë ka shtrirje të gjerë në veprimtarinë e njeriut dhe në angazhimin e tij, sepse kësaj dëshire të fortë ai përkushtohet para dëshirave të tjera. Epja ka edhe një kuptim tjetër: përulje ndaj nderit, veprës dhe rëndësisë së një aktiviteti me vlerë të veçantë dhe me përmasa të mëdha për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, kulturor, social etj. Epja rrjedh nga respekti i një individi ndaj një tjetri dhe ndaj veprës së tij, të tilla si: Epem para shtatores së Skënderbeut, pra përkulem para shtatores së tij. Epja ka edhe kuptim psikologjik.

EPSH, - I. m. Dëshirë e ndezur seksuale e mbështetur në shtytjen dhe në nevojën e lindur seksuale. Për prof. Eqrem Çabejn epshi është "zjarr i madh i mishit dhe i gjakut". Një zjarr i tillë përfshin gjithë organizmin e njeriut, sidomos organet seksuale. Epshi ka disa cilësi domethënëse të shtytësit, të nevojës dhe të motiveve, por ky duhet dalluar nga termat e tjerë, sepse në shqipe emërton "zjarrin seksual".

ER/Ë, - A. f. Veti e disa trupave që lëshojnë grimca të padukshme, të cilat veprojnë mbi shqisën e të nuhaturit. Cilësia e erës, intensiteti dhe kohëzgjatja e saj janë të lidhura me burimin e erës, nga i cili varet edhe ndijimi

nuhator ose olfaktiv, përkatësisht ndijimi i erës. Era dallohet me anën e receptorëve të shqisës së të nuhaturit. Vetinë e ndijimit të erës e shkaktojnë proceset kimike të ngacmuesve të posaçëm flurorë.

ERG, - U. m. I ardhur nga greqishtja *έργος* "punë". Në psikologji ka ardhur nga fizika dhe shfrytëzohet për të emërtuar koncepte të posaçme që kanë të bëjnë me dinamikën e personalitetit, me energjinë, me fuqinë e akteve të caktuara, të sjelljeve të veçanta etj. Në psikologjinë e Mekdugalit termi *érg* emërton konceptin e fuqisë së instinkteve të tij, ndërsa në psikanalizë ergu emërton fuqinë e shtytësve, e në radhë të parë fuqinë e shtytësit seksual.

ERGOGRAF, - I. m. I ardhur nga greqishtja *εργος* "punë" dhe *γράφος* "shkrim". Instrument për gjurmimin e sasisë së punës së kryer dhe për matjen e numrit të lëvizjeve të muskujve të një organi dhe për matjen e cilësisë së lëvizjeve që kryen organi i caktuar (gishti, dora, këmba etj.) gjatë kohës së veprimit të tij në procesin e një pune të caktuar. Ergografi përdoret sidomos në psikologjinë e punës për gjurmimin e saktë të aftësive punuese të një punëtori, si edhe për matjen e saktë të lodhjes objektive e subjektive të tij.

ERGONOMI, - A. f. Shkenca mbi punën që emërtohet me termin me origjinë nga greqishtja *εργος* "punë" dhe *νομία* "ligj". Disiplinë shkencore e veçantë, e cila merret me gjurmimin e raportit të njeriut punues me punën profesionale të tij, duke pasur detyrë kryesore përshtatjen e punës dhe të kushteve të punës, aftësive punuese, interesimeve, qëndrimeve etj. të tij. Ergonomia synon humanizimin e raportit njeri – makinë, plotësimin e ndjenjës së kënaqësisë së punëtorit, ngritjen e produktivitetit, të cilësisë së punës dhe përsojen e kësaj cilësie. Ergonomia është disiplinë e ndërlikuar e sintezës së arritjeve të fizikës, të fiziologjisë, të sociologjisë dhe të psikologjisë.

ERGOTERAPI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *έργο* "unë" dhe *θεραπεία* "shërim". Formë e shërimit të disa çrregullimeve psikike të njeriut me anë të angazhimit të tij në një proces punësh të lehta dhe të zhvillimit të preokupimit gjatë procesit të punës, duke mënjanuar përqendrimin në sjellje të papërshtatshme dhe duke kërkuar largimin e tij nga preokupimet e panevojshme. Një angazhim i tillë i këtyre individëve ngjall vetëbesim, përforcon ndjenjën e kënaqësisë, të suksesit etj.

ERGU NË PSIKOLOGJINË E KATELIT. Në psikologjinë e personalitetit të psikologut amerikan Rejmond Katel (Raymond Cattell, 1905 – 1989) termi erg emërton tiparet dinamike burimore të personalitetit. Me këtë kuptim ergu ka bazë konstitucionale, që manifestohet me ndjeshmëri të nivelit të lartë në perceptimin e dukurive, të trupave, proceseve etj. nga ana e atij, që ka dispozitë të lindur për një perceptim të tillë, si edhe reagim të veçantë ndaj grupit të disa objekteve. Sipas R. Katelit ekzistojnë këto tipare themelore të ergut: 1) Frika, 2) Fitimi, 3) Kërshëria, 4) Ergu i luftës, 5) Ergu i mbrojtjes prindërore, 6) Ergu i narcizizmit, 7) Ergu i seksit, 8) Ergu i shoqërimit, 9) Ergu i urisë, 10) Ergu

i vetnënshtrimit dhe 11) Ergu i vetafirmimit.

ERGU NË PSIKOLOGJINË E MASLOUT. Në psikologjinë humaniste të Abraham Maslout (Abraham Maslow, 1908 – 1970) është shkurtesë e përbërë nga shkronjat e para të këtyre termave të anglishtes: E(xistence), R(elatedness), G(routh). Ergu në teorinë e personalitetit sipas A. Maslout është emërtues i tri niveleve të nevojave themelore të njeriut. Grupin e parë të këtyre nevoja, përkatësisht grupin e E(xistence) e përbëjnë këto nevoja: biologjike (nevoja për ujë, ushqim, seks etj.), grupin e dytë të R(elatedness) e përbëjnë nevojat e karakterit shoqëror (bashkëpunimi, shoqërimi, ekipimi etj.) dhe grupin e tretë të G(routh) e përbëjnë nevojat psikologjike të zhvillimit personal, si: nevoja e përsosjes së sjelljeve, nevoja e mendimit të të folurit, nevoja e krijimtarisë, nevoja e vetafirmimit etj.

ERIKSON Erik H. (Erik H. ERIKSON). Psikolog gjerman. Lindi në Frankfurt më 15.06.1902 dhe vdiq në Herviq (Harwich) të Masaçusetsit më 12.05.1994. Shkoi në Vjenë më 1927 dhe aty u njoh me Zigmund Frojdin; para vitit 1933 ra në kontakt me Ana Frojdin, ku vendosi përfundimisht angazhimin e tij në çështjet e psikanalizës. Filloi të merret me studimin e psikanalizës, të cilën e përfundoi në kuadrin e Shoqatës Psikanalitike të Vjenës më 1933 dhe po këtë vit u shpërngul nga Vjena dhe u vendos në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Filloi punën në klinikën psikologjike të Universitetit të Harvardit, e prej këtej në Institutin për marrëdhënie ndërnjerëzore të Universitetit të Jelit. Asnjëherë nuk u largua nga gjurmimi i fëmijëve dhe i të rinjve me vështirësi në sjellje dhe me probleme të sjelljeve të tyre. Gjurmoi jetën e fëmijëve dhe të rinjve Sioux të Indianëve, duke shkuar edhe në rezervatin e tyre dhe pas një viti gjurmoi jetën e fëmijëve dhe të të rinjve të fisit Yrok të Indianëve në Universitetin Berkli të Kalifornisë. U kthye në Harvard dhe u mor me gjurmime psikologjike derisa doli në pension. Gjatë kësaj kohe i parapriu gjurmimeve psikologjike. Çështja kryesore me të cilën u mor në gjurmimet e veta ishte çështja e identitetit të personalitetit dhe pasojat psikologjike të zgjidhjes ose moszgjidhjes së identitetit të vet nga ana e njeriut. Për zhvillimin e identitetit dhe përgjithësisht të personalitetit, Eriksoni, si edhe psikanaliza në përgjithësi, i ka dhënë rëndësi zhvillimit psikik në moshën fëmijërore dhe zhvillimit të besimit në veten e tij. Kusht i domosdoshëm i zhvillimit të identitetit është formimi i egos ose i unit të njeriut. Veprat kryesore të Erik Eriksonit janë: "*Childhood and society*" – ("*Fëmijëria dhe shoqëria*"), 1963; "*Identity, Youth and Crisis*" – *("Identiteti, rinia dhe kriza"*), 1968.

EROS, - I. m. Perëndi, Zot i dashurisë në mitologjinë greke, bir i Hermesit dhe i Afërditës, që kishte tiparet nxitëse të bashkimit. Erosi u shfrytëzua nga teoria e psikanalizës së Frojdit. Sipas pikëpamjes së dytë më të përpunuar të teorisë së Frojdit, Erosi emërton shtytësin e parë dhe themelor të jetës së njeriut, dhe ka të bëjë me atë fuqi të brendshme të veprimtarisë së gjithanshme psikike të njeriut, që i jep atij jetë. Erosi në kuptimin e gjerë përfshin të gjithë shtytësit që sigurojnë

zhvillimin e jetës së njeriut dhe kanë lidhje me shtytësit individualë, të tillë si: shtytësi i urisë, i etjes dhe shtytësi i egos, si edhe me shtytësin seksual, që ka të bëjë me zhvillimin dhe mbrojtjen e gjinisë njerëzore. Mbi bazën e këtij shtytësi sipas Frojdit zhvillohet fuqia e energjisë psikike për të luftuar dhunën, urrejtjen dhe të gjitha ato fuqi shkatërruese të jetës dhe të zhvillimit të njeriut.

EROTIKË, - A. f. Të gjitha format e zhvillimit të dashurisë seksuale që përfshijnë: dashurinë fizike, trupore dhe dashurinë shpirtërore apo psikike. Sipas këtij kuptimi erotika ka të bëjë me nxitjen e dashurisë seksuale nga tiparet fizike të trupit, të pjesëve të trupit të njeriut, të përfytyrimeve dhe të krijimit të figurave fantastike nga ana e atij që përjeton shpejt dhe lehtë ngacmimin seksual.

EROTIZ/ËM, - MI. m. Ndjenja e shqetësimit të lehtë seksual te njeriu, e mbështetur në gatishmërinë e lindur të tij për shqetësim të shpejtë seksual dhe përjetim të kënaqësisë së shtuar për kënaqësi seksuale. Erotizmin me këtë kuptim e shkaktojnë edhe ato pjesë të trupit, të cilat nuk janë të lidhura me funksionin e organeve gjenitale, madje edhe disa cilësi individuale, si të folurit bukur, mendimi objektiv, ligjërimi etj., mund të marrin vlera të shqetësimit seksual.

EROTIZMI ANAL. Formë e veçantë e kënaqësisë dhe e përjetimit seksual. Erotizmi anal shkaktohet nga prirja e zhvilluar që nga stadi i zhvillimit psikoseksual anal. Kjo ka të bëjë me ngacmim të zonës anale në mënyrën e drejtpërdrejtë ose me veprime të posaçme të lidhura me defekim, si edhe me zotërim të sfinkterit të anusit.

EROTIZMI ORAL. Synim i arritjes së kënaqësisë me aktivitet oral, që rrjedh nga faza orale e zhvillimit psikoseksual. Te të rriturit ky synim shfaqet me pirje të shpeshtë të duhanit, me përtypje me ritëm të shpeshtë, me të folur të pakufizuar etj.

EROTOMANI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *eros* dhe *mani* "çmenduri". Proces i zhvillimit të epshit seksual përtej nivelit normal. Erotomania shfaqet me pushtim të fuqishëm dhe të plotë të një individi nga fuqi të pafundme të energjisë seksuale të drejtuar ndaj individit të gjinisë tjetër. Erotomania shfaqet te disa anëtarë të të dy gjinive. Ky çrregullim i epshit seksual ka forma të veçanta të manifestimit të tij. Shih – ***NINFOMANIA; SATIRIAZA.***

ERUDICION, - I. m. Term i huazuar nga latinishtja *erudition* që nënkupton një shtrirje të gjerë dhe në thellësi të njohurive të një individi të caktuar në një fushëveprimi teorike dhe praktike të caktuar ose në disa fusha të tilla.

ERRËSIMI I VETËDIJES. Topitje e funksionimit të vetëdijes, kryesisht te individët me sëmundje psikike të ndryshme. Errësira e vetëdijes manifestohet me rënie në nivele të ulëta të disa proceseve psikike, në radhë të parë të përqendrimit të vëmendjes, të kujtesës, të të menduarit me atë të të folurit. Shfaqet edhe në raste specifike të përjetimit të situatave befasuese, por ka karakter kalimtar.

ESEJA PSIKOLOGJKE. Gjini letrare që ka përmbajtje psikologjike, ku shprehen në mënyrë mbisunduese ndjenjat, mendimet dhe pikëpamja e

një shkrimtari për një çështje të caktuar psikologjike, të përshkruar dhe të shpjeguar me stil letrar. Eseja psikologjike është kryesisht ese me pretendime shteruese të fakteve e të dhënave për një ngjarje të përshkruar në mënyrë përmbledhëse.

ESTETIK, - E. mb. Që ka të bëjë me estetikën, që merret me studime të estetikës.

ESTETIKË, - A. f. Disiplinë shkencore e filozofisë që merret me studimin e së bukurës në natyrë dhe në art, me qenien, me thelbin, me kriteret e së bukurës dhe me kuptimin e së bukurës. Estetika në kuptimin e objektit gjurmues të saj prek edhe psikologjinë, sepse estetika trajton edhe kriteret e përjetimit të së bukurës, ndjenjat estetike të njeriut, si edhe zhvillimin e formimin e tyre. Ndërmjet psikologjisë së artit dhe estetikës, si edhe ndërmjet estetikës eksperimentale e empirike ekziston një lidhje e ngushtë.

ESTETIKA EKSPERIMENTALE. Degë e psikologjisë e cila merret me hulumtimin e fakteve empirike të së bukurës, me rregullsitë dhe me parimet e përjetimit të së bukurës. Themelues i estetikës eksperimentale është psikologu gjerman Teodor Fehner (Theodor Fechner, 1801 – 1887) dhe me studimin e saj është marrë Ernst Mojman (Ernst Meumann, 1826 – 1915) filozof dhe psikolog gjerman, Teodor Lips (Theodor Lipps, 1851 – 1914) estet dhe psikolog gjerman, etj. Estetika eksperimentale ka përparuar pak në rezultatet e saj, sepse metodat hulumtuese të ndjenjave estetike, të shijes estetike, të sjelljeve estetike kanë kufizimet e tyre.

ESTEZIOMET/ËR, - RI. m. Instrument për gjurmimin e ndjeshmërisë së lëkurës, përkatësisht për gjurmimin dhe matjen e pragut absolut dhe të pragut diferencial të ndjeshmërisë së lëkurës ndaj një trupi ngacmues. Pragu absolut i ndijimit të lëkurës provohet duke ngacmuar lëkurën e dorës me një qime të bishtit të kalit dhe duke e shtypur atë në lëkurë për të identifikuar receptorin e të prekurit, kurse pragu diferencial provohet me anë të afërsisë dhe të largësisë së dy fijeve të tilla që ushtrojnë ndikim në të njëjtën kohë në lëkurën e një pjese të organit të trupit dhe kur subjekti lakmon për ndijim të dy pjesëve, atëherë matet sa është largësia e dy receptorëve të ndijimit të prekjes. Dallohen dy lloje aparatesh të tilla:

a. **Esteziometri i Frejit** – Aparat që mat intensitetin e shtypjes së lëkurës nga një ngacmues i jashtëm dhe fuqinë shtypëse të tij, nga i cili shkaktohet ndijimi i shtypjes dhe ndijimi i të prekurit dhe me këtë rast identifikohet receptori i ndijimit të prekjes dhe të shtypjes;

b. **Esteziometri i Spirmanit** (Charles Spearman, 1863 – 1945). Aparat që mat pragun e dallimit të largësisë ndërmjet dy receptorëve të prekjes së lëkurës, që shkaktohet nga ngacmimi i njëkohshëm i dy ngacmuesve në receptorët e prekjes. Një prag i tillë ndryshon prej një pjese në pjesën tjetër të lëkurës; kështu, ndërsa tek gjuha largësia ndërmjet dy ngacmuesve të njëkohshëm është 1 mm, në lëkurën e shpinës është 6 mm, kurse në atë të shuplakës së dorës rreth 10 mm.

ESTROGJEN, - I. m. Gjashtë hormonet seksuale të femrave. Estrogjeni prodhohet nga vezoret, nga

cipa e gjëndrës mbiveshkore (në sasi të vogël). Estrogjenet kryesore janë: estroni, estradili, dhe estrioli. Estrogjeni kryen këto funksione: nxit zhvillimin e veçorive parësore seksuale, si zhvillimin e organit seksual të femrës, të vezores dhe të mitrës, si edhe zhvillimin e karakteristikave dytësore seksuale te femrat, si zhvillimi i gjoksit, zmadhon indet dhjamore të nënlëkurës, ndryshon intensitetin e zërit duke e rritur volumin e tij, zgjeron eshtrat e vitheve të femrave etj. Funksion i veçantë i estrogjenit është kontrolli i zhvillimit të strukturës dhe të funksionit të organeve seksuale duke përfshirë edhe menstruacionet.

ETIKË, - A. f. Disiplinë e filozofisë që merret me studimin e moralit, të asaj çfarë është e mirë dhe e keqe, pozitive dhe negative në sjelljet e njeriut. Përmbajtja e studimeve etike përkon me psikologjinë, sepse bëhet fjalë për sjellje dhe për motive të veprimtarisë së njeriut në procesin e realizimit të qëllimeve, dëshirave, kërkesave dhe të vlerave shoqërore të tij, në raport me të tjerët dhe me parimet e normat morale të mjedisit social të anëtarëve të këtij mjedisi.

ETIKA NË PSIKOLOGJI. Parimet dhe normat profesionale në psikologji, të përcaktuara në mbështetje të marrëveshjes së arritur me konsensus nga anëtarët e shoqatës së psikologëve të një vendi. Kodeks etik të tillë ka shoqata e psikanalitistëve, e cila ka zbatuar me korrektësi parimet e normat etike të psikanalistëve gjatë seancave dhe komunikimeve me klientët e tyre. Kodi etik i shoqatës së psikologëve të një vendi është detyrim i sjelljes profesionale të secilit pjesëtar të asaj shoqate. Në shoqatat e psikologëve me kodeks etik të përcaktuar përmenden së paku këto parime: ndalimi i keqpërdorimit të pozitës profesionale të tyre në raport me subjektet provuese, përjashtimi i çdo rreziku të subjekteve nga hulumtimet psikologjike, përjashtimi i diskriminimit në baza gjinore, fetare, kombëtare, shfrytëzimi i rezultateve të psikologëve nga njëri-tjetri kur ato janë të lejueshme, referimi i saktë i burimeve të literaturës etj. Bashkësia Europiane e Shoqatave Kombëtare të Psikologëve (EPPA) ka hartuar metakodeksin e psikologëve qysh më 1995. Sipas këtij metakodeksi çdo shoqatë e psikologëve, e përkatësisht çdo psikolog është i detyruar të respektojë së paku katër parime: respektimin e të drejtave dhe dinjitetin e individit, profesionalitetin në kryerjen e detyrave dhe në hulumtimet në fushën e psikologjisë, përgjegjësinë e lartë ndaj secilit individ me të cilin bie në kontakt psikologu dhe së fundi, respektimin e dijes, të formimit profesional dhe të punës profesionale të psikologut. Shqiptarët ende nuk kanë kodeks profesional të psikologëve.

ETIOLOGJI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *ετιολογία* "të mësuarit e shkaqeve". Shkenca që merret me hulumtimin e origjinës, të shkaqeve të dukurive, të objekteve dhe të proceseve. Përmbajtja e saj shtrihet në shumë fusha, megjithëse etiologjia ka lindur në disiplinat e mjekësisë, ku shpjegohen shkaqet e sëmundjeve organike. Ndër disiplinat e psikologjisë ku përdoret më tepër termi etiologji dallohet psikopatologjia, që zhvillon mendimin për shkakun ose shkaqet e çrregullimeve psikike, për sëmundjet psikike, për sjelljet deviante etj.

ETJ/E, - A. f. Motiv biologjik që shpreh gjendjen e brendshme subjektive të njeriut, që shkaktohet nga mungesa e lëngjeve, sidomos e ujit në inde, nga humbja e lëngjeve qelizore dhe nga ndryshimet hormonale në përbërjen e gjakut. Zakonisht manifestohet me tharje të buzëve, të fytit dhe të mukozës së laringut. Ka fuqi shtytëse për organizmin të drejtuar në marrjen e sasisë së duhur të ujit, dhe, me marrjen e kësaj sasie gjendja fiziologjike e organizmit ekuilibrohet dhe njeriu nuk ka më nevojë për të marrë ujë, kështu etja shuhet. Për shuaje të etjes në kulturën e mjediseve të ndryshme përdoret jo vetëm uji, por edhe lëngjet artificialë të prodhuar nga frutat, si edhe qumështi e disa nga produktet e lëngta të tij.

ETNI, - A. f. Bashkësi shoqërore e qëndrueshme e një grupi të madh njerëzish, e zhvilluar historikisht në një truall të gjerë, në bazë të kulturës dhe mënyrës së jetesës së përbashkët, ku gjuha, tradita, kultura materiale ose lëndore dhe kultura shpirtërore e asaj bashkësie në territorin e caktuar ka shkaktuar lidhje sociale e shpirtërore ndërmjet anëtarëve të asaj bashkësie. Një bashkësi e tillë është e përbërë nga pjesëtarët që kanë tipare të përbashkëta sjelljesh karakteristike, origjinë të hershme dhe, në këtë mënyrë, pjesëtarët e asaj etnie janë bërë të vetëdijshëm për origjinën e përbashkët historike, duke përfshirë gjuhën dhe vlerat e bartura prej një brezi në brezin tjetër. Etnia dhe vetëdija etnike i paraprin kombit dhe vetëdijes kombëtare.

ETNOCENTRIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga greqishtja *εθνος* "popull" dhe *κεντρυμ* "qendër". Etnocentrizmi është prirje e formuar dhe e qëndrueshme e atyre individëve, te të cilët vlerësohet shumë etnia dhe kombësia e tyre duke nënçmuar të tjerët, sidomos popujt fqinjë dhe pakicave. Sipas tyre standardet kulturore e shoqërore të fqinjëve ose të pakicave janë inferiore, kurse standardet kulturore e shoqërore të popullit të vet janë superiore. Thelbin e etnocentrizmit e përbëjnë qëndrimet e lidhura në një tërësi koherente kognitive, emocionale dhe konative. Etnocentrizmi ushtron ndikim të fuqishëm në proceset kognitive dhe emocionale, duke u bërë fuqi motivuese për sjelljet e njerëzve bartës të etnocentrizmit.

ETNOGJENEZË, - A. f. I ardhur nga greqishtja *εθνογένεσης*. Procesi i zhvillimit të një etnie deri në nivelin e ndërgjegjësimit të pjesëtarëve të saj se ata i përkasin asaj etnie. Etnogjeneza e shqiptarëve është origjina e tyre ilire dhe proceset zhvillimore të shqiptarëve nga bashkësia etnokulturore ilire deri në zhvillimin e tyre në bashkësi të veçantë të etnisë, të popullit dhe të kombit duke u veçuar nga të tjerët. Studimet e etnogjenezës janë ndër më të ndërlikuarat, sidomos kur ndërhyjnë çështjet politike në shpjegimin e gjenezës historike, sociologjike, psikologjike etj. të një etnie, populli e kombi dhe raportet e tij me proceset zhvillimore të popujve fqinjë.

ETNOLOGJI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *εθνος* "popull" dhe *λόγος* "shkencë". Shkenca për etninë që studion kulturën lëndore dhe shpirtërore të etnive, përkatësisht të popujve dhe të kulturave të tyre, si edhe origjinën e veshjeve, të objekteve arkitektonike, të besimeve, të vlerave shoqërore, duke bërë edhe krahasimin e tyre në mjediset e popujve të ndryshëm. Etnologjia

lidhet me psikologjinë, sepse si lëndë e psikologjisë është studimi i vlerave e i formave të sjelljeve të njerëzve në mjedise të ndryshme etnike. Shih – ***ETNOPSIKOLOGJIA.***

ETNOPSIKANALIZË, - A. f. Studimi psikanalitik i çrregullimeve psikike të karakterit pak a shumë të përgjithshëm të një etnie, të një kombi. Studimet etnopsikanalitike kryhen me qëllime krahasuese, për marrjen e masave shëruese dhe për përgjithësimin e pikëpamjeve për origjinën dhe zhvillimin e tyre te njerëzit. Termi psikanalizë është përdorur nga psikanalisti hungarez Geza Rohajm (Geza Roheim, 1891 – 1953) dhe nga antropologu dhe psikanalisti amerikan e francez Zhorzh Devere (Georges Devereus, 1908 – 1985).

ETNOPSIKOLOGJI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *εθνος* "popull", *ψυχο* "shpirt" dhe *λόγος* "shkencë". Disiplinë e sistemit të shkencave të psikologjisë, e cila merret me studimin e "shpirtit të popullit". Lëndë e studimit të saj ishte mendësia, veçoritë e përgjithshme psikike të një etnie, tiparet e personalitetit dhe të karakterit të një populli, përmasat psikologjike të dokeve e të zakoneve të një bashkësie etnike dhe krahasimi i tyre me "shpirtin" e pjesëtarëve të etnive të tjera, si edhe me kulturën lëndore e shpirtërore të etnive të ndryshme. Pavarësisht nga e vërteta se në etnologji, që është disiplinë më e vjetër se etnopsikologjia, hasim në shumë përmbajtje psikologjike, etnopsikologjia u nda nga etnologjia me studimet e themeluesit të psikologjisë empirike Vilhem Vunt (Wilhelm Wundt, 1832 – 1920), autor i veprës etnopsikologjike "Psikologjia e popujve", në dymbëdhjetë vëllime. Etnopsikologjia ka buruar nga e ashtuquajtura psikologji shpirtërore e gjysmës së parë dhe fillimit të gjysmës së dytë të shekullit të njëzet, me krijimin e sistemit fashist, i cili e shfrytëzoi përmbajtjen e saj për qëllime të këqija, diskriminime "racore", duke e trajtuar racën gjermane superiore dhe duke bërë ndarjen e popujve në raca të larta dhe në raca të ulta. Për këto shkaqe, si edhe për shkak të kufizimit të metodave dhe procedurave hulumtuese objektive të strukturave e proceseve psikike, të sjelljeve dhe dimensioneve të përgjithshme dhe karakteristike për pjestarët e një etnie, lënda e etnopsikologjisë tashmë trajtohet në kuadrin e psikologjisë sociale.

ETOLOGJI, - A. f. Shkenca që studion veprimet shtazarake me synim shpjegimin e origjinës dhe të zhvillimit të veprimeve të ndërlikuara te kafshët e llojeve më të larta, madje edhe te njerëzit. Rezultatet fillestare të etologjisë ushtruan ndikim në zhvillimin e mirëfilltë të kësaj disipline shkencore, që merret me studimet krahasuese të sjelljeve të njerëzve, me tiparet e personalitetit dhe të karakterit të përgjithshëm të pjesëtarëve të një bashkësie shoqërore, të një etnie dhe të një kombi, mbi bazën e të drejtës zakonore të një populli të caktuar. Etologjia sot merret me hulumtimin e morfologjisë së veprimeve të kafshëve në mjedisin natyror të tyre dhe me ndikimin e faktorëve gjenetikë dhe të faktorëve të mjedisit në veprimtarinë e gjithanshme të tyre; kjo synon studimin e gjenezës së tërësishme të veprimeve të kafshëve, duke zbatuar në radhë të parë metodën e vëzhgimit

sistematik joeksperimental. Themelues të etologjisë janë Konrad Lorenc (Konrad Lorenz, 1903 – 1986), Nikolas Tinberger (Nikolaas Tinbergen, 1907) dhe Karl fon Frish (Karl von Friesh, 1886 – 1982). Sipas tyre sjelljet dhe veprimet duhen studiuar që nga rrënjët filogjenetike të zhvillimit të tyre, duke u nisur nga instinktet dhe shndërrimet e tyre në forma të ndryshme të sjelljeve dhe të veprimeve.

ETOS, - I. m. I ardhur nga greqishtja *έθος* "doke, zakon, karakter" që i përket kryesisht terminologjisë së etikës, por me kuptimin e saj shtrihet edhe në psikologji. Etosi është tërësia e tipareve morale të një bashkësie, grupi apo një individi, e përbrendësuar nga edukata e asaj bashkësie, grupi apo individi dhe që manifestohet në sjelljet e tij. Etosi përbën tiparet e karakterit të anëtarit të një bashkësie apo grupi social dhe ka të bëjë me sjelljet e tij ndaj asaj bashkësie apo atij grupi.

EUFORI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *ευφορία* "dalldi e këndshme". Gjendje e posaçme psikike që karakterizohet nga entuziazmi i nivelit të lartë, gëzimi i madh, ndjenja e mirëqenies, e optimizmit të madh etj., që shoqërohet me aktivitet të posaçëm. Kjo është gjendje e ekzagjeruar emocionale që e kalon masën normale të përjetimeve dhe të sjelljeve të njeriut. Euforia shkaktohet nga një situatë e posaçme shoqërore, ku individi arrin sukses të papritur dhe e përjeton këtë situatë në mënyrë të jashtëzakonshme, prandaj flitet për euforinë shoqërore. Ka zgjatje kohore të kufizuar. Euforinë mund ta shkaktojnë edhe disa substanca biokimike me pasoja të posaçme fiziologjike dhe psikologjike. Të tilla janë marrja e pijeve alkoolike në masë të tepruar, marrja e drogave etj.

EUGJENETIKË, - A. f. I ardhur nga greqishtja *εύ* "mirë" dhe *γενος* "lindje, pasardhje" që hulumton format e aktiviteteve dhe përsosjen e tyre, në bazë të shfrytëzimit të rezultateve të gjenetikës në zhvillimin e gjinisë njerëzore. Eugjenetika ose eugjenika është e lidhur me studiuesin e psikologjisë Fransiz Galton (Francis Galton, 1822 – 1911). Sipas tij eugjenetika duhet të merret me studimin e përmirësimit të tipareve fizike dhe shpirtërore të njerëzve, duke ushtruar ndikim të veçantë në embrionin zhvillimor të tyre.

EUPSIKË, - A. f. Në psikologjinë humaniste të Abraham Maslout, i ardhur nga greqishtja *εύ* "mirë" dhe *ψυχος* "shpirt". Organizimi i bashkësisë ideale të shoqërisë, e cila do t`i japë mundësi maksimale secilit individ të shëndoshë për t`i zhvilluar tiparet e veta deri në nivelin e vetafirmimit të tij. Ky koncept dhe emërtimi i tij kanë konotacion të optimizmit humanist dhe tashmë ka më tepër kuptim utopik.

EUSTRES, - I. m. I ardhur nga greqishtja *εύστρες*. Reagim stresor por ky reagim është i favorshëm për njeriun që e përjeton. Eustresi manifestohet në sjelljet e njeriut për t`i mbajtur arritjet, sukseset, përparësitë ndaj të tjerëve dhe sjelljet me të cilat ai ka arritur sukseset e përparësitë e tij. Termi *eustres* është neologjizëm i krijuar nga endokrinologu Hans Seli (Hans Sely, - - -).

EUTANAZI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *εύ* "mirë" dhe *τανατος* "vdekje". Vdekja e lehtë dhe e shpejtë e njeriut, e shkaktuar nga mjete të posaçme. Eutanazia shfaqet kryesisht te ata të

sëmurë që nuk mund t`i gjejnë vetes ilaç, ndërkohë që dhembjet e trupit të tyre janë të mëdha dhe shpesh edhe të padurueshme. Eutanazia zakonisht emërton marrjen e substancave vdekjeprurëse me qëllim çlirimin e njeriut nga vuajtjet e padurueshme dhe çuarjen e tij drejt vdekjes. Kjo formë e eutanazisë quhet eutanazi aktive. Eutanazia kryhet me kërkesën këmbëngulëse të pacientit dhe me pëlqimin e familjes së tij. Përndryshe, eutanazia ndalohet ligjërisht.

EUTIMI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *ευθυμία.* Gjendja psikike të cilën e karakterizon prirja e individit kah gjendja e të qenurit mirë, optimiste, e qetë dhe pa brenga. Një prirje e tillë te disa individë ka karakter relativisht të qëndrueshëm, madje edhe të përhershëm. Rastet e tilla janë të rralla, kurse më të shpeshta janë ato raste të prirjeve të tilla që kanë karakter relativisht të qëndrueshëm brenda një kohe të caktuar.

EVALUACION, - I. m. Term i ardhur në shqip nga anglishtja evaluation "vlerësim" që ka të bëjë me vlerësimin e saktë të realizimit të qëllimit të një programi, projekti etj. Shih - ***VLERËSIMI.***

EVOLUCION, - I. m. Në biologji, i ardhur nga latinishtja *evolution* "zhvillim". Në psikologji emërton konceptin e ndryshimeve zhvillimore të formave të larta dhe të ndërlikuara të strukturave, të proceseve e të funksioneve psikike nga ato të thjeshtat. Qasja studimore e një zhvillimi të tillë në psikologji realizohet kryesisht në bazë të koncepteve themelore të teorisë së Çarls Darvinit (Charles Darwin, 1809 – 1882), siç janë konceptet: adaptim, instinkt, përzgjedhje, e trashëgim. Por në psikologji termat e koncepteve të teorisë së Darvinit kanë edhe kuptim shtesë dhe nuk mund të zbatohen me të njëjtin kuptim si në biologji. Metodat dhe instrumentet matës të studimeve evolutive të strukturave e të proceseve psikike, si edhe të sjelljeve në psikologji janë kryesisht ato që kanë të bëjnë me studimet ontogjenetike.

Ë

ËMBËLSI, - A. f. Njëra ndër cilësitë e posaçme të ndijimit të shijës që shkaktohet nga trupat me përbërje të veçantë kimike të gjendjes së ngurtë dhe të lëngët, kur vijnë në kontakt të drejtpërdrejtë me pupritë e gjuhës. Ndijimin e shijës së ëmbëlsirës e shkaktojnë trupat e ndryshëm me përbërje kimike të veçantë, si hurma, mjalti, sheqeri etj. Kur këta shkrihen në gojë nën ndikimin e përtypjes së ushqimit lëshojnë gjëndra jargore gjatë përtypjes së tyre. Ky proces ka karakter kimik dhe si i tillë ngacmon njëkohësisht pupritë e pjesës së përparme të gjuhës, që kanë dendësi më të madhe dhe me të cilat janë të lidhura mbaresat e nervit të shijës. Në fundin e këtyre puprrive nuk janë identifikuar receptorë të posaçëm të shijës.

ËND/ËRR, - RRA. f. Formë e veçantë e aktivitetit mendor, që zhvillohet në trurin e njeriut gjatë kohës së gjumit. Ëndrra është lidhje e lirë simbolesh ndër më të ndryshmet, përfytyrimesh, që përfaqësojnë disa nga përmbajtjet e pavetëdijes së njeriut brënda një kohe të shkurtër, një sekuence, të gjumit të tij. Lidhja e simboleve të ëndrrës, e përfytyrimeve në ëndërr është e ndërlikuar, sepse në ëndërr simbolet e përfytyrimet lidhen pa radhë konkrete, larg raportit shkak – rrjedhim konkret, përfytyrimet e paraqitura në ëndërr janë të gjalla dhe përçohen me ndjenja të veçanta. Ëndrrat i përkasin atij aktiviteti psikik që ka karakter të pavetëdijshëm, ato nuk kanë të bëjnë me ligje logjike, përkatësisht janë irracionale. Megjithëkëtë Frojdi ka argumentuar se ëndrrat kanë kuptimin e tyre, i cili për ëndërruesin shpesh mbetet i panjohur. Ëndrra është e lidhur me lëvizje të shpejtë të syve dhe i përket fazës REM të gjumit. Ëndrrat janë pjesë përbërëse e jetës së njeriut në fazat e zhvillimit të tij. Me studimin e ëndrrave janë marrë shumë studiues, ku dallohen sidomos përfaqësuesit e psikanalizës. Në shqipe ëndrra ka edhe një konotacion të posaçëm: dëshirë e flaktë që synojmë ta plotësojmë.

ËNDJ/E, - A. f. Ndjenja e kënaqësisë së një individi ndaj një objekti që i plotëson atij një dëshirë, një nevojë dhe një vlerë. Me rastin e përjetimit

të ëndjes në këtë kuptim individi nuk e përjeton objektin e ëndjes si objekt të tij, por megjithatë synon ta arrijë dhe ta përvetësojë. Ëndja ka kuptim të përafërt me dëshirën, por ndryshon nga dëshira ngaqë objekti i ëndjes nuk ka arritur ta ketë përfaqësimin mendor të plotë dhe të qëndrueshëm në individin e caktuar. Kështu duhet kuptuar kuptimi i ëndjes në përmbajtjen e fjalisë "Ndiej ëndje kur e shijoj mollën e kuqe ", ". .. kur i shoh rrobat e hekurosura", "... kur rrezaton pastërtia e fustaneve të saj" etj. Shih - ***KËNAQËSIA***.

ËNDRRA MANIFESTUESE. Përmbajtje e asaj ëndrre që ëndërruesi ka arritur ta mbajë mend dhe ta riprodhojë. Ëndrra manifestuese nuk është thelbi i ëndrrës, por psikanaliza këtë e shfrytëzon për të nxjerrë nga pacienti përmbajtjen e fshehur të ëndrrës, që përbën dhe thelbin e ëndrrës. Sipas Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939) përmbajtja e vërtetë e ëndrrës, përkatësisht thelbi i ëndrrës, shkakton shfaqjen e përzier të figurave pamore të pjesës së ëndrrës manifestuese. Thelbi i ëndrrës ka karakter të përmbajtjeve mendore të pavetëdijshme, që e mundojnë, e pushtojnë njeriun, por që ky nuk është në gjendje t'i shfaqë. Këtu ndërhyn psikanaliza, me qëllim nxjerrjen e kësaj përmbajtjeje nga pacienti i tij, duke e bërë këtë të vetëdijshëm dhe duke e çliruar nga ngarkesat e mëdha psikike.

ËNDRRA NË PSIKANALIZË. Ëndrrat kanë zënë një vend të rëndësishëm. Sipas Z. Frojdit ëndrra është plotësim dëshirash të pavetëdijshme që lidhen zakonisht me seksualitetin e njeriut, si edhe me dëshirat e tjera, të cilat nga pikëpamja morale janë të paarritshme. Këto dëshira janë shtypur nga energjia e vetëdijes së njeriut, janë fshehur në përmbajtjen e pavetëdijshme të tij dhe në ëndërr derdhen në simbolizmin e saj të kondensuar dhe me simbole të zhvendosura në rrafshin kohor e hapësinor. "Ëndrra është urë mbretërore e depërtimit të dijes deri në aktivitetin e mendjes së pavetëdijshme". Ëndrrat kryejnë funksionin e mbrojtjes së gjumit nga ndërprerja e tij. Përmbajtja e ëndrrave krijohet kryesisht nga figurat pamore dhe ndaj tyre "egoja" e njeriut gjatë kohës së gjumit zakonisht është vëzhguese, sepse burojnë nga "idi" i njeriut. Për Karl G. Jungun (Carl G. Jung, 1875 – 1961) ëndrrat janë fakte të jetës psikike dhe jo trillime. Por, ëndrrat sipas K. G. Jungut lindin dhe zhvillohen nga pavetëdija kolektive e njeriut dhe jo nga "idi" i tij si mendon Frojdi. Përmbajtja e tyre u përngjan miteve dhe disa simboleve që hedhin dritë në situata njerëzore të ndryshme.

ËNDRRAT DITORE. Njeriu normal shpesh ëndërron edhe gjatë ditës. Ëndrrat e ditës janë tërësi përfytyrimesh e idesh të zhvilluara sipas dëshirave të ndryshme të njeriut dhe, si të tilla, kanë karakter individual dhe "censura" e paravetëdijës gjatë kohës që njeriu është i zgjuar, kur ky ëndërron, nuk e lejon njeriun t`i shfaqë lirisht ato. Ëndrrat ditore janë produkt i fantazisë së njeriut, që nxiten nga dëshirat duke bërë lidhje të çuditshme simbolesh që ai synon të arrijë në plotësimin e këtyre ëndrrave, që në realitet janë të paarritshme. Megjithëse dallojnë nga ëndrrat e gjumit në disa pikëpamje, ëndrrat ditore nuk shkëputen krejtësisht nga ëndrrat e gjumit.

ËNDRRAT KOMPENSUESE. Term i psikologjisë së Karl G. Jungut, i cili me këtë term shpjegon karakterin dhe funksionin e ëndrrave. Sipas Karl G. Jungut ëndrrat kryejnë funksionin vetërregullues të psikikës së njeriut, duke kompensuar sjelljet orientuese të njëanshme të veprimtarisë së vetëdijshme të tij. Sipas tij "të gjitha ndjenjat, mendimet, disponimet, dëshirat etj. që në jetën e vetëdijshme nuk marrin përfaqësim dhe rëndësi të kënaqshme, mund të shfaqen në ëndërr dhe me këtë na kujtojnë mundësi të reja, mundësi të tërësishme jetësore". Në këtë mënyrë ëndrrat kryejnë funksion kompensues dhe ndihmojnë zhvillimin e tërësishëm të personalitetit.

Burimet:

Zigmund Frojd *"Interpretimi ëndrrave – Jeta seksuale e njeriut"*, Tiranë, 1997.

Erich Fromm *"Nëntë skica psikologjike"*, Tiranë, 2005.

Zigmund Frojd *"Interpretimi i ëndrrave"*, Tiranë, 2010.

F

f = frekuenca. Shkalla e dendësisë së arritjeve në një test nga ana e subjekteve, që i janë nënshtruar atij testi.

FAJ, - I. m. Lloj i ndjenjave morale. Faji shfaqet te subjekti atëherë kur ai vlerëson se me një sjellje të tij i ka shkaktuar pa të drejtë dëm, duke ngjallur te ai njëkohësisht ndjenjën e pakënaqësisë. Njohuria e individit për dëmin dhe pakënaqësia e shkaktuar ndaj individit tjetër nga një sjellje a një veprim i caktuar ndaj tij përbën strukturën qendrore të fajit. Një faj i tillë lind vetëm te njeriu, i cili ka arritur t`i përvetësojë rregullat, parimet dhe normat morale të mjedisit shoqëror dhe të krijojë në veten e tij struktura psikike për rregullat, parimet dhe normat morale. Në raport me to vlerëson se sjellja a veprimi i tij është në kundërshtim me kërkesat e atij sistemi etik dhe si pasojë e kësaj sjelljeje a veprimi i ka shkaktuar tjetrit pakënaqësi e vuajtje. Në varësi nga pasojat ndjenja e fajit ka intensitet të ndryshëm, të cilin corpus-i i shqipes nuk është në gjendje ta shprehë me saktësi.

FAJI NË PSIKANALIZË. Në shpjegimet psikanalitike faji konsiderohet ndjenjë morale me rëndësi të posaçme, sepse shkaktohet nga vlerësimi i subjektit që me sjelljen a veprimin e tij ka bërë gabim ndaj tjetrit, në rend të parë ndaj të afërmit, shokut e mikut të ngushtë. Një faj i tillë lind nga frika prej super egos. Përderisa egoja e konsideron fajin pasojë e sjelljeve me të cilat është shkelur rregulli, parimi e norma morale e përqendruar në super ego, njeriu jeton në frikë nga kritika e dënimi. Kjo është frika nga tensioni aktiv ndërmjet egos dhe super egos. Kjo gjendje emocionale lind te ata individë, të cilët kanë arritur t`i internalizojnë rregullat, parimet e normat morale të mjedisit të tyre shoqëror. Ky internalizim është përqendruar dhe zhvilluar në super egon e individit të caktuar.

FAKT, - I. m. I ardhur nga latinishtja *factum*. Ky term është ngulitur edhe në gjuhën shqipe. Në kuptimin e përgjithshëm të tij ka të bëjë me ekzistencën e verifikuar të një objekti, dukurie, raporti, pikëpamjeje, veprimi etj. Dallojmë fakte të ndryshme. Të tilla mund të jenë: faktet konkrete, abstrakte,

materiale, biologjike, sociologjike, psikologjike etj. Lënda e psikologjisë, si edhe ajo e disiplinave të tjera empirike, mbështetet në fakte ekzistuese dhe të verifikuara. Hulumtuesi i dukurive, proceseve, sjelljeve e strukturave psikike i mbledh, i klasifikon dhe i përpunon faktet e tilla sipas kërkesave objektive të metodave hulumtuese.

FAKTET PSIKOLOGJIKE. Procesi psikik, sjellja, tipari, struktura psikike etj., që ka cilësinë, përmasat, zhvillimin etj., të cilat njeriu i përjeton, por që për disa nuk është i vetëdijshëm, por i shfaq në mënyrë të veçantë ndaj vetes së tij, të tjerëve dhe ndaj mjedisit të gjerë shoqëror. Faktet e tilla mund të përcaktohen me anë të vëzhgimit të thjeshtë, vëzhgimit sistematik, vëzhgimit eksperimental, si edhe me anë të vetvëzhgimit dhe formave të tij. Si të tilla faktet psikologjike përcaktohen kryesisht me gjykime perceptuese. Faktet psikologjike dallohen nga shpjegimet, nga vlerësimet dhe nga gjykimet vlerësuese.

FAKTOR, - I. m. Në kuptimin e përgjithshëm lidhet me shkaktarin e një dukurie, të një procesi, të ndryshimit të një gjendjeje, procesi, raporti etj. Me këtë kuptim termi faktor emërton konceptin e shkakut të një dukurie, sjelljeje etj., përkatësisht faktori mund të jetë kusht i një pasoje, i lindjes së një procesi, i ndryshimit të një gjendjeje psikike të përhershme ose të përkohshme, të tërësishme ose të pjesshme. Në psikologji përgjithësisht, sidomos në psikometri, faktori është një nga produktet e analizës faktoriale, si p.sh., faktori G(eneral) i inteligjencës. Në kuadrin e analizës faktoriale, shih – ***ANALIZA FAKTORIALE***, faktori sipas studiuesit Rajmond B. Katel (Reymond B. Cattell, 1905 – 1998) "ndikim themelor përgjegjës për një pjesë të ndryshueshmërisë së një numri të manifestimeve bihejviorale"**.** Me anë të faktorëve në psikologji përshkruhet struktura dhe integriteti i personalitetit, si dhe motivacioni, emocionaliteti etj. Në psikologji termat faktor dhe faktorial u përdorën në fillim për të emërtuar përbërësit e inteligjencës, kurse sot kanë përhapje kuptimore më të gjerë. Kuptimi i përbashkët i përdorimit të këtij termi në psikologji është ai, sipas së cilit në bazë të një aktiviteti qëndron një fuqi, e cila prodhon energji që vë në lëvizje një klasë të caktuar dukurish psikike. Veprimet inteligjente janë faktorizuar deri në gjysmën e parë të shekullit njëzet në tri grupe faktorësh: në faktorin e përgjithshëm, në faktorët gruporë dhe në faktorin specifik të inteligjencës. Shih – ***INTELIGJENCA.***

FAKTORËT E TË MËSUARIT. Tërësi kushtesh e lidhjesh ndërmjet tyre që nxisin, drejtojnë dhe angazhojnë njeriun në procesin e të mësuarit. Kushtet që i nevojiten të mësuarit janë kushtet fizike: sasia e duhur e oksigjenit, drita e mjaftueshme, lagështia normale e ajrit etj.; kushtet fiziologjike: funksioni i rregullt i sistemit nervor, ai i shqisave, metabolik, i sistemit psikomotorik etj. Ndër kushtet psikologjike që ndikojnë te të mësuarit përmendim:

a. Motivacioni i të mësuarit – Faktorët e brendshëm, fuqia e brendshme e strukturave psikologjike të njeriut (ambicia, dëshira, interesi, nevoja, synimi, vetëafirmimi etj.), që e shtyn atë

të mësojë, që ia drejton dhe ia organizon veprimtarinë e tij për të mësuar një lëndë të caktuar;

b. **Nxitësit e të mësuarit** – Faktorë të jashtëm (dhurata, informimi për rezultatin e të mësuarit, shpërblimi, vlerësimi etj.) që e nxisin dhe e përforcojnë procesin e të mësuarit dhe zotërimin e përmbajtjes së lëndës që mësohet;

c. **Riprodhimi i lëndës gjatë të mësuarit** – Aktivitet që shpie në zotërimin e lëndës që mësohet, e pikërisht, një përmbajtje e caktuar nuk mund të mësohet dhe aq më pak të zotërohet pa qëndrim aktiv dhe pa riprodhim kuptimplotë të saj;

d. **Të mësuarit me kuptim** – Sistemi i njohjes dhe i përvetësimit të informacioneve duke u përqendruar në përvetësimin e raporteve thelbësore ndërmjet tyre;

e. **Shprehia e të mësuarit** – Bashkërenditja e veprimeve sistematike të lidhura me një kohë të caktuar, me vendin dhe me mënyrat produktive të të mësuarit etj.

FAKTORËT E ZHVILLIMIT. Ndryshimet psikofizike sasiore dhe cilësore janë rezultat i ndikimit të këtyre faktorëve kryesorë: i pjekurisë organike dhe i ligjeve gjenetike dhe i ndikimit të shumë faktorëve të jashtëm, nga të cilët dallohet roli i faktorit të të mësuarit. Rezultatet e gjurmimit të përmasave të ndikimit të këtyre faktorëve ende nuk kanë dhënë efekte të prera. Megjithëkëtë, dihet se zhvillimi trupor i strukturave, i organeve dhe i funksioneve të tyre në trupin e njeriut, duke përfshirë edhe zhvillimin neuropsikik, është rezultat i ligjeve të trashëgimisë. Ndërkaq, zhvillimi i të folurit, i informimit, i qëndrimeve, i bindjeve dhe i tipareve të karakterit është rezultat i socializimit të njeriut nën ndikimin e faktorëve të jashtëm, në rend të parë i faktorit të të mësuarit. Madje, ka struktura psikike që janë rezultat i ndikimit të dy faktorëve të përmendur. Inteligjenca dhe shkalla e zhvillimit të saj te njeriu varet nga ndikimi i faktorëve të trashëgimisë dhe nga ndikimi i faktorëve të jashtëm, përkatësisht nga ndikimi i faktorit të të mësuarit.

FAKTORËT GRUPORË. Faktorë me funksion ndikues në një grup të ngjashëm sjelljesh a procesesh. Të tillë janë faktorët aritmetikë, fjalësorë etj. të inteligjencës. Faktorët gruporë përftohen nga interkorrelimi i lartë i rezultateve të gruptesteve të zbatuara te të njëjtët subjekte ose te grupsubjektet e tjerë të të njëjtës kulturë, gjuhë, mjedisi social, si edhe të të njëjtës moshë e gjini.

FAKTORI BIPOLAR. Faktor i identifikuar me zbatimin e analizës faktoriale që ka kuptimin e pranisë së një tipari, qëndrimi, vlere etj. që shtrihet ndërmjet dy poleve duke kaluar nëpërmjet pikës asnjanëse, përkatësisht përmes pikës indiferente ndaj njërit skaj a pol në skajin a polin tjetër. I tillë është faktori që shtrihet në njërin skaj – faktori mbisundues ose dominues dhe i njëjti që shtrihet në skajin antipod, përkatësisht në polin e kundërt – faktori i nënshtrimit apo submisivitetit.

FAKTORI GESHTALT. Faktor nxitës i perceptimit të tërësisë së një objekti, të një figure. Faktor i tillë ose geshtalt mund të jetë faktori i afërsisë, i ngjashmërisë, i papërfundimit dhe

faktori i pandërprershmërisë. Shih – ***PSIKOLOGJIA GESHTALTISTE.***

FAKTORI HAPËSINOR. Njëri nga faktorët e aftësive parësore i identifikuar me anë të procedurës së analizës faktoriale, që ka të bëjë me aftësinë e njeriut për t`u orientuar drejt dhe mirë në hapësirë, për t`i dalluar lehtë dhe shpejt objektet në hapësirë e cilësitë e tyre, raportet hapësinore ndërmjet tyre dhe për t`i përfytyruar marrëdhëniet hapësinore në formë përfytyrimesh. Shënohet me shkronjën S. Shih – ***AFTËSITË PARËSORE.***

FAKTORI I MEMORJES. Një ndër shtatë faktorët ose aftësitë parësore të njeriut, që i përket teorisë së shpjegimit të inteligjencës të psikologut dhe psikometristit amerikam Luis L. Terston (Louis L. Thurstone, 1887 – 1955). Për identifikimin e faktorëve parësorë Terstoni zbatoi metodën e analizës faktoriale. Faktori i memories ose i kujtesës është bartës i aftësisë së proceseve të kujtesës, kryesisht i kujtesës asociative dhe mekanike, pjesërisht edhe i kujtesës semantike.

FAKTORI I PËRGJITHSHËM. Faktor i përbashkët i identifikuar në bazë të analizës faktoriale mbi themelin e të cilit zhvillohen me sukses veprimet a sjelljet e njeriut në një klasë të gjerë aktivitetesh të tija. Faktori i përgjithshëm i përket aftësive intelektuale dhe operacioneve që zhvillohen në kuadrin e këtyre aftësive. Ky faktor emërtohet edhe me shkurtesën faktori G ose G(eneral).

FAKTORI I PËRGJITHSHËM I INTELIGJENCËS. Faktori bazë e të gjitha veprimeve të inteligjencës. Nga ky faktor buron energjia e përgjithshme mentale e njeriut, e cila ia bën të mundur njeriut vendndodhjen në situata të ndryshme problemore. Faktori i përgjithshëm i inteligjencës është i njohur me shenjën G faktor ose faktori gjeneral.

FAKTORI I RASTËSISHËM. Në metodat hulumtuese të psikologjisë, në psikometri është ai faktor që zgjidhet pa kriter objektiv ndërmjet shumë vlerave të nivelit të lartë që kanë të bëjnë me ndryshoren e pavarur të zgjedhur rastësisht, për të provuar ndikimin e saj dhe të shkallës së këtij ndikimi në një proces psikik. Faktori i rastësishëm operacionalizohet në procesin e përpunimit statistikor të të dhënave të grumbulluara. Rezultatet e përftuara nga të provuarit e ndikimit të ndryshores së pavarur me faktor të rastësishëm i përkasin efektit të rastësishëm.

FAKTORI I RENDIT TË DYTË. Faktor që përftohet nga analiza faktoriale e faktorëve të rendit të parë dhe nga ndërlidhja e rezultateve të faktorëve të rendit të parë. Faktorët e rendit të dytë kanë shtrirje më të gjerë se faktorët e rendit të parë. Kështu, në teorinë e strukturës së inteligjencës sipas Luis L. Terstonit (Louis L. Thurstone, 1887 – 1955) faktor i rendit të dytë është faktori G, i cili kryen funksionin shtrirës së tij në zgjidhjen e situatave të përgjithshme problemore të natyrës fizike, sociale, matematikore etj.

FAKTORI I RENDIT TË PARË. Faktor i përgjithshëm me ndikim funksional të një ndryshoreje të caktuar që përftohet nga zbatimi i testeve të ndryshme që masin ndryshimet e një ndryshoreje të të njëjtit subjekt,

në bazë të korrelimit të rezultateve të përftuara nga zbatimi i atyre testeve dhe i shkallës së lartë interkorreluese të rezultateve të tyre. Faktori i rendit të parë ndryshon nga faktorët e rendit të dytë, ngaqë i pari përftohet drejtpërdrejt nga analiza e rezultateve origjinale të testeve matricë dhe nga korrelimi i rezultateve të tyre.

FAKTORI I REZONIMIT. Aftësi e veçantë, një ndër faktorët parësorë që ka të bëjë me nxjerrjen e përfundimeve të formuluara në formë përgjithësimesh (parimi, rregullsia, ligji). Shih – ***AFTËSITË PARËSORE.***

FAKTORI MNEMOTIK. Faktor i kujtesës që është përbërës i aftësive të inteligjencës, dhe që në literaturën e psikologjisë shënohet me simbolin M. Faktori i kujtesës është identifikuar në bazë të analizës faktoriale të inteligjencës. Ky faktor shfaqet me aftësinë e mbajtjes mend në mënyrë të drejtpërdrejtë të lëndës së pakuptimtë dhe i përket kujtesës mekanike. Faktori mnemotik hyn në grupin e aftësive parësore.

FAKTORI SPECIAL. Faktor i veçantë i inteligjencës, i cili i mundëson njeriut suksesin në një fushë të veçantë të veprimtarisë. Faktori i përgjithshëm ose faktori gjeneral është i lindur dhe është i pranishëm në masë të ndryshueshme te të gjithë njerëzit. Statistikani dhe psikologu anglez Çarls E. Spirman (Charles E. Spearman, 1863 – 1945) ka arritur në zbërthimin e strukturës së inteligjencës dhe në identifikimin e këtyre faktorëve, duke zbatuar analizën faktoriale, koeficientët e korrelacionit rang dhe procedura të tjera psikometrike.

FAKTORI SPECIFIK. Emërtim i përbashkët për secilin faktor që ka shtrirje të ngushtë, që ka të bëjë vetëm me një aftësi. Ky term në kuptimin psikometrik emërton konceptin e shpjegimit të ndryshores së përftuar nga matjet e një aftësie me anë të një testi. I këtillë është faktori S(pecifik) në teorinë e Çarls E. Spirmanit.

FAKTORI VERBAL. I ardhur nga latinishtja *verbalis* "që ka të bëjë me fjalë, që shprehet me anë të fjalëve". Faktori verbal ose faktori V është një nga faktorët parësorë të aftësive mendor. Faktori V(erbal) ka të bëjë me të kuptuarit e lehtë dhe të shpejtë të simboleve të të folurit, me njohjen e kuptimit të një numri sa më të madh fjalësh. Të kuptuarit e tillë mund të matet me gjetjen e lehtë dhe të shpejtë të antonimit, homonimit, sinonimit për fjalën e dhënë, si ditë – natë (antonimi), Verë - verë (homonimi), rrugë – udhë (sinonimi). U konstatua nga rezultatet e analizës faktoriale të testeve të aftësive nga ana e psikologut amerikan Luis L. Terston (Louis L. Thurstone, 1887 – 1955). Shih – ***AFTËSITË PARËSORE.***

FAKTORIAL, - E. mb. Që ka të bëjë me faktorë, apo që i përket faktorëve të caktuar.

FAKULTETET PSIKIKE. Emërtim i konceptit klasik të fuqive, të kapaciteteve psikologjike nga të cilët përbëhet dhe zhvillohet jeta psikike e njeriut. Fakultete, fuqi, kapacitete psikike janë: instinktet, vullneti, arsyeja e njeriut. Nga zhvillimi i këtyre fakulteteve a kapaciteteve psikike zhvillohen lidhjet e shumëllojshme të formave të ndryshme të jetës psikike. Pikëpamja për fakultetet a kapacitetet psikike lindi dhe

u zhvillua qysh nga shekulli i shtatëmbëdhjetë, kur psikologjia ishte në kuadrin e disiplinave filozofike. Nismëtar i kësaj pikëpamjeje ka qenë filozofi dhe matematikani gjerman Kristian Volf (Christian Wolf, 1679 – 1754). Kjo pikëpamje u shtri deri në gjysmën e parë të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Mendimtari shqiptar Hasan Tahsini ka qenë ithtar i kësaj pikëpamjeje. Shih – ***PSIKOLOGJIA FUQIMORE.***

FALIK, - E mb. Që i përket simbolit të falusit, që ka të bëjë me falusin.

FALUS, - I. m. I ardhur nga greqishtja, që lidhet më tepër me terminologjinë e antropologjisë. Falusi në kuptimin e përgjithshëm është simboli i pjellorisë, i organit seksual të mashkullit. Në kulturat e popujve primitive falusi është konsideruar organ i fuqisë. Sot, në terminologjinë e miteve termi falus simbolizon frymën, fuqinë krijuese të njeriut, karakterin mashkullor të njeriut dhe ky simbol paraqitet në formë figure, përfytyrimi etj. të organit seksual mashkullor. Zigmund Frojdi (Sigmund Freud, 1856 – 1939) e përcakton falusin si objekt kryesor të interesit seksual të fëmijëve; Karl Jungu (Carl Jung, 1875 – 1961) e përcakton falusin si simbol të veçantë, ku penisi është vetëm pjesë e këtij simboli.

FAMILJ/E, - A. f. I ardhur nga latinishtja *family*, që është ngulitur në terminologjinë juridike, sociologjike dhe psikologjike të gjuhës shqipe. Në kuptimin e vjetër familja ishte bashkësi pjesëtarësh të një ekonomie. Familja është bashkësi e veçantë individësh e formuar në bazë të martesës e të kurorëzimit me pëlqimin e burrit e të gruas, të cilët me dëshirën e tyre, kanë vendosur një marrëdhënie psikologjike, morale e juridike. Familjen e përbën burri e gruaja dhe fëmijët e tyre, ose dy breza prindër–fëmijë, që quhet *familja e ngushtë*, ose bashkëshortët, fëmijët e prindërit e bashkëshortit, rrallë ata të bashkëshortes, të cilët jetojnë së bashku dhe kanë ekonomi të përbashkët – *familja e gjerë*. Themelin e familjes e përbën ndjenja e dashurisë ndërmjet burrit e gruas, sinqeriteti i ndërsjellë, respektimi i mendimeve, i qëndrimeve dhe i interesave me vlerë të përbashkët, si edhe pozita e barabartë e burrit dhe e gruas. Familja është institucioni shoqëror, ku pjesëtarët e saj gjejnë sigurinë, prehjen dhe dashurinë. Tri janë funksionet kryesore të familjes: funksioni biologjik, ekonomik dhe funksioni psiko-social. Familja me baza të shëndosha psikologjike përbën themelin e rëndësishëm për zhvillimin dhe formimin e personalitetit të shëndoshë fizik e psikik. Në familje zhvillohet dhe formohet sistemi i qëndrimeve dhe i vlerave, si edhe baza e sigurt ekonomike për secilin anëtar të saj. Numri i anëtarëve të një familjeje ndryshon prej kulturës së një populli te kultura e një populli tjetër. Në mjediset shqiptare deri nga mbarimi i gjysmës së parë të shekullit të njëzet familja, kryesisht ajo e vendeve rurale, ka pasur karakter patriarkal, kurse më vonë ka pasuar shpërbërja e tipit të kësaj familjeje. Në Kosovë deri nga mbarimi i gjysmës së parë të shekullit të njëzet ka pasur familje të tilla, familje të mëdha prej rreth 100 anëtarësh, kurse tashmë familjet përbëhen nga bashkëshortët me fëmijë dhe me prindër, por me prirje të zhvillimit drejt familjes së ashtuquajtur *familje nukleare* (burri e gruaja dhe fëmijët e tyre).

FAMILJA PATRIARKALE. Familje që ka karakterizuar popujt e vjetër. Në familjen patriarkale fjalën kryesore e ka burri; ai është pushtetmbajtës i familjes dhe përgjegjës për mbarëvajtjen e proceseve zhvillimore të saj. Në familjen patriarkale gruaja ka pozicion të injoruar; ajo konsiderohet individ në shërbim të burrit, e aftë për lindjen e fëmijëve dhe kryerjen e punëve shtëpiake. Në bjeshkë e në viset blegtorale të shqiptarëve, pikërisht aty ku ka mbisunduar kanuni, ka pasur familje patriarkale me shumë anëtarë dhe familje patriarkale me pak anëtarë. Zhvillimi i përgjithshëm social-ekonomik ka ndikuar në shndërrimin e familjes patriarkale në familje bashkëkohore, të përbërë nga bashkëshortët dhe fëmijët e tyre, ku ndërlidhjet e tyre mbështeten në cilësinë e ndjenjës së dashurisë dhe ku baza ekonomike është frut i punës së përbashkët të të dy bashkëshortëve.

FAMILJE PROFESIONESH. Grup profesionesh me disa struktura dhe cilësi të përbashkëta. Të tilla mund të jetë familja e profesioneve mekanike, familja e profesioneve intelektuale, familja e profesioneve shëndetësore etj. Në kategorinë e familjes së profesioneve mekanike hyjnë: makinistët, shpuesit e pellgjeve minerale, hapësit e puseve etj.

FANATIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga latinishtja *fanaticus* "i tërbuar". Pasion i thellë i një individi ndaj një individi tjetër, ndaj një pikëpamjeje, ndaj një vepre etj. Fanatizmi ka strukturë të ndërlikuar psikologjike. Këtë e karakterizon entuziazmi i tepruar, qëndrimi jokritik ndaj objektit të fanatizmit dhe besnikëria e madhe dhe e skajshme ndaj objektit të fanatizmit (ndaj prijësit fetar, ndaj pastërtisë kulmore të rrobave, ndaj mbështetjes skajore të një ideologjie etj.). Formohet dhe zhvillohet gjatë socializimit të fëmijës që nga mosha e fëmijërisë. Duke u bërë tipar karakteristik i sjelljes së qëndrueshme të individit të caktuar ndaj objektit të fanatizmit shpesh njeriu bie në gjendjen e çrregullimit të personalitetit dhe të identitetit psikologjik të tij. Në ish-vendet e sundimit totalitar fanatizmi ka marrë formën e çuditshme të sjelljeve kolektive shumë të dëmshme. Përmasa të tilla ka pasur edhe në sistemin monist ndër Shqiptarët e Shqipërisë dhe të Kosovës të gjysmës së dytë të shekullit të njëzet.

FANITJ/E, - A. f. Proces alucinativ dhe gjendje karakteristike e disa individëve, të cilët i karakterizon paraqitja e paqëllimshme e përmbajtjes së një objekti, ngjarjeje, situate etj. në formë përfytyrimi pamor, dëgjimor, shijues etj., ose edhe në formë të përfytyrimit të kombinuar pamor "dëgjimor, shijues-oflaktiv etj. Procesi dhe gjendja fanitëse e njeriut ushtron ndikim në proceset njohëse dhe në sjelljet e individit gjatë kohës së përjetimit të saj.

FANTAZ/ËM, - MA. f. I ardhur nga greqishtja që ka kuptimin e figurës së fantazisë, figurës halucinative, të përfshirjes së një objekti, ngjarjeje etj., e cila përjetohet në formën e përfytyrimit të gjallë, me ndjenjën e besimit në nivel të lartë nga ana e individit, por duke qenë ai i vetëdijshëm se fantazma nuk ka objekt perceptimi. Fantazma është emërtim sipas mitologjisë greke, Perëndia e ëndrrave, *Φαντασία*. Fantazmat i imponohen individit në kushte të posaçme. Këto janë figura subjektive të gjalla, të lidhura kryesisht me

ardhmërinë e caktuar të tij, si edhe me veprimet e tij të paramenduara. Figura fantazmash mund t`i paraqiten poetit, piktorit, kompozitorit të zhytur thellë në mendime. Te individët që vuajnë nga disa çrregullime psikike (histeria, fobitë imponuese) fantazmat e tilla janë pjesë përbërëse e gjendjeve të tyre. Fantazmat shfaqen edhe te individët e zakonshëm në formë figurash ëndërrore dhe shpesh të shoqëruara me gjendje të ngarkuar emocionale, madje edhe me disa simptoma neurotike.

FANTAZI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *φαντασία*. Proces psikik i përjetimit të figurës së gjallë të një objekti, dukurie, ngjarjeje etj., i pjesëve të tyre dhe i formimit të figurës sintetike, shpesh të çuditshme, nga lidhja e përbërësve të ndryshëm të asaj ngjarjeje me elementet e ngjarjeve të tjera që nuk gjenden në formën objektive pranë subjektit. Figurat e tilla janë produkte të fantazisë dhe, si të tilla, këto figura gjenden larg realitetit. Të tilla mund të jenë figurat e ëndrrave, të miteve, të përrallave etj. Këto figura përcillen me ndjenjë të kënaqësisë. Figurat e fantazisë janë më të gjalla te krijuesit, kurse te njerëzit normalë, megjithëse janë pjesë e jetës estetike të tyre, figurat e fantazisë nuk janë aq të theksuara. Sipas psikanalizës figurat e fantazisë janë produkt i atyre gjendjeve të kënaqësisë së njeriut që krijohen duke lënë anash, madje edhe duke mohuar parimin e realitetit dhe duke u lëshuar në parimin e kënaqësisë. Ëndrra për lindjen e përsëritur nga ana e fëmijës është produkt i procesit të fantazisë. Figurat e fantazisë mund të marrin përmasa patologjike, atëherë kur ato bëhen dominuese në sjelljet dhe në veprimet e njeriut, atëherë kur njeriu i organizon sjelljet e veprimet e tij sipas këtyre figurave e jo sipas përmbajtjes reale të proceseve kognitive. Shih – ***IMAGJINATA.***

FANTAZMA DHE PSIKANALIZA. Psikanaliza i shpjegon fantazmat si forma të shprehjes së dëshirave të pavetëdijshme, të fshehura thellë në pellgun e së pavetëdijshmes. Figura në formë fantazmash mund të jetë figura e lidhur me shtytësin e hershëm seksual të moshës së fëmijërisë ndaj anëtarit të afërm të familjes, madje edhe ndaj motrës, vëllait; fantazma se prindërit nuk janë ata biologjikë, por janë përvetësues të fëmijës etj.

FANTOM, - I. m. Formë e perceptimit "të gënjeshtërt" të një individi, kur ai e përjeton këtë me strukturë mendore shumë të gjallë duke iu afruar perceptimit konkret, megjithëse është i vetëdijshëm se për këtë nuk ekziston ngacmuesi real i një perceptimi të tillë. Sipas psikanalizës fantoma është figura përfaqësuese e një individi të dashuruar në të, por të paprekur në pikëpamje morale e juridike.

FARING, - U. m. Në anatomi është fyti me muskuj të gojës dhe me membranën mbështjellëse të këtyre muskujve. Faringu lidh buzët dhe hundën me laringun. Në psikologji përmendet për shkak të rolit të receptorëve të shijes e të erës dhe të ndijimeve të cilësisë dhe intensitetit të ngacmuesve që shkaktojnë ndijimin e shijes e të nuhaturit dhe ato të lëvizjeve të këtyre muskujve.

FARMAKOLOGJI, - A. f. Shkencë farmaceutike e lidhur me disiplinat e tjera mjekësore. Lënda bazë studimore e farmakologjisë janë barnat apo

ilaçet, të cilat përdoren për parandalimin e sëmundjeve. Nga zhvillimi i kësaj disipline shkencore lindi shkenca e psikofarmakologjisë. Shih – ***PSIKOFARMAKOLOGJIA.***

FASCICULUS ARCUATUS. Në anatominë e sistemit nervor ka kuptim psikonervor të veçantë. Termi *fasciculus arcuatus* është emërtim latin i fijes nervore, e cila lidh qendrën nervore të Vernikut me atë të Brokut. Këto dy qendra janë baza nervore e të folurit, e ligjërimit dhe e kuptimit të ligjërimit. Shih – ***QENDRA VERNIK; QENDRA BROK.***

FASCIKULUS, - I. m. I ardhur nga latinishtja *fasciculus*, që i përket terminologjisë së anatomisë, por me ndikim njohës edhe në lëndën e psikologjisë. Fascikulusi emërton gërshetën e fijezave nervore, që formojnë njësi të veçantë anatomike ose fiziologjike.

FASHITJ/E, - A. f. Procesi i shuarjes shkallë–shkallë të një shqetësimi shpirtëror, rënie e ngadalshme e intensitetit të një ndijimi, emocioni dhe i ritmit të një veprimi deri në shkallën e ndërprerjes së përjetimit të tyre. Fashitet dhembja, shija e hidhët, era e keqe e mbeturinave etj.

FAT, - I. m. Lloj i përjetimit të një gjendjeje ndjenjash nga ana e njeriut, kur ai vlerëson se me aktivitetin e tij e ka plotësuar njerën nga dëshirat e rëndësishme të jetës së vet dhe me këtë ai ka arritur ta afirmojë veten dhe sjelljet që e kanë prurë në këtë gjendje kënaqësie të shkallës së lartë. Pikërisht për këtë shkak fati i këtillë konsiderohet se është një arritje e jashtëzakonshme dhe formë e rëndësishme e përshtatjes apo adaptimit, e qetësimit të organizmit dhe e stabilizimit të sjelljeve të veta ndaj mjedisit dhe ndryshimeve të këtij mjedisi. Përmbajtja e fatit formohet nga një "shkrirje" e kënaqësisë së madhe me dëshirën dhe vlerën e madhe e të rëndësishme të saj, kur dëshira dhe vlera e këtillë arrin të plotësohet.

FATALIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga latinishtja *fatum* "fat". Në psikologji i ardhur nga filozofia, sipas së cilës të gjitha dukuritë, proceset, strukturat objektive etj. janë të paracaktuara dhe të varura nga fati, nga perëndia. Ndryshimet sasiore e cilësore të dukurive, të objekteve, të proceseve etj. janë të paracaktuara nga fuqitë mbinatyrore dhe se vullneti e inteligjenca e njeriut nuk mund të shkaktojnë ndonjë ndryshim apo të ndikojnë në zhvillimin e tyre. Kjo pikëpamje e përgjithshme prek edhe dukuritë, proceset e sjelljet psikologjike, sepse ka mbështetje në ndjenjën e besimit të thellë të njeriut në përcaktimin paraprak të asaj që do të ndodhë dhe se njeriu me aktivitetin e vetëdijshëm apo të pavetëdijshëm nuk mund ta ndryshojë atë që është paraparë.

FATI I PËRBASHKËT. Term i psikologjisë geshtaltiste që emërton njerin nga parimet e perceptimit, sipas të cilit pjesët e një tërësie ose format e saj që kanë prirje të lëvizin në të njëjtin drejtim, të anojnë kah forma e përbashkët etj. Këto pjesë ose forma në fushën perceptive të njeriut formojnë një tërësi perceptuese për të.

FAZË, - A. f. Në psikologjinë e zbatuar emërton kohëzgjatjen e caktuar të ecurisë së një gjendjeje, të një dukurie, procesi apo sjelljeje të organizmit dhe

përsëritjen e saj në kuadrin e një cikli të zhvillimit të asaj dukurie, procesi a sjelljeje të një organizmi të caktuar. E tillë mund të jetë faza e çrregullimit maniako-depresiv, faza e falusit, e zhvillimit psikoseksual në psikanalizë, faza e fëmijërisë së hershme etj. Një fazë zhvillimi zëvendëson fazën paraprake dhe kështu vazhdon ecuria e procesit në tërësinë e tij, si procesi i çrregullimit fiziologjik (faza e menstruacioneve) ose procesi i çrregullimit psikik (faza e pubertetit).

FAZA ANALE. Faza e dytë e zhvillimit psikoseksual të njeriut, e zhvillimit të libidos që karakterizohet nga kënaqësia e zonës erotike anale. Kjo kënaqësi shkaktohet nga çlirimi i zorrëve nga ngarkesat. Kjo ka të bëjë me kënaqësinë e fëmijës së moshës dyvjeçare kur defekon dhe lidhet me kërkesën e pastrimit të trupit. Një pastrim i tillë për fëmijën e moshës dyvjeçare është ndalesa e parë dhe impulsive e shtytësit të brendshëm, të shtytësit anal. Kjo ndalesë ka rëndësi të madhe, sepse fëmija për herë të parë fillon të mësohet vetvetiu ngaqë tërhiqet nga kënaqësia anale për t`i gëzuar prindërit e tij dhe për të zhvilluar dashurinë e tyre ndaj fëmijës.

FAZA E GJUMIT REM. REM është shkurtesë e formuar nga fjalët angleze R(apid) "i shpejtë", E(yes) "sy" dhe M(ovements) "lëvizje me lëvizje të shpejta të syve". Me shkurtesën REM emërtohet faza e parë e gjumit, kur sytë e njeriut bëjnë lëvizje të shpejta poshtë – lart dhe djathtas – majtas. Faza REM e gjumit shfaqet disa herë gjatë gjumit. Në fillim të gjumit shfaqet rreth 15 minuta dhe shfaqet herë pas here gjatë gjumit disa orësh. Faza e gjumit REM mbisundon rreth ¼ e kohës së gjumësisë. Faza REM fillon të shfaqet kur humbin valët alfa të trurit. Shumë njerëz kur zgjohen tregojnë se gjatë kësaj faze kanë parë ëndrra.

FAZA E HORDHIVE PRIMITIVE. Njëra ndër fazat e para të zhvillimit filogjenetik të njerëzisë. Këtë fazë e karakterizon familja e madhe hordhe, sidomos raporti i atit, i kryeplakut të familjes së madhe me anëtarët e asaj familjeje, ku ai ka qenë padron i të gjitha femrave dhe ka pasur të drejtën e shfrytëzimit të tyre. Këtë dukuri e ka supozuar edhe Çarls Darvini (Charles Darwin, 1809 – 1882), por Zigmund Frojdi (Sigmund Freud, 1856 – 1939) e ka konceptuar gjerësisht, duke theksuar se rebelimi i anëtarëve të atyre familjeve horde ka çuar deri në vrasjen e atit të këtyre familjeve dhe në zhvillimin e ekzogamisë, të ndjenjës së fajit dhe në ndalim të incestit. Shih – ***INCESTI.***

FAZA E LATENCËS REM. Fazë që emërton dallimin kohor ndërmjet çastit të gjumit të plotë të njeriut dhe shfaqjes së lëvizjeve horizontale dhe vertikale të pulitjes së shpejtë të syve. Shih – ***GJUMI.***

FAZA E REFRAKSIONIT. Në anatominë e fiziologjisë së sistemit nervor dhe në psikologjinë fiziologjike përcakton kohën shumë të shkurtër të zvogëlimit të ndjeshmërisë së qelizës nervore menjëherë pas aktivimit të saj nga një impuls nervor. Kur qelizat nervore janë në gjendje të qetë intensiteti i ulët i ngacmimit të tyre nuk është në gjendje të shkaktojë një impuls nervor dhe, pas një kohe shumë të shkurtër,

të matur me të mijtat e sekondës, intensiteti i ngacmimit shkakton reagim të tyre. Dendësia e impulsive nervore të qelizës kur qeliza nervore fillon reagimin e saj është aq më e madhe sa më i lartë të jetë intensiteti i ngacmimit të asaj qelize. Në bazë të neurofiziologjisë shpjegohet largësia shumë e vogël, e hetueshme me zor, ndërmjet ndikimit të një ngacmuesi fizik në shqisat e njeriut dhe të paraqitjes së ndijimit të tij. Shih – ***KOHA E LATENCËS.***

FAZA E VERIFIKIMIT. Faza përfundimtare e procesit të zgjidhjes së një situate problemore. Faza e verifikimit pason pas fazës së inkubacionit dhe fazës së iluminacionit. Në këtë fazë subjekti kërkon vërtetësinë e zgjidhjes së situatës problemore. Faza e verifikimit është pjesë përbërëse e zhvillimit të procesit të mendimit krijues dhe ndahet me vështirësi nga fazat paraprake të inspiracionit, të inkubacionit dhe të iluminacionit, pas së cilës shfaqet prirja e subjektit për të argumentuar saktësisht zgjidhjen e suksesshme të një situate problemore. Identifikimi i fazës së verifikimit në procesin e ndërlikuar të zgjidhjes së situatave problemore është i lidhur me hulumtimin e psikologëve geshtaltistë. Shih – ***PSIKOLOGJIA GESHTALTISTE.***

FAZA FALIKE. Fazë e veçantë e zhvillimit seksual të njeriut në teorinë psikanalitike. Këtë fazë të zhvillimit psiko-seksual e karakterizon interesimi i fëmijës mashkull për organin seksual të tij, kurse fëmija e gjinisë femërore përqendrohet në organin seksual femëror. Në këtë fazë lulëzon zhvillimi psiko-seksual fëmijëror. Kënaqësia e shkaktuar nga prekja e organit seksual dhe shfaqja e tij zhvillohet kryesisht ndërmjet vitit të tretë dhe vitit të pestë. Faza falike është e lidhur me fazën paraprake anale dhe pas fazës falike vijon faza e Edipit. Disa nga individët mbeten të lidhur me këtë fazë dhe për pasojë zhvillohen tipare të karakterit falik.

FAZA GJENITALE. Sipas psikanalizës i përket fazës së fundit të zhvillimit seksual të fëmijës, përkatësisht të libidos së tyre, dhe ka të bëjë me moshën e pubertetit, kur arrihet kulmi i zhvillimit psikoseksual. Në fazën gjenitale fillojnë të zhvillohen marrëdhëniet ndërmjet individëve të gjinive të kundërta dhe libido është e drejtuar në individin e gjinisë së kundërt.

FAZA ORALE. Faza e parë e zhvillimit psikoseksual të fëmijës, që vërehet gjatë vitit të parë të rritjes së foshnjës. Në këtë fazë hasen këto reagime karakteristike: thithje e gjirit të mëmës, kafshim i gjirit ose kafshim i pjesëve të tjera të trupit të një individi, thithje gishtërinjsh etj. Me këto sjellje foshnja kënaq libidon, përkatësisht qetëson tensionin e organizmit të shkaktuar nga mungesa e kënaqësisë erotike. Sipas teorisë klasike të psikanalizës në fazën orale libido është e përqendruar në buzët e foshnjës. Rëndësinë e njohjes së kësaj faze të zhvillimit psiko-seksual, e sidomos, veprimin e shkuljes së thonjve me dhëmbë, të të thithurit të gjinjve, të gishtërinjve etj. e ka trajtuar posaçërisht psikiatri dhe psikanalisti Karl Abraham (Karl Abraham, 1877 – 1925). Sipas tij, faza orale ndahet në dy pjesë: faza pasive, që zgjat deri rreth gjashtë muaj dhe karakterizon kënaqësinë psiko-seksuale

të thithjes së gjirit, dhe faza aktive që shfaqet pas muajit të gjashtë, kur kanë filluar të dalin dhëmbët dhe kur foshnja fillon të ndiejë kënaqësinë, duke kafshuar a dëmtuar me dhëmbë objektin që ka në gojë.

FAZA ZHVILLIMORE. Veçoritë zhvillimore psiko-fizike të individit në një fazë apo një shkallë të caktuar të jetës së tij (në shkallën a nivelin e foshnjërisë, të fëmijërisë së hershme, të mesme, të vonshme etj.). Ky term sot përdoret më tepër për të emërtuar fazat e zhvillimit të strukturave apo funksioneve psikike të caktuara psikike. E tillë është teoria e zhvillimit kognitiv e psikologut zviceran Zhan Piazhe (Jean Piaget, 1896 – 1980) dhe teoria e zhvillimit moral të Lorenc Kohlbergut (Lawrence Kohlberg, 1927 – 1987).

FAZAT E HULUMTIMIT PSIKOLOGJIK. Procesi koherent i gjurmimit të një çështjeje të caktuar psikologjike. Ky proces ndahet në pesë faza:

1) **Përkufizimi i problemit**: A ekzistojnë ndryshime në sjelljet agresive ndërmjet fëmijëve femra dhe meshkuj në kopshtet e edukimit të tyre?
2) **Hipoteza:** Fëmijët meshkuj në kohën e edukimit në kopsht janë më agresivë se fëmijët femra;
3) **Metodat hulumtuese:** Vëzhgimi sistematik në kushte natyrore i sjelljeve të tyre në kopsht;
4) **Analiza e të dhënave**: Zbatimi i procedurave statistikore gjatë mbledhjes së të dhënave;
5) **Përgjigjja në problemin e parashtruar**: Në kohën e edukimit të fëmijëve në kopsht fëmijët e gjinisë mashkullore janë më agresivë se fëmijët e gjinisë femërore.

FAZAT E ZHVILLIMIT KOGNITIV. Faza të zhvillimit mendor të psikologut zviceran Zhan Piazhe (Jean Piaget, 1896 – 1980). Sipas tij zhvillimi kognitiv ka katër faza kryesore: fazën psikomotorik, paraopracional, të operacioneve formale dhe fazan e operacioneve formale. Faza psikomotorik i përket moshës zhvillimore prej lindjes deri në zhvillimin e funksioneve simbolike, përkatësisht prej lindjes deri në moshën një vjet e gjysmë. Gjatë kësaj moshe zhvillohen lëvizjet dhe veprimet si mjete intelektuale. Faza paraoperacionale është e lidhur me moshën prej 1,6 muaj dhe zgjat deri në moshën 7 – 8 vjet, moshë kjo kur zhvillohen funksionet simbolike (zhvillimi i të folurit). Faza e tretë është faza e zhvillimit të operacioneve konkrete që fillon nga mosha 7 ose 8 vjeç dhe zgjat deri në moshën 11 – 12 vjeç. Këtë fazë e karakterizon zhvillimi i aftësive për grupim, klasifikim sipas ngjashmërisë, identitetit të dukurive, të objekteve konkrete. Faza e operacioneve formale shtrihet prej moshës 12 deri në moshën 15 – 16-vjeçare, ku i riu operon jo me objekte konkrete, por me emërtime fjalësore dhe me hipoteza mendore.

FAZAT E ZHVILLIMIT MORAL. Zhvillime morale brenda një vazhdimësie, ku dallohen zhvillimi i ndjenjave morale, i gjykimeve dhe i sjelljeve morale nga fëmijëria deri në pjekurinë e njeriut. Në këtë proces të gjatë dallohen tri faza kryesore dhe secila prej tyre ka nga dy nivele, që së bashku përbëjnë një linjë zhvillimore të ndarë në

gjashtë faza të ndërlidhura. Këto janë: 1) Faza paramorale; 2) Faza konvencionale dhe 3) Faza e parimeve morale. Faza paramorale ka nivelin *a* dhe *b*. Niveli *a* ka të bëjë me realizime personale pa pasur kurrfarë dijenie për të mirën dhe të keqen, por duke iu shmangur sjelljeve dënuese. Niveli *b* është kënaqja e motiveve duke favorizuar një sjellje të mirë. Faza e dytë po ashtu ka dy nivele: niveli i parë i përket sjelljeve të dëshiruara me falënderim nga të tjerët, kurse niveli i dytë, përkatësisht niveli i katërt, i përket nënshtrimit të personalitetit autoritativ dhe kuptimit të dënimit, si edhe paraprirja e tij nga ana e fëmijës. Faza e tretë është faza më e lartë e zhvillimit të sjelljeve morale. Në nivelin e parë të kësaj faze (niveli i pestë) karakterizohet me marrjen në konsideratë të vlerave të bashkësisë, kujdesi për organizim dhe drejtim të sjelljeve morale sipas këtyre vlerave dhe me vetënderim. Më në fund, në nivelin e gjashtë, përkatësisht në nivelin e dytë të fazës të tretë, njeriu arrin të mendojë për ndërgjegjen e tij, për prejardhjen e moralit dhe tashmë individi fillon ta dëgjojë "zërin e brendshëm" që del nga ndërgjegjja e vet. Ky proces i zhvillimit moral sipas këtyre fazave i atribuohet psikologut amerikan Laurenc Kohlbergut (Lawrence Kohlberg, 1927 – 1987), dhe konsiderohet se është vazhdim i pikëpamjeve të zhvillimit kognitiv të psikologut zviceran Zhan Piazhe (Jean Piaget, 1896 – 1980).

FAZAT E ZHVILLIMIT PSIKOSEKSUAL. Fazat kohore të zhvillimit sipas psikanalizës klasike. Këto janë: ***FAZA ORALE; FAZA ANALE; FAZA FALUSORE; FAZA GJENITALE***, – shih. Zhvillimi psikoseksual sipas Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939) kalon nëpër këto faza: faza orale e vitit të parë, anale e vitit të dytë, falusore e vitit 3 – 5 të jetës së fëmijës, e latencës ndërmjet vitit 5 – gjenitale e vitit 7 – 13 dhe e pjekurisë së seksualitetit gjenital pas viteve të pubertetit. Mbi këtë bazë Zigmund Frojdi shpjegoi edhe zhvillimin e sjelljeve morale të fëmijës, përkatësisht të njeriut.

FAZAT E ZHVILLIMIT TË NJERIUT. Zhvillime kohore fizike e psikike të njeriut, karakteristike për atë fazë të ndërlidhur me fazat e tjera të zhvillimit ciklik psiko-social. Fazat për zhvillimin psikik janë: 1) Faza e besimit përballë mosbesimit; 2) Faza e autonomisë përballë dyshimit dhe turpit; 3) Faza e nismës përballë fajit; 4) Faza e kujdesit përballë inferioriteti; 5) Faza e identitetit përballë konfuzionit; 6) Faza e intimitetit përballë izolimit; 7) Faza e zhvillimit përballë ngecjes në një pikë zhvillimore dhe 8) Faza e integrimit të egos përballë dezintegrimit. Kjo ndarje fazash zhvillimore të njeriut u përcaktua nga Erik H. Erikson (Erik H. Erikson, 1902 – 1994).

FAZAT ZHVILLIMORE TEORIKE. Sistem konceptesh e gjykimesh të ndërlidhura logjikisht që paraqesin zhvillimin e proceseve psikike dhe të sjelljeve në formë përparimesh cilësore, karakteristike për secilën fazë të lidhur me tjetrën. Kjo teori mbështetet në këto kritere: kriteri i parashikimit të zhvillimeve cilësore në sjellje, rendi i pakontestueshëm për të gjithë, sjelljet brenda një faze dhe të lidhura me fazat e tjera duhet të kenë bazë konceptuale të njëjtë dhe në fund zhvillimi teorik duhet të ketë karakter hierarkik,

ku secila fazë nënkupton fazën paraprake. E tillë është teoria psikomotorike e Arnold L. Gezelit (Arnold L. Gesell, 1880 – 1961), e zhvillimit kognitiv të Zhan Piazhes (Jean Piaget, 1896 – 1980), e zhvillimit moral sipas Laurenc Kohlbergut (Lawrence Kohlberg, 1927 – 1987) etj.

FEHNER Gustav (Gustav FECHNER). Fizikan dhe psikolog gjerman. Lindi në Gros-Sarchen (Niederlausitz) më 19.04.1801 dhe vdiq në Lajpcig më 18.11.1887. Së bashku me Ernst Veberin janë themeluesit e psikofizikës. Në fillim të karrierës së tij ishte profesor i fizikës, por më pas u mor me gjurmime eksperimentale të fushës së raporteve ndërmjet intensitetit fizik të ngacmuesit të shqisave dhe pragut të ndjeshmërisë shqisore të njeriut. Ka ndërmarrë eksperimente për të caktuar dhe vërtetuar pragun e ndryshimit të ndijimeve, përkatësisht pragun diferencial. Aktiviteti i tij gjurmues dhe rezultatet e arritura kanë ushtruar ndikim në zhvillimin e psikologjisë eksperimentale. Në fushën e psikofizikës Gustav Fehneri njihet me ligjin e njohur ligji i Fehnerit, sipas të cilit intensiteti i ndijimit rritet në progresion aritmetik, kurse intensiteti i ngacmuesit rritet në progresion gjeometrik. Ky ligj mbeti i njohur në literaturën e psikologjisë me termin ligji Veber-Fehner. Është ndër ligjet e rëndësishme të zbulimeve psiko-fiziologjike dhe psikometrike të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Përpos gjurmimeve psikofizike Gustav Fehneri është i njohur edhe si themelues i estetikës psikologjike, ku kërkoi zbatimin e metodave dhe të procedurave psikometrike në gjurmimin e dukurive psikologjike të së bukurës. Këto pikëpamje kanë ndikuar në zhvillimin e mendimeve psikologjike të Ernst Mojmanit, të Teodor Lipsit etj. Veprat kryesore të tij janë: *"Elemente der psychophisik"* – (*"Elemente të psikofizikës"),* 1860; *"Vorschule der Asthetik"* – (*Parashkollimi estetik"*), 1876; "*In sachen der Psychophisik"* – (*"E vërteta për psikofizikën"*), 1887; *"Uber die psychischen Massprincipen und das Webersche Gesetz"* – (*"Mbi parimet e përgjithshme psikike dhe ligji i Veberit"*), 1887.

FE, - JA. f. Term me shtresim kuptimor psikologjik në teologji, metafizikë, sociologji etj. Në psikologji feja është sistem qëndrimesh të ndërlidhura me besimin e fuqishëm ndaj ekzistencës së qenies më të lartë – Perëndisë dhe në rolin e tij në zhvillimin e Gjithësisë dhe të secilit individ. Psikologjia e studion fenë si besim dhe konceptim të Perëndisë, ku pyetjet kryesore që parashtrohen në psikologji, sidomos në psikologjinë e religjionit janë: Si konceptohet i mbifuqishmi dhe i plotfuqishmi; Çfarë është burimi dhe zhvillimi i ndjenjave fetare, si zhvillohen ato, çfarë janë sjelljet fetare dhe cili është themeli i tyre? etj. Sistemi i qëndrimeve të lidhura me fenë ka këto përmasa kryesore psikologjike: përmasën kognitive, emocionale dhe motivuese. Por, psikologjia e sotme është e kufizuar në njohjen e brendshme të bazës së besimit fetar, të strukturës dhe të funksioneve të tyre. Pavarësisht nga kufizimet metodologjike sot është formësuar disiplina zbatuese e psikologjisë së fesë – psikologjia e religjionit, ku ka mjaft rezultate interesante për dimensionin psikologjik të fesë apo religjionit.

FEMINIZ/ËM, - MI. m. Dukuria e konceptimit të tërësisë psikologjike e sociale të njeriut te i cili mbisundojnë tiparet e personalitetit të femrës, sistemi i qëndrimeve dhe modelet karakteristike të sjelljeve femërore. Nga struktura e tillë e organizimit të sjelljeve të individëve feministë zakonisht të tjerët presin që ai në situata të njëjta, ose të ngjashme do të shpalosë sjellje karakteristike për botën femërore. Me bazën kuptimore të këtij termi marrin përmasa feministe disa nga profesionet, si profesioni i murgeshës në mjekësi, ai i arsimtares, i mbrojtjes së femrave nga dhuna familjare etj. Rezultatet e hulumtimeve empirike të kësaj dukurie kanë treguar se femërorja e mashkullorja janë përmasa të veçanta individuale dhe se disa nga qëndrimet, tiparet e personalitetit etj. të botës femërore gjenden edhe te pjesëtarët e gjinisë mashkullore dhe, përkundrazi, modelet e sjelljeve të meshkujve të zhvilluara sipas qëndrimeve e tipareve të personalitetit mashkullor gjenden edhe në botën femërore.

FENIHEL Oto (Otto FENICHEL). Psikanalist amerikan me prejardhje austriake. Lindi në Vjenë më 1897 dhe vdiq në Los Anxhelos më 1946. Bir i një familjeje të njohur hebreje. Pas përfundimit të studimeve për mjekësi u përqendrua në psikanalizë dhe u bë ndër persoanlitetet e njohura të brezit të dytë të psikanalistëve të botës. U shoqërua me psikanalistët Ani Rajh, Barbara Lantosh, Edit Xhekobson etj., dhe, së bashku me të, krijoi të majtën e Zigmund Frojdit. Më 1932 u emërua nënkryetar i Shoqatës Gjermane Psikanalitike. Oto Fenihel ka pasur miq të profesionit të psikanalizës në Berlin, Oslo, Pragë dhe, së fundi, edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ku u vendos që nga viti 1937. Ishte i entuziazmuar me pikëpamjet e Zigmund Frojdit, të cilat i përpunoi dhe i plotësoi më tej. Në ndryshim nga Zigmund Frojdi ky kishte pikëpamje tjetër për shtytësin e vdekjes. Veprat kryesore të tij janë: *"Problèmes de technique psychanalitique"* – (*"Problemet e teknikës psikanalitike"*), 1941; *"La Théorie psychoanalitique des nérvoses"* – (*"Teoria psikanalitike e neurozës"),* 1945.

FENOMEN, - I. m. I ardhur në psikologji nga filozofia, e pikërisht nga greqishtja *φαινόμενο*. Gjendja, ngjarja, procesi etj. i jashtëm ose i brendshëm i organizmit të njeriut, të cilën ai është në gjendje ta vëzhgojë drejtpërdrejt, ta përshkruajë pak a shumë saktësisht dhe ta regjistrojë si të dhënë empirike në bazë të përjetimit të tij subjektiv. Përshkrimi i kësaj të dhëne fizike përfshin paraqitjen e dukurisë, rrjedhjen dhe kushtet e paraqitjes së saj. Këndvështrimi subjektiv i dukurisë, procesit e rrjedhjes së tij psikike nga ana e individit të vetëdijshëm për këtë i përket fenomenologjisë, kurse regjistrimi i tij si e dhënë subjektive nuk kërkon shpjegim për shkaqet e kësaj dukurie.

FENOMENI (DUKURIA) AUBERT. Dukuri karakteristike e të vërejturit të një vize vertikale nga ana e një perceptuesi të saj. Perceptuesi i kësaj vize me rastin e lëvizjes së kokës përjeton dukurinë e lëvizjes së kësaj vize. Kjo dukuri dallohet kur njeriu e ul kokën; viza "lëviz" në drejtim të kundërt. Këtë dukuri e ka trajtuar mjeku dhe psikologu gjerman Herman Ludimal (Rudolf) Aubert (Hermann Ludimal

(Rudolf) Aubert, 1826 – 1992) dhe sipas mbiemrit të tij mori emërtimin Dukuria Aubert**.**

FENOMENI (DUKURIA) FEREI. Dukuria e reagimit elektrik të lëkurës, e njohur si reagim elektrodermal. Dukuria Ferei ka të bëjë me zvogëlimin e rezistencës elektrike të lëkurës, kur kjo ngacmohet nga ana e një ngacmuesi me fuqi të dobët elektrike. Kjo dukuri shfaqet me rastin e matjes së ndryshimeve termodermale të lëkurës, kur një individ i caktuar përjeton emocione dhe ndryshime të gjendjes emocionale.

FENOMENI (DUKURIA) FI. Lloj i iluzionit të lëvizjes së trupave nga të cilët buron drita, që shfaqet në njërin trup e më pas në tjetrin ose vërehet në të njëjtën kohë. Dukuria FI emërton këtë lloj iluzioni: nëse dy burime të dritës relativisht të largëta njëra nga tjetra ndizen në të njëjtën kohë ato perceptohen si një burim; nëse intervali kohor në mes njërit burim dhe burimit tjetër është i vogël, atëherë këto burime perceptohen si dy burime të njëkohshme; nëse dallimi kohor i ndezjes së dy burimeve të dritës është i madh, atëherë këto dy burime perceptohen si burime të ndezura njëri pas tjetrit. Lëvizja e filmit kinemaskopik është shembull praktik i kësaj dukurie. Dukuria FI i atribuohet përshkruesit të parë të saj, drejtuesit të psikologjisë geshtaltiste, psikologut gjerman Maks Vertaimer (Max Werthiemer, 1880 – 1943).

FENOMENI I (DUKURIA E) KONTRASTIT. Dukuria karakteristike e perceptimit të dy strukturave, përmbajtjeve, ngjyrave etj. që kanë cilësi të kundërta dhe kur perceptohen njëra pranë tjetrës ose njëra pas tjetrës i duken njeriut edhe më të kundërta se ç'janë në të vërtetë. Dallohen dy lloj kontrastesh: kontrasti simultan dhe kontrasti suksesiv. Kontrasti simultan ka të bëjë me përjetimin e perceptimit të një objekti ose me ndijimin e një ngjyre në kuadrin e kontekstit ku paraqitet objekti perceptues ose ngjyra e sipërfaqes së një ndijimi kromatik. Figura e katrorit me ngjyrë të murrme në bazamentin e ngjyrës së zezë duket më e ndritshme se i njëjti katror në bazamentin e ngjyrës së bardhë. Dy figura në formë kryqi me madhësi të ndryshme perceptohen ndryshe kur njëri gjendet pranë tjetrit dhe dy figura në formë kryqi me madhësi të njëjtë perceptohen ndryshe kur njëri gjendet i izoluar nga tjetri: figura e kryqit të vogël pranë figurës së kryqit të madh duket edhe më e vogël nga ç'është, kurse kur perceptohet e njëjta figurë e izoluar perceptohet me madhësi reale. Kontrasti suksesiv ka të bëjë me perceptimin e dy trupave që perceptohen njëri pas tjetrit dhe me ndijimin e një cilësie që i ekspozohet syrit të njeriut dhe më pas syrit i ekspozohet ngjyra tjetër. Fiksimi i ngjyrës së bardhë të dëborës dhe më pas hedhja e vështrimit në pallton me ngjyrë të mbyllët bën që ngjyra e palltos të duket më e errët se sa është në të vërtetë. Dukuri të ngjashme kemi te ndijimi që shkaktohet nga kalimi prej një zhurme të madhe në një lokal të qetë, ku zëri i një individi duket më i ulët se i njëjti zë në lokalin e zhurmshëm. Uji që pihet pas limonadës duket i tharët, kurse pas ëmbëlsirës duket i ëmbël etj.

FENOMENI I (DUKURIA E) "MAJËS SË GJUHËS". Fjala, emri, fillimi i vargut të një poezie etj. që qën-

dron në majë të gjuhës njihet fare mirë, por individi nuk arrin ta thotë, thua se i ka humbur për atë çast vokalizmi. Kjo dukuri shfaqet shpesh pothuajse te të gjithë në formën e pamundësisë së rikujtimit të rrokjes së parë me të cilën fillon fjala. Individi ka ndjesinë se këtë e ka aty, por në të vërtetë i mungon. Shkaku i kësaj dukurie ende nuk është sqaruar plotësisht. Dukurinë e "majës së gjuhës" e ka përshkruar gjerësisht filozofi dhe psikologu amerikan Uiliam Xhejms (William James, 1842 – 1910) qysh në vitin 1890.

FENOMENI (DUKURIA) PANUM. Dukuri pamore që përftohet nga të parit stereoskopik. Dukuria panum ka të bëjë me të parët stereoskopik binokular, kur njërit sy i ekspozohen dy vija paralele, kurse tjetrit vetëm një vijë. Kjo dukuri e ka marrë emrin sipas zbuluesit, fizikanit dhe psikologut danez Peter L. Panum (1820 – 1885) dhe u paraqit në literaturën e psikologjisë në vitin 1858.

FENOMENI (DUKURIA) PSIKIKE. Procesi, veprimtaria dhe tiparet psikike me funksionet e tyre që karakterizojnë njeriun dhe botën e kafshëve. Shumëllojshmëria, cilësia dhe përmasat e zhvillimit të tyre karakterizojnë secilën prej dukurive psikike. Dukuritë psikike shkaktohen nga faktorët e brendshëm dhe nga faktorët e jashtëm. Këto shfaqen në sjelljet e njeriut dhe në aktivitetet e botës shtazore dhe të specieve të tyre ndaj ngacmuesve të botës së jashtme dhe ndaj ngacmuesve të botës së brendshme.

FENOMENIZ/ËM, - MI. m. I përdorur nga ana e psikologut zviceran Zhan Pijazhe (Jean Piaget) në shpjegimin e fazave të zhvillimit mendor te fëmijët. Sipas tij fenomenizmi është faza e mendimit parashkakor, kur fëmija e lidh shfaqjen e një dukurie me shfaqjen e një tjetre para/ose së bashku me të dhe duke menduar se dukuria e parë është shkak i paraqitjes së një dukurie tjetër bashkë me të. Kështu, rrezet e diellit janë të nxehta sepse dielli lind ditën (dita është shkak i shfaqjes së rrezeve të nxehta të diellit).

FENOMENOLOGJI, - A. f. Shkenca për dukuritë, sipas kuptimit të termit me prejardhje greke *φαινομε* "dukuri" dhe *λογία* "shkencë". Drejtim filozofik i Edmund Huserlit (Edmund Husserl, 1859 – 1938), me refleksion të posaçëm në rëndësinë dhe hulumtimin e dukurive psikike. Sipas këtij drejtimi hulumtimi i drejtpërdrejtë i përvojës së njeriut përbën lëndën e psikologjisë dhe thelbi i dukurive, duhet kërkuar mbi themelin e hulumtimit të drejtpërdrejtë të dukurive të vetëdijshme, kurse realiteti fizik i ngacmuesve të jashtëm duhet marrë në konsiderate në masë më të vogël. Njohja e saktë e së vërtetës duhet mbështetur në hulumtimin e raportit ndërmjet atij që vëzhgon dhe dukurive reale, dhe në reagimin e tij ndaj dukurive reale. Lënda e fenomenologjisë është mënyra si vëzhgohet dhe përjetohet një dukuri reale nga ana e një individi. Fenomenalizmi ka ushtruar ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e psikologjisë bashkëkohore.

FENOMENOLOGJIK, - E. mb. Që i përket fenomenologjisë ose që ka të bëjë me fenomenologji.

FENOTIP, - I. m. I ardhur në psikologji nga biologjia, pikërisht nga greqishtja *παινομαλ* "paraqitem" dhe

τύπος "formë, veçori". Emërton gjendjen, strukturën, funksionin, sjelljen shprehimore të një qenie të gjallë. Fenotipi është rezultat i përbashkët i veprimit të faktorëve të brendshëm, shih – ***GJENOTIPI*** dhe të faktorëve të jashtëm në gjallesat e një lloji të caktuar gjatë një periudhe të gjatë kohore dhe të predispozitës së formuar mbi këtë bazë të gjallesës për zhvillim të fenotipit.

FEOHOMOCITOM/Ë, - A. f. Term i përdorur në anglisht *Pheochomocytoma*. Feohomocitoma është emërtim i niveleve të larta të prodhimit të disa hormoneve të gjëndrave mbiveshkore (epinefrinë e norepinefrinë) që ushtrojnë ndikim në shfaqjen e disa çrregullimeve psikofiziologjike, si hipertensioni, dhembja e kokës, frika e madhe, paniku etj.

FERENCI Shandor (Sandor FERENCZI). Mjek neurolog dhe psikanalist hungarez. Lindi në Mishkolc të Hungarisë më 1873 dhe vdiq në Budapest më 22.05.1933. Pasi përfundoi studimet në Fakultetin e Mjekësisë së Vjenës më 1904 punoi shunë kohë si mjek. Më 1908 iu bashkua rrethit psikanalitik të ngushtë, duke patur lidhje të ngushtë me Zigmund Frojdin deri në fund të jetës. Më 1910 mori pjesë në themelimin e Shoqatës Ndërkombëtare Psikanalitike. Qëllimi i kësaj shoqate ishte ruajtja e pastërtisë së mësimeve psikanalitike, e pikërisht e mësimeve të psikanalizës klasike. Është ndër themeluesit e Shoqatës Psikanalitike të Hungarisë më 1913. Shandor Ferenci me angazhimet e tij praktike dhe teorike iu afrua më tepër terapisë ekzistenciale. Vuri në zbatim terapinë aktive në kuptimin që pacientit i shkaktonte frustrime dhe i vëzhgonte sjelljet e tij. Por, ky sistem i terapisë aktive e bënte terapeutin aktiv ndaj pacientit, pra e shtynte t`i shprehte sjelljet e veta, si edhe emocionet në formë krejtësisht të lirë, duke mos respektuar plotësisht personalitetin e subjektit-pacient. Në kuadrin e këtij raporti terapeuti duhet të luante rolin e nënës ndaj pacientit, duke e rikthyer këtë në raport të hershëm nënë-pacient dhe duke e pastruar atë nga reagimet dhe sjelljet e mundimshme dhe jonormale. Vepra kryesore e tij është*: "Katasztröfák u nemi alét fejlödésében"* – (*"Roli i katastrofës në evolucionin e jetës seksuale"*), 1932 në Budapest (botuar e përkthyer në gjermanisht, frëngjisht e anglisht, por me titull tjetër. Në frëngjisht dhe anglisht ka titullin "*Talas – psikanaliza e fillimit të jetës seksuale",* ku termi "talas" në psikanalizë është simbol i ujit që rrjedh vazhdimisht, simbol i lindjes dhe i kthimit të qenies në gjendjen e paralindjes.

FESTINGER Leon (Leon FESTINGER). Psikolog amerikan. Lindi në Nju Jork më 8.05.1919 dhe vdiq në Nju Jork më 11.02.1989. Pas përfundimit të studimeve në kolegjin Siti të Nju Jorkut u zhvendos më 1942 në Universitetin Shtetëror në Ajovi, ku kreu doktoratën në moshën 21-vjeçare. Ka qenë ligjërues i psikologjisë në universitetet: Ajovi, Roçeter, Miçigan, Minesota dhe në Universitetin Stanford, si edhe në Institutin e Teknologjisë në Masaçusets. Në fund të jetës punoi në shkollën për gjurmime shoqërore në Nju Jork. Leon Festingeri mbeti i njohur në psikologjinë e personalitetit dhe në psikologjinë sociale me teorinë e njohur të disonancës kognitive,

pra të mospërputhjes kognitive. Sipas kësaj teorie disonanca kognitive është jokonseguenca ndërmjet qëndrimeve dhe mendimeve të vetë njeriut për të njëjtën çështje. Kjo mospërputhje çoi në tension të brendshëm dhe në emocione negative. U shfaq edhe në formë konflikti ndërmjet qëndrimit dhe sjelljes së njeriut për të njëjtin objekt. Kjo zgjoi interesim të madh dhe u ndërmorën gjurmime për njohjen e strukturës dhe të funksionit psikologjik të saj. Rezultatet pozitive argumentuan funksionin e saj në shpjegimin e proceseve individuale-shoqërore të mjediseve me sisteme politike e sociale të ndryshme. Vepra kryesore e tij është: *"A theory of cognitive dissonance"* – (*"Teoria mbi disonancën kognitive"*), botuar më 1957.

FETISH, - I. m. I ardhur nga portugalishtja *feticio* "magjik". Fetishi është objekt që njeriu i atribuon cilësi të jashtëzakonshme, duke besuar verbërisht se ajo cilësi është vendosur në të dhe ka fuqi të çuditshme, fuqi adhuruese dhe të respektueshme. Fetishi është më tepër veçori e mendimit primitiv. Në psikanalizë fetishi mund të jetë këmisha, gjoksi, këpuca etj. e partnerit të gjinisë së kundërt, për të cilën pjesë të trupit ose objekte personale të saj/tij janë të lidhur me libidon, pra pikërisht me dëshira erotike, me energji të impulsit seksual etj. Shih – ***LIBIDOJA.***

FETISHIZ/ËM, - MI. m. Besim i verbër në fuqi të mbinatyrshme, në fuqi magjike të objekteve dhe entuziazmi i një individi në objekte magjike dhe në cilësitë e tyre që u atribuohen objekteve jo të gjalla të natyrës, përkatësisht fetisheve. Objektet e tilla kanë fuqi tërheqëse për të tjerët. Kështu, disa objekteve (hënës, gurit të thepisur, qengjit etj.) u përshkruhen cilësi magjike, cilësi të fetishit. Në psikopatologji dhe në psikiatri fetishizmi është formë e perversionit seksual, lloj i sjelljes jonormale seksuale të disa individëve, që ka të bëjë me mbivlerësimin seksual dhe shqetësimin seksual nga disa objekte (të çantës, të dorëzave, të shallit, të shamisë etj.) dhe të pjesëve të trupit të një individi të gjinisë tjetër dhe "kënaqjen seksuale"ndaj këtyre pjesëve dhe jo ndaj objektivit të vërtetë seksual. Shih – ***PARAFILIA.***

FETUS, - I. m. Në embriologji emërton fazën e zhvillimit të organizmit pas fazës embrionale. Faza e fetusit shtrihet në kohën zhvillimore të organizmit të paralindjes, duke përfshirë moshën nga tre muaj deri në muajin e nëntë, përkatësisht deri në moshën e lindjes së tij. Shih – ***PERIODIZIMI I ZHVILLIMIT PSIKIK TË NJERIUT.***

FËMIJA AUTIK. Fëmijë e tërhequr, jo komunikues dhe i pa interesuar për të tjerët me këto deficite psikike: shkallë të ndryshme të pazhvillueshmërisë foljore a verbale duke filluar nga paaftësia e plotë e të folurit deri në të folurin jogramatikor, të folur për të shprehur nevojat e tij personale duke iu drejtuar vetes e jo të tjerëve ose duke përsëritur fjalët e veta. Simptoma kryesore e fëmijës autik është paaftësia e të folurit që dallohet gjatë zhvillimit 30-mujor të tij.

FËMIJA PROBLEMATIK. Term i psikologjisë klasike për fëmijën, i cili edukohet me vështirësi, është me sjellje të papërshtatshme për mjedisin që e rrethon dhe paraqet problem për prindërit, arsimtarët, shokët etj. Fëmijë problematikë janë quajtur fëmijët agre-

sivë, impulsivë, kokëfortë, të padëgjueshëm, të përkëdhelur, të pasjellshëm, me shkallë të ulët të socializimit etj. Kriteret e përcaktimit të fëmijëve problematikë janë relativë; në një mjedis fëmijët e qetë, të tërhequr etj. i quajnë fëmijë problematikë, kurse në disa mjedise të tjera fëmijët e tillë nuk janë fëmijë problematikë. Kuptimi i këtij termi është më tepër përshkrues. Sot ky term përdoret gjithnjë e më pak.

FËMIJËRI, - A. f. Periudha e zhvillimit të fëmijërisë prej moshës së foshnjërisë, përkatësisht prej lindjes së foshnjës deri në moshën 12-vjeçare te fëmijët e gjinisë femërore, përkatësisht deri në moshën 14-vjeçare te fëmijët e gjinisë mashkullore (në disa mjedise sociale–kulturore përcaktimet kohore të moshës së fëmijërisë ndryshojnë nga përcaktimet e mjedisit tonë). Këtë periudhë e karakterizon zhvillimi relativisht i gjatë fizik, fiziologjik, psikologjik, social dhe etik. Periudha e fëmijërisë në literaturën e psikologjisë zhvillimore zakonisht ndahet në tri faza: fëmijëria e hershme që zgjat deri në moshën 3-vjeçare, fëmijëria e mesme deri në moshën 6–7-vjeçare dhe fëmijëria e vonshme që zgjat deri në moshën e fillimit të pubertetit. Në kuadrin e një ndarjeje të tillë përshkruhet dhe shpjegohet procesi i zhvillimit kognitiv, emocional dhe konativ, si edhe zhvillimi i tipareve të personalitetit dhe integriteti, veçantia dhe uniteti i tyre. Tri janë veçoritë kryesore të fëmijërisë: varësia e zhvillimeve psiko-sociale nga zhvillimi ekonomik-social dhe kulturor i mjedisit ku zhvillohet fëmija, theksimi i rëndësisë së zhvillimit të fëmijëve në këtë moshë për formimin dhe konsolidimin e personalitetit, si edhe shpjegimi i çrregullimeve të sjelljeve të fëmijëve të kësaj moshe në psikologjinë klinike dhe në psikiatri, duke u përqendruar në fazën e hershme, të mesme dhe të vonshme të fëmijërisë. Gjatë zhvillimit të fëmijërisë dallohet sidomos zhvillimi i lëvizjeve, i të folurit e i mendimit, i fantazisë që në fëmijërinë e mesme zhvillohet shkallë-shkallë, me qasje reale të tyre kah dukuritë fizike, biologjike e sociale, zhvillimi karakteristik i ndjenjave, i interesimeve, i qëndrimeve dhe ndryshimi i marrëdhënieve shoqërore ndërmjet fëmijëve të moshës së fëmijërisë së vonshme etj.

FIDBEK, – U. m. I ardhur nga anglishtja *feedback* "lidhje e kthyeshme, informacion i kthyeshëm", e që ka hyrë edhe në disa gjuhë të tjera. Ky term në biologji dhe në psikologji ka ardhur nga kibernetika. Fidbeku emërton konceptin e informacionit sinjalizues të operacionit të një sistemi veprues në momentin e dhënë, për vazhdimësinë e operacioneve të tjera apo për ndërprerjen e tyre. Kështu, termostati që rregullon mbajtjen e temperaturës konstante në një dhomë pune i jep sinjal sistemit të ngrohjes për veprim, kur temperatura është më e ulët ose më e lartë se niveli konstant i saj. Në psikologji fidbeku përdoret në këto situata: a) në psikologjinë fiziologjike informacioni kinestetik i receptorëve të muskujve i jep shkas vazhdimit të sistemit të lëvizjeve drejt një qëllimi të caktuar; b) në psikologjinë e të mësuarit informacioni i përgjigjes së saktë (rezultati) është sinjal i vazhdimit të sistemit të të mësuarit për zotërim të lëndës më të vështirë; c) në psikologjinë sociale të qeshurit e të tjerëve

(reagimi ndaj aktit të një pjesëtari të grupit) është sinjal i vazhdimit ose i mosvazhdimit të një aktiviteti motorik ose fjalësor etj. Prandaj, informacioni kinestetik, rezultati, reagimi etj. janë fidbek që sinjalizojnë operacionin pasues të një aktiviteti të caktuar.

FIGURË, - A. f. Paraqitje vizuale e një objekti, dukurie, procesi etj., që në fushën e psikologjisë ka kuptimin e një përvoje të perceptimeve të mëparshme, që në një moment të caktuar i shfaqet njeriut si përvojë unike me strukturë të qëndrueshme brenda konturit mendor në trajtën pamore të saj. Paraqitja e tillë mendore bën të mundur që ajo figurë të ketë formë, qartësi dhe ndarje të saj nga të gjitha figurat e tjera.

FIGURA E BABAIT. Në psikanalizë emërton figurën e përgjithshme të tipareve që ka çdo baba, figurën e mashkullit, i cili ka marrë rolin dhe funksionin e mbikëqyrjes, të kujdestarit, të njeriut që sillet ndaj të tjerëve me kujdesin e babait ndaj fëmijës së tij. Në literaturë një figurë e tillë shpesh emërtohet edhe me termin "imago i babait".

FIGURA E DYFISHTË. Figura pamore që me formën, strukturën dhe ndërlidhjet e pjesëve të tyre është jounike dhe objektet e vizatuara dalin me radhë në rolin e figurës kryesore, në varësi nga shkalla e përqendrimit të të parit. Nga njeriu kërkohet të tregojë çfarë sheh në atë figurë. Ka disa lloje figurash të dyfishta. Më e njohura është figura, vizatimi i njohur në literaturën e psikologjisë – vizatimi i Boringut (Edwin Boring, 1886 – 1968), ku subjekti mund ta shohë një grua të moshuar ose një grua të re.

FIGURA E NËNËS. Figurë analoge me figurën e babait. Figura e nënës në psikanalizë emërton një individ të gjinisë femërore, e cila ka marrë rolin e kujdesit të nënës ndaj të vegjëlve dhe ka pak a shumë ato cilësi e tipare të përbashkëta si edhe nëna biologjike. Të tilla mund të jenë: motra, tezja, gjyshja, mësuesja etj. Në psikologjinë komplekse të K. Jungut një figurë e tillë është lloj arketipi dhe emërtohet "Nëna e madhe".

FIGURA E QËNDRUESHME. Figurë e qëndrueshme në retinën e syrit, pavarësisht nga lëvizjet e syve të njeriut. Figura e stabilizuar në retinë i përket të parit të figurave më të afërta të syrit, që fiksohen në të njëjtin vend të retinës. Një figurë e tillë është figurë e fiksuar në të njëjtin vend të retinës dhe kjo nuk ndryshon pavarësisht nga lëvizja e syve, sepse lëviz bashkë me lëvizjet e syve.

FIGURA EIDETIKE. Figura mendore shumë të gjalla e të pasura me hollësi të objekteve që janë perceptuar; këto

figura dallohen nga perceptimi i objektit, megjithëse subjekti e di se objekti nuk ushtron ndikim të drejtpërdrejtë në shqisën e caktuar të tij. Figurat eidetike kanë këto karakteristika: subjekti e përjeton këtë figurë të gjallë edhe pak kohë pas largimit të objektit perceptues prej fushës pamore, dëgjimore, nuhatëse etj.; figura eidetike shfaqet disa sekonda a disa minuta dhe më pas zhduket, por ka raste kur figurat e tilla zgjasin shumë kohë pas perceptimit të objektit. Figurat eidetike shfaqen te fëmijët deri rreth moshës 14-vjeçare.

FIGURA ORBINSON. Figurë, nëpërmjet së cilës organizimi i ngacmuesve të saj shkakton perceptim të pacaktuar në mënyrë të saktë. Kjo dallohet në figurën më poshtë, ku në anën e majtë gjendet figura e një katrori dhe në anën e djathtë ajo e rrethit, por të dyja perceptohen jo si të rregullta. Figura mori emrin Orbinson, sipas zbuluesit të saj V. D. Orbinson (W. D. Orinson, 1940). Tërësia e kësaj figure e ilustron këtë lloj perceptimi.



FIGURA REVERSIBËL. Figurë që ka organizim pamor të tillë që i mundëson perceptuesit dallimin e një ose dy figurave të organizuara në një tërësi pamore. Një figurë e tillë përmendet në psikologji si figura e tejdukshme e Nekerit.



FIGURA RUBIN. Figurë e dykuptimshme që ilustron raportin ndërmjet bazës dhe figurës. Te ky rast kur perceptohet figura e bardhë; ajo ka formën e një vazoje lulesh dhe kur perceptohet baza e ngjyrës së bardhë ku është vendosur figura, atëherë perceptohen profilet e figurave të dy zezakëve. Shkaktohet nga dallimi i vështirësuar i figurës së tillë, për shkak të organizmit të strukturës karakteristike të ngacmuesve. Kjo figurë është e njohur edhe me termin figurë e kthyeshme (reversibël). U bë e njohur që nga viti 1915 nga ana e mendimtarit danez Edgar Rubin (Edgar Rubin, 1886 – 1997).

FIGURA – SFONDI. Raport i rëndësishëm ndërmjet figurës dhe hapësirës mbi të cilën është vizatuar ajo figurë, pikërisht fushës perceptuese pas figurës së vënë në qendër të asaj fushe ose të sfondit të saj. Në kuadrin e këtij raporti figura ka trajtë formuese më të qartë, kurse sfondi është pa trajtë. Sipas përfaqësuesve të psikologjisë geshtaltiste dallimi i figurës nga sfondi i saj është forma elementare e organi-

zimit të perceptimit nga ana e njeriut. Figura në fushën perceptuese është e dallueshme sepse ajo gjendet në qendër të vëmendjes së subjektit, ajo gjendet para sfondit, është më e integruar dhe ka kufizimet e veta, që e ndajnë nga sfondi ku ajo është vendosur. Sa më i madh të jetë kontrasti ndërmjet figurës dhe sfondit aq më lehtë perceptohet figura. Ky dallim varet jo vetëm nga struktura fizike e raporteve ndërmjet figurës-sfondit, por edhe nga përvoja, interesimet dhe motivet e subjektit. Shih – ***VAZOJA RUBIN.***

FIGURA STEREOSKOPIKE. Figurë e parë me anë të stereoskopit. Kur figura e tillë dydimensionale shikohet herë me një sy e herë me syrin tjetër shihet si figurë reale me dy përmasa, por kur largësia e figurës së parë me syrin e majtë përputhet me të parit e së njëjtës figurë me syrin e djathtë të vënë në stereoskop, atëherë përftohet figura e objektit me tri përmasa. Parja tripërmasore e figurës stereoskopike është produkt i shkrirjes së dy figurave pak të ndryshuara në retinën e syrit të majtë dhe atij të djathtë. Kjo dukuri shpjegon rolin e dy syve, përkatësisht të të parit binokular në dallimin e thellësisë së objektit.

FIGURA VAZHDUESE HERING. Figura vazhduese e të parit pas ndërprerjes së ndikimit të një tufe drite në syrin e njeriut. Me atë rast ende vazhdon figura e të parit të tyre pavarësisht nga fakti se para disa sekondash tufa e rrezeve të dritës e ka ndërprerë ndikimin e saj. E. Heringu e ka quajtur këtë figurë vazhduese figurë vazhduese pozitive, sepse ka të njëjtin cilësi, si edhe ngacmuesi i mëparshëm i syrit, nga i cili ka buruar figura vazhduese.

FIGURAT E KTHYESHME (REVERSIBËL). Organizim i pandryshueshëm ngacmuesish në fushën perceptive të tyre nga ana e njeriut, që mund të shihet herë në një formë e herë në formën tjetër. Figurë reversibël ose e kthyeshme është figura eker dhe figura e ashtuquajtur figurë e shkallëve reversibël. Këto shkallë kur vështrohen për një kohë të gjatë shihen nga lart-poshtë dhe pas një kohe ato vështrohen nga poshtë-lart. Mënyra e perceptimit të tyre është e kthyeshme, përkatësisht njeriu mund ta kthejë perceptimin nga fillimi i tij.



FIGURAT GOTSSHALD. Lloj testi i krijuar nga vizatimet e objekteve të ndërlikuara, brenda të cilave "fshihet"një figurë e thjeshtë, të cilën subjekti duhet ta dallojë sa më shpejt pas ekspozimit të asaj figure të ndërlikuar. Figurat e testit Gotshalt janë krijuar nga psikiatri Kurt Gotsshald (Kurt Gottschaldt, 1902 – 1991).

FIJET NERVORE. Degë të trupit të qelizave nervore përmes të cilave një qelizë nervore lidhet me tjetrën, me qelizat e organeve shqisore, me muskuj dhe me gjëndra. Me anën e fijeve nervore bëhet bartja e impulsive nervore. Shih – ***AKSONET; DENDRITET.***

FIJEZAT MAKULARE. Pjesë e nervit pamor që gjenden në njollën e verdhë

(*macula lutea*). Fijezat makulare zgjaten nga njolla për të formuar pjesën qendrore të nervit pamor.

FIKSIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *fictio* "trillim, shtirje". Gjendje, proces psikik i brendshëm që konsiderohet se është realitet i qëndrueshëm. Si i tillë nuk ekziston në botën reale, por njeriu atë e përfytyron, e mendon, e supozon etj. Herë-herë fiksimi është i dobishëm në procesin e mendimit, sepse shndërrohet në mjet të zbulimit ose të gjetjes të së vërtetës. Por, kur njeriu nuk mund të vendosë kufi ndërmjet fiksimit dhe realitetit, sidomos kur fiksimi e pushton dhe ai nuk mund të ndahet prej tij, atëherë fiksimi është simptomë e çrregullimit të sjelljeve të njeriut.

FIKSIMI AFEKTIV. Lidhje e madhe, madje me përmasa të mëdha e një individi me një individ tjetër (me motrën, motra me vëllanë, me mësuesin, me fqinjin etj.). Kjo lidhje e nivelit të lartë emocional me tjetrin është më tepër karakteristike për fazat e hershme të zhvillimit psikoseksual të njeriut, për të cilat bën fjalë psikanaliza**.** Lidhje e tillë mund të jetë lidhja e fëmijës me babanë ose me nënën, përkatësisht lidhja e vajzës me të atin dhe lidhja e djalit me të ëmën, si dhe pasojat e mëvonshme në sjelljet e këtyre fëmijëve.

FIKSIMI ANAL. Lidhja e individit me objektet dhe zhvillimi i formave të sjelljes së tij, që karakterizojnë fazën anale të zhvillimit psikodinamik të njeriut, atë që i përket zhvillimit të kënaqësive me çlirim nga feçet, karakteristik për moshën dyvjeçare të zhvillimit të fëmijës. Shih – ***FAZA ANALE.***

FIKSIMI DREJTUES. Term i psikologjisë individuale të psikologut austriak Alfred Adler (1870 – 1937) që emërton konceptin e parimit mendor të njeriut normal, kur ai i ndan, i grupon, i klasifikon mendimet e përvojën e tij sipas asaj që atë e afron shumë me realitetin. Me këtë kuptim emërtohet grupi, kategoria e mendimeve, e përvojës që është më elastike në zgjidhjen e një situate problemore. Në literaturën psikologjike më shumë përdoret termi ide drejtuese.

FIKSIMI NEUROTIK. Në teorinë e personalitetit të Karen D. Hornei (Karen D. Horney, 1883 – 1952), fiksim kryesor i njeriut me fuqi nxitëse të madhe dhe të pandërprerë të aktivitetit për ta arritur e plotësuar qëllimin e lidhur drejtpërdrejt me këtë fiksim; një qëllim i tillë për individin neurotik është i parealizueshëm. Termi fiksim neurotik haset kryesisht në psikologjinë individuale të Alfred Adlerit.

FIKSIMI NË PSIKANALIZË. Në psikanalizë emërton ngecjen e njeriut në fazën e zhvillimit psikoseksual të caktuar, përkatësisht lidhjen e libidos së tij për njërën nga fazat e zhvillimit psikoseksual (faza orale, anale etj.) dhe lidhjen e kënaqjes së libidos me objektin e asaj faze dhe vështirësitë e mëdha të kalimit prej asaj faze në fazën e mëvonshme të zhvillimit psikoseksual. Interesi për objekt të asaj faze, frika për orientim në objekte të tjera dhe sjellja e mëvonshme psikoseksuale përcaktohet në masë të madhe nga energjia e shpenzuar në objektin e asaj faze ku ai ka mbetur. Një fiksim i tillë me njeriun ose me një objekt të caktuar shkakton pamundësinë e zhvillimit të lidhjeve

normale ndërmjet njerëzve dhe shfaqjen e disa formave neurotike në sjelljet e tyre. Sipas psikanalizës, njeriu nuk është plotësisht i vetëdijshëm për këtë.

FIKSIMI ORAL. Lidhja e sjelljeve karakteristike për fazën orale me objektet e tjera dhe përqendrimi i tyre në këto objekte.

FIKSIMI PARENTAL. Të parët e familjes janë fiksuar për dashuri, besnikëri dhe respekt të thellë për anëtarin e familjes së tyre. Sjellja kryesore e anëtarit të familjes me fiksim parental realizohet duke qenë e motivuar nga dashuria e madhe ndaj të parëve të familjes së tij.

FILANTROPI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *φιλάνθρωπος* "dashamir i njeriut, dashurues i njerëzve". Filantropia është kuptimi më i lartë i veprimtarisë së gjithëmbarshme të njeriut. Filantropia është qëndrim i zhvilluar mbi themelin e dashurisë dhe të përjashtimit të egoizmit. Filantropia shfaqet me sjellje mirëbërëse, me ndjenja pozitive dhe me veprime të qëndrueshme të kujdesit të njeriut ndaj të tjerëve, sidomos ndaj të atyre me kapacitete të kufizuara psikike dhe ndaj të varfërve. Filantropia përbën bazën e bashkëpunimit njerëzor ndërmjet njerëzve të moshave, gjinive, etnive dhe kulturave të ndryshme.

FILANTROPIZ/ËM, - MI. m. Pikëpamje dhe drejtim pedagogjik i zhvilluar në Gjermani në shekullin e tetëmbëdhjetë. Sipas kësaj pikëpamjeje njeriu ka natyrë njerëzore, që nënkupton dashuri e mirësjellje ndaj të tjerëve dhe në thelbin e vet psikologjik ka sinqeritet dhe optimizëm ndaj jetës dhe ndaj njerëzisë. Fëmija ka natyrë njerëzore dhe ai vjen në jetë me mirësi, por kushtet sociale, ekonomike dhe edukative e bëjnë atë njeri të papërshtatshëm dhe të dobët për mjedisin e tij. Kjo pikëpamje përforcon rolin e edukatës morale në rend të parë dhe dijenitë për të, që ai mund t`i zbatojë për të siguruar gjatë gjithë jetës një fat të mirë për të dhe për të tjerët. Themelues i kësaj pikëpamjeje ka qenë J. B. Bazedov. Dallohet jehona e kësaj pikëpamjeje në psikologjinë humaniste të Abraham Maslout (Abraham Maslow, 1909 – 1994), në psikoterapinë e Karl Roxhersit (Carl Rogers, 1902 – 1987) etj.

FILISTEIZ/ËM, - MI. m. Pikëpamje psikologjike që emërton ngarkesën e individit me vetëkënaqësi. Ndonëse objektivisht është i kufizuar, në pikëpamjen kognitive, kulturore e morale filistezimi e konsideron veten model, sipas të cilit të gjithë të tjerët duhet të sillen, të mendojnë dhe të përjetojnë të njëjtat gjendje emocionale. Vetëm qëndrimet e pastabilizuara dhe sjelljet me dy fytyra të tij kanë karakter të përgjithshëm dhe të përhershëm. Fan S. Noli (1882 – 1965) ka trajtuar gjendjen filistine të Shqiptarëve në anarkinë sociale, morale, fetare etj. të tyre. Për filisteizëm Noli flet në veprën "Izraelitë e filistinë", të botuar më 1907, ku egoizmi dhe individualizmi, si tipare të filisteizmit përshkruhen me gjallëri të rrallë.

FILOGJENETIK, - E. mb. Që i përket filogjenezës, që ka të bëjë me njohjen e procesit filogjenetik të qenieve të gjalla. Ka rëndësi të posaçme për njohjen e evolucionit të jetës psikike dhe të formave të saj, si edhe të faktorëve dhe të ndërlidhjeve të tyre, që

kanë ndikuar në zhvillimin filogjenetik të jetës psikike. Njohja e sjelljeve të njeriut bashkëkohor duhet të përfshijë edhe njohjen filogjenetike të njerëzisë, sepse vetëm njohja ontologjike është e pamjaftueshme.

FILOGJENEZË, - A. f. I ardhur nga greqishtja *φυλο* "gjini"; *γένεση* "lindje, origjinë". Procesi i gjatë i lindjes dhe i zhvillimit morfologjik dhe funksional të llojeve të qenieve të gjalla (të botës bimore e shtazore) duke përfshirë edhe gjininë njerëzore, që shtrihet prej formës së parë më të lashtë të paraqitjes së tyre deri në kohët më të reja. Psikologjia zhvillimore duke shfrytëzuar faktet dhe të dhënat e disa disiplinave të afërta (të anatomosë, të biologjisë dhe të fiziologjisë krahasuese) ka arritur të konstruktojë një sistem konceptesh dhe gjeneralizimesh teorike për zhvillimin e aftësive dhe të proceseve psikike të njeriut.

FILOZOFI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *φιλο* "mik" dhe *σωφία* "urtësi". Disiplinë universale që studion dhe afron pikëpamje të përgjithshme për gjithësinë, për jetën dhe për njeriun, për zhvillimin e mendimit njerëzor dhe gjurmët e këtij mendimi në zbulimin e të së vërtetës, për origjinën e gjithë asaj që ekziston, për natyrën njerëzore, për njohjen e të vërtetës dhe mundësitë e ardhjes deri në të vërtetën objektive. Degë studimore të filozofisë janë: *estetika*: njohja e natyrës dhe e tipareve e cilësive të së bukurës; *etika*: studion çështjet e moralit; *logjika*: studion mendimin dhe formate të zhvillimit të tij për të zbuluar të vërtetën etj. Psikologjia deri nga mbarimi i shekullit të nëntëmbëdhjetë ka qenë disiplinë e filozofisë. Filozofia ka ndikuar në zhvillimin e psikologjisë empirike në disa drejtime: me rregullsitë e me parimet e shpjegimit të disa proceseve psikike, me trajtimin antropologjik, me anë të mënyrave të mendimit për jetën psikike, për dukuritë psikike dhe për sjelljet e njeriut etj. Posaçërisht është i ndjeshëm ndikimi i pikëpamjeve të fenomenologjisë, të filozofisë antropologjike, të filozofisë ekzistencialiste etj. Por, edhe degët e ndryshme të filozofisë shfrytëzojnë rezultatet e duhura të psikologjisë empirike (estetika, etika, logjika, antropologjia humaniste etj.).

FILOZOFIK, - E. mb. Që ka të bëjë me filozofi etj. Në psikologji hasim disa terma të koncepteve të filozofisë. Ndër to më të përgjithshmet janë: ***PSIKOLOGJIA FILOZOFIKE*; *PSIKOTERAPIA FILOZOFIKE*** – shih.

FILT/ËR, - RI. m. Term i fizikës. Në psikologji emërton instrumentin e veçantë, sipas të cilit ngacmuesi fizik duke kaluar nëpër filtër lëshon vetëm atë pjesë të tij, kurse të tjerët i refuzon. Filteri zakonisht përdoret në laboratorin psikologjik për të hulumtuar ndijimin e valëve elektromagnetike me gjatësi dhe shpeshtësi të ndryshme, ndijimin akustik të valëve ajrore etj.

FINALIZIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *finis* "fundi, qëllimi". Pikëpamje e përgjithshme, sipas së cilës të gjitha dukuritë e çfarëdo që ngjet në gjithësi bëhet për një qëllim, pikërisht sipas një qëllimi të caktuar. Finalizimi i atribuohet psikologjisë gjenetike të Zhan Pijazhesë (Jean Piaget, 1896 – 1980), psikologjisë hormike të Uliam Mekdugalit (William Mcdougall, 1871

– 1938) dhe psikologjisë së qëllimshme të Eduard K. Tolmanit (Edward Ch. Tolman, 1886 – 1959). Finalizimi për Pjer Zhanen (Pierre Janet, 1859 – 1947) është fazë parakauzale e zhvillimit të mendimit te fëmijët, kur fëmijët e shpjegojnë një dukuri në bazë të përfundimit të saj, përfundim ky, i cili është shkak i asaj dukurie. Ndërkaq, U. Mekdugali dhe E. Tolman e kanë përdorur këtë term për të emërtuar në psikologjinë e secilit atë fuqi që e vë në lëvizje, që është shkak i aktivitetit të organizmit dhe njëkohësisht ka veti ta kontrollojë aktivitetin e tij.

FIS, - I. m. Term i etnologjisë dhe i sociologjisë që me kuptimin e ngushtë dhe të gjerë të tij prek edhe lëndën e psikologjisë, sidomos atë të etnopsikologjisë. Fisi është bashkësi me prejardhje të përbashkët e anëtarëve të saj nga i pari i fisit, nga ati i tyre. Fisin e përbënin anëtarët me prejardhje të përbashkët, që kishin disa veçori të përbashkëta, ndër të cilat dallohen: bashkësia e fisit përbëhej prej anëtarëve me përkatësi vendore, etnike e fetare të ndryshme, me lidhje të forta shpirtërore ndërmjet pjesëtarëve të një fisi të caktuar, me ndjenjë të dalluar të solidaritetit, me tipare nderi e karakteri të veçantë, me ndalesë martese ndërmjet anëtarëve të fisit të njëjtë, bashkësi e formuar në territor të përbashkët dhe formë e rregullimit shoqëror në fazat e hershme të zhvillimit të shoqërisë njerëzore. Gjurmët e kësaj forme të vjetër të organizimit të shoqërisë i hasim edhe ndër Shqiptarët. Disa prej tyre janë fise të njohura. Fiset kishin identitet të emërtuar saktësisht, si fisi Bytyçi, Hoti, Kuqi, Shkreli, Thaçi etj.

FISNIKËRI, - A. f. Ndjenjë e ndërlikuar e njeriut ndaj të tjerëve, ku shprehet bujaria, durimi, respektimi i dinjitetit, zemërgjerësia etj. gjatë kontakteve të shumëllojshme të një individi me një individ tjetër ose me të tjerët. Fisnikëria merr tipare të personalitetit kur sjellja e fisnikëruar bëhet e qëndrueshme dhe shprehet përherë në situata të ndryshme të kontakteve ndërmjet njerëzve.

FISURË, - A. f. I ardhur nga latinishtja *fissure* "hulli". Fisura i përket terminologjisë së anatomisë së sistemit nervor. Fisura emërton "çarjen" e thellë, "hullinë në formë të "pykës" përbrenda një organi, zakonisht përbrenda trurit. Me këtë term zakonisht emërohet hullia trunore e Rolandit dhe hullia trunore e Selvisë. Shih – ***HULLITË E KORES SË TRURIT.***

FIZIKALIZ/ËM, - MI. m. Term i psikofizikës që emërton konceptin e mendimit psikologjik në bazë të termave të fizikës, si edhe zbatimin e metodave të fizikës në hulumtimet psikologjike. Termi fizikalizëm i përket më tepër terminologjisë klasike të psikologjisë.

FIZIKË, - A. f. Disiplinë e shkencave të natyrës që merret me studimin e materies, të proceseve, të masës dhe të energjisë së materies, duke përfshirë lëvizjet lëndore dhe rrezatuese të saj prej grimcave më të vogla deri te ato të një shkalle më të përgjithshme. Në terminologjinë e psikologjisë ky term përmendet kryesisht për të shpjeguar raportet ndërmjet dukurive e proceseve fizike dhe atyre psikike. Në këtë kuadër është zhvilluar edhe fusha e psikofizikës. Shih – ***PSIKOFIZIKA.***

FIZIOLOGJI, - A. f. I ardhur nga greqishtja. Një ndër disiplinat e biologjisë, e cila merret me studimin e proceseve dhe të funksioneve të organizmit në përgjithësi, si edhe të organeve dhe të strukturave të tyre duke filluar nga funksioni i qelizës, i indeve, i organeve dhe i sistemit të ndërlidhjeve të organizmave në tërësi. Objekt i studimit të fiziologjisë së njeriut është studimi i funksionit të organeve të trupit të njeriut dhe të proceseve që kryhen në organizmin e tij. Fiziologjia e njeriut ka rëndësi të posaçme për psikologjinë, sepse në bazë të saj shpjegohet baza biologjike e sjelljeve të organizmit dhe e proceseve psikike. Nga fiziologjia e organizmit të njeriut për shpjegimin e dukurive psikike, të proceseve dhe të sjelljeve të njeriut dallohet rëndësia e fiziologjisë së shqisave, e sistemit nervor dhe e gjëndrave me sekretim të brendshëm. Fiziologjia patologjike me rezultatet e arritura në hulumtimin e mekanizmave të lindjes dhe të zhvillimit të proceseve patologjike ka ndihmuar njohjen më të plotë të disa proceseve kognitive, emotive dhe konotative.

FIZIOLOGJIK,- E. mb. Që lidhet me fiziologjinë, që i përket fiziologjisë.

FIZIONOMI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *φυσιο* "natyrë"; *γνωμία* "njohës". Përpjekje e dështuar e përcaktimit të tipareve psikike të një individi (të aftësive, të qëndrimeve, të gjendjes emocionale etj.), në bazë të tipareve të jashtme të fytyrës (balli mendor, syri besnik etj.). Fizionomia e debilëve, sidomos e idiotëve (rrudhat e fytyrës, ndryshimet e lëvizjes së muskujve të fytyrës etj.) përputhet pak a shumë me shkallën e ulët të zhvillimit mendor të tyre.

FIZIONOMIK, - E. mb. Që ka të bëjë me fizionominë ose i përket fizionomisë. Ky mbiemër haset kryesisht në formën e fjalëformimit të kompozitës, si: perceptimi fizionomik**,** që ka të bëjë me perceptimin e ndjeshmërisë emocionale të njeriut. Termi *perceptimi fizionomik* haset kryesisht në psikologjinë geshtaltiste. Sipas psikologëve geshtaltistë Maks Vertaimer, Kurt Kofka, Volfgang Këler (Wolfgang Köhler, 1887– 1967**)**, por edhe sipas Kurt Levinit melodia e caktuar nuk përjetohet nga njeriu vetëm si varg tonesh muzikore, por si tërësi e organizuar perceptive që ka përmbajtje emocionale, e cila i jep kuptim perceptimit të toneve muzikore të një kompozimi.

FJALË, - A. f. Njësia më e vogël gjuhësore, e cila ka një kuptim të caktuar. Fjala është simbol emërtues për një objekt, dukuri, proces, mendim, qëndrim, raport etj. Fjalët sipas formës gramatikore e sintaksore të tyre ndahen në emra, përemra, mbiemra, folje etj. Fjala është përbërësja e strukturës së një fjalie. Fjala duke qenë mbajtëse e një kuptimi të caktuar ka dy përmasa themelore: përmasë denotative që emërton një kuptim të përcaktuar saktësisht, të cilën e përbëjnë të gjitha objektet ose dukuritë që i takojnë përmbajtjes së saj; njësi të tilla janë kryesisht termat e disiplinave shkencore. Përmasa konotative që emërton një kuptim shtesë dhe një kuptim bashkëngjitës me të. Në përdorimin e fjalëve gjatë të folurit dallohet kuptimi i tyre në kontekstin e mendimit që shtjellohet dhe lidhja e ngushtë ndërmjet mendimit dhe të folurit. Fjala në kuptimin psikologjik kryen disa funksione, si:

a. **Funksioni atributiv i fjalës** – Të kuptuarit e fjalës si pjesë e pandarë e objektit, të cilin ajo emërton. Funksioni atributiv i fjalës është karakteristikë e të folurit të fëmijëve në moshën e fëmijërisë së hershme;

b. **Funksioni objektiv i fjalës** – Të kuptuarit e fjalës si objekt e jo si shenjë emërtuese e një objekti të caktuar. Një dukuri e tillë është e lidhur kryesisht me të ashtuquajturën fjalë "magjike";

c. **Funksioni shënjues i fjalës** – Fjala e thënë çon në reagim të caktuar të njeriut ndaj objektit emërtues të saj. Fjala mund të emërtojë një objekt, një dukuri, proces etj., por pavarësisht çfarë ajo emërton shpesh paraqitja e saj lidhet me një reagim të caktuar të njeriut ndaj atij objekti, dukurie, procesi etj.

FJALË TË URTA. Përgjithësim i mendimit për përvojën e sintetizuar në formën e parimit, ligjit të sjelljeve morale me vlerë të qëndrueshme. Fushat më të njohura të nxjerrjes së fjalëve të urta janë: familja, mençuria, morali, marrëdhëniet shoqërore etj. Fjalët e urta shprehen me fjalë e me fjali të qarta dhe koncize. Fjalët e urta kanë përmasë historike. Popujt e ndryshëm kanë edhe këtë formë të krijimtarisë popullore. Shqiptarët kanë krijuar një fond të madh fjalësh të urta, të tilla si: "Ari në zjarr provohet, miku në rrezik kuptohet", "Shtriji këmbët sa ke jorganin", "I ngopuri nuk ia di të uriturit" etj.

FJALORI RECEPTIV. Fjalor me shtrirje të gjerë fjalësh e termash, të cilave u dihet kuptimi nga ana e atij që i merr nga të tjerët.

FLEGMATIK, - E. mb. I ardhur nga greqishtja *φλέγμα* "jargë". Termi i përket njërit nga katër tipat e temperamentit të njeriut. Tipi i temperamentit flegmatik ka këto karakteristika: I ngadalshëm dhe i lehtë ndaj ngacmuesve të jashtëm, madje shpesh edhe indiferent ndaj tyre; ndryshon qetësisht gjendjen emocionale dhe është i ngadalshëm në shfaqjen e ndryshimeve emocionale; ka një maturi të caktuar në shfaqjen e qëndrimeve, të sjelljeve dhe në vlerësimin e tyre; është gjakftohtë dhe ngacmohet me vështirësi etj. Tipin e temperamentit flegmatik e ka përshkruar Hipokrati e Gali. Sipas Hipokratit këtë tip të temperamentit e shkakton sasia e madhe e jargëve të organizmit të njeriut.

FLEKSIBILITETI, - I. m. I ardhur nga latinishtja *flektere* "i lakueshëm". Fleksibiliteti ka kuptim të përgjithshëm në të folurit e përditshëm, ku përdoret më tepër në kuptimin e përshtatjes. Në psikologji fleksibiliteti emërton dukurinë e perceptimit kognitiv, kur njeriu në fondin e përmbajtjes së procesit të të menduarit fut gatishmërinë e pritjes emocionale që i kontribuon zgjidhjes së situatës problemore, duke mundësuar gjetjen e zgjidhjes së shpejtë e origjinale të një situate të caktuar emocionale. Termi fleksibilitet në psikologjinë sociale është më i pranueshëm. Ky term emërton dukurinë e përshtatjes së rolit individual të një individi në grupin shoqëror, si edhe ndryshimin e një shprehie, madje (më rrallë) edhe të një qëndrimi të caktuar.

FLEKSOR, - I. m. Në anatomi i ardhur nga latinishtja *flexor* "mbledhës" që emërton muskujt që mbështjellin ashtin e gjymtyrëve, të cilët gjatë veprimtarisë së tyre tkurren. Fleksori është në lidhje të ngushtë me

funksionin e muskujve të kundërt - muskuj ekstensorë. Muskujt fleksorë dhe ata ekstensorë mblidhen e shtrihen duke krijuar në këtë mënyrë një marrëdhënie antagoniste ndërmjet tyre.

FLETANKETË, - A. f. Mjet anketimi në trajtën e një letre me pyetje, të hartuara sipas kërkesave hulumtuese të një çështjeje të caktuar. Zbatohet me qëllim të mbledhjes së të dhënave për hulumtim të një çështjeje, në rend të parë të një çështjeje shoqërore. Pyetjet e parashtruara sipas qëllimit të hulumtuesit zakonisht janë pyetje konkrete, të qarta, të njëkuptimshme dhe të shkurtra, të hartuara sipas drejtshkrimit të gjuhës shqipe. Përgjigjet në këto pyetje jepen në formë të lirë, ose në formë përzgjedhëse për një, ndër tri a pesë përgjigje të parashtruara pranë pyetjes së caktuar. Përgjigjet jepen me shkrim ose nënvizohet përgjigja e saktë nga ana e çdo subjekti të përzgjedhur ose të rastësishëm për hulumtim. Zbatohet më tepër në psikologjinë sociale, ku gjurmohen qëndrimet, bindjet, vlerat shoqërore etj. të një grupi a shtrese përfaqësuese të popullsisë së një vendi. Fletanketa për hulumtimin e mendimeve, të qëndrimeve, të bindjeve, të vlerave shoqërore etj. ka formën e fletanketës së standardizuar. Kjo teknikë hulumtuese ka kryesisht karakter anonim.

FLETËPYETËSI MINESOTO I INTERESAVE. Fletëpyetës që regjistron interesat e të rinjve për profesione të caktuara. Ky fletëpyetës përbëhet nga 158 pyetje me tri përgjigje dhe subjekti duhet të përzgjedhë atë që i përgjigjet atij më mirë.

FLETËPYETËSI STRONG I INTERESIMEVE PROFESIONALE. Forma e parë e fletëpyetësit për njohjen dhe identifikimin e interesimeve profesionale të nxënësve, të studentëve dhe të të rriturve. U botua dhe u përdor për herë të parë më 1927 për të rinjtë dhe më 1938 për femrat. Më pas u ripunua dhe u quajt Inventari Strong i interesimeve, sipas emrit të hartuesit, psikologut amerikan Eduard K. Strong (Edward K. Strong, 1884 – 1963. Ky inventar ka 317 detyra me përgjigjen po/jo për fusha të ndryshme pune. Detyra e subjektit është të shënojë pohimin ose mohimin e secilës detyrë dhe në bazë të përpunimit të përgjigjeve dhe normave përcaktohet interesimi i të rinjve dhe të rejave për 1 – 3 profesione. Më 1974 u ripunua përsëri nga ana e psikologëve amerikanë në Universitetin e Standfordit nga Eduard K. Strong dhe Donald Kempbëll (Donald Campbell, 1916 – 1996).

FLETËVËZHGIM, - I. m. Fletë letre me sistem të përcaktuar saktësisht për mbajtjen e shënimeve për të dhënat e vëzhguara sistematikisht lidhur me një çështje hulumtuese të caktuar. Fletëvëzhgimi ka karakter të njësuar. Të dhënat shënohen drejtpërdrejt gjatë vëzhgimit të tyre, por duke mos ia tërhequr vëmendjen subjektit që hulumtohet. Fletëvëzhgimi konceptohet dhe formësohet sipas planit të vëzhgimit dhe në të shënohen vetëm të dhënat që kanë të bëjnë me çështjen vëzhguese.

FLUENTITET, - I. m. I ardhur nga anglishtja *fluency* "*rrjedhshëm*". Term i pangulitur në gjuhën shqipe, por

shpesh përmendet në psikologjinë e aftësive. Me këtë term emërtohet faktori mendor parësor i njeriut me fond të pasur fjalësh, me aftësi të posaçme të gjetjes së lehtë e të shpejtë të fjalës përkatëse e të riprodhimit të saj, si edhe me aftësi të të folurit të rregullt dhe të rrjedhshëm.

FLUKTUACION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *fluctuation* "valëzim". Kuptimi i përgjithshëm i tij është oscilim (oscilim i vëmendjes, oscilim i fuqisë punëtore, oscilim i gjendjes emocionale etj.). Në psikologji termi fluktuacion haset më shumë në përshkrimin dhe shpjegimin e vëmendjes, të ndryshimit të vendit të punës etj. Vëmendja e ndryshon intensitetin e përqendrimit të saj në një objekt, dukuri, përmbajtje etj., duke mos ndryshuar objekti, dukuria e përmbajtja as në cilësi dhe as në shtrirjen e tyre. Pas disa sekondash vëmendja e përqendruar dobësohet, madje edhe mund të humbasë plotësisht nga objekti i saj. Në psikologjinë e punës po ashtu haset termi fluktuacion i punëtorëve që ka të bëjë me ndryshim të vendit të punës së një ose disa punëtorëve (puna monotone, paga e vogël, kushtet e rënda të punës etj.) Disa faktorë psikikë e fiziologjikë mund të shkaktojnë fluktuacionin e vëmendjes (dobësimi i interesit për dukurinë e caktuar, gjendja afektive e njeriut, lodhja e tepërt e tij etj). Shih – ***VËMENDJA.***

FOBI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *φόβομαι* "frikësohem". Term i qëndrueshëm në disa disiplina të psikologjisë (psikologjia klinike, psikologjia shëndetësore, psikopatologjia etj.), por edhe në psikiatri. Në këto disiplina fobia emërton frikën irracionale, të paarsyeshme të një individi nga situatat dhe nga objektet e caktuara, të cilat, në të kundërt ushtrojnë ndikim normal te njeriu, sepse nuk janë të rrezikshme. Fobitë e tilla zakonisht janë të lidhura me një objekt, dukuri, proces etj. të caktuar (frika e paarsyeshme ndaj detit, errësirës, lartësisë së madhe, maces etj.). Fobitë karakterizohen jo vetëm me frikë ndaj gjendjes, objektit, situatës etj., por edhe me sjellje karakteristike të njeriut ndaj gjendjes, objektit, situatës që shkakton këtë lloj frike; njeriu që ka fobi ndaj tyre zakonisht përdor sjellje larguese prej atyre gjendjeve, objekteve, situatave që i shkaktojnë frikë të tillë. Megjithëkëtë, kur fobitë janë të intensitetit të ulët ato nuk shkaktojnë dëm për shëndetin, në jetën dhe në veprimtarinë profesionale të njeriut, por kur këto kanë intensitet të lartë, sidomos kur janë të qëndrueshme, atëherë fobitë e tilla janë të dëmshme dhe kanë përmasa patologjike. Ekziston një numër i madh fobish të përcaktuara saktësisht nga bashkëpunimi i psikiatërve me psikologë klinikë. Pohohet se janë të regjistruara rreth 200 lloje fobish, si fobia ndaj baktereve, bletëve, dritës, flokëve, grave, gjakut, kafshëve, lokaleve të mëdha, lumenjve, insekteve, minjve, peshqve, sëmundjeve, zjarrit etj. Por, me kalimin e kohës edhe fobitë ndryshojnë. Sot janë të shpeshta fobitë ndaj sifilizit, ndaj ambientit të ndotur, ndaj substancave të reja kimike etj. Psikiatri Maser ka hartuar një regjistër me rreth 200 lloj fobish. Ndër më të shpeshtat janë: **aerofobia** – frika e paarsyeshme, e qëndrueshme dhe me intensitet të lartë nga rreziku i paqenë i frymës së madhe**; demofobia** – frika me përmasat e përmendura

nga masa e madhe e njerëzve; **fleksofobia** – frika e fobisë ndaj ndryshimeve; **hemofobia** – frika e karakterit të fobisë nga gjaku e rrjedhja e tij; **klaustrofobia** – frika me përmasa të frikës së fobisë nga mjediset e mbyllura; **pirofobia** – frika e karakterit të fobisë nga zjarri; **toksikofobia** – frika e fobisë nga helmet, acidet helmuese etj. Nga grupfobitë më të njohura përmenden:

a. **Fobitë nga insektet** – Frikë e paarsyeshme, intensive dhe e qëndrueshme e njeriut ndaj insekteve (fluturave, grerëzave, mizave etj.);
b. **Fobitë nga gjaku, injeksionet dhe lëndimet** – Grup fobish të ndërlidhura që shfaqen me frikë gati në nivel të panikut nga të parit e rrjedhjes së gjakut, nga lëndimet dhe nga injeksionet;
c. **Fobitë nga kafshët** – Frikë me intensitet të lartë, e paarsyeshme dhe gati e përhershme e njeriut nga ballafaqimi me kafshë të ndryshme (macja, zogu, qeni etj.). Kjo lloj fobie është e njohur edhe me termin zoofobia;
d. **Fobitë ndaj sëmundjeve** – Frikë jologjike, me intensitet të lartë dhe me tipare të qëndrueshme te disa njerëz me frikë të madhe nga sëmundja e kancerit, e tuberkulozit, e zemrës etj.
e. **Fobitë nga shtatzënia** – Frika e madhe, intensive dhe gjithsesi e paarsyeshme nga të ngelurit shtatzënë. Shfaqet nga mospasja e dëshirës për të pasur pasardhës, nga shkalla e ulët e pranimit të identitetit seksual femëror, nga steriliteti etj.;
f. **Fobitë nga dukuritë natyrore** – Frika e madhe e paarsyeshme dhe e dëmshme e njeriut që nuk arrin t`i përshtatet bubullimës, frymës së madhe, vetëtimës etj.

FOBIA DHE PSIKANALIZA. Shpjegim i fobive dhe i reagimeve të njeriut që vuan nga frika e paarsyeshme, e qëndrueshme dhe me intensitet relativisht të lartë nga ana e psikanalistëve. Sipas tyre fobia është shfaqje e jashtme e shtytësit që e shkakton këtë fobi e që gjendet në pavetëdijen e njeriut, por që ka energji vepruese. Ky shtytës mund të jetë shtytësi seksual, shtytësi i jetës, i vdekjes etj., i shtypur ose i ndrydhur ose i zhvendosur dhe, si i tillë, është shkaktar i frikës së karakterit të fobisë. Fobia është shenjë e egos së njeriut për rrezikun që vjen nga idi. Nëse njeriu nuk është në gjendje që me vetëdije të ballafaqohet me një rrezik të tillë, atëherë ego këtë rrezik të brendshëm e shfaq ndaj objekteve, dukurive e situatave të jashtme. Zigmund Frojdi lidhur me fobitë ka folur gjerësisht për agorafobitë – fobitë nga hapësirat e mëdha.

FOKUS, - I. m. Term i hyrë në terminologjinë e psikologjisë nga anglishtja. Fokusi është qendër e konvergimit të rrezeve të dritës që kalojnë nëpër thjerrëzën e syrit; objekti ku është përqendruar vëmendja dhe mendimi i njeriut të caktuar. Në fokus të vëmendjes mund të jetë p.sh., zbërthimi i kuptimit të një termi me prejardhje nga gjuha e huaj. Pikërisht në këtë zbërthim është orientuar dhe është përqendruar vëmendja e njeriut dhe ky zbërthim është "objekt i gjallë", kurse të tjerët përreth tij janë në hije, nuk kanë gjallëri.

FOLI A DË (**FOLIE Á DEUX**). I ardhur në shqip nga frëngjishtja dhe ka kuptimin e çmendurisë së dy individëve. Dukuri psikopatologjike, e cila ka të bëjë me rastet e dy individëve të afërt (bashkëshorte e bashkëshort,

mësues e nxënës i tij, motër e vëlla etj.) që fillojnë të shfaqin sjellje jonormale të njëjta ose të ngjashme. Kjo dukuri e të prekurit të të dy të afërmve nga e njëjta sjellje psikopatologjike ndodh në formë suksesive (njëri pas tjetrit), d.m.th., kur njëri prej tyre sëmuret, pas një kohe e njëjta sëmundje psikike prek edhe tjetrin shumë të afërt me të. Sëmundja psikike mund të jetë e ndryshme: shfaqet çrregullim i ideve, ide sumanute, sjellje psiko-seksuale jonormale, vuajtje nga fobia e caktuar etj. dhe këto çrregullime psikike pothuajse i ndajnë burrë e grua, mësuese e nxënëse, motër e vëlla etj. dhe kjo ndodh jo në të njëjtën kohë, por, pas një kohe të shfaqjes së çrregullimit te njëri fillon të shfaqet edhe te tjetri i njëjti çrregullim psikik ose shumë i ngjashëm me të. Psikologjia klinike dhe psikiatria këtë e shpjegon në bazë të induktimit të sjelljeve të çrregulluara të një individi me tjetrin dhe të ndikimit që ka njëri individ te tjetri.

FOLUR, - IT (TË) as**.** Të folurit është kumtim i informacioneve me anë të fjalëve të renditura sipas rregullave gramatikore të gjuhës së caktuar. Në raport me gjuhën të folurit është formë e realizimit të saj.

FOLURIT E AUTOMATIZUAR (TË). E folur e zhveshur pak a shumë nga kontrolli i vetëdijshëm, duke mos menduar mbi përmbajtjen e asaj çka flet. Të folurit e zhveshur nga kontrolli i vetëdijes shfaqet te disa psikoza dhe te ata individë me moshë shumë të thyer, por herë-herë edhe te të rriturit në gjendje emocionale të tensionuar**.**

FOLURIT EGOCENTRIK (TË). Sipas teorisë së Zhan Pijazhe (Jean Piaget, 1806 – 1980) të folurit, si edhe mendimi i fëmijëve deri rreth moshës tre vjeç ka karakter egocentrik. Karakteristika themelore e të folurit egocentrik të fëmijës së moshës tre vjeç është se të folurit e tij është i drejtuar kah vetja e fëmijës. Të folurit e kësaj moshe përbëhet nga fjali të shkurtra, të parregullta nga pikëpamja gramatikore e me karakteristika të përgjithshme. Të folurit egocentrik pas moshës tri- dhe katërvjeçare fillon të eliminohet dhe, sipas Zhan Pijazhes, rreth moshës shtatë vjeç ky lloj i të folurit zhduket. Lav Vigotski ((Lav S. Vygotsky, 1896 – 1934) në bazë të rezultateve nga hulumtimet e tij, e mohon karakterin egocentrik të të folurit të fëmijës, sidomos përgjithësimin egocentrik të sjelljeve të tij.

FON. asnj. Njësi përcaktuese e ndjeshmërisë së intensitetit të ngacmuesve tingullorë nga ana e një individi të caktuar. Ky intensitet matet me anën e dridhjeve të valëve ajrore dhe të shpeshtësisë së tyre. Intensiteti i përjetuar i tingullit nga ana e një subjekti përcaktohet duke e krahasuar me intensitetin e ndonjë ngacmuesi tingullor prej 1000 Hz që shprehet në decibel. Rezultatet e hulumtimeve laboratorike kanë treguar se shkalla më e lartë e ndjeshmërisë së tingujve është ajo e intensitetit ndërmjet 2000–4000 Hz (kjo është shpeshtësia e valëve ajrore të zërit të njeriut). Gjatë komunikimit me të tjerët të folurit e individit me intensitet të ulët deri te të folurit me vikamë sillet prej 20 – 80 fon. Ndërkaq, burimet tingullore prej 90 fon kanë intensitet shumë të lartë, kurse ata mbi 130 fon shkaktojnë dëmtim të organit ndijimor të zërit, përkatësisht dëmtim të veshit të njeriut.

FONACION, - I. m. Në kuptimin e përgjithshëm nënkupton prodhimin e tingujve nga një burim zëri i caktuar. Në kuptimin e veçantë ka të bëjë me prodhimin e zërit të njeriut nga dridhja e fijezave të zërit të fytit, e shtyrë nga frymëmarrja dhe nga ritmi i ndryshuar i saj që kalon nëpër grupin e këtyre fijezave.

FONEMË, - A. f. I ardhur nga greqishtja *φωνίμα* "zë, tingull". Fonema është njësia më e vogël zanore e një gjuhe, e cila vetvetiu zakonisht nuk ka kuptim të caktuar. Gjuhët e ndryshme kanë sasi të ndryshme fonemash dhe, kryesisht ky numër sillet prej 7 – 10 deri në 80. Gjuha shqipe ka 36 fonema, nga të cilat 7 janë zanore (a, e, ë, i, o, u, dhe y), kurse 29 të tjerat janë bashkëtingëllore. Secila fonemë ka një shenjë grafike të vetën. Në shqipe disa prej fonemave janë dyshkronjëshe (dh, gj, ll, nj, rr, sh, th, xh dhe zh), kurse shkronja ç dhe ë dallohen nga të tjerat me shenjat diakritike të tyre. Këto shkronja kanë perceptueshmëri të ndryshme të shkallëve dhe shkalla e perceptueshmërisë së alfabetit të gjuhës shqipe është e një niveli pak mbi mesataren.

FONOFOBI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *φωνή* "zëri", *φόβος* "frikë". Frikë e paarsyeshme dhe fare e parrezikshme për cilindo, por ka njerëz që frikësohen edhe nga zëri i lartë i lokomotivës, i hingëllimit të kalit, i tufanit, por edhe nga zëri i ngritur lart nga ana e ligjëruesit, mikut, shokut etj. Shih – ***FOBIA***.

FONOPATI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *φωνή* "zë, tingull" dhe *πάτος* "sëmundje". Fonopatia është çrregullim i shqiptimit të drejtë të secilës fonemë të një gjuhe të caktuar. Në shqipe mund të shkojë deri në nivel të çrregullimit të shqiptimit të drejtë të fonemës q dhe ç, e dhe ë, gj dhe xh, r dh err etj., dhe fjalët e shqiptuara me çrregullim të shqiptimit të tyre marrin formë shqiptuese të parregullt dhe perceptohen gabimisht, sidomos nga ai që fjalët i shqipton gabimisht, pasi këtë gjuhë që flet nuk e ka gjuhë amtare.

FORENZIK, - E. mb. Që i përket shkencave forenzike, që ka të bëjë me disiplinën juridike, e cila merret me studimin e delikuencës dhe të formave të ndryshme të krimeve.

FORMË, - A. f. Tërësia integrale dhe struktura e tërësishme e objektit ose e figurës së tij, që ka kufizimet e veta dhe në bazë të kufizimeve objekti dhe figura ndahet nga të gjithë të tjerët. Forma është tipari i jashtëm përcaktues i një objekti të caktuar dhe i figurës së këtij objekti. Forma ka kuptim të posaçëm psikologjik: ajo është strukturë e tërësishme e kufizuar dhe tërësia e objektit, e figurës dhe e përmbajtjes së një përshkrimi të kufizuar është më e rëndësishme se elementet me të cilët është formuar ajo tërësi.

FORMA E MIRË. Në psikologjinë geshtaltiste emërton njërin nga parimet a ligjet e organizimit të tërësisë së perceptimeve. Sipas këtij parimi ngacmuesit që kanë formë të mirë, që janë organizuar simetrikisht etj. perceptohen si tërësi e veçantë, më lehtë dhe më shpejt se sa ngacmuesit që nuk kanë formë të mirë dhe organizim simetrik.

FORMA NË PSIKOLOGJINË GESHTALTISTE. Koncept themelor i drejtimit të psikologjisë

geshtaltiste. Sipas këtij drejtimi forma është atribut relativisht i pavarur nga elementet përbërëse të saj. Një element ose disa elementë të saj mund të ndryshojnë ose mund të ndryshojë raporti ndërmjet dy ose disa elementeve të një tërësie, por forma e asaj tërësie dhe perceptimi i saj mbetet i pandryshueshëm. Portreti i Skënderbeut mund të paraqitet bardhë e zi ose me ngjyrë të kuqe e ngjyrë argjendi, por perceptimi i formës nuk ndryshon, kompozimi i "Bareshës"mund të interpretohet nga një soprano ose bariton, por tërësia e kompozimit mbetet e njëjtë. Për psikologjinë e perceptimit dhe për komentimin e figurave të Rorshahut (Hermann Rorschach, 1884 – 1922) forma ka rëndësi të posaçme.

FORMACIONI RETIKULAR. Në anatominë e sistemit nervor i ardhur nga latinishtja *formation reticulus* "formim rrjetësor". Formacioni retikular është rrjetëza nervore që përbëhet nga grumbuj bërthamash (rreth 90) dhe nga pjesët e tyre (neuritet dhe dendritet e formave të ndryshme), që shtrihen përgjatë trungut nervor (prej pjesës vazhduese të palcës së kurrizit deri në pjesën e sipërme të trurit të mesëm) dhe lidhet me cipën e trurit të madh, me hipotalamusin, me talamusin, me palcën kurrizore etj. Ky formacion është i lidhur me të gjitha pjesët e sistemit nervor. Rezultatet më të reja hulumtuese kanë treguar se formacioni retikular përbëhet nga tri shtresa nervore kryesore: 1) Përbërja nervore aktivuese; 2) Përbërja nervore retikobulbare dhe retikospinale dhe 3) Përbërja prej lidhjeve bërthamore të quajtura "rafe bërthama". Kjo strukturë me funksion të përbashkët nervor kryen këto funksione të posaçme: Përbërja nervore aktivuese është rregullatore e shtrirjes së sjelljeve, e veprimtarisë së përbashkët të organizmit (sidomos gjatë kohës kur organizmi rri zgjuar, si edhe gjatë gjumit); Përbërja nervore retikobulbare e retinospinale është rregulluese e lëvizjeve të organizmit dhe e pjesëve të tij dhe ajo e rafe bërthamave besohet se ndikon në rregullimin e sasisë së impulsive nervore në trurin e njeriut dhe, në këtë mënyrë kjo, ndikon në procesin e ndjeshmërisë. Funksioni i përbashkët i pjesëve të formacionit retikular luan rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e të gjitha proceseve psikike dhe të sjelljeve, sidomos në procesin e vëmendjes, të lëvizjeve të organizmit, në zgjimin e funksioneve të strukturave nervore dhe në zhvillimin e lëvizjeve refleksive. Me rastin e lëndimit të strukturës aktivuese të formacionit nervor njeriu bie në gjumë të thellë me kohëzgjatje të paparaparë (koma është pasojë e dëmtimit të kësaj strukture dhe e funksionimit të saj).

FORMALIZ/ËM, - MI. m. Mbisundim i formës dhe zhvillim i parimeve formale ndaj përmbajtjes së asaj që mësohet nga ana e nxënësit, studentit dhe e cilitdo tjetër. Kjo qasje e procesit të të mësuarit i jep rëndësi dhe thekson anën formale të asaj që mësohet, d.m.th. të mësuarit e formave të organizimit të asaj që mësohet, të mënyrës ose mënyrave të organizimit të të dhënave, klasifikimin e tyre dhe zbatimin konsekuent të parimeve, rregullave dhe ligjeve në të mësuarit e përmbajtjeve të reja dhe në zbatimin e asaj që mësohet në jetën dhe në veprimtarinë e përditshme.

FORMAT E SHPJEGIMIT. Shpjegimi i dukurive, proceseve psikike dhe i sjelljeve mbështet në dy forma themelore: 1) në përshkrimin e të dhënave, të fakteve të zbërthyera dhe të raporteve ndërmjet faktorëve që kanë ndikuar në zhvillimin e dukurive psikike dhe 2) në përshkrimin e kushteve të paraqitjes së tyre në situatën konkrete. Për këtë përqasja shkakore dhe ajo gjenetike përbëjnë thelbin e shpjegimit të dukurive, proceseve psikike dhe të sjelljeve. Shpjegimi i kalon caqet e përshkrimit të një dukurie, gjendjeje, procesi psikik etj., sepse orvatet të japë përgjigje me pyetjen *përse*?, si: *Përse procesi psikik është i këtillë? Përse mendimi krijues zhvillohet në forma të ndryshme*? etj. Lidhur me dhënien e përgjigjes ndaj pyetjes *përse* dallojmë edhe këto forma të shpjegimit: Shpjegimin konstruktiv, sipas së cilit dukuria, procesi psikik e sjellja shpjegohen duke zbërthyer atë dhe raportet e saj në kuadrin e një rregulle, parimi dhe ligji të caktuar. Shpjegimi operacional është shpjegim i përmbajtjes së koncepteve psikologjike me fjalë dhe me terma që përshkruajnë saktësisht dukurinë, procesin psikik dhe sjelljen në kushte të caktuara. Shpjegimi reduktiv shpjegon proceset e thjeshta të një dukurie, procesi psikik dhe të një lloj sjelljeje mbi të cilat zhvillohen ato të ndërlikuarat. Shpjegimi zhvillimor është shpjegim i lindjes, i zhvillimit të një dukurie, procesi psikik e sjelljeje, duke përshkruar faktorët dhe rrugën e këtij zhvillimi**.**

FORMIMI I GRUPIT SHOQËROR. Në psikologjinë sociale emërton procesin e afrimit, të angazhimit dhe të bashkërenditjes së sjelljeve të disa individëve për të kryer një veprimtari sociale të përbashkët, veprimtari kjo, që kënaq pjesëtarët e veprimit të përbashkët të anëtarëve të grupit. Motivet e formimit të grupeve sociale të vogla ose të mëdha janë të ndryshme, por në formimin dhe zhvillimin e tyre ndikojnë edhe nxitësit e jashtëm (afërsia e banimit, ambienti i punës, fitimi i përbashkët etj.). Në këtë pikëpamje, ndër faktorët e formimit të grupeve sociale në psikologjinë geshtaltiste, përfshirë edhe psikologjinë e fushave të Kurt Levinit (Kurt Lewin, 1890 – 1947), përmendin: nevojën për të pasur qëndrime të ekuilibruara ndërmjet moshatarëve të njëjtë, produktin e përbashkët, largimin nga vetmia etj.

FORMIMI I KONCEPTEVE (NOCIONEVE). Konceptet apo nocionet formohen dhe zhvillohen në mbështetje të proceseve kognitive, para së gjithash dhe mbi të gjitha në mbështetje të proceseve të mendimit dhe të zhvillimit të të folurit. Këto procese shpien në zbulimin dhe identifikimin e vetive të përbashkëta e thelbësore të një grupi objektesh e dukurish dhe në bazë të tyre bëhet dallimi i këtyre objekteve e dukurive nga të gjithë të tjerët. Në formimin e koncepteve (nocioneve) angazhohet procesi i analizës dhe i sintezës, sidomos procesi i abstraksionit dhe i përgjithësimit, që zhvillohen mbi atë të perceptimit e të kujtesës. Shih – ***MENDIMI; ABSTRAKSIONI; PËRGJITHËSIMI.***

FORMIMI I MENDIMIT SIPAS PËRSHTYPJEVE. Formimi i mendimit të tërësishëm për një individ në bazë të përshtypjeve nga kontakti i parë me të. Zakonisht përshtypjet e tilla janë të zbehta, të pjesshme, herë-herë edhe

të pakoordinuara, që dallohen brenda një kohe të shkurtër gjatë kontaktit me të. Përshtypjet e para kanë të bëjnë me perceptimin periferik të gjesteve, të manifestimit të emocioneve sipas ndryshimit të lëvizjes së muskujve të fytyrës, të sjelljeve etj. Ato formohen në bazë të vëzhgimit spontan, madje edhe me disa akte të pavetëdijshme, duke përfshirë në këtë kuptim të përgjithshëm edhe ndonjë cilësi e veti të paperceptuar. Ky mendim i përgjithshëm për individin e caktuar sado që është periferik, me zbrazësi, me pjesë përshtypjesh të palidhura etj. ka një tërësi, brenda së cilës theksohet rëndësia e një, dy, ose disa përshtypjeve. Mendimi i formuar në bazë të përshtypjeve të para luan rol në përcaktimin e raportit të sjelljeve të një individi ndaj një individi tjetër, për të cilin ka formuar një mendim përshtypjesh.

FORMIMI I SHPREHIVE. Proces i qëllimshëm i organizimit të ushtrimeve e stërvitjeve, që ka për qëllim zhvillimin e lëvizjeve të organeve të caktuara të trupit të njeriut, dallimin e lëvizjeve parësore nga lëvizjet përcjellëse, lidhjen e lëvizjeve parësore e përforcimin e tyre, si dhe koordinimin e tyre në një tërësi lëvizjesh pothuajse të automatizuara. Shpejtësia e formimit të shprehive varet nga disa faktorë si: nga rëndësia e shprehisë për profesionin e caktuar, motivet, interesi, sistemi racional i organizimit të ushtrimeve, zbatimi i tyre në situata të caktuara etj. Shih – ***SHPREHIA.***

FORMIMI LËNDOR. Pikëpamja për rolin mbisundues të njohjes dhe zotërimit të përmbajtjes së asaj që mësohet, siç janë: të dhënat e faktet, si edhe raportet ndërmjet tyre nga disiplinat e ndryshme shkencore e mësimore, që janë të nevojshme dhe të dobishme për jetën dhe veprimtarinë praktike të njeriut. Te qasja e formimit lëndor duhet të mbisundojë përmbajtja e jo forma, ose mënyra e organizimit të mësimit për zhvillimin e proceseve kognitive dhe formimin e qëndrimeve, të interesave dhe të disa strukturave psikologjike, si edhe zhvillimi i funksioneve optimale të tyre**.**

FORMIMI TRAJTOR. Pikëpamje e psikologjisë pedagogjike dhe shkollore e ardhur nga didaktika. Formimi trajtor thekson rolin dhe rëndësinë e të mësuarit, sipas të cilit të mësuarit përqendrohet në zhvillimin e proceseve kognitive (vëzhgimin, kujtesën, mendimin e të folurit) dhe detyra e të mësuarit është formimi i disa vetive pozitive të personalitetit për punë mendore, siç janë shprehitë e gjurmimit të raporteve ndërmjet fakteve, interesimi për njohjen dhe ndarjen e raporteve thelbësore nga ato dytësore, zhvillimi i qëndrimit për gjurmimin e mënyrave më të efektshme të të mësuarit dhe përgjithësisht për të ushtruar mendimin dhe intelektin, pavarësisht nga përmbajtja e asaj që mësohet. Me rëndësi është trajta e asaj që stërvit intelektin dhe proceset kognitive e jo lënda, përmbajtja e struktura e asaj që mësohet. Ndër lëndët e tilla mësimore veçohen: matematika, gramatika, sidomos ajo e latinishtes së vjetër dhe logjika, që konsiderohen lëndë të "gjimnastikës së arsyes së njeriut". Përfaqësuesit më të njohur të kësaj qasjeje të të mësuarit kanë qenë pedagogët Johan F. Herbart (Johann F. Herbart, 1776 – 1841), Tuiskon Ciler (Tuiscon Ziller, 1817 – 1882), V. Rajn (W. Rein,

1847 – 1929), E. Salvyrk (E. Zallwurk, 1839 – 1926) etj.

FORMULAT K – R. Shkurtesë për emërtimin e formulave të Kuder–Riçardsonit, që përdoren për përcaktimin e vlerës së besueshmërisë së një testi**.**

FORMULAT KUDER–RIÇARDSON. Forma të ndryshme të përcaktimit të masës së vlefshmërisë së një testi. Formulat Kuder–Riçardson mbështeten në shkallën e vështirësisë së pyetjeve e detyrave testore dhe në nivelin e ndryshores së rezultatit të tërësishëm. Forma statistikore e zbatimit të këtyre formulave kryesisht ka të bëjë me gjetjen e shkallës së ndërlidhjes ndërmjet dy a tri formave të të njëjtit test. Këto formula morën emrin e zbuluesve të tyre, psikologëve amerikanë Frederik Xh. Kuder (Frederic G. Kuder, 1903 – 2000) dhe Merion V. Riçardson (Marion W. Richardson,1891 – 1963).

FORNIKS, - I. m. Në neuroanatomi i ardhur nga latinishtja *fornix*. Me këtë term emërtohet gërsheta e fijezave nervore, të cilat lidhin hipokampusin me disa qeliza anësore të hipotalamusit. Shih – ***HIPOKAMPUSI***; ***HIPOTALAMUSI***.

FOSHNJËRI, - A. f. Fazë e zhvillimit të fëmijës pas lindjes, e cila fillon me ushqimin e foshnjës me qumështin e nënës dhe zgjat deri në mbarimin e moshës 12–15-mujore. Në periodizime të ndryshme faza e foshnjërisë përfillet në mënyra të ndryshme në pikëpamje të zgjatjes së saj. Te ne kjo përkon më tepër me kohën e të ushqyerit të fëmijës me qumështin e nënës. Gjatë kësaj kohe foshnja pëson ndryshime fizike dhe psikike; ajo u përshtatet kushteve të reja të jetës. Funksionet biologjike të organeve, të sistemit të organeve dhe të organizmit në përgjithësi përsosen gradualisht. Në këtë fazë foshnja mëson t`i rrokë me dorë objektet e vogla, fillon t`i zhvillojë format elementare të të mësuarit në bazë të refleksit të kushtëzuar. Zërat e veçantë të foshnjës fillojnë të marrin formën e artikuluar duke filluar të nxjerrë fjalët e para. Kah mbarimi i kësaj moshe foshnja fillon të hedhë hapat e parë më të sigurt dhe të ecë.

FOTO. as. I ardhur nga greqishtja *phos* "dritë". Foto është njësi ndriçuese dhe përcaktohet nga ndriçimi i një sipërfaqeje të larguar prej 1 cm nga burimi i dritës me intensitet prej 1 qiri.

FOTOFOBI, - A. f. Frikë e paarsyeshme, madje edhe frikë e sëmurë që e pushton njeriun nga drita në masë të madhe. Fotofobia shfaqet me reagime dhe me sjellje të veçanta të njeriut, i cili vuan nga fotofobia duke u larguar me shpejtësi nga lokali ku papritmas ndizet një burim drite i fuqishëm. I tillë është kuptimi i fjalës fotofobi. Por, fotofobia shfaqet te ata individë që nuk kanë pigment drite të mjaftueshëm, si edhe në disa gjendje të tjera fiziologjike e psikologjike.

FOTOKINEZË, - A. f. I ardhur nga greqishtja *φωτοκινέζης* "kthim në drejtim të burimit të dritës". Fotokineza është aktivitet i kafshëve që gjenden në një shkallë të ulët zhvillimi. Këtë e karakterizon aktiviteti i këtyre kafshëve kur ndaj tyre veprojnë ngacmues të dritës dhe, me këtë rast, këto lëvizin duke e kthyer trupin e tyre në drejtim të burimit të dritës.

FOTOPIGMET, - I. m. Strukturë biokimike e qelizave të rrjetëzës ose retinës së syrit, përkatësisht e asaj shtrese të rrjetëzës që është e përbërë nga shkopthat dhe nga kunjëzat. Në këto qeliza gjendet substanca biokimike e quajtur rodopsinë dhe me anën e tyre ato absorbojnë dritën, duke shndërruar këtë proces në impulse nervore që barten nga periferia në qendrën e të parit, ku edhe përftohet ndijimi pamor. Pigmentet në shkopthat e retinës përbëhen nga proteina e retinës dhe nga vitamina A1. Këto reagojnë maksimalisht në gjatësitë e valëve të dritës prej rreth 500 nanometër. Në kunjëza pigmentet janë ende të panjohura saktësisht, megjithëse dihet se reagimi absorbues maksimal i tyre është prej rreth 430 – 570 gjatësi valësh drite të matura me nanometër.

FOTORECEPTOR, - I. m. Shtresa e posaçme e rrjetëzës ose e retinës së syrit, e përbërë nga shkopthat dhe kunjëzat. Qelizat e kësaj shtrese kanë formën e shkopthave dhe të kunjëzave dhe janë qeliza të specializuara për marrjen dhe dërgimin e impulsive nervore në qendrën e të parit, ku lind ndijimi i të parit të dritës. Fotoreceptorët luajnë rol të posaçëm në dallimin e tonit të ngjyrës dhe të intensitetit të saj. Shih – ***SHKOPTHAT E KUNJËZAT***.

FOTOTAKSIZ/ËM, - MI. m. Lëvizja dhe drejtimi i trupit të kafshëve (kafshëve të nivelit të ulët biologjik) në drejtim të burimit të dritës. Fototaksizmi pozitiv është drejtimi i trupit të kafshëve kah burimi i dritës, kurse fototaksizmi negativ është drejtimi i trupit të kafshëve në drejtim të kundërt nga burimi i dritës. Ky tipar i lëvizjes së kafshëve ka karakter trashëgues.

FOTOTROPIZ/ËM, - MI. m. Reagim karakteristik refleksiv i bimëve ndaj burimit të dritës. Fototropizmi shfaqet në dy forma: fototropizmi pozitiv – kthim i trupit të bimës në drejtim të burimit të dritës dhe forma e dytë e fototropizmit është fototropizmi negativ – kthim i trupit të bimës në drejtim të kundërt nga ai i dritës.

FOVEA CENTRALIS RETINAE. Emërtim latinisht i gropëzës qendrore të rrjetëzës ose retinës së syrit, që dallohet në të ashtuquajturën pikë e verdhë e retinës, ose siç është e njohur në terminologjinë e anatomisë *macula lutea*. Në këtë gropëz gjenden kunjëzat e gjatë dhe të shpeshtë. Secila qelizë e zgjatur, përkatësisht secili kunjëz lidhet me një qelizë të shkurtër bipolare që e përçon impulsin nervor deri në qelizat ganglion. Fovea me strukturën e saj qelizore dhe me lidhjet e këtyre qelizave me qelizën e shkurtër bipolare mundëson të parit e mprehtë të një objekti; sa më shumë të largohet figura e atij objekti nga fovea aq më e vogël dhe më e vrazhdë është mprehtësia e të parit të tij.

FRANKËL Emil Viktor (Emil Viktor FRANKL). Psikiatër dhe psikanalist austriak. Lindi në Vjenë më 26.03.1905 dhe vdiq më 24.06.1997. Themelues i analizës ekzistenciale dhe i logoterapisë. I angazhuar sidomos në procesin e psikoterapisë të drejtuar në konceptin e jetës dhe të zhvillimit të pacientit. Përmendet edhe si themelues i shkollës së tretë të psikanalizës (përveç psikanalizës klasike të Zigmund Frojdit dhe

të psikologjisë individuale të Alfred Adlerit). Gjatë periudhës së pushtimit nazist, si personalitet me origjinë hebreje u burgos dhe vuajti dënimin në kampin e përqendrimit në Theresienstadt (Tersienshtad), e pak më vonë në kampin famëkeq të përqendrimit në Ausschwitz (Aushvic). Në këto kampe përjetoi tmerrin e njohur me termin "Holokaust". Pohohet se nga përjetimet e tilla formoi pikëpamjen e tij për psikoterapinë, të shfaqur më 1963. Koncepti themelor i kësaj pikëpamjeje psikoterapeutike është: drejtimi dhe përqendrimi i vëmendjes së pacientit në ekzistencën, si edhe në ardhmërinë e tij, duke u orvatur që t`i japë kuptim jetës së vet. Sipas tij, ky kuptim ishte fuqia motivuese e njeriut. Veprat kryesore të tij janë: *"Logos und existenc"* – (*"Logosi dhe ekzistenca"*), 1951*; "Theorie und Therapie der neurosen"* – (*"Teoria dhe terapia e neurozave"*), 1956*; "Die Psychotherapie in derpraxis"* – (*"Psikoterapia në praktikë"*), 1961; *". . . trotzdem Ja zum Leben sagen. Ein Psychologe erlebt das konzentrationslager"* – (*"Ku qëndron kuptimi i jetës. Një psikolog përjeton kampin e përqëndrimit"*), përkthyer nga anglishtja në shqip, 2003.

FREKUENCË, - A. f. I ardhur nga latinishtja *frequentia* "shpeshtësi, shumësi". Sasia e përsëritjeve të vlerave të ndryshme në kuadrin e një ndryshoreje të caktuar. Në statistikën e psikologjisë termi frekuencë ka zbatim të madh. Me termin frekuencë në statistikë të psikologjisë emërtohet vlera numerike e dendësisë ose dendurisë së rezultateve të përftuara nga matja e një ndryshoreje të një numri të caktuar subjektesh dhe vendosja e numrit të përsëritjeve të asaj ndryshoreje në klasat e ndara sipas intervaleve të caktuara. Shih – ***DENDURIA.***

FRENIM, - I. m. Term me kuptim psikologjik të veçantë që në disa tekste të psikologjisë e ka zëvendësuar termin inhibicion. Frenimi është dobësim, ndërprerje e mosfillim i një procesi, i një veprimi fiziologjik, psikologjik, shoqëror etj. për shkak të ndikimit që ushtron në të procesi a veprimi tjetër i një organi të caktuar të trupit të njeriut, i strukturës psikike dhe i raporteve sociale në tipin e sjelljes së caktuar të një individi – anëtar i grupit social të caktuar. Në psikologji dallohen disa lloje frenimesh, ku dallojmë:

a. **Frenimi asociativ** – Dobësimi dhe mosaktivizimi i lidhjes së formuar ndërmjet reagimit ndaj një ngacmuesi të caktuar në rastet kur ai (ngacmuesi i caktuar) lidhet me reagimin tjetër duke e penguar zhvillimin e reagimit të formuar;

b. **Frenimi i brendshëm** – Frenim që lind në procesin e formimit të refleksëve të kushtëzuara. Ka të bëjë me venitjen dhe me shuarjen e refleksit të kushtëzuar nga mosshoqërimi i ngacmuesit të kushtëzuar me ngacmuesin e pakushtëzuar; këtë e shkakton edhe refleksi i ri i kushtëzuar që është në kundërshtim me refleksin e kushtëzuar, por të formuar më herët;

c. **Frenimi i diferencuar** – Proces diferencues i ngacmuesve nga ana e kafshëve dhe e njerëzve që shfaqet me venitjen dhe me mosreagimin e tyre ndaj ngacmuesve të ngjashëm ose të përafërt me ngacmuesin që shkaktonte reagim;

d. **Frenimi i jashtëm** – Venitje dhe shuarje e refleksit të kushtëzuar kur

ngacmuesi i jashtëm ushtron ndikim në organizmin e kafshës dhe të njeriut, krahas me ngacmuesin e jashtëm;

e. **Frenimi kortikal** – Frenim i impulseve nervore të një qendre të kores a cipës së trurit të madh nga impulset nervore të një qendre tjetër;

f. **Frenimi paravajtës** – Pengesa që i bën mësimi paraprak mësimit që mësohet pas tij në kuptimin e të mbajturit mend dhe të riprodhimit të saktë të përmbajtjes së mësuar pas një përmbajtjeje tjetër të mësuar më parë (përmbajtja e lëndës A e pengon të mësuarit e lëndës B);

g. **Frenimi prapavajtës** – Vetia dhe harrimi i të dhënave, i fakteve, i lidhjeve ndërmjet tyre dhe i gjithë përmbajtjes së mësuar nga pengesa që shkakton të mësuarit e lëndës tjetër, të lëndës së re. Pengesa e tillë ka karakter prapavajtës duke shkaktuar harresën e lëndës së mësuar më parë (lënda B që mësohet pengon mbajtjen në mend dhe riprodhimin e lëndës së mësuar A). Frenimi paravajtës dhe ai prapavajtës është shkaku kryesor i harresës.

h. **Frenimi reciprok** – Pamundësia e të kujtuarit të dy të dhënave, dy informacioneve që janë mësuar njëri pas tjetrit nga ndikimi negativ që ushtron frenimi i ndërsjellë i tyre në mbajtjen mend. Frenimi reciprok në fiziologji ka kuptim tjetër: frenimi apo inhibicioni i një grupi muskujsh çon në aktivim automatik të muskulit antagonist. Në terapinë bihejviorale frenimi reciprok ka kuptim tjetër: shfaqja e emocioneve pozitive (e gëzimit, e mirëqenies etj.) frenon shfaqjen e emocioneve negative (të frikës, të trishtimit etj.).

FRENOLOGJI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *φρηνος* "zemër, karakter" dhe *λόγος* "shkencë". Frenologjia është doktrinë joshkencore, sipas së cilës në bazë të madhësisë, të formës së kafkës dhe të "relievit" të eshtrave të kafkës mund të përcaktohet zhvillimi i vetive dhe i tipareve shpirtërore të një njeriu të caktuar. Kjo varet drejtpërdrejt nga lokalizimi i të ashtuquajturit "fuqi a kapacitete shpirtërore" në zona të veçanta të trurit, të cilat gjoja mund të dallohen nga madhësia, forma dhe nga relievi i eshtrave të kafkës. Madhësia, forma dhe relievi i eshtrave të kafkës mundëson identifikimin e aftësive të zhvilluara në nivel mbimesatar. Në këtë doktrinë truri i njeriut është konsideruar organ i frymës, i jetës së njeriut. Sipas kësaj doktrine u bënë përpjekje për të dalluar dhe shpjeguar ndryshimet individuale sidomos në fushën e aftësive, ndërmjet njerëzve. Frenologjia u shfaq qysh nga viti 1810. Themelues të kësaj doktrine ishin fiziologu gjerman Franc J. Gal (Franz J. Gall, 1758 – 1828) dhe fizikani gjerman Johan S. Shpurchajm (Johann K. Spurzheim, 1809 – 1872).

FRES Pol (Paul FRAISSE). Psikolog francez. Lindi më 1911. Doktoroi në filozofi në Universitetin e Luvenit dhe u mor me studime psikologjike. Profesor i psikologjisë në Universitetin e Sorbonës qysh më 1957, kurse më 1961 mori detyrën e Drejtorit të Institutit Psikologjik të Parisit. Pol Fres u dallua në zhvillimin e metodave ekzakte të gjurmimit të proceseve psikike dhe të formave të ndryshme të sjelljeve, në kushte dhe rrethana saktësisht të përcaktuara. Në shqyrtimet e tij ka pasur për bazë unitetin e personalitetit dhe qasjen studimore të këtij uniteti. Kjo qasje ishte në shtratin konceptual

të zhvillimit të mendimit psikologjik europian. Ka bashkëpunuar me psikologët europianë, sidomos me Zhan Pijazhen. Me një qasje të tillë, por më tepër me rezultatet studimore, ai ushtroi ndikim të fuqishëm në zhvillimin e psikologjisë eksperimetale. Veprat kryesore të tij janë: *"Manuel praktique de psychologie experimentale"* – (*"Doracak i psikologjisë eksperimentale"*), 1956; *"Psyhologie du temps"* – (*"Psikologjia e kohës"*), 1957; *"Traite de psychologie experimentale"* – (*"Trajtimi i psikologjisë eksperimentale"*), bashkautor me Zhan Pijazhe, 1963 – 1965 etj.

FRIGJIDITET, - I. m. I ardhur nga latinishtja *frigidus* "i (e) ftohtë". Dukuri e çrregullimit të kënaqësisë seksuale dhe e përjetimit të orgazmës që karakterizon femrat. Çrregullimi i tillë shkaktohet kryesisht nga faktorët psikogjenë, por edhe nga disa çrregullime fiziologjike. Frigjiditeti mund të shfaqet nga dhembjet, nga lindja e vështirë e foshnjës, nga abortet e shpeshta etj., por edhe nga faktorët me tipare psikologjike, si agresiviteti i fshehur ndaj meshkujve, mungesa e dëshirës për marrëdhënie seksuale, nga turpi, frika etj.

FRIKË, - A. f. Emocion themelor dhe parësor i jetës psikike, që shfaqet si reagim i njeriut të caktuar ndaj situatave dhe objekteve të papritura ose të paramenduara, të cilat ai i vlerëson të rrezikshme duke mos qenë i gatshëm të përballojë situata dhe objekte të tilla. Sipas këtij vlerësimi te ai lind gjendja e tensionuar, e pakënaqësisë intensive të organizmit. Frika zakonisht është reagim normal i njeriut ndaj situatave e objekteve që për të janë të rrezikshëm dhe për këtë ai e përgatit organizmin për t`iu kundërvëmë rrezikut të kërcënuar. Sipas këtij kuptimi, frika i shërben njeriut për mbrojtje dhe përshtatje ndaj situatës së re dhe kjo është reagim adaptues, i lindur në pikëpamje gjenetike, ndaj cilitdo stimul që rrezikon jetën dhe qenien e organizmit. Frika zgjat pak dhe largohet sapo të përfundojë së ndikuari objekti dhe situata e rrezikshme. Frika ka strukturë psikologjike, fiziologjike dhe vepruese të unifikuar. Struktura psikologjike ka të bëjë me trajtimin e frikës si sinjal i rrezikimit të organizmit, i përjetimit të gjendjes së shqetësimit shpirtëror, i pakënaqësisë së madhe, i pamundësisë për t`iu kundërvënë objektit dhe situatës rrezikuese me ndikim të dukshëm negativ në proceset intelektuale. Një gjendje e tillë përcillet me ndryshime fiziologjike, si: përshpejtim i ritmit të rrahjes së zemrës, të pulsit, ngritje e tonusit të muskujve, e tensionit të gjakut, ngritje e nivelit të sekretimit të gjakut, zverdhje e lëkurës së fytyrës, aktivizimi i mëshikëzës së urinës, tharje e mukozës së muskujve të buzëve etj. Ndryshimet e përbashkëta psikologjike dhe fiziologjike janë të lidhura edhe me ndryshimin e sjelljeve të njeriut të frikësuar. I frikësuari orvatet të organizojë sjellje për t`iu shmangur ballafaqimit me objektin dhe me situatën e rrezikshme ose përgatitet për ta zotëruar objektin ose situatën e rrezikshme. Frika mund të ketë përmasë të një simptome, shenje, sindrome dhe tipari karakteristik. Frika është simptomë për personalitetin e caktuar, kur shfaqet si përjetim subjektiv i rëndë, që largon përkohësisht ose ngushton mundësinë e përjetimit të kënaqësisë dhe të fatmirësisë dhe njeriu ndaj një frike të tillë nuk është në gjendje të

kontrollojë lëvizjet dhe sjelljet e tij. Nëse frika shfaqet si tërësi simptomash të ndryshme, ajo atëherë merr përmasën e një sindrome dhe, më në fund, kur frika shndërrohet në karakteristikë të përhershme reaguese dhe në pritje për të reaguar me frikë ndaj situatave të ndryshme, shpesh dhe jo aq kërcënuese, atëherë frika merr përmasat e tiparit të sjelljes personale.

FRIKA E GJUMIT. Dukuri e rrallë e gjumit të çrregulluar që shfaqet kryesisht te fëmijët. Frikën e gjumit e karakterizojnë këto simptoma: zgjimi nga gjumi me bërtitje, me dridhje gjymtyrësh e buzësh dhe me vaj e me dënesë. Për këtë dukuri dhe për shkaqet që shkaktojnë këtë dukuri bartësi i saj nuk është i vetëdijshëm. Fëmija që vuan nga kjo dukuri i përshtatet me vështirësi kërkesave të situatave normale. Frika e gjumit konsiderohet se është simptomë e neurozës ose e një çrregullimi tjetër psikik.

FRIKA MAGJIKE. Sindroma e çrregullimit të ankthit dhe e disa çrregullimeve seksuale. Frika magjike shfaqet me simptomën e mossuksesit të kryerjes së aktit seksual, gjoja se këtë e pengon dikush tjetër. Kjo frikë mbështetet në besimin e njeriut se organin e tij seksual e ka marrë një tjetër më i madh, me qëllim që këtë ta shfrytëzojë për marrëdhënie seksuale me një grua tjetër (zakonisht me gruan e tij). Ky besim e kjo bindje shkakton mossuksesin seksual të disa meshkujve. Frika seksuale është sindromë e dalluar te pjesëtarët e fisit Joruba të Afrikës.

FRIKA NË PSIKANALIZË. Lindja dhe zhvillimi i frikës, e lidhur me aktin e parë të rëndë dhe të rrezikshëm – me aktin e lindjes dhe të çlirimit të të porsalindurit nga ngrohtësia fiziologjike e trupit të së ëmës. Frika e lindur nga akti i tillë përjetohet si traumë dhe mbetet burim frike nga të gjitha situatat e vështira, të rënda e të rrezikshme për jetën e njeriut. Sipas kësaj pikëpamjeje frika është një lloj emocioni që shfaqet si reagim ndaj situatave traumatike. Një pikëpamje e tillë ka qenë e Çarls Darvinit (Charles Darwin, 1809 – 1882), sipas të cilit afektet e ndihmojnë qenien e gjallë t`i përshtatet mjedisit, duke i zotëruar pengesat dhe duke fituar përvojë për zotërimin e situatave traumatike, ose duke iu larguar situatave të rrezikshme. Përvoja e fituar në këtë mënyrë është bartur brez pas brezi dhe është bërë karakteristikë e trashëguar.

FRIKA NGA PARAQITJA PARA PUBLIKUT. Paraqitja para të tjerëve lidhet me disa ndryshime procesesh e sjelljesh, si: frika se nuk do të gjendet mirë, nuk do të ecë drejt e bukur, do të ketë pengesa në zgjedhjen e fjalëve e të termave të duhura, nuk do të duket i veshur mirë, droja e shfaqjes së ndonjë të mete, e lidhur me ndjenjën e inferioritetit etj. Flasim për frikë normale deri në atë çast, kur fillon të bëhet frikë me intensitet të lartë, duke shkaktuar edhe refuzim të paraqitjes para publikut dhe duke u larguar nga situatat që kërkojnë paraqitjen para të tjerëve. Disa situata kërkojnë paraqitje para të tjerëve, si: aktorët, moderatorët e tubimeve, politikanët, recituesit, spikerët etj. Frika nga paraqitja para publikut merr karakter frike patologjike, kur individi refuzon nga frika shfaqjen e tij para të tjerëve dhe

u shmanget situatave që kërkojnë që ai të paraqitet para publikut në lokale ose në hapësira të pakufizuara.

FRIKA NGA PERËNDIA. Lloj frike karakteristike më tepër për individët religjiozë, që i frikësohen themeluesit të Gjithësisë dhe autoritetit të paprekur të tij dhe të të dërguarve të Zotit. Kjo formë e frikës shfaqet më tepër në ato situata, kur individi religjioz vlerëson se nuk ka arritur t`i zbatojë urdhrat ose ka vepruar në kundërshtim me kërkesat dhe urdhrat e të madhit Zot.

FRIKA NGA PROVIMI. Frikë e shumë individëve kur këta duhet të gjenden në situatë –test. Frika nga provimi është karakteristike për nxënësit dhe studentët, por edhe te të tjerët që përgatiten për provim për magjistër, për doktoratë etj. Frika nga provimi ka karakteristika individuale dhe shpesh fillon të shfaqet në fazën para provimit me disa shenja: humbje oreksi, neveri, pengesa për gjumë të qetë etj. Ka karakter të frikës normale, por te disa individë mund të marrë përmasa jonormale, sidomos kur frika nga provimi shndërrohet në fobi dhe në panik.

FRIKA SEPARATISTE. Lloj i posaçëm i frikës që ka të bëjë me ndjenjën e asaj frike që njeriu e identifikon në veten e tij, kur ky nuk është në gjendje të kryejë veprime të duhura pa praninë dhe ndihmën e një individi të rëndësishëm për të. Frika separatiste karakterizon më tepër fëmijët dhe individët me zhvillim të kufizuar, por shfaqja e saj te të rriturit normalë konsiderohet se është jonormale.

FRIKA SINJALIZUESE. Sipas psikanalizës është sinjal që egoja duhet të angazhojë energji më të madhe për të zotëruar frikën nga një situatë e rrezikshme që pason. Frika e këtillë është frikë e dozës së ulët të egos që i shërben egos sinjal për të angazhuar mekanizma mbrojtës të organizmit. U identifikua nga ana e themeluesit të psikanalizës Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939) Frika sinjalizuese u identifikua në gjurmimet e tij të mëvonshme për ankthin sinjalizues**.**

FRISH Karl fon (Karl von Friesch). Zoolog austriak me ndikim në zhvillimin e zoopsikologjisë dhe të psikologjisë në përgjithësi. Lindi në Vjenë më 1886 dhe vdiq më 1982. Kreu studimet në Universitetin e Vjenës dhe të Munihut, ku më pas punoi si pedagog. U mor me studimin e biologjisë së peshqve dhe të komunikimit të tyre me ngjyra të ndryshme. Rezultatet e studimeve të tij kanë ushtruar ndikim në zhvillimin e komunikimit simbolik. Është fitues i Çmimit Nobel për fiziologji dhe mjekësi në vitin 1973, së bashku me Konrad Lorencin dhe me Nikolas Tinbergen. Vepra kryesore e tij është: "*The Dance Language and Orientation of Bees" – ("Vallja gjuhësore dhe orientimi i bletëve"),* 1967.

FROJD Ana (Anna FREUD). Psikanaliste austriake. Lindi më 3.12.1895 në Vjenë dhe vdiq në Londër, më 8.10.1982. Vajza e Zigmund Frojdit. Pohohet se Ana Frojd u trajtua nga prindërit si "Truri i familjes", kurse motra e saj, më e madhe, Sofia Frojd, si "Bukuria e familjes". Qysh në vogëli zotëronte disa gjuhë të huaja. Më 1918 iu nënshtrua psikanalizës nga ana e babait të saj, kurse më 1922 u pranua në Kongresin Psikanalitik Ndërkom-

bëtar dhe në Berlin filloi të zhvillonte praktikën psikanalitike, por për shkak të kancerit të të atit e ndërpreu praktikën për t`i ardhur në ndihmë të atit në Vjenë. Nga viti 1927 deri më 1934 udhëhoqi Bashkimin Ndërkombëtar Psikanalitik, duke punuar njëkohësisht në praktikën psikanalitike të fëmijëve. Pas pushtimit të Austrisë nga nazizmi u shpërngul me të atin nga Vjena dhe u vendos në Londër, ku zhvilloi praktikën psikanalitike në Klinikën për Terapinë e Fëmijëve në Hampstead, qendër botërore për psikologjinë e fëmijëve. Në historinë e mendimit psikologjik mbeti e njohur më tepër me studimin e saj për mekanizmat mbrojtës dhe me analizën e kritereve për dallimin e zhvillimit normal nga zhvillimi jonormal. Në këtë të fundit ka theksuar se dallimi i shkallës së zhvillimit normal nga ai jonormal është më i vështirë të konstatohet te fëmijët se te të rriturit. Megjithëkëtë, angazhimi i saj kryesor ishte në fushën e mekanizmave mbrojtës dhe vepra kryesore e saj është ajo që ka të bëjë me mekanizmat mbrojtës, sidomos me zhvillimin e tyre te fëmijët. Është nderuar me diplomën e doktoratës së nderit të disa universiteteve amerikane. Detyra e saj jetësore ishte ruajtja e trashëgimisë së të atit dhe pohohet se pikërisht për këtë shkak nuk u martua. Pas vdekjes së saj më 1982 shtëpia e Zigmund Frojdit dhe e Ana Frojdit u shndërrua në Muzeun Freud. Veprat kryesore të saj janë: *"Das Ich und die Abwehrmechanismen"* – (*"Uni dhe mekanizmat mbrojtës"*), Vjenë, 1936; *"Infants withaut Families"* – (*Fëmijët jashtë familjes"*), 1944*; "Normality and Pathology in Childhood"* – (*"Normalja dhe patologjikja te fëmijët"*), 1956; *"Wege und Irrwege in der KInderentwicklung"* – (*"Rruga e zhvillimit dhe bredhjet në psikologjinë e fëmijëve"*), 1968.

FROJD Zigmund Shlomo (Sigmund Schlomo FREUD). Neurolog dhe psikiatër austriak me origjinë hebraike. Themelues i psikanalizës. Lindi në Frajberg (sot Pfibor) më 6.05.1856 dhe vdiq në Londër më 23.09.1939. Emri i saktë i tij qe Zigismund (Sigismund), por është quajtur Zigmund (Sigmund) dhe me këtë emër njihet në literaturën bibliografike, si edhe në literaturën e gjerë të psikanalizës. Jetoi në Vjenë prej vitit 1859 deri kur emigroi në Angli më 1938. Shkollimin e të gjitha niveleve e kreu me sukses në Vjenë; përfundoi më 1881 Fakultetin e Mjekësisë dhe më 1885, në moshën 29-vjeçare, u zgjodh docent privat për neuropatologji në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Vjenës. Zigmund Shlomo Frojdi pas përfundimit të studimeve të mjekësisë u mor me hulumtimin e anatomisë, të histologjisë dhe të fiziologjisë së sistemit nervor. Që nga kjo kohë filloi të botojë trajtesa shkencore mbi sëmundjet organike të sistemit nervor. Pas këtij angazhimi në hulumtime fiziologjike dhe neurologjike fitoi bursën për shkollim të mëtejshëm, për kualifikim në Paris në spitalin e njohur Salpetrier, ku u njoh me neurologun e njohur francez, Zhan Marten Sharkon. Kështu pohohet ndikimi i madh i shkencave mjekësore të Parisit dhe i psikologjisë franceze të Pjer Zhanes në zhvillimin dhe përsosjen profesionale dhe shkencore të Frojdit, edhe pse ky i fundit e mohoi njohjen me Pjer Zhanen. Më 1886 u kthye në Vjenë, si mjek neurolog i specializuar. Gjatë viteve 1886–1889 ngriti shërbimin për

shërimin e sëmundjeve psikike, duke zbatuar sugjestionimin dhe hipnozën. I pakënaqur me rezultatet e shërimit, më 1889 shkoi në Nansa pranë psikologut Ipolit Bernam, ku mësoi zbatimin e sugjestionit hipnotik si metodë e shërimit të çrregullimeve neurotike, duke zbatuar në praktikën e tij mjekësore sugjestionin, katarsën dhe hipnozën. Në të njëjtën kohë u njoh me internistin e njohur Jozef Brojerin (Joseph Breuer, 1842 – 1925), nga i cili mësoi zbatimin e hipnozës katarstike për shërimin e sëmundjeve psikike. Por, me gjithë këtë përvojë, rezultatet e shërimit ishin të pakta. Për këtë arsye kërkoi nga pacientët të flisnin lirisht për gjithçka që u binte ndër mend, pavarësisht nga përmbajtja e tyre, duke besuar se në këtë mënyrë pacienti do të çlirohej nga ndjenjat e shtypura ose të ndrydhura, që, sipas tij, përbënin themelin e çrregullimeve psikike. Kjo ishte mënyra gjurmuese dhe procedura terapeutike. Këtë mënyrë të asocimit të lirë të mendimeve nga ana e pacientit dhe e interpretimit të kësaj lënde nga ana e mjekut-psikoterapeut Frojdi e quajti psikanalizë. Kjo psikanalizë filloi të përdoret në shumë vende të Europës dhe në vende përtej oqeanike dhe kështu filloi të zhvillohet lëvizja psikanalitike. Që nga fillimi i veprimtarisë profesionale e shkencore në Vjenë, më pas në Paris dhe mandej përsëri në Vjenë, ai konsideronte se disa nga sëmundjet psikike kishin për bazë faktorët psikikë; këtë sidomos e ka pohuar për neurozat, shërimin e të cilave e mbështeti në asocimin e lirë të mendimeve, pra në metodën psikanalitike. Nga lënda e grumbulluar dhe e sistematizuar konceptoi teorinë e zhvillimit psikik të njeriut, fazat psikoseksuale të këtij zhvillimi, rëndësinë e madhe të përvojës fëmijërore për zhvillimin psikik të mëvonshëm të njeriut dhe strukturën e personalitetit. Zhvillimit psikoseksual ai i dha rëndësi të posaçme për zhvillimin psikik. Sipas tij ky zhvillim kalon nëpër këto faza: faza orale, anale, falike, latante dhe faza gjenitale. Dinamikën e personalitetit Frojdi e shpjegoi në bazë të shtytësve, ku dalloi posaçërisht shtytësin e jetës dhe të vdekjes, kurse strukturën e personalitetit e shpjegoi në bazë të shtresës së pavetëdijes, paravetëdijes dhe vetëdijes, pra në bazë të strukturës Id, Ego dhe Super ego. Me këtë sistem konceptual psikanaliza e Zigmund Frojdit ka ndikuar në zhvillimin e psikologjisë sociale, në psikologjinë e personalitetit, në sociologji, në antropologji, në etnologji, në psikologjinë e besimit dhe në përgjithësi, në sistemin filozofik të zhvillimit të kulturës. Teoria e personalitetit dhe e zhvillimit e Zigmund Frojdit ka pasur kritika, madje shpesh edhe kritika të ashpra, të cilat kishin për bazë shpjegimin e personalitetit dhe të zhvillimit të tij në bazë të lëndës së mbledhur nga të sëmurët psikikë dhe zbatimin e kësaj lënde për shpjegimin e shumicës me zhvillim psikik normal, pamundësinë e argumentimit të kontrolluar të kësaj lënde, mosmarrjen në konsideratë të mjedisit social në zhvillimin dhe formimin e personalitetit, dhënies përparësi të shtytësve në zhvillimin e personalitetit dhe, sidomos, mbështetjen e zhvillimit të personalitetit në proceset psikoseksuale. Për këto shkaqe nga Frojdi u ndanë bashkëpunëtorët më të ngushtë të tij: Alfred Adleri –

themelues i psikologjisë individuale dhe Karl Gustav Jungu – themelues i psikologjisë analitike ose komplekse. Mandej u zhvillua neopsikanaliza, e konkretisht psikanaliza sociale me sistemet e posaçme konceptuale për psikanalizën nga ana e Erik Fromit, Karl Roxhersit, Karen Horneit, Melania Klajnit etj. Veprat kryesore të Frojdit janë: Përmbledhje veprash prej 18 vëllimesh botuar prej vitit 1942 deri në vitin 1968. Këtë përmbledhje e realizoi në anglisht studiuesi Xhejms Strejç dhe i vuri titullin: *Standard Edition of the Complete Psychological Works of Sigmund Freud"* (SE) – (*"Botim standard i të gjitha veprave psikologjike të Zigmund Frojdit"*) dhe botimi në gjermanisht nga Richard Sterba me titull *"Gesammelte Werke (GW).* Në gjuhën shqipe u përkthyen në tërësi këto vepra: *"Pesë leksione mbi psikanalizën",* 2004 (Përkthimi i parë në shqip mbi psikanalizën më 1938); *"Përtej parimit të kënaqësisë",* 2004; "Mbi letërsinë dhe artet", 2005; "*Shakaja dhe lidhja e saj me të pavetëdijshmen",* 2005; *"Psikanaliza fëmijërore*", 2005; *"Psikopatologjia e jetës së përditshme",* 2005; *"Presidenti Uillson"*(vëllimi 1 e 2), 2005; *"Moisiu dhe feja monoteiste",* 2005; *"Ese mbi psikanalizën",* 2006; *"Psikanaliza e histerisë dhe e ankthit",* 2007*; Interpretimi i ëndrrave",* 2010*; "Harrimi i gjërave",* 2010. Në gjuhën shqipe u botuan edhe vepra që ndihmojnë të kuptuarit e mësimeve të Zigmund Frojdit dhe të psikanalizës në përgjithësi. Ndër to përmendim: *"Themelet e psikanalizës"* (përkthim nga anglishtja), *"Si ta kuptojmë Frojdin"*(përkthim nga frëngjishtja); "*Çështje të psikologjisë dhe të psikanalizës"* nga Don Lush Gjolaj.

FROJDIZ/ËM, - MI. m. Koncepti i Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939) për zhvillimin psikik të njeriut, për motivet e këtij zhvillimi e për motivet e sjelljeve të çrregulluara, për strukturën psikike të njeriut etj., shih – ***PSIKANALIZA.*** Me termin Frojdizëm zakonisht emërtohet sistemi i koncepteve dhe teoria klasike e psikanalizës me konceptet dhe termat themelorë të pavetëdijes, të seksualitetit, të rëndësinë e përvojës së hershme të fëmijërisë në zhvillimin e tipareve psikike të të rriturit, me mënyrën e ndryshimit të mendimeve, të ndjenjave, të qëndrimeve dhe të sjelljeve me metodën psikanalitike etj. Një trajtim i tillë i psikanalizës përjashton ndryshimet e mëvonshme të përqendruara në neopsikanalizë, në psikanalizën sociale etj. Në literaturën shqipe gjatë sistemit monist Frojdizmi ka pasur konotacion negativ, sepse është konsideruar pikëpamje e dështuar biologjike për shpjegimin e zhvillimit psikik, për shpjegimin e zhvillimit të kulturës, të moralit dhe të shoqërisë njerëzore. Në trajtimin e tillë të frojdizmit nga ana jonë dhe nga ana e psikologëve të vendeve të bllokut të Lindjes (Hungari, Poloni, Rumani etj.) ka ndikuar pikëpamja sovjetike për psikanalizën dhe për themeluesin e saj Zigmund Frojdin.

Burimet:

Sigmund Freud: *"Das Unbewuste"* – (*"Mbi të pavetëdijshmen"*), Gesammelte Werke, Frankfurt/M. 1914.

Alfred Adler: *"Praxis und Theorie der Individualpsychologie"* – (*"Praktika dhe teoria e psikologjisë individuale"*), Frankfurt/M. Fischer, 1930.

Carl G. Jung: *"Die Archetypen und das Kollektive Unbewuste"* – (*"Arketipat dhe e pavetëdijshmja kolektive"*), Freiburg, 1935 – 155.

Sigmund Freud: *"Zur Geschihte der psychoanalitischen Bewegung"* – (*"Historia e lëvizjes*

psikanalitike"), Gesammelte Werke Bd. 10. Frankfurt /M.: Fischer, 43 – 113.
Sigmund Freud: *"Ese mbi psikanalizën",* Shtëpia botuese "Fan Noli", Tiranë, 2006.

FROM Erik (Erich FROMM). Psikanalist me prejardhje hebreje. Lindi në Frankfurt më 23.03.1900 dhe vdiq më 18.03.1980 në Lokarno. Filloi studimet për drejtësi dhe filozofi në Universitetin e Frankfurtit, por shpejt iu kthye psikanalizës, madje anës së majtë të psikanalizës, prej nga më vonë lindi frojdo-marksizmi. U doktorua për historinë politike të hebrenjve në Universitetin e Hajdelbergut, ku mbrojti tezën "Das judisch Gesetz" – ("Ligji i hebrenjve") para se të bëhej anëtar i qarkut të filozofisë së Frankfurtit. Me ardhjen në pushtet të nacionalsocialistëve gjermanë braktisi Gjermaninë dhe u vendos në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku zhvilloi aktivitet të rëndësishëm dhe, kuptohet, të frytshëm shkencor nga fusha e sociologjisë dhe e psikanalizës. Qe ligjërues në Universitetin e Kolumbias të Nju Jorkut, më pas profesor i universitetit shtetëror të Miçiganit dhe më në fund e përmbylli karrierën shkencore si drejtor i departamentit për psikanalizën në shkollën e mjekësisë në Meksikë. I përket psikanalistëve humanistë, më saktë grupit të neoanalistëve. Erik Fromi dinamikën e personalitetit dhe motivet e sjelljeve të njeriut i lidhi më tepër me rolin e mjedisit shoqëror. Në këtë kontekst e ka trajtuar egon dhe rolin e rëndësinë e super egos, kryesisht në raport me mjedisin social të individit, duke i dhënë vlerë të posaçme raporteve shoqërore në zhvillimin e personalitetit. Veprat kryesore të tij janë: "*Escape from Freedom" – ("Arratisja nga liria"),* 1941, përkthyer në shqip më 1998; *The Authoritarian Personality" – ("Personaliteti autoritar"*), 1950; "*The Anatomy of Human Destructiveness" – ("Anatomia e destruktivitetit njerëzor"),* 1973; "*Man for Himself: Am Inquire into the Psychology of Ethics" – ("Njeriu për vete: Gjurmim në psikologjinë e etikës"*), 1947 (përkthyer në shqip më 2003; *"Forgotten Language: An Introduction to the Unterstanding of Dreamas" – ("Gjuha e harruar: hyrje në të kuptuarit e ëndrrave, të përrallave dhe miteve"),* 1951; (përkthyer në shqip më 1993);*"Sigmund Freud`s Mission: An Analysis of His Personality and Influence" – ("Misioni i Zigmund Frojdit: Analiza e personalitetit dhe e ndikimit të tij"*), 1959, (përkthyer në shqip, 2003, 2009); "*The Crisis of Psychoanalysis" – ("Kriza e psikanalizës"*) (përkthyer në shqip me titullin "Nëntë skica psikologjike", 2005; "*Greatness and Limitations of Freud`s thought" – ("Madhështia dhe kufizimet e mendimit të Frojdit"*) (përkthyer në shqip me titull "Teoria e Frojdit: Madhështia dhe kufizimet më 2009)*; "The Heart of Man" – ("Psikanaliza e dashurisë",* 1998); *"Psychology and Religion" – ("Psikologjia dhe feja"*) (përkthyer në shqip, 2002); *"Psikoanaliza, seksi dhe karakteri"* (përkthim nga "Selected Works, I, The Dogma of Christ, NY"), 1986 etj.

FRONTAL, - E. mb. I ardhur nga latinishtja që përdoret edhe në terminologjinë e neuroanatomisë. Termi frontal ka kuptimin e ballorit. *Frontalis lobus* "pjesa ballore", fjala është për pjesën ballore të trurit.

FRUSTRIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *frustratio* "të penguarit". Frustrimi është në rend të parë gjendje emocionale negative e ndërlikuar,

gjendje e pakëndshme e individit, i cili ka ndeshur në një pengesë serioze fizike, sociale ose psikike gjatë veprimtarisë së tij për të arritur deri në qëllimin e caktuar. Kjo ndodh atëherë, kur individit i është bllokuar aktiviteti i drejtuar dhe i përqendruar në atë qëllim. Struktura e gjendjes së njeriut të frustruar është e ndërlikuar, sepse përbëhet nga dëshpërimi, pakënaqësia, tensioni psikik e organik, mundësia e reagimit me sjellje të papërshtatshme, me sjellje agresive, por edhe me sjellje regresive etj. Bashkë me një gjendje të tillë shfaqen edhe mekanizmat mbrojtës. Individi i bllokuar ndaj pengesave të tilla mund të reagojë realisht duke kërkuar shtyrje të veprimtarisë për një kohë të mëvonshme, duke bërë përpjekje për të rikonstruktuar mënyrat e sjelljes së tij, duke ndryshuar rrugët dhe mjetet e arritjes deri në një qëllim të përcaktuar etj. Por, ka mjaft raste kur individi i bllokuar reagon edhe në mënyra jorealiste, si: ofendon, urren, organizon sjellje negative ndaj bllokuesit etj. Gjendjet frustruese kanë përmasa pozitive, sepse njeriu mësohet që në jetën e tij nuk ka vetëm rrugë të shtruara me lule, por edhe rrugë plotë ferra, që duhet zotëruar me kuptim dhe me sjellje të shtuara, të kultivuara dhe të pranueshme nga të tjerët. Madje, gjendja frustruese e njeriut të rritur i jep mundësi që ai të ekspozojë aftësitë dhe potencialin e fuqisë morale të tij.

FRUSTRIMI EKZISTENCIAL. Pengesat e të kuptuarit të ekzistencës, të vullnetit të lirë dhe të mënyrave të ekzistencës dhe të zhvillimit të individualitetit të njeriut. Këtë term e ka përdor për herë të parë Viktor Frenkl (Viktor Frankl, 1905 – 1997).

FRYMË, - A. f. Koncept filozofik me përmasa domethënëse psikologjike, por me disa kuptime. 1) Ajri në procesin e frymëmarrjes te frymorët – shenjë jetese e njerëzve dhe e kafshëve që lidhet me tërësinë karakteristike të proceseve kognitive, emocionale dhe të vullnetit, si edhe me disa karakteristika të personalitetit të njeriut. Tërësinë domethënëse të frymës e mbisundon mendimi duke përfshirë edhe mendimin krijues që funksionon në lidhje me disa ndjenja dhe me motive të veçanta. Me këtë kuptim fryma është tërësi dhe produkt e mendjes. Njeriu si frymor synon t`i njohë dhe t`i zotërojë dukuritë, objektet, proceset e ndryshme dhe raportet ndërmjet tyre duke bërë përpjekje të krijojë vlera njerëzore. Përmbajtja dhe funksioni i tillë i frymës karakterizon vetëm njerëzit. Kjo përbën pjesën kuptimore të psikikës, që ka për bazë strukturën dhe funksionin e ndërlikuar të trurit e të kores a cipës së trurit të madh. Ky kuptim i frymës e bën këtë të jetë jolëndore; 2) Në shqipe fryma ka edhe këtë kuptim: prirja dhe gatishmëria e individit që ka karakter relativisht të qëndrueshëm si në shprehjen fryma bujare, fryma burrërore, fryma e mirëkuptimit etj.; 3) Parimi a qëllimi thelbësor i një përmbajtjeje, veprimi etj. si në pohimin: fryma e ligjit e jo shkronja e tij; 4) Fryma është qenie hyjnore e disa religjioneve që nuk ka të bëjë me botën materiale. Kjo është vetë shpirti i njeriut në filozofinë idealiste. Shih – ***SHPIRTI.*** Fryma e tërësisë shpirtërore të një populli, fryma popullore, që karakterizon tiparet kryesore të psikikës së atij populli, në bazë të të cilave ai popull (bashkësi, grup etj.) dallon

prej të tjerëve. Me këtë kuptim fryma pothuajse identifikohet me kuptimin e termit psikikë, si në shprehjen: Fryma grupore është fryma psikike. Shih – ***PSIKIKA GRUPORE.***

FRYMËZIM, - I. m. Fazë e posaçme e mendimit krijues, të cilën e karakterizon grumbullimi i fuqisë intelektuale dhe i ndjenjave ndaj një situate të caktuar, ndaj objektit e dukurisë së posaçme dhe shpërthimi i vrullshëm e i papritur i kuptimit të thelbit të çështjes së caktuar. Frymëzimi me këtë kuptim i përket fazës së tretë të mendimit krijues. Ky moment i zbulimit të së resë, i zgjidhjes së situatës së ndërlikuar problemore mund të arrijë pas shumë kohësh të pjekurisë së mëvetësishme të situatës problemore dhe të orvatjes së zbulimit të së resë në art dhe në mendimin shkencor. Në këtë proces ka gjasë se nuk janë identifikuar të gjithë elementët e gjendjes së tillë krijuese të njeriut të zakonshëm, që gjendet pranë situatës problemore të shkencëtarit dhe poetit.

FSHIKËZA SINAPTIKE. Flluskë shumë e vogël në anën e trashë të neuritit ose aksonës të qelizës nervore, ku është vendosur një substancë specifike kimike që mundëson bartjen e impulsive nervore nga një qelizë nervore në qelizën tjetër nervore. Shih – ***NEUROTRANSMETUESI.***

FTOHTËSI, - A. f. Lloj i ndijimit të lëkurës, që shkaktohet nga ndikimi që ushtron trupi i jashtëm si ngacmues i lëkurës që ka temperaturë më të ulët se 32 gradë Celsius. Ngacmuesi i tillë i lëkurës mund të jetë në gjendje të ngurtë, të lëngët dhe në gjendje flurore me temperaturë nën zeron fiziologjike të lëkurës. Por, ndijimi i tillë ka karakter relativ, sepse dora e futur në një shishe uji të ftohtë prej 25 gradë Celsius dhe më pas e futur në një shishe tjetër me temperature prej 27 gradë Celsius ka ndijim të nxehtësisë, e jo sipas rregullit të ftohtësisë. Kjo dukuri është pasojë e përshtatjes së lëkurës dhe ndijimit të kësaj përshtatje ndaj ngacmuesit të rinj.

FUGË, - A. f. I ardhur nga latinishtja *fuga* "arratisje". Fuga është term i psikiatrisë; emërton një lloj sjellje të çrregulluar të një individi, i cili papritmas arratiset nga shtëpia dhe vendoset në një vend tjetër, duke ndryshuar identitetin e vet dhe mënyrën e jetesës e të aktivitetit të tij. Në vendin tjetër individi me fugë të zhvilluar orvatet të krijojë një identitet të ri. Shfaqet më tepër te fëmijët, por edhe te të moshuarit, sidomos te pleqtë e shtyrë në moshë. Te këta individë thua se humbin gjurmët e jetës më të hershme, megjithëse dijet për të nuk janë të zhdukura, madje kanë edhe energji vepruese të pavetëdijshme. Psikanaliza e shpjegon fugën si rezultat të motiveve të pavetëdijshme dhe të konflikteve të brendshme, po ashtu të pavetëdijshme, por edhe si dukuri e pamundësisë së njeriut për t`i përballuar tensionet e brendshme psikike. Fuga është dukuri e rrallë te njerëzit normalë dhe shfaqet kryesisht te ata, të cilët janë të ngarkuar me depresion dhe kërkojnë me këmbëngulje siguri, dashuri dhe ndihmë më të madhe se në familjen e në mjedisin e vet, duke besuar se këtë mund ta gjejnë duke braktisur shtëpinë dhe mjedisin e tyre dhe, së fundi duke ndryshuar identitetin e tyre. Pas shërimit nga fuga te këta individë shfaqet amnezia për gjithë atë që u ka ndodhur.

FUGA IDEARUM. I ardhur nga latinishtja që në shqipe ka kuptimin e largimit të ideve. *Fuga idearum* emërton konceptin e ikjes së përshpejtuar të ideve. Është proces që godet përmbajtjen e procesit të mendimit, ku idetë lidhen vetëm në mënyrë sipërfaqësore. Figura idearum karakterizon sëmundjen e manisë, si edhe atë të skizofrenisë.

FULGOS Ante (Ante FULGOSI). Psikolog kroat. Lindi në Zagreb më 1930. Doktor i shkencave psikologjike. Profesor ordinar i psikologjisë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Zagrebit. Merret kryesisht me studimin e proceseve kognitive të perceptimit, të mendimit, të mendimit kreativ, por edhe me analizën e inteligjencës dhe të strukturës së aftësive. Pjesëmarrës në anketën ndërkombëtare të psikologut slloven Vid Peçjak "Veliki psiholozi o psihologiji" – ("Psikologët e mëdhenj mbi psikologjinë"). Sipas qëndrimit të tij psikologjia mund të bëjë shumë më tepër për zgjidhjen e problemeve shoqërore dhe të individit. Detyra e saj (flet për fillimin e viteve `80 të shekullit XX – *shën.* P. N.) është të japë një figurë shkencore adekuate ose të shpjegojë njeriun, dhe më pas edhe shoqërinë. . . Ai konsideronte se psikologjia në botë ka perspektivë të mirë zhvillimore. Njerëzit gjithnjë e më shumë interesohen për shpjegime shkencore, jo për shpjegime filozofike ose ideologjike. . . Hulumtimet dhe shpjegimet shkencore për njeriun çdo ditë janë më të fuqishme". Veprat kryesore të tij: *"Faktorska analiza"* – (*"Analiza faktoriale"*), 1979; *"Psihologija ličnosti. Teorija i istraživanja"* – (*"Psikologjia e personalitetit. Teoria dhe gjurmime"*), 1987 etj.

FUNKSION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *functio* "veprim, kryerje e shërbimit" që përdoret në biologji, matematikë, psikologji etj. Në biologji funksion emërton aktivitetin karakteristik të një organi të organizmit, në matematikë – varësinë e ndryshimit të një madhësie nga madhësia tjetër, në statistikën e psikologjisë - varësinë e ndryshimeve të një ndryshoreje nga ndryshimet e ndryshores tjetër. Në psikologji emërton aktivitetin psikik të një strukture psikike, si: funksioni kognitiv, i emocioneve, i motiveve, i personalitetit të poetit, i rolit të udhëheqësit etj.

FUNKSIONALIZ/ËM, - MI. m. Drejtim psikologjik, sipas të cilit proceset dhe vetitë psikike janë mjete që i shërbejnë njeriut për t`u gjendur me sukses dhe për t`iu përshtatur kushteve të ndryshueshme antropogjeografike, biologjike, shoqërore, sikurse edhe raporteve të ndryshueshme ndërmjet tyre. Në mbështetje të këtij përcaktimi, psikologjia ka detyrë të studiojë proceset mendore dhe sjelljet tona sipas funksioneve dhe dobisë së tyre për organizmin e njeriut dhe rolin e tyre në zhvillimin normal të jetës së njeriut. Funksionalizmi në psikologji u zhvillua nën ndikimin e disa pikëpamjeve, si: teoria e Çarls Darvinit (Charles Darwin, 1809 – 1882), pragmatizmi i Uiliam Xhejmsit (William James, 1842 – 1910), qasja holistike e hulumtimit të sjelljeve e Xhon Djuit (John Dewey, 1859 – 1952) etj. Përfaqësuesit e psikologjisë funksionale në Europë kanë qenë: Teodul Ribo (Theodule Ribot, 1839 – 1916), Eduard Klapared (Edouard Claparede, 1873 – 1940), Karl Shtumpf (Carl Stumpf,

1848 – 1936). Por, më karakteristik për zhvillimin e funksionalizmit në psikologji është lidhja e programit të shkollës psikologjike të Çikagos me në krye Xhon Djui (John Dewey, 1859 – 1952), V. Engjëll etj. me zhvillimin e psikologjisë funksionale. Funksionalizmi bashkëkohor në psikologji çmon qasjen e studimit të dukurive psikike objektive dhe subjektive nga këndvështrimi i dobisë së tyre në procesin e përshtatjes së organizmit, kushteve të ndërlikuara të mjedisit ku ai zhvillohet dhe formohet. Metoda e studimit të dobisë dhe të funksionit të akteve psikike është metoda e vëzhgimit sistematik të sjelljeve a veprimeve të jashtme dhe metoda eksperimentale.

Burimet:

William James: *"The Principles of Psychology"* – (*"Parimet të psikologjisë"*), 1890.
William James: *"Textbook of Psychology"* – (*"Libër tekstesh rreth psikologjisë"*), 1892.
John Dewey: *"Now we Think"* – (*"Mendimi i ri"*), 1910.
Edouard Claparède: *"Les associations des idees"* – (*"Asociacioni i ideve"*), 1932.
David Katz: *"Mensch und Tier"* – (*"Njeriu dhe kafsha"*), 1937.

FUNKSIONALIZMI PROBABILITET. Teori e përgjithshme e sjelljeve të njeriut në bazë të së cilës perceptimi është procesi i zbulimit të veçorive të një dukurie, objekti, procesi etj., sipas të cilave njeriu zgjedh atë formë të reagimit që ka shkallën më të lartë të probabilitetit, sepse, pikërisht, ajo formë e reagimit do të jetë më e përshtatshmja dhe më e suksesshmja ndaj atij aspekti të perceptimit. Termi i përket pikëpamjes mbi perceptimin të psikologut amerikan Egon Brunsvik (Egon Brunswik, 1903 –).

FUNKSIONET AUTONOME TË EGOS. Funksionet e asaj strukture të personalitetit sipas psikanalizës, që kanë të bëjnë me proceset kognitive në rend të parë (me perceptim, kujtesë të menduar dhe të folur), si edhe me vendimmarrje dhe organizim të sjelljeve sipas kushteve, rrethanave e raporteve reale. Funksionet autonome të egos kryhen pa ndikimin e energjisë së shtytësve. Këto funksione janë "pajë e natyrës së njeriut". Këto janë studiuar nga psikiatri e psikanalitiku amerikan Hainc Hartman (Heinz Hartmann, 1894 – 1970).

FUNKSIONET KORTIKALE. Funksionet psikike (proceset psikike, sensorike dhe motorike) që ndodhen nën kontrollin e kores a cipës së trurit të madh, përkatësisht të korteksit. Në literaturën e psikologjisë me funksione kortikale emërtohen veprimet e vullnetshme të njeriut, që shkaktohen, organizohen dhe drejtohen për një qëllim të caktuar të njeriut, pikërisht në zotërimin e tij me anë të veprimeve të posaçme të tij.

FUNKSIONI ATRIBUIV I FJALËVE. Të përshkruarit e fjalëve të shqiptuara ose të shkruara, cilësi të objektit që ato emërtojnë; lidhje e ngushtë e fjalëve emërtuese me objektin emërtues. Kjo është cilësi e mendimit të fëmijëve, si edhe e mendimit magjik të fiseve primitive. Këtë e ka trajtuar psikologu rus Lav S. Vigotski (Lav S. Vygotsky, 1896 – 1934).

FUNKSIONI SIMBOLIK. Aftësi e posaçme e njerëzve pë të vepruar dhe komunikuar me anë të simboleve, përkatësisht me anë të sistemit të fjalëve apo atij verbal, me anë të gjesteve, mi-

mikës, lëvizjeve, figurave etj. Në zhvillimin ontogjenetik këtë funksion e hasim te fëmijët e moshës njëvjeçare, kur në sjelljet e tyre fillojnë të fusin ndërmjetësin zanor të kërkimit të ushqimit, të plotësimit të nevojës për etje etj.

FUQI, - A. f. Në fizikë emërton konceptin e energjisë me të cilin kryhet një punë e caktuar. Në psikologji termi fuqi emërton forcën e asaj vetie psikike të njeriut, me anën e së cilës ai gjendet me sukses dhe shpejt në një situatë problemore. Në psikologji hasen:

a. **Fuqia dalluese** – Aftësia dalluese e syrit të njeriut që bën të mundur dallimin e shpejtë të një figure, trupi, cilësie etj. nga një figurë, trup, cilësi tjetër që gjendet në afërsi të madhe me të tjerët dhe ka ngjashmëri me ta;

b. **Fuqia e egos** – Term i psikanalizës, të cilin ajo mund ta shfrytëzojë për qëllimet e veta dhe në raport me fuqinë e idit dhe të super egos. Sa më e madhe të jetë fuqia e egos aq më e vogël është mundësia e çrregullimit të sjelljeve të një individi dhe, përkundrazi, sa më e dobët të jetë fuqia e egos aq më e madhe dhe aq më e lehtë është mundësia e përjetimit të dëmtimit të personalitetit. Fuqia e egos ka edhe një kuptim të veçantë në teorinë e personalitetit të Rajmod Katelit (Reaymond Catell, 1905 – 1998). Sipas kësaj teorie fuqia e egos ka të bëjë me tiparin burimor të personalitetit, që ka karakter pozitiv dhe shfaqet në aftësinë dhe gatishmërinë e individit për t`i kontrolluar veprimet e afektet e tij. Ky tipar u shënjua me shenjën C+;

c. **Fuqia e muskujve** – Veprimi i muskujve në zotërimin e rezistencës së pengesave të tyre. Kjo fuqi varet nga morfologjia anatomike e muskujve, nga proceset biokimike, nga shfrytëzimi i rezervave energjetike;

d. **Fuqia e superegos** – Tipare burimore emocionale dhe e sjelljeve të personalitetit, që janë stabilizuar dhe kanë qëndrueshmëri duke përcaktuar përgjegjësinë, sjelljen e ndërgjegjshme dhe emocionale në kryerjen e detyrave shoqërore sipas parimeve dhe normave morale të mjedisit ku ai individ vepron. Ky tipar është identifikuar nga Rajmond Katel (Reaymond Catell, 1905 – 1998) dhe është shënjuar me shenjën G+ ;

e. **Fuqia shoqërore** – Aftësia e një individi të caktuar për të fituar shpejt e lehtë simpatinë e të tjerëve, për të qenë i respektuar nga të tjerët etj.;

f. **Fuqia e shtytësve** – Intensiteti i nevojave që e shtyjnë individin në aktivitet për të plotësuar atë nevojë. Fuqia e shtytësve është masa e kërkesës për energji shtytëse;

g. **Fuqia e vullnetit** – Term i psikologjisë klasike, me të cilin është emërtuar koncepti i aftësisë së njeriut për ta vënë nën kontroll gjithë aktivitetin dhe aftësia e njeriut për t`iu bërë ballë ngacmuesve të ndryshëm.

FUQIA DISKRIMINUESE. Karakteristikë matëse e një testi të standardizuar për të nxitur dhe për të bërë dallimin e saktë ndërmjet subjekteve, të cilat i provojmë në një ndryshore psikologjike. Shih – ***NDJESHMËRIA E TESTIT.***

FUQIMOR, - E. mb. Që ka fuqi të caktuar, që përbëhet nga fuqitë e caktuara.

FUSHA MINIMALE E TË DËGJUARIT. Shtypja më e vogël e valëve të zërit në kordhën e veshit, që është në gjendje të shkaktojë ndijimin e të dëgjuarit të zërit.

FUSHA MOTORIKE E CIPËS SË TRURIT. Qendrat e cipës ose të kores së trurit të madh që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me neuronet dalëse të zhvillimit motorik të njeriut. Këto qendra marrin pjesë sidomos në zhvillimin dhe formësimin e aktivitetit të vullnetshëm të njeriut. Qendrat motorike gjenden përreth brazdës së Rolandit (Luigi Rolando, 1773 – 1831). Këto janë struktura të ndërlikuara trunore, kanë karakter parësor dhe dytësor dhe përbëjnë bazën e të gjitha sjelljeve të njeriut. Këto kanë edhe zhvillim hierarkik. Shih – ***STRUKTURAT SENSOMOTORIKE.***

FUSHA RECEPTIVE. Pjesë e hapësirës receptore të shqisës së caktuar, ku qelizat receptore të saj kapin energjinë e ngacmuesit dhe e shndërrojnë këtë në impuls nervor që bartet në qendrën e caktuar nervore dhe shndërrohet në ndijim. E tillë është fusha e rrjetëzës ose e retinës së syrit, fusha e qelizave receptore të lëkurës (e prekjes, e temperaturës, e dhembjes etj.).

FUZION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *fuzio* "shkrirje ose bashkim". Termi fuzion u përdor në psikanalizë dhe prej andej ka gjetur zbatim edhe në disa shpjegime të proceseve psikike, sidomos të atyre kognitive. Me termin fuzion kuptojmë shkrirjen e dy ose më shumë elementeve në një tërësi dhe pamundësinë e dallimit të këtyre elementeve në kuadrin e asaj tërësie.

FUZIONI BINOKULAR. Bashkimi i dy figurave të njëjta të secilit sy në një përjetim të tërësishëm pamor. Fuzioni binokular i përket bashkimit të figurës së rrjetëzës ose retinës së syrit të majtë me atë të syrit të djathë në një figurë të tërësishme.

FUZIONI NË PSIKANALIZË. Koncept psikanalitik i bashkimit të balancuar të aktit të veprimit të shtytësit të jetës (Eros) me atë të shtytësit të vdekjes (tanatos), në kuadrin e tërësisë së jetës normale të një individi. Por, në faza të ndryshme të jetës së njeriut ka raste kur mbisundon njëri ndaj tjetrit, duke shkaktuar sjellje të posaçme dhe jonormale në aktivitetin e njeriut.

FUZIONI TONIK. Lidhja dhe bashkimi i disa toneve që ndikojnë në veshin e majtë dhe të djathtë në një tërësi tonike të tërësishme. Kjo tërësi është perceptim i toneve të akorduara.

FYTYRË, - A. f. Pjesa e përparme e kokës së njeriut, të cilën e inervon nervi VII ose nervi i fytyrës. Fytyra konsiderohet pjesa më karakteristike dhe më shprehimore e organeve të trupit të njeriut. Ajo mund të shprehë në mënyrë të posaçme gjendjen psikike të çastit, gjendjen shëndetësore të njeriut dhe, mbi të gjitha, fytyra e njeriut dhe ndryshimet lëvizore të muskujve të saj, si edhe ngurtësia e tyre, është pjesa që personifikon tërësinë e pasur të jetës emocionale të njeriut. Dëshpërimi, frika, gëzimi, hidhërimi, turpi, trishtimi dhe zemërimi shprehen me lëvizje të muskujve të fytyrës, me skuqje, ngrysje, të qeshur etj. Lëvizjet e muskujve të fytyrës marrin pjesë në shprehjen e dëshirave, të emocioneve e pjesërisht edhe të disa elementeve të proceseve kognitive, sidomos të mendimit. Por, gjithmonë ndryshimet e muskujve të fytyrës dhe pozicioni i tyre nuk shprehin të njëjtin emocion.

G

G – Shkurtesë për faktorin e përgjithshëm, faktorin G(j) të inteligjencës, të cilin e ka përkufizuar psikologu dhe statistikani anglez Çarls Spirman (Charles Spearmen, 1863 – 1945).

G - shenjë për termin *ganz* "tërësi" i ardhur nga gjermanishtja. Shenja G përdoret në ato hulumtime, ku zbatohet testi psikodiagnostik i pikave të ngjyrës së testit të psikiatrit zviceran Herman Rorshah (Hermann Rorschach, 1884 – 1922).

GABIM, - I. m. Pasaktësi në matje, në numër, në llogaritje, në vrojtim etj. që bëhet nga njohja e pamjaftueshme dhe e padrejtë e rregullave, e ligjeve etj. dhe nga zbatimi jo i drejtë i tyre në matjen dhe në vlerësimin e dukurive, të proceseve, të vetive psikike etj. Në psikologji termi gabim zbatohet më tepër në statistikën e psikologjisë.

GABIMI ABSOLUT. Gabim i shprehur në njësi që janë zbatuar në matjen e dukurisë, të intensitetit të një procesi psikik, të funksionit të një strukture psikike etj.

GABIMI EKSPERIMENTAL. Lëshim dhe gabim që ka të bëjë me zbatimin e gabuar të metodës së eksperimentit, të kontrollit të efektit të një ndryshoreje, të përcaktimit të përmasave ndikuese të saj, të interpretimit të gabuar të rezultateve hulumtuese eksperimentale etj. Gabimi eksperimental ka disa burime: ndryshimet e kushteve të jashtme, ndryshimet organike të subjekteve, zbatimi jo i drejtë i procedurave hulumtuese etj.

GABIMI I PËRFAQËSIMIT. Gabim që i atribuohet të gjithë anëtarëve të një grupi, për shkak të zgjedhjes së gabuar të përfaqësuesve të tyre, te të cilët është matur një dukuri e caktuar.

GABIMI I RASTËSISHËM. Gabim që e shkaktojnë faktorët e rastësishëm e jo gabim që shkaktohet nga faktorët sistematikë. Gabim të tillë e hasim në statistikën e psikologjisë, kur bëhet zgjedhja e rastësishme e subjekteve në hulumtimin e një dukurie të caktuar psikike.

GABIMI I VROJTIMIT. Shmangia e vrojtimit individual të një dukurie apo cilësie të saj nga vlera e vërtetë, e cila është përcaktuar në bazë të matjeve të sakta të asaj dukurie apo cilësie.

GABIMI KONSTANT. Gabim që paraqitet vazhdimisht në matjet e një dukurie të caktuar apo të një cilësie të saj në kushte të njëjta; gabimin konstant e shkakton një faktor i posaçëm që ushtron ndikim në dukurinë që matet apo në cilësinë e saj.

GABIMI SISTEMATIK. Metodë gjurmuese e psikologjisë që emërton ato lloj gabimesh në të gjitha gjurmimet e tipit të njëjtë që ushtrojnë ndikim në përgjithësimin e rezultateve gjurmuese, kur veprohet sipas një sistemi të caktuar. Kur dyshohet, ka mundësi korrigjimi me anë të procedurave statistikore. Gabimi sistematik emërtohet edhe gabim konstant.

GABIMI STANDARD. Vlerë statistikore që tregon mundësinë e dallimit të vlerës së vërtetë të ndryshores psikologjike të provuar nga vlera standarde e asaj ndryshoreje (nga e mesmja aritmetike, shmangia standard, koeficienti i korrelacionit etj.). Llogaritet sipas formulës:

$$GS = \frac{\delta}{\sqrt{N}}$$

GS = Gabimi standard, δ = Shmangia mesatare kuadratike dhe N = Numri i përgjithshëm i rasteve.

GABIMI STANDARD I KOEFICIENTIT TËKORRELACIONIT. Shmangia standarde e lakores teorike të dendësisë së vlerave të përftuara nga një koeficient korrelacioni që merret nga hulumtimi i ndërlidhjes a korrelacionit te disa mostra, gjedhe apo kampione subjektesh. Nga përcaktimi i saktë i këtij gabimi mësojmë se në çfarë shkalle vlerësimi korrelativ (koeficienti i korrelacionit) i një grupi të caktuar subjektesh shmanget nga shkalla e vërtetë e koeficientit të korrelacionit që vlen për të gjitha popullatat.

GABIMI STANDARD I NDRYSHIMIT TË VLERAVE. Shmangia standard e lakores teorike të dendësisë, të përbërë nga dallimet e shumta që janë përftuar në matjen e së njëjtës dukuri te mostrat, gjedhet, a kampionet e veçanta. Përcaktimi i nivelit të gabimit standard tregon shkallën e dallimit të vlerës së arritur me matjen e një dukurie brenda grupit të subjekteve të caktuar nga dallimi i saktë i asaj vlere që përfaqëson gjithë popullimin.

GABIMI STANDARD I VLERËS SË MESME. Shmangia standarde e lakores teorike të dendësisë që shkaktohet nga një numër relativisht i madh vlerash mesatare të përftuara në mostrat, në gjedhet, në kampionet e veçanta. Përcaktimi i gabimit standard të vlerës mesatare është i rëndësishëm dhe i dobishëm, sepse na tregon shkallën e vlerës së shmangur nga vlera e vërtetë e gjithë popullimit.

GAL Franc Jozef (Franz Josef GALL). Mjek francez. Lindi në Tifenbron më 9.03.1758 dhe vdiq në Montrouge afër Parisit më 22.08.1828. Ka ushtruar ndikim në studimin e lidhjes së zhvillimeve psikike me sistemin nervor, duke pohuar se zhvillimi i aftësive psikike të njeriut është i varur nga shkalla e zhvillimit të disa pjesëve të trurit. Zhvillimi i këtyre pjesëve dallohet në bazë të perceptimit të relievit të kafkës, përkatësisht të perceptimit të nyjave të ashtit të kafkës ose të gungave që dalin në pah në sipërfaqen e kafkës së njeriut; nën këto gunga "gjenden më të zhvilluara" pjesët e

trurit dhe këto zhvillime mundësojnë përcaktimin e zhvillimit mbimesatar të aftësive të njeriut. Për këtë Franc Jozef Gali konsiderohet themelues i frenologjisë. Më vonë pas zhvillimit të fiziologjisë dhe të psikologjisë fiziologjike, supozimet e tilla u treguan qëndrime boshe, sepse zhvillimi më i madh ose më i vogël i disa pjesëve të trurit nuk ka lidhje me shtrirjen dhe vëllimin e tyre dhe aq më pak me shkallën më të lartë të zhvillimit të aftësive të njeriut. Megjithëkëtë, pikëpamja e Franc Jozef Galit ka kontribuar në nxitjen e angazhimeve anatomike, fiziologjike dhe psikologjike për zgjerimin dhe thellimin e dijeve mbi sistemin nervor dhe lidhjen anatomike dhe fiziologjike të proceseve të trurit me proceset psikike. Vepra kryesore e tij është: *"Anatomie und Physiologie des Nervensystem im allgemien und des Gehirns im bestethen"* – (*"Anatomia dhe fiziologjia e sistemit nervor në përgjithësi dhe e trurit në veçanti"*), 1814.

GALVANOTROPIZ/ËM, - MI. m. Mekanizëm biologjik i kafshëve që shkakton lëvizjen e trupit të kafshës në drejtim të burimit të dritës ose largimin e saj nga burimi i dritës. Drejtimi i trupit të kafshës dhe i aktivitetit të saj në drejtim të burimit të dritës emërtohet me termin galvanotropizëm pozitiv, kurse drejtimi i trupit të kafshës dhe i aktivitetit të saj në të kundërtën e burimit të dritës quhet galvanotropizëm negativ.

GANGLION, - I. m. I ardhur nga greqishtja *ganglion* "grup, gërshet". Grup qelizash nervore që e kanë trupin e tyre zakonisht jashtë Sistemit Nervor Qendror. Ganglioni përbën atë nyje qelizash nervore që me shtrirjen e trupit të tyre dhe të pjesëve të trupit kryejnë funksione të veçanta. Përgjatë palcës kurrizore gjenden dy rende nyjash nervore të tilla: rendi i nyjave të sistemit nervor vegjetativ dhe rendi i nyjave të sistemit nervor somatik. Ganglionet sipas rolit që kanë në trupin e njeriut ndahen në disa grupe, nga të cilat dallohen, krahas ganglioneve të palcës së kurrizit, ganglionet themelore, që përbëjnë masën e përhimët të sistemit nervor, sidomos të trurit të mesëm.

GANGLIONET BAZALE. Tërësi të ndërlidhura neuronesh që gjenden vetëm në pjesët e mesme të të dy hemisferave të trurit të madh dhe në pjesët e larta të trungut të trurit. Këtu hyjnë bërthamat subkortikale (bërthama bishtore, trupi i zbehtë i trurit, bërthama subtalamike dhe substancë e zezë e trurit. Çrregullimi i funksionit të tyre është i lidhur me disa forma të ankthit, sidomos me ankthin e përgjithshëm.

GARIM, - I. m. Formë e veprimtarisë ku një individ ose grup individësh angazhohen për të arritur rezultate cilësore sa më të larta dhe për të arritur në objektivin e caktuar sa më shpejt. Garimi shërben si nxitës i veprimtarisë dhe i zhvillimit të saj. Zbatohet në praktikën edukativo–arsimore, si edhe në tubime të veçanta ku matet dija nga një fushë e caktuar ose nga një lëndë mësimore, fuqia fizike e ngritjes së peshës, shpejtësia e vrapimit, e notit në forma të ndryshme, si edhe aftësia matematikore, artistike etj. e subjekteve të moshës së njëjtë ose të përafërt.

GAS. Shih – ***SINDROMA GAS.***

GATISHMËRI, - A. f. Përgatitja e mjaftueshme e organizmit të njeriut për të reaguar në mënyrë të caktuar

ndaj një ngacmuesi, ndaj një situate të pritur, ndaj një thirrjeje etj. Një gatishmëri të tillë e shkakton stërvitja e duhur, përvoja e fituar, interesimi, pjekuria psikike etj. Zakonisht gatishmëria për të reaguar në mënyrë të caktuar organizohet duke pasur për bazë dobinë dhe përfitimin individual nga përvoja e fituar. Sipas gatishmërisë së organizmit ka forma të reagimit që kanë bazë organike, por shumë prej formave reaguese me gatishmëri paraprake kanë mbështetje në përvojën e fituar dhe në shfrytëzimin e proceseve kognitive.

GATRI EDVIN (Edwin GUTHRIE). Psikolog amerikan. Lindi në Linkoln më 1886 dhe vdiq në Uashington më 1959. I njohur më tepër me kontributet e tij në fushën e psikologjisë së të mësuarit. Që nga fillimi i jetës studentore u orientua në studimet e psikologjisë, të cilat i përfundoi me sukses në Universitetin e Nebraskës. Doktoratën në psikologji e përfundoi në Universitetin e Pensilvanisë më 1912. Gjatë kësaj kohe u zhvillua dhe u formua në frymën e zhvillimit të hovshëm të bihejviorizmit. Ka qenë profesor i psikologjisë në Universitetin e Uashingtonit derisa doli në pension. Autoritet shkencor në teorinë e të mësuarit, duke iu përmbajtur rreptësisht parimeve dhe masave të psikologjisë akademike. Theksohet si asociacionist në literaturën psikologjike anglosaksone. Veprat kryesore të tij janë: *"The Psychology of Learning"* – (*"Psikologjia e të mësuarit"*), 1935 (ribotuar e përpunuar më 1952); *"The Psychology of Human Conflict"* – (*"Psikologjia e konfliktit njerëzor"*), 1938; *"Conditioning"* – (*"Të ushtruarit"*), 1942.

GESHTALT, - I. m. I ardhur nga gjermanishtja dhe koncept themelor i psikologjisë geshtaltiste. Termi geshtalt është përkthyer në gjuhë të tjera, përfshirë edhe shqipen me formë, konfiguracion etj., por në shqipe vështirë mund të gjendet termi adekuat që emërton kuptimin e saktë. Geshtalt përfaqëson tërësinë e objektit, situatës, dukurisë psikike etj. si integritet i posaçëm elementesh, integritet ky, që përjetohet si tërësi që nuk formohet nga elementet përbërës të saj. Geshtalti është cilësi e posaçme fizike, biologjike, sociale e psikologjike që nuk përbëhet nga elementet përbërës të asaj tërësie. Cilësia e tërësisë është e ndryshme nga shuma e elementeve përbërës të asaj tërësie. Melodia nuk është renditje tonesh, perceptimi nuk është shumë ndijimesh etj., por cilësi e pavarur. Termi lindi në fushën e hulumtimit të perceptimit qysh nga fillimi i dhjetëvjeçarit të dytë të shekullit të njëzet, por termi geshtalt u përhap shpejt në hulumtimin e emocioneve, të kujtesës, të mendimit, të të mësuarit dhe të motivacionit. Termi geshtalt i përket psikologjisë geshtaltiste.

GESHTALTI AUTOKTON. I ardhur nga greqishtja *autokthon* "i vetëlindur" dhe nga gjermanishtja *geshtalt* "formë". Geshtalti autokton është strukturë integruese e perceptimit të objektit, të njeriut, të situatës etj., e formësuar më shumë nga faktorët e brendshëm, faktorët burimorë, vetërregullues të organizmit sesa nga ata të jashtëm.

Burimet:

Christian von Ehrenfels: *"Uber "Gestaltqualitaten"* – (*"Mbi cilësinë Geshtalt"*), Vierteljahresschrift für wissenschaftliche Philosophie, 14 Nachdruck in: Ferdinand Wenihadl (Hg.)

(1960: Getalthaftes Sehen. Darmstadt: Wissentschaftliche Buchgesellschaft, 11 – 43, 1890.
Maria Fürst: *"Psychologie"* – (*"Psikologjia"*), Wien, 1991, fq. 15 – 27.
Max Wertheimer: *"Untersuhungen zur Lehre von Gestalt"* – (*" Gjurmimi i të mësuarit mbi geshtaltin"*), 1925.
Kurt Koffka: *"Principles of Gestalt Psychology"* – (*"Parimet e psikologjisë geshtaltiste"*), 1935.
Wolfgang Köhler: *"Gestalt Psychology" and Introduction to New Concepts in Modern Psychology – "Psikologjia Geshtalt dhe hyrje në konceptet e reja të psikologjisë moderne"*), Mentor Books, 1965.
Terry F. Pettijohn: *"Psikologjia - Një hyrje koncize", S*htëpia Botuese "LILO', Tiranë, 1996, fq. 131 – 133.

GEZEL Arnold L. (Arnold L. GESELL). Psikolog dhe mjek amerikan. Lindi më 1880 dhe vdiq më 1961. Kreu studimet për psikologji dhe mjekësi, por doktoroi në psikologji. Qysh më 1931 në Universitetin e Jelit ngriti Klinikën për Zhvillimin e Fëmijëve (Clinic of Child Development) dhe ka qenë drejtor i kësaj klinike derisa doli në pension. Prej vitit 1926 ishte redaktor i revistës "Journal of Genetic Psychology" ("Revista e psikologjisë gjenetike"). Një vit para pensionimit u zgjodh anëtar i Akademisë Kombëtare të Shkencave dhe anëtar i Akademisë së Arteve dhe Shkencës. Mbeti i njohur me kontributet e tij në zhvillimin e psikologjisë së fëmijëve dhe të psikologjisë zhvillimore. Në zhvillimin e psikologjisë së fëmijëve është i njohur me përcaktimin e normave të zhvillimit të fëmijëve, sidomos të zhvillimit fizik dhe psikomotorik. Veprat kryesore të tij janë: *"The Mental Growth of the Pre-school Child"* – (*"Rritja mendore e fëmijëve parashkollorë"*), 1925; "*The First Five Years of Life: A Guide to the Study of the Preschool Child"* – (*"Pesë vitet e para të jetës: udhërrëfyes për studimin e fëmijëve parashkollorë"*), 1940 (me bashkëpunëtorë); *Child Dewelopement: An Introduction to the Study of Human Growth"* – (*"Zhvillimi i fëmijës: Hyrje në studimin e rritjes njerëzore"*), *1949 (me bashkëpunëtorë)* etj.

GËNJESHT/ËR, - RA. f. Pohim ose mohim i paraqitur nga ana e njeriut që nuk përputhet me të vërtetën, nuk i përgjigjet realitetit. Gënjeshtra bëhet me qëllim të fshehjes së të vërtetës për t`ia arritur një qëllimi të caktuar.

GËNJESHTËRT (I, E). mb. Që është i gënjeshtërt, që ka të bëjë me gënjeshtër.

GËNJESHTRA TE FËMIJËT. Formë e paraqitjes të së pavërtetës nga ana e fëmijëve që shkaktohet nga ndjenjat, nga moskuptimi i ngjarjeve, nga imagjinata dhe nga përfitimi që ai ka prej gënjeshtrave. Në paraqitjen e gënjeshtrave te fëmijët rol të dukshëm luan edhe konstatimi se edhe të tjerët thonë gënjeshtra dhe prej tyre kanë përfitime. Gënjeshtra të tilla paraqiten më tepër në moshën e hershme të fëmijërisë, se sa në atë të vonshmen.

GËZIM, - I. m. Emocion i posaçëm të cilin e karakterizon kënaqësia e veçantë e individit për qëllimin e arritur, për realizimin e dëshirës, për detyrën e përfunduar me sukses etj. Intensiteti i gëzimit varet nga vlerësimi i rëndësisë së qëllimit dhe nga "investimi" i përpjekjeve të njeriut për realizimin e plotë të tij, pikërisht nëse këtë e kemi arritur befasisht dhe nëse dëshira për të arritur në qëllimin e caktuar ka qenë e fuqishme dhe afatgjatë. Emocioni i gëzimit përjetohet me ndryshime fiziologjike, që janë të dukshme sidomos në fytyrën e njeriut.

GLAUKOMË, - A. f. Në patologjinë e syrit i ardhur nga greqishtja *glaucoma* "katarakt". Glaukoma është formë e atrofizimit të nervit optik, që shkaktohet nga shtypja e brendshme e syrit. Dallohet glaukoma kronike akute dhe glaukoma kronike. Gjendja e tillë patologjike ushtron ndikim negativ në procesin e të parit dhe, nëse nuk merren masa shëruese, kjo gjendje mund të çojë në verbëri.

GLUKOZË, - A. f. Sheqeri i rrushit – pjesëmarrës i rëndësishëm i proceseve metabolike të organizmit. Sheqeri i rrushit qarkullon në gjak dhe është burim i rëndësishëm i energjisë për funksionimin e qelizave, të indeve dhe organeve e sistemit të tyre. Nëse bie sasia e glukozës në gjak paraqiten pengesa të ndryshme organike që shoqërohen me frikë intensitetesh të ndryshme dhe me shfaqje të panikut.

GOLDSHTAJN Kurt (Kurt GOLDSCHTEIN). Psikiatër dhe neurolog gjerman. Lindi më 1878 dhe vdiq më 1956. Profesor në Universitetin e Kenigsbergut dhe në Universitetin e Berlinit. Më 1933 u zhvendos në Amsterdam (Holandë). Një vit më pas emigroi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku u angazhua në Universitetin e Kolumbisë, më pas në Universitetin e Harvardit dhe në fund të karrierës profesionale dhe shkencore u vendos si studiues në Institutin Psikiatrik të Nju Jorkut. Ishte ndër përkrahësit e mëdhenj të psikologjisë geshtaltiste. Në mbështetje të gjurmimeve të dëmtimit të sistemit nervor të të plagosurve në Luftën I Botërore arriti në përfundimin se parimet e psikologjisë geshtaltiste vlejnë edhe për funksionimin e sistemit nervor; pasojat e njerëzve të plagosur në kokë në zhvillimin e procesit të mendimit, të të folurit etj. nuk ishin të lidhur me lëndimin e ndonjë qendre të cipës së trurit të madh, por me funksionin e tërësishëm të cipës së trurit të madh. Vepra kryesore e tij është: *"Der Aufbau des Organismus"* – (*"Ndërtimi i organizmit"*), 1934.

GOLEMAN Daniel (Daniel GOLEMAN). Lindi në Stocktony (Kaliforni) më 1928. Kreu studimet universitare në kolegjin Amherst dhe mbrojti doktoratën për psikologji në Universitetin e Harvardit. Është psikologu i parë që u mor me studimin e inteligjencës emocionale, duke dhënë sqarime për natyrën, funksionin dhe matjen e saj. Këtë çështje e studioi në radhë të parë me qëllim të përmirësimit të suksesit të nxënësve në shkollë, sepse nga vëzhgimet e kontrolluara dalloi ngecjen e tyre në arritjen e sukseseve më të larta, për shkak të ndikimit të pakontrolluar të inteligjencës emocionale te shumë nxënës. Nga biografia e tij mësojmë se për dymbëdhjetë vjet rresht ka qenë konsulent në gazetën prestigjioze "The New York Times", duke botuar artikuj për shkencën e bihejviorizmit dhe mendimin shkencor për trurin dhe rolin e tij në zhvillimin dhe organizimin e sjelljeve. Ishte redaktor i lartë i revistës "Psychology Today" - ("Psikologjia sot"). Veprat kryesore të tij janë: *"Working with Emotional Intelligence"* – (*"Puna dhe inteligjenca emocionale"*), London: Blomsbury, 1998; *"Mendja medituese",* 1996; *"Të drejtuarit kryesor dhe emocionet destruktive",* 2002 (në bashkëpunim me Richard Boyatsis dhe Amnie McKee).

GOLTON Frensis (Frensis GALTON). Studiues anglez i antropologjisë dhe i psikologjisë. Lindi më 1822 dhe vdiq më 1911. Kreu studimet për mjekësi dhe matematikë në Universitetin e Kembrixhit. Ishte anëtar i "Royal society". I lindur dhe i rritur në një mjedis farefisnor të dhënë pas studimeve shkencore (me afërsi familjare me Çarls Darvinin) Frensis Goltoni u mor me studime biometrike, statistike dhe gjenetike. Nga këto fusha e avancoi metodologjinë hulumtuese edhe në psikologji. Këto studime iu deshën për të gjurmuar tiparet psikologjike dhe çështjen e trashëgimisë së tyre. Është themelues i eugjenikës. Sipas tij tiparet psikologjike të njeriut trashëgohen njësoj si ato trupore që trashëgohen sipas ligjeve gjenetike. Sipas tij prindërit kontribuojnë në zhvillimin e pasardhësve të tyre me ½, gjyshërit me ¼, stërgjyshërit me 1/8 etj. Për të argumentuar këtë qëndrim Frensis Goltoni ka zbatuar metoda dhe procedura të posaçme gjurmuese, si: anketën, matjen e zhvillimit të inteligjencës në bazë të reagimit të të provuarve ndaj ngacmuesve të shqisave dhe matjes së kohës së këtij reagimi. Teoria e rrënjëve të trashëgimisë nuk arriti të argumentohet. Është themelues i institutit të parë eugjenik dhe i laboratorit Galton në Universitetin e Londrës, i cili qe qendër për studimet e psikologjisë diferenciale, si edhe bashkëthemelues i revistës "Biometrika". Frensis Goltoni është ndër të parët që zbatoi metodat kuantitative për gjurmime psikologjike. Për këtë arsye kontributi i tij në zhvillimin e psikologjisë ka të bëjë më tepër me zhvillimin e metodave hulumtuese në psikologji, se sa me rezultatet e arritura në fushën e psikologjisë diferenciale.

GOMARI BURIDON. Emërtim i çuditshëm i një gomari, që, i ndodhur ndërmjet dy mullarëve bari të thatë, përkatësisht të sanës gati, nuk ngordhi së urituri duke mos pasur fuqi të vendos cilit mullar t`ia mësyjë. Në psikologji merret si shembull i një situate konfliktesh tërheqëse së dyfishtë: dy objekte kanë fuqi tërheqëse të njëjtë për zgjidhjen e një situate, në rastin në fjalë të urisë, por njeriu nuk është në gjendje të vendos cilin objekt ta pushtojë dhe të bëjë zgjidhjen e asaj situate. Sipas shembullit "Gomari Buridon" në periudhën skolastike shpjegohet varësia e vullnetit të njeriut nga motivet. Në rrethana të barabarta objektesh tërheqëse, si edhe në rrethana motivesh të kundërta, kur njeriu domosdo duhet ta pushtojë vetëm njërin objekt nga dy të mundshmit, përkatësisht nuk ka dëshirë të gjendet në asnjërën situatë, por njërën domosdo duhet ta përqafojë duke u larguar nga një situatë e vështirë, atëherë njeriu vështirë vendos, vullneti i tij (në kuptimin e atëhershëm) luhatet. Kështu, e shpjegoi raportin motiv – objekt, dëshirë–situatë skolastiku francez i shekullit XIV Zhan Buridon (Johannes Buridanus, 1295 – 1356).

GONADË, - A. f. I ardhur nga greqishtja *γενώ* "lindje". Gjëndrat seksuale mashkullore - testikujt dhe funksionimi i tyre dhe ovaret – gjëndrat seksuale femërore dhe funksionimi i tyre, të cilat sekretojnë hormone seksuale, që ndikojnë në sjelljet seksuale të njeriut dhe në paraqitjen e ndryshimeve seksuale dytësore te meshkujt dhe te femrat. Aktivizimi i tyre fillon

në kohën e pubertetit. Gjëndrat seksuale të meshkujve prodhojnë spermatozoide, ndërsa ovaret prodhojnë hormone të veçanta.

GONADOTROPIN/Ë, - A. f. Hormon i gonadës që prodhohet në pjesën e përparme të hipofizës dhe nxit veprimin e gjëndrave seksuale.

GRADIENT, - I. m. I ardhur nga latinishtja *gradiens* "që ecën, që bën hapa". Gradienti është ndryshim proporcional në pikëpamje sasiore i një procesi, reagimi, vetie etj. në raport me njësinë e caktuar të kohës dhe i ndryshores që paraqet grafikisht një ndryshim të tillë.

GRADIENTI I AFËRSISË. Synimi i organizmit për t`iu afruar sa më shumë qëllimit apo objektivit të parashtruar dhe rritja e intensitetit të këtij synimi sa më shumë që njeriu i afrohet qëllimit të aktivitetit të tij.

GRADIENTI I EFEKTIT.

Ndikimi i reagimit të përforcuar ose të penguar në reagimin që vjen para ose pas tij. Në këto reagime (para ose pas reagimit të përforcuar ose të penguar) ndihet efekti përforcues ose pengues i reagimit. Sa më afër qëllimit të përforcuar ose të penguar të jetë organizmi i njeriut, aq më i efektshëm është gradienti dhe, përkundrazi, sa më larg të jetë reagimi përforcues ose pengues nga reagimi paraprijës ose pas tij, aq më i vogël do të jetë ndikimi i efektit të reagimit përforcues ose pengues në reagimet para dhe pas tij.

GRADIENTI I LARGIMIT. Rritja e intensitetit të organizmit për t`iu shmangur qëllimit a objektivit të padëshirueshëm dhe negativ, por të domosdoshëm, sa më shumë njeriu i afrohet këtij objektivi të padëshirueshëm dhe negativ. Përvoja ka treguar se qëllimi a objektivi negativ bëhet më shpejt edhe më shumë i keq, i dëmshëm, i padëshirueshëm etj. se sa afrimi i njeriut ndaj qëllimit a objektivit pozitiv e të dëshirueshëm. Gradienti i largimit është vërtetuar më tepër në veprimet e kafshëve: në eksperimentet me minj sa më shumë që minjtë i afrohen bllokut metalik të elektrizuar, aq më shumë ata kanë treguar aktivitet për t`iu larguar këtij blloku.

GRADIENTI I PËRGJITHËSIMIT. Sa më të ngjashëm të jenë reagimet ndaj ngacmuesve të rinj, por të ngjashëm edhe me ngacmuesit e hershëm, aq më i madh është përgjithësimi i përvojës dhe besimi i njeriut se edhe te ngacmuesit e rinj reagimet do të paraqiten në formë, në intensitet etj. të njëjtë, dhe, sa më të ndryshëm të jenë ngacmuesit nga ngacmuesi burimor, efekti i përgjithësimit do të jetë më i vogël, përkatësisht reagimet ndaj këtyre ngacmuesve do të jenë aq më të dobëta dhe të rralla. Kjo ndodh nga përgjithësimi i përvojës së njeriut për të reaguar ndaj ngacmuesve të njëjtë, të ngjashëm dhe të ndryshëm.

GRADIENTI I TEKSTURËS. Faktor i posaçëm i perceptimit të thellësisë së objekteve, por jo i vetmi. Gradienti i teksturës ka të bëjë me prirjen e zmadhuar të dallimit të shpejtësisë apo dendësisë së objekteve të mprehta nga largësia e vëzhguesit prej këtyre objekteve. Kjo do të thotë se sa më larg të gjendet njeriu nga tekstura e objekteve, aq më e madhe duket shpeshtësia e dendësia e tyre dhe, përkundrazi, sa më afër të gjendet njeriu nga tekstura e objekteve, aq më të rrallë duken ata në rrjetëzën apo retinën e syrit të tij. Këtë e ilustron figura e mëposhtme:



GRAFIK, - U. m. I ardhur nga greqishtja *γράφω* "shkruaj". Paraqitja grafike e veçantë e raporteve ndërmjet vlerave sasiore të dy ndryshoreve psikologjike të përftuara nga matja e zhvillimit të tyre. Paraqitja grafike e këtyre raporteve ngre lart shkallën e konkretizimit të raporteve ndërmjet atyre ndryshoreve. Të dhënat dhe raportet e tilla mund të paraqiten me anën e lakores së formës së veçantë në sistemin koordinativ, sikurse edhe me anën e figurave të madhësive të ndryshme që përfaqësojnë sasitë e caktuara dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre.

GRAFOLOGJI, - A. F. I ardhur nga greqishtja *γράφω* "shkruaj" dhe *λόγος* "shkencë". Interpretim i vetive psikike dhe i zhvillimit të tipareve të tyre në bazë të analizës së dorëshkrimit të një individi të caktuar. Interpretimi i tillë niset nga supozimi se ndërmjet karakteristikave të dorëshkrimit të një individi dhe vetive e tipareve të veçanta të personalitetit të tij, si edhe motiveve të pavetëdijshme, gjendjes emocionale dhe konflikteve ekziston një lidhje e caktuar. Këto lidhje dorëshkrimi me cilësitë e tij individuale, si dorëshkrimi me shkronja të mëdha, të ndara njëra nga tjetra etj. shprehin vetëbesimin e dorëshkruesit, kurse dorëshkrimi me shkronja të imta, të afruara njëra me tjetrën dhe me margjina të vogla shpreh shtypjen e tij nga ana e ngjarjeve të botës së jashtme dhe dobësinë e tij për t`i përballuar këto shtypje o ndrydhje. Grafologjia rrjedh nga studiuesi francez Abot Z. H. Mishon (Abbot J. H. Michon, 1806 – 1881). Themelues i grafologjisë konsiderohet se është filozofi dhe psikologu gjerman Ludvig Klages (Ludwig Klages, 1872 – 1956), i cili u përpoq t`i japë grafologjisë karakterin e një disipline shkencore, por pa sukses.

GRAFOMANI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *γράφω* "shkruaj" dhe *μανία* "marrëzi, dëshirë e sëmurë". Dëshirë jonormale e pakontrolluar për të shkruar shumë duke mos pasur kritere për vlefshmërinë e asaj çfarë shkruan. Dëshira e tillë shfaqet për një kohë të gjatë te grafomanët, mandej kërkon angazhim dhe mund të madh.

GREGAR, - E. mb. I ardhur nga latinishtja *grex* "kope", grigjë", që përcakton prirjen e lindur të kafshëve, përkatësisht instinktin e të qëndruarit së bashku me të tjerët që i përkasin llojit të vet. Instinktin gregar e dallojmë te llojet e ndryshme të insekteve, te majmunët, te peshqit etj. Uliam MekDugal (William McDougall, 1871 – 1938) e ka trajtuar motivin gregar të njeriut – si prirje të lindur për të jetuar dhe zhvilluar jetë të përbashkët shoqërore. Derivate të këtij motivi janë synimet e njeriut për të marrë pjesë në koncerte,

të lojëra, në teatër etj., si edhe për të qenë pjesëtar i një grupi, i një partie, madje edhe i një kombi etj. Nga ky motiv rrjedh, po ashtu, edhe pakënaqësia dhe shqetësimi i njeriut, kur ky gjendet jashtë grupit social, jashtë bashkësisë fetare, artistike, shoqatës profesionale etj.

GRIMASË, - A. f. I ardhur nga frëngjishtja. Formë e veçantë e paraqitjes së emocioneve në bazë të ngërdheshjes, të shtrembërimit, të pozitës dhe të lëvizjes së muskujve të fytyrës, por grimasa mund të jetë edhe shfaqje e dëshirës, qëndrimit, synimit etj. Grimasa mund të jetë e përkohshme dhe e përhershme. Grimasa e përkohshme ka të bëjë me gjendjen e shkurtër të manifestimit emocional, kurse grimasa e përhershme rrjedh nga çrregullimet neuromuskulare, siç është paraliza e muskujve të fytyrës.

GROPA QENDRORE E RRJETËZËS (RETINËS). Term i anatomisë me kuptim të posaçëm për psikologjinë. Gropa qendrore e rrjetëzës ose e retinës është gropa qendrore e njollës së verdhë e njohur me termin latin *macula lutea*. Në gropën qendrore gjenden kunjëzat e reagimit ndaj dritës dhe ngjyrave, arteriet e holla të gjakut, ganglionet etj. Kunjëzat në gropën qendrore të kësaj rrjetëze janë të dendur dhe reagojnë ndaj dritës dhe ngjyrave, duke ndikuar edhe në përcaktimin e mprehtësisë së të parit.

GRUP, - I. m. Në psikologjinë sociale, grumbull i organizuar individësh të cilët kanë afërsi psikologjike ndërmjet tyre dhe kryejnë aktivitete sipas një qëllimi të përbashkët të tyre. Aktiviteti i grupit kryhet mbi bazën e interesave të përbashkëta dhe qëllimit të njëjtë, të pikëpamjeve relativisht të njëjta ose të ngjashme për zhvillimet e përgjithshme dhe, si i tillë, grupi funksionon sipas normave dhe identitetit të tij. Psikologjia sociale merret me disa lloj grupesh shoqërore a sociale, ndër të cilët dallohen:

a. **Grupi parësor** – Grup individësh me një numër të vogël anëtarësh, që kanë qëllim të përbashkët të veprimtarisë, përcaktime, synime e vlera të përbashkëta, si edhe lidhje të ngushta emocionale;

b. **Grupi dytësor** – Grup me pak ose shumë anëtarë, të cilët kanë pikëpamje, interesa dhe qëndrime të ngjashme, me lidhje jo të forta emocionale ndërmjet tyre, por me norma të sjelljeve që kanë të bëjnë vetëm me një strukturë, përmbajtje e karakteristikë të jetës dhe të aktivitetit të tyre (klubet, shoqatat profesionale etj.);

c. **Grupi formal** – Grup individësh që e kanë përcaktuar saktësisht qëllimin, raportet ndërmjet tyre dhe secili ka detyrën, pozitën dhe rolin e vet të caktuar. Grupe të tilla mund të jenë: organizatat ushtarake, institucionet shkollore, organizatat ekonomike etj.;

d. **Grupi joformal** – Grup individësh të lidhur ndërmjet tyre spontanisht, me komunikime të zakonshme, me bindje, interesa, synime etj. të ngjashme dhe të bashkuar rreth një qëllimi të përbashkët (grup për të ndihmuar të pastrehët, të varfrit etj.);

e. **Grupi natyror** – Grup individësh të lidhur njëri me tjetrin nga afërsia e vendbanimit, e lagjes, e rajonit etj.;

f. **Grupi i madh** – Grup i përbërë nga një numër i madh anëtarësh, përkatësisht nga 30 deri në qindra anëtarë, që

kanë synime të ndryshme e detyra të ndërlikuara dhe pozita e role të veçanta. Të tillë janë grupet, si: komuniteti fetar, policia, partia politike etj. Lidhjet emocionale janë sipërfaqësore, personaliteti individual është i shkrirë në atë të përgjithshëm, përkatësisht në atë të grupit etj.;

g. **Grupi i vogël** – Grup i përbërë prej 2 – rreth 20 vetash me qëllime të thjeshta dhe me detyra individuale të ngjashme. Kjo përbërje mundëson kontakte të shpeshta dhe të ngushta ndërmjet anëtarëve të grupeve të tilla. Të tillë mund të jenë grupet e organizuara në formë kryesie, eskadrile, sekretariati etj.;

h. **Grupi i interesit** - Grup individësh të lidhur ndërmjet tyre me interesin e përbashkët. Interesi i përbashkët mund të jetë i shumëllojshëm, si: interesi për mbrojtjen e mjedisit, të kafshëve të rralla, të pyjeve etj.; interesi i tyre është i lidhur me ndikimin që bëjnë në mendimin ose opinionin e përgjithshëm ose në qendrat e fuqishme për të ndryshuar qëndrimet dhe sjelljet me qëllim të mbrojtjes së mjedisit, të kafshëve, të pyjeve etj.

GRUPET T. Term i psikologjisë së Kurt Levinit (Kurt Lewin, 1890 – 1947) që emërton grupe të vogla individësh, të cilët ushtrohen në zhvillimin e ndjeshmërisë shoqërore për nevojat, përjetimet, pengesat, problemet, vështirësitë, konfliktet e brendshme të të tjerëve, për varësinë reciproke ndërmjet anëtarëve të grupeve sociale, për sjelljet dinjitoze dhe për vlerat shoqërore e rëndësinë e tyre në zhvillimin e raporteve ndërmjet tyre. Ndërgjegjësimi i tyre për të gjitha këto ushtron ndikim pozitiv edhe në njohjen e saktë të vetes dhe në zgjidhjen konstruktive të konflikteve ndërpersonale. Ka ushtruar ndikim në zhvillimin e formave të ndryshme të psikoterapisë grupore.

GRUPI EKSPERIMENTAL. Subjektet e një prej grupeve të eksperimentit që i nënshtrohet ndikimit të ndryshores së pavarur ose faktorit eksperimental. Grupi eksperimental është i barabartë me grupin kontrollues dhe dallohet prej tij vetëm nga ndikimi i faktorit eksperimental, ose i ndryshores së pavarur që provohet nga efekti i kësaj ndryshoreje.

GRUPI KONTROLLUES. Grup ekuivalent me grupin eksperimental që ndryshon nga ai vetëm nga mosndikimi i faktorit eksperimental ose i ndryshores së pavarur në të. Përbëhet nga subjektet e së njëjtës moshë, gjini, dijesh relativisht të nivelit të njëjtë etj. Rezultatet e arritura në testin provues, p.sh., në testin didaktik nga ana e këtij grupi krahasohen me rezultatet e të njëjtit test të grupit eksperimental, ku ka vepruar një faktor (metoda tjetër e të nxënit të përmbajtjeve të njëjta mësimore) dhe në bazë të përpunimit statistikor arrihet në përfundim për shkallën e ndikimit të faktorit eksperimental në suksesin e arritur të testit didaktik.

GRUPI MARGJINAL. Në psikologjinë sociale, grup individësh që ka arritur t`i ruajë zakonet, normat e vlerat kulturore të veta përballë normave e vlerave të kulturës së përgjithshme të një mjedisi të gjerë. Grupet margjinale janë grupet e atyre që kanë migruar nga mjediset burimore të tyre e janë vendosur në një mjedis të gjerë

me traditë, norma e vlera kulturore të tjera, por grupi margjinal, edhe pse për një kohë të gjatë qëndrimi dhe zhvillimi në mjedis joburimor, ka arritur t`i ruajë vlerat kulturore të etnisë së tij. Ai ka arritur t`i përshtatet vetëm pjesërisht traditës e vlerave kulturore të një mjedisi tjetër.

GRUPI NORMATIV. Grup subjektesh që i nënshtrohet një hulumtimi, i cili ka për synim përcaktimin e normave të sjelljes së tyre në një fushëveprim të caktuar.

GRUPI REFERENT. Grupi apo kolektivi me të cilin individi identifikohet dhe lidhet emocionalisht duke përdorur normat, rregullsitë dhe sjelljet e përbashkëta të atij grupi si burim të qëndrimeve dhe vlerave të tij, përkatësisht duke krahasuar qëndrimet dhe vlerat personale me ato të atij grupi, me qëllim të përmbajtjes së rregullsive e normave të sjelljeve të përbashkëta.

GRUPIM, - I. m. 1) Procesi i ndarjes së të dhënave e fakteve të mbledhura dhe i organizimit të tyre në klasa me skaje të përcaktuara saktësisht, ku njihen plotësisht që nga fillimi i klasës faktet me intensitet më të ulët dhe në fund të asaj klase faktet me intensitet më të lartë. 2) Grupimi në teorinë e zhvillimit mendor të fëmijëve është faza e zhvillimit të operacioneve formale – logjike, kur fëmija arrin të kalojë kufirin e njëjësit, përkatësisht të një shishe uji, një luleje, një guri etj., dhe fillon t`i klasifikojë objektet, dukuritë etj. e t`i lidhë këto në një sistem lidhjesh reciproke. Kjo fazë fillon të zhvillohet rreth moshës 7 – 8-vjeçare**.**

GRUPIMI I FREKUENCAVE. Vendosja e frekuencave, përkatësisht e rezultateve të konstatuara në kuadrin e klasave të veçanta që janë klasifikuar në përputhje me intervalin e fillimit dhe të mbarimit të secilës klasë. Sipas grupimit të frekuencave secila klasë ka numrin e përgjithshëm të rezultateve që ka arritur grupi i caktuar i subjekteve të testuar.

GRUPIMI I TË DHËNAVE PSIKOLOGJIKE. Klasifikimi i të dhënave, i vlerave sasiore psikologjike në klasa të dhënash të posaçme sipas përmasave të përkufizuara saktësisht.

GRUPIMI SINTETIK. Tërësia e të dhënave, e fakteve të përgjithshme që formohet nga të dhënat e faktet e veçanta dhe nga lidhja e këtyre të dhënave e fakteve ndërmjet tyre. Grupimi sintetik është lidhja e pikave harmonike në një tërësi perceptuese të veçantë**.**

GRUPOR, - E. mb. Që ka të bëjë me grupin, që i përket grupit.

GULM, - I. m. Gjendje psikike e njeriut, të cilën e karakterizon pasiguria në mundësitë dhe në aftësitë e tij për të shkaktuar ndryshime në një situatë, në një dukuri, në një proces etj. dëmprurës për dinjitetin, për pozitën shoqërore, ekonomike etj. të individit. Intensiteti i gulmit varet nga rëndësia negative e asaj situate, dukurie, procesi etj. për një individ të caktuar.

GURMAZ, - I. m. Organi i frymëmarrjes dhe i prodhimit të zërit. Te njeriu gjatësia e tij është 6 cm. Skeleti i gurmazit përbëhet nga kërcorët që kanë formën e piramidës dhe nga kërcorët çift me tri kërcorë tek. Nga kërcorët nisen fijezat lidhore me pjesën e brendshme të kërcorit mbrojtës, duke formuar në këtë mënyrë korda zanore

në njërën anë dhe në anën tjetër, si edhe zbrazëtirën ndërmjet tyre. Zëri lind nga dridhja e kordave zanore, të cilat i shkakton ajri që del jashtë prej mushkërive. Ky zë formësohet në fjalë të posaçme me anën e aparatit të të folurit.

GUSHË, - A. f. Çrregullimi i gjëndrës tiroide që shfaqet me deformim të muskujve të fytit. Gusha ushtron ndikim negativ në të dëgjuar e në të folur, sikurse edhe në zhvillimin e mendimit dhe të emocioneve. Gusha shkaktohet nga sasia e pamjaftueshme e jodit në organizëm, si edhe nga faktorë të tjerë.

GUXIM, - I. m. Gatishmëria e njeriut për kryerjen e një detyre, qëndrimi, vendimi etj. pa pasur frikë nga pengesat, vështirësitë dhe nga rreziqet.

GYPI I EUSTAKUT. Gyp muskulor që lidh pjesën e veshit të mesëm me pjesën anësore të gurmazit. Gypi i eustakut kryen funksionin e barazimit të shtypjes ajrore nga të gjitha anët e timpanit, duke mundësuar në këtë mënyrë dridhjen e timpanit.

GYPI NEURAL. Në embriologji emërton atë strukturë embrionale nga e cila zhvillohet sistemi nervor. Sistemi nervor fillon të zhvillohet në anët e indeve të ektodermës dhe nga anët e këtyre indeve fillon të formohet gypi neural që shtrihet në trupin e qelizës nervore. Nga pjesa e zbrazët e këtij gypi fillojnë të zhvillohen në të ashtuquajturat "dhomat" ose zbrazëtirat e trurit, përkatësisht katër zgjerime të mbushura me lëng të pastër dhe të pangjyrë që quhet likuor.

GJ

Gj = Simbol i emërtimit të faktorit të përgjithshëm ("general factor" ose të faktorit të përgjithshëm të inteligjencës, përkatësisht të aftësisë së përgjithshme në teorinë e Çarls Spirmanit (Charles Spearman (1863 – 1945). Shih – ***TEORIA DYFAKTORIALE E INTELIGJENCËS.***

GJAKIM, - I. m. Dëshirë me intensitet të lartë, lakmi e madhe e njeriut për diçka shumë të rëndësishme për të. Ndryshon nga dëshira e zakonshme, sepse gjakimi për diçka, pikërisht lakmia për një objektiv të caktuar ka vlerën e gjakut të njeriut. Në gjakim objektivi është saktësisht i përcaktuar dhe dëshira e madhe e nivelit të lakmisë jo vetëm që është ide, përfytyrim mendor i vetëdijshëm, por bashkë me të, gjakimi shoqërohet me veprim të drejtuar dhe të përqendruar në objektivin e gjakimit. Objektivi i gjakimit e pushton mendimin, proceset emocionale dhe proceset motivuese të tij.

GJAKMARRJE, - A. f. Institucioni i së drejtës dokesore të trashëguar; forma më e vrazhdë dhe më e egër e hakmarrjes ndaj vrasësit, ndaj të cilit, ose ndaj njërit prej anëtarëve të familjes a të fisit, familja e të vrarit kërkon hakmarrje ekuivalente sipas parimit "kokë për kokë", "sy për sy". Gjakmarrja ka veti të theksueshme psikologjike dhe këto shfaqen, së pari, në karakterin e fuqive motivuese dhe në formimin e tyre të lidhur ngushtë me bazën emocionale, shih –***HAKMARRJA.*** Gjakmarrja është e pranishme në mjediset kulturore rurale dhe relativisht të prapambetura të disa popujve. Kjo është e zhvilluar kryesisht te Shqiptarët e Veriut të Shqipërisë, të Kosovës, në Mal të Zi, në Korsikë etj. Gjakmarrja u tregua shumë rezistuese ndaj përpjekjeve për ta mposhtur e zhdukur.

GJEDH/E, - JA. f. Në statistikën psikologjike po emërtohet edhe me termin kampion. Gjedhet emërtojnë konceptin e një numri të caktuar individësh të një popullate të madhe. Anëtarët e gjedhes zgjidhen nga një popullatë e madhe, sipas kriterit të përfaqësimit sa më të mirë, përkatësisht që kanë cilësitë relevante të të gjithë popullatës, sipas kriterit sa më të saktë numerik të gjithë popullatës, të cilin e përfaqëson gjedhe ose kampioni. Gjedhe e tillë zgjidhet për qëllime

hulumtuese. Gjedhe dhe përcaktimi i saj ka rëndësi të madhe në hulumtimet psikologjike, sepse pothuaj të gjitha ndryshoret psikologjike që hulumtohen mbështetën në rezultatet e arritura nga pjesëtarët e gjedhes, ngaqë nuk ka mundësi objektive të hulumtohet e gjithë popullata (rasti i miliona votuesve, i qindra mijëra nxënësve të një vendi që regjistrohen në klasën e parë të shkollës fillore, i miliona konsumuesve të një artikulli ushqimor artificial, i dhjetëra e qindra mijëra anëtarëve të një partie politike etj.).

GJEDHJA ADEKUATE. Gjedhe ose kampioni i përbërë nga një numër i mjaftueshëm anëtarësh për të cilin besohet se mund të arrihet shkalla e duhur e saktësisë së ndryshores psikologjike që matet.

GJEDHJA E PAANSHME. Gjedhja ose modeli i paanshëm në statistikë është përzgjedhje e atillë e grupit të anëtarëve të një popullate, që përfaqëson tërë popullatën nga e cila është zgjedhur ai grup. Gjedhja, modeli ose grupi më i paanshëm në statistikë është ai që zgjidhet rastësisht, përkatësisht ai që zgjidhet nga anëtarët, ndër të cilët secili prej tyre ka mundësi reale për të qenë anëtar i gjedhes, i modelit ose i grupit përfaqësues. Forma më e mirë e përzgjedhjes së paanshme është përzgjedhja sistematike, përkatësisht përzgjedhja në bazë të regjistrimit të 1000 rasteve të gjithë popullatës dhe nxjerrja nga ky regjistër i secilit anëtar që ka numrin 100. Në këtë mënyrë secili nga dhjetë anëtarët do të bëhet anëtar i grupit përfaqësues të popullatës prej 1000 subjektesh.

GJEDHJA E RASTËSISHME. Gjedhe e përbërë nga ata përfaqësues të popullimit (të një klase, të disa paraleleve nxënësish të klasës së njëjtë, të një brezi maturantësh etj.), ku secili prej popullimit burimor ka pasur mundësi të njëjtë të zgjidhet në gjedhen e rastësishme. Zgjedhja e rastësishme kryhet sipas tabelës së numrave të rastësishëm, sipas kriterit të zgjedhjes së nxënësit të dhjetë në çdo grup prej 10 vetash, ndër njëmijë nxënës të popullimit burimor të regjistruar sipas alfabetit të gjuhës shqipe, secili i lindur në gjysmën e parë të muajit janar brenda kuotës së caktuar (jo në muajt e tjerë të vitit) të vitit 1998 etj.

GJEDHJA E STRATIFIKUAR. Përzgjedhja e anëtarëve të gjedhes së caktuar duke e ndarë popullimin burimor në disa shtresa si stratuma homogjene, homogjenitet ky, që nuk është karakteristik për gjithë popullimin burimor. Pas ndarjes në shtresa homogjene bëhet zgjedhja e rastësishme e anëtarëve të gjedhes. Saktësia më e madhe e kësaj përzgjedhjeje arrihet duke zvogëluar shmangien standarde të dallimeve ndërmjet grupeve ose shtresave të përcaktuara. Zbatohet sidomos në procesin e anketimit të çështjeve politike, ku struktura e popullatës burimore është e madhe dhe e përbërë nga shtresa të ndryshme moshash, profesionesh, partish politike etj.

GJEDHJA RIPËRFAQËSUESE. Gjedhja që reflekton më së miri ndryshoren që hulumtohet dhe madhësinë e popullimit burimor. Gjedhja e përfaqësuar rishtazi kryhet sipas procedurave statistikore, ku përjashtohet mundësia e zbatimit të çfarëdo kriteri tjetër, përveç kriterit më të mirë të përzgjedhjes së përfaqësuar rishtazi.

GJEN, - I. m. I ardhur në biologji dhe gjenetikë nga greqishtja *γένος* "gjini". Gjeni është njësia biokimike dhe funksionale e kromozomeve, që janë bartëse të elementeve trashëgues të organizmave të caktuar te pasardhësit e tyre. Këto përbëhen nga struktura e disa lëndëve makromolekulare dhe kanë pjesë të acidit dezoksiribonukleik. Karakteristikat kryesore të gjeneve janë: drejtojnë procesin e sintezës së proteinave në organizëm, kanë aftësi të riprodhohen vetë, janë bartëse të informacioneve gjenetike. Falë rregullsive të bashkimit të gjenit mashkull me atë të qelizës femër dhe funksionit themelor të tyre zhvillohen karakteristikat biologjike dhe psikologjike të njerëzve. Secila qelizë e organeve të njeriut, përveç rruazave të kuqe të gjakut që nuk kanë gjene dhe qelizave seksuale që kanë gjysmën e numrit të gjeneve, secila qelizë e organeve të trupit të njeriut përbëhet prej 46 kromozomeve, përkatësisht nga 23 çifte kromozomesh, që janë bartëse të disa veçorive biologjike dhe psikologjike të organizmit.

GJENDJA HIPNOIDE. I ardhur nga greqishtja *hypnos* "gjumë" dhe *eidhos* "formë". Gjendje jonormale e vetëdijes së disa individëve që është e ngjashme me gjendjen e gjumit. Gjendja hipnoide shfaqet me çrregullim të lidhjeve të përfytyrimeve të ngjeshura me efekte. Ky term u përdor së pari nga ana e fizikanit austriak Jozef Broier (Josef Breuer, 1842 – 1925), që ishte i mendimit se nga gjendja hipnoide individi mund të kalojë në histeri hipnoide. Termi gjendje hipnoide më pas u popullarizua nga ana e psikiatrit dhe neurologut austriak Zigmund Frojd (Sigmund Freud, 1856 – 1939).

GJENDJA KALIMTARE E VETËDIJES. Gjendje e vetëdijes që karakterizon rrjedhën e vazhdueshme të saj, duke mos pasur përfytyrim të objektit të fiksuar në përmbajtjen e vetëdijes. Gjendjet e tilla dallohen në rastet kur emri i kërkuar është "në skaj të vetëdijes", "në majë të gjuhës", por nuk i kujtohet njeriut, kur presim dikë, por nuk e kemi të fiksuar përfytyrimin e asaj që presim etj. Kjo gjendje kalimtare e vetëdijes është përshkruar nga ana e mendimtarit dhe psikologut amerikan Uiliam Xhejms (William James, 1842 – 1910).

GJENDJA RACIONALE. Karakteristikë e atyre individëve që tregojnë gatishmëri të plotë për të pranuar vetëm atë që i përket argumenteve dhe ndërlidhjeve të tyre, si dhe bindjeve të ngritura mbi themelin e tyre.

GJENEALOGJI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *γένος* "gjini, brez" dhe *λόγος* "shkencë". 1) Gjenealogjia është historiku i prejardhjes së gjinisë, të fisit, të familjes, të individit. 2) Gjenealogjia emërton edhe atë disiplinë shkencore ndihmëse të historisë, e cila merret me prejardhjen e personaliteteve të shquara historike.

GJENERALIZIM, - I. I ardhur nga latinishtja *generalis* "i (e) përgjithshëm" dhe ka përdorim në disa disiplina shkencore. Shih – ***PËRGJITHËSIMI.***

GJENERAT/Ë, - A. f. E ka origjinën nga latinishtja *generatio* "brez". Gjenerata ose brezi përfaqëson të gjithë numrin e atyre individëve që i përkasin një kohe të caktuar zhvillimi dhe kanë moshë relativisht të njëjtë kundrejt para-ardhësve dhe pasardhësve të tyre.

GJENERIK, - E. mb. I ardhur nga greqishtja *γένος* "gjini" që cilëson karakteristikat dhe tiparet e përbashkëta e të përgjithshme të një gjinie, të një lloji, në bazë të të cilave ai dhe pjesëtarët e tij ndryshojnë nga të tjerët.

GJENET ÇIFT. Dy gjene që lindin nga bashkimi i një gjeni femër me gjenin mashkull në procesin e fekondimit të vezës së femrës nga ana e spermatozoidit. Këto dy gjene përcaktojnë ndonjë cilësi trashëguese; nëse kanë efekte të njëjta çifti i gjeneve është homozigot, nëse efektet e dy gjeneve janë të kundërta, atëherë çiftet janë heterozigotë. Ky bashkim i gjeneve prindërore përbën bazën trashëguese të pasardhësve të tyre.

GJENETIKË, - A. f. I ardhur nga greqishtja e vjetër *γενετικός* "që ka të bëjë me trashëgiminë dhe me origjinën e organizmave dhe të vetive e tipareve të tyre". Gjenetika është disiplinë e biologjisë, që merret me studimin e trashëgimisë dhe të bartësve organikë të trashëgimisë, shih - ***GJENI*** dhe përcaktimin e ligjeve biologjike të trashëgimisë së vetive dhe të tipareve të organizmit.

GJENETIKA BIHEJVIORALE. Disiplinë relativisht e re shkencore që merret me studimin e raportit ndërmjet dy strukturave komplekse: të disiplinës mbi sjelljet njerëzore dhe disiplinës së gjenetikës, pikërisht ndërmjet faktorëve të trashëgimisë dhe procesit trashëgues dhe zhvillimit të sjelljeve të njeriut. Orvatet të shpjegojë se si vetitë e tiparet e prindërve barten te pasardhësit, si ndryshojnë dhe si zhvillohen vetitë e tiparet e reja në sjelljet e një individi. Studimi i raportit ndërmjet këtyre dy disiplinave është i ndërlikuar në pikëpamjen e metodave dhe procedurave gjurmuese, si edhe në pikëpamjen e raportit përmbajtjesor ndërmjet tyre.

GJENETIKA E SJELLJEVE. Disiplinë bashkëkohore e sistemit të shkencave të psikologjisë, e cila studion bazën trashëguese të llojeve të ndryshme të reagimeve të përgjithshme dhe karakteristike për një lloj të caktuar të organizmave. Gjenetika e sjelljeve sot është e përqendruar në hulumtimin e gjeneve që ushtrojnë ndikim në përmasat e sjelljeve të qëndrueshme, të zhvillimit të inteligjencës, si edhe në hulumtimin e patologjisë së sjelljeve dhe të formave të tyre.

GJENEZË, - A. f. I ardhur nga greqishtja *γενός* "gjini, brez". Në psikologji ka kuptimin e lindjes dhe të zhvillimit të proceseve, të strukturave e të sjelljeve, përkatësisht të prejardhjes dhe zhvillimit të tyre.

GJENI DOMINANT. Gjeni më aktiv në çiftin e gjeneve, që me rolin dhe me aktivitetin e supozuar biokimik pengon ose e zvogëlon zhvillimin e funksionit dhe të gjenit recesiv në bartjen e veçorive trashëguese biologjike dhe psikologjike.

GJENI HETEROZIGOT. Gjeni bartës i dy gjeneve të prindërve, që funksionojnë dhe veprojnë në mënyrë të ndryshme në zhvillimin e një tipari te i porsalinduri; derisa njëri gjen është gjen dominues, tjetri është gjen recesiv. Gjenet homozigotë kanë tjetër strukturë, funksion e ndikim veprues.

GJENI HOMOZIGOT. I ardhur nga greqishtja. Çift gjenesh që ka dy çifte gjenesh dominantë (A – A), ose

dy çifte gjenesh recesive (a – a). Këto gjene përcaktojnë një karakteristikë të organizmit në drejtim të zhvillimit të njëjtë.

GJENI MBIZOTËRUES. Gjeni më aktiv se gjeni recesiv. Aktiviteti i tij më i dukshëm ka të bëjë me rolin e tij më të madh në proceset biokimike, me të cilat gjeni mbizotërues e mbulon, e maskon veprimin e gjenit recesiv në përcaktimin e veçorive trashëguese të individit. Gjeni mbisundues mund të jetë bartës i një veçorie të njërit prind, bie fjala bartës i veçorisë së ngjyrës së zezë të syve, ose bartës i veçorive trashëguese të dy prindërve.

GJENI RECESIV. Gjeni i posaçëm në çiftin e gjeneve, që e shfaq funksionin dhe ndikimin e tij në prani të pamjaftueshme funksionale ose në mungesë të gjenit dominant. Falë rolit të gjenit dominant në çiftin e gjeneve roli funksional i gjenit recesiv shprehet më pak.

GJENIALITET, - I. m. Niveli i lartë i zhvillimit të aftësive të njeriut gjeni, aftësi këto që janë dëshmuar me zbulimin epokal në fusha të ndryshme të artit, të shkencës, të teknikës etj. Termi u përdor për herë të parë nga psikologu anglez Franciz Galton (Francis Galton, 1822 – 1911) në veprën e njohur të tij "Trashëgimia e gjeniut" – ("Heriditary Genius"), botuar më 1869. Më pas natyra e gjenialitetit u studiua nga psikometristi amerikan Levis M. Terman (Lewis M. Terman, 1877 – 1956).

GJENI, - U. f. I ardhur nga latinishtja *genius* "fryma mbrojtëse". Termi është i stabilizuar në terminologjinë e shumë gjuhëve, si edhe në atë të psikologjisë në gjuhën shqipe. Termi gjeni emërton konceptin e njeriut me aftësi të zhvilluara në nivelin më të lartë, që manifestohen në krijimtarinë e vlerave artistike, politike, shkencore dhe teknike që kanë rëndësi të madhe për zhvillimin e artit, të shkencës, të teknikës etj. Aftësitë e tij kanë të bëjnë me mendimin diskursiv – analitik të thellë, me prirje të jashtëzakonshme sintetike dhe me elemente të posaçme intuitive. Besohet se koeficienti i inteligjencës së gjenive është mbi 140. Por, rezultatet e hulumtimeve më të reja kanë treguar se është vështirë të përcaktohet profili i strukturës psikike të gjeniut, sepse të gjithë proceset kognitive dhe sjelljet e tij janë të ndërlikuara edhe nën ndikimin e shumë faktorëve jokognitivë (motivet, tiparet e temperamentit, natyra e emocioneve etj.), si edhe nën ndikimin e faktorëve të mjedisit, ku gjeniu zhvillohet dhe formohet. Besohet se numri i tyre në gjithë popullimin është rreth 0,5 % - 1 %.

GJENOSTAZË, - A. f. Çdo lloj gjendje psikopatologjike dhe prapambetje në zhvillimin dhe formimin psikik të njeriut. Ky term u përdor kryesisht në psikiatri duke shpjeguar gjendjet psikopatologjike dhe prapambetjet nga faktori biologjik që ka ndërhyrë në procesin e zhvillimit biologjik e psikologjik të individit, që nga fazat e hershme të zhvillimit të tij. Ndërhyrja e këtij faktori pengues bllokon procesin e zhvillimit dhe, pasojë e këtij bllokimi, janë proceset e vonuara dhe patologjike të zhvillimit të njeriut.

GJENOTIP, - I. m. I ardhur nga greqishtja *γενός* "lindje" dhe *τύπος* "tip". U përdor në gjenetikë, por më pas edhe në psikologji. Në gjenetikë emërton faktorët trashëgues, të cilët janë

shkaktarë të zhvillimit të një organizmi të veçantë ose të një tipari të tij. Gjenotipi bazën e konstitucionit të një organizmi e shpjegon në mbështetje të gjeneve dhe të funksionit të tërësishëm të tyre. Në këtë shtrirje domethënëse hynë edhe tiparet psikologjike të temperamentit, të aftësive dhe të strukturave të tyre, që nuk kemi mundësi të drejtpërdrejtë për t`i vëzhguar. Por, në disa pikëpamje psikologjike të shpjegimit të personalitetit dhe të zhvillimit të tij termi gjenotip ka marrë kuptime të shtuara. Në teorinë e psikologut amerikan Gordon V. Olportit (Gordon V. Allport, 1897 – 1967), me termin gjenotip kuptohet dispozita burimore personale e zhvillimit të personalitetit dhe e tipareve të tij. Në teorinë e personalitetit të Kurt Levinit (Kurt Lewin, 1890 – 1947), psikologut gjerman me origjinë polake, gjenotipi ka kuptim shtrirës shumë të gjerë, sepse ai emërton tërësinë e të gjithë faktorëve bartës të një dukurie psikike.

GJEOPSIKOLOGJI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *γε* "tokë", *psyche* "shpirt" dhe *λόγος* "shkencë". Disiplinë e shkencave psikologjike, e cila merret me studimin e ndikimit që ushtrojnë dukuritë meteorologjike, klimatike dhe ndryshimet e tyre në gjendjen dhe në proceset psikike, si edhe në sjelljet e njeriut.

GJEOTROPIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga greqishtja *γε* "tokë" dhe *τρόπος* "lëvizje". Gjeotropizmi është reagim, lëvizje e bimëve në drejtim të tokës (gjeotropizmi pozitiv) ose në drejtim të kundërt të tokës (gjeotropizmi negativ).

GJERGJI Don Lush. Prift katolik, psikolog shqiptar. Lindi në Stubëll të Epërme afër Vitisë në Kosovë më 21.03.1949. Kreu studimet për magjistër në filozofi dhe u diplomua në teologji në Universitetin Papnor "Urbaniana" të Romës më 1973. Kreu doktoraturën për psikologji më 1975 në Universitetin Shtetëror "La Sapienza" të Romës, duke mbrojtur me sukses tezën "La donna albanese" – ("Gruaja shqiptare"). Anëtar i Akademisë Europiane. Aktualisht është Vikar Gjeneral i Ipeshkvisë së Kosovës në Prishtinë. Don Lush Gjergji që nga fillimi i karrierës së tij është drejtuar në studimet teologjike-katekistike dhe psikologjike e shoqërore, duke u përqendruar posaçërisht në studimin e jetës dhe të veprës së Nënë Terezës. Lidhur me studimet teologjike – katekistike ka realizuar udhëtime studimore në shumë vende të Europës dhe në ato përtej oqeanike. Në këtë fushë të gjerë dallohet ndikimi i kulturës psikologjike dhe i proceseve kognitive në njohjen e thellë të katekizmit, e pikërisht të mësimeve themelore të katolicizmit, të traktateve teologjike të Krishtërimit. Nënë Tereza – personaliteti i dashurisë njerëzore, i varfërisë dhe i humanizmit gjithëpërfshirës njerëzor të jashtëzakonshëm është angazhimi intelektual, moral, fetar dhe fizik i përhershëm i Don Lush Gjergjit. Virtytet - tiparet intraverte dhe ekstraverte të personalitetit të Nënë Terezës dhe sjelljet e saj ndaj të varfërve, të sëmurëve dhe të pastrehëve janë analizuar, përshkruar dhe shpjeguar thellësisht vetëm nga ana e Don Lush Gjergjit me 15 botime. Në fushën e psikologjisë është i njohur me shqyrtimet e posaçme të zbatimit të psikologjisë në zhvillimin e botëkuptimit të krishterë dhe të ndjen-

jave religjioze te të vegjlit dhe të rinjtë e fesë së krishterë. U mor me studimin e metodologjisë hulumtuese shkencore në psikologjinë sociale. Ndër Shqiptarët është ravijëzues i zhvillimit të psikologjisë religjioze, veçanërisht i psikologjisë së fesë së krishterë dhe pedagog i zhvillimit të vetëdijes religjioze e kombëtare. Ka botuar deri tani 60 libra, ndër të cilat po veçojmë: *"Kah toka e premtuar",* 1985 e 1999; *"Atenagora – Profet i bashkimit",* 1995; "*Zëri i heshtjes*", 1997; "*Nëna jonë Terezë",* 1980 e 1990, e botuar në kroatisht, sllovenisht, italisht, frëngjisht, spanjisht, hungarisht dhe anglisht; *"Lule për Nënën – monografi kushtuar Nënës Terezë",* 1989; *"Nëna e Dashurisë"*, botim i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës (2000) dhe e revistës "Drita" (2010), e botuar në italisht, gjermanisht, anglisht, frëngjisht, spanjisht, polakisht, kroatisht dhe sllovenisht; *"Dashuria në vepër: Nëna Tereza",* 1992; *"Dashuria që nuk vdes",* 2013; "*La donna Albanese" – "Gruaja shqiptare"* (e botuar pjesërisht në shqip me titull *"Roli i femrës shqiptare në familje dhe në shoqëri"),* 1977 e 1999; *"Resistenza nonviolenta nel Kossovo" – ("Rezistenca e jodhunës e Kosovës"),* 1993, 1996. Punimet shkencore me rëndësi të veçantë: *"Si lind sentimenti religjioz në fëmijë"*, "*Metodologjia e hulumtimeve shkencore në psikologjinë sociale", "Problemet e zhvillimit psikik te foshnja","Pleqëria "në sy të fesë", "Edukimi në fe sot", "Edukimi fetar i fëmijëve, "Edukimi fetar në pubertet", "Psiholoski profil razvoja vjere kod djece (7 – 11 god.)" – ("Profili psikologjik i zhvillimit të besimit fetar te fëmijët (7 – 11 vjeç")* *etj.* të botuara në revistën fetare-kulturore "Drita" të Ferizajt dhe në Revistën "Rast vjere i obitelji" të Zagrebit.

GJERONTOLOGJI, - A f. I ardhur nga greqishtja *γερον* "i vjetër" dhe *λόγος* "shkencë". Gjerontologjia është disiplinë ndërshkencore, që merret me studimin sistematik të të gjitha ndryshimeve te njerëzit e moshuar, përkatësisht te pleqtë. Ndryshimet e njerëzve të moshuar janë kryesisht ndryshime negative antropologjike, fiziologjike, juridike, mjekësore, psikologjike e sociale. Gjerontologjia është disiplinë që e filloi zhvillimin e vet relativisht vonë, përkatësisht në gjysmën e dytë të shekullit të njëzet, por kohët e fundit zhvillimi i saj mori hov, sepse numri i të moshuarve po rritet gjithnjë e më shumë.

GJEST, - I. m. I ardhur nga latinishtja *gestus* dhe *i stabilizuar* edhe në gjuhën shqipe. Termi gjest emërton formën e shprehjes së një dëshire, të një mendimi, qëndrimi etj., me anën e lëvizjeve të trupit, të pjesëve të tij dhe me anë të lëvizjes së muskujve të fytyrës, duke luajtur rol të rëndësishëm në procesin e komunikimit. Gjestet mund të jenë të pavarur ose shoqërues të të folurit. Në rastin e parë tregon pranim, përkrahje, moslejim etj., në të dytin shton vlerën komunikuese të të folurit duke rritur shkallën e konkretizimit të të folurit. Gjestet si formë e shprehjes së kënaqësisë – pakënaqësisë, të lejimit – të moslejimit, të ndalimit – të mosndalimit etj., kanë përmasa të mëdha sociale dhe janë të lidhura me zhvillimin e kulturës lokale.

GJËNDRA E HIPOFIZËS. I ardhur nga greqishtja *υποφία* "rritje". Gjëndër e vogël me madhësi të kokrrës së bizeles, që është e vendosur në bazën e trurit. Luan rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe në rregullimin e

funksioneve të gjëndrave të tjera me sekretim të brendshëm dhe, për këtë shkak dikur është quajtur "gjëndra mbretëreshë", përkatësisht "gjëndra sunduese". Hipofiza është e ndarë në dy pjesë: në pjesën e përparme dhe në atë të prapme. Pjesa e përparme quhet adenohipofiza dhe është e lidhur me hipotalamusin dhe pjesa e prapme që quhet neurohipofizë. Adenohipofiza rregullon rritjen e trupit dhe të organeve të organizmit, kontrollon funksionin e gjëndrave mbiveshkore, rregullon aktivitetin e gjëndrës tiroide, ngacmon sekretimin e gjëndrave seksuale dhe ndikon në zhvillimin e trupit kallor (*luteum corpus*) etj. Neurohipofiza kontrollon metabolizmin e ujit në organizëm, rregullon kontraktimin e muskujve të lëmuar, të enëve të gjakut, kontraktimin e matricës dhe atë të funksionit të sekretimit të gjëndrave qumështore. Këto funksione hipofiza i kryen duke prodhuar hormone të posaçme, si: hormonet somatotropinë, adenokortikotropinë, tirotropinë, gonadotropinë, hormonin antidiuretik, oksitocinën etj.

GjËNDRA MBIVESHKORE. Gjëndër mbi sipërfaqen e pjesës së sipërme të secilës veshkë. Përbëhet nga disa pjesë, ndër të cilat dallohet: palca dhe cipa e gjëndrës së veshkave. Palca e kësaj gjëndre prodhon këto hormon e: adrenalinë ose epinefrinë, norepinefrinë (sasi të vogla) dhe dopaminë. Nga cipa e kësaj gjëndre sekretohen këto hormone: kortizol, kortizon, adesteron, androgjen dhe estrogjen. Disa nga këto hormone ushtrojnë ndikim në jetën emocionale dhe në gjendjen stresante të njeriut.

GJËNDRA ME SEKRETIM TË BRENDSHËM. Struktura qelizore organike që përbëjnë tërësi morfologjike dhe funksionale të veçanta. Këto janë: gjëndrat tiroide, gjëndrat mbiveshkore, gjëndrat gonade, hipofiza, pankreasi, testet dhe vezoret. Këto gjëndra tajitin ose sekretojnë produkte biokimike me rëndësi të posaçme për proceset fiziologjike të organeve dhe të organizmit (ekuilibri osmotik, riprodhimi, rritja, shkëmbimi i lëndëve etj.). Produktet e tilla të lëngëta të tyre quhen *hormone* – shih. Hormonet e këtyre gjëndrave derdhen drejtpërdrejt në gjak, në limfë dhe në pjesët e lëngëta të indeve; këto nuk kanë kanale për nxjerrjen jashtë organizmit të hormoneve të tyre. Me anën e qarkullimit të gjakut furnizohen me hormone të gjitha pjesët e organizmit. Gjëndrat me sekretim të brendshëm ushtrojnë ndikim të rëndësishëm edhe në zhvillimin emocional, intelektual dhe në veprimet e vullnetshme të njeriut. Çrregullimet e gjëndrave me sekretim të brendshëm dhe të funksionit të tyre (hipoprodhimi ose hiperprodhimi i hormoneve) shkaktojnë sëmundje organike të ndryshme, por godasin edhe zhvillimin e disa proceseve e vetive psikike, si edhe sjelljet e njeriut.

GJËNDRA PARATIROIDE. Gjëndër me sekretim të brendshëm, që gjendet pranë gjëndrës tiroide ose mbrojtëse. Gjëndra paratiroide përbëhet prej katër pjesëve të vogla. Prodhon një hormon të posaçëm, hormonin parahormon, i cili rregullon metabolizmin e kalciumit dhe të përqendrimit të tij në gjak, si edhe atë të fosforit në organizëm. Mungesa e këtij hormoni ka pasoja negative në funksionimin e

organeve të organizmit, ndër të cilat dallohen ngërçet e muskujve të disa organeve.

GJËNDRA PINEALE. Gjëndër e vogël me sekretim të brendshëm, që në anatomi njihet me termin latin *epyphisis cerebri* dhe me termin *corpus pineale*. Në psikofiziologjinë e sotme njihet me termin epifizë. Për gjëndrën pineale mjeku dhe mendimtari i vjetër grek, Galeni (Galen, rreth 129 – 199 p.e.r.) ka menduar se është organ trunor rregullues i rrjedhës së mendimeve, kurse mendimtari i madh francez René Dekart (René Decartes, 1596 – 1650) ka menduar se është organ qendror i lidhjes së trupit me shpirtin racional të njeriut. Shih – ***EPIFIZA.***

GJËNDRA SEKSUALE. Shih – ***GONADA.***

GJËNDRA TIROIDE. Gjëndër e vendosur në indin e qafës, në fund të laringut në dy anët e kraharorit. Gjëndra tiroide quhet edhe gjëndër mbrojtëse. Sekreton hormonin tiroksinë, i cili kryen funksionin e kontrollimit të metabolizmit të organizmit dhe ushtron ndikim në procesin e rritjes së organizmit. Hiposekretimi dhe hipersekretimi i tiroksinës shkakton çrregullime organike dhe ndryshime në aktivitetin e njeriut. Në rastin e hipotiroksinës shfaqet hipotireoza te të rriturit – zvogëlimi i procesit metabolik, rritja e peshës trupore, ulja e ritmit të aktivitetit të njeriut, sëmundja e Bazedit etj., kurse te të vegjlit shkakton zhvillim mendor të nivelit të ulët. Hipersekretimi i gjëndrës tiroide shkakton hipertirezën – përshpejtimin e proceseve metabolike, ndjeshmërinë e nivelit të lartë etj.

Burimet:

Stenli S. Stevens: *"Hanbook of experimental psychology"* – (*"Doracak për psikologjinë eksperimentale")*, Wiley. New York, 1951.
F. Beach: *"Hormones and Behavior"* – (*"Hormonet dhe sjelljet"*), Hoeber. New York, 1948.
Ethem Ruka: *"Fiziologjia e gjallesave shtazore"*, shblu, Tiranë, 1998.

GJUHË, - A. f. Sistem i simboleve më të përsosura i përbërë nga simbole të formës së artikuluar ose të shkruar të njësive tingullore (të fjalëve), nga rregullat gramatikore të kombinimit të tyre në fjali, me të cilat njeriu e regjistron përvojën, e transformon këtë dhe këtë e fikson duke e bartur te individët e tjerë të bashkësisë kulturore të caktuar në procesin e komunikimit. Gjuha është mjet komunikimi me të tjerët, mjet i mendimit dhe i shprehjes së tij, mjet i njohjes së realitetit, mjet shpjegues dhe konstruktues i mjedisit, që njëkohësisht vë rend në botën psikike të njeriut, e zhvillon dhe e kupton këtë. Gjuha është rezultat i praktikës shoqërore të bashkësisë së caktuar dhe përvetësohet nga ana e anëtarëve të asaj bashkësie me anë të procesit të socializimit dhe të të mësuarit. Njeriu e ka aftësinë gjuhësore të lindur. Gjuha realizohet me anë të të folurit. Gjuha ka këto funksione: aktivues – ndikim te të tjerët; ekspresiv – shprehje e gjendjes emocionale të njeriut; shoqëror – vënia dhe përforcim i lidhjeve ndërmjet njerëzve; magjik – ndikim në dukuri me anë të fjalëve; dhe estetik – shprehje e bukur e mendimeve dhe e ndjenjave. Besohet se sot ekzistojnë rreth tremijë gjuhë të gjalla. Me studimin psikologjik të gjuhës merret psikolinguistika.

GJUHA ANALITIKE. Në gjuhësi konsiderohen gjuhë analitike ato

gjuhë, të cilat kërkojnë rend, rregulla të shprehjes dhe, kuptohet, zbatim të plotë të tyre në shfaqjen e mendimeve, të emocioneve, të motiveve etj. Në gjuhët analitike relacionet gramatikore janë të caktuara, të fiksuara dhe këto relacione te gjuhët analitike nuk durojnë liri lëvizjesh të fjalëve e fjalive.

GJUHA E GJESTEVE. Formë joverbale e të folurit të një gjuhe me anë të gjesteve, shih – ***GJESTI.***

GJUHA FIGURATIVE. Shprehje idesh, mendimesh, qëndrimesh, ndjenjash etj. me anë të metaforave, simboleve dhe idiomave të ndryshme.

GJUHA – ORGAN SHQISOR. Gjuha është organ shijues i cilësive të llojeve të ndryshme të ushqimit, që ndikon në përtypjen dhe në gëlltitjen e tij me anë të lëvizjeve që ajo bën. Gjuha është organ muskulor i gojës që shërben edhe si organ i të folurit që lidhet ngushtë me qendrat e zonës kortikale (qendrat Brok dhe Vernik). Në gjuhë janë të vendosura organet receptore, që janë të lidhura me mbaresat e nervit shijues, që bartin impulse nervore në qendrën trunore të të shijuarit. Organi i gjuhës është i pajisur me çiftin e 12^{të} të nervave kafkore.

GJUHA SINTETIKE. Gjuhë, të cilat lejojnë përdorim të lirë të rendit të fjalëve dhe të rregullave gramatikore; gjuhë ku fleksioni i relacioneve gramatikore të fjalëve e fjalive është relativisht i lirë.

GJUHA TRUPORE. Formë e shprehjes sistemore të komunikimit joverbal. Gjuha trupore shfrytëzon gjestet, mimikën, pozitën e trupit dhe ndryshimet e tij për të komunikuar me të tjerët.

GJUM/Ë, - I. m. Gjendje periodike e veçantë e njeriut, ndërprerja e plotë ose e pjesshme e funksionimit të disa qendrave të cipës a kores së trurit të madh, dobësimi i madh i kontrollit të vetëdijshëm ndaj disa llojeve të veprimeve psikike dhe ndërprerja e përkohshme e reagimeve ndaj shumë ngacmuesve që kanë intensitet të mesëm dhe të ulët e që ushtrojnë ndikim në shqisat e njeriut. Sistemi nervor autonom dhe pavetëdija e njeriut funksionojnë normalisht. Rregullatorët neurofiziologjikë të gjumit janë të lidhur me qendrat e posaçme të trurit. Qendrat e gjumit gjenden në trurin e mesëm. Me anën e gjumit ripërtërihet energjia vitale organike dhe psikike e njeriut. Gjatë kohës së gjumit aktiviteti nervor studiohet me elektroencefalograf. Janë konstatuar lëvizje të syve gjatë kohës së gjumit. Në psikologji këto lëvizje maten me elektro-olulografi dhe emërtohen me shkurtesën REM (nga anglishtja R(apid) E(ye) M(ovements). Fiziologët Nathaniel Kleitman (Nathaniel Kletiman, 1895 – 1999) dhe Eugjen Asarinski (Eugene Asarinsky, 1921 – 1998) kanë zbuluar gjumin me përshpejtim të lëvizjeve të syve, që e kanë quajtur gjumi paradoksal. Sipas studimeve të tilla, gjatë procesit të gjumit dallohet këto faza: 1) Faza e valëve alfa me amplitudë të lartë 95 – 6 minuta; 2) Faza e valëve me amplitudë më të ulët; 3) Faza e valëve delta; 4) Faza e katërt fillon pas një ore gjumë, kur fillojnë të shfaqen lëvizje të shpejta të syve dhe valët alfa. Njeriu normal e kalon 1/3 e jetës së tij në gjumë. Fëmijët e vegjël flenë deri 16 orë, fëmijët e moshës parashkollore flenë rreth 14 orë, kurse të rriturit flenë rreth 8 orë.

GJUMI NREM. Gjumë pa lëvizje të shpejta të syve. Gjumi NREM ka një proces që ndahet në katër faza me kohëzgjatjeje të përbashkët prej 90 – 120 minutash. Shih – ***GJUMI.***

GJUMI REM. Gjumë me lëvizje të shpejta të syve, që i përket fazës së pestë të gjumit. Në këtë fazë njeriu sheh pjesën më të madhe të ëndrrave, kurse lëvizja e muskulaturës e lidhur me veprimtari të vullnetshme është ndërprerë. Gjumi REM karakterizohet me valët beta që kanë frekuencë prej rreth 12 herc dhe me shpeshtim të frymëmarrjes.

GJURMËT PSIKONERVORE. Ndryshim i substancës së trurit ose i indit nervor që shkakton procesi i të mësuarit. Mbi këtë kuptim është zhvilluar mendimi se kujtesa në gjurmët e indit nervor dhe në ndryshimet e tij ruan përmbajtjen e asaj që është mësuar (të një tregimi, lëvizjeje, shprehie etj.), shih – ***ENGRAMI.*** Ndryshimet substanciale të indeve të trurit dallohen sidomos në cipën a koren e trurit, në stratum dhe në hipokampus.

GJURMIMI AKSIONAL. Gjurmim i organizuar dhe i drejtuar në përsosjen e veprimeve konkrete gjatë organizmit dhe ekzekutimit të një prove, eksperimenti. Gjurmimi aksional ka karakter të programuar. Në këtë lloj gjurmimi i rëndësishëm është qëllimi i organizimit të eksperimentit, përkatësisht përsosja e akteve, e rendit, e bashkërenditjes të akteve gjurmuese e jo përfitimi i rezultateve. Ky term i atribuohet psikologut me prejardhje gjermane i njohur me psikologjinë topologjike Kurt Levin (Kurt Lewin, 1890 – 1947).

GJURMIMI I OPINIONIT PUBLIK. Organizim i veprimtarisë profesionale e shkencore duke zbatuar një tërësi procedurash dhe metodash, përfshirë edhe ato statistikore për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave të përftuara mbi mendimin, besimin dhe bindjen e pjesëtarëve të një mjedisi të caktuar shoqëror për çështje me rëndësi të posaçme për atë mjedis. Për mbledhjen e të dhënave nga anëtarët e një mjedisi të caktuar shoqëror zakonisht zbatohet anketimi me anë të fletëpalosjes, herë–herë shoqërohet edhe me një intervistë të grupit përfaqësues, si edhe me modifikime të tyre. Ndërkaq, për përpunimin e të dhënave zbatohen metodat e duhura statistikore.

GJURMIMI NORMATIV. Gjurmim me metoda jo eksperimentale të zbatuara me qëllim të përcaktimit të normës zhvillimore të një ndryshoreje, përkatësisht të normës testore, të normës së arritjeve në një fushëveprim nga ana e një numri të mjaftueshëm subjektesh të një popullate të caktuar.

GJURMIMI PILOT. Term i metodologjisë hulumtuese i ardhur nga anglishtja. Emërton gjurmimin paraprak të një përmase të vogël, që organizohet me qëllim të të ushtruarit të organizimit të mirëfilltë të gjurmimit të një ndryshoreje psikologjike, duke mbarështruar rendin, kohën dhe mënyrën e zbatimit të procedurave hulumtuese.

GJURMIMI SISTEMOR. Gjurmim shkencor që ka të bëjë me sistemin e brendshëm të strukturave dhe lidhjeve koherente të një sistemi gjurmues, që organizohet sipas një sistemi teorik të caktuar dhe sipas zbatimit të tij

synohet të përgjithësohet pikëpamja, parimi, qëndrimi etj., duke ushtruar ndikim edhe në rritjen e cilësive të atij sistemi ose të strukturave të brendshme të tij.

GJYKIM, - I. m. Një ndër format themelore të të menduarit. Gjykimi është lidhje e raport konceptesh, me të cilën përcaktohet karakteri pohues apo mohues i lidhjes apo raportit ndërmjet dy a më shumë koncepteve. Gjykimi shprehet me anë të një fjalie. Gjykimi është i lidhur me besimin dhe me bindjen e njeriut në lidhjen dhe në raportin e koncepteve të caktuara.

GJYKIMI RELACIONAL. Marrëdhënie e caktuar ndërmjet subjektit dhe predikatit. Në kuptimin e mirëfilltë gjykimet relacionale janë gjykime të tipit shkak - pasojë, gjykime të lidhura njëra me tjetrën në mënyrë kushtëzuese.

GJYMTYR/Ë, - A. f. Organet më lëvizëse të njeriut, të cilat përbëhen nga duart e këmbët. Aftësitë motorike të njeriut dhe të mësuarit e shprehive e të shkathtësive janë të lidhura drejtpërdrejtë me lëvizjet e gjymtyrëve, sidomos me lëvizjet e duarve dhe të gishtërinjve të duarve. Gjymtyrët ndahen në gjymtyrë të sipërme dhe në gjymtyrë të poshtme.

a. **Gjymtyrët e sipërme** – Dora e djathtë dhe dora e majtë. Këto përbëhen nga muskujt dhe eshtrat, të cilët kanë formë, shtrirje dhe funksion dhe lidhje të veçantë ndërmjet tyre. Eshtrat e gjymtyrëve të sipërme përbëhen nga krahu, parakrahu i dorës dhe prej brezit të shpatullës, me anën e të cilit pjesa e lirë e skeletit të gjymtyrëve të sipërme lidhet me trungun. Muskujt e gjymtyrëve të sipërme janë muskujt e gjatë skeletorë shtrirës dhe mbledhës. Shtrirja dhe mbledhja e tyre mundëson lëvizjen e duarve me anën e të cilave realizohen veprimet e vullnetshme;

b. **Gjymtyrët e poshtme** - Këmba e djathtë dhe këmba e majtë që përbëhen nga eshtrat e muskujt që kanë përbërje, shtrirje, formë dhe lidhje të veçantë ndërmjet tyre. Eshtrat e kofshës, të kërcirit dhe të këmbës përbëjnë pjesën e lirë të skeletit, i cili lidhet me trungun me anën e brezit pelvik. Muskujt e gjymtyrëve të poshtme përbëhen nga muskujt e pelvisit, të kofshës, të kërcirit dhe të këmbës. Këta janë muskuj skeletorë të gjatë e mbledhës që mundësojnë lëvizjet e këmbëve.

GJYMTYRA FANTOME. Përjetim subjektiv i ndijimeve të asaj gjymtyre të trupit, e cila i është këputur ose amputuar për shkaqe të ndryshme dhe njeriu me gjymtyrë të këputur përjeton ndijim të kromës e të dhembjes, por edhe të prekjes, thuajse se gjymtyra nuk i është këputur ose amputuar. Përjetimi i tillë shpjegohet duke u mbështetur në aktivitetin e qelizave nervore të cipës ose kores së trurit që ruajnë përfytyrimin e gjymtyrës së këputur dhe funksionin e tyre të "stampuar" në strukturën e tyre gjatë kohës kur gjymtyra ka vepruar normalisht

H

H – Shenjë e fuqisë, e shprehisë, gjendje e supozuar e organizmit që shfaq intensitetin e prirjes së organizmit për të reaguar ndaj një ngacmuesi në një formë të caktuar. Është shenjë e teorisë dhe e të mësuarit të psikologut amerikan Klark Hal (Clark Hull, 1884 – 1952).

HABI, - A. f. Ndjenjë që shfaqet nga diçka e papritur. Habia ka të bëjë me përjetimin karakteristik që lind nga ballafaqimi i njeriut me dukuri, me procese, me raporte etj., për të cilat ka përvojë, dije dhe përgatitje tjetër nga ajo që shfaqet para tij. Habia ushtron ndikim të posaçëm në zhvillimin e proceseve intelektuale dhe në sjelljet e njeriut. Ajo zgjat dhe ka intensitet të ndryshueshëm.

HABITUACION, - I m. I ardhur nga latinishtja *habitus* "qëndrim". Termi habituacion në psikologji ka hyrë nga anglishtja dhe në kuptimin e përgjithshëm emërton të bërit shprehi të një aktiviteti të thjeshtë. Formë e thjeshtë e të mësuarit, që ka të bëjë me të mësuarit e organizmit për të reaguar dobët ose për të mos reaguar fare ndaj atyre ngacmuesve, të cilët ndikojnë në organizëm, por që, për atë organizëm këta ngacmues nuk kanë rëndësi jetësore. Habituacioni ndryshon nga përshtatja apo adaptimi i organizmit për të reaguar me ulje të intensitetit reagues ndaj ngacmuesve. Ai i përket procesit të të mësuarit elementar që nuk ka aq të bëjë me shqisa, por më tepër me aktivitetin e sistemit nervor të tyre.

HAKMARRJ/E, - A. f. Zakon i vjetër i popujve të disa vendeve, që në disa treva ka ruajtur forma të vrazhda. Hakmarrja ka të bëjë me kundërveprimin e një individi ndaj dëmtuesit, dhunuesit, vrasësit të anëtarit të familjes, të fisit etj. Hakmarrja shfaqet në ndëshkimin që i bëhet keqbërësit nga ana e atij ose të afërmve të atij që kanë pësuar një të keqe. Elementet e bazës psikologjike të hakmarrjes kanë të bëjnë me përjetimin e ndjenjës së ndërlikuar të padrejtësisë dhe të detyrës për shpagimin e së keqes, me motivin e agresivitetit dhe me dëshirën e gatishmërinë e njeriut për shpagim të dëmit të bërë sipas dokeve shoqërore të popullit të caktuar. Forma më e

rëndë dhe më e vrazhdë e hakmarrjes është gjakmarrja. Shih – ***GJAKMARRJA.***

HAL KLARK (Clark HULL, 1884 – 1952). Psikolog amerikan, neobihejviorist. Ka ushtruar ndikim të fuqishëm në zhvillimin e psikologjisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në gjysmën e parë të shekullit të njëzet. Që nga viti 1929 ka punuar në Universitetin e Jelës, ku ka udhëhequr shkollën eklektike të psikologjisë në SHBA. U mor me studimin e aftësive dhe të testeve për matjen e aftësive, por më tepër ishte hulumtues i teorisë së zhvillimit psikik të njeriut, duke përfshirë edhe studimin e hipnozës dhe të sugjestionit. Aktiviteti hulumtues i tij u dallua në psikologjinë kognitive, ku ka kontribuar sidomos në zhvillimin e modelit të teorisë së mendimit deduktiv mbi bazën e fakteve psikologjike. Në studimet e tij ka përmendur "15 modele matematiko-verbale të proceseve psikologjike, nëpër të cilat kalojnë ngjarjet psikologjike". Parimet e të mësuarit të Klark Halit mbështeten në përforcimin e lidhjes ngacmues – reagim: të mësuarit është i suksesshëm nëse shpërblehet reagimi; sa më i lartë, më i madh dhe më i shpejtë të jetë shpërblimi për reagimin e suksesshëm, aq më i suksesshëm do të jetë të mësuarit. Klark Hal ka qenë ndikuar nga teoria e reflekseve të kushtëzuara, nga roli i motivacionit në sjelljet e njeriut, të theksuar në studimet e Zigmund Frojdit, nga arritjet pozitive të bihejviorizmit së Xhon B. Uotsonit etj. Veprat kryesore të tij janë: *"Principles of Behavior: An Introduction to Behavior Theory"* – (*"Parimet e sjelljes: Hyrje në teorinë e sjelljes"*), 1943; *"Essentials of Behavior"* – (*"Thelbi i sjelljes"*), 195*1; "A Behavior System: An Introduction to Behavior Theory Concerning the Individual Organism"* – (*"Sistemi i sjelljes: Një hyrje në teorinë e sjelljes lidhur me organizmin individual",* 1952) etj.

HALUCINACION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *hallucination* "të folurit e pakuptimshëm". Perceptim jonormal i një dukurie, objekti, i një situate etj., që ka të gjitha veçoritë e përvojës së perceptimit për një individ të caktuar, por pa ngacmues real të shqisave. Halucinacionet janë dukuri psikike patologjike, që lindin nga dëmtimi i funksionit të vetëdijes së njeriut, por të shoqëruara me bindje të thellë se këto për subjektin e sëmurë janë objekte reale; këto duhen konsideruar indikatorë të çrregullimeve dhe të sëmundjeve psikike, në radhë të parë të skizofrenisë. Por, të tilla janë vetëm ato halucinacione që paraqiten shpesh dhe kanë filluar të bëhen forma të qëndrueshme të përjetimit të disa individëve. Halucinacionet mund të shfaqen edhe te individët normalë, por kjo ngjet shumë rrallë, përkatësisht vetëm në situata të tensionuara emocionale, nga helmimet e llojeve të ndryshme të organizmit, nga pagjumësia etj. Halucinacionet për nga struktura e tyre mund të jenë të thjeshta (ndijime të çuditshme) dhe të ndërlikuara (perceptim njerëzish, kafshësh, objektesh fizike etj). Më shpesh hasen këto tri lloje halucinacionesh:

a. **Halucinacionet pamore** - Perceptim "i rremë" për objektin a dukurinë e caktuar, kur objekti a dukuria e caktuar as që kanë pasur mundësi të ndikohen nga mjedisi real i individit;

b. **Halucinacionet dëgjimore** – Perceptimi i gjallë i një burimi tingullor, i cili nuk ka kurrfarë baze reale;

c. **Halucinacionet haptike** – Halucinacione të prekjes. Shfaqen në fushën e ndijimeve të lëkurës kur individi përjeton prekjen nga ana e një individi tjetër, megjithëse këtë askush nuk e ngacmon.

HALUCINOZ/Ë, - A. f. Gjendja psikopatologjike e individit, të cilin e karakterizon pushtimi i tij nga halucinacione të shumëllojshme. E tillë mund të jetë halucinoza alkoolike, ku disa individë që marrin alkool pushtohen plotësisht nga halucinacionet. Në raste të tilla marrja e një substance, si, p.sh, marrja e alkoolit bëhet shkaktare e shfaqjes së halucinacioneve.

HALUCINOZA ALKOOLIKE. Psikozë që mund të shfaqet gjatë alkoolizmit kronik me halucinacione të tipit pamor, dëgjimor dhe të kombinuar. Gjendja mund të përmirësohet pas rreth një viti abstinence dhe përmbajtje të masave psikiatrike, por ka raste kur halucinacioni kalon në gjendje kronike. Nga rastet e tilla disa psikiatër mendojnë se alkooli ka aktivizuar psikozën e skizofrenisë.

HAMENDJ/E, - A. f. Mendim përcaktues i një individi, i cili në bazë të të dhënave të pamjaftueshme për dukurinë, objektin, raportin etj. pohon ose mohon një mendim, pikëpamje, qëndrim etj. dhe këtë e bën me një ndjenjë dyshimi, me shkallë të ulët besimi dhe me përjetim të nevojës për vërtetimin e plotë të tij.

HANDIKAP. asnj. Term me prejardhje nga gjuha anglosaksone, që ka hyrë në përdorim edhe në gjuhën shqipe kryesisht nga viti 2000. Handikap është emërtim i një gjendjeje të vështirë fizike e psikike të njeriut, me kapacitete të kufizuara të zhvillimit të tij. Për shkak të zhvillimit të kufizuar fizik apo psikik ose fizik e psikik individët e tillë pengohen për t`i arritur qëllimet e tyre në jetën e përditshme, sidomos në aktivitetin profesional. Kuptimi i këtij termi shtrihet jo vetëm te ata që vërtetë kanë kufizime zhvillimesh fizike e psikike, por edhe te ata që mendojnë se janë të kufizuar, ose mjedisi i tyre i vlerëson të tillë dhe i shkakton dëm zhvillimit të tyre.

HAPËSIR/Ë, - A. f. Kusht dhe formë e ekzistencës së materies. Me këtë kuptim hapësira është një abstraksion, përshkrim kufizues i formës gjeometrike të një objekti, i cili ka gjatësi, gjerësi, formë dhe thellësi të caktuar ose i një figure që ka gjatësi, gjerësi dhe formë dhe me largësi ndërmjet tyre. Termi hapësirë në psikologji është përdorur me këto kuptime: 1) Hapësirë e përvojës së një individi, ku ai jeton dhe vepron; 2) Në analizën faktoriale, ku hapësira është faktor konceptual i inteligjencës dhe 3) Në teorinë e fushave të Kurt Levinit (Kurt Lewin, 1890 – 1947). Hapësira është emërtim i shtrirjes jetësore të njeriut.

HAPËSIRA E LËVIZJES SË LIRË. Tërësia e të gjitha skutave të një hapësire, të cilën një individ i caktuar e konsideron të përshtatshme për sjelljet e tij. Shtrirja e kësaj hapësire ka karakter individual, madje është e varur nga karakteri i mjedisit dhe nga kultura e pjesëtarëve të atij mjedisi. Sipas psikologut Dejvid Kreç (David Krech) "për një individ të arsimuar,

të suksesshëm, të shëndoshë, që jeton në një klimë të lirë sociale, hapësira e lëvizjes së lirë është shumë e madhe; për individin pa privilegje, të sëmurë, të paaftë ose viktimë të diskriminimit social dhe të padrejtësisë, hapësira e lëvizjes së lirë mund të jetë shumë e ngushtë".

HAPËSIRA JETËSORE. Hapësira që në psikologjinë vektoriale të Kurt Levinit përmbledh dukuritë, objektet, njeriun me aftësitë e tij, motivet, interesat, shprehitë, sjelljet e qëllimshme dhe mjetet që në çastin e caktuar ndikojnë në sjelljet e njeriut ndaj dukurive, objekteve e ndryshimeve të tyre. Tërësia e tyre dhe e raporteve ndërmjet syresh përcaktojnë sjelljen e njeriut ndaj objekteve e dukurive të hapësirës jetësore të tij. Hapësira jetësore e njeriut është e dyllojshme:

a. **Hapësira jetësore afatgjatë** – që emërton tërësinë karakteristike të sjelljeve të individit brenda një kohe relativisht të gjatë ndaj gjithë asaj që atë e rrethon;

b. **Hapësira jetësore afatshkurtër** – që emërton sjelljet e individit brenda një kohe të shkurtër. Sjellje të tilla janë të lidhura kryesisht me situatat konkrete të asaj hapësire dhe formën e reagimit të individit ndaj atyre situatave.

HARKU REFLEKSIV. Mekanizëm neurofiziologjik i organizmit, i përbërë nga ngacmuesi i shqisave, i muskulit, i gjëndrës, nga nervi prurës i impulsit nervor (neuroni aferent), nga marrja dhe përpunimi i këtij impulsi në qendrën nervore (në palcën kurrizore, në pjesët nënkortikale të trurit) dhe nga nervi nxjerrës (neuroni eferent) që bart impuls nervor deri në shqisën, në muskulin, në gjëndrën, duke e vënë në veprim këtë të fundit. Harku refleksiv është njësia elementare e sistemit nervor dhe forma më e thjeshtë e veprimtarisë së sistemit nervor.

HARTA KOGNITIVE. Harta mendore e karakterit pamor, që është e përbërë nga përfytyrimet, së pari, për mjedisin e ngushtë, në bazë të së cilit kafsha dhe njeriu orientohet në hapësirën e tij. Harta është skemë e formuar në bazë të përvojës dhe sipas saj njeriu dhe kafsha organizon sistemin e sjelljeve dhe të veprimeve të veta. Supozohet se minjtë e mëdhenj i zotërojnë rrugët e labirintet sipas kësaj harte dhe arrijnë deri te ushqimi, pasardhësit, uji etj. Këtë e ka argumentuar në mënyrë eksperimentale psikologu amerikan Eduard K. Tolman (Edward Ch. Tolman, 1886 – 1959).

HARTIMI I TESTIT. Term emërtues i veprimtarisë së gjithëmbarshme në hartimin e një testi. Kjo veprimtari përfshin: 1) Hartimin e detyrave testore, 2) Zbatimin eksperimental të kësaj forme të parë të testit në gjedhen ose modelin e caktuar dhe përpunimin e rezultateve të para provuese të vlerës së testit. Këtu hyjnë këto detyra: analiza e detyrave dhe e problemave testore, duke eliminuar ato të dobëta dhe duke sistemuar detyrat e problemat e përshtatshme me qëllimin e testit. 3) Zbatimin e formës përfundimtare të testit në gjedhen ose modelin përfaqësues të popullatës së caktuar dhe 4) Bazhdarimin i testit, që është shndërrimi i rezultateve të përgjithshme, përkatësisht i rezultateve bruto në rezultate të derivuara.

HARTLI David (David HARTLEY). Mjek psikolog dhe filozof anglez. Lindi më 1704 dhe vdiq më 1757. Në psikologji njihet më tepër si themelues formal i asociacionizmit dhe i ligjeve të asociacionit të ideve. Sipas pikëpamjeve të tij proceset e kujtesës, të të menduarit, të emocioneve dhe të veprimeve të vullnetshme të njeriut shpjegohen në mbështetje të asociacionit të ideve. Përjetimi i dy ideve në të njëjtën kohë ose njëra pas tjetrës dhe përsëritja e tyre shkaktojnë lidhje të caktuara në trurin e njeriut dhe këto lidhje trunore janë korrelate të lidhjes së ideve, pra ripërtëritja e këtyre lidhjeve shkakton ripërtëritjen e korrelateve të dy a më shumë ideve. David Hartli nxori në pah rolin e përsëritjeve të ideve si proces parësor për krijimin e lidhjeve apo asociacioneve të ideve. Asocimi i ideve nuk kryhet sipas vullnetit të njeriut, por është një proces mekanik mbi të cilin zhvillohen proceset e tjera psikike. Në kuadrin e një sistemi të tillë qëndrimesh personaliteti dhe vetëdija e njeriut janë pasive, sepse idetë riprodhohen në mënyrën si janë paraqitur dhe falë përsëritjes së tyre. Pra idetë nuk krijohen në mendjen e njeriut, por vetë riprodhohen. Sistematika e paraqitjes së këtyre pikëpamjeve është mjaft bindëse, por mungesat e saj filluan të dallohen qysh me botimin e veprës "*Analiza e dukurisë së vetëdijes njerëzore*", 1829. Vepra kryesore e tij është: *"Observations on Man, His Frame, His Duty, and His Expectations"* – (*"Vëzhgime mbi njeriun, ambientin, detyrat dhe shpresat e tij"*), 1749.

HARTMAN Hajnc (Heinz HARTMANN). Mjek dhe psikanalist amerikan me origjinë austriake. Lindi në Vjenë më 1894 dhe vdiq në Nju Jork më 1970. U rrit në një familje aristokrate dhe të pasur të Vjenës të prirë për mjekësi dhe art, por jo fetare. U diplomua në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Vjenës më 1920. Studiues i thellë i veprave të Zigmund Frojdit, sidomos analizues dhe rishikues i çështjes së dytë të strukturës së personalitetit, kur Frojdi përcaktoi strukturën trishtresore të personalitetit: atë të idit, të egos dhe të super egos. Në moshën e rinisë shkoi në Berlin, ku u njoh me idetë e sociologëve Maks Veber (Max Weber, 1864 – 1920) dhe Kurt Levin (Kurt Lewin, 1890 – 1947). Më 1925 u kthye në Vjenë dhe u bë anëtar i Shoqatës Psikanalitike të Vjenës. Iu nënshtrua psikanalizës së Zigmund Frojdit, i cili e vlerësoi lart zhvillimin intelektual të tij, duke e cilësuar si nxënësin më të mirë të psikanalizës, që i përket brezit të dytë. Prej vitit 1932 qe një ndër drejtorët e "Revistës Ndërkombëtare të Psikanalizës" – ("Internationale Zeitschrift fur Psychoanalyse"); Kryetar i Shoqatës së Psikanalistëve të Nju Jorkut gjatë viteve 1952–1954. Më pas u zgjodh Kryetar i Shoqatës Ndërkombëtare Botërore. Në psikologji njihet si i pari studiues i psikologjisë së egos, psikologji kjo, që zhvilloi idenë e studimit të njeriut në krahët e integrimit të tij në mjedisin shoqëror. Është variant i frojdizmit amerikan, që si qendër të studimit psikik të njeriut ka egon mbi atë të idit dhe super egos, pra mbi idin dhe të pavetëdijshmen e njeriut. Ego psikologjia është koncept dhe term i Hajnc Hartmanit. Me këtë qasje ai e ka shtrirë teorinë psikanalitike patologjike të Zigmund Frojdit në teori të përgjithshme të zhvillimit

normal të personalitetit. Veprat kryesore të tij janë: *"La psychologie du moi et le problem de l`adaptation"* – (*"Ego psikologjia dhe problemi i përshtatjes"*), 1939; *"Essays on Ego Psychology"* – (*"Ese mbi ego psikologjinë"*), 1964; *"Elementes de psychologie psychanalytique"* – (*"Elementet e psikologjisë psikanalitike"*), (me bashkëpunëtorë, 1975) etj.

HARRES/Ë, - A. f. Humbje e pjesshme ose e tërësishme, e përkohshme ose e përhershme e asaj që është mësuar. Harresa shfaqet në pamundësinë e të kujtuarit, të riprodhimit, të rinjohjes dhe në angazhimin e individit për ta rimësuar atë që ka harruar. Harresa e tillë shfaqet ndaj të gjitha formave të të mësuarit (harrohen dijet, ndjenjat, përvoja, shkathtësitë, shprehitë etj.). Harrohet sasia e asaj që është mësuar e përvetësuar dikur dhe harrohet edhe cilësia e asaj që ka qenë e përvetësuar, si: struktura e përmbajtjes së lëndës, lidhja e saj me përmbajtjet e tjera dhe shndërrohet ajo që mbetet në kujtesë në përmbajtje të ndryshuar nga përmbajtja burimore apo origjinale. Procesi i harresës së përmbajtjeve të mësuara është i ndryshueshëm, sepse në kujtesën e tyre ndikojnë faktorë të ndryshëm. Harresa është proces i natyrshëm dhe shfaqet në forma dhe me intensitet të ndryshuar.

HEBEFRENI, - A. f. I ardhur në psikiatri nga greqishtja *χεβε* "pubertet" dhe *φρηνος* "mendje, shpirt". Sëmundje shpirtërore, skizofreni e rëndë. Hebefrenia paraqitet në moshën e pubertetit (15 – 20 vjeç), si dhe pas kësaj moshe. Hebefrenia karakterizohet me çrregullime të rënda psikike, veçanërisht me çrregullime të proceseve kognitive (me halucinacione, me asociacione të çrregulluara, me ide fikse etj.), me çrregullim të proceseve të ndjenjave, të raporteve ndërmjet proceseve njohëse dhe atyre emocionale, si edhe me sjellje të papërshtatshme dhe të çuditshme.

HEDONIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga greqishtja *ηδονή* "kënaqësi". Termi hedonizëm ka hyrë në psikologji nga filozofia, përkatësisht nga etika. Hedonizmi emërton atë pikëpamje, sipas së cilës, besimi në kënaqësi dhe motivimi për ta arritur këtë e për t`iu larguar pakënaqësisë është një e mirë e nivelit të lartë dhe i vetmi kuptim i jetës dhe i aktivitetit të njeriut. Në psikanalizë hedonizmi shpjegohet sipas parimit të kënaqësisë, sipas të cilit shtytësit dhe energjia e tyre synojnë plotësimin e kënaqësinë e tyre pa marrë në konsiderate kurrfarë ndalese dhe pengese.

HELIOTROPIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga greqishtja *ηλιο* "dielli" dhe *τρόπο* "lëvizje". Lëvizja e disa organizmave, zakonisht e bimëve në drejtim të burimit të rrezeve të diellit.

HELMHOLC (Ludvig Ferdinand fon) Herman (Hermann Ludwig Ferdinand von HELMHOLTZ). Mjek fiziolog dhe fizikan gjerman. Lindi më 1821 dhe vdiq më 1894. Pas përfundimit të mjekësisë dhe angazhimit të tij si mjek u zgjodh më 1949 profesor i fiziologjisë në Universitetin e Këningsburgut, gjatë viteve 1855–1858 ishte profesor i fiziologjisë në Universitetin e Bonit, më pas në Universitetin e Heidelbergut. Mandej u zgjodh profesor i fizikës në Universitetin e Berlinit dhe drejtor i parë i Institutit Mbretëror për Fizikë

dhe Teknologji në Sharlotenburg. Herman Helmholci është bërë i njohur me zbulimet e tij në fushën e psikologjisë fiziologjike, ku konstatoi se bartja e impulseve nervore është më e vogël se ajo që e kishin përshkruar më parë. Në kuadrin e kësaj disipline ka konceptuar teorinë e të parit të ngjyrave. Sipas kësaj teorie ekzistojnë tri lloje substancash nervore për dallimin e ngjyrave: 1) Substanca nervore e të parit të ngjyrës së kuqe, 2) Substanca nervore e të parit të ngjyrës së gjelbër dhe 3) Substanca nervore e të parit të ngjyrës së kaltër. Përzierja e tyre shkakton të parët e ngjyrave të tjera. Ishte përkrahës i teorisë së energjisë specifike të Johans Milerit. Së fundi qe konceptues i teorisë së rezonancës në procesin e dëgjimit të zërave. Sipas tij, të dëgjuarit e toneve me intensitet të ndryshëm është i mundur falë dridhjes së fijeve të indit të membranës bazilare. Me këto zbulime të kohës së tij ka zënë vend të rëndësishëm në zhvillimin e psikologjisë eksperimentale të ndijimeve. Veprat kryesore të tij janë: *"Handbuch der Physiologischen Optik"* – (*"Doracak për fiziologjinë e të parit"*), 1856 – 1867; *"Die lehre von den tonempfinddungen"* – (*"Shkenca mbi ndijimin e toneve"*), *1963; "Der lehre von den Tonempfingdungen als Physiologische Grunlale für die Theorie der Musik"* – (*"Të mësuarit mbi ndijimin e toneve si bazë fiziologjike për teorinë e muzikës"*), 1862.

HELSON Harri (Harry HELSON). Psikolog amerikan. Lindi më 1898. Mbrojti doktoratën për psikologji në Universitetin e Harvardit më 1924. Ka punuar në kolegjin "Bryn Mawr" për 21 vjet (1928 – 1949), më pas në Universitetin e Teksasit (1951 – 1961), në Universitetin e Kanzasit (1961 – 1967) dhe në Universitetin e Masaçusetsit deri sa doli në pension. Ka qenë përkrahës i psikologjisë geshtaltiste. Ai përpunoi hollësisht parimet dhe konceptet e psikologjisë geshtaltiste, duke dalluar tri lloj ngacmuesish: fokalë, bazikë dhe të brendshëm. Derisa ngacmuesit fokalë dhe bazikë janë pak a shumë të përpunuar në kuadrin e parimeve të psikologjisë geshtaltiste, si ngacmues të brendshëm ai ka konsideruar të gjithë ato procese dhe gjendje të organizmit të brendshëm të njeriut, duke përfshirë proceset e kujtesës, proceset fiziologjike etj. Nga tërësia interaktive e të gjithë këtyre ngacmuesve zhvillohen proceset psikologjike. Ka përdorur edhe konceptin me termin e njohur "shkallë e përshtatjes", me të cilin ka kuptuar vlerën e së mesmes gjeometrike të të gjithë stimujve që veprojnë në organizëm. Veprat kryesore të tij janë: *"Theoretical Foundation of Psychology"* – (*"Bazat teorike të psikologjisë"*), 1951; *"Adaptation - Level Theory: An Experimental and Systematic Aproach to Behavior"* – (*"Teoria e nivelit përshtatës: drejtimi eksperimental dhe sistematik i sjelljeve"*), 1964.

HEMERALOPI, - A. f. Dukuria e "verbimit" ndaj dritës së ditës, përkatësisht dukuria e disa individëve, të cilët shohin mirë në mungesë të mjaftueshme të dritës dhe nuk shohin mirë në dritën e ditës. Hemeralopia rrjedh nga çrregullimi i fotoreceptorëve të rrjetëzës (retinës) së syrit, përkatësisht nga çrregullimi i funksionimit të kunjëzave dhe nga mundësia e kufizuar e regjenerimit të tyre.

HEMIANOPSI, - A. f. Dukuria e verbimit të gjysmës së fushës pamore

të syve. Te disa individë ndodh që, për shkak të lëndimit e të dëmtimit të rrugëve nervore ose të qendrave të të parit të cipës a kores së trurit të madh, gjysma e të parit të syrit të djathtë dhe e atij të majtë të jenë në gjendje verbimi. Ka raste kur gjysma e syrit të djathtë dhe gjysma e syrit të majtë të jenë të verbuar, madje ka edhe raste kur vetëm gjysma e njërit sy nuk sheh, kurse gjysma tjetër dhe i tërë syri tjetër është në gjendje të palënduar dhe këto pjesë të të dy syve shohin mirë**.**

HEMIANOPSIA BITEMPORALE. Ngushtim i fushës së të parit të objekteve të të dy syve. Ky çrregullim i të parit ka të bëjë me dallimin e qartë të objekteve që gjenden para syve, por jo edhe me të parit e atyre objekteve që gjenden mbas tyre. Shkak i këtij çrregullimi është ndërprerja e rrugëve nervore në kiazmën pamore apo optike, ku kryqëzohen nervat e syve. Këtu dëmtohet ana e prapme e rrjetëzës apo e retinës së syrit. Hemianopsia bitemporale shpesh është simptomë e tumorit të hipofizës. Ky tumor i shtyp fijezat nervore të kiazmës pamore.

HEMISFERA MBIZOTËRUESE. Hemisfera e trurit të majtë ku janë të vendosura qendrat e të folurit të njeriut. Rezultatet e gjurmimeve të mëvonshme kanë treguar se hemisfera e majtë është e specializuar për disa funksione të proceseve psikike dhe të sjelljeve të njeriut, kurse hemisfera e djathtë është e specializuar për disa të tjera. Por, specializimi i tyre për rregullimin e funksioneve të proceseve psikike dhe të sjelljeve të njeriut ka karakter relativ.

HEMISFERAT E TRURIT. Në anatomi, dy pjesët ose gjysmërruzujt e trurit të madh dhe dy pjesët e trurit të vogël që kanë përbërje dhe formë simetrike. Njëra hemisferë e trurit të madh ndahet nga hemisfera tjetër me plasën, brazdën ose çarjen ndërhemisferike ose me plasën gjatësore të trurit të madh (*fissura longitudinalis*). Dy hemisferat lidhen me trupin kallor (*corpus callosum*) dhe me pjesë të tjera që përbëjnë formacionin ndërhemisferik të trurit. Hemisferat kryejnë funksion të përbashkët dhe secila prej tyre mbisundon lëvizjet e anëve të kundërta të trurit: hemisfera e djathtë mbisundon lëvizjet e majta të trupit të njeriut, hemisfera e majtë atë të pjesës së djathtë të trupit.

HERBART Johan Fridrih (Johann Friedrich HERBART). Filozof, psikolog dhe pedagog gjerman me ndikim në zhvillimin e psikologjisë në mbarimin e shekullit XVIII dhe fillimin e shekullit XIX. Lindi në Oldenburg më 4.05.1776 dhe vdiq në Gëtingen më 14.08.1841. Konsiderohet përfaqësues eminent i psikologjisë asociacioniste në Gjermani dhe më gjerë. Për Xhon Fridrih Herbartin përfytyrimet me llojet dhe veçantitë e tyre janë formë e jetës shpirtërore të njeriut, madje këto janë formë themelore e jetës shpirtërore. Doktrina asociacioniste për të trajtohet si "mekanikë dhe statikë e përfytyrimeve". Fuqia e përfytyrimeve është aq e madhe, saqë këto përfytyrime, duke zotëruar gjithë jetën shpirtërore, konsiderohen se janë shkaktare që ndjenjat dhe synimet e njeriut të shtyhen nga struktura e vetëdijes dhe të bëhen pjesë e pavetëdijes së njeriut. Duke u mbështetur në pikëpamjet e tilla psikologjike, ai ka konceptuar shkallët formale të edukatës në për-

gjithësi dhe të mësimit në veçanti, të cilat janë: 1) Përgatitja e mësimit për edukim, 2) Paraqitja e qëllimit të mësimit dhe edukatës, 3) Thellimi i dijes për qëllimin e paraqitur, 4) Zbatimi praktik i dijeve, 5) Ushtrimi për zotërimin e plotë të tyre. Sipas mendimit të tij interesat e njeriut janë të shumta dhe luajnë rol të rëndësishëm edhe në teorinë e dijes. Interesat ndahen në dy grupe: Interesat natyrore (interesat empirike, filozofike dhe estetike) dhe Interesat historike (interesat simpatike, shoqërore dhe fetare). Në trevat shqipfolëse ndikimi i pikëpamjeve psikologjike dhe pedagogjike e filozofike të Johan Fridrih Herbartit u ndje vonë, madje, siç pohojnë psikologët, ky ndikim u ndie pas vitit 1916. Vlen të theksohet se dallohet ndikimi i pikëpamjeve psikologjike të Johan Fridrih Herbartit në trajtimin e çështjeve psikologjike në shkrimet e pedagogut shkodran Gaspër Beltojës, e pikërisht në përmbajtjen e veprës "Pedagogjia teorike", ku ka përpunuar disa nga konceptet e psikologjisë me synim përcaktimin e termave përkatës të tyre në gjuhën shqipe: "*Intelligence – Kuptimi*", "*Attention – Vështrimi*"; "*Memory – Kujtesa*", "*Imagination – Përfytyrimi*", "*Abstraction – Abstraksioni*" etj. Veprat kryesore të tij janë: *"Allgemeine Padagogik aus dem Zweck der Erziehung abgeleitet"* – (*"Pedagogjia e përgjithshme e nxjerrë nga qëllimi i edukatës"*), 1806; *"Hauptpunckte der Metaphysik"* – (*"Pikëpamja e përgjithshme për metafizikën"*), *1806; "Lehrbuch der Psychologie"* – (*"Teksti i psikologjinë"*), *1816; "Psychologie als wissenschaft"* – (*"Psikologjia si shkencë"*), 1824 – 1825.

HERBARTIZ/ËM, - MI. m. Tërësi pikëpamjesh pedagogjike dhe psikologjike të zhvilluara nga Johan Fridrih Herbart (Johann Friedrich Herbart, 1776 – 1841), mendimtar gjerman në fushën e psikologjisë, që ushtroi ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e pedagogjisë. Në veprat e tij psikologjike: "Teksti i psikologjisë", "Psikologjia si shkencë", "Gjurmime psikologjike" etj. theksohet rëndësia e përfytyrimeve për zhvillimin e proceseve të njohjes, pra të proceseve kognitive. Johan Herbart i ka dhënë rëndësi përvojës dhe studimit të rolit të saj në shkencën e psikologjisë. Sipas tij psikika krijohet nga idetë dhe këto kanë jetë, janë dinamike dhe statike. Idetë lidhen ndërmjet tyre sipas proceseve të caktuara, ku rol të posaçëm luan masa perceptive. Ato ide që përputhen me masën perceptive mbeten në kujtesën e njeriut, kurse të tjerat lidhen ndërmjet tyre sipas ngjashmërisë dhe kundërshtisë. Merita e madhe e tij në psikologji qëndron në kontributin e tij për pavarësi të psikologjisë, në zbatimin e matematikës për studimin e dukurive dhe të proceseve psikike dhe në zhvillimin e koncepteve të pavetëdijes etj. Me veprat psikologjike të përmendura Johan F. Herbart ka ndikuar edhe në zhvillimin e tekstologjisë pedagogjike.

HERC, - I. (Hz). Njësi standarde ndërkombëtare e matjes së numrit të dridhjeve të valëve të ajrit në një sekondë. U quajt herc, sipas zbuluesi të tij – fizikanit gjerman Hajnrih R. Herc (Heinrich R. Herz, 1857 – 1894).

HEREDITARIZ/ËM, - MI. m. Pikëpamje mbi zhvillimin e strukturave trupore e psikike, si edhe mbi sjelljet duke mbështetur rolin mbisundues të trashëgimisë në zhvillimin e formimin e tyre.

HEREDITET, - I m. I ardhur nga latinishtja *heredis* "trashëgimtar". Shih – ***TRASHËGIMIA.***

HEREZI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *αίρεση* "zgjedhje". Term që haset në psikologjinë e krishterimit. Ka kuptimin e mospajtimit me ato pikëpamje e qëndrime të kundërta me ato, që kisha i konsideron se janë të vërteta kishtare. Bartësit e herezisë janë dëbuar dhe dënuar për pikëpamjet, qëndrimet dhe sjelljet e tyre.

HERËSI I NDËRLIDHJES FI. Herësi i ndërlidhjes katërfishore, ose i quajtur ndryshe koeficienti i korrelacionit FI që përcakton masën e lidhjes ndërmjet arritjeve të renditura të dy grupeve subjektesh paralele të një përmase, p.sh., beqarë – të martuar, meshkuj – femra, mësimdhënës të mjekësisë–mësimdhënëse të infermierisë etj. Shih – ***NDËRLIDHJA; KORRELACIONI.***

H

HERING Evald (Ewald HERING). Psikolog austriak. Lindi më 1834 dhe vdiq më 1918. Kreu mjekësinë në Lajpcig dhe për shumë kohë qe profesor i fiziologjisë në Universitetin e Vjenës; më pas në Universitetin e Karlit në Pragë e në Universitetin e Lajpcigut. Gjatë veprimtarisë së tij qe nën ndikimin e psikofiziologjisë dhe psikofizikës së Teodor Fehnerit dhe të Ernst Veberit. Në psikologji mbeti i njohur me teorinë e të parit të ngjyrave. Dalloi tri çifte ngjyrash dhe, rrjedhimisht, tri çifte substancash fotokimike të retinës në syrin e njeriut, të tilla si: substanca për të parë ngjyrat: e kuqe – e gjelbër, e kaltër – e verdhë dhe e zezë – e bardhë. Këto substanca fotokimike veprojnë në mënyrë të pandërprerë nën ndikimin e dritës dhe në procesin e shkrirjes dhe të bashkimit të tyre, njeriu dallon atë ngjyrë që mbizotëron në këto procese. Kombinimi i ngjyrave themelore jep ngjyrën që prodhohet nga proceset e përzierjes së ngjyrave. Evald Hering kishte pikëpamje nativiste; për të perceptimi i hapësirës ishte i lindur. Veprat kryesore të tij janë: *"Beiträge zur Physiologie I – V"* – (*"Kontribute fiziologjike I – V"*) botuar prej vitit 1861 deri në vitin 1865; *"Die Lehre vom binokularen Sehen"* – (*"Të mësuarit për të parit binokular"*), 1868*; "Über des Gedächtnis al seine allgemaeine Funktion der organisierten Materie"* – (*"Mbi kujtesën si një funksion i përgjithshëm i materies së organizuar"*), 1870; "*Deutung des Psychophisieschen Gesetzes"* – (*"Rëndësia e ligjit psikofizik"*), 1909; *"Grundzüge der Lehre vom Lichtsinn"* – (*"Bazat e të mësuarit për dritën"*), *1920;* (teksi u rishikua dhe u botua më 1905 dhe më 1907).

HERMAFRODIT, - I. m. Term i biologjisë dhe i mjekësisë që emërton njeriun me zhvillim të strukturave riprodhuese (të organeve seksuale) femërore dhe mashkullore gati të padiferencuara. Ky zhvillim e mori emrin nga mitologjia greke, ku Hermafroditi – bir i Hermesit dhe i Afërditës – na paskësh qenë dashuruar me një nimfë, në trupin e së cilës ndodheshin organet seksuale të dy gjinive.

HEROINË, - A. m. Një ndër përbërësit e grupit të narkotikëve. Ka ndikim në ndryshimin e gjendjes emocionale të njeriut, lehtëson tensionin psikik të njeriut dhe zbret shkallën e frikës dhe të ankthit duke ngritur nivelin e euforisë. Për këto cilësi heroina konsiderohet narkotik i nivelit relativisht të lartë.

HETEROSEKSUALITET, - I. m. I ardhur nga greqishtja *χέτερος* "i ndryshëm" dhe nga latinishtja *sexualities* "gjini". Heteroseksualiteti emërton dukurinë e gjendjes seksuale të njeriut mashkull të drejtuar te pjesëtari i gjinisë së kundër – i gjinisë femër. Në heteroseksualitet hyjnë këto cilësi tërheqëse të individit të njërës gjini përballë atij të gjinisë tjetër: dëshira, emocionet, interesi, nevoja dhe sjellja e njeriut, me të cilat ai do duhej të bëhej atraktiv, tërheqës për të individët e gjinisë së kundërt, që i drejtohet individit të gjinisë së kundërt. Heteroseksualiteti është dukuri normale e njerëzve normalë.

HEURISTIK/Ë, - A. f. Term i greqishtes që emërton parimet dhe metodat, zbatimi i të cilave çon në zbulimin e fakteve, të parimeve, të ligjeve etj., në vërtetimin e hipotezave dhe të teorive shkencore, si edhe në nxitjen e të tjerëve për të ndjekur rrugë njohëse objektive në njohjen dhe në zbulimin e së vërtetës. Heuristika me këtë kuptim mund të emërtojë edhe fusha të psikologjisë. E tillë është psikologjia kognitive heuristika, emërtim ky, me të cilin tregohet metoda që përdoret për zgjidhjen e problemeve, për marrjen e vendimeve etj.

HI KUADRATI. Metoda e gjurmimit statistikor të raportit ndërmjet shkallës së dendësisë së paraqitur nga matja e një ndryshoreje të pavarur me numrin e caktuar të subjekteve dhe dendësinë e pritur, dendësinë teorike. Ky raport llogaritet sipas formulës:

$$x^2 = \frac{(f_0 - f_t)^2}{f_t}$$

HIDHËRIM, - I. m. Njëra ndër llojet e emocioneve më të shpeshta. Hidhërimi është ndjenjë e pakënaqësisë, e rënies së besimit te tjetri, e inatit etj., që shkaktohet nga pengimi i plotësimit të motiveve, nga pengesat për realizimin e një qëllimi të caktuar dhe nga ngacmuesit e ndryshëm që kanë drejtim veprimi të kundërt me atë që njeriu pret. Ndjenjat e përmendura (pakënaqësia, humbja e besimit, inati etj.) janë përbërëse të hidhërimit të njeriut, por hidhërimi është cilësi e veçantë emocionale.

HIERARKI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *χιξερος* "botë" dhe *χειν* "sundoj". Termi buron nga teologjia dhe emërton sundimin e priftërinjve. Hierarkia ka kuptim të përgjithshëm, sipas së cilës emërtohet klasa, kategoria etj. e koncepteve, e ngjarjeve, e individëve etj. që renditen duke filluar nga ai i nivelit më të lartë e duke ardhur te ai më ti ulëti dhe duke përfunduar në më të ulëtin.

HIERARKIA DOMINUESE. Rangje të anëtarëve të një grupi individësh, të përcaktuara sipas nëngrupit, individit më të rëndësishëm, më të fuqishëm dhe ky nëngrup ose individ konsiderohet se është dominues në sjelljet e anëtarëve të atij grupi. Në shpjegimin e kësaj hierarkie të sjelljeve shoqërore u mor për bazë radha e zotërimit të një pule në grupin e pulave të tjera të të njëjtit grup.

HIERARKIA E ANKTHIT. Disa ngacmues e përfytyrime situatash të ndryshme, të shkallëzuara sipas intensitetit të tyre, që shkaktojnë ankth te njeriu. Hierarkia e ankthit është një ndër teknikat që shfrytëzohet në terapinë bihejvioriste.

HIERARKIA E MOTIVACIONIT MASLOU. Pikëpamje e psikologut amerikan Abraham Maslou (Abraham Maslow, 1908 – 1970), sipas të cilit të gjitha motivet duhen konsideruar përbërës të një sistemi hierarkik të nevojave, ku janë renditur dy lloj nevojash: nevojat biologjike dhe meta nevojat. Shih – ***HIERARKIA E NEVOJAVE.***

HIERARKIA E MOTIVEVE. Radha sipas së cilës shfaqen motivet, përkatësisht nevojat sipas rëndësisë e vlerave, si edhe sipas intensitetit të tyre. Ky term i përket teorisë së psikologut amerikan Abraham Maslou. Sipas tij motivet e njeriut përbëjnë një sistem hierarkik nevojash, i përbërë prej këtyre grupeve nevojash: 1) Nevojat biologjike a fiziologjike, 2) Nevojat e sigurisë, 3) Nevojat e lidhjes emocionale, të përkatësisë dhe yë dashurisë, 4) Nevojat kognitive, 6) Nevojat estetike, 7) Nevoja e vetaktualizimit. Abraham H. Maslou e ka konceptuar këtë sistem nevojash e motivesh duke u orvatur t`i japë karakter universal dhe duke pohuar se njeriu më parë duhet të plotësojë nivelin më të ulët të nevojave dhe pas përmbushjes së tyre mund të fillojë plotësimi i nevojave të nivelit më të lartë.

HIERARKIA E NEVOJAVE. Term i psikologut amerikan Abraham Maslou (Abraham Maslow, 1908 – 1970). Sipas teorisë së tij "të gjitha motivet e njeriut mund të konsiderohen përbërës të një sistemi hierarkik të nevojave". Shumësia e motiveve njerëzore buron nga hierarkia e nevojave. Sa më e ulët të jetë një nevojë në sistemin hierarkik, aq më e fuqishme është ajo nevojë dhe pa plotësimin e saj nuk zhvillohet një nevojë e nivelit më të lartë në hierarkinë e nevojave. Sistemi hierarkik përmban shtatë grupe nevojash: 1) Nevoja fiziologjike (për oksigjen gjumë, ujë etj.); 2) Nevoja për sigurim jetësor (mungesë e urrejtjes dhe e rrezikut, kushte të sigurta për jetën etj.); 3) Nevojat për t`i takuar një mjedisi dhe nevoja e dashurisë (bashkimi me të tjerët, pranimi i njeriut nga të tjerët etj.); 4) Nevojat për arritje sa më të larta, për respektim nga të tjerët (status i lartë në shoqëri, nderim, prestigj shoqëror etj.); 5) Nevojat njohëse ose kognitive (kureshtja, informimi, kuptimi etj.); 6) Nevojat estetike (nevoja për art, bukuri, rend etj.) dhe 7) Nevojat e vetaktualizimit (realizim i potencialit njerëzor të individit, i dispozitave, i synimeve etj.) Shih – ***HIERARKIA E MOTIVEVE.***

HIERARKIA E SHPREHIVE. Renditja e shprehive nga ato më të thjeshtat te shprehitë më të ndërlikuara. Një sistem i tillë ka rëndësi sidomos në procesin e edukimit dhe të mësimit shkollor fillor. Sipas këtij rendi shprehitë formohen duke i ushtruar dhe përvetësuar elementet e thjeshta, lidhjet ndërmjet tyre dhe duke bërë koordinimin e të gjitha elementeve dhe formimin e një shprehie të tërë. Në teorinë e të mësuarit sipas Klark Hal (Clark Hull, 1884 – 1952) hierarkia e shprehive ka kuptimin e zhvillimit dhe të formimit të shprehive mbi bazën e shprehisë së formuar në një nivel më të ulët, e pikërisht pas zotërimit të një shprehie më pak të ndërlikuar mund të fillojë të mësuarit e një shprehie më të ndërlikuar. Këtu bëhet fjalë veçanërisht për zhvillimin e shprehisë së daktilografimit dhe të shprehisë së ligjërimit.

HIGJIENA MENDORE. I ardhur nga greqishtja *υγειο* "i shëndetshëm", *μείο* "mendje, shpirt". Nëndisiplinë e higjienës së përgjithshme dhe njëra ndër disiplinat e grupit të shkencave zbatuese të psikologjisë. Higjiena mendore ka për objektiv themelor ruajtjen dhe përparimin e shëndetit mendor të njerëzve. Kjo disiplinë ka katër detyra kryesore: 1) Hulumtimin e faktorëve individualë dhe shoqërorë që shkaktojnë çrregullime dhe sëmundje mendore apo psikike; 2) Marrjen e masave për pengimin e ndikimit të tyre në shëndetin mendor të njerëzve dhe 3) Zhvillimin e qëndrueshëm të shkathtësive të individëve për ruajtjen dhe përparimin e shëndetit mendor dhe 4) Zhvillimin harmonik të aftësive të njeriut, të proceseve dhe të sjelljeve të tij në përputhje me njerëzit e shëndoshë mendërisht. Në zhvillimin e higjienës mendore shfrytëzohen rezultatet e arritura në higjienën e përgjithshme, në fiziologji, në psikologji dhe në sociologji. Higjiena mendore fillimet e saj si lëvizje mendore i ka në Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga mbarimi i shekullit të nëntëmbëdhjetë. U shndërrua në disiplinë zbatuese të psikologjisë nga fillimi i shekullit të njëzet, duke e emërtuar këtë disiplinë në Europë, sidomos nga psikiatri zviceran Eugjen Bloiler (Eugen Bleuler, 1857 – 1939) me termin "Psikohigjiena".

HIJ/E, - A. f. Term i psikologjisë analitike ose komplekse të Karl G. Jungut (Carl G. Jung, 1875 – 1961). Hija emërton tiparet dhe aspektet e errëta të personalitetit. Këto janë përbërësit e shtypur të personalitetit, pjesët inferiore, vlerat e ulëta të personalitetit, të cilat sipas K. Jungut "janë shtresat më të ulëta, që gati nuk dallojnë nga natyra e shtytësve të kafshëve". Përbërësit e tillë të hijes kanë karakter të pavetëdijshëm, i përkasin anës emocionale, kanë pavarësi dhe dinamikë të posaçme, që orvaten të depërtojnë në vetëdijen e njeriut. Megjithëse ne e mohojmë ekzistencën e pjesës së errët të personalitetit, një hije e tillë është pjesë përbërëse e trupit psikik, njësoj si edhe ana e ndritshme e trupit tonë. Njohja e hijes nga ana e njeriut është pjesë përbërëse e veprimtarisë morale të tij.

HIPERAKUZI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *υπερ* "mbi" dhe *ακοή* "dëgjim". Mprehtësi e madhe, madje edhe e jashtëzakonshme e të dëgjuarit të toneve dhe zhurmave me intensitet të ulët. Dëgjimi i këtij niveli tepër të lartë dallohet veçanërisht në kohën e pubertetit.

HIPERALGJEZI, - A. f. I ardhur nga greqishtja që ka të bëjë me ndjeshmërinë e nivelit më të lartë të njeriut ndaj dhembjeve.

HIPERBULI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *υπερ* "mbi" dhe *βολή* "vullnet". Hiperbulia emërton fuqinë e vullnetit të ngritur në nivel të lartë. Shfaqet në faza të posaçme të aktivitetit të njeriut dhe nuk ka karakter të qëndrueshëm.

HIPERESTEZI, - A. f. I ardhur nga greqishtja që emërton rritjen e intensitetit të ndjeshmërisë së shqisave, sidomos të ndjeshmërisë së prekjes së lëkurës. Hiperestezia ka kuptimin që shtrihet edhe në ndjeshmërinë e rritur të një shqise ndaj aromës, shijimit etj. Kjo dukuri dallohet sidomos brenda një faze të pagjumësisë, të një helmimi të veçantë të organizmit. Dukuria e

hiperestezisë shfaqet edhe në rastet e vuajtjes nga histeria.

HIPERFAGI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *υπερ* "mbi" dhe *τροφία* "ngopje". Hiperfagia është dukuria e marrjes së pamasë të ushqimit, grykësi ose mosngopje e dallueshme dhe uri e jashtëzakonshme. Shkaktohet nga çrregullimi i disa qendrave vitale dhe i një pjese të hipotalamusit. Te hiperfagia ndryshon regjimi i të ushqyerit, sepse ushqimi merret kohë pas kohe. Njeriu i pangopur kërkon dhe merr shpesh ushqim me kalori. Të gjitha këto ndryshime shfaqen në trashjen e organizmit dhe në sedimentin dhjamor të trupit të individit që vuan nga hiperfagia.

HIPERFRAZI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *υπερ* "mbi" dhe *φράση* "të folur", që nënkupton të folurit pa masë. Në rastet ekstreme mund të jetë simptomë e ndonjë çrregullimi psikik, përkatësisht simptomë e sëmundjes së manisë (në kuadrin e psikozës maniako – depresive).

HIPERKATEKS, - I. f. Në psikanalizë, i ardhur nga greqishtja. Shtimi i energjisë psikike të shtytësve në funksion të zotërimit të një objektivi të brendshëm ose të jashtëm, ose për të përforcuar me energji një proces tjetër psikik.

HIPERKINEZI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *υπερ* "mbi" dhe *κίνδυνος* "lëvizje". Lëvizje gati e pandërprerë dhe e pakontrolluar e një individi. Te hiperkinezia bëhet fjalë edhe për lëvizje të pavullnetshme dhe automatike ose gjysmëautomatike. Hiperkinezia shkaktohet kryesisht nga ndryshimet patologjike të nervave të sistemit motorik parapiramidal.

HIPERLEKSI, - A. f. I ardhur nga greqishtja. Shkathtësia e parakohshme e një fëmije gjatë të lexuarit në një proces standard të të mësuarit të shkronjave të alfabetit të një gjuhe. Duhet pasur kujdes se zhvillimi i kësaj shkathtësie shumë kohë para standardeve shkollore të të mësuarit të alfabetit nuk është shenjë e zhvillimit mbimesatar mendor të fëmijës. Në rastet e tilla kështillohet kontrolli i zhvillimit mendor dhe i shkallës së këtij zhvillimi.

HIPERMIMI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *υπερ* "mbi" dhe *μίμος* "imitues". Gjestikulimi dhe mimicërimi i tepruar dhe i panevojshëm i shprehjes së mendimit dhe të ndjenjave. Kjo është më e dallueshme të fëmijët, kurse te të rriturit merr përmasa patologjike në rastet e sëmundjes së histerisë dhe të manisë.

HIPERMNEZI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *υπερ* dhe *μνησία* "kujtesë". Mbikujtesa, e pikërisht aftësia mbinormale e zhvillimit të kujtesës, që shfaqet nga mbajtja mend e riprodhimi i hollësive, shpesh edhe të panevojshme. Në rastin e hipermnezisë mbahen mend dhe riprodhohen datat e ngjarjeve të parëndësishme, rendi i fjalëve të një fjalori, shkronja e parë e shumë fjalëve të një gjuhe të huaj, numra telefonikë të ndryshëm etj. Hipermnezia nuk është në lidhje pozitive me inteligjencën e shkallës mbimesatare. Shih – ***IDIOTI SAVANT.***

HIPERMNEZIA HIPNOTIKE. Shfaqja për disa pacientë e aftësive të jashtëzakonshme të kujtesës së ngjarjeve, të dhënave të hollësishme dhe të lidhjeve të përfytyrimeve të "harruara" që prej shumë kohësh, por të

rishfaqura te ta në gjendje hipnotike. Kjo dukuri u shfrytëzua si argument se harresa në kuptimin e mirëfilltë të saj nuk ekziston. Shih – ***HARRESA.***

HIPERSOMNI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *υπερ* "mbi" dhe nga latinishtja *somnus* "gjumë". Çrregullim i gjumit të njeriut që manifestohet me zgjatje të orëve të gjumit. Hipersomnia ka karakter kronik, kur individi ndjen nevojë për gjumë gati të pandërprerë ditën dhe natën. Hipersomnia mund të jetë periodike me një zgjatje prej disa ditësh deri në disa javë, natyrisht me zgjime të shkurtra për nevoja biologjike, por kjo mund të marrë edhe karakterin e një sëmundjeje kur merr përmasat e zgjatjes së gjumit në mënyrë të vazhduar. Në rastet e fundit hipersomnia mund të jetë pasojë e sëmundjeve organike, si: encefaliti, epilepsia, tumoret e trurit etj.

HIPERTIREOZ/Ë, - A. f. I ardhur nga greqishtja *υπερ* "mbi" dhe *θυρεοειδής* "tiroide". Sëmundje e funksionimit të gjëndrës tiroide që manifestohet me gushë, me përshpejtim të rrahjes së zemrës, me lodhje të shpejtë, me pagjumësi, me ankth, me kokërdhokun e syve të dalë jashtë mase nga zgavra e syrit etj. Këto janë simptoma të asaj sëmundje të njohur me termin sëmundja e Bazedit. Hipertireoza është pasojë e rritjes së nivelit të tiroksinës – hormonit të gjëndrës tiroide.

HIPNOANALIZ/Ë, - A. f. I ardhur nga greqishtja *ύπνος* "gjumë" dhe *αναλυδχης* "zbërthim". Formë e terapisë psikanalitike e cila shfrytëzon hipnozën për zbulim të rezistencës së pacientit dhe për thyerje të kësaj rezistence, duke përfituar të dhëna të dobishme për analizën e përmbajtjes së formave të çrregullimit të disa sjelljeve të pavetëdijshme të këtij pacienti.

HIPNOPEDI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *ύπνος* "gjumë" dhe *παιδεία* "mësim". Të mësuarit nga njeriu gjatë kohës së gjumit. Në fillim të gjysmës së dytë të shekullit të njëzet është folur dhe shkruar shumë për mundësinë e njeriut për të mësuar gjatë kohës kur ai fle. Të mësuar gjatë fjetjes është orvatje për të përvetësuar përmbajtjet e lëndëve të caktuara, të gjuhëve të huaja, madje edhe të disa shkathtësive etj. me anë të dëgjimit të zërit të magnetofonit. Nuk ka rezultate pozitive për hipnopedi.

HIPNOTERAPI, - A. f. Formë e psikoterapisë që zbaton hipnozën si mjet të kurimit të çrregullimeve dhe të sëmundjeve psikike (ankthi, depresioni, histeria, stresi pastraumatik etj. Zbatohet nga ana e specialistëve të psikiatrisë dhe nga psikologët klinikë. Hipnoterapia zbatohet me sukses, por jo edhe te të gjitha rastet e sëmundjeve psikike. Megjithëse ka histori të vjetër të zbatimit të saj duke filluar nga neurologu francez Zhan Martin Sharko (Jean Marten Charcot, 1825 – 1993), themelues i hipnoterapisë moderne konsiderohet psikiatri dhe psikoterapisti amerikan Milton H. Erikson (Milton H. Erickson, 1901 – 1980).

HIPNOZ/Ë, - A. f. I ardhur nga greqishtja *ύπνος* "gjumë". Gjendje psikike e individit që është e ngjashme me gjendjen e tij në gjumë. Gjendjen psikike të individit në hipnozë e karakterizojnë këto cilësi: ngushtimi i fushës së vetëdijes, pasiviteti i individit, vëmendja e përqendruar vetëm në

një ose në një rreth të ngushtë objektivash, zvogëlimi i energjisë së funksioneve psikike, nënshtrimi i fuqishëm ndaj sugjestioneve etj. Rezultatet e ndryshimeve të valëve elektroencefalografike tregojnë se gjendja e njeriut në hipnozë ka valë të tjera nga gjendja e tij në gjumë. Megjithëkëtë gjendja e njeriut në hipnozë ekziston. Hipnoza ka qenë dhe pjesërisht ka mbetur forma e gjurmimit të përmbajtjeve të pavetëdijshme, dhe i ka paraprirë psikanalizës dhe psikoterapisë psikanalitike. Gjendja e njeriut në hipnozë shkaktohet artificialisht nga hipnotizuesi, i cili në mënyrë të posaçme shkakton përqendrimin e vëmendjes së individit a klientit në një objektiv të caktuar dhe më pas me anën e ngacmuesve monotonë ia zvogëlon shkallë – shkallë vetëkontrollin dhe e vë atë në gjendje relaksi progresiv, pikërisht në gjendje të përgjumur. Dallohet gjendja hipnotike periferike, ajo e thellë dhe gjendja e komës hipnotike. Hipnoza është njohur që në kohët e lashta, ndoshta që në fillimet e historisë së njerëzimit. Pohohet se hipnoza ka qenë njohur nga Egjiptianët, Grekët, Ilirët etj. Këtë e ka përmendur edhe mjeku i njohur i shekullit të gjashtëmbëdhjetë Paracelzus (Paracelzus, 1493 – 1541). Hipnozën e ka zbatuar edhe mjeku austriak Anton Mesme (Anton Mesmer, 1734 – 1815). Në kohët më të vonshme termi hipnozë lidhet me emrin e kirurgut skocez Xhejms Braid (James Braid, 1889 – 1928). Hipnoza u shfrytëzua si mjet psikoterapeutik, sidomos nga ana e Jozef Broier (Josef Breuer, 1842 – 1925), Zhan Martin Sharkot (Jean Marten Sharcot, 1825 – 1893) dhe Ipolit Bernhaim (Hyppolyte Bernheim, 1840 – 1919). Zigmund Frojdi (Sigmund Freud, 1856 – 1939) e braktisi hipnozën dhe zhvilloi teknikën e asociacioneve të lira dhe shpjegimin e ëndrrave. Sot hipnoza zbatohet në disa fusha të mjekësisë dhe të disiplinave humaniste, por zbatimi i saj është larg asaj të kohërave më të vjetra.

HIPOAKUZI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *υπό* "nën" dhe *kusis* "dëgjim". Hipakuzia është term i fiziologjisë së dëgjimit që ka të bëjë me dëmtim të dëgjimit. Emërton konceptin e dobësimit të dëgjimit të toneve dhe zhurmave me intensitetit të ulët që në shkallën e hipakuzisë janë të padëgjueshme.

HIPOALGJEZI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *υπό* "nën" dhe *αλγυος* "dhembje" që nënkupton zvogëlimin e madh të ndjeshmërisë së njeriut ndaj dhembjeve. Hipalgjezia shfaqet nën ndikimin e disa faktorëve, si: droga, disa medikamente dhe në një gjendje të veçantë të njeriut (gjendje transi).

HIPOFIZ/Ë, - A. Shih – ***GJËNDRA E HIPOFIZËS.***

HIPOFUNKSION, - I. m. I ardhur nga greqishtja *υπό* "nën" dhe latinishtja *function* "realizim, veprim". Zvogëlimi i funksionit të strukturave organike dhe psikike të organizmit, përkatësisht rënia e funksionit të tyre nën gjendjen normale. Ka disa shkaqe të hipofunksionit të strukturave psikike dhe organike, si: helmimi, lodhja e madhe, konfliktet e përhershme, sëmundjet e ndryshme, si edhe degjenerimi organik në moshën e pleqërisë.

HIPOKAMPUS, - I. m. I ardhur nga greqishtja *ιππό καμπος* "çuditëri

detare". Term i anatomisë së sistemit nervor, i rëndësishëm për rolin e funksionin e tij, sidomos në zhvillimin e procesit të kujtesës. Hipokampusi është formacion neurologjik i ndërlikuar i trurit, që përbëhet nga qelizat nervore të organizuara në formë të kalit të detit, në formacion shumë të vogël dhe shtrihet në pjesën limbike të trurit. Luan rol të rëndësishëm në zhvillimin e procesit të të mësuarit, sidomos në mbajtjen mend të përmbajtjeve që mësohen. Ky rol i hipokamusit shfaqet sidomos në shndërrimin e përmbajtjeve të kujtesës afatshkurtër, në përmbajtje të ngulitura të kujtesës afatgjatë. Dëmtimi i funksionit të hipokampusit reflektohet negativisht në proceset e kujtesës. Kur dëmtimi i hipokampusit është i dyanshëm ai shkakton pamundësinë e mbajtjes mend të përmbajtjeve të reja. Ata që vuajnë nga një dëmtim i tillë i hipokampusit janë në gjendje të kujtojnë disa nga përmbajtjet motorike e intelektuale, si edhe emocionet e hershme, por përmbajtjet e reja që orvaten t`i mësojnë, arrijnë t`i vendosin me vështirësi në kujtesën afatgjatë, ose këtë nuk arrijnë ta kryejnë fare.

HIPOKINEZ/Ë, - A. f. I ardhur nga greqishtja *υπό* "nën" dhe *κίνηση* "lëvizje". Veprimtari e zvogëluar në masë të madhe nga ana e një individi. Hipokineza shfaqet me lëvizje të ngadalëësuara, me jogatishmëri për të reaguar me të gjithë kapacitetin motorik, me një trajtë gjysmë të ngurtë të organizmit dhe të gjymtyrëve të tij etj.

HIPOKONDRI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *υπό* "nën" dhe *κουος* "nën bri". Çrregullim psikik që manifestohet me ngarkesën subjektive dhe me përqendrimin e tepruar të vëmendjes së individit në organizmin e tij, si edhe me angazhimin e tij, drejtuar në formë të pandërprerë në gjendjen shëndetësore të tij. Shfaqet me frikësim të madh ndaj ndryshimeve të parëndësishme organike dhe psikike, madje shpesh vuan nga ngarkesa e ekzistencës së ndonjë sëmundje organike të supozuar. Disa forma simptomash të hipokondrisë i hasim edhe te disa sëmundje psikike, si: neurastenia, neuroza, paranoja, skizofrenia etj. Simptomat e hipokondrisë psikanaliza i shpjegon me kthim të libidos dhe drejtim të energjisë ndaj trupit të një individi të caktuar e jo ndaj trupave jashtë organizmit. Shih – ***LIBIDOJA.***

HIPOKRIZI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *υπό κρισία*. Shtirja e disa njerëzve gjoja sikur kanë bindje, dëshirë, interes, sinqeritet etj. për një individ ose të tjerë individë, si edhe për mirëqenien e tyre, kurse në të vërtetë nuk i ka. Dyfytyrësia e paraqitjes së bindjeve, të qëndrimeve, të vlerave etj. në të cilat ai nuk beson, është ndër format e shpeshta të hipokrizisë.

HIPOLOGJI, - A. f. Mungesa e aftësisë së të menduarit logjik dhe e shprehjes së drejtë e të kuptueshme të mendimeve dhe të qëndrimeve. Ndër shkaqet e hipologjisë është edhe çrregullimi i funksionit të disa qendrave nervore.

HIPOMANI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *υπό* "nën" dhe *μανία* "çmenduri". Formë e manisë me një intensitetit më të ulët. Shih – ***MANIA.*** Hipomania godet në radhë të parë gjendjen emocionale të njeriut, ku individi

shfaq çrregullime emocionale jo aq të rënda. Në fillim të zhvillimit të hipomanisë individi nuk shfaq çrregullime të dukshme, madje është i këndshëm për shoqërinë, komunikues dhe i përzemërt. Por, më pas gjendja e tij emocionale vjen duke u keqësuar. Ky ndryshim negativ shfaqet sidomos me rritjen e shkallës së ndjeshmërisë emocionale, me tolerancë të ulët, me sjellje të vrazhda, me të folur të shpejtë, me gatishmëri të marrjes së detyrave, por duke mos i kryer ato, me kontroll të sjelljeve të tij morale që vjen vazhdimisht duke u dobësuar. Rrjedha e mendimeve dhe kujtesa është relativisht e padëmtuar, por ai nuk është në gjendje të bëhet i vetëdijshëm për çrregullimin e gjendjes emocionale dhe as për sjelljet e tij negative.

HIPOMNEZI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *υπό* "nën" dhe *μνηση* "kujtesë". Formë e ndryshimit patologjik të kujtesës, dëmtim i aftësisë së kujtesës që shfaqet me zvogëlim të madh të të mbajturit mend, të rinjohjes dhe të riprodhimit. Shkaktohet nga faktorët psikogjenë dhe nga ndryshimet negative organike. Hipomnezia shfaqet kryesisht te të moshuarit dhe e shoqëruar me disa simptoma të sëmundjeve psikike.

HIPOTAKSI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *υπο* "nën" dhe *αταξία* "çrregullim i lëvizjeve". Zvogëlimi i aftësisë së kontrollit të lëvizjeve dhe të veprimeve të vullnetshme të njeriut. Shfaqet me intensitet të ndryshuar dhe është pasojë e çrregullimit të funksionit të disa pjesëve të palcës kurrizore.

HIPOTALAMUS, - I. f. I ardhur nga greqishtja *υποθάλαμος* "zonë nëngungore". Strukturë relativisht e vogël nervore (madhësia e një kokrre kikiriku), por shumë e ndërlikuar, që kryen funksione të rëndësishme organike dhe psikike. Gjendet nën talamus dhe përbëhet nga tri pjesë: 1) Pjesa periferike përbëhet prej një numri të madh qelizash sekretuese që i shërbejnë hipotalamusit për të kontrolluar funksionin e hipofizës, 2) Pjesa qendrore që përbëhet nga bërthamat e qelizave nervore hipotalamike dhe 3) Pjesa anësore e përbërë prej rrugëve nervore, aksoneve dhe prej trupit të qelizave nervore. Këto pjesë përbëjnë një tërësi organike që me funksionet e saj lidhet ngushtë me sistemin nervor vegjetativ dhe, së bashku, rregullojnë temperaturën, rrahjet e zemrës, presionin e gjakut, urinën dhe etjen, proceset emocionale të frikës e të tmerrit dhe sjelljet seksuale të njeriut.

HIPOTETIK, - E. mb. I ardhur nga greqishtja *υποθετικός* "i (e) supozuar". Hipotetik ose i supozuar mundet të jetë koncepti, gjykimi, raporti etj., i cili është i kushtëzuar. Hipotetik mund të jenë konstruktet psikologjike, si: arketip, karakteri anal, ndjenja etj. Hipotetik është gjykimi "Nëse arrihet marrëveshja, paqja është e sigurt".

HIPOTEZ/Ë, - A. f. I ardhur nga greqishtja *υπόθεση* "baza". Supozim, pohim ose mohim që duhet argumentuar në bazë të kontrollit të plotë dhe të saktë të kushteve dhe raporteve esenciale që shkaktojnë dukurinë që duhet shpjeguar. Hipoteza, pra, është supozim i paargumentuar për ekzistencën, zhvillimin, ndryshimin etj. të një dukurie, objekti, sjellje etj. që duhet argumentuar dhe pastaj duhet pranuar

ose hedhur poshtë, në mbështetje të rezultateve të arritura në procesin e të provuarit të saj. Hipoteza ka rëndësi të madhe në procesin hulumtues: ajo drejton procesin e të menduarit, nxit mbledhjen e të dhënave e të fakteve adekuate dhe rrit në nivel më të lartë ndjeshmërinë e hulumtuesit për problemet anësore. Në metodologjinë e psikologjisë bëhet fjalë për këto lloje hipotezash:

a. **Hipoteza eksplikuese** – Supozim shkencor i argumentuar në bazë të argumenteve të mjaftueshme, solide dhe të besueshme për shpjegim objektiv të një dukurie, çështjeje, problemi etj.;

b. **Hipoteza alternative** – Argumentim i një hipoteze tjetër nga hipoteza që i është nënshtruar vërtetimit të saj. Në gjurmimet psikologjike hipoteza alternative nënkupton orvatjen e argumentimit të paqëndrueshëm të hipotezës zero (hipoteza nul), që shpie në pranimin e hipotezës tjetër, të hipotezës alternative, e cila e përjashton hipotezën zero**.**

c. **Hipoteza eksploruese** – Hipotezë pune, e cila kërkon hulumtim më të gjerë dhe argumentim të saj me fakte esenciale, që duhet mbledhur e përpunuar. Qëllimi i hipotezës eksploruese është nxitja e hulumtimeve më të gjera për dukurinë, procesin, lidhjen e proceseve etj. E tillë do të ishte hipoteza: ndërmjet zhvillimit të inteligjencës dhe të mësuarit ekziston një lidhje, por nuk dimë çfarë është ajo lidhje, sa është koeficienti i kësaj lidhjeje etj.;

d. **Hipoteza për nivelin e shtresave të individualitetit** - Supozim sipas të cilit personaliteti është i organizuar nga nivelet e larta ose shtresat e larta psikike kah ato të nivelit më të ulët, përkatësisht nga niveli i zhvillimit të shtresës së vetëdijes, të para vetëdijes dhe të pas vetëdijes. Një nevojë, konflikt etj. mund të shfaqet në një nivel, por jo edhe në nivelin a shtresën tjetër të personalitetit;

e. **Hipoteza për mosekzistencën e harresës** – Pikëpamje supozuese se nuk ekziston harresa në kuptimin e mirëfilltë të termit harresë. Dukuria e hipermnezisë, e shfaqjes së ideve gjatë hipnozës, e paraqitjes së kujtimeve pas disa dekadave etj. merret si argument për mosekzistencën e harresës.

f. **Hipoteza zero** – Hipotezë e hulumtimeve empirike. Hipoteza zero është supozim që niset nga pohimi se nuk ekziston kurrfarë lidhjeje ndërmjet dy dukurive, ndërmjet rezultateve të arritura në matjen e një ndryshoreje psikologjike në dy grupe subjektesh të vendlindjeve të largëta, kurse në hulumtime më të gjera të së njëjtës lidhje orvatemi ta vërtetojmë të kundërtën, përkatësisht mu ndërmjet atyre dy grupeve subjektesh ekziston një lidhje e një niveli të caktuar të ndryshoreve që hulumtohet. Hipoteza zero provohet me test – t.

HIPOTEZA PSIKOLOGJIKE STATISTIKE. Zero hipoteza. Sipas kësaj hipoteze dy vlera sasiore të së mesmes aritmetike të dy kampionëve a gjedheve të së njëjtës popullatë, me gjithë ndryshimet e vogla ndërmjet tyre, kanë vlerë statistikore për të gjithë popullatën, meqë ndryshimet ndërmjet tyre janë shkaktuar nga faktorët e rastësishëm. Kur rezultatet e arritura dhe shpjegimi statistikor i tyre përputhet me një ligjësi statisti-

kore, atëherë hipoteza e parashtruar në fillim të gjurmimit vërtetohet; nëse kjo nuk ngjet, ajo është e pavlefshme.

HIPOTIREOZ/Ë, - A. f. I ardhur nga greqishtja υπό "nën", *θυρεο* "mbrojtës" dhe *ειδισμός* "forma". Tireoza është çrregullim i funksionimit të gjëndrës tiroide për një kohë relativisht të gjatë, që ka pasoja organike dhe psikike për njeriun. Çrregullimi i funksionimit të kësaj gjëndre ka të bëjë me sekretimin e pamjaftueshëm të hormonit të saj – tiroksinës. Tiroksina është rregulluese e proceseve metabolike dhe e sasisë së jodit në proceset fiziologjike të organizmit, ku dallohet sidomos roli i sasisë së mjaftueshme të jodit në zhvillimin e cipës apo kores së trurit të madh. Nga pikëpamja e çrregullimeve organike hipotireoza shfaqet me ngadalësimin zhvillimor të organizmit, me rritjen e kufizuar të trupit, me pagjumësi etj. Hipotireoza ka pasoja të rënda edhe në zhvillimin e strukturave e të proceseve psikike, posaçërisht në prapambetjen intelektuale e motorike. Shih – ***KRETENIZMI.***

HIROMANTI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *χέρι* "dora" dhe *μαντεία* "fall". Pseudoshkencë. Dikur është besuar se hiromantia është interpretim dhe vlerësim i tipareve psikike dhe i fatit të njeriut në bazë të veçorive anatomike të shuplakës së dorës dhe të trashësisë e drejtimit të vizave të lëkurës së saj. Themelues i saj ka qenë Embrouz Birsi. Hiromantia u tregua si besëtytni dhe si e tillë nuk ka kurrfarë baze shkencore. Sot përmendet rrallë në literaturën bashkëkohore të psikologjisë dhe në terminologjinë e psikologjisë.

HISTERI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *ιστερικός* "miter". U standardizua në terminologjinë e psikiatrisë dhe të psikologjisë klinike për një kohë të gjatë në shumë gjuhë, sikurse edhe në gjuhën shqipe. Qysh nga koha e studiuesit egjiptian Kahun Papirus (Kahun Papirus, rreth viteve 1900 p.e.r.) dhe Hipokratit (Hypokrat, 460 – 377 p.e.r.) histeria njihej si mosfunksionim i mitrës dhe për shumë kohë konsiderohej se histeria është sëmundje nervore e femrave. Galeni i Romës (Galen 131 – 201) dhe shumë më vonë Zhan Martin Sharkot (Jean Marten Charcot, 1825 – 1893) dhe Zigmund Frojd (Sigmund Freud, 1856 – 1939) kanë kontribuuar në etimologjinë e kësaj sëmundjeje, duke theksuar se nga histeria nuk vuajnë vetëm femrat, por edhe meshkujt. Historia është çrregullim psikik i femrave dhe i meshkujve dhe ka këto simptoma kryesore: anestezioni funksional, disosacioni i ideve, dhembje e pjesëve të ndryshme të trupit, halucinacionet, mutizmi, ndjeshmëri e theksuar emocionale, paraliza funksionale, përfytyrimi i vetes gjithmonë shoqërohet me ndjenja joadekuate, somnambulizmi, vështirësi në dallimin e fantazisë nga realiteti etj. Shkaqet e kësaj sëmundjeje janë shkaqe psikogjene. Me gjithë çrregullimet fiziologjike e psikologjike, të sëmurët nga histeria janë individë fizikisht të shëndoshë.

HISTERIA MASIVE. Term emërtues i asaj dukurie psikosociale të një vendbanimi, fshati a të një grupi të madh individësh të një regjioni, kur këta sillen në mënyrë emocionale të pakontrolluar, shpesh me sjellje paniku pas përhapjes së një lajmi jo shpresëdhënës. Në një rast ka mjaftuar lajmi radiofonik se njerëzit e planetit Mars do të zbresin në tokë dhe do ta pushtojnë

atë, për të shkaktuar te dëgjuesit e këtij lajmi dhe te përhapësit e tij panik.

HISTOGRAMË, - A. m. I ardhur nga greqishtja *ιστό* "thurje" dhe *γραμμα* "gramë". Histograma është formë e paraqitjes grafike të dendësisë ose frekuencave të të dhënave psikologjike të përftuara nga matja e një ndryshoreje. Paraqitja grafike e këtyre rezultateve bëhet me anën e kënddrejtave që kanë gjerësinë e intervalit proporcional të klasës, kurse gjatësia e kënddrejtave i përgjigjet dendurisë së të dhënave të klasës përkatëse. Këtë e ilustron figura e mëposhtme:



HISTOLOGJI, - A. f. Disiplinë shkencore e biologjisë me rëndësi të veçantë edhe për shkencat mjekësore. Histologjia merret me studimin e strukturës mikroskopike të indeve të organeve dhe të sistemeve të këtyre organeve të organizmit. Rezultatet e hulumtimeve histologjike janë të rëndësishme për psikologjinë fiziologjike.

HISTORIA E PSIKOLOGJISË. Lindja dhe zhvillimi i shkencës së psikologjisë është e lidhur ngushtë me përmendoret psikologjike. Këto tregojnë interesimin e hershëm të njerëzimit për jetën shpirtërore dhe për dukuritë e saj, por, gjithashtu edhe formimin e vonshëm të psikologjisë si shkencë e pavarur. Ky zhvillim është trajtuar nga ana e psikologut gjerman Herman fon Ebinghauz (Hermann von Ebinghaus, 1850 – 1909) me fjalët: *"Psikologjia ka histori të shkurtër, por të kaluar të lashtë"*. Fjalia e parë e kësaj periudhe tregon se psikologjia është ndër shkencat relativisht të reja, kurse fjalia e dytë tregon interesimin për njohjen e shpirtit dhe të dukurive të tij që nga kohët e lashta, madje, edhe shumë kohë para zbulimit të sistemit grafik të shkronjave. Për historinë e psikologjisë flitet zakonisht pas zbulimit të sistemit të grafisë së shkronjave, meqë parahistoria e zhvillimit të saj deri sot ka dhënë rezultate të kufizuara. Duke marrë për bazë këtë kriter klasifikues të zhvillimit të mendimit psikologjik, zhvillimi i tij dhe i psikologjisë ndahet në tri periudha kryesore: 1) Periudha e zhvillimit të mendimit psikologjik popullor, 2) Zhvillimi i mendimit psikologjik në kuadrin e mendimit filozofik dhe 3) Psikologjia – shkencë e pavarur.

1. Zhvillimi i mendimit psikologjik popullor

Mendimi psikologjik popullor i përket periudhës para zbulimit të sistemit të grafisë shkrimore. Kjo është periudhë zhvillimore e veprimtarisë shpirtërore, por e popujve me kulturë të pashkruar të sistemit grafik shkrimor. Këtu hyjnë shfaqjet e lashta të dukurive shpirtërore, si: zakonet popullore, gjëegjëzat, fjalët e vajtimit, këngët, vallet, fjalët e urta popullore etj. Të gjitha këto krijime kanë përmasa psikologjike të ndryshme (emocionale, njohëse dhe motivuese), të lidhura drejtpërdrejt me sjellje. Ndër to dallohen zakonet popullore. Këto janë modele të rrënjosura thellë në aktivitetin e secilit anëtar të grupimit shoqëror,

të çdo populli, të çdo etnie. Zakonet tradicionale janë përgjithësime përvojash të shumë brezave, që zhvillohen dhe përsosen duke u bartur prej njërit brez në brezin tjetër, pa pranimin e plotëvetëdijshëm të tyre. I tillë ka qenë Ligji XII i tabelave në Romë (450 vjet p.e.r.), i ligjeve të Drakonit në Greqi (shekulli VI p.e.r.), e drejta zakonore shqiptare etj. Këto modele sjelljesh të kësaj tradite u mblodhën dhe u botuan herët a vonë, natyrisht pas zhvillimit të sistemit të grafisë shkrimore. Mitet, legjendat dhe besimet religjioze gjenden në fillesat e zhvillimit të kulturave të të gjithë popujve. Mitet ishin tregime fantastike për zhvillimin e gjithësisë, të zotave dhe të njerëzve. Legjendat janë trillime fantastike të pabesueshme, por të dallueshme në disa lloj tregimesh popullore. Besimet në perëndi u kanë paraprirë miteve dhe përbëjnë struktura shpirtërore të hershme në zhvillimin e mendimit dhe të sferës së emocioneve. Këto konsiderohen se janë struktura të "shpirtit popullor". Të lidhur ngushtë me këto mendime popullore janë edhe animizmat, përkatësisht shpirtëzimi i të gjitha objekteve dhe dukurive inorganike dhe organike, si edhe pavdekshmëria e shpirtit të njeriut etj.

H

2. Zhvillimi i mendimit psikologjik në kuadrin e mendimit filozofik

Mendimet mbi shpirtin dhe mbi dukuritë shpirtërore dallohen në veprat dhe në trajtesat e çështjeve filozofike të mendimtarëve Kinezë, Indianë, Arabë e posaçërisht të mendimtarëve antikë Grekë dhe Romakë. Në fillim njohjes së dukurive shpirtërore, mendimet mbi shpirtin dhe mbi dukuritë shpirtërore i përqasen si tërësi e posaçme dhe madje disa nga vetitë shpirtërore u janë atribuuar edhe objekteve jo të gjalla. Në kuadrin e sistemeve të caktuara filozofike, filozofët antikë Grekë bënë shumë përgjithësime disa nga të cilat kanë vlerë të caktuar edhe sot. Qysh herët Krotonias Alkemoni i Kretonit (rreth viteve 520 p.e.r.) konsideronte se truri është bartës i jetës shpirtërore dhe se ai ka lidhje me shqisa. Hipokrati (460 – 377 p.e.r.) paralajmëroi nevojën e studimit të ndryshimeve individuale sipas temperamentit. Aristoteli (384 – 322 p.e.r.), përshkroi shpirtin animal, vegjetativ dhe të arsyes dhe përcaktoi disa nga aktivitetet shpirtërore. Bëri fjalë për kujtesën, për përfytyrimet, për iluzionet etj. Formuloi ligjet e lidhjeve të përfytyrimeve etj. Erozosias Teofrasti (372 – 288 p.e.r.) me veprën "Karakteret" dallohet si paraprijës i studimeve për ndryshimet individuale ndërmjet njerëzve dhe si paraprijës i metodës së të vërejturit objektiv dhe të rolit të saj në studimet psikologjike.

Termi psikologji siç dihet rrjedh nga greqishtja e vjetër, megjithëse, si neologjizëm *φυσιο* "shpirt" dhe *λόγος* "shkencë, fjalë" shfaqet vonë, gjegjësisht pas vitit 1500. Termi psikologji u krijua nga Filip Shvarcerde (Philip Shvazerde) i njohur me emrin Filip Melantoni (Philip Melantoni, 1497 – 1560). U përdor për herë të parë nga Rudolf Gokel (Rudolf Gockel i quajtur Goklenius (Goclenius, 1547 – 1628) në veprën e botuar në greqisht me titull: *"Psychologie de hominis perfection anima"* – (*"Psikologjia e njeriut dhe përsosja e shpirtit"*), botuar më 1590. Sipas arbëreshit kroat, Kruno Kërstiç (Kruno Krstić, 1905 – 1987), humanisti kroat

Marko Maruliç (Marko Marulič, 1450 – 1524) e përdori termin "Psichiologia" në shkrimin e humbur "*Psikologjia e arsyes së shpirtit njerëzor*" – "*Psychiologia de ratione animae humanea*". Ndërkaq, në veprën "Shorter Oxford English Dictionary" është shënuar se termi *psychology* – "psikologji" haset më 1693; termi *psychological* – "psikologjik" më 1776 dhe termi *psychologis* – "psikolog" më 1727. Mendimtarët antikë grekë u interesuan për çështjen substanciale të shpirtit. Në pyetjen themelore ç'është shpirti dhe çfarë raportesh ekzistojnë ndërmjet shpirtit dhe organizmit, përgjigjet e tyre u ndanë në ato materialiste dhe në ato idealiste. Platoni (Platon, 427 deri më 347 p.e.r.) ka pohuar se ekzistojnë dy botë: ajo materialiste dhe ajo e ideve, duke i dhënë përparësi të dytës dhe duke renditur edhe shpirtin (shqisor, emocional dhe racional) në kategorinë idealiste. Aristoteli (Aristotel, 384 – 322 p.e.r.) botoi veprën "Për shpirtin" – ("Pery psyches"). Kjo është vepër e parë psikologjike, ku u përshkruan dhe u shpjeguan disa nga dukuritë shpirtërore (për ndijimet, iluzionet, emocionet, mendimin, karakterin etj). Tri ligjet e asociacioneve të ideve (të vazhdimësisë apo të kontinuitetit, të ngjashmërisë dhe të kontrastit) kanë ruajtur aktualitetin edhe sot. Këto përbëjnë pikëpamjen themelore të psikologjisë filozofike, kurse pikëpamja idealiste ishte pikëpamje dominuese gjatë një periudhe të gjatë të zhvillimit të mendimeve për shpirtin. Gjatë periudhës së Mesjetës mbisunduan pikëpamjet metafizike dhe religjioze për shpirtin.

Thoma Akuini (Tommaso d'Aquino, 1225 – 1274) mendimet e Aristotelit i lidhi me Krishtërimin, duke shkaktuar stanjacion mendor e veçanërisht, stanjacion të mendimit për shpirtin dhe për dukuritë e tij. Këtë periudhë e karakterizon përqasja dogmatike ndaj shpirtit dhe ndaj dukurive të tij. Në periudhën e humanizmit ringjallen pikëpamjet antike për shpirtin. Më vonë përfaqësuesit e filozofisë së empirizmit, të racionalizmit dhe të materializmit të shek. XVIII (Xhon Loku, René Dekarti, Baruh Spinoza, Pol Holbahu etj.), theksuan rolin e faktorëve fizikë, fiziologjikë dhe të kushteve të tjera të mjedisit të jashtëm në zhvillimin e jetës psikike dhe të dukurive të saj.

Filozofi francez René Dekart (René Decartes, 1596 – 1650) dhe matematikani e filozofi gjerman Gotfrid V. fon Lajbnic (Gottfried W. von Leibnitz, 1646 – 1716) ishin ndër themeluesit e paralelizmit psikofizik, duke shpjeguar në këtë mënyrë çështjen e raportit trup – shpirt. Xhon Lok (John Lock, 1632 – 1704) është themelues i doktrinës asociacioniste në psikologji. Këtë doktrinë e përpunuan disa mendimtarë, ndër të cilët David Hartli (David Hertley, 1705 – 1757) u përpoq të gjente bazën fiziologjike të asociacioneve, duke shpjeguar proceset e ndërlikuara psikike (emocionet, ëndrrat, vullnetin) në bazë të ligjit të vazhdimësisë dhe të shpeshtësisë apo të frekuencës së paraqitjes së tyre. Më vonë u ndie ndikimi i tyre në themelimin e disa drejtimeve psikologjike. Nën ndikimin e tyre jeta psikike filloi të studiohet me baza të elementeve materialiste, mbi të cilat u zhvillua psikologjia.

Mendimet, pikëpamjet e sistemit filozofik, sikurse edhe zhvillimi i shkencave natyrore, sidomos i atyre që

zbatuan metodën e eksperimentit, së pari fiziologjia e fizika, si edhe zhvillimi i disiplinave mjekësore bëri që të krijohet baza teorike për zhvillimin e psikologjisë si shkencë e pavarur. Ndër këta studiues të shkencave natyrore dallohet fizikani dhe fiziologu gjerman Herman L. Helmholc (Hermann L. Helmholtz, 1821 – 1894), për gjurmimin eksperimental të ndijimeve të dëgjimit dhe të të parit, mjeku dhe frenologu gjerman Franc J. Gal (Franz J. Gall, 1758 – 1828) për pikëpamjen e tij për lokalizimin e funksioneve psikike dhe të cilësive zhvillimore të trurit të madh, fiziologu francez Klod Bernard (Claude Bernard, 1815 – 1878) dhe Ivan M. Seçenov (Ivan M. Sečenov, 1829 – 1905). Rezultatet e gjurmimeve klinike ushtruan ndikim në gjurmimin eksperimental të zhvillimit të proceseve psikike, ku dallohen disa gjurmues, ndër të cilët fiziologu dhe kirurgu francez Paul Brok (Paul Broca, 1824 – 1880).

3. Psikologjia - shkencë e pavarur

Zë fill në studimet eksperimentale të Ernst. H. Veberit (Ernst H. Weber, 1795 – 1878), Gustav T. Fehnerit (Gustav Th. Fechner, 1801 – 1887) dhe Vilhelm Vuntit (Wilhelm Wundt, 1832 – 1920). Vilhelm Vunti themeloi laboratorin e parë për studime psikologjike në Lajbnic më 1879 dhe përcaktoi një program të veçantë për studimin eksperimental të dukurive psikike. Studimet eksperimentale të Helmholcit (1821 – 1894), Seçenovit (1829 – 1905), të Loces (1817 – 1881) etj. nga fusha e fizikës dhe e fiziologjisë, duke prekur edhe fushën e psikologjisë, patën rëndësi teorike dhe metodologjike për zhvillimin e psikologjisë si shkencë e pavarur. Studimet e para psikologjike ishin të lidhura kryesisht me proceset e thjeshta psikike dhe mbi bazën fizike dhe fiziologjike të tyre. Këto treguan rëndësinë e studimeve ndërdisiplinore për zhvillimin e psikologjisë dhe hapën rrugë për studime eksperimentale të dukurive të ndërlikuara psikike. Herman fon Ebinghauzi (Hermann von Ebbinghaus, 1850 – 1909) studioi kujtesën dhe harresën, Osvald Kylpe (Oswald Külpe, (1862 – 1915) studioi procesin e të menduarit. V. Vunt, H. Ebinghauz dhe O. Kylpe ishin themeluesit e shkollës së strukturalizmit në psikologji. Uliam Xhejms (William James, 1842 – 1910), Robert S. Uduërth (Robert S. Woodworth, 1869 – 1962), Xhejms M. Katel (James M. Cattell, 1860 – 1944) etj. themeluan shkollën funksionaliste të psikologjisë. Alfred Bine (Alfred Binet, 1857 – 1911) studioi inteligjencën dhe hartoi shkallën e njohur për matjen e inteligjencës. Zhan Piazhe (Jean Piaget, 1896 – 1980) i parapriu themelimit të shkollës kognitive të psikologjisë me përfaqësuesit Xhorxh Miler (Georg Miller, 1920 –) e Ulrik Naiser (Ulric Neiser, 1928 –). Maks Vertaimeri (Max Werthiemer, 1880 – 1943) studioi tërësinë e proceseve psikike (para së gjithash, të perceptimeve) dhe, së bashku me Kurt Kofkën (Kurt Koffka, 1886 – 1941), Volfgang Këlerin (Köhler Wolfgang, 1887 – 1941) e me Kurt Levinin (Kurt Lewin, 1890 – 1947) hodhën bazat e shkollës së psikologjisë geshtaltiste. Zigmund Frojdi (Sigmund Freud, 1856 – 1939), Karl Jungu (Carl Jung, 1875 – 1961) dhe Alfred Adleri (Alfred Adler, 1870 – 1937) ishin themeluesit e shkollës së

psikanalizës. Këtë e vazhduan psikanalistët socialë Karen Hornei (Caren Horney, 1885 – 1952), Erik Erikson (Eric Erikson, 1902 – 1994), Erik From (Erich Fromm, 1900 – 1980) etj. Ivan P. Pavllovi (Ivan P. Pavlov, 1849 – 1946) studioi aktivitetin e lartë nervor dhe reflekset e kushtëzuara, duke kontribuar në themelimin e shkollës bihejvioriste të Xhon B. Uotsonit (John B. Watson, 1878 – 1958), të Eduard K. Tolmanit (Edward Ch. Tolman,1886 – 1959), të Klark L. Halit (Clark L. Hull, 1884 – 1952), të Frederik Skinerit (Frederick Skiner, 1904 – 1990), të Alfred Bandurës (1925– 1952) etj. Frencis Goltoni (Francis Galton, 1822 – 1911) në Angli dhe Xhejms M. Kateli (James M. Catell, 1860 – 1946) në SHBA studiuan aplikimin e metodave psikologjike dhe të rezultateve të psikologjisë në zgjidhjen e problemeve konkrete të njerëzve gjatë punës në fabrika, në shkolla, në ushtri etj. Mori hov zhvillimi i shkollës humaniste të Albert Maslout (Albert Maslow, 1908 – 1989), të Karl Roxhersit (Carl Rogers, 1902 – 1987), Karen Horneit (Karen Horney, 1885 – 1952) etj. Rezultatet e studimeve të tyre dhe të shumë të tjerëve i dhanë shkas afirmimit të psikologjisë si shkencë e pavarur dhe zhvillimit të hovshëm të studimeve empirike. Zhvillimi i saj mori hov në pesëdhjetë vjetët e fundit të shekullit të njëzet.

Si e këtillë psikologjia u zhvillua nën ndikimin e vazhdueshëm të disa rrymave mendore, nga të cilat dallohet ndikimi negativ i reduksionizmit të dukurive psikike në dukuri fiziologjike e sociologjike. Psikologjia në konflikte të vazhdueshme me pikëpamje të këtilla apo të ngjashme me këto, u afirmua gjithnjë e më tepër në sajë të rezultateve empirike. Zhvillimi i saj në drejtimin e studimeve empirike thelloi njohuritë për rolin e njeriut e të aftësive të tij në zhvillimin e veprimtarisë edukativo-arsimore, në shtimin e produktivitetit të punës, në përforcimin e fuqive të armatosura, në mbrojtjen e shëndetësisë etj. U afirmuan disa degë zbatuese ose aplikative, psikologjia klinike, psikologjia e punës, psikologjia pedagogjike etj. Së bashku me to u vunë bazat e një sistemi të diferencuar të shkencave psikologjike. Sot psikologjia zë vend të dalluar në sistemin e shkencave. Kësaj i takon pozita qendrore në "trekëndëshin" e sistemit të shkencave, brinjët e të cilit i përbëjnë filozofia, shkencat natyrore dhe shkencat shoqërore.

HISTORIA E RASTIT. Metodë e grumbullimit të të dhënave për subjektin karakteristik. Të dhënat biografike, të kushteve familjare, të rrethit shoqëror, të raporteve shoqërore etj. shënohen objektivisht dhe sistematizohen me përpikëri. Këto të dhëna ndihmojnë për njohjen e zhvillimit dhe të formimit të personalitetit që me vështirësi i përshtatet kërkesave të mjedisit të ngushtë dhe të gjerë ku ai jeton dhe zhvillohet. Zbatohet më tepër në psikologjinë zhvillimore, në psikologjinë pedagogjike, në psikologjinë forensike etj.

HISTORIA E VETËDIJES. Psikologjia empirike e ka nisur zhvillimin e saj me studimin e dukurive psikike të vetëdijshme dhe ka kaluar në faza të ndryshme të lëndës studimorem, duke ardhur në ditët e sotme në konceptimin e proceseve psikike dhe

të sjelljeve, si lëndë e psikologjisë. Në rrugëtimin konceptual të zhvillimit të mendimit për vetëdijen dallojmë këto faza: strukturalizmin, funksionalizmin, geshtaltizmin, qëllimin, psikanalizën dhe bihejviorizmin. Strukturalizmin në psikologji e ka trajtuar psikologu gjerman Edvard Tiçener (Edward B. Titchener, 1867 – 1927), i cili ka shtjelluar mendimin për elementet e vetëdijshme psikike dhe lidhjen e tyre. Në bazë të metodës së vetëvëzhgimit, ka dalluar këto elemente të vetëdijshme të aktivitetit psikik të njeriut: ndijimet, përfytyrimet dhe ndjenjat me cilësitë si vijon: cilësia, intensiteti dhe kohëzgjatja e tyre. Format e tjera të ndërlikuara të jetës psikike janë lidhje dhe kombinim i këtyre elementeve. Për funksionalizmin vetëdija është përjetim i vazhdueshëm i njeriut me përmbajtje dinamike të pandërprerë. Si uji i lumit që rrjedh vazhdimisht, ashtu edhe përmbajtja e vetëdijes ndryshon pandërprerë. Mendimtari dhe psikologu amerikan Uljam Xhejms (William James, 1842 – 1910) është përfaqësuesi eminent i kësaj pikëpamjeje të funksionalizmit. Geshtaltizmi i është qasur gjurmimit të vetëdijes si anë e tërësishme e përjetimeve psikike. Për psikologjinë e akteve të mendimtarit gjerman Franc Brentano (Franz Brentano, 1838 – 1917) karakteristika themelore e vetëdijes është intencionaliteti, përkatësisht aktet e vetëdijshme kanë drejtimin e tyre në një qëllim apo objektiv të caktuar. Veprimet e paqëllimshme janë veprime të pavetëdijshme. Bihejviorizmi i Xhon Uotsonit (John Watson, 1896 – 1958) e mohon vetëdijen dhe termat e koncepteve të vetëdijshme. Psikanaliza e Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1938) nuk e mohon vetëdijen, por këtë e lidh ngushtë me të pavetëdijshmen dhe me strukturën përmbajtësore të saj. Psikologjia e filozofisë së materializmit vetëdijen e ka përcaktuar "shprehje subjektive dhe të realitetit objektiv". Ky mendim ka dominuar në psikologjinë e gjysmës së dytë të shekullit të njëzet edhe ndër Shqiptarët. Secila shkollë psikologjike i është qasur gjurmimit të vetëdijes në bazë të konceptimit të përgjithshëm të saj për jetën psikike dhe për format e ndryshme të shfaqjes së saj, duke përfshirë edhe sjelljet e njeriut ndaj vetes dhe ndaj mjedisit e ndryshimeve të tij.

HISTORIA E ZHVILLIMIT TË PSIKOLOGJISË NDËR SHQIPFOLËSIT. Në trevat e shqipfolësve gjenden përmendore të fiseve ilire që nga lashtësia, e që, në mënyrë karakteristike pasqyrojnë edhe format e shprehjes shpirtërore dhe disa nga sjelljet individuale dhe kolektive. Është për të besuar se ato piktura të sjelljeve kanë qenë të përcaktuara nga strukturat e ndryshimeve shpirtërore. Dallohen edhe piktura sjelljesh të drejtuara kah objekti i caktuar, që kanë pasur karakter teologjik. Pikturat, muralet e zbuluara nga arkeologët në disa zona të Dardanisë së atëhershme, në Jug të Shqipërisë etj. janë shprehje e animizmit, mitizmit, etj. Këto janë ndër dëshmitë e zhvillimeve shpirtërore të të parëve tanë. Në dëshmi të ngjashme mbështesin arkeologjinë shpirtërore edhe të tjerët. Megjithëkëtë, këto dëshmi janë të pamjaftueshme për një qasje të diferencuar studimore të zhvillimeve

psikike. Dëshmitë e shkruara për sjelljet e lashta të shkruara pas zbulimit të sistemit shkronjor janë më objektive. Të dhëna të shkëputura për zhvillimet shpirtërore të përgjithshme dhe të Shqiptarëve gjenden në veprat e autorëve të vjetër. Të dhëna të këtilla gjenden sidomos në veprën "Çeta e profetëve" e Pjetër Bogdanit.

Sjelljet normative nga Lashtësia deri në kohët më të reja janë brumosur, përforcuar e përmirësuar me shekuj. E tillë është e drejta zakonore mbarëshqiptare, e cila është "tërësia e normave të pashkruara (rregullave të sjelljes) të vendosura *ad hoc* nga gjykatat e pleqve apo Kuvendet për rregullimin e marrëdhënieve shoqërore në fusha të ndryshme të jetës, zbatimi i të cilave sigurohej nga forca e traditës, opinionit shoqëror dhe nga autoriteti patriarkal i organizmave të vetëqeverisjes së popullit. Ai është krijuar nga populli gjatë shekujve dhe jo nga një individ i caktuar apo organi legjislativ i posaçëm. Kanuni i Lekë Dukagjinit, sjelljet dhe lutjet fetare në "Mesharin" e Gjon Buzukut, në doktrinën fetare "Çeta e Profetëve" e Pjetër Bogdanit etj., figurat mitologjike dhe strukturat e folklorit popullor (urtësitë, përrallat, këngët popullore etj.) dhe përmbajtja e tyre u bartën nga një brez në tjetrin, duke mos qenë të shkruara. Këto i përkasin zhvillimit të mendimit psikologjik të Shqiptarëve në periudhën ende të pazbuluar të sistemit të grafisë, përkatësisht të alfabetit të gjuhës shqipe. Kuptohet, krijimet popullore kanë qenë të pandërprera. Studiuesit shqiptarë, pavarësisht nga mungesa e alfabetit të gjuhës shqipe, deri më 1908 kanë botuar veprat e tyre në gjuhët e tjera. Kështu, kanë vepruar humanistët shqiptarë duke i botuar veprat e tyre në latinisht. Jeronim de Rada botoi veprën e njohur të tij "Parime të estetikës" në italisht, Hasan Tahsini botoi veprën "Psikologji ose Ilmi Ruh" në osmanisht etj.

Periudha e zhvillimit të mendimit psikologjik pas zbulimit të sistemit të grafisë për Shqiptarët ka një karakteristikë të posaçme. Shqiptarët kanë shkruar sipas sistemit të gramatikës latine, greke, arabe e turke. Leonik Tomeu (1456 – 1531), Marin Beçikemi (1468 – 1526), Marin Barleci (Marinus Barletius, rreth 1460 – 1512/13) etj. kanë lënë shkrime në latinisht, ku janë përvijuar edhe dukuritë shpirtërore, veprimtaria e personazheve dhe disa tipare sjelljesh karakteristike.

Përshkrime dhe shpjegime dukurish psikike dhe sjelljesh të veçanta të afërta me psikologjinë filozofike gjenden në shkrimet e Teodor Kavaliotit (Theodor Kavalioti, 1718 – 1797), të studiuesit të estetikës e shkrimtarit Jeronim de Rada (1814 – 1903), të studiuesit të etikës dhe logjikës Jani Vreto (1822 – 1900). Faik Konica në mënyrë jo të drejtpërdrejtë ushtroi ndikim në kalimin e fazës së mendimit psikologjik popullor në mendimin psikologjik shkencor. Me përshkrimin e pamjes fizike dhe të temperamentit të Shqiptarëve, sidomos me theksimin e rolit të vëzhgimit shkencor si metodë hulumtuese, duhet konsideruar si ndërmjetësues i kalimit të mendimit psikologjik popullor në mendimin psikologjik shkencor.

Konsolidimi konceptual i psikologjisë dhe zhvillimi institucional i saj

Zhvillimi i psikologjisë sipas metodave e teknikave gjurmuese, sistemimi i fakteve, i përgjithësimeve në formë rregullash, ligjesh e teorish dhe uniteti i tyre në Shqipëri ka filluar me përcaktimin e psikologjisë si lëndë mësimore në Normalen e Elbasanit në vitin mësimor 1913 – 1914. Në fakt, në këtë vit u bë institucionalizimi i mendimit psikologjik shkencor, që ishte modifikuar për nevojat e formimit të kuadrit mësimor për shkollën shqipe. Kjo ngjau pesë vjet pas Kongresit të Manastirit, ku u përcaktua Alfabeti i gjuhës shqipe, përkatësisht fillesat e shkrim - këndimit shqip të përbashkët. Me të drejtë thuhet se "fillimi i mendimit shkencor është i lidhur me fillesat e zhvillimit të shkrimit e të leximit"; këtë e argumenton edhe institucionalizimi i psikologjisë si lëndë mësimore në vitin shkollor 1913–1914 në Normalen e Elbasanit. Kjo është një kohë shumë e shkurtër ndërmjet institucionalizimit të shkrimit dhe leximit shqip me sistemin e grafisë së përcaktuar dhe institucionalizimit të psikologjisë, ndoshta më e shkurtra në historinë e zhvillimit të mendimit shkencor në përgjithësi. Njëkohësisht kjo nismë lë pas vetes periudhën shumë të gjatë të mendimit metafizik dhe metapsikik për dukuritë e proceset shpirtërore të Shqiptarëve. Megjithkëtë, kur bëhet fjalë për trajtimin shkencor të dukurive, gjendjeve e proceseve psikike, kjo datë shënon integrimin e zhvillimeve mendore të Shqiptarëve në rrjedhat e kulturës europiane. Mendimi shkencor psikologjik ndër Shqiptarët, edhe pse ka ekzistuar më herët, shkrimet e mendimtarëve shqiptarë për të u botuan në latinisht, greqisht, osmanisht etj. Kjo vërehet edhe nga botimi i veprave të mirëfillta të psikologjisë.

Vepra të mirëfillta nga psikologjia janë vepra "Psikologji" ose "Dituri mbi Shpirtin" ("Ilmi Ruh") e Hasan Tahsinit (1811 – 1881), e botuar më 1884 dhe e përkthyer nga osmanishtja në shqipe më 1979; vepra "Fillime të pedagogjisë", pjesa I, "Psikologji për shkollat normale e për mësuesit e fillorevet" e Aleksandër Xhuvanit, e shkruar në shqip dhe e botuar më 1933. Këto ishin burime psikologjike të mirëfillta për shqipfolësit e të gjitha trevave, pavarësisht nga ndarja politiko-administrative e viseve shqiptare deri pas mbarimit të Luftës II Botërore.

Në gjysmën e dytë të shekullit të njëzet mendimi psikologjik i shqipfolësve dhe psikologjia në trevat e tyre u zhvillua përgjithësisht në dy qendra kryesore: në Tiranë dhe në Prishtinë, që për shkaqe ideologjike dhe politike të sistemeve të ndryshëm monistë, u zhvilluan pothuajse të pavarur njëri nga tjetri. Gjatë kohës së sundimit monist u shkruan disa vepra psikologjike në gjuhën burimore shqipe, që pasuan pas përkthimeve të librave nga rusishtja dhe serbokroatishtja. Bedri Dedja, Hamit Beqja, Nuri Abdiu, Pajazit Nushi, Neki Juniku, Masar Nagavci, Myqereme Rusi, Nait Vranezi, Besnik Spahiu ishin ndër psikologët e parë shqiptarë të diplomuar për psikologji, përkatësisht në pedagogji – psikologji (ata që studiuan në Moskë nga Shqipëria); disa prej tyre hartuan tekste psikologjike për nevoja të arsimimit të nxënësve dhe studentëve, por

gati të gjithë në fillim të karrierës së tyre i janë përkushtuar kryesisht mësimdhënies së lëndëve të psikologjisë së përgjithshme, të psikologjisë fëmijërore dhe të psikologjisë pedagogjike.

Zhvillimi i mendimi psikologjik të kësaj kohe në Shqipëri kishte si bazë shkollën fiziologjike ruse të Ivan Pavllovit dhe me ngjyrime të përmbajtjeve të tyre me fijeza mendore ideologjike të posaçme.

Në Kosovë dhe në Maqedoni psikologjia u zhvillua nën ndikimin e botimeve psikologjike në gjuhën serbo - kroate, por duke përfshirë edhe zhvillimet e këtij mendimi në shtetet perëndimore të Europës dhe të SHBA. Zhvillimet e tilla i përkasin kryesisht katër dekadave të gjysmës së dytë të shekullit të njëzet.

Zhvillimi i mendimit psikologjik ndër shqipfolësit përputhet kryesisht me zhvillimin e mendimit psikologjik të përgjithshëm, sepse mendimi psikologjik shqiptar ka kaluar nëpër të njëjtat faza nëpër të cilat ka kaluar mendimi shkencor: faza mitologjike e përfshirë si pjesë e çdo besimi, faza metafizike dhe faza e mendimit shkencor. Mirëpo, në ndryshim nga zhvillimi i përgjithshëm, mendimi psikologjik i shqipfolësve ka disa veçori, nga të cilat dallojmë: zhvillimin e vonuar, zhvillimin e mendimit psikologjik për nevoja arsimore, zhvillimin shkrimor të mendimit psikologjik burimor sipas sistemit të shkronjave në gjuhët e tjera dhe më pas sipas alfabetit të gjuhës shqipe (pas vitit 1908). Në sistemin pluralist u nxit dhe mori hov zhvillimi i ngushtë profesional e shkencor, sidomos në viset shqiptare të Shqipërisë dhe të Kosovës. Filloi të kompensohet e humbura në të shkuarën. Tashmë ndihet ndikimi i përmbajtjeve të veprave psikologjike të anglishtes në shqipërimin e tyre, por edhe në botimet burimore në gjuhën shqipe.

Burimet:

John Shoter: "I*mages of Man in Psychological Research" – ("Imazhi i njeriut në gjurmimet psikologjike"*), London 1975.

Duane P. Scultz: "*A History of Modern Psychi\ology" – ("Historia e psikologjisë moderne*"), HarcourtBrace & Company, 1975.

Lav S. Vigotskij: "*Voprosi Teori istorij Psihologii" – ("Zhvillimi teorik i historisë së psikologjisë)*, Moskva, 1982.

Maurice Reuchlin: *"Historia e psikologjisë"*, Shtëpia Botuese "Kuvendi", Lezhë 1999.

Edwin G. Boring: *"A History of Experimental Psychology"* – (*"Historia e psikologjisë eksperimentale"*), 1929;

James M. Baldwin: *"A history of Psychology: A Sketch and an Interpretation"* – (*Historia e psikologjisë: skicë dhe interpretime"*), Putnam, 1913.

Gardner Murphy: *"Historical Introdukction to Modern Psychology"* – (*"Hyrje në historinë e psikologjisë bashkëkohore"),* London 1959.

Jani Vreto: "*Vepra të zgjedhura*", Tiranë, 1973.

Nuri Abdiu: "*Kontribute themelore në historinë e mendimit psikologjik shqiptar (deri më 1939*), Tiranë, 2003.

Marcella Vasconi: *"Psikologjia – Historia, Metodat, Objektivat"* (përkthim në shqip nga italishtja), Botimet Toena, Tiranë, 2004.

Edmond Rrapti: "*Histori e mendimit psikologjik*" (*autorë, koncepte, vepra*), Shtëpia Botuese "Pegi", Tiranë, 2004.

Jeronim De Rada, "*Parime të estetikës*", Globus R, 2003.

HISTORIKU I TESTIMIT. Të provuarit e shkallës dhe të cilësive zhvillimore të strukturave dhe funksioneve psikike me anë të testeve është i lidhur me gjysmën e dytë të shekullit nëntëmbëdhjetë. Studiuesi britanik, familjar i të mirënjohurit Çarls Darvin, Frencis

Golton (Francis Galton, 1822 – 1911), pas përfundimit të studimeve të matematikës iu përkushtua gjurmimit të dallimeve antropologjike dhe psikologjike ndërmjet njerëzve, si edhe matjes së këtyre ndryshimeve. Deri në vitin 1880 kishte mbledhur shumë të dhëna për ndryshimet e tilla, që i përpunoi me procedura statistikore themelore. Ky konsiderohet, ndonëse jo i pari, gjithsesi ndër të parët, i cili hapi një epokë të re në zhvillimin e testeve dhe të testimit në përgjithësi. Megjithëkëtë, termi i konceptit testim mendor është i lidhur me emrin e psikologut amerikan Xhejms M. Katel (James M. Catell, 1860 – 1944), i cili më 1890 hartoi testet e para të inteligjencës, duke u mbështetur në të dhënat për dallimet në ndjeshmërinë shqisore dhe në kohën e reagimit të subjekteve ndaj ngacmuesve të shqisave. Shtatë vjet më vonë, përkatësisht më 1897 psikologu gjerman Herman Ebinghauzi (Hermann Ebbingahuas, 1850 – 1909) hartoi testet matematikore dhe të plotësimit të fjalive për matjen e zhvillimit mendor të nxënësve. Kthesën më të njohur në zhvillimin e testimit për matjen e zhvillimit mendor e kanë bërë dy studiues francez, psikologu Alfred Bine (Alfred Binet, 1857 – 1911) dhe mjeku e psikiatri Teodor Simon (Theodore Simon, 1873 – 1961). Ftesës së Ministrisë së Arsimit të Francës për t`i ndarë nxënësit me zhvillim mendor të vonuar nga ata me zhvillim normal këta iu përngjitën me hartimin e testit Bine – Simon për matjen e inteligjencës. Ky test u hartua në bazë të përcaktimit të strukturës së inteligjencës nga komponentët e të gjykuarit, të kuptuarit dhe të arsyetuarit. Testi i mbështetur në këto komponente të inteligjencës përmbante 30 probleme dhe u tregua i suksesshëm në përcaktimin e zhvillimit të inteligjencës. Mbi këtë koncepcion të hartimit të testeve dhe të testimit psikologu amerikan Luis Terman (Lewis Terman, 1877 – 1956) hartoi shkallën e ngadalësuar dhe të përshtatur për matjen e inteligjencës së fëmijëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Më pas psikologu britanik Siril Bert (Cyril Burt, 1883 – 1971) hartoi disa teste, duke u bazuar në metodën e analizës faktoriale të inteligjencës. Më pas matja e nivelit të zhvillimit të inteligjencës filloi në shumë vende dhe kryhej kryesisht për nevoja praktike. Ndër Shqiptarët matja e zhvillimit të inteligjencës filloi të zbatohet nga fundit i shekullit të njëzet.

Burimet:

Alfred Binet: *"L`etude experimental de l`inteligence"* – (*"Të provuarit eksperimental të inteligjencës"),* Paris, Alfred Costes, 1922.

Charles Jackson*: "Understanding Psycological Testing"* – (*"Testimi psikologjik"),* Published by The British Psychological Society, London, 1996.

Lee J. Cronbach: "*Esentials of Psychological Testing"* – (*"Thelbi i testimit psikologjik"*), (5th Edition). New York: HarperCollins, 1990.

Jean Piaget*: The origin of intelligence in child"* – (*"Origjina e inteligjencës së fëmijëve"*), London, 1953.

Philip Vernon: *"Intelligence and attainment tests"* – (*"Inteligjencia dhe arritjet e testimit"*), London, University of London Press, 1964.

Zoran Bujas: *"Teorija i konstrukcija testove za ispitivanje inteligencije"* – (*"Teoria dhe kontruktimi i testeve për të provuar inteligjencën"*), Zagreb, 1964.

Adem Tamo: *"Testimi i diturisë: Teoria dhe praktika",* Shblu, Tiranë, 1995.

Save the Children: *"Si të hartojmë një test?,* Tiranë, 2002.

Kiro Poposki – Zoran Stojanovski: *"Testet e diturisë",* Tetovë, 1996.
Vladimir Mužić: *"Testovi znanja"* – (*"Testet e diturisë"*), Školska knjiga, Zagreb, 1974.
Hans Eusenck*: "The Measurement of Intelligence"* – (*"Matja e inteligjencës"*), Lancaster. Medical and Technical Publishing, 1973.
Steering Committee on test standards *"Psychological Testing: A User`s Guide"* – (*"Testimi psikologjik: Udhërrëfyesi i përdorimit"*), Leicester: The British Psycholocical Society, 1996.
Adem Tamo & Theodori Karaj & Edmond Rrapti: (*"Mësimdhënia dhe të nxënët"*), Mokra, Tiranë, 2005, fq. 349 – 383.

HISTORIOGRAMË, - A. f. I ardhur nga greqishtja. Lloj grafiku me anën e të cilit paraqiten ndryshimet e dukurisë që studiohen gjatë një periudhe të caktuar kohore. Në ordinatë paraqitet rezultati i vlerësimit të asaj dukurie te një ose disa subjekte, kurse në abshisë intervalet e caktuara kohore.

HOLISTIK, - E. mb. I ardhur nga greqishtja *ὅλος* "i (e) tërësishëm" që përcakton përkatësinë e një pjese të saj, që ka të bëjë me tërësinë, që merret me tërësinë e organizmit, që ka qasje të tërësishme etj. Në psikologji, shkolla geshtaltiste dhe shkolla psikanalitike kanë pasur qasje holistike, përkatësisht qasje të tërësishme të njeriut dhe të jetës psikike dhe të dukurive, të proceseve psikike dhe të sjelljeve të njeriut. Përfaqësuesit e këtyre dy shkollave kanë zbatuar qasje studimore të tërësishme ndaj njeriut e strukturave, proceseve, funksioneve psikike dhe sjelljeve të njeriut, duke marrë për bazë parimin sipas të cilit dukuritë, proceset, strukturat e ndërlikuara nuk mund të njihen dhe të kuptohen duke i zbërthyer ato në pjesët përbërëse të tyre; aktiviteti psikik duhet studiuar në kuadrin e tërësisë së organizmit përkatës.

HOLIZ/ËM, - MI. m. Teori antropologjike, biologjike dhe psikologjike, sipas së cilës tërësia biologjike dhe tërësia psikologjike e organizmit dhe veçoritë e tiparet e tij kanë të bëjnë me tërësinë e organizmit dhe veprimtaritë kulturore të mjediseve që duhen trajtuar si tërësi, sepse ato janë të ndërvarura. Kjo tërësi është cilësi e posaçme që nuk formohet nga elementet përbërës të saj, por është "biologjia e tërësisë", "psikologjia e tërësisë". Në kuadrin e tërësisë kanë kuptim pjesët ose elementet e saj, pikërisht tërësia u jep kuptim pjesëve dhe elementeve të saj. Personaliteti është tërësi unike në psikologji dhe nuk mund të reduktohet në tipare e në veçori të posaçme. Pikëpamje të tillë kanë Zigmund Frojd (Sigmund Freud, 1856 – 1939), Gordon Olport (Gordon Allport, 1897 – 1967), Abraham Maslou (Abraham Maslow, 1908 – 1970) etj.

HOLL Grenvil S. (Granville S. HALL). Psikolog amerikan, ndër psikologët e parë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Lindi më 1844 dhe vdiq më 1924. Në fillim studioi teologji, më pas fiziologji dhe filozofi në Universitetin e Nju Jorkut, të Bonit dhe në Universitetin e Berlinit. Mbrojti doktoratën për psikologji në Universitetin e Harvardit me tezën "Perceptimi muskulor i hapësirës" para komisionit të drejtuar nga Uiliam Xhejmsi. Më pas shkoi për studime në laboratorin e Vilhelm Vuntit në Lajpcig. Më 1881 u emërua profesor i psikologjisë në Universitetin Xhon Hopkins. Ndërkaq, më 1888, me rastin e themelimit të Universitetit Klark (Clark), u emërua Kryetar i këtij universiteti deri sa doli në pension më 1920. Më 1884

themeloi laboratorin e parë të gjurmimeve psikologjike në Universitetin Xhon Hopkins, duke ndikuar ndjeshëm në zhvillimin e psikologjisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ishte themelues i revistës "American Journal of Psychology", 1887, që më pas u shndërrua në "Pedagogical Seninary – Journal of Genetic Psychology". Më 1902 bashkë me kolegë themeloi Shoqatën Amerikane të Psikologjisë – APA ("American Psychological Association"). Me emrin e tij lidhet edhe ligji "Ontogjeneza është rikapitullim i filogjenezës" me kuptimin psikologjik të tij. Më 1893 themeloi Shoqatën Kombëtare për Hulumtimin e Zhvillimit të Fëmijëve, e cila ndikoi në zhvillimin e psikologjisë zhvillimore, pra të psikologjisë së fëmijëve. Veprat kryesore të Grenvil Hollit janë: *"Adolescence, Its Psychology and Its Relation to Psychology, Anthropology, Sociology, Sex, Crim, Religion and Education"* – (*"Adoleshenca e psikologjisë dhe lidhja e saj me psikologjinë, antropologjinë, sociologjinë, seksin, krimin, fenë dhe edukatën"*), 1904*; "Founders of Modern Psychology"* – (*"Bazat e psikologjisë moderne"*), 1912; *"Life and Confessions of Psychologist"* – (*"Jeta dhe rrëfimet e psikologut"*), 1923 etj.

HOMEOSTAZ/Ë, - A. f. I ardhur nga greqishtja *ομοίοσταση* "qëndrim i barabartë". Prirja e organizmit për të ruajtur drejtpeshimin e brendshëm të tij; parimi i rivendosjes së drejtpeshimit organik, psikik e shoqëror të individit, kur është çrregulluar drejtpeshimi fiziologjik, psikik e shoqëror nga mungesa ose tepria e lëndës biokimike, nga mungesa dhe tepria e energjisë psikike dhe nga ajo shoqërore. Sipas këtij parimi rivendosja e drejtpeshimit organik ka karakter të vetërregullimit automatik me anë të mekanizmave të pavetëdijshëm. Homeostaza shfaqet si burim shtytjesh a motivesh, në radhë të parë të atyre biologjike. Kështu, në qoftë se bie ose rritet niveli i kripërave, i oksigjenit, i sheqerit etj. aktivizohen mekanizmat e caktuar fiziologjikë për të rivendosur gjendjen normale të organizmit. Qysh nga fillimi i gjysmës së dytë të shekullit të nëntëmbëdhjetë homeostazën e ka trajtuar fiziologu francez Bernar Klod (Bernard Cloude, 1813 – 1879) dhe më pas atë e ka përshkruar dhe shpjeguar hollësisht fiziologu amerikan Valter B. Kenon (Valter B. Cannon, 1887 – 1945).

HOMO DUPLEKS. Njeri i dyzuar për nga tiparet e karakterit të tij, njeri me dy kritere, dy standarde mendimesh, qëndrimesh dhe sjelljesh: me sjellje private dhe me sjellje shoqërore. Njeriu dupleks në brendësinë e tij nuk ka qëndrime të stabilizuara, por këto i ndryshon sipas kushteve dhe rrethanave ku gjendet dhe sipas interesit të tij. Sipas mendimtarit francez, sociologut Emil Durkhaim (Emile Durkheim, 1858 – 1917) njeriu është krijesë e dyzuar, që përbëhet nga qenia individuale dhe tjetra është qenia shoqërore e tij; ndaj vetes dhe interesave e qëndrimeve të tij ka sjellje që ndryshojnë nga ato ndaj të tjerëve.

HOMO SAPIENS. I ardhur në biologji nga latinishtja *homo sapiens* "njeri i arsyeshëm". Gjini njerëzore, zhvillimi së cilës daton që nga koha e Paleolitit të lashtë. Homo sapiensit i atribuohen tiparet biologjike, sociale dhe psikike të njeriut bashkëkohor. Termi homo sapiens u përdor për herë të parë nga evolucionisti Karl Line (Carl Linne,

1707 – 1778), shih - ***NJERIU***. Në varësi nga natyra njerëzore në literaturën e psikologjisë dhe të disa disiplinave të tjera dallojmë tipin e njeriut *homo economikus, homo educandum, homo fabier, homo ludens* (loja e njeriut konsiderohet bazë e kulturës), *homo dupleks, homo politikus, homo religious*, *homo symbolicum, homo sociologus* etj. Nga këto emërtime më i afërti me psikologjinë është njeriu dupleks.

HOMOGAMI, - A. f. I ardhur nga latinishtja *homogamy*. Prirja e njerëzve që të zgjedhin partnerin e jetës të ngjashëm me veten e tyre. Një prirje e tillë është e kuptueshme kur manifestohet në martesën e njerëzve me partner të një race, kombi e feje, por distanca psikologjike ndërmjet tyre është e madhe dhe e përshkruar e shpjeguar mbi bazën e rezultateve të hulumtimeve empirike.

HOMOGJENITETI I TESTEVE. Një ndër karakteristikat metrike të testeve që ka të bëjë me përftimin e rezultateve të njëjta ose shumë të ngjashme kur zbatojmë të njëjtin test, dy ose tri herë te të njëjtët subjekte dhe përfitojmë të njëjtat rezultate ose rezultate shumë të ngjashme. Homogjeniteti i testit përcaktohet me llogaritjen e koeficientit të korrelacionit në tri mënyra kryesore: 1) Pas një kohe relativisht të gjatë zbatohet i njëjti test dhe në bazë të rezultateve të arritura llogaritet koeficienti i korrelacionit ndërmjet rezultateve të arritura herën e parë dhe herën e dytë; sa më i lartë të jetë koeficienti i korrelacionit aq më homogjen është testi; 2) i njëjti test ndahet në dy pjesë, sipas një parimi të caktuar (grupin e parë e formojnë detyra e probleme çift, kurse grupin e dytë ato jo çift) dhe llogaritet koeficienti i korrelacionit me korrektim sipas formulës Spirman – Braun; 3) Nëse kemi dy teste për matjen e të njëjtës ndryshore, atëherë llogaritet koeficienti i korrelacionit ndërmjet rezultateve të arritura në dy testet. Te testet e arritjeve kërkohet nivel i homogjenitetit prej 0, 80 - 0, 90. Homogjeniteti i testit arrihet duke shtuar numrin e detyrave dhe të problemeve të një testi të caktuar.

HOMONIMI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *όμοιος* "i njëjtë" dhe *όνομα* "emër". Shqiptim dhe të shkruarit e njëjtë e dy a më shumë fjalëve, të cilat kanë burim dhe kuptim të ndryshëm, si: gjuha "sistem i të folurit dhe shqisë e të shijuarit", "njeriu i paditur në gjyq dhe ai që s`ka dijeni".

HOMOSEKSUALIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga greqishtja *όμοιος* "i njëjtë" dhe nga latinishtja *sexus* "seks". Forma më e degjeneruar e plotësimit të motivit seksual nga ana e njerëzve, të cilët i përkasin të njëjtës gjini. Kjo dukuri rreth fillimit të gjysmës së dytë të shekullit njëzet ka përfshirë rreth 5 % të meshkujve dhe të femrave. Qysh më parë homoseksualiteti është përcaktuar si shmangie nga plotësimi i motivit seksual me shfaqje të prirjes seksuale ndaj një individi të gjinisë tjetër, madje homoseksualiteti është konsideruar sëmundje. Sot konsiderohet çështje individuale pa kurrfarë vlerësimi psikopatologjik nga ana e psikiatrit dhe e psikologut klinik. Në psikanalizë homoseksualiteti konsiderohet se është përbërës i seksualitetit fëmijëror dhe shfaqet në formë të hapur te neurotikët dhe te paranojakët.

HOMUNKULUS, - I. m. I ardhur nga latinishtja *homunculus* "njeri në miniaturë". Term tashmë i vjetruar për individin e zhvilluar organikisht në formën e njeriut të vogël, por me proporcione normale ndërmjet pjesëve të trupit. Sot termi homunkulus përdoret më tepër në neurofiziologji dhe në neuropsikologji. Me termin homunkulus emërtohet koncepti i skemës së projektuar në koren a cipën e trurit të madh të atij individi, i cili për shkak të zhvillimit të ndjeshmërisë së gishtërinjve dhe të shuplakës së dorës i shfaqet këtij individi me gishtërinj dhe me shuplakë shumë të zhvilluar dhe në disproporcion të madh me pjesët e tjera, kurse te individi tjetër, që ka të zhvilluar të folurit dhe oreksin në cipën apo koren e trurit shfaqet goja dhe gjuha tepër e zhvilluar dhe në disproporcion të madh me pjesët e tjera të organizmit.

H

HORMON, - I. m. I ardhur nga greqishtja *ορμόνη* "nxitja". Substancë biokimike që prodhohet në indet e organeve dhe kryesisht në gjëndrat me sekretim të brendshëm, prej nga, me anën e qarkullimit të gjakut dhe të limfës barten në organet e organizmit duke shkaktuar efekte të ndryshme fiziologjike dhe psikike; nxitin reagimin e proceseve fiziologjike të kontrollit të aktivitetit të sistemit nervor, sidomos të atij vegjetativ, të rritjes së organizmit etj. Të tilla janë hormonet: adrenalina, estroni, gonadotropina, hidrokortizoni, oksitocina, progesteroni, somatotropina, testosteroni, tiroksina, vazopresina etj. Disa nga hormonet luajnë rolin e neurotransmiterëve. Hormonet kanë përbërje kimike të ndryshme dhe luajnë rol të rëndësishëm në ruajtjen e baraspeshës organike, në përshtatjen e organizmit ndaj kushteve e rrethanave të ndryshme të mjedisit të tij, duke nxitur zhvillimin e sjelljeve të organizmit që kontribuojnë në përshtatjen e organizmit ndaj kushteve të ndryshuara të mjedisit.

HORMONET GONADOTROPË. Grup hormonesh i gjëndrave seksuale që prodhohen nga pjesa e përparme e hipofizës. Këto hormone rregullojnë rritjen e organizmit, si edhe zhvillimin dhe aktivitetin e gjëndrave seksuale. Kur nxisin aktivitetin e gjëndrave seksuale këto çlirojnë hormone. Hormonet gonadotropë të meshkujve dhe të femrave janë të ndryshme. Këto hormone fillojnë të sekretohen rreth moshës tetë vjeç dhe arrijnë kulmin e sekretimit rreth moshës 12 – 14-vjeçare. Kjo ngjet atëherë kur qelizat e hipotalamusit fillojnë të sekretojnë këto hormone, përkatësisht në moshën e pubertetit.

HORMONI ANTIDIURETIK. Hormon që sekretohet nga pjesa e prapme e hipofizës. Kryen funksionin e rregullimit të sasisë së ujit në organizëm nëpërmjet veshkave. Ndikon në nxjerrjen jashtë të urinës së koncentruar, duke ruajtur sasinë e duhur të ujit për nevojat e zhvillimit të proceseve fiziologjike në organizëm. Në këtë mënyrë pakëson sasinë e urinës dhe ruan baraspeshën e sasisë së ujit në organizëm. Vepron edhe si neurotransmiter në disa nga pjesët e trurit dhe është i përfshirë në proceset e kujtesës. Njihet edhe me termin vazopresinë. ADH është shkurtesa e hormonit antidiuretik ose vazopresinë.

HORNEI Karen (Karen HORNEY). Psikiatre, neopsikanaliste. Lindi në Hamburg të Gjermanisë më 1885 dhe

vdiq në Nju Jork më 1952. Norvegjezja Karen Hornei kreu studimet e mjekësisë në Berlin në moshën 28-vjeçare (prej vitit 1914 – 1918) dhe iu nënshtrua psikanalizës së Karl Abrahamit. Gjatë studimit iu përkushtua psikanalizës dhe metodës psikoterapeutike. Gjatë viteve 1920 – 1932 punoi në Institutin Psikanalitik të Berlinit (ka qenë themeluese e këtij instituti); prej nga më pas u shpërngul në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në Çikago ngriti Institutin Psikanalitik dhe u bëhet drejtore e këtij instituti (1932 – 1934). Pas dy vitesh ngriti një institut të tillë edhe në Nju Jork, "American Institute of Psychoanalysis", të cilin e drejtoi deri sa vdiq. Në Nju Jork kaloi një jetë aktive në shoqëri të ngushtë me intelektualët e dalluar e të mërguar nga shtetet e Europës, sidomos me Erik Fromin. Kritikoi ashpër Zigmund Frojdin dhe për këtë shkak u detyrua të japë dorëheqjen nga Instituti Psikanalitik i Nju Jorkut, por shpejt ngriti dhe Institutin e saj privat për psikanalizën. Në fillim të karrierës së saj profesionale u mor me studimin e psikologjisë së femrave, ku vinte në dukje gjendjen e rëndë të femrës në mjedise të zhvilluara, e cila vuante nga frika e humbjes së dashurisë, që për të kishte kuptimin e humbjes së ekzistencës. Por, këtë e përgjithësonte pak a shumë edhe për meshkujt. Për Karen Hornein faktorët shoqërorë janë faktorë mbizotërues për zhvillimin e personalitetit. Mjediset shoqërore të zhvilluara ushtrojnë ndikim edhe në shtimin e nevojave të personalitetit. Mjediset e këtilla mundësojnë plotësimin e nevojave ekzistenciale. Madje, në plotësimin e këtyre nevojave njeriu i këtyre mjediseve has në vështirësi dhe në pengesa të shumëllojshme. Për këto shkaqe lindin konfliktet, ankthi, streset etj. Përvojat e hershme të zhvillimit psikik të njeriut të rritur kanë rëndësinë e tyre, por këto nuk janë vendimtare për ekzistencën dhe zhvillimin e tij. Në situata të tilla më e rënda është nëse vetë njeriu, ose me anë të psikoterapeutit nuk i dallon këto vështirësi e pengesa. Për këtë shkak e përgjithëson mendimin për psikologji duke thënë: "Psikologjia është shkenca për jetën shpirtërore, pikërisht për unin. Vetëdija është mendim, vetëdije elektrike që rrjedh ose jetë subjektive". Lëvizja e njerëzve kah njerëzit, kundër njerëzve dhe nga njerëzit janë koncepte të psikologjisë së Karen Horneit. Veprat kryesore të saj janë: *"The Neurotic Personality of Our Time"* – (*"Personaliteti neurotik i kohës sonë"*), 1937; *"New Ways in Psychoanalisis"* – (*"Rrugët e reja të psikanalizës"*), 1939; *"Our inner conflicts"* – (*"Konfliktet tona të brendshme"*), 1945; "*Neurosis and Human Growth"* – (*"Neuroza dhe zhvillimi i personalitetit"*), 1950.

HOSPITALIZI/M, - MI. m. Term i formuar nga rrënja e fjalës latine *hospes, itis* "që pranon të huaj". Termi hospitalizim ka ardhur në shumë gjuhë nga literatura angleze e psikologjisë dhe e psikiatrisë. Termi hospitalizim emërton regresin patologjik në zhvillimin e fëmijëve të ndarë nga e ëma që rriten në institucione sociale e mjekësore, dhe ka të bëjë me zhvillim të hospitalizuar deri në moshën dy vjeçare. Fëmijët e tillë kanë disa cilësi zhvillimore negative, nga të cilat dallohen: aktiviteti i kufizuar, gjumësia, indiferenca emocionale, pamundësia e rezistencës

ndaj sëmundjeve etj. Hospitalizimin e ka përmendur psikanalisti austriak Rene A. Shpic (Rene A. Spitz, 1887 – 1974). Sipas tij ndarja e fëmijës nga e ëma dhe zhvillimi i tij jashtë kujdesit të së ëmës ka pasoja negative të mëdha, madje edhe të pariparueshme. Kjo ndarje reflektohet negativisht në funksionet e strukturave labile, si në të folur, të menduar në zhvillimin e emocioneve etj. dhe, nëse vazhdon zhvillimi i ndarë nga nëna dëmtohet zhvillimi i aftësive intelektuale e motorike.

HULUMTIM, - I. m. Veprimtari sistemore e organizuar dhe e drejtuar në vërtetimin e natyrës, të prejardhjes së një dukurie, procesi, raporti, strukture etj. duke zbatuar parime, rregullsi, metoda e procedura dhe forma organizuese të vërtetuara. E tillë duhet të jetë secila veprimtari që synon të japë përgjigje të saktë në tri pyetjet kryesore të secilit hulumtim në disiplinat shkencore teorike dhe zbatuese : çfarë është, përse është e tillë dhe si u zhvillua? Një hulumtim i tillë në psikologji ka disa faza: 1) formulimi i saktë e i prerë i problemit hulumtues, 2) përkufizimi i qëllimit të hulumtimit, 3) përcaktimi i ndryshores së pavarur dhe të varur, 4) përkufizimi i hipotezës, 5) përcaktimi i gjedhes, përkatësisht i kampionit hulumtues, 6) përzgjedhja e metodave dhe e procedurave hulumtuese, 7) faza e zbatimit të hulumtimit, 8) përpunimi i të dhënave dhe 9) nxjerrja e përfundimeve e publikimi i tyre.

HULUMTIMET KULTUROLOGJIKE. Hulumtime karakteristike për studime psikologjike. Hulumtimet kulturologjike kryhen me qëllim të studimit të faktorëve kulturorë dhe përmasave të ndijimit të tyre në lindjen dhe në zhvillimin e tipareve karakteristike të personalitetit, përkatësisht në ndryshimet individuale në struktura, procese e në sjelljen e individëve të zhvilluar në mjedise kulturore të ndryshme.

HULUMTIMI OPERACIONAL. Hulumtim për identifikimin e operacionit që kryen ndryshorja e caktuar në sistemin e posaçëm të veprimeve, duke përcaktuar saktësisht përmasën e saj, efektin konkret në raport me ndryshoret e tjera që veprojnë në kuadrin e atij sistemi.

HULLIA E CIPËS SË TRURIT. Brazdë, çarje e thelluar në masën e sipërfaqes së cipës a të kores së trurit të madh, që e bën sipërfaqen e cipës së trurit më të madhe se ajo që do të ishte në formën e rrafshët. Hullitë kanë formë të rrudhur specifike dhe shtrirje vertikale e horizontale. Hulli të tilla janë:

a. **Hullia e Rolandit** – Që shtrihet nga mesi i pjesës anësore të hemisferës së djathë e të majtë në drejtimin vertikal, duke ndarë në këtë mënyrë pjesën ballore nga pjesa tëmthore dhe duke vënë kufi ndërmjet pjesës kortikale motorike dhe asaj sensorike; emërtohet edhe me termin hulli qendrore. Mori emrin e zbuluesit të saj anatomistit italian Luigji Rolando (Luigi Rolando, 1773 – 1832).

b. **Hullia e Selvisë** – Që shtrihet horizontalisht duke ndarë pjesën tëmthore nga pjesa ballore e zverkore;

c. **Hullia shporore** – Që ndan rrudhën e pestë nga rrudha e gjashtë zverkore.

HUMOR, - I. I ardhur nga greqishtja *χιούμορ* "lëng". Gjendje emocionale e njeriut ndaj përmbajtjeve, situatave,

ndaj individëve etj., që karakterizohet me kënaqësi, gëzim, komizëm, simpati, të qeshur etj. Gjendje emocionale e zgjatur në kohë që i jep ngjyresë veprimtarisë së caktuar. Ka karakter të qëndrueshëm. Termi humor në psikologji ka ardhur nga Galeni (Galenos, 129 - 199) kur është supozuar se temperamenti varet nga lëngjet e organizmit (gjaku, jargët, tëmthi i verdhë, tëmthi i zi), përkatësisht nga mbizotërimi i njërit prej tyre në organizmin e një njeriu të caktuar. Në literaturën shkollore të psikologjisë me termin humor është përcaktuar gjendja e përgjithshme emocionale me intensitet të ulët dhe me zgjatje kohore relativisht të madhe.

HUNDË, - A. f. Shqisa e të nuhaturit dhe një nga organet e frymëmarrjes. Hunda është organ i dalë nga fytyra e njeriut në formë piramide, që përbëhet nga eshtrat, pjesa kërcore, lëkura mbështjellëse e pjesës së jashtme të saj dhe nga cipa mbështjellëse e mureve të brendshme të dy kanaleve hundore – lotore. Në pjesën e sipërme të këtyre kanaleve të hundës janë vendosur receptorët olfaktorë të nuhatjes dhe pjesët e mbaresës së nervit olfaktor të të nuhaturit. Trupat në gjendje flurore duke u shndërruar në substancë kimike me anë të lëngut hundor bëhen ngacmues të receptorëve olfaktorë. Këta ngacmues kimikë shndërrohen në impulse nervore dhe barten deri në bulbin olfaktor e prej këndej deri në rinencéfalon, ku njeriu përjeton erën e ngacmuesit të receptorëve olfaktorë të hundës.

HUTESA MENDORE. Gjendja psikike e njeriut, i cili duke u gjendur para një situate problemore konkrete që kërkon zgjidhje, humb përqendrimin e vëmendjes në elemente parësore dhe në lidhjen e tyre. Duke mbështetur elementet e lidhjet jothelbësore të asaj situate nuk arrin dot ta zgjidhë situatën problemore. Këtë dukuri e ka konstatuar psikologu gjerman David Kac (David Katz, 1884 – 1953).

I

I – simbol i intensitetit;

I – intervali i klasës së të dhënave;

I – shkurtesë për inhibicionin.

ID, - I. m. I ardhur nga latinishtja *id* "ajo". Idi është term i psikanalizës i përdorur Zigmund Frojdi (Sigmund Freud, 1956 – 1939) në teorinë e mendjes së pavetëdijshme trishtresore. Ai e ka konsideruar idin shtresën më të thellë të psikikës, shtresën e së pavetëdijshmes në kuptimin e mirëfilltë dhe e ka paraqitur në formën përshkruese në kuadrin e tri konstrukteve të psikikës së njeriut: id, ego dhe superego. Në id gjenden strukturat biologjike të shtytësve dhe përmbajtjet e shtypura të aktivitetit psikik të njeriut, që krijojnë dinamikën e së pavetëdijshmes. Idi është shtresa më e vjetër e zhvillimit të psikikës së njeriut, që priret drejt plotësimit të shtytësit të amësisë, të etjes, të shtytësit seksual, të urisë etj., përkatësisht të shtytësit të jetës dhe të shtytësit të vdekjes. Prirjet psikike të pavetëdijes kërkojnë zhvillimin e tyre sipas parimit të kënaqësisë, duke mos njohur e as zbatuar rregullat, parimet e ligjet e të menduarit logjik, as ato të moralit dhe duke mos u kushtuar vëmendje as hapësirës dhe as kohës ku gjendet njeriu. Proceset dinamike të idit janë procese parësore të pavetëdijshme. Karakteristika kryesore e tyre është se ato procese kanë burim energjetik të tyre, janë të huaja për vetëdijen e njeriut, megjithëse e furnizojnë veprimtarinë psikike të vetëdijshme të tij.

IDE, - JA. f. I ardhur nga greqishtja e i stabilizuar në terminologjinë psikologjike të shumë gjuhëve si edhe në gjuhën shqipe, por jo edhe me kuptim të njëjtë. Ideja është mendim i përgjithësuar për një dukuri, objekt, raport etj. mbi veçoritë e tiparet thelbësore të dukurive dhe të objekteve të njëjta, si edhe për raportet ndërmjet tyre. Në psikologjinë kognitive bashkëkohore shfrytëzohet termi ide me kuptimin klasik të përgjithshëm, i cili ka për bazë gjendjen e caktuar të trurit, por për idenë nuk ka mundësi të flitet drejtpërdrejt, por vetëm në bazë të përvojës së njeriut.

IDEAL, - I. m. I ardhur nga greqishtja duke u mbështetur në bazën e termit ide, përkatësisht në termin neolatin

idealis "shembull, qenie". Ideali është mendim i një caku kulmor të përkryer e të dëshiruar, që shoqërohet me ndjenja të një intensiteti relativisht të lartë dhe të besimit për mundësinë e realizimit të tij. Në psikologjinë bashkëkohore termi ideal po përdoret me dy kuptime: 1) Niveli më i lartë i përsosmërisë që synon të arrijë individi, por që nuk arrin deri në këtë kulm. Me këtë kuptim e hasim në psikologjinë e personalitetit dhe 2) Strukturë e ndërthurur mendimesh e tiparesh thelbësore të një dukurie, objekti, raporti etj. e organizuar në nivel të përsosur. Ideali ka fuqi të madhe motivuese (ideali i lirisë, i mirëqenies, i arritjes maksimale në mësime, në zhvillimin shkencor, në artin e skulpturës etj.).

IDEAL, - E. mb. Që përcakton kuptimin e asaj që prodhohet në mendimin e njeriut, që ekziston vetëm në strukturën mendore të njeriut (në ide, mendim, në përfytyrim etj.). Mbiemri ideal ka edhe kuptim tjetër: *ideal–e* është ai që ka arritur zhvillim të përkryer, zhvillim të plotë, që është e barasvlershme me ideal.

IDEALIZ/ËM, - MI. m. Pikëpamje dhe drejtim themelor filozofik, që ushtroi ndikim të veçantë në zhvillimin e psikologjisë dhe të mendimit psikologjik. Idealizmi konsideron se ideja, mendimi e përfytyrimi mendor është realitet dhe bazë e përvojës dhe e dijenisë njerëzore; materiali dhe format e saj reale janë dytësore, sepse këto varen nga përmbajtja mendore e njeriut (nga ideja, mendimi, përfytyrimi). Në gjurmimin e raporteve organizëm–shpirt edhe psikologjia i ka shërbyer me mënyrën e vet zhvillimit të idealizmit. Në psikologjinë filozofike idealizmi paraqitet në dy forma kryesore: 1) Psikologjia e idealizmit objektiv, sipas së cilës thelbi i qenies objektive rrjedh nga ekzistenca e ideve, e pikërisht e ideve të pandryshuara që konsiderohen parësore dhe 2) Psikologjia e idealizmit subjektiv, që konsideron parësore kompleksin e ndijimeve dhe tërësinë e ideve të njeriut, të cilat duhet t`i studiojë psikologjia.

IDEALIZIM, - I. m. Proces i mendimit të përgjithësuar të atribuimit të tipareve pozitive të të tjerëve, duke i cilësuar ata të jashtëzakonshëm, të nivelit të lartë, të arritjes në majën e zhvillimit etj. Termi ka përdorim të kufizuar në shprehjet psikologjike, por përdorim të shpeshtë në të folurit e përditshëm. Idealizimi në psikanalizë ka kuptim të veçantë dhe konsiderohet si mekanizëm mbrojtës i njeriut. Idealizimi shfaqet me konceptualizëm përfaqësues të një grupi social, të një individi etj., ndaj të cilëve njeriu ka dy qëndrime të kundërta: një qëndrim pozitiv dhe një qëndrim negativ, të shoqëruar me sjellje situacionale.

IDEJA E PLATONIT. Term i filozofisë që shtrihet edhe në psikologji. Emërton konceptin e dualizmit trup - frymë, duke ndarë njërin nga tjetri, sepse trupi, lënda i nënshtrohet parimeve dhe ligjeve zhvillimore të ndryshme nga ato të frymës. Fryma, mentaliteti është parësor, kurse trupi është formë e përgjithshme e shprehjes së vërtetësisë së realitetit. Ky term haset rrallë në fjalorët e psikologjisë.

IDEJA FIKSE. Ide e ngulitur, e qëndrueshme dhe pushtuese e mendimit, shpesh pa bazë logjike, dhe e sjelljeve të motivuara nga kjo ide, nga e cila

mendimi nuk arrin të çlirohet. Ideja fikse nuk përbëhet vetëm prej një ideje, por mund të formohet edhe prej dy a më shumë idesh. Njeriu me proces mendor normal dhe me sjellje normale bindet lehtë në argumentet e pabaza të asaj ideje, por megjithëkëtë ai nuk arrin të çlirohet nga ideja fikse. Karakteristika thelbësore e idesë fikse është karakteri jologjik i saj dhe besimi i thellë i tij në përmbajtjen e asaj ideje. Psikologu zviceran Pier Zhane (Pierre Janet, 1859 – 1947) e ka përdorur termin ide fikse për të emërtuar atë përmbajtje mendore dhe sjellje të individit neurotik, e cila me funksionin e saj pushtues pengon rrjedhjen e ideve normale dhe e ngushton shtrirjen e vëmendjes dhe përqendrimin e saj në ide reale.

IDEJA KONTROLLUESE. Mendim nxitës i formuluar me fjalë të qarta për subjektin, me të cilin eksperimentuesi përpiqet të ndikojë te subjekti në zgjimin e mendimeve për çështjen nga e cila subjekti vuan. Me anën e ideve kontrolluese provohen ngarkesat ideo–emocionale që shkaktojnë çrregullim mendimesh e sjelljesh dhe bëhen orvatje për vetëdijesimin e tyre nga ana e pacientit. Zakonisht zbatohet në seancë psikoterapeutike.

IDEJA SUMANUTE. Ide të ngulitura me përmbajtje patologjike që janë karakteristike për disa çrregullime psikike. Idetë sumanute i përkasin asaj forme të mendimit psikologjik, që janë të pashkoqura nga përmbajtja e mendimit të njeriut për veten e tij, për madhështinë, për përndjekjen nga të tjerët etj. dhe, me gjithë argumentet bindëse të kundërta, i sëmuri nuk i ndryshon idetë e tilla. Në psikologjinë klinike dhe në psikiatri bëhet fjalë për këto lloj idesh sumanute:

a. **Ide sumanute të madhështisë** – Bindja në ide se ai rrjedh nga prindërit e famshëm, të fuqishëm, të pushtetshëm, të nderuar dhe të respektueshëm nga të gjithë; personaliteti i prindërve të tillë në mendimin patologjik të tij është mbështetje e madhe e rëndësisë që ka ai në familje, në mesin e të tjerëve etj.

b. **Ide sumanute erotomaniake** – Pushtimi i mendimit dhe i sjelljeve të një individi nga ideja bindëse, sipas së cilës ai është individi me tipare tërheqëse nga personalitetet e famshme politike, shkencore, artistike etj., e pas tij vrapojnë mendimtarët e mëdhenj, artistet e famshme, madje edhe ato që kanë vdekur;

c. **Ide sumanute të përndjekjes** – Ide të ngulitura te një individ që lidhen me supozimin se atë e përgjojnë vazhdimisht, e ndjekin të panjohurit me qëllim të marrjes së pasurisë, të fëmijëve, të eliminimit fizik etj. Kundër tij konceptohen kurthe nga më të njohurit e shërbimit sekret etj.

IDENTIFIKIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *idem* "i (e) njëjtë" dhe *facere* "bëj". Në psikologji ka tri kuptime: 1) Proces psikik me anën e të cilit individi njeh ngjashmërinë dhe njëtrajtësimin e dukurive, të objekteve dhe individëve; 2) Akt i lidhjes emocionale të një individi me individët e tjerë (me të cilët ai gjen ngjashmëri) dhe të cilëve u entuziazmohet dhe, që i konsideron edhe si të tij idealet, objektivat, qëndrimet, synimet dhe vlerat e atyre me të cilët njëjtësohet; 3) Në psikanalizë identifikimi është proces i njëjtësimit të egos

së një individi me egon e individit tjetër, të cilin e konsideron të përsosur (një teolog, një mësues, një prind, një prijës etj.). Identifikimi ka karakterin e një procesi, ngaqë "e fut në zemër" individin tjetër dhe i modifikon sjelljet e tij me sjelljet e atij individi. Një identifikim i tillë ka karakterin e mekanizmit mbrojtës, sepse në identifikimin me individin tjetër që e konsideron të përkryer ai sheh suksesin, por edhe mossuksesin e vet. Identifikimi si mekanizëm mbrojtës paraqitet në dy forma: 1) Identifikim parësor që nënkupton pranimin e dëshirave, të qëllimeve, synimeve etj. të tjetrit si të tijat dhe 2) Identifikim dytësor që nënkupton përjetimin e plotësimit të dëshirës së tij, duke vërejtur plotësimin e dëshirës së tjetrit me të cilin ai identifikohet.

IDENTIFIKIMI ME AGRESORIN. Mekanizëm mbrojtës i përshkruar nga psikologjia Ana Frojd (Anna Freud, 1895 – 1982) dhe psikanalisti austriak Rene Shpic (Rene Spitz, 1887 – 1974). Identifikimi me agresorin nënkupton sjelljen në mënyrë identike me individin agresor për ta larguar ose për ta bërë më të lehtë frikën nga agresori. Individi i rritur, i pafuqishëm, i pambrojtur dhe i frikësuar nga armiku agresor orvatet t`i përngjajë atij duke u bërë i ngjashëm me të. Psikologu amerikan me origjinë austriake Bruno Betelhajm (Bruno Bettelheim, 1903 – 1990) identifikimin me agresorin e ka vërejtur te disa hebrenj në kampet e përqendrimit nazist. Sipas tij: "… të burgosurit (hebrenjtë P. N.) e shtyrë në moshë i kanë pranuar qëllimet dhe vlerat e tyre (të agresorëve gjermanë P. N.)".

IDENTITET, - I. m. I ardhur nga latinishtja *identitas* "njëjtësim". Identiteti është përputhshmëria e dy a më shumë koncepteve, madhësive, objekteve, përfytyrimeve etj. Në logjikë identiteti emërton ekzistencën e plotë ndërmjet dy ose më shumë dukurive, koncepteve, objekteve etj. Identiteti i koncepteve kupton barazi e përputhshmëri të përmbajtjes dhe të shtrirjes (të vëllimit) të tyre dhe kjo shprehet me formulën A = A. Në psikologji identiteti është term i psikologjisë së personalitetit, sipas të cilit identiteti i personalitetit është përjetimi i vetëdijshëm i vetvetes dhe i tipareve thelbësore të personalitetit të tij në formë të njëjtë dhe të pandërprerë, pavarësisht nga ndryshimet e tij në periudha dhe rrethana të ndryshme të zhvillimit. Kjo është tërësia unike e vetëdijes, e cila mbetet relativisht e pandryshueshme, pavarësisht nga ndryshimi i kushteve dhe i situatave psikike të tij. Identitetin e personalitetit e ka trajtuar gjerësisht psikanalisti amerikan me origjinë gjermane Erik H. Erikson (Erik H. Erikson, 1902 – 1994) duke u mbështetur në dy konstatime: a) Vetëvëzhgimi i njëtrajtshmërisë dhe i vazhdueshmërisë së ekzistencës së vetvetes në hapësirë dhe në kohë dhe b) Perceptimi i ekzistencës dhe i vazhdueshmërisë së zhvillimit të tij nga të tjerët. Identiteti në teorinë e Zhan Pijazhes (Jean Piaget, 1896 – 1980) për zhvillimin mendor të identitetit është konceptim i ekzistencës së raporteve. Sipas teorisë së Zhan Pijazhes identiteti është të kuptuarit e pandryshueshmërisë së një sasie figurash, objektesh etj., pavarësisht nga ndryshimi i formës ose i renditjes së tyre (një litër lëng mbetet në

të njëjtën peshë, pavarësisht nga ena e madhe ose e vogël e vendosjes së atij lëngu).

IDENTITETI I PERSONALITETIT. Vetëdija përcaktuese e njëtrajtësimit të personalitetit të caktuar në bazë të perceptimit të tipareve psikologjike të veta dhe të unitetit të këtyre tipareve, që atë e karakterizojnë si personalitet të veçantë për një periudhë relativisht të gjatë kohore. Shih – ***PERSONALITETI.***

IDENTITETI I PERSONALITETIT NEGATIV. Emërtim i atij përjetimi të ngulitur të njeriut, i cili tiparet thelbësore dhe integritetin e tyre e përjeton të dobët, me tipare të këqija, të rrezikshëm etj. Një përjetim i tillë është pasojë e rrethanave dhe e kushteve edukuese të fëmijëve në familje të cunguara, të përvuajtura, alkoolistësh, në mjedise nënçmuese të pjesëtarëve të etnive, të pakicave, të feve e sekteve të ndryshme të tyre etj.

IDEOLOGJI, - A. f. Tërësi e ndërlikuar mendimesh, besimesh e qëndrimesh themelore të një individi, grupi individësh apo klase individësh lidhur me historinë, me interesat, me perspektivën dhe me rolin që ato luajnë në sjelljet e njeriut.

IDETË E LINDURA. Pikëpamje filozofike, sipas së cilës idetë e njeriut janë të lindura. Idetë e lindura i përkasin pikëpamjes idealiste.

IDIOMË, - A. f. I ardhur nga greqishtja në gjuhësi *ιδίωμα* dhe ka gjetur zbatim edhe në psikologji. Idioma është mënyrë karakteristike e shprehjes gjuhësore të një mendimi me përmbajtje relativisht të pandryshuar. Në psikologji idioma ka të bëjë me individualitetin e një personaliteti dhe të tipareve të sjelljes karakteristike të tij. Në këtë kuptim secili individ është një idiomë.

IDIOPATOLOGJIK, - E. mb. Që ka të bëjë me çrregullime karakteristike, me sëmundje të një etiologjie të veçantë të identifikuar ose të paidentifikuar. Termi i përket psikologjisë klinike dhe ka ardhur nga mjekësia, ku emërton gjendjen parësore patologjike të një organi ose të organizmit të shkaktuar nga çrregullimet organike e funksionale brenda organizmit.

IDIOSINKRAZI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *ιδιο* "i imi" dhe *συγκρασία* "përzierje". Idiosinkrazia ka dy kuptime: 1) Në kuptimin e përgjithshëm idiosinkrazia është karakteristikë e posaçme e reagimit të njeriut ndaj një situate ose dukurie të veçantë, kur të tjerët reagojnë normalisht ndaj asaj situate; 2) Në kuptimin e veçantë idiosinkrazia është gjendje e ndjeshmërisë së shtuar të disa njerëzve që shfaqet si reagim negativ i organizmit të tyre ndaj disa lloj ushqimesh, barërash mjekësore, erërash etj. Një reagim i tillë shfaqet në ndryshimet organike të disa organeve (lëkurë, mukozë, organet tretëse etj.) dhe shoqërohet me neveri të posaçme të njeriut ndaj tyre.

IDIOT, - E. mb. I ardhur nga greqishtja "njeri i pa udhëzuar në punët publike, i paditur", që përcakton një individ me shkallën më të ulët të zhvillimit mendor. Idioti ka koeficient të inteligjencës nën 0.25, që i përgjigjet zhvillimit intelektual të një fëmije normal në moshën rreth 3 vjeç. Idiotit i mungon aftësia e fitimit të sjelljeve adaptuese, ka të folur të pazhvilluar, shfaq pamundësi të aftësive motorike për t'u zhvilluar, është i paaftë të mësojnë

zejet më të thjeshta dhe përbën një problem të vështirë për familjen dhe shoqërinë. Sot ky term me përmasë konotative negative po zëvendësohet në terminologjinë bashkëkohore me termin individ me prapambetje të thellë mendore.

IDIOTËSI, - A. f. Term i vjetruar i greqishtes *ιδιωτισμός* "padije". Termi idiotësi është përshtatur dhe stabilizuar edhe në terminologjinë e psikiatrisë dhe të psikologjisë në gjuhën shqipe, megjithëse tashmë po përdoret gjithnjë e më pak. Me termin idiotësi emërtohet koncepti i çrregullimit të rëndë mendor, në rend të parë, i çrregullimit të rëndë mendor të atyre individëve që quhen idiotë. Idiotësia është shkalla më e ulët e prapambetjes mendore, përkatësisht e prapambetjes mendore ose e mungesës së aftësive intelektuale.

IDIOTËSIA INFANTILE. Sëmundje e rëndë neurologjike, që konsiderohet se është e trashëguar. Idiotësia infantile karakterizohet me prapambetje të rëndë fizike dhe psikike dhe fëmija i lindur me këtë sëmundje ka jetë shumë të shkurtër, zakonisht jeta e tij zgjat rreth tetëmbëdhjetë muaj. Sëmundja shkaktohet nga mungesa e enzimave në organizëm dhe nga pengesa serioze në procesin e metabolizmit. Idiotësia infantile njihet edhe me termin sëmundja Tej–Saks, sipas emrit të oftalmologut anglez Uorren Tej (Warren Tay, 1843 – 1927) dhe të neurologut amerikan Bernard Saks (Bernard Sachs, 1858 – 1927). Idiotësia infantile është më e përhapur te fëmijët hebrenj!

IDIOTI SAVANT. I ardhur nga frëngjishtja *idiot savant* "idiot i mësuar, i mençur". Idioti savant është individ me shkallë të ulët të zhvillimit të përgjithshëm mendor, por me aftësi të zhvilluar në nivel të lartë për një lloj aktiviteti. I tillë është ai individ që ka kufizime të mëdha në zhvillimin e aftësive, por ai mund të jetë i shkëlqyeshëm gjatë ekzekutimit me violinë të kompozimeve që i ka dëgjuar vetëm një herë, në mbajtjen mend të numrave telefonikë të një numri të madh qytetarësh, në llogaritjen e datave të ditës së premte për çdo vit paraardhës, në shumëzimin përmendësh të numrave pesëshifrorë etj. Këta janë të rrallë, të çuditshëm dhe të pashpjegueshëm.

IDIOTIZMI AMAUROTIK. Term i vjetruar për sindromën Taj–Zaks që ka emërtuar degjenerimin e Sistemit Nervor Qendror me këto simptoma kryesore: humbje progresive e të parit, zhvillim i ulët i inteligjencës, dobësim i zhvillimit të muskujve dhe i fuqisë së tyre etj. U zbulua nga oftalmologu anglez Varen Taj (Warren Tay, 1843 – 1927) dhe nga neurologu i SHBA Bernard Saks (Bernard Sachs (1858 – 1944), duke u identifikuar më 1881 dhe përshkruar hollësisht më 1887.

IDOL, - I. m. I ardhur nga greqishtja *είδωλο* "figurë". Me termin idol është emërtuar ideja, objekti, individi, piktura etj. e admiruar, e nderuar dhe e respektuar si hyjni mbinatyrore. Ndaj objektit të tillë është shprehur besim i madh se ai do të sjellë fat të mirë. Këtij objekti i janë lutur, i janë përkulur duke pritur nga ai realizimin e dëshirave, të synimeve etj. Idoli në këtë kuptim ka karakterizuar sjelljen e njerëzve të kulturës religjioze pagane. Sot ka artistë filmash, lojtar futbolli,

shkrimtar, politikan etj., që konsiderohen idol të të rinjve dhe të të rejave. Struktura mendore e atij që e admiron tjetrin, e adhuron, e respekton, i përulet etj. mund të përcaktohet me vështirësi, megjithëkëtë në përfytyrimin e adhuruesve të idolit dallohen paragjykimet, afektet, entuziazmi etj., që përcillet me imitim sjelljesh, fjalësh etj. të tyre.

IDOLATRI, - A. f. I ardhur nga *ειδωλο* "figurë" dhe *λατρεία* "adhurim". Dukuria e adhurimit dhe e admirimit jokritik të idoleve nga ana e atyre, të cilët abstragojnë vetitë e cilësitë negative të personaliteteve të artit, të politikës, të shkencës etj., duke i përgjithësuar njëkohësisht vetëm ato veti dhe cilësi pozitive ose të menduara si të tilla, në një figurë ata individë të cilët i adhurojnë dhe i konsiderojnë shembull për kopjim të sjelljeve të tij dhe për imitim paragjykues të disa tipareve të tij. Të tillë mund të jenë "Yjet" e artit filmik, të futbollit, të muzikës së lehtë etj. Zhvillimit të idiolatrisë i kontribuojnë sot sidomos mjetet dhe media elektronike, si edhe shtypi.

IDHNAK, - E. mb. Që përcakton personalitetin me tipar hidhërimi e zemërimi të shpejtë dhe të lehtë. Termi idhnak ka përdorim të shpeshtë në gjuhën e përditshme.

IDHUJTARI, - A. f. Adhurimi, nderimi dhe respektimi i idhujve ose i idoleve nga ana e njerëzve që u qasen objekteve të idhujtarisë me paragjykime.

IDHULL, - I . m. Objekt i adhurimit. Shih - ***IDOL.***

IKJA E IDEVE. Rrjedhje e shpejtë, vrapim dhe fluturim jonormal i ideve, që shoqërohen me shprehje të një ritmi të shpejtë. Ikja e ideve është simptomë karakteristike e disa çrregullimeve psikike.

IKON/Ë, - A. f. Në teologji i huazuar nga greqishtja *εικόνα* "figurë, fytyrë". Ikona është figura e një shenjti të krishterë, e pikturuar mbi një copëz druri, ku qëndron e pandryshueshme për një kohë të gjatë. Në psikologjinë e kujtesës termi ikonë emërton konceptin e figurës mendore përfaqësuese të ngacmuesit pamor, figura e të cilit qëndron brenda një kohe të shkurtër në kujtesën sensorike.

IKONIK, - E. mb. Që ka të bëjë me ikona, përkatësisht me figura.

ILUMINACION, - I. m. Term me kuptim të veçantë psikologjik, të theksuar në psikologjinë geshtaltiste, që karakterizon mendimin krijues. Ilumination është faza e tretë e zgjidhjes së një situate problemore, që vjen pas fazës së përgatitjes ose të përgatitjes dhe të inkubacionit. Pas fazës së iluminacionit vjen faza e katërt dhe e fundit – faza e verifikimit. Karakteristika e fazës së iluminacionit është ndriçimi i papritur, befasues i situatës problemore dhe i rrugës së zgjidhjes së asaj situate. Kjo fazë paraqitet te subjekti pas fazës relativisht të gjatë të heshtjes, të inkubacionit të asaj situate problematike.

ILUMINIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *illuminatio* "ndriçim". Iluminimi në psikologjinë e mendimit krijues emërton fazën e veçantë të këtij mendimi, fazën e tretë, që e karakterizon "ndezja" e papritur e dritës në raportin kryesor të një situate problemore, ku gjendet zgjidhja e asaj situate. Kjo ndodh pas një kohe relativisht të gjatë të "inkubacionit", përkatësisht të

"zierjes" së brendshme të energjisë së akumuluar brenda një kohe të gjatë, por të qetë, të drejtuar në kërkim të zgjidhjes së situatës problemore, kur befas paraqitet zgjidhja e asaj situate problemore. Por, kjo zgjidhje nuk do të thotë se është zgjidhje e vërtetë. Kjo duhet vërtetuar në fazën e fundit të mendimit krijues, në fazën e verifikimit.

ILUMINIZ/ËM, - MI. m. Term i filozofisë dhe i sociologjisë që përkon edhe me psikologjinë, sepse prek proceset kognitive dhe sjelljet njerëzore. Termi iluminizëm ka depërtuar në gjuhën shqipe nga latinishtja *illuminatio* "ndriçim madhështor". Iluminizmi lidhet me lëvizjen intelektuale të Europës, sidomos të asaj franceze, të shekullit XVI – XVIII. Iluminizmi emërton rolin e madh të arsyes njerëzore në ndriçimin dhe arsimimin e saj. Fuqia e arsyes njerëzore është e pakufishme për të kuptuar realitetin dhe në frenimin e sjelljeve të një individi.

ILUZION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *illusion* "mashtrim i shqisave". Ky term i latinishtes është përbërës edhe i terminologjisë shqipe të psikologjisë. Iluzioni është perceptim i shtrembëruar i objektit që ushtron ndikim të drejtpërdrejtë në shqisat e një individi. Iluzionet shkaktohen nga faktorët fizikë, fiziologjikë dhe psikologjikë. Në grupin e faktorëve fizikë të iluzioneve bëjnë pjesë: renditja e objekteve që perceptohen, proporcionet e objekteve, ndryshimi ndërmjet sfondit dhe objektit perceptues, mënyra e kufizimit të objekteve dhe figurave që perceptohen etj. Në grupin e faktorëve fiziologjikë hyjnë: proceset ndijimore dhe kortikale, lodhja, helmimi etj. Grupin e faktorëve psikologjikë e përbëjnë: dëshirat, interesat, ndjenjat etj. Iluzionet mund të jenë produkt i disa faktorëve. Iluzionet i ndeshim në fushën e të parit, të dëgjuarit, të prekjes, të shijes dhe të nuhaturit, si edhe në fushën ndijuese të lëvizjeve, të ekuilibrit të trupit etj. Pra, iluzionet paraqiten në të gjitha modalitetet shqisore të ndijimeve dhe të perceptimeve të jashtme, por edhe të brendshme. Ndër to më të pranishme janë iluzionet e të parit. Hulumtimet e iluzioneve kanë bërë që të dallohen disa loje iluzionesh, ndër të cilat:

a. Iluzioni i Aristotelit – Përshtypja e individit për dy objekte, kur vetëm një objekt i vogël vihet ndërmjet dy gishtërinjve kryqëzues**;**

b. Iluzioni i Cëlnerit – Lloj iluzioni i perceptimit të hapësirës që e mori emrin sipas zbuluesit të këtij iluzioni Johan K. F. Cëlner (Johan Carl Friedrich Zöllner, 1834 – 1862). Iluzioni Cëlner ka të bëjë me perceptimin e gabuar të vizave vertikale paralele, kur këto viza priten në drejtime të kundërta joparalele. Këtë e ilustron figura e mëposhtme:



c. Iluzioni Ebinghauz – Dy rrathët e brendshëm të rrethuar me rrathë madhësish të ndryshme (njëri me rrathë më të mëdha dhe tjetri me rrathë

më të vegjël) janë identikë, por rrethi i parë i rrethuar me rrathë më të vegjël duket më i madh, kurse i dyti i rrethuar me rrathë të mëdhenj duket më i vogël se i pari. Këtë e ilustron figura e mëposhtme:



U quajt iluzion sipas zbuluesit të tij Herman fon Ebinghauz (Hermann von Ebbinghaus, 1850 – 1909).

d. Iluzioni Hering – Formë e iluzionit pamor. Dy vijat vertikale paralele të gjatësisë dhe të largësisë së njëjtë nën ndikimin e vijave të dala nga një pikë dhe të paraqitura në drejtime të ndryshme shkaktojnë pamundësinë e dallimit të vijave vertikale paralele dhe dukjen e tyre më të largët njëra nga tjetra, pikërisht në pikën e paraqitjes së vizave nga e djathta dhe e majta, ku edhe shpeshtësia e këtyre vijave është më e madhe. Këtë e ilustron figura e mëposhtme:



Këtë iluzion e ka trajtuar për herë të parë psikologu dhe fiziologu gjerman Evald Hering (Ewald Hering, 1834 – 1918).



e. Iluzioni Muller–Lyer – Dy drejtëza me gjatësi të barabarta, por nëse cepat e njërës kufizohen me V nga brenda dhe cepat e tjetrës me V nga jashtë, vizat nuk duken paralele, siç e tregon figura e mëposhtme:



Ky iluzion u quajt iluzioni Muller–Lyer sipas sociologut e psikologut gjerman Franc Karl Muller–Lyer (Franz Carl Müller–Lyer, 1857 – 1916).



f. Iluzioni pamor – Mashtrime pamore në fushën e perceptimeve të formës, të madhësisë, të largësisë ndërmjet dy objekteve etj., që shkaktohen në radhë të parë nga ndikimi që ushtron organizimi, renditja dhe raportet ndërmjet ngacmuesve të shqisës së të parit. Shih - ***ILUZIONI***.

g. Iluzioni Pogendorf – Formë e iluzionit pamor–gjeometrik, e zbuluar nga fizikani gjerman Johan Kristian Pogendorf (Johann Christian Poggendorff, 1796 – 1877). Diagonalja e drejtë e ndërprerë nga katërkëndëshi jep pamjen e një diagonaleje të këputur dhe të shkallëzuar. Këtë e ilustron figura e mëposhtme:



h. Iluzioni Ponzo. Iluzion pamor, i njohur edhe me termin iluzion i hekurudhës, ku dy vizat vertikale që ngushtohen gradualisht nga poshtë-lart shkaktojnë të parit jo objektiv të dy vizave horizontale me gjatësi të njëjtë të vendosura njëra ndaj tjetrës ndërmjet dy vijave të ngushta vertikale. Vija horizontale e lartë duket më e gjatë se e njëjta vijë e vendosur nën të. Këtë e ilustron figura e mëposhtme:



Iluzioni Ponzo u emërtua sipas emrit të fiziologut italian Mario Ponzo (Mario Ponzo, 1882 – 1960).

i) Iluzioni Sharpantie – Iluzion i madhësisë dhe i peshës. Iluzioni i madhësisë ka të bëjë me prirjen e një individi për të çmuar më shumë objektet e vogla që kanë masë identike, si edhe ato të mëdha. Iluzioni i peshës i përket atij iluzioni, që shfaqet me rastin e mbajtjes në dorë të objekteve të peshave të ndryshme. Me këtë rast te njeriu shfaqet prirja që peshën e tyre ta vlerësojnë më të vogël ose më të madhe se sa e kanë realisht objektet në fjalë. Në terminologjinë e psikologjisë pohohet se këtë e ka përshkruar për herë të parë mjeku francez Ogisten Shapantje.

j) Ilusioni Zanforlin - Formë karakteristike e iluzioneve pamore e ngjashme me iluzionin Myler – Lyer. Sipas këtij iluzioni dy viza të shtrira horizontalisht dhe të kufizuara në secilin skaj të tyre me rrathë të njëjta perceptohen viza me gjatësi të ndryshme, kurse këto kanë gjatësi shtrirjeje të njëjtë. Këtë e ilustron figura e mëposhtme:



Vizat horizontale kanë gjatësi të njëjtë dhe janë të kufizuara me rrathë të njëjta; viza e lartë kufizohet me rrathë madhësish të njëjta, por të vizatuara përbrenda vizës së shtrirë, ndërkaq viza horizontale poshtë saj është e kufizuar me rrathë po ashtu madhësish të njëjta, por të vizatuara jashtë skajit të majtë dhe të djathtë të vizës, janë shkaktarë që vizat e njëjta për nga gjatësia të perceptohen njëra më e shkurtë (viza e lartë), kurse e viza poshtë saj perceptohet më e gjatë se e njëjta vizë e vizatuar lartë kësaj të fundit. Iluzioni Zanforlin u përshkruar për herrë të pare më 1967 nga psikologu Italian Mari Zanforlin.

k. Iluzioni Xhekstrou – Iluzion pamor apo vizual. Kur i shikojmë dy figura në formë unaze të vendosura njëra mbi tjetrën, përftohet perceptimi i gabuar se figura e sipërme është më e vogël se ajo e poshtme, kurse në realitet këto janë të barabarta. Ky iluzion shkaktohet ngaqë viza e fundit e figurës së sipërme krahasohet me vizën e sipërme të figurës së poshtme. Këtë e ka përshkruar psikologu amerikan me origjinë polake Jozef Xhestrov (Joseph Jastrow, 1863 – 1944). Këtë iluzion e dallojmë në figurën e mëposhtme:



IMAGO. asnj. Term i psikanalizës, i përdorur në fillim nga Karl G. Jungu (Carl G. Jung, 1875 – 1961). Sipas tij imago është figura e një qenie, objekti të rëndësishëm që ekziston në pavetëdijen kolektive. Një figurë e tillë mund të jetë figura e babait dhe e nënës. Sipas K. G. Jungut figura e tillë ka përmasa të plota subjektive dhe duhet dalluar nga figura e qenies ose e objektit real. Termin

imago e ka përdorur edhe Zigmund Frojdi (Sigmund Freud, 1856 – 1939), por këtë term e ka zbatuar në kuadrin e teorisë së tij, në kuadrin e mendimit të pavetëdijshëm të njeriut, duke mënjanuar plotësisht pavetëdijen kolektive. Shih – ***FIGURA E BABAIT.***

IMAGJINAT/Ë, - A. f. I ardhur nga latinishtja *imaginattio*. Imagjinata është procesi i krijimit të konstrukteve, të përfytyrimeve të reja në bazë të lidhjeve të reja ndërmjet elementeve të përvojës, të përfytyrimeve të formuara më herët nga ana e përvojës së njeriut. Imagjinata shfaqet në aftësinë e njeriut për të krijuar atë që nuk ekziston. Sipas psikologjisë klasike procesi i krijimit të konstrukteve imagjinare sillet prej riprodhimit aktiv të përfytyrimit të objekteve dhe të dukurive nga përvoja e kaluar, që është quajtur imagjinatë riprodhuese në imagjinatë krijuese, që ka të bëjë me lidhje të reja ndërmjet elementeve të përvojës së kaluar dhe formimin e një konstrukti të ri deri në rikombinimin e paqëllimshëm të elementeve të përvojës dhe krijimin e një figure joreale (imagjinata fantastike). Sot flitet më tepër për mendimin krijues, ku imagjinata luan rol të rëndësishëm. Imagjinata është proces i rëndësishëm për të gjithë veprimtarinë e njeriut: kjo shfaqet në forma elementare edhe në zeje të thjeshta, si edhe në art, shkencë, teknikë e mjekësi. Në këtë kuptim imagjinata është proces i rëndësishëm i krijimtarisë. Ky është aktivitet i jetës psikike normale, por kur kalon caqet e realitetit dhe përcillet me besim të thellë të njeriut në produktin e saj, imagjinata e tillë mund të jetë simptomë e çrregullimit psikik. Imagjinata është karakteristikë dalluese e njeriut nga qeniet e tjera më të larta. Në shqipe termi imagjinatë zbatohet në të folurin e përditshëm, si edhe në atë profesional e shkencor dhe shpesh nuk bëhet dallim ndërmjet termit fantazi e imagjinatë. Psikologjia bën dallimin kuptimor ndërmjet fantazisë dhe imagjinatës. Në fantazi kemi krijime figurash e konstruktesh të reja nga përvoja e njeriut, por këto krijime janë më larg realitetit dhe paraqiten në tregime, në mite, në tregime, në përralla etj. Shih – ***FANTAZIA.***

IMAGJINATA RIPRODHUESE. Paraqitja besnike, riprodhimi i thjeshtë që bëhet kryesisht në formë përfytyrimesh të gjalla të asaj që është përjetuar më parë (figura, përshkrimi etj.).

IMAZH, - I. m. Përfytyrim i një gjësendi, individi etj. të cilin e kemi perceptuar më parë dhe tashmë paraqitet në formë të figurës mendore në mungesë të plotë të gjësendit apo individit të perceptuar shumë kohë më parë. Shih – ***PËRFYTYRIMI.***

IMBECILITET, - I. m. Term i psikologjisë klasike i ardhur nga latinishtja *imbecillitas* "ligështi" që emërton konceptin e shkallës së ulët të prapambetjes psikike, pikërisht atë të prapambetjes intelektuale. Imbecilitetin e karakterizojnë këto veçori: aftësia e kufizuar e të mësuarit dhe e fitimit të përvojës, imitimi i disa sjelljeve, në rend të parë i atyre sjelljeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e organizmit nga rreziqet e zakonshme, koeficienti i ulët i zhvillimit të inteligjencës që sillet 50 – 25 dhe manifestohet te të rriturit me kapacitet sa i një fëmije 7-vjeçar. Ata që vuajnë nga kjo sëmundje mezi mësojnë të flasin, kanë fjalor shumë të kufizuar të gjuhës amtare; të paktë janë ata që

arrijnë të përvetësojnë shkathtësinë e leximit dhe të shkrimit. Imbeciliteti është i lindur dhe mund të shkaktohet nga disa sëmundje të trurit në moshën e hershme të fëmijërisë. Ky term përdoret gjithnjë e më pak në psikologjinë bashkëkohore. Në vend të tij sot po përdoret gjithnjë e më shumë termi prapambetje mendore e kufizuar.

IMITIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *imitation* "kopjim". Imitimi është proces i kopjimit të saktë ose të ngjashëm të mënyrës së veprimeve, të sjelljeve të një individi nga ana e një individi tjetër. Ka karakter të qëllimshëm dhe të paqëllimshëm. Imitimi shpesh nuk lë pasoja të thella në personalitetin e njeriut. Imitimi është forma më e thjeshtë e të mësuarit që mbështetet në vëzhgim dhe haset kryesisht te fëmijët, të cilët orvaten t`i paraqesin sjelljet e tyre sipas modelit të një të rrituri.

IMPLICIT, - E. mb. I ardhur nga latinishtja *implicates* "që nënkuptohet, që gjendet në përmbajtjen e saj", me përdorim të përgjithshëm "kuptim, rëndësi" etj. që nuk është shprehur haptas, por nënkuptohet.

IMPOTENC/Ë, - A. f. I ardhur nga latinishtja *in* "jo" dhe *potential* "fuqia, aftësia seksuale" që emërton mungesën e fuqisë së njeriut në përgjithësi, por në radhë të parë mungesën e fuqisë së një individi mashkull për kryerjen e aktit seksual. Ky term gjen përdorim edhe në literaturën profesionale të psikologjisë dhe të psikiatrisë. Rrjedh nga çrregullimet nervore dhe hormonale, por më tepër nga shkaqet psikike.

IMPOTENCA DYTËSORE. Paaftësi e kryerjes së aktit seksual nga ana e disa meshkujve, kur këta gjenden në situata të posaçme psikike ose ndaj një partneri të caktuar seksual. Impotenca dytësore emërtohet edhe me termin impotencë speciale.

IMPOTENCA ORGAZMIKE. Mungesë e orgazmës ose arritje e vështirë e orgazmës edhe pas shqetësimit paraprak seksual. Në literaturën profesionale termi impotencë orgazmike përdoret kur nuk shkaktohet nga ndonjë çrregullim psikik, si depresioni, ose kur nuk shkaktohet nga marrja e barnave të veçanta. Rastet e impotencës orgazmike janë të shumta dhe individët e tillë janë të kënaqur me gjendjen e tyre.

IMPOTENCA PARËSORE. Pamundësia e shpeshtë e kryerjes së aktit seksual të individit mashkull me partnerin e gjinisë së kundërt, që shfaqet edhe pas përpjekjes së parë ose disa përpjekjeve për kryerjen e këtij akti. Impotenca parësore ka edhe një emërtim tjetër: impotencë e përgjithshme.

IMPOTENCA PSIKOGJENE. Pamundësia e kryerjes së aktit seksual nga shkaqet psikologjike, siç janë: ankthi, ngarkesa me frikë nga mossuksesi, nga konfliktet ndërpersonale, nga molisja, nga karakteri narcizoid i mashkullit, nga pamundësia e kalimit të fazës së incestit në zhvillimin psikoseksual etj. Shih – ***INCESTI.***

IMPRESION, - I. Shih – ***MBRESË; PËRSHTYPJE.***

IMPRESIONIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga latinishtja *impression* "mbresë, përshtypje". Term i estetikës, por me ngjyresë të thellë psikologjike. Impresionizmi mbështetet vetëm në mbresat, në përshtypjet e ndijimeve dhe gjendjen shpirtërore të njeriut, të

shkaktuar nga mbresat e këtilla, duke mohuar çfarëdolloj burimi tjetër të dijeve. Lindi në fushën e pikturës, por pas vitit 1878 u shtri edhe në letërsi dhe në muzikë. Sipas impresionizmit detyra e krijuesit në artin e pikturës, të letërsisë dhe të muzikës është t`i paraqesë mbresat e veta personale për objektet, dukuritë dhe situatat e jashtme, që kanë ndikuar në vetëdijen e tij.

IMPULS, - I. m. I ardhur nga latinishtja *impulses* "nxitës" që përdoret në fiziologji dhe në psikologji, por me kuptim thelbësor gati të pandryshuar. Në fiziologji termi impuls emërton nxitësin elektrofiziologjik të fijezave nervore nga një ngacmues adekuat i shqisave të caktuara. Në psikologji nxitësi është faktor i brendshëm i individit që e shtyn të ndërmarrë një aktivitet të caktuar. Impulsi në psikanalizë është energjia e shtytësve, në rend të parë, energjia e shtytësit seksual të idit.

IMPULSI NERVOR. Lloj specifik i një procesi të ndërlikuar fiziko-kimik dhe elektrik të ndryshimit të ngarkesës së cipës së qelizës nervore, të neuronit që bartet nga një neuron në tjetrin sipas potencialit elektrik të fijeve të neuronit dhe të ndryshimit të këtij potenciali që përhapet me një shpejtësi prej rreth 100 m në sekondë.

IMPULSIVITET, - I. m. Tipar i veprimeve të një personaliteti të caktuar, të cilin e karakterizon vrulli dhe shpejtësia e reagimit ndaj ngacmuesve perceptivë e mendorë, duke mos pasur kohë të marrë në konsideratë pasojat e reagimeve të tilla. Impulsiviteti shfaqet zakonisht te ata individë që nuk kanë arritur t`i stabilizojnë reagimet emocionale të tyre, por shpesh ky tipar nuk mungon edhe te të tjerët me gjendje normale dhe me reagime emocionale të stabilizuara.

IMUNITET, - I. m. I ardhur nga latinishtja *immunitas* "lirim nga detyrimet shtetërore". Term i vjetër që i përket imunologjisë, por ka rëndësi edhe për psikologjinë. Imuniteti është sistem i ndërlikuar fiziologjik që mbron organizmin nga llojet e ndryshme të infeksioneve të shkaktuara nga mikroorganizmat. Mbrojtja nga infeksionet organike lidhet edhe me mbrojtjen e strukturave psikike dhe me mbrojtjen e funksionimit të drejtë të tyre (mbrojtja nga infeksioni i syrit lidhet me zhvillimin e procesit të perceptimit, mbrojtja nga infektimi i sistemit nervor reflektohet edhe në mbrojtjen e proceseve psikike dhe të sjelljeve të lidhura drejtpërdrejt me sistemin nervor, mbrojtja e gjëndrës tiroide lë pasoja edhe në zhvillim e drejtë të aftësive mendore të individit etj.). Në kohët më të vonshme u zhvillua si disiplinë shkencore psikoneuroimunologjia. Shih – ***PSIKONEUROIMUNOLOGJIA.***

INATI. Shih – ***MËRIA.***

INCEST, - I. m. I ardhur nga latinishtja *incestare* "çnderim" që emërton procesin e kryerjes së marrëdhënieve seksuale ndërmjet meshkujve e femrave me afërsi gjaku, që është i ndaluar me ligj. Incest konsiderohen edhe marrëdhëniet seksuale ndërmjet nënës e djalit, babait e vajzës së tij, vëllait e motrës etj. Marrëdhënia seksuale më e rrallë dhe më e rrezikshme, me pasoja të rënda organike dhe psikike është ajo ndërmjet nënës dhe djalit, kurse më i shpeshtë është incesti ndërmjet babait

e vajzës dhe ndërmjet vëllait e motrës. Incesti shfaqet midis meshkujve dhe femrave të një gjaku të një moshe më të re dhe të një moshe të shtyrë. Sipas Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939) kjo dukuri daton që nga kohët më të lashta të zhvillimit të njerëzisë dhe, së bashku me të, është zhvilluar edhe ndalesa e marrëdhënieve seksuale ndërmjet anëtarëve të një vëllazërie, të një fisi etj. Incesti është ndalesë e përbashkët në kulturat e të gjithë popujve. Ndër Shqiptarët ky proces ka qenë i ndaluar që në kohët e lashta e që e parashikonte edhe Kanuni dhe shoqërohej me dënime shumë të ashpra ndaj atyre që shkelnin Kanunin dhe ndaj anëtarëve të tjerë të familjes. Kuptohet, pas vitit 1912 incesti u ndalua edhe me ligj. Incesti përjetohet si traumë dhe ka pasoja të rënda psikike në vitet e mëvonshme.

INDEKS, - I. m. I ardhur nga latinishtja *index* "herës" që ka kuptim të posaçëm në statistikën e psikologjisë, në psikologjinë sociale dhe në disa disiplina të tjera. Ne statistikë termi indeks (index) emërton herësin ndërmjet masave statistikore, ndërmjet një mase statistikore të caktuar dhe një standardi të caktuar për ndryshoren matëse. Në psikologjinë sociale indeksi është shënjuesi i disa indikatorëve të ndryshoreve shoqërore-psikologjike të ndërlikuara.

INDEKSI I ASIMETRISË. Treguesi numerik i dallimit ndërmjet dendësisë së të dhënave të përftuara nga matja e një ndryshoreje psikologjike. Ka forma të ndryshme të përcaktimit të indeksit të asimetrisë. Në rastet e indeksit të asimetrisë paraqitja grafike e dallimit të dendësisë ndërmjet vlerave të përftuara është më e madhe në anën e majtë ose në anën e djathtë. Këtë e tregon figura e mëposhtme.



Shkalla e asimetrisë së dendësisë së rasteve përcaktohet me indeksin e asimetrisë. Njëra ndër këto forma është dallimi ndërmjet të mesmes aritmetike dhe vlerës qendrore të të dhënave të njëjtave të përftuara nga matja e së njëjtës ndryshore tek të njëjtët subjekte.

INDEKSI I BESUESHMËRISË. Vlerësimi i shkallës së ndërlidhjes a korrelacionit ndërmjet rezultateve të përftuara nga matja konkrete e një ndryshoreje psikologjike dhe rezultateve të përftuara nga zbatimi i të njëjtit test pas një kohe relativisht të gjatë te të njëjtët subjekte. Sa më i lartë, mbi 0,80, të jetë koeficienti i ndërlidhjes a korrelacionit ndërmjet këtyre rezultateve aq më e lartë është shkalla e besueshmërisë së një testi, përkatësisht aq më të sigurt jemi se kjo shkallë mat vërtetë ndryshoren për të cilën është përpiluar testi. Koeficienti i besueshmërisë përcaktohet në disa mënyra:

a. Koeficienti i qëndrueshmërisë – Koeficient që përcaktohet sipas shkallës së ndërlidhjes apo korrelacionit ndërmjet rezultateve testim-ritestim. I njëjti test, me të njëjtat udhëzime u jepet pas një kohe relativisht të gjatë të njëjtëve subjekte dhe përcaktohet shkalla e ndërlidhshmërisë ndërmjet

rezultateve të testimit e të ristestimit. Mund të ritestohet dy ose më shumë herë i njëjti test te të njëjtët subjekte. Shkalla e përftuar e ndërlidhjes ndërmjet këtyre dy a më shumë rezultateve tregon qëndrueshmërinë e brendshme të besueshmërisë së një testi;

b. **Koeficienti i konsistencës së brendshme të testit** – Koeficient që përcaktohet në bazë të rezultateve të korreluara ndërmjet detyrave problema të gjysmës së parë të testit me gjysmën tjetër të tij. Zakonisht testi ndahet në dy gjysma sipas parimit të numrave çift dhe të numrave tek; sa më i lartë të jetë koeficienti i ndërlidhjes a korrelacionit ndërmjet rezultateve të dy gjysmave aq më homogjen është testi.

c. **Koeficienti i ekuivalencës së testeve** – Koeficient që përcaktohet nga korrelimi i rezultateve të përftuara nga zbatimi i dy testeve ekuivalente te subjekte të njëjtë. Koeficienti i lartë i përftuar në këtë mënyrë tregon shkallën e besueshmërisë së një testi të paraqitur në dy forma.

INDEKSI I NGECJES ZHVILLIMORE. Vlerësimi i shkallës së ngecjes në zhvillimin e një aftësie në raport me moshën e njeriut. Indeksi i tillë përcaktohet me anën e testeve Veksler-Belvi. Indeksi i ngecjes zhvillimore mbështetet në matjet konkrete kur dallojmë se ndonjëra nga aftësitë (e perceptimit, e kujtesës, e zgjidhjes së problemeve etj.) ndal në procesin e zhvillimit.

INDEKSI KORNEL. Fletëpyetës i standardizuar që është formuar për dallimin e prirjeve neurotike të rekrutëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës nga individët e tjerë joneurotikë. U zbatua gjatë Luftës Dytë Botërore dhe sipas rezultateve të arritura u tregua instrument me vlerë për të realizuar qëllimin për të cilin ai ishte hartuar. Pyetësori Kornel ka njëqind pyetje. Sipas përgjigjes së dhënë rekrutët neurotikë dalloheshin nga ata joneurotikë. Indeksi Kornel ka dy veçori kryesore: është ekonomik dhe mundëson zbatimin masiv të tij. Pohohet se u tregua më i përsosur se Inventari Vudvort për personalitetin (Robert S. Woodworth, 1869 – 1962).

INDEKSI MORFOLOGJIK. Shprehje numerike e raportit ndërmjet disa përmasave trupore. Indeksi morfologjik mundëson caktimin e tipit konstitucional të njeriut, përkatësisht cakton cilit tip i përket një individ i caktuar (ektomorf, mezomorf, endomorf). Sipas psikologut amerikan Hans J. Ajzenk (Hans J. Eysenck, 1916 – 1997) indeksi morfologjik llogaritet duke përcaktuar gjatësinë e trupit, shumëzuar me 100 dhe pjesëtuar me gjerësinë e gjoksit dhe produkti duhet shumëzuar me 6.

INDI NERVOR. Tërësi e veçantë neuronesh që kryejnë funksion specifik.

INDIFERENC/Ë, - A. f. I ardhur nga latinishtja *indiferetia* "asnjanës". Term i përgjithshëm me kuptim psikologjik që paraqet gjendjen psikike të një individi, të karakterizuar nga mosinteresimi për dukuritë, objektet e situatat, si edhe nga asnjanësia ose neutraliteti i qëndrimeve, i sjelljeve të pa aktivizuara të tij. Pikërisht këtë individ e karakterizon pasiviteti.

INDIFERENTIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga latinishtja *indeterminatus* "i pacaktuar", që i përket terminologjisë së filozofisë, por me kuptim që shtrihet edhe në psikologjinë e vullnetit

të lirë. Sipas indiferentizmit vullneti i lirë i njeriut është forma e veprimtarisë, e cila e formëson veprimtarinë e gjithëmbarshme të tij. Derisa në kuptimin klasik vullneti ka të bëjë me procesin e vendosjes së njeriut për një qëllim të vetëdijshëm, vullneti i lirë i përket vetë njeriut dhe ai gjendet nën sundimin e tij, e jo i kushtëzuar nga natyra e qëllimit, kushtet, mundësitë, mjetet dhe rrugët e jashtme të realizimit të tij. Liria e njeriut është ajo që përcakton zhvillimin e natyrën e tij. Vullnetin e lirë dhe rëndësinë e tij në zhvillimin e personalitetit e kanë trajtuar sidomos psikologjia humaniste me në krye Abraham Masloun dhe psikologjia ekzistencialiste me në krye Ludvig Binsvangerin (Ludvig Binsvanger, 1881 – 1966), duke iu vënë kundër psikanalizës së Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939) dhe bihejviorizmit të Xhon Uotsonit (John Watson, 1878 – 1958).

INDINJAT/Ë, - A. f. Emocion i ndërlikuar i përbërë nga hidhërimi dhe zemërimi me një intensitet të lartë, të shkaktuar nga pengimi i aktivitetit për plotësimin e një motivi dhe të një qëllimi të caktuar. Indinjata shfaqet me mllef dhe me urrejtje ndaj atij që i pengon sjelljet e motivuara dhe të drejtuara për një qëllim të posaçëm. Indinjata ka strukturë të ndërlikuar emocionesh dhe lidhet me vlerën e qëllimit që një individ synon të arrijë.

INDIVID, - I. m. I ardhur nga latinishtja *individuum* "i pandashëm". Me termin individ emërtohet qenia e veçantë, e përveçme, tërësia e integruar biologjike, sociale e psikike e një njeriu të caktuar, i cili është unik duke u dalluar nga të gjithë të tjerët. Në psikologjinë bashkëkohore individi, sipas psikologut amerikan Gordon Alport (Gordon Allport, 1897 – 1967), përcaktohet si individ i pavarur që karakterizohet nga sistemi unik i formësimit të tij.

INDIVIDI IMPULSIV. Individ i rrëmbyeshëm që reagon shpejt, me pririe të dalluar për të reaguar ndaj mbresave të para që i bien në mend. Kjo pririe karakterizon stilin e reagimit të tyre kur u lëshohet lehtë energjisë së shtytësve të brendshëm, reagon në mënyrë të papërmbajtur duke mos kontrolluar si duhet impulset, reagimet emocionale dhe sjelljet e tij. Individi impulsiv paraqet sjellje agresive sidomos kur dikush e pengon atë në realizimin e dëshirave dhe të synimeve të tij.

INDIVIDUACION, - I. m. Sipas psikologjisë së Karl G. Jungut (Carl G. Jung, 1875 – 1961) shpreh procesin e zhvillimit të diferencuar të qenies së njeriut që çon në veçimin e tij dhe në formimin e personalitetit unik të ndarë nga të gjithë, në rend të parë nga tiparet psikologjike të përbashkëta për një kolektiv të caktuar. Kjo veçanti e personalitetit është e dhënë apriori e dhuntisë së tij. Në mbështetje të kësaj dhuntie zhvillimi i personalitetit kryhet gjatë një procesi, i cili ecën prej të përgjithshmes kah e përveçmja. Gjatë këtij procesi synohet arritja e personalitetit në njohjen e vetëdijshme të vetvetes dhe në formimin e unit të tij.

INDIVIDUALITET, - I. m. Tërësia e të gjitha tipareve të një individi, në bazë të identifikimit të të cilave ai ka mëvetësinë e tij dhe ndryshon nga të gjithë të tjerët. Tipare të tilla të integruara në personalitetin e një individi

të caktuar janë: autonomia, bindjet, gatishmëria për aktivitet të mbrojtjes së vetvetes, konsekuenca e sjelljeve, qëndrimet etj. Studiuesi amerikan i psikologjisë së personalitetit Gordon Alport (Gordon Allport, 1897 – 1967) ka vlerësuar se, pikërisht individualiteti është fakti themelor dhe i nivelit më të lartë të natyrës njerëzore.

INDIVIDUALIZ/ËM, - MI. m. Përparësia, favorizimi i interesave, të nevojave, të qëndrimeve e të vlerave individuale mbi ato të të tjerëve dhe mbi të përgjithshmet dhe këmbëngulja e realizimit të tyre, duke mos pasur konsideratë për interesat, kushtet, motivet dhe qëndrimet e të tjerëve. Tiparet e sipërpërmendura individi i caktuar i konsideron vlera të jashtëzakonshme dhe ai është i bindur për to. Për këtë shkak ai paraqet tipare të sjelljes së një egoisti, të një egocentristi.

INDIVIDUALIZIM, - I. m. Procesi i zhvillimit psikik të njeriut që ka të bëjë me vetëdijesimin e njeriut për ndarjen e tij nga të tjerët dhe shkallën e duhur të zhvillimit të aftësisë së kontrollit të sjelljeve individuale.

INDOKTRINIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *in* "jo" dhe *doctrina* "doktrinë". Angazhim i qëllimshëm, sistematik dhe i planifikuar që u drejtohet individëve të tjerë për imponimin e një doktrine në mënyrë jokritike, për imponimin e interesave, të qëndrimeve, të sjelljeve etj. të një ideologjie të caktuar. Kjo mënyrë e imponimit të sistemit ideologjik kërkon edhe pengimin e verifikimit të sistemit konceptual të asaj ideologjie nga ana e të tjerëve dhe besimin në trajtë të verbuar të këtij sistemi konceptual të asaj ideologjie. Në indoktrinim kontribuojnë mjetet e informimit masiv, sidomos televizioni. Indoktrinimi mund të jetë ekonomik, fetar, politik, ushtarak etj.

INDUKSION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *inducere* "me shpënë". Formë e të menduarit të njeriut që ka të bëjë me nxjerrjen e një konkludimi nga analiza e rasteve të veçanta, e gjykimeve të veçanta dhe lidhja e drejtë e atyre gjykimeve në një mendim të përgjithshëm që vlen për rastet e veçanta që i përkasin klasës së atyre rasteve. Këtu kemi të bëjmë me një proces mendor që zhvillohet duke ecur nga e veçanta në të përgjithshmen, përkatësisht ajo që është e vërtetë për rastet e veçanta është e vërtetë edhe për të gjitha rastet e asaj klase. Disiplinat empirike, siç është psikologjia, e ndërtojnë sistemin konceptual të tyre në mbështetje të induksionit; në psikologji rezultatet e metodës eksperimentale të nxjerra nga hulumtimi eksperimental i tyre përgjithësohen në formë rregullsie, parimi, ligji e teorie. Induksioni në fiziologji ka të bëjë me zhvillimin indirekt të aktivitetit të një fushe të caktuar të trurit, duke shkaktuar aktivitetin e një fushe tjetër që lidhet me të ose në bazë të afërsisë ose në bazë të lidhjes neurale që kanë ato dy fusha. Një ndikim i tillë mund të jetë ndikim pozitiv ose ndikim negativ. Në neurofizilogji dallohet induksioni suksesiv dhe induksioni simultan. Induksioni suksesiv është dukuria neurologjike e qendrave kortikale me drejtim të kundërt nga ajo që është zhvilluar më parë, kurse induksioni simultan emërton dukurinë neurofiziologjike të qendrave kortikale kur këto veprojnë në drejtim të kundërt me qendray kortikale fqinjë.

Këtë e ka dalluar fiziologu Sherington. Në psikologjinë klinike dhe në psikiatri induksioni ka të bëjë me procesin e bartjes së një reagimi, të reagimit emocional në rend të parë, nga një individ në individin tjetër ose te individët e tjerë. Hasen disa tipa induksionesh:

a. **Induksioni pamor** – Ndikimi që ushtron aktiviteti pamor i një pjese të retinës në pjesët e tjera të retinës;

b. **Induksioni perceptiv** – Plotësimi i perceptimit të një dukurie, objekti, procesi etj. dhe i të dhënave shqisore të tyre me elemente të tjera, të cilët i kontribuojnë formimit të perceptimit të tërësishëm për atë dukuri, objekt, proces etj.

c. **Induksioni nervor** – Formë e induksionit fiziologjik që ka të bëjë me ndikimin pozitiv ose negativ që ushtron funksionimi i një qendre apo fushe nervore në funksionimin e përgjithshëm të asaj qendre a fushe.

INERVIM, - I. m. Furnizim i organeve, i gjëndrave dhe i muskujve me nerva përkatës dhe me pjesë të tyre, përkatësisht lidhja e nervave dhe e pjesëve të tyre me indet e organeve dhe të sistemit të organeve të organizmit. Inervimi i muskujve është reciprok, kur çifti antagonist i muskujve furnizohet me ato nerva që ngacmojnë mbledhjen e njërit muskul dhe shtrirjen e muskulit tjetër.

INFANT, - I. m. I ardhur nga latinishtja *infants* "fëmijë, që nuk flet". Termi infant përdoret rrallë në gjuhën shqipe, por haset në literaturën e psikologjisë zhvillimore. Me termin infant emërtohet foshnja, përkatësisht fëmija i pafuqishëm dhe i paaftë për të folur dhe për të ecur.

INFANTIL, - E. mb. Që i përket infantit, fazës së zhvillimit të foshnjës e fëmijës deri në moshën 2 vjeç.

INFANTILIZ/ËM, - MI. m. Prapambetje e një fëmije të rritur, madje edhe e një të rrituri në zhvillimin emocional, kognitiv dhe psikomotorik. Një prapambetje e tillë i përket nivelit të këtyre proceseve karakteristike për infantin, përkatësisht për foshnjën, por që shfaqen te të rriturit, pavarësisht se mosha e individit nuk e justifikon sjelljen infantile. Një nivel i tillë i prapambetjes dallohet sidomos në proceset njohëse ose kognitive; së pari kjo prapambetje dallohet në të folur. Infantilizmi lidhet me zhvillimin psikologjik jo të duhur të individit në moshën e fëmijërisë së tij.

INFERIORITET, - I. m. I ardhur nga latinishtja *inferior* "më i ulët". Termi inferioritet gjen përdorim në disa disiplina, por edhe në të folurin e përditshëm. Në kuptimin e përgjithshëm inferioriteti është pozicioni më i dobët, më i ulët, më pak i vlefshëm etj. kundruall vlerësimit real të aftësive, të gjindshmërisë, të suksesit etj.

INFERIORITETI ORGANIK. Ndjenja e vlerës më të vogël të një individi që shkaktohet nga mungesa e njohurive mbi strukturën e një organi ose mbi çrregullimin e funksionit të një organi të caktuar. Njohuri të tilla e shtyjnë njeriun të ndërmarrë veprime plotësuese me qëllim kompensimin e asaj strukture apo organi, si edhe kompensimin e funksionit të çrregulluar të këtij organi ose të ndonjë organi tjetër.

INFILTRIMI FRUSTRUES.Shtrirja e gjendjes frustruese të njeriut të frustruar në një fushëveprim më të gjerë se

që ka gjendja e brendshme ose objekti i jashtëm i frustrimit.

INFLACION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *inflation*. Ka kuptim të veçantë në psikologji mbështetur në psikologjinë komplekse të Karl G. Jungut (Carl G. Jung, 1875 – 1987). Sipas K. G. Jungut inflacioni është "fyerje e psikikës së vetëdijshme nga depërtimi i madh i arketipave të përmbajtjes së pavetëdijes kolektive në strukturat e vetëdijshme të individualitetit". Një inflacion i tillë shfaqet në dy mënyra: në mënyrë pozitive dhe negative. Në mënyrë pozitive shfaqet te njeriu mendjemadh me ndjenjën e individit të përveçëm dhe të zgjedhur në mesin e shumë të tjerëve. Ndërkaq, kur individin e përfshin ndjenja e pavlerës për vetveten, si edhe ndjenja e inferioritetit të thellë, madje, kur individi bie në depresion, atëherë mund të flasim për inflacionin negativ. Sipas K. G. Jungut "Inflacioni është i pavetëdijshëm i vetëdijes.....; lind atëherë kur vetëdija i merr përmbajtjet e pavetëdijes dhe humb aftësinë, që është *condition sine qua non* "e secilës vetëdije". "Fryrja" e personalitetit nga inflacioni varet edhe nga përmbajtja e tipit të arketipit që depërton në vetëdijen e tij; nëse depërton përmbajtja e arketipit *Anima*, atëherë individi zhvillon sjellje të çuditshme, herë-herë edhe sjellje me përmasa histerike etj. Nëse depërton përmbajtja e arketipit "Individë", atëherë ai e konsideron veten të pakrahasueshëm me mjekun, me politikanin, me burrin e shtetit etj.

INFORMACION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *information* "lajm" e që ka kuptim të përgjithshëm në procesin e të folurit të zakonshëm, duke emërtuar përmbajtjen e një lajmi, të një fakti të dhënë, të cilësisë së një dukurie, objekti, individi etj. Disa e reduktojnë të mësuarit në marrje të informacioneve dhe në përpunimin e tyre. Në psikologjinë e të mësuarit informacioni është fakt shkencor me përmasë të caktuar sasiore e cilësore, që përftohet nga hulumtimi i caktuar, u kumtohet të tjerëve dhe shërben për analizën dhe për një shpjegim më të gjerë dhe më të thellë. Në teorinë e informacionit termi informacion ka marrë një kuptim të përkufizuar saktësisht. Këtu informacioni është cilësi kuantitative e një rendi faktesh që përcakton probabilitetin e paraqitjes së sasisë të një informacioni të caktuar në kuadrin e atij rendi. Llogaritet me formulë të veçantë.

INHERENT, - E. mb. I ardhur nga latinishtja *inhaerens* "i përforcuar, i lidhur" që përdoret edhe në psikologji duke cilësuar tiparet substanciale të një personaliteti, që janë të pandashme nga personaliteti i caktuar, që përbëjnë bërthamën psikologjike të atij personaliteti.

INHIBICION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *inhibition* "ndalim, pengim" që ka përdorim të madh në psikologji. Kuptimi i përgjithshëm i termit inhibicion është pengimi, ndalimi, frenimi i vazhdimit të një procesi, të një veprimi. Inhibicioni ka kuptim të veçantë në fiziologji, në psikologjinë kognitive dhe në psikanalizë. Në fiziologji inhibicioni emërton ndaljen e një procesi, pengimin e zhvillimit të mëtejshëm të një procesi neurofiziologjik me anë të një procesi tjetër. Në psikologjinë kognitive, sidomos në psikologjinë e harresës termi inhibicion emërton pengimin e mbajtjes mend të një ose disa informacioneve nga ana e

informacioneve të tjera. Në psikanalizë termi inhibicion emërton ndalimin e zhvillimit të një procesi të shtyrë nga energjia e një shtytësi të pavetëdijshëm të idit nga ana e energjisë së super egos, duke mos lejuar atë të depërtojë deri në sferën e vetëdijes së njeriut, përkatësisht duke mos lejuar impulse të idit të depërtojnë në vetëdije dhe të angazhojnë qendrat motorike për realizimin e tyre. Dallojmë këto lloj inhibicionesh:

a. **Inhibicioni asociativ** – Pengesë për rikujtimit e një fjale të vjetër nga ana e shoqërimit të saj me një fjalë të re. Nuk i kujtohet fjala inhibicion për të reaguar ndaj fjalës frenim, sepse në zhvillimet e deritanishme mendore ai e ka përdorur zakonisht fjalën inhibicion e frenim. Në rastet e tilla bëhet fjalë për procesin pengues të zhvillimit të asociacionit të vjetër nga një element i ri, përkatësisht nga ana e një ngacmuesi të ri;

b. **Inhibicioni i brendshëm** – Pengim apo frenim i zhvillimit të procesit neuropsikik në cipën apo koren e trurit të madh nga bllokimi i lidhjeve të përkohshme nervore. Termi i përket terminologjisë së fiziologjisë e psikologjisë së Ivan Pavllovit (Ivan Pavlov, 1849 – 1936);

c. **Inhibicioni i inhibicionit** – Frenim i inhibicionit, përkatësisht frenim i ndikimit të pengimit të mëtejshëm të një reagimi gati të harruar me rastin e paraqitjes së një ngacmuesi të ri. Inhibicionin e inhibicionit e ka identifikuar Ivan Pavllovi;

d. **Inhibicioni kortikal**. Shih – ***FRENIMI KORTIKAL.***

e. **Inhibicioni proaktiv** – Frenim paravajtës i cili ka të bëjë me procesin e pengimit të mbajtjes mend dhe të riprodhimit të përmbajtjes së re, të shkathtësisë dhe të shprehisë së re nga ana e përmbajtjes, të shkathtësisë e të shprehisë së memorizuar më herët. Të mësuarit në fillim e gjuhës italiane e frenon, e pengon mbajtjen mend dhe riprodhimin e rregullave gramatikore të gjuhës frënge etj.

f. **Inhibicioni reaktiv** – Prirje frenuese ose inhibuese e vazhdimit të një aktiviteti nga ana e aktivitetit të njëjtë ose të ngjashëm të zhvilluar brenda një kohe të gjatë. Të mësuarit e ngjeshur brenda një kohe të shkurtër çon në frenim të të mësuarit të mëtejshëm. Inhibicioni reaktiv vjen në shprehje në formën e të mësuarit të përqendruar, të mësuar pa pauza. Ky term i përket teorisë së të mësuarit të Klark Hullit (Clark Hull, 1884 – 1952).

g. **Inhibicioni retroaktiv** – Frenim prapavajtës, përkatësisht pengesa e mbajtjes mend dhe e riprodhimit të përmbajtjes së vjetër, të shkathtësive dhe të shprehive të mësuara, si edhe riprodhimi i vështirësuar i tyre nga ana e përmbajtjes, e shkathtësisë dhe e shprehisë së re që tashmë mësohet. Shkathtësia e ngasjes së biçikletës e mësuar shumë herët pengohet ose frenohet nga të mësuarit e ngasjes së motoçikletës. Inhibicioni i inhibicionit quhet edhe dezinhibicion.

h. **Inhibicioni sinaptik** – Sinapsa që ndikon në neuronin pranues ndryshon shkallën e bartjes së impulsit nervor në cipën e neuronit, në drejtim të zvogëlimit të potencialit qetësues dhe në këtë mënyrë zvogëlon mundësinë e paraqitjes së impulsit nervor.

INKOHERENC/Ë, - A. f. I ardhur nga latinishtja *incohaerens* "i palidhur, që haset edhe në literaturën e psikologjisë". Inkoherenca është organizmi i dobët i lidhjeve ndërmjet komponentëve të një tërësie mendore. Në kontekstin e psikologjisë së të folurit inkoherenca në procesin e të folurit ka kuptimin e një të foluri të ngatërrueshëm, të çrregulluar, të pakuptimshëm që manifestohet në përdorim fjalësh e termash pa vend, në formim fjalish të pakuptimshme, me përdorim neologjizmash pa njohur kuptimin e plotë të tyre etj.

INKORPORACION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *in* "në" dhe *corpus* "trup". Në kuptimin e përgjithshëm inkoroporimi në psikologji do të thotë procesi i futjes së një "objekti" të botës së jashtme në trupin e njeriut, përkatësisht proces i shndërrimit të një dukurie, objekti, individi etj. në përbërës psikik të atij individi. Procesi i inkorporimit është karakteristik për mendimin psikanalitik. Sipas këtij mendimi inkorporimi është karakteristik për fazën orale të zhvillimit psikoseksual, kur fëmija angazhohet të fusë në aparatin psikik të tij atë që i përgjigjet parimit të kënaqësisë, përkatësisht çdo gjë të mirë, që lidhet me pozitiven dhe atë që është e pakëndshme, e keqe dhe e rrezikshme ta dëbojë nga vetja e tij. Kjo formë e reagimit shfaqet në një trajtë të veçantë të mekanizmit mbrojtës, kur njeriu i pakënaqur, i hidhëruar, i cenuar etj. orvatet që me fantazinë e tij të damkosë, të eliminojë tjetrin etj.

INKUBACION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *incubation* "shtrirje mbi një objekt". Termi inkubacion në psikologji ka ardhur nga biologjia, ku termi inkubacion emërton fazën disaorëshe, disamuajshe, madje edhe disavitesh të shtrirjes joaktive të një çështjeje, ideje, problemi që pret zgjidhje etj., por individi për aq kohë nuk merret me atë. Gjatë kohës së inkubacionit proceset e pavetëdijshme nuk e lëshojnë atë çështje, ide, problem, derisa individit nuk i paraqitet papritmas zgjidhja e saj edhe në befasi. Gjatë kohës së inkubacionit çështja, ideja e problemi vetvetiu i përket kohës së "pjekurisë", kurse individi që është bartës i saj është i angazhuar në çështjet e tjera ditore e profesionale. Pohohet që kjo çështje merr vetvetiu formën e zgjidhjes së saj dhe i paraqitet individit në zgjidhjen e saj substanciale në kuadrin e lidhjeve të ideve të reja. Faza e inkubacionit i përket mendimit krijues, të cilin e ka trajtuar në mënyrë të veçantë psikologu amerikan Uolles MekKinon (Wallace MacKinon, 1903 – 1987). Psikologjia geshtaltiste i ka përcaktuar fazat e përgjithshme të procesit të mendimit krijues gjatë zgjidhjes së tërësishme të një situate problemore, natyra psikologjike e të cilit gjurmohet.

INKURAJIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *in* "në" dhe *curare* "kujdesohem". Psikologjia e ka shfrytëzuar këtë term për të emërtuar procesin të dhënit guxim e zemër për kryerjen e një veprimi të filluar. Inkurajimi është nxitje, fuqizim i energjisë psikike për vazhdimin e një pune, aktiviteti etj.

INSAJT, - I. m. I ardhur nga anglishtja *insight* "depërtim mendor, mendjemprehtësi". Insajti u fut në përdorim dhe u bë term psikologjik i psikologjisë, që nga viti 1925, kur psikologu gjerman Volfgang Këler (Wolfgang Köhler, 1887 – 1967) termin *einsicht* të

gjermanishtes e përdori për të emërtuar depërtimin mendor në pasqyrimin e përbërësve të një problemi, të lidhjeve kryesore ndërmjet tyre dhe arritjen në zgjidhjen inteligjente të tij. Volfgang Këler këtë e konstatoi në eksperimentet e tij me majmunë në siujdhesën Tenerif, duke krijuar situatën e marrjes së bananes së varur në tavanin e lartë nga shimpanzetë në një dhomë ku kishte vendosur disa shkopinj dhe arka. Shimpanzetë, duke vendosur një arkë mbi tjetrën ose duke lidhur një shkop me tjetrin i arritën t'i kapnin bananet, duke shuar në këtë mënyrë urinë. Këto arritën deri në zgjidhjen e kësaj situate dhe në shuarjen e urisë, ngaqë elementet përbërëse të problemit të shuarjes së urisë (shkopinjtë, arkat, bananet) gjendeshin në fushën e të parit të tyre. "Zbulimi" i lidhjeve kryesore ndërmjet përbërësve të një problemi apo situate problemore arrihet pas një mëtimi të gjatë apo të shkurtër, kur papritmas shfaqet "përjetimi aha" me zgjidhje të shpejtë të këtij problemi. Ndërkaq, kur majmunët u gjenden në situatën problemore të shuarjes së urisë me banane të varura në tavan, por shkopinjtë dhe arkat ishin jashtë fushës së të parit të shimpanzeve, asnjë nuk arriti të kujtohet se diku larg ndodheshin shkopinjtë dhe arkat, të cilat duheshin kërkuar e gjetur në hapësirë dhe duheshin afruar në vendin ku ishin varur bananet, për të zgjidhur problemin e shuarjes së urisë. Volfgang Këleri ishte i mendimit se shimpanzetë arritën ta zgjidhin problemin e shuarjes së urisë, kur bënë "ristrukturimin radikal" të elementeve të situatës problemore. Këtë e quajti *einsicht*, përkatësisht *insight*. Situatë shumë e ngjashme dallohet edhe te fëmijët pas moshës 18 muajsh, por, fëmijët e kësaj moshe e përvetësojnë gjuhën, e cila ia mundëson fëmijës afrimin mendor të elementeve që gjenden jashtë fushës perceptive të tyre dhe zgjidhjen e problemit. Shih – ***MËTIMI***.

INSINUACION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *insinuation* "mashtrim". Paraqitje e qëllimshme e të dhënave të pavërteta, e mendimeve të formuara pa bazë reale me qëllim të zhvillimit të ndjenjës së fajit te bartësi i një veprimi të caktuar; shpifje që i bëhet një individi tjetër për qëllime të veçanta.

INSOMNI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *in* "jo" dhe *somnus* "gjumë". Shih – ***PAGJUMËSIA.***

INSPIRIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *inspirium* "frymëmarrje". Në psikologjinë geshtaltiste është fazë e posaçme e mendimit krijues që karakterizon grumbullimin e fuqisë intelektuale dhe të ndjenjave të nxitura nga një situatë e caktuar, objektin dhe dukurinë e posaçme dhe shpërthimin e vrullshëm dhe të papritur të mëtimit për kuptim të thelbit të një çështjeje të caktuar. Në fazën e inspirimit të procesit të mendimit krijues njeriu angazhohet në të kuptuarit e çështjes, të situatës problemore dhe për këtë shkak ai mbledh të dhëna e akte, është i motivuar për zgjidhjen e asaj situate problemore dhe ka gatishmëri psikike për t`iu qasur zgjidhjes së saj. Shih – ***FRYMËZIMI.***

INSTANC/Ë, - A. f. I ardhur në psikologji nga terminologjia juridike e latinishtes *instantia* "pushtet kompetent". Psikanaliza e ka shfrytëzuar termin instancë për të emërtuar strukturën e personalitetit: id, ego dhe superego, që kanë dinamikë, funksione

dhe mekanizma të veçantë në aparatin psikik të personalitetit.

INSTINKT, - I. m I ardhur nga latinishtja *instinguere* "nxitës". Instinktet janë veprime natyrore (të pamësuara) të qenieve të gjalla, e pikërisht nxitës të veprimeve të lindura të qenieve të një lloji të caktuar kafshësh. Veprime të tilla janë: ndërtimi i çerdhes së zogjve, veprimet solidare nga rreziku që u kërcënohet ujqërve, formimi i hojeve për vendosjen e mjaltit nga ana e bletëve etj. Në kuptimin etiologjik instinktet janë veprime të ndërlikuara dhe të koordinuara që lindin te të gjithë pjesëtarët e një lloji të caktuar kafshësh, në kushtet e posaçme të zhvillimit të tyre dhe paraqesin aktivitet të rëndësishëm jetësor me të cilin secili anëtar i një lloji të caktuar kafshësh dhe secili lloj i kafshëve i plotëson nevojat biologjike të tyre. Kuptimin biopsikologjikë të instinkteve e ka dhënë antropologu dhe psikologu anglez Uiliam MekDugal (William McDougal, 1871 – 1938), sipas të cilit: "Instinktet janë dispozita psikofizike të trashëguara ose të lindura që e shtyjnë organizmin që i zotëron ta dallojë dhe ta përqendrojë vëmendjen në gjësende të njëfarë lloji, të përjetojë shqetësim emocional të një cilësie të caktuar kur e dallon objektin e këtij lloji dhe të reagojë ndaj tij në mënyrë të veçantë ose së paku të ndjejë impuls për ndërmarrjen e një aktiviteti ndaj tij". Veçoritë kryesore të instinkteve janë: a) Karakteri universal i instinkteve në kuptimin e përkatësisë së atij instinkti të gjithë anëtarëve të një lloji të caktuar kafshësh; b) Karakteri trashëgues; c) Sistemi i ndërlikuar i veprimeve të një tërësie, që pothuajse nuk ndryshon gjatë përvojës individuale dhe ç) Karakteri i paraqitjes automatike dhe të pavullnetshme të instinkteve. Studiuesit Nikolas Tinbergen, (Nikolaas Tinbergen,1907 – 1988) dhe Konrad Lorenc (Konrad Lorenz, 1902 – 1977) kanë argumentuar se instinktet, ndonëse janë mekanizma veprimi të lindur, mund të modifikohen nën ndikimin e përvojës për t`i bërë veprimet e kafshëve më të përshtatshme në plotësimin e nevojave jetësore të tyre.

Burimet:

Charles Horton Cooley: "*Human Natyre and the Social Order*" – *("Natyra njerëzore dhe rregullimi shoqëror"),* New York: Schocken, 1964.
Charles Horton Cooley: "*Social Organization*" – ("*Organizimi shoqëror*") New York: Schocken, 1962.
William McDougall: "*An Introduction to Social Psychology*" – ("Hyrje në psikologjinë sociale") London: Methuen, 1908.
Konrad Lorenz: "*Studies in Animal and Human Behavior*" – ("*Studimi i sjelljeve të kafshëve dhe i njerëzve"*, London: Methuen, 1970.

INSTINKTIV, - E. mb. Që ka të bëjë me instinkt, që ka karakteristikat e instinkteve ose që i përket instinktit.

INSTINKTIVIZ/ËM, - MI. m. Doktrinë biopsikologjike e Uiliam MekDugalit (William Mcdougal, 1871 – 1938) ku instinktet përbëjnë bazën e aktivitetit të gjithëmbarshëm të kafshëve dhe të njerëzve. Madje, edhe sjelljet më të ndërlikuara të fituara nga përvoja e njeriut dhe me karakteristika të theksuara individuale burojnë nga energjia e instinkteve dhe gjejnë mbështetje në një numër të caktuar, përkatësisht në 12–16 instinkte. Ky numër instinktesh përbën prirjet e trashëguara të organizmit mbi të cilat zhvillohen dhe diferencohen nevojat, shtytësit e motivet e veprimtarisë.

INSTINKTOID, - I. m. Term i psikologjisë humaniste të Abraham Maslout (Abraham Maslow, 1908 – 1970) që emërton energjinë e fuqishme depërtuese të organizmit për plotësimin e nevojave elementare të jetës, siç është nevoja për të pasur siguri, për të dashur, për të qenë i nderuar etj. Instinktoidi i përngjet shumë energjisë instinktive, por për ndryshim nga instinktet kjo energji nuk është e lindur, nuk shfaqet automatikisht dhe karakterizohet me përmasën e vullnetit të njeriut. Disa nga motivet e fituara kanë energji të fuqishme, madje edhe më të fuqishme se instinktet. Nevoja për të bukurën, për drejtësi, për liri, për të ndershmen, për të vërtetën etj. janë nevoja të fituara pa kurrfarë mbështetjesh në trashëgimi dhe kanë energji depërtuese shumë më të fuqishme se instinktet. Nevojat e tilla i përkasin instinktoideve.

INSTITUCIONALIZ/IM, - MI. m. Procesi i përshtatjes apo adaptimit të një individi, të një klienti (kur është fjala për institute shëndetësore) ndaj jetës, parimeve dhe normave të aktivitetit institucional deri në atë masë sa bëhet i varur nga ai institucion dhe sjelljet e tij funksionojnë normalisht vetëm brenda jetës së atij institucioni, kurse jashtë atij institucioni individi që ka kaluar shumë kohë në të nuk e ndien veten mirë. Kohët e fundit po i kushtohet kujdes i veçantë mjekimit dhe shërimit të të sëmurëve psikikë në mjedise të përditshme të jetës së tyre.

INSTITUT, - I. m. I ardhur nga latinishtja *institution* "urdhëresë, ent". Instituti është organizatë kulturore, shëndetësore, shkencore etj. e themeluar në bazë të marrëveshjes së përbashkët të të interesuarve dhe me urdhëresë të organit më të lartë shoqëror-politik për një veprimtari të gjerë, ku veprimtaria, mënyra e sjelljes së individëve, pozita dhe roli i tyre është përcaktuar në mënyrë të normuar dhe aktiviteti i përbashkët çon në plotësimin e nevojave shoqërore të mjedisit ku vepron instituti. Institutet përbëjnë arkitekturën e zhvillimit të kulturës, të shëndetësisë, të shkencës etj. të një vendi. Dallohen disa lloje institutesh, si instituti edukativ, ekonomik, fetar, hulumtues, politik, ushtarak etj. Termi institut ka ardhur në psikologji nga terminologjia juridike dhe sociologjike.

INSTITUTI GALLUP. Institut për hulumtimin e mendimit ose të opinionit publik në Shtetet e Bashkuara të Amerikës i themeluar më 1935 nga statisticieni, sociologu dhe psikologu Xhorxh H. Gallup. Në institut hulumtohet mendimi ose opinioni publik i qytetarëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës lidhur me zhvillimin dhe organizimin e jetës shoqërore, politike dhe ekonomike. Ka të angazhuar specialistë nga fusha e matematikës, e statistikës, e psikologjisë sociale, e sociologjisë etj. Zbaton metoda dhe procedura bashkëkohore të hulumtimit të mendimit dhe të qëndrimeve të qytetarëve të këtij vendi për çështje me rëndësi të madhe për zhvillimin e jetës së lirë dhe organizimin e drejtë të zhvillimit politik, ekonomik e shoqëror në kushtet dhe raportet aktuale. Instituti Gallup përmendet si institut i rrallë i hulumtimeve objektive, i mbledhjes së shpejtë dhe i përpunimit të saktë të qëndrimeve të qytetarëve.

INSTITUTI PSIKOLOGJIK. Organizatë profesionale dhe shkencore që

merret me hulumtime dhe me studime psikologjike me qëllim zhvillimin e psikologjisë dhe përparimin e shkencës së psikologjisë ose të një disipline të veçantë të saj. Institute të tilla ka në shumë vende dhe nga më të njohurit përmenden: Instituti Shkencor-Hulumtues për Hulumtimin e Procesit të të Mësuarit të Njeriut i Universitetit të Kalifornisë në Berkli, Instituti Psikologjik në Bohum, Instituti për Psikologji Eksperimentale në Bratislavë etj.

INSTRUMENTAL, - E. mb. Që në psikologji përdoret më tepër për të përshkruar saktësisht motivimin dhe drejtimin e sjelljeve të një individi, të përqendruar në arritjen e tij në një objektiv të caktuar, me anë të një veprimi ose të një mjeti të posaçëm, që shërben si instrument i arritjes në qëllimin e caktuar.

INSTRUMENTI PSIKOLOGJIK. Term përmbledhës për të gjitha mjetet dhe metodat hulumtuese të strukturave, të funksioneve, të proceseve dhe të sjelljeve psikologjike të secilit individ duke filluar nga anketa dhe duke arritur deri në përdorim dhe zbatim të testeve psikologjike. Termi instrument psikologjik përdoret për të emërtuar zbatimin e drejtë të mjeteve adekuate psikologjike në laboratorin psikologjik.

INSUFICIENCA MENDORE. Term që posa ka filluar të përdoret edhe në gjuhën shqipe duke zëvendësuar termin prapambetja mendore. Shih – ***PRAPAMBETJA MENDORE.***

INSULA RAJL. Pjesë e cipës së trurit të madh në anatominë e sistemit nervor, e tërhequr thellë nën brazdën e Selvisë. Konsiderohet se pjesët e saj marrin pjesë në funksionimin e qendrave motorike të trurit. Insula Rajl njihet edhe si ujdhesa Rajl. Ka marrë emrin e mjekut gjerman Johan K. Rajl (Johann Ch. Reil, 1759 – 1813).

INSULIN/Ë, - A. f. Hormon i prodhuar nga qelizat e pjesës së pankreasit që përbëhet nga të ashtuquajturat "ujdhesa" Langerhans. Ndikon në proceset metabolike të organizmit, konkretisht në proceset metabolike të glukozës. Sasia e vogël e prodhuar nga qelizat e "ujdhesave" Langerhans shkakton çrregullime metabolike që manifestohen në çrregullimin metabolik të karbohidrateve dhe në sjellje të veçanta mbrojtëse të atij që vuan nga çrregullimet metabolike.

INTEGRIMI I NEVOJAVE. Procesi i koordinimit dhe i bashkimit të sjelljeve karakteristike dhe dinamike, analiza e të cilave çon në identifikimin e nevojave, për plotësimin e të cilave individi organizon sjellje të veçanta. Termi i përket psikologjisë së Marit.

INTEGRITET, - I. m. I ardhur nga latinishtja *integritas* "tërësi" që haset në disa disiplina, si në biologji, etikë, në psikologji, në sociologji etj. dhe ka kuptimin e tërësisë së harmonizuar organike, fiziologjike, psikologjike, shoqërore etj., të tërësisë së paprekur, të padëmtuar. Në psikologji termi integritet përdoret më tepër në psikologjinë e personalitetit, ku theksohet integriteti i personalitetit si koncept themelor i psikologjisë së personalitetit.

INTEGRITETI I PERSONALITETIT. Lidhshmëria dhe organizimi harmonik i tipareve, aftësive, interesave, motiveve, qëndrimeve, vlerave dhe i shprehive në një tërësi të organizuar, funksionale dhe të qëndrueshme. In-

tegriteti i personalitetit sipas kuptimit të mësipërm mundëson funksionimin normal psikofiziologjik, duke pasur sa më pak konflikte të brendshme.

INTELEKT, - I. m. I ardhur nga latinishtja *intellektus* "mendje, kuptimësi". Term përmbledhës që emërton të gjitha proceset njohëse a kognitive, përkatësisht proceset e mendjes që mundësojnë njohjen racionale, njohjen e nivelit më të lartë të realitetit, i cili i tejkalon caqet e njohjes shqisore të këtij realiteti. Këtë kuptim e ka pasur që në fillim të zhvillimit të psikologjisë së mendimit. Sot në literaturën e psikologjisë bëhet fjalë më tepër për aftësitë intelektuale, me anën e të cilave njeriu koncepton, gjykon dhe nxjerr përfundim.

INTELEKTUAL, – E. f. Që cilëson funksionet e intelektit, sjelljet intelektuale, punën intelektuale të atij individi, i cili angazhohet në ato fusha ku kërkohet arsyeja, mendja dhe mendimi dhe roli i mendjes në frenimin e energjisë së shtytësve, të impulsive emocionale, të intuitës etj.

INTELEKTUALIZ/ËM, - MI. m. Intelektualizmi është doktrinë psikologjike, sipas së cilës të gjitha çështjet duhen vështruar e zgjidhur në bazë të shqyrtimit mendor të argumenteve dhe të lidhjeve kryesore ndërmjet tyre. Mbi këtë bazë duhet vepruar në vështrimin dhe zgjidhjen e çështjeve të artit, të etikës, të filozofisë, të politikës, të shkencës etj. Një qasje e tillë parimore përjashton pjesëmarrjen e gjendjes emocionale, të dëshirave, të interesave, të faktorëve irracionalë etj. të njeriut në sjelljet e mirëfillta intelektuale të tij.

INTELEKTUALIZIM, - I. m. Mekanizëm mbrojtës që ka të bëjë me angazhimin dhe përqendrimin e një individi në shqyrtimin, në "rrahjen" intelektuale të një çështjeje, gjendjeje, të një situate, duke injoruar dëshirat, interesat, qëndrimet etj. të individëve, përkatësisht të karakterit subjektiv. Intelektualizimi si mekanizëm mbrojtës është identifikuar nga ana e Ana Frojd (Anna Freud, 1895 – 1982). Shfaqet sidomos në vështrimin dhe shqyrtimin e çështjeve të përgjithshme dhe abstrakte, si është çështja e lirisë njerëzore, e drejtësisë, e vullnetit të lirë etj.

INTELIGJENC/E, - A. f. I ardhur nga latinishtja *intellegere* "njoh realitetin me anë të intelektit, kuptoj". Term i konceptit më të rëndësishëm për njohjen e konstruktit dhe të funksioneve të proceseve të mendjes. Dallojmë tri lloje përkufizimesh të inteligjencës: përkufizimet biologjike, psikologjike dhe operacionale. Përkufizimet biologjike kanë të bëjnë me aftësinë e organizmit për t'iu përshtatur nevojave të organizmit dhe kushteve e raporteve ekonomike, sociale, kulturore, etj. Sipas përkufizimeve operacionale inteligjenca është ajo që masin testet e inteligjencës. Në psikologji dallohet ky përkufizim i inteligjencës: aftësi e të kuptuarit të marrëdhënieve thelbësore ndërmjet koncepteve të një situate problemore të caktuar dhe e gjetjes së reagimeve të reja që i përshtaten situatës së re, përkatësisht aftësi e përgjithshme për zgjidhjen e situatave problemore që kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me shfrytëzimin e përvojës dhe me kompensimin e mungesës së saj me anë të mendimit abstrakt. Sipas

David Uekslerit inteligjenca është aftësia e të kuptuarit të botës dhe e përmendimit të sjelljeve adekuate kur ballafaqohemi me nxitësit e saj".

Inteligjenca konsiderohet tipar i personalitetit dhe një ndër faktorët e rëndësishëm të zhvillimit të tij. Zhvillimi i saj është rezultat i faktorëve të lindur bioenergjetik dhe i aktivitetit të njeriut në kushtet dhe raporteve ekonomike, shoqërore, kulturore, etj. të familjes dhe të mjedisit më të gjerë të individit. Inteligjenca arrin shkallën më të lartë të zhvillimit rreth moshës 18 vjeçare. Shih **Zhvillimi i inteligjencës**.

Burimet:

Charles Spearman: *"General Intelligence – Objectively determined and measured"* – (*"Inteligjenca e përgjithshme – Përcaktimi objektiv dhe matja"*). American Journal of Psychology, 15: 201 – 293, 1904.

Alfred Binet: *"Les idées modernes sur les enfants"* – (*"Idetë moderne të fëmijëve"*), Paris, 1909.

Francis Galton: *"Genie und Vorerbung"* – (*"Gjeniu dhe origjina"*). Leipzig: Klinkhardt. 1910.

Alfred Binet, Théodore Simon: "*A method of Measuring the Development of the Intelligence of Joyng Children"* – (*"Metoda e matjes së inteligjencës së fëmijëve të vegjël"*), Courier Company, 1913.

William Stern: *"Die Intelligenz der Kinder und Jugentlichen und die Methoden ihrer Unterzuchung"* – (*"Inteligjenca e fëmijëve dhe e të rinjve dhe metoda e gjurmimit të saj"*), Leipzig: Barth, 1920.

Lewis M. Terman and Maud A. Merill: *"Measuring Intelligence: A Guide to the Administration of the New Revised Stanford – Bimet Tests of Intelligence"* – (*"Matja e inteligjencës: udhërrëfyes për administrimin e rishikimit të testit Stanford – Bine të inteligjencës"*), Houghton Mifflin, 1937.

Louis L. Therstone, Thelma G. Thurstone: *"Factorial studies of intelligence"* – (*"Studimi faktorial i inteligjencës"*), Chicago: The University of Chicago Press, 1941.

Jean Piaget: *"La psychologie de L`Intelligence"* – (*"Psikologjia e inteligjencës"*), Librarie Armand Colin, Paris, 1961.

David Wechsler: *"Die Messung der Intelligenz Erwachsener"* – (*"Matja e inteligjencës së të rriturve"*), Bern: Huber, 1964.

Joy P. Guilford: *"The nature of human intelligence"* – (*"Natyra e inteligjencës njerëzore"*), New York: Macgraw Hill, 1967.

Raymond B. Cattell: *"Abilities – their structure, growth, and action"* – (*"Aftësitë – struktura, rritja dhe veprimi"*), Boston: Houghton Mifflin, 1971.

Haward Gardner: *"Dimensionet e mendjes – Teoria e llojeve të ndryshme të inteligjencës"*, Instituti i Studimeve Pedagogjike, Tiranë, 2003.

INTELIGJENCA ABSTRAKTE. Aftësia e të kuptuarit të raporteve të ndara nga tërësia, e raporteve abstrakte dhe të raporteve ndërmjet simboleve që zëvendësojnë objektin e dukurinë dhe në vend të tyre përdoren simbolet, që kanë të bëjnë me zgjidhje të një problemi, situate problemore etj. P.sh., A = D, kurse C # A dhe B. Çfarë është raporti ndërmjet D dhe C? Inteligjenca abstrakte i përngjet tipit të inteligjencës fluide.

INTELIGJENCA ARTIFICIALE. Kopje kompjuterike e funksionimit të inteligjencës së njeriut. Në kuptimin e ngushtë inteligjenca artificiale është instrument elektromekanik dhe elektrokimik që ka cilësinë e kryerjes së atyre operacioneve mendore që janë të ngjashme me ato që i kryen mendja e njeriut dhe që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me aftësinë e të mësuarit, të të menduarit dhe të marrjes së vendimeve.

INTELIGJENCA EMOCIONALE. Aftësia e njeriut që ka të bëjë me njohjen e emocioneve vetjake, me kontrollimin e impulsive emocionale,

me shfrytëzimin e emocioneve për të motivuar veten, me njohjen e emocioneve të njerëzve të tjerë dhe me shkathtësinë rregulluese të marrëdhënieve ndërmjet komunikuesve. Por, mbetet i panjohur fakti se nëse është fjala për strukturë unike të inteligjencës emocionale apo për disa aftësi të veçanta. Termi inteligjencë emocionale njihet shumë herët. Sipas përmbajtjes së tekstit "Etika e Nikomanit" e hasim te Aristoteli (384 – 322 p.e.r.). Por, vetëm pas mbarimit të gjysmës së parë të shekullit të njëzet është bërë term i psikologjisë nga ana e psikologut amerikan Peter Salovej (Petere Salovey, 1958), Xhon Majer (John Mayer, 1953) dhe Daniel Goleman.

INTELIGJENCA KONKRETE. Lloj inteligjence jofjalësore ose joverbale, e cila ka të bëjë me aftësinë e njeriut për të manipuluar me objekte konkrete gjatë zgjidhjes së problemeve dhe të situatave problemore, si edhe me aftësinë e perceptimit të hapësirës dhe të përmasave të saj. Inteligjenca konkrete manifestohet me përdorimin në kohë dhe në relacione të drejta midis pjesëve përbërëse të një tërësie, kur kërkohet që pjesët e shpërndara të kësaj tërësie të lidhen njëra me tjetrën për një kohë sa më të shkurtër. Kjo formë e inteligjencës dallohet edhe te disa antropoidë.

INTELIGJENCA SHOQËRORE. Aftësi e supozuar e të kuptuarit të njeriut, të sjelljeve shoqërore të tij dhe e zgjidhjes së situatave problemore të raporteve ndërmjet anëtarëve të një mjedisi shoqëror. Prania e këtij tipi të inteligjencës vlerësohet në bazë të kuptimit të situatës problemore shoqërore dhe lehtësisë e shpejtësisë së zgjidhjes së kësaj situate. Për këtë qëllim përdoren teste të veçanta. Këto teste ndryshojnë për nga përmbajtja e tyre dhe mënyra e parashtrimit të detyrave dhe problemave nga testet e inteligjencës abstrakte dhe nga ata të inteligjencës konkrete, si edhe të matjes dhe vlerësimit të inteligjencës emocionale, megjithëse me këta të fundit kanë disa përngjasime. Inteligjenca shoqërore u përmend nga psikologu me origjinë angleze Edvard L. Torndajk (Edward L. Thorndike, 1874 – 1949). U përpunua nga Houard Gardneri (Howard Gardner, 1943 –) dhe studiuesit e tjerë, që identifikuan edhe strukturën e ndërlikuar, ku marrin pjesë aftësia e njohjes së emocioneve të tjetrit, e depërtimit në motivet e sjelljes shoqërore, e vetëkontrollit të sjelljeve dhe të afekteve, e vendosjes me lehtësi të marrëdhënieve me të tjerët, e tolerancës dhe e përshtatjes shoqërore të individit etj.

INTENC/Ë, - A. f. I ardhur nga latinishtja *intentio,* që shpreh besimin dhe dëshirën e një individi të drejtuar në një objektiv të caktuar, zotërimin e të cilit individi e konsideron fund të synimit të tij. Intenca në psikologjinë e akteve është konsideruar veti e të gjithë proceseve psikike të vetëdijshme. Në psikanalizën e Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1836 – 1939), që është mbështetur në filozofinë dhe dijet teorike të Franc Brentanos, intenca konsiderohet se mund të jetë e pavetëdijshme.

INTENCIONALITET, - I. m. Term që haset më tepër në psikologjinë e akteve të filozofit dhe teologut gjerman Franc Brentano (Franz Brentano,

1838 – 1917) dhe që emërton gjendjen mendore të njeriut të drejtuar gjithmonë në objektin e botës së jashtme të tij. Me gjendje mendore të diferencuar dhe të qartë emërton besimin, dëshirën, qëllimin e synimin e një individi të drejtuar në një dukuri, objekt, proces etj. Kështu, kur njeriu bie në dashuri, kur ai hidhërohet, zemërohet etj. dashurinë e tij e drejton në një individ të caktuar, hidhërohet dhe zemërohet ndaj një individi të veçantë etj.

INTENSITET, - I. m. I ardhur nga latinishtja *intensitas* "forcë" që ka hyrë në terminologjinë e psikologjisë nga fizika dhe emërton sasinë matëse të energjisë së një dukurie fizike, të një lëvizjeje, të një trupi etj. (Intensiteti i dritës i matur me qirinj, i temperaturës së matur me gradë Celsius etj., i zërit i matur me Herc etj.). Termi intensitet u përdor në fillim në psikofizikë duke emërtuar raportin ndërmjet sasisë së energjisë fizike të një ngacmuesi të një shqise të caktuar dhe të vlerësimit subjektiv të ndijimit, të shkaktuar nga intensiteti i atij ngacmuesi. Intensiteti i ndijimit të këtillë mund të shprehet në shkallën vlerësuese. Hasen këto lloj intensitetesh:

a. **Intensiteti i emocioneve** – Veçori emocionesh të cilën e përbën shkalla e thellësisë së përjetimit të një emocioni nga ana e një individi;
b. **Intensiteti i motiveve** – Forca me të cilën një motiv i caktuar ushtron ndikim në veprimtarinë e një individi;
c. **Intensiteti i ndijimeve** – Veçori e ndijimit, të cilën e përbën përjetimi subjektiv i forcës së një ngacmuesi nga ana e një individi të caktuar;
d. **Intensiteti i ngacmuesit** – Forca e ngacmuesit fizik që në kushte të posaçme shkakton ndijim te një individ;
e. **Intensiteti i qëndrimeve** – Forca e një qëndrimi që mund të përcaktohet me shkallën matëse të intensitetit të qëndrimeve etj.

INTERAKCION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *inter* "ndërmjet" dhe *agere* "me veprue". Ekuivalenti i tij në shqip është ndërveprim dhe nënkupton efektin ose ndikimin reciprok ndërmjet dy a më shumë dukurive, individëve, trupave etj. Ndërveprues mund të jetë raporti ndërmjet organizmit, mjedisit fizik dhe shoqëror.

INTERAKCIONI SHOQËROR. Ndërveprimi reciprok ndërmjet dëshirave, emocioneve, qëndrimeve, sjelljeve etj. të anëtarëve të një grupi shoqëror. Në grupin shoqëror secili anëtar i dallon propozimet, qëndrimet, sjelljet e tjetrit dhe reagon ndaj tyre. Mbi bazën e interakcionit të anëtarëve të një grupi shoqëror zhvillohet dinamika e grupit.

INTERES, - I. m. I ardhur nga latinishtja *intresse* "marr pjesë". Qëndrim pozitiv i një individi ndaj një dukurie, përmbajtjeje librore, objekti etj., i cili rrjedh nga rëndësia e tij për atë dukuri, përmbajtje, objekt etj., nga përjetimi i ndjenjave pozitive, nga drejtimi e përqendrimi i vëmendjes, si edhe nga organizimi i sjelljeve pozitive ndaj objektit të interesit. Interesi manifestohet në një drejtim relativisht të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të veprimtarisë së njeriut ndaj objektit të interesit. Identifikimi i interesave realizohet me pyetësorin Strong të interesave profesionale, me pyetësorin Kuder të inte-

resave profesionale dhe me testin Irle të interesave profesionale.

INTERESIM, - I. m. Angazhim i qëndrueshëm dhe afatgjatë i proceseve konjitive dhe i sjelljeve të njeriut ndaj një fushëveprimi të caktuar. Angazhimi i këtillë formohet nga një ndjeshmëri e shtuar, nga drejtimi e përqendrimi i përhershëm i individit ndaj objektit të interesimit të tij. Në psikanalizë interesimi shpjegohet si kundërshtim i energjisë së një shtytësi nga ana e egos të një individi, duke larguar vëmendjen dhe sjelljet e tij nga objekti i shtytësit, përndryshe i ndaluar për t'u pushtuar nga energjia e atij shtytësi më tepër për shkaqe etike. Falë sublimimit të kësaj energjie, energjia e shtytësit të këtillë, p.sh. e epshit seksual, shndërrohet në energji të angazhuar në art, në politikë, në shkencë etj. Në këtë kuptim interesimi luan rol të rëndësishëm në procesin e të mësuarit dhe në drejtimin e organizimin e duhur të tij.

INTERESIMI PROFESIONAL. Interesim që lidhet më tepër me formularin për vlerësimin e interesave të të rinjve për zgjedhjen e një profesioni të suksesshëm. Një formular i tillë lidhet me emrin e psikologut amerikan Eduard K. Strong (Edward K. Strong, 1884 – 1963). Ky formular mbështetet në identifikimin e interesave të kandidatëve për të pasur sukses në punën profesionale. Shih – ***INVENTARI I INTERESIMEVE STRONG – KEMBEL.***

INTERFERENC/Ë, - A. f. I ardhur nga latinishtja *inter* "ndërmjet" dhe *fero* "bart" dhe i përdorur fillimisht në fizikë; më pas zuri vend shpejt në terminologjinë e psikologjisë, sidomos të psikologjisë së të mësuarit dhe të psikologjisë së kujtesës. Në kuptimin e përgjithshëm interferenca ka të bëjë me ndikimin reciprok pengues të zhvillimit të një procesi nga një proces tjetër. Kuptimi i këtillë i përket pengesës që i bën një motiv një motivi tjetër, në një proces tjetër, një sjellje e ushtruar mirë pengon formimin e një sjelljeje tjetër, sidomos kur këto dy procese shkaktohen nga një ngacmues i njëjtë.

INTERFERENCA E RIPRODHIMIT. Kufizimi i riprodhimit të lëndës së mësuar dikur, pengesa e riprodhimit të asaj që është mësuar dikur, për shkak të lëndës tjetër të mësuar ose të veprimtarisë së bërë në pauzën ndërmjet ndërprerjes së të mësuarit të saj dhe të riprodhimit të mëvonshëm.

INTERFERENCA E SHPREHIVE. Pengesë e shkaktuar nga shprehia e formuar gjatë të mësuarit të shprehisë së re dhe nga ndikimi negativ i procesit të ushtrimeve për të mësuar shprehinë e re në procesin e realizimit të shprehisë së vjetër. Kështu, shprehia e formuar gjatë kërcimit së larti pengohet në realizimin e saj nga të ushtruarit e kërcimit në largësi, shprehia gjatë drejtimit të automobilit e përdorimit të ndërruesit të shpejtësisë që është i vendosur në dysheme pengon formimin e shprehisë së re sidomos në fillim të përdorimit të automobilit të ri i cili ndërruesin e shpejtësisë e ka të vendosur në timonin e automobilit etj. Pengesa të tilla shkaktohen ngaqë ndaj ngacmuesve të njëjtë duhet reaguar me lëvizje të ndryshme.

INTERFERENCA E TË MËSUARIT. Pengesë e ndërsjellë ndërmjet

përmbajtjeve që mësohen njëra pas tjetrës, nga e cila rrjedh dobësimi i të mbajturit në mend dhe i riprodhimit të tyre. Të mësuarit e anglishtes bashkë me të mësuarit e frëngjishtes mund të shkaktojë pengesa në mbajtjen në mend dhe në riprodhimin e drejtë të vokaleve të njërës dhe të tjetrës gjuhë. Shih - ***INHIBICIONI.***

INTERIORIZIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *interior* "i brendshëm". Proces i përbrendësimit të operacioneve dhe të raporteve të jashtme shoqërore në strukturën mendore të njeriut. I këtillë është procesi i përvetësimit të gjuhës amtare. Ky proces luan rol të rëndësishëm në socializimin e fëmijës. Me anë të këtij procesi fëmija i përvetëson përfytyrimet shoqërore, përkatësisht sjelljet shoqërore të familjes dhe të mjedisit ku ai zhvillohet. Mbi bazën e përvetësimit të përvojës kulturore-historike të mjedisit zhvillohen edhe format e larta të zhvillimit psikik të individit dhe bëhen mjet veprimi brenda individit. I këtij mendimi ka qenë Lev S. Vigotski (Lev S. Vygotsky, (!896 – 1934). Kuptime të ngjashme ky term ka edhe në psikologjinë e zhvillimit konjitiv të Zhan Pijazhes (Jean Piaget, 1896 – 1980). Sipas tij operacionet e jashtme të veprimtarisë së fëmijës shndërrohen në operacione mendore adekuate.

INTERKORRELACION, - I. m. Shkalla e raportit ndërlidhës ndërmjet rezultateve të matjes së një ndryshoreje psikologjike dhe rezultateve të një ndryshoreje tjetër. Interkorrelacioni përdoret më tepër për të njohur ndërlidhjen ndërmjet një ndryshoreje dhe disa ndryshoreve më të vogla të matricës së korrelacionit. Këtë kuptim ka llogaritja e koeficientit të korrelacionit ndërmjet arritjeve të nxënësve të klasës së tetë të një shkolle në zotërimin e anglishtes dhe nxënësve të së njëjtës klasë të një shkolle tjetër po në lëndën e anglishtes.

INTERNALIZIM, - I. m. Procesi i bartjes së bindjeve, të normave, të parimeve, të qëndrimeve, të standardeve të sjelljeve pozitive, të vlerave etj. në strukturën psikike të brendshme të njeriut dhe trajtimi i tyre si përmbajtje funksionale e vetë individit. Me përvetësimin e bindjeve, të normave të sjelljes së mirë, të parimeve morale, të vlerave shoqërore etj., përkatësisht me shtresimin e brendshëm të përmbajtjes së tyre sjellja e individit sipas përmbajtjeve psikike të brendshme paraqitet spontanisht, sepse pushon nevoja e shpërblimit ose e dënimit nga të tjerët. Rolin e kontrollit të sjelljeve të tyre tashmë e merr struktura psikike e brendshme e individit. Sipas psikanalizës përmbajtja e superegos zhvillohet dhe formohet në bazë të procesit së internalizimit.

INTERNEURON, - I. m. Neuron i Sistemit Nervor Qendror që gjendet ndërmjet qelizave nervore. Zakonisht interneuronet gjenden ndërmjet qelizave nervore (neuroneve) aferente dhe qelizave nervore ose neuroneve eferente. Interneuronet kryejnë funksionin e bartjes së impulsive nervore prej një nueroni në neuronin tjetër, përkatësisht prej neuronit sensorik në neuronin motorik.

INTERORECEPTOR/Ë, - T .m. Receptorë të brendshëm që gjenden në organet tretëse, të frymëmarrjes,

të enëve të gjakut etj. Ngacmues të receptorëve të brendshëm janë ndryshimet e organeve dhe të funksioneve të tyre. Ngacmues të tillë të këtyre receptorëve mund të jenë: ndryshimi i vëllimit të organeve viscerale, ndryshimet në përqendrimin e elektroliteve, ndryshimet në qarkullimin e gjakut dhe të tensionit të tij etj. Këta ngacmues nuk shkaktojnë gjithmonë ndijime, por shpesh ngacmojnë sistemin nervor autonom dhe pasojë e këtij ngacmimi janë reagimet refleksive të njeriut. Ky term u mor nga fiziologjia dhe u përdor nga fiziologu anglez Çarls S. Sherington (Charles S. Sherrington, 1857 – 1952). Në disa fjalorë të tjerë në vend të termit interoreceptor përdoret termi enteroreceptor.

INTERPOLIMI I TË DHËNAVE. Procedurë statistikore, sipas së cilës në bazë të të dhënave të njohura vlerësohet vlera e të dhënave që gjenden ndërmjet tyre. Kështu, nëse në testin e arritjeve në zotërimin e gjuhës angleze nga ana e nxënësve të klasës së shtatë është arritur të fitohen 38 pikë, kurse në fillim të klasës së tetë janë fituar 58 pikë, atëherë besohet se për çdo muaj ata fitojnë nga 2 pikë, sepse viti shkollor zgjat dhjetë muaj dhe, duke zbritur 58 – 38 që bëjnë 20 dhe duke pjesëtuar me dhjetë përftohet vlera prej dy pikësh. Prandaj përparimi për çdo muaj është dy pikë.

INTERPRETIMI. Shih – ***SHPJEGIMI.***

INTERVAL, - I. m. I ardhur nga latinishtja *intervallum* "largësi, ndërkohë". Me interval emërtohet largësia ndërmjet dy pikave, dy çasteve kohore, që e ndan atë në pjesë të barabarta; largësia ndërmjet fillimit të një dukurie, procesi etj. dhe fillimit të një dukurie, procesi etj. tjetër, përkatësisht ndërmjet mbarimit të një dukurie e fillimit të një dukurie tjetër. Termi interval në statistikën e psikologjisë ka kuptim të veçantë, që përcaktohet me togfjalësha terminologjikë, si:

a. **Intervali i klasës –** Largësi e njëjtë minimale e maksimale ndërmjet fillimit e mbarimit të një klase të të dhënave, fillimit e mbarimit të klasës së dytë, fillimit e mbarimit të klasës së tretë etj. brenda të cilave i vendosim të dhënat e përftuara nga matja e një dukurie, funksioni, procesi psikik etj.
b. **Intervali i mesores –** Klasë e të dhënave sasiore psikologjike të grupuara sipas vlerës së mesores aritmetike ose medianës;
c. **Intervali i modit –** Klasa e të dhënave që përcaktohet sipas vlerave sasiore që përsëriten më shpesh;
d. **Intervali i pasigurisë** – term i psikofizikës. Intervali i pasigurisë është dallimi ndërmjet pragut më të lartë dhe pragut më të ulët të ndijimeve, ku gjysma e këtij dallimi merret si vlerë e pragut diferencial. Pragu i pasigurisë përcaktohet duke saktësuar pikën maksimale të ndijimit të një ngacmuesi nga ana e një subjekti provues që e percepton atë pikë mbi standardin e njohur dhe intensitetin e sapo hetuar nën standardin e njohur.

INTERVENIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *intervenire* "ndërmjetësoj", që zbatohet në mjekësi, në pedagogji, në psikoterapi etj. Termi intervenim ka kuptimin e zbatimit të një faktori për të ndërprerë një proces negativ të caktuar. Në psikoterapi ndërpritet një formë dëmtuese e sjelljes, duke e zëvendësuar me një formë tjetër të

një sjelljeje pozitive. Në psikologjinë pedagogjike nxënësi udhëhiqet ta ndërpresë formën e të mësuarit, duke ndërhyrë me zbatimin e formës më të përshtatshme për të zotëruar përmbajtjen e një lënde mësimore etj.

INTERVIST/Ë, - A. f. I ardhur nga anglishtja *interview* "bashkëbisedim". Term i qëndrueshëm në gazetari, në kriminologji, në metodologjinë e psikologjisë etj. Në psikologji intervista është ndër procedurat klasike të grumbullimit të të dhënave për hulumtimin e personalitetit me qëllim të diagnostikimit, të këshillimit, të ndërmarrjes psiko-terapeutike etj. Intervista bëhet duke parashtruar pyetje gojarisht nga ana e gjurmuesit (intervistuesi) të një çështjeje të caktuar dhe duke marrë përgjigje nga subjekti (i intervistuari). Mbi këtë bazë intervista përkufizohet si "Ndërveprim shoqëror, rezultat i të cilit është kalimi i informatave nga i intervistuari te intervistuesi". Intervista ka rrjedhë dhe faza të caktuara zhvillimi. Intervista është e formësuar (e strukturuar) dhe e paformësuar (e pastrukturuar).

a. **Intervista e formësuar** – Intervistë e përgatitur paraprakisht mirë, që përbëhet nga pyetjet e formuluara saktësisht dhe të renditura me përpikëri që u parashtrohen subjekteve me sistem të pandryshuar. Të dhënat e përftuara dhe të grumbulluara në këtë formë të intervistës përpunohen më lehtë;

b. **Intervista e paformësuar** – Procedurë e bashkëbisedimit ndërmjet intervistuesit dhe të intervistuarit që përbëhet nga pyetjet dhe përgjigjet e lira për temën që gjurmohet. Në këtë formë të intervistimit pyetjet shpesh dalin nga bashkëbisedimi ndërmjet intervistuesit dhe të intervistuarit.

Të dhënat e përftuara dhe të grumbulluara kanë vlerë studimore e praktike, po qe se zgjojnë interesim te të intervistuarit, janë të sinqerta, sidomos kur këta kanë aftësi verbale të zhvilluar. Intervista ka kryesisht karakter individual. Por, në raste specifike mund të organizohet intervista grupore.

INTERVISTA GRUPORE. Formë e intervistës që organizohet dhe zhvillohet njëkohësisht me dy ose më shumë individë me qëllim të vëzhgimit sa më të gjithanshëm të një çështjeje të caktuar.

INTERVISTA STRES. Formë e testit të stresit që karakterizon ekspozimin e njeriut ndaj kushteve stresante (stresi emocional) dhe vëzhgimi i kontrolluar i përjetimeve, i sjelljeve dhe i aftësisë së të intervistuarit për t`iu përshtatur situatës së krijuar, si edhe i ndryshimeve fiziologjike të organizmit (ndryshimet kardiovaskulare etj.).

INTERVISTA TERAPEUTIKE. Intervistë e organizuar me qëllim që gjatë shtrimit të pyetjeve dhe marrjes së përgjigjeve klienti të ndërgjegjësohet për ta njohur sa më mirë veten dhe problemet psikike të tij. Niset nga përcaktimi se rrjedha e drejtë dhe logjike e mendimeve dhe e shprehjeve të lira të tyre është baza e personalitetit të shëndoshë. Çrregullimi i mënyrës së shprehjes, i mbajtjes së trupit, i rendit e i rrjedhës së mendimeve dhe i sjelljeve kërkon ndërhyrjen e psikoterapeutit, duke bërë që klienti të çlirohet nga frika, nga mosbesimi dhe tensioni psikik dhe fizik. Në këtë mënyrë ai arrin ta kuptojë më mirë veten dhe sjelljet e motivet, si edhe ngarkesat e veta,

bëhet i vetëdijshëm për to dhe kështu, çlirohet nga këto ngarkesa.

Burimet:

Albert Bandura: *"Self efficacy: Towards a unifying theory of behavioral change"* – (*"Efikasiteti vetjak: Drejt një teorie të unifikuar të ndryshimeve bihejviorale"*), Psychological review, 1977, 84. fq. 191 – 215.

S. Bloch*: "Wat is psychotherapy?"* – (*"Çfarë është psikoterapia"*), Oxford, 1982.

S. Bloch*: "An introduction to the psychotherapies"* – (*"Hyrje në psikoterapi"*), Oxford, 1979.

Sigmund Freud*: "Hyrje në psikanalizë",* Tiranë, 2004.

Slavoljub Radonjic: *"Terapeutski principi i metode bihejvioralne terapije"* – (*"Parimet e metodat terapeutike të terapisë bihejviorale"*), Bihejvior psikoterapija, Avalske sveske, 1/78.

INTIM, - E. mb. I ardhur nga latinishtja *intimus* "i brendshëm". Termi cilëson dëshirën, emocionin, motivin etj. të brendshëm të një individi, që ka karakter privat dhe mund të afrojë rreth vetes një shok të ngushtë, të cilit ia beson shfaqjen e brendësisë intime të tij. Disa nga sjelljet e njeriut mund të kenë karakter intim. Të tilla janë sjelljet reciproke të zgjatjeve të duarve me njëri-tjetrin, përqafimi me tjetrin etj.

INTIMITET, - I. m. Afërsia, sinqeriteti i njeriut ndaj të tjerëve duke shkaktuar mirëkuptim, besim, ngrohtësi dhe kënaqësi të posaçme ndërmjet anëtarëve të një grupi formal ose joformal me pak anëtarë. Intimiteti në psikologjinë geshtaltiste është parim i ndërlidhjes së elementeve të një tërësie që shkakton ndërvarësi të atyre elementeve dhe perceptim të drejtë të asaj tërësie. Parimi i tillë dallohet sidomos në ato raste kur largimi i një elementi shkakton humbjen e karakterit të asaj tërësie. Në psikologjinë e Homburger E. Eriksonit (Homburger E. Erikson, 1902 – 1994) intimiteti është faza e gjashtë e zhvillimit psikosocial që karakterizohet nga orvatja e subjektit për të formuar lidhje intime të qëndrueshme ndërmjet shokëve e shoqeve.

INTRACEPSION, - I. m. Term i konceptit të psikologjisë së Henri S. Marrej (Henry S. Murray, 1893 – 1988) që emërton konceptin e tiparit të atyre individëve për të cilët jeta e tyre (pikëpamjet, qëndrimet, vlerat etj.) është e kthyer kah bota subjektive e tyre. Këta e kanë të zhvilluar imagjinatën dhe e gjithë veprimtaria e tyre motivohet nga bota e brendshme e tyre.

INTRACEPTIVITET, - I. m. Tipar i personalitetit të atyre njerëzve, të cilët kanë prirje t`i përkushtohen më së tepërmi vetes së tyre, përkatësisht gjendjes subjektive, sidomos ndryshimit të saj. Për këta individë bota subjektive e tyre ka vlera dhe rëndësi të jashtëzakonshme. Kjo prirje është e rrallë dhe tregon për aftësitë e këtyre individëve për të kuptuar botën e tyre psikike. Disa nga profesionalistët në psikologji, psikiatri, shkrimtarët e romaneve etj. dallohen nga të tjerët nga prirja intraceptive e tyre. Ndërkaq, disa të tjerë, sidomos ata me karakter autoritar, e kanë të zhvilluar pak ose aspak këtë prirje.

INTRAFUZAL, - E. mb. Në anatominë e fiziologjisë muskulore emërtohen fijezat muskulore që janë pjesë përbërëse e muskujve. Fijezat intrafuzale kryejnë funksionin e receptorëve të shtrirjes së muskujve dhe rregullojnë proceset motorike të organizmit.

INTRAPSIKIK, - E. mb. Që ka të bëjë me botën psikike të brendshme, që konsiderohet se qëndron në mendjen

e njeriut ose që rrjedh nga mendja e tij. Me karakter të tillë mund të jenë konfliktet ndërmjet dëshirave, interesave, motiveve, nevojave, qëndrimeve etj.

INTRIGIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *intrigare* "ngatërroj". Intrigimi është qëndrimi aktiv i individëve, të cilët mbështesin veprimin e të shtyrit të fshehtë të të tjerëve në marrëdhënie ngatërresore e dinakërike ndërmjet tyre, duke i soditur me kënaqësi raportet e tilla. Pasojat e këtij qëndrimi intrigues mund të jenë të vrazhda dhe të rënda, madje edhe të paparashikueshme, por gjithmonë negative nga këndvështrimi etik. Në artin filmik dhe në atë letrar "intriga" dhe "intrigimi" shpesh janë lajtmotiv i përmbajtjes së tyre (filmi "Hamleti" i realizuar më 1996", romani "Tre moskëtjerët" i Aleksandër Dumas, "Darka e gabuar" e Ismail Kadaresë). Intrigim ka edhe kuptimin me ngjall interes, kureshtje, kuriozitet për një çështje të caktuar. "Intrigova interesin, vëmendjen e mikut tim për lëvizjen e re politike, për motivet dhe pasojat e përgjithshme dhe të veçanta të asaj lëvizjeje, d.m.th. e interesova për atë lëvizje".

INTRINSEK, - E. mb. I ardhur nga latinishtja me kuptimi nga brenda, që buron nga brendësia e organizmit, përkatësisht që nuk shkaktohet nga ngacmuesit e jashtëm të organizmit. Ky term cilëson vetitë natyrore të organizmit që shkaktohen dhe rrjedhin nga brendia e organizmit. Në këtë kuptim në psikologji bëhet fjalë për motivet intrinseke, përkatësisht për motive të brendshme.

INTROJEKSION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *introjectio* "ndërhyrje". Proces i ndërlikuar psikik me anën e të cilit dukuritë, objektet, proceset etj. të botës së jashtme ose aspekte të veçanta të tyre shndërrohen në përmbajtje të brendshme psikike dhe, me këtë rast, përmbajtja e tillë e brendshme kryen funksione psikologjike mbi ata të botës së jashtme. Konsiderohet se ky proces është proces shumë i hershëm në zhvillimin ontogjenetik të organizmit të fëmijës, që fillon të shfaqet atëherë kur fëmija ende nuk është në gjendje ta dallojë unin e tij nga jo uni. Ky proces në psikanalizë konsiderohet mekanizëm mbrojtës dhe në fillim shfaqet në përbrensimin e gjirit të nënës, të duarve, të fytyrës së saj etj., meqë kjo i sjell atij kënaqësi.

INTROSPEKSION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *introspicere* "shikoj nga brenda". *Shih* – **VETËVËZHGIMI.**

INTROSPEKSIONIZ/ËM, - MI. m. Pikëpamje psikologjike që e konsideron lëndën e psikologjisë produkt të metodës së vetvëzhgimit sistematik, përkatësisht të introspeksionit. Termi introspeksionizëm është i lidhur drejtpërdrejt me psikologjinë strukturaliste të Vilhelm Vuntit (Wilhelm Wundt, 1832 – 1920) dhe të Eduard B. Tiçinerit (Edward B. Titchener, 1867 – 1927). Me zhvillimin e metodave dhe të procedurave të reja hulumtuese të dukurive, proceseve dhe sjelljeve pikëpamja e introspeksionizmit tashmë i përket historisë së psikologjisë.

INTROVERSION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *introversion* "i kthyer nga brenda". Introversioni është term i teorisë së personalitetit të Karl Jungut

(Carl Jung, 1875 – 1961) që emërton interesimin, drejtimin dhe përqendrimin e sjelljeve të njeriut të zhvilluara në drejtim të vetvetes (të ndjenjave, të mendimeve, të përfytyrimeve individuale) e jo në drejtim ndaj objekteve, dukurive dhe proceseve të botës së jashtme dhe as në drejtim të marrëdhënieve ndërpersonale.

INTROVERT, - E. mb. I ardhur nga latinishtja *introvertere* "i drejtuar nga brenda" që karakterizon sjelljet e atij individi, i cili i drejton këto sjellje kah bota e brendshme subjektive e tij. Mbiemri introvert karakterizon tipin e individit, sjelljet e të cilit shtrihen në kuadrin e introversionit në relacionin introversion – ekstraversion të psikologjisë komplekse të Karl Jungut (Carl Jung, 1875 – 1961).

INTUIT/Ë, - A. f. I ardhur nga latinishtja *intuero* "shikoj, vështroj". Formë e aftësisë së njohjes së drejtpërdrejtë të tërësisë së një çështjeje të ndërlikuar, njohje kjo së cilës nuk i paraprijnë procese të ndërlikuara mendore. Intuita në njohjen, madje, edhe në zbulimin e zgjidhjeve të reja, shfaqet në paraqitjen e zgjidhjeve të reja papritmas, duke mos pasur mundësi të shpjegohet procesi i zgjidhjes së tillë. Pohohet se intuita mund të jetë proces i pavetëdijshëm ose i paravetëdijshëm, por jo edhe proces i vetëdijshëm. Intuita ka zënë vend të posaçëm në psikologjinë e Karl Jungut. Sipas tij intuita është ai funksion psikologjik që i bart perceptimet në rrugën e pavetëdijshme. Lëndë e këtij perceptimi mund të jenë: objektet e jashtme dhe të brendshme ose lidhjet ndërmjet tyre. Karakteristika e intuitës është se ajo nuk është as perceptim shqisor, as ndjenjë, as përfundim intelektual, megjithëse mund të paraqitet edhe në këto forma…".

INTUITIV, - E. mb. Që i përket intuitës, që ka të bëjë me intuitën, që është rezultat i intuitës. Për një mendim, qëndrim etj. themi se është intuitiv atëherë, kur jemi të bindur në vërtetësinë e tij, megjithëse nuk jemi në gjendje ta arsyetojmë.

Burimet:

Philip Goldberg: *"Die Kraft der Intuition – Wie man lernt, seiner Intuition zu vertrauen"* – (*"Fuqia e intuitës – Si të mësojmë ta gjurmojmë intuitën tonë"*)**,** Lizenzausgabe für Gondrom Verlag GmbH & Co. KG, Bindlach 1995 mit Genehmigung des Scherz Verlag, Bern und München;

Mario Augusto Bunge: "*Intuition and Science"* – (*"Intuita dhe shkenca"*), Westport, Conn., 1975;

Lee V. Hamilton: *"Intuitive Psychologist or Intuitive Lawyer? Alternative Models of the Atribution Process"* – (*"Psikologu intuitiv apo avokati intuitiv? Modele alternative të procesit të përkushtimit"*), Journal of Personality and Social Psychology, Nov. 1980, fq. 767 – 772;

Robert Orstein: "*Die Psychologie des Bewustensein"* – *("Psikologia e së pavetëdijshmes"*), Köln, 1974.

INVALID, - I. m. Individi që vuan nga çrregullimet e rënda funksionale të organeve ose nga humbja e tërësishme e funksionit të një organi të organizmit të njeriut, por që mund të zhvillojë jetë normale nëse i plotësohen disa nga kushtet zhvillimore të domosdoshme. Gjendja e tillë shkaktohet nga fatkeqësitë, sëmundjet, traumat etj. Në terminologjinë e politikës speciale e shëndetësore termi invalid përdoret më rrallë dhe në vend të këtij termi në shqipe ka filluar të ngulitet termi individë me nevoja të veçanta.

INVENTAR, - I. m. I ardhur nga latinishtja *inventorium* me shkallë të lartë të përdorimit në disa fusha që ka zënë vend edhe në terminologjinë e psikologjisë, por më tepër si togfjalësh terminologjik. Shih – ***INVENTARI MULTIFAZOR I MINESOTOS PËR PERSONALITETIN***. Kuptimi i përgjithshëm i termit inventar ka të bëjë me regjistrimin rendor të pajisjeve të një objekti (depo, instrumentariumi, klinika, zyra etj.). Në psikologji termi inventar ka kuptimin e një instrumentariumi psikologjik të përbërë nga anketa e pyetësori, testi etj. me anën e të cilave maten dhe vlerësohen aftësitë, bindjet, interesimet, qëndrimet etj. të individëve.

INVENTARI I DEPRESIONIT BEK. Tërësi e përbërë nga anët më të rëndësishme të sjelljeve e të ndjenjave të paraqitura në këtë inventar. Subjekti ka detyrë të zgjedhë atë lloj sjellje e përjetim ndjenjash që i përgjigjet më shumë sjelljeve dhe ndjenjave të tij. Kështu, subjekti zgjedhë nga disa pohime të parashtruara në relacionin "jam në gjendje me marrë vendim të pavarur deri në shkalën nuk jam në gjendje të marrë vendim të pavarur". Zbatimi i këtij inventari ndihmon për vlerësim të zhvillimit dhe të ngadalësimit a pengimit të zhvillimit të aftësisë së marrjes së vendimeve dhe të zhvillimit të emocioneve dhe të ndryshimit të intensitetit dhe të cilësisë së tyre. Ky inventar u përpilua nga psikiatri amerikan Aron T. Bek (Aron T. Beck, 1921**).**

INVENTARI I INTERESIMEVE. Instrument matës vlerësues që ka formën e një pyetësori, që synon të matë dhe të vlerësojë interesimet profesionale, dhuntitë, qëndrimet pozitive të të rinjve ndaj punëve, veprimtarive e thirrjeve profesionale të caktuara. Pyetësori përbëhet nga një numër i madh pyetjesh që kërkojnë përgjigje të sakta dhe nga përzgjedhja e atyre përgjigjeve që janë më të pëlqyeshme nga ana e të rinjve që gjenden në pragun e zgjedhjes së profesionit jetësor të tyre.

INVENTARI I INTERESIMEVE STRONG–KEMBEL. Ndër pyetësorit më të njohur të hulumtimit të interesimeve profesionale të të rinjve. Ky inventar ka pasur 317 detyra në formë pyetjesh dhe në formë pyetjesh e përgjigjesh të dhëna për profesionin e synuar, për lëndët shkollore më të këndshme, për kontaktet me individë etj. Arritjet e një individi në përgjigjet e dhëna dhe në përzgjedhjet e bëra të përgjigjeve krahasohen me arritjet e atyre që i kryejnë punët profesionale të caktuara me sukses dhe në bazë të shkallës së ndërlidhshmërisë së këtyre dy serive të të dhënave individi parapëlqehet për dy a tri profesione më të afërta ku ai do të mund të jetë i suksesshëm. Ekziston forma e veçantë e këtij inventari për meshkuj dhe për femra. Versioni i parë i këtij pyetësori profesional është përpiluar në vitin 1927 nga ana e psikologut amerikan Eduard K. Strong (Edward K. Strong, 1884 – 1963). Ky version i është nënshtruar verifikimit më 1974 dhe ka 325 detyra. Versioni i ri ka marrë emërtimin Inventari i Interesimeve Strong – Kembel. Për shkak të ndryshimeve relativisht të mëdha ndërmjet profesioneve të Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Shqipëri e Kosovë ky inventar është i papërdorshëm për ne.

INVENTARI I PERSONALITETIT. Pyetësor i hartuar për hulumtimin, matje dhe vlerësimin e tipareve të individualitetit dhe të shkallës së zhvillimit të tyre te një individ i caktuar. Inventari i personalitetit përbëhet nga një numër i madh pyetjesh dhe pohimesh, ndër të cilat subjekti duhet të përzgjedhë ato që karakterizojnë proceset e format e qëndrueshme të sjelljeve të tij, si edhe ato që nuk kanë të bëjnë me proceset e sjelljet e qëndrueshme të tij. Në mbështetje të përgjigjeve dhe të përzgjedhjeve maten dhe vlerësohen tiparet e personalitetit dhe përcaktohet prania e tipareve të personalitetit dhe shkalla e zhvillimit të tyre.

INVENTARI I PERSONALITETIT AJZENK. Lloji më i përsosur i inventarit i përpiluar nga psikologu britanik me prejardhje gjermane Hans J. Ajzenk (Hans J. Eysenck, 1916 – 1997). U përpilua mbi bazën e Inventarit MPI (Maudsley Personality Inventary) që me 48 detyrat e veta ka matur intraversionin – ekstraversionin dhe neurotizmin e normalitetin. Ndërkaq, me Inventarin Ajzenk të personalitetit matet edhe përmasa e tretë bazike e personalitetit: shkalla e gënjeshtrës. Me të dhënat e tilla plotësohet dhe saktësohet pasqyra e rezultateve të përftuara mbi përmasën introversion – ekstraversion dhe neurotizëm – normalitet.

INVENTARI I PERSONALITETIT BERNTROJER. Tërësi prej 125 detyrash të shtruara në formë fletëpyetësi, ku subjekti ka detyrë të bëjë përzgjedhjen sipas tipit po / jo. Nga grumbullimi i përgjigjeve dhe analiza faktoriale e tyre ndahen gjashtë kategori themelore tiparesh: neurotizmi, intraverzioni, vetëkënaqësia, dominimi, vetëbesimi dhe shoqërizimi. Sipas rezultatit përfundimtar të subjektit përcaktohet kategoria përkatëse e personalitetit të tij. U hartua nga psikologu amerikan Robert Berntrojer (Robert G. Bernreuter, 1901).

INVENTARI I PERSONALITETIT UDUËRTH. Inventari i parë i regjistruar i personalitetit që ka formën e pyetësorit. U hartua nga ana e Robert Uduorthit (Robert Woodworth, 1869 – 1962). Inventari Uduërth i personalitetit ka pasur për qëllim përzgjedhjen e rekrutëve më të aftë për kryerjen e detyrave ushtarake në gjinitë e ndryshme të forcave të armatosura të Shteteve të Bashkuara të Amerikës gjatë Luftës së Parë Botërore, si edhe për identifikimin e ushtarëve me gjendje emocionale të paqëndrueshme. Inventari Uduërth i personalitetit është quajtur "Regjistër të dhënash personale" dhe ka pasur 116 pyetje me përgjigje të tipit "po" dhe "jo". Megjithëse kishte shkallë të lartë zbatimi ky inventar sot nuk përdoret.

INVENTARI MULTIFAZOR I MINESOTOS PËR PERSONALITETIN. Një ndër inventarët më të mirë për gjurmimin e personalitetit dhe të tipareve të tij në literaturën e psikologjisë që njihet me simbolet MMPI (Minnesota Multiphasic Personality Inventary). U krijua për herë të parë në vitin 1942. Inventari përbëhet prej 556 pohimeve, me të cilat subjekti mund të përgjigjet: pajtohem, nuk pajtohem dhe nuk mund të përcaktohem. Kishte si qëllim përcaktimin e sindromave të personalitetit për nevoja psikiatrike dhe të psikologjisë klinike. Por, rezultatet e mëvonshme treguan se MMPI është inventar i dobishëm për gjurmi-

min e çështjeve të personalitetit dhe për matjen e zhvillimit të tipareve të personalitetit. Ka 13 shkallë vlerësuese, nga të cilat tri janë shkallë kontrolluese: L shkalla – (shkalla e gënjeshtrave), K shkalla – (shkalla e fshehjes së tipareve) dhe F shkalla – (shkalla e pakuptimit të pohimeve). Nga 10 shkallët e tjera, 8 të tilla provojnë prirjet patologjike. Këto janë: Hs – prirja kah hipokondrisë, D – prirja kah depresionit, Hy – prirja kah histerisë, Pd – prirja kah shmangies psikopatike, Pa – prirja kah paranojës, Pt, - prirja kah psikastenia, Sc – prirja kah skizofrenisë dhe Ma – prirja kah hipomanisë. Shkallët e tjera janë M – mashkullorja, F – femërorja dhe Si – introversioni social. MMPI u përpilua nga psikologët amerikanë S. R. Hatavej dhe Makinli. Ky inventar u rishikua më 1951 dhe ka 567 pohime. Ekziston edhe MMPI i formës së shkurtër i përbërë nga 71 pohime. MMPI ka formën e testit për adoleshentët dhe formë tjetër për të rriturit.

I

INVOLUCION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *in* "jo" dhe *evolution* "zhvillim". Me termin involucion emërtohet procesi i rrënimit dhe i shuarjes graduale të disa funksioneve psikike dhe organike. Ky proces ka karakter zhvillues, por në sensin negativ. Involucioni te njeriu fillon në moshën e pjekurisë, kurse në moshën e pleqërisë merr karakter gjithnjë e më intensiv duke e çuar njeriun deri në vdekje. Procesi involvues nuk ka ritëm të njëjtë te të gjitha funksionet psikike dhe nuk zhvillohet në harmoni të plotë me involvimin e proceseve organike. Disa nga proceset kognitive gjenden në funksion normal edhe në moshën e shtyrë kalendarike.

INJORANC/Ë, - A. f. I përdorur kryesisht në të folurën e zakonshme dhe ka hyrë në shqipe nga latinishtja *ignoratio* që emërton kuptimin e mungesës së dijes, përkatësisht padijeninë e individit në një fushë të caktuar teorike e praktike dhe sjelljet e tij të shkaktuara nga mungesa e dijes ose nga padija. Injoranca është rezultat i mosarsimimit dhe i mosangazhimit të njeriut për vetarsimim e vetedukim.

IQ – Shkurtesë e anglishtes *Intelligence Quotient* "Koeficienti i inteligjencës". Shih – ***KOEFICIENTI I INTELIGJENCËS.***

IRID/Ë, - A. f. Në anatominë e syrit i ardhur nga greqishtja *ίριδα* "ylber". Irida është cipëz muskulor, ylberthi i syrit që shtrihet nga trupi i muskulit ciliar deri në sy. Gjendet përreth bebes së syrit dhe ka karakter elastik. Irida ka përbërje fibroze të ngjyrosura në formë vijëzash të ndritshme, unazash dhe pikash; përbërja e tillë ka karakter individual dhe është e papërsëritshme. Në mesin e iridës gjendet bebëza e syrit, e cila rregullon në mënyrë refleksive sasinë e dritës që arrin në sy; kjo zvogëlohet nga drita e madhe dhe zmadhohet nga sasia e dritës së vogël.

IRONI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *ειρωνεία* "përqeshje". Term i letërsisë që ka karakterin e një figure stilistike, por prek edhe anën psikologjike të shkrimtarit dhe të lexuesit. Ironia është lloj i shprehjes komike, ku shkrimtari përqesh dhe vë në lojë të habitshme një individ, duke shprehur të kundërtën e asaj që mendon dhe beson. Ironia është therëse, e ftohtë dhe depërtuese në thellësinë konjitive të asaj që përflitet e shkruhet. Në ironi

hasim kontrastin ndërmjet kuptimit të fjalëve të shprehura dhe kuptimit mendor të tyre. E tillë është shprehja ironike "Nuk e meritova këtë lëvdatë!" drejtuar atij që ofendon padrejtësisht. Në letërsinë shqipe hasen një varg shprehjesh ironike në krijimtarinë e Andon Zako Çajupit, Faik Konicës, Fan S. Nolit, Ramiz Kelmendit etj. Në sjellje të individit herë herë merr karakter të mekanizmit mbrojtës. Si e këtillë shfaqet te ata të cilët përballen me konflikte emocionale dhe nga këto nxjerr aspekte talljeje.

IRRACIONAL, - E. mb. I ardhur nga latinishtja *irrationalis* "i paarsyeshëm", që karakterizon përmbajtjen e procesit të mendimit dhe marrjen e vendimeve jashtë rregullave dhe jashtë ligjeve të një mendimi racional e të arsyeshëm. Irracionale janë sjelljet e një individi të nxitura dhe të drejtuara nga gjendja emocionale e tij, kur gjendjet e tilla mbisundojnë parimet dhe ligjet e të menduarit logjik.

IRRACIONALIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga latinishtja *irrationalis* "i paarsyeshëm". Irracionalizmi është pikëpamje e psikologjisë fetare, sipas së cilës burimi i njohjes së realitetit, i dukurive, i lidhjeve dhe i raporteve objektive është vetëm intuita, instinkti, vullneti i njeriut. Besimi i njeriut në irracionalen lindi në fushën e besimit, përkatësisht të teologjisë, por shpejt mori karakter të përgjithshëm filozofik. Përfaqësuesit eminentë të psikologjisë së irracionalizmit janë: filozofi dhe psikologu gjerman Eduard fon Hartman (Eduard von Hartmann, 1824 – 1906) dhe filozofi e psikologu francez Anri Bergson (Henri Bergson, 1859 – 1941). Për Eduard fon Hartmanin i tërë sistemi i njohjes ka themelet e veta në të pavetëdijshmen, ndërkaq, për Anri Bergsonin themelin e njohjes e përbën intuita.

Burimet:

Eduard von Hartmann: *"Philozophie des Unbewussten, Versuch einer Weltanschauung"* – (*"Filozofia e së pavetëdijshmes, gjurmim i një pikëpamjeje"*), 1869;
Eduard von Hartmann: *"Religionsphilozophie"* – ("*Filozofia e besimit*"), 1881 – 1882;
Henri Bergson: "*Essai sur les donnees immediate de la conscience"* – (*"Pasqyrë immediate e fakteve të vetëdijes"*), 1889;
Henri Bergson: *"Introduction a la metaphysique"* – (*"Hyrje në metafizikë"*), 1903.

IRRACIONALJA NË PSIKANALIZË. Një ndër termat dhe konceptet themelore të psikanalizës klasike. Sipas Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1822 – 1911) veprimtarinë e njeriut e nxit dhe e drejton parimi i kënaqësisë së shtytësve, në rend të parë i shtytësit seksual. Sjelljet e njeriut dhe gjeneza e tyre burojnë nga egoizmi i shtypur ose i ndrydhur i tij, kurse shpjegimi i tyre në bazë të arsyes është i pabazë.

IRREVERSIBILITET, - I. m. Term i rrallë në terminologjinë e psikologjisë, i ardhur nga latinishtja *irreversibilitas* "pathyeshmëri" që ka depërtuar në psikologjinë gjenetike nga biologjia, ku disa procese biologjike lëvizin vetëm në një drejtim, pa mundësi të kthehen në gjendjen e mëparshme. Impulsi nervor që lëviz nëpër sinaps nuk ka mundësi të kthehet në drejtim të kundërt. Në psikologjinë gjenetike ka kuptim të përgjithshëm dhe të veçantë. Me kuptim të përgjithshëm irreversibiliteti paraqitet si parim i zhvillimit të fëmijës. Kuptimi i veçantë e

termit irreversibilitet i përket psikologjisë së inteligjencës të Zhan Pijazhesë (Jean Piaget, 1896 – 1980). Me këtë term emërtohet cilësia e zhvillimit të inteligjencës paraoperacionale.

IZOLIM, - I. m. Term i qëndrueshëm në gjuhën shqipe që ka ardhur nga italishtja *isolare* "izoloj". Izolimi në të folmen e zakonshme ka kuptimin e veçimit të një dukurie, objekti, individi etj. nga të gjitha të tjerat. Izolimi në psikologji është mekanizëm mbrojtës. Ky mekanizëm mbrojtës manifestohet në funksionimin e pavetëdijshëm të njeriut, kur ky në formë të pavetëdijshme ndan, izolon kujtimin e një ngjarjeje, të një ndodhie nga përjetimet emocionale dhe nga impulset shtytëse, që, përndryshe, janë përjetuar të lidhura ndërmjet tyre. Përvoja e tërësisë së përjetimit të asaj ngjarjeje nuk është harruar, por gjendja emocionale që ishte përbërëse e përjetimit të asaj ngjarjeje, ndahet, veçohet, izolohet për të mos shkaktuar konflikt në strukturën psikike të atij njeriu. Ndarja, izolimi i emocioneve nga burimi konjitiv i asaj ngjarjeje është karakteristik për gjendjen e çrregulluar psikike, përkatësisht për neurozën obsesive.

IZOMORFIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga greqishtja *ιδιο* "i njëjtë" dhe *μορφία* "formë", i përdorur në matematikë, në kimi si edhe në psikologjinë geshtaltiste. Në psikologjinë geshtaltiste termi izomorfizëm emërton dukurinë e mosngjashmërisë ndërmjet fushës nervore të ngacmuar nga ngacmuesi fizik dhe përvojës a perceptimit që ka individi për stimuluesin.

J

JAKOB Levi Moreno (Levi Moreno JAKOB). Psikiatër amerikan me prejardhje nga familje herreje dhe rumuno–austriake. Lindi në Bukuresht më 20.05.1892 dhe vdiq në Bikon afër Nju Jorkut më 14.05.1974. Kreu mjekësinë në Vjenë dhe u specializua për psikiatri nën drejtimin e profesorit Oto Potcl (Otto Potzl), entusiast i filozofisë dhe i teatrit. Jakob Levi Moreno është themelues i sociometrisë, i sociodramës dhe i psikodramës. Qysh më 1925 u shpërngul në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Bikon ngriti një klinikë psikiatrike, kurse më pas, çeli në Nju Jork Institutin për Psikiatri Grupore dhe Psikodramë. Sipas tij problem kryesor i personalitetit bashkëkohor është humbja e elanit jetësor, koncept dhe term i përdorur edhe nga Anri Begsoni, por edhe humbja e natyrës spontane të personalitetit. Kjo humbje ka të bëjë me lindjen e vështirësive në përshtatjen e njeriut ndaj mjedisit dhe kërkesave të tij dhe me shfaqjen e sjelljeve të çrregulluara. Vështirësitë dhe çrregullimet e këtilla janë pasojë e ndikimit të mjedisit shoqëror dhe jo e ndikimit të faktorëve të brendshëm të njeriut. Për këtë shkak Jakob Moreno ka vlerësuar se një mjedis shoqëror, i cili nuk i jep mundësi zhvillimit të natyrshëm të njeriut dhe fuqive krijuese të tij nuk do të ketë ardhmëri. Sociometrinë e vlerësoi tepër lart, madje duke e konsideruar këtë disiplinë më vete. Në kuadrin e këtij koncepti zhvilloi metodën e matjes së intensitetit të afërsisë dhe të largësisë ndërmjet anëtarëve të grupeve shoqërore me variante të ndryshme. Kjo metodë njihet edhe si testi sociometrik. Me anë të zbatimit të testit sociometrik dhe të paraqitjes grafike të rezultateve të shkallës së simpatisë dhe të antipatisë ndërmjet anëtarëve të një grupi në sociogram mund të njihet kohezioni dhe shkalla e tij ndërmjet anëtarëve të atij grupi shoqëror. Zhvilloi format e ndryshme të psikoterapisë me anë të psikodramës dhe ndriçimin e raporteve ndërmjet anëtarëve të një grupi shoqëror me anë të sociodramës. Veprat kryesore të tij janë: *"Who shall survive?* – (*"Kush do të mbijetojë?"*), 1934; *"Psychodrama"* – (*"Psikodrama"*, 1946); *"Sociometry and the Science of Man"* – (*"Sociomteria dhe shkenca mbi njeriun"*), 1956.

JASPERS Karl (Karl JASPERS). Filozof, psikolog dhe psikiatër gjermano-zviceran. Lindi në Oldenburg më 23.02.1883 dhe vdiq në Bazel më 26.02.1969. Pas përfundimit të studimeve për mjekësi në Universitetin e Heidelbergut u punësua si mjek psikiatër në spitalin psikiatrik të këtij vendi, kurse nga viti 1948, profesor i Universitetit të Bazelit (Basel). Lloj i mendimit të posaçëm filozofik dhe psikologjik të tij është kujdesi për ruajtjen e integritetit të personalitetit të njeriut – vetëkuptim dhe projektim i Unit ekzistencial. U mor me studimin e shkaqeve gjenetike të sëmundjeve psikike dhe me diagnostikimin e tyre; këto i dhanë shkas të drejtohet në studimet psikologjike, duke konsideruar shpirtin gjithëpërfshirës të aktivitetit të njeriut. Ka qenë ithtar i psikologjisë së frymës dhe ka konsideruar se qasja studimore e proceseve psikike, duhet të jetë qasje fenomenologjike, sepse vetëm kjo qasje mund të na japë një "pamje të prerë" për dukuritë e proceset psikike dhe kjo, më pas, mund të plotësohet me qasje gjenetike dhe dinamike. Shpjegimet e sakta të dukurive e proceseve psikike kërkojnë njohje të saktë të shkaqeve të tyre, që është e pamundur dhe për këtë shkak shpjegimin e mbështesim në shkaqe organike. Komunikimi i njerëzve me të tjerët është koncepti themelor i njohjes së njerëzve; ky komunikim shtrihet prej dashurisë në urrejtje dhe një komunikim i tillë i siguron njeriut ekzistencën e vet. Vepra kryesore të tij nga fusha e psikologjisë janë: "*Allgemeine Psychopathologie*" – ("*Psikopatologjia e përgjithshme*"), 1913; "*Psychologie der Weltanschaunungen*" – (*"Psikologjia e botëkuptimit"*), 1919; *"Die geistige Situation der Zeit"* – (*"Situata shpirtërore e kohës"*), 1931; "*Vernunft und existenz*" – (*"Arsyeja dhe ekzistenca"*), 1935; "*Hoffnung und Sorge*" – (*"Shpresa dhe shqetësimi"*), 1965.

JENSH R. Erik (Erich R. JAENSCH). Psikolog austriak-gjerman. Lindi në Breslav më 26.02.2883 dhe vdiq në Marbug më 12.01.1940. Së bashku me vëllain e tij Valter Jensh zbuluan fenomenin psikologjik të eidetizmit. Këtë fenomen e karakterizon prania e figurave shumë të gjalla në mendjen e njeriut, pas fiksimit të këtyre figurave në bazën e ngjyrës tjetër. Kjo është dukuri e pranishme kryesisht te disa tipa individësh të moshës fëmijërore dhe asaj adoleshente, por edhe te disa të rritur të dy gjinive. Këto figura dallojnë nga figurat shqisore, gjegjësisht nga pasfigurat, sepse, ndonëse, figura perceptuese është larguar nga fusha e të parit, subjektet e përjetojnë figurën e atij objekti mu në bazën ku ishte e vendosur shumë gjallërisht, madje disa me vështirësi arrijnë ta dallojnë këtë figurë nga figura perceptuese. Kjo figurë zgjat disa sekonda, rrallë 1 ose 2 minuta pas largimit të figurës perceptuese. Por, dukuria e eidetizmit është shumë e rrallë. Besohet se një adoleshent eidetik shfaqet në 1000 adoleshentë. Vëllezërit Jensh dalluan se eidetizmi është dukuri e lidhur më shumë me moshën e pubertetit dhe individët eidetikë kanë përbërje antropologjike të veçantë. Këta madje kanë dalluar dy tipa eidetikësh: tipin eidetik, i cili mund të shkaktojë vetë eidetizmin dhe mund ta ndërpresë po vetë dhe tipin eidetik, te të cilët figurat eidetike imponohen. Ka gjasa që te këta tipa shfaqet dukuria e hiperfunksionit dhe e hipofunk-

sionit të gjëndrës mbrojtëse. Dukuria e eidetizmit është përpunuar nga ana e tij në veprën "Eidetizmi dhe tipologjia e jetës shpirtërore", botuar më 1934.

JOST Adolf (Adolph JOST, 1874 – 1920). Psikolog gjerman. Gjurmues i psikologjisë eksperimentale të kujtesës. I njohur pak nga historia e psikologjisë, madje edhe nga ajo e Gjermanisë, ku përmendet vetëm për ligjin e mbajtjes mend të materialit të mësuar, e konkretisht të ligjit për mbajtjen mend të materialit të mësuar më herët, në raport me atë që mësohet tash. Mbeti i njohur me ligjin e quajtur "Ligji i Jostit". Ky ligj përbëhet nga dy pjesë: Pjesa e parë që përbëhet nga dy vargje rrokjesh që mësohen njëri pas tjetrit, vargu i parë, më i vjetër, mbahet mend më mirë se vargu që mësohet pas tij; dhe pjesa e dytë, vargu i vjetër përsëritet më lehtë dhe më mirë, sepse i reziston harresës më shumë se vargu i ri. Përgjithësisht lënda e mësuar më herët, pra, lënda e vjetër mbahet mend dhe nuk harrohet aq lehtë në raport me lëndën e re, e cila nuk është në gjendje t`i rezistojë procesit të harresës, sikurse lënda e vjetër, "e ngulitur" tashmë në strukturën e proceseve të kujtesës. Ky ligj u botua për herë të parë në revistën "*Zeitschrift für Psychologie*" – "*Revista për psikologji*", 1897.

JUNG Karl Gustav (Carl Gustav JUNG). Mjek zviceran dhe psikolog. Lindi në Kesvil (Chesswil) më 26.07.1875 dhe vdiq në Kysnaht (Chüsnacht afër Zyrihut) më 16.06.1961. Kreu studimet për mjekësi në Universitetin e Bazelit dhe u kualifikua për psikiatri më 1900, duke u punësuar në Spitalin e Zyrihut, ku punonte Eugen Blojleri. Më 1905 u emërua docent në katedrën e psikiatrisë të Universitetit të Zyrihut, kurse më 1909 mori titullin "Doktor nderi" i Universitetit Klark (Clark) të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. U takua me Zigmund Frojdin më 1907 dhe vazhduan miqësinë për disa vite, por pas pesë vitesh, më 1912 u ndanë. Shkaqet e ndarjes së tyre ishin ndryshimet e mëdha të pikëpamjeve për njeriun dhe jetën psikike të tij, si edhe dallimet parimore për faktorët e zhvillimit të jetës psikike. Karl Gustav Jungu hodhi poshtë pikëpamjen për rolin e seksualitetit në zhvillimin e jetës psikike, libidon e cilësoi potencial energjetik të zhvillimit, por jo të natyrës seksuale, theksoi rolin e fesë në jetën e njeriut dhe zhvillimin e saj. Përgjithësisht ishte kundër psikanalizës klasike të Zigmund Frojdit. Karl Gustav Jungu zhvilloi një drejtim të posaçëm të psikologjisë thellësore, që e quajti psikologjia analitike. Konceptet themelore të psikologjisë analitike janë: e pavetëdijshmja kolektive, individuale dhe e vetëdijshmja, themeli i personalitetit qëndron në të pavetëdijshmen kolektive, të cilën e karakterizon shuma e përvojave të të gjitha brezave paraprake dhe që shfaqet në fomë arketipash. Ai e mbështeti funksionimin e jetës psikike të njeriut mbi natyrën dhe zhvillimin e arketipave, të cilët janë rregullues të integritetit dhe të pjekurisë së personalitetit. Këta luajnë rol të rëndësishëm gjatë procesit të zhvillimit të mendimit, ndijimeve, ndjenjave dhe intuitës. Sipas mënyrës së kombinimit të këtyre katër proceseve ai ka dalluar tetë lloje tipash. Te këta ka dalluar arketipat kryesorë që i ka emërtuar individë,

anima, animus etj. Procesin e zhvillimit psikik të njeriut ai e quajti individualizim i personalitetit. Ka dalluar dy lloje tipash kryesorë të personalitetit: tipin ekstravert dhe tipin intravert. Tipi ekstravert është i drejtuar kah bota e jashtme e njeriut, kurse tipi intravert është i drejtuar kah bota e brendshme e tij. Fondi i botimeve të Karl Gustav Jungut është rreth 50 tema. Veprat kryesore të tij janë: "*Gessamelte Werke*" – ("*Vepra të përmbledhura*") në gjashtë vëllime, Walter – Verlag AG, OLten, 1971: *"Zür psychologie und Pathologie sogenannter occulter Phaenomenennen"* – ("*Psikologjia dhe patologjia e ashtuquajtur e fenomeneve kulte"),* 1902; *"Diagnostische Assoziations - Studien"* – (*"Studim i asociacioneve diagnostikuese"*), 1903; *"Über die Psychologie des Unbevusten"* – (*"Psikologjia e së pavetëdijshmes"*), 1916 (përkthyer në gjuhën shqipe, 2003, vëllimi 1 dhe 2); *"Psychologischen Typen"* – (*"Tipat psikologjikë"*), *1*918 (botuar në shqip, 2003); *"Über psychische energetic und das Wesen der Traume"* – (*"Mbi energjinë psikike dhe qenien e gjumit"*), 1928; *"Ein moderner Mythus"* – *("Një mit modern"),* 2004. Nga anglishtja në shqip u përkthyen këto vepra të tij: *"Mbi psikikën njerëzore",* 2002; *"Ëndrrat",* 2003; *"Psikologjia dhe feja",* 200*3; "Frojdi dhe psikanaliza",* 2003*; "Ese mbi gjurmimin e pavetëdijes",* 2004*; "Psikologjia analitike",* 2006; *"Njeriu dhe simbolet e tij*", 2010.

JUNIKU Neki. Psikolog shqiptar. Lindi në Gjakovë më 12.08.1942. U diplomua në Departamentin e Psikologjisë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Beogradit më 1965. Profesor i lëndëve të psikologjisë në Shkollën Normale. Më 1977 u emërua asistent i psikologjisë në departamentin e pedagogjisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Ka përfunduar me sukses studimet pasuniversitare në departamentin e psikologjisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Beogradit. Kreu doktoratën për psikologji në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, si edhe specializimin përmes programit CIP, "Cliveland International Program" – "Programi Ndërkombtar i Klivlendit" në Universitetin Shtetëror të Floridës. Gjatë viteve 2005–2006 kreu një studim në Universitetin Shtetëror të Kolumbias në Qendrën e Studimeve të Traumës. Docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar për lëndët Psikologji zhvillimore dhe Psikologji pedagogjike në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Një ndër themeluesit e departamentit të psikologjisë në Universitetin e Prishtinës. Udhëheqës i projektit studimor mbi traumat, drejtor i projektit "Ruajtja e shëndetit mendor në Kosovë". Veprat kryesore të tij janë: *"Kaptina nga psikologjia",* 1967; *"Modifikimi i sjelljes në shkollë",* 1997; *"Psikologjia"* libër shkollor (me bashkautor). Përktheu nga serbokroatishtja në shqip këto tekste: *"Psihologija ličnosti"* – (*"Psikologjia e personalitetit"*), 1965; "*Dečja psihologija*" – ("*Psikologjia fëmijnorë*"), 1976; *"Psihologija"* – (*"Psikologjia*)*",* 1967. Ka botuar një numër artikujsh profesionalë dhe shkencorë, ndër të cilët dallohen: *"Disa qasje teorike të fenomenit të ankthit", "Teoria e Skinerit mbi kushtëzimin operant"* në Buletinin e Fakultetit Filozofik të Prishtinës

K

K - shkronja e parë e termit konstant dhe simbol për termin kuartil – çerek.

KACAFYTJ/E, - A. f. Formë e vrazhdë e motivit të agresivitetit. Kacafytja shfaqet në të rrokurit fyt më fyt të dy ose më shumë individëv

KAFEIN/Ë, - A. f. Kafeina është një lloj alkaloidi që gjendet në kafe, në çokollatë etj. Kafeina bllokon veprimtarinë e një lloj enzime, që asgjëson neurotransmetuesit dytësorë të sinapseve cerebrale, duke shkaktuar në këtë mënyrë shtimin e aktivitetit të shumë neuroneve dhe ngritjen e shkallës së gjendjes së zgjimit të një njeriu. Kafeina stimulon gjendjen zgjuar të njeriut. Tepria e marrjes së sasisë së madhe të kafeinës shkakton disa çrregullime psikike, si ankthin, çrregullimin e fjetjes, intoksikimin etj.

KAFK/Ë, - A. f. Kupa ashtërore e kokës së njeriut dhe e disa lloj kafshësh. Përbëhet prej eshtrave të rrafshit të kresë dhe prej eshtrave të fytyrës. Kafka e njeriut përbëhet pre 29 eshtrash të lidhura njëra me tjetrën duke i dhënë asaj formë të veçantë. Vëllimi i hapësirës që e rrethon kafkën është rreth 1500 cm^2, kurse diametri i saj sillet prej 50 – 60 cm. Kafka mbron trurin nga ndikimet e rrezikshme që vijnë nga jashtë.

KAFSH/Ë, - A. f. Qenie e gjallë me veçori biologjike të gjallesave që lëviz vetë, ka aftësi karakteristike të ndjeshmërisë dhe të përshtatjes së mjedisit ku ajo jeton. Lëvizjet e kafshëve janë të lidhura drejtpërdrejt me nevojat biologjike dhe kontribuojnë në përshtatjen e saj ndaj kushteve fizike e biologjike të mjedisit. Aktiviteti i gjithëmbarshëm i kafshëve mbështetet në një numër të caktuar instinktesh dhe ka karakter të theksuar instinktiv. Kafshët kanë mundësi të mësojnë, por niveli i kësaj aftësie të tyre varet nga shkalla e zhvillimit dhe nga niveli i zhvillimit të sistemit nervor. Këto mësojnë sipas formave të ulëta të të mësuarit, ku mbisundon metoda e të mësuarit sipas refleksit të kushtëzuar dhe metoda e orvatjeve dhe e suksesit të rastit. Te disa sisorë dallohen edhe elementet e të mësuarit sipas formave më të larta të të mësuarit. Në studimet eksperimentale të psikologjisë kafshët janë objekt studimi i veçantë.

KALTËR (I, E). mb. Që ka ngjyrë të kaltër (figura, sipërfaqja e një trupi etj.). Ngjyra e kaltër është lloj i ngjyrës kromatike, kurse pasqyrimi i saj te njeriu shkakton ndijimin e ngjyrës së kaltër. Cilësinë e ngjyrës së kaltër e përcaktojnë valët elektromagnetike me gjatësi prej rreth 450 milimikron.

KAMPION, - I. m. Term i statistikës, përkatësisht i psikometrisë. Me termin kampion emërtohet koncepti i një numri të kufizuar të anëtarëve të një popullate të gjerë, që e përfaqëson numerikisht dhe cilësisht gjithë atë popullatë prej së cilës ata janë zgjedhur. Termi kampion në shqip ka zëvendësuar termin mostër që ende përdoret, por më tepër në të folurin e përditshëm, ndërkaq përdoret edhe gjedhe **– *GJEDHA***. Në hulumtimet psikologjike, si edhe në disiplinat e tjera, shpesh nuk është e mundur të provohet e gjithë popullata, si, p.sh., të hulumtohen qëndrimet e Shqiptarëve ndaj çështjes çame. Për këtë shkak bëhet përzgjedhja e përfaqësuesve që e përfaqësojnë sa më mirë dhe sa më saktë gjithë popullatën e Shqiptarëve kudo që ata gjenden. Që kampioni përfaqësues të jetë sa më i mirë cilësisht dhe numerikisht ai duhet përzgjedhur në mënyrë të paanshme. Hulumtimet me anë të kampionit shkurtojnë shumë kohën dhe mundin dhe për këtë shkak janë më ekonomike. Për të siguruar paanshmërinë e përzgjedhjes në psikometri njihen disa forma kampionesh:

a. **Kampioni i rastësishëm** – Përzgjedhje e atillë kur të gjithë anëtarët e një popullate pas verifikimit të shtrirjes së gjithë popullatës, kanë mundësi të barabarta për t`u zgjedhur në kampion dhe kur përzgjedhja e secilit kampion nuk ndikon në përzgjedhjen e tjetrit. E tillë është përzgjedhja e numrave të shkruar dhe tabelat e tyre të vogla që janë hedhur në një enë të ngjashme me lodër ose tupan. Çdo numër i nxjerrë ka vlerë të njëjtë të përfaqësimit të gjithë popullatës;

b. **Kampioni sistematik** – Përzgjedhje e barabartë e secilit anëtar të një popullate hulumtuese sipas parimit përzgjedhës të secilit anëtar të pesëdhjetë nga shtatë mijë pronarë telefonash të një lokacioni. Kështu, provojmë 350 anëtarë për qëndrimet e tyre ndaj çështjes së komunikimit të shpejtë të tyre me botën e jashtme, në vend që të provojmë gjithë popullatën e pronarëve të telefonave zyrtarë të një lokacioni etj.

KANAL, - I. m. Term i përgjithshëm që ka zënë vend në terminologjinë e psikologjisë fiziologjike dhe që ka ardhur nga teoria e informatikës. Kanali emërton sistemin e bartjes së sinjaleve prej fazës hyrëse deri në fazën dalëse. Termi kanal në psikologjinë fiziologjike emërton organin ose pjesën e organit që ka trajtë gypi dhe funksion të caktuar, duke përbërë bazën fiziologjike të dukurive dhe proceseve psikike të caktuara. Organizmi konsiderohet se është një kanal i përgjithshëm. I tillë është kanali i bartjes së impulseve nervorë nga receptorët në efektorë. Por vendndodhja, përbërja dhe funksioni karakteristik i secilit prej kanaleve të organeve të organizmit emërtohet me togfjalësh të veçantë, si:

a. **Kanali dëgjimor** – Kanali i jashtëm dëgjimor i njohur me term latin *meatus*. Kanali dëgjimor i përket pjesës së veshit të jashtëm;

b. **Kanali i kortit –** Kanal që gjendet në kërmillin e veshit dhe ka formë spirale;

c. **Kanali parakthinor** – Kanali i kërmillit të veshit të brendshëm që është i mbushur me lëng dhe reagon ndaj dridhjeve të yzengjisë duke ngacmuar organin e kortit;

d **Kanali qendror –** Kanal që shtrihet përgjatë palcës së kurrizit;

e. **Kanali rruazor –** Shtylla kurrizore e njeriut dhe e kërbishtorëve të tjerë. Në pjesën e brendshme të shtyllës gjendet kanali rruazor ose gypi i posaçëm në të cilin është e vendosur palca e kurrizit;

f. **Kanalet gjysmërrethorë e kockorë –** Tri gypa kockorë të veshit të brendshëm që përbëjnë shqisën, receptorin e ekuilibrit – bazën e ndjimeve statike dhe dinamike të njeriut.

KANON Valter (Walter CANNON). Fiziolog amerikan. Lindi më 1871 dhe vdiq më 1945. Mësimdhënës në Universitetin e Harvardit prej vitit 1906–1942. U mor me studimin e ndryshimeve fiziologjike në raport me ndryshimet motivuese dhe emocionale të njeriut. Konsiderohet se ky është farkëtues i konceptit dhe i termit homeostaza – ruajtja e kushteve konstante në organizëm për të vënë në funksionim qelizat e trupit të njeriut. Ka përshkruar hollësisht ndryshimet organike e fiziologjike në gjendje rreziku dhe stresi të organizmit, kur organizmi lëshon energjinë e madhe të kundërvënies së këtyre situatave, të luftës kundër tyre, pra në veprimtarinë për largimin nga një situatë e rrezikshme. Këtë reagim Valter Kanoni e ka quajtur "Cannon emergency function" – "Funksioni energjetik i Kanonit". Reagimin e organizmit në këtë mënyrë ia atribuon gjëndrave me sekrecion të brendshëm, sidomos sekretimit të hormonit adrenalinë. Ky reagim sipas tij zhvillohet në tri faza: 1: zvogëlimi i shtypjes së gjakut, ngritja e nivelit të qarkullimit të gjakut, gjendja shok; 2: energjia e drejtuar kundër shokut me presion të lartë të gjakut dhe me ngritje të aftësisë së agresivitetit dhe 3: gjendja e molisjes së organizmit. Vepra kryesore e tij është: *"Bodily Changes in Pain, Hunger, Fear and Rage"* – (*"Ndryshimet trupore në dhembje, në gjendje urie, zjarrmie dhe xhindosje"),* botuar më 1929.

KANUNI MORGAN. Kanuni i fiziologut dhe psikologut britanik Konuej Llojd Morgan (Conwey Lloyd Morgan, 1852 – 1936). Sipas këtij kanuni "një veprim në asnjë rast nuk guxojmë ta shpjegojmë si rezultat të një aftësie psikike më të lartë, po qe se ai mund të shpjegohet si rezultat i aftësisë sipas një shkalle psikologjike më të ulët". Ky kanun i formuluar që nga viti 1894 ushtroi ndikim në studimet e disa bihejvioristëve, me në krye Xhon B. Uatson (John B. Watson, 1878 – 1958).

KAPACITET, - I. m. I ardhur nga latinishtja *capacitates* që emërton sasinë e informacioneve, të koncepteve, të përfytyrimeve etj., që ka një strukturë psikike, që bart një kanal etj. Në psikologji termi kapacitet ka kuptimin e aftësisë (dikur, fillimi i gjysmës së parë të shekullit njëzet, është folur për psikologjinë e kapaciteteve dhe është bërë fjalë për numrin e aftësive të njeriut).

KAPACITETI I KANALIT. Kapaciteti i kanalit është term i informatikës që emërton sasinë maksimale

të informacioneve që kanali mund të bartë brenda një njësie kohore të matur me bit në sekondë.

KAPACITETI I KUJTESËS AFATSHKURTËR. Kapaciteti i kujtesës afatshkurtër është sasia e informacioneve të reja që mund të merren brenda pak minutash nga ana e kujtesës afatshkurtër. Kapaciteti i kujtesës afatshkurtër është i vogël. Rezultatet e shumë hulumtimeve bashkëkohore kanë treguar se kapaciteti i kujtesës afatshkurtër është rreth shtatë informacione, përkatësisht 7 plus 2 ose 7- 2. Shih ***– KUJTESA AFATSHKURTËR.***

KARAKTER, - I. m. I ardhur nga greqishtja *χαραχτήρας* "mbresë, skalitje" dhe i ngulitur në gjuhën shqipe dhe në terminologjinë shqipe të psikologjisë dhe të etikës. Në kuptimin e përgjithshëm karakteri është personalitet i bindjeve, i qëndrimeve dhe i përmbajtjes parimore të tyre në sjelljet e përgjithshme të tij. Në psikologji termi karakter dallohet me vështirësi nga kuptimi i termit personalitet, madje në disa burime psikologjike, si në ato të Gordon V. Olportit (Gordon V. Alport, 1897 – 1967), flitet vetëm për personalitetin. Karakteri është tërësi tiparesh të veçanta të personalitetit që kanë të bëjnë kryesisht me tiparet emocionale-motivuese dhe morale dhe me konsekuencën e sjelljeve të tij, në bazë të parimeve dhe normave morale. Në bazë të këtyre tipareve personaliteti i një njeriu dallohet nga të gjithë të tjerët. Ky unitet tiparesh të personalitetit zhvillohet dhe formohet gjatë të mësuarit dhe socializimit të fëmijës. Bazën psikologjike të tipareve të unisuara të karakterit e përbëjnë qëndrimet, ndjenjat e larta dhe vlerat shoqërore që realizohen në veprimtarinë e vullnetshme të njeriut.

KARAKTERI ANAL. Strukturë e organizuar tiparesh të karakterit me "fije" lidhëse të saj me fazën anale të zhvillimit të individit. Themeluesi i psikanalizës Zigmund Frojdi (Sigmund Freud, 1856 – 1939) e ka përshkruar këtë strukturë të organizuar tiparesh me tri tipare mbisunduese: kryefortësia, koprracia dhe pedantëria. Dy tiparet e para (kryefortësi dhe koprracia) zhvillohen nga lëvizja e shtytësit anal, e kënaqësisë anale, përkatësisht nga sublimimi i energjisë së shtytësit anal dhe shndërrimi i energjisë së tij në kokëfortësi dhe koprraci. Pedantëria buron nga mbrojtja e individit nga energjia dhe impulset e fazës anale.

KARAKTERI AUTORITAR. Term i neopsikanalistit me prejardhje gjermane Erik From (Erich Fromm, 1900 – 1980). Karakteri autoritar është organizim i integruar i tipareve të sjelljeve të atyre individëve, të cilët verbërisht i nënshtrohen autoriteteve mbi veten e tyre, por njëkohësisht i mundojnë tmerrësisht ata që gjenden nën veten e tyre. Erik From ka gjetur mbështetjen e tyre në tiparet sado mazohiste dhe këtë e ka shfaqur haptas në veprën e tij "Arratisja nga liria".

KARAKTERI BIOFIL. Strukturë tiparesh e integruar e personalitetit të njeriut, në të cilin mbisundon dashuria për jetën, për zhvillimin, për rritjen, për kënaqësi që jeta i jep njeriut etj. dhe kjo dashuri ka shtrirje të përgjithshme. Kjo është dashuri ndaj jetës së të gjithëve, dashuri ndaj zhvillimit

të përbashkët jo vetëm të njerëzve të një mjedisi, por përgjithësisht ndaj njerëzisë. Karakteri biofil është term i konceptit të Erik Fromit, sipas të cilit karakteri biofil i njeriut i drejton fuqitë e veta jo vetëm në zhvillim dhe në rritje, por në zhvillimin dhe afirmimin e aftësive krijuese të njeriut. Ky pasion i dashurisë është pasion parësor i jetës dhe i zhvillimit të njeriut.

KARAKTERI FALUSOR. Në psikanalizë emërton konceptin e njeriut që ka tipare të sjelljeve të fazës falusore të zhvillimit psikoseksual të tij. Tipar kryesor i sjelljeve të njeriut me karakter falusor është organizimi dhe shfaqja e sjelljeve të fuqishme, guximtare, trimërore e luftarake. Sipas psikanalistit hungarez me origjinë hebraike Vilhelm Rajh (Wilhelm Reich, 1897 – 1957) karakterin falusor e karakterizojnë tiparet e përmendura si edhe hakmarrja, narcizmi, pafytyrësia, synimi për të qenë i pari në çdo aktivitet etj. V. Rajh konsideron se organi mashkullor shërben për hakmarrje ndaj botës femërore dhe më pak për dashuri ndaj femrave.

KARAKTERI GJENITAL. Karakter i formuar i një individi, i cili i ka kaluar me sukses të gjitha fazat paraprake të zhvillimit psikoseksual. Karakteri gjenital i përket individit të pjekur, i cili ka këto veçori: ka raport real me mjedisin dhe ndryshimet e tij, përfshirë edhe njerëzit e atij mjedisi, ka arritur baraspeshim emocional, di të dashurojë pa imponim, ka formuar ndjenjën e përgjegjësisë, di ta përjetojë kënaqësinë e tij në punë etj.

KARAKTERI NEUROTIK. Organizim i posaçëm i tipareve kryesore të karakterit të njeriut, sipas psikologjisë individuale të Alfred Adlerit (Alfred Adler, 1870 – 1940), me anën e të cilave ai mbrohet nga vlera e mangët e tij. Tiparet e një karakteri të tillë janë: egoizmi, inati, kokëfortësia, mosbesimi etj. që çlirohen me vështirësi nga tiparet e organizuara në karakterin e njeriut. Tiparet e karakterit të tillë mund të jenë bazë e manifestimit të neurozave, përkatësisht të sjelljeve neurotike. Termi karakteri neurotik haset edhe në literaturën popullore dhe, zakonisht, përdoret për të emërtuar forma të ndryshme të çrregullimeve neurotike të njeriut.

KARAKTERI NË PSIKANALIZË. Në psikanalizën e Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939) zhvillimi i karakterit i atribuohet zhvillimit të libidos dhe sipas këtij zhvillimi Frojdi ka përcaktuar karakterin oral, anal etj. Duke ju vënë kundër kësaj pikëpamjeje Erik From (Erich Fromm, 1900 – 1980) dhe Karen Hornaj (Karen Horney, 1885 – 1952) konsiderojnë se baza e zhvillimit të dhe e formimit të karakterit gjendet në organizmin e mjedisit shoqëror dhe në raportet ndërnjerëzore të këtij mjedisi. Në psikologjinë individuale të Alfred Adlerit (Alfred Adler (Alfred Adler, 1870 – 1937) karakteri ka kuptim të posaçëm. Sipas tij karakteri është mënyrë e posaçme e plotësimit të synimit për mbisundim.

KARAKTERI OBSESIV. Sjellje karakteristike e atyre individëve, te të cilët paraqitet vazhdimisht rregulli, rendi dhe disiplina në veprimtarinë e gjithëmbarshme të tyre, si edhe mbështetja e argumentuar e qëndrimeve të ngurta të tyre. Sipas psikanalizës karakteri obsesiv është kthimi i zhvillimit

të sjelljeve të individit në fazën analosadiste dhe për këtë shkak te ai zhvillohen sjellje karakteristike të natyrës konfliktuale në raportet mbisundim – nënshtrim, sjellje të vrazhda – sjellje të buta, të kujdesshme, sjellje të mençura – sjellje të nxitura nga emocionet.

KARAKTERI ORAL. Organizim tiparesh karakteristike të sjelljeve të njeriut që rrjedhin nga faza orale e zhvillimit psikoseksual. Këto sjellje kanë të bëjnë me kënaqësinë e njeriut nga erotizmi oral. Përqendrimi i gjatë i sjelljeve të kësaj faze është rrjedhojë e pranisë së fazës orale të zhvillimit psiko-seksual të fëmijës.

KARAKTERI RECEPTIV. Cilësi e tipareve të personalitetit shumë pasiv ndaj mjedisit e ndryshimeve të tij. Termi karakter pasiv i përket pikëpamjeve psikologjike të psikanalistit amerikan të lindur në Gjermani Erik Fromit (Erich Fromm, 1900 – 1980).

KARAKTERISTIKAT METRIKE TË TESTEVE. Karakteristika themelore dhe të domosdoshme të një instrumenti matës në psikologji mbi vlerat e të cilave psikologu merr vendim për shkallën e zhvillimit të inteligjencës, për qëndrimin, për tiparin e personalitetit etj. Vetëm fletëpalosja, shkalla e matjes së qëndrimeve, testi etj. që kanë karakteristika metrike mundësojnë saktësinë e matjes së ndryshoreve psikologjike. Karakteristikat metrike të testeve janë: **vlefshmëria ose validiteti**, kur instrumenti matës (testi) mat vërtetë atë për të cilën është konstruktuar, **besueshmëria ose reliabiliteti**, kur rimatja me të njëjtin instrument në kushte dhe rrethana të njëjta jep rezultate të njëjta ose shumë të ngjashme, **ndjeshmëria** e instrumentit matës, që është shkalla e dallimit të ndryshimeve më të vogla në intensitetin e një ndryshoreje psikologjike dhe **objektiviteti** i instrumentit matës, që ka të bëjë me pavarësinë e rezultateve të arritura nga faktorët subjektivë. Testi, shkalla vlerësuese e tipareve të personalitetit, e qëndrimeve etj. që nuk ka karakteristika dhe rezultate të arritura me instrumentet matëse pa karakteristika metrike nuk mund të ketë vlera diagnostikuese dhe të prognozës.

KARAKTEROLOGJI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *character* "mbresë, skalitje" dhe *logos* "shkencë". Karakterologjia nisi zhvillimin e saj me përcaktimin e shenjave karakteristike organike dhe morfologjike, si madhësia e ballit të kokës, shuplaka e dorës, gjatësia e gishtërinjve etj. Në këtë mënyrë karakterologjia mori karakterin e pseudoshkencës. Më pas karakterologjia u konsiderua shkencë mbi karakterin. Merret me studimin e karakterit, të tipareve të tij dhe me zhvillimin, organizimin dhe formimin e tyre, duke përfshirë edhe shkallën e ndërlidhjeve të tyre. Nismëtar i kësaj disipline konsiderohet se është mendimtari grek Erozosias Teofrasti (Erozosia Theofrast, rreth 372 – 288 p. e. r.), që botoi veprën e tij të përkthyer edhe në shqip "Karakteret". Por, themelues i vërtetë i kësaj disipline ka qenë J. Bausen, që arriti ta afirmojë prej dekadës së tretë të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Sot karakterologjia i përket së kaluarës. Me studimin e karakterit merret psikologjia e personalitetit.

KARIZ/ËM, - MA. f. Në psikologjinë politike i ardhur nga anglishtja

charisma. Karizma emërton tërësinë e cilësive karakteristike të një individi udhëheqës i sektit fetar, i partisë politike, i shtetit etj. të një vendi, që e dallojnë nga të gjithë të tjerët, duke përbërë në këtë mënyrë konceptin e një personaliteti të veçantë me ndikim të fuqishëm në rrjedhat fetare, politike, sociale etj.

KASTRIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *castratio* "tredhje". Shih **– *TREDHJA*.**

KATABOLIZ/ËM, - MI. m. Proces i ndërlikuar kimik dhe fizik i shthurjes së strukturave trupore, sidomos i protoplazmës dhe qelizave, si edhe i proceseve ndërlidhëse të tyre. Katabolizmi është term i fiziologjisë, por ka kuptim psikologjik të veçantë. Mbi procesin e katabolizmit shprehet Zigmund Frojdi (Sigmund Freud, 1857 – 1939), kur e përcakton atë si themelin biologjik të shtytësit të vdekjes. Përballë procesit katabolik gjendet procesi me funksion të kundërt, procesi anabolik dhe këto dy procese formojnë metabolizmin.

KATAFAZI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *κατά* "gjatë, teposhtë" dhe *φαση* "të folur". Katafazia është përsëritje e fjalëve dhe e frazave të njëjta dhe me të njëjtin stil, pa lidhje me situatën foljore dhe as me përmbajtjen e tyre.

KATALEKSI, - A. f. Dukuri patologjike që shfaqet në prirjen e përsëritjes së fjalëve të papërshtatshme gjatë procesit të leximit të një teksti. Kataleksia shpesh konsiderohet se është formë e lehtë e disleksionit.

KATALEPSI, - A.f. I ardhur nga greqishtja *κατάληψη* "shtangim, ngrirje". Katalepsia është çrregullim psikomotorik që shfaqet me shtangie të muskujve të trupit, kryesisht të gjymtyrëve. Katalepsia është pasojë e çrregullimit të tonusit të muskujve. Kjo gjendje zgjat dhe ai që vuan nga një çrregullim i tillë psikomotorik nuk arrin t`i realizojë dëshirat, nevojat dhe as synimet e tij. Katalepsia shpesh realizohet nën ndikimin e hipnozës. I sëmuri nga katalepsia nuk reagon ndaj ngacmuesve të jashtëm, si edhe ndaj atyre që shkaktojnë dhembje. Shtangimi i tillë mund të jetë simptomë e katatonisë, e skizofrenisë etj.

KATAPLEKSI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *κατά* "poshtë" dhe *πληξη* "rënie". Katapleksia është humbje e papritur e tonusit muskular, që shpesh shkaktohet nga përjetimi i gjendjeve emocionale të fuqishme dhe të befasishme, nga gjendja shokuese, sidomos prej afekteve. Shpesh katapleksia është simptomë e narkolepsisë.

KATARAKT/Ë, - A. m. I ardhur nga latinishtja *cataracta* "perde në sy" që është një lloj sëmundje e syrit që shfaqet me një perde përpara kokërdhokut të syrit, me humbje të pjesshme ose të tërësishme të tejdukshmërisë së kristalinit të syrit. Është ndër sëmundjet e shpeshta të syve. Ka disa lloje kataraktash: kataraktë e butë - "cataracta molle", kataraktë e fortë – "cataracta dura", kataraktë e pjekur e pleqërisë – "cataracta mature senile" dhe kataraktë progresive – "cataracta progressive". Më shpesh haset katarakta e pleqërisë, që shfaqet në forma të posaçme dhe paraqitet zakonisht pas moshës 45-vjeçare. Katarakta progresive është turbullim gjithnjë e më i madh i pamjes. Ka disa shkaqe, ndër të cilat dallohen: helmimi me lëndë kimike, sëmundja e sheqerit ose

"diabetisi", ndikimi i rrezeve ultra të kuqe, i rrezeve rëntgen, i rrezeve të furishme të rrufesë, etj. Shërimi është i mundur me anë medikamentesh të posaçme, por zakonisht me anë ndërhyrjesh kirurgjikale**.**

KATARSIS. asnj. I ardhur nga greqishtja *cathairo* "pastroj". Katarsis ka kuptim të përgjithshëm si term i përdorur në mjekësi, në letërsi dhe në psikanalizë. Në letërsi me katarsis kuptojmë çlirimin dhe qetësimin e shpirtit, qetësimin e gjendjes së tensionuar emocionale, duke u përqendruar në gjendjen e personazheve letrare, të dramës dhe të komedisë. Me këtë kuptim është përdorur nga Aristoteli (Aristotel, 384 – 322 p.e.r.). Sipas tij është pastrim i afekteve dhe i pasioneve nga shpirti i njeriut, që përjeton shikuesi i një drame, tragjedie etj. në rolin e një personazhi skenik, i cili nëpërmjet vuajtjeve fiton urtësi e qetësi shpirtërore. Katarsis në psikanalizë shpjegohet si zvogëlim i tensionit psikik të individit, kur ai shpreh rishtas përvojat patogjene, që "pastrohen" nga shpirti i tij dhe individi çlirohet nga ato përvoja patogjene dhe nga emocionet negative të lidhura me këto përvoja.

KATASTROFIZ/ËM, - MI. m. Dukuri mendore që karakterizon më tepër ata që vuajnë nga depresioni i madh. Katastrofizmi shfaqet në përfytyrimet, në mendimet dhe në qëndrimet negative të përhershme, që do të pasojnë në të ardhmen e tij, të familjes dhe të afërmve të vet. Këto mendime dhe qëndrime negative të qëndrueshme manifestohen në pohimet se së shpejti atë do ta godasë katastrofa (asgjësimi nga zjarri i madh, shkatërrimi nga fatkeqësia e përmbytjes nga shirat e mëdhenj e të pandërprerë etj.) Për këtë ai fajëson veten duke pohuar se kjo e keqe e madhe është pasojë e gabimeve që ai ka bërë.

KATATONI, - A. f. Formë e skizofrenisë që karakterizohet nga ngrirja e tërësishme psikomotorike e trupit dhe e gjymtyrëve. Katatonia konsiderohet se është simptomë serioze e sëmundjeve psikike, si skizofrenia, depresioni, çrregullimi pas traumatik i stresit etj. Katatonia ka dy karakteristika themelore: palëvizshmërinë psikomotorike (stupori katatonik) dhe aktivitetin e shtuar motorik të vetvetishëm, që nuk nxitet nga ngacmuesit e jashtëm. Katatonia u përshkrua për herë të parë që nga mbarimi i shekullit nëntëmbëdhjetë.

KATEGORI, - A. f. Term i qëndrueshëm në terminologjinë e filozofisë i ardhur nga greqishtja, që përdoret në psikologji dhe në psikometri. Në psikologji emërton konceptin më të gjerë një tërësie mendore të një klase të caktuar individësh. Konceptet mentalitet, psikikë, sjellje etj. kanë si karakteristikë kategorinë. Termi buron nga filozofia e Aristotelit (Aristotel, 384 – 322 p.e.r.). Në psikometri termi kategori emërton konceptin e ndarjes së të dhënave të përftuara nga matja e caktuar e një ndryshoreje psikologjike në grupe të veçanta sipas shtrirjes dhe cilësive të tyre, por duke zbatuar me përpikëri parimet dhe kriteret e ndarjes së të gjitha të dhënave.

KATEGORITË E PRAPAMBETJES MENDORE. Psikologjia bashkëkohore njeh katër kategori të prapambetjes mendore, të tilla si: 1) Kategoria

e lehtë e prapambetjes mendore; 2) Kategoria e mesatare e prapambetjes mendore; 3) Kategoria e rëndë e prapambetjes mendore dhe 4) Kategoria shumë e rëndë e prapambetjes mendore. Kategorisë së prapambetjes mendore të lehtë i përkasin ata individë që arrijnë koeficientin e inteligjencës prej 0.70 deri në 0.55, kategorisë së prapambetjes mesatare i përkasin ata individë, të cilët kanë koeficient të inteligjencës prej 0.55 deri në 35, të kategorisë së prapambetjes së rëndë i përkasin ata individë, të cilët arrijnë koeficientin e inteligjencës prej 0.35 deri 0.20 dhe kategorisë me prapambetje shumë të rëndë të inteligjencës i përkasin ata individë që kanë koeficient të inteligjencës nën 0.25. Në shkallën e shpërndarjes ose të distribucionit më shumë raste ka kategoria me prapambetje mendore të lehtë dhe nën mesatare, më pas vjen kategoria e prapambetjes së rëndë dhe më pak raste ka kategoria shumë e rëndë e prapambetjes mendore.

KATEKOLAMINAT. Nëngrup i neurotransmetuesve që hyjnë në grupin e aminobiogjenetikëve. Në këtë nëngrup hyjnë dopamina dhe noradrenalina, si edhe hormonet e thelbit të gjëndrës mbiveshkore, përkatësisht adrenalina dhe noradrenalina, që luajnë rol të rëndësishëm në reagimet stresante të organizmit.

KATEKS/Ë, - A. f. I ardhur nga greqishtja *κaδηεσης* "ruajtja". Sipas psikanalizës kateksa është investimi i sasisë së energjisë të një shtytësi, të libidos në një objekt, të një individi, një procesi etj. dhe pushtimi i objektit nga kjo energji, me qëllim të plotësimit të nevojës së shtytësit të caktuar. Zigmund Frojdi (Sigmund Freud, 1856 – 1939) e ka shpjeguar kuptimin e kateksës, duke bërë krahasimin e saj me ngarkesën elektrike që përçon një objekt të caktuar, duke e pushtuar atë objekt.

KATEL Rejmond (Raymond CATELL). Psikolog anglez dhe amerikan. Lindi në Uest Bromvik pranë Birmingamit (West Bromwich) më 20.03.1905 dhe vdiq në Honolulu, Havai (Hawaii) më 1998. Pas përfundimit të studimeve për kimi në Universitetin e Londrës, u përqendrua në studime psikologjike. Student i Çarls Spirmanit. Në Angli nuk qëndroi shumë kohë. Iu përgjigj pozitivisht ftesës së Eduard Torndajkut dhe filloi punë në fillim në Universitetin Klark (Clark), më pas në Universitetin e Harvardit dhe në Ilinois, ku ngriti Institutin për Testimin e Personalitetit dhe të Aftësive. U mor kryesisht me studimin e metodave empirike-statistikore dhe zbatimin e tyre në gjurmimin e personalitetit dhe të strukturës së inteligjencës. Është ndër themeluesit e analizës faktoriale. Me zbatimin e kësaj metode hartoi testin e personalitetit, ku përcaktoi 16 dimensionet e personalitetit. Ky test u quajt "16 – PF – Test". Rejmond Kateli njihet edhe nga disa koncepte të reja të tij në fushën e strukturës së inteligjencës: inteligjencia fluide dhe inteligjencia e kristalizuar janë koncepte që u përkufizuan nga ana e tij. Gjykuar sipas metodave gjurmuese të tij Rejmond Kateli ka synuar zhvillimin e psikologjisë të mbështetur në metoda ekzakte. Veprat kryesore të tij janë: *"The description and measurement of personality"* – (*"Përshkrimi dhe matja e personalitetit"*), *1946; "The meaning and measurement of*

neurotism and anxiety" – (*"Kuptimi dhe matja e neurotizmit dhe e ankthit"*), 1961; *"The scientific analysis of personality"* – (*"Analiza shkencore e personalitetit"*), 1966; *"Abilities: their Structure, Growth and Action"* – (*"Aftësitë: struktura, rritja dhe veprimtaria"*), 1971.

KAUZ/Ë, - A.f.I ardhur nga latinishtja *causalis* "shkak". Kauza është vlerësim i lartë i një çështjeje, duke e konsideruar atë shkak të veprimeve dhe të shkatërrimit të ndjenjave të veçanta ndaj asaj çështjeje. E tillë është kauza ndaj atdheut, kombit, lirisë së popullit etj.

KAUZALITET, - I. m. Sipas filozofisë kauzaliteti emërton konceptin abstrakt, sipas të cilit për dy dukuri, ndodhi, procese që janë të lidhura njëra me tjetrën konsiderohet se dukuria paraprake është shkak i dukurisë së pastajme, përkatësisht pasojë, rrjedhim i dukurisë paraprake. Përcaktimin e kauzalitetit ndërmjet dukurive e mundëson metoda e eksperimentit.

KAUZALITETI PSIKOLOGJIK. Raporti ndërmjet shkakut dhe rrjedhimit të dukurive, funksioneve, proceseve dhe tipareve psikologjike dhe raporti i përmasave shkak-rrjedhim të tyre. Në kuptimin e përgjithshëm jeta psikike dhe të gjitha dukuritë e saj kanë shkakun (shkaqet) e lindjes, përmasat e zhvillimit dhe shkaqet e ndryshimit të tyre. Shpjegimi i tyre kërkon domosdoshmërisht identifikimin e shkakut në raport me pasojën, përkatësisht të nevojës, të motivit dhe të sjelljes së një individi të caktuar. Psikologjia ka detyrë imediate njohjen e këtyre shkaqeve dhe identifikimin e plotë të raporteve ndërmjet tyre. Njohja e sjelljeve të shumëllojshme të njeriut është e lidhur në rend të parë me njohjen e shkaqeve, e pikërisht të motiveve të vetëdijshme dhe të pavetëdijshme të secilës sjellje.

KELLI Xhorxh Aleksandër (George Aleksander KELLY). Psikolog amerikan. Babai i psikologjisë klinike kognitive. Lindi më 1905 në Kansas dhe vdiq më 1967. Pas përfundimit të studimeve për fizikë e matematikë u regjistrua për master në psikologji, të cilin e përfundoi në Universitetin Shtetëror të Ajovas (Iowa), madje ku dhe doktoroi më 1931. U dallua më tepër në disiplinën e psikologjisë klinike. Ka punuar në Universitetin shtetëror "Fort Hays" (Kanzas), kurse gjatë zhvillimit të operacioneve luftarake në Luftën II Botërore ka punuar psikolog i aeoronautikës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Pas përfundimit të luftës punoi një vit në Universitetin Meriland, kurse më pas në Universitetin Shtetëror të Ajovas, ku zëvendësoi psikologun Karl Roxhers në cilësinë e drejtorit të Programit Klinik të Psikologjisë. Xhorxh Aleksandër Keli është konceptues i teorisë së konstrukteve të personalitetit. Sipas kësaj teorie konstruktet e personalitetit janë shumë të ngjashme me qëndrimet, por meqë kanë edhe elemente të pavetëdijshme disa prej këtyre konstrukteve është vështirë të përkufizohen. Në kuadrin e teorisë së konstrukteve të personalitetit ka bërë këtë klasifikim të konstrukteve: 1) Konstrukte të sistemit të mbyllur – konstrukte që nuk lejojnë depërtimin e elementeve të rinj; 2) konstrukte të sistemit të hapur – konstrukte të hapura për elementet e ri; 3) konstrukte parësore – konstrukte që nuk lejojnë që ndonjë pjesë e përmbajtjes së një konstrukti

të kalojë në konstruktin tjetër; 4) konstrukte konsteluese – konstrukte që ruajnë pandryshueshmërinë e elementeve; 5) konstrukte propozicionale – konstrukte që lejojnë elemente e tyre të kalojnë në përmbajtjen e konstrukteve të tjera; 6) konstrukte të gjera – konstrukte me shtrirje përmbajtjesore të gjerë; 7) konstrukte të kufizuara – konstrukte që kanë elemente të pakta; 8) konstrukte shtyllore – konstrukte që kanë mbështetje vetëm në përmbajtjen e tyre, që ndryshojnë me vështirësi, duke i krijuar personalitetit vështirësi në sjellje; 9) konstrukte periferike – konstrukte që ndryshojnë lehtë; 10) konstrukte pushtuese – konstrukte që shpien në paraparje të njëjta; 11) konstrukte fluide – konstrukte që lejojnë ndryshueshmërinë e parashikimeve, në varësi nga kushtet. Kjo teori ka zënë vend të dalluar ndër teoritë shpjeguese të personalitetit. Lidhur me këtë ekziston edhe Testi Keli. Vepra kryesore e tij është: *"The Psychology of Personal Construcs"* – (*"Psikologjia e konstrukteve të personalitetit"*), botuar më 1955.

KËLER Volfgang (Wolfgang KÖHLER). Psikolog gjerman. Lindi në Revel (Estoni) më 21.01.1887 dhe vdiq në Lebanon të Nju Jorkut më 11.06.1967. Por, meqë prej vitit 1924 jetoi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës Volfgang Këlerin e konsiderojnë psikolog amerikan. Ka studiuar në Tybingen, në Bon dhe në Universitetin e Berlinit. Nxënës i psikologut Karl Shtumpf. Pas përfundimit të studimeve u zgjodh asistent në Universitetin e Frankfurtit. Në prag të Luftës II Botërore, më 1913 u zgjodh drejtor i Qendrës Antropologjike të Akademisë Pruske të Shkencave në Tenerif, ku u mor me studimin e zhvillimit të inteligjencës te majmunët. Pas provave në këtë siujdhesë u kthye në Gjermani më 1920 dhe u emërua profesor i psikologjisë në Universitetin e Gëtingenit; një vit më vonë, më 1921 profesor në Universitetin e Berlinit. Anëtar i Shkollës së Berlinit. Së bashku me Maks Verthajmerin dhe Kurt Kofkën më 1921 krijuan revistën "Psychologische Forschung" – "Gjurmime psikologjike" që u botua deri më 1938. Më 1935 emigroi përfundimisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku punoi si profesor i psikologjisë në kolegjin Svorthmor (Swarthmore), derisa doli në pension. Më pas e vazhdoi aktivitetin e tij në kolegjin Darmut. Ka qenë Kryetar i Shoqatës së Psikologëve Amerikanë dhe anëtar i Akademisë Kombëtare të Shkencave. Volfgang Këleri në psikologji ka mbetur i njohur më tepër me provat e bëra me majmunë në siujdhesën Tenerif dhe me rezultatet e këtyre provave. Këto prova dhe rezultatet e arritura i botoi më 1917 në gjermanisht dhe përmbajtjen e këtij botimi të rishikuar e botoi në anglisht dhe në frëngjisht pas vitit 1924. Ndër rezultatet e provave të tij dallohen ato që vërtetuan se majmunët nuk mësojnë vetëm në bazë të metodës së orvatjeve dhe gabimeve, por edhe në bazë të mëtimit të marrëdhënieve ndërmjet mjeteve dhe objektit, përkatësisht ndërmjet shkopinjve të mundshëm për t`u ngjitur njëri me tjetrin; duke u bërë më të gjatë majmunët arritën të marrin bananen e varur në tavan dhe të ushqehen me të. Veprat kryesore të tij janë: *"Intelligenzprufungen an Menschenaffen"* – (*"Të provuarit e inteligjencës së majmunëve-njeri"*), 1917; "*Gestalt*

Psychology: An Introduction to New Concepts in Modern Psychology" – ("*Psikologjia Geshtalt: Hyrje në konceptet e reja të psikologjisë moderne"*), 1957. Ka botuar disa trajtesa me vlerë të posaçme.

KËMB/Ë, - A. f. Gjymtyrë e poshtme e njeriut ose e kafshëve që përbëhet nga tri pjesë kryesore: nga pjesa e sipërme, nga pjesa e nën gjurit dhe nga shputa e këmbës. Këto tri pjesë janë të ndërlidhura organikisht ndërmjet tyre. Pjesa mbi gju lidhet me pjesën e skeletit të trupit me anën e ashtit iliak. Muskujt e këmbës janë muskuj skeletorë ose muskuj të gjatë, me anën e të cilëve kryhen lëvizjet e këmbëve.

KËNAQËSI, - A. f. Emocion elementar i lidhur më tepër me të dhëna shqisore. Kënaqësia është cilësi emocionale e një poli të kundërt me pakënaqësinë. Lidhet me realizimin e një qëllimi të caktuar, me plotësimin e motiveve dhe zvogëlimin e tendosjes së organizmit, si edhe me dëshirën e subjektit që gjendja e tillë emocionale të zgjasë sa më shumë. Bihejvioristët e përcaktojnë kënaqësinë si gjendje të brendshme të organizmit të angazhuar në sjellje të veçanta të organizmit, duke përjashtuar llojet e tjera të sjelljeve. Kënaqësia shfaqet pas muajit të tretë të lindjes së fëmijëve dhe ka bazë neurofiziologjike..

K

KËNDVËSHTRIMET MBI ÇRREGULLIMET PSIKIKE. Çrregullimet psikike janë të shumëllojshme dhe, rrjedhimisht, pikëpamjet dhe këndvështrimet mbi shkaqet e tyre janë të ndryshme. Lidhur me këtë, në tekstet psikiatrike dallohen disa këndvështrime:

a. **Këndvështrimi bihejviorist** – Këndvështrim që i shpjegon çrregullimet psikike si rezultat i çrregullimeve të mësuara, ku mbizotëron forma e kushtëzimit emocional dhe zhvillimi zinxhir i reagimeve emocionale të mësuara gabimisht. Çrregullimet psikike të mësuara kanë të bëjnë me formim të sjelljeve jonormale të individit të caktuar

b. **Këndvështrimi biologjik** - Këndvështrim që i shpjegon çrregullimet psikike dhe sjelljet jonormale si produkte të faktorëve organikë të lindura dhe të çrregullimit të funksioneve të tyre; çrregullimet psikike janë pasojë e prishjes së ekuilibrave neurokimike të organizmit;

c. **Këndvështrimi bio-psikosocial** – Këndvështrim që i shpjegon çrregullimet psikike dhe sjelljet jonormale të lidhura me to si rezultat i faktorëve të ndërlidhur biologjikë, psikologjikë dhe socialë;

d. **Këndvështrimi humanist** – Këndvështrim që i shpjegon çrregullimet psikike dhe sjelljet jonormale të njeriut në bazë të shkaqeve të keqpërshtatjes së tij dhe përforcimit të skemave të lidhura me keqpërshtatje;

e. **Këndvështrimi socio-kulturor** – Këndvështrim që i konsideron çrregullimet psikike dhe sjelljet jonormale produkte të raporteve jofavorizuese familjare, shoqërore dhe mjedisore të gjera.

KËRKESA NEUROTIKE. Në teorinë e personalitetit të Karen D. Hornej (Karen D. Horney, 1883 – 1952) nënkupton kërkesën e njeriut neurotik që manifestohet me ndjenjën e fuqishme të superioritetit mbi të tjerët. Kërkesa neurotike shtrihet në ndjenjën e superioritetit, në mendimin dhe në pritjen e njeriut neurotik për t`ia plotësuar të tjerët dëshirat, nevojat dhe synimet.

KËRMILLI I VESHIT. Strukturë e veshit të brendshëm, që është e zhvilluar në trajtë të përdredhur, ka formën e spirales gypore ashtore dhe është bartës i receptorëve të dëgjimit të toneve dhe zhurmave. Në terminologjinë e anatomisë së veshit kërmilli emërtohet me termin latin *kohlea*. Kërmilli i veshit te njeriu ka bazë relativisht të gjerë, që vjen duke u ngushtuar deri në majë të kërmillit. Përbëhet nga tre gypëza paralelë mbështjellës të mbushur me lëng. Këta gypa quhen gypi i shkallës vestibulare, i shkallës kohleare ose media dhe gypi i shkallës së timpanit. Gypëzat e shkallës së vestibulit dhe të shkallës kohleare a mediale ndahen njëri nga tjetri me anë të cipës bazilare. Në cipën bazilare gjendet organi i kortit, që përbëhet edhe nga qelizat receptore të dëgjimit. Gypi i shkallës vestibulare dhe i shkallës së timpanit janë të mbushur me perilimfë, kurse ai i shkallës media është i mbushur me endolimfë. Valët ajrore që depërtojnë në kërmill e trazojnë lëngun e kërmillit duke kaluar nga kulla, çekiçi dhe yzengjia; dridhja e tyre ngacmon qelizat receptore të organit të kortit.

KËRSHËRI, - A. f. Dëshirë e njeriut për të parë e dëgjuar diçka, me qëllim të njohjes së dukurive, raporteve dhe cilësive të tyre. Kërshëria ka përmasë të motivit, sepse nxit, drejton dhe organizon veprimtarinë kognitive të njeriut që ai ta njohë sa më mirë realitetin.

KËSHILLIMORET PËR ZGJEDHJE TË PROFESIONIT. Institucion profesional që ka detyrë këshillimin e të rinjve me rastin e zgjedhjes së profesionit jetësor, të degës së studimeve, që do të përputhet më së miri me dëshirën, me interesin, me aftësitë psikofizike të të riut (me tiparet karakteristike të personalitetit të këshilluesit), me kërkesat e profesionit të caktuar dhe me nevojat shoqërore. Në ekipin këshillues të këshillimores për zgjedhjen e profesionit marrin pjesë: mjeku, psikologu, punëtori social dhe këshilltari për zgjedhjen e profesionit.

KËSHILLIMORET PSIKOLOGJIKE. Institucion profesional për dhënie këshillash psikologjike individëve, grupeve dhe organizatave shoqërore që kanë hasur situata të vështira në jetën e përditshme nga shtypja nga jashtë, nga konflikte interesash të brendshme, nga konflikte të paparashikueshme etj. dhe që gjenden në situata të vështira për jetën dhe veprimtarinë normale të tyre. Në rastet e këtilla në këshillimore psikologjike nuk bëhet fjalë për psikoterapi, por për aftësim të individit për t`u ballafaquar me situata të tilla dhe për t`i zgjidhur ato në bazë të angazhimit maksimal të aftësive të tij. Këshillimorja psikologjike në shoqërinë bashkëkohore është forma më e përhapur e psikologjisë zbatuese ose aplikative në institucionet arsimore, shëndetësore dhe në organizata ekonomike. Veprimtaria e këshillimoreve psikologjike kërkon psikologë, njohës të mirë dhe të afirmuar në fushën e psikologjisë së personalitetit dhe të teorive të personalitetit.

KIAZMA OPTIKE. Në anatominë e syrit i ardhur nga latinishtja *chiasma opticum* "kryqëzorja pamore". Kiazma optike është pika e bazës së trurit, ku fijezat e nervave optike lidhen dhe ndahen njëra nga tjetra.

KIBERNETIK/Ë, - A. f. I ardhur nga greqishtja *κυβερνητικός* "drejtoj anijen". Disiplinë shkencore e veçantë që studion sistemet organike dhe inorganike, rrjedhjen e informacioneve dhe veprimet drejtuese operacionale të aktiviteteve profesionale në fabrika, në institucione hulumtuese, shëndetësore etj. Kibernetika është disiplinë ndërdisiplinore e teorisë së informatikës, së sistemeve, së probabilitetit dhe e neurofiziologjisë. Kjo disiplinë ka gjetur zbatim në psikologji, sidomos në psikologjinë inxhinierike. Themelues i saj është matematikani amerikan Norbert Uiner (Norbert Winer, 1894 – 1964).

KIMIA MENDORE. Në psikologjinë strukturaliste të Edvard B. Tiçenerit (Edward B. Titchener, 1867 – 1927) emërton konceptin e metodës së gjurmimit të elementeve më të thjeshta psikike, nga të cilat përbëhen dukuritë dhe proceset e ndërlikuara psikike. Kjo mënyrë e gjurmimit të elementeve më të thjeshta psikike, e zbulimit dhe e lidhjeve të tyre në tërësinë psikike u bart në psikologji nga shkenca e kimisë. Shih ***– STRUKTURALIZMI NË PSIKOLOGJI.***

K

KIMIORECEPTOR, - I. m. Trupthat ose qelizat receptore të formuara për të reaguar ndaj ndikimit të erërave, lëngjeve, mishit të pjekur etj., kur këta bien në kontakt sidomos me shqisën e të nuhaturit dhe me atë të shijimit.

KIMIOTERAPI, - A .f. Në psikiatri dhe në psikologjinë klinike emërton formën e psikoterapisë, që ka karakteristikën e zbatimit të medikamenteve (barnave) dhe të substancave kimike në shërimin e çrregullimeve të sjelljeve psikike të ndryshme. Medikamentet e tilla më të përdorshme janë antidepresantët dhe substancat kimike për qetësimin e organizmit.

KIMIZMI PSIKOLOGJIK. Mënyrë e mendimit për përftimin e dukurive psikike të ndërlikuara nga elementet përbërës të tyre. Në fillim të përdorimit të këtij termi nga ana e strukturalistëve supozohej se nga "përzierja" e elementeve të thjeshta përftohet një dukuri psikike e ndërlikuar. Më pas termi kimizmi psikologjik emërtoi bashkëdyzimin e elementeve psikike dhe përftimin e dukurisë së një cilësie të re, që përbëhej nga elementet e bashkëdyzimit.

KIMOGRAF, - I. m. Aparat i regjistrimit grafik të ndryshimeve që shfaqen gjatë gjurmimit të një ndryshoreje psikologjike. Kimografi përbëhet prej një lodre a tupani të mbështjellë me letër speciale dhe një pende lëvizëse që shënon në formë vize formën që ndryshon sipas burimit të ndryshores psikologjike që gjurmohet. Aparatet e tilla sot janë përsosur duke nxjerrë jashtë përdorimit kimografët e tipit klasik.

KINESTEZI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *kinesthesis* "lëvizje" dhe *aistheis* "ndijim". Ndijimi muskular-motorik i pozicionimit të trupit, i koordinimit të lëvizjeve dhe i lëvizjeve që duhen zhvilluar dhe organizuar për të realizuar në tërësi veprimin me anën e të cilit arrihet zotërimi i një qëllimi. Organet shqisore të këtyre lëvizjeve gjenden në muskuj, në kërcinj dhe në eshtra dhe këto janë rruazat e muskujve, qelizat e Golgit, puçrrat e Paçinit etj. Këta receptorë dërgojnë informacione në trurin e njeriut, në bazë të të cilave njeriu

përcakton fuqinë shtypëse të dorës, të këmbës në sipërfaqen e jashtme të një trupi, të vendndodhjes së trupit (i shtrirë, me qëndrim vertikal, gjatë ecjes, uljes etj.) dhe të lëvizjes së pjesëve të trupit të njeriut. Në situatat e posaçme, siç është rasti i udhëtimit të gjatë me anije, me tren etj. te njeriu shfaqen ndijime iluzionesh në formë luhatjesh të trupit.

KINEZIMET/ËR, - RI. m. I ardhur nga greqishtja *kinesis* "lëvizje" dhe *metros* "matje". Kinezimetri është aparat i posaçëm për matjen e pragut të ndjeshmërisë së lëvizjeve dhe të vendndodhjes së trupit të njeriut.

KINEZIOLOGJI, - A. f.I ardhur nga greqishtja *kinesis* "lëvizje" dhe *logos* "shkencë". Kineziologjia është disiplinë shkencore, e cila merret me studimin e muskujve dhe me lëvizjen e tyre, përkatësisht me lëvizjen e trupit të njeriut dhe me funksionet komunikative të lëvizjeve të trupit dhe të organeve të tij, sidomos të gjymtyrëve. Dijet nga kineziologjia dhe zbatimi i tyre i drejtë ndikojnë në pengimin e bllokimit të sistemit lëvizor dhe energjetik të organizmit. Kineziologjia ka metodat hulumtuese të saj, por shfrytëzon edhe metodat e disa disiplinave mjekësore.

KINEZIOTERAPI, - A. f. Term përmbledhës për të gjitha format e terapisë së lëvizjeve, përkatësisht të përmirësimit të gjendjes së lëvizjeve të çrregulluara (të ritmit, të shpejtësisë, të koordinimit të lëvizjeve etj). Në këtë grup të terapisë hyjnë: gjimnastika, gjimnastika ritmike, ushtrimet e gjymtyrëve etj.

KIROMANTIA. Shih **– *HIROMANTIA.***

KLAGES Ludvig (Ludwig KLAGES). Filozof dhe psikolog gjerman. Lindi në Hanover më 10.12.1872 dhe vdiq në Kilhberg (afër Zyrihut) më 29.07.1956. Përfaqësues i filozofisë së jetës, ku thekson se jeta është vetë shpirti. Sipas tij shtytjet e aktivitetit të njeriut dhe ndjenjat e njeriut dhe të shpirtit të tij shfaqen me anë të lëvizjeve të trupit dhe të pjesëve të tij. Për këtë na mëson grafologjia. Ai ka argumentuar se karakteri i njeriut dhe tiparet e tij janë të pandashme nga vetë qenia. Këto dallohen sidomos në përmbajtjen e veprës "Bazat e dijeve për manifestimin". Veprat kryesore të tij janë: "*Handschrift und Charakter"* – (*"Dorëshkrimi dhe karakteri"*), 1917; *"Prinzipien der Charakterologie"* – (*"Parimet e karakterologjisë"*), 1910; *"Grundlagen der Charakterkunde"* – (*"Themelet e formimit të karakterit"*), 1928.

KLAN, - I. m. I ardhur në shqip nga anglishtja *clan*, por me origjinë nga gjuha kelte. Në kuptimin klasik përfaqëson një grup individësh farefisnorë të lidhur mes tyre që besojnë në pararendës të përbashkët. Termi klan është përpunuar në sociologji sidomos nga Emil Durkhajm (Emil Durkheim, 1858 – 1917). Përbërësit sociologjikë dhe psikologjikë që përcaktojnë klanin dhe pjesëtarët e tij janë: besimi në totem, ndalesa e martesave ndërmjet anëtarëve të të njëjtit klan, pjesëmarrja e përbashkët në hakmarrje etj. Termi klan në të përditshmen bashkëkohore ka kuptimin e një grupi pak a shumë të vogël, pjesëtarët e të cilit i lidh interesi i përbashkët. Në psikologjinë sociale klani është grup joformal me pak anëtarë i formuar në bazë të interesit të

përbashkët të tyre, që nuk përputhet me interesin e përbashkët të një grupi më të madh ose të një organizate. Klanet e tilla mund të kenë ndikim të fuqishëm në marrjen e vendimeve të përgjithshme për organizimin e punës në një fabrikë, institucion hulumtues, korporatë etj.

KLAPARED Eduard (Edouard CLAPAREDE). Psikolog zviceran. Lindi më 1873 dhe vdiq më 1940. Studioi për mjekësi, ku u diplomua dhe kreu doktoratën. U zgjodh docent e më pas profesor në Universitetin e Gjenevës. Më 1904 u emërua drejtor i laboratorit të psikologjisë. Që nga viti 1901 mori pjesë në krijimin e "Archives de psychologie" (publikim), si edhe në themelimin e Institutit "Zhan Zhak Ruso". Në këtë institut filloi puna sistematike në orientimin profesional. U angazhua më tepër në zhvillimin e psikologjisë zbatuese. Shqipfolësit gjejnë informacione për jetën, aktivitetin dhe veprat e tij në botimin e revistës "Shkolla shqiptare" e vitit 1942. Veprat kryesore të tij janë: *"Les associations des idees"* – (*"Asociacioni i ideve"*), 1903; *"L`orientionprofessionnelle, ses problems et ses methods"* – (*"Orientimi profesional dhe problemet e metodës së saj"*), 1922.

KLAS/Ë, - A. f. Grup dukurish, objektesh, individësh, simbolesh etj. të grupuar sipas veçorisë së përbashkët sasiore ose cilësore. Termi klasë ka përdorim të gjerë në disa disiplina shkencore: në logjikë, në sociologji, në psikometri etj. Klasa në psikometri është nënndarje e të dhënave të rezultateve të përftuara nga matja e një ndryshoreje psikologjike te shumë individë, të dhëna këto që janë renditur, sistemuar dhe janë ndarë sipas madhësive të tyre në grupe vlerash dhe përmasash të njëjta.

KLASA SPECIALE. Koncepti i grupit të nxënësve me aftësi fizike e psikike të kufizuara të tipit të njëjtë, ku mësimi organizohet sipas një plani dhe programi të veçantë dhe udhëhiqet nga arsimtarët, të cilët kanë përgatitje të përgjithshme, të veçantë dhe speciale për organizimin e veprimtarisë edukative dhe arsimore me nxënës të këtij grupi.

KLASA SHOQËRORE. Term i sociologjisë dhe i psikologjisë sociale që përfaqëson një grup të madh njerëzish, të cilët ndryshojnë sipas vendit të tyre në një sistem historik të caktuar të prodhimtarisë shoqërore, pikërisht sipas raportit të tyre ndaj mjeteve të prodhimit. Grupet e tilla kanë disa veti të përbashkëta ekonomike, sociale dhe psikike, të cilat në thelb i përcakton baza materiale e tyre. Përkatësia klasore e anëtarëve të një klase nuk mbështetet në trashëgimi dhe as në ligj.

KLASIFIKIM, - I. m. Ndarja e dukurive, e të dhënave, e koncepteve etj. në klasa të veçanta sipas një parimi të caktuar dhe sipas kritereve të veçanta: të cilësisë, shtrirjes, vlerës etj. të përbashkët të anëtarëve të asaj klase dhe përcaktimi i vendit të secilit prej tyre në sistemin e studiuar të dukurive, të të dhënave, të koncepteve etj.

KLASIFIKIMI I MOTIVEVE. Grup motivesh që përfshijnë motivet parësore, dytësore, homeostazike, johomeostazike, biologjike, sociale, e personale.

a. **Motivet parësore** – Motive themelore të veprimtarisë së organizmit. Motivet parësore janë motive universale

dhe të lindura; kanë të bëjnë kryesisht me motive biologjike (motivi amnor, i etjes, i fjetjes, i urisë, motivi seksual etj.);

b. **Motivet dytësore** – Motive të prejardhura nga motivet parësore, por që ndërkohë janë ndarë nga ky grup motivesh dhe kanë formuar grupin e motiveve të fituara gjatë jetës, përvojës dhe gjatë procesit të të mësuarit të njeriut, duke funksionuar si motive të pavarura. Motive dytësore janë: nevoja për shoqërim, nevoja për të qenë besnik, nevoja për t`u sjellë sipas parimeve e normave morale të shoqërisë etj.;

c. **Motivet homeostazike** – Motive që mbështeten në homeostazë. Motivet homeostazike lindin dhe zhvillohen nga çrregullimi i baraspeshës së organizmit. Ky çrregullim shkaktohet nga mungesa ose tepria e lëndëve në organizëm dhe lind nevojën e marrjes së lëndëve munguese ose të nxjerrjes së lëndëve të tepërta, për të arritur gjendjen normale në funksionimin e organizmit;

d. **Motivet johomeostazike** – Motive të fituara që nuk kanë bazë zhvillimore në prishjen e baraspeshës së organizmit;

e. **Motivet biologjike** – Motive të mbështetura në prirjet e përgjithshme dhe të lindura të organizmit të njeriut. Të tilla janë: motivi i etjes, urisë, motivet seksuale etj. Motivet biologjike si prirje të përgjithshme dhe të lindura të njeriut pësojnë ndryshime të mëdha gjatë jetës në mjedis dhe gjatë të mësuarit (uria është e përgjithshme dhe e lindur për të gjithë njerëzit, por mënyrat e plotësimit të saj mësohen dhe janë të shumëllojshme);

f. **Motivet sociale** – Motive të fituara që kanë të bëjnë me nevoja psikologjike dhe që lidhen me nevojat për shoqërim, motivet e arritjeve, të agresivitetit etj.;

g. **Motivet personale** – Motive karakteristike për një personalitet të caktuar që zhvillohen dhe formohen në mbështetje të nevojave individuale dhe mënyrës së plotësimit të këtyre nevojave (motivi i afirmimit, i mirëqenies, i plotësimit të shprehive individuale, pastrimi i përditshëm i trupit ose i disa pjesëve të tij, shfrytëzimi i kohës së lirë në mënyrë të organizuar etj.).

KLASIFIKIMI I TË DHËNAVE PSIKOLOGJIKE. Fazë e përpunimit të të dhënave statistikore në psikometri që ka të bëjë me ndarjen e të dhënave psikologjike në klasa të veçanta dhe përcaktimi i vendit të secilës së dhënë në klasën e caktuar brenda tërësisë së asaj klase dhe tërësisë së të gjitha të dhënave të përftuara nga matja e një ndryshoreje psikologjike. Të dhënat e tilla dhe përmasa e tyre përcaktohen saktësisht vetëm sipas një parimi të caktuar.

KLASIKËT E PSIKOLOGJISË. Personalitete shkencore të dalluar me arritjet e tyre në njohjen sa më të saktë të çështjeve fondamentale të natyrës së njeriut dhe të ndryshimit të saj për një jetë sa më cilësore të tij. Të këtilla janë dijet për atë çfarë na motivon në aktivitetin e shumëllojshëm; çfarë janë gjendjet emocionale të njeriut, si përjetohen dhe si duhen kontrolluar ato; çfarë janë sjelljet e njeriut në situata dhe raporte konkrete dhe si duhet formësuar racionaliteti i tyre; cili është raporti ndërmjet funksionimit të sistemit

nervor dhe sjelljeve të njeriut; si e formëson njeriu konceptin për vetveten etj. Klasikët e psikologjisë janë ato personalitete, të cilët kanë vënë themelet zhvillimore të psikologjisë, të metodave dhe procedurave të hulumtimit empirik të proceseve psikike (të proceseve njohëse apo kognitive, emocionale dhe të proceseve motivuese), të gjendjeve psikike të shumëllojshme dhe të tipareve psikike të personalitetit, të bazës organike dhe sociale të zhvillimit të sjelljeve etj. Ndër klasikët më të njohur përmendim: Vilhelm Vunt (Wilhelm Wundt, 1832 – 1920), Zigmund Frojd (Sigmund Freud, 1856 – 1939), Uiljam Xhejms, 1842 – 1910), Zhan Pijazhe (Jean Piaget, 1896 – 1980), Ivan Pavllov (Ivan Pavlov, 1849 – 1936), Xhon Uotson (John Watson, 1878 – 1958) etj. Ndër klasikët e brezit më të ri përmendim: Frederik Berhus Skiner (Frederic Burrhus Skinner, 1904 – 1990), Hans Jyrgen Ajzenk (Hans Jürgen Eysenck, 1916 – 1997), Stanli Milgram (Stanley Milgram, 1933 – 1984) etj.

KLEPTOMANI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *κλεπτο* "vjedh" dhe *μανία* "marrëzi". Dëshirë impulsive e sëmurë e njeriut për të vjedhur atë që ka mundësi dhe që kësaj dëshire ai nuk ka mundësi t`i rezistojë. Kleptomani nuk ka nevojë as përfitim nga ajo që vjedh, por këtë e bën i shtyrë nga dëshira dhe nga impulsi i befasishëm për vjedhje. Kjo dukuri haset edhe te ata individë që janë mirë nga gjendja ekonomike. Individi kleptoman kundër vullnetit të tij është i detyruar që dëshirën dhe impulsin e vjedhjes ta shndërrojë në vepër, pavarësisht nga padobia e asaj që vjedh. Kleptomania shfaqet ndaj llojeve të ndryshme të objekteve: ndaj këpucëve, monedhave, orëve etj. E tillë është biblikleptomania: dëshirë impulsive dhe e sëmurë për vjedhje librash.

KLIENT, - I. m. Rrjedh nga latinishtja dhe ka ardhur në psikologjinë klinike nga disiplinat e mjekësisë dhe kryesisht është sinonim i termit pacient. Klienti është individi që kërkon këshillë, ndihmë dhe shërbim psikologjik. Klientin nuk e karakterizon sëmundja; ai nuk është i sëmurë, por kërkon shërbim psikologjik për të zgjidhur një problem të natyrës psikologjike (si ta lërë pirjen e duhanit, çfarë të bëjë me fëmijën e vet që ka sjellje të papërshtatshme, si të sillet ndaj bashkëshortit që ka filluar ta tejkalojë masën e marrjes së alkoolit etj.). Termi klient ka hyrë në terminologjinë e psikologjisë, në terapinë drejtuar klientit nga psikologu amerikan Karl Roxhers (Carl Rogers, 1902 – 1987).

KLIKË, - A. m. I ardhur nga frëngjishtja *clique*, që ka zënë vend në terminologjinë e psikologjisë sociale. Me termin klikë emërtohet koncepti i një grupi të vogël individësh, të cilët lidhen njëri me tjetrin dhe krijojnë raporte shumë të ngushta ndërmjet tyre. Pjesëtarët e klikës bashkohen për të realizuar një interes të veçantë që është në kundërshtim me parimet, normat dhe me dispozitat ligjore. Këta synojnë me këmbëngulje për realizimin e qëllimeve të tyre, nga i cili kanë dobi individuale dhe grupore.

KLIMAKS, - I. m. I ardhur nga greqishtja *κλίμαξ* "përshkallëzim". Klimaksi ka kuptim të përgjithshëm dhe të veçantë në poezi dhe në psikologji. Kuptimi i përgjithshëm i klimaksit është ngritja

shkallë-shkallë deri në majën e një lartësie të caktuar. Në poezi ka kuptimin e renditjes së shprehjeve nga shprehja me intensitet më të dobët te shprehjet gjithnjë e më të fuqishme, e deri në atë më të fuqishme. Në psikologji klimaksi ka kuptimin e shqetësimit emocional shumë të lartë; arritjen e intensitetit më të lartë gjatë plotësimit të një shtytësi, sidomos të shtytësit seksual.

KLIMAKTERIUM, - I. m. I ardhur nga greqishtja *κλιμακτερ* "ngritje nëpër shkallë". Me termin klimakterium emërtohet periudha e kthesës së jetës së njeriut. Kjo periudhë i përket kohës ndërmjet mbarimit të pjekurisë dhe fillimit të pleqërisë, kur fillon rënia konstante e aktivitetit të menstruacioneve deri në ndërprerjen e tyre. Kjo periudhë është karakteristike për anëtarët e dy gjinive. Te femrat klimakteriumi fillon nga mosha dyzetepesë vjeç dhe përfundon rreth moshës pesëdhjetepesë vjeç, kur ndërpritet cikli i menstruacioneve, ku arrihet menopauza. Brenda kësaj periudhe edhe meshkujt pësojnë ndryshime negative hormonale, por te meshkujt vështirë të caktohet koha e përfundimit të klimakteriumit. Klimakteriumi, sidomos te femrat, shoqërohet me disa ndryshime fiziologjike e psikologjike, si: çrregullimi i aktivitetit të zemrës, dhembja e kokës, ndryshimi i shpejtë i gjendjes emocionale, ndjeshmëria e shtuar ndaj ngacmuesve socialë e fizikë, pagjumësia etj.

KLINIK/Ë, - A. Term i mjekësisë me origjinë nga gjuha greke *κλινικός*. Klinika është institucion shëndetësor, ku diagnostikohet dhe shërohet i sëmuri nga sëmundjet organike dhe nga sëmundjet psikike. Në klinikë kryhen gjurmime të sëmundjeve dhe të shkaktarëve të tyre, të kushteve të veprimit të këtyre shkaktarëve sipas veçantisë fizike e psikike të çdo individi, provohen ecuritë terapeutike e psikoterapeutike, mund të publikohen rezultatet hulumtuese, ushtrohen studentët dhe organizohen forma të ndryshme të specializimit të mjekëve, të psikiatërve dhe të psikologëve klinikë.

KLINIKA PSIKOLOGJIKE. Institucion i specializuar për diagnostikime psikologjike individësh me çrregullime psikologjike, si edhe për shërimin e tyre. Në klinikat psikologjike u jepet ndihmë e specializuar individëve me një trajtim të posaçëm psikologjik. Këtë e bëjnë psikologët e specializuar në disiplinën e psikologjisë klinike, ekipe psikologësh, psikiatrish, mjekësh të patologjisë etj. Sot klinikat psikologjike janë diferencuar sipas mënyrës së zbatimit të metodave psiko-terapeutike dhe bëhet fjalë për klinikë bihejviorale, klinikë për trajtim psikologjik të fëmijëve problematikë etj.

KLITOR, - I. m. Pjesa e jashtme organike e organeve gjenitale të femrave. Përbëhet nga struktura organike shumë të ndjeshme. Me këtë strukturë dhe me ndjeshmëri të nivelit të lartë klitori luan rol të rëndësishëm në orgazmën seksuale.

KOCKËZAT E DËGJIMIT. Term i anatomisë së shqisës së dëgjimit, përkatësisht të veshit. Në latinisht njihen me termin *ossicula auditus*. Këto janë tri kockëza të lidhura njëra me tjetrën, që ndërtojnë një varg të shtrirë prej cipës së timpanit deri në hapjen ovale të kërmillit ose të kohlesë. Këto tri kocka bartin dridhjet e membranës së timpanit deri në kërmill.

KOD, - I. m. I ardhur nga latinishtja *codex* "tabelë druri për të shkruar". Kodi është sistem shenjash dhe rregullash të njëkuptimshme të përcaktuara saktësisht, sipas të cilave një informacion mund të shndërrohet në një formë tjetër grafike, duke mos ndryshuar përmbajtjen e saj, por duke mundësuar komunikimin ndërmjet dhënësit dhe marrësit të atij informacioni. Kodi mund të jetë etik, estetik, fetar, ushtarak etj.

KODEKS, - I. m. Përmbledhje parimesh, rregullash dhe ligjesh të miratuara, sipas të cilave organizohen dhe kryhen sjelljet e anëtarëve të një organizate, partie, shoqate etj. Kodeksi parasheh përgjegjësinë dhe objektivitetin në punë, transparencën në kufijtë e punës profesionale, mbrojtjen e interesit të shoqatës, të organizatës etj.

KODEKSI MORAL. Sistem i tërësishëm që ka marrë formë të qëndrueshme në një mjedis të caktuar social dhe sipas të cilit organizohen sjelljet e një anëtari të atij mjedisi social. Një sistem i tillë është i detyrueshëm për secilin pjesëtar të atij mjedisi. Kodeks moral mund të ketë edhe një shoqatë profesionale e shoqërisë, si shoqata e avokatëve, e mjekëve, e psikologëve etj. Kodeksi moral mund të jetë i shkruar ose i formuluar gojarisht. Pavarësisht nga forma e tij, kodeksi i detyron anëtarët e atij mjedisi ose të atij profesioni të sillen sipas rregullave të atij kodeksi.

KODEKSI PROFESIONAL I PSIKOLOGËVE. Përmbledhje parimesh, rregullash dhe normash të punës profesionale të psikologëve dhe të sjelljeve të tyre që janë miratuar nga ana e tyre dhe si të tilla duhet të zbatohen në punën profesionale. Parimet, rregullat dhe normat e paracaktuara në kodeks janë kryesisht të karakterit etik, që kanë të bëjnë me idealin e profesionit të psikologut, dhe me sjelljet e tyre gjatë punës profesionale në fabrika, në klinika, në shkolla etj. Shoqata Amerikane e Psikologjisë ka përcaktuar kodin e etikës psikologjike që nga viti 1953.

KODI GJENETIK. Shenja shifrore në strukturën e gjeneve të kromozomeve që përcakton zhvillimin e strukturave organike, të cilësive dhe të funksioneve të organeve dhe të organizmit. Kodi gjenetik përbëhet nga shpërndarja e tri çifteve të nukleideve në molekulën e acidit dezoksiribonukleik ADN. Kodin gjenetik e kanë trajtuar sidomos biokimistët amerikanë Marshal V. Nirenberg (Marshall W. Nirenberg, 1927) dhe Robert V. Holi (Robert V. Holi, 1922 – 1993).

KODI SEMANTIK. Përfaqësimi psikik i informacioneve dhe i sistemit ndërlidhës të tyre në bazë të kuptimit që ato kanë.

KODIM, - I. m. Emërtim për procesin e shndërrimit të një sasie të dhënash nga një formë në tjetrën me anë të kodit ose të shifrës së përcaktuar saktësisht ndërmjet dhënësit dhe marrësit së atyre të dhënave. Gjatë procesit të komunikimit në largësi ndërmjet dhënësit të të dhënave dhe marrësit të tyre më parë bëhet "përkthimi" i tyre sipas shenjave të përcaktuara dhe më pas bëhet bartja e tyre nëpër kanalin komunikues të përcaktuar.

KODIMI SPECIFIK. Rregull i psikologjisë kognitive, sipas të cilit "kodimi

fillestar i përmbajtjes së një teme do të jetë nën ndikimin e kontekstit të temës që është mësuar. Por, ky kodim fillestar gjatë të mësuarit të temës së re e dobëson rinjohjen e së njëjtës fjalë, por e thënë në një kontekst tjetër". Në literaturë përmendet fjala "rrënjë" e mësuar në kuptimin e rrënjës së dhëmbit; në këtë[mënyrë zvogëlohet aftësia e njohjes së fjalës rrënjë të përdorur në kontekstin "rrënja katrore".

KODON, - I. m. Emërtim i tri vargjeve nukleidesh të njëpasnjëshme që janë pjesë e kodit gjenetik. Kodoni përcakton aminoacidin që do të jetë pjesë përbërëse e vargut të aminoacideve në albumina me sintezën e së cilës udhëhiqet secili gjen.

KOEDUKIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *co* "bashkë" dhe *educatio* "edukatë". Koedukimi është organizim i përbashkët i procesit edukativ–arsimor për femra dhe për meshkuj në institucionet shkollore të niveleve dhe tipave të ndryshëm të shkollave sipas parimeve të mirëfillta pedagogjike dhe psikologjike.

KOEFICIENT, - I. m. I ardhur nga latinishtja *co* "bashkë" dhe *officere* "bëj". I përket terminologjisë së psikometrisë dhe nënkupton vlerën sasiore të ndërlidhjes së faktorëve; koeficienti është herësi ndërmjet madhësive të dy ndryshoreve psikologjike, pra herësi i raportit ndërlidhor ndërmjet njërës ndryshore dhe ndryshores tjetër.

KOEFICIENTI I ALIENACIONIT. Koeficienti i alienacionit ose i tjetërsimit është masa përcaktuese e shkallës së alienacionit ndërmjet dy ndryshoreve që kanë të përcaktuar koeficientin e korrelacionit. Koeficienti i alienacionit përcaktohet sipas formulës:

$$k = \sqrt{1 - r^2}$$

ku, k është "koeficienti i korrelacionit" dhe r^2 "koeficienti i determinizmit". Gjen zbatim sidomos në dokimologji, kur kërkohet përcaktimi i shkallës së mospërputhjes së notave të arsimtarëve të ndryshëm për të njëjtën lëndë mësimore dhe për të njëjtët nxënës.

KOEFICIENTI I ASOCIACIONIT. Koeficienti i asociacionit është koeficienti i korrelacionit, që tregon sa ndryshon shpërndarja e dendësisë së të dhënave të tabelës normale nga shpërndarja e rastësishme e të dhënave. Koeficienti i asociacionit zbatohet kur dy ndryshoret i përkasin kategorive dikotome.

KOEFICIENTI I BESUESHMËRISË SË TESTIT. Koeficienti i besueshmërisë së një testi ka të bëjë me vetë testin. Vlera numerike e besueshmërisë së një testi përcaktohet duke identifikuar vlerën numerike në mes arritjeve nga të njëjtët subjekte, duke zbatuar në mënyrë suksesive të njëjtin test te të njëjtët subjekte dhe duke mos ndryshuar kushtet e testimit. Koeficienti i besueshmërisë së një testi arrihet edhe kur korrelojmë arritjet e subjekteve të njëjtë në dy forma të testit, që ka për qëllim matjen e së njëjtës ndryshore. Koeficienti i besueshmërisë së një testi duhet të jetë së paku + 0.80.

KOEFICIENTI I DETERMINIMIT. Koeficient që përcaktohet nga ngritja e koeficientit të korrelacionit në katror. Me koeficientin e determinizmit vendoset fuqia përcaktuese e lidhjes

ndërmjet dy a më shumë ndryshoreve. Koeficienti i determinimit në të vërtetë tregon proporcionin e përbashkët të ndryshimit të dy ndryshoreve. Koeficienti i determinimit përcaktohet kur kërkohet përcaktimi i saktë i prognozës së një vlere.

KOEFICIENTI I DISPERSIONIT. Koeficienti i shpërndarjes së të dhënave psikologjike është raporti ndërmjet masës së përgjithshme të të dhënave të shpërndara dhe vlerës mesatare të këtyre të dhënave. Koeficienti i dispersionit të të dhënave përftohet duke pjesëtuar masën e të dhënave me vlerën mesatare të tyre.

KOEFICIENTI I INTELIGJENCËS. Treguesi i nivelit të inteligjencës së një individi. Koeficienti i inteligjencës përcaktohet nga raporti ndërmjet rezultatit të arritur në një test të inteligjencës së standardizuar dhe moshës kalendarike të individit të provuar me atë test inteligjencë. Koeficienti i inteligjencës në literaturën bashkëkohore zakonisht shënohet me shkurtesën IQ nga anglishtja (Intelligente Quotient). Koeficienti i inteligjencës është treguesi i shkallës së zhvillimit të inteligjencës së një individi në raport me shkallën e zhvillimit të inteligjencës së të tjerëve të së njëjtës moshë. Formula e përcaktimit të këtij koeficienti është: KI "MM : MK x 100, ku MM është mosha mendore dhe MK "mosha kalendarike". P. sh. fëmija X e ka MM (moshën mendore) 12 vjeç, kurse MK (moshën kalendarike) e ka 9 vjeç. KI (koeficienti i inteligjencës së kësaj fëmije është: 144 muaj: 98 muaj "1.47 x 100 "147. Koeficienti i inteligjencës prej 0.90 – 110 konsiderohet koeficient normal; rreth 45 % të popullsisë kanë koeficient të inteligjencës që shtrihet prej 0.90 deri 110. Fëmija X (rasti i ynë) ka koeficientin e inteligjencës 147, që do të thotë se fëmija X i përket grupit të fëmijëve prej 1 % që kanë inteligjencë mbi 140 dhe për këta pohohet se kanë inteligjencë shumë të lartë.

KOEFICIENTI I KONSEGUENCËS SË TESTIT. Koeficienti i konseguencës së një testi tregon shkallën e korrelacionit me të cilën shprehet konseguenca e atij testi. Shkalla e këtij korrelacioni përcaktohet duke krahasuar rezultatet e dy gjysmave të një testi, përkatësisht duke korreluar rezultatet e arritura në të njëjtin test dhe rezultatet e arritura pas zbatimit të tij te të njëjtët subjekte pas dy a tre muajsh. Sa më i lartë të jetë ky koeficient, aq më konseguent është ai test.

KOEFICIENTI I KONTIGJENCËS. Koeficienti i kontigjencës është herësi i shkallës së lidhjes ndërmjet dy ndryshoreve, kur këto janë të ndara në dy a më shumë grupe cilësore të ndryshme, ndonëse i përkasin të njëjtës ndryshore psikologjike. Koeficienti i kontigjencës përcaktohet duke zbatuar hi katrorin, përkatësisht duke zbatuar formulën C "katrori i X në katror duke pjesëtuar me N + x në katror, ku C është koeficienti i kontigjencës, N është numri i rasteve. Koeficienti i kontigjencës zbatohet në hulumtimet e tipit: Sa pajtohen rezultatet e arritura në testin e së njëjtës lëndë nga ana e nxënësve të një klase me notat e përftuara nga arsimtarët e tyre për të njëjtat lëndë mësimore.

KOEFICIENTI I KORRELACIONIT. Koeficienti i korrelacionit ose i ndërlidhjes emërton masën

numerike të nivelit të lidhjes ndërmjet dy ndryshoreve psikologjike, ndërmjet nivelit të inteligjencës dhe suksesit të arritur në zotërimin e lëndëve mësimore te të njëjtët nxënës. Koeficienti i korrelacionit mund të jetë pozitiv ose negativ; është pozitiv kur rritja e një ndryshoreje është e lidhur me rritjen e ndryshores tjetër; është negativ kur me rritjen ose me ndryshimin pozitiv të njërës ndryshore, ndryshorja tjetër zvogëlohet. Koeficienti i lidhjes ndërmjet dy ndryshoreve sillet prej 0 deri në + 1, përkatësisht deri në - 1. Shumë të rralla janë rastet kur dy ndryshoret përputhen plotësisht, pra arrijnë shkallën e korrelacionit + 1 ose – 1. Koeficienti i korrelacionit zakonisht shënohet me shkronjën **r.** Ndërmjet ndryshoreve psikologjike mund të ekzistojë lidhje shumë e dobët dhe e parëndësishme, lidhje e ulët, e mesme intensive, e lartë dhe lidhje shumë e lartë. Lidhja shumë e dobët ndërmjet dy ndryshoreve ka koeficientin prej 0.00 deri në 0.20; lidhja e ulët sillet prej 0.20 deri në 0.40; lidhja e mesme intensive ka koeficientin që sillet prej 0.40 – 0.60; lidhja e lartë ka koeficientin prej 0.60 deri në 0.80 dhe lidhja shumë e lartë ka koeficientin pre 0.80 deri në 1.00. Koeficienti i korrelacionit përcaktohet sipas dy metodave**:**

a. **Metoda e korrelacionit rang** – Metodë që përcakton shkallën numerike të ndërlidhjes ndërmjet rezultateve të dy ndryshoreve te subjektet e njëjtë, si, rezultatet e ranxhuara të subjekteve në lëndën e matematikës dhe të gramatikës së gjuhës amtare. Kjo është metoda e statisticienit dhe e psikologut anglez Çarls E. Spirman (Charles E. Spearmen, 1863 – 1945). Formula e kësaj metode është:

$$r = 1 - \frac{6\sum D^2}{N(N^2 - 1)}$$

Në këtë formulë r "koeficienti i korrelacionit; Σ "shuma; D "dallimi ndërmjet rangut të secilit subjekt në ndryshoren e parë dhe të dytë; N "numri i rasteve.

b. **Metoda e produkteve korrelative** – Metodë që përcakton saktësisht shkallën numerike të lidhjes ndërmjet dy ndryshoreve. Koeficienti i korrelacionit sipas kësaj metode llogaritet duke zbatuar këtë formulë:

$$Kn = \frac{\sum (dx, dy)}{\sqrt{\sum d^2 x, \sum d^2 x,}}$$

Sipas kësaj formule dx dhe dy është "ndryshimi ndërmjet rezultateve individuale nga mesatarja aritmetike përkatëse (Mx, My). Kjo metodë e përcaktimit të koeficientit të korrelacionit i atribuohet matematikanit dhe studiuesit të filozofisë, të fizikës, të religjionit dhe të drejtësisë Karl Pirsonit (Karl Pearson, 1857 – 1936). Kjo metodë është më e saktë se metoda e rangjeve.

KOEFICIENTI I KORRELACIONIT BISERIAL. Koeficienti vargor apo serial i ndërlidhjes ndërmjet një ndryshoreje, që shprehet me dy kategori, si p.sh.: kaluan provimin – mbetën në provim, alkoolistët – jo alkoolistët etj. dhe ndryshores tjetër që paraqet rezultatin e përgjithshëm prej shtrirjes - 1 deri në shtrirjen + 1.

KOEFICIENTI I KORRELACIONIT SHUMËFISH. Shkalla numerike e lidhjes ndërmjet një ndryshoreje

dhe disa ndryshoreve të përbëra nga dy ose më shumë të tilla, por që konsiderohet se përbëjnë një të tërë të një ndryshoreje. Koeficienti i korrelacionit shumëfish zbatohet sidomos në fushën e orientimit profesional. Në këtë fushë merret si ndryshore e varur prognoza e suksesit të një subjekti në një profesion të caktuar nga disa rezultate të arritura në disa teste – ndryshorja e pavarur.

KOEFICIENTI I KORRELACIONIT TAU. Koeficienti i ndërlidhjes apo i korrelacionit ndërmjet vargut të të dhënave të përftuara nga matja e dy ndryshoreve ose e efektit të dy faktorëve. Është pothuaj i njëjtë me mënyrën e përcaktimit të koeficientit sipas formulës së korrelacionit rang, pikërisht sipas formës së koeficientit Spirmën. Zbatohet për llogaritjen e korrelacionit të pjesshëm. U konceptua nga statistikani britanik Moris Xh. Kendal (Maurice G. Kendall, 1907).

KOEFICIENTI I LEXUESHMËRISË. Koeficienti i lexueshmërisë emërton shkallën e zhvillimit të shkathtësisë së leximit të teksteve popullore, artistike e shkencore nga ana e një individi. Koeficienti i lexueshmërisë përcaktohet duke pjesëtuar moshën e lexueshmërisë me moshën kalendarike të lexuesit dhe shuma e përftuar shumëzohet me 100. Kështu, nëse fëmija 10-vjeçar lexon në nivelin e fëmijës 12-vjeçar, atëherë koeficienti i lexueshmërisë së tij përftohet duke pjesëtuar moshën e lexueshmërisë ose ML me moshën kalendarike ose MK, përkatësisht 12 : 10 x 100 = 120. Kur koeficienti i lexueshmërisë është 100, atëherë kemi të bëjmë me lexues me shkathtësi mesatare të leximit. Rasti ynë ka koeficientin e lexueshmërisë 120 d.m.th., ky fëmijë lexon shpejt, rrjedhshëm dhe me shkallë të lartë kuptimi të asaj që lexon.

KOEFICIENTI I VLERËS SË TESTEVE. Treguesi numerik i shkallës së vlerës së një testi, përkatësisht i asaj karakteristike metrike të një testi, që tregon apo mat dhe në çfarë mase ai test mat atë ndryshore psikologjike për të cilën është hartuar ky test. Koeficienti i vlerës së një testi përcaktohet duke korreluar rezultatet e arritura në një test dhe kriterit sipas të cilit përcaktohet vlera e atij testi.

KOEFICIENTI VARIACION. Koeficienti ose herësi i raportit ndërmjet shmangies standard dhe së mesmes aritmetike. Përftohet duke pjesëtuar shmangien standard me të mesmen aritmetike dhe herësi shumëzohet me 100. Shërben për krahasimin e ndryshimit të të dhënave ndërmjet dy ose më shumë vargjeve të tilla.

KOFKA Kurt (Kurt KOFFKA). Psikolog amerikan me prejardhje gjermane. Një ndër themeluesit e psikologjisë geshtaltiste. Lindi në Berlin më 18.03.1886 dhe vdiq në Northampton (Masaçusets) më 22.11.1941. Anëtar i Shkollës Geshtaltiste të Berlinit. Ka studiuar psikologji dhe kreu doktoratën duke mbrojtur tezën "Mbi të mësuarit e ritmit". Në fillim të karrierës ishte asistent i psikologjisë në Friburg, më 1918 u zgjodh profesor inordinar në Universitetin e Gisenit dhe deri më 1924, kur emigroi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. U caktua profesor i psikologjisë në Universitetin Kornel (Cornell), Klark (Clark), Viskonsin-

Medison (Wisconsin-Madison), kurse në Kolegjin e Smithit filloi procedurat për titullin profesor e vijoi veprimtarinë deri më 1927, kur përfundoi karrierën profesionale dhe shkencore. U mor me gjurmimin e parimeve të psikologjisë geshtaltiste në psikologjinë zhvillimore, përkatësisht në psikologjinë e të mësuarit dhe të kujtesës. Falë angazhimit të Kurt Kofkës parimet e psikologjisë geshtaltiste kanë gjetur zbatim jo vetëm në fushën e perceptimit, por edhe në të gjitha proceset dhe sjelljet. Konceptet kryesore të kësaj psikologjie, si: dinamika e fushave, forma, gjurmët, organizimi, struktura, transponimi i elementeve etj. gjetën zbatimin e tyre edhe në procesin e të mësuarit, të kujtesës, madje edhe në terapinë e sjelljeve. Veprat kryesore të tij janë*: "Die Grundlagen der psychischen Entwiklung: eine Einfuhrung in die Kinder – psychologie" – ("Bazat e zhvillimit psikik – Hyrje në psikologjinë fëmijërore"),* 1921; *"Principles of Gestalt psychology" – ("Parimet e psikologjisë Geshtalt"),* 1935.

KOH/Ë, - A. f. Në kuptimin e përgjithshëm koha është kusht, formë dhe veçori e ekzistencës së materies. Materia kuptohet më së miri në lëvizje të pandërprerë, që realizohet brenda një kohe të caktuar. Përcaktimi i zgjatjes së kohës në mënyrë objektive bëhet në bazë të njësive kohore që maten me sekonda, minuta, orë, ditë, javë, muaj, vit etj. Por, përjetimi subjektiv i zgjatjes kohore të një dukurie, ngjarjeje, procesi etj. ndryshon nga zgjatja objektive e saj.

KOHA ASOCIATIVE E REAGIMIT. Koha e matur prej çastit të dhënies së një sinjali (të një ngacmuesi, të fjalës etj.) deri në reagimin e subjektit ndaj atij ngacmuesi, asaj fjale etj., pikërisht deri në dhënien e përgjigjes së duhur për atë që kërkohet ndaj fjalës së shqiptuar nga eksperimentuesi. Koha e tillë matet me anën e testit të fjalëve asociative.

KOHA PSIKOLOGJIKE. Koha psikologjike është përjetimi subjektiv i zgjatjes së një segmenti kohor të një dukurie, ngjarjeje, procesi etj. Koha psikologjike ka të bëjë me vlerësimin e zgjatjes së një dukurie nga ana e vetë njeriut, duke mos u bazuar në faktorë të jashtëm, siç janë: ora, cikli ditë – natë, kalendari i një viti etj. Përjetimi subjektiv i kohës varet nga faktorët e brendshëm të njeriut, nga përvoja, ndjenjat shoqëruese të një dukurie, rëndësia e saj për njeriun etj., që janë faktorë subjektivë.

KOHA REAGUESE. Koha minimale e domosdoshme që i nevojitet një subjekti për të reaguar ndaj një ngacmuesi ose stimuli adekuat për një shqisë të caktuar. Koha reaguese quhet ndryshe kohë latente. Në këtë fushë dallimet individuale janë të mëdha, siç janë të mëdha edhe dallimet në kohën reaguese ndaj ngacmuesit të njërës shqisë nga reagimi ndaj ngacmuesit të shqisës tjetër. Në hulumtimet psikofizike koha reaguese ka qenë ndryshorja më e provuar në laboratorin e hulumtimeve psikologjike.

KOHA SHOQËRORE. Koha karakteristike për një mjedis shoqëror, për kulturën e një populli që i referohet ngjarjeve të rëndësishme të atij mjedisi apo atij populli. E tillë është koha e Rilindjes Kombëtare, koha pas Shpalljes së Pavarësisë më 1912 etj. Shkallët

e vlerësimit të kohës sipas ngjarjeve kulturore ndryshojnë shumë prej një populli në tjetrin.

KOHEZION, - I. m. Term i përgjithshëm që përdoret shpesh në psikologji, si kohezioni i komponentëve perceptues, kohezioni i elementeve në fushën e të parit, kohezioni ndërshoqëror etj. Kohezioni është prirja e ruajtjes së bashkimit ndërmjet elementeve, grupeve, komponentëve, pjesëve etj.

KOHEZIONI GRUPOR. Synimi dhe angazhimi i anëtarëve të një grupi për ta mbajtur të gjallë gjithmonë grupin, për t`i mbajtur bashkë të gjithë anëtarët e atij grupi dhe për t'i rezistuar bashkërisht të gjitha formave të shkatërrimit të atij grupi.

KOHLE, - A. f. I ardhur nga latinishtja *cohlea* "kërmilli i veshit". Kohlea ose kërmilli i veshit është struktura gypore e formës spirale të veshit të brendshëm, që është i mbushur me lëng, ku janë të vendosura qelizat receptore. Shih ***– KËRMILLI I VESHIT.***

KOKAIN/Ë, - A. f. Lloj alkaloidi, e pikërisht lloj i drogës më të vjetër. Përftohet nga fletët e bimës koka *Erythroxylon* që zhvillohet në disa vende të Amerikës së Jugut (Bolivi, Meksikë, Peru etj. Kokaina ka ndikim anestetik. Efekti i marrjes së kokainës ka të bëjë me nxitjen e qetësimit dhe me shtimin e kënaqësisë dhe të euforisë së njeriut. Kokaina vepron në sistemin nervor simpatik dhe bllokon ripërthithjen e dopaminave. Marrja e kokainës për një kohë të gjatë shkakton gjendjen e varësisë së njeriut nga kokaina, duke shkaktuar ankth, depresion dhe mall për marrjen e saj. Kokaina më e pastër është kokaina në formë pluhuri.

KOK/Ë, - A. f. Pjesa e sipërme e trupit të njeriut, pikërisht pjesa e përparme e trupit të kafshëve, ku janë të vendosur truri, kafka, muskujt e fytyrës, sytë, veshët me shqisën statike e dinamike, gjuha, hunda etj. Në fytyrë degëzohen nervat V dhe VII dhe në muskulaturën e fytyrës kontrollojnë lëvizjet e saj duke mundësuar edhe mimikën.

KOLBERG Lorenc (Lawrence KOHLBERG). Psikolog amerikan me prejardhje hebraike. Lindi më 1927 dhe vdiq më 1987. Është i njohur për studimet e tij mbi zhvillimin e moralit. Ishte bartës i sjelljeve problematike në moshën e re dhe për këtë shkak ishte nën përkujdesjen e shërbimit social dhe delikuencës së të miturve. Vijon mësimet në njërën ndër shkollat e mesme ku trajtoheshin dhe mësonin nxënësit me sjellje problematike. Në moshë më të thyer u bë qytetar i njohur dhe i nderuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Lorenc Kolbergu përjetoi rëndë tmerret e Luftës II Botërore, sidomos ato të Gjermanisë naziste ndaj hebrenjve. Nën ndikimin e këtyre përjetimeve arriti të formojë qëndrimin e tij ndaj moralit njerëzor dhe nevojën për shkollim të mëtejmë. U regjistrua në Universitetin e Çikagos, ku u diplomua për psikologji dhe më pas mbrojti tezën e doktoratës nga fusha e patologjisë së sjelljeve të njeriut. Filloi karrierën profesionale si psikolog klinik dhe nga përvoja me pacientët u bind se çështja kryesore e tyre dhe e të tjerëve është çështja e raportit të tyre me të vërtetën dhe me drejtësinë. Prej këtej përfundimisht vendosi të studionte moralin dhe zhvillimin e

tij, duke pasur për bazë karakterin e përgjithshëm apo universal të moralit. Për studimin e moralit dhe të zhvillimit të tij mblodhi një lëndë të gjerë nga praktika e zhvillimit të sjelljeve të fëmijëve të moshave të ndryshme në Tajvan, Turqi, Izrael, Meksikë dhe në disa vende të tjera. Këto të dhëna i përpunoi dhe konstatoi se ekzistojnë tri shkallë të moralitetit: moraliteti parakonvencional, konvencional dhe paskonvencional. Secila nga këto shkallë apo nivele ka nga dy faza. Në kuadrin e një skeme të tillë shpjegoi zhvillimin e moralit në tërësi. Veprat kryesore të tij janë: "*The Philosophy of Moral Development: Moral Stages and dhe idea of Justice*" – (*"Filozofia e zhvillimit moral: Fazat e moralit dhe ideja e drejtësisë"*), 1981*; "The Psychology of Moral Developement: Moral Stages and dhe Life Cicle"* – (*"Psikologjia e moralit: Fazat e moralit dhe ciklet e jetës"*), 1984.

KOLEKTIV, - I. m. I ardhur në shqipe nga latinishtja *collectivus* "i grumbulluar". Kolektivi ka zënë vend në terminologjinë e psikologjisë sociale dhe me këtë term emërtohet bashkësia shoqërore e vogël ose e madhe, e cila nënkupton lidhjen ndërmjet anëtarëve të saj të krijuar mbi bazë interesash, qëndrimesh, vlerash të përbashkëta, duke pasur edhe një qëllim të përbashkët të aktivitetit të anëtarëve të saj.

KOM/Ë, - A. f.I ardhur nga greqishtja *κώμα* "gjumë i thellë", që ka zënë vend në terminologjinë e psikiatrisë dhe të psikologjisë klinike. Koma është gjendje e çrregullimit organik e psikik, të cilën e karakterizon pavetëdijshmëria e njeriut brenda një kohe të caktuar. Koma është shkalla më e lartë e humbjes së vetëdijes, që manifestohet sidomos në humbjen e sjelljeve të vullnetshme si edhe me humbjen e reagimeve refleksive. Gjendja e tillë shkaktohet nga çrregullimet metabolike, helmimet, infektimet, lëndimi i disa pjesëve të trurit, nga përjetimi i gjendjeve traumatike etj.

KOMIK, – U. m. I ardhur nga greqishtja *κωμικός* "shaka, tallje". Termi i përket terminologjisë së letërsisë, por ka edhe përmbajtje psikologjike. Emërton gjendjen e kënaqësisë, të gëzimit, të haresë së papritur dhe të të qeshurit të njeriut. Kjo gjendje komike buron nga të kuptuarit e lidhjeve mospërputhëse të mendimeve, të qëndrimeve, të shprehjeve, të sjelljeve etj. dhe nga krijimi i situatave qesharake.

KOMISUR/Ë, – A. f. Term i anatomisë së sistemit nervor i ardhur nga greqishtja *κομμισσύρα* "lidhje". Komisura emërton lidhjen e fijezave neurale që kalojnë nëpërmjet sistemit nervor qendror dhe i lidhin pjesët korresponduese të secilës anë të trurit.

KOMORBIDITET, - I. m. Term i mjekësisë që përdoret më tepër në terminologjinë e patologjisë, të psikiatrisë, por edhe në terminologjinë e psikologjisë klinike. Me termin komorbiditet emërtohet prania e dy a më shumë sëmundjeve te një individ brenda të njëjtës kohë. Komorbiditeti ka nivel të lartë, që shpesh arrin mbi 60 % të klientëve. Në këto raste diagnozës bazë i bashkëngjitet edhe një çrregullim ose sëmundje që nuk ka lidhje me diagnozën e sëmundjes bazë.

KOMPENSIM, - I. m. Në psikologji i ardhur nga greqishtja *κομπενσάτιο* "barazim, zhdëmtim". Sipas psikanalizës

së Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939) është një ndër mekanizmat mbrojtës të rëndësishëm, me anën e të cilit individi me të meta ose me mangësi psikike e sociale orvatet t`i kompensojë me sjellje të veçanta, duke mos lejuar arritjen e të metave në vetëdijen e tij. Në psikologjinë individuale të Alfred Adlerit (Alfred Adler, 1870 – 1937) dhe në psikologjinë analitike ose komplekse të Karl G. Jungut (Carl G. Jung, 1875 – 1961), e pikërisht në teorinë e personalitetit të të dy studiuesve termi kompensim ka kuptim të veçantë. Kompensimi në teorinë e personalitetit të Alfred Adlerit është mekanizëm psikologjik kundër ndjenjës së inferioritetit. Në psikologjinë e Karl G. Jungut kompensimi është funksioni vetërregullues i aparatit psikik të njeriut. Sipas tij "kompensimi është proces i përhershëm psikik i njëjtësimit dhe i barazimit ndërmjet vetëdijes dhe pavetëdijes". Ky është synimi vetërregullues që funksioni i vetëdijes së pazhvilluar të kompensohet me zhvillim të pavetëdijes së një njeriu të caktuar. Në psikologjinë bashkëkohore të personalitetit kompensimi konsiderohet mekanizëm mbrojtës, me anë të cilit njeriu me arritjen e sukseseve të dallueshme në një fushë veprimi mbrohet nga mossuksesi në një fushë tjetër të veprimit të tij.

KOMPETENC/Ë, – A. f. I ardhur nga latinishtja *competentia*. Kompetenca është term me kuptim të përgjithshëm që përdoret edhe në psikologji duke ruajtur kuptimin e përgjithshëm. Kompetenca është aftësia e një individi për të kryer me sukses detyrat e një fushe të caktuar, ku ai ka fituar njohuri të thella, të plota dhe të sakta, të shoqëruara me një shkallë të lartë sigurie për dije të tilla dhe nga të cilat ai është i aftë të arrijë në zgjidhje objektive të situatave problematike. Pra, krahas dijeve kompetenca nënkupton edhe aftësinë e përdorimit të suksesshëm të tyre në zgjidhjen e problemeve dhe të situatave problematike.

KOMPLEKS, - I. m. I ardhur nga latinishtja *complexus* "i ndërlikuar, i përbërë prej pjesëve të lidhura në një tërësi". Kompleksi është gërshetim mendimesh, përfytyrimesh, qëndrimesh etj. që kanë për bazë lidhje të ndërlikuar ndjenjash negative, të drejtuara në një objekt ose situatë të caktuar. Ringjallja e njërit mendim, përfytyrim, qëndrim etj. për objektin ose situatën e caktuar shkakton aktivizimin e këtij sistemi, që manifestohet me reagimin karakteristik të individit ndaj atij objekti ose ndaj asaj situate. Reagimi i individit që ka kompleks ndaj një situate apo objekti të caktuar i nënshtrohet më tepër kompleksit të tillë, sesa karakterit real të asaj situate. Zigmund Frojdi (Sigmund Freud, 1856 – 1939) kompleksin e ka quajtur "dirigjent i autorizuar i sjelljeve të njeriut në botën e jashtme". Për këtë shkak kompleksi ndikon në rrjedhjen e procesit të mendimit dhe në organizimin e sjelljeve të njeriut, madje këtyre në disa raste mund t`u japë zhvillim patologjik. Komplekset kanë kryesisht karakter të pavetëdijshëm. Termin kompleks në psikologji e ka përdorur Karl G. Jungu (Carl G. Jung, 1875 – 1961). Literatura psikanalitike është e mbushur me lloje të ndryshme kompleksesh, si kompleksi i Edipit, Jokastës, i inferioritetit, i superioritetit, i tredhjes etj.

KOMPLEKSI AUTONOM. Kompleks me ngarkesë të theksuar emocionale dhe me shkallë të lartë të funksionimit autonom. "Sillet si trup i pavarur në hapësirën e vetëdijes së njeriut" i ardhur nga pavetëdija kolektive. "Kompleksi zakonisht mund të shtypet me energjinë e vullnetit, por nuk mund të dëbohet dhe në rast të volitshëm paraqet përsëri fuqinë e vet fillestare". Termi kompleks autonom i përket psikologjisë analitike apo komplekse të Karl G. Jungut (Carl G. Jung, 1875 – 1961). Shih ***– KOMPLEKSI.***

KOMPLEKSI DIANA. Grup përfytyrimesh dhe idesh të përçuara me emocione dhe të lidhura me simbolin e Dianës, e cila e ka të ngulitur thellë në vetëdijen e saj dëshirën për t`u bërë mashkull. Një dëshirë e tillë ka fuqi emocionale të madhe dhe i drejton asaj sjelljet e veta në veshje, në shprehje, në paraqitje etj., e pikërisht siç thotë Frojdi se, kompleksi është dirigjent i arsyeshëm i sjelljeve të njeriut në botë dhe rrjedhimisht, kompleksi ia orienton Dianës sjelljet e saj drejt shndërrimit në gjininë mashkullore.

KOMPLEKSI I EDIPIT. Tërësi dëshirash, ndjenjash, idesh etj. të përqendruara në dëshirën e pushtimit të prindit të gjinisë së kundërt nga ana e fëmijës dhe e mënjanimit të prindit të gjinisë së njëjtë. Në këtë anësi fshihet dëshira seksuale e fëmijës. Në fillim ka ekzistuar mendimi se këtu kemi të bëjmë vetëm me dëshirën e fëmijës mashkull për të anuar kah e ëma me xhelozi ndaj të atit. Më vonë kompleksi i Edipit është konsideruar kompleks universal.

KOMPLEKSI I ELEKTRËS. Kompleksi i Edipit që manifestohet te vajzat në formë të kundërt: këto bëhen ziliqare ndaj meshkujve dhe organit të tyre seksual. Kompleksi i Elektrës është term i psikanalizës i përdorur kryesisht nga Karl G. Jungu, kompleks, që emërton dukurinë e drejtimit të dashurisë së vajzës nga e ëma kah i ati, pas moshës 4 – 5 vjeç. Psikanalistët këtë dukuri e shpjegojnë si pasojë e dëshirës së përgjithshme të vajzave për organin mashkullor, që nuk e kanë hasur te e ëma. Objekti i parë i dashurisë së vajzës ishte nëna, por kjo dashuri përfundon duke e ndërruar objektin e dashurisë. Pas moshës 4 – 5 vjeç vajza lidhet me babanë, me shpresë se nga ai do të marrë atë që e ëma nuk ka pasur mundësi t`ia japë. Tashmë vajza bëhet ziliqare ndaj penisit të mashkullit. Kur vajza zhvillohet me trup dëshira e pavetëdijshme për të pasur një organ mashkullor zëvendësohet me dëshirën për të pasur fëmijë. Vajzat mbeten për një kohë relativisht të gjatë duke përjetuar këtë kompleks dhe për këtë pohohet se te ato dëmtohet përmbajtja dhe funksioni i superegos. Termit dhe konceptit të Elektrës i janë bërë shumë vërejtje.

KOMPLEKSI I FAJËSISË. Ndjesia e fajit që e përjeton njeriu nga ndërgjegjësimi i shkeljes së normave morale. Kompleksi i fajit ushtron për një kohë të gjatë ndikim të posaçëm në sjelljet e njeriut.

KOMPLEKSI I FUQISË. Kompleksi i fuqisë është lloj i një kompleksi të theksuar nga ana e Karl G. Jungut (Carl G. Jung, 1875 – 1961). Sipas tij kompleksi i fuqisë është tërësi e atyre

përfytyrimeve dhe synimeve me prirje që uni të vihet mbi ndikimet e të gjithë të tjerëve dhe ndikimet e tjera t`i nënshtrohen unit". Njeriu që ka kompleksin e fuqisë ka ndjesinë se është sundues, pushtues dhe mbisundues i të gjithëve. Të tjerët mund të jenë individë të botës së jashtme (banorët e lagjes, të qytetit, të institucionit etj.), por mund të jenë edhe të brendshëm (përfytyrimet, pikëpamja, qëndrimet etj.).

KOMPLEKSI I INFERIORITETIT. Sipas psikologjisë individuale të Alfred Adlerit (Alfred Adler, 1870 – 1937) nënkupton një tërësi emocionesh, idesh dhe qëndrimesh të pavetëdijshme që formohen te njeriu nga zhvillimi i pamjaftueshëm fizik, shkalla e ulët sociale, zhvillimi i kufizuar intelektual etj. Kompleksi i inferioritetit të zhvilluar ushtron ndikim negativ, madje edhe patologjik, në zhvillimin e mendimit, të përjetimeve dhe të sjelljeve të njeriut. Kjo tërësi merr formën ndikuese të një kompleksi, kur shtresohet dhe bëhet gjithnjë e më shumë energjik, e pikërisht më i fuqishëm. Kompleksi i inferioritetit shfaqet në tërheqjen e njeriut nga situatat e caktuara, në mosbesimin e tij në forcat e veta fizike, shoqërore dhe psikike. Ata që vuajnë nga një kompleks i tillë zakonisht zhvillojnë veprimtari të nivelit të lartë për të kompensuar atë që u mungon ose mendojnë se u mungon.

KOMPLEKSI I JOKASTËS. Jokasta ka qenë e bija e Agamemnonit dhe e Klitemnestrës, motra e Orestës dhe nëna dhe gruaja e Edipit. Sipas psikanalizës kompleksi i Jokastës është variant i kompleksit të Edipit, që ka të bëjë me animin e fëmijës vajzë kah i ati, ku fshihet dëshira seksuale e saj ndaj të atit dhe xhelozia e fëmijës ndaj të ëmës. Termi kompleksi i Jokastës i përket psikologjisë së Karl G. Jungut (Carl G. Jung, 1875 – 1961).

KOMPLEKSI I MADHËSHTISË. Mbivlerësim i aftësive, i rezultateve, i ambicieve etj. të individit nga ana e atij vetë, mendim ky që nuk përputhet me realitetin. Kompleksi i madhështisë ose i superioritetit shpjegohet kryesisht nga ndikimi që ushtron te individi i tillë si mbrojtje nga ndjenjat e thella të inferioritetit. Ky kompleks shpesh shoqërohet me sjellje mendjemadhësie, arrogance, agresiviteti etj. Te njeriu me kompleksin e madhështisë dallohen përfytyrimet, ndjenjat, qëndrimet etj. të përqendruara në theksimin e superioritetit intelektual, moral, fizik etj. ndaj të tjerëve. Kompleksi i madhështisë ose i superioritetit është i theksuar posaçërisht në psikologjinë e Alfred Adlerit (Alfred Adler, 1870 – 1937).

KOMPLEMENTAR, - E. mb. I ardhur nga latinishtja *complementarius* "plotësues", që përcakton plotësimin e një substance, të një lloj aktiviteti me një lloj tjetër substance, apo të një aktiviteti tjetër.

KOMPULSION, - I.m. I ardhur nga latinishtja *compellere* "detyro". Detyrim nga brenda i një individi për të kryer ndonjë veprim ose ndonjë sjellje, e cila nuk ka kurrfarë qëllimi, por që ky individ nuk është i aftë për ta kundërshtuar një veprim apo një sjellje të tillë. Veprim kompulsiv është numërimi i dritareve të shtëpive kur ai

kalon në rrugë, numërimi i shtyllave telefonike, të larët e duarve kohë pas kohe, kontrollimi disa herë i mbylljes me çelës të derës së oborrit, kërkesë e përhershme e lejes për kryerje aktivitetesh etj. Kërkesa e individëve të tjerëve për t`i ndërprerë këto veprime e sjellje shkakton ankth të nivelit të lartë, kurse pas kryerjes së veprimeve kompulsive individi përjeton lehtësi nga shkarkimi i ankthit të tij.

KOMUNIKIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *communication*. Në kuptimin e përgjithshëm është këmbim informacionesh ndërmjet njerëzve, dhënie e marrje informacionesh nga njëritjetri. Në psikologji komunikimi është këmbim informacionesh me anë të shenjave, formë karakteristike e ndërveprimit simbolik ndërmjet dhënësit e marrësit të informacioneve, të porosive, të urdhëresave etj. Përmbajtja e simboleve të komunikimit mund të jetë përmbajtje intelektuale, emocionale, sociale, ushtarake etj. Për nga forma komunikimi mund të jetë komunikim fjalësor ose jofjalësor, pra verbal ose joverbal.

KOMUNIKIMI JOVERBAL. Mënyrë komunikimi ndërmjet individëve që përdorin duart, gjestet, lëvizjet e syve etj. për t'u lidhur midis tyre, pa përdorimin e fjalëve dhe shprehjeve frazeologjike. Komunikimi joverbal ka zhvillim të gjatë filogjenetik te njerëzit. Në shumë situata foljore folësit i shfrytëzojnë edhe shenjat trupore të veçanta për të theksuar rëndësinë e fjalëve, për ndryshimin e kuptimit të tyre etj.

KOMUNIKIMI VERBAL. Komunikim ndërmjet dy a më shumë individëve me anën e kodimit dhe dekodimit të simboleve fjalësore (të fjalëve, të figurave, të lëvizjeve, të numrave) të njohura për sistemin e gjuhës së tyre. Komunikimi verbal është forma më e lartë e tejbartjes së mendimeve, të porosive, urdhrave dhe të shprehjeve të sakta të formave të ndryshme të mendimeve dhe të ndjenjave. Kjo formë komunikuese i ka kontribuar shumë zhvillimit psikik të njeriut, sidomos zhvillimit dhe përsosjes së vazhdueshme të proceseve kognitive.

KONACION, - I.m. I ardhur nga latinishtja *conatus* "orvatje, përpjekje". Krahas koncepteve të njohjes dhe të ndjenjave dallohet edhe konacioni – dimensioni i tretë i jetës dhe i aktivitetit psikik të njeriut, që ka të bëjë me vullnetin e njeriut, me dashjen, dëshirën, synimin dhe me veprimtarinë e drejtuar në një qëllim apo objektiv të caktuar. Termi konacion i përket psikologjisë introspeksioniste të fundit të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX. Emërtonte shtresën e ndijimeve kinestetike, të përfytyrimit dhe të mendimit të lidhur me veprimtarinë e drejtuar në arritjen e një qëllimi të caktuar të njeriut. Sot haset rrallë në literaturën e psikologjisë.

KONCEPT, - I. m. Paraqitje e brendshme psikologjike e një individi për veçoritë e përgjithshme dhe thelbësore të një objekti, dukurie, procesi etj., ose të një lloji e klase të veçantë të tyre. Koncepti emërtohet me termin e caktuar (ambicie, kujtesë, ndjenjë e atdhedashurisë etj.). Është rezultat i proceseve kognitive, në radhë të parë i procesit të abstraktimit, të ndarjes dhe të mënjanimit mendor të cilësive

jothelbore dhe i përgjithësimit të veçorive thelbësore. Konceptet kanë rëndësi të madhe për njohjen e realitetit, për klasifikimin e dijeve dhe për rregullimin kognitiv të gjithë asaj që na rrethon. Konceptet përbëjnë bazën e sjelljeve të njeriut ndaj mjedisit të jashtëm dhe atij të brendshëm, si edhe ndaj raporteve e ndryshimeve të tyre.

KONCEPTI PËR VETEN. Tërësi bindjesh, idesh, pikëpamjesh, qëndrimesh etj. që ka njeriu për veten e tij. Në këtë tërësi hyjnë sistemi relativisht i pandryshuar dhe i organizuar i bindjeve, i gjykimeve, i qëndrimeve për tiparet kryesore të personalitetit të vet.

KONCEPTIMI MOLAR I PSIKOLOGJISË. Konceptimi molar i dukurive, i proceseve psikologjike dhe i sjelljeve që ka të bëjë me qasjen studimore të tërësisë së akteve psikike dhe me shpjegimin holistik të tyre, ku njësia studimore është përcaktimi se çfarë bën njeriu dhe përse vepron kështu? Ky konceptim ka filluar me qasjen geshtaltiste të perceptimeve dhe është përkrahur nga përfaqësuesit e disa teorive të personalitetit dhe të psikologjisë humaniste. Pikërisht, në studimet e Eduard K. Tolman (Edward Ch. Tolman, 1886 – 1959) vërehet qasja molare e studimit të akteve psikike.

KONDICION, - I.m. I ardhur nga latinishtja *conditio* "kusht" që përdoret shpesh edhe në psikologji. Kondicioni është gatishmëri e aftësive të organizmit për të kryer një veprim të mundimshëm. Ka kuptim të përgjithshëm dhe kuptim të veçantë. Kuptimi i përgjithshëm ka të bëjë me shkallën e lartë të gatishmërisë së aftësive të organizmit për të kryer një veprim që kërkon angazhim të mundit fizik e psikik dhe për t`iu rezistuar mundimeve me intensitet të lartë. Kuptimi i veçantë nënkupton shkallën e lartë të gatishmërisë së aftësive psikike e organike që kanë të bëjnë me një aktivitet specifik të gjatë dhe me intensitet të caktuar. Kondicioni për të ecur ka kuptim të përgjithshëm, kurse kondicioni për një lojë profesionale futbolli ka kuptim të veçantë.

KONÉ. asnj. Qeliza receptore të retinës së syrit që kryejnë funksionin e pamjes së ngjyrave. Besohet se syri i njeriut ka rreth 7 milionë kone ose kunjëza, që janë të lidhura me mbaresat e fijezave të nervit optik. Shih – ***KUNJËZAT DHE SHKOPTHAT; SYRI.***

KONEKCIONIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga latinishtja *connectere* "lidh". Konekcionizmi është model i rrjetës neurale, pikërisht model i qasjes studimore të sistemit të rrjetës së nyjave nervore të trurit, ku secila nyje e ngacmuar që ka nivelin e ngacmimit të saj shkakton ngacmimin e nyjës tjetër. Rrjedhimisht, ngacmimi i nivelit të caktuar aktivizues të nyjës nervore shkakton llojin e reagimit dhe të sjelljes së caktuar të individit. Termi konekcionizëm i përket terminologjisë së psikologjisë së të mësuarit, konkretisht teorisë asociacioniste të të mësuarit dhe e ka përdorur Eduard Li Torndajk (Edward Lee Thorndike, 1874 – 1949). Mbi bazën e konekcionizmit shpjegohen shumë procese neurokognitive.

KONFABULIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *co* "me" dhe *fabulare* "tregim, përrallë". Procesi i përmbushjes së rrjedhës së kujtesës e të mendimit me disa hollësi të trilluara, që të tjerëve

u duken shpesh të sakta, por në të vërtetë nuk i përkasin objektivitetit; këto janë tregime fantastike. Në literaturën e psikologjisë konfabulimi shpesh trajtohet si formë e para-amnezisë. Forma më e shprehur e konfabulimit dallohet në disa episode folëse të atyre që vuajnë nga sindroma e Korsakut.

KONFIGURACION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *configuratio* që përdoret në terminologjinë e gjeografisë, të shkencave ushtarake, si edhe në psikologji. Në psikologji termi konfiguracion emërton tërësinë e harmonizuar të përbërësve të një dukurie, objekti, procesi etj. Me këtë kuptim konfiguracioni është diçka tjetër nga shuma e elementeve që përbëjnë një tërësi. Termi konfiguracion haset më tepër në terminologjinë e procesit të perceptimit.

KONFIRMIM, - I. m. Në kuptimin e përgjithshëm vërteton saktësinë e një informacioni, pohimi, mohimi etj. Në psikologjinë e të mësuarit ka një kuptim të veçantë, ku me konfirmim kuptohet përforcimi i një lidhjeje ndërmjet dy ngacmuesve (dy fjalëve, ngjyrave, përfytyrimeve etj.). Psikologu amerikan Eduard Ç. Tolman (Edward Ch. Tolman, 1886 – 1959) në teorinë e të mësuarit konfirmimin e ka përcaktuar konstrukt teorik të plotësimit të një pritjeje nga ana e një subjekti të caktuar.

KONFLIKT, - I. m. I ardhur nga latinishtja *conflictus* "grindje, përleshje, përplasje, mospajtim". Termi konflikt ka kuptim të përgjithshëm në komunikimin e zakonshëm – gjendja e shkaktuar nga papajtueshmëria e interesave, e pikëpamjeve, e qëndrimeve të dy individëve, Prej këtij kuptimi termi konflikt ka hyrë në psikologji dhe nënkupton përplasjen ndërmjet dy interesave, motiveve, qëndrimeve etj. përbrenda strukturës psikologjike të një individi ose ndërmjet dy sosh me pikëpamje, qëndrime, synime të kundërta, që manifestohet në orvatjet e secilit për ta penguar realizimin e interesave, të motiveve e të qëndrimeve të kundërta. Nën ndikimin e funksionimit të interesave, të motiveve, të qëndrimeve të kundërta pengohet aktiviteti i individit dhe krijohet te ai një gjendje e veçantë psikologjike. Konfliktet e tilla dhe funksioni i tyre është trajtuar posaçërisht në psikanalizë, ku Zigmund Frojdi (Sigmund Freud, 1856 – 1939) ka theksuar konfliktin ndërmjet shtytjes seksuale dhe shtytësve të egos, e më vonë ndërmjet erosit dhe tanatosit. Alfred Adleri ka theksuar synimin për mbisundim dhe ndjenjën për raporte ndërmjet anëtarëve të një bashkësie sociale, kurse Karl G. Jungu (Carl G. Jung, 1875 – 1961) ka theksuar konfliktin ndërmjet unit të vetëdijshëm dhe arketipave. Në psikologji bëhet fjalë për kuptimin, rëndësinë dhe tipologjinë e konflikteve sipas psikologut amerikan me origjinë gjermane Kurt Levinit (Kurt Lewin, 1890 – 1947). Sipas psikologjisë strukturore të teorisë së fushave të tij ekzistojnë këto lloje konfliktesh psikologjike:

a. **Konflikti i refuzimit të dyfishtë** – Përleshje e përplasje e brendshme e njeriut kur ai gjendet në pozicionin e zgjedhjes së domosdoshme të njërit qëllim negativ ndërmjet dy qëllimeve refuzuese me intensitet të njëjtë. I tillë është konflikti që të qëndrojë në punë në një institucion të mërzitshëm apo të mbesë pa punë. Në rastet e këtilla

zgjedhja e domosdoshme është e vështirë dhe zakonisht shtyhet afati i zgjedhjes, por dikur, arrin një çast, kur njeriu duhet të vendosë për njërin qëllim që ka më pak të këqija. Këtë konflikt e ilustron figura e mëposhtme:

b. Konflikti i tërheqjes së dyfishtë – Përcaktimi i vështirë i njeriut për njërën nga dy mundësitë e dëshirueshme për të, sepse si njëri ashtu edhe tjetri janë në të njëjtën kohë njësoj tërheqës. Ky konflikt shfaqet kur njeriu gjendet ndërmjet dy qëllimeve pozitive, por duhet zgjedhur vetëm njëri nga këta dy qëllime. Konflikti i tipit të tillë zakonisht zgjidhet lehtë dhe pa pasoja negative për individin. Tipi i këtij konflikti paraqitet grafikisht sipas kësaj skeme:



c. Konflikti i tërheqjes dhe i refuzimit të njëkohshëm – Gjendja e njeriut kur ai duhet të vendosë të zgjedhë qëllimin që edhe e tërheq edhe e refuzon (marr alkool, por dëmtoj shëndetin dhe njëkohësisht nuk mund të çlirohem nga ai; i afrohem marrëveshjes për martesë me një vajzë të pëlqyeshme, por e dyshimtë në pikëpamjen morale; individit i afrohet punësim më i favorshëm, por me detyrime të mëdha etj.). Tipi i konfliktit të tillë është shumë i vështirë. Vështirësitë shfaqen në faktin se individi sa më shumë të largohet nga një qëllim, aq më shumë ai qëllim fiton në fuqinë tërheqëse të tij dhe, përkundrazi, sa më afër të jetë zgjidhja aq më refuzues bëhet dhe fillon të mendojë për qëllimin tjetër. Këtë e paraqet skema e mëposhtme:



KONFLIKTI AKTUAL. Konflikti i lidhur me çastin, me të tashmen e njeriut, me situatën dhe me gjendjen që ai ndodhet momentalisht. Marrja në konsideratë e faktorëve, e raporteve, e situatës së çastit për shpjegimin e një konflikti ka rendësi parësore ndaj gjurmimit të rrënjëve të atij konflikti nga përvoja më e hershme. Pikëpamje të tillë kanë përfaqësuesit e psikologjisë geshtaltiste me në krye Kristian fon Erenfels (Christian von Ehrenfels, 1859 – 1932), ata të psikologjisë ekzistencialiste të prirë nga Ludvig Binsvanger (Ludwig Bingwanger, 1881 – 1966 dhe ata të psikologjisë humaniste të prirë nga Abraham Maslou (Abraham Maslow, 1908 – 1970).

KONFLIKTI I INTERESAVE. Përleshje ndërmjet dy interesave të një individi në dy vende pune, në dy role etj. të njëkohshme që kërkojnë qëndrime dhe sjellje të ndryshme dhe shpesh edhe të kundërta. E tillë është përplasja ndërmjet interesit dhe qëndrimit të mirë të një gruaje shtëpiake dhe ambicieve të saj për t`u afirmuar në fushën e artit, të shkencës ose përleshja ndërmjet interesave dhe

detyrimeve të një individi dhe aftësive të kufizuara të tij për të kryer me sukses të plotë detyrat profesionale në punë.

KONFLIKTI KULTUROR. Në kuptimin psikologjik është konflikt specifik i një individi, kur ai ballafaqohet me dy lloje normash, dy standarde sjelljesh, përkatësisht me dy praktika kulturore, që i kundërvihen njëra-tjetrës dhe njeriu nuk mund t`i respektojë sjelljet e njëkohshme të dy standardeve kulturore. Të jesh besnik i fjalës së dhënë apo mos ta mbash atë në dobi të grupit social?

KONFLIKTI NEUROTIK. Konflikt i brendshëm i njeriut që karakterizohet nga përplasja e brendshme e dy synimeve të kundërta të tij. Konflikti neurotik ka këto veçori: synimet e kundërta të këtij konflikti janë synime detyrimore që kanë mbështetje të fuqishme në nevojat e kundërta të njeriut dhe kanë karakter të pavetëdijshëm. Këto janë veçoritë e konfliktit neurotik të përcaktuara nga ana e psikanalistes amerikane me origjinë gjermane Karen D. Hornej (Karen D. Horney, 1883 – 1952). Psikanaliza e shpjegon konfliktin neurotik si ndarje të personalitetit në dysh: njëra pjesë e personalitetit ka dëshira të caktuara, kurse pjesa tjetër e tij u kundërvihet fuqimisht këtyre dëshirave. Sipas Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939) "pa konflikt të këtyre dy pjesëve nuk ka neurozë". Këtu kemi të bëjmë me përplasjen e shtytjes infantile seksuale të idit dhe me mbrojtjen e egos së personalitetit. Konflikti neurotik zhvillohet atëherë, kur energjia e shtytësit të idit bëhet më e fuqishme se energjia e egos.

KONFLIKTI THEMELOR. Konflikti i individit ndërmjet nevojës për të tjerët dhe nevojës për të pasur fuqi mbi të tjerët. Kur konflikti ndërmjet nevojave të përmendura është i pazgjidhshëm nga ana e bartësit të tij, atëherë bartësi i tij e shtyp konfliktin, e ndrydh, largohet nga të tjerët, por largohet edhe nga vetja e tij. Ky është njeriu me konflikt nevrik. Konflikti nevrik ka karakter të pavetëdijshëm. Nëse bartësi është në gjendje ta zgjidhë vetë, atëherë organizimi i sjelljeve dhe rrjedha e tyre kryhet në mënyrë krejtësisht normale. Zgjidhja e këtillë e konfliktit ka karakter të vetëdijshëm. Termi personalitet bazal i përket psikologjisë së Karen Hornaj (Caren Horney, 1885 – 1952).

KONFORMIZ/ËM, - MI. m. Term i psikologjisë sociale që emërton kuptimin e asaj dukurie psikike që ka të bëjë me ndryshimin e bindjes, të qëndrimit, të sjelljes së njeriut në përputhje me qëndrimin e përgjithshëm të një grupi social, duke iu përshtatur normave të atij grupi dhe duke qenë nën ndikimin e qëndrimit të përbashkët, e jo nga bindja e tij se qëndrimi dhe sjellja personale ndaj një dukurie, objekti, procesi etj. duhet ndryshuar. Dukuria e konformizmit ndikon në perceptimin, mendimin, në qëndrimin dhe në sjelljen e një individi. Në psikologjinë sociale ndeshen disa forma konformizmi:

a. **Konformizmi i sjelljeve –** Prirje e një ose disa anëtarëve të një grupi për ta ndryshuar sjelljen personale, varësisht nga ndryshimi i sjelljes së shumicës në grup, me qëllim përshtatjen e tij ndaj sjelljes së përgjithshme;
b. **Konformizmi i qëndrimeve –** Ndryshimi i qëndrimeve personale

nga ndikimi që ushtron grupi social i caktuar; në rastet e ndryshimit të qëndrimeve nuk është e thënë që të ndryshohet edhe sjellja e individit;

c. **Konformizmi i tipareve të personalitetit –** Prirja e një individi, anëtari të një grupi social për t`i ndryshuar tiparet e tij nga ndikimi që ushtron ky grup social. Kjo formë e konformizmit është e lidhur ngushtë me ndryshimin e qëndrimeve, të bindjeve dhe të sjelljeve individuale.

KONFUZION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *confutio*. Gjendje psikike e ngjashme me gjendjen e lirë. Gjendja e konfuzionit manifestohet me paqartësi mendore; mendimet e qëndrimet vështirë të shkoqiten dhe kjo gjendje shkakton huti të pashpjegueshme; njeriu e ka vëmendjen të shpërndarë dhe ndjen frikë, duke e pasur të pamundur që ta zotërojë veten. Konfuzioni shfaqet në nivele të ndryshme dhe shkaktohet nga traumat e kokës, infeksionet e ndryshme (të trurit, të gjakut etj.), nga skleroza etj.

KONFUZIONI I IDENTITETIT TË PERSONALITETIT. Dukuri e hutimit të personalitetit që shfaqet me përjetimin e ndjenjës së humbur, pjesërisht ose tërësisht për veten, si personalitet i pavarur dhe integral fizik, social e psikik, që dallohet nga të gjithë të tjerët, paqartësi për veten që është unik si sot, ashtu edhe dje, si edhe nesër, paqartësi në ndjenjën e përkatësisë së gjinisë etj. Konfuzioni i tillë është dukuri karakteristike e asaj moshe të të rinjve, kur këta kalojnë nga mosha e fëmijërisë në moshën e rinisë, përkatësisht në moshën e adoleshentit. Pasojë e një konfuzioni të tillë është marrja e vendimeve të rëndësishme pa menduar thellësisht për pasojat afatgjata të tyre (zgjedhja e profesionit, e partnerit, e shokut të ngushtë etj.). Këtë lloj konfuzioni e ka trajtuar sidomos psikanalisti Erik H. Erikson (Erik H. Erikson, 1902 – 1994).

KONFUZIONI MENDOR. Gjendje mendore jonormale i një individi të caktuar, ku më shumë janë goditur proceset kognitive. Gjendjen e konfuzionit mendor e karakterizon pamundësia e përqendrimit në objektin e bisedës, humbja e aftësisë së mbajtjes mend të informacioneve të reja, të gjykuarit jothelbësor, pamundësia e lidhjes me kohë dhe me hapësirë të caktuar, reagimet shpesh të vonuara dhe të pakoordinuara, duke mos ditur se kush janë. Konfuzioni mendor shkaktohet nga tumoret e trurit, traumat e kokës, skleroza multiple etj.

KONGRUENCË, - A. f. Term që përdoret rrallë në psikologji, i ardhur nga latinishtja *congruere* "përputhje". Me këtë kuptim të përgjithshëm emërton kongruencën e një instrumenti matës në psikologji, siç janë: pyetësori, testet, shkalla e vlerësimit etj. Kongruenca e vlefshmërisë së një testi është formë e vlefshmërisë së atij testi, që ka të bëjë me krahasimin e rezultateve të përftuara në zbatim të një testi të ri, kur rezultatet e arritura krahasohen me rezultatet e një testi të ngjashëm, vlefshmëria e të cilit është argumentuar. Kjo arrihet me zbatimin e metodës së ndërlidhjes apo korrelacionit.

KONGRUENCA E NDRYSHIMIT TË QËNDRIMEVE. Në psikologjinë sociale emërton ndryshimin e qëndrimit varësisht nga porosia apo mesazhi i marrë nga dhënësi i saj.

KONGJENITAL, - E. mb. I ardhur nga latinishtja *congenitus* "i (e) lindur". Cilësi fizike a psikike e lindur, jo si rezultat i trashëgimisë, por nga dëmtimet e sistemit nervor të zhvillimit të embrionit në fazën e paralindjes ose gjatë procesit të lindjes. E meta fizike apo psikike shfaqet me lindjen e fëmijës, megjithëse vështirë të dallohet në ditët e para pas lindjes. Kjo mund të ndodhë nga ndonjë sëmundje virusale e nënës, nga marrja e drogave gjatë periudhës së shtatzënisë, nga infeksioni i nënës, nga procesi i vështirë i lindjes së foshnjës etj. Pohohet se edhe marrja e pijeve alkoolike, pirja e duhanit, marrja e barnave etj. mund të shkaktojë çrregullime organike afatgjata që nga dita e parë e lindjes së fëmijës.

KONICA Faik. Mendimtar shqiptar, njohës i thellë i mendësisë shqiptare. Lindi në Konicë më 14.02.1875 dhe vdiq në Uashington më 15.12.1942. Me shkrimet e veta kryesisht letrare dhe kritike ka ushtruar ndikim jo të drejtpërdrejtë në zhvillimin e mendimit shkencor ndër Shqiptarët. Kreu studimet e larta në Universitetin Shtetëror të Dizhonit, ku dha me sukses të lartë provimin e diplomës "Bachelier es Letres – philosophie" - "Baçelor i letrave të letërsisë e filozofisë". Më pas, më 1892 u regjistrua në Kolegjin Qeveritar të Karkasonës, ku studioi letërsinë e filozofinë. Më 1895 mbaroi studimet e letërsisë dhe të filozofisë në Universitetin e Dizhonit. Prej këtej studioi në Paris letërsinë mesjetare frënge, latine e greke. Më 1912 fitoi diplomën e magjistrit të arteve dhe të letërsisë në Universitetin e Harvardit në Masaçusets. Themelues dhe botues i revistës "Albania", organ i vetëm i asaj kohe me përmbajtje të përgjithshme për Shqiptarët e Shqipërinë, për historinë e kulturën, për traditat, virtytet, zakonet e sjelljet e Shqiptarëve. Për shkallën e lartë të inteligjencës dhe kulturën e gjerë të tij u quajt "Volteri shqiptar", kurse Gijom Apolinieri e quajti "Enciklopedi që ecën". Në përshkrimin dhe shpjegimin e sjelljeve dhe të motiveve të Shqiptarëve dallohet angazhimi i tij për modelin e ri të sjelljeve të tyre, ku për zhvillimin e mendimit psikologjik kanë vlerë të posaçme tri qëndrime kryesore të tij: 1. Identifikimi i veseve të Shqiptarëve, vetëdijesimi i Shqiptarëve për to me qëllim të zhdukjes së tyre, 2. përshkrimi i "pamjes fizike dhe temperamentit" të "racës shqiptare" dhe 3. cilësimi i vëzhgimit shkencor si metodë hulumtuese, për dallim nga vëzhgimi i zakonshëm, i rastit dhe përshkrimi i tij nga ana e një vëzhguesi "por jo (vëzhgim P.N.) i një shkencëtari". Mbi bazën e vëzhgimit të zakonshëm dhe të përshkrimit të disa tipareve nga studiuesit vizitorë të Shqipërisë, ka bërë përshkrimin e tipareve të karakterit të Shqiptarëve, ku ka dalluar: tiparin e zgjuarsisë, të krenarisë, të vetëdijes për përkatësinë kombëtare të tyre, të bujarisë, të besnikërisë, të tolerancës fetare, të përkushtimit të thellë të individit ndaj prindërve e familjes, por ka dalluar edhe tiparin e individualizmit, të lakmisë për para, të bezdishmërisë, të gjaknxehtësisë, të kokëfortësisë, të parapëlqimit për skllavëri, të mungesës së vizionit për ardhmëri etj. Faik Konica e përcaktoi lirinë njerëzore mbi bazat etike, sociologjike, psikologjike e juridike shumë kohë para shpalljes së Deklaratës së Përgjithshme për të

Drejtat e Njeriut. Për të liria është e drejtë e çdo individi: "Për të besuar si të dojë, për të folur çka në zemër, për të shkruar çka në kokë dhe për të bërë ç`të dojë, me kusht që të mos dëmtojë askënd". E tëra mund të quhet psikologji popullore e Shqiptarëve, sepse nuk është bazuar në metoda e procedura sistematike e matëse, por vetëm në vëzhgime të disa vizitorëve të jashtëm dhe të pranuara e të përshkruara prej tij. Ka dalluar mungesën e angazhimeve kërkimore në Shqipëri duke përmendur rëndësinë e matjeve antropologjike për njohjen e tërësishme të Shqiptarëve. Ka përkrahur matjet antropologjike të antroplogut gjerman Dr. Paul Tregerit, i cili duke u mbështetur në disa matje arriti në përfundimin për "karakterin homogjen të racës shqiptare". Të tjerë i kanë emërtuar Shqiptarët e Alpeve Dinarike "Brachycephalic" – "Brahicefalik"- *individ me gjerësi të kafkës së kokës nga 80 %, krahasuar me gjatësinë e kokës.* Me këtë Faik Konica argumentoi rëndësinë e matjeve antropologjike për njohjen e tërësishme të Shqiptarëve, por, edhe pse nuk e ka thënë, del edhe nevoja e matjeve të zhvillimeve mendore për njohjen e tërësishme të Shqiptarëve (edhe sot është pak e zhvilluar ndër studiuesit shqiptarë). Veprat kryesore të Konicës janë: *"Albania, the Rock Garden of Southastern Europe"* – (*"Shqipëria, kopshti shkëmbor i Europës Juglindore"*), botuar më 1957 në Boston; *"Doktor gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit",* 1924 etj.

KONKLUZION, - I. m. Term i logjikës dhe i psikologjisë i ardhur nga latinishtja *conclusio* "përfundim". Shih ***– PËRFUNDIMI***.

KONKRET, - E. mb. I ardhur nga latinishtja *concretus* që përcakton atë formë të ekzistencës së materies që ka karakter lëndor, që mund të kapet me anë të shqisave, ngaqë ekziston në realitetin e gjithëmbarshëm, ka cilësi e përmasa të caktuara si edhe lidhje të caktuara kohore e hapësinore.

KONOTACION, - I. m. Term i gjuhësisë i ardhur nga latinishtja *connotatio*. Emërton kuptimin subjektiv, në rend të parë kuptimin e ngarkuar me emocione të një fjale. Fjalët dashuri, drejtësi, liri etj. për të gjithë ata që komunikojnë në gjuhën e caktuar kanë një kuptim të përgjithshëm, por krahas dhe bashkë me këtë kuptim kanë edhe shtesa kuptimesh që përdoren gjatë procesit të komunikimit. Fjala *borë* përpos tërësisë së tipareve kryesore e thelbësore të borës ka edhe kuptim plotësues në procesin e komunikimit: *e ftohtë, ngricë, e butë* etj. Këto shtesa subjektive shpesh shkaktojnë nivele të ndryshme mosmarrëveshjesh.

KONSERVATORIZ/ËM, - MI. m. I ardhur në shqip nga latinishtja *conservation* "ruajtje". Konservatorizmi emërton synimin dhe gatishmërinë e ruajtjes së formave të vjetra të sjelljes. Ky synim ka shtrirje të përgjithshme dhe të veçantë dhe, si i tillë, mund të ketë efekte pozitive dhe efekte negative. Synimi kah ruajtja e gjithëmbarshme e së vjetrës dhe qëndrueshmëria ndaj përpjekjeve për formimin e sjelljeve dhe llojeve të veçanta e të reja të tyre pengon zhvillimin e individit, sikurse edhe ruajtja e disa formave të veçanta të sjelljeve të individit të formuara në fazat e mëhershme të zhvillimit.

KONSERVIM, - I. m. Term i psikologjisë së Zhan Pijazhes (Jean Piaget, 1896 – 1980) që nënkupton shkallën e zhvillimit të mendimit të një fëmije, kur ai është në gjendje të konstatojë se masa dhe pesha e një trupi nuk ndryshon pavarësisht nga ndryshimi i formës dhe i madhësisë së asaj lënde. Sasia e ujit të zbrazur në një gotë të gjatë e të hollë është e njëjtë me sasinë e ujit të zbrazur në një gotë të gjerë dhe jo të thellë. Kur fëmija është në gjendje ta dallojë këtë cilësi të masës së një lënde, në rastin tonë të masës së njëjtë të ujit, por të zbrazur në gota uji me forma e madhësi të ndryshme, atëherë konstatojmë se ai gjendet në fazën e zhvillimit të mendimit konkret – operacional.

KONSOLIDIM, - I. m. Term me kuptim të përgjithshëm të rregullimit, të përforcimit të asaj që është mësuar dhe, si I tillë, është rrënjosur në sistemin e sjelljeve të një individi. Në psikologji konsolidimi ka të bëjë me lidhjen e ndryshimeve neurofizilogjike dhe të sjelljeve adekuate të këtyre ndryshimeve trunore. Konsolidimi i tillë arrihet me rritjen e numrit të sinapsave në trurin e njeriut.

KONSONANC/Ë, - A. m. Term i muzikës dhe i perceptimit të toneve muzikore që emërton harmoninë e disa toneve në një tërësi të pëlqyeshme dhe të këndshme për dëgjuesin e tyre. Tërësi të tilla janë kombinimi i toneve të disa instrumenteve muzikore të një shoqërie instrumentalistësh që janë në akord të plotë.

KONSONANCA KOGNITIVE. Gjendja psikike e njeriut, te i cili strukturat kognitive janë në lidhje harmonike; po ashtu dhe funksioni i secilës nga ato struktura, si edhe ndërlidhjet funksionale të tyre janë në lidhje harmonike me aktivitetin e përgjithshëm të njeriut.

KONSTANT/E, - JA. f. Vlerë e pandryshueshme, e përhershme dhe vlerë e qëndrueshme. Më së paku vlera të tilla ka në psikologji, por ka sidomos në psikofizikë.

KONSTANTJA E VEBERIT. Ligji i parë psikologjik në fushën e ndijimeve që vazhdon të konsiderohet edhe sot. Sipas këtij ligji për të pasur ndijim dhe ndryshim të tij është e domosdoshme rritja më e vogël e intensitetit të ngacmuesit, në mënyrë që njeriu të jetë në gjendje ta ndiejë këtë ndryshim. Ky ndryshim ndërmjet intensitetit të mëparshëm të ngacmuesit dhe shtimit të tij për të shkaktuar ndijim të një cilësie tjetër në krahasim me të mëparshmin është ndryshim konstant. Shprehet me formulën AI/I = k (k është konstantja, I = intensiteti i ngacmuesit paraprak, AI = ngritja e sapondier e atij intensiteti). Ky ligj u tregua i vlefshëm vetëm për shtrirjen mesatare të intensitetit të ngacmuesve, por jo edhe për shtrirjen e skajshme të intensitetit të ngacmuesve. Ligji u formulua nga psikofizikani gjerman Gustav Th. Fehner (Gustav Th. Fechner, 1803 – 1887), i cili shfrytëzoi rezultatet hulumtuese të mësuesit të tij Ernst H. Veber (Ernst H. Weber, 1795 – 1878).

KONSTANTSHMËRIA E NDRIÇIMIT. Dukuri e perceptimit të qëndrueshëm të ndriçimit të objekteve, të mjedisit, të proceseve etj., pavarësisht nga ndryshimi i kushteve të ndriçimit dhe nga këndvështrimi i objekteve, i

mjedisit, i procesit etj. Një copëz qymyr e perceptuar në errësirën e natës duket e zezë, megjithëse është më e ndritshme se errësira e natës.

KONSTANTSHMËRIA E PERCEPTIMIT. Prirja e qëndrueshme e njeriut që objektin e perceptimit ta perceptojë sipas përvojës së fituar, përkatësisht gati në formë konstante, të pandryshueshme ose shumë të ngjashme, megjithëse ai ka pësuar disa ndryshime ose kanë ndryshuar disa kushte e rrethana të perceptimit të tij. Kjo dukuri tregon se disa rregulla e parime psikologjike nuk përputhen gjithmonë me ato fizike dhe fiziologjike. Kjo dukuri ushtron ndikim pozitiv në aftësinë e përshtatjes së njeriut ndaj ndryshimeve ngacmuese të tij.

KONSTANTSHMËRIA E PERCEPTIMIT TË FORMËS. Emërton dukurinë e mosndryshimit të formës së objektit të perceptuar më parë, megjithëse tashmë ka ndryshuar këndi i të parit të atij objekti, si edhe figura e asaj forme të objektit perceptues në retinën e syrit të njeriut. Figura e rrethit duket e qartë kur shikohet drejt, por kur e njëjta figurë shikohet anash ajo lë përshtypjen e një elipsi. Megjithëkëtë, ne atë e perceptojmë jo sipas formës së saj në retinën e syrit, por sipas asaj që dimë për rrethin.

KONSTANTSHMËRIA E PERCEPTIMIT TË MADHËSISË. Mosndryshimi i madhësisë së perceptimit të një trupi, megjithëse madhësia e figurës së retinës së atij trupi ndryshon varësisht nga largësia e tij prej syve të njeriut dhe varësisht nga këndvështrimi i perceptimit të atij trupi.

KONSTATIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja, por i ngulitur në gjuhën shqipe. Konstatimi emërton përcaktimin e një fakti, të një dukurie, një të vërtete etj. nga ana e një individi të caktuar në bazë të funksionimit të proceseve intelektuale, duke emërtuar atë me një simbol (fjalë, shenjë, term etj.) dhe me një fjali të qartë, me terma domethënëse të shkoqitur dhe të njohur për ata që flasin një gjuhë të caktuar.

KONSTELACION, - I. m. Term me prejardhje nga latinishtja *constelatio*, që përdoret në psikologji. Përbën një tërësi të organizuar relativisht mirë të figurave, ideve, qëndrimeve etj. që ushtrojnë ndikim në perceptimin e drejtë të tyre, si edhe në përzgjedhjen e sjelljeve adekuate të njeriut ndaj tërësisë së këtij konstelacioni.

KONSTELACIONI I MENDIMIT. Rrjedhje normale e mendimit sipas renditjes së faktorëve të brendisë së tij. Konstelacioni i mendimit ushtron ndikim të drejtpërdrejtë në përcaktimin e drejtimit të asaj rrjedhjeje drejt zgjidhjes së një problemi, të një situate problemore etj. Në drejtimin e mendimit të tillë marrin pjesë edhe ndjenjat, por ndikimi i tyre është i vogël. Prirja përcaktuese e mendimit nuk merr pjesë në rrjedhjen e një mendimi të tillë.

KONSTITUCION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *constitution*, që emërton një tërësi relativisht të qëndrueshme të vetive fizike, ndonëse në literaturën e psikologjisë haset edhe kuptimi i termit konstitucion, që ka të bëjë edhe me cilësi psikologjike.

KONSTITUCIONI FIZIK. Trupi i qenieve të gjalla, zakonisht trupi i njeriut, përbërja anatomike, struktura

anatomike dhe funksioni i tërësishëm i të gjitha pjesëve të trupit të tij.

KONSTRUKT, - I. m. Term i ardhur nga latinishtja *constructus*, që ka marrë kuptim të veçantë në psikologji dhe në psikometri. Konstrukti bën fjalë për ndërlidhjen integrale të të dhënave në një tërësie. Në kuadrin e këtij kuptimi konstrukti ka dy karakteristika: secili konstrukt bën pjesë në një tërësi teorike, ku janë përcaktuar marrëdhëniet e tij me konstruktet e tjera të asaj tërësie. Në psikologji bëhet fjalë për konstruktet në bazë të efekteve që ato prodhojnë.

KONSTRUKTET E KULTURËS. Përbërësit thelbësorë të kulturës së një bashkësie dhe ndërlidhja e tyre. Konstrukte të kulturës janë përbërësit kryesorë dhe më të përgjithshëm të vlerave kryesore dhe të sistemit të këtyre vlerave. Termi konstrukt i kulturës emërton konceptin abstrakt të vlerave më të përgjithësuara. Konstrukte të kulturës shqiptare janë besa, mikpritja dhe toleranca fetare, që janë karakteristike për shumicën e Shqiptarëve.

KONSTRUKTET E PERSONALITETIT. Konstruktet e personalitetit janë qarqe tipike të përvojës së personalitetit të një individi, në bazë të të cilave ai percepton realitetin fizik, biologjik, social e psikologjik, si edhe dukuritë e raportet ndërmjet tyre. Themeli i perceptimit dhe i shpjegimit të realitetit kompleks është përvoja e fituar, e cila u jep kuptim të veçantë formave të këtij realiteti dhe raporteve brenda tij. Konstruktet e tilla i japin mundësi secilit të kuptojë çfarë pritet, të parashohë sjelljet e rrjedhimet e tyre, si edhe të krijojë shkallë të vlerësimit e të kontrollit të sjelljeve të tij. Termi konstrukte personale është term kryesor i teorisë së personalitetit të psikologut amerikan Xhorxh Kelit (George Kelly, 1905 – 1966). Sipas tij strukturat dhe qarqet e interpretimit dhe të parashikimit të ngjarjeve, të sjelljeve të të tjerëve dhe të sjelljeve të veta janë bipolare.

KONSTRUKTI EMPIRIK. Tërësi të dhënash e faktesh të bazuara vetëm në qasjen empirike të hulumtimit të tyre.

KONSTRUKTI HIPOTETIK. Shprehja më e shpeshtë e përdorimit të termit konstrukt në psikometri. Konstrukti hipotetik është supozim i ekzistencës së një strukture psikike, që nuk ka mundësi të identifikohet, por ka efekte që ai konstrukt i prodhon dhe, rrjedhimisht, në bazë të efekteve të tij besohet se ai ekziston. Në psikologji ka shumë konstrukte hipotetike, ndër të cilët dallohen: engrami, inteligjencia, motivi, qëndrimi, refleksi etj.

KONSTRUKTI PSIKOLOGJIK HIPOTETIK. Ndryshore që është e pamundur të vëzhgohet dhe të matet drejtpërdrejt, por supozohet se ekziston ngaqë është burim i besueshëm i një dukurie, procesi etj., ngaqë besohet se prodhon një lloj sjelljeje të veçantë te grupi i subjekteve që provohen. Konstrukti psikologjik i tillë nuk mund të regjistrohet, sepse nuk ka forma manifestuese të kapshme për shqisat e njeriut, të argumentuara mendërisht etj., por besohet se është një entitet psikologjik që duhet hulumtuar dhe identifikuar. Konstrukti hipotetik është koncepti i egos në psikanalizë, engrami, inteligjencia etj.

KONSTRUKTIVIZ/ËM, - MI. m. Teoria e perceptimit e përpunuar nga psikologu anglez Riçard L. Gregori (Richard L. Gregory, 1923). Sipas tij perceptimi i një dukurie, objekti, procesi është nivel më i lartë mendor, përkatësisht kognitiv nga natyra fiziologjike e ndikimit të një ngacmuesi. Në procesin e perceptimit marrin pjesë jo vetëm elementet ngacmues të shqisave, por edhe grimcat e kujtesës dhe ndjenjat e përjetuara më parë dhe të ruajtura në kujtesën e njeriut. Sjellja e njeriut ndaj objektit perceptues është kompleks fizik, fiziologjik dhe psikologjik.

KONTAKTI KULTUROR. Dukuria e raportit ndërmjet kulturave të dy a më shumë popujve që janë në raporte ekonomike, mediatike, emigruese, sociale, ushtarake etj. Raportet e tilla mund të krijohen me qëllim për të mbisunduar vlerat kulturore të një populli ndaj një populli tjetër, e me këtë rast kultura e popullit pushtues bëhet kulturë parësore. Raportet e kulturave në kontakt mund të kenë karakter asimilues, por edhe karakter bashkëqendrues, ku secili popull orvatet t`i ruajë vlerat e veta kulturore kryesore. Ka raste kur kulturat e dy popujve janë bashkuar spontanisht ose me qëllim dhe krijohet një sistem vlerash kulturore të përbashkëta ose një kulturë e re.

KONTAKTI ME REALITETIN. Kontakti me realitetin emërton konceptin e formimit të përfaqësimit mendor në mënyrë objektive të botës fizike, biologjike, sociale, psikologjike dhe të ndryshimeve të dukurive dhe të lidhjeve ndërmjet syresh. Kontakti i tillë nënkupton njohjen e motiveve, të sjelljeve të vetes dhe të të tjerëve, si edhe formimin e një pasqyre të qartë dhe objektive për personalitetin e tij.

KONTAKTI REAL. Koncept me përmbajtje dhe me shtrirje në përputhje me rregullat, normat, parimet dhe vlerat shoqërore të mjedisit ku është zhvilluar, formuar dhe vepron individi i caktuar.

KONTEKST, - I. m. Term me kuptim të ndërlikuar gjuhësor e psikologjik, i ardhur nga latinishtja *contexere* "me lidh". Me kontekst kuptojmë tërësinë e një mendimi të shprehur me fjali, ku kuptimi i tërësishëm mundësohet nga kuptimi i komponentëve përbërës dhe i lidhjeve ndërmjet tyre. Mbi këtë bazë mundësohet kuptimi i plotë i tekstit të shkruar, pikërisht i kumtesës, i porosisë, i referatit etj. dhe organizimi i sjelljeve të njeriut ndaj kuptimit të përgjithshëm. Zakonisht konteksti i një mendimi, i një lloj sjelljeje etj. ka kuptim më të gjerë nga përmbajtja e thënë ose e shkruar. Në psikologji ka mendime se të gjitha format e sjelljeve të njeriut duhen analizuar në kuadrin e një konteksti të caktuar dhe se, rrjedhimisht, çdo shpjegim i formave të sjelljeve të njeriut jashtë kontekstit është shpjegim jo i plotë dhe i gabueshëm. Në këtë kuadër perceptimi i njeriut me lartësi trupore mesatare në radhën e njerëzve të tjerë me lartësi më të madhe duket më i shkurtër, kurse i njëjti njeri në radhën e njerëzve me trup të shkurtër duket më i gjatë.

KONTIGJENT, - I. m. I ardhur nga latinishtja *contingens*, që përdoret edhe në psikometri, kur dallojmë se vlera kuantitative ose kualitative e një ndryshoreje është e lidhur me vlerën

e ndryshores psikologjike që vjen pas ndryshores së parë. Sipas mendimit të disa studiuesve lidhja ndërmjet dy ndryshoreve është lidhje shkakore, përkatësisht ndryshorja e dytë shkaktohet nga ndryshorja e parë dhe se ka mundësi të përcaktohet shkalla e varësisë së njërës ndryshore nga ndryshorja paraprake ose përkundrazi. Zakonisht lidhja e tillë shprehet me kategori kualitative të ndryshoreve.

KONTRAKATEKS, - A. f. Term i psikanalizës që ka të bëjë me energjinë e investuar të egos në procesin e kundërshtimit të kateksës së shtytësve. Shih – ***KATEKSA***. Turpi, ndjenja e fajit apo neveria etj. që janë zhvilluar që nga faza e latencës janë fuqi frenuese të energjisë së shtytësve, kur energjia e shtytësve pushton një objekt. Ruajtja e kësaj forme të investuar të energjisë së shtytësve shkakton konflikte në vetë personalitetin, madje kërkon investim të përhershëm të energjisë psikike, ndërkaq kontrakateksa ose kundërinvestimi shkakton ekuilibrim të energjisë së investuar në objektin e caktuar.

KONTRAKOMPULSION, - I. m. Term i latinishtes *contra* "kundër" dhe *compulsion* "domosdo". Në psikanalizë termi kontrakompulsion ka kuptim të veçantë, që ka të bëjë me ide dhe me veprime të reja që kryejnë funksionin e dërrmimit të ideve dhe të veprimeve kompulsive të mëparshme, të cilat individi nuk ka pasur mundësi t`iu shmanget, megjithëse ato janë shfaqur kundër vullnetit dhe kundër dëshirës së tij. Shih – ***KOMPULSIONI.*** Kontrakompulsionet në të vërtetë janë kompulsione që u kundërvihen kompulsioneve të vjetra.

KONTRAKTIMI I MUSKUJVE. Cilësia e tkurrjes dhe e lëshimit të muskujve. Kontraktimi i muskujve përbëhet nga kontraktimi izomerik dhe izotonik, e pikërisht kontrasti i muskujve agonist dhe antagonist. Kontraktimi i muskujve shkaktohet nga ngacmimi i muskujve. Kontraktimi i muskujve mundëson lëvizjen e organeve muskulorë dhe të sistemit të këtyre organeve.

KONTRAST, - I. m. I ardhur nga frëngjishtja *contraste* "kundër, mospërputhje". Në psikologji termi kontrast ka kuptimin e dallimit të madh ndërmjet dy cilësive perceptuese, kur cilësitë e tilla gjenden njëra pranë tjetrës në një hapësirë dhe kohë të caktuar, ose kur perceptohet një cilësi dhe pas saj perceptohet cilësia tjetër e realitetit.

KONTRASTI I ASOCIACIONEVE. Parimi i lidhjes së dy a më shumë ideve, përfytyrimeve etj., që kanë cilësi të kundërta. Sipas këtij parimi te njeriu gjatë perceptimit ose gjatë procesit të mendimeve shfaqet prirja e ringjalljes së mendimit, të idesë dhe të përfytyrimit të kundërt me të parin. Shih – ***SHOQËRIMI I PËRFYTYRIMEVE.***

KONTRASTI SIMULTAN. Dukuri e theksuar e perceptimit pamor që ka të bëjë me ndikimin e perceptimit të cilësisë së një strukture të veçantë në perceptimin e një cilësie tjetër të vënë pranë ose pas tij. Në këtë rast perceptimi i cilësisë së parë ndikon në intensitetin e perceptimit të cilësisë së dytë. Rasti i dalluar i kontrastit simultan është perceptimi i dy ngjyrave kromatike ose jokromatike: perceptimi i sipërfaqes së një trupi me ngjyrë të

kaltër varet nga cilësia kromatike ose akromatike e mjedisit ku perceptohet sipërfaqja e atij trupi. Figura e ngjyrosur me ngjyrë të murrme dhe e vendosur në një sipërfaqe të bardhë duket më e murrme se e njëjta figurë e vendosur në sipërfaqen e një trupi të ngjyrosur me ngjyrë të zezë. Kontrasti simultan ka të bëjë me çeltësinë dhe me tonin e ngjyrës.

KONTRASTI SUKSESIV. Ndikimi i perceptimit paraprak të një objekti në perceptimin e objektit që vjen pas tij. Në këtë rast kemi të bëjmë me dukurinë pamore të ndikimit të ngjyrës së objektit paraprak, pas të cilit vështrohet sipërfaqja e ngjyrosur me ngjyrë tjetër e objektit që perceptohet. Në këtë rast përjetohet ndikimi i ngjyrës komplementare.

KONTRATRANSFERIM, - I. m. Term i psikoterapisë që nënkupton reagimin e pavetëdijshëm emocional të psikoterapeutit në personalitetin dhe në sjelljet e transferuara ose të mbartura të pacientit. Kontratransferimi ose kundërmbajtja manifestohet në harresën e kohës së seancës psikanalitike, interpretimin jo me rend të shoqëruar me pakënaqësi te pacienti, madje edhe me sjellje agresive ndaj pacientit. Që nga kontaktet e para të psikoterapeutit me pacientin psikoterapeuti zhvillon një raport emocional që shtrihet prej emocioneve të dëshiruara deri në ato të padëshiruara. Në rast të zhvillimit të kontratransferimit të emocioneve pozitive pacienti ndihet më i sigurt dhe më i gatshëm të hyjë në bisedë për çështjet më intime; në rast të kundërt te ai ndjehet ngurrim, frikë etj. dhe, lidhur me këtë, atmosfera e komunikimit shkon kah mbyllja dhe pacienti mund të largohet nga seancat psikoterapeutike. Për këto shkaqe në seancat psikanalitike duhet njohur, analizuar dhe mbajtur nën kontroll procesi i kontratransferimit.

KONTROLL, - I. m. I ardhur nga frëngjishtja *controle* "mbikëqyrje" që ka kuptim të gjerë. Në psikometri kontrolli ka të bëjë me identifikimin e plotë të faktorit kauzal të një ndryshoreje dhe mbajtjen e këtij faktori nën mbikëqyrje. Në psikologjinë bihejvioriste kontrolli është procesi i përcaktimit të saktë të formave të modifikimit të sjelljeve të njeriut, nën ndikimin e përforcimit të asaj forme të sjelljes me anë të shpërblimit ose të eliminimit me anë të dënimit të saj. Kontrolli i tillë mundëson edhe parashikimin e formës së caktuar të sjelljes së njeriut, kur ai gjendet në situatë të njëjtë ose të ngjashme.

KONTROLLI I EMOCIONEVE. Proces i zotërimit të emocioneve, i intensitetit dhe i formës së manifestimit të jashtëm të tyre nga ana e atij që përjeton emocionet intensive, si edhe zotëron emocioneve e të tjerëve. Kontrolli i emocioneve është procesi që mësohet gjatë jetës dhe gjatë aktivitetit të vetë njeriut. Arrihet në dy mënyra kryesore: 1) Duke ushtruar veten që emocionet, kryesisht ato intensive të mos i shfaqim me mimikë, me ngritje të zërit, me ndryshim të sjelljeve dhe të ritmit të tyre etj. dhe 2) Me përvetësim të formave të tolerancës së frustrimit, duke u larguar nga situatat që shkaktojnë emocione, të cilat kontrollohen me vështirësi dhe

duke mos pranuar stimuj ose situata që shkaktojnë afekte.

Burimet:

Lynda Madison: *"The Feelings Book"* - "*Libri i ndjenjave*", American Girl, botuar në shqip, Tiranë 2013.

KONTROLLI I SJELLJES. Qëllimi kryesor i psikologjisë bihejvioriste që ka kuptim shtrirës shumë të gjerë. Në hulumtimet psikologjike kontrolli i sjelljeve është proces që ka mundësi të realizohet duke identifikuar plotësisht ngacmuesin që shkakton një sjellje të caktuar, rrethanat dhe raportet e një situate ngacmuese, si edhe duke kontrolluar faktorët përforcues ose pengues të asaj sjelljeje.

KONTROLLI KORTIKAL. Frenimi ose inhibicioni dhe ngacmimi i një drejtimi të qendrave të larta të trurit ndaj nënqendrave, përkatësisht ndaj qendrave subkortikale.

KONTROLLI STATISTIKOR. Rishqyrtim i të dhënave statistikore me qëllim të vërtetimit të saktë të ndikimit që ushtron vetëm faktori që studiohet në ndryshoren që hulumtohet. Kontrolli statistikor kryhet vetëm atëherë kur nuk janë kontrolluar si dhe sa duhet faktorët irelevantë dhe ndarja e tyre nga faktori kryesor shkakor i një ndryshoreje dhe i ndryshimeve që pëson ajo ndryshore vetëm nën ndikimin e një, ose dy faktorëve thelbësorë ose relevant.

KONTUR, - I. f. I ardhur nga frëngjishtja *contour* "skicë". Vija kufizuese e një figure apo e një objekti, në bazë të së cilës një figurë dallohet nga figura tjetër, një objekt dallohet nga objekti tjetër. Kufijtë ndarës të njërës figurë nga figura tjetër, të një objekti nga objekti tjetër shpesh janë perceptime subjektive, sepse vijat kufizuese te disa figura shkaktojnë iluzione se ato ekzistojnë si figura, si objekte. Të tilla duken sidomos në fushën e të parit dhe të lidhjes që ka figura me sfondin e saj. Konture të tilla janë figurat e mëposhtme:



KONVERGJENC/Ë, - A. I ardhur nga latinishtja *convergere* "afri, synim i një qëllimi". Konvergjenca është bashkërenditje ose lidhje veprimesh me qëllim të realizimit të një qëllimi të vetëm. Bashkërenditja e veprimeve drejtohet në një pike të vetme, në një objektiv të posaçëm, që synohet të

zotërohet nga ana e njeriut. Termi konvergjencë ka kuptim të veçantë në psikologjinë e perceptimit pamor, ku rol parësor dhe të pazëvendësueshëm luajnë sytë. Në neurofiziologji konvergimi ka kuptimin e derdhjes së stimujve nervorë në një neuron, në një rrugë neurale ose në një qendër nervore.

KONVERGJENCA E SYVE. Me divergjencë të syve kuptojmë dukurinë e funksionimit të koordinuar të lëvizjeve të syrit, kur këta drejtohen në një objekt, rrezet e dritës së të cilit bien në njërin sy dhe në syrin tjetër. Me këtë rast drejtimin e dy syve e caktojmë në një pikë të vetme, ku vijat parëse të syrit të djathtë dhe të atij të majtë priten pikërisht në atë pikë. Perceptimi i tillë mbështetet edhe në ndijimet kinetstetike të muskujve që vënë në lëvizje kokërdhokun e syve. Ndijimet e këtilla ndihmojnë në përcaktimin e thellësisë së trupave të afërt me njëri-tjetrin (në largësi më të vogël se pesëmbëdhjetë metra).

KONVERSION, - I.m. Term i ardhur nga latinishtja *conversion* që ka kuptim të përgjithshëm, që e ruan edhe në kuptimin e termit psikologjik. Konversioni është ndryshimi rrënjësor i bindjeve për vlerat e një religjioni, të një sekti etj. në një varg bindjesh të tjera që i përkasin një religjioni ose sekti tjetër. Termi konversion në psikanalizë ka kuptim të posaçëm. Sipas Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939), konversioni është shndërrimi i libidos së ndarë nga përfytyrimi i shtypur në energji inervuese. Me këtë kuptim konversioni bëhet mekanizëm psikik i zhvendosjes së një konflikti dhe i orvatjeve të njeriut që këtë konflikt ta zgjidhë, duke ndryshuar gjendjen e tij organike dhe duke shprehur simptoma dhembjeje, ngërçi, humbje ndjeshmërie në një pjesë të organizmit dhe paralizë.

KONJICION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *cognoscere* "njohje, dijeni". Konjicioni është term i një koncepti të gjerë, ku hyjnë strukturat, funksionet dhe proceset mendore që kanë të bëjnë me njohjen e realitetit, si vëmendja, përfytyrimet, perceptimi, simbolizmi, konceptimi, marrja dhe përpunimi i informacioneve, proceset e kujtesës, të mendimit të lidhur me të folurin. Rezultatet e këtyre proceseve janë njohja e dukurive, e objekteve, e proceseve, e relacioneve etj. dhe tërësia e dijeve të përftuara nga funksioni i aktivitetit mendor të njeriut. Sipas psikologjisë së kapaciteteve, përkatësisht psikologjisë së fuqive konjicioni është njëra ndër tri kategoritë themelore të aktivitetit mendor. Konjicioni, emocionet dhe konacioni përbëjnë aktivitetin integral psikik të njeriut.

KOOPERIM, - I. m. Term i përdorur zakonisht në psikologjinë e punës dhe në psikologjinë sociale, i ardhur nga latinishtja *cooperation* "bashkëveprim". Kooperimi ka kuptim të përgjithshëm të përqendruar në bashkëveprim harmonik të disa individëve në punën e përbashkët dhe për arritjen e një qëllimi të njëjtë. Ky kooperim siguron kohezionin ndërmjet sjelljeve të anëtarëve të një grupi të caktuar. Kooperimi në procesin e prodhimit ndërmjet punëtorëve të një procesi të tërësishëm prodhues është faktor i shtimit të produktivitetit të punës. Në organizimin

e një pune të mirë kërkohet kooperim i mirëfilltë i pjesëmarrësve, duke mos zbatuar gara dhe duke mos u orvatur për konkurrencë. Kooperimi arrihet me anën e disa faktorëve, ndër të cilët dallohen: stili i drejtuesit të grupit, pjekuria e anëtarëve të grupit etj.

KOORDINATA KARTEZIANE. Një ndër zbulimet e filozofit dhe matematikanit francez Rene Dekart (Rene Descartes, 1595 – 1650), që ka gjetur zbatim të rëndësishëm edhe në paraqitjen grafike të rezultateve të matjes së ndryshoreve psikologjike. Koordinata karteziane është sistemi grafik i vendosjes së një pike në hapësirën ndërmjet dy drejtëzave të vendosura njëra me tjetrën nën një kënd të drejtë. Vija horizontale është vija e ordinatës ose vija **x,** kurse vija vertikale është vija e abshisës ose vija **y**. Këto vija kryqëzohen në një kënd të drejtë, kurse vendndodhja e secilës pikë përcaktohet nga vlera e saj në hapësirën ndërmjet vijës horizontale dhe asaj vertikale.

KOORDINIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *coordination* "vë rend". Koordinimi emërton kuptimin e harmonizimit dhe të bashkërenditjes së funksioneve të përbërësve të një sistemi veprimesh të qëllimshme. Sipas këtij kuptimi bëhet fjalë për koordinim të lëvizjeve të një organi ose të dy organeve simetrike dhe josimetrike të trupit të njeriut. Këtë kuptim e ka edhe koordinimi i lëvizjeve të syrit. Lëvizja e syve të njeriut është harmonizim i lëvizjeve të kokërdhokut të syrit të njeriut me atë të syrit tjetër dhe drejtimi i të dy syve në pamjen e një objekti të caktuar.

KOORDINIMI I LËVIZJEVE SYDORË. Formë e ndërlikuar e harmonizimit të lëvizjeve të vullnetshme me të dhënat e shqisës së të parit, pikërisht me syrin e njeriut. Ky lloj koordinimi fillon të zhvillohet pas lindjes së foshnjës dhe zë fill kur foshnja mund të qëndrojë ulur pa ndihmën e të tjerëve. Kjo arrihet pas moshës 5 – 7 muajsh dhe në këtë moshë fusha pamore e fëmijës fillon të përputhet me zgjatjen e dorës së tij. Në këtë moshë fillon përputhja dhe harmonizimi i ndijimeve pamore me ndijimet kinetstetike dhe më pas zgjerimi i këtij procesi. Në literaturën e psikologjisë koordinimi i lëvizjeve ndërmjet syrit dhe dorës emërtohet me termin profesional koordinimi okulomotorik.

KOORDINIMI OKULOMOTORIK. Koordinim i lëvizjeve të pjesëve të ndryshme të trupit, si lëvizjet e duarve, të gishtërinjve, të këmbëve, të kokës etj.

KOPROFAGJI, - A. f. Ngrënie e mbeturinave të jashtëqitjes. Koprofagjia është sjellje jonormale që haset më tepër te sëmundjet psikike, si te skizofrenët e rëndë, çrregullimet obsesive–kompulsive, te individët me zhvillim mendor të kufizuar, pra të prapambetur në pikëpamjen intelektuale etj.

KOPROLALI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *κοπρο* "feçe" dhe *λαλιά* "bisedoj". Formë e sjelljes së njeriut që arrin nivelin e shprehisë dhe ka të bëjë me sharje, me shprehje të pavullnetshme të fjalëve të turpshme, me fyerje të tjetrit. Koprolalia ka si bazë veprime të imponueshme. Koprolalinë e ka trajtuar edhe Alfred Adleri (Alfred Adler, 1870 – 1937). Sipas pikëpamjes së tij koprolalia është sundim psikik i pavetëdijshëm i një individi tjetër në pikëpamjen seksuale, kur disa motive

barten nga sfera e emocioneve dhe e kognicionit në sferën e shtytësve, posaçërisht në sferën e shtytësit seksual. Koprolalia është "zhargon" shprehës i veçantë. Haset edhe në të folmen e disa Shqiptarëve në mjedise sociale.

KOPRRACI, - A.f.Lloj vesi që synon kursimin e vazhdueshëm përtej masës së duhur.

KORA MBIVESHKORE. Kore a cipë e gjëndrës mbiveshkore që gjendet mbi sipërfaqen e veshkave duke i mbështjellë këto në mënyrë të posaçme. Kora apo cipa e gjëndrës mbiveshkore prodhon steroide, pikërisht hormone të veçanta, si: aldosteroni, kortizoli, kortizoni etj., që marrin pjesë edhe në jetën emocionale dhe seksuale.

KORDA TIMPANI. Term i anatomisë i ardhur nga latinishtja *Chorda tympany*. Me termin korda timpani emërtohen fijezat nervore të cilat formojnë një pjesë të nervit kranial VII. Këto fijeza bartin ngacmimet e shqisës së shijes, duke kaluar nëpër pjesën e veshit të mesëm.

KORE, - A. f. Formë e sëmundjes neuro-muskulare që manifestohet në lëvizje të pakoordinuara dhe të paqëllimshme, me ngërçe dhe me dridhje muskujsh, sidomos të gjymtyrëve, të fytyrës dhe të trupit etj. Sëmundja është e rrallë dhe nga kjo sëmundje vuajnë kryesisht të rriturit e moshës 30 – 40 vjeç, por edhe fëmijët e moshës së pubertetit. Zakonisht zgjat një deri në tre muaj. Shkaqet e koresë janë ende të panjohura. Ndër format e njohura të kësaj sëmundje përmendet Korea e Huntingonit, sipas neurologut amerikan (George S. Huntingon, 1850 – 1916) dhe Korea e Sidenamit, sipas fizikanit anglez (Thomas Sydenham, 1624 – 1689).

KOREA HUNTINGTON. Sëmundje neurologjike e trashëguar që shfaqet në lëvizje të pakoordinuara, të paqëllimshme, me depresion dhe me rrënim të funksioneve kognitive. Kjo sëmundje rrjedh nga rrënimi i qelizave të trupit striatum ose të korpusit striatum, shih – ***KORPUS STRIATUM.*** Kjo sëmundje u identifikua nga neurologu amerikan George Huntington (George Huntington, 1850 – 1916).

KORREKTIM, - I. m. Term i përgjithshëm që ka kuptimin e përmirësimit të një procesi, duke mënjanuar gabimet e bëra. Në psikometri korrektimi është shndërrim i rezultateve në rezultate plotësisht të sakta, duke përdorur metoda të mënjanimit të gabimeve në matje, në vëzhgim, në vlerësim etj. Në psikologjinë sociale korrektimi është ndryshimi i sjelljeve të njeriut, duke mënjanuar sjelljet problemore dhe duke harmonizuar sjelljet e individit me kërkesa dhe me parime e norma morale.

KORJA E TRURIT TË MADH. Cipa e hollë sipërfaqësore e dy hemisferave të trurit, që në terminologjinë e anatomisë së sistemit nervor emërtohet korteks cerebral (latinisht *cortex cerebri*); ka ngjyrë të përhimët, trashësi prej 1,5 – 4 mm, me një sipërfaqe prej rreth 2300 cm^2 dhe është formuar kryesisht nga trupi i qelizave nervore dhe nga enët shumë të holla të gjakut. Korja e trurit të madh përbëhet prej rreth 9 – 14 miliardë qelizash trunore, që formojnë gjashtë shtresime të ndryshme nervore. Korja e trurit të madh është shkalla më e lartë e zhvillimit të trurit.

Kjo është bartëse e funksioneve parësore sensorike, e kontrollit dhe e koordinimit të lëvizjeve dhe e integrimit të tyre në sjellje të veçanta. Funksioni më i rëndësishëm i kores apo cipës së trurit të madh është se kjo është bartëse e funksioneve të larta psikike të njeriut (e kujtesës, e mendimit, e të folurit etj.). Korja e trurit të madh është bartëse e gjithë aktivitetit dhe jetës psikike të njeriut. Në pikëpamjen e zhvillimit filogjenetik u zhvillua shumë më tepër te njeriu se te sisorët më të lartë; gjithashtu u zhvillua më vonë se pjesët e tjera të trurit. Në pikëpamjen funksionale te korja e trurit të madh dallohen zona trunore parësore dhe dytësore e ndijimeve, zona parësore dhe dytësore e lëvizjeve dhe zona asociative. Zona parësore e ndijimeve dhe e lëvizjeve formohet prej qendrave të veçanta nervore, ku impulset nervore shndërrohen në veprimtari psiko-nervore, përkatësisht në ndijime. Zona dytësore e ndijimeve dhe e lëvizjeve kryen funksionin e integrimeve të pjesshme të veprimtarisë së qendrave nervore të ndijimeve dhe të lëvizjeve. Zona asociative kryen funksionin e përgjithshëm integrues të kores së trurit të madh.

KORNE, - A. f. Në anatominë e syrit, membrana ose cipa e tejdukshme e jashtme e syrit, që gjendet në pjesën e përparme të sklerës së kokërdhokut të syrit. Kornea mbulon irisin dhe bebëzën e syrit.

KORPUS GENIKULATUM LATERALE. I ardhur nga latinishtja *corpus geniculatum laterale* "bërthama e talamusit" që haset edhe në literaturën e psikologjisë. Në bërthamën e talamusit kryhet bartja e ngacmimit nervor, të shkaktuar nga ngacmuesi i shqisës së të parit dhe ky ngacmim përfundon në qelizën e fundit nervore në qendrën e të parit të kores apo cipës së trurit të madh. Secila pjesë e retinës është e lidhur drejtpërdrejt me pjesën e caktuar të bërthamës së talamusit. Shih – ***TALAMUSI.***

KORPUS GENIKULATUM MEDIALE. Në literaturën e anatomisë i ardhur nga latinishtja *corpus geniculatum mediale* "trupi gjunjëzor i mesëm". Me termin *korpus genikulatum mediale* emërtohet bërthama e hipotalamusit ku kryhet bartja e ngacmimit të shqisës së të dëgjuarit deri në qelizën nervore të fundit të kësaj pjese, mbaresat e së cilës përfundojnë në qendrën e dëgjimit të cipës së trurit të madh. Secila pjesë e kërmillit të veshit ku gjenden qelizat receptore të dëgjimit është e lidhur saktësisht me pjesën e caktuar të bërthamës së talamusit.

KORPUS KALOSUM. Term i anatomisë i ardhur nga latinishtja *corpus callosum* "trupi kallor". Ka formën e lythit dhe përbëhet nga një gërshetë e trashë e fijeve ose e fibrave nervore që lidhin hemisferën e majtë me hemisferën e djathtë. Këto fije të gërshetës bartin informacione prej hemisferës së majtë në hemisferën e djathtë. Konsiderohen se këto janë koordinuese të aktivitetit të hemisferës së majtë me atë të djathtën.

KORPUS STRATUM. I ardhur nga latinishtja *corpus striatum*. Term i anatomisë së sistemit nervor që emërton tri grupe qelizash nervore të vendosura brenda pjesës së përparme të trurit të madh. Në trupin ose korpusin

striatum përfundojnë fijezat nervore që sjellin shqetësimet nervore nga korja ose cipa e trurit të madh, nga talamusi dhe nga substanca e zezë. Për dukuritë psikike ka rëndësi fakti se nga substanca e zezë, që në latinisht njihet me termin latin *substantia tigra*, trupi i striatumit ose *korpus striatum* përfton neurotransmetuesin dopaminë, që konsiderohet se është i domosdoshëm për funksionim normal të këtij trupi. Ngacmimet nervore që rregullojnë sistemin e lëvizjeve ose motorikën e njeriut, nisen nga *trupi striatum* për në koren e trurit të madh, duke kaluar nëpër talamus. Theksohet rëndësia e funksionimit të trupit striatum në fitimin e shkathtësive. Ky funksion dallohet kur me rastin e çrregullimit të aktivitetit të trupit striatum shfaqen çrregullime në fushën e lëvizjeve ose në fushën motorike të njeriut, siç është rasti me koren Huntington dhe me sindromën e Korsakovit shih – ***KOREA HUNGTINGTON; SINDROMA KORSAKOV.***

KORSAKOV Sergejeviç Sergej (Sergej Sergeevič KORSAKOV). Psikiatër-neurolog rus. Lindi më 1854 në Moskë dhe vdiq më 1900. Ka punuar profesionalisht në klinikën psikiatrike e neurologjike të Moskës. Profesor i Universitetit të Moskës. Një kohë të gjatë ka udhëhequr Klinikën e psikoneurologjisë në Universitetin e Moskës në cilësinë e drejtorit të kësaj klinike. Nga pak të dhëna biografike të botuara për jetën dhe aktivitetin studimor të tij kuptojmë se Sergej Sergejeviç Korsakov është personalitet i njohur në psikiatri dhe neurologji, por jo aq edhe në psikologji. Koncepti dhe termi themelor i psikiatrisë është "Sindroma e Korsakovit". Ky në realitet është produkt i gjurmimeve të tij në fushën e paralizës alkoolike. Paraliza alkoolike është tema e doktoratës (1887). Vepra kryesore e tij është "*Ob alkogolom paraliče*" – (*"Mbi paralizën alkoolike"*), 1887 dhe *"Kurs Psihiatrii"* – (*"Kurs i psikiatrisë"*), 1893.

KORTEKS, - I. m. I ardhur nga latinishtja *cortex*, që i përket terminologjisë së anatomisë. Zakonisht emërton koren ose cipën e jashtme të indeve të një organi. Në terminologjinë e anatomisë së sistemit nervor termi korteks i shoqëruar me mbiemrin cerebri ("*Cotex cerebri*") emërton koren ose cipën e jashtme të trurit të madh. Shpesh termi korteks përdoret si shkurtesë për koren apo cipën e trurit të madh. Shih – ***KORJA E TRURIT TË MADH.***

KORTEKSI ORBITOFRONTAL. Korteksi ose membrana mbështjellëse e pjesës së trurit të madh, e cila shtrihet në anën e poshtme të lobit ballor. Kjo pjesë e trurit lidhet me pjesët e tjera të trurit në forma të ndryshme. Korteksi orbitofrontal merr impulse nervore të informacioneve nga talamusi, amigdala dhe nga receptorët e të nuhaturit. Nga ana tjetër kjo pjesë e membranës mbështjellëse të trurit i dërgon impulset nervore të informacioneve në hipokamp, në hipotalamus dhe në amigdalë. Në kuadrin e kësaj lidhjeje nervore të ndërlikuar dallohet procesi rregullues i përjetimeve emocionale.

KORTIKALIZIM, - I. m. Marrja shkallë-shkallë e kontrollit të proceseve psikike dhe të sjelljeve të njeriut nga ana e kores apo cipës së sistemit nervor. Kortikalizimi ka edhe kuptim të evolucionit filogjenetik të qenieve të

kafshëve: sa më lartë të qëndrojë një kafshë në shkallën e zhvillimit filogjenetik të saj, aq më tepër veprimtaria e saj kontrollohet nga ana e kores apo cipës së trurit. Kontrolli i tillë është i lartë te primatët, kurse te njeriu ka arritur shkallën më të lartë të zhvillimit.

KORTIKOSTEREOID, - E. m. Grup substancash në trajtë hormonesh steroide që sekretohen (tajohen) nga korja apo nga cipa e gjëndrave mbiveshkore. Këto substanca luajnë rol të rëndësishëm në përforcimin e qëndrueshmërisë së organizmit ndaj lëndimeve fizike të tij. Përforcimi i tillë që kryhet nga ana e kortikosteroideve shkakton veprime mbrojtëse të veçanta të organizmit.

KORTIZOL, - I. m. Hormon që tajohet nga korja ose cipa e gjëndrave mbiveshkore. Kortizoli ndikon në proceset metabolike, sidomos në metabolizmin e karbohidrateve, yndyrave dhe të proteinave. Sasia e kortizolit rritet shumë, kur njeriu gjendet në gjendje stresi.

KORTIZON, - I. m. Lloj i posaçëm i hormoneve që prodhohet nga korja ose cipa e gjëndrave mbiveshkore. Ndikon në procesin metabolik të karbohidrateve, yndyrave, proteinave, natriumit dhe të kaliumit.

KORRELACION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *correlation* "marrëdhënie e ndërsjellë" – ***ndërlidhje***. Me termin korrelacion emërtohet raporti ndërmjet dy ndryshoreve dhe ky raport sillet në mënyrë të tillë, që ndryshimi sistematik pozitiv ose negativ i njërës ndryshore lidhet me ndryshimin sistematik pozitiv ose negativ të ndryshores tjetër.

KORRELACIONI RANG. Përcaktimi i koeficientit të ndërlidhjes ose korrelacionit sipas rangut që zë secila vlerë e përftuar nga matja e një tipari, suksesi etj., duke zbatuar formulën Spirman të ndërlidhjes ose korrelacionit**.**

KOVARIANC/Ë, - A. f. Term i statistikës që ka të bëjë me raportin që kanë dy ndryshore psikologjike dhe shfaqet kur ndryshimi i njërës ndryshore shoqërohet me ndryshimin e ndryshores tjetër. Kovarianca ka lidhje me përcaktimin e koeficientit të ndërlidhjes ose të korrelacionit. Llogaritet sipas formulës Exy/N, ku E është shuma e rezultateve të dy ndryshoreve, x dhe y paraqesin shmangien e secilit rezultat nga e mesmja aritmetike, kurse N është numri i përgjithshëm i rasteve.

KRAHASIM, - I. m. Proces mendor me anën e të cilit individi, duke vënë përballë një individi tjetër një objekt, një dukuri, një proces etj. përpiqet t`i njohë ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet tyre. Krahasimi është proces elementar që shfaqet qysh në fazën perceptive dhe ka rëndësi të veçantë për zhvillimin e formave të ndërlikuara të proceseve mendore.

KREATIVITET, - I. m. I ardhur nga latinishtja *creatio* "krijimtari". Dukuria psikike e përbërë nga një strukturë e ndërlikuar vetish dhe procesesh psikike, që me funksionimin e tyre çon në zgjidhje të një situate të ndërlikuar problemore, në konceptualizimin e zgjidhjeve të reja, në krijimin e produkteve artistike e shkencore. Produktet e kreativitetit janë vetëm ato produkte teorike dhe lëndore që kanë karakter unik, janë të reja (ndryshojnë

nga ato të deritashme) dhe janë të dobishme për mjedisin social, artistik dhe shkencor të gjerë dhe të ngushtë.

KREÇMER Ernst (Ernst KRETSCHMER). Psikiatër gjerman. Lindi në Vystenrot (Wüstenrot) dhe vdiq në Tybingen më 8.02.1964. Studioi për mjekësi në Mynih dhe në Hamburg. U doktorua më 1914 duke mbrojtur tezën "Mbi deliriumin dhe sindromën maniako-depresive". Veproi si mjek gjatë luftës I Botërore në Klinikën Neurologjike të Tybingenit, kurse më 1926 u emërua profesor i psikiatrisë dhe i neurologjisë në Universitetin e Marburgut. Pas përfundimit të Luftës II Botërore ishte Drejtor i Klinikës Neurologjike në Tybingen. Është konceptues i tipologjisë konstitucionale të njeriut. Sipas tij përbërja trupore përcakton strukturën psikike të tipit të njeriut. Nga rrafshi trupor apo konstitucional ai dalloi tipin leptozom, të cilit i përgjigjet struktura e sëmundjes së skizofrenisë dhe tipin piknik, që i përshtatet strukturës psikike të sëmundjes maniako–depresive. Sipas tij bazën e tipologjisë së njerëzve e formojnë ndryshimet e shkallës së zhvillimit të proceseve psikike dhe të sjelljeve të njeriut. Tipat konstitucionalë– psikikë ai i dallonte në mbështetje të konstatimit të nivelit ndërlidhës ndërmjet përmasave zhvillimore të trupit dhe përmasave të zhvillimit të strukturave psikike. Veprat kryesore të tij janë: "*Körperbau und Charakter*" – (*"Trupndërtimi dhe karakteri"*), 1921; "*Der sensitive Beziehungwahn*" – (*"Marrëdhënia e iluzioneve sensitive"*), 1918; *"Geniale Menschen"* – (*"Njeriu gjenial"*), 1929;" *Psychotherapeutische Studien*" – (*"Studime psikoterapeutike"*), 1949.

KREDO, - JA. f. Tërësi mendimesh dhe pikëpamja e formuar e një individi ose e një grupi të caktuar individësh për fushëveprimin e tyre dhe për nivelin e lartë cilësor të aktivitetit të tyre, të organizuar sipas bindjeve dhe qëndrimeve të tij. Kredoja dallohet edhe për përmasat motivuese të individit.

KRENARI, - A. f. Lloj ndjenje, të cilën individi e përjeton ndaj suksesit të arritur në një fushëveprim të caktuar dhe vlerësohet lartë nga autoritetet e mjedisit social të tij, duke u nderuar dhe respektuar nga mjedisi i tij, sidomos nga autoritetet etike e sociale të atij mjedisi. Në strukturën e krenarisë bënë pjesë edhe përjetimi i kënaqësisë dhe i gëzimit vetjak nga sjellja e tij e harmonizuar me unin ideal. Krenaria fillon të zhvillohet nga mosha dy dhe trevjeçare dhe manifestohet me reagimin e fëmijës ndaj falënderimeve dhe shpërblimeve për sjelljen morale të tij. Gjenezën e zhvillimit të krenarisë dhe rolin e saj në zhvillimin e personalitetit e ka trajtuar gjatë edhe psikologu amerikan Gordon Olport (Gordon Alport, 1897 – 1967).

KREPELIN Emil (Emil KRAEPELIN). Psikiatër gjerman me orientim psikologjik. Lindi më 1856 dhe vdiq më 1926. U diplomua për mjekësi në Universitetin e Vyrsburgut dhe u doktorua më 1878 duke mbrojtur me sukses tezën "Vendi i psikologjisë në psikiatri". Punoi në spitalin psikiatrik të Mynihut dhe gjatë kësaj kohe, më 1882 ishte për kualifikim të mëtejshëm pranë psikologut Vilhelm Vunt në laboratorin e tij në Lajpcig. Ka qenë profesor i psikiatrisë në Dorpat më 1885, më 1891 në Heidelberg,

kurse prej vitit 1903 derisa doli në pension ka qenë drejtor i Spitalit psikiatrik në Mynih, duke qenë dhe profesor i psikiatrisë. Me propozim të Vilhelm Vuntit u largua nga gjurmimet e drejtpërdrejta dhe u mor me studime psikiatrike. Por, nga Vilhelm Vunti mori përgatitjen e duhur për organizim hulumtimesh eksperimentale dhe konsiderohet pionier i psikologjisë klinike. Në psikologji dhe në psikiatri mbeti i njohur me gjurmimet e ndikimit të disa substancave farmakologjike në sjelljen e pacientëve. Por, kontributi më i madh i tij është në psikiatri: ka pranuar klasifikimin e vjetër të sëmundjeve shpirtërore, duke i shtuar këtij klasifikimi ndarje të reja të grupeve të sëmundjeve shpirtërore, të cilat janë pranuar botërisht. Veprat kryesore të tij janë*: "Compendium der Psychiatrie"* – (*"Kompendiumi i psikiatrisë"*), 4 vëllime, Leipzig, 1883; *"Einführung in die Psychiatries Klinik"* – (*"Hyrje në psikiatrinë klinike"*), 3 vëllime, Leipzig, 1901; "Leçons cliniques sur la demenence précoce et la psychose maniaco – depressive" –"Leksione klinike për demencën praekoks dhe psikozën maniako – depresive", Leipzig, 1907, etj.

KRESTOMACIA PSIKOLOGJIKE. Përmbledhje studimesh psikologjike nga autorët e ndryshëm që klasifikohen sipas parimeve të caktuara dhe ndihmojnë në kuptimin e zhvillimit kronologjik të mendimit psikologjik, psikanalitik, bihejviorist etj., ose përmbledhje studimesh për zhvillimin e shkollave psikologjike nga shkolla strukturaliste deri në shkollën kognitive.

KRETINIZ/ËM, - MI. m. Term i prejardhur nga frëngjishtja *cretnisme* "miksedemë e bashkëlindur". Kretinizmi është sëmundje e lindur, e shkaktuar nga çrregullimi i funksionimit të gjëndrës tiroide, e pikërisht nga mungesa e duhur e hormonit të tiroksinës, që luan rol të rëndësishëm në zhvillimin e trurit dhe të proceseve dhe sjelljeve psikike. Rrjedhimet e kretinizmit shfaqen në disa çrregullime organike apo trupore dhe psikike. Ndër çrregullimet organike apo trupore dallohen: rritja e pamjaftueshme e trupit dhe e disa organeve të tij, lëkura e thatë, zhvillimi i çrregullt i dhëmbëve, gjuha e dalë nga zgavra e gojës, çrregullimi i funksionimit të gjëndrave seksuale etj.; kurse ndër çrregullimet psikike dallohen: ngadalësimi i ritmit të zhvillimit psikik, prapambetja intelektuale, përqendrimi i dobët i vëmendjes, mbajtja mend me vështirësi etj. Sëmundja e kretinizmit fillon që në zhvillimin e organizmit të fëmijës në fazën e paralindjes. Ndër llojet e kretinizmit dallohet kretinizmi endemik, që shfaqet në ato vise, ku mungon sasia e duhur e jodit në ujin e pijshëm. Kretinizmi dytësor ka të bëjë me çrregullimin e funksionit të gjëndrës tiroide gjatë zhvillimit të njeriut. Kur sëmundja e kretinizmit diagnostikohet shpejt dhe jepet terapia e duhur, atëherë ekziston mundësia e zhvillimit fizik dhe psikik sipas rrjedhës normale.

KRIJIMTARI, - A. f. Proces dhe rezultat i angazhimit të mendimit krijues në zbulimin e vlerave materiale, shoqërore dhe shpirtërore të rëndësishme për zhvillimin e gjithëmbarshëm. Në të folurin e përgjithshëm,

si edhe në literaturën e psikologjisë bashkëkohore bëhet fjalë për kreativitet. Shih – ***KREATIVITETI; MENDIMI KRIJUES.***

KRIM, - I. m.I ardhur nga latinishtja *crimen* "faj i rëndë". Krimi është veprim i rrezikshëm i njeriut drejtuar kundër shëndetit fizik e psikik të tjetrit, kundër integritetit psikofizik të personalitetit, kundër shoqërisë dhe shtetit. Veprime të krimit janë: dëshmia e rremë, dhunimi, grabitja e individit, mashtrimi, mitmarrja, shpërdorimi i detyrës shoqërore e shtetërore, vrasja etj., që kanë pasoja të dëmshme për njeriun, shoqërinë dhe shtetin. Ndër format më të rënda të krimit janë: krimi i aparteidit, krimi kundër njerëzimit dhe krimi i gjenocidit.

a. **Krimi i aparteidit** – Krim që kryhet ndaj një race të caktuar me qëllim të përjetësimit të sundimit të pakicës së bardhë mbi grupet e tjera të popullsisë jo të bardhë;

b. **Krimi kundër njerëzimit** – Krim i rëndë, që nuk parashikohet, që nxitet, që tolerohet dhe që kryhet ndaj një popullsie, race, kombi, feje ose ndaj një pjese të tyre;

c. **Krimi i gjenocidit** – Forma më e rëndë e krimit të planifikuar, të organizuar dhe të kryer me qëllim zhdukjen e vetëdijshme të pjesëtarëve të një fisi, një sekti, një etnie, një feje etj.

d. **Krimi seksual** – Krim i dhunshëm ndaj anëtarëve të gjinisë femërore, sidomos ndaj të miturave, që në operacione luftarake mund të jetë formë dhe mjet i luftës së një kundërshtari ndaj një kundërshtari tjetër.

KRIMINALITET, - I. m. Term përmbledhës për të gjitha format e sjelljeve të atyre individëve, që shkelin normat juridike të një vendi, duke prishur rendin shoqëror dhe shtetëror në kohën e caktuar. Individët e tillë i nënshtrohen dënimeve sipas ligjit penal të atij vendi. Normat e tilla kanë karakter të ndryshueshëm prej një shteti në shtetin tjetër dhe, madje, këto norma ndryshojnë edhe brenda një shteti gjatë zhvillimit të shoqërisë së atij vendi. Kriminaliteti përbën lëndën e psikologjisë forenzike dhe kriminologjisë.

KRIMINALOGJI. – A. f. Shkenca që studion sistematikisht krimet, format e krimeve, bartësit e krimeve dhe faktorët psiko-socialë e mjekësorë të tyre, si edhe zbatimin e së drejtës penale. Përmbajtja e kriminalogjisë është e ndërlikuar, sepse ka të bëjë me përmbajtje juridike, mjekësore, sociologjike e psikologjike. Këtu përfshihet studimi i formave të krimit, shkaqet dhe pasojat e krimit, si edhe faktorët inkriminues: mosha, gjinia, prejardhja etnike e kombëtare etj.

KRIPTESTEZI, - A.f. Ndijim i fshehur që i përket dukurive paranormale. Kriptestezia është term përmbledhës për të gjitha përjetimet jashtëshqisore, por në rend të parë i përket dukurisë së perceptimit të jashtëzakonshëm. Kriptestezia është perceptim që përjetohet nga ana e njeriut, por ky perceptim nuk shkaktohet nga ngacmuesi real dhe as nga rruga nervore e rregullt. Megjithëkëtë, perceptimi i kriptestezisë ka karakter të qartë. Kriptestezia u studiua sidomos nga parapsikologu amerikan Xhozef B. Rajn (Joseph B. Rhine, 1895 – 1980). Rezultatet e hulumtimeve nuk kanë arritur ta shpjegojnë këtë dukuri.

KRIPTOFAZI, - A. f. Proces i komunikimit të çuditshëm, të fshehtë, ndërmjet dy ose disa individëve, të cilët kanë krijuar kod të veçantë marrëveshjeje ndërmjet tyre. Gjuha e tillë nuk është gjuhë e re, por kombinim i fjalëve dhe i lidhjeve shumë të hershme ndërmjet tyre. Janë shënuar raste të tilla me përmasa patologjike.

KRIPTOMNEZI, - A. f. I ardhur nga greqishtja që përbëhet nga prefiksi *κρυπτο* "fsheh" dhe *μνησία* "kujtesë". Kriptomnezia është formë e çrregullimit të kujtesës, që ka të bëjë me harresën e individit – zbulues të një strukture të materies, të një procesi etj., duke ia atribuuar vetes atë zbulim. Kjo dukuri ndodh te shkencëtarët, të cilët dikur kanë lexuar për një ide, zbulim etj., por që ndërkohë emri i atij zbuluesi zhduket nga ana e tij dhe në mënyrë iluzore shfaqet si ide, si zbulim origjinal i tij.

KRITER, - I. m. I ardhur nga greqishtja *κριτήριο* "masë". Kriteri është masa, standardi i vërtetuar për vlefshmërinë e një testi ose të një instrumenti matës të zhvillimit të proceseve, të strukturave dhe të funksioneve psikike të një individi. Kjo masë është model në bazë të të cilit krahasohen arritjet e dy ose më shumë individëve, me qëllim të vlerësimit të nivelit të përputhjes ose të shmangies së secilës dukuri që studiohet, duke zbatuar këtë masë ose kriterin e caktuar. Kriteret e caktuara saktësisht dhe të zbatuara me përpikëri mundësojnë klasifikimin e të dhënave, duke lehtësuar përpunimin e tyre. Masa e arritur për zotërimin e lëndëve të caktuara shkollore mund të shërbejë si kriter përcaktimi për vlefshmërinë e një testi që përdoret në orientimin profesional.

KRITERI KOMPOZITË. Kriter i përftuar nga rezultati i disa fushave të aktivitetit, i dy-, apo tri kompozitave të një veprimtarie të përbashkët pjesëtuar me numrin e veprimtarive. Kriteri kompozitë shprehet me një vlerë, me një notë. Një mësues mund ta ketë notën 4 për shpjegim, 3 për saktësi dhe 1 për vlerësim objektiv të dijes së nxënësve. Kriteri kompozitë i tij është 2.7 (4+3+1)/3.

KRITERI SHUMËFISHOR. Kriter që mbështetet në vlerësime të posaçme të secilës veprimtari. Me rastin e përzgjedhjes profesionale vlerësohet veçmas cilësia e punës, sasia e arritur e punës, mungesat në punë, saktësia kohore e ardhjes me kohë në punë etj. Në mbështetje të vlerësimit të secilit aktivitet dhe të arritjeve në testin e përzgjedhjes profesionale përpilohet një kriter objektiv i pranimit të më të mirëve në një profesion të caktuar. Kjo formë e hartimit të kriterit është më objektive se ajo e kriterit kompozitë, por shumë më e ndërlikuar.

KRITIK, - E. mb. Term mbiemëror i ngulitur në shqip nga greqishtja *criterion* "notë". Në psikologji kritike është vlera numerike, e cila ndan një cilësi nga cilësia tjetër, sepse pas kësaj vlere paraqitet një cilësi tjetër e aftësisë, e qëndrueshmërisë emocionale që matet etj. Shkalla kritike e nivelit të zhvillimit të inteligjencës është 0.80, mbi këtë shkallë kritike individi kualifikohet me inteligjencë të lartë dhe nën këtë shkallë individi kualifikohet me inteligjencë mesatare.

KRIZ/Ë – A. f. I ardhur nga greqishtja *κρίση* "pikë kthese". Ky term është ngulitur edhe në terminologjinë shqipe

në ekonomi, financa, politikë, mjekësi, si edhe në psikologji. Kriza ka kuptimin e përgjithshëm dhe kuptimin e veçantë të saj. Kuptimi i përgjithshëm ka të bëjë me pikën e kthesës së një procesi (ndryshim i rrjedhës normale të jetës dhe një sëmundje e papritur, rrënimi i proceseve vitale të jetës së njeriut, rënie e paparë e zhvillimit ekonomik, zhvlerësim i monedhës së një vendi etj.). Në psikologji kriza është ndryshimi i madh i gjendjes psikike të njeriut në një periudhë të jetës së tij, si në periudhën e pubertetit, ku dobësohen mekanizmat mbrojtës dhe ndodhin ndryshime të mëdha në sjelljen e një individi.

KRIZA E FAZËS SË MESME JETËSORE TË NJERIUT. Përjetim i krizës zhvillimore të shumë njerëzve në fazën e zhvillimit të tyre rreth moshës dyzet vjeçare. Kjo fazë ka të bëjë me ata individë që rreth moshës dyzet vjeç arrijnë të kuptojnë se kanë kaluar gjysmën e jetës së tyre dhe fillojnë të verifikojnë arritjet e tyre, të identifikojnë nivelin e realizimit të qëllimit të tyre jetësor. Në këtë proces këta shpesh konstatojnë se ende merren me aktivitete jo të rëndësishme për veten dhe për mjedisin e tyre, për të mos thënë merren me aktivitete të kota.

KRIZA E IDENTITETIT. Vështirësia dhe humbja e kuptimit dhe e ndjenjës së identitetit për vetveten. Kriza e identitetit ndodh në situatat e kthimeve të mëdha gjatë zhvillimit të jetës së njeriut, kur çrregullohet përjetimi i ndjenjës së njëjtësisë së unit dhe ai i zhvillimit të pandërprerë të individit. Kjo krizë zgjat shumë kohë, pavarësisht nga ndryshimet fizike, sociale e psikike. Kriza e identitetit të përshkruar në këtë mënyrë është dukuri me përmasa patologjike. Por, vështirësi të ngjashme hasim edhe gjatë zhvillimit normal të personalitetit, kur kalohet prej një faze zhvillimore në një fazë tjetër zhvillimore (prej pubertetit në fazën e adoleshencës) dhe kur dallohen vështirësi në përjetimin e ndjenjës së identitetit të qëndrueshëm. Në raste të tilla kriza e personalitetit mund të luajë rol pozitiv në zhvillimin dhe në përforcimin e ndjenjës së përjetimit të identitetit të shëndoshë.

KRIZA E IDENTITETIT TË PERSONALITETIT. Krizë akute në zhvillimin e personalitetit që manifestohet me dobësimin dhe humbjen e vetëdijes së njeriut për vazhdimësinë e zhvillimit të pandërprerë të vetvetes, gjatë së cilës shfaqen çorganizime akute dhe psikologjike, të shkaktuara nga zhvillime të jashtme të papritura, të cilat pengojnë individin në arritjen e qëllimit kryesor të jetës së tij. Meqë ndaj këtyre pengesave individi nuk arrin të reagojë me metoda të zakonshme të zgjidhjes së problemeve të zakonshme, atëherë çrregullohet qëndrueshmëria psikike dhe ai përjeton krizën e personalitetit të tij. Termi krizë e identitetit të personalitetit është term i psikanalistit amerikan me origjinë gjermane Erik Erikson (Erik Erikson, 1902 – 1994). Krizën e identitetit ai e ka dalluar gjatë seancave psikanalitike me veteranët e luftës, të cilët e "kishin humbur ndjenjën e identitetit personal dhe të rrjedhës normale historike". Erik Eriksoni në procesin e rehabilitimit të këtyre individëve me gjendje jonormale psikologjike, ka arritur të konstatojë se krizë të identitetit kanë edhe njerëzit nor-

malë, kur këta ballafaqohen me kthesa të mëdha në rrjedhën e jetës së tyre, si: humbja e vendit të punës, ndërprerja e marrëdhënieve martesore, sëmundja e rëndë e një anëtari të familjes etj.

KROMATOPSI, - A. f. Përjetim jonormal i cilësisë së ngjyrave kromatike të objektit që perceptohet, I cili nuk zotëron ngjyrë të tillë. Në këtë përjetim jonormal ngjyrat e sipërfaqes së objekteve të zeza ose të bardha shihen të ngjyrosura me të kuqe, të verdhë, të kaltër etj., madje, ngjyrave të tjera u shtohet edhe ndonjë përjetim i ngjyrës joekzistuese. Kromatopsia është gjendje jonormale e përjetimit të ngjyrave, e shkaktuar nga marrja e drogave dhe nga ekspozimi i syve të njeriut nën ndikimin për një kohë të gjatë të një ngjyre.

KROMOZOM, - I. m. Term i histologjisë që në kuptimin e tij prek edhe psikologjinë. Termi kromozom i përket greqishtes *χρωμό*"ngjyrë" dhe *σωμα* "trup", përkatësisht puçërza të ngjyrosura. Kromozomi është përbërëse e nukleusit të qelizës, që është e sajuar nga shumë gjene – bartëse të trashëgimisë. Në qelizat e trupit të njeriut gjenden 46 kromozome të ndara në 23 çifte kromozomesh të babait dhe 23 çifte kromozomesh të nënës. Kromozomet përbëhen nga acidi dezoksiribonukleik dhe nga proteinat. Gjatë fekondimit, 23 kromozome mashkullore bashkohen me 23 kromozome femërore. Nga këto një kromozom është kromozom pjellor. Kromozomi pjellor mund të jetë X ose Y. Kromozomi X përcakton gjininë femërore, kurse kromozomi Y përcakton gjininë mashkullore.

KRONIK, - E. mb. I ardhur nga latinishtja *chronicus* "prej" dhe *χρώμα* "kohë", që përcakton vazhdimësinë e një procesi, ekzistencën e përhershme të një dukurie. Në terminologjinë psikologjike ky mbiemër shoqërohet me një emër të caktuar.

KRONOBIOLOGJI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *χρώμα* "kohë", *βίος* "jetë" dhe *λογία* "shkencë". Kronobiologjia është fushë ndërdisiplinore, e cila merret me studimin e ritmeve biologjike ose me studimin e bioritmeve. Dallohen tre bioritme: bioritmi trupor, bioritmi mendor dhe bioritmi emocional. Kronobiologjia në kuptimin e ngushtë të saj merret me hulumtimin e atyre formave të sjelljeve, që karakterizohen me zhvillimet periodike të tyre, siç janë ritmet cirkularë. Nga kjo fushë kohët e fundit është diferencuar kronopsikofiziologjia, e cila merret me hulumtimin e lëvizjeve ciklike të funksioneve psikofizike.

KRONOMETRIA MENDORE. Matje e saktë e kohës brenda së cilës kryhet një proces psikik, proces mendor apo një sjellje e njeriut, e organizuar sipas udhëzimeve të posaçme eksperimentuese. Matjet e tilla kryhen me kronometër preciz.

KRUAJTJ/E, - A. f. Dukuri e ndijimit të lëkurës. Me gjithë hulumtimet e gjata ende dihet pak për natyrën fiziologjike dhe psikologjike të kruajtjes. Zakonisht shkaktohet nga ngacmimi i mbaresave nervore të lëkurës prej ngacmuesve kimikë dhe mekanikë të lëkurës. Mbi këtë bazë besohet se mbaresat nervore të lëkurës janë bartëse të dukurisë së kruajtjes. Por, kruajtja është edhe dukuri e gjymtyrëve të

këputura nga trupi i njeriut. Me këtë konstatim besohet se kruajtja nuk është vetëm dukuri e lidhur me lëkurën, por ka edhe bazë nervore qendrore, prandaj ende priten rezultate më të sakta.

KRYENEÇËSI, - A. f. Formë e qëndrimit të ngulitur të një individi, që ka marrë përmasat e tiparit të personalitetit dhe ka të bëjë me bindjen e thellë dhe shkallën e lartë të sigurisë për mendimin, pikëpamjen, synimin etj. të tij. Kryeneçësia shoqërohet me qëndresë të fuqishme ndaj argumenteve që i kundërvihen atij mendimi, asaj pikëpamjeje dhe atij synimi. Kryeneçësia manifestohet me ngulmimin e njeriut për t`i organizuar proceset mendore dhe sjelljet vetëm sipas një mendimi, një pikëpamjeje dhe një synimi të formuar.

KRYQËZIMI PAMOR. I ardhur nga latinishtja *chiasma opticum*. Kryqëzimi pamor ose kiazma optike është vendtakimi i fijezave të nervave pamorë të dy syve. Fijezat nga fusha e brendshme e retinës kryqëzohen në kiazmë, kurse fijezat e nervit optik të anës së jashtme të retinës së të dy syve mbeten në anën e tyre. Në kiazmë kryqëzohen fijezat nervore që sjellin impulse nervore nga pjesa e brendshme e gjysmave të retinës, por fijezat e anës së jashtme të retinës nuk kryqëzohen. Shih – ***KIAZMA OPTIKE.***

KUALITET, - I. m. I ardhur nga latinishtja *qualitas* "cilësi". Termi kualitet ka zënë vend të qëndrueshëm në disa fusha. Në psikologji termi kualitet ka filluar të përdoret që nga koha e strukturalizmit psikologjik, duke u përdorur më tepër për të emërtuar cilësinë përmbajtjesore të një ndijimi dhe të modeleve të tyre, për të bërë dallimin e qartë ndërmjet një ndijimi dhe një ndijimi tjetër dhe për të saktësuar llojin e atij ndijimi.

KUARTILE, - T. I ardhur nga latinishtja që përdoret në psikometri. Kuartilet janë katër pjesë të një të tëre. Në psikometri kuartili është njëra nga tri pikat që i ndajnë rezultatet e mbarështuara sipas madhësisë në katër pjesë të barabarta, ku secila pjesë ka një të katërtën e atyre rezultateve, përkatësisht N/4, ku N shënon numrin e tërësishëm të rezultateve. Vlerat kufizuese të kuartileve paraqesin një fazë të domosdoshme në përpunimin e të dhënave statistikore, me rastin e përcaktimit të indeksit të shtrirjes së rezultateve gjysmëkatërfishore ose të indeksit të shtrirjes semi-interkuartile të rezultateve të një ndryshoreje të provuar.

KUBI NEKER. Lloj i iluzionit pamor që hyn në grupin e figurave me dy kuptime dhe të figurave reversibël. Kubi Neker i përngjet figurës së tejdukshme që herë e shohim nga lart–poshtë dhe herë nga poshtë–lart dhe me këtë rast organizimi i perceptimit të tij oshilon nga njëra anë në tjetrën. Ky lloj iluzioni u zbulua nga matematikani dhe fizikani zviceran Luis Neker (Louis Necker, 1730 – 1804) dhe ilustrohet në figurën e mëposhtme:



KUESTIONER, - I. m. Term i përvetësuar nga frëngjishtja *questionnaire* "pyetësor". Shih – ***PYETËSORI.***

KUFIRI FIZIOLOGJIK I SHPREHIVE. Pika më e lartë e ushtrueshmërisë së një ose disa organeve për kryerjen e një shprehie të caktuar, përtej të cilit koordinimi, saktësia dhe shpejtësia e kryerjes së lëvizjeve është pothuaj e pamundur, sepse kufiri fiziologjik është i përcaktuar me faktorët biologjikë të organizmit.

KUFIRI I STËRVITJEVE. Shkalla më e lartë e suksesit të ekzekutimit të një shprehie, e arritur me anë të ushtrimeve të organizuara, me plan dhe me një qëllim të caktuar. Në këtë proces të ndërlikuar dallohen ngecje, përparime intensive, mendimi se është arritur kulmi i përvetësimit të shprehisë së caktuar, përparimi me shpejtësi dhe saktësi i ekzekutimit të saj etj. Në fillim stërvitjet japin efekt të vogël dhe të parëndësishëm, dhe më pas, pas shtimit të angazhuar të subjektit për arritje sa më të larta, përparimi është më i dukshëm, por më vonë suksesi bie, madje edhe në shkallën fillestare, për të përshpejtuar efektin sa më të madh dhe kështu arrihet deri në zotërimin e plotë të një shprehie, kur shtimi i numrit të stërvitjeve mbetet në nivelin e arritur. Ngecjet në procesin e përparimit duhen kuptuar si angazhim i brendshëm i strukturimit të mënyrave të veprimit dhe, menjëherë pas ngecjes dallohet përshpejtimi i efektit të stërvitjes, përkatësisht niveli më i lartë i ekzekutimit të shprehisë. Këtë zhvillim të stërvitjeve e ilustron edhe figura e mëposhtme:



KUFIRI KLASOR. Vlera sasiore më e lartë dhe më e vogël e të dhënave empirike, brenda të cilave grupohen të dhënat përkatëse. Në shembullin e mësipërm kufiri më i lartë i një klase të të dhënave është 59, 69, 79, 89, 99, kurse kufiri më i ulët i kësaj klase të dhënash është 50, 60, 70, 80, 90.

KUFIZIMET RACIONALE. Karakteristikë e posaçme e disa individëve që marrin vendime për zgjidhjen e situatave të ndërlikuara, vetëm në bazë të sjelljeve të përgjithshme racionale në ato fusha ku kanë informacione reale të mjaftueshme.

KUJTES/Ë, - A. f. Term i përgjithshëm i psikologjisë, sidomos i psikologjisë kognitive. Kujtesa në kuptimin klasik është proces psikik që ka të bëjë me të mbajturit mend (të përvojës, të informacioneve të mësuara, të ngjarjeve, të figurave etj.), pas ndërprerjes së ndikimit të ngacmuesve në shqisat e njeriut dhe në trurin e tij, me rinjohjen dhe me riprodhimin e asaj që është përjetuar dhe është mësuar. Në psikologjinë bashkëkohore kujtesa trajtohet si proces i ndërlikuar kognitiv, me anën e të cilit njeriu merr informacione nga bota e jashtme, i përpunon këto informacione, i ruan gjatë një kohe të caktuar dhe i riprodhon të njëjta në situata të duhura. Disa

psikologë bashkëkohorë kujtesës i atribuojnë tri operacione: kodimin e informacioneve, përforcimin apo ruajtjen e tyre, si edhe gjetjen e riprodhimin e tyre, kur këto kërkohen nga njeriu që i gjen dhe që është në gjendje t`i riprodhojë njësoj. Kujtesa luan rol të pazëvendësueshëm në përshtatjen e organizmit ndaj mjedisit, raporteve të ndryshme dhe ndryshimeve të tyre në mjedisin e caktuar. Kujtesa me të gjitha operacionet e saj është ngushtësisht e lidhur me perceptimin, me të mësuarit, e pikërisht, ajo është kusht i të mësuarit, me harresën dhe me procesin e të menduarit të njeriut.

Burimet:

Endel Tulving & Wayne Donaldson: *"Organization of Memory"* – (*"Organizimi i kujtesës"*), New York: Academic Press, 1972.
Vernon Gregg: *"Human Memory"* – (*"Kujtesa njerëzore"*), Methuen, London, 1975.
John R. Anderson: *"Language, Memory and Thought"* – (*"Gjuha, kujtesa dhe mendimi"*), Hillsdale, NJ: Erlbaum, 1976.
Alan D. Baddeley: *"Die Psychologie des Gedachtnisses"* – (*"Psiologjia e kujtesës"*), Sttutgart: Klett – Cotta, 1979.
Frederic C. Bartlett: *"Remembering: A Study in experimental and social psychology"* – (*"Kujtesa: Studim eksperimental dhe psikologjia sociale"*), Cambridge: Cambridge University Press, 1979.
Hermann Ebbinghaus: *"Über das Gedähtnis. Unterzuhungen zur experimentellen Psychologie"* – (*"Mbi Kujtesën. Gjurmime të psikologjisë eksprimentale"*). Leipzig: Duncker, 1885.
Franz Schermer: *"Lernen und Gedächtnis"* – (*"Të mësuarit dhe kujtesa"*), Stuttgart, Berlin, Köln: Kohlhammer, 1991.
Karen Markowitz & Eric Jensen: *"The Great Memory Book"* – (*"Libër për kujtesë të lartë"*), The Brain Store, San Diego, 1999.
Alan D. Baddeley: *"Human Memory: Theory and Practice"* – (*"Kujtesa njerëzore. Teoria dhe praktika"*), Boston: Allyn & Bacon, 2002.
Pajazit Nushi: *"Kujtesa dhe trajtimi i saj në literaturën shqipe nomotike"*, Prishtinë, 2008.
Zenel Orhani: *"Psikologjia kognitive"*, Botimet "Vllamasi", Tiranë, 2010, fq. 202 – 263.

KUJTESA ASOCIATIVE. Hipotezë, sipas së cilës njeriu i mban mend, i rinjeh dhe i riprodhon të dhënat në mbështetje të lidhjeve, të asociacioneve që ato kanë ndërmjet syresh. Kujtesa asociative filloi të studiohet nga empiristët anglezë: Dejvid Hjum, 1711 – 1776), Xhon S. Mill (John, S. Mill, 1806 – 1873), Xhon Lok (John Locke, 1632 – 1704) etj., por u përforcua nga studimet e disa bihejvioristëve dhe përfaqësuesve të psikologjisë kognitive.

KUJTESA AUTOBIOGRAFIKE. Mbajtja mend dhe riprodhimi i ngjarjeve që ka përjetuar njeriu gjatë zhvillimit të jetës së tij. Të tilla janë: ngjarja e mbylljes së provimeve të maturës dhe e shpalljes së rezultateve, e pikërisht përjetimi i vendit që ka zënë nxënësi në raport me rezultatet e të tjerëve, martesa, ndërprerja e marrëdhënieve të punës etj. Kujtesa autobiografike karakterizohet me ngjyrimin e përmbajtjeve me dëshira, me qëndrime, me lloje të ndryshme emocionesh etj. Për këtë shkak kujtesa autobiografike vështirë se mund të jetë besnike e asaj çfarë vërtetë ka përjetuar dhe çfarë mban mend dhe riprodhon një individ i caktuar nga ngjarjet e përjetuara me kalimin e kohës.

KUJTESA BLIC.I ardhur nga gjermanishtja *blitz* "foto". Lloj i kujtesës së jashtëzakonshme për mbajtjen mend dhe riprodhimin e saktë të hollësive, para se njeriu ta përjetojë një ngjarje të papritur, gjatë zhvillimit dhe pas

përfundimit të saj. Kujtesa blic manifestohet sidomos në mbajtjen mend dhe në riprodhimin e saktë të atyre ngjarjeve që kanë rëndësi vitale për një individ të caktuar, për grupin, etninë apo kombin e tij.

KUJTESA DEKLARATIVE. Lloj i kujtesës që karakterizohet me angazhimin e vetëdijshëm të njeriut për t`i gjetur të dhënat e përvetësuara (informacionet, nocionet, gjykimet etj.) në kujtesën e tij dhe këto të dhëna ai duhet t`i riprodhojë para vetes ose para të tjerëve**.** Kujtesa deklarative njihet edhe me termin kujtesë eksplicite. Kujtesa deklarative ose eksplicite ndahet në dy lloj kujtesash. Këto janë:

a. **Kujtesa episodike** – Lloj kujtese që ka të bëjë me mbajtjen mend dhe riprodhimin e episodeve, të ngjarjeve që njeriu i ka përjetuar vetë. Te kujtesa episodike mbahet mend burimi, fillimi dhe mbarimi kohor e hapësinor i ngjarjes, si edhe kushtet dhe rrethanat e asaj ngjarjeje. Këtë lloj kujtese, si edhe kujtesën semantike e ka trajtuar posaçërisht E. Tulving dhe G. Anderson;

b. **Kujtesa semantike** – Lloj kujtese që ka të bëjë me mbajtjen mend dhe riprodhimin e drejtë sipas kuptimit që kanë fjalët, termat dhe lidhje e tyre. Të këtilla janë fjalët e fjalitë domethënëse për ngjarjet dhe faktet që kanë ndodhur (mbajtja mend e historisë së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, e ngjarjes së familjes Jasharaj në Drenicë etj.). Kujtesa semantike ka të bëjë me kuptimin e fjalëve, të termave, me dijen për rregulla të gramatikës e zbatimit të drejtë të tyre etj. Kujtesa semantike përbëhet nga disa shtresa kuptimore hierarkike: prej konceptit të përgjithshëm p.sh., koncepti ”kafshë” burojnë konceptet e veçanta ”shpezë” e deri koncepti “bilbil”.

KUJTESA EIDETIKE. Kujtesë që ka të bëjë me mbajtjen mend dhe riprodhimin e figurave eidetike. Shih – ***EIDETIZMI.*** Kujtesa eidetike është karakteristike vetëm për disa individë. Zakonisht te fëmijët shfaqet te rreth 8 % e fëmijëve. Supozohet se kujtesa eidetike ka të bëjë më tepër me kujtesën shqisore. Ndërkaq priten rezultatet e hulumtimeve më të reja. Në literaturën e psikologjisë së kujtesës kjo lloj kujtese emërtohet edhe me termin kujtesë fotografike.

KUJTESA EKSPLICITE. Mbajtja mend në mënyrë të vetëdijshme nga ana e një individi që mëson dhe shtrirja e vetëdijshme e proceseve të kujtesës në përvetësimin e asaj për të cilën njeriu është i vetëdijshëm se e ka pronë, kapital të vetin, të vendosur në kujtesën e tij. Niveli i njohjes së tillë të përmbajtjeve të përvetësuara arrihet duke i vënë detyrë vetes që lënda duhet mësuar, sepse më pas duhet rinjohur dhe riprodhuar tërësisht. Kujtesës eksplicite i përkasin kujtesa episodike dhe kujtesa semantike. Shih – ***KUJTESA EPISODIKE; KUJTESA SEMANTIKE.***

KUJTESA EMOCIONALE. Formë e kujtesës, e cila ka të bëjë me mbajtjen mend dhe riprodhimin e reagimeve emocionale të fituara gjatë përvojës së njeriut. Mbahet mend dhe riprodhohen emocionet e gëzimit, hidhërimit, mallëngjimit etj., por këto emocione mbahen mend dhe riprodhohen më tepër kur njeriut i kujtohen njerëzit

ose situatat që kanë shkaktuar emocione të këtilla.

KUJTESA EPISODIKE. Formë kujtese relativisht e përsosur e mbajtjes mend, e rinjohjes dhe e riprodhimit të saktë të kohës, të vendit, të rendit dhe të mënyrës së mbledhjes së të dhënave dhe të sistematizimit të tyre.

KUJTESA FILOGJENETIKE. Term i psikanalizës që është trajtuar nga Z. Frojdi dhe K. Jungu, si edhe studiues të tjerë të kësaj fushe. Kujtesa filogjenetike është kujtesë universale dhe karakteristike për llojin e caktuar të disa qenieve të gjalla. Falë ekzistencës së kujtesës filogjenetike qeniet e gjalla janë në gjendje të mbajnë mend dhe të riprodhojnë disa nga sjelljet karakteristike për atë lloj qeniesh. Kujtesa për nënën, babanë etj. janë arketipa që gjatë zhvillimit filogjenetik të gjinisë njerëzore janë bartur brez pas brezi dhe kanë arritur të formojnë dispozicion të caktuar me rëndësi të veçantë për zhvillimin e secilës qenie të re njerëzore. Argumentet e ekzistencës së kujtesës filogjenetike janë të kufizuara, por jo të mohueshme.

KUJTESA GJENETIKE. Kujtesa biologjike për ngjarjet e ngulitura në kujtesën e kafshëve të një gjinie a lloji të caktuar gjatë zhvillimit të asaj gjinie apo lloji. Mbi këtë bazë janë bërë të qëndrueshme disa forma veprimesh që karakterizojnë të gjithë pjesëtarët e asaj gjinie apo lloji. E tillë është frika nga rrëzimi i një kafshe nga një lartësi dhe veprimi i saj për t`iu larguar këtij rreziku. Këto reagime janë mbetje adaptuese të asaj gjinie a lloji kafshësh që janë zhvilluar dhe janë përforcuar në kujtesën e kafshëve gjatë zhvillimit evolutiv të tyre.

KUJTESA IKONIKE. Përvojë e shkurtër pamore, e njohur në leksikun e psikologjisë edhe me termin memoria ikonike, që ka të bëjë me ruajtjen e figurës së ngacmuesit të shqisës së të parit një-, ose më së shumti dy minuta. Përmbajtja e kujtesës ikonike përcaktohet nga pasndijimet, përkatësisht nga ngacmuesi që e ka ndërprerë ngacmimin e tij në shqisën e të parit, por figura e tij zgjat një kohë shumë të shkurtër, si rezultat i mosqetësimit të turbullirës nervore. Kujtesa ikonike mundëson të parët e filmave në televizion, sepse këtu kemi të bëjmë me zëvendësim të një figure statike me një figurë tjetër dhe kujtesa ikonike lehtëson lidhjen e figurave të tilla në tërësi.

KUJTESA MUZIKORE. Komponente përbërëse e muzikalitetit të njeriut që ka të bëjë me mbajtjen mend, rinjohjen dhe riprodhimin e lehtë të tërësive muzikore, që shkaktojnë emocione pozitive te njeriu. Kujtesa muzikore edukohet me ushtrime të organizuara të të kënduarit pa zë, me përsëritje të melodive të lehta dhe më pas të ndërlikuara, me përsëritje të motiveve muzikore, me këndim të thjeshtë e më pas të ndërlikuar sipas notave të pentagramit etj.

KUJTESA PROCEDURALE. Lloj i veçantë i kujtesës që ka të bëjë me mbajtjen mend dhe me riprodhimin e aktiviteteve të ndërlikuara, në rend të parë të aktiviteteve psikomotorike, që kanë arritur të kryhen gati mekanikisht nga subjektet, të cilat realizohen pa kontroll të vetëdijshëm të proceseve përbërëse të tyre. Kujtesës procedurale i përkasin mbajtja mend dhe riprodhimi i proceseve lëvizëse të shtypjes së përmbajtjeve librore në doreshkrim

me kompjuter të tipit të veçantë, ngasja e automobilit, e biçikletës etj. Shih – ***KUJTESA MOTORIKE.***

KUJTESA PUNUESE. Emërtim i mbajtjes mend, ruajtjes dhe riprodhimit të atyre informacioneve që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me të kuptuarit e përmbajtjeve mendore, me arsyetimin e zgjidhjeve dhe të metodave të zbatuara në zgjidhjen e situatave problemore. Ekzistencën dhe funksionin e kësaj kujtese e ka studiuar dhe arsyetuar psikologu amerikan Alan Badelei.

KUJTESA RIPRODHUESE. Mbajtja mend dhe riprodhimi i lëndës që mësohet në mënyrë relativisht të pandryshueshme, ose duke mos bërë ndryshime të qëllimshme në strukturën, në renditjen dhe në raportet e të dhënave të lëndës që mësohet.

KUJTESA SENSOMOTORIKE. Kujtesa afatshkurtër, ruajtja e të dhënave dhe e informacioneve shqisore brenda një afati kohor shumë të shkurtër, por të mjaftueshëm për të procesuar disa informacione në kujtesën afatgjatë. Për të dhënat e informacionet pamore kjo fazë zgjat rreth 0.5 sek, kurse për ato dëgjimore zgjat rreth 2 sek. Disa prej tyre kalojnë në kujtesën afatgjatë, të tjerat humbin pas kalimit të kohës së ruajtjes së tyre.

KUJTESA SOCIALE. Term i psikologjisë së kujtesës bashkëkohore, por i disa studiuesve të psikologjisë sociale, të rolit të faktorëve socialë dhe të kontekstit të këtyre faktorëve në mbajtjen mend dhe në riprodhimin e ngjarjeve dhe të proceseve historike e sociale. J. Hartvik, D. Midleton, C. Paden etj. kanë argumentuar rolin e bindjeve, të qëndrimeve, të përshtypjeve të para, të vlerave etj. në mbajtjen mend dhe riprodhimin e përmbajtjeve që mësohen. Megjithëkëtë, saktësisht është vështirë të përcaktohet natyra e veçantë e kujtesës sociale dhe identifikimi i plotë i saj si lloj i veçantë i kujtesës.

KUJTIM, - I. m. Rikthim i informacionit të vendosur në kujtesën afatgjatë me angazhim të vetëdijshëm të individit në rikthimin e informacionit në kujtesën e punës, përkatësisht në gatishmërinë e riprodhimit të atij informacioni ose të lidhjeve ndërmjet informacioneve nga ana e një individi të caktuar. Kujtimi ka edhe një kuptim tjetër: ringjallje e përfytyrimit të një individi të dashur në shenjë nderimi dhe, në rastet e këtilla, fjala është për përfytyrime të ngjeshura me emocione që kanë të bëjnë me raportin e kujtesës ndaj përfytyrimit të atij që kujtohet dhe zakonisht kujtimet e këtilla janë ringjallje e përfytyrimit të shokut, të mikut etj. me emocionet pozitive për të.

KULT, - I. m. I ardhur nga latinishtja *cultus* "i adhuruar" që emërton konceptin e adhurimit të një individi, i cili konsiderohet se është udhëheqës shpirtëror i një sekti, i një besimi me ritualet e veta. Këtij individi i atribuohen cilësi të veçanta, duke shprehur adhurim, besim dhe nderim ndaj tij. Struktura psikologjike e kultit është e ndërlikuar, por mbisundojnë ndjenja e besimit të thellë, e respektit dhe e adhurimit ndaj bartësit të kultit, ndonëse shkaqet e vërteta janë objektivisht të panjohura.

KULTI I PASARDHËSVE. Kult ndaj pasardhësve që ka të bëjë me besimin e thellë në frymën e gjallë dhe

admirimin e anëtarëve të një fisi, të një familjeje të caktuar, paraardhësit e të cilëve nuk jetojnë.

KULTI I PERSONALITETIT. Atribuim cilësish, tiparesh dhe vlerash një personaliteti të caktuar (të fesë, të partisë, të shtetit etj.), që realisht nuk i ka, por konsiderohet i tillë; shoqëria, partia etj. nuk dinë çfarë të bëjnë në mungesë të tij. Musolini u konsiderua "Njeri i madh", Hitleri, Stalini etj. vlerësoheshin "Të arritur të pazëvendësueshëm".

KULTUR/Ë, - A. f. I ardhur nga latinishtja *cultus* "kultivim" që përbën një sistem të tërësishëm normash, rregullash, qëndrimesh, vlerash, zakonesh e metodash të kultivuara në një nivel karakteristik të një mjedisi njerëzish të organizuar. Pjesëtarët e këtij mjedisi të gjerë a të ngushtë e zhvillojnë veprimtarinë e tyre njëri me tjetrin, si dhe të gjithë pjesëtarët ndaj mjedisit të tyre fizik e social sipas këtij sistemi normash, rregullash, qëndrimesh e vlerash, duke synuar ngritjen sa më të lartë të fisnikërisë së sjelljeve të tyre. Kuptimi i termit kulturë ka të bëjë vetëm me atë sistem normash, rregullash, qëndrimesh, vlerash etj. që nuk i përkasin trashëgimisë dhe nuk kanë bazë trashëgimie, por mësohen gjatë jetës dhe aktivitetit të njeriut dhe barten prej një brezi në brezin tjetër me anë të edukimit, të institucioneve të ngritura për plotësimin sa më të mirë të nevojave biologjike, sociale dhe psikologjike të njeriut. Kultura është objekt i studimit të antropologjisë, të psikologjisë, të sociologjisë, madje, kohët e fundit u krijua edhe disiplina shkencore e kulturologjisë. Në psikologji njohja e kulturës dhe e aspektit implicit e eksplicit të saj ka rëndësi të posaçme, sepse kultura është burimi kryesor i socializmit të njeriut.

KULTURA E LEXIMIT. Kulturë që ka të bëjë me leximin sistematik, me kuptimin rrjedhshëm të veprave nga krijimtaria letrare popullore, artistike, shkencore etj. Bazuar te ky lexim lexuesi përsos vazhdimisht mënyrën e perceptimit të fjalëve dhe të fjalive që lexon dhe mënyrën e kuptimit të tyre në kontekstin e caktuar.

KULTURA E PUNËS. Qëndrim i formuar për punën dhe rëndësinë e saj dhe, mbi këtë bazë, organizimi i atillë i procesit të punës fizike dhe mendore që sjell rezultate të larta cilësore në produktet e punës.

KULTURA EKSPLICITE E INDIVIDIT. Tërësia e të gjitha sjelljeve të njeriut, të dallueshme dhe karakteristike për kulturën e një mjedisi të caktuar. Te kultura eksplicite hynë të gjitha tiparet karakteristike të sjelljeve të individit, të cilat i hasim te shumica absolute e anëtarëve të një mjedisi kulturor: sjelljet sipas zakoneve të atij mjedisi, mënyra e përgatitjes dhe e marrjes së ushqimit, mënyra e edukimit të fëmijëve sipas vlerave të atij mjedisi, mënyra e veshjes së të rriturve të gjinisë femërore e asaj mashkullore, sjelljet në ceremonitë e lindjes, të martesës, si edhe sjelljet në raste varrimi etj.

KULTURA FORMALE E TË MËSUARIT. Term i konceptit didaktik, por me përmasa të theksuara psikologjike. I përket teorisë së mbartjes së të mësuarit dhe të efekteve të

të mësuarit të suksesshëm. Sipas kësaj teorie, të mësuarit e një lënde mësimore ushtron ndikim pozitiv në të mësuarit e përmbajtjes së një lënde tjetër mësimore, duke përvetësuar në rend të pare parimet, rregullat, ligjet etj. të të mësuarit, e jo duke theksuar e përqendruar vëmendjen vazhdimisht në elementet e përmbajtjes së asaj që mësohet. Të mësuarit e gramatikës, të logjikës, të matematikës etj. ndihmon të mësuarit e lëndëve të tjera (të biologjisë, të historisë, të sociologjisë etj.), ngaqë nxënësi përmes të mësuarit të lëndëve të përmendura njihet me parimet, me rregullat dhe me mënyrat e të menduarit të drejtë, të shprehjes së saktë të mendimeve, të metodave si mbahet mend sa më mirë përmbajtja e asaj që mësohet, të zhvillimit të shijes për mendime të sakta e të bukura etj. Këto parime, rregulla, ligje etj. të formuara nga të mësuarit e parimeve, të rregullave, të ligjeve etj. të një lënde ose disa sosh mbarten në të mësuarit e përmbajtjes së lëndëve të tjera mësimore. Gjatë të mësuarit të lëndëve mësimore rëndësi të madhe ka jo aq përmbajtja e asaj që mësohet, por forma (si të mendohet logjikisht, si të shprehet drejt, rrjedhshëm e bukur, çfarë duhet bërë për ta mbajtur mend përmbajtjen e asaj që mësohet për një kohë sa më të gjatë etj. Shih – ***FORMIMI TRAJTOR; FORMIMI LËNDOR.***

KULTURA IMPLICITE. Termi për kulturën subjektive se si individi e ndien, për shkaqet dhe standardet e veprimit kulturor. Kulturën implicite e krijojnë bindjet, vlerat sociale dhe kuptimi i rëndësia e njohjes dhe e zbatimit të tyre me sjellje të përshtatshme, të kultivuara dhe të mirëpritura nga pjesëtarët e kulturës së një mjedisi.

KULTURA LËNDORE. Shprehje e kulturës shpirtërore që ka të bëjë me atë që krijon njeriu me punën e vet fizike e mendore dhe me krijimin dhe zhvillimin e të mirave prodhuese. Këto plotësojnë në rend të parë nevojat lëndore dhe shpirtërore të njeriut. Produkte të kulturës lëndore janë: armët, artefaktet, artizanati, veglat bujqësore, teknike etj. Kultura lëndore ose materiale është term i sociologjisë së kulturës, përkatësisht i kulturologjisë e arkeologjisë, por ka lidhje të ngushtë edhe me psikologjinë sociale.

KULTURA POLITIKE. Sistem bindjesh, qëndrimesh, vlerash dhe sjelljesh ndaj objektit të politikës, përkatësisht ndaj partisë që i përket, ndaj kushtetutës së vendit, si edhe ndaj akteve juridike e shoqërore të miratuara në parlamentin e një vendi dhe që përmbajnë norma të sjelljeve të veçanta të gjithë individëve që drejtojnë politikën zhvillimore të një vendi.

KULTURA SHPIRTËRORE. Vlera të krijuara me vetëdije që synojnë zhvillimin dhe përparimin e vendit dhe të mirat për të gjithë. Në kulturën shpirtërore hyjnë të gjitha veprat e krijuara nga njeriu, që plotësojnë nevojat shpirtërore të tij. Në kulturën shpirtërore marrin pjesë: arti e vepra artistike, feja, filozofia, morali, normat e sjelljeve, mënyrat e të menduarit, sporti, shkenca me veprat shkencore etj.

KUMULATIV, - E. mb. Në psikometri përcakton sasinë e shtuar të shumës paraprake me rezultatin individual e që pason pas asaj shume. Me këtë kuptim duhet kuptuar termi

frekuencat ose dendësitë e klasave të veçanta, kur këto janë të renditura në një tabelë dhe kur dendësisë së rasteve të një klase të dhënash i shtohet sasia e rasteve së klasës që pason pas saj, përkatësisht kur shumës së dendësisë së të dhënave të dy klasave i shtohet sasia e rasteve të klasës së tretë, përkatësisht kur shumës së të dhënave të tri klasave i shtohet sasia e të dhënave të klasës së katërt e kështu me radhë. Shuma e fundit e dendësisë së rasteve të të gjitha klasave paraqet sasinë e përgjithshme të rasteve të të gjitha klasave. Dendësia kumulative është fazë e rëndësishme e përpunimit statistikor të të gjitha rasteve, sidomos kur llogaritim vlerën qendrore të tyre.

KUNDËRVEPRIM, - I. m. Veprim i posaçëm i organizmit ose i pjesëve të tij ndaj një ngacmuesi që ushtron ndikim në të, përkatësisht në pjesët e tij. Kundërveprimi mund të jetë i thjeshtë dhe i ndërlikuar. Kundërveprimi i thjeshtë është reagimi i muskujve dhe i gjëndrave ndaj ngacmuesve adekuatë të tyre. Kundërveprimi i ndërlikuar ka të bëjë me reagimin e individit ndaj situatave foljore, në të cilat dallohet qëndrimi i caktuar dhe cilësia e intensiteti i emocioneve të tij.

KUNDËRVEPRIMI FOBIK. Reagim i pazakonshëm ndaj objekteve dhe situatave normale të jetës së njeriut. I tillë mund të jetë reagimi i njeriut ndaj lokalit të mbyllur, kur ai fillon të shfaqë frikë të paarsyeshme ndaj atij lokali.

KUNDRIM, - I. m. Pikëvështrim i posaçëm i një dukurie, i një objekti, i një procesi, i një sjelljeje të caktuar. Kundrimi realizohet sipas një plani të posaçëm të përpiluar nga ana e të interesuarit, për gjurmimin e dukurisë, të objektit, të procesit etj.

KUNEUS, - E. f. I ardhur nga latinishtja *cuneus*. Në anatominë e sistemit nervor emërton grupin e neuroneve të vendosura në pjesën e përparme të trurit të njeriut, që bartin impulse nervore nga pjesa e sipërme e trupit dhe e duarve të organizmit të njeriut në zonat ndijimore të trurit. Në këtë rrugëtim të impulsive nervore gjenden lidhjet sinaptike të para të trurit të njeriut.

KUNJËZAT DHE SHKOPTHAT. Qeliza receptore të të parit që përbëjnë njërën nga dhjetë shtresat e rrjetëzës ose të retinës së syrit. Qendra e rrjetëzës ose e retinës së syrit e njohur me emërtimin *fovea centralis retinae* dhe pjesa tjetër e njohur me termin *macula lutea* kanë vetëm kunjëza. Syri i njeriut ka rreth shtatë milionë kunjëza. Sa më shumë të largohemi nga qendra e retinës numri i kunjëzave zvogëlohet, kurse në periferi të rrjetëzës ose të retinës gjenden shkopthat. Kunjëzat janë pak të ndjeshëm dhe, këta reagojnë vetëm ndaj intensitetit të lartë të dritës. Kunjëzat mundësojnë dallimin e ngjyrave kromatike. Në literaturën e psikologjisë të përkthyer në shqip kunjëzat emërtohen edhe me termin kon, sigurisht ngaqë i përngjasin figurës së konit.

KUPTIM, - I. m. Tërësia e proceseve mendore e angazhuar në njohjen e përmbajtjes së një fjale, simboli, termi etj., që emërtojnë cilësinë, funksionin, operacionet dhe lidhjet thelbësore ndërmjet tyre të një objekti të emërtuar me një simbol të veçantë.

Kuptimi i një fjale, lidhjeje, raporti etj. bëhet me anë të angazhimit të plotë të proceseve mendore të njeriut.

KUPTIMI PËR HUMOR. Ndjeshmëria individuale e njeriut për të dalluar atë që është komike dhe tallëse në veten e tij. Kuptimi për humor ndaj vetes i atribuohet vetëm personalitetit të pjekur mendor; ky personalitet është në gjendje të dallojë sjelljet e tij qesharake dhe të distancohet nga sjelljet e këtilla. Këtë e kanë identifikuar studiuesit e psikologjisë së personalitetit dhe e hasim në psikologjinë e psikologëve amerikanë Gordon V. Olport (Gordon V. Allport, 1897 – 1967) dhe të Abraham H. Maslou (Abraham H. Maslow, 1908 – 1970).

KUQËSI, - A. f. Emërtim i ngjyrës së kuqe të sipërfaqes së një objekti, tonin e së cilës e përcakton gjatësia e valëve elektromagnetike pre rreth 780 – 610 milimikron.

KURAJ/Ë, - A. f. Gatishmëri psikofizike e njeriut për të zotëruar frikën dhe çrregullimet e sjelljeve që janë produkt i frikës. Kuraja ka të bëjë drejtpërdrejt me zotërimin e atyre formave të frikës që shkaktohen nga faktorët e jashtëm, përkatësisht nga burimi i frikës i njohur për njeriun (ballafaqimi me ariun në pyll, vërshimi etj.). Kuraja e njeriut ka karakter të ngushtë individual: derisa tjetrin e rrok paniku nga vërshimet, ka individë që e ruajnë qëndrueshmërinë dhe orvaten me sukses ta zotërojnë frikën e shkaktuar nga vërshimet.

KURESHTJ/E, - A. f. Dëshirë e ngritur në nivelin e prirjes së njeriut për të njohur të renë dhe të pazakonshmen. Kërshëria ka përmasat e një motivi të shoqëruar me ndjenjën e nevojës: kureshtja e shtyn dhe e drejton njeriun për t`i organizuar proceset dhe sjelljet e tij drejt njohjes së dukurisë, objektit, procesit, raportit etj., që është pjesërisht i njohur ose që është fare i panjohur për të. Ka mendime sipas të cilave kureshtjes i japin karakter universal për qeniet e gjalla (për miun, macen, majmunin etj.). Kureshtja si motiv e shtyn njeriun të fitojë dije nga fushat e ndryshme të zhvillimit të disiplinave të shkencës dhe të artit. Sipas psikologut amerikan me origjinë britanike Viliam Mekdugal (William MackDougal, 1871 – 1938) kureshtja është një instinkt, nga i cili u zhvilluan impulset e brendshme që e shtyjnë njeriun ta njohë të panjohurën për të, të gjurmojë gjenezën dhe zhvillimin e saj, si edhe faktorët ndikues në procesin e zhvillimit të një dukurie, objekti, procesi, raporti etj. Madje, sipas tij, rrënjët elementare të shkencës dhe të teknikës burojnë nga instinkti i kureshtjes.

KUSHTET E NDIJIMEVE. Faktorët, nga ndikimi i të cilëve në shqisat e njeriut përjetohet një ndijim i caktuar dhe cilësitë e atij ndijimi. Kushtet e ndijimeve janë tri llojesh dhe bashkëveprimi i tyre shkakton përjetimin e ndijimit të caktuar dhe të cilësive të tij. Kushtet e ndijimeve përfshijnë:

- **Kushtet fiziko–kimike –** Ngacmuesit e caktuar që ushtrojnë ndikim të drejtpërdrejtë në shqisat e njeriut dhe me cilësitë e me përmasat e tyre janë në gjendje të shkaktojnë ngacmim të shqisave (era e mirë e trëndafilit, ngjyra e gjelbër e barit, zëri i një tenori etj.).
- **Kushtet fiziologjike** – Shqisat me elementet receptore të tyre, me nervat sjellës, me qendrat nervore përkatëse

të cipës së trurit dhe me funksionet e tyre, ku impulset nervore shndërrohen në ndijim, në bazë të funksionimit të përbashkët të tyre, shih – ***APARATI NDIJUES.***

- **Kushtet psikologjike** – Tërësi faktorësh psikologjikë që marrin pjesë në përjetimin e asaj cilësie gjatë kohës së perceptimit të një trupi, procesi, dukurie etj. (vëmendja, perceptimi etj.).

KUSHTËZIM, - I. m. Kushtëzimi në përgjithësi ka kuptimin e reagimit që varet nga një ngacmues neutral i mëhershëm. Kushtëzimi është term i psikologjisë së të mësuarit. Kushtëzimi emërton formën më të thjeshtë të të mësuarit të kafshëve dhe të njerëzve, që ka të bëjë me kushtet specifike në të cilat organizmi mëson të reagojë. Te njeriu të mësuarit e reagimeve të kushtëzuara ka kryesisht karakter të të mësuarit të reagimeve të pavetëdijshme. Të mësuarit e reagimeve të kushtëzuara realizohet në laboratorë eksperimentalë, siç kanë vepruar fiziologu rus Ivan P. Pavllov (Ivan P. Pavlov, 1849 – 1936) dhe psikologët amerikanë Eduard L. Trondajk (Edward L. Thorndike, 1874 – 1949) dhe Burhus F. Skiner (Burhus, F. Skinner, 1904 – 1990). Kushtëzimi është formë e reagimit të mësuar ndaj një objekti, sinjali, situate etj., kur këto lidhen në mënyrë suksesive ose në mënyrë simultane me marrjen e ushqimit, me shkaktimin e një dridhjeje elektrike etj. të organizmit. Përsëritja e lidhjes ngacmues fizik (dritë e fortë, zhurmë etj.) dhe më pas ushqim ose ujë (që i jepet organizmit), bën që organizmi, pas disa përsëritjesh dritë – ushqim, fillon të reagojë duke lëshuar jargë edhe ndaj dritës. Sipas kësaj forme mësohen format e thjeshta të reagimit të organizmit. Sipas këtij modeli mësohen edhe disa reagime emocionale të organizmit. Kështu, kur një ngacmues neutral paraqitet i lidhur me përjetimin e një emocioni, fëmija fillon të reagojë edhe ndaj këtij ngacmuesi me emocione etj. Ekzistojnë dy forma kryesore të të mësuarit të kushtëzuar**:**

a. **Kushtëzimi klasik** – Formë e të mësuarit që i atribuohet fiziologut rus Ivan P. Pavlov. Kushtëzimi klasik ka të bëjë me atë formë elementare të të mësuarit që përftohet nga fakti se, kur një ngacmues i kushtëzuar dhe një ngacmues i pakushtëzuar shoqërohen njëri me tjetrin duke u përsëritur së bashku, atëherë organizmi fillon të shfaqë një lloj sjelljeje të kushtëzuar. Në laboratorin eksperimentues të Ivan P. Pavlov me bashkëpunëtorët e tij, qeni i është ekspozuar zhurmës së ziles dhe më pas i është dhënë ushqimi. Përsëritja e kësaj lidhjeje ka shkaktuar atë që, qeni ka filluar t`i lëshojë jargët edhe ndaj zhurmës së ziles etj. Ushqimi është ngacmues i pakushtëzuar, kurse zhurma e ziles në fillim ishte ngacmues neutral (ndaj këtij ngacmuesi kafsha nuk reagonte), por pas disa përsëritjeve kjo zhurmë u bë kusht i shkaktimit të reagimit. Lidhja ndërmjet kushtit të pakushtëzuar dhe reagimit të kushtëzuar u bë shkak i të mësuarit të kafshës për të reaguar edhe ndaj ngacmuesit neutral;

b. **Kushtëzimi instrumental** – Formë e të mësuarit që lidhet me emrin e psikologut amerikan Burhus F. Skner. Ka të bëjë me të mësuarit e reagimit, duke shpërblyer reagimin e suksesshëm me ushqim të mirë. Reagimi i tillë mësohet pas disa përsëritjeve:

pëllumbi mëson të trokasë në enën e mbushur me kokrra gruri, pasi ka mësuar se pikërisht në enën mbi të duhet të trokitet për të lëshuar kokrra gruri. Këtë lloj reagimi Burhus F. Skineri e ka quajtur reagim operant, sepse me anën e këtij reagimi pëllumbi ka arritur qëllimin e vet – të ushqehet me kokrra gruri. Në procesin e kushtëzimit instrumental uria e pëllumbit dhe të çuarit e tij deri në enën e mbushur me ujë dhe të vendosur mbi të, të tundurit me sqep të kësaj ene është reagim i kushtëzuar, shpërblimi me ushqim është ngacmim i pakushtëzuar, kurse të ushqyerit me kokrra gruri është reagim i pakushtëzuar. Përmenden katër lloje të kushtëzimit instrumental: përforcimi pozitiv, përforcimi negativ, ndëshkimi dhe shuarja.

KUSHTËZIMI DIFERENCIAL. Formë e të mësuarit të kushtëzuar që realizohet duke përforcuar, e pikërisht duke shpërblyer një lloj sjelljeje, e duke injoruar ose duke dënuar sjelljen tjetër. Në këtë mënyrë mësohet dallimi i atyre ngacmuesve ndaj të cilëve reagohet pozitivisht dhe i atyre ngacmuesve ndaj të cilëve nuk reagohet ose reagohet negativisht.

KUSHTËZIMI EMOCIONAL. Formë e të mësuarit të reagimit emocional që zhvillohet sipas mekanizmit të kushtëzimit. Sipas këtij mekanizmi reagimi emocional zhvillohet kur një ngacmues neutral shfaqet gjatë kohës së përjetimit të një emocioni të caktuar. Perceptimi i qenit të rrezikshëm shkakton frikë; kur fëmijës i paraqitet përsëri qeni te ai shfaqet frika.. Kështu zhvillohen një varg reagimesh të karakterit të fobisë. Në të mësuarit e kushtëzimit emocional paraqitja e mëvonshme e atij ngacmuesi zgjon te individi emocionin e përjetuar në bazë të lidhjes së mëparshme të tij me gjendjen emocionale.

KUSHTËZIMI I GJURMËVE NERVORE. Gjurmët nervore për ngacmuesin e kushtëzuar bëhen mbështetje e zhvillimit të reagimeve të reja ndaj ngacmuesve të kushtëzuar. Ky pohim mbështetet në gjykimin hipotetik të gjurmëve nervore dhe të zhvillimit e përforcimit të tyre nga ndikimi i procesit të të mësuarit të kushtëzuar.

KUSHTËZIMI I RANGUT MË TË LARTË. Formë e re e të mësuarit e mbështetur në të mësuarit e reagimit të kafshës apo të fëmijës ndaj një ngacmuesi të kushtëzuar, duke i shtuar këtij reagimi ngacmuesin e ri të kushtëzuar. Kështu, gjatë të mësuarit dhe reagimit ndaj zhurmës së ziles, po qe se këtë e lidhim me reagim ndaj dritës, organizmi fillon të mësojë të reagojë edhe ndaj dritës. Ky lloj reagimi i mësuar quhet reagim i rendit të dytë ose kushtëzim i rendit më të lartë. Te njeriu mund të zhvillohen edhe forma më të larta të reagimeve të tilla, si reagimi i rendit të tretë, të katërt etj. Bihejvioristët konsiderojnë se në këtë mënyrë njeriu mëson forma të reagimeve abstrakte e simbolike.

KUSHTËZIMI INSTRUMENTAL. Forma e dytë e të mësuarit të kushtëzuar (përpos kushtëzimit klasik) që u identifikua nga fiziologu dhe psikologu rus Ivan Pavllov (Ivan Pavlov, 1849 – 1936) dhe bashkëpunëtorët e tij. Shih – ***TË MËSUARIT INSTRUMENTAL.***

KUSHTËZIMI OPERANT. Lloj i veprimit a i sjelljes së mësuar në bazë

të përforcimit të atij veprimi me anë shpërblimesh, dhuratash etj. Përforcimi i tyre e shpie organizmin e kafshës deri në objektin me të cilin kafsha plotëson nevojën e saj. Dallimi i kushtëzimit operant nga kushtëzimi klasik qëndron në atë që veprimi operant është tërësi veprimesh të shkaktuara nga rrethanat e njëjta dhe përforcimi i pandërprerë i atyre veprimeve që janë reagim ndaj këtyre rrethanave. Kushtëzimi operant ka kuptim pak të ndryshuar nga kushtëzimi instrumental. Dallimi qëndron në atë që, te kushtëzimi operant nuk përforcohen sjelljet me anë të mjeteve për të arritur deri në ushqim, por përforcohen reagimet e reja dhe spontane që nuk nxiten nga faktorët e mjedisit të jashtëm. Veprimet operante janë veprime që shkaktojnë ndryshime të mjedisit, duke përforcuar (shpërblyer) ato veprime pozitive që në formimin e sjelljeve të ndërlikuara, kurse veprimet e kushtëzimit instrumental janë veprime që shkaktohen nga ndikimi i ngacmuesve të mjedisit, që, përkatësisht shkaktohen nga ngacmuesit e mjedisit. Shih – ***KUSHTËZIMI INSTRUMENTAL.***

K

KUSHTËZIMI PRAPAVAJTËS. Formë e të mësuarit të kushtëzuar, që në provat eksperimentuese zbatohet duke rikthyer procesin e kushtëzimit: në fillim organizmi i nënshtrohet ngacmuesit të pakushtëzuar (ushqimit) dhe më pas atij të kushtëzuar (zhurmës, dritës, rrymës elektrike etj.). Kushtëzimi i pakushtëzuar është formë më pak e suksesshme e kushtëzimit.

KUTIA E SKINERIT. Mjet eksperimental në formë kutie, që mori emrin nga hartuesi e përdoruesi i saj për qëllime studimore - psikologu amerikan Burhus F. Skiner (Burrhus F. Skinner (104 – 1990). Në kuti eksperimentuesi vendosi një levë të lidhur me një burim ushqimi për minjtë, nën të cilën kishte vendosur një pjatë. Kur miu kishte uri vihej në lëvizje për të kërkuar ushqim dhe kur shkelte në këtë levë ose lëvizte një shkop ushqimi rridhte (kokrra gruri ose pika uji). Pas disa përsëritjesh të këtyre lëvizjeve miu arrinte të mësonte vendin dhe reagimin (shkeljen ose lëvizjen e shkopit) ndaj kësaj leve dhe të merrte ushqimin e duhur. Në këtë mënyrë miu mësoi si të shuante urinë e tij. Kjo kuti mund të vizatohet në disa forma, por dy kushte janë të domosdoshme: vënia e një manipuluesi (sustë, shkop etj.), me të cilin subjekti provues (në rastin e Skinerit miu, pëllumbi) mund të manipulojë dhe ena me ushqim, me ujë etj. Prekja e shkopit shkaktonte derdhjen e ushqimit në një pjatë ose derdhjen e ujit në enën e caktuar dhe me këtë ushqim, pra me këtë sasi uji kafsha shpërblehej. Pas disa përsëritjeve kafsha arrinte të mësonte të përdorte shkopin, të shkelte në sustë dhe të merrte ushqimin dhe të shuante urinë, pra etjen. Kjo kuti u përdor për të dalluar cilësitë e të mësuarit operant.

KYLPE Osvald (Osvald KÜLPE). Filozof dhe psikolog gjerman. Lindi në Kandau (Kurlant) më 3.08.1862 dhe vdiq në Mynih më 30.12.1915. Studioi histori në Universitetin e Lajpcigut dhe më pas u mor me studime të psikologjisë. U doktorua për psikologji me mbrojtjen e tezës "Ndijimet shqisore te Vilhelm Vunti". Që nga viti 1894 punoi si profesor i Universitetit të Vyrcburgut, ku ngriti dhe laboratorin psikologjik, nga e cila u zhvillua

Shkolla e Vyrcburgut, që kontribuon në zhvillimin e studimeve të mendimit. Këtu qëndron vlera dhe kontributi i Osvald Kylpes. Ky, së bashku me bashkëpunëtorët, treguan se edhe proceset e larta mendore kanë mundësi të studiohen me metoda ekpserimentale. Rezultatet e gjurmimit ekpserimental të procesit të mendimit nga ana e Osvald Kylpes treguan se procesi i të mendurit zhvillohet pa përfytyrime dhe pa ndijime të pranishme gjatë kohës së orvatjeve për zgjidhjen e problemeve dhe të situatave problemore. Veprat kryesore të tij janë: *"Grundriss der Psychologie"* – (*"Bazat e psikologjisë"*), 1893*; "Vorlesungen über Psychologie"* – (*"Hyrje në psikologji"*), 1922.

L

LAGASH Daniel (**Daniel LAGASHE, 1903 – 1972)**. Psikiatër dhe psikolog francez. Lindi në Paris. Pas përfundimit të studimeve në filozofi kreu studimet edhe për mjekësi dhe më 1934 doktoroi me sukses në mbrojtjen e tezës "Mbi halucinacionet verbale dhe të folurit". U interesua kryesisht për psikanalizë dhe zbatimin e metodës psikanalitike për mjekimin dhe shërimin e pacientëve. Ka qenë vazhdues i Pjer Zhanes për disiplinën e psikologjisë klinike dhe pati merita për futjen e psikanalizës në studimet universitare. Më 1937 u zgjodh docent në Fakultetin e Strasburgut dhe pas dhjetë vjetësh, pas vitit 1947 drejtoi katedrën e psikologjisë në vend të psikologut të njohur Pol Gijom. Ka mbetur i njohur në historinë e psikologjisë franceze me ligjëratën e mbajtur më 1949 "*L` Unite de psychologie*" – ("Uniteti i psikologjisë") dhe në emër të unitetit të psikologjisë Daniel Lagash u bë ithtar i psikanalizës klasike të Zigmund Frojdit, me të cilin ishte takuar në qershorin e vitit 1938 në Paris. Sipas tij "uniteti i psikologjisë duhet të përfshijë anën natyrore të degës së psikologjisë, që rrok bihejviorizmin dhe teorinë e të mësuarit (përfshirë statistikën dhe eksperimentimin) dhe degën e saj, të ashtuquajturën degë humaniste, e cila nënkupton psikologjinë klinike dhe psikanalizën, që është gjithashtu ultraklinike". Krahas aktivitetit të tij universitar Daniel Lagash vuri themelet e bibliotekës së psikanalizës në Francë, duke botuar 42 tituj, ndër të cilët edhe veprat e Zigmund Frojdit, si edhe veprat e autorëve anglezë dhe amerikanë të njohur pak nga publiku lexues i Francës. Veprat kryesore të tij janë: *"La psychanalyse"* – (*"Psikanaliza",* 1955); *La psychanalyse et la structure de la personnalité"* – (*"Psikanaliza dhe struktura e personalitetit",* 1958).

LAIK, - E. mb. I ardhur nga greqishtja *λαός* "popull". Laiku ose laikja është individi profan, jofetar, që nuk beson në Zot. Dallohet nga individi ateist, meqë nuk e refuzon fenë, as besimin fetar të të tjerëve, por nuk beson në të. Mbiemri laik ose laike ka edhe kuptimin e të padituritit në një fushë të caktuar të dijes. Përdorimi i këtij termi

me kuptimin përkatës varet nga zhvillimi i mendimit të gjerë dhe nga caku i shprehjes së atij mendimi dhe qëndrimi.

LAJBNIC Vilhelm Gotfrid (**Gottfried Wilhelm LEIBNITZ**). Mendimtar i gjithanshëm gjerman me ndikim në zhvillimin e psikologjisë në gjysmën e dytë të shekullit XVII. Lindi më 1646 dhe vdiq më 1716. U bë i njohur në mendimin filozofik me pikëpamjen e tij mbi monadologjinë. Trupi-shpirti është i formuar nga një numër i madh monadash. Monadat janë struktura jolëndore, janë aktive dhe aktiviteti e gjallëria e tyre mbështeten në fuqinë e brendshme psikike. Monadat janë të shumëllojshme dhe brendia e tyre ka të bëjë me përfytyrime. Përfytyrimet janë të shkallëzuara; shkallën më të ulët të tyre e përbëjnë përfytyrimet e pavetëdijshme që mbështeten në "perceptime të vogla", përkatësisht në perceptime të shkallës së ulët ("*petites perception*"). Monadat e shpirtit mund të zhvillohen dhe të ngrihen lart deri në nivelin e aperceptimit. Pikërisht ky nivel është i përbërë nga përfytyrimet e vetëdijshme. Përfytyrime të qarta kanë monadat e shpirtit. Ndërkaq, vetë shpirti është monada më e lartë. Së këndejmi del se shpirti është monada më e lartë, monada kryesore. Ndërkaq, monadat e trupit janë të zbrazëta, këto nuk janë të qarta as për vetëdijen e njeriut. Monadat janë aktive, por aktivteti i tyre nuk shkaktohet nga ndikimet e jashtme, por buron nga vetë natyra e monadave. Monadat e trupit dhe ato të shpirtit e zhvillojnë këtë aktivitet pavarësisht nga njëra-tjetra. Mbi këtë pikëpamje u zhvillua paralelizmi psikofizik, sipas të cilit lëvizjet dhe ndryshimet e trupit dhe ato të shpirtit zhvillohen sipas proceseve të ndara, duke mos ndikuar njëra në tjetrën. Ky konstatim ka bërë që Gotfrid Vilhelm Lajbnici të konsiderohet themelues i paralelizmit psikozik. Ka përkrahur pikëpamjen e Xhon Lokut se "*Në intelekt nuk ka asgjë që më parë të mos ketë qenë në shqisa",* dhe këtij pohimi i shtoi mendimin "*përpos vetë intelektit*". Nga përmbajtja e veprës së Hasan Tahsinit "*Ilmi Ruh*" dallohet ndikimi i pikëpamjeve të Gotfrid Vilhelm Lajbnicit në trajtimin e strukturës së jetës psikike nga kapacitetet mendore. Veprat kryesore të tij janë: *Discours de Metaphisique"* – (*"Diskursi metafizik*", 1686)*; "Monadalogie"* – (*"Monadologjia",* 1714) etj.

LAJTMOTIV, - I. m. I ardhur nga gjermanishtja *leitmotiv* "motivi kryesor". Term i historisë së artit letrar e muzikor me theksime psikologjike të dalluara. Në fushën e krijimtarisë artistike lajtmotivi emërton shkakun kryesor, drejtimin e mendimit dhe cakun e tij të përshkruar, të shpjeguar dhe të theksuar, që përshkon gjithë veprën e krijuesit. Në vepra të këtilla cilësohen pothuajse vazhdimisht tiparet e sjelljeve, të një gjendjeje psikike etj. të një personaliteti të caktuar, i cili karakterizon personazhin e një opere apo operete, të një novele, romani etj. Shquhet krijimtaria e operave të Zhorzh Bizesë, "Plaku dhe Deti" i Ernest Hemingueit, novelat e Ismail Kadaresë etj.

LAKAN Zhak (**Jasques LACAN).** Psikiatër, psikanalist francez. Lindi në Paris më 14.04.1901 dhe vdiq në Paris më 9.09.1981). Qe një shpjegues i thellë i psikanalizës së Zigmund Frojdit në Francë, megjithëse jo i kuptueshëm për të gjithë lexuesit e studimeve të tij. Drejtues i Klinikës

së Psikiatrisë së Fakultetit të Mjekësisë në Paris. Ligjërues në klinikën e spitalit për sëmundje mendore "Ana e Shenjtë", si edhe në fakultetin juridik etj. Përkrahës i metodës psikanalitike dhe angazhimit të shërimit me anën e bashkëbisedimit dhe të analizës së fjalëve të thëna nga ana e pacientëve. Përvetësoi konceptet themelore të psikanalizës së Zigmund Frojdit: konceptin e të pavetëdijshmes, të seksualitetit, të bartjes, të shtypjes apo të ndrydhjes dhe të shtytësit. Në historinë e psikanalizës sistemi konceptual i Zhak Lakanit u quajt "*Llakanizëm*" që nga fillimi i gjysmës së dytë të shekullit të njëzet. Është themelues i Shkollës së Frojdizmit në Paris, kurse shumica e bashkëpunëtorëve të tij i bashkohet shoqatës "Association psychoanalytique de France" – "Shoqata Franceze e Psikanalizës", e pranuar në "International Psychoanalytical Association" – "Shoqata Ndërkombëtare Psikanalitike", e njohur me shkurtesën IPA. Në studimet psikanalitike të tij dallohet pikëpamja e tij për "fazat e pasqyrës", sipas së cilës fëmijët prej moshës 6 – 18 muaj e identifikojnë veten me formën (me geshtaltin) e të tjerëve. Ky do të ishte përkufizimi i parë i unit të tyre. Ndërkaq, në historinë e psikanalizës ka mbetur i njohur referati i tij me titull "Fonciton et champ de la parole et du langage en psychoanalyase" – "Funksioni dhe fusha e të folurit dhe e gjuhës në psikanalizë", të kumtuar në shtatorin e vitit 1953 në Kongresin e Psikanalizës në Romë. Zhak Llakan ka theksuar edhe rëndësinë dhe rolin e gjuhës në formimin e së pavetëdijshmes. Mbi këtë bazë ai ka theksuar edhe suksesin e metodës psikanalitike të mbështetur në asociacionet e lira. E pavetëdijshmja përkufizohet me anë të të folurit dhe gjuhës; kjo përfshin gjendjen aktuale dhe historinë e njeriut, gjendjen e vetëdijshme dhe të pavetëdijshme të tij. Veprat kryesore të tij janë: "*De la psychose paranoiaque dans ses rapports avec la personalite*" – (*"Psikoza paranoide dhe raporti i saj me personalitetin",* 1932); *"Les complexes familiaux"* – (*"Kompleksi familjar",* 1938); "*Ecrits"* – (*"Shkrime",* 1966); *"Mon Enseignement"* – (*"Mësimet e mia*"), 2005 (përkthyer dhe botuar në shqip, 2012).

LAKORJA E GAUSIT. Shpërndarje normale teorike e rezultateve të përftuara nga një numër jashtëzakonisht i madh i subjekteve, te të cilët është provuar një ndryshore psikologjike e caktuar. Kjo lakore është zbulim i matematikanit të njohur gjerman Karl F. Gaus (Carl F. Gauss, 1777 – 1855). Shih - ***SHPËRNDARJA NORMALE.***

LAKORJA E HARRESËS EBINGHAUS. Paraqitja grafike e procesit të harresës së një lënde të mësuar, të një lënde të pakuptimtë, përkatësisht e rrokjeve. Një proces i tillë është matur sipas njësive të metodës së kursimit në raport me intervale të caktuara kohore (orë), që e zbatoi me kujdes psikologu gjerman Herman Ebinghaus (Hermann Ebbighauz, 1850 - 1909). Sipas kësaj lakoreje tempi i harresës së lëndës së pakuptimtë qëndron në raport të zhdrejtë me kohën, sepse pas 20 minutash të ndërprerjes së të mësuarit të rrokjeve, individi ka harruar 42 % të listës së rrokjeve, pas 1 ore 50 %, pas 9 orësh 64 %, pas një dite 66 %, pas 2 ditësh 72 % dhe pas një jave, pikërisht pas 7 ditësh është harruar 79 % e lëndës së pakuptimtë që është

mësuar dhe përvetësuar mirë. Grafiku i harresës ndaj kohës së riprodhimit të lëndës së mësuar tregon zhvillim jolinear të procesit të harresës. Rezultatet e tilla janë paraqitur grafikisht sipas figurës së mëposhtme:



LAKORJA E RETENCIONIT EBINGHAUS. Paraqitja grafike e raportit ndërmjet kohës së përvetësimit të një listë rrokjesh në bazë të procesit të të mësuarit të tyre dhe sasisë së përqindjes së riprodhimit të tyre. Ndërsa në abshisë vihet njësia kohore (ora, dita, java etj.), në ordinatë vihet sasia ose përqindja e rrokjeve të riprodhuara pa gabim. Një lakore e tillë tregon se në fillim, pas përvetësimit të plotë të listës së rrokjeve, përkatësisht pas një ore, dite, jave etj., lakorja ulet shpejt, kurse më pas ulet, por me ngadalësi gjithnjë e më të madhe.

LAKORJA KUMULATIVE. Paraqitje grafike e rezultateve kumulative, kur këto rezultate janë rreshtuar nga më të voglat te ato më të mëdhatë, përkatësisht nga më të ulëtat deri te ato më të lartat. Lakorja kumulative konkretizon lidhjen funksionale ndërmjet atyre të dhënave dhe, kur shpërndarja e të dhënave është normale ajo merr formën e lakores f.

LARGËSIA GRUPORE. Shkalla e largimit të një grupi, nëngrupi a pjesëtari të atij grupi nga mjedisi social, nga grupi i madh dhe shkalla e largimit të një anëtari nga qëllimi, detyrat dhe intimiteti i raporteve ndërmjet anëtarëve të një grupi.

LARGËSIA PSIKOLOGJIKE. Në psikofizikë emërton largësinë fizike të një individi nga stimuli i caktuar dhe reflektimin e kësaj largësie në ndryshoren psikologjike që provohet. Në psikologjinë sociale emërton vështirësitë që paraqiten në raportet sociale ndërmjet një individi dhe një individi tjetër, ose të tjerëve. Në psikologjinë klinike ka të bëjë me nivelin e largësisë dhe të afërsisë ndërmjet klientit e psikologut klinik, si edhe me përmbajtjen e klientit për të shprehur emocionet në nivele të ndryshme të largësive ndërmjet tyre.

LARGËSIA SHOQËRORE. Niveli i largësisë sociale të ndjenjave dhe të qëndrimeve ndërmjet anëtarëve të një mjedisi social të caktuar. Largësia shoqërore shoqërohet nga ndryshimet ndijimore ndërmjet anëtarëve të një klase shoqërore, të një grupi ndaj një grupi tjetër, të një etnie ndaj një etnie tjetër etj. Largësia shoqërore hulumtohet me testin e afërsisë etnike, si pyetjet e këtij testi: a do të dëshironit të jetonit në një shtëpi me një zezak, apo të kishit një fqinj zezak në lagje, në qytet, në një shtet etj.

LARING, - U. m. term i ardhur nga latinishtja *larynx* "pjesë e sipërme e gabzherrit. Termi i anatomisë, që në psikologji fiziologjike përmendët për shkak se në pjesën e sipërme të gabzherrit gjenden kordhat e zërit, nga dridhja e të cilëve me anë të frymëmarrjes përfitohet zëri.

LEMNISKUSI MEDIAL. Në psikologjinë fiziologjike rruga nervore shumësinaptike që ngrihet nëpër formacionin retikular etj.

LESHLI Karl (**Karl LASHLEY**, **1890 – 1958**). Neuropsikolog amerikan, bashkëpunëtor i Xhon Uotsonit. Asistent, më pas profesor në Universitetin Minesoto, në Çikago dhe prej vitit 1935 profesor i neuropsikologjisë në Universitetin e Harvardit. Këtu doli në pension dhe njëkohësisht drejtoi Laboratorin Eksperimentues të Floridës, ku kreu gjurmime te kafshët (kryesisht me majmunë) për të konstatuar lidhjen e llojeve të sjelljeve me qendrat nervore. Ka shfrytëzuar metodat bashkëkohore neurokirurgjike, si: metodën e ekstirpacionit, të gërshetimit të funksioneve neurologjike në raport me format e të mësuarit. Rezultatet e këtyre gjurmimeve kanë treguar për funksionimin e trurit në tërësi gjatë të mësuarit, dhe jo aq për lidhjen e formave të të mësuarit me qendrat e caktuara neurologjike. Procesi i të mësuarit ka karakter të gjithanshëm, si edhe funksionimi i trurit në raport me format e të mësuarit. Me botimin e këtyre rezultateve, kryesisht në revista, pohohet se i ka dhënë shkas Ivan Pavllovit të botojë vështrimin kritik të ngutshëm me titull "*Përgjigjja e fiziologut psikologëve*", 1932. Vepra kryesore e tij është: *"Brain Mechanism and Intelligence: a Quantitative Study of Injuries to the Brain"* – (*"Mekanizmi i trurit dhe inteligjenca: studim kuantitativ mbi dëmtimin e trurit"*, Çikago, 1929).

LEVIN Kurt (**Kurt LEWIN**). Psikolog amerikan i ardhur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga Gjermania. Lindi në Mogilno (Posen) më 9.09.1890 dhe vdiq në Njuton (Newton) në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (Masaçusets) më 12.02.1947. Studioi në Universitetin e Berlinit dhe më pas u doktorua më 1914. Asistent për psikologjinë në Institutin për Teknologji të Masaçusetsit dhe profesor inordinar më 1926. Prej vitit 1933 iu përgjigj pozitivisht ftesës për të punuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke u shpërngulur nga Gjermania. Ka punuar në disa universitete si profesor i psikologjisë së fëmijëve, por më gjatë ka qëndruar në Universitetin shtetëror të Ajovas. Ishte themelues dhe drejtor i Qendrës për Dinamikën Grupore në Institutin për Tekonologji të Masaçusetsit. Përfaqësues eminent i psikologjisë geshtaltiste të Shkollës së Berlinit dhe një ndër themeluesit e psikologjisë topologjike. Në psikologjinë topologjike të Kurt Levinit dallojmë koncepte të reja, si fusha, hapësira, hapësira jetësore, tensioni etj. Dallojmë orvatje që sjelljen e njeriut ta paraqesë me terma gjeometrike. Për të sjellja është funksion i situatës, ku gjendet njeriu. Këtë e paraqet me formulën S = (f)S. Metodat gjurmuese të Kurt Levinit kishin të bënin me marrëdhënie dhe me raporte ndërpersonale; për këtë ai u bë i rëndësishëm edhe për zhvillimin e psikologjisë sociale. Veprat kryesore të tij janë: "*A Dynamic Theory of Personality"* – (*"Teoria dinamike e personalitetit"*, 1935); *"Principles of Topological Psychology"* – (*"Parimet e psikologjisë topologjike"*, 1936); *"Field Theory in Social Sciences"* – (*"Teoria e fushave në shkencat shoqërore"* - botime dorëshkrimesh gjatë viteve 1939 – 1947) etj.

LËVIZJA DELTA. Formë e lëvizjes së imagjinuar të trupave të jashtëm, sipas

së cilës, njeriut që percepton një trup i duket se pozita e trupit perceptues ndryshon sipas shkallës së ndryshimit të ndriçimit të atij trupi.

LIBIDO, - JA. f. Libidoja është energjia shtytëse e jetës seksuale të njeriut. Buron nga idi dhe zhvillohet në forma të veçanta gjatë jetës psikoseksuale të njeriut. Libidoja është term i konceptit psikanalitik, ku me vonë ka marrë domethënien e energjisë jetësore të njeriut. Sipas Zigmund Frojdit libidoja është uri por gjuha e zakonshme nuk ka shprehje që, për nevojën seksuale, do t'i përgjigjej me saktësi fjalës "Uri".

LIBIDO E OBJEKTIVUAR. Individi ose objekti ku përqendrohet libidoja e njeriut dhe investohet energjia e libidos, përkatësisht energjia e shtytësit të erosit. Në ndryshim nga libido narciztike, libido e objektivuar është e lidhur me një objekt të jashtëm, që mund të jetë një individ tjetër ose pjesë e trupit të tij. Termin e ka përdor Zigmund Frojdi (Sigmund Freud, 1856 – 1939) duke i dhënë kuptim të modifikuar shtytësve në studimet e mëvonshme.

LIBIDO NARCIZOIDE. Emërtim i asaj energjie të libidos që ka për objekt dashurie egon. Shih - ***EGO LIBIDOJA.***

Burimet:

Zigmund frojdi: "Teoria e libidos dhe narcizmi. Zhvendosja, Teoria analitike". Fan Noli, Tiranë, 2001. Zigmund Frojd: "Tri leksione mbi teorinë e seksualitetit", Fan Noli, Tiranë, 1997. Erich Fromm, ""Misioni i Zigmund Frojdit, Dituria, Tiranë, 2003. Pajazit Nushi: "Psikanaliza dhe mendimi psikologjik shqiptar", Libri Shkollor, Prishtinë, 2006.

LIGJET E ASOCIACIONEVE. Ligje që shpjegojnë lidhjet mendore ndërmjet përmbajtjeve të ndryshme. Tri janë të tillë: ligji i ngjashmërisë, i kontrastit dhe ligji i afërsisë kohore e hapësinore.

LIGJET STATISTIKORE. Lloj ligjesh psikologjike që shprehin lidhjen e përhershme dhe të qëndrueshme ndërmjet ndryshoreve të konceptit të probabilitetit. Sipas parimit të përgjithshëm të vlerësimit të këtyre ligjeve psikologjike, pohohet se ndryshorja A (ndjeshmëria e zërit) në kushtet C përcakton edhe vlerën e ndryshores B me shkallë të ndryshme të probabilitetit së paraqitjes së ndryshores B.

LIGJI BEL–MAZHAND. Rrënjët e prapme ose dorsale të nervave kurrizorë që përbëjnë fijezat nervore qendërprurëse ose aferente, përkatësisht sensorike, kurse rrënjët e përparme ose ventrale përbëjnë fijezat nervore qendërsjellëse apo eferente, përkatësisht motorike. Këtë ligj e ka zbuluar anatomisti skocez Çarls Bel (Charles Bell, 1774 – 1842) dhe fiziologu francez Fransua Mazhandi (François Magendie, 1783 – 1885).

LIGJI BIOGJENETIK. Supozimi se njeriu gjatë zhvillimit individual të tij përsërit ndryshimet kryesore morfologjike dhe funksionale nëpër të cilat ka kaluar i tërë njerëzimi gjatë zhvillimit evoluitiv. Një kuptim i tillë është shprehur me fjalët "Ontogjeneza është rikapitullim i shkurtër i filogjenezës". Ky ligj është formuluar nga mendimtari anglez Ernst Hekel (Ernst Haeckel, 1834 – 1911). Është konsideruar se një ligj i tillë vështirë se mund të pranohet, aq më tepër kur është vështirë të argumentohet plotësisht. Ligjin biogjenetik u përpoqën ta zbatojnë edhe në shpjegimin e zhvillimeve psikike. Kjo orvatje ka çuar deri në

formulimin e doktrinës rikapitulluese të jetës psikike. Psikologu amerikan Stenli Holl (Stanley Hall, 1844 – 1924) u orvat që këtë ligj ta zbatojë edhe në shpjegimin e zhvillimit të jetës psikike. Sipas tij jeta psikike e fëmijës është rikapitullim i zhvillimit psikik të gjinisë njerëzore. Por, kjo ngjashmëri ka arritur të argumentohet me vështirësi dhe prej formulimit të këtij ligji e deri më sot ka mbetur vetëm hipotezë**.**

LIGJI BUNSEN – ROKO. Ligj shpjegues i raportit prag absolut i të parit "zgjatje dhe intensitet i ngacmuesit". Sipas këtij ligji pragu absolut i ndjimit të të parit (sasia më e vogël e energjisë pamore të një ngacmuesi që është në gjendje të shkaktojë ndijim pamor) është produkt i zgjatjes dhe intensitetit të atij ngacmuesi. Ligji vlen për ngacmuesit që kanë ndikim kohor tepër të shkurtër, përkatësisht deri në 50 m/s. Ky ligj i identifikua nga: kimisti gjerman Robert V. Bunsen (Robert W. Bünsen, 1811 – 1899) dhe kimisti anglez Henri E. Roko (Henry E. Rocoe, 1833 – 1915).

LIGJI EMPIRIK. Tërësi e qëndrueshme konceptesh, rregullash e parimesh të nxjerra nga hulumtimi i përvojës në një fushë të caktuar studimore dhe të mbështetura në përvojë. Në psikologji me këtë emërtim përcaktohet ligji i efektit të psikologut Eduard Torndajk (Edward Thorndike, 1874 – 1949). Sipas ligjit të efektit, përforcimi i një reagimi me stimuj të këndshëm, të pëlqyeshëm për subjektin e ngre në një nivel më të lartë besimin se ai reagim do të ketë dendësi (frekuencë) më të madhe në sjelljet e një individi.

LIGJI FIT. Përcaktuesi i raportit ndërmjet shpejtësisë së lëvizjeve dhe largësisë e saktësisë së tyre. Ligji Fit shprehet me formulën:

$$T = a + b\log_2(2\frac{L}{M})$$

ku T është shpejtësia e lëvizjes së njeriut, a dhe b janë konstante, L është largësia dhe M është madhësia– gjerësia e objektivit me të cilin përfundon lëvizja.

LIGJI HORNER. Ligj gjenetik i zbuluar nga oftalmologu zviceran Johann F. Horner, 1831 – 1886). Sipas këtij ligji verbimi për ngjyrën e kuqe dhe atë të gjelbër ka bazë hereditare dhe bartet nga një mashkull në një mashkull tjetër të të njëjtit prind nëpërmjet nënës, e cila nuk i nënshtrohet këtij lloj verbimi. Shih **– *DALTONIZMI.***

LIGJI I FEHNERIT. Ligj i psikofizikës, i formuluar nga fizikani, psikologu dhe mistiku gjerman Gustav T. Fehner (Gustav Th. Fechner, 1801 – 1887). Sipas këtij ligji intensiteti i ndijimit rritet bashkërisht me intensitetin e ngacmuesit, por rritja e intensitetit të ndijimit është në raport logaritmik me intensitetin e ngacmuesit, d.m.th. derisa intensiteti i ngacmuesit rritet në progresion gjeometrik intensiteti i ndijimit rritet në progresion aritmetik. Ligji i Fehnerit shprehet me formulën Ψ "k log e IN ngc., ku Ψ "intensiteti i ndijimit, k "konstante, IN ngc. "intensiteti i ngacmuesit". Ligji i Fehnerit mbështetet në rezultatet e hershme të Ernst H. Veberit (Ernst H. Weber, 1795 – 1878) dhe është në thelb zgjerim i raportit intensitet i ndijimit ndaj intensitetit të ngacmuesit të E. Veberit. Për këtë shkak emërtohet ligji i Veber–Fehnerit.

LIGJI I MARBES. Ligj i psikologut gjerman Karl Marbe (Karl Marbe, 1869 – 1953), që shpjegon raportin ndërmjet shpejtësisë së bashkimit të fjalëve dhe shpeshtësisë së paraqitjes së fjalës ngacmuese, kur kërkohet nga subjekti që fjalën e dëgjuar ta bashkojë sa më shpejt me fjalën e parë që i bie në mend. Sipas këtij ligji, shpejtësia e bashkimit të lirë të fjalëve varet nga shpeshtësia e asaj fjale në leksikun e një gjuhe të caktuar, përkatësisht, koha e përgjigjes ndaj fjalës së dëgjuar me fjalën e parë që i bie në mend individit është aq më e shkurtër, sa më shpesh përdoret ajo fjalë.

LIGJI RIBÓ. Rrënimi progresiv i kujtesës sipas rendit prej rrënimit, harresës, humbjes së informacioneve e lidhjeve të tyre, prej rrënimit të kujtimeve të freskëta, të reja kah ato më të vjetrat, të cilat janë më pak të prekura nga harresa. Kujtimet nga jeta e fëmijëve e rinia janë të kursyera nga një rrënim i tillë; pleqtë i mbajnë mend shumë mirë ngjarjet nga jeta e hershme, por nuk janë në gjendje t`i mbajnë mend ngjarjet e kohës së tyre. Psikologu francez Teodil Ribó (Theodule A. Ribot, 1839 – 1916) e ka formuluar këtë ligj në veprën e njohur të tij "Sëmundjet e Kujtesës" të botuar në frëngjisht më 1888, duke shfrytëzuar edhe rezultatet e neurologut anglez Xhon H. Xhekson (John H. Jackson, 1835 – 1911).

LIGJI RIKO. Ligj i psikologjisë fiziologjike sipas të cilit sipërfaqet e vogla të retinës apo rrjetës së syrit kanë prag absolut të ndjeshmërisë në raport proporcional të kundërt me sipërfaqen e retinës. Ligji Riko vlen edhe për pragun absolut të sipërfaqes së lëkurës. U emërtua sipas astronomit italian Anibele Riko (Annibele Ricco, 1844 – 1919).

LIGJI SINDROMATIK I SJELLJEVE. Sjellje të ndërlidhura të personalitetit që paraqiten në formë ligji, por nuk kanë karakter të ndërlidhjes shkakore. Ky term haset më tepër në psikopatologji dhe në psikologjinë klinike. I këtillë është grupi i tipareve të sjelljeve karakteristike për sindromën e karakterit anal - kokëfortësia, kursimi dhe pedanteria.

LIGJI XHEKSON. Ligj sipas të cilit në procesin e rrënimit të funksioneve psikike dhe të bazës neurologjike të tyre, në fillim rrënohen funksionet e larta psikike, përkatësisht ato që janë zhvilluar dhe formuar më vonë, kurse të tjerat, pikërisht ato që janë zhvilluar dhe formuar herët i rezistojnë rrënimit, sepse kanë arritur të stabilizohen. Ky proces i rrënimit është i njohur me termin *disolucioni Xhekson*. Këtij ligji i atribuohen edhe sëmundjet e emocioneve, të kujtesës, të vëmendjes e të vullnetit.

LIPS Teodor (**Theodor LIPPS**). Filozof dhe psikolog gjerman. Lindi në Vallhalben (Pfals) më 28.07.1914 dhe vdiq në Munih më 17.10.1914. Qenien e filozofisë dhe të disiplinave të tjera e mbështeti në psikologji. Sipas tij "*Përvoja e brendshme krijon themelin e të gjitha shkencave shpirtërore, pra edhe të logjikës e estetikës*". Për këtë shkak psikologjia është baza e të gjitha shkencave të tjera, sepse realiteti njihet me anën e proceseve psikike. U mor posaçërisht me njohjen e ndjeshmërisë së të bukurës. Hulumtoi llojet e ndryshme të

ndjeshmërisë së të bukurës dhe ka mbrojtur teorinë e përjetimit të së bukurës ("Einfühlung"), ku u dallua koncepti kryesor i pikëpamjeve të tij për psikologjizmin edhe në estetikë. Veprat kryesore të Teodor Lipsit janë: "*Psychologischen Studien"* – (*"Studime psikologjike",* 1885); "*Von Fühlen, Wollen und Dencken"* – (*"Mbi ndjenjat, vullnetin dhe mendimin*", 1902); "*Einfuhlung als Quelle der ästhetischen Lust"* – (*"Ndjeshmëria estetike si burim i kënaqësisë",* 1903/06).

LOBUSI OKSIPITAL. I ardhur nga latinishtja *lobus occipitalis* "lobul, pjesëz zverkore e trurit". Term i anatomisë së sistemit nervor, përkatësisht i trurit. Në këtë lobul gjendet fusha e posaçme e trurit, ku përpunohen impulset nervore që bartin informacione të të parit, të cilat vijnë nga receptorët pamorë.

LODHJA KRONIKE. Lodhje që nuk është rezultat i humbjes së energjisë për punë dhe as nuk largohet me anë të pushimit, pikërisht me anë të gjumit. Lodhja kronike ka të bëjë me disa çrregullime të proceseve kognitive: rënie dhe mungesë përqendrimi të vëmendjes, probleme të ndryshme me të mësuarit, me kujtesën dhe me proceset e saj etj.

LOK Xhon (John LOCK). Filozof, mjek dhe psikolog anglez me ndikim edhe në disa disiplina të tjera, veçanërisht në pedagogji. Lindi në Vrington afër Bristolit më 29.08.1632 dhe vdiq në Oatestu më 28.10.1704. Përfaqësues i empirizmit dhe i sensualizmit në filozofi. Ushtroi ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e psikologjisë së njohjes, sot, psikologjia kognitive. Konsiderohet themelues i doktrinës së asociacionizmit në psikologji. Sipas tij asnjë ide nuk është e lindur, por të gjitha janë produkt i njohjes së realitetit në bazë të përvojës së njeriut. Këtë e dallojmë në pohimin e njohur të tij: "*Nihil est in intellectu quod antea non fuerit sensu*" – "*Asgjë nuk është në intelekt pa qenë më parë në shqisa*". Intelekti sipas tij me lindjen e fëmijës është "*Tabulae rasae*" – "*Tabelë e zbrazët*". Kjo pikëpamje e Xhon Lokut ka ushtruar ndikim në zhvillimin e mendimit psikologjik të disa drejtimeve apo shkollave psikologjike të gjysmës së dytë të shekullit XIX. Ai dalloi dy lloje përvojash: përvojën shqisore dhe atë të mendimit. Përvoja shqisore arrihet nëpërmjet shqisave; kjo është baza e dijeve, e sistemit të ideve, burim i ideve dhe i të kuptuarit të së vërtetës. Por, ide krijon edhe vetëdija e njeriut me anë të procesit të mendimit. Ai dalloi gjithashtu dy lloje idesh: ide të thjeshta dhe të ndërlikuara; idetë e thjeshta merren nga ana e njeriut në mënyrë pasive dhe nuk kanë mundësi të zbërthehen, kurse idetë e ndërlikuara janë produkt i mendjes së njeriut. Idetë e thjeshta janë dyfarëshe: 1. Idetë e thjeshta ose përfytyrimet, që burojnë nga një shqisë e periferisë së trupit të njeriut, dhe 2. Idetë që burojnë nga dy ose më shumë shqisa. Idetë e ndërlikuara janë idetë e të menduarit dhe të vullnetit dhe idetë që prodhohen nga të perceptuarit e jashtëm dhe të brendshëm. Por, mbi të gjitha është arsyeja: "Arsyeja apo mendja duhet të jetë gjykatës dhe udhëheqës i gjithçkaje". Sipas Xhon Lokut e tërë jeta psikike e njeriut formohet nga idetë shqisore dhe nga kombinimi i tyre; vetëdija e njeriut mbështetet në ide dhe këto janë si atomet në fizikë. Idetë e

tilla kanë cilësi parësore dhe dytësore. Cilësitë pasuese të ideve janë produkte të shqisave, kurse ato dytësore janë produkte të procesit të mendimit. Por, pikëpamja kryesore e tij ka mbetur e pandryshueshme: dija e njeriut mbështetet në përvojën e tij. Xhon Loku i ka kushtuar kujdes të veçantë edukatës së njeriut. Sipas tij, edukuesi duhet të niset nga karakteristikat individuale të të edukuarve dhe të krijojë një sistem virtytesh mbi bazën e përvojës së tij dhe të lidhjeve ndërmjet ideve për një sjellje të mirë. Veprat kryesore të Xhon Lokut janë: *"An Essay Concerning Human Understanding"* – (*"Shqyrtim i arsyes njerëzore",* 1690); *"Two Treatises of Government"* – (*"Dy trajtime mbi udhëheqjen"*, 1690).

LOMBROZO Cezare (**Cesare LOMBROSO**). Mjek dhe kriminalist italian. Lindi në Veronë të Italisë më 18.11.1836 dhe vdiq në Turin më 19.10,1909. U mor me studimin e sjelljeve kriminale dhe të natyrës së njerëzve kriminalë. Është konceptues i një teorie social-antropologjike për kriminelët, sipas së cilës: tiparet e krimit te kriminelët kanë bazë atavizmi, pra tiparet e tilla janë të lindura. Këtë teori e mbështeti në matjet antropologjike e psikologjike të të rriturve normalë dhe kriminelëve dhe mbi ndryshimet e konstatuara arriti në përfundim se tipi i njeriut kriminel është i lindur. Teoria e tij nuk ka gjetur përkrahje, por, teoria e tij është e para teori që studion origjinën e krimit e të kriminelëve. Madje, Cezare Lombrozo ka kërkuar angazhimin e të gjithëve për një trajtim human të kriminelëve. U mor edhe me studimin e shkaqeve të gjenialitetit, duke nxjerrë përfundimin se njerëzit gjenialë janë të ngjashëm me të sëmurët psikikë. Po ashtu ka studiuar edhe deformimet e tjera sociopatologjike (shkaqet e prostitucionit, kretinizmin, pelagrën etj.). Veprat kryesore të Cezare Lombrozos janë: *"L`uomo delinquent in rapport all` antropologia, giurisprudenza e disciplina carceraria"* – (*"Njeriu delikuent përballë antropologjisë, shkencave juridike dhe disiplinës së burgut",* 18760); *"Genie und Irrsin"* – *"Gjenia dhe marrëzia*", 1887) etj.

LORENC Konrad (**Konrad LORENZ**). Zoolog-etolog dhe psikolog austriako-gjerman. Lindi në Vjenë më 17.02.1903 dhe vdiq në Altenberg pranë Danubit më 28.02.1989. Një ndër themeluesit e etologjisë. Studioi mjekësi në Universitetin e Kolumbias të Nju Jorkut; u doktorua në Universitetin e Vjenës për zoologji, dhe dha mësim në lëndët psikologjia e kafshëve dhe anatomia krahasuese. Në vitin 1940 u caktua profesor i psikologjisë krahasuese dhe drejtor i Departamentit të Psikologjisë në Universitetin e Kënigsbergut; prej vitit 1951 drejtor i Qendrës për Fiziologjinë e Sjelljeve pranë Institutit "Maks–Plank", kurse prej vitit 1973 drejtues i departamentit të sociologjisë së kafshëve pranë Akademisë së Shkencave të Austrisë , Vjenë. Në studimet e tij ka zbatuar metodat e etologjisë objektive. Qëllimi i këtyre studimeve ishte "njohja e sjelljeve të kafshëve për të depërtuar në thellësinë e sjelljeve të njerëzve". Fitues i "Çmimit Nobel" me etologët Karl fon Frish dhe Nikola Tinbergen, me të cilët hulumtoi formimin dhe manifestimin e modeleve të sjelljeve individuale dhe sociale te kafshët. Në historinë e mendimit shkencor mbeti i njohur me pikëpamjen e tij për

instinktet, që i konsideronte "veprime të programuara të organizmit dhe bazë e koordinuar e aktivitetit trashëgues". Këto veprime zhvillohen në bazë të pjekurisë individuale të organizmit dhe nuk janë produkt i procesit të të mësuarit. Në ndryshim nga pikëpamja e Mek Dugalit për instinktet Konrad Lorenci identifikoi tri lloj instinktesh: instinktin e të ushqyerit, të të shumuarit dhe instinktin e agresivitetit. Sipas tij instinkti i agresivitetit te kafshët kryen tri funksione: 1) luftën për shtrirje të barabartë të kafshëve të të njëjtit lloj në hapësirën biologjike, 2) përzgjedhjen e më të fortit në luftën për ekzistencë dhe 3) mbrojtjen e pasardhësve. Ai ka merita të posaçme për zhvillimin e mjekësisë psikosomatike, ku dëshmon se konfliktet në mjedisin social shpien "jo vetëm në sjellje jonormale, por edhe në sëmundje të vërteta, si: ngritja e presionit të gjakut dhe infarkti". Veprat kryesore të Konrad Lorencit janë: *"Das sogenante Böse"* – (*"Mbi të ashquajturën të keqe",* 1963); *"Über tierisches und menschliches Verhalten"* – (*"Mbi sjelljen e kafshëve dhe të njerëzve"*, 1964/65); "*Vorgleichende Verhaltenforschung"* – (*"Gjurmime krahasuese të sjelljeve",* 1978) etj.

"LUFTO OSE LARGOHU". Reagim i lindur i organizmit të kafshëve dhe njerëzve, që shfaqet kur këta ballafaqohen me situata të rrezikshme, siç është rasti i ballafaqimit të maces me qenin, i njeriut të sulmuar papritmas, i atij që befas ballafaqohet me një armik të armatosur etj. Zakonisht reagimi i këtillë shfaqet te njeriu, kur ky e percepton situatën e rrezikshme në çastin e caktuar dhe nuk i mbetet tjetër veçse të luftojë kundër atyre që kanë shkaktuar një situatë të tillë ose të largohet nga kjo situatë. Situatat e rrezikshme dhe perceptimi tyre shkakton te njeriu disa ndryshime fiziologjike, ndër të cilat dallohen: orientimi i kokës dhe i organeve shqisore në drejtim të burimit të rrezikut, përshpejtimi i pulsit, i rrahjes së zemrës, i rritjes së presionit të gjakut, i zgjerimit të bebes së syrit, i rritjes së muskulaturës dhe përgjithësisht i përgatitjes së organizmit për veprim. Ndaj situatave të rrezikshme pjesëtarët e fiseve primitive reagojnë me formën "lufto ose largohu", ndërkaq në mjediset e civilizuara qytetarët reagojnë me forma sjelljesh të kultivuara, pa rrezikuar qenien e tyre dhe as të të tjerëve, por, sipas rezultateve të disa hulumtuesve, situata të tilla të shpeshta kanë pasoja negative në shëndetin e tyre, sepse shkaktohen nga disa çrregullime psikosomatike.

LUMTURI, - A. f. Gjendje e ndërlikuar psikike dhe relativisht e qëndrueshme e mirëqenies, e mirënjohjes dhe e altruizmit. Në fillim të zhvillimit të psikologjisë lumturia përcaktohej si ndjenjë e lidhur me kënaqësinë e madhe të njeriut. Ajo është përjetim i asaj gjendjeje psikike, kur njeriu arrin t`i plotësojë aspiratat, nevojat, dëshirat dhe synimet e kuptimësisë së jetës. Lumturinë e përjeton i varfri ashtu edhe i pasuri, njeriu i lirë si dhe i burgosuri, i riu ose e reja, dhe plaku ose plaka etj. Lumturia ka dimension personal: për altruistin është bamirësia që altruisti u bën të tjerëve, për besimtarin është besimi në Zot dhe në jetën tjetër pas vdekjes; për disa lumturia është të jesh i pasur, kurse amerikanëve të pasur pasuria nuk u ka sjellë lumturi etj. Lumturia përjetohet kolektivisht

dhe varet nga besimi, bindja e njeriut e nga botëkuptimi i tij. Gjendja e lumturisë te njeriu gjurmohet me anë të metodës impresive dhe ekspresive. Në psikologjinë sociale dhe në psikologjinë e personalitetit lumturia është interpretuar në forma të ndryshme: për mendimtarin Nikollai Hartman (Nicola Hartmann, 1882 – 1950) ajo i përket formës së veçantë të qenies shpirtërore të njeriut; për Erik Fromin (Erich Fromm, 1900 – 1980) kultura e papërshtatshme e mjedisit të njeriut është shkaktare e mungesës së lumturisë, madje edhe shkaktare e sëmundjeve shpirtërore, për psikologjinë e Abraham Maslout (Abraham Maslow, 1908 – 1970) lumturia është shfaqje e shkallës së lartë të vetaktualizimit të qenies së njeriut etj. Është një term i vështirë për t`a përkufizuar saktësisht si koncept.

Burimet:

Stefano Bartolini: "*Manifest për lumturinë – Si të kalohet nga shoqëria e kamjes në atë të mirëqenies*", Tiranë, 2014.

Abraham H. Maslow: "*Drejt psikologjisë së mirëqenies*", Tiranë, 2008.

Erich Fromm: "*Ikja nga liria*", Prishtinë, 1982.

LL

LLOJET E AFAZISË. Dallohen dy lloje apo forma kryesore të afazisë. Llojet e tilla u klasifikuan sipas lëndimit të pjesëve të caktuara të cipës së trurit të madh të cilat janë: afazia e përgjithshme – humbje e tërësishme e aftësisë së të folurit dhe afazia e pjesshme e ndarë në dy forma: në afazi sensorike dhe afazi motorike. Afazia e plotë është pasojë e lëndimit të fushës së cipës së trurit të madh, të njohur me emërtimin fusha Vernik dhe fusha Brok, si edhe e lidhjeve funksionale ndërmjet tyre. Afazia sensorike është humbje e aftësisë së të kuptuarit të fjalëve dhe të kuptimit së tyre. Ndjeshmëria e zërit është e padëmtuar, por paraqiten pengesa në kuptimin e fjalëve dhe në artikulimin e tyre. Kjo afazi është pasojë e lëndimit të fushës së cipës së trurit, e njohur me emërtimin fusha e Vernikut, përkatësisht e neurologut gjerman Karl Vernik (Carl Wernicke, 1848 – 1905). Afazia motorike është një lloj afazie që ka këto karakteristika: pamundësinë e artikulimit, e fonetizimit të fjalëve dhe fjalive, megjithëse lëvizja e buzëve dhe e gjuhës është e padëmtuar, po ashtu është e ruajtur dhe e padëmtuar aftësia e kuptimit të fjalëve dhe fjalive. Kjo lloj afazie është pasojë e lëndimit të fushës së cipës së trurit, e emëruar zonës së Brokit, pikërisht zona e mjekut, fiziologut dhe kirurgut francez Pol Brok (Paul Broca, 1824 – 1880). Shih – ***ZONA BROK.***

LLOJET E AFTËSIVE. Dallohen këto lloj aftësish: ***intelektuale; mekanike; profesionale; specifike; motorike; parësore mendore; sensorike; shqisore*** – shih. Aftësitë intelektuale ose mendore kanë të bëjnë me njohjen e lehtë dhe të shpejtë të raporteve esenciale në zgjidhjen e problemeve të ndërlikuara në fushëveprimin teorik dhe praktik të njeriut. Aftësitë mekanike i përkasin gatishmërisë së kuptimit të shpejtë dhe të lehtë të parimeve mekanike dhe zbatimit të drejtë të tyre në zgjidhjen e problemeve dhe të situatave problemore mekanike në fushën e makinerisë, të fizikës mekanike etj. Aftësitë profesionale lidhen me gatishmërinë e një individi për të kryer me sukses

punën në profesionin e tij. Aftësitë specifike përfshijnë çdo aftësi të njeriut për kryerjen e lehtë dhe të shpejtë të detyrave të një lloji të caktuar. Aftësitë motorike janë gatishmëri për punë të sukseshme fizike e mendore, që shfaqen në zhdërvjellëshmërinë, në shpejtësinë, në saktësinë e ekuilibruar e të koordinuar të lëvizjeve të organeve të trupit të njeriut. Aftësitë parësore mendore përbëjnë një tërësi aftësish themelore që mundësojnë sukses në zgjidhjen e shpejtë e të lehtë të detyrave intelektuale. Aftësitë sensorike përcaktojnë gatishmërinë dhe suksesin e individit në dallimin e lehtë dhe të shpejtë të intensitetit të ngacmuesve të ndryshëm dhe në dallimin e ndryshimeve të hollësishme ndërmjet tyre. Aftësitë shqisore janë aftësitë e ndijimeve dhe të perceptimeve të mbështetura në funksionimin e sistemit shqisor Identifikimi i aftësive intelektuale, motorike dhe sensorike bazohet në zbatimin e metodës së analizës faktoriale.

LLOJET E AGNOZISË. Agnozia pamore apo vizive, dëgjimore apo akustike, nuhatore apo olfaktore, e shijes dhe e prekjes. Ndarja e tillë i atribuohet lëndimit të qendrave përkatëse të ndijimeve dhe të funksionit të fushave dytësore nervore të tyre. Agnozia pamore ka të bëjë me pamundësinë e njohjes së objekteve në bazë të të dhënave apo informacioneve pamore. Agnozia dëgjimore ka të bëjë me pamundësinë e njohjes së objekteve dhe përmbajtjeve sipas informacioneve të tipit zanor. Agnozia taktile i përket mosnjohjes së objekteve nga ana e të dhënave dhe informacioneve të receptorëve të lëkurës për prekje etj.

LLOJET E AGRESIONIT. Veprimtaria agresive e individit shfaqet në këto forma kryesore: Agresioni armiqësor që ka për qëllim asgjësimin e armikut; agresioni instrumental–mjet për arritur te ushqimi, te pushtimi i territorit ose te lirimi i tij, në mbrojtje të pasardhësve etj. Agresioni i drejtpërdrejtë është veprimi i drejtuar në objektin armiqësor dhe agresioni i drejtuar në asgjësimin e një objekti tjetër, që zëvendëson objektin e drejtpërdrejtë të armiqësisë. Lloj i veçantë i agresionit është agresioni altruist, i shfaqur në mbrojtjen e të pafuqishmëve. Këtij grupi të agresionit i përket edhe agresioni amënor - sulmet e nënës për t`i mbrojtur pasardhësit e pafuqishëm të saj. Format e shumëllojshme të manifestimit të agresionit (thumbimi me fjalë, satira, të qeshurit nën sy etj. janë rezultat i socializimit, përkatësisht i të mësuarit të individit si ta shfaqë agresionin e tij.

LLOJET E AMNEZISË. Humbja e aftësisë së të mbajturit mend dhe e riprodhimit të përmbajtjeve të përjetuara është disa llojesh. Ndër to dallohen: 1) Amnezia anterograde; 2) Amnezia retrograde; 3) Amnezia organike; 4) Amnezia psikogjene dhe 5) Amnezia progresive. Amnezia anterograde është pamundësia e të kujtuarit të gjithë asaj çfarë ka ndodhur pas traumës, ndërkaq përmbajtjet e mëparshme janë të ruajtura dhe pothuaj të paprekura. Shkaktohet nga lëndimi i pjesës së mesme të cipës parietale ose tepore të trurit të madh. Amnezia retrograde është pamundësia e të kujtuarit të të gjitha ngjarjeve që i kanë paraprirë traumës dhe kanë shkaktuar amnezinë. Në rastin e amnezisë

retrograde njeriu është i paaftë të rikujtojë me hollësi çfarë ka qenë shtresuar në kujtesë nga e kaluara e tij. Amnezia organike shkaktohet nga lëndimi organik i trurit dhe kjo lloj amnezie tërheq pas vetes humbjen e gjithë asaj çfarë ka ngjarë brenda një periudhe kohore të caktuar. Në rastin e amnezisë organike shfaqen edhe çrregullime fiziologjike. Kësaj lloj amnezie i përket amnezia e pjesës parietale ose tepore të trurit, ku janë të vendosura strukturat e hipokampusit, të amigdalës etj. Amnezia e pjesës tepore apo temporale godet keq kujtesën afatgjatë. Amnezia psikogjene shkaktohet së pari nga përjetimet e rënda emocionale që çojnë në pamundësinë e rikujtimit të ngjarjeve të një kategorie të caktuar. Amnezia psikogjene ka karakter funksional. Amnezia progresive është shtrirje graduale e amnezisë duke përfshirë gjithnjë e më tepër përmbajtjet e kujtesës nga jeta dhe aktiviteti i njeriut.

LLOJET E ASOCIACIONEVE. Llojet kryesore të asociacioneve janë dy: asociacionet e kontrolluara dhe asociacionet e lira. Asociacionet e kontrolluara kanë të bëjnë me procedurën e marrjes së përgjigjes së saktë për relacionet e koncepteve, si: *koncepti i përgjithshëm* shpendë shtëpiakë – pula, *fjala sinonimike* përfytyrim "shëmbëllim, *antonimike* miqësi – armiqësi etj. Zbatohet më tepër në hulumtimin e procesit të të menduarit. Asociacionet e lira janë formë e asociacioneve që u zbatuan në metodën psikanalitike. Pacienti rrëfen përmbajtjet e veta në formën e lirë, përkatësisht paraqet një gërshetë idesh e përjetimesh ndër më të ndryshmet. Kështu, në testin prej 100 fjalësh pacienti përgjigjet ndaj fjalës së caktuar me fjalën e parë që i bie ndër mend. Përgjigjet dhe paraqitjet e tilla nuk janë krejtësisht të lira, sepse këto janë nën ndikimin e përmbajtjeve të vetëdijshme dhe të atyre të pavetëdijshme. Pacienti i shpreh mendimet e përjetimet e veta ashtu siç atij i vinë, pa marrë parasysh a janë të dhembshme, të papranuara, të ndaluara në pikëpamje etike etj. Psikanalisti ka për detyrë të analizojë deklaratat e pacientit dhe të konstatojë "fokusin" e përmbajtjeve që shkaktojnë parregullsi në sjelljet e tij, për këtë duhet ta bëjë pacientin të vetëdijshëm dhe kështu ta lirojë nga ngarkesa e madhe psikike negative e tij.

LLOJET E DETYRAVE TESTORE. Lloje detyrash që kanë të bëjnë me format dhe mënyrat e përcaktimit dhe të formulimit të drejtë të detyrave dhe problemave të testeve. Këto mund të jenë detyra dhe problema, për të cilat individi jep përgjigje, pra zgjidh problemat e parashtruara në test, në të cilin, nga përgjigjet apo zgjidhjet e dhëna, subjekti zgjedh atë që mendon se është e saktë, pra zgjidhjen e duhur të problemit të parashtruar. Në këtë pikëpamje detyrat dhe problemat testore mund të jenë të tipit krahasues, të zgjedhjes së përgjigjes ndër dy apo tri propozimeve, të tipit klasifikues etj.

LLOJET E NEURONEVE. Neuronet ndahen sipas funksionit që kryejnë dhe sipas formës anatomike të tyre. Sipas funksionit dallojmë dy lloje neuronesh:

a. **Neurone aferente** – Neurone që janë bartëse të impulseve nervore nga organet shqisore të organizmit drejt palcës kurrizore dhe në qendrat përkatëse të trurit, ku impulset nervore shndërrohen

në imazhe psikike të caktuara (dëgjimore, nuhatore, pamore etj.);

b. **Neurone eferente** – Neurone që janë bartëse të impulseve nervore nga qendrat e trurit kah palca kurrizore në muskuj dhe në gjëndra dhe i vënë këto në veprim. Neuronet eferente emërtohen edhe neurone motorike;

c. **Neuronet e tipit Golxh 1 –** Tip i veçantë i qelizës nervore, që e karakterizon aksona e gjatë. Degët e këtyre qelizave nervore hapin rrugën hyrëse e dalëse nga palca kurrizore duke lidhur në këtë mënyrë qelizat nervore të Sistemit Nervor Qendror me strukturat e ndryshme të periferisë së trupit të njeriut;

d. **Neuronet e tipit Golxh 2 –** Qeliza nervore me aksone të shkurtër. Këto qeliza lidhin strukturat e veçanta të qelizave nervore me strukturat e qelizave të afërta nervore të Sistemit Nervor Qendror.

LLOJET E NGJYRAVE. Në psikofizikë dhe në psikofiziologji dallohen disa lloje ngjyrash, të cilat janë:

a. **Ngjyrat akromatike** - ngjyra e bardhë dhe e zezë, si edhe të gjitha nuancat që gjenden në mes të bardhës dhe të zezës;

b. **Ngjyrat kromatike** – Ngjyra e gjelbër, e kaltër, e kuqe dhe e verdhë dhe nuancat që gjenden në mes të këtyre ngjyrave. Ngjyrat kromatike i duken vëzhguesit si ngjyra të pastra, e jo ngjyra të përziera. Sot flitet edhe për tri ngjyra kryesore kromatike: ngjyra e gjelbër, e kuqe dhe kaltër, kurse të tjerat janë përzierje valësh elektromagnetike, Shih - ***TEORIA JANG–HELMHOLC.*** Ngjyrat kromatike emërtohen edhe si ngjyra themelore, apo ngjyra parësore;

c. **Ngjyrat neutrale** – Çifte ngjyrash kromatike, nga përzierja e valëve elektromagnetike e të cilave përftohet ngjyra akromatike me ton mesatar;

d. **Ngjyrat komplementare** – Çifte ngjyrash kromatike, nga përzierja e të cilave përftohet ngjyra akromatike. Çifte të tilla kanë: e kuqja – e gjelbra, e verdha – e kaltra.

e. **Ngjyra spektrale** – Ngjyra që përftohen nga zbërthimi i dritës kur ajo kalon nëpër një prizëm; në këtë rast përfitohet brezi i ngjyrave të ylberit. Ky term emërton edhe mbisundimin e valëve elektromagnetike të një ngjyre ndaj ngjyrave të tjera.

LLOJET E NXITËSVE. Nxitësit e organizmit të njeriut ose të organeve të tij janë të shumëllojshëm. Ndër ta dallojmë:

a. **Nxitës të brendshëm –** Gjendje specifike e organizmit të njeriut që nxit ndryshime organike e psikike, duke shkaktuar ndryshim të gjendjes së tij, përkatësisht ndërmarrje sjelljesh për ta ndryshuar këtë gjendje;

b. **Nxitës dytësorë –** Objekte, situata, veprime etj. ose cilësi të tyre që janë në gjendje të nxisin ndryshime në veprimin e tyre; këta rrjedhin nga nxitësit parësorë dhe janë mësuar me lidhje ndërmjet tyre;

c. **Nxitës të jashtëm –** Veprues fizikokimikë në organizëm që shkaktojnë ndryshim të sjelljes së tij;

d. **Nxitës parësorë –** Objekte, situata, veprime adekuate, që me veprimin e tyre në organizmin e njeriut janë në gjendje të shkaktojnë ndryshime në sjelljet e tij.

LLOJET E PËRFYTYRIMEVE. Përfytyrimet janë të lidhura me burimin perceptor të tyre, përkatësisht me

karakterin shqisor të perceptimeve. Nga kjo pikënisje dallojmë këto lloj përfytyrimesh:

a. **Përfytyrime dëgjimore** – Riprodhim tonesh e kombinim i tyre të perceptuara më parë me anë të shqisës së dëgjimit;

b. **Përfytyrime imagjinare** – Përfytyrim i krijuar nga imagjinata, duke ndërlidhur pjesë të përmbajtjeve të ndryshme në një tërësi figurative të posaçme;

c. **Përfytyrime të kujtesës** – Mbajtje mend dhe riprodhim figurash pamore, burimesh tingullore, lëvizore etj.;

d. **Përfytyrime lëvizore** – Figurë mendore riprodhuese e lëvizjes së trupit dhe e pjesëve të tij, në rend të parë e gjymtyrëve, që kanë për bazë shqisën muskularo-motorike;

e. **Përfytyrime pamore** – Figura objektesh, dukurish, situatash etj., që lindin si pasojë e ndikimit të perceptimeve të shqisës së të parit.

LLOJET E QËNDRIMEVE. Sipas strukturës së përmbajtjes të tyre dallohen disa lloj qëndrimesh:

a. **Qëndrimi abstrakt**. Qëndrim i pastabilizuar, të cilin njeriu e ndryshon sipas rrethanave. Njeriu me qëndrim abstrakt herë kalon nga një përbërës, anë, formë etj. e një objekti, dukurie, situate etj. në tërësinë konkrete të tyre dhe herë vepron në të kundërtën. Qëndrimi abstrakt shpesh nuk shoqërohet me veprimtari konkrete;

b. **Qëndrimi aktiv –** Prirja e dalluar dhe gatishmëria e theksuar e një individi për ndërmarrjen e një veprimtarie konkrete ndaj një çështjeje, dukurie, situate etj.;

c. **Qëndrimi anticipues –** Qëndrim i marrë që më parë për të reaguar ndaj asaj që pritet të ndodhë. I tillë mund të jetë qëndrimi paraprak i disa individëve për pamundësinë e ekzistencës së jetës në Mars, për krizën që mund të shkaktojë deficiti i madh monetar te ne etj.

d. **Qëndrimi konkret** – Gatishmëri e reagimit të drejtpërdrejtë ndaj një dukurie, objekti, ndaj një situate konkrete me të cilën individi bie në kontakt**;**

e. **Qëndrimi pasiv** – Mendim i përcaktuar, i shoqëruar edhe me ndjenja të veçanta të një intensiteti kryesisht mesatar, por jo edhe me veprimtari konkrete ndaj një çështje e një situate të caktuar**;**

f. **Qëndrimi personal** – Qëndrim që i përket vetëm një individi duke karakterizuar pikëpamjen dhe sjelljet e tij ndaj një çështjeje të caktuar. I tillë është qëndrimi i Nënës Terezë ndaj të varfërve, të sëmurëve, të pastrehëve etj.;

g. **Qëndrimi i përgjithshëm** – Qëndrimi ndaj humanizmit, fesë, luftës etj.;

h. **Qëndrimi social** – Prirje, gatishmëri e formuar e njeriut për të reaguar në formë të caktuar ndaj një anëtari të një grupi shoqëror formal, ndaj një grupi shokësh, ndaj një dukurie shoqërore të caktuar etj.

LLOJET E REAGIMIT. Në psikologji hasen disa lloje reagimesh të organizmave, sidomos të organizmit të njeriut, të cilat shprehen me sintagmat:

a. **Reagimi befasues** – Kundërveprim i pavullnetshëm ndaj një ngacmuesi të papritur, befasues të organizmit ose të një pjese të tij. Të tilla janë reagimet e muskujve skeletorë dhe të organeve të brendshme të organizmit, duke përfshirë edhe reagimin e gjëndrave;

b. **Reagimi i fiksuar** – Reagim që përsëritet herë pas here, megjithëse njeriu është bindur që këtë reagim ta shuajë ose ta ndryshojë;

c. **Reagimi refuzues** – Lëvizje larguese e organizmit të njeriut nga një objekt ngacmues i posaçëm;

d. **Reagimi i përmbajtur** – Ecuri e organizimit të një eksperimenti psikologjik, ku kërkohet që subjekti të mos reagojë menjëherë, por të presë një kohë të shkurtër, me qëllim gjurmimin e mundshëm të simboleve që ndërkohë paraqiten;

e. **Koha reaguese** – Koha rrjedhëse nga momenti i veprimit të ngacmuesit në organizëm ose në një pjesë të tij deri në momentin e reagimit të tij ndaj atij ngacmuesi. Koha reaguese, përkatësisht zgjatja dytësore ndaj ngacmuesit varet nga lloji i ngacmuesit dhe nga intensiteti i tij. Sa më intensiv të jetë ngacmuesi, aq më e shkurtër është koha reaguese. Reagimi ndaj ngacmuesve pamorë zakonisht zgjat më pak se 2/10 e sekondës, ndaj ngacmuesve dëgjimorë është edhe më e shkurtër. Në situatat jo laboratorike kohëzgjatja reaguese sillet rreth 1 – 2 sekonda**;**

f. **Ndryshorja reaguese –** Ndryshorja e varur në një gjurmim raportesh ndërmjet shkakut dhe rrjedhimit në një proces eksperimental;

g. **Potenciali reagues** – Mbisundimi i reagimit me fuqi, me potencial më të madh se reagimi me potencial më të vogël ndaj dy ngacmuesve që veprojnë në të njëjtën kohë në organizmin e njeriut. Termi potencial reagues i përket teorisë të të mësuarit të Klark L. Hulit (Clark L. Hull (1884 – 1952), ku besohet se do të shfaqet ai reagim që ka fuqi, apo potencial më të madh;

h. **Reagimi "rrushi i thartë"** – Formë e mekanizmit mbrojtës të reagimit racionalizues. Kuptimi i reagimit "rrushi i thartë" buron nga tregimi i Ezopit, kur dhelpra e uritur nuk ka arritur të marrë për ushqim rrushin nga njëfarë lartësie e pjergullës prej tokës dhe ka "deklaruar" se këtë nuk e ka bërë, sepse ai ishte gjoja i thartë. Justifikim i paaftësisë me reagim verbal të kapshëm dhe të pranueshëm nga mjedis**i;**

i. **Reagimi befasues** – Reagim i ndërlikuar me bazë emocionale i organizmit ndaj ngacmuesve të një intensiteti të lartë dhe të befasishëm (zakonisht ndaj ngacmuesve dëgjimorë). Reagimi i tillë te të porsalindurit ka karakter të thjeshtë refleksiv, te të rriturit mund të jetë pjesërisht refleksiv (nuk shfaqet në të njëjtën formë te të gjithë njerëzit, siç është rasti me foshnjat). Reagimi i tillë manifestohet me dridhje të kokës, me mbyllje të syve dhe me hapje të buzëve etj.

LLOJET E RECEPTORËVE. Receptorët klasifikohen sipas parimeve të ndryshme. Sipas karakterit të ngacmuesve ndahen në fotoreceptorë (receptorë të të parit, të dritës), kimikoreceptorë (receptorë të shijes e të nuhaturit), receptorë mekanikë (të prekjes, të drejtpeshimit etj.), dhe në receptorë termikë (receptorë të temperaturës së lëkurës). Sipas fiziologut anglez Çarls S. Sherington (Charles S. Sherrington, 1861 – 1952) receptorët ndahen sipas pozitës së tyre në organizëm. Sipas kësaj ndarjeje dallojmë: eksteroreceptorët, interorecetorët dhe proprioreceptorët. Shih – ***EKSTERORECEPTORI.***

LLOJET E REFLEKSEVE. Reagimet refleksive janë të shumëllojshme. Në literaturën e psikologjisë dallojmë këto forma të reagimeve refleksive, përkatësisht këto lloje refleksesh të rëndësishme për të kuptuar zhvillimet psikomotorike të njeriut:

a. **Refleksi i Babinskit** – Tkurrja e gishtërinjve të këmbës, kur ngacmohet sipërfaqja e shputës së saj. Gishti i madh bën lëvizje në drejtim të kundërt të gishtërinjve të tjerë, që lëvizin në drejtim të ngritjes së tyre në lartësi. Karakterizon fëmijët e moshës deri një vjeç, kurse më pas mund të jetë simptomë e çrregullimeve motorike. U zbulua nga neurologu francez Zhozef Babinski (Joseph Babinski, 1875 – 1932);

b. **Refleksi bebëzor** – Ndryshim automatik i madhësisë së bebes së syrit varësisht nga intensiteti i dritës dhe nga largësia e afërsia e objektit që shihet**;**

c. **Refleksi i dridhjes** – Mbyllja refleksive e kapakëve të syrit që shkaktohet nga zëri i fortë dhe i befasishëm, nga drita e fuqishme etj.

d. **Refleksi i kushtëzuar** – Reagim ndaj ngacmuesve të jashtëm që është produkt i të mësuarit. Është pasojë e lidhjeve të përkohshme ndërmjet ngacmuesve të jashtëm dhe organizmit. Mësohet nga përsëritja e lidhjes ndërmjet ngacmuesve natyralë dhe atyre artificialë (zërit, dritës etj.). Është emërtuar nga rezultatet gjurmuese të fiziologut rus Ivan P. Pavllov (Ivan P. Pavlov, 1949 – 1936);

e. **Refleksi i pakushtëzuar** – Reagim i lindur i organizmit ndaj atyre ngacmuesve që kanë rëndësi jetësore për të (ndaj ushqimit, ujit, të ftohtit etj.). Karakterizojnë llojin e caktuar të organizmave;

f. **Refleksi i të kapurit** – Reagim automatik i shuplakës së dorës dhe gishtërinjve të dorës kur shuplaka e saj ngacmohet me një trup të caktuar të gjendjes së ngurtë ose të lëngët. Ky refleks quhet refleksi i Darvinit (Charles Darwin, 1809 – 1882). Është reagim normal i foshnjave deri në moshën një vjeç;

g. **Refleksi i lirisë –** Reagim i lindur i organizmit që ka të bëjë me angazhimin e tij në shkëputjen nga ato lidhje me mjedisin e jashtëm që pengojnë lëvizjen e lirë. Është një prej reagimeve refleksive me vlerë dhe me rëndësi biologjike të madhe për zhvillimin e organizmit. U identifikua si i tillë nga fiziologu rus Ivan P. Pavllov (Ivan P. Pavlov, 1849 – 1936);

h. **Refleksi i orientimit –** Reagim i menjëhershëm i organizmit ndaj një ngacmuesi të befasishëm, por me intensitet të lartë, duke kthyer kokën në drejtim të atij ngacmuesi. Reagimi i këtillë ka për qëllim mbrojtjen e organizmit dhe manifestohet me ngritjen e tonusit muskulor, me përshpejtimin e qarkullimit të gjakut në tru, me rënien e valëve alfa etj. U zbulua nga fiziologu rus Ivan P. Pavllov (Ivan P. Pavlov, 1849 – 1936);

i. **Refleksi kompensues –** Lëvizje refleksive e organizmit që shfaqet vetvetiu, atëherë kur organizmi pëson humbje të baraspeshës. Ky refleks ka karakter spontan dhe kryen funksionin e kompensimit të baraspeshës organike të çrregulluar, duke zhvilluar veprim të rikthimit të gjendjes së mëparshme të organizmit, përkatësisht të gjendjes normale të tij;

j. **Refleksi patelar** – Shtrirja horizontale e pjesës nën gju të këmbës, kur pjesa nën gju ngacmohet nga ndikimi i menjëhershëm i një objekti, siç është çekiçi me kokë gome;

k. **Refleksi i pozicionit të trupit** – Reagim i shpejtë i mekanizmave fiziologjikë me të cilët organizmi mban pozicionin e duhur dhe drejtimin e tij në hapësirë**;**

l. **Refleksi i të ecurit** – Reagim automatik i këmbëve të foshnjës, kur trupi i saj ngrihet nga nëna në anën e përparme mbi sipërfaqen e shtratit, foshnja lëviz me këmbë në formë rrethore**;**

m. **Refleksi i përqafimit** – Shtrirja e duarve të foshnjës dhe lëvizja e tyre në formë harkore, që i përngjet lëvizjes së duarve për përqafim. U emërtua refleksi Moros, sipas emrit të pediatrit austriak Ernst Moro (Ernst Moro, 1674 – 1951);

n. **Refleksi i tërheqjes** – Reagim i lindur që shfaqet me largimin, tërheqjen e trupit ose të pjesëve të tij, të gjymtyrëve nga ngacmuesi që shkakton dhembje.

LLOJET E STRESIT. Dallohen këto lloje stresesh: 1) Stresi fiziologjik; 2) Stresi shoqëror dhe 3) Stresi psikologjik. Stresi fiziologjik është reagimi i organizmit ndaj ngacmuesve të rrezikshëm për funksionimin normal të tij. Stresi shoqëror është reagim i bashkësisë shoqërore ndaj ndikimit të pazakonshëm të një ngjarjeje, ndodhie shoqërore. Stresi psikologjik është shndërrim i dëmshëm i raportit ndërmjet individit dhe karakteristikave ngacmuese të rënda për të. Derisa stresi fiziologjik shkaktohet nga ngacmuesi dëmprurës i organeve trupore dhe i indeve të tyre, stresi psikologjik përcaktohet nga vlerësimi i individit të ngacmuar ose është ngacmuesi apo situata e rrezikshme dhe dëmprurëse dhe që përcakton në çfarë mase e rrezikon qëndrueshmërinë psikike të njeriut.

LLOJET E SHENJAVE. Shenjat janë të natyrshme dhe artificiale. Të natyrshme janë ato shenja që kanë ngjashmëri të madhe me sendin e natyrshëm. Kështu, tymi është shenjë se aty diçka po digjet. Artificiale janë të gjitha ato shenja që kanë domethënie të emërtuar në bazë të mirëkuptimit ndërmjet anëtarëve të një mjedisi kulturor; shkronjat e alfabetit të gjuhës shqipe janë shenja konvencionale të tingujve të gjuhës shqipe të caktuar në Kongresin e Manastirit më 1908. Shenjat e tilla janë simbolet. Shih - ***SIMBOLET***.

LLOJET E TË MËSUARIT. Lloje ose forma të veçanta të të mësuarit të përmbajtjeve të caktuara. Llojet kryesore të të mësuarit janë:

a. **Të mësuarit asociativ** – Të mësuarit e përmbajtjes së një lënde sipas parimit të shoqërimit të pandërprerë rendor të të dhënave; sipas këtij lloji të të mësuarit rikujtimi dhe riprodhimi i një të dhëne, përkatësisht i një informacioni tërheq rikujtimin dhe riprodhimin e informacionit tjetër me të cilin është mësuar;

b. **Të mësuarit në bazë të kushtëzimit** – Të mësuar në bazë të lidhjes së ngacmuesit dhe reagimit natyror me ngacmuesin artificial dhe përvetësimi i reagimit ndaj atij artificial, pa ndërmjetësimin e atij natyror. Shih – ***KUSHTËZIMI.***

c. **Të mësuarit e lëvizjeve** – Të mësuarit e bashkërenditjes, të saktësisë,

të shpejtësisë dhe të koordinimit të lëvizjeve dhe të integritetit të tyre në një tërësi të caktuar, që ka të bëjë drejtpërdrejt me të mësuarit e shkathtësive dhe të shprehive;

d. **Të mësuarit mekanik** - Të mësuarit me qëllim të mbajtjes në mend të të dhënave dhe informacioneve të renditura në përmbajtjen e një lëndë të caktuar, duke i riprodhuar ato sipas rendit dhe formës së dhënë nga ana e atij që konsideron se nuk ka nevojë të kërkohet dhe as të mësohet kuptimi i tyre, si edhe as raporti ndërmjet tyre;

e. **Të mësuarit e qëllimshëm** – Lloj i të mësuarit që ka të bëjë me qëllimin eksplicit, kur njeriu i vë vetes detyrë të mësojë përmbajtjen e një lënde për të arritur në një objektiv të caktuar, të paracaktuar prej tij;

f. **Të mësuarit e rastësishëm** – Të mësuarit dhe përvetësimi i informacioneve dhe i lidhjeve ndërmjet tyre pa një orientim të caktuar të individit dhe pa qëllim që ato t`i mësojë dhe t`i përvetësojë dhe as duke mos marrë udhëzime nga ana e eksperimentuesit që ato të mësohen dhe të përvetësohen;

g. **Të mësuarit racional** – Veprimtari e organizuar e individit me qëllim të njohjes dhe përvetësimit të marrëdhënieve ndërmjet koncepteve, gjykimeve etj. të një tërësie lëndore;

h. **Të mësuarit në bazë të përpjekjeve dhe të gabimeve** - Lloj i të mësuarit të kafshëve dhe të njerëzve kur gjenden në një situatë problemore. Kafsha për të dalë nga situata problemore, si dhe njerëzit për ta zgjidhur problemin e caktuar, herë pas here bëjnë përpjekje dhe rastësisht godasin pikërisht atë veprim që i shpie në sukses. Gjatë përsëritjes së veprimeve për të dalë nga situata e ndërlikuar, kafsha kryen veprime të verbra, të pasuksesshme dhe këto veprime shkallë-shkallë humbin, por përforcohen ato veprime që e çojnë atë në sukses. Këto të fundit përforcohen në bazë të lidhjes së tyre me suksesin përfundimtar. Kjo formë e të mësuarit shfaqet edhe te njeriu, por në një tjetër mënyrë cilësore të ndryshme nga kafshët. Njeriu sapo arrin në zgjidhje të situatës problemore nuk bën më përpjekje të pasuksesshme. Njeriu i paramendon rrugët, mjetet dhe sjelljet e tij që e çojnë në zgjidhjen e problemit dhe përqendrohet në ato sjellje që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me zgjidhjen e tij;

i. **Të mësuarit inteligjent** – Lloj i të mësuarit të ndërlikuar dhe i një niveli më të lartë të të mësuarit. Të mësuarit inteligjent mbështetet në dallimin e marrëdhënieve thelbësore ndërmjet të dhënave të një situate problemore. Të mësuarit inteligjent është karakteristikë për njerëzit. Njeriu sapo e zgjidh problemin nuk bën orvatje të shumta që të arrijë rastësisht në zgjidhjen e situatës. Të mësuarit inteligjent ka këto veçori: gjatë të mësuarit inteligjent njeriu arrin shpejt në zgjidhjen e problemit e të situatës problemore; në zgjidhjen e situatave problemore a të problemeve të njëjta njeriu shkon drejtpërdrejt në zgjidhje, duke mos bërë orvatje dhe gabime dhe më në fund ai bën përgjithësimin e mënyrës së zgjidhjes së problemeve dhe të situatave problemore të asaj klase. Formën inteligjente të zgjidhjes së problemeve dhe të situatave problemore e kanë studiuar edhe përfaqësuesit e shkollës geshtaltiste, posaçërisht Volfgang Koler (Wolfgang Kohler, 1887 – 1967)

në siujdhesën Tenerif. Në provat e tij konstatoi se edhe majmunët zotërojnë aftësinë e zgjidhjes së situatave problemore. Këtë e dalloi te Majmuni Sultan, i cili bashkoi dy thupra njërën me tjetrën dhe krijoi një thupër me gjatësi të mjaftueshme për të arritur deri te banania e varur në murin e tavanit. Por, këtë e bëri vetëm ngaqë thuprat ndodheshin në fushën e të parit, kurse njeriu kërkon mjete për zgjidhje e problemeve dhe të situatave problemore edhe jashtë fushës perceptive.

LLOJET E TRANSFERIMIT TË TË MËSUARIT. Dallohen disa lloje të transferimit të të mësuarit të cilat janë: transferimi i dyanshëm (bilateral) – bartje e përvojës prej njërës anë simetrike të trupit në anën tjetër, përkatësisht prej dorës së majtë në të djathtën. Transferimi i metodave të të mësuarit – bartje e mënyrave të të mësuarit të suksesshëm të një lënde mësimore në një lëndë tjetër (prej të mësuarit e gramatikës së gjuhës shqipe në të mësuarit e lëndës së anglishtes, të matematikës etj.). Transferimi motorik – tejbartje e përvojës së formimit të një shprehie nga një fushëveprim në tjetrin, kur shprehia e mëparshme lehtëson formimin e shprehisë tjetër, përkatësisht shprehia tjetër ekzekutohet me saktësi, shpejtësi dhe me koordinim të lëvizjeve në mënyrë më të përsosur. Transferimi negativ – vështirësitë, pengesat e përvetësimit të përvojës së re, të shkathtësive e shprehive të reja nga të mësuarit e mëparshëm. Transferimi i parimeve – bartje e dijes së përgjithësuar e të formuluar në formë parimesh, rregullash e ligjesh në zgjidhjen e problemeve e të situatave problematike konkrete, në bazë të zbatimit të drejtë të parimeve, rregullave dhe ligjeve të mësuara më parë.

LLOJET E TRAUMAVE. Lloje turbullirash psikike me sjellje të çekuilibruara dhe të qëndrueshme të njeriut, ndër të cilat veçohen: 1) Traumat encefalopatike – lëndim i trurit me pasoja psikike të rënda si: përqendrimi i dobët i vëmendjes, dhembje e kokës, lodhje e shpejtë etj.; 2) Traumat kraniocerebrale – lëndim i kokës dhe i trurit që shoqërohet me tronditje të trurit dhe me pasoja afatgjata në trupin e njeriut. Këto i përngjajnë psikozave dhe sjelljeve karakteristike të psikotikëve**.**

LLOJET E VALËVE TRUNORE. Oshilime elektromagnetike me formë valësh trunore. Në këtë kuptim dallohen: valët alfa, valët beta, valët delta dhe valët teta. Valët alfa të trurit janë karakteristike për njeriun e zgjuar, aktiv dhe pasiv. Valët alfa sillen ndërmjet 8 Hz dhe 12 Hz. Valët beta të trurit janë valë të trurit me aktivitet prej 12 Hz – 30 Hz, që hasen në gjendjen normale të njeriut të zgjuar. Valët delta janë valë me shpeshtësi deri në 4 Hz; hasen normalisht në gjumin e të rriturit. Valët teta zakonisht hasen te fëmijët e vegjël. U zbuluan nga ana e neurologut gjerman nga Jena, Hans Berger.

LLOJET E VERBIMIT. Dallohen disa lloj verbimi: Verbim bore – zvogëlim i të parit të objekteve e dukurive, i shkaktuar nga ekspozimi i syve ndaj një drite me intensitet të lartë. Verbimi i tillë është i ngjashëm me pamundësinë e të parit nga reflektimi i rrezeve të dritës nga bora, kur mbi sipërfaqen e saj reflektohen rrezet e diellit. Ver-

bimi cerebral – verbëri e shkaktuar nga dëmtimi i qendrës pamore të trurit të madh. Quhet edhe verbim kortikal – verbim qendror. Verbimi i ditës – dukuria e shikimit të vështirësuar gjatë ditës, që shfaqet kur individi shikon më lehtë në hapësirën me dritë të kufizuar. Verbimi funksional – humbja e aftësisë së të parit pa dëmtim organik të asnjë pjese të aparatit të të parit. Verbimi i natës - humbja e aftësisë së të parit në errësirë. Rrjedh nga mungesa dhe mospërtëritja e shkopthave në rrjetëzën a retinën e syrit. Verbimi për ngjyra – paaftësia e disa individëve për të dalluar disa ngjyra kromatike. Shih – ***DALTONIZMI; DEUTERANOPIA; PROTANOPIA.*** Verbimi natyror i njohur edhe me termin verbim pule – paaftësia e të parit natën, në errësirë (njësoj si pulat). Verbimi psikogjen – verbim i shkaktuar nga disa shkaqe psikologjike. Individi humb përkohësisht aftësinë e shikimit, megjithëse syri dhe baza neurale e të parit është e palënduar.

LLOJET E VETËVRASJES. Emil Durkeim ka dalluar disa lloj vetëvrasjesh. Vetëvrasja altruiste – vetëflijimi për të mirën e të tjerëve (ushtari vetëflijohet, hidhet para mitralozit për të shpëtuar të tjerët, Mic Sokoli vë trupin para grykës së topit për të shpëtuar shokët e luftës dhe për të mbrojtur lirinë. Vetëvrasje anomike – ndodh nga vlerësimi i individit se jeta e tij nuk ka kuptim, humbja e lidhjes kuptimore me vlerat njerëzore e morale. Vetëvrasjet egoiste – asgjësim i jetës për shkak të mossuksesit të madh dhe të vlerësimit se ai vetë është shkaktar për këtë dështim. Sot bëhet fjalë edhe për llojin e vetëvrasjes grupore – vetëvrasje e afërt kohore e hapësinore e disa individëve (kryesisht e adoleshentëve). Besohet se lajmi për një vetëvrasje në media u shërben këtyre si "urdhëresë" për një seri vetëvrasjesh. Ndodh atëherë kur vetëvrasja merr përmasa publicitare.

LLOJET KRYESORE TË TESTEVE. Sipas qëllimit të testeve për të provuar dallojmë këto lloj testesh: 1) Testet e aftësive; 2) Testet didaktike dhe 3) Testet e personalitetit. Testet e aftësive janë sistem pyetjesh, detyrash dhe problemesh të standardizuara, zgjidhja e të cilave nga ana e të testuarit tregon aftësitë dhe përcakton shkallën e zhvillimit të tyre te një individ i caktuar. Teste të tilla janë testet psikomotorike që hartohen dhe zbatohen me qëllim të njohjes dhe të përcaktimit të shkallës së zhvillimit të lëvizjeve, të bashkërenditjes dhe koordinimit të lëvizjeve të tërësishme, përkatësisht në shkathtësi dhe në shprehi; Testet sensorike që janë sistem ngacmues për matjen e reagimit shqisor, të shpejtësisë dhe të saktësisë së reagimit. Këto teste përcaktojnë aftësitë dhe zhvillimin e tyre – si kusht i veprimtarisë së suksesshme të individit në një veprimtari të posaçme. Testet didaktike përmbajnë pyetje, detyra e problema të nxjerra nga programi i zhvilluar në një lëndë mësimore. Testet didaktike kanë për qëllim përcaktimin e saktë të shkallës dhe të cilësisë së përvetësimit të njohurive, shprehive dhe shkathtësive të parashikuara me program gjatë mësimit të asaj lënde. Testet e personalitetit përbëhen prej paraqitjes së situatave të ndryshme para subjekteve, nga të cilët kërkohet të tregojnë si do të reagojnë në situata të tilla. Me

anën e tyre vlerësohen tiparet e personalitetit, intensiteti i zhvillimit të tyre dhe shkalla e integritetit të personalitetit, të strukturave dhe të sjelljeve të tij. Këto teste provojnë interesat, qëndrimet, tiparet e karakterit dhe të temperamentit të njeriut. Sipas mënyrës së zbatimit të testeve dallojmë teste individuale dhe teste grupore a kolektive. Testet individuale provojnë aftësitë, inteligjencën, dijet e përgjithshme të një individi, tiparet e personalitetit etj. Këto i jepen vetëm një individi dhe zgjidhja e detyrave dhe e problemave të këtij testi janë të lidhura saktësisht me njëfare kohe të parashikuar. Teste të tilla janë testet Bine – Simon, Ueksler – Belvi etj. Testet grupore u jepen një grupi të caktuar individësh për zgjidhje. Ky grup mund të ketë 30, 50 dhe rrallëherë 100 individë. Kanë për qëllim matjen dhe vlerësimin e aftësive, të shkallës së informimit etj. të një popullate të caktuar. Test i tillë është testi AGCT, testi i matricës progresive, testi alfa – beta etj. Testet sipas strukturës formuluese të pyetjeve, të detyrave dhe të problemeve mund të jenë teste fjalësore apo verbale, teste jofjalësore dhe teste manipuluese. Testet verbale janë teste që kanë për qëllim matjen dhe vlerësimin e inteligjencës së përgjithshme ose të informimit të individit nga një fushë e caktuar ku mbisundojnë aftësitë verbale. Këto janë formuar nga pyetjet, detyrat dhe problemet e formuluara saktësisht me fjalë dhe me fjali të kuptueshme. Testet manipuluese kanë për qëllim matjen dhe vlerësimin e aftësive të përgjithshme dhe të gatishmërisë për kryerjen e detyrave, zgjidhjen e situatave problemore etj. dhe janë hartuar nga detyrat perceptive dhe motorike.

LLURIA R. Aleksandër (Aleksandar R. LURIJA). Psikolog rus. Lindi më 1903 dhe vdiq më 1977). Kreu universitetin për psikologji në Moskë. Doktoroi më 1937 në Tbilisi duke kryer në të njëjtin vit edhe studimet pët mjekësi. Në Luftën e Parë Botërore ka qenë drejtor i spitalit për neurokirurgji, prej nga fitoi një përvojë të rëndësishme për përcaktimin e çrregullimeve neurofiziologjike dhe neuropsikologjike. Ka konceptuar metodën e njohur të neurokirurgjisë të emërtuar "Metoda Lluria". Rezultatet e përftuara nga zbatimi i kësaj metode, sidomos ato nga fusha e afazisë, u përputhën me ato të përftuara edhe në disa vende të tjera. Pas tetë vjetësh në doktoratë u zgjodh profesor i psikologjisë në Universitetin "Lomonosov" të Moskës, kurse dy vjet më pas, d.m.th., më 1947 u zgjodh anëtar i Akademisë së Shkencave Pedagogjike të Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike. Veprat kryesore të tij janë: *"Reč i intelekt v razvitni rebenika"* – (*"Fjala dhe zhvillimi i intelektit të nxënësve*", 1927); *"Psihofiziologija afektivni procesov"* – (*"Psikofiziologjia e proceseve afektive",* 1937); *"Gramatičeskaja afazija"* – (*"Afazia gramatikore*", 1947); *"Osnovi nejropsihologii"* – (*"Bazat e neuropsikologjisë",* 1948).

M

M = shkurtesa për faktorin e aftësisë së kujtesës, përkatësisht për faktorin e memories.

M = shkurtesë për vlerën mesatare të të dhënave të përftuara nga matja e një ndryshoreje psikologjike.

Ma = shkurtesa për mesataren aritmetike.

MADHËSHTI, - A. f. Përjetim karakteristik i ndjenjave të një individi për vlerën dhe rëndësinë e një vepre dhe të bartësit të saj. Struktura e ndërlikuar e ndjenjës së madhështisë përbëhet nga krenaria, gëzimi dhe konsiderata e veçantë ndaj krijuesit të saj.

MAGJEPSJ/E, - A. f. Preokupim i madh i individit nga bukuria e një vepre artistike, që shfaqet drejtpërdrejt në ndryshimin pozitiv të gjendjes emocionale të individit dhe të proceseve kognitive të tij.

MAGJI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *μαγιά.* Tërësi lëvizjesh dhe ritualesh të ndryshme të atyre që besojnë se me anën e tyre ushtrojnë ndikim në ndryshimin e dukurive natyrore dhe të veprimeve të të tjerëve për të siguruar kushte ekzistence dhe jetese të qeta, pavarësisht nga ligjet e natyrës. Ai që beson në magji konsideron se veten mund t`ia nënshtrojë dëshirave dhe qëllimeve të tij ndryshimeve objektive natyrore dhe shoqërore. Xhon Frajzeri (John Freiser) antropolog dhe etnolog anglez ka konsideruar se magjia është projektim i asociacioneve të njeriut në botën e jashtme. Dallohen këto lloje magjish:

a. **Magjia imituese** – Imitim i dukurive natyrore nga ana e një numri anëtarësh të disa fiseve primitive. Magjia imituese është forma më e vjetër e magjisë. Imitohen lëvizjet e atyre dukurive që i dëshirojnë që të ndodhin, si lëvizja e reve për të rënë shi gjatë kohës së thatësisë së madhe, lëvizjet e atyre dukurive që duhet të pengojnë dëmet e caktuara (lëvizjet që i përngjajnë zjarrit të shkaktuar në pyll, duke shpresuar se ajo me anë të lëvizjes së njerëzve mund të ndalet;
b. **Magjia simpatike** – Formë magjie më e përsosur se ajo imituese; këtë e karakterizon besimi i individëve me lutje të njëllojshme e të përbashkëta dhe me disa rituale të veçanta që mund

ta pengojnë dukurinë dhe rrjedhimet negative të saj (lutje të veçanta për ta penguar bubullimën, rrufenë, tërmetin etj).

MAGJIA E FJALËVE. Besimi i madh i njeriut në fuqinë e fjalëve dhe të mendimit që ato shprehin. Magjia e fjalëve ka të bëjë me besimin dhe me bindjen e pjesëtarëve të disa fiseve primitive, se ato fjalë që ata përsorin gjejnë zbatim në aktivitetin praktik të tyre. Magjia e fjalëve dallohet edhe në disa raste të çrregullimeve mendore. Përmendet rasti i një pacienti të Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939), i cili pretendonte se emri i tij është pjesë e shpirtit të tij.

MAGJIZ/ËM, - MI. m. Një nga karakteristikat e mendimit parakauzal të fëmijëve. Kjo karakteristikë shfaqet në besimin e fëmijëve se këta, me anën e mendimit të tyre mund të ndikojnë në ndryshimin e rrjedhës së një objekti, procesi, dukurie natyrore etj. Në këtë rrjedhë të mendimit fëmijët pretendojnë se hëna lëviz, sepse ata vetë lëvizin dhe se lëvizja e tyre është shkak i ndryshimit të pozicionit të hënës, përkatësisht shkak i lëvizjes së saj në horizont. Magjizmin e ka përshkruar psikologu zviceran Zhan Pijazhe (Jeam Piaget, 1896 – 1980).

MAHIZ/ËM, - MI. m. Pikëpamje idealiste e fizikanit dhe e filozofit austriak Ernst Mah (Ernst Mach, 1838 – 1916). Trupat e cilësitë e tyre janë të një rëndësie të dorës së dytë ndaj ndijimeve, të cilët janë parësorë ndaj trupave objektivë. Sipas kësaj pikëpamjeje objektet, dukuritë, proceset, situatat etj. janë komplekse ndijimesh, kurse dija për to është sistem ndijimesh të pavarura nga objektet, dukuritë, proceset, situatat etj.

MAHNITJ/E, - A. f. Formë e përjetimit të habisë së njeriut, kur ai ballafaqohet me objekte, dukuri, vepra, që kanë cilësi dhe përmasa të jashtëzakonshme, si edhe kur atij i paraqiten situata e objekte të papritura në lidhje kontrasti me ato të tashmet.

MAINONG Aleksius (Alexius MEINONG). Filozof dhe psikolog austriak. Lindi në Lemberg më 17.07.1853 dhe vdiq në Grac (Graz) më 27.11.1920. Gjimnazin dhe studimet universitare i kreu në Vjenë, ku studioi historinë, por iu kthye studimeve të filozofisë dhe, duke qenë nën ndikimin e filozofisë së Franc Brentanos u mor hollësisht me studimin e mendimeve filozofike të David Hjumit. Është themelues i laboratorit të parë psikologjik në Grac. Në vitin 1878 ishte docent privat, kurse më pas kaloi në Grac dhe prej vitit 1882 u zgjodh profesor i rregullt, derisa në fund të jetës. U mor me studime psikologjike duke konsideruar psikologjinë pjesë apo disiplinë të filozofisë. Ai kontribuoi në zhvillimin e psikologjisë në dy fusha: në fushën e zhvillimit të psikologjisë eksperimentale dhe në atë të psikologjisë fenomenologjike. Sa i përket fushës së parë Aleksius Majnongu konsiderohet se është themelues i drejtimit geshtaltist të shkollës së Gracit. Në fushën e dytë konsiderohet se ishte përkrahës i atomizmit në psikologji, zbërthimit të fenomeneve psikike në strukturat e veçanta dhe të përshkrimit të secilës prej tyre në mënyrë të saktë. Në fushën e njohjes përmendet si themelues i "teorisë së sendeve" – "Gegenstandstheo-

rie". Në kuadrin e kësaj teorie ai ka dalluar katër forma elementare të përjetimit të akteve psikologjike të njohjes: 1) njohjen pasive të objekteve, strukturën e së cilës e përbëjnë përfytyrimet, 2) njohjen objektive aktive – të përçuar me mendime, 3) njohjen dinjitoze të mbështetur në emocionalitetin pasiv, të përbërë nga ndjenjat dhe 4) njohjen e dëshiruar, të përçuar me emocionalitetin aktiv të përbërë nga dëshirat. Këto dallohen sidomos në veprën "Hulumtime mbi teorinë e sendeve dhe mbi psikologjinë". Veprat kryesore të tij janë: *"Über Annahmen"* – (*"Mbi hipotezën"*), 1902; *"Untersuchungen zur Gegestandstheorie und Psychologie"* – (*"Baza e teorisë së sendeve dhe psikologjia"*), 1904; *"Über die Erfahrungsgrundlagen unseres Wissens"* – (*"Mbi bazën e përvojës së qenies tonë"*), 1906; "*Über die stellung der Gegenstandstheorie im System der Wissenschafen"* – (*"Mbi qëndrimet e teorisë së sendeve në sistemin e shkencave"*), 1907; *"Über Möglichkeit und Wahrscheinlichkeit"* – (*"Mbi mundësinë dhe besueshmërinë"*), 1915.

MAJMUN, - I. m. Nënrend sisorësh me zhvillim karakteristik të trupit, të gjymtyrëve, të shuplakave dhe të trurit. Majmunët e llojeve të ndryshme gjenden në një shkallë më të lartë zhvillimi se kafshët e tjera. Kjo shfaqet në shkallën më të lartë të zgjidhjes së disa situatave problemore praktike, në bazë të dallimit të raporteve elementare shqisore ndërmjet objekteve e dukurive të asaj situate dhe të ndodhjes së tyre në raport me situata, objekte, dukuri etj. të rëndësishme për jetën dhe aktivitetin e tyre. Majmunët shfrytëzohen për gjurmime krahasuese në fushën e psikologjisë krahasuese.

MAKIAVELIZ/ËM, - MI. m. Pikëpamje mbi natyrën e njeriut, e konceptuar nga mendimtari italian (letrari, politikani, këshilltari mbretëror) Nikolo Makiaveli (Niccollo Machiavelli, 1469 – 1527). Pikëpamja e tij e përgjithshme për njeriun është ajo sipas së cilës njerëzit për nga natyra e tyre janë frikacakë, individualistë dhe të pamoralshëm. Këta duhen sunduar me sjellje dhelpërore, me gënjeshtra dhe me kërcënime. Makiavelizmi në psikologji emërton tiparin e personalitetit të sjelljes mospërfillëse ndaj të tjerëve, përveçse kur individi ka dobi materiale, kur duhet mos hequr dorë nga sundimi mbi ta etj. Baza mendore e kësaj pikëpamjeje është se njerëzit duhen manipuluar duke përdorur sjellje dhelpërore, sipas parimit të përgjithshëm "qëllimi arsyeton mjetin". Këtë e mësojmë nga vepra e tij "Sunduesi". Instrumenti psikologjik matës i tiparit të makiavelizmit është shkalla mah. Shih – ***SHKALLA MAH.***

MAKROSKOPI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *μάκρος* "i madh" dhe *όψης* "shikim". Dukuria e iluzionit për madhësinë e trupave që perceptohen, kur këta duken më të mëdhenj se sa janë në të vërtetë. Makropsia rrjedh kryesisht nga vendndodhja e një trupi ndërmjet trupave të tjerë që kanë madhësi të ndryshme, nga ndikimi që ushtron përdorimi i disa drogave, sidomos kanabisi, nga migrena etj.

MAKSIM/Ë, - A. f. I ardhur nga latinishtja *maxima* "rregull". Mendim i ngjeshur ose i kondensuar dhe i shkurtër për çështjet e rëndësishme të jetës dhe të veprimtarisë së njeriut. Deri në përcaktimin e maksimave arrihet në bazë të shfrytëzimit të përvojës së disa

brezave, që gjatë jetës dhe aktivitetit të tyre kanë arritur t`i verifikojnë përmbajtjet e vërteta të maksimave.

MAKTH, - I. m. Formë ankthi. Në psikologjinë bashkëkohore paraqet gjendjen psikike të njeriut, që ka të bëjë me përjetimin e një ngushtësie të madhe shpirtërore, me shqetësim shpirtëror të shkaktuar nga ëndrrat e frikshme që përjetohen gjatë gjumit, përkatësisht gjatë lëvizjes së syve gjatë një gjumi të thellë. Zakonisht përmbajtjen e ëndrrave të tilla njeriu është në gjendje t`a mbajë mend.

MAKULA AKUSTIKE. I ardhur nga latinishtja *macula acustica.* Makula akustike është term i përbashkët i dy fushave të qelizave receptore të dy qeskave (të utrikulusit e sakulusit) të vendosura në aparatin vestibular të veshit të brendshëm, bartës receptorë të ndijimeve të drejtpeshimit.

MAKULA LUTEA. I ardhur nga latinishtja *macula lutea* **"**njolla e verdhë" që bën pjesë në anatominë e syrit. Njolla e verdhë gjendet në mes të rrjetëzës së syrit dhe është jashtëzakonisht e vogël (ka një sipërfaqe më të vogël se një milimetër katror). Ajo është bartëse e qelizave receptore të të parit – e kunjëzave me formë të gjatë, kurse thupërzat e formës tjetër gjenden në periferi të rrjetëzës (të retinës) së syrit. Ky formacion qelizash receptore mundëson të parit më të qartë e më të mprehtë të objekteve nga largësi të ndryshme.

MAKUTËRI, - A. f. Dukuri psikofiziologjike që ka të bëjë me pangopësinë e njeriut. Makutëria nxitet nga lakmia e madhe për të shijuar dhe ngrënë sa më shumë. Kjo dukuri karakterizon njerëzit normalë si edhe ata që vuajnë nga disa çrregullime mendore. Shfaqet te të gjitha moshat, por më e pranishme është te të rinjtë dhe pleqtë.

MALEUS, - I. m. I ardhur nga latinishtja *malleus* "çekan". Çekani i veshit të mesëm, që është një prej tri koshave jashtëzakonisht të vegjël të kësaj pjese të veshit të mesëm. Në këtë pjesë gjenden edhe tri kosha kaq të vegjël, që janë të lidhur ndërmjet tyre dhe funksionojnë si një tërësi organike.

MALEZ, - I. m. I ardhur nga latinishtja *malaise*. Lloj parandjenje që shfaqet te disa individë për një sëmundje që ndjehet me vështirësi. Pas kësaj parandjenje njeriu ende nuk është i sigurt se ka gjasa të shfaqjes së një sëmundjeje. Ndodh që pas kësaj parandjenje të fillojnë disa çrregullime organike a psikike.

MALTUSIANIZ/ËM, - MI. m. Sistem konceptesh e gjykimesh që mbështesin teorinë e ekonomistit anglez Toma R. Maltus. Sipas maltusianizmit i vetmi shpëtim i zhvillimit të njerëzisë është mosprishja e baraspeshës ose e ekuilibrit ndërmjet shumimit të njerëzimit dhe rritjes së burimeve ushqimore. Për ta ruajtur këtë baraspeshim duhet planifikuar familja dhe kontrolluar shtimi i numrit të pasardhësve në raport me burimet ushqimore të tyre. Shih – ***TEORIA E TOM R. MALTUSIT.***

MALL, - I. m. Ndjenjë e thellë shpirtërore që njeriu e përjeton për mikun, familjen, shokun, vendlindjen etj., të cilat gjenden larg tij në pikëpamje hapësinore ose kohore. Ky kuptim i mallit përbën një kualitet të ndërthurur të pakënaqësisë, të dëshpërimit, të hidhërimit etj. Malli shpesh ka

përmasa motivuese, ngaqë e shtyn njeriun të ndërmarrë masa veprimesh për të ndryshuar gjendjen e tij të mallëngjyeshme.

MALLËNGJIM, - I. m. Përjetim i ndjenjës së dhembshurisë, të keqardhjes dhe të mallit të madh të një individi që gjendet larg individit tjetër, me të cilin ka kaluar çaste të këndshme e të hareshme. Mallëngjimi shoqërohet me dëshirën e madhe për t`u gjendur pranë shokut, mikut, vëllait, motrës së vetmuar, shokut të bankës në shkollë etj.

MALLKIM, - I. m. Qëndrim relativisht i ngarkuar me ndjenja negative i një individi i shprehur ndaj individit tjetër, përkatësisht ndaj atij, që i ka shkaktuar dëm, të keqe, smirë etj. Mallkimi është i lidhur me dëshirën që tjetrin ta gjejë e keqja. Objekt mallkimi mund të jetë një njeri, grup njerëzish etj. që kanë synuar të keqen e një individi (të shokut, fqinjit, kolegut etj.) dhe, herë-herë këtë e kanë arritur. Për këtë shkak mallkuesi ka përvojë të keqe me ta.

MANDAL/Ë, - A. f. Në psikologjinë e Karl G. Jungut (Carl G. Jung, 1875 – 1961) është figurë arketipe, që simbolizon tërësinë dhe harmoninë e brendshme të njeriut, unitetin pskikologjik të personalitetit. Figura arketipe e mandalës ka karakter të përgjithshëm, karakter gjithëpërfshirës e njerëzor. Mandala shpreh identitetin e unit.

MANI, - A. f. I ardhur nga latinishtja *mania* "tërbim". Gjendje e sëmurë psikike, që godet keq në radhë të parë emocionet me ndryshim të pazakontë të gjendjes emocionale, ku dallohet ndryshimi i vrullshëm i emocioneve, mbisundimi i gjendjes euforike në veprimtarinë e individit, lëvizshmëria e pakontrolluar, furia e ideve e pamundësia e bashkërenditjes së tyre dhe e kontrollit të lidhjeve ndërmjet tyre, pamundësia e zotërimit të vetvetes për kryerjen e një dëshire etj. Një gjendje e tillë përfshin edhe proceset kognitive dhe ato psikomotore, që shpien në simptoma të psikozës maniako-depresive. Dallohen sidomos këto simptoma kryesore të kësaj sëmundjeje: entuziazmi i pazakonshëm, i shkaktuar nga diçka e panjohur, përshpejtim i madh i procesit të mendimit dhe të të folurit, impulsiviteti i madh etj. Ky lloj çrregullimi psikik i përket kryesisht manisë njëpolare, kur nuk shfaqen edhe episode të depresionit. Një mani e tillë shfaqet edhe te psikozat e tjera.

MANIA DEPRESIVE. I ardhur nga latinishtja *mania* "marrëzi, tërbim" dhe *depression* "rënie shpirtërore". Në psikiatri është lloj i veçantë i psikozës dhe quhet psikoza maniako–depresive, psikoza bipolare dhe psikoza ciklike. Kjo psikozë quhet bipolare e ciklike, sepse është forma më e shpeshtë e çrregullimeve emocionale, që shfaqen me lëkundje emocionale të madhe prej një skaji në skajin tjetër dhe karakterizohet me ndryshimin e gjendjes shpirtërore prej aktivitetit euforik, gëzimit të madh, ndjenjës së gjithëfuqishme, furisë së ideve, llomotitjes dhe lëvizshmërisë së madhe në gjendje të pikëlluar, të frikësuar, me rrjedhje mendimesh dhe fjalësh të ngadalshme dhe me pasivitet të thellë. Rrjedha e kësaj psikoze ka karakter rrethor, prandaj quhet psikozë qarkore, përkatësisht cirkulare. Fazën e parë të kësaj psikoze e karakterizon mania, përkatësisht lëvizshmëria e madhe, eupforia,

vërshimi i madh i ideve dhe i fjalëve, kurse faza e dytë shoqërohet me frikë, pikëllim, ngadalësim dhe me pasivitet të madh. Ndërmjet këtyre fazave te pacienti shfaqen pauza të shkurtra kohore, gjatë të cilave të sëmurit nuk i kujtohet të thotë asgjë. Fazat e tilla zëvendësohen njëra pas tjetrës. Psikoza maniako-depresive është sëmundje psikike e rëndë me cikle kohorë të zëvendësueshëm, që zgjasin 3 – 6 muaj deri në 12 muaj. Dhe më pas gjendja e fazës së parë zëvendësohet me përmbajtje të çrregulluar emocionale të fazës së dytë. Psikoza bipolare e lëvizjes cirkulare mund ta ketë burimin nga shkaqet hereditare dhe nga shkaqe të tjera, kryesisht pak të njohura ose të panjohura, ndër të cilat përmenden: streset e rreshtuara, krizat jetësore, papjekuria emocionale, por edhe pafuqia e individit për të kontrolluar emocionet e veta. Për shërimin e saj përdoren barna antidepresivë e neuroleptikë, format e veçanta të psikoterapisë, si edhe pengimi i zhvillimit të kësaj sëmundjeje me anë të elektroshokut.

MANIA E PËRNDJEKJES. Formë e manisë, e tërbimit te njeriu, që karakterizohet nga mbisundimi i idesë se atë vazhdimisht dikush e përndjek për t`i shkaktuar një të keqe, për ta privuar nga jeta etj. Zakonisht mania e përndjekjes me simptomat e saj konsiderohet se karakterizon sëmundjen e paranojës. Shih – ***PARANOJA.***

MANIA SHOQËRORE. Dukuri sociologjike dhe psikologjike që ka të bëjë me shpërthim emocionesh, entuziazmi të furishëm për jetën e re, për ndryshimet e mëdha sociale etj. Mani shoqërore janë: fashizmi, fondamentalizmi fetar, hipizmi etj. Mania shoqërore duhet dalluar nga mania psikopatologjike dhe format psikiatrike të manisë.

MANIFESTIM, - I. m. Manifestimi është proces me anën e të cilit shfaqet objektivisht diçka e brendshme, e fshehur, duke u bërë e pashme, e mundshme për vëzhgim për të gjithë ata që kanë interes ta njohin atë. Karakteri i njeriut manifestohet në tiparet e sjelljeve etike të tij, temperamenti shfaqet ose manifestohet me formën, shpejtësinë dhe intensitetin e reagimit të njeriut ndaj situatave të ndryshme etj.

MANIPULIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja që përdoret edhe në të folurin e përditshëm në gjuhën shqipe. Në psikologji zakonisht bëhet fjalë për motivin e manipulimit të njeriut me objekte të ndryshme, me qëllim të njohjes së tyre duke zbërthyer me duar strukturën e tyre dhe lidhjet ndërmjet pjesëve të atij objekti të ri. I vetmi qëllim i motivit manipulues është njohja e objektit, e dukurisë, e motiveve etj. Disa psikologë besojnë se ky motiv rrjedh nga instinkti, përkatësisht nga aftësia e lindur e qenieve të gjalla për njohjen.

MANT/ËR, - RA. f. Në sanskrishte është lutje e vjetër fetare që këndohet në formë të himnit dhe shfrytëzohet si mjet meditimi nga ana e njeriut. Zbatuesit e kësaj lutjeje, kryesisht fetarë (hindusët, budistët etj.), në fillim e përsëritën këtë lutje shumë herë duke shkaktuar ngushtimin e aktivitetit të vetëdijshëm dhe një relaksim trupor e shpirtëror. Nga përsëritja ritmi i saj

karakteristik përsoset dhe njeriu çlirohet prej fuqive të fshehta shpirtërore. Me këtë arrihet në përjetimin e lumturisë së vërtetë.

MANJERIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga frëngjishtja *manierisme* "imitim i verbër". Manjerizmi është shfaqje e panatyrshme e një përjetimi bosh të brendshëm të njeriut që realizohet me sjellje artificiale, me mimikë të çuditshme, me shprehje figurash stilistike shpesh jo të qëndrueshme, me qëndrim jo të zakonshëm të trupit në formë karikature etj. Disa prej këtyre simptomave karakterizojnë histerinë, skizofreninë, si edhe psikozën e manisë.

MARAZ, - I. m. I ardhur nga greqishtja *μαραίνω* "shuarje, zhdukje". Formë e depresionit anaklinik, e rrënimit të individit. Marazi shkaktohet nga pengimi i zhvillimit emocional, ndijimor dhe shoqëror të tij. Në fillim të përdorimit të këtij termi, ai ka emërtuar rrënimin organik të të vegjëlve nga ushqimi i dobët dhe nga mungesa e sasisë dhe e cilësisë së tij. Më vonë kjo domethënie është bartur edhe në rrënimin psikik, duke emërtuar në radhë të parë rrënimin emocional, që lidhet me çrregullimin e proceseve të tjera psikike.

MARBE Karl (Carl MARBE). Psikolog gjerman. Lindi në Paris më 1869 dhe vdiq në Vyrsburg më 1953. Mbështeti zhvillimin e psikologjisë eksperimentale mbi bazën e hulumtimeve të Vilhelm Vuntit, duke u marrë kryesisht me gjurmimin eksperimental të procesit të mendimit dhe të çështjeve të psikologjisë forenzike. Qysh herët u njoh me pikëpamjet dhe qëndrimet psikologjike të Hygo Mynsterbergut në Frajburg, të Herman Ebinghauzit në Berlin, të Vilhelm Vuntit e të Osvald Kylpes në Lajpcig dhe të Alfred Bines në Paris. Në Vyrcburg u bë i njohur me zbatimin e metodës eksperimentale në studimin e procesit të mendimit dhe me rezultatet e arritura në këtë fushë. Profesor ordinar i psikologjisë eksperimentale në Handelshoschule, Frankfurtit (Shkolla e Lartë Komerciale). Ishte drejtor i kësaj shkolle prej vitit 1926 deri në vitin 1931. Bashkë me Osvald Kylpen gjurmuan procesin e mendimit; ku Marbe u ndal posaçërisht në gjurmimin e lidhjes së përfytyrimeve me procesin e mendimit. Në gjurmimet e kësaj lidhjeje konstatoi se përfytyrimet nuk ishin të domosdoshme në procesin e mendimit, pra në zgjidhjen e problemeve. Më vonë u mor me zbatimin e dijeve dhe të metodave psikologjike në forenzikë, ku dha një kontribut të posaçëm. Përgjithësisht njihet si psikolog eksperimentalist, kontribues i rëndësishëm në zhvillimin e psikologjisë empirike mbi bazat eksperimentale. Veprat kryesore të tij janë: *"Grundzuge der forensiche Psychologie"* – (*"Bazat e psikologjisë fornzikë"*), 1*913; "Die action gegen die Psychologen"* – (*"Veprimi kundër psikologut"*), 1913; *"A history of psychology in autobiography"* – (*"Historia e psikologjisë në autobiografi"*), 1936.

MARFI Gardner (Gardner MURPHY). Psikolog amerikan. Lindi më 1895 dhe vdiq më 1979. Kreu studimet në Universitetin e Jelës dhe në Universitetin e Harvardit. Nga viti 1921 ka qenë profesor i katedrës së psikologjisë në Universitetin e Kolumbisë dhe më 1923, në moshën 28-vjeçare mbrojti doktoratën në të njëjtin universitet.

Më 1940 qe drejtor i departamentit të psikologjisë në "City" Kolegj të Universitetit të Nju Jorkut, kurse më 1952 iu përgjigj ftesës së fondacionit Meninger, duke u bërë drejtues i këtij fondacioni. Në vitin 1967 iu kthye mësimdhënies së psikologjisë në Universitetin Xhorxh Uashington. U mor me studimin e procesit të të mësuarit, ku theksonte rolin e tërësisë së perceptuar në zhvillimin dhe organizimin e sjelljeve, si edhe me strukturën e dinamikën e personalitetit në dritën e funksionit të të mësuarit dhe të ndryshimeve progresive të sjelljeve. Veprat kryesore të tij janë: "*Personality: A Biosocial Approach to Origines and Structures*" – (*"Personaliteti: hyrje biosociale në origjinën dhe në strukturën"*), 1947; *"Historical introduction to modern psychology"* – (*"Hyrje hostorike në psikologjinë bashkëkohore"*), 1949.

MARGO, - T. m. I ardhur nga latinishtja "anësor, skaj". Në psikologji një e dhënë për subjektin e provuar ndodhet në margo, kur ajo e dhënë gjendet në përfundim të një klase të dhënash dhe në fillim të një klase tjetër të dhënash. Objekti i vëmendjes gjendet në margo atëherë kur njeriu mezi e heton, kur ai gjendet në qendër të vëmendjes, përkatësisht kur njeriu nuk është plotësisht i vetëdijshëm për ndikimin e tij.

MARIJUHANË, - A. f. Në farmakologji, hashash dhe kanabis. Marijuhana është lloj i drogës psikaktive që i përket bimës *cannabis indica.* Nga fletët e kësaj bime merren majat dhe pas tharjes së tyre përpunohen dhe formohen cigare që thithen në formën e pirjes së duhanit. Nga tymi i thithur prej saj përdoruesi ndryshon karakterin e proceseve psikike dhe të sjelljes së tij. Ndër karakteristikat e ndryshimeve të tilla janë: euforia, kënaqësia seksuale e shoqëruar me halucinacione të llojllojshme, përgjumja, ndryshimet e mëdha në perceptimin e kohës dhe të hapësirës (minuta duket shumë e gjatë, të gjitha objektet e dukuritë duken shumë të largëta etj.), përjetimi se nuk ka kurrfarë pengesash në jetën dhe në veprimtarinë e tij etj. Varësia psikike dhe fizike e njeriut nga marijuhana është shumë më e rrallë se në rastin e marrjes së opiateve. Megjithëkëtë, ata që marrin marijuhanë dhe që kanë zhvilluar shprehinë e marrjes së saj ose të hashashit strukturohen si individë psikopatë.

MARRË (I, E). mb. I çmendur, me çrregullime psikike që godasin në radhë të parë proceset kognitive (perceptimin, kujtesën, të menduarit e të folurit). Te i marri këto çrregullime shfaqen në këputjet e shpeshta të lidhjeve ndërmjet formave e përmbajtjes së mendimit, të rrjedhës së mendimit, në përdorimin e një numri të kufizuar fjalësh, në përqendrimin e njeriut në raportet sipërfaqësore duke mos pasur mundësi të dallimit të raporteve thelbësore ndërmjet objekteve e dukurive të botës reale dhe me varfëri të jetës emocionale të tij.

MARRËDHËNI/E, - A. f. Lidhje e ndërsjellë ndërmjet dy ose më shumë objekteve, dukurive, ndryshoreve, proceseve, situatave etj. Kjo lidhje e ndërsjellë gjendet me anën e procesit të mendimit ose vihet në anën e mendimit, përkatësisht i atribuohet procesit të të menduarit. Lidhjet e tilla i

karakterizon ndikimi që ushtron njëra dukuri në tjetrën, në mënyrë të tillë që ajo, e cila ka vlerë për njerën, ka vlerë edhe për tjetrën ose përkundrazi, ajo që nuk ka vlerë për njërën ka vlerë për tjetrën. Lidhje ose marrëdhënie të tilla në psikologji ka shumë dhe këto në gjurmimet psikometrike përcaktohen sidomos me anë të metodës së ndërlidhjes ose të korrelacionit. Marrëdhëniet në psikologji mund të jenë dy llojesh:

a. **Marrëdhënie parësore** – Marrëdhënie afatgjatë ndërnjerëzore që bazohet në lidhjet e fuqishme emocionale ndërmjet dy apo disa individëve, të cilët njihen shumë mirë me njëri-tjetrin; këto nuk i kufizojnë rolet e tyre në caqe të normuara, por i tejkalojnë me besim të madh në rolin e njërit dhe të tjetrit;

b. **Marrëdhënie dytësore** – Marrëdhënie ndërmjet dy a më shumë individëve, por që janë afatshkurtra dhe zhvillohen kryesisht në kuadrin e caqeve dhe të normave të caktuara grupore. Lidhja emocionale ndërmjet tyre është lidhje sipërfaqësore dhe një individ mund ta zëvendësojë lehtë individin tjetër në aktivitetet e tyre brenda një grupi.

MARRËDHËNIA FIGURË – SFOND. Raport i rëndësishëm për perceptimin e drejtë të një figure dhe të sfondit mbi të cilin ajo është vizatuar. Në këtë raport së pari dallohet objekti që imponohet, kurse sfondi mbi të cilin gjendet ai objekt është më i vakët. Kontrasti ndërmjet tyre është njëri ndër faktorët e qartësisë së objektit të perceptimit. Shih – ***VAZOJA RUBIN.***

MARRËDHËNIET NDËRNJERËZORE. Lidhje e ndërsjellë bashkëpunimi ndërmjet dy a më shumë individëve në një fushë të caktuar bashkëpunimi (bashkëpunim dhe bashkëveprim në ekip mjekësh, sportistësh, shkencëtarësh, në fabrikë, në institucione arsimore, informative, shkencore, në njësi ushtarake etj.). Një lidhje dhe bashkëpunim i tillë është i tipit fëmijë - prind, student – profesor, punëtor – punëdhënës etj. Marrëdhënie të tilla kanë shtrirje horizontale, vertikale dhe të kombinuar. Marrëdhëniet horizontale kanë të bëjnë me bashkëpunimin dhe bashkëveprimin ndërmjet anëtarëve të një grupi, të një ekipi, të njësive etj. dhe të pjesëtarëve të tyre që kanë nivel të barabartë aftësish, shkollimi, shoqëror etj.; marrëdhëniet vertikale janë ato që zhvillohen ndërmjet anëtarëve që kanë nivel aftësish, shkollimi, shoqëror etj. të pabarabartë. Motivet, shtrirja e kompetencave, synimet etj. të tyre janë të ndryshme dhe këto kanë mundësi të vlerësohen. Bazën psikologjike të marrëdhënieve ndërnjerëzore e përbëjnë tiparet e arsyes, zhvillimi i ndjenjës së identitetit të njeriut nëpërmjet marrëdhënieve të tij me të tjerët, motivi i vetaktualizimit të personalitetit në marrëdhëniet ndërnjerëzore etj. Këto marrëdhënie zhvillohen në formën fjalësore dhe jofjalësore, por në formë komunikimi në procesin e punës. Këto marrëdhënie mund të jenë marrëdhënie të suksesshme ose të pasuksesshme, pozitive a negative, të mira a të këqija, plotësuese a jo plotësuese etj. Me studimin e marrëdhënieve ndërnjerëzore merret psikologjia sociale, psikologjia klinike, psikologjia e punës etj. Termi

marrëdhënie ndërnjerëzore është futur në terminologjinë e psikologjisë së punës më 1924, kur u argumentua në eksperimentimet e Heutornit ndikimi i marrëdhënieve ndërnjerëzore në produktivitetin e punës.

MAS/Ë, - A. Në psikologjinë sociale, tërësia e pjesëtarëve të një grupi të madh të paorganizuar, të pastabilizuar, me strukturë të ndryshme, që i shtyn të jenë në këtë grup një motiv ose një qëllim i përbashkët. E tillë mund të jetë masa e një mitingu, koncerti, ekspozite etj. Në këtë masë njerëzish pjesëtarët e masës komunikojnë lirisht njëri me tjetrin, i shprehin lirisht emocionet, qëndrimet dhe bindjet e tyre, duke synuar që t`i kenë edhe sjelljet e njëjta ose të ngjashme. Ndaj udhëheqësit e tyre orvaten të sillen në mënyrë uniformike.

MASA INTERMEDIA. I ardhur nga latinishtja. Në anatominë e sistemit nervor masa intermedia emërton indin nervor, i cili lidh dy pjesët, përkatësisht dy gjysmat e talamusit. Shih *–TALAMUSI.*

MASA STATISTIKORE. E dhënë statistikore e përftuar nga matja herë pas here e një ndryshoreje psikologjike të një subjekti, ose nga matja e së njëjtës ndryshore te subjektet e një moshe, gjinie etj. Sasia e të dhënave të përftuara nga matjet e tilla krijojnë grumbullin e të dhënave statistikore që duhet përpunuar, për të vërtetuar ose mohuar hipotezën e parashtruar të një gjurmimi.

MASA THEMELORE E TË DHËNAVE. Grumbulli i të dhënave numerike të përftuara nga matja e një ndryshoreje psikologjike të pjesëtarëve të një mostre apo të një gjedhi të caktuar, i cili përfaqëson numrin e përgjithshëm të anëtarëve të masës së gjerë për ndryshoren që studiohet. Kjo masë e të dhënave përfaqëson bazën e të dhënave që i nënshtrohen përpunimit statistikor të tyre.

MASA TENDRYSHUESHMËRISË. Masa që përcaktojnë shkallën e dallimit numerik të vlerave individuale nga vlera mesatare e tyre. Përdoren për të emërtuar edhe dallimet ndërmjet arritjeve në një test të subjekteve të provuar me anë të këtij testi. Në psikometri emërtojnë shmangien e vlerave numerike individuale nga vlera mesatare e tyre. Për këtë qëllim zbatohen këto masa të ndryshueshmërisë:

a. **Shmangia standarde** – Shmangie që tregon sa të ngjeshura janë vlerat numerike individuale rreth vlerës numerike mesatare, përkatësisht rreth vlerës mesatare aritmetike. Shmangia standarde është një normë ose standard, që në bazë të përcaktimit të saj kuptojmë nivelin e shmangies së një të dhëne numerike individuale nga vlera aritmetike e atij grupi të dhënash. Shmangia standarde llogaritet sipas kësaj formule:

$$Sh.M.K.(\delta) = \sqrt{\frac{\sum d^2}{N}}$$

Sipas kësaj formule llogaritet në fillim shuma e ndryshimeve individuale nga vlera e së mesmes aritmetike e ngritur në katror dhe kjo shumë pjesëtohet me numrin e subjekteve të provuara, përkatësisht me N dhe nga kjo shumë nxirret rrënja katrore. Shmangia standarde quhet edhe shmangie kuadra-

tike. Shmangia standarde ose kuadratike është masa më e saktë e llogaritjes së ndryshueshmërisë së të dhënave nga vlera mesatare e tyre.

b. **Shmangia mesatare** – Masë statistikore e përcaktimit të homogjenitetit ose heterogjenitetit të vlerave sasiore psikologjike të anëtarëve të një grupi të provuar. Shmangia mesatare llogaritet sipas kësaj formule:

$$Sh.M. = \frac{\sum dM}{n}$$

Sipas kësaj formule në fillim llogaritet ndryshimi sasior ndërmjet vlerave individuale dhe mesatares aritmetike dhe shuma e përftuar pjesëtohet me numrin e subjekteve të provuara ose me N.

MASAT E VLERËS QENDRORE. Vlera qendrore të përftuara nga sasia e të dhënave të matjes së një ndryshoreje psikologjike që përfaqësojnë vlerën e përgjithshme ose mesatare të arritjeve nga matja e disahershme e asaj ndryshoreje te një individ ose nga matja e asaj ndryshoreje te një grup i caktuar subjektesh. Masat e vlerës qendrore i përkasin statistikës përshkruese ose deskriptive Masat e vlerës qendrore janë:

a. **Masa aritmetike** – Mesatarja aritmetike që përftohet nga mbledhja e të gjitha vlerave numerike të matjes së një ndryshoreje dhe kjo shumë pjesëtohet me numrin e subjekteve pjesëmarrës në matjen e kësaj ndryshoreje. Formula e përgjithshme e gjetjes së mesatares aritmetike është: Ma = shm : N, ku Ma është shkurtesa për mesatarën aritmetike, shm = mbledhja numerike e të arritjeve dhe N = numri i subjekteve që kanë marrë pjesë në matjen e asaj ndryshoreje. Mesatarja aritmetike zbatohet atëherë kur shpeshtësia e të dhënave numerike ka karakter të shpërndarjes normale të tyre;

b. **Masa e mesores** – Vlera e mesme numerike ose mediana e një numri të vogël të arritjeve të subjekteve të provuara e të rreshtuara nga më e madhja te më e vogla ose nga më e vogla te më e madhja, ku vlera numerike që gjendet në mesin e këtij rreshti vlerash numerike përfaqëson mesoren ose medianën. Mesorja zbatohet vetëm kur kemi të bëjmë me një numër të kufizuar subjektesh (15 – 20) dhe kur vlerat numerike individuale janë asimetrike. Kjo masë e vlerës qendrore nuk zbatohet në gjurmimet e ndërlikuara;

c. **Masa mbisunduese** - Vlera numerike e përsëritur më shpesh ndër vlerat numerike të matjes së një ndryshoreje psikologjike. Masa mbisunduese është vlera numerike që ka frekuencë më të lartë ndër vlerat e tjera numerike. Masa mbisunduese ose dominante zbatohet atëherë, kur kemi nevojë ta përcaktojmë me afërsi vlerën numerike mesatare. Kjo masë në psikometri është e njohur me termin mod.

MASKIM, - I. m. I futur në psikologji nga gjermanishtja *maskiern* "fsheh". Dukuri e perceptimit të trupave që ka të bëjë me pengim të pjesshëm ose të plotë të perceptimit të ngacmuesve të shqisave e receptorëve të tyre, kur shkaktohet perceptimi i pasaktë dhe nuk mundësohet ose, madje deformohet ky perceptim, për shkak të veprimit të njëkohshëm të dy ose më shumë ngacmuesve, ose për shkak të ndikimit suksesiv të tyre në shqisat e njeriut. Maskimi mund të shfaqet te të

gjitha llojet shqisore të perceptimit të trupave, të dukurive, të proceseve, të situatave etj. Në psikologji dallohen këto lloje maskimesh:

a. **Maskimi dëgjimor** –Ton i dallueshëm me vështirësi, që fshihet nga ndikimi që ushtron në të njëjtën kohë ose menjëherë pas tij toni më i lartë, ose kur toni i lartë mbulohet me një ton i thellë duke e penguar perceptimin e të parit;
b. **Maskimi nuhator** – Fshehje e erës së një burimi nga era më intensive e burimit tjetër;
c. **Maskimi pamor** – Fshehje e formës së një trupi të mbuluar me formën e një trupi tjetër etj. Zbatohet sidomos në psikologjinë ushtarake, në rastin e veshjes së ushtarëve me rroba të bardha, kur këta fshihen nga zbulimi i armikut në periudhën e dimrit, kur moti është me borë.

MASKIMI I DEPRESIONIT. Formë e fshehjes së simptomave të depresionit nga ndryshimet fiziologjike që e kanë bazën në sistemin nervor autonom ose vegjetativ. Ndryshimet e këtij sistemi nervor te maskimi depresiv dalin në plan të parë, kurse simptomat e depresionit psikik, që janë shenja thelbësore të këtij depresioni mbeten në plan të dytë. Maskimi i depresionit përmendet në literaturën e psikiatrisë relativisht vonë, në shekullin e njëzet.

M

MASLOU Abraham (Abraham MASLOW). Lindi në Broklin, SHBA më 1908 dhe vdiq në Menlo Park (Kaliforni) më 1970. Fëmija i shtatë inteligjent i prindërve të varfër me origjinë hebreje. Në fillim studioi drejtësi në kolegjin e Nju Jorkut, por më 1928 filloi të interesohet për psikologji dhe të merret me studime rreth psikologjisë. Kreu doktoratën në psikologji më 1934 në Universitetin Viskonsin. Në kolegjin universitar të Bruklinit qe mësimdhënës i psikologjisë prej 14 vjetësh; u mor me studimet e sjelljeve, sepse kur ishte në qarkun e psikologëve të njohur Karen Hornej dhe neopsikanalistit e sociologut Erik From, por edhe të antropologëve Ruti Benedikt dhe Margaret Mid, si edhe Gardner Marfi e Eduard Tolman, qe ithtar i madh i bihejviorizmit. Ishte asistent i Eduard Torndajkut. Qysh herët u shkëput nga bihejviorizmi, por u dëshpërua edhe me pikëpamjet e psikanalizës dhe u mor me gjurmimin e drejtimeve të tjera të psikologjisë. Në këtë drejtim emri i tij lidhet me psikologjinë e motivacionit, përkatësisht me drejtimin e psikologjisë humaniste. Nga viti 1968 qe kryetar nderi i Shoqatës së Psikologëve të Amerikës dhe anëtar i Fondacionit Laughlin. Vdekja nga ataku në zemër e gjeti në këtë funksion. Më 1943 botoi artikullin e njohur "*Teoria e motivacionit*" në revistën "Psychological Review". Nga përmbajtja e këtij artikulli dallohet angazhimi i tij në fushën e psikologjisë së dinamikës së personalitetit. Në këtë fushë ai dallonte dy lloje nevojash njerëzore, të cilave u jepte shpjegim të posaçëm. Grupin e parë të këtyre nevojave e përbëjnë të ashtuquajturat "*D – needs*", pra "deficiency needs" – "nevoja që burojnë nga mungesa e lëndëve të domosdoshme për jetën e organizmit të njeriut"; këto janë nevojat biologjike të organizmit të njeriut. Grupin e dytë të nevojave e përbëjnë të ashtuquajturat "*B needs*", pra "being needs" – "nevojat zhvillimore". Nevojat e grupit të parë

lindin nga mungesa e ushqimit, e ujit, e sigurimit të organizmit etj. Nevojat e grupit të dytë janë nevoja zhvillimore psikologjike, të cilat Abraham Maslou i quajti "metanevoja", ku bënin pjesë nevoja për bamirësi, bukuri, dashuri, drejtësi, shoqërizim, prestigj, kureshtje dhe vetaktualizim. Strukturën e nevojave e renditi në një sistem hierarkik të njohur me emërtimin sistemi hierarkik i nevojave, të cilin e përbëjnë shtatë grupe nevojash; pa plotësimin e grupit të parë nuk fillon të realizohet grupi i dytë, dhe, përgjithësisht pa plotësimin e grupit paraprak të nevojave nuk aktualizohen nevojat e grupit më të lartë. Nevojat e këtij sistemi kulmojnë me nevojën e vetaktualizimit – aktualizimi i vetë personalitetit dhe i potencialeve psikologjike zhvillimore të tij, që arrihet vetëm atëherë kur shtatë grupet e nevojave të tjera janë plotësuar. Veprat kryesore të tij janë: *"Motivation and Personality"* – (*"Motivimi dhe personaliteti"*), Harper & Row. New York, 1976; "*Toward a Psychology of Being",* 1968, që u përkthye edhe në gjuhën shqipe *"Drejt psikologjisë së qenies",* 2008.

MASTURBIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *manus* "dorë" dhe *stupare* "përlyej". Vetëkënaqësi e degjeneruar e disa meshkujve dhe femrave, të cilët ngacmojnë me duar organet seksuale, duke shkaktuar në këtë mënyrë orgazmën. Masturbimi është dukuri relativisht normale, por vetëm brenda disa kushteve kufizuese të saj. Zakonisht është dukuri e moshës së pubertetit dhe e adoleshencës, por është i pranishëm edhe te të rriturit, sidomos te ata, që me vështirësi arrijnë të krijojnë kontakt me partnerin e gjinisë tjetër (të arratisurit, të burgosurit etj.) Akti i masturbimit shërben për lehtësim të tensionit të shtytësit seksual dhe është i lidhur me emocionin e frikës dhe të fajit. Masturbimi është i rrezikshëm për shëndetin fizik e mendor. Kur në moshën e pjekurisë masturbimi shndërrohet në shprehi, atëherë ai merr formën e masturbimit patologjik. Rezultatet e disa gjurmimeve kanë treguar se shumica e adoleshentëve, madje në disa vende 92 % e tyre masturbohen.

MASHKULLORIZIM, - MI. m. Formë e mendimit, e qëndrimeve dhe e sjelljeve të veçanta të disa femrave që kanë dëshirë dhe synojnë të paraqiten me cilësi dhe me tipare, që tradicionalisht iu atribuohen personalitetit të meshkujve. Mashkullorizimi ka karakter individual.

MASHTRIM, - I. m. Cilësi e paraqitjes së të pavërtetës në mënyrë të vetëdijshme. Mashtrimi ka karakter të qëllimshëm dhe zakonisht kryhet në dobi të mashtruesit.

MASHTRIMET PERCEPTIVE. Shih – ***ILUZIONET.***

MATJA E DREJTPËRDREJTË. Një ndër matjet më të rralla në psikologjinë e drejtpërdrejtë që përcakton intensitetin e një ngacmuesi, të shtrirjes së një ngacmuesi etj., sipas një mase të caktuar (matet gjatësia e trupit me metër, temperatura e organizmit me termometër etj).

MATJA E ZHDREJTË. Matja e zhdrejtë ose indirekte është forma më e zbatueshme në psikologji. Maten në mënyrë indirekte zhvillimi i kujtesës së njeriut sipas sasisë së informacioneve të mbajtura mend, në bazë të riprodhimit të drejtë të tyre, matet

shkalla e zhvillimit të inteligjencës në bazë të numrit të detyrave dhe të problemeve të zgjidhura, shkalla e koordinimit të lëvizjeve dhe e shpejtësisë së tyre matet me numrin e saktë të këtyre lëvizjeve, përkatësisht me numrin e lëvizjeve të gabuara dhe të vonuara etj. Matja e zhdrejtë ose indirekte është përcaktimi i masës së saktë sasiore të një procesi, dukurie, qëndrimi, në bazë të efektit konkret të tyre, të shndërruar në shkallë vlerësuese të përcaktuar saktësisht.

MATJA NË PSIKOLOGJI. Gjurmimet e proceseve psikike dhe të sjelljeve të njeriut, të cilat kanë mundësi të përcaktohen si në këndvështrimin cilësor ose kualitativ, ashtu edhe në këndvështrimin sasior ose kuantitativ. Nga ana sasiore ose kuantitative matja e proceseve dhe e sjelljeve të njeriut është atribuimi numerik i tyre në përputhje me rregullat e caktuara. Matja në psikologji ka për qëllim vlerësimin sasior dhe përcaktimin e saktë të zhvillimit të një procesi psikik, të shtrirjes, të intensitetit, të efektit konkret sipas një kriteri të caktuar numerik. Psikologjia bashkëkohore shfrytëzon matjen e proceseve dhe të sjelljeve, sepse me to përshkruhen saktësisht dukuritë psikike, përcaktohet rregullsia e zhvillimit dhe e manifestimit të tyre, si edhe zbulohen lidhjet ndërmjet tyre dhe ndërmjet dukurive psikike dhe atyre fizike, biologjike e sociale, duke emërtuar në këtë mënyrë lidhjen shkakësore ndërmjet dukurive. Matja në psikologji është e mundur nëse plotësohen këto kushte: secili numër duhet të ketë identitetin e tij, të gjithë numrat më të mëdhenj ose më të vegjël rreshtohen sipas vlerës sasiore që kanë, duhet të përcaktohet rendi ndërmjet numrave që emërtojnë ndryshimet sasiore të dukurive psikike dhe, së fundi, rendi i tyre duhet të fillojë me zero (0), që emërton mungesë të plotë të çfarëdo intensiteti, shtrirjeje, zhvillimi etj. dhe të shkojë me shkallëzimin 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 e 9.

MATRIARKAT, - I. m. I ardhur nga latinishtja *mater* "nëna" dhe greqishtja *ἀρχοντας* "udhëheqës". Bashkësi shoqërore e udhëhequr nga gruaja, përkatësisht nga nëna, e cila ka rolin dominues në rregullimin e raporteve familjare dhe shoqërore, duke qenë më e nderuara dhe më e respektuara në mjedisin familjar. Dallohet forma e matriarkatit familjar dhe forma e matriarkatit shoqëror. Derisa në formën e matriarkatit familjar nëna e ka luajtur rolin dominues në familje, në sistemin e matriarkatit shoqëror femra, përkatësisht gruaja, e luan rolin dominues në shoqëri. Matriarkatin shoqëror e ka shpjeguar edhe psikanalisti humanist Erik From (Erich Fromm, 1900 – 1980).

MATRIC/Ë, - A. f. I ardhur nga frëngjishtja *matrice* që ka dy kuptime: 1) Tabela e posaçme e simboleve e përpiluar sipas kolonave të përkufizuara saktësisht dhe 2) Konteksti domethënës i veçantë. Në psikologji termi matricë emërton strukturën e përgjithshme të tipareve karakteristike të personalitetit, që kanë karakter të qëndrueshëm në sjelljet e tij.

MATRICA E BINDJEVE. Vlerat e objekteve të një mjedisi dhe roli i tyre në përcaktimin e llojit të sjelljeve të personalitetit. Termi matrica e bindjeve i përket psikologjisë së personalitetit, përkatësisht pikëpamjeve të

psikologut amerikan për personalitetin dhe sjelljet e tij Eduard K. Tolman (Edward Ch.Tolman, 1886 – 1959).

MATRICA E NDËRLIDHJES. Matrica e ndërlidhjes ose e korrelacionit është tabela ku janë të renditura ndryshoret, kurse në kolona rreshtohen ndryshoret e njëjta ose ndryshoret e tjera dhe, aty ku këto gërshetohen gjendet koeficienti i ndërlidhjes ose i korrelacionit, që saktësisht tregon shkallën e ndërlidhjes ndërmjet atyre ndryshoreve.

MATRICA PROGRESIVE RAVEN. Test jofjalësor ose joverbal i njohur për matjen e shkallës së zhvillimit të inteligjencës. Përbëhet nga 60 figura (matrica) të ndara në 5 grupe figurash nga 12 sosh. Secilës prej tyre u mungon një pjesë. Subjekti nga pjesët e afruara duhet të zgjedhë brenda një kohe të caktuar pjesën plotësuese të matricës. Figurat apo matricat renditen prej më të lehtave deri te më të vështirat dhe më të komplikuarat sipas raporteve logjike ndërmjet pjesëve më të lehta të asaj figure dhe pjesëve më të vështira të saj. Me anën e këtij testi vlerësohet shkalla e zhvillimit të faktorit të përgjithshëm të inteligjencës, e pikërisht shkalla e zhvillimit të rezonimit logjik e perceptiv. Zbatohet për matjen e inteligjencës së subjekteve prej moshës 6 – 65 vjeç. Ekziston edhe forma e testit për matjen e inteligjencës të të vegjëlve të moshës 5 – 11 vjeç. Testi është ekonomik, nuk kërkon zhvillim të faktorit verbal dhe vlerësohet lehtë. U konstruktua nga psikologu i Britanisë së Madhe Xhon K. Raven (John C. Raven, 1902 – 1970). Në fillim u zbatua për përzgjedhje të kandidatëve për shërbim ushtarake, por më pas edhe për nevoja të tjera. Ndër Shqiptarët e ka zbatuar psikologu shqiptar Pajazit Nushi në vitet e para të shekullit Të njëzetenjë dhe anëtarët e ekipit "Atom" në Prishtinë në vitet e para të dekadës së parë të shekullit të njëzet.

MATRICAT PROGRESIVE. Test për matjen dhe vlerësimin e zhvillimit të inteligjencës së një individi, të përpiluar nga ana e psikologut amerikan J. C. Raven. Detyrat dhe problemat që kërkojnë zgjidhje në këtë test janë të karakterit të përcaktimit të saktë të një mendimi dhe të rezonancës perceptuese. Detyrat e këtij testi janë të karakterit jofjalësor ose joverbal dhe kanë të bëjnë me perceptimin e një figure, së cilës i mungon një pjesë dhe subjekti duhet ta gjejë atë pjesë ndërmjet atyre të paraqitura dhe ta plotësojë këtë figurë brenda një kohe sa më të shpejtë. Forma bardhë e zi e figurave është e standardizuar për moshën prej 6 – 65 vjet. Zbatohet në formën individuale dhe kolektive. Testi Raven pati sukses edhe për matjen dhe vlerësimin e zhvillimit të inteligjencës te shqiptarët.

MATURACION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *maturus* "i (e) pjekur". Procesi i rritjes dhe i zhvillimit biologjik të organizmit sipas kodit gjenetik. Për maturacion nuk ndihet nevoja e ndërhyrjes së përvojës dhe të mësuarit. Shih – ***PJEKURIA.***

MATURI, - A. f. Qëndrim i stabilizuar i një individi, të cilin e karakterizojnë sjelljet e përmbajtura, veprimet e paramenduara mirë, mendimet e fjalët e peshuara drejt e të shprehura me përpikëri, duke njohur mirë edhe pasojat e tyre. Maturia zakonisht karakterizon individin e pjekur psikik e fizik**.**

MAZOHIZ/ËM, - MI. Formë e çrregullimit seksual që zhvillohet në bazë të kënaqësisë me partnerin, duke i sjellë atij dhembje, vuajtje e çnderim moral e fizik, përkatësisht duke përjetuar kënaqësinë e tij me pozitën fijuese të viktimës. Elementet e mazohizmit fillojnë nga fyerjet dhe ofendimet morale deri në sjellje shumë të vrazhda jonjerëzore dhe të dënueshme (kafshimi, përgjakja, rrahja e partnerit, mbyllja në dhomë dhe detyrimi i jetës në vetmi, lidhja e partnerit me tela thumbues etj.). Emërtimi i këtij çrregullimi ka ardhur nga shkrimtari Leopold fon Sasher Masoh (Leopold von Sacher-Masoch, 1836 – 1895). Ky shkrimtar ka botuar përshkrime të shumëllojshme të kësaj forme të perversionit seksual.

MAZOHIZMI DYTËSOR. Lloj i sjelljes mazohistike që shfaqet pas zhvillimit të sjelljeve parësore mazohistike. Kanë të bëjnë me ndikimin e synimeve agresive të shtypura e të ndrydhura, energjia e të cilave është kthyer te vetë individi, duke i shkaktuar vetvetes vuajtje, mundim etj.

MAZOHIZMI MASIV. Dukuri e çuditshme e një mase të gjerë të popullsisë së një vendi ose e të gjithë popullit të atij vendi që flijohet drejtpërdrejt nga nderimi, respektimi i regjimit të udhëheqësit të tyre dhe që duke përjetuar kënaqësi punojnë në dëmin e përgjithshëm të atij populli. Në literaturën e psikologjisë përmendet rasti i popullit gjerman nën sundimin e Adolf Hitlerit (Adolff Hitler, 1889 – 1945), por ka edhe raste të popujve të tjerë. Termin mazohizëm masiv e ka përdor psikanalisti austriak i mërguar në Amerikë Teodor Rajk (Theodor Reick, 1888 – 1970).

MAZOHIZMI PSIKIK. Dukuri psikike e njohur nga lashtësia që ka të bëjë me përjetim të kënaqësisë seksuale duke shkaktuar dhembje dhe duke pasur herë pas here dëshirë të një përjetimi të tillë seksual. Individi me këtë ves seksual e përjeton këtë kënaqësi seksuale që shkakton dhembje duke mos përjetuar frikë. Termin mazohizëm e ka përdorur fillimisht shkrimtari dhe juristi austriak Zaher fon Mazoh (Sacher vob Masoch, 1836 – 1895). Z. Frojdi (Sigmund Freud, 1856 – 1939) ka dalluar dy lloje mazohizmash: mazohizmin parësor – përjetim seksual në vuajte. Te kjo formë e mazohizmit një pjesë e libidos është e lidhur me shtytësin e vdekjes. Forma e dytë është mazohizmi dytësor – dëshirë seksuale për të arritur kënaqësinë seksuale duke i shkaktuar vetes dhembje. Në psikanalizë mazohizmi është mbrojtja e egos, mjet me të cilin egoja e njeriut përgënjeshtron superegon.

MBAMEND/JE, - JA. f. Mbajtja në mend e përmbajtjes së mësuar është proces i kujtesës. Me mbamendje kuptojmë procesin e ruajtjes së gjurmëve nervore që i shkakton përvoja e individit dhe të mësuarit aktiv nga ana e tij. Mbajtjes mend i paraprin procesi i të mësuarit të informacioneve, të koncepteve e lidhjeve ndërmjet tyre. Kusht i domosdoshëm i mbamendjes është të mësuarit me të cilin krijohen kushtet themelore të futjes së gjurmëve të asaj përmbajtjte që mësohet në kujtesën e njeriut, si edhe angazhimi i vetëdijshëm i njeriut në ruajtjen e gjurmëve të asaj që është mësuar ose

mësohet. Mbajtja mend është e njohur me termin *retencë*. Shih - ***RETENCA.*** "Mbamendja është arka e thesarit dhe roja e tij" (Ciceroni).

MBARESAT NERVORE TË LIRA. Mbaresa të fijeve nervore që janë të shpërndara në brendësi të lëkurës. Supozohet se mbaresat e fijeve nervore janë bartës receptorë të ndijimeve të dhembjes. Këto mbaresa nervore nuk kanë mbështjellës të posaçëm.

MBIKOMPENSIM, - I. m. Në psikologjinë individuale të Alfred Adlerit (Alfred Adler, 1870 – 1937) emërton synimin e shtuar të një individi për riaftësim të një strukture psikike, të një procesi, tipari etj., me qëllim zhvillimin e tij mbi nivelin e zhvillimit normal. Ky synim mbështetet në eliminimin e ndjenjës së inferioritetit dhe të zhvillimit të një vlere mbi nivelin normal të saj. Mbikompensimi mbështetet në energjinë psikike të angazhuar me qëllim nga ana e njeriut dhe me synimin që duhet kultivuar e zhvilluar. Mbikompensimi është reagim i njeriut ndaj ndjenjës së inferioritetit.

MBINXËNIE, - A. f. Përvetësim i një përmbajtjeje prozatike, poetike, motorike etj. mbi nivelin e përkryerjes së saj dhe angazhimi për përsosje të një niveli sa më të lartë të asaj përmbajtjeje. Mbinxënia është e pranishme sidomos te të mësuarit motorik, si të rënit e violinës, pianos etj.

MBISUNDIM, - I. m. Në psikologjisë sociale, prirje e dalluar e një tipari të personalitetit që ka të bëjë me sundimin e tij ndaj tipareve të tjerë. Mbisundimi i njërit mbi të tjerët është i lidhur me zhvillimin anatomik e fiziologjik të individit (pamja trupore) me përvojë, me pozitën dhe rolin e individit në grup, me nivelin e ndikimit social e kulturor të tij etj.

MBIZOTËRIM, - I. m. Qëndrim i stabilizuar i një individi që shfaqet në sjelljet kontrolluese të tij ndaj të tjerëve, i kryefamiljarit ndaj anëtarëve të tjerë të familjes, i kryeplakut të fshatit ndaj të tjerëve, i të parit pushtetar ndaj të tjerëve etj. Mbizotërimi mund të jetë edhe qëndrim i përbashkët social. I tillë është mbizotërimi i burrave ndaj grave, i pleqve ndaj të rinjve, i qytetarëve ndaj fshatarëve etj.

MBRES/Ë, - A. f. Gjurmët e mbetura në trurin e njeriut nga ndikimi që ka ushtruar në të perceptimi i parë i një gjësendi, i një individi, i një përmbajtje të mësimit të një lënde etj. Mbresa ka të bëjë drejtpërdrejtë me ndijimin e parë, të shoqëruar me ndjenjën e kënaqësisë ose të pakënaqësisë. Termi *mbresë*, apo *impresion* u përdor nga Dejvid Hjum (David Hume, 1711 – 1776) për të bërë dallimin nga "ideja". Pohohet se Hjum ishte kundër lidhjes së kuptimit të këtij termi me teoritë përfaqësuese të perceptimit, që kishin të bënin më tepër me idetë. Aleksandër Xhuvani (1880 – 1961) në përpjekjet e rij për pastrimin e gjuhës shqipe nga fjalët e huaja, ndër të tjera ka kërkuar të përdoret fjala *mbresë*, përshtypje në vend të fjalës *impresion*.

Burimet:

David Hume: "*A treatise of human natyre*" – (*"Traktat mbi natyrën njerëzore"*), Bk I. pt I. sect. I, 1738.

Aleksandër Xhuvani: "*Për pastërtinë e gjuhës shqipe"*, Tiranë, 1965.

MBURRJ/E, - A. f. Ndjenjë krenarie, kënaqësie, gëzimi etj. për veprën e kryer, për rolin e suksesshëm të saj,

për realizimin me mjeshtëri të saj, për qëndrimin burrëror të një individi të caktuar në një situatë të ndërlikuar sociale, ekonomike, politike etj. Mburrja, si edhe krenaria, është e drejtuar në vetëqenien e njeriut. Mburrja luan rol të rëndësishëm në vetformimin e personalitetit.

MEDIAL, - E. mb. I ardhur nga latinishtja në terminologjinë e anatomisë, të fiziologjisë dhe të psikologjisë fiziologjike, që ka kuptimin e së mesmes, përkatësisht të një ndryshoreje të mesme, të bërthamës së mesme të dy qelizave nervore, të rrokjes së mesme të një fjale etj.

MEDIAL FOREBRAIN BUNDLE. Gërshetë mesore e fijeve nervore të trurit të përparmë, që kohët e fundit haset në literaturën e psikologjisë të përkthyer nga anglishtja. Gërsheta e ndërlikuar e fijeve nervore të trurit të përparmë ka edhe rrënjë të bërthamës së nervave të trurit të mesëm. Kjo gërshetë fijezash nervore kalon nëpër pjesën anësore të hipotalamusit dhe përfundon në pjesët e ndryshme të limbikut dhe të fushave të ndryshme të kores a cipës së trurit të madh. Gërsheta mesore e fijeve nervore të trurit të përparmë merr pjesë në kryerjen e funksioneve të ndërlikuara nervore dhe të sjelljeve të njeriut: rregullon procesin e fjetjes, të zgjimit dhe të zhvillimit të proceseve emocionale.

MEDIANË, - A. f. I ardhur nga latinishtja *medius* "mesor". Masë e përcaktimit të prirjes qendrore të një dukurie, procesi,veprimi etj., që përcaktohet nga vlerat numerike individuale të përftuara prej matjes së tyre te një numër i vogël subjektesh. Mediana është vlera numerike që gjendet në mesin e vlerave individuale, duke ndarë përgjysmë vlerat individuale të renditura prej më të lartës deri te më e ulëta. Mediana ndan vlerat sasiore në dy grupe: 50 % gjenden në njërën anë dhe 50 % në anën tjetër. Te rezultatet e pagrupuara mediana llogaritet sipas formulës: M = N + 1 : 2. N është numri i përgjithshëm i rasteve individuale dhe këtij numri i shtohet 1 dhe kjo shumë pjesëtohet me 2. Shih – ***MASA E MESORES.***

MEDIOSKEN/Ë, - A. f. Emërtimi i një dukurie në zhvillimin fizik, psikik e moral të njeriut në moshën 45 – 55-vjeçare. Ka të bëjë me përjetimin e nevojës së individit të kësaj moshe për të kërkuar identitet të ri, pasi ka përshtypjen se është i humbur në konfuzionin e situatave sociale, ekonomike, politike etj.

MEDITIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *meditation* "përsiatje", që përdoret në filozofi, në mësimet e religjionit dhe në psikologji. Në psikologji emërton gjendjen e individit, i cili mendon thellë, përqendrohet në një çështje a problem dhe në zgjidhjen e drejtë të tij, duke lënë anash ngacmuesit e jashtëm. Njeriu që mediton fokusohet në një çështje të caktuar dhe ndërmerr aktivitete shtypëse të funksionit të sistemit nervor simpatik, ku ngadalësohen proceset metabolike, kurse vëmendja e njeriut që mediton ngushtohet, përkatësisht fokusohet vetëm në një çështje të caktuar. Në psikoterapi meditimi emërton teknikën e vënies së pacientit në gjendjen e përqendrimit të madh të vëmendjes, të relaksimit sa më të plotë fizik e psikik, me qëllim të identifiki-

mit të saktë të unit të tij dhe zhvillimit të fuqisë rezistuese ndaj streseve. Me rastin e meditimit janë argumentuar këto ndryshime: zhvillimi i alfa valëve trunore, rënia e harxhimit të oksigjenit, përjetimi i përvojës relaksuese të organizmit. Shih – ***PËRSIATJA.***

MEDITIMI TRANSSHENDENTAL. I ardhur nga latinishtja *meditativus* "i kredhur në mendime, zhytje e njeriut në mendime të thella". Zbatohet për qëllime psiko-terapeutike. Ka për synim relaksimin psikik të njeriut duke u mbështetur në ndryshime psikike mirëbërëse, përkatësisht në ushtrime ditore prej dyzet minutash. Këtë formë e ka zbatuar Maharish Mahesh Jogi dhe përkrahësit e kësaj forme zhyten në mendime për të kuptuar "Çfarë është mantri?!". Kjo gjendje shoqërohet me disa ndryshime fiziologjike të organizmit të njeriut. Zbatohet në forma të ndryshme që kanë pësuar ndryshime që nga koha e mendimeve filozofike të budizmit.

MEDULA OBLONGATA. Emërtim latin i pjesës së vazhduar të trurit, të sistemit nervor qendror. Kjo lidh pjesën e sipërme të palcës së kurrizit me organin nervor të quajtur urë ose pons. Medula oblongata ka shumë rrugë nervore aferente dhe eferente. Në këtë pjesë të sistemit nervor janë të vendosura bërthamat ose nukleuset e nervave të trurit, përkatësit të nervit IX (nëntë), X (dhjetë), XI (njëmbëdhjetë) dhe XII (dymbëdhjetë). Medula oblongata ka qendra funksionale të rëndësishme të jetës së njeriut, si atë për funksionimin e zemrës, të presionit së gjakut dhe të frymëmarrjes.

MEGALOMANI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *μεγαλο* "i (e) madh" dhe *μανία* "marrëzi". Dukuria e disa individëve, të cilët përjetojnë ndjenjën e mbivlerësimit të aftësive, të punës, të veprës etj. së tyre; kjo është ndjenjë e tepruar e vlerës personale që ata ia atribuojnë vetes. Megalomania konsiderohet se është pjesë përbërëse e çrregullimit narcizoid.

MEJOZ/Ë, - A. f. Në embriologji, proces i ndarjes së qelizës kur prej kësaj ndarjeje lindin qeliza me numër të përgjysmuar kromozomesh, në raport me qelizën ndarëse të tyre. Me këtë proces ndahet sperma në 23 kromozome dhe vezoret e femrës po ashtu në 23 kromozome. Shih - ***MITOZA.***

MEKANICIZ/ËM, - MI. m. Doktrinë e përgjithshme e shpjegimit të dukurive natyrore, biologjike, shoqërore e psikologjike sipas parimeve dhe ligjeve të fizikës mekanike. Përmbajtja e një doktrine të tillë ka përçuar edhe disa drejtime psikologjike, duke theksuar se sjelljet e njeriut mund të shpjegohen në bazë të funksionimit të makinave të ndërlikuara, përkatësisht në bazë të reduktimit të dukurive psikologjike sipas parimeve dhe ligjeve të fizikës mekanike. Psikanaliza e Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939) e ka shpjeguar zhvillimin e personalitetit, duke shfrytëzuar parimet e ligjet e hidraulikës, sipas të cilave energjia e përhershme, energjia konstante psikike gjatë zhvillimit të personalitetit shndërrohet prej një forme në formën tjetër.

MEKANIZ/ËM, - MI. m. Tërësi veglash e veprimesh të lidhua ndërmjet tyre në mënyrë të veçantë që, duke e vënë në lëvizje njëra-tjetrën funksionojnë si makinë. Funksioni i mekanizmit kryhet sipas një cikli të

pandryshuar dhe ka karakter ritmik të posaçëm. Në psikologji termi mekanizëm emërton tërësinë e funksioneve të koordinuara që kryhen në mënyrë të automatizuar me anën e organeve të veçanta të trupit të njeriut. Të tillë janë:

a. **Mekanizmi i kushtëzimit** – Mënyrë e mësuar e reagimit të organizmit ndaj ngacmuesve jonatyrorë, në bazë të lidhjes së përkohshme nervore që formohet nga ndikimi i ngacmuesit natyror e jonatyror në organizëm. Shih – ***KUSHTËZIMI***;

b. **Mekanizmi i përshtatjes së organizmit** – Harmonizimi i marrëdhënieve ndërmjet organizmit dhe kërkesave biofizike, shoqërore, kulturore etj., me anë të të cilave individi plotëson motivet dhe ka mundësi t`i plotësojë kërkesat e ndryshme të mjedisit të vet.

MEKANIZMAT E PUNËS SË ËNDRRËS. Mekanizma të pavetëdijshëm të shndërrimit të përmbajtjes së vërtetë të një ëndrre, të mendimeve latente të saj, në ëndërr manifestuese, që zakonisht ëndërruesi është në gjendje ta riprodhojë pak a shumë. Një shndërrim i tillë kryhet me anë të ngjeshjes së mendimeve, simbolizimit të posaçëm të përbërësve të saj dhe përpunimit dytësor të informacioneve të ëndrrës. Roli i këtyre mekanizmave është që ta bëjë ëndrrën jotransparente, të ndryshueshme dhe të pakuptueshme.

MEKANIZMAT MBROJTËS. Forma të sjelljeve të veçanta të njeriut, me anën e të cilave ai i largon nga vetëdija e tij ose, së paku, përpiqet t`i lerë anash ato përmbajtje, që i shkaktojnë atij konflikte të brendshme, ankth, frustrim etj., duke mbrojtur egon e njeriut nga përballja me impulse të padëshiruara. Këta mekanizma kanë për qëllim mbrojtjen e personalitetit të vet dhe dinjitetin e tij. Një mbrojtje e tillë i përket egos së personalitetit dhe egoja e shtyn, e shtyp, e ndrydh energjinë e shtytësve, duke mos lejuar që ajo energji të shkaktojë frikë, ankth dhe duke penguar zhvillimin e atyre kushteve psikike që e shpien njeriun në çrregullime neurotike. Mekanizmat mbrojtës i përkasin pjesës së pavetëdijshme të egos. Mekanizmat mbrojtës kanë këto veçori: 1) janë veprime automatike të pavetëdijshme, 2) veprojnë në drejtim të mohimit ose të falsifikimit të realitetit. Mekanizmat mbrojtës janë theksuar nga ana e Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939) dhe të bijës Ana Frojd (Anna Freud, 1895 – 1997). Në psikologji përmenden disa mekanizma mbrojtës, të cilët, psikanalisti austriak me nënshtetësi amerikane Oto Fenihel (Otto Fenichel, 1897 – 1946) i ka ndarë në mekanizma të suksesshëm dhe në mekanizma të pasuksesshëm. Mekanizmat mbrojtës të suksesshëm janë mekanizmat që kontrollohen nga egoja. Shih – ***SUBLIMIMI; REGRESIONI.*** Mekanizmat mbrojtës të pasuksesshëm, Shih – ***MOHIMI; NDRYDHJA*****; PROJEKSIONI; RACIONALIZIMI; "RRUSHI I THARBËT",** janë ato mekanizma që pengojnë ose bllokojnë shkarkimin e energjisë psikike në vetëdijen e njeriut.

MEKDUGAL Uiliam (**William MCDOUGALL**). Psikolog britanik. Lindi në Lankashire më 22.06.1871 dhe vdiq në Durham (Karolina Veriore) më 28.11.1938. Profesor i filozofisë mendore në Univeriste-

tin e Oksfordit prej vitit 1904–1920 dhe prej vitit 1920 ka zënë vendin e Hygo Mynsterbergut në Universitetin e Harvardit, ku u punoi si profesor i psikologjisë deri në vitin 1927; prej vitit 1927 deri në vitin 1938 profesor i psikologjisë edhe në Universitetin Duk. Në historinë e psikologjisë theksohet për pikëpamjet e tij të psikologjisë hormike, të parapsikologjisë, të mendjes grupore dhe, sidomos, me pikëpamjet e tij për instinktet dhe sjelljet. Për psikologun Uiliam Mek Dugal psikologjia duhet të merret me studimin e sjelljeve, bazën e të cilave e formojnë instinktet. Sipas tij "instinktet janë dispozita të trashëguara dhe të natyrshme që përcaktojnë perceptimin, ndjeshmërinë dhe aktivitetin". Në fillim të studimit të instinkteve dhe të sjelljeve të lidhura me instinkte ai ka numëruar 11 instinkte kryesorë, kurse më vonë e ka shtuar numrin e tyre, duke u përpjekur të shpjegojë tërësinë e zhvillimit të sjelljeve mbi bazën e instinkteve. Njëmbëdhjetë instinktet kryesorë sipas tij janë: 1. Instinkti i arratisjes nga rreziku, 2. instinkti i shtytjes në aktivitet, 3. instinkti i kureshtjes, 4. instinkti i agresivitetit, 5. instinkti prindëror, 6. instinkti i autoritetit, 7. instinkti riprodhues, 8. instinkti Gregar (prirja për të jetuar në grup me të tjerët, në kope, në tufë), 9. instinkti i vetëposhtërimit, 10. instinkti i konstruktivitetit dhe 11. instinkti i pangopshmërisë. Ka zhvilluar mendimet e tij në fushën e psikologjisë speciale, të cilën e ka konsideruar bazë të shkencave shoqërore. Veprat kryesore të tij janë: *"Introduction to Social Psychology"* – (*"Hyrje në psikologjinë sociale"*), 1908; *"Group Mind"* – (*"Mendja grupore"*), 1920; *"Outline of Psychology"* – (*"Ravijëzim i psikologjisë"*), 1923; *"Abnormal Psychology"* – (*"Psikologjia jonormale"*), 1926. Pohohet se ka shkruar 167 artikuj nga fiziologjia, psikologjia sociale dhe filozofia.

MELANKOLI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *μελάς* "i zi" dhe *χολέ* "tëmth, tëmthi i zi". Termi melankoli u përdor në fillim nga mendimtari i lashtë grek Hipokrati (Hipocrattes, rreth 460 – rreth 377 p. e. r.) për të emërtuar një nga katër lëngjet trupore dhe funksionin e tyre në ruajtjen e ekuilibrit të organizmit. Çekuilibri i këtyre lëngjeve shkaktonte sëmundje. Sot termi melankoli emërton gjendjen psikike të njeriut, të cilën e karakterizon dëshpërimi i thellë, pikëllimi gati i vazhdueshëm, tërheqja nga shoqëria dhe nga mjedisi i përbashkët, mosinteresimi për dukuritë e ndryshme, përjetimi i ndjenjës së jetës boshe dhe mbyllja e individit në vetvete. Veprimtaria e tij është si të thuash përherë e frenuar, është karakteristike më tepër për moshën 40 - 45 vjeç për femra dhe 55 – 65 vjeç për meshkuj. Në psikanalizë melankolia shpjegohet si pasojë e humbjes së objektit të dashuruar, por edhe i të njëjtit objekt me mërzi të pavetëdijshme, ndaj të cilit libidoja nuk ka ku të drejtohet e të përqendrohet, sepse është i vdekur, i humbur dhe e tërë energjia e libidos kthehet në veten e njeriut. Egoja e melankolikut identifikohet me egon e objektit të humbur (me bashkëshortin e vdekur, me mikun e burgosur për krime të rënda etj.), ndërkaq, super – egoja mbisundon shprehimisht, sepse has në ego të humbur.

MELATONIN/Ë, - A. m. Hormoni i gjëndrës së epifizës që i përket grupit të aminave biogjene. Prodhimi i këtij hormoni dhe derdhja e tij në gjak gjatë periudhës së zhvillimit të fëmijës e frenon zhvillimin seksual të tij. Te të rriturit besohet se melatonina rregullon ritmin biologjik gjatë njëzetekatër orëve, si edhe procesin e fjetjes së tyre. Nuk ka argument bindës për këtë funksion të tij.

MEMBRANA BAZILARE. Cipë e hollë që gjendet në kërmillin e veshit të brendshëm. Kjo cipë shtrihet prej themelit të kërmillit në afërsi të uzengjisë deri në majë të organit të kortit. Membrana bazilare është bartëse e receptorëve të vibrimit të valëve ajrore, që janë ngacmues të këtyre receptorëve dhe shkaktues të ndijimit të dëgjimit. Pjesa më e ngushtë e saj është në hyrje dhe ka formë elipsi; kjo pjesë vibron (dridhet) ndaj valëve ajrore me shpeshtësi të lartë, përkatësisht rreth 20.000 Hz. Më pas largohet me shtrirje më të gjerë dhe vibron deri në shkallën më të ulët të valëve ajrore, përkatësisht deri në shkallën 4000 Hz. Dridhjet ose vibrimet e tilla të membranës bazilare barten në qelizat ndijimore. Me ndërmjetësinë e tyre këto vibrime shndërrohen në impulse nervore dhe barten deri në qendrën e dëgjimit të trurit, ku bëhet shndërrimi i tyre në ndijim dëgjimor.

MEMBRANA TYMPANI. I ardhur nga latinishtja. Cipa e veshit që ndan pjesën e veshit të jashtëm nga pjesa e veshit të mesëm dhe shtrihet përgjatë pjesës së fundit të kanalit të veshit. Kjo membranë është cipë vibruese që i merr dhe i përcjell valët e ajrit në çekan, kullë e yzengji dhe prej këndej në qelizat receptore të kërmillit të veshit. Vibrimi i saj ndryshon sipas intensitetit dhe shpeshtësisë së valëve ajrore. Sipas këtij raporti membrana e timpanit reagon fuqishëm dhe shpesh, por edhe dobët e rrallë. Shih – ***VESHI.***

MEMECËRI, - A. f. Dukuri patologjike që ka të bëjë me pamundësinë e të folurit. Është pasojë e lëndimit të qendrës së të folurit në trurin e njeriut, e lëndimit të organeve të të folurit, e shurdhërisë së hershme dhe e bllokimit të theksueshëm emocional që nga mosha e hershme. Kur memecëria shoqërohet me shurdhëri, atëherë kemi dukurinë e shurdhmemecërisë.

MEMORJE, - A. Shih – ***KUJTESA.***

MENARK/Ë, - A. f. Fillimi i procesit të menstruacioneve, përkatësisht i ndryshimeve mujore në pastrimin natyror të cipës së uterusit.

MENÇURI, - A. f. Aftësia e një shkalle të lartë, zgjuarsia ose urtësia e njeriut, që shfaqet në zgjidhjen e drejtë e të shpejtë të situatave problemore. Mençuria është fjalë popullore, që në literaturën e psikologjisë zëvendësohet me termin inteligjencë. Shih – ***INTELIGJENCA.***

MENDELIZ/ËM, - MI. m. Tërësi dijesh, ligjesh dhe supozimesh për themelet e gjenetikës të vëna nga ana e Gregor J. Mendel (Gregor J. Mendel, 1822 – 1884), studiues i gjenetikës dhe përkrahës i fesë nga Austria. Ligjet e tij kanë të bëjnë me trashëgiminë. Dallohen këto tri ligje: 1) Cilësitë e veçanta trashëgohen të ndara nëpërmjet gjeneve, 2) Secila qelizë riprodhuese ka vetëm një gjen nga secili çift i gjeneve dhe 3) Disa faktorë të caktuar janë mbizotërues nga faktorët e tjerë

të trashëgimisë. Deri në përcaktimin e këtyre ligjeve Gregor J. Mendel ka arritur duke eksperimentuar me bimët e bizeles. Këto ligje janë nxjerrë në literaturë nga vepra e njohur e tij "Eksperimente me hibridë bimësh"**.**

MENDËSI, - A. f. Tërësia e cilësive dhe e tipareve të proceseve të mendimit, të emocioneve dhe të motivacionit, si edhe të sjelljeve të një individi, të një bashkësie shoqërore e etnike, të një populli etj. Termi mendësi më tepër përkon me mënyrën e të menduarit, të reagimit emocional dhe të sjelljeve të përgjithshme, që janë karakteristike për një individ, bashkësi, popull, komb etj.

MENDËSIA GRUPORE. Tërësia e besimeve, dëshirave, bindjeve, e disa qëndrimeve, e shpresave të përbashkëta të anëtarëve të një bashkësie shoqërore të një vendi të caktuar (të një fisi, një fshati, një qyteti etj.).

MENDIM, - I. m. Aspekti më i ndërlikuar i gjithë aktivitetit psikik, me anë të të cilit njeriu dallohet nga të gjitha qeniet e gjalla. Mendimi është rezultat i të menduarit dhe njëkohësisht proces me anën e të cilit në përgjithësi njeriu i përpunon përfytyrimet, simbolet, idetë, konceptet dhe lidhjet e raportet ndërmjet tyre duke ndarë lidhjet e raportet thelbësore nga ato periferike. Kështu është përkufizuar mendimi e procesi i të menduarit në psikologjinë klasike. Për këtë arsye mendimi kontribuon në njohjen objektive dhe të plotë të dukurive, objekteve, proceseve, situatave etj. Me anën e njohjes së lidhjeve dhe të raporteve objektive ndërmjet simboleve, ideve, koncepteve etj. njeriu arrin në zgjidhjen e problemeve dhe të situatave problemore. Sot mendimi dhe të menduarit përkufizohen si proces me anën e të cilit arrijmë në zgjidhje të problemeve dhe të situatave problemore. Mendimi mbështetet në proceset simbolike. Me anën e njohjes së tyre dhe të simboleve që ato procese përfaqësojnë njeriu arrin në zgjidhje të problemeve dhe të situatave problemore. Ky është proces që nuk mund të vëzhgohet drejtpërdrejt, por gjykohet për natyrën, përmbajtjen dhe zhvillimin e tij në mënyrë indirekte: duke analizuar procesin e zgjidhjes së problemeve dhe të situatave problemore sipas raportit vetvëzhgues dhe të vetvëzhgimit eksperimental. Përmbajtja e mendimeve mbështetet në perceptime, por mendimi i tejkalon shumë caqet e të dhënave të drejtpërdrejta të shqisave; mendimi mbështetet në simbole. Mendimi dhe të menduarit, si edhe zhvillimi i tyre, janë të lidhura ngushtë me të folurit. Fjalët ndikojnë në zhvillimin dhe formimin e procesit të të menduarit dhe njëkohësisht janë simbole të shfaqjes ose manifestimit të përmbajtjes së mendimit. Ka mendime se procesi i mendimit dhe vetë mendimi është e folur pa zë (mendim të tillë kanë bihejvioristët). Me gjurmimin psikologjik të mendimit si proces dhe si rezultat janë marrë shumë psikologë. Ndër ta dallohen, psikologët gjermanë, përfaqësues të shkollës së Marburgut: Osvalt Kylpe (Oswald Kulpe, 1862 – 1915), Karl Marbe etj., Eduard B. Tiçener (Edward B. Titchener, 1867 – 1027); psikologu zviceran Zhan Pijazhe (Jean Piaget, 1896 – 1980); psikologët rusë Xhon R. Anderson (John R. Anderson, 1947), Xhon B. Uatson (John B.

Watson, 1878 – 1958), Sergej L. Rubinshtajn (Sergej L. Rubinstein, 1889 – 1960), Lev S. Vigotski (Lev S. Vygotsky, 1896 – 1934); psikologu amerikan Roxher Shenk (Roger Schank, 1946); gjuhëtari amerikan Benjamin Le Vorf (Benjamin Lee Whorf, 1897– 1941) etj. Në psikologji hasen disa lloj mendimesh:

a. **Mendimi abstrakt** – Veprim me simbole dhe me terma konceptesh, gjatë procesit të zgjidhjes së një çështjeje problemore;
b. **Mendimi autist** – Mendim dëshirash e interesash që mbështetet pak në fakte dhe marrëdhënie reale;
c. **Mendimi diskursiv** – Mendim konceptesh e lidhjesh ndërmjet tyre**;**
d. **Mendimi divergjent** – Procesi i gjetjes së disa zgjidhjeve për një çështje të caktuar;
e. **Mendimi egocentrik** – Mendim karakteristik për moshën fëmijërore. Mendimi egocentrik shfaqet në shndërrimin e procesit të mendimit dhe të përmbajtjes së realitetit në dëshira personale;
f. **Mendimi krijues** – Përgjithësim i ri idesh, figurash, konceptesh etj., me anën e të cilit zgjidhet një çështje që ka vlerë të rëndësishme shoqërore;
g. **Mendimi paralogjik** – Mendim i padiferencuar që është karakteristik për mendimin primitiv dhe për mendimin e fëmijëve të moshës parashkollore; mendimi paralogjik kryhet jashtë parimeve dhe ligjeve logjike;
j. **Mendimi produktiv** – Njohuri të reja të arrritura me anën e procesit të mendimit nga ana e një njeriu të caktuar;
k. **Mendimi sinkretik** – Formë e hershme e të menduarit të njeriut, të cilën e karakterizon lidhja e ngushtë e mendimit të njeriut me mendimet dhe me situatat konkrete, jashtë të cilave ai nuk është në gjendje të mendojë dhe të distancohet nga këto situata.
l. **Mendimi emetues** – Përjetim i posaçëm, kryesisht i atyre njerëzve që vuajnë nga skizofrenia, se mendimet që lindin në kokën e tyre shfaqen me zë me qëllim që këto mendime t`i dëgjojnë të tjerët.

MENDIMET E IMPONUARA. Përjetim karakteristik i njerëzve që vuajnë nga skizofrenia. Mendime të imponuara janë ato mendime që përjetohen nga ana e njeriut, por nuk i përkasin atij; mendimet e tilla vijnë nga të tjerët dhe futen në kokën e njeriut, zakonisht të skizofrenit. Mendimet e imponuara janë simptoma karakteristike të zhvillimit të sëmundjes së skizofrenisë.

MENDIMET E TËRHEQURA. Mendime që kanë të bëjnë me përjetimin e njeriut të sëmurë nga skizofrenia. Ky beson se mendimet e tij merren nga koka e tij prej të tjerëve, dhe të cilët i shfrytëzojnë këto mendime. Skizofreni ka ndjesinë se koka e tij ka mbetur e zbrazët, ngaqë të gjitha idetë, pikëpamjet, qëndrimet etj. i janë marrë nga të tjerët.

MENDIMI ASOCIATIV. Formë e shpjegimit të procesit së të menduarit në bazë të asociacionit të ideve, të koncepteve dhe të përfytyrimeve, që nuk ka të bëjë me mendimin diskursiv. I takon së kaluarës.

MENDIMI AUTIK. Proces dhe përmbajtje e mendimit e nxitur dhe e drejtuar spontanisht nga dëshirat, nevojat, frikësimet etj. Mendimi autik është i mbështetur kryesisht në parimin e kënaqësisë së shtytësve duke

marrë pak ose aspak në konsideratë situatën reale dhe kushtet realiste ku ai e zhvillon mendimin e tij.

MENDIMI DIVERGJENT. Formë e të menduarit që zbatohet gjatë procesit të zgjidhjes së problemeve dhe të situatave problemore, ku individi e drejton procesin e të menduarit në dy a më shumë drejtime, për të kapur sa më shumë aspekte të një problemi a situate problemore dhe për të gjetur zgjidhje të drejtë të atij problemi apo situate problemore. Mendimin divergjent e zbatojnë sidomos ata që kërkojnë zgjidhje të re, zgjidhje origjinale të një situate problemore, të një akti krijues. Shih – ***MENDIMI KONVERGJENT.***

MENDIMI DOGMATIK. Formë e të menduarit që karakterizohet me refuzim të dyshimeve, me padurim të kritikave dhe të provave, për të vërtetuar saktësinë e vërtetësisë të atij mendimi, të asaj pikëpamjeje, të atij gjykimi, konkludimi etj. Mendimi dogmatik nuk mbështetet në proceset kognitive të njohjes të së vërtetës, por në besimin e pakusht të dogmës së mendimit të thënë. Z. Frojdi e ka karakterizuar mendimin religjioz – mendim dogmatik.

MENDIMI I DHUNSHËM. Mendim që kryhet me frikë, që e angazhon njeriun në çështje të pavlefshme dhe të parëndësishme. Njeriu me mendim të dhunshëm është i vetëdijshëm se mendimi i tij është i pavlefshëm, i parëndësishëm dhe përcillet me frikë, madje vet ai ndaj këtij mendimi është kritik, por nuk arrin të çlirohet prej tij. Shfaqet te njerëzit e lodhur shumë nga puna dhe shpesh është simptomë e skizofrenisë.

MENDIMI INDUKTIV. Proces i të menduarit që zhvillohet duke lidhur gjykimet e përveçme me njëra tjetrën për të arritur deri në gjykimin e përgjithshëm për veçoritë e raportet esenciale dhe të përgjithshme të gjykimeve të përveçme. Në bazë të mendimit induktiv konstatojmë se ajo që vlen për të përveçmet e një klase dukurish, objektesh, procesesh etj. vlen edhe për të gjithë klasën, përkatësisht për të përgjithshmen. Mendimi induktiv është proces aktiv gjatë formimit të koncepteve dhe gjatë zhvillimit të problemeve dhe situatave problemore.

MENDIMI INTUITIV. Mendim karakteristik për fëmijët e moshës 4–7-vjeçar. Te fëmijët e kësaj moshe mendimi është i drejtuar në dallimin e formave të përbashkëta të një grupi të caktuar objektesh, kur kryhet ndarja, renditja, zhvendosja etj. e objekteve për të dalluar forma të përbashkëta të tyre. Mendimi intuitiv është mendim figurativ dhe i përket psikologjisë së Zhan Pijazhes (Jean Piaget, 1896 – 1980).

MENDIMI KATATIM. Formë dhe përmbajtje e procesit të mendimit të njeriut, që mbisundohet nga ndonjë kompleks dhe nga ideja sumanute, që shkaktojnë lidhjen e atij njeriu me atë vatër ideje dhe mosçlirimin e rrjedhjes normale të procesit të mendimit. Për këtë shkak është çrregulluar raporti ndërmjet realitetit dhe mendimit te njeriu i caktuar. Mendimi katatim është formë e afërt e të menduarit autik.

MENDIMI KAUZAL. Lloj i mendimit, kur sipas rrjedhës së përmbajtjes së procesit mendor përcaktohen lidhjet shkakore – rrjedhimore ndërmjet

dukurive reale. Mendimi kauzal zbatohet edhe në psikologji, kur duhet identifikuar shkakun e një ndryshore psikologjike.

MENDIMI KONCEPTUAL. Formë e mendimit të njeriut, të cilin e karakterizon operimi me koncepte abstrakte. Në pikëpamjen ontogjenetike kjo formë e mendimit zhvillohet relativisht vonë. Gjatë zhvillimit kognitiv të fëmijëve mendimi konceptual dallohet kur njeh dhe zotëron mirë gjuhën amtare të tij, si edhe kur është në gjendje ta dallojë mendimin nga të folurit.

MENDIMI KONKRET. Formë elementare e të menduarit, e cila të bëjë me përfytyrime të dukurive dhe objekte konkrete, si edhe me koncepte konkrete të tyre gjatë rrjedhës së procesit të të menduarit, të drejtuar në zgjidhje të një problemi a të një situate problemore. Mendimi konkret manifestohet në zgjidhjen e çështjeve konkrete dhe praktike.

MENDIMI KONVERGJENT. Formë e të menduarit që ka të bëjë me gjetjen e një zgjidhjeje për problemin a situatën problemore, duke lënë anash çfarëdo të dhëne të paargumentuar plotësisht, duke konverguar të gjitha argumentet relevante drejt zgjidhjes së problemit të caktuar, përkatësisht drejt zgjidhjes së situatës problemore. Procesi i konvergimit të argumenteve të vërtetuara çon në ngushtimin e vazhdueshëm të zgjidhjeve të mundshme, derisa të mos arrihet në zgjidhjen përkatëse. Kjo realizohet duke mbledhur argumentet dhe duke bërë sintezën e argumenteve thelbësore që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me zgjidhjen e problemit të parashtruar. Për këtë shkak karakteristika kryesore e mendimit konvergjent është vlerësimi mendor kritik i supozimeve, i propozimeve, i hipotezave të parashtruara dhe i vërtetimit të tyre vetëm në bazë të sistemit argumentues. Mendimi konvergjent është një prej pesë klasave të faktorëve të inteligjencës sipas teorisë për inteligjencën të psikologut amerikan Xhoi P. Gilford (Joy P. Guilford, 1897 – 1987).

MENDIMI KRITIK. Strategji e të menduarit që karakterizohet me synimin e qëndrueshëm të njeriut për t`i kontrolluar mirë, vërtetuar argumentet, qëndrimet etj. duke mënjanuar plotësisht ndikimin e çfarëdo lloj autoriteti, emocioni, paragjykimi, stereotipie etj. në zgjidhjen e drejtë të një situate problemore. Strategjia e tillë e të menduarit ka të bëjë me largimin e të menduarit dogmatik, në procesin e marrjes së një vendimi, me verifikimin dhe me analizën e hollësishme të të gjitha pohimeve.

MENDIMI MAGJIK. Shkallë e ulët e mendimit të njerëzve të fiseve primitive, të fëmijëve të moshës nga 3 – 7 vjeç dhe të disa individëve me çrregullime psikike. Mendimi magjik ka të bëjë me shpjegimin e ndryshimeve të jashtme të çfarëdoshme, duke besuar se këto ndryshime janë shprehje e mendim edhe të vetë njeriut. Mendimi magjik është shumë i ngarkuar me ndjenja dhe me dëshira të shumta. Psikanaliza mendimin magjik e shpjegon si refleksion të ndjenjës narcizoide tek impotentët.

MENDIMI OPERACIONAL. Term i përdorur nga psikologu zviceran

Zhan Pijazhes (Jean Piaget, 1896 – 1980), që emërton domethënien e parimeve të përgjithshme që zbatohen në operacionet konkrete dhe formale të të menduarit. Në sistemin e mendimit të Pijazhes mendimi operacional ka të bëjë më tepër me atë fazë mendimi të fëmijës, kur mendimi është i pranishëm në një sistem dhe e udhëheq këtë sistem.

MENDIMI SKIZOFREN. Tërësi e organizuar tiparesh mendore të çrregulluara që karakterizojnë tipin skizofren të personalitetit. Kjo tërësi përbëhet nga të menduarit primitiv, jologjik, autik dhe me të folur të pakuptimtë. Përmbajtja e mendimit skizofren përftohet kryesisht nga përfytyrimet magjike dhe nga përjetimet e çuditshme personale. Lidhjet e ideve dhe të përfytyrimeve janë ndër më të çuditshmet.

MENDIMI RACIONAL. Njohje e së vërtetës e një rendi më të lartë nga ai i njohjes me anë të shqisave dhe të përvojës.

MENDJ/E, - A. f. Term i një koncepti të përbashkët filozofik e psikologjik. Në psikologji ky term ka kuptim me shtrirje të gjerë. Zakonisht mendja emërton aftësinë më të lartë të mendimit të njeriut për njohjen e gjithësisë (të objekteve, dukurive dhe relacioneve thelbësore, duke përfshirë edhe relacionin trup-shpirt). Në këtë kuadër mendja i afrohet kuptimit të termit inteligjencë e nivelit më të lartë dhe termit frymë, shpirt. Kështu është përdorur termi mendje në psikologjinë klasike. Të gjitha proceset konjitive (perceptimi, kujtesa, mendimi, të folurit) dhe përvoja me ndërlidhjet e tyre formojnë mendjen e njeriut. Mendimtari dhe psikologu amerikan Uiljam Xhejms (William James, 1842 – 1910) ka vënë shenjë barazie ndërmjet trurit dhe mendjes. Kjo mund të kuptohet se mendja është arsyeja e njeriut që realizohet me anë të funksionimit të trurit, ku realizohet tërësia e veprimtarisë dhe e jetës psikike; ajo që del nga truri, nga mendja i përket mendores – fuqisë më të lartë kuptimore të njeriut. Psikologu bashkëkohor amerikan Houard Gardner (Howars Gardner) kur flet për studimet e tij për mendjen ai në të vërtetë bën fjalë më tepër për inteligjencën. Po kështu Margaret Donaldson flet për mendjen e fëmijës ("Chidren`s Minds"), por në thelb bën fjalë për aftësinë e të mësuarit, të kuptuarit, të përfunduarit etj. Megjithëkëtë, kuptimi i termit mendje është i lidhur, shpesh edhe i varur nga konteksti i rrjedhës së mendimit teorik, produktiv dhe krijues.

Burimet:

William James: *"Text- book of psychology"* – (*"Libër tekstesh të psikologjisë"*), 1892.
Magaret Donaldson: *"Children`s Minds"* – (*"Mendja e fëmijës"*), 1978.
Avadhutike Anandamitra: *"Sekretet e mendjes",* Tiranë, 2001.
Howard Gardner: *"Mendja e pashkolluar – Si mendojnë fëmijët dhe si duhet t`i mësojë shkolla ata",* Instituti i Studimeve Pedagogjike, Tiranë, 2002.
Haward Gardner: *"Dimensionet e mendjes – Teoria e llojeve të ndryshme të inteligjencës,* Instituti i Studimeve Pedagogjike, Tiranë, 2003.
Howard Gardner: *"Mendja e disiplinuar – Çfarë duhet të kuptojnë nxënësit",* Instituti i Studimeve Pedagogjike", Tiranë, 2003.

"MENDOJ, PRA EKZISTOJ". E thënë në formë maksime në latinisht *Cogito ergo sum* e filozofit francez Rene

Dekart (Rene Descartes, 1596 – 1650). Maksima "Mendoj, pra, ekzistoj" e ka nxitur zhvillimin e psikologjisë.

MENDOR, - E. mb. I ardhur nga latinishtja *mens* "shpirt, frymë, mendje" që ka të bëjë me gjithë atë që prodhon mendja e njeriut. Ky ka qenë kuptimi në fillim të zhvillimit të psikologjisë. Më pas ky kuptim ka ndryshuar, ndërsa sot ka kuptim të gjerë dhe të ngushtë. Me kuptimin e gjerë emërtohen të gjitha dukuritë, proceset dhe sjelljet që kanë të bëjnë me psikikën e njeriut. Kuptimi i ngushtë ka të bëjë me dukuritë dhe me funksionin e proceseve njohëse ose kognitive dhe me zhvillimin e tyre. Të tillë janë termat: aftësi mendore, higjienë mendore, moshë mendore, mbeturina mendore, sëmundje mendore, zhvillim mendor etj.

Burimet:

Narzis Ach: *"Über die Willenständgkeit und das Denken"* – ("*Mbi gjendjen e vulnetshme dhe mendimin"*), Göttingen: Vandenhoeck & Ruprecht, 1905.

Rubinstein S. Leonidovič: *"Psihologija mišljenja i govora"* – (*"Psikologjia e të menduarit dhe e të folurit"), Pe*dagoško – književni zbor, Zagreb 1946.

Karl Bühler: *"Tatsachen und Probleme zu einer Psychologie der Denkvorgange"* – (*"E vërteta dhe problemet e psikologjisë së procesit të mendimit"),* II. Über Gedankenzusammenhänge. III. Über Gedankenerinnerungen. Archiv für gesamte Psychologie, 12: 1 – 92.

Karl Duncker: *"Zur Psychologie des produktiven Denkens"* – (*"Psikologjia e mendimit produktiv"),* Berlin: Julius Springer, 1935.

Max Wertheimer: *"Produktives Denken"* – (*"Mendimi produktiv"*) (2 Aufl.).Frankfur/M.: Kramer, 1964.

Lav Vigotskij: "*Mišlenie i Reč" – "Mendimi e të folurit*", Moskva, 1956.

Judith Greene: *"Thinking an Language"* – (*"Të menduarit dhe gjuha"),* Methuen, London, 1975.

Johanna Turner: *"Cognitive Development"* – (*"Zhvillimi kognitiv"),* Methuen, London, 1975

John R. Anderson: *"The Architecture of Cognition"* – (*"Arkitektura e njohjes"),* Cambridge, MA: Harvard University Press, 1983.

Burkhard Vollmers: *"Kreatives Experimentieren: die Methodik von Jean Piaget, den Gestalt psychologien und der Würzbuger Schule"* – (*"Eksperimente krijuese: Metodika e Zhan Piazhes, Psikologjia Geshtalt dhe shkolla e Vyrzburgut"),* Wiesbaden: Deutscher Universitats – Verlag, 1992;

Charles G. Morris – Albert A. Maisto: "*Psikologjia – shkenca e proceseve mendore dhe e sjelljes njerëzore"*, Qendra për Arsim Demokratik, Tiranë, 2008, fq. 229 – 245.

MENDUARIT INTUITIV (TË). Të menduarit intuitiv është formë e të menduarit, që karakterizohet me dallimin e së vërtetës duke mos ndërmjetësuar deri në ardhje të asaj të vërtete premisat, gjykimet e posaçme. Për procesin e të menduarit intuitiv individit I nevojitën vetëm disa të dhëna dhe befas arrin deri në njohjen e tërësisë së një situate, në njohjen e rrugëve të zgjidhjes së asaj situate.

MENDUARIT KREATIV (TË). Lloj i të menduarit të lartë që shpie në krijim origjinal mendor (zbulimet shkencore, teknike dhe artistike). Në literaturën e psikologjisë emërtohet edhe me termin të menduar imagjinar. Të menduarit kreativ është proces i ndërlikuar dhe ka rrjedhje jo të vazhdueshme. Ky proces unik përshkruhet i ndarë në katër faza: 1) Përgatitja (Preparacioni), 2) Pjekuria (Inkubacioni); 3) Frymëzimi (Iluminacioni) dhe 4) Vërtetimi (Verifikimi).

MENDUESHMËRI, - A. f. Cilësi e njeriut të mençur, i cili mendon thukët për çështjet e ndryshme, posaçërisht për çështje që kanë të bëjnë me një fushëveprim profesional e shkencor të caktuar. Mendueshmëria dallohet jo vetëm nga gjerësia dhe thellësia e mendimit, por edhe nga mënyra e përqasjes dhe e zgjidhjes së çështjeve, si edhe nga formësimi gjuhësor i qartë e i shkoqitur i mendimeve.

MENINGJE, - T. m. Në anatominë e sistemit nervor, cipat mbështjellëse të trurit dhe të palcës kurrizore. Meningjitet përbëhen nga tri cipa kryesore: 1) *Dura mater* – "nëna e fortë": cipa e jashtme dhe më e forta që mbështjell trurin dhe palcën e kurrizit, 2) *Pia mater* "nëna e butë", cipa më e thellë mbështjellëse e trurit dhe e palcës së kurrizit dhe 3) *Arahnoidea* "cipa rrjetore" e mesme që mbështjell trurin dhe palcën e kurrizit. Falë këtyre tri cipave sistemi nervor është i mbrojtur mirë nga ndikimet mekanike të rrezikshme nga jashtë, si edhe nga ndikimet e temperaturës dhe të ndryshimeve të mëdha të saj.

MENOPAUZ/Ë, - A. f. Ndërprerje natyrore dhe e përhershme e ciklit menstrual dhe, rrjedhimisht edhe i mundësisë për të lindur te gjinia femërore. Menopauza është pasojë e ndryshimeve fiziologjike dhe hormonale që fillon në kohën e klimakteriumit dhe, me pak përjashtime, shfaqet zakonisht në moshën 45 – 50 vjeç. Menopauza shfaqet me disa simptoma psikosomatike, ndër të cilat më të dallueshme janë: jostabiliteti psikomotorik, lodhje e pashpjegueshme, keqësim i ritmit të rrahjes së zemrës, pagjumësi, nervozizëm etj. Rezultatet e gjurmimeve më të reja kanë treguar se simptomat psikosomatike nuk janë aq pasojë e zhvillimeve fiziologjike të ndryshuara në kohën e fillimit të menopauzës, por rezultojnë nga disa vështirësi psikike të lidhura kryesisht me faktin se gjysma e jetës përfundoi dhe po fillon periudha e moshës së pleqërisë.

MENSTRUACIONE, - T. shm. Përgjakësim periodik mujor i uterusit dhe i organeve seksuale te femrat, i shoqëruar me mënjanim të disa indeve të këtyre organeve te femrat e moshës së rritur. Përjetohet në forma psikike të ndryshme individuale, me dhembje, me ndjenjë turpi, me kërkesë të largimit të përkohshëm nga mjedisi social etj. Proceset metabolike të gjëndrave me tajim të brendshëm pësojnë disa ndryshime. Ndryshimet e tyre janë të dukshme sidomos ato të hormonit të gjëndrës së hipofizës, që ngacmon hipotalamusin dhe ushtron ndikim të tërthortë në hipofizë dhe në funksionimin e saj.

MENTALITET, - I. Shih – ***MENDËSIA.***

MENTALIZ/ËM, - MI. m. Doktrinë mbi ekzistencën e dukurive dhe sjelljeve të qarta mendore ose psikike. Këto nuk kanë të bëjnë me dukuritë fizike e as me proceset fiziologjike dhe nuk mund të reduktohen në këto të fundit. Dukuritë dhe sjelljet mendore kanë karakter të vetëdijshëm dhe rrjedhimisht njohja e tyre është e mundur me anën e metodës së vetvëzhgimit.

MERXHANI Branko. Sociolog shqiptar me ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e psikologjisë ndër shqipfolësit.

Lindi në Turqi më 1894 dhe vdiq në Stamboll më 28.09.1981. U shqua me orvatjet e tij për të vënë në ballë të zhvillimit kulturor "mendimin filozofik, sociologjik dhe psikologjik". Ai theksonte ". . . rëndësinë që duhet të kishte filozofia, sociologjia dhe psikologjia për kulturimin, zhvillimin dhe kultivimin e jetës social-politike të kombit shqiptar". Në biografinë e tij shkruhet "Branko Merxhani qe ndër të rrallët e ditur që u burrërua nëpërmjet mentalitetit të botës lindore e u brumos nëpërmjet diturisë dhe përparimit të botës perëndimore". Me këtë kulturë dhe mendim sociologjik të mprehtë konsiderohet se është drejtuesi kryesor i lëvizjes "Neoshqiptarizmi". Branko Merxhani e ka konsideruar sociologjinë, përpos të tjerash ". . . Laborator të sëmundjeve psikologjiko-shoqërore. Si vlerë pozitive ka vetëm gjurmimin. Zbulimin e rrënjës të së keqes". Nuk ngurrohet të pohojë se ne Shqiptarët jemi të sëmurë nga shpirti e nga mendja. Ka konsideruar se "mjet shërimi i kësaj gjendjeje është "Të zihemi nga shkenca"! Lidhur me këtë kërkon ". . . të studiojmë më thellësisht llojin dhe psikologjinë e Shoqërisë Shqiptare" duke vazhduar më tej.... "Mundemi shumë bukur të përpiqemi të realizojmë Sublimacionin e instinkteve". Në artikujt e tij të botuar në revista kulturore e pedagogjike vazhdimisht ka theksuar rëndësinë e njohjes së vetes sonë, përkatësisht njohjen e psikologjisë dhe zbatimin e saj praktik në shoqërinë e mjedisit shqiptar. Branko Merxhani i ka përmendur në shqip idetë e para të psikanalizës së Zigmund Frojdit. Madje lidhur me këtë ka kritikuar edhe librin e psikologjisë së Aleksandër Xhuvanit, për mostrajtim të mjaftueshëm dhe të duhur të psikanalizës. Por, është i hapur edhe në kritikën e zhvillimit dhe të faktorëve të zhvillimit të shoqërisë shqiptare, prapambetjen e së cilës ia atribuon "Fenerit të shkencës sociologjike". Nga sociologjia dhe nga ata që japin lëndën e sociologjisë ka kërkuar që kjo shkencë të zbatohet në "Morfologjinë shoqërore të vendit". Sipas tij "Dispozita për një gjurmim të ngulur shkencor dhe sistematik na mungon krejt"! Ka botuar vështrimin "Një librë mbi Psykologji", 1934, ku ka trajtuar librin e psikologjisë së Aleksandër Xhuvanit. Lidhur me këtë ka pohuar se ka shkruar librin "Mësimet e para të psikologjis"', 1932, duke shënuar se përmbajtja e këtij libri është e ndarë në katër pjesë. Libri është lënë në dorëshkrim, por deri më sot nuk është gjetur. Në paraqitjen e mendimeve dhe qëndrimeve të tij në revistën "Përpjekja shqiptare" dhe në revistat e tjera, si edhe në shtypin e ditës hasim konceptet psikologjike "Mekanizma psikike", "Inteligjenca", "Temperamenti", "Pasioni" etj. Për këto arsye Branko Merxhani përfshihet në historinë e mendimit shkencor dhe në historinë e mendimit psikologjik.

MESATARJA ARITMETIKE. Masa më e saktë që përfaqëson grupin e të dhënave numerike individuale të përftuara nga matja e një ndryshoreje psikologjike. Mesatarja aritmetike llogaritet duke mbledhur vlerat numerike individuale dhe duke i pjesëtuar me numrin e përgjithshëm të rasteve. Shih – ***MASA ARITMETIKE.*** Formula për këtë është:

$$M_a = \frac{N_1 + N_2 + N_3}{N}$$

Në këtë formulë Ma është mesatarja aritmetike dhe N është numri i rasteve.

MESER August (August MESSER). Psikolog e filozof gjerman. Lindi në Mainc më 11.02.1867 dhe vdiq në Rostok më 11.07.1937. Vazhdues i hulumtimeve të procesit të mendimit të filluar që nga veprimtaria e Osvald Kylpes në shkollën e Vyrzburgut. Ka studiuar në universitetin e Gizenit, Hajdelburgut dhe të Strasburgut. Punoi si profesor i shkollave të mesme, më pas më 1899 u zgjodh docent në universitetin e Gizenit, profesor i asociuar më 1904 dhe profesor i rregullt nga viti 1910. Në skenën e hulumtimeve psikologjike u paraqit për herë të parë në Kongresin e Psikologjisë Eksperimentale më 1904, ku, së bashku me Osvald Kylpen paraqitën kumtesën "Versuche über Abstraction" – "Gjurmimi i abstraksionit". Përmbajtja e kësaj kumtese mbështetej në të provuarit e procesit të të menduarit, duke zbatuar metodën e eksperimentit (tipin e vetvëzhgimit eksperimental të mendimit). Në mbështetje të kësaj metode ai së bashku me pjesëtarët e tjerë të shkollës së Vyrzburgut kanë hulumtuar procesin e të menduarit. Në kuadrin e këtyre gjurmimeve August Meseri mbeti i njohur me rezultatet e hulumtimit të raportit ndërmjet ndijimeve dhe mendimit, ku tregoi alternimin e sensualizmit me analizën e perceptimit, të vëmendjes, të mendimit dhe lidhjen ndërmjet ndijimeve e përfytyrimeve në kuadrin e një raporti kohor dhe hapësinor të caktuar. Ka ushtruar ndikim edhe në zhvillimin e pedagogjisë, ku dallohet me pikëpamjen kundër sensualizmit psikologjik, që e dallojmë sidomos në veprën ""*Mbikqyrje mbi botën dhe edukata*". Veprat kryesore: të tij janë: *"Experimentell – psychologische Untersuchungen über das Denken"* – (*"Gjurmimi eksperimental – psikologjik i mendimit"*), 1906; *"Empfindung und Denken"* – (*"Ndijimi dhe mendimi"*), 1908.

MESMER Franc Anton (Franz Anton MESMER). Mjek dhe hipnotizues gjerman. Konsiderohet si Babai i hipnozës. Lindi më 1734 dhe vdiq më 1815. Në studimet e tij është marrë me "magnetizmin e kafshëve". Sipas tij disa njerëz kanë një energji të veçantë, me anën e së cilës mundësohet shërimi i disa sëmundjeve dhe njeriu kthehet në gjendje të shëndoshë! Franc Mesmer ka studiuar mjekësi, teologji, filozofi dhe drejtësi në Vjenë. Ka ushtruar shumë kohë profesionin e mjekut në Vjenë dhe në Paris. Më 1784 u formuan dy komisione mendimtarësh të lartë për të vërtetuat qenësinë e kësaj energjie, por Franc Mesmeri para anëtarëve të këtyre komisioneve nuk qe në gjendje të jepte shpjegime të tjera, krahas shpjegimit që kjo energji është mistike, pra energji i fshehur. Ky shpjegim qe i papranueshëm për pesë anëtarët e komisionit të parë, të kryesuar nga akademikët Benjamin Franklin dhe Lavuazjer, ashtu dhe për pesë anëtarët e tjerë të Fakultetit të mjekësisë. Franc Mesmeri nuk ka lënë ndonjë vepër të shkruar. Por, të tjerë autorë kanë shkruar për mesmerizmin. Ndër ta përmendet Frank Podmore me veprën "*Mesmerism and Cristian Science*" – ("*Mesmerizmi dhe shkenca kristiane*"), botuar më 1909.

MESMERIZ/ËM, - MI. m. Term i përdorur nga mjeku dhe hipnotizuesi Franc A. Mesmer (Franz A. Mesmer, 1734 – 1815), që emërton energjinë specifike të disa individëve, që u quajt "magnetizëm animal" dhe që atyre u mundëson gjoja shërimin e disa sëmundjeve. Ka kuptimin e hipnozës.

MESOR/E, - JA. Shih - ***MASAT E VLERËS QENDRORE, MASA E MESORES (MEDIANA).***

META-ANALIZ/Ë, - A. f. Teknikë psikometrike, me anën e së cilës përcaktohet trendi më i rëndësishëm integrues i zhvillimit të një ndryshoreje psikologjike nga krahasimi i rezultateve të arritura në gjurmimin e kësaj ndryshoreje dhe nga përllogaritja statistikore e tyre.

METABOLIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga greqishtja *μεταβολή* "shndërrim" në terminologjinë e fiziologjisë, që ka vlera njohëse edhe për psikologjinë fiziologjike. Metabolizmi është tërësia e shndërrimeve fiziko– kimike të ushqimit në energji të caktuar për organizmin e gjallë. Metabolizmi ka të bëjë me dy procese kryesore: **anabilizmi,** që është proces i përftimit të energjisë në organizëm nga këmbimi i përbërësve fiziko–kimikë dhe nga **katabolizmi**, që është proces i shpërbërjes së asaj energjie në organizëm. Dallohet edhe **metabolizmi bazal**, që emërton energjinë e nevojshme të organizmit, kur trupi është në gjendje të qetë me temperaturë të mjedisit prej 16 – 20 gradë Celsius. Kjo energji i nevojitet organizmit për punën e zemrës, të qarkullimit të gjakut, të aktivitetit nervor, të frymëmarrjes dhe të proceseve të tjera vitale për jetën dhe zhvillimin e proceseve fiziologjike dhe psikike të organizmit.

METAFIZIK/Ë, - A. f. I ardhur nga greqishtja *μετα* "prapa" dhe *φυσικός* "natyra". Ka të bëjë me atë që fshihet prapa objekteve e dukurive fizike. Metafizika është degë e shkencave filozofike me lidhje të posaçme edhe me psikologjinë. Merret me gjurmimin e parimeve dhe të ligjeve të fundit të zhvillimit të materies. Çështjet kryesore të saj janë ato që qëndrojnë jashtë fizikut të njeriut dhe prekin edhe çështjet psikologjike. Të tilla janë: natyra njerëzore, vullneti i lirë, shpirti e pavdekshmëria e tij etj. Këto çështje i përkasin edhe psikologjisë irracionale, që nuk ka të bëjë me psikologjinë empirike.

METAKOGNICION, - I. m. Dije e një individi për aftësitë dhe mendimet e tij të pa shndërruara në qëndrime dhe në sjellje objektive të dallueshme dhe të mundshme për t`u matur. Metakognicioni është dija e vetëdijshme e njeriut për të gjithë ata faktorë që marrin pjesë në mendimet personale të pashfaqura për të tjerët.

METAMEMORIE, - A. f. Tërësi e dijeve të njeriut për kujtesën e tij, për kapacitetin, format dhe zhvillimin e kujtesës. Kjo tërësi dijesh ka të bëjë me vetëdijen e njeriut për strukturën e kujtesës së tij dhe, përgjithësisht, për funksionimin e proceseve të kujtesës, duke mos objektivizuar para të tjerëve dijen për kujtesën e tij. Ka studime për fillimin e njohjes së kujtesës së vet që nga mosha fëmijërore, por rezultatet janë të ndryshme.

METAMERIZ/ËM, - MI. m. Dukuri e veçantë psikike e përjetimit të

perceptimit të një tërësie objektive, megjithëse kemi të bëjmë me dy trupa, me dy ngacmues të ndarë njëri nga tjetri. Kështu dy xixa të ndara shkaktojnë përjetimin e një xixe të përbashkët, kur njëra gjendet afër tjetrës.

METAMORFOZA E PERSONALITETIT. Shndërrim i shpejtë dhe i dallueshëm i personalitetit dhe i tipareve të sjelljeve të tij. Karakterizon kryesisht shndërrimin e sjelljeve normale në ato jonormale.

METANEVOJ/Ë, - A. f. Motive njerëzore të nivelit të lartë, të tilla si: bukuria, drejtësia, liria, nderi, rendi dhe vetaktualizimi. Këto nuk zhvillohen nëse paraprakisht nuk plotësohen nevojat biologjike. Është term i teorisë së personalitetit të psikologut amerikan Abraham H. Maslou (Abraham H. Maslow, 1908 – 1970). Shih – ***HIERARKIA E MOTIVEVE.***

METAPSIKANALIZ/Ë, - A. f. Qasja analitike e psikanalizës dhe e analizës së çrregullimeve shpirtërore dhe e trajtimit psikanalitik sipas psikanalizës klasike të Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939). Termi metapsikanalizë i përshtatet më tepër mendimeve psikanalitike të psikologut amerikan me prejardhje gjermane Oto Rank (Otto Rank).

METAPSIKIK/Ë, - A. f. Qëndrim i lidhur ngushtë me besimin, sipas të cilit njeriu ka aftësi shpirtërore të jashtëzakonshme, përkatësisht jashtë psikikës së tij. Metapsikika nuk ka bazë shkencore dhe përbën themelet e spiritizmit. Dukuritë metapsikike shprehen me gjendjen e jashtëzakonshme të shpirtit dhe të frymës së njeriut.

METAPSIKOLOGJI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *meta* "jashtë", *psiho* "shpirti" dhe *λόγος* "shkenca". Emërton zhvillimin e pikëpamjeve abstrakte të psikologjisë jashtë sferës empirike dhe metodave objektive të gjurmimit të proceseve psikike dhe të sjelljeve të njeriut. I tillë është mendimi për raportin shpirt – trup. Në psikanalizë metapsikologjia është forma më e lartë e abstraksionit për zhvillimin e proceseve psikike të njeriut. Zigmund Frojdi (Sigmund Freud, 1856 – 1939) në kuadrin e mendimit të formave më të larta abstrakte për proceset psikotike ka sugjeruar shpjegimin psikologjik të vlerës dhe të rëndësisë së dinamikës, të strukturave topografike dhe të cilësive ekonomike të dukurive psikotike. Këto vlera të ndërlidhura të zhvillimeve psikotike kanë këto veçori: aspektin dinamik – që shpreh energjetikën e shtytësve të aktivitetit, aspektin topik – që shpreh vendin e proceseve psikike në aparatin psikik të Zigmund Frojdit (*id*, *ego* dhe *super–ego*) dhe aspektin ekonomik – që shpreh shpërndarjen e energjisë psikike në sistemin e strukturave psikike. Parimi themelor i metapsikologjisë është parimi i dinamikës së proceseve dhe sjelljeve të njeriut. Sipas këtij parimi në jetën psikike të njeriut asnjëherë nuk ndodhin dukuri të rastësishme, sepse jeta psikike me të gjitha format e saj ka ligjshmërinë, shkaqet dhe qëllimin e vet. Një dinamikë të tillë të jetës psikike Zigmund Frojdi ia ka atribuuar të pavetëdijshmes. Parimin e dinamikës e ka shtrirë edhe në gjenezën e proceseve dhe të sjelljeve të njeriut. Ai ka pohuar se sjelljet e tashme të njeriut i kanë rrënjët e tyre në të kaluarën e tij. Tiparet e

karakterit të njeriut, format e sjelljeve të rëndomta dhe ato të çrregulluara mund të zbulohen duke i shoqëruar me zhvillimin historik psikoseksual të njeriut nga mosha më e hershme e tij. Zigmund Frojdi ka shkruar edhe një regjistër metapsikologjik, ku ka përmendur shqyrtimin e këtyre çështjeve: shtytësit, e pavetëdijshmja, shtypja a ndrydhja, ëndrrat dhe pikëllimi. Mendimi bashkëkohor metapsikologjik nënkupton pikëpamjet themelore teorike dhe metodologjike të jetës psikike dhe të zhvillimeve psikotike të njeriut.

METAPSIKOLOGJIA E FRIKËS. Frika parësore e njeriut që i ka rrënjët në zhvillimin biologjik të tij: ky është përjetimi i rrezikut të ndarjes së fëmijës nga e ëma. Kjo frikë ka përmasa dinamike, sepse kërkon kthimin e fëmijës në gjendjen e dikurshme të tij, duke i kënaqur nevojat elementare nga lidhja me të ëmën. Një frikë e tillë shkaktohet nga procesi i lindjes dhe nga përjetimi i traumës së lindjes së fëmijës. Frika parësore angazhon gjithë aparatin psikik dhe gjithë energjinë psikike, duke u shpërndarë në të tërë sistemin nervor autonom. Pjekuria e aparatit psikik sipas Zigmund Frojdit (e egos, super-egos dhe e idit) shkakton diferencimin e frikës ndaj objekteve dhe dukurive që njeriu i konsideron të rrezikshme për të. Në këtë proces, zhvillimi i egos luan rol të rëndësishëm, sepse zhvillon mekanizmin mbrojtës nga ngacmuesit e rrezikshëm të brendshëm dhe të jashtëm. Përderisa në fillim Frojdi e ka shpjeguar zhvillimin e frikës nga shndërrimi i libidos në frikën e lindjes, të traumës së shkaktuar nga lindja, të ndarjes nga e ëma, më pas, ai e shpjegon zhvillimin e frikës dhe mbrojtjen nga pasojat e saj me zhvillimin dhe përforcimin e egos së njeriut.

METATETIK, – E. mb. I ardhur nga greqishtja "i (e) ndryshuar", që ka të bëjë me ndryshimet sasiore të ngacmuesit që shkaktojnë ndryshime cilësore në ndijimin e tij. Ndryshimet e gjatësisë së valëve elektromagnetike shkaktojnë ndryshime të ngjyrave, rrjedhimisht edhe ndryshime në cilësinë e ndijimit të ngjyrës.

METEMPSIKOZ/Ë, - A. f. Pikëpamje e vjetër mbi shpirtin ose psikikën pas vdekjes së trupit. Sipas kësaj pikëpamjeje shpirti është i pavdekshëm. Shpirti, pas vdekjes së trupit të njeriut, në një moment të pacaktuar kalon prej trupit të vdekur në një trup a qenie tjetër. Metempsikoza është besimi në migrimin e shpirtit të njeriut pas vdekjes nga ai në një formë tjetër të njeriut, madje edhe te kafshët dhe te bimët, nëse njeriu gjatë jetës ka bërë gabime të mëdha.

METOD/Ë, - A. f. I ardhur nga greqishtja *μέθοδος* "mënyrë, rrugë, mjet". Ka përdorim të gjerë në praktikë dhe në teori. Mënyra e njohjes dhe e arritjes deri te e vërteta për objektet, dukuritë, proceset etj. Metoda në kuptimin e ngushtë ka të bëjë me mënyrat sistematike të veprimeve të verifikuara që zbatohen në procesin e gjurmimit të një çështjeje të caktuar të një disipline shkencore, ose të një çështjeje të ndërlikuar ndërdisiplinore. Me anën e metodave zbulohen, përshkruhen, sistemohen dhe përpunohen faktet dhe konceptet shkencore. Në psikologji metodat hulumtuese kanë kuptim shtrirës më të gjerë dhe dallohen nga procedurat ose teknikat gjurmuese.

METODA E AMPLIFIKIMIT. Metoda e amplifimit ose e shtjellimit të gjerë, të degëzuar (sipas emërtimit në latinisht), që i përket psikologjisë analitike të Karl G. Jungut (Carl G. Jung, 1875 – 1961). Kjo metodë ka të bëjë me zgjerimin e kuptimit të simboleve, të panoramave pamore të ëndrrave dhe kërkon që kjo të kryhet, jo vetëm nga ëndërruesi, por edhe nga shpjeguesi i ëndrrave. Simbolet e ëndrrave shpesh ëndërruesi nuk është në gjendje t`i kuptojë, prandaj kërkon ndihmën e komentuesit të ëndrrave. Sipas Jungut, simbolet dhe panorama e ëndrrave burojnë nga e pavetëdijshmja kolektive dhe, si të tilla janë degëzime të arketipeve**.**

METODA E ANTICIPIMIT. Grup metodash të të mësuarit dhe të të mbajturit mend të asaj që mësohet. Zbatohet për të provuar mbamendjen gjatë të mësuarit mekanik të një serie numrash, formulash, fjalësh të një gjuhe të huaj etj. Metoda e anticipimit zbatohet në këtë mënyrë: nga subjekti provues kërkohet që të thotë numrin, fjalën, formulën etj. pas asaj që i është thënë. Metoda e anticipimit shfrytëzohet më tepër në gjurmimet eksperimetale të të mësuarit dhe të procesit të retencionit ose të mbajtjes mend. Sa më pak përsëritje t`i bëhet të mësuarit të një serie rrokjesh, fjalësh, formulash etj., aq më i fuqishëm është procesi i mbajtjes mend ose i retencionit dhe aq më i vogël është ndikimi i harresës. Përkundrazi, sa më shumë përsëritje të një serie të dhënash të bëhen nga ana e atij që i nënshtrohet eksperimentit, aq më e vogël është sasia e mbajtjes mend të asaj serie dhe aq më i madh është ndikimi i harresës. Shih – ***METODAT E HULUMTIMIT TË KUJTESËS.***

METODA E ASOCIACIONEVE. Metodë që zbatohet për të gjurmuar kujtesën dhe proceset e kujtesës. Metoda e asociacioneve ka të bëjë me të mësuarit e çifteve të fjalëve, numrave, simboleve etj. dhe kërkon nga subjekti, që pas thënies së një fjale, numri, rrokjeje etj. ta thotë njëlloj atë fjalë, atë numër, atë rrokje që i është mësuar.

METODA E ASOCIACIONEVE TË LIRA. Metodë dhe procedurë gjurmuese e zbulimit të konflikteve të shtypura ose të ndrydhura dhe të shtyra nga përmbajtja e vetëdijshme në përmbajtjen e së pavetëdijshmes. Zbatohet duke kërkuar nga ana e një subjekti të caktuar, që në fjalën e dhënë nga ana e gjurmuesit, t`i thotë përmbajtjet që kanë të bëjnë me atë fjalë. Kështu, në fjalën e dhënë "nënë" nga ai kërkohet të thotë përmbajtjet që kanë të bëjnë me këtë fjalë. Përmbajtja e thënë i shërben gjurmuesit për të dalluar idetë e shtypura, të cilat me energjinë e tyre të brendshme shkaktojnë ankth, sjellje të pashpjegueshme, nervozizëm etj., nga të cilat njeriu kërkon të çlirohet dhe të mos jetojë vazhdimisht nën efektet e dëmshme të energjisë së këtyre konflikteve të brendshme. Metoda e asociacioneve të lira u zbatua për herë të parë nga neurologu dhe psikiatri austriak Zigmund Frojd (Sigmund Freud, 1856 – 1939).

METODA E EKSPRESIONIT. Metoda e shprehjes së emocioneve që ka të bëjë me përshkrimin e saktë dhe shpjegimin e ndryshimeve fiziologjike të organizmit të njeriut gjatë kohës së

përjetimit të hidhërimit, të gëzimit, të pikëllimit etj.

METODA E IMPRESIONIT. Metodë e përshkrimit dhe shpjegimit të saktë të emocioneve në bazë të përshtypjeve që ka njeriu gjatë kohës së përjetimit të tyre. Informacionet e nxjerra nga subjekti provues me anë të zbatimit të kësaj metode krahasohen me informacionet e subjekteve të tjerë, për të bërë sa më të qartë natyrën e përjetimit të emocioneve të veçanta.

METODA E KORRELACIONIT PIRSON. Një ndër metodat e matjes së ndërlidhjes ose korrelacionit ndërmjet përmasave sasiore të dy ndryshoreve lineare psikologjike, si: ndërmjet numrit të përsëritjeve mekanike dhe përsëritjeve kuptimlidhëse të një serie rrokjesh nga dyzet studentë, ndërmjet shpejtësisë dhe saktësisë së lëvizjes së gishtërinjve të dorës së djathtë në një aparat matës, ndërmjet sasisë së hormonit të gjëndrës mbiveshkore dhe zemërimit etj. Metoda e korrelacionit Pirson në psikometri dhe në statistikë përgjithësisht është e njohur edhe me termin metoda e korrelacionit produkt. Kjo është metoda më precize e llogaritjes së koeficientit të korrelacionit. Shih – ***KORRELACIONI***. Zbulues i metodës Pirson të korrelacionit është matematikani dhe statisticieni anglez Karl Pirson (Karl Pearson, (1857 – 1936). Formula për llogaritjen e korrelacionit (r) produkt me anë të vlerës z është:

$$r_{xy} = \frac{\sum(z_x, z_y)}{N-1}$$

METODA E KURSIMIT EBINGHAUS. Metodë e hulumtimit të kujtesës që u përdor për herë të parë nga H. Ebinghaus. Sipas kësaj metode gjurmohet se sa kursehet numri i përsëritjeve, ose koha e të mësuarit të një liste rrokjesh, ose sasia e rrokjeve të përvetësuara, kur procesi i të mësuarit të asaj liste rrokjesh është ndërprerë dhe i njëjti subjekt ka filluar të mësojë një listë tjetër rrokjesh, një lëndë të re ose i është nënshtruar një aktiviteti të posaçëm. Sa më e madhe të jetë sasia e rrokjeve që riprodhohen pa gabim pas procesit të të mësuarit të një lënde të re (rrokje, vargje të poezisë, formula kimike etj.), aq më i madh është kursimi (numri i përsëritjeve është më i vogël, koha e të mësuarit rishtas të atyre rrokjeve deri në përvetësimin e plotë është më e shkurtër, si dhe sasia e lëndës së harruar është aq më e vogël. Një raport i tillë mund të na tregojë sa ka ndikuar një lëndë e re në procesin e harresës së rrokjeve të mësuara para se të mësohet kjo lëndë e re (rrokjet, vargjet, formulat etj.). Shih – ***METODAT E HULUMTIMIT TË KUJTESËS***.

METODA E OBSTRUKSIONIT. I ardhur nga latinishtja *obstruktio* "pengesë". Metodë që zbatohet për të përcaktuar shkallën e intensitetit të motiveve në hulumtimet eksperimentale, duke i vënë pengesë kafshës për të arritur te të vegjlit e saj, tek ena me ujë për shuarjen e etjes ose te kutia me ushqim për shuarjen e urisë etj. Ndërmjet maces, qenit, miut etj. dhe enës me ujë vihen pengesa të ndryshme, p.sh., një pol i elektrizuar, një mur qelqi, një enë qelqi e gjatë e mbushur me ujë etj., që macja, miu etj. duhet

ta kalojnë për të arritur deri te ena e mbushur me ujë ose te kutia e mbushur me ushqim etj. Eksperimentuesi mat numrin e orvatjeve dhe të gabimeve të kafshës për të zotëruar pengesën dhe për të arritur deri në enën me ujë, në kutinë me ushqim etj. Sipas numrit të orvatjeve të suksesshme dhe numrit të orvatjeve të kota është konstatuar rendi dhe hierarkia e motiveve; motivi më i fuqishëm është motivi amnor, e pas tij vjen motivi i etjes, i urisë, ai seksual, i kureshtjes etj.

METODA E PREFERENCËS. Një ndër metodat e psikologjisë estetike, sipas së cilës provohet subjekti në zgjedhjen e një objekti, kur ai ndryshon nga të tjerët vetëm në aspektin e cilësisë shqisore të caktuar, sepse ka bukuri, erë, madhësi, shije etj. të ndryshme nga objektet e tjerë që krahasohen me të parin. Renditja e objekteve të përzgjedhura sipas një kriteri (bukuria, proporcioni, shija etj. është shenjë se çfarë parapëlqen subjekti. Kjo metodë zbatohet më tepër në psikologjinë estetike.

METODA E VETËVËZHGIMIT. Vëzhgim sistematik dhe i kujdesshëm i përmbajtjes së vetëdijes dhe përshkrim i qartë i saj, duke përfshirë edhe shpjegimet e mundshme të këtyre përmbajtjeve. Në psikologjinë strukturaliste ka qenë metoda kryesore e hulumtimit të elementeve psikike, të ndijimeve, të përfytyrimeve dhe të ndjenjave të njeriut. Zbatohet në formën e drejtpërdrejtë – kur kërkohet nga subjekti të raportojë për përjetimet e tij të brendshme me rastin e ekspozimit të tij ndaj një ngacmuesi dhe në formën indirekte – kur kërkohet të raportojë për atë që atij i kujtohet, kur ka përjetuar një gjendje të caktuar, si trauma, neveria, stresi etj. Mbledhjes së të dhënave sipas kësaj metode i atribuohen disa të meta: të dhënat e përftuara janë jo të plota, të pamundura për t`u kontrolluar e verifikuar, të pabesueshme plotësisht dhe kanë karakter të thjeshtë subjektiv. Është e njohur më tepër me termin ***introspeksion*** – shih.

METODA EKSPERIMENTALE. Shih – ***EKSPERIMENTI.***

METODA FENOMENOLOGJIKE. Metodë e veçantë me të cilën hulumtohen gjendjet, proceset psikike, sjelljet etj. ashtu qysh janë dhënë në përjetimin subjektiv të njeriut të caktuar. Në zbatimin e kësaj metode hulumtuesi nuk bënë përgatitje në kuptimin e përcaktimit të shemës, të teknikave të veçanta dhe të shfrytëzimit të pikëpamjeve paraprake për dukurinë që hulumtohet; detyra e tij është përfitimi i përshkrimit të saktë të përjetimit ashtu qysh ai e ka ndie paraqitjen e asaj përvoje, sepse kjo mënyrë shpie në kuptimin e botës së brendshme të njeriut, e botës subjektive të pastër të tij.

METODA GJENEALOGJIKE. Metodë gjurmuese e ndikimit të faktorëve trashëgues në zhvillimin e disa tipareve biologjike dhe psikologjike të organizmit të njeriut. Metoda gjenealogjike zbatohet duke e ndjekur sistematikisht dhe me përpikëri të madhe zhvillimin dhe degëzimin e familjeve. Kjo metodë shfrytëzohet edhe për konstatimin e faktorëve trashëgues të sëmundjeve. Me anë të kësaj metode u zbulua se disa çrregullime dhe sëmundje psikike barten me anën e

gjeneve recesive. Metoda gjenealogjike u zbatua në studimet e antropologut e statisticienit anglez Francis Galtonit (Francis Galton, 1822 – 1911).

METODA GJENETIKE. Veprimtari e organizuar hulumtuese mbi lindjen dhe zhvillimin e dukurive, të proceseve, të sjelljeve dhe të tipareve psikike të tyre.

METODA NORMATIVE. Metoda jo eksperimentale që zbatohen me qëllim të përpunimit të të dhënave të përftuara nga vëzhgimi i një ndryshoreje psikologjike të subjekteve normalë. Një ndryshore e tillë ka të bëjë me matjen e saj dhe me të dhënat e përftuara për nivelin e zhvillimit mendor të subjekteve normalë, për shkallën e vjetërsisë së subjekteve të një grupi të caktuar etj.

METODA SOCIOMETRIKE. Mënyrë e posaçme e hulumtimit të marrëdhënieve shoqërore ndërmjet anëtarëve të një grupi shoqëror formal ose joformal. Marrëdhëniet e tilla mund të jenë pozitive, përkatësisht marrëdhënie afruese dhe marrëdhënie negative, përkatësisht marrëdhënie refuzuese. Nga niveli i këtyre marrëdhënieve mund të matet dhe të përcaktohet saktësisht edhe shkalla e afrueshmërisë dhe shkalla e refuzimit ndërmjet anëtarëve të grupit të caktuar. Shkalla e shtrirjes së marrëdhënieve tërheqëse, si edhe ajo e refuzimit ndryshon. Njohja e marrëdhënieve të tilla nevojitet për zhvillimin e raporteve të shëndosha ndërmjet anëtarëve të një mjedisi shoqëror. Metodën sociometrike e ka zbatuar psikiatri amerikan i shkolluar në Austri, Jakob I. Moreno (Jacob I. Moreno, 1892 – 1974). Sipas tij metoda socio-metrike është "qasje eksperimentale e problemit të marrëdhënieve spontane, krijuese, të rolit shoqëror të njeriut, të ndërveprimeve dhe të marrëdhënieve ndërpersonale".

METODA TRANSVERSALE. Metodë gjurmuese e ndryshimeve individuale të një ndryshoreje përgjatë grupeve të subjekteve me shkallë zhvillimi të asaj ndryshoreje të njëpasnjëshme (të moshës 4,5 e 6-vjeçare). Me këtë rast, arritjet i rreshtojmë në një varg prej rastit më të vogël deri në rastin më të madh, për të nxjerrë përgjithësimet e duhura për rrjedhën zhvillimore të asaj ndryshoreje studimore. Kjo prerje transversale ka disa anë pozitive: është ekonomike, mundëson kontrollin e rezultateve, lehtëson përcaktimin e normave zhvillimore për moshat e caktuara etj.

METODAT E HULUMTIMIT TË KUJTESËS. Mënyra sistematike dhe të verifikuara të të provuarit të kujtesës me qëllim të njohjes së natyrës, të funksionit, të zhvillimit dhe të matjes së efektit të saj. Metodat e hulumtimit të kujtesës kanë karakter të metodave indirekte të hulumtimit, të tilla si:

a. **Metoda e anticipimit –** Mënyrë e matjes së sasisë së mbajtjes mend (të retencionit) të një liste të dhënash të pakuptimta (të fjalëve të një gjuhe të huaj, të numrave, të rrokjeve etj.). Metoda e anticipimit zbatohet duke kërkuar nga subjekti që, pas fjalës së thënë nga eksperimentuesi ai ta thotë fjalën që vjen pas asaj fjale. Sa më shumë të kërkohet ekspozimi i listës së të dhënave për t`i qëlluar cila e dhënë radhitet pas asaj që është thënë, aq më e vogël është sasia e mbajtjes mend

ose e retencionit, dhe, përkundrazi, sa më pak të kërkohet ekspozimi i asaj liste të dhënash dhe anticipimit të drejtë të të dhënave, aq më e madhe është sasia e retencionit.

b. Metoda e kursimit – Metodë që mat gjurmët e mbetura në kujtesë nga të mësuarit e një përmbajtjeje, duke konstatuar sasinë më të vogël të përsëritjeve dhe kohën më të shkurtër të përvetësimit të asaj përmbajtjeje pas një kohe të caktuar (pas një-, tri-, dhjetë orësh, përkatësisht pas një-, dhjetë-, tridhjetë ditësh të ndërprerjes së të mësuarit të asaj përmbajtjeje). Dallimi ndërmjet numrit të përsëritjeve të asaj përmbajtjeje kur ajo është mësuar herën e parë dhe numrit të përsëritjeve të së njëjtës përmbajtje kur kjo rimësohet pas tridhjetë ditësh, tregon sasinë më të vogël të përsëritjeve, përkatësisht kohën më të shkurtër të përvetësimit të asaj përmbajtjeje. Kjo sasi më e vogël e përsëritjeve ose e kohës më të shkurtër tregon shkallën e kursimit të përsëritjeve ose të kohës nga të mësuarit e parë të asaj përmbajtjeje. Sa më e madhe të jetë shkalla e kursimit të përsëritjeve të asaj lënde që e kemi mësuar para tridhjetë ditësh, përkatësisht sa më e shkurtër të jetë koha për ta mësuar në nivel të përsëritjes së asaj lënde pa gabime, aq më mirë ajo përmbajtje është mbajtur mend, përkatësisht aq më e madhe është shkalla e retencionit të asaj përmbajtjeje. Metoda e kursimit është e lidhur me emrin e psikologut gjerman Herman fon Ebighauz (Herna von Ebbinghaus, 1850 – 1909);

c. Metoda e rikonstruksionit – Mënyrë specifike e vlerësimit të kujtesës në bazë të renditjes së fjalëve, të numrave, të simboleve etj. sipas mbajtjes mend të rendit të vërtetë të tyre, kur subjekti i caktuar i ka mësuar fjalët, numrat, simbolet para një muaji dhe tashmë (pas një muaji) rendi i tyre është përzier dhe ai ka për detyrë që secilës fjalë, secilit numër, secilit simbol etj. t`ia gjejë vendin e dikurshëm dhe ta vendosë atë pikërisht aty ku e ka pasur vendin, kur është mësuar para një muaji.

d. Metoda e rinjohjes – Ecuri mendore e matjes së elementeve të një liste mbiemrash prej pesëdhjetë sosh, nga të cilët njëzetepesë janë mbiemra të rinj, kurse të tjerët janë mbiemra të mësuar më parë. Nga subjekti kërkohet të përcaktojë cilët janë mbiemrat që janë mësuar më parë (para një viti) dhe cilët janë mbiemrat që shfaqen për herë të parë. Numri i saktë i njohjes së mbiemrave të vjetër tregon masën indirekte të mbajtjes në mend (të retencionit) të atyre mbiemrave. Për zbatimin preciz të kësaj metode, nga numri i saktë zbritet numri i gabimeve dhe sasia e mbetur shumëzohet për 100, kur dëshirojmë të operojmë me përqindje;

e. Metoda e riprodhimit – Ecuri e matjes së gjurmëve të mbetura (të retencionit) nga të mësuarit e parë të një përmbajtjeje në nivel të riprodhimit të saktë të saj dhe të riprodhimit të po asaj përmbajtjeje pas njëzet ditësh. Numri i saktë i elementeve të riprodhuara të asaj përmbajtjeje (listë fjalësh të gjuhës angleze prej 70 sosh) pas njëzet ditësh pjesëtohet me numrin e përgjithshëm të elementeve të asaj liste fjalësh të mësuara para njëzet ditësh dhe kjo sasi pjesëtohet për 100. Kjo është metodë më e vështirë për matjen e retencionit, sepse nga subjektet

kërkohet vetëm riprodhimi i pavarur i 70 fjalëve të anglishtes pas një kohe të caktuar (në rastin tonë pas 20 ditësh).

METODAT E PSIKOFIZIKËS. Metoda gjurmuese të raportit ndërmjet karakteristikave të energjisë fizike, përkatësisht të intensitetit të ngacmuesve fizikë dhe cilësive të përjetimeve psikike, përkatësisht cilësive të ndijimeve. Shih – ***PSIKOFIZIKA.*** Psikofizika klasike ka shfrytëzuar këto metoda proceduriale e teknike gjurmuese:

a. **Metoda kufizuese e intensitetit fizik** – Metodë që zbatohet duke filluar ngacmimin e një shqise (të dëgjimit, të nuhaturit, të të parit etj.) me ngacmuesin adekuat të saj me një intensitetit shumë të ulët (nën pragun e ndjeshmërisë) dhe duke ngritur gradualisht intensitetin deri në atë masë, sa të shkaktojë ndijim te subjekti provues. Në këtë mënyrë fiksohet sasia e matur e energjisë së trupit fizik, e pikërisht kufiri i intensitetit të ngacmuesit që është në gjendje të shkaktojë ndijim. Kjo është forma e parë e kësaj metode. Forma e dytë kufizuese e intensitetit fizik zbatohet duke filluar nga intensiteti mbi pragun e ndijimit dhe duke e zvogëluar sasinë e intensitetit të ngacmuesit fizik deri në masën, që subjekti provues raporton se deri në këtë pikë ndikimi ngacmuesi ka ndijim. Pikërisht nën atë pikë ngacmuesi nuk shkakton ndijim. Pas disa provash të tilla mblidhen rezultatet dhe gjendet mesatarja e intensitetit të trupit fizik që është në gjendje të shkaktojë ndijim, madje edhe ndryshim të pragut të ndijimit;

b. **Metoda e ngacmuesve konstantë** – Teknikë gjurmuese e emërtuar në psikofizikën klasike, ose metodë, me anën e së cilës provohet pragu i ndjeshmërisë së një shqise të caktuar. Zbatohet duke përzgjedhur 5 – 10 ngacmues konstantë intensitetesh të ndryshme dhe duke ngacmuar subjektin herë me njërin ngacmues, herë me tjetrin; nga subjekti kërkohet të raportojë kur ai e ndien ndikimin e ngacmuesit. Kështu provohet subjekti me një seri ngacmuesish dhe pas disa provash gjendet ai ngacmues konstant që është në gjendje të shkaktojë ndijim, pikërisht të arrijë pragun e ndjeshmërisë**;**

c. **Metoda e përshtatjes së subjektit** – Metodë që zbatohet duke kërkuar dhe duke përcaktuar bga vetë subjekti ngacmuesin me intensitet më të ulët, që i përshtatet atij për të shkaktuar ndijim, ose për të bërë dallimin ndërmjet pragut absolut dhe pragut diferencial të ndijimit. Shih – ***PRAGU I NDJESHMËRISË;***

d. **Metoda e vlerësimit të drejtpërdrejtë numerik** - Metodë e psikofizikës bashkëkohore, sipas së cilës subjekti bën përzgjedhjen e një ngacmuesi me intensitet standard që është në gjendje të shkaktojë pragun minimal të ndijimit. Më pas bën përzgjedhjen e disa ngacmuesve me intensitet rreth intensitetit standard dhe me këta ngacmues të intensitetit + 10 nga standardi, provon ndikimin e tyre për të shkaktuar ndijim. Nëse standardi është 10, atëherë duhet vlerësuar nëse intensiteti prej 20 shkallësh a është dy herë më i lartë nga standardi prej 10 shkallësh. Pas përsëritjeve të kësaj prove përcaktohet funksioni psikofizik konstant i ngacmuesit, që është në gjendje të shkaktojë ndijim dhe të bëjë dallimin

e ngacmuesve me intensitet të ndryshëm nga ngacmuesi standard. Këtë metodë e ka zbatuar studiuesi amerikan i psikofizikës Stenli S. Stivens (Stanley S. Stevens, 1906 – 1973). Metoda e vlerësimit të drejtpërdrejtë numerik ka mundësi të zbatohet edhe për konstruksionin e shkallës së matjes të qëndrimeve në psikologjinë sociale.

e. **Metoda e zgjedhjes së detyrueshme** – Metodë përzgjedhje e njërit nga ngacmuesit e paraqitur, me anë të të cilit subjekti i nënshtrohet gjurmimit të tyre. Me zbatimin e kësaj metode ngushtohet shumë qarku i kritereve të subjektit për të dhënë përgjigje dhe kjo cilësi ia shton objektivitetin gjurmimit psikofizik.

METODAT E TË MËSUARIT. Mënyra të verifikuara të të mësuarit të suksesshëm që i zbaton vetë njeriu gjatë këtij procesi, përkatësisht të zotërimit të plotë të asaj që mësohet. Metodat e të mësuarit kanë të bëjnë me organizimin e këtij procesi nga ana e atij që mëson. Metodat e të mësuarit janë:

a. **Metoda e të mësuarit të tërësishëm** – Të mësuarit e përmbajtjes së një teme, të nëntemave të një kapitulli, duke riprodhuar përmbajtjen e tyre në tërësi, përkatësisht prej fillimit deri në mbarim;

b. **Metoda e të mësuarit pjesë-pjesë** – Formë e të mësuarit gjatë së cilës, ai që mëson një përmbajtje e ndan në dy–, tri–, katër pjesë dhe kur e përvetëson pjesën e parë deri në shkallën e riprodhimit pa gabime kalon në të dytën dhe, para se të kalojë në të mësuarin e pjesës së tretë e riprodhon pa gabim pjesën e dytë dhe kështu vazhdon deri në të mësuarit e pjesës së fundit;

c. **Metoda e të mësuarit të kombinuar** – Metodë që zbatohet duke lexuar në tërësi një temë me nëntemat e saj deri në të kuptuarit e përmbajtjes së saj. Më pas këtë e ndan në pjesë të veçanta dhe kur e mëson pjesën e parë kalon në të dytën, nuk kalon në të tretën pa e lidhur pjesën e parë me të dytën me anë të riprodhimit të tyre, më pas kalon në të mësuarit e pjesës së tretë dhe para se të fillojë të mësojë të katërtën e riprodhon pjesën e parë të lidhur me të dytën dhe me të tretën, e kështu me radhë;

d. **Metoda e të mësuarit me pauza** – Metodë që zbatohet duke i ndarë përsëritjet e duhura në periudha kohore të caktuara dhe duke i zbatuar këto sistematikisht. Sipas kësaj metode më produktive janë 21 përsëritje të lëndës brenda 7 ditësh, duke e përsëritur këtë nga 3 herë në ditë, se sa 21 përsëritje të së njëjtës përmbajtje që individi i bën pa ndërprerje;

e. **Metoda e të mësuarit të përqendruar** - Të mësuarit e përmbajtjeve të një lënde në bazë të përsëritjeve të njëpasnjëshme brenda një kohe të shkurtër që ka në dispozicion individi. Kjo metodë zbatohet zakonisht kur nxënësi a studenti gjendet në prag të provimit.

METODAT KËRKIMORE NË PSIKOLOGJI. Mënyra të organizuara të gjurmimit të një çështjeje psikologjike që mbështeten në zbatimin e drejtpërdrejtë të parimeve teorike dhe praktike, në mbledhjen e të dhënave psikologjike dhe në përpunimin shkencor të tyre, me qëllim që të arrihen rezultate që të mundësojnë shpjegimin e çështjes së shtruar për hulumtim. Metodat kryesore të psikologjisë

bashkëkohore janë metoda e vetvëzhgimit, e vëzhgimit sistematik, e eksperimentit dhe metodat statistikore. Zbatimi i këtyre metodave në gjurmimin e çështjeve psikologjike i përshtatet fazave kërkimore kryesore të një çështjeje psikologjike, të cilat janë: a) përcaktimi dhe formulimi i qartë i çështjes kërkimore dhe parashtrimi i hipotezës, b) parashtrimi i çështjes hulumtuese në atë mënyrë që të lidhet me faktet empirike dhe me teoritë e njohura, c) përkufizimi i hipotezës sipas parimeve të përgjithshme që mundësojnë vërtetimin ose mohimin e saj, ç) përcaktimi i procedurave të mbledhjes dhe të përpunimit të të dhënave psikologjike që i përkasin problemit ose çështjes së shtruar për gjurmim, që kanë të bëjnë pikërisht me hipotezën e shtruar për vërtetim, d) analiza e hollësishme e të dhënave të grumbulluara dhe lidhjet ndërmjet tyre, për të pohuar ose mohuar hipotezën e parashtruar dhe dh) përgjithësimi i rezultateve dhe formulimi i qartë i përfundimeve të arritura, duke hapur procese të reja gjurmimi të asaj çështjeje.

a. Metoda e vetvëzhgimit – Metoda kërkimore më e vjetër e psikologjisë, që ka të bëjë me raportimin e subjektit mbi përjetimet e tij me rastin e ngacmimit të një shqise, të përjetimit të një emocioni, të organizimit të vetëdijshëm të sjelljeve të vetëdijshme etj. Shih – ***INTROSPEKSIONI*;**

b. Metoda e vëzhgimit – Metodë që ka të bëjë me perceptimin e atyre reagimeve dhe sjelljeve të jashtme të njeriut, të cilat mund të perceptohen dhe të maten nga ana e studiuesve të tyre. Metoda e vëzhgimit organizohet në formë sistematike dhe sipas programit, përkatësisht, projektit vëzhgues të bashkërenditur mirë. Veprimet e bashkërenditura përfshijnë: saktësimin e objektivit të vëzhgimit, regjistrimin e saktë të ndryshimeve reaguese në kushte të njëjta dhe në kushte të ndryshuara dhe verifikimin e tyre nga ana e të tjerëve, pikërisht të kushteve në të cilat shfaqet dukuria që gjurmohet. Nga bihejvioristët kjo metodë konsiderohet si metoda e vetme objektive. Zbatimi i drejtë i kësaj metode dhe i formave të veçanta objektive të saj për bihejvioristët siguron të dhëna të sigurta shkencore, që mund t`i nënshtrohen përpunimit të tyre;

c. Metoda eksperimentale - Mënyrë e organizuar e gjurmimit të faktorit ose faktorëve, që shkaktojnë dukuri psikike të caktuara ose shkaktojnë ndryshimin sasior ose cilësor të tyre. Metoda eksperimentale zbatohet me qëllim të përcaktimit të përmasave shkakore të një ose disa faktorëve në zhvillimin e një dukurie psikike dhe në ndryshimin e saj nën ndikimin e një faktori ose të faktorëve të caktuar, duke matur dhe vlerësuar ndikimin e atij faktori në sjelljen e një individi të caktuar. Shih – ***EKSPERIMETI NË PSIKOLOGJI***;

d. **Metodat statistikore -** Mënyra e mbledhjes dhe e përpunimit sasior të të dhënave psikologjike të përftuara nga matja e tyre. Dallohen dy grupe procedurash statistikore: procedurat e përshkrimit statistikor dhe procedurat e konkludimit statistikor. Procedurat e përshkrimit statistikor kanë të bëjnë me mbledhjen e të dhënave, me renditjen, me klasifikimin, me përcaktimin e vlerës së mesme të tyre dhe të nivelit të shmangies së të dhënave individuale nga vlera e mesme e tyre. Këtu hyjnë:

MESATARJA ARITMETIKE, MESORJA (MEDIANA) DHE VLERA SASIORE TIPIKE (MODI), SHMANGIA MESATARE SEMIKUARTILE DHE SHMANGIA STANDARDE – shih.

Procedurat e përfundimit statistikor zbatohen me qëllim nxjerrjen e përfundimeve në bazë të përpunimit të vlerave sasiore dhe të nivelit ndërlidhës të tyre. Për këtë qëllim zbatohen këto procedura të veçanta: ***RAPORTI KRITIK, RAPORTI I GABIMIT STANDARD, KOEFICIENTI I NDËRLIDHJES (I KORRELACIONIT), HIPOTEZA ZERO*** – shih.

METODOLOGJIA E PSIKOLOGJISË. Dije e përgjithshme mbi metodat dhe procedurat hulumtuese ose kërkimore të së vërtetës psikologjike. Metodologjia e psikologjisë është sistem parimesh, metodash dhe procedurash koherente, zbatimi i drejtë i të cilave shpie në njohjen e së vërtetës për dukurinë, procesin, llojin e sjelljes etj. Metodologjia e psikologjisë mund të përkufizohet si disiplinë shkencore, që merret me përsosjen e metodave, të procedurave ose teknikave gjurmuese në psikologji. Metodologjia e psikologjisë është disiplinë e veçantë, e cila lidhet drejtpërdrejt me metodologjinë e përgjithshme shkencore, përkatësisht me filozofinë e procesit kërkimor.

MEZENCEFALON, - I. m. I ardhur në anatominë e sistemit nervor nga greqishtja *μεσεγκέφαλος* "truri i mesëm". Truri i mesëm përbëhet nga *tegmentumi* dhe *tektumi*. Në këto pjesë janë të zhvilluara bërthama e kuqe, bërthama e zezë, formacioni retikular etj. Truri i mesëm me pjesët e përmendura luan rol të rëndësishëm në zhvillimin psikomotor dhe të aktivitetit të vullnetshëm të njeriut.

MEZODERM/Ë, - A. f. I ardhur në anatominë e lëkurës nga greqishtja *μεσο* "i mesëm" dhe *δέρμα* "lëkurë". Mezoderma është shtresa e mesme e lëkurës së organizmave shumëqelizorë, që zhvillohet nga qelizat e fazës së parë të embrionit. Mezoderma është baza e zhvillimit të mëvonshëm të muskujve dhe të eshtrave të organizmit.

MEZOMORF, - I. m. I ardhur në psikologji nga tipologjia e personalitetit e psikologut amerikan Uiljam H. Sheldon (William H. Sheldon, 1898 – 1907), që përcakton tipin e zhvillimit trupor të njeriut, te i cili mbisundon zhvillimi fizik a trupor nga muskulatura, eshtrat etj. dhe ka një strukturë relativisht proporcionale të trupit, shih – ***TIPOLOGJIA E SHELDONIT***. Në psikologjinë bashkëkohore proporcionaliteti i trupit të njeriut përcaktohet sipas indeksit të zhvillimit trupor. Shih – ***INDEKSI I ZHVILLIMIT TRUPOR***.

MËNGJARASH, - E. mb. Që punon me dorë të majtë, që luan me këmbë të majtë, që e ka të zhvilluar më shumë pjesën e majtë të trupit se atë të djathtën, përgjithësisht përcakton ata individë (rreth 10 %) te të cilët mbisundon lehtësia e shfrytëzimit të pjesës së majtë të trupit, duke përfshirë jo vetëm pjesët e gjymtyrëve të majta, por edhe syrin, veshin, lëkurën e pjesës së majtë të trupit. Të qenët mëngjarash është rezultat i mbizotërimit të funksionit të hemisferës së djathtë mbi funksionin e

gjymtyrëve të majta të trupit. Dukuria e rrallë e funksionimit të gjymtyrëve të majta të trupit duhet konsideruar dukuri normale e zhvillimit dhe nuk duhen bërë përpjekje për të zhvilluar me çdo kusht vetëm funksionimin e gjymtyrëve të djathta. Kjo është dukuri e lindur.

MËRI, - A. f. Reagim emocional ndaj të tjerëve, i cili ka karakter social. Përjetohet kur individi vlerëson se të tjerët bëjnë kërkesa të tilla ndaj tij, me qëllim dëmtimin e identitetit dhe të integritetit të personalitetit, duke vlerësuar se të tjerët kanë mendim negativ për të. Qëllimi i mërisë që kanë të tjerët për një individ të caktuar është ta nxisin atë në sjellje dhe veprime, me të cilat mohohet qëndrimi negativ që kanë të tjerët për atë individ. Në këtë pikëpamje mëria është ndjenjë sociale që i afrohet mendimit dhe qëndrimit fyes e ofendues. Në literaturën e psikologjisë mërisë i atribuohet rol i rëndësishëm në aktivizimin e individit për të vepruar në drejtim të kundërshtimit, të refuzimit të qëndrimeve fyese dhe ofenduese të të tjerëve për Unin e individit të caktuar. Madje, mërisë i atribuohen ato përmasa nxitëse që i kanë shtyrë individët të angazhohen shumë në vërtetimin e vlerave të tyre, duke zbuluar ide të reja dhe duke i mbrojtur me këmbëngulje të madhe.

M

MËRZI, - A. f. Ndjenjë e ndërlikuar, e shkaktuar nga frustrimi i njeriut nga pengesat e jashtme ose pengesat personale të tij. Mërzia shkaktohet në ato situata, të cilat individi i vlerëson se nuk afrojnë mundësi të plotësimit ose të kënaqjes së dëshirave të tij. Mërzia ka përmasa motivuese, sepse e shtyn njeriun të kërkojë rrethana dhe kushte të tjera, ku ai mund t`i plotësojë ose kënaqë dëshirat e tij. Psikologjia e emocioneve ka dalluar dy lloje mërzish: mërzinë nga situata frustruese, për të cilat individi është i vetëdijshëm dhe mërzinë strukturore, të cilën e karakterizojnë disa çrregullime jetësore të njeriut, si humbja e interesit për ndryshime sociale, ekonomike, politike etj., zbehja dhe humbja e kuptimit të dëshirës dhe e plotësimit të dëshirave etj. Individët e tillë dinë çfarë nuk duan, por hasin në vështirësi të përcaktojnë çfarë dëshirojnë**.**

MËSUARIT (TË). as. Proces i ndryshimit të përhershëm të përjetimeve dhe të sjelljeve të njeriut, që shkaktohen nga nevojat e njeriut dhe nga ndikimi i faktorëve të jashtëm dhe që formohen nën ndikimin e përvojës individuale të tij. Thelbi i procesit të të mësuarit ka të bëjë me karakterin relativisht të përhershëm të ndryshimeve dhe jo me ndryshimet kalimtare të tij që lindin nga lodhja, nga marrja e alkoolit, nga sëmundjet kalimtare etj. Në kuptimin e të mësuarit nuk hyjnë as ndryshimet e përhershme që lindin si rezultat i pjekurisë, apo i plakjes së njeriut. Pra, thelbin domethënës të të mësuarit e përbëjnë vetëm ndryshimet e qëndrueshme të aktivitetit të njeriut; repertori i këtyre ndryshimeve është i madh, sepse njeriu mëson dije teorike dhe praktike, shfaq emocione dhe reagime emocionale, motive, qëndrime, shkathtësi e shprehi (si t`i plotësojë nevojat e motivet), njeriu mëson si të mësojë, mëson vlera sociale, tipare të sjelljeve etj. Të mësuarit është proces, por edhe rezultat i procesit të të mësuarit. Të mësuarit në psikologji ndryshon nga të mësuarit në

pedagogji, ku të mësuarit përkufizohet proces i përftimit të dijeve, shkathtësive e shprehive. Përkufizimit pedagogjik të të mësuarit në shqip do t`i përshtatej më shumë të nxënit (nxënësi nxë dijeni, shkathtësi e shprehi). Në psikologji konsiderojmë se të mësuarit është proces themelor i zhvillimit të gjithanshëm të personalitetit. Pa të mësuar njeriu do të ishte qenie me jetë vegjetative shumë të kufizuar.

Burimet:

Burrhus F. Skinner: "*Science and Human Behavior"* – (*"Shkenca dhe sjellja e njeriut"*), New York: FreePress, 1953.

Jürgen Bredenkamp, Werner Wippich: *"Lern – und Gedächtnispsychologie"* – (*"Të mësuarit dhe psikologjia e kujtesës"),* Bd. 1. Stuttgart: Kohlhammer, 1977.

John P. Houston: *"Fundamentals of Learning and Memory"* – (*"Të mësuarit fondamental dhe kujtesa"*) (3. Aufl.) New York: Harcourt Brace Jovanovich, 1986.

Pëllumb Gaçe: *"Të mësuarit e sotëm dhe psikologjia pedagogjike",* Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë, 1988.

Axel Buchner" *"Implizites Lernen: Probleme und Perspektiven"* – (*"Të mësuarit implicit. Problemet dhe perspektiva"*). Weinheim: Psychologie Verlags Union, 1993.

James Deese, Stewart H. Hulse: *"The Psychology of Learning"* – (*"Psikologjia e të mësuarit"*) (Third Edition), International Student Edition, McGRAW – HILL BOOK COMPANY, New York – St. Louis – San Francisko – Duseeldorf – London – Mexikca – Panama – Sidney – Toronto, KOGAKUSHA COMPANY, LTD. Tokyo.

Isuf Zeneli: *"Bazat psikologjike të të nxënit – Mekanizmat e funksionimit të mendjes",* Prishtinë, 2006.

Charles G. Morris, Albert A. Maisto: *"Psikologjia – Shkenca e proceseve mendore dhe e sjelljeve njerëzore",* CDE Qendra për Arsim Demokratik, Tiranë 2008, fq. 162 – 223.

Ivan Furllan: "*Bazat e procesit të të nxënit*", Prishtinë, 1988.

Pajazit Nushi:*"Të nxënit e lëndëve mësimore dhe zotërimi i tyre*", Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës, Prishtinë,1997.

MËSUARIT AKTIV (**TË)**. Të mësuarit i shtyrë nga dëshira, qëllimi, synimi i atij që mëson një përmbajtje të caktuar. Të mësuarit është aktiv atëherë kur ai që mëson gjurmon informacionet, i riorganizon dhe u jep kuptim atyre dhe ndërlidhjeve që ato kanë, duke e riprodhuar përmbajtjen e caktuar me fjalë dhe me terma të veta. Te të mësuarit aktiv mbisundon të mësuarit në formën e zgjidhjes së problemeve a situatave problemore, të vështruarit kritik të informacioneve dhe të lidhjeve logjike të tyre, duke bërë ndarjen e asaj që është thelbësore nga informacionet e lidhjet dytësore, duke lidhur përmbajtjet e mësuara më parë me përmbajtjet e reja etj.

MËSUARIT ASOCIATIV (TË). Formë e të mësuarit mekanik që zhvillohet në bazë të asociacioneve të fjalëve e fjalive që paraqiten të lidhura njëra me tjetrën sipas renditjes së tyre në tekstin e caktuar. Ky term ka marrë domethënie të ndryshme në shkolla dhe në drejtimet psikologjike të ndryshme: në fillim bëhet fjalë për lidhje ndërmjet ideve, te bihejvioristët bëhej fjalë për të mësuarit e reagimit në mbështetje të lidhjes ngacmues–reagim, kurse te përfaqësuesit e psikologjisë kognitive flitet për të mësuar të lidhjes ndërmjet përfytyrimeve dhe pohimeve etj. Por, gjithnjë fjala është për të mësuar të lidhjeve.

MËSUARIT DISKRIMINUES (TË). Përgjigje të mësuara e të përvetësuara nga ana e një grupi subjektesh provë ndaj ndryshimeve të stimujve dhe të situatave të ndryshme të formuluara

në trajtë detyrash a pyetjesh në një test.

MËSUARIT E NOCIONEVE (TË). Njohja dhe zbatimi i atyre kushteve që kanë të bëjnë me përvetësimin e atyre nocioneve që tashmë janë formuar dhe janë të qëndrueshëm në terminologjinë e një disipline shkencore të caktuar. Të mësuarit e nocioneve mund të bëhet në bazë të përvojës individuale, por ky proces kryhet me anë të organizmit didaktik e metodik të nxënies shkollore. Në procesin e të mësuarit të nocioneve dhe të zbatimit të tyre gjatë mendimit dhe sjelljes së njeriut hasen vështirësi të posaçme në të mësuar të nocioneve abstrakte, si nocioni ego – uni, qenia, jeta etj. Kësaj kategorie nocionesh sot i kushtohet literaturë e gjerë e psikologjisë zhvillimore dhe e psikologjisë pedagogjike, ku hasim nocionet: identifikimi i nocioneve, konstrukti i nocioneve, shfrytëzimi i nocioneve, induktimi i nocioneve etj.

MËSUARIT EKSPLICIT (TË). Proces i vetëdijshëm i organizimit të proceseve kognitive dhe të sjelljeve të njeriut për ta përvetësuar dhe mbajtur mirë në kujtesën e tij, ngaqë përmbajtja e këtij të mësuari do të dallohet dhe cilësohet në procesin e riprodhimit të tij. Të mësuarit eksplicit e shpie njeriun në sistemin e dijes së tij, për të cilën ai është i vetëdijshëm.

MËSUARIT INSTRUMENTAL (TË). Formë e veçantë e të mësuarit të thjeshtë e lidhur me emrin e fiziologut dhe psikologut rus Ivan Pavllov. Të mësuarit instrumental ka të bëjë me përvetësimin e atyre lëvizjeve e veprimeve që shpërblehen. Zhvillohen dhe formohen në sjellje të dobishme dhe të qëndrueshme vetëm ato sjellje të cilat shpërblehen, kurse lëvizjet e sjelljet e tjera zbehen dhe zhduken gradualisht, derisa lëvizjet e sjelljet shpërblyese përforcohen dhe bëhen të qëndrueshme.

MËSUARIT MEKANIK (TË). Formë e thjeshtë e të mësuarit që bazohet në përsëritjen e përmbajtjes logjike të numrave, të rrokjeve etj., vetëm për t`i mbajtur në mend sipas radhës së paraqitjes së tyre në tekstin prej të cilit ato janë mësuar. Të mësuarit mekanik është formë e pranishme e të mësuarit të një vargu të dhënash (një varg prej 12 rrokjesh, disa numra telefoni të shokëve, disa adresa banimi të miqve etj.), por jo edhe për të mësuar në kuptimin e përmbajtjeve të gjera dhe të ndërlikuara.

MËSUARIT MOTORIK (TË). Lloj të mësuari që ka të bëjë me përvetësimin e shkathtësive dhe të shprehive (të shkruarit, ngarja e automobilit, e biçikletës etj). Të mësuarit e shkathtësive e të shprehive realizohet me anë të njohjes së përbërësve të tyre dhe të kryerjes së ushtrimeve e angazhimit të vetëdijshëm të njeriut në zhvillimin dhe përvetësimin e tyre. Pas ushtrimeve të kryera mirë dhe sistematikisht shprehia e caktuar ekzekutohet automatikisht duke e reduktuar energjinë psikike në minimumin e saj.

MËSUARIT OPERANT (TË). Të mësuarit operant është formë e thjeshtë e të mësuarit, e cila mbështetet në kushtëzimin operant. I përket kryesisht terminologjisë së Burhus F. Skinerit (Burrhus Frederick Skinner, 1904 – 19090). Sipas tij "të mësuarit operant është përforcim përzgjedhës i

veprimeve të thjeshta të një subjekti, kur këto veprime janë të rregullta, në përputhje me sjelljen më të ndërlikuar që dëshirohet të arrihet dhe kështu rritet shpeshtësia e reagimeve të dëshiruara, kurse vargu i reagimeve të thjeshta gradualisht shndërrohet në sjellje të ndërlikuar".

MËSUARIT RACIONAL (TË). Të mësuarit në bazë të shfrytëzimit të mendimit racional dhe të operacioneve mendore në të kuptuarin e të dhënave, të informacioneve, sidomos të lidhjeve dhe të raporteve ndërmjet tyre në lëndën që mësohet. Mbështetet në gjykime e raporte ndërmjet tyre, duke nxjerrë në mënyrë të vetëdijshme përfundimin e duhur nga ato gjykime.

MËSUARIT RECEPTIV (**TË**). Formë e të mësuarit të njeriut që ka të bëjë kryesisht me asimilimin, me përvetësimin e informacioneve fjalësore dhe të lidhjeve ndërmjet tyre, ashtu si këto të dhëna janë në tekstin burimor, si edhe me palosjen e tyre në strukturat kognitive të atij që i mëson.

MËSUARIT RELACIONAL (TË). Të mësuarit e përmbajtjeve ku duhen mbisunduar dhe zotëruar raportet ndërmjet të dhënave, fakteve informacioneve, por jo vetë këto të izoluara njëra nga tjera. "Çelësi" i të mësuarit relacional është përvetësimi i të dhënave, fakteve, informacioneve, por në bazë të identifikimit të marrëdhënieve ndërmjet tyre. Është formë produktive e të mësuarit.

MËSUARIT VERBAL (TË). Të mësuarit e përmbajtjeve të shprehura me anën e fjalëve dhe të lidhjeve gramatikore e sintaksore ndërmjet tyre. Të mësuarit e tillë mund të jetë të mësuarit e të dhënave, të cilësive, të numrave etj., që shprehen me anën e simboleve të caktuara (me fjalë, me figura, me numra etj.), duke njohur kuptimin që këto emërtojnë. Kjo formë e të mësuarit ka shtrirje të gjerë: nga të mësuarit e rrokjeve, të mësuarit e fjalëve, të mësuarit e lidhjeve kuptimore ndërmjet dy fjalëve të së njëjtës gjuhë (antonimet – sinonimet), të gjuhëve të ndryshme (ujë – water), të mësuarit e vargjeve të një poezie, të mësuarit e përmbajtjeve të tërësishme të një drame, romani, tragjedie etj.

MËSHIR/Ë, - A. f. Ndjenjë dhembshurie, keqardhjeje, pikëllimi etj. e një individi ndaj një tjetri, i cili gjendet në gjendje të mjerë, i është luhatur ndjenja e sigurisë, e shpresës dhe i ka "humbur" kuptimi i mirëqenies dhe i lumturisë. Ndjenja e mëshirës përjetohet nga ata, të cilëve u është mbyllur vendi i punës dhe nuk kanë mundësi të gjejnë punë tjetër për të siguruar mjete jetese për veten dhe familjen e tyre.

MËTIM, - I. m. Strukturë psikike hipotetike dhe formë e veçantë e veprimtarisë intelektuale të njeriut me anën e së cilës, njeriu depërton shpejt dhe lehtë në të kuptuarit e raporteve kryesore ndërmjet të dhënave të një situate problemore, që shpie në zgjidhje të drejtë të saj. Mëtimi ka të bëjë me përsiatjen e drejtuar në gjurmimin e në zbulimin e lidhjeve dhe të raporteve kryesore të asaj situate dhe në zgjidhjen e saj pa zbatuar metodën e përpjekjeve dhe të gabimeve. Mëtimi është i lidhur me njohjen e situatës dhe me kuptimin e saj që lypset nga njeriu, të cilit i parashtrohet situata problemore për zgjidhje.

MËVESHTI, - A. f. Plogështi e një individi të caktuar që mund të zgjasë relativisht shumë kohë. Mëveshtia shfaqet me mungesën e kundërveprimit të individit ndaj ngacmuesve që ushtrojnë ngacmim në të. Rrjedh nga mungesa e interesit, e motiveve, e ndjenjave, e qëndrimeve etj. ndaj asaj që ngjet dhe vepron në mjedisin e tij. Ndryshimet fizike, shoqërore e psikike dhe raportet ndërmjet tyre vlerësohen të parëndësishme nga ana e të plogështuarit. Këto shkaqe bëjnë që ai të jetë pasiv ndaj asaj që ngjet dhe ndaj atyre ndryshimeve që veprojnë dhe ushtrojnë ndikim të drejtpërdrejtë ose të zhdrejtë në të.

MIASTENI, - A. f. Term i patologjisë, që ka përdorim edhe në psikopatologji dhe në psikologjinë klinike. Miastenia është sëmundje që ka të bëjë me vështirësinë dhe pamundësinë e ekzekutimit të lëvizjeve. Shpesh haset edhe forma e veçantë e kësaj sëmundje *miastenia gravis*, që ka të njëjtën formë manifestuese dhe shkaktohet nga zvogëlimi i receptorëve për neurotransmetuesin e acetilkolinës në membranën e muskujve. Për këtë shkak impulset nervore që vijnë nga fijezat nervore në muskuj nuk arrijnë të shkaktojnë kontraktimin e muskujve dhe lëvizja e tyre përkeqësohet dhe bëhet e pamundur.

M

MID Margaret (Margaret MEAD). Etnologe dhe psikologe amerikane. Lindi në Filadelfia më 1901 dhe vdiq më 1978. Studioi antropologji dhe psikologji në Universitetin e Kolumbisë së Nju Jorkut, ku u doktorua më 1924. Profesore e etnologjisë në Universitetin e Kolumbisë. Ka bërë shpesh udhëtime studimore në ishujt e Polinezisë për të gjurmuar kulturën, doket, zakonet dhe sjelljet e fiseve indiane të Amerikës dhe të shtatë bashkësive të këtyre ishujve: një bashkësie në ishujt Samoa të Polinezisë, katër bashkësive (Mundugumor, Arapesh, Shambuli dhe Jatimul) të Guinesë së Re dhe dy të tjera në Manusi dhe në ishujt Amirote. Në gjurmimet e saj konstatoi dallime të përgjithshme në sjelljet e banorëve të fiseve të afërta njëri me tjetrin. Kështu, në disa fise primitive dallonte se kalimi prej moshës së re në atë të pjekurën bëhet pa krizën e pubertetit dhe të adoleshencës. Në njerin fis meshkujt mund të jenë agresivë ose të tërhequr, ndërsa femrat mund të jenë dominuese ose në rol nënshtrues. Të gjitha këto dallime ia atribuoi rolit të kulturës së mjedisit, që ka ushtruar ndikim të rëndësishëm në modifikimin e sjelljeve të këtyre fiseve. Prej këtej arriti në përfundimin se në zhvillimin dhe në formimin e personalitetit, rol parësor dhe vendimtar luan mjedisi kulturor. Këto ishin zbulime të sjelljeve të posaçme të fiseve të afërta njëri me tjetrin; refuzoi konceptimin psikanalitik të krahasimit të njerëzve të egjër me fëmijë, të raportit nënë-fëmijë dhe të karakterit të mundshëm universal të Kompleksit të Edipit. Veprat kryesore të tij janë: *"Coming of age of Samoa"* – (*"Pjekuria në Samoe"*), 1928; *"Sex and temperament in three primitive societies"* – (*"Seksi dhe temperamenti në tri bashkësi primitive"*), 1935; *Continuites in cultural evolution"* – (*"Vazhdimësia në përparimin kulturor"*), 1964 etj.

MIELENCEFALON, - I. m. I ardhur nga latinishtja *myencephalon*, që i përket terminologjisë së sistemit nervor. Pjesë e sistemit nervor që përbëhet

nga pjesa vazhduese e palcës kurrizore, e cila së bashku me metencefalonin, përkatësisht me urën trunore dhe me trurin e vogël formojnë pjesën e pasme të trurit – rregulloren e proceseve vitale të organizmit.

MIELINIZIM, - I. m. Procesi i zhvillimit gjenetik të membranave mbështjellëse të qelizave nervore dhe të degëve të tyre. Gjurmimet eksperimentale kanë treguar se rrugët aferente nervore (bartja e impulsive nervore nga shqisat e njeriut në sistemin nervor qendror) mielinizohen gjatë zhvillimit të embrionit të njeriut qysh në barkun e nënës. Rrugët nervore eferente (që bartin impulse nga qendrat e sistemit nervor qendror në muskuj), sidomos mielinizimi i qelizave nervore piramidale, e përfundojnë zhvillimin e mielinizimit të tyre rreth moshës dy vjeçare. Ndërkaq, mielinizimi i pjesëve të përparme të trurit të madh përfundon në moshën e adoleshencës (prej moshës 15 deri në moshën 20 vjeç). Zhvillimi i tillë i mielinizimit pas lindjes së fëmijës ka rëndësi për njohjen e bazës fiziologjike të përjetimeve psikike (të proceseve psikike) dhe të sjelljeve të ndërlikuara të njeriut.

MIELINIZIMI MEMBRANOR. Ka strukturë biokimike proteinë–lipide që mbështjell një numër të madh të fijeve nervore, që mbrohen prej saj dhe funksionojnë në mënyrë të izoluar. Kjo mbështjellje dhe izolim mundëson bartjen e impulseve duke mos kaluar prej një fijeje nervore në tjetrën dhe prej një gërshete fijezash në tjetrën. Membranat e mielinizuara ndahen njëra nga tjetra me largësi të barabarta. Membranat e mielinizuara të fijeve nervore mundësojnë bartjen e impulsive nervore shumë më shpejt se fijet nervore të pamielinizuara.

MIGREN/Ë, - A. f. Dhembje e madhe e kokës që shpesh shoqërohet me ligështi të organizmit, me kthim ose nxjerrje të ushqimit dhe me çrregullim të të parit. Rezultatet e gjurmimit të shkaqeve të migrenës konsiderohet se kanë të bëjnë me disa ndryshime dhe me çrregullime kardiovaskulare të trurit. Këto ndryshime kanë bazë psikologjike, sepse shkaktohen nga ngarkesa e madhe emocionale e njeriut, sidomos nga streset dhe lidhen ngushtë me çrregullimet hormonale.

MIKLIM, - I. f. Përkëdhelje ndaj një individi e shtyrë nga dashuria për të. Miklimi shprehet në forma të ndryshme: me fjalë lavdërimi, me lëmim flokësh, me shtrirje duarsh mbi supet, mbi kokën e tjetrit etj. Miklimi ka përmasa motivuese, sepse e shtyn individin të angazhohet në një aktivitet të veçantë, përkatësisht në ndryshimin e tij. Në gjendje miklimi të njeriut objekti ose situata e jashtme e tërheq atë ngaqë has në gatishmëri për të reaguar pozitivisht ndaj asaj situate.

MIKPRITJ/E, - A. f. Institucion psikoetnologjik i trashëgimisë dhe dokeve të Shqiptarëve. Ka të bëjë me ndërlidhjen e tipave të besës, të nderit, të përzemërsisë në një tërësi integrale, në ndjenjë specifike që zhvillohet në bazë të motivit të vetafirmimit të karakterit të të zotit të shtëpisë e të anëtarëve të familjes së tij. Dera e shtëpisë është e hapur; të njohurve dhe të panjohurve që shkelin pragun e shtëpisë, u bëhet nderim i posaçëm, ky konsiderohet mik i shtëpisë. Ndaj tij i zoti i shtëpisë ka detyrime të posaçme. Mban përgjegjësi për mikpritjen dhe për sigurimin

e plotë të jetës së tij, gjatë kohës së qëndrimit në shtëpi, sikurse edhe jashtë shtëpisë, derisa miku t`i dorëzohet një njeriu të besuar. Gjatë kësaj kohe nëse mikut i ndodh diçka nga njerëzit me të cilët është në gjak, kjo konsiderohet si prerje e mikut në besë. Kjo për të zotin e shtëpisë quhej "marria më e madhe e tij". Për këtë ai ndiqej për gjakmarrje, e cila përçmohej sikur të vonohej. Sot mikpritja dhe sjelljet e lidhura me të kanë pësuar ndryshime relativisht të mëdha.

MIKROCEFALI, - A. f. Në patologji, i ardhur nga greqishtja që cilëson kokën e vogël me pasoja psikologjike të veçanta. Ka raste të lindjes së fëmijëve me kokë të zvogëluar që pengon zhvillimin normal të trurit. Mikrocefalia është trashëguese ose mund të zhvillohet gjatë kohës së paralindjes së fëmijës, kur e ëma vuan nga disa sëmundje virusale, nga helmimi dhe nga rrëzimi. Mikrocefalia godet keq zhvillimin e sistemit nervor qendror dhe pasojat psikike janë të rënda. Pasoja më e rëndë është zhvillimi i çrregulluar mendor, përkatësisht zhvillimi i çrregulluar i strukturave të inteligjencës dhe i proceseve intelektuale, si edhe i funksioneve psikike të tjera të lidhura drejtpërdrejt me funksionimin e trurit.

MIKROPSI, - A. f. I ardhur nga greqishtja në anatomi, *μικρός* "i vogël" dhe *όψης* "shikim". Mikropsia emërton të parit jonormal të madhësisë së një objekti. Mikropsia shfaqet në të parit e madhësisë së objektit të caktuar me përmasa më të vogla, seç është në realitet. Mikropsia rrjedh nga disa çrregullime të rrjetëzës ose të retinës, por ka edhe karakter të çrregullimit funksional.

MIKSEDEMI, - A. m. Term i patologjisë së gjëndrave me sekrecion të brendshëm. Sëmundje e shkaktuar nga rrjedha e zvogëluar e hormonit të tiroides, përkatësisht nga rrjedha e zvogëluar e tiroksinës. Shih – ***HIPOTIREOZA; GUSHA.*** Miksedemia emërton dobësimin e përgjithshëm të organizmit, shkallën e ulët të metabolizmit, përgjumësinë etj.

MILGRAM Stenli (Stanley MILGRAM). Psikolog amerikan. Lindi në Nju Jork më 1933 dhe vdiq në Nju Jork më 1984. Studioi psikologji sociale. U doktorua për psikologji, duke u përqendruar në shkaqet e përshtatjes së njeriut dhe të sjelljeve përshtatëse të tij, si edhe në komentimin e shkaktarëve të përshtatjes së njeriut. Studimin e përgatiti dhe e mbrojti nën përkujdesjen e psikologut Gordon Olport në Univesitetin e Harvardit. Ka bashkëpunuar me psikologun Solomom Ashin, duke marrë pjesë në eksperimentet e tij për gjurmimin e sjelljeve përshtatëse sociale. Por, eksperimentet e Stenli Milgramit shkaktuan habinë e shumë vëzhguesve dhe komentuesve të rezultateve të tyre. Njëra nga provat e tij ishte përshtatja e sjelljeve të autoritetit të një urdhërdhënësi, mësuesi, kur subjektet ishin ulur në karrige dhe eksperimentuesi i ngacmonte me elektroshok. Shumë prej vëzhguesve pritnin që këto subjekte nuk do t`i përgjigjeshin pozitivisht kërkesës së mësuesit të tyre, për t`u ulur në karrige në pritje të elektroshokut. Por, nuk ngjau kështu; "numri më i madh i tyre qëndroi deri në elektroshokun e fundit të gjeneratorit". Lind pyetja: Përse ngjau kjo? Sepse në një moment nuk jemi më ata që jemi dhe bëhemi

"zbatuesit" e urdhrit të tjetrit. Sipas tij kjo ndodh ngaqë truri i njeriut është i përgatitur ta pranojë autoritetin e tjetrit. Ai mori pjesë edhe në anketën ndërkombëtare të psikologëve. Sipas tij "fuqia krijuese e psikologjisë sociale qëndron vërtetë në mundësitë e saj për të rikonstruktuar llojet e ndryshme të përvojës shoqërore në mënyrë eksperimentale. Të shpjegon dhe të shkakton operacion konkret të fuqive të fshehura sociale dhe në këtë mënyrë mund të gjurmojë modelet dhe rezultatet me anën e fjalorit gjuhësor". Vepra kryesore: e tij është *"Obedience to authority"* – (*"Nënshtrimi i autoritetit"*), 1974.

MILJ/E, - A. f. I ardhur nga frëngjishtja në psikologjinë e ambientalizmit. Milja emërton tërësinë e mjedisit fizik, biologjik, sociologjik, ndërnjerëzor e psikologjik që e rrethon njeriun dhe të cilit ai i ekspozohet. Ekspozimi i njeriut ndaj mjedisit të vet ushtron ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e përgjithshëm të personalitetit dhe në tiparet e sjelljeve të tij në moshën e rritur.

MIMETIK/Ë – E. mb. I ardhur nga greqishtja *μίμησης* "imitim". Mimetika cilëson ato sjellje me të cilat njeriu imiton të ecurit, të folurit, stilin e jetës etj. të tjetrit. Cilësori mimetik zakonisht përdoret në termat e përngjitur, si: psikomimetik, simpatikomimetik etj.

MIMIK/Ë, - A. f. I ardhur nga greqishtja *μιμρος*. Mimika është lëvizje e veçantë e muskujve të fytyrës, me anën e të cilave shprehet gjendja emocionale, dëshira, mendimi etj. Lëvizjet e tilla zakonisht shoqërojnë të folurit. Mimika në artin teatral është shkathtësi e veçantë krijuese, me të cilën aktori shpreh në mënyrë karakteristike gjendjen e personazhit, rolin e të cilit ai luan. Në mimodramë veçanërisht rolet luhen vetëm me lëvizje muskujsh të fytyrës dhe me lëvizje trupore.

MINIMAL, - E. mb. Vlera më e vogël, më e ulët e një ndryshoreje në një shkallëzim të caktuar.

MINIMUMI I TË PARIT. Ngacmuesi me shtrirje më të vogël që mund të shkaktojë ndijim pamor, i cili mund të identifikohet. Në gjurmimet e pikës së verdhë të rrjetëzës ose të retinës minimumi i të parit zgjat një sekondë.

MIOGRAFI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *μιος* "muskul" dhe *γράφειν* "me shkru". Miografia emërton procesin e regjistrimit të aktivitetit të muskujve, kur njeriu punon dhe kur është në gjendje të qetë. Ky proces kryhet me anën e elektromiogramës. Zakonisht kryhet me anë të elektrodave që vihen në sipërfaqe të lëkurës ose në fijezat muskulore.

MIOPI, - A. f. I ardhur nga latinishtja *myopia* "dritëshkurtër". E metë e të parit të qartë të objekteve dhe dukurive të largëta. Miopia shkaktohet nga gjatësia jonormale e kokërdhokut të syrit, ose nga çrregullimi i akomodimit të syve të njeriut. Rrezet e dritës së objektit të largët fokusohen para retinës në vend që të bien mu në retinë. Miopia korrigjohet duke përdorur syze me diopti të xhamave, të përcaktuar nga mjeku okulist.

MIOTONI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *μυός* "muskul" dhe *τόνος* "tonus" që emërton ngërçin e muskujve, sidomos atë të muskujve të gjymtyrëve, kur pengohet realizimi i

veprimeve të vullnetshme. Miotonia është dukuri e rrallë dhe shfaqet zakonisht në moshën 20 - 35 vjeç. Ka disa simptoma të atrofizimit të muskujve.

MIQËSI, - A. f. Marrëdhënie e ndërsjellë dashamirësie, dashurie, respekti dhe nderimi ndërmjet dy ose më shumë individësh. Miqësia është ndjenjë e ndërlikuar që ka përmasa të fuqishme tërheqëse ndërmjet individëve të miqësuar. Shfaqet me kënaqësinë e njeriut kur ai gjendet pranë mikut të tij. Miqësia në shqipe ka edhe një domethënie: ajo emërton fejesën dhe martesën ndërmjet një mashkulli dhe një femre të familjeve të ndryshme.

MISTER, - I. m. I ardhur nga greqishtja *μυστήριο* "fshehtësi". Misteri është fshehtësi, errësirë e pashpjegueshme e një dukurie, raporti, procesi etj. Termi mister në fillim është përdorur në ritet fetare, kurse më vonë e ka zgjeruar fushën kuptimore të tij, duke përfshirë të gjithë atë që është e fshehtë, që nuk kuptohet. Megjithëkëtë, përmbajtja e këtij termi ka ruajtur theksin religjioz.

MISTICIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga greqishtja *μυστικός* "i (e) fshehtë". Doktrinë shpirtërore, sipas së cilës ekziston një farë lloj dije dhe njohje e mbinatyrshme, irracionale, e fshehtë. Kjo njohje nuk përputhet me dijen dhe njohjen e realitetit me anë të shqisave dhe të proceseve kognitive (të perceptimit, të kujtesës, të mendimit e të folurit) dhe nuk ka të bëjë me metodat racionale të njohjes së realitetit, të zhvillimeve dhe të ndryshimeve objektive. Termi ka ardhur nga teologjia dhe historia e teologjisë, ku ka mbisunduar besimi i njeriut në njohjen hyjnore e metafizike, si dhe ndjenja e përfshirjes së tij në këtë fuqi të fshehtë.

MISTIFIKIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *mistifikare*. Përshkrim i shtrembëruar dhe shpjegim i gënjeshtërt i një dukurie, procesi, raporti etj. që bëhet ndaj të tjerëve për qëllime individuale, duke shfrytëzuar në radhë të parë besimin e të tjerëve në atë që mistifikon.

MIT, - I. m. I ardhur nga mitologjia greke *μύθος* "rrëfim, tregim". Përfytyrim dhe mendim i trilluar që shoqërohet me besimin e individit të një kulture të caktuar në përmbajtjen e tij. Miti është tregim me origjinë të panjohur dhe të pamundur për t`u vërtetuar, por është bërë pjesë e traditës së kulturës së një bashkësie, etnie, populli etj. Në psikanalizë miti është fantazi kolektive. Në psikologjinë analitike të Karl G. Jungut (Carl G. Jung, 1875 – 1961) konsiderohet mjet i rëndësishëm për analizën e së pavetëdijshmes kolektive. Karl G. Jungu ka analizuar shumë mite dhe kuptimin e tyre. Ai në këto mite ka zbuluar shfaqjen simbolike të arketipave. Ka edhe mendime që e kundërshtojnë atë të Karl G. Jungut, duke i dhënë mitit karakterin e pasqyrimit të përgjithshëm për ekzistencën e qenieve mbinatyrore, të asaj qenie që e drejton aktivitetin e të gjithë njerëzisë në sjellje me përmasa të përcaktuara në formë normash të veçanta.

MITOKONDRI, - A. f. Term i fiziologjisë që emërton ato struktura të citoplazmës së qelizave ku krijohet energjia për zhvillimin e proceseve biokimike të qelizës. Këto struktura të citoplazmës kanë edhe një numër të caktuar të gjeneve.

MITOLOGJI, - A. f. Shkenca që merret me studimin e miteve. Mitologjia është përmbledhje mitesh që

karakterizojnë kulturën e një populli të caktuar dhe fazat e veçoritë e zhvillimit të miteve. Mitologjia merret me mbledhjen, përpunimin, shpjegimin e origjinës, të përmbajtjes, të zhvillimit të miteve, të formave të paraqitjes së miteve dhe me rëndësinë e miteve për të kuptuar zhvillimin e kulturës së një bashkësie, etnie, populli. Me studimin e miteve u morën antropologët, etnologët, sociologët etj. Në psikologji me studimin e miteve janë marrë edhe psikanalistët Zigmund Frojd (Sigmund Freud, 1856 – 1939) dhe Karl G. Jung (Carl G. Jung, 1875 – 1961).

MITOMANI, - A. f. Term i përbërë nga *μύθος* dhe *μανία* "marrëzi". Prirje patologjike e qëndrueshme e disa individëve që tejkalon çdo kufi të përshkrimit me fjalë të ndodhive, ku ka gënjeshtra ose i tërë kallëzimi mund të jetë kallëzim gënjeshtar. Termin mitomani dhe kuptimin e tij e ka përshkruar hollësisht Ernest Dupre në librin e njohur "Patologjia e imagjinatës dhe e emocioneve që nga viti 1925".

MITOZ/Ë. - A. f. Procesi i ndarjes së qelizave, kur nga kjo ndarje lindin qeliza me numër të njëjtë kromozomesh sa ka edhe qeliza ndarëse. Me mitozë të qelizave zhvillohen të gjitha qelizat trupore, përpos qelizave vezë dhe atyre të spermatozoideve.

MITURI, - A. f. Emërtim i zhvillimit trupor e psikik të njeriut deri në moshën 18- vjeçare. Deri në moshën 18 vjeç individi nuk arrin të bëhet i pavarur plotësisht, përgjegjës dhe kontrollues i plotë i sjelljeve dhe i veprimeve të tij.

MIZANTROPI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *μίσεω* "urrej" dhe *άνθρωπος* "njeri". Qëndrim i stabili-zuar i një individi që ka të bëjë me mospërfillje, me përbuzje, me neveri dhe me urrejtje ndaj të tjerëve, duke përfshirë edhe të afërmit e tij. Si qën-drimet e tjera, ashtu edhe mizantropia është pasojë e të mësuarit. Mizantro-pia është antonim i filantropisë.

MIZONEIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga greqishtja *μίσεω* "urrej" dhe *neos* "i ri". Urrejtje e stabilizuar e njeriut ndaj gjithë asaj që është e re. Mizoneizmi shfaqet me rezistencën e njeriut ndaj çdo gjëje të re. Një rezistencë e tillë mund të shfaqet ndaj ideve, modeleve, shprehive etj. të reja, madje edhe atëherë kur këto sjellin dobi. Mizoneizmi është në radhë të parë qëndrim i rrënjosur, sipas të cilit bartësi i këtij qëndrimi reagon apriori me refuzim të së resë.

MIZORI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *μίσεω* "urrejtje". Mizoria ka kuptim të veçantë: në rend të parë është qëndrim dhe prirje e ulët dhe e egër e një individi që shoqërohet me kënaqësi, ndërsa individit tjetër i shkakton të këqija, mjerim dhe vuajtje.

MJEDISI SHOQËROR. Rrjet i organizuar e i qëndrueshëm raportesh ndërmjet njerëzve, grupeve dhe institucioneve shoqërore të një vendi, që kanë historinë e kulturës, të gjuhës, traditën e të drejtat e tyre. Mbi këtë bazë mjedisi shoqëror i ka formalizuar e normëzuar shumë raportet ndërmjet anëtarëve të këtij mjedisi dhe ka zhvilluar sistemin e bashkëjetesës së vullnetshme të tyre, solidaritetit ndërmjet tyre dhe perspektiven e zhvillimit të vet. Në kuadrin e zhvillimit të këtillë anëtarët e mjedisit shoqëror veprojnë

në familje, shoqata, organe e institucione profesionale, duke siguruar në këtë mënyrë vazhdimësinë e jetës dhe të zhvillimit të atij mjedisi. Mjedisi i këtillë është i hapur ndaj ndryshimeve paraprijëse të zhvillimit ekonomik, politik, kulturor e shoqëror dhe, mbi këtë bazë, kanë krijuar sistemin e raporteve shoqërore dhe ekonomike. Ky sistem ushtron ndikim të fuqishëm në procesin e socializimit të njeriut, përkatësisht në zhvillimin psikik e fizik të tij. Në këtë sistem dallohet ndikimi i familjes, i institucioneve parashkollore, i shkollave të të gjitha niveleve, i mjeteve të informimit etj. në zhvillimin dhe formimin e tipareve njerëzore, ashtu siç i parasheh sistemi zhvillimor i këtij mjedisi. Pothuajse të gjitha sjelljet e njerëzve janë sjellje shoqërore të ngjyrosura me tiparet e një mjedisi të caktuar shoqëror. Sot ka lëvizshmëri të madhe gjeografike dhe profesionale të popullsisë së shumë mjediseve shoqërore.

MJEKËSIA E GJUMIT. Disiplinë shkencore relativisht e re që merret me studimin e pengesave të të fjeturit gjatë natës, me pagjumësinë e tepruar, me çrregullimet pak a shumë sistematike të ritmit të të fjeturit, me shkaqet e përgjumjes së tepruar etj. Mjekësia e gjumit është më tepër kombinim i psikiatrisë, i neurologjisë, i psikologjisë klinike etj.

MJEKËSIA E PUNËS. Disiplinë e shkencave të mjekësisë që studion ndryshimet fiziologjike gjatë procesit të punës, mbrojtjen e punëtorëve nga dëmtimi dhe fatkeqësitë gjatë procesit të punës, si dhe shërimin e punëtorëve nga pasojat e dëmtimit të tyre gjatë punës. Mjekësia e punës është e lidhur ngushtë me psikologjinë e punës. Shih – ***PSIKOLOGJIA E PUNËS.***

MJERIM, - I. m. Gjendje e ngarkuar psikike e njeriut, i cili përjeton mundime të mëdha, hidhërime, vuajtje etj. relativisht të gjata. Gjendja e tillë shkaktohet nga fatkeqësia, mossukseset e njëpasnjëshme në punë, nga skamja e tepruar dhe e gjatë etj. Një gjendje e tillë ngjall te të tjerët reagime të veçanta emocionale, sidomos atë të keqardhjes dhe të mëshirës.

MJETET MNEMOTIKE. Të gjitha mjetet, format dhe mënyrat e përdoruara për mbajtjen mend sa më lehtë e sa më shpejt të lëndës që mësohet. Forma e mbajtjes mend të vitit kur është formuar laboratori i parë i psikologjisë në Lajpcig (1879), është pohimi se, ai është themeluar një vit pas Kuvendit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878). Viti 1878 i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit është mjet lehtësues që individi e përdor për mbajtjen mend të vitit të themelimit të laboratorit psikologjik në Lajpcig. Kjo formë e mbajtjes mend u zhvillua në fillim nga retorikët e Greqisë dhe të Romës së vjetër. Përmendet në literaturë rasti i mnemoteknikut rus S., i cili për të mbajtur mend emrat e objekteve, i vendosi në mënyrë të dukshme në rrugë të njohura mirë për të. Për të riprodhuar pa gabim radhën e objekteve dhe të emrave të tyre subjekti S "ka shëtitur" mendërisht nëpër këto rrugë dhe i ka emërtuar pa gabim emrat e të gjithë objekteve që i është dashur t`i mbajë mend.

MJETI I SIGURISË. Mjet dhe metodë e çlirimit të njeriut nga ngarkesa

emocionale negative (nga frika, ankthi), si edhe nga vështirësitë jetësore që ndikojnë negativisht në sjelljet e njeriut. Ka kuptimin e metodës në psikologjinë klinike, sepse i përket mënyrave të vërtetuara për të çliruar individin nevrik nga sjelljet neurotike. Ky term haset më tepër në teorinë e personalitetit të Karen Hornait (Karen Horney, 1883 – 1952).

MLLEF, - I. m. Ndjenjë e ndërlikuar e hidhërimit, zemërimit, neverisë së një individi e përforcuar me indinjatë kundër individit tjetër. Mllefi ngjesh energji psikike që e shtynë bartësin e saj të gjejë momentin e zbrazjes ndaj atij që ka mllef. Nën ndikimin e energjisë së mllefit bartësi i saj përjeton ngarkesë të mundimshme, sepse vlerëson që tjetri i ka sjellë dëm.

MMPI. Shkurtesë e inventarit multifazor të Minesotos për personalitetin, përkatësisht shkurtesë e anglishtes (M)inessota (M)ultiphasic (P)ersonality (I)nventory. MMPI është inventar psikodiagnostik i përpiluar me qëllim të përcaktimit të shkallës së afrueshmërisë, e përkatësisht të largësisë së përjetimeve dhe të sjelljeve të një personaliteti të caktuar nga kriteret psikiatrike të një grupi të caktuar individësh. Shih – ***INVENTARI MULTIFAZOR I MINESOTOS PËR PERSONALITETIN.***

MMQ. Shkurtesë e anglishtes Mausdley Personality Questionary – Fletëpyetës për Personalitetin e Shmangur, të hartuar nga psikologu Hans J. Eysenk (Hans Eysenck, 1916 – 1997). MMQ është paraqitur në tri versione. Versioni i fundit ka të bëjë me të provuarin e ekstraversionizmit dhe të psikotizmit.

MNEM/Ë, - A. f. I ardhur nga greqishtja *μνεμα* "kujtesë", i përdorur shumë në psikologjinë klasike. Me termin mnemë është emërtuar gjurma që lë në qelizat e trurit ngacmimi i tyre nga përvoja dhe të mësuarit. Mnema ka kuptim hipotetik; ende nuk mund të verifikohet dhe të përshkruhet hollësisht kjo gjurmë e qelizave të trurit.

MNEMONIK/Ë, - A. f. I ardhur nga greqishtja, që emërton konceptin e përmirësimit ose të përforcimit të kujtesës. Mnemonika zbatohet duke lidhur fjalët pak të njohura ose të panjohura me fjalë të njohura. Shih – ***MNEMOTEKNIKA.***

MNEMOTEKNIK/Ë, - A. f. Term i vjetër, me të cilin janë emërtuar teknikat përkujtuese, përkatësisht mjetet, format dhe mënyrat që lehtësojnë mbajtjen mend të një përmbajtjeje të caktuar fjalësore, motorike etj., si, mbajtjen mend të një vargu të gjatë numrash, fjalësh të huaja, formulash etj., si edhe të një serie lëvizjesh të lidhua njëra pas tjetrës në një tërësi, përkatësisht në një shprehi. Mnemoteknika është shkathtësi e të mbajturit mend dhe e riprodhimit të pagabuar të një lënde të pakuptimtë (të numrave, viteve, emrave etj.), duke i dhënë asaj lënde kuptim të caktuar. Shkathtësia e tillë ka të bëjë me lidhjen e përmbajtjes me pak kuptim, të pakuptimtë etj., me përmbajtje të kuptueshme dhe të njohur për individin që duhet ta mbajë mend atë material. Mnemoteknika përmendet që nga Simonidi i Kreosit i shekullit V e.r.

MOBILITETI SHOQËROR. Gatishmëria e lëvizjes së lehtë të një individi nga një grup, klasë, shtresë etj. në

tjetrin, që ka nivel të barabartë ose më të lartë në kuptimin vertikal ose horizontal. Në mjedise të gjera demokrate mobiliteti shoqëror është më i shprehur nga ai i mjediseve të tjera.

MODALITETI SHQISOR. Llojet e ndijimeve të njeriut për cilësitë e objekteve, të proceseve, të trupave etj., që zhvillohen në bazë të reagimit të shqisave ndaj llojit të ngacmuesve adekuat të tyre. Lloji i tillë i shqisave dhe i ngacmuesve të tyre janë: ndijimet shqisore të të dëgjuarit, të të parit, të nuhatjes, të shijes etj.

MODEL, - I. m. Term i ri i disa disiplinave të shkencave sociale, i ardhur nga latinishtja *modulus* "masë, madhësi, mostër, kampion". Në psikologji modeli ka kuptimin e paraqitjes së strukturës thelbësore të një dukurie. Në psikometri modeli është paraqitja e të dhënave dhe raporteve ndërmjet tyre, me anë të elementeve reale ose të menduar, me qëllim përfitimin sa më të qartë të tërësisë së relacioneve ndërmjet tyre, madje edhe me qëllim të zbulimit të relacioneve të reja në kuadrin e të dhënave të renditura. Modeli mund të jetë i thjeshtë (modeli plastik i strukturës së syrit), modeli matematik etj. Zhvillimi fillestar i psikologjisë është strukturuar sipas zhvillimit të disiplinave të shkencave natyrore. Disa nga modelet e këtyre disiplinave, sidomos të biologjisë, të fiziologjisë dhe të fizikës, janë bartur edhe në shpjegimin e proceseve dhe të sjelljeve.

MODELET E STRUKTURËS SË INTELIGJENCËS. Paraqitje teorike e strukturës të inteligjencës dhe e organizimit të aftësive të inteligjencës së njeriut. Dallohen disa modele të tilla:

a. **Modeli i teorisë dyfaktoriale të inteligjencës** – Shpjegim i operacioneve të inteligjencës në bazë të dy faktorëve: të faktorit gjeneral ose të përgjithshëm (gj) dhe të faktorëve specialë (s). Këtë model e ka konceptuar psikologu britanik Çarl E. Sperman (Charles E. Spearman, 1863 – 1945), por më parë është përcaktuar nga psikologu francez Alfred Bine (Alfred Binet, 1875 – 1911).

b. **Modeli i aftësive mendore parësore të inteligjencës** – Inteligjenca është grup i aftësive përcaktuese të aktit përfundimtar të zgjidhjes së problemeve ku merr pjesë inteligjenca. Këta faktorë janë shatë: 1) Faktori P (perceptiv), S (spacial ose hapësinor), N (numerik) M (mnemik ose i kujtesës), V (verbal ose fjalëzor), W (i rrjedhshmërisë së fjalëve) dhe faktori R (i rezonancës). Modeli i tillë u konceptua nga psikologu dhe psikometri amerikan Luis L. Terston (Lewis L. Thurstone, 1887 – 1955).

c. **Modeli kierarkik i inteligjencës** – Shpjegim i strukturës dhe i funksionit të inteligjencës në bazë të shkallës zhvillimore të këtyre faktorëve: 1) Faktorët specifikë, 2) Faktorët gruporë, 3) Faktorët verbalë – arsimorë dhe faktorët konkretë – mekanikë dhe 4) Në majën e këtyre faktorëve gjendet faktori gjeneral ose i përgjithshëm. Ky model është përpunuar nga psikologu britanik Filip Vernon (Philip Vernon, 1905 – 1987).

d. **Modeli morfologjik i strukturës së inteligjencës** – Model që përcakton tri aspekte të të inteligjencës: aspektin operues (çfarë veprohet?) me pesë lloje operacionesh: të kujtesës, të kognicionit, të konvergjencës, të divergjencës

dhe të vlerësimit; të produkteve (të lëndës mbi të cilën kryhen operacionet) me gjashtë lloje produktesh: të njësive, klasave, relacioneve, sistemeve, transformimeve dhe zbatimeve; aspektin e përmbajtjes (materiali mbi të cilin kryhen operacionet) me katër lloje përmbajtjesh: materiali figurativ, semantik, simbolik dhe bihejvioral. Me shumëzimin e tyre u përftuan 120 faktorë aftësish, relativisht të pavarura të inteligjencës. Modeli morfologjik u përpunua nga psikologu amerikan Xhoj P. Gilford (Joy P. Guilford, 1897).

MODELI HIERARKIK I INTELIGJENCËS. Model me përmasa të teorisë për inteligjencën që i atribuohet psikologut britanik Filip Vernon (Philip Vernon, 1905 – 1987). Ky psikolog, në mbështetje të analizës faktoriale të rezultateve të testeve të inteligjencës dhe vlefshmërisë së tyre, më 1956 paraqiti modelin e pikëpamjes psikometrike të inteligjencës të njohur me emërtimin "Modeli hierarkik i inteligjencës". Sipas këtij modeli inteligjenca ka strukturë të ndërlikuar të përbërë nga tri shkallë faktorësh: 1) Faktorët specifikë që gjenden në shkallën më të ulët të inteligjencës, 2) Faktori i veprimit mendor me forma dhe aftësi mekanike o : m dhe 3) Faktori i përgjithshëm – faktori g, që përbëhet nga dy grupe të rëndësishëm faktorësh: a) faktori i aftësisë së veprimit të lehtë dhe të shpejtë me fjalë dhe b) faktori i arsimimit. Faktori i parë shënohet me raportin v : a, kurse i dyti shënohet me raportin a : m. Nën secilin nga faktorët kryesorë gjenden faktorët më të vegjël gruporë (faktori i aftësisë verbale dhe faktori i aftësisë numerike; më pas faktorët hapësinorë (spacialë) dhe manualë. Këtë e paraqet figura e mëposhtme:



MODELI I BIMËS. Shpjegim i formimit të njeriut nga faktorët e jashtëm, siç ngjet me bimën, kurse zhvillimi i tij i përket mekanizmave vetërregullues të brendshëm që gjenden në vetë farën e dhënë të organizmit. Një kuptim të tillë e hasim në psikologjinë e Karl G. Jungut, të Abraham Maslout, Karl Roxhersit, Karen Hornaj etj., përfaqësues të psikologjisë humaniste.

MODELI I NJERIUT KAFSHË. Term i përdorur për të shpjeguar anën teorike të zhvillimit të njeriut nga bota shtazore. Sipas këtij modeli veprimtarinë e gjithëmbarshme të njeriut e shpjegojmë në bazë të nxitësve, të nevojave të brendshme biologjike dhe të lindura të njeriut. Këtë veprimtari, pra, nuk e udhëheqin proceset e vetëdijshme dhe mendja e njeriut, por ato të pavetëdijshme dhe të lindura. Ky term me kuptim të tillë u përdor në psikologji nën ndikimin e Darvinizmit, të drejtimit refleksologjik dhe të psikanalizës.

MODELI I PERSONALITETIT PEN. Model shpjegues i strukturës hierarkike të psikologjisë së personalitetit i përcaktuar në bazë të zbatimit të analizës faktoriale. Sipas këtij modeli në taksonominë strukturore të personalitetit, në majë të saj, gjenden faktorët e rendit të parë: **P**(sikotizmi), **E**(kstraversioni) dhe **N**(eurotizmi). Nën këta faktorë parësorë shtrihen

faktorët dytësorë të personalitetit dhe poshtë faktorëve dytësorë shtrihen tiparEt e ngushta dhe shprehitë. Modeli PEN shpjegohet edhe me ndryshimet e bazës neurofiziologjike: te psikotizmi shfaqet niveli më i lartë i testosteronit, te ekstraversioni paraqiten ndryshime në funksionimin e cipës apo kores së trurit të madh, kurse te neurotizmi pragu i aktivizimit të sistemit nervor simpatik është më i lartë. Ky është model shpjegues i personalitetit i konstruktuar nga psikologu amerikan Hans J. Ajzenk (Hans J. Eysenck, 1916 – 1997).

MODELI I TË MËSUARIT BRUNER. Formë e konceptuar e të mësuarit, e përvetësimit të informacioneve të reja si edhe të lidhjeve ndërmjet tyre, me angazhimin e drejtpërdrejtë të proceseve kognitive, në rend të parë të procesit të mendimit, në përvetësimin e tyre. Në këtë proces të ndërlikuar rol të rëndësishëm lehtësues në përvetësimin e tij luan organizmi i mirë kuptimor i përmbajtjes që mësohet. Procesi i përvetësimit fillon nga shkalla e ulët angazhuese e proceseve kognitive duke kaluar në përfaqësim përfytyrues dhe përfundon me angazhim të individit në shndërrim simboli të asaj përmbajtjeje. Në këtë proces angazhimi i procesit të të menduarit manifestohet në dy drejtime: duke konstatuar ndryshime ndërmjet përmbajtjeve kognitive të mëhershme dhe atyre të tashme dhe duke gjetur përngjasime ndërmjet tyre, si edhe duke lidhur konceptet bazë në një tërësi sistematike. Kjo formë e të mësuarit dhe e zhvillimit mendor përgjithësisht u trajtuar hollësisht nga psikologu amerikan Xherom S. Bruner (Jer ome S. Bruner, 1915).

MODELI INFANTIL I NJERIUT. Njeriu i rritur në thelb është infant ose fëmijë, sepse dëshirat, fantazitë, motivet, synimet etj. të të rriturit i kanë rrënjët e tyre në fëmijërinë e hershme. Me këtë term shprehet në radhë të parë teoria psikanalitike e Zigmund Frojdit.

MODELI KONJITIV I SJELLJES. Pikëpamje e përgjithshme për rolin e të mësuarit në përvetësimin e modeleve të sjelljeve të njeriut në një mjedis të caktuar kulturor. Sipas kësaj pikëpamjeje, edhe çrregullimet psikike të ndryshme janë rezultat i të mësuarit të mënyrave, të formave dhe modeleve të papërshtatshme të të menduarit për sjelljet, si edhe i të mësuarit të sjelljeve të papërshtatshme, sjelljeve problemore.

MODELI MAKINË I NJERIUT. Shpjegim i strukturës dhe i aktivitetit të njeriut sipas modelit të makinës së ndërlikuar. Njeriun "makinë" e vënë në lëvizje ngacmuesit ose stimuluesit e jashtëm, duke shkaktuar reagim të organizmit në forma të ndryshme. Reagimet ndaj ngacmuesve janë të mësuara ose të lindura. Nëse e zotërojmë strukturën e tillë të njeriut makinë, atëherë mund të kuptohen lehtë, të shpjegohen, të parashikohen dhe të kontrollohen format e veprimtarisë së njeriut. Termin e njeriut makinë me këtë kuptim e hasim kryesisht në literaturën e psikologjisë bihejvioriste.

MODELI MATEMATIK. Model gjurmues i proceseve dhe i sjelljeve sipas përmasave numerike, relacioneve ndërmjet tyre dhe sipas tipit të formulave matematike, duke mundësuar saktësinë e konstatimeve dhe të parashikimeve të zhvillimit të tyre.

MODELI MJEKËSOR. Qasja e pacientit në psikiatri dhe në psikologjinë klinike. Qasja e pacientit sipas modelit mjekësor është: të gjitha çrregullimet organike, fiziologjike dhe çrregullimet psikike janë të zhvilluara nga shkaku ose shkaqet e caktuara, prandaj mjekimi është i mundur në bazë të konstatimit të atyre shkaqeve dhe shërimi është i mundshëm, duke eliminuar shkakun ose shkaqet e tyre.

MODELI PËRFAQËSUES. Term i përdorur më tepër nga ana e psikologut amerikan Xherom S. Bruner (Jerome S. Bruner, 1915). Sipas tij fëmija e konceptualizon veten dhe realitetin sipas shkallës së zhvillimit të strukturave kognitive dhe funksioneve të tyre. Sipas këtyre shkallëve konceptualizimi i realitetit te fëmija zhvillohet në këtë mënyrë: 1) Modeli i aksionit – reagimi motik i fëmijës ndaj ngacmuesve të jashtëm dhe imitimi motorik i sjelljeve, 2) Modeli i përfaqësimit ikonik – zhvillimi ikonik ose figurativ i formave të realitetit, ku detajet e objekteve fillojnë të humbin; ky nivel i zhvillimit kognitiv është më shumë abstrakt se real, 3) Modeli i përfaqësimit simbolik – shndërrimi i formave dhe zhvillimeve reale në simbole karakteristike.

MODELIMI KAUZAL. Procedura analitike statistikore, me anën e zbatimit të të cilave synohet të identifikohet raporti ndërmjet shkakut e rrjedhimit të ndryshoreve psikologjie. Ndërlidhja e një ndryshore me ndryshoren tjetër, shpesh e shkallës së lartë, nuk tregon raport shkak – rrjedhim ndërmjet tyre. I tillë është raporti ndërmjet kënaqësisë së psikologut shkollor dhe efekteve pozitive të tij. Por, kjo ndërlidhje nuk vërteton se kënaqësia është shkak i efekteve pozitive ose se efektet pozitive rrjedhin nga kënaqësia në punë të psikologut shkollor. Shkak i efekteve pozitive mund të jetë jo vetëm kënaqësia, por edhe shkalla e lartë profesionale dhe përkushtimi i psikologut shkollor në efektet pozitive. Analizat e ndërlidhjeve parciale dhe analiza regresive e të dhënave të dy ndryshoreve mund të shpie hulumtuesit deri në konstatimin e rolit të disa faktorëve në efektet pozitive dhe të qëndrueshme të një psikologu shkollor të suksesshëm.

MODESTI, - A. f. Tipar i një personaliteti të caktuar që shfaqet me përmbajtjen e vlerave e meritave dhe të kërkesave ndaj të tjerëve. Modestia, si e tillë, ka intensitet të ndryshëm, që sillet prej përshtatjes së sjelljeve të rëndomta, sjelljeve të nivelit mesatar dhe mund të shkojë deri te nënçmimi i vlerave personale. Modestia është tipar që mësohet gjatë jetës dhe përvojës së njeriut.

MOD, - I. m. Një ndër masat statistikore të vlerës së mesme. Modi quhet vlerë mbisunduese, sepse ka frekuencën më të shpeshtë, përsëritet më shumë në rezultatet e arritura të matjes së një aftësie, të arritjeve në një fushë veprimi etj. Modi është masa statistikore më e pasigurt dhe ka përdorim të rrallë në psikometri. Një seri rezultatesh mund të kenë një mod, dy ose tre mode. Kështu dallojmë unimodalen, bimodalen dhe disamodalen në një varg relativisht të gjatë vlerash numerike.

MODIFIKIMI I SJELLJES. Ndryshimi i sjelljes dhe përshtatja e saj ndaj kërkesave të brendshme dhe të jashtme të njeriut. Modifikimi i sjelljes ka të bëjë me teprinë e përdori-

mit të sjelljeve problematike ose me mungesën a deficitin e sjelljes së duhur. Në modifikim e sjelljeve zbatim të rëndësishëm ka gjetur përforcimi i sjelljeve të duhura dhe ndëshkimi i atyre që njeriu nuk arrin t`iu përmbahet pa i kryer. Termi modifikim i sjelljes është i lidhur në fillim me psikologjinë e Eduard Torndajk (Edward Thorndike, 1874 – 1949). Përgjithësisht modifikimi i sjelljes ka të bëjë me ndryshimin e një lloj sjelljeje me sjellje më të përshtatshme. Me studimin dhe modifikimin e sjelljes është marrë edhe psikologu shqiptar ***Neki Juniku*** – shih.

MODUL, - I. m. Term i ri i psikologjisë që ka dy kuptime: 1) faktor, kapacitet, fuqi kognitive, si faktori, fuqia ose moduli gjuhësor. Kuptimi i këtij termi në psikologji lidhet me filozofinë e psikologut amerikan Xheri Fodor (Jerry Fodor, 1935). 2) Aspekt i mësuar i një sjelljeje të njeriut, që shfaqet në fazën përfundimtare të zhvillimit kognitiv dhe ka të bëjë me zgjidhje të situatave problemore. Ky është kuptimi i modulit në teorinë e zhvillimit kognitiv të fëmijëve, sipas teorisë së psikologut amerikan Xherom S. Bruner (Jerome S. Bruner, 1915).

MOHIM, - I. m. Mekanizëm mbrojtës i pasuksesshëm që shpreh një reagim mohues të personalitetit ndaj një ngjarje të jashtme, por që shkakton dhembje, pikëllim, hidhërim etj., duke mos e pranuar atë të vërtetë. E tillë është vdekja e papritur e bashkëshortes, e mikut etj. në mërgim.

MOJMAN Ernst (Ernst MEUMANN). Psikolog gjerman dhe hulumtues i estetikës, themelues i psikologjisë pedagogjike eksperimentale. Lindi në Uerdingen (në afërsi të qytetit Krefeld) më 1862 dhe vdiq në Hamburg më 1915. Më 1891 mbrojti tezën e doktoratës në Universitetin e Tybingenit. Ka punuar si asistent më 1893 në Institutin "Vilhelm Vunt" dhe më 1894 u zgjodh asistent i parë. Më pas u zhvendos në Zyrih e më tej në Kënigsberg, në Mynster, në Hale dhe në Lajpcig. Ernst Mojman është themelues i Arkivit të mbarë psikologjisë më 1903 dhe, në të njëjtën kohë, anëtar i Shoqatës Gjermane për Psikologjnë Eksperimentale. Më 1907 ai themeloi *"Revistën për psikologji pedagogjike" ("Zeitschrift für pedagogische Psihologie"),* që u bë revistë qendrore për çështjet e psikologjisë e pedagogjisë. Ai i barti metodat e procedurat eksperimentale të veprimtarisë gjurmuese të Institutit "Vilhelm Vunt" në hulumtime psikologjike (së pari në hulumtimet e kujtesës), pedagogjike dhe estetike. Në estetikë ka shfrytëzuar dhe mbështetur pikëpamjet e tij mbi të dhënat e Gustav Teodor Fehnerit. Është i njohur për kontributet e tij në zhvillimin e psikologjisë pedagogjike. Veprat kryesore të Ernst Mojmanit janë: *"Vorlesungen zur Einführung in die experimentalle Pädagogik und ihre psychologische Grundlagen" – ("Leksione për hyrje në pedagogjinë eksperimentale dhe bazat psikologjike të saj")* , 1907; *"Intelligenz und Wille" – ("Inteligjenca dhe vullneti"),* 1907; *"Einfürhung in die Ästhetik der Gegenwart" – ("Hyrje në estetikën e sotme"),* 1908; "*Abriss der experimentallen Pädagogik" – ("Skica e pedagogjisë eksperimentale"),* 1914.

MOLISJ/E, - A. f. Gjendja organike dhe psikike e një individi shumë të lodhur, që nga puna e tepërt gjendet në pikën e kufirit të humbjes së ener-

gjive të fundit për aktivitet të mëtejshëm. Një gjendje e tillë shkaktohet nga përqendrimi i acidit laktik (të qumështit) në indet e organizmit, që çon për rrjedhojë në gjendjen acitoze të individit. Harxhimi i glikogjenit në organizëm dhe ndryshimet negative në funksionimin e qendrave nervore dhe të sinapseve neuromuskulare çojnë gjithashtu në molisje. Kjo gjendje është e pandarë nga dhembja e muskujve, nga humbja e interesit, mërzia, pakënaqësia etj. Shih – ***RRASKAPITJA.***

MOMENTI PSIKOLOGJIK. Koha më e shkurtër se një sekondë, e mjaftueshme për të perceptuar dy ngacmues si një ngacmues i tërë. Në psikometri ka kuptim të posaçëm.

MONGOLIZ/ËM, - MI. m. Sëmundje që ka të bëjë me zhvillimin e kufizuar mendor dhe me disa veçori trupore të mongolezëve. Tri janë veçoritë trupore të atij që vuan nga sëmundja e mongolizmit: 1) anomalia e kokës: koka e vogël, e rrumbullakët me fytyrë të rrafshët, 2) anomalia e gjuhës: gjuha e madhe, e trashë dhe me çarje relativisht të thella; 3) anomalia e syve: hapja e kapakëve të syrit është e ngushtë, kurse pamja e syve është pamje e shtrirë etj. Aftësitë intelektuale kanë nivel zhvillimit të kufizuar, duke u shtrirë prej nivelit të imbecilitetit deri në atë të idiotizmit. Shkaqet e kësaj sëmundjeje janë ende të panjohura krejtësisht. Mongolizmi shfaqet te nënat që nuk arrijnë të marrin në sasi të duhura albumina, vitamina dhe kripëra minerale etj. Ka raste kur kjo sëmundje shfaqet te fëmija që lind nga prindër në moshë të kaluar. Mongolizmi nuk është sëmundje trashëguese. Mongolizmin e ka përshkruar qysh më 1866 mjeku anglez Xhon L. H. Daun (John L. H. Down, 1828 – 1896). Shih – ***SINDROMA DAUN.***

MONIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga greqishtja *μόνος* "një" dhe që ka hyrë në psikologji nga filozofia. Monizmi është pikëpamje filozofike që orvatet të argumentojë ekzistencën vetëm të një realiteti përfundimtar: të frymës ose të materies. Kjo pikëpamje ka hyrë në psikologji për shkak të shpjegimit të raportit trup – psikikë, duke i përmbledhur të gjitha konceptet e dukurive, të proceseve psikike dhe të sjelljeve në një entitet të përbashkët: në dukuritë trupore-organike, ose duke i vendosur të gjitha dukuritë trupore në entitetin e frymës, të psikikës. Në këtë kuadër ekzistojnë disa lloje monizmash, nga të cilët dallohet monizmi psikofizik, sipas të cilit trupi dhe shpirti nuk janë entitete krejtësisht të ndryshme, por dy aspekte të të njëjtit entitet: shpirti me dukuritë e tij është shprehje e trupit dhe trupi me ndryshimet e veta është shprehje e shpirtit dhe e dukurive të ti**j.**

MONOGRAFIA PSIKOLOGJIKE. Vepër profesionale dhe shkencore mbi dukurinë psikike, personalitetin e dalluar në studimet psikologjike etj. Monografia psikologjike dallohet edhe si metodë hulumtuese, sepse ka qasje të posaçme studimore për një proces psikik ose për një personalitet psikologjik. Monografi psikologjike mund të jetë: "Psikologjia e inteligjencës" e Zhan Pijazhes, "Të menduarit dhe të folurit" e Lav Vigotskit, "Si ta kuptojmë Frojdin" e Zhak Sedas etj.

MONOKROMATOPSI, - A. f. I ardhur nga greqishtja që ka të bëjë me verbim të njeriut ndaj ngjyrave.

Ekzistojnë dy forma kryesore të monokromatopsisë: 1) Njeriu dallon vetëm të murrmen, kurse të gjitha valët elektromagnetike që shkaktojnë cilësinë e ngjyrave nuk është në gjendje t`i dallojë. Kjo formë e verbimit ndaj ngjyrave quhet akromatopsi dhe shkaktohet nga mungesa e fijeve në formë thupërzash në retinën e syrit. 2) Të gjitha ngjyrat janë të reduktuara në një nuancë të vetme. Kjo shkaktohet nga ekzistenca vetëm e një tipi konesh në retinën e syrit. Shih – ***DALTONIZMI; PRONATOPIA.***

MONOKULAR, - E. mb. Të parit me një sy që shkakton dallimin e sipërfaqes, kurse dallimi i thellësisë së trupave (pamja tripërmasore) është i vështirë. Këtë e mundësojnë disa shenja, ndër të cilat dallohen: shenjat fiziologjike: akomodimi i lentës dhe madhësia e figurës së trupit në retinë, përvoja e njeriut, ndijimet kinestetike etj. Shenjat objektive, që mundësojnë dallimin e thellësisë gjatë të parit me një sy, kanë të bëjnë me karakteristikat e ngacmuesve të syrit që janë: afërsia e trupit shkakton qartësinë e perceptimit të tij, madhësia e trupit, e me këtë rast trupat me madhësi të vogël duken më të largët, mbulesa e një trupi me trupin tjetër, ku trupi që mbulohet pjesërisht nga tjetri duket më i afërt, vija konvergjente e të parit me një sy, si p.sh., në rastin që, sa më e madhe të jetë kjo vijë aq më i largët duket trupi.

MONOMANI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *μονο* "një" dhe *μανία* "çmenduri". Monomania është term klasik që ka emërtuar së pari paranojën. Monomania është lloj çmendurie e parregullsie në funksion të një strukture psikike. E tillë është parregullsia në funksionin emocional, kurse intelekti dhe motivacioni ruhen dhe funksionojnë normalisht.

MONOTONI, - A. f. Term i ardhur në psikologji nga greqishtja. Monotonia është përsëritja e njëtrajtshme e një dukurie, procesi, veprimi etj., pa pësuar kurrfarë ndryshimesh në strukturën dhe në rrjedhën e ritmin e saj. Ky term përdoret më tepër në psikologjinë e punës, duke theksuar më shumë përjetimin e reagimit të posaçëm të një punëtori ndaj monotonisë në një punë të caktuar, siç është puna me lëvizje të njëtrajtshme. Reagimi i punëtorit ndaj kësaj pune monotone është përjetimi kompleks i mërzisë, i zvogëlimit të motivacionit për punë etj. Objektivisht monotonia dhe reagimi negativ i saj te punëtorët shfaqet me zvogëlimin e sasisë së prodhimit dhe me keqësimin e cilësisë së produkteve. Rënia e intensitetit të punës për shkak të monotonisë shfaqet më tepër në mesin e punës.

MONTESORI Maria (Maria MONTESSORI). Mjeke italiane. Lindi në Shiravale (afër Ankonës) më 31.08.1870 dhe vdiq në Nordvijk të Hollandës më 6.05.1952. U lind dhe u rrit nga prindër liberalë të Italisë së fundshekullit të nëntëmbëdhjetë dhe të dekadave të para të gjysmës së shekullit të njëzet. Pas përfundimit të studimeve në Fakultetin e mjekësisë në Romë më 1896 u diplomua edhe në filozofi e psikologji eksperimentale. Më 1896 u emërua drejtore e Shkollës Ortofrenike, e Institutit Mjekësor-Psikologjik, ku ka punuar dhe gjurmuar zhvillimin psikik të fëmijëve jonormalë dhe të fëmijëve me zhvillim psikik të vonuar. U mor kryesisht me procesin e

të mësuarit dhe rolin e tij në zhvillimin e fëmijëve. Më 1906 konceptoi institucionin "Casa dei Bambini" – "Shtëpia e Fëmijëve". Në këtë institucion mblodhi fëmijët nga lagjet e varfra në San Lorenco, ku dhe ngriti shtëpinë e fëmijëve më 1907. Në procesin e edukimit dhe të zhvillimit të fëmijëve zbatoi metodën pedagogjike të mbështetur në psikologji. Kjo metodë tashmë është e njohur me termin "Fenomeni Montesori" ose "Sistemi Montesori". Sipas këtij sistemi edukimi dhe arsimimi i fëmijëve është individual (përveç lojës së përbashkët). Fëmijët kanë kapacitete dhe fuqi psikologjike të lindura për vetëzhvillim; në secilën fazë të zhvillimit të tyre fëmijët i shfaqin nevojat e tyre të brendshme, të cilat aktivohen në kushte të volitshme sociale dhe ekonomike. Edukata ka për detyrë, që duke respektuar personalitetin e fëmijës, t`i mundësojë secilit fëmijë zhvillimin e lirë të personalitetit dhe të aftësive natyrore të tij. Për të arritur këtë Maria Montesori kryente në shtëpinë e fëmijëve ushtrime, pra stërvitje të muskujve, të shqisave dhe të sistemit nervor. Në këtë kuadër mbështeti zhvillimin e aftësive sensomotorike dhe intelektuale, duke u përqendruar më tepër në vetedukim. Për këtë qëllim ajo ishte e mendimit se "Fëmija duhet të jetë i pavarur në aktivitete dhe të gjejë vetë atë çka i intereson gjatë aktivitetit dhe punës së pandërprerë". Në aktivitete të shumëllojshme që ajo organizonte kërkonte që fëmija të gjente lirisht atë që atij i interesonte me anë të kënaqësisë që ndiente, duke zhvilluar edhe interesin e veçantë të tij. Ajo besonte se në këtë mënyrë zhvillohet personaliteti i lirë dhe tiparet e posaçme të tij. Sipas këtij sistemi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga viti 1913 ngriti 100 shkolla të tipit "Casa dei Bambini". Pjesërisht këtë e zbatoi edhe në Hindi. Stërvitja e fuqishme e fëmijëve me anë të aktiviteteve të lira dhe zhvillimit të lirë moral të tij u quajt "Fenomeni Montesori". Ky fenomen ka përmasa të theksuara të biologjizimit dhe të injorimit të rolit të procesit të socializimit të fëmijëve. Më 1958 themeloi në Nancy McCormick Rambush të Shteteve të Bashkuara të Amerikës "Shoqatën Montesori të Amerikës". Kjo shoqatë mund të ketë ndikuar edhe në formimin e atyre pak pedagogëve shqiptarë që studiuan në universitetet italiane, por në historinë e arsimit dhe të mendimit pedagogjik shqiptar nuk përmendet. Veprat kryesore të saj janë: "*Il metodo della pedagogia scientifica aplicato all`autoeducazione infantile nelle Casa dei Bambini*" – (*"Metodat e pedagogjisë shkencore të zbatuara në vetedukimin e fëmijëve në "Shtëpinë e Fëmijëve"*), 1909; *"Antropologia pedagogica"* – (*"Pedagogjia antropologjike"*), 1910; *"Manuale della pedagogia scientifica"* – (*"Doracak i pedagogjisë shkencore"*), 1935; "*Il segreto dell`infansia*" – (*"Sekreti i fëmijërisë"*), 1950 etj. Në anglisht përmendet botimi i disa veprave, si: "*The Montessori Method*" – (*"Metoda e Montesorit"*), botuar më 1911; *"The Advanced Montessori Method" – "Metoda Montesori e përparuar",* 1917; *"Discovery of the Child"* – (*"Eksplorimi i fëmijëve"),*botuar më 1946 etj.

MORAL, - I. m. I ardhur nga latinishtja *moris* "zakon". Morali është term që bën pjesë në terminologjinë e disa disiplinave, së pari në terminologjinë e etikës dhe përkon me atë të psikologjisë. Morali është tërësi parimesh, idealesh, rregullsish, vlerash, zakonesh

dhe normash shoqërore të një shoqërie ose të një pjese të saj, që përcaktojnë çfarë është sjellja e mirë dhe e keqe, e vlefshme dhe e pavlefshme, e drejtë dhe e padrejtë. Secili mjedis shoqëror e kulturor ka moralin e vet, i cili kryen funksion të rëndësishëm në zhvillimin e marrëdhënieve shoqërore ndërmjet anëtarëve të një shoqërie të caktuar. Kuptimi dhe sjellja e pranueshme, e mirë, e drejtë ose e papranueshme, e keqe dhe e padrejtë ndryshon varësisht nga zhvillimi i raporteve sociale, ekonomike e politike të mjedisit ku zhvillohet dhe formohet personaliteti e karakteri i njeriut. Kuptimi për sjelljet pozitive a negative, të mira a të këqija, të drejta apo të padrejta dhe sistemi i sjelljeve të tilla te njeriu zhvillohet dhe formohet gjatë procesit të socializimit, ku rol të rëndësishëm luan edukata, posaçërisht edukata familjare, sidomos edukata morale.

MORAL INSANITY. Shih – ***ANOMALIA MORAL INSANITY***.

MORALITETI AUTONOM. Shkalla më e lartë e zhvillimit të vetëdijes morale dhe të sjelljeve të kontrolluara nga vetëdija e tillë e njeriut. I përket nivelit të atillë të zhvillimit të njeriut, kur ai ka përvetësuar parimet dhe normat morale, është në gjendje të vlerësojë sipas këtyre parimeve dhe normave, si edhe të veprojë në mbështetje të tyre. Moraliteti autonom i personalitetit shfaqet në respektimin e tjetrit dhe të dinjitetit të tij, në shkallën e lartë të zhvillimit të ndjenjës së përgjegjësisë për sjelljet e veta pavarësisht nga situate ku ai gjendet. Ky term përmendet në psikologjinë e Zhan Piazhes (Jean Piaget, 1896 – 1980).

MORATORIUM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *morari* "zgjat e mos këput". Në psikologji është term i përdorur nga ana e psikologut amerikan Erik H. Erikson (Erich H. Erikson, 1902 – 1994). Me termin moratorium Eriksoni ka emërtuar shtyrjen e detyrave të adoleshentit ndaj kërkesave të mjedisit social. Gjatë adoleshencës mund të ndodhë që ai të bëjë sjellje të rënda, madje edhe të dënueshme. Në këto raste adoleshenti nuk duhet dënuar, sepse kjo është periudha më e rëndësishme e zhvillimit dhe e formimit të identitetit të tij.

MORFEM/Ë, - A. f. Term i gramatikës i ardhur nga greqishtja *μόρφημα* "formë". Emërton njësinë më të vogël gjuhësore që është bartëse e një kuptimi të caktuar. Morfema mund të jetë një fjalë, si *libër, hije, mollë* etj. ose mund të jetë fjalë e përngjitur, si *pakuptim, mospërfillje, artificialisht,* përkatësisht fjalë me parashtesa, me prapashtesa etj. Morfemat i studion morfologjia e një gjuhe të caktuar. Morfemat kombinohen sipas rregullave gramatikore duke formuar fjali, me të cilat shprehet një gjykim i caktuar.

MORFIN,Ë, - A. f. Morfina është një lloj droge, një strukturë e ndërlikuar farmakologjike. Morfina ka ndikim të fuqishëm qetësues, euforik dhe hipnotik te të sëmurit me dhembje të mëdha. Me rastin e marrjes së dozave të caktuara të morfinës i sëmuri mund të qetësohet, por më pas mund të lindë nevoja e marrjes përsëri të morfinës. Me pak marrje të dozave të morfinës zhvillohet varësia fiziologjike dhe psikologjike e njeriut nga morfina. Morfina është term sipas perëndisë greke të gjumit Morfej.

MORI, - A. f. Gjendje euforike e një njeriu të caktuar, e cila manifestohet kryesisht me mospërmbajtje të euforisë dhe me jo gatishmëri për të vepruar seriozisht në veprimet me të tjerët. Moria ka bazë anatomike dhe fiziologjike të lidhur me pjesën ose copën ballore – temporale të trurit.

MORON, - I. m. Term i psiko-patologjisë i ardhur nga greqishtja *μωρός* "i trashë, me mendje të trashë". Kështu janë emërtuar rastet e zhvillimit të kufizuar mendor të disa individëve. Moronët kanë deficite në zhvillimin e inteligjencës. Termi moron i përket zhvillimit të psikologjisë së dikurshme, kurse sot përdoret më tepër në literaturën e psikologjisë angleze. Në vend të termit moron përdoret termi debil. Shih – ***DEBILITETI.***

MORTALITET, - I. m. Term i demografisë i ardhur nga latinishtja *mortalis* "vdekshmëria". Me termin mortalitet emërtohet përqindja e raportit ndërmjet të vdekurve dhe numrit të përgjithshëm të popullsisë së një vendi, përkatësisht raporti ndërmjet numrit të të vdekurve brenda një njësie kohore (brenda një viti) për një popullsi prej 1000 banorëve të atij vendi. Që një popull, një etni, një komb të jetë i zhvilluar e të ketë mirëqenie duhet që numri i të vdekurve të jetë më i vogël se ai i të lindurve.

MORTIDO, - JA. f. Emërtim i energjisë hipotetike të shtytësit të vdekjes, përkatësisht i Tanatosit. Termi mortido u përdor nga psikanalisti P. Federn. Sot ka përdorim të rrallë.

MOSBESIM, - I. m. Humbja e besimit të njeriut në vërtetësinë e një mendimi të caktuar, në angazhimin e dikujt tjetër në një punë të caktuar, në autoritetin e dikujt etj. Mosbesimi në kushte të veçanta merr përmasa të një qëndrimi, që ushtron ndikim në mendimin, veprimin, punën etj. të njeriut.

MOSBINDJE, - A. f. Mungesa e bindjes së një individi në arsyet e dhëna për një dukuri, gjendje, proces, apo veprim etj. Mosbindja shkaktohet nga arsyet e pamjaftueshme, nga arsyet kundërthënëse etj.

MOSDASHJ/E, - A. f. Mungesa e gatishmërisë së njeriut për të realizuar përcaktimin, qëndrimin, synimin etj. të tij, me gjithë qartësinë e mendimit, të qëllimit, rrugëve dhe të mjeteve të realizimit të tyre.

MOSINTERESIM, - I. m. Mungesë e angazhimit psikik të një individi ndaj objekteve, të cilët dikur shkaktonin drejtim dhe përqendrim të vëmendjes dhe angazhim të proceseve e veprimeve të tjera psikike.

MOSKUPTIM, - I. m. Mungesa e aftësisë dhe e dëshirës së njeriut për të kuptuar tërësinë e raporteve themelore të një çështjeje, të një problemi ekonomik, social, familjar etj.

MOSNJOHJ/E, - A. f. Mungesa e njohurive dhe informacioneve të një individi për çështjen, problemin, fushëveprimin etj., që shfaqet në reagimin e papërshtatshëm të tij ndaj këtyre elementeve.

MOSPËRPUTHJA KOGNITIVE. Procesi mendor dhe sjellja e lidhur me të, e përshtatur, e modifikuar, atëherë kur njeriu përballet me një konflikt. Mospërputhja kognitive është term i psikologjisë sociale, të cilin e ka përdorur psikologu social nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës Leon Festinger

(Leon Festinger (1919 – 1989). Shih – ***DISONANCA KOGNITIVE.***

MOSVEPRIM, - I. m. Mungesa e veprimit konkret me anën e të cilit realizohet dashja, dëshira dhe vendimi i caktuar i njeriut.

MOSHË, - A. f. Koha e kaluar prej lindjes deri në një çast të caktuar të jetë së njeriut. Kjo është mosha kalendarike e njeriut. Mosha kronologjike zakonisht llogaritet ose me vite, ose me vite dhe me muaj. Përjashtim nga kjo mënyrë llogaritjeje bëjnë foshnjat deri në moshën njëvjeçare, mosha e të cilave llogaritet me muaj. Me këtë rast duhet pasur ndër mend se jeta e njeriut fillon me fekondimin e qelizës femërore, prandaj edhe mosha e jetës së tij është nëntë muaj më e gjatë nga dita e lindjes. Emërtimi i saktë i moshës së njeriut bëhet duke vënë vitin dhe muajin e moshës së tij. Megjithëkëtë, sipas marrëveshjes së përgjithshme mosha e njeriut llogaritet prej ditës së lindjes deri në ditën, muajin dhe vitin e caktuar, përkatësisht nga muaji i lindjes në një vit të caktuar deri në muajin dhe vitin e caktuar. Kështu mosha e X. Y. është dhjetë vjet e tetë muaj dhe kjo shkruhet 10, 8.

MOSHA E FËMIJËRISË. Faza e zhvillimit të individit prej lindjes deri në moshën 14-vjeçare. Zhvillimi fizik e psikik i individit të kësaj moshe ka karakteristika të veçanta. Shih – ***FËMIJËRIA.***

MOSHA E PJEKURISË. Faza më e gjatë e jetës së njeriut. Kjo fazë e zhvillimit fillon nga mosha 21 vjeç dhe përfundon në moshën 60-vjeçare. Në këtë fazë, zhvillimi fizik arrin kulmin e vet. Pas moshës 30-vjeçare fillon dobësimi i funksionimit të disa organeve, sidomos i shqisës së të parit e të dëgjuarit, fillojnë të shfaqen disa pengesa në funksionimin e disa organeve dhe sistemeve të organeve të brendshme të trupit të njeriut. Faza e pjekurisë është faza më produktive e jetës së njeriut. Interesat janë të lidhura kryesisht me një lloj të veprimtarisë, kurse qëndrimet marrin formën e stabilizimit të tyre. Në këtë fazë bëhen ndryshime në tiparet e personalitetit.

MOSHA E PLEQËRISË. Faza e fundit e jetës së njeriut. Faza e pleqërisë fillon nga mosha 61-vjeçare. Gjatë kësaj faze intensifikohet dobësimi i organeve, i sistemit dhe i funksionimit të tyre (sistemi i organeve të frymëmarrjes, i tretjes së ushqimeve, i shqisave, i jashtëqitjes etj.). Strukturat kognitive (kujtesa, mendimi e të folurit) pësojnë ndryshime negative. Procesi i të menduarit dhe inteligjenca e njeriut të kësaj moshe funksionojnë me pengesa. Shih – ***PERIODIZIMI I ZHVILLIMIT FIZIK E PSIKIK.***

MOSHA E RINISË. Faza e zhvillimit të një individi prej moshës 14-vjeçare deri kur mbush 20 vjeç. Gjatë viteve të rritjes së individit të kësaj moshe vihet re zhvillimi i shpejtë trupor, rritja e gjatësisë së trupit, pjekuria e organeve seksuale dhe mbyllet procesi i përforcimit kockor të skeletit të njeriut. Lindin interesa dhe qëndrime të reja, zhvillohet vetëdija për vetveten, ndjenja e pavarësisë, formohen disa pikëpamje të përgjithshme shoqërore etj.

MOSHA KALENDARIKE. Mosha kalendarike ose mosha kronologjike e llogaritur me ditë, muaj dhe vite. Në të

folmen popullore mosha kalendarike është koha e vjetërsisë së një individi prej ditës së lindjes deri në një ditë të caktuar të jetës së tij. Megjithëkëtë, jeta e fëmijës fillon zakonisht nëntë muaj para lindjes së tij. Për këtë shkak mosha biologjike e vërtetë e një individi është mosha prej lindjes plus muajt e paralindjes nga data e koncepitimit. Mosha kalendarike kronologjike shënohet me shkurtesën MK.

MOSHA MENDORE. Niveli i arritur i zhvillimit mental ose mendor që matet me testet e inteligjencës. Mosha mentale a mendore shprehet me vite e me muaj dhe matet duke caktuar raportin ndërmjet moshës mendore mesatare të një grupmoshe të caktuar dhe moshës mesatare të individit që i përket grupmoshës së caktuar. Nëse një fëmijë e moshës 9-vjeçare dhe një tjetër e moshës 11-vjeçare kanë arritur moshën mendore të një fëmije 10 vjeç, atëherë fëmija nëntë vjeç është mendërisht i zhvilluar një vit më shumë, kurse i dyti ka zhvillim të nivelit mendor prej një viti më të vogël se mosha kalendarike e tij. Moshën mendore e ka futur në terminologjinë e psikologjisë psikologu francez Alfred Bine (Alfred Binet, 1857 – 1911). Mosha Mendore shënohet me shkurtesën MM.

MOSHIZ/ËM, - MI. m. Emërtim përmbledhës i individëve që kanë hyrë në moshën e pleqërisë. Moshizmi është dukuri sociale, ekonomike dhe psikologjike me përmasa gjithnjë e më të mëdha në zhvillimet bashkëkohore, ku po shtohet vazhdimisht numri i pleqve. Ky shtim i tyre është pasojë e disa faktorëve, ndër të cilët dallohen: plakja gjithnjë e më e madhe e popullsisë së të moshuarve, izolimi i pleqve etj. Për jetën dhe sjelljet e tyre ka edhe disa paragjykime, si: të moshuarit janë të varur nga të tjerët në aspektin psikologjik e social, të moshuarit kanë qëndrime të forta e të ngurtësuara që shpesh nuk përputhen me qëndrimet e shoqërisë bashkëkohore, pleqtë janë vetëm marrës nga mjedisi ekonomik e social dhe jo dhënës etj. Ka angazhime serioze në fushën e hulumtimeve psikologjike të pleqërisë dhe të shfrytëzimit të përvojave dhe të thellësisë së proceseve kognitive, sidomos të mendimit, në zgjidhjen e situatave problemore të ndërlikuara (kujtesa pëson ndryshime negative të mëdha).

MOTIV, - I. m. Në terminologjinë e psikologjisë i ardhur nga latinishtja *movere* "lëviz". Motivi është nevojë e shoqëruar me dëshirën e njeriut dhe me synimin për të arritur një qëllim me veprimtarinë e tij. Gjendja e shqetësuar e organizmit të njeriut që nxit nga brenda një aktivitet të caktuar dhe e drejton njeriun drejt një qëllimi apo objektivi, shkakton organizimin e veprimtarisë dhe kontrollin e saj drejt këtij qëllimi apo objektivi të caktuar. Motivet kanë këto veçori themelore: përjetim të vetëdijshëm të gjendjes së shqetësuar të organizmit nga nevoja e zhvillimeve organike e psikike të tij, përcaktim mendor a përfytyrim të objektit, prirje për arritjen e atij objekti me të cilin ai plotëson nevojën, dëshirën dhe e qetëson organizmin. Motivet gati përherë janë të ndërlidhura me emocione. Megjithëkëtë ekziston dallimi ndërmjet motiveve dhe emocioneve, madje ka emocione që nuk janë të lidhura me aktivitete (ndjenjat estetike). Termi motiv mbulon disa kuptime të

energjisë dinamike-nxitëse të brendshme biologjike e psikologjike që e vënë organizmin e njeriut në një aktivitet të caktuar. Format e energjisë së brendshme dinamike emërtohen me disa terma, si: dëshirë, epsh, impuls, nevojë, synim, instinkt, shtytje, prirje, por secili prej këtyre termave ka kuptim të veçantë në psikologji.

MOTIVACION, - I. m. Term përmbledhës me kuptim të ndërlikuar psikik për fuqitë e brendshme që vënë në lëvizje, drejtojnë, organizojnë dhe kontrollojnë veprimet e njeriut kah qëllimit ose objektivit të caktuar dhe përfshirja e tij për plotësimin e motiveve të ndryshme. Kuptimi i termit motivacion shtrihet në të gjithë sistemin rregullator të veprimtarisë së njeriut, duke përfshirë motivacionin e vetëdijshëm dhe atë të pavetëdijshëm.

Burimet:

Kurt Lewin: *"A dynamic Theroy of Personality. Selected Papers"* – (*"Teoria dinamike e personalitetit. Shënime të përzgjedhura"*), New York: McGraw – Hill, 1935.

Herbert Marcuse: *"Triebstruktur und Gesellschaft"* – (*"Struktura e shtytësve dhe shoqëria"*), Frankfurt, 1965.

John W. Atkinson, Birch David: "*The Dynamics of Action" – ("Dinamika e aktivitetit"*), New York: Wiley, 1970.

Alfred Lorenzer: *"Zur Begründung Einer Materialistischen Sozialsationstheorie"* – (*"Themelet e një teorie materiastike të socializimit"*), Buhrkamp Verlag 1972.

Robert J. Havighurst: *"Developmental Tasks and Education"* – (*"Misioni i zhvillimit dhe edukata"*), (3. Aufl.). New York: McKay, 1974.

Phil Evans: *"Motivation"* – (*"Motivimi"*), Methuen & Co LTD. London, 1975.

Abraham H. Maslow: *"Motivation and Personality"* – (*"Motivimi dhe personaliteti"*), Haper & Row, New York, 1976.

Robert Serpell: *"Culture`s influence on behavior"* – (*"Ndikimi i kulturës në sjellje"*), Methuen, London, 1976.

Julius Kuhl: *"Motivation, Konphlict und Handlungskontrolle"* – (*"Motivacioni, konflikti dhe kontrolli i veprimeve"*), Berlin: Springer, 1983.

David C. McClelland: *"Human Motivation"* – (*"Motivimi njerëzor*"), Cambridge, MA: Cambridge University Press, 1987.

Abraham H. Maslow: *"Drejt psikologjisë së qenies"* (përkthim nga anglishtja), Plejad, Tiranë, 2008.

Zenel Orhani: "*Motivacioni – Trajtesë psikologjike*", Botime "Vllamasi", Tiranë, 2011.

MOTIVACIONI EKSTRINSEK. Nxitja e aktivitetit të njeriut nga faktorët e jashtëm, përkatësisht nga nxitësit e jashtëm tërheqës për të; faktorë ose nxitës të jashtëm mund të jenë falënderimet, gara, ndëshkimi, shpërblimi etj. (kur nxënësi mëson për notë e jo i shtyrë nga interesimi i tij, atëherë pohojmë se kemi të bëjmë me motivacion të jashtëm të tij). Ky lloj motivacioni është i njohur edhe me termin motivacioni ekstrinsek.

MOTIVACIONI I BRENDSHËM. Shih – ***MOTIVACIONI INTRINSEK.***

MOTIVACIONI I JASHTËM. Shih – ***MOTIVACIONI EKSTRINSEK.***

MOTIVACIONI I PAVETËDIJSHËM. Forma të sjelljeve të njeriut për të cilat ai në çaste të caktuara nuk është i vetëdijshëm për dëshirat, synimet e prirjet e tij, si edhe për ato pasoja të sjelljeve të tij që nuk është në gjendje t`i parashikojë dhe t`i kontrollojë. Frojdi ka një kontribut të madh në trajtimin e motiveve të pavetëdijshme.

MOTIVACIONI INTRINSEK. Gjendje psikike e energjizuar dhe e drejtuar në objekte e qëllime, me

marrjen e të cilave zhvillohen procese fiziologjike dhe psikologjike për ta ndryshuar pozitivisht një gjendje të tillë. Kuptimi i ngushtë i termit motivacion intrinsek ka të bëjë me lindjen e nevojave të brendshme të njeriut dhe plotësimin tyre, duke përjetuar kënaqësi për aktivitetin e zhvilluar në drejtim të plotësimit të tyre.

MOTIVET ANTISOCIALE. Motivet, nxitësit e brendshëm të sjelljeve të njeriut të drejtuara dhe të organizuara kundër të tjerëve, kundër vlerave shoqërore të një mjedisi dhe, mbi këtë bazë, kundër bashkëpunimit me të tjerët, kundër raporteve pozitive me të tjerët. Motive antisocialë janë: motivi i agresivitetit, i egoizmit, i dominimit mbi të tjerët etj.

MOTIVET BIOLOGJIKE. Motivet elementare dhe kryesore për zhvillimin e jetës dhe të proceseve fiziologjike të organizmit të njeriut. Motive biologjike janë: motivi i etjes, i urisë, shtytja seksuale, motiv prindëror ose amnor, nevoja për oksigjen, për mbajtje të temperaturës së trupit në shkallën e duhur për organizëm, për ikje nga dhembjet, për pushim, gjumë dhe për zhvillim të aktivitetit të organizmit. Në grupin e motiveve biologjike hyjnë nevojat dhe shtytësit, plotësimi i tyre është i domosdoshëm. Ky grup motivesh ka tri karakteristika kryesore janë të lindur, shfaqen menjëherë pas lindjes dhe kanë karakter universal, përkatësisht paraqiten te të gjitha qeniet njerëzore.

MOTIVET E EKZISTENCËS. Grup i përgjithshëm i motiveve biologjike që kanë të përbashkët qëllimin e mënjanimit të të gjitha pengesave që rrezikojnë ekzistencën e njeriut. Motivet e ekzistencës kanë të bëjnë me plotësimin e nevojave biologjike për jetën e njeriut dhe janë drejtuar në ato objektiva që mundësojnë zhvillimin normal të jetës dhe të veprimtarisë. Të tillë janë motivet: uria – ushqimi, etja – uji, rraskapitja e organizmit nga puna – pushimi etj.

MOTIVET E SIGURIMIT. Klasë e madhe e motiveve e drejtuar në ruajtjen dhe krijimin e një mjedisi e situate me nivel të lartë të sigurisë për jetën, reduktimin e rreziqeve në minimumin e mundshëm, ikjen nga rreziqet për jetën me çdo kusht, zhvillimin e marrëdhënieve sa më të shëndosha me të tjerët, formimin e bindjes për sigurinë e jetës dhe zhvillimin normal fizik, psikik e moral të vetvetes etj. Shumë studiues motivet e sigurisë i kategorizojnë në motive biologjike.

MOTIVET FIZIOLOGJIKE. Motive që lindin në bazë të disa ndryshimeve në organizëm dhe që mbështeten në nevojën e indeve për lëndë ushqyese, për ujë, për largim nga ngacmuesit e rrezikshëm për organizmin etj. Në literaturën e psikologjisë motivet fiziologjike emërtohen edhe me termin motive biologjike.

MOTIVET HOMEOSTAZIKE. Fazat e ciklit motivues janë: paraqitja e nevojës (mungesë ose tepri e disa lëndëve të nevojshme për organizmin), e shoqëruar me tensionim të organizmit dhe me paraqitjen e përfytyrimit të qëllimit. Kjo fazë e motivacionit vë në gatishmëri lëvizëse organizmin e njeriut, aktivizimin e organizmit drejt qëllimit, arritjen e qëllimit me të cilin plotësohet nevoja, vënien e

drejtpeshimit veprues të organizmit, qetësimin e njeriut dhe kthimin e tij në gjendjen para ciklit motivues. Një gjendje e tillë është e përkohshme, sepse pas pak kohe lënda organike (ushqimi, uji, pushimi etj.) harxhohet, e për pasojë pushimi ndërpritet. Lënda e harxhuar e çrregullon përsëri funksionimin e baraspeshuar të proceseve organike dhe cikli motivues shfaqet rishtas.



MOTIVET ORGANIKE. Motive biologjike (uria, etja, pushimi etj.), plotësimi i të cilave është i domosdoshëm për jetën dhe ekzistencën e organizmit të njeriut.

MOTIVET SOCIALE. Motive të mësuara dhe të fituara gjatë jetës dhe aktivitetit të njeriut. Motive të këtilla janë motivi i shoqërizimit me të tjerët, i stilit të sjelljes me të tjerët, i afirmimit, i arritjes së shkallës sa më të lartë në hierarkinë shoqërore të njeriut në mjedisin social të tij etj.

MOTIVET THEMELORE. Motivet biologjike e fiziologjike, si: motivi i etjes, motivi seksual, motivi i urisë etj. Secili nga këto motive është i lidhur drejtpërdrejt me ndryshimet fiziologjike të organizmit. Shih – ***MOTIVET.***

MOTIVI AFILATIV. Motiv i posaçëm shoqëror që manifestohet në prirjen e qëndrueshme të njeriut për të qenë me të tjerët, për t`u shoqëruar dhe lidhur me anëtarët e tjerë të shoqërisë. Kjo prirje e zhvilluar edhe nga nevoja e të vegjëlve për t`u mbrojtur, për t`u zhvilluar nga të tjerët, shndërrohet në motiv dhe manifestohet në situata të pasigurta, të vetmisë, të rrezikshme dhe që shkaktojnë frikë. Zhvillimi aktivitetit i shtyrë nga motivi afilativ, përkatësisht nga prania e të tjerëve në situata të caktuara, zvogëlon frikën, përforcon njohjen e situatës dhe të pasojave të saj, kontribuon në sqarimin e situatave etj., duke u mbështetur në reagimet dhe në sjelljet e të tjerëve. Këtë e kanë përjetuar shumë persona në burgje izoluese (në qeli të vetmuara), në ndonjë bregdet të panjohur etj.

MOTIVI I ARRITJEVE. Dëshira me synimin për të arritur suksese sa më cilësore dhe të larta, që meritojnë admirim, nderim e respekt. Angazhimi i intensitetit të lartë për të arritur rezultate të larta, rezultate mbi standardet e caktuara përjetohet me kënaqësi të madhe nga ana e individit, siç përjetohet me pakënaqësi të madhe mossuksesi në një fushë veprimi të caktuar. Motivi i arritjeve i përket grupit të motiveve sociale.

MOTIVI I DEFICIENCËS. Nevoja e vetëdijshme e njeriut për largimin e ngacmuesve të dëmshëm për jetën dhe zhvillimin e njeriut, ikja nga rreziqet etj. Motivi i deficiencës dallohet vështirë nga motivet e sigurimit dhe të ekzistencës. Motivet e deficiencës në teorinë e motivacionit të psikologut amerikan Abraham Maslou (Abraham H. Maslow, 1908 – 1970) i përkasin nevojave elementare ose themelore të njeriut, nevojave fiziologjike, nevojës për siguri, dashuri, nderim dhe për famë. Këto nevoja janë kryesisht të

pavetëdijshme dhe kërkojnë plotësimin automatik të tyre.

MOTIVI I PASURIMIT. Dëshira e madhe për pasuri lëndore dhe shpirtërore, për arritje të nivelit sa më të lartë, për falënderime e mirënjohje sa më të shumta dhe sa më të larta, për krijimtari dhe zbulime të reja etj. Sipas teorisë së motivacionit të Abraham H. Maslout këto motive janë metamotive, ku bëjnë pjesë: motivi i të njohurit të së resë dhe i kuptimit të saj, nevoja për drejtësi, për bukuri, për mirësi dhe nevoja për vetaktualizim.

MOTIVIM, - I. m. Gjallërim i motiveve, shtim i intensitetit të tyre nga ndikimi që ushtrojnë të tjerët me anën e nxitësve të ndryshëm. Në kuptimin e ngushtë motivimi është vënia e organizmit të njeriut në gjendje motivuese, në gjendje gatishmërie për aktivitet**.**

MOTONEURON, - I. m. Emërtimi i qelizës nervore, e cila me degët e saj është e lidhur me muskujt e organizmit dhe i vë në veprim këta muskuj. Motoneuronet janë dy farësh: alfa dhe gama motoneuron. Alfa motoneuronet janë qelizat e mëdha nervore që trupin e tyre e kanë të shtrirë në brirët e palcës kurrizore dhe me degët e saj bartin ngacmimet në muskujt skeletorë. Gama motoneuroni është qeliza nervore, që e ka trupin e saj në masën e përhimët të palcës kurrizore, kurse fijezat e saj janë pjesë të muskujve të lidhur dhe të receptorëve muskulorë. Gama motoneuroni luan rol të rëndësishëm në rregullimin e koordinimit dhe të shpejtësisë, si edhe të ritmit të lëvizjeve.

MOTORIK/Ë, - A. f. Term me përdorim relativisht të madh në disa fusha, duke përfshirë edhe disiplinën e psikologjisë, i ardhur nga latinishtja *motorius* "i lëvizshëm". Motorika është term përmbledhës për të gjitha format e lëvizjeve të njeriut dhe organeve të trupit të tij (të gjymtyrëve, të kokës dhe të gjithë trupit të njeriut). Motorika emërton lëvizjet e thjeshta, ashtu edhe lëvizjet e ndërlikuara dhe të organizuara në njësi të veçanta (shprehitë e shkathtësitë). Në këtë shtrirje kuptimore të gjerë motorika përfshin të ecurit, vrapimin, kërcimin, notimin, ngjitjen e shkallëve dhe zbritjen e tyre) dhe manipulimin ose përdorimin e duarve dhe të gishtërinjve për kapje objektesh, lëvizje të tyre, ndryshim të pozitës, të formës, të lidhjeve etj. të objekteve të ndryshme.

MPIRJE EMOCIONALE. Paaftësi për të përjetuar gjendje normale të emocioneve. Zakonisht shfaqet me pakësim të interesit për të marrë pjesë në aktivitete sociale dhe ikje nga marrëdhënia me të tjerët.

MPREHTË (I, E). mb. që ka ndjeshmëri të lartë, mendim, ndijim, objekt etj. që ka qartësi të madhe. E mprehtë mund të jetë dhembja, gjykimi etj. Dhembja e mprehtë është dhembje e një organi me intensitet të lartë dhe me zgjatje kohore të shkurtër që paraqitet në intervale të ndryshme kohore dhe shkaktohet nga faktorët e ndryshëm. Gjykim i mprehtë është gjykim i qëlluar plotësisht që parashtrohet dhe shfaqet nga njeriu mendjemprehtë.

MPREHTËSI, - A. f. Aftësia e dallimit të hollësive e të imtësive të një fushe perceptive. Në këtë kuptim mprehtësia zakonisht ka të bëjë me

aftësinë perceptuese të shqisave. Një individ me mprehtësi shqisore tepër të lartë është në gjendje të ketë ndjesi për ngacmuesit me intensitet shumë të ulët dhe me kohëzgjatje të shkurtër. Aftësitë e tilla psikofizika klasike i ka emërtuar me termin mprehtësi shqisore ose sensorike. Kjo ka të bëjë radhë të parë me shqisën e të parit dhe me atë të dëgjimit, si edhe dhe me shqisën e të prekurit ("thupër e thepisur si maja e thikës"):

a. **Mprehtësia e të parit** – Pika më e ulët e ndjeshmërisë pamore të cilësisë së strukturave, nën të cilën cilësia pamore nuk ka mundësi të përjetohet si ndijim i atij ngacmuesi pamor; mprehtësia e tillë përcaktohet objektivisht me anën e këndit më të të ngushtë ku një strukturë pamore dallohet nga tjetra. Kjo është struktura prej rreth 1,5 mm e parë nga largësia prej 5 metrash.

b. **Mprehtësia e dëgjimit** – Aftësia e dallimit të tingujve me intensitet shumë të ulët, që kapen nga ana e shqisës së dëgjimit në kuadrin e pragut absolut të ndjeshmërisë. Herë-herë mprehtësia e dëgjimit përdoret në vend të pragut absolut të ndjeshmërisë së tingujve. Por, me mprehtësi të dëgjimit kuptohet edhe aftësia e dallimit të ngacmuesve tingullorë me dendësi të ndryshme valësh ajrore (veshi i njeriut e ka të zhvilluar në nivelin më të lartë ndjeshmërinë e tingujve që sillen prej 1000 deri në 5000 Hz).

MUND, - I. m. Përjetim i lodhjes i shoqëruar me pakënaqësi, me neveri dhe me rënie të shkallës së durimit nga ana e një individi të caktuar. Mundi shkaktohet nga angazhimi i gjatë kohor i njeriut në punë të rendë fizike dhe mendore, nga ndërlikueshmëria e detyrës që duhet kryer, nga angazhimi në realizimin e saj, sikurse edhe nga qëllimi i largët dhe intensifikimi i angazhimit për ta arritur këtë. Mundi i njeriut ka përmasa të theksuara subjektive.

MUSKUJT BOSHTORË. Muskuj të ndërlikuar që përbëjnë receptorin e muskujve. Këta receptorë bartin impulse muskulore (shtrirjen dhe mbledhjen e muskujve) deri në trurin e mesëm, në palcën kurrizore dhe në trurin e vogël. Impulset nervore të këtyre pjesëve të trurit ndikojnë në ndryshimin e shkallës së ndjeshmërisë. Në këtë proces rol të rëndësishëm luajnë gama motoneuronet, duke rregulluar procesin e lëvizjes të gjymtyrëve dhe të pjesëve të tjera të trupit.

MUSKUJT SKELETORË. Strukturë organike e trupit e përbërë nga qelizat e zgjatura që mund të mblidhen dhe të zgjaten. Muskujt skeletorë janë të mbështetur për skelet dhe mundësojnë lëvizjen e pjesëve të veçanta të trupit. Në këta muskuj përfundojnë fijezat e trupit të qelizave nervore. Kur impulset nervore arrijnë në këta muskuj aty lind fuqia vepruese e muskujve. Kjo fuqi shkakton shtrirjen dhe mbledhjen e muskujve, e pikërisht kontraktimin e tyre. Kontraktimi mund të jetë dyfarësh: 1) Izometrik – kontraktim me fryrje muskujsh, me tonus të zmadhuar, duke mos ndryshuar gjatësia e tyre dhe 2) Izotonik – kontraktimi zvogëlohet, por nuk ndryshon tonusi. Falë këtij raporti zhvillohen lëvizjet e pjesëve të ndryshme të trupit të njeriut. Shih – ***MUSKULI.***

MUSKUL, - I. m. I ardhur nga latinishtja *musculus*. Në anatomi muskuli

është organ indesh elastike që formohet nga një lloj i posaçëm i qelizave të përzgjatura, që funksionojnë si tërësi dhe kryejnë funksionin e shtrirjes dhe të mbledhjes së tyre, duke mundësuar në këtë mënyrë lëvizjen e organeve të trupit të njeriut. Dallohen disa lloje muskujsh:

a. **Muskuli agonist** – Muskul që së bashku me muskujt e tjerë që veprojnë në eshtra të njëjta shkaktojnë lëvizje;
b. **Muskuli antagonist** – Muskul që përfshihet në ekzekutimin e atyre veprimeve që pengojnë lëvizjen**;**
c. **Muskuli fleksor** – Muskul mbledhës që shkakton fleksion të duarve dhe të këmbëve;
d. **Muskuli ekstensor** – Muskul shtrirës që mundëson shtrirjen e duarve dhe të këmbëve;
e. **Muskujt skeletorë** – Muskuj që mundësojnë lëvizjen e pjesëve të veçanta të trupit të njeriut; muskujt skeletorë mblidhen dhe shtrihen shpejt. Në muskujt skeletorë përfundojnë fijezat fundore të qelizave të strukturës trupore të trurit**;**
f. **Muskujt e lëmuar** – Muskuj të posaçëm që ndërtojnë organet e brendshme të trupit, enët e gjakut, muskujt e organeve mbyllës etj. Muskujt e lëmuar kanë shtrirje dhe mbledhje të ngadalshme; në muskujt e lëmuar përfundojnë fijezat e qelizave të sistemit nervor vegjetativ;
g. **Muskuli i zemrës** – Muskul i veçantë që gjendet vetëm në zemër. Muskuli i zemrës është i ngjashëm me muskujt e lëmuar, por mblidhet dhe shtrihet me ritëm të shpejtë. Në muskulin e zemrës përfundojnë fijezat nervore të qelizave të sistemit nervor vegjetativ.

MUTACION, - I. m. Në gjenetikë i ardhur nga latinishtja *mutation* "ndryshim". Mutacioni është ndryshim i hovshëm dhe befasues në strukturën dhe në cilësitë e lëndës gjenetike të organizmit (ndryshim në gjene dhe në kromozome) që bartet nga një brez në brezin tjetër. Ndryshimet e tilla mund të jenë spontane dhe të induktuara, përkatësisht të shkaktuara në mënyrë artificiale. Mutacioni konsiderohet se është faktor i rëndësishëm i zhvillimit të qenieve të gjalla.

MUTACIONI I ZËRIT. Ndryshim i zërit të të folurit të atyre që kalojnë nga faza e parapubertetit në fazën e paspubertetit. Në këtë fazë zëri i të folurit të meshkujve ndryshon zakonisht nga soprani në bas. Ky ndryshim i zërit karakterizon më tepër meshkujt, kurse te femrat është më pak i dallueshëm.

MUTIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga latinishtja *mutismus*. Në psikopatologji është çrregullim psikogjen i komunikimit me të tjerët, çrregullim i të folurit, ndonëse organet e të folurit dhe qendrat trunore të të folurit, si edhe ndërlidhja e tyre, nuk janë të dëmtuara. Mund të jetë pasojë e depresionit ose e qëndrimit indiferent të individit ndaj mjedisit, ndryshimeve dhe kërkesave të tij. Mutizmi shfaqet më tepër te fëmijët që refuzojnë të flasin nga negativizmi ose nga një faktor tjetër. Mutizmi i fëmijëve ka zgjatje kohore të kufizuar, përkatësisht mund të zgjasë disa javë, rrallë disa muaj. Mutizmi kur është pasojë e negativizmit fëmijëror mund të zbutet dhe të eliminohet me anë të zbatimit të metodave psikoterapeutike. Zakonisht shfaqet te

ata fëmijë që kanë pasur mbrojtje të pamjaftueshme nga prindërit dhe kanë përjetuar trauma emocionale.

MYLER Johanes Peter (MÜLLER Johannes Peter). Fiziolog gjerman, një ndër themeluesit e fiziologjisë eksperimentale. Lindi më 1801 dhe vdiq më 1858. Profesor i fiziologjisë në Universitetin e Bonit më 1826, më pas profesor në Universitetin e Berlinit më 1833. Theksohen punimet e tij në fushën e shqisave, të trurit, të gjëndrave me sekretim të brendshëm dhe të anatomisë e embriologjisë krahasuese. Në psikologji, e konkretisht në psikologjinë fiziologjike është i njohur kryesisht me teorinë e energjisë specifike të shqisave, me ligjin e energjisë specifike të nervave të shqisave. Sipas kësaj teorie "secila shqisë është në gjendje të prodhojë ndijim përkatës, pavarësisht nga lloji i ngacmuesit të saj". Bartës i këtij ndijimi është energjia specifike e nervave të asaj shqise. Me këtë qëndrim Myler Johanes hyri në qarkun e metafizikantëve, duke besuar në fuqitë trupore, përkatësisht në fakultetet trupore. Kjo teori sot i përket të kaluarës; rrallë haset në shkrimet fiziologjike dhe në shkrimet psikofizike e psikofiziologjike. Vepra kryesore e tij është: *"Handbuch der Physiologie des Menschen"* – (*"Doracak për Fiziologjinë e njeriut"*), 1833 – 1840.

MYNSTERBERG Hugo (Hugo MÜNSTERBERG). Psikolog amerikan me origjinë gjermane. Lindi më 1863 dhe vdiq më 1916. Pas përfundimit të studimeve për mjekësi, filozofi dhe psikologji në Gjenevë dhe në Hajdelberg u doktorua në Lajpcig pranë Vilhelm Vuntit më 1885. Dy vjet më pas, më 1887 u doktorua edhe në mjekësi në Universitetin e Friburgut. Profesor në Universitetin e Harvardit. Më 1892 iu përgjigj pozitivisht ftesës së Uiliam Xhejmsit dhe filloi punë në Universitetin e Harvardit, ku themeloi laboratorin psikologjik më 1897. U angazhua posaçërisht në gjurmimin e kuptimit të vlerave, të qëllimeve dhe të normave të sjelljeve të njeriut. Në këtë fushë u dallua me pikëpamjen e tij të shkrirjes së mendimeve filozofike të Fihtes në arritjet psikologjike. Veprimtaria e tij psikologjike ka ushtruar ndikim në zhvillimin e psikologjisë zbatuese, sidomos në zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës. Në disiplinat e psikologjisë zbatuese konceptoi metodat dhe procedurat psikologjike. Me emrin e tij janë të lidhur disa koncepte me termat e tyre të psikologjisë zbatuese. Ndër këto koncepte dhe terma dallohet ai i psikoteknikës. Po ashtu hartoi testin për përzgjedhjen e profesioneve dhe të personelit profesional. Qe i angazhuar në çështjet e zhvillimit të psikoterapisë. Veprat kryesore të tij janë: "*Psychology and Crime*" – ("*Psikologjia dhe krimi*"), 1908; *"Psikotherapy"* – (*"Psikoterapia"*), 1909; *"Grundzuge der Psychologie"* – (*"Bazat e psikologjisë"*), 1910; *"Psychologie und Wirtschaftsleben"* – (*"Psikologjia dhe jeta ekonomike"*), 1912; "*Psychology: general and applied"* – (*"Psikologjia: e përgjithshmja dhe zbatuesja"*), 1914.